



**KONTROLI I LARTË I SHTETIT**

**Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Drejtorinë e Tatimpaguesve të Mëdhenj**

# **RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI**

**Mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së  
Drejtorisë së Tatimpaguesve të Mëdhenj**

**Tiranë, Tetor 2023**

<b>Nr.</b>	<b>PËRMBAJTJE</b>	<b>Faqe</b>
<b>I.</b>	<b>PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE</b>	<b>3</b>
1	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	3
2	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	3
3	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit	8
<b>II.</b>	<b>HYRJA</b>	<b>10</b>
1	Objekti i auditimit	10
2	Qëllimi i auditimit	11
3	Identifikimi çështjes	11
4	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	11
5	Përgjegjësitë e audituesve	12
6	Kriteret e vlerësimit	12
7	Standardet e auditimit	13
8	Metodat e auditimit	13
9	Dokumentimi i auditimit	13
<b>III.</b>	<b>PËRSHKRIMI I AUDITIMIT</b>	<b>14</b>
1	<b>Informacion i përgjithshëm mbi subjektin</b>	<b>14</b>
2	<b>Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit</b>	<b>15</b>
2.1	Programimi i të ardhurave tatimore dhe kontributeve, realizimi i tyre, ndarë sipas strukturës përkatëse për periudhën objekt auditimi. Mbi vlerësimin e përputhshmërisë ligjore të veprimtarisë së Drejtorisë së Analizës, Riskut dhe Kontabilitetit të të Ardhurave	15
2.2	Mbi vlerësimin e përputhshmërisë ligjore të veprimtarisë së Drejtorisë së Kontrollit Tatimor	44
	-Sektori i Kontrollit në Vend	44
	-Sektori i Kontrollit nga Zyra	314
2.3	Mbi vlerësimin e përputhshmërisë ligjore të veprimtarisë së Drejtorisë së Shërbimeve të Tatimpaguesve	340
2.4	Mbi vlerësimin e përputhshmërisë ligjore të veprimtarisë së Drejtorisë së Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara	350
2.5	Mbi përputhshmërisë dhe rregullshmërinë në ekzekutimin e buxhetit vjetor, për periudhën në auditim	367
2.6	Çështje të tjera që dalin gjatë auditimit	373
<b>IV</b>	<b>GJETJET DHE REKOMANDIMET</b>	<b>410</b>

## I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

### I.1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Mbi organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, si dhe bazuar në Programin e Auditimit nr. 14/1, datë 09.01.2023, i ndryshuar, të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, Kontrolli i Lartë i Shtetit auditori Drejtorinë e Tatimpaguesve të Mëdhenj. Auditimi ka përfshirë realizimin e të ardhurave tatimore, zbatimin e procedurave të kontrollit tatimor nga ana e Sektorit të Kontrollit Tatimor në Vend; Sektorit të Kontrollit nga Zyra; Sektorit të Shërbimit ndaj Tatimpaguesve; Drejtorisë së Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore, etj. Në përfundim të auditimit, grupi i auditimit hartoi Projekt Raportin e Auditimit, bazuar në Letrat e punës, Akt Konstatimet, vërejtjet e bëra nga DTM, sipas drejtimeve të auditimit të përcaktuara në Programin e Auditimit. Projekt Raporti i Auditimit u dërgua në DTM me shkresën nr. 14/9 prot në KLSH, datë 04.08.2023, njohja e të cilit është konfirmuar nga subjekti i audituar, me shkresën përcjellëse nr. 52/28 prot., datë 11.09.2023, protokolluar në KLSH me nr. 14/11, prot., datë 12.09.2023. Mbi këtë bazë është hartuar Raporti Përfundimtar i Auditimit. Nga auditimi ka rezultuar se raportet e kontrolleve tatimore kanë rezultuar me problematika në aspektin procedural dhe në saktësinë e arkëtimit të të ardhurave tatimore në buxhetin e shtetit. Gjithashtu janë konstatuar mangësi në procedurat e ndjekura për vjeljen e detyrimeve të papaguara, monitorimit të të ardhurave tatimore, përzgjedhjen e subjekteve objekt kontrolli në vend, etj.

### I.2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

Gjetja nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referenca me Raportin Përfundimtar	Rëndësia	Rekomandimi
1	Nga auditimi konstatohet se për periudhën objekt auditimi nuk është realizuar detyrimi për kryerjen e propozimeve për kontroll të tatimpaguesve të vlerësuar me risk të lartë në raportin 50% me 50% të rasteve (pra 50% të kontrolleve propozuar nga DTM dhe 50% nga DPT). Referuar regjistrin të vendosur në dispozicion nga Sektori i Analizës së Riskut, duke kryqëzuar informacionin me subjektet e propozuara për kontroll të plotë pranë DPT konstatohet se për periudhën Korrik-Nëntor 2022, nga totali prej 106 subjektsh të propozuara, rezultojnë se vetëm 15 subjekte (ose 14% e totalit) paraqiten si subjekte me	Drejtimi 2.1	E lartë	Strukturat përgjegjëse pranë DTM dhe DPT të marrin masat për mbulimin me kontroll në vend të propozimeve nga DTM në masën 50% të total kontrolleve të kryera, si dhe garantimin e prioritizimit në përzgjedhje të subjekteve që mbartin realisht risk, dokumentuar kjo në rezultatet e indikatorëve të implementuar në regjistrin e riskut të strukturës përgjegjëse.

	<p>risk sipas regjistrit të riskut të Sektorit të Analizës së Riskut, ndërkohë që 70% e subjekteve të tjera të propozuara për kontroll pranë DPT rezultojnë pa risk (75 subjekte); dhe 15 të tjera (16%) nuk ishin subjekte të analizës së riskut (risk “NA”).</p>			
2	<p>Nga auditimi u konstatua shitja e mallit nafte bruto e kryer nga kompania “B.P” me destinacion jashtë territorit të Shqipërisë është kryer nën çmimin e bursës Brent të publikuar sipas buletinit Platts sipas kushtit FOB të lëvrimit dhe si pasojë se rezultuan diferenca të pagesës së rentës minerare që lidhen me vlerën e mallit “naftë brutto” në deklaratat e eksportit . Vlera e eksportuar e mallit nafte brutto nga shoqëria B. LTD drejt shoqërisë shoqërisë “C.T S.A.U. T.C , P.D.L.C” me seli në Spanje rezulton nën çmimin e publikuar të Naftës Brutto Brent të publikuar nga të dhënat e çmimit PLATTS të nxjerra sipas publikimeve ditore nga komisioni AD-HOC pranë Ministrisë së Financave si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave. Për transaksionet e kryera me procedura eksporti nga territori shqiptar rezulton se çmimi për njësi / fuçi neto është në nivelin 23% deri 33% me uljet se çmimi i publikuar i bursës. Si pasojë janë konstatuar diferenca në pagesën e rentës minerare (taksë kombëtare) dhe në llogaritjen e tatimit fitimit për pjesën e vlerës së shitjeve dhe</p>	2.2	E lartë	<p>Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave për artikullin “Naftë Bruto” me origjinë nga “Prodhimi Vendas Shqipëri” sipas kushtit të lëvrimit FOB, bazuar në faktet dhe provat e trajtuara dhe të paraqitura sa më sipër si dhe në materialin e Projekt Raportit të Auditimit të gjykojë dhe të kërkojë ndjekjen e procedurave për kontabilizimin dhe arkëtimin e detyrimeve të pagesës së rentës minerare të konstatuar si diferenca pagese në shitje malli në procedura eksporti në shumën 131,528,466 leke, dhe bazuar në çmimet e publikuara të bursës Platts të kërkohej pagesa e detyrimeve të tjera tatimore, për vlerën e mallit të shitur të rivlerësuar të ri trajtuar sipas çmimit të bursës brend të rivlerësuar në procedure</p>

	<p>te ardhurave të munguara si pasoje e shitjes se mallit nafte bruto jashtë territorit te RSH nën çmimin e bursës Brend. Bazuar në çmimet e publikuara të bursës Platts u saktësua dhe u trajtua rivlerësimi i pagesës se rentës minerare, për vlerën e mallit të shitur te ri trajtuar sipas çmimit të bursës brend te rivlerësuar ne procedure eksporti ne shumen 1,315,284,657 leke dhe ne frymën e legjislacionit tatimor ne RSH, si dhe rivlerësime te pagës se rentës minerare me një detyrim tatimor te taksës kombëtare te rentës minerare ne shumen 131,528,466 leke.</p>			<p>eksporti ne shumen 1,315,284,657 lekë për te cilat nga DTM duhet te llogariten edhe detyrimet e tatimit mbi te ardhurat e rivlerësuar nga shitja duke marrë konsideratë llojin e aktivitetit, ne përmbushje te përcaktimeve te ligjit Hidrokarbur ne Republikën e Shqipërisë neni 5 dhe 6 ligjit nr. 153/2020.</p>
3	<p>Nga auditimi rezultoi se gjendja e detyrimeve të papaguara në fillim të vitit 2021 paraqitet në vlerën 12,509 milion lekë që i përket një numri prej 271 subjektsh debitore, dhe në fund të vitit 2021 këto detyrime rezultojnë në vlerën 13,209 milion lekë që i përket një numri prej rreth 308 subjektsh debitore. Gjendja e detyrimeve të papaguara në fillim të vitit 2022 paraqitet në vlerën 13,208 milion lekë që i përket një numri prej 308 subjektsh debitore dhe në fund të vitit 2022 këto detyrime rezultojnë në vlerën 12,484 milion lekë që i përket një numri prej rreth 257 subjektsh debitore. Nga auditimi rezulton se nga ana e drejtorisë DMDTP në DTM stoku i detyrimit tatimorë të papaguar i vitit 2021 dhe vitit 2022 nuk është mbuluar me të gjithë masat shtrënguese të</p>	2.4	E lartë	<p>Nga Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të papaguara në DTM të merren masa konkrete në ushtrimin e kompetencave të dhëna sipas legjislacionit në fuqi duke zbatuar mënyrat e vlerësimit të riskut, për të përcaktuar dhe zbatuar, në çdo rast, masën më të përshtatshme të mbledhjes me forcë si edhe duke siguruar mbulimin e borxhit tatimor me të gjithë masat shtrënguese, në mënyrë që të maksimalizohet mbledhja e detyrimeve tatimore të papaguara.</p>

	<p>përcaktuar në Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 , neni 93 “Sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurisë”, neni 97, kreu XI “Masat shtrënguese”. Nga auditimi rezulton se gjatë vitit 2021 nuk është ezauruar në asnjë rast masa “Njoftim transferimi detyrimi tatimor palës së tretë” dhe “Njoftim për transferimin e detyrimit Ortakut, Aksionerit, Administratorit” edhe gjatë vitit 2022 nuk është ezauruar në asnjë rast masa shtrënguese; “Njoftim transferimi detyrimi tatimor palës së tretë në zbatim të nenit 98”, “Njoftim për transferimin e detyrimit Ortakut, Aksionerit, Administratorit” dhe “ Urdhër sekuestrimi”. Mos mbulimi i borxhit tatimor me të gjithë masat shtrënguese, rrit riskun e mos arkëtimit të detyrimeve të papaguara nga subjektet.</p>			
4	<p>Nga auditimi mbi respektimin e kostos minimale fiskale, çmimit dhe fitimit minimal fiskal për efekt të llogaritjes së detyrimeve tatimore në sektorin e ndërtimit është konstatuar se në praktikën e përzgjedhura për kontroll, megjithëse nuk janë respektuar këto norma nga tatimpaguesit sipas pasqyrimit në raportet e kontrollit tatimor, nga inspektorët e kontrollit nuk është kryer vlerësim alternativ sipas kërkesave të Ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, i ndryshuar. Nga DTM është pretenduar nëpërmjet observacioneve se mos kryerja e vlerësimit alternativ është</p>	2.2	E lartë	<p>Nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve të merren masa të menjëhershme për përcaktimin e efekteve të vlerësimeve alternative të munguara me pasojë në të ardhurat tatimore në , si dhe në vijimësi, të ndjekë zbatimin e përcaktimeve ligjore në lidhje me respektimin e kostos minimale fiskale, çmimit minimal fiskal dhe fitimit minimal fiskal në sektorin e ndërtimit.</p>

	<p>bazuar në një shkresë “kthim përgjigje” të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve me nr. 11840/1 prot., datë 19.09.2019 në vijim të kërkesës nr. 307/37 prot., datë 12.06.2019 me lëndën “Kërkesë për interpretim dhe sqarim teknik”. KLSH konstaton se legjislacioni aktual në fushën e ndërtimit e ka të përcaktuar qartë detyrimin për respektimin e kostos minimale fiskale, çmimit minimal fiskal dhe fitimit minimal fiskal sipas përcaktimeve të bëra në nenin 20 “Punimet e ndërtimit, kryerja e procesit të ndërtimit, si dhe të mirëmbajtjes” të udhëzimit nr. 6 datë 30.1.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, i ndryshuar. Pra kjo dispozitë e Udhëzimit të Ministrit të Financave është detyruese për kryerjen e vlerësimeve alternative, për të cilën nga DPT është mbajtur qëndrim jo ligjor dhe në tejkallim të kompetencave dhe detyrave funksionale.</p>			
5	<p>Nga auditimi mbi kontrollin e ushtruar në tatimpaguesit KP T. B.E, A., A., A., B., F. K. C. F., MC. I., E., A. K., N. C, M. K., A.-S. SHPK, I. SHPK, A. A. E. SHA, B. M. T., A., etj janë konstatuar mangësi me efekti financiar të shmangur në shumën totale 2,024,711 mijë lekë.</p>	2.2	E lartë	<p>Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj, referuar mangësive dhe parregullsive në procedurën e kontrollit, vlerësuar me efekte negative në të ardhurat tatimore, në përputhje me kërkesat ligjore dhe procedurale, të kryejë rikontroll tatimor me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit të</p>

				evidentuara.
--	--	--	--	--------------

### I. 3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit

#### I.3.1. Konkluzioni i Auditimit

Në përfundim të auditimit të përputhshmërisë bazuar në ISSAI/IFPP 400-499 parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë dhe ISSAI/IFPP 4000-4899, standardet e auditimit të përputhshmërisë, të ushtruar në DTM për periudhën e veprimtarisë nga 01.01.2021 deri në 31.12.2022, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 14/1, datë 09.01.2023, i ndryshuar, miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, grupi i auditimit ka arritur në konkluzionin se, përsa i përket përputhshmërisë së çështjeve të audituara, subjekti i audituar “Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj” me përjashtim të rasteve të cilësuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, të cilat i përkasin kryesisht kontrollit tatimor në vend, përgjithësisht ka vepruar në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore, të cilat kanë shërbyer si kritere vlerësimi.

#### I.3.2. OPINIONI I AUDITIMIT

##### **Opinion i auditimit të përputhshmërisë.**

Ne kemi audituar zbatueshmërinë e akteve ligjore nën ligjore dhe rregullative (kriteret e paracaktuara të vlerësimit), për veprimtarinë e Drejtorisë së Tatimpaguesve të Mëdhenj (DTM) për periudhën 01.01.2021 deri më 31.12.2022, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë së rregullave, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve në lidhje me realizimin e të ardhurave tatimore, zbatimin e procedurave të kontrollit tatimor, nga ana e Sektorit të Kontrollit Tatimor në Vend; Sektorit të Kontrollit nga Zyra; Sektorit të Shërbimit ndaj Tatimpaguesve; Drejtorisë së Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore etj.,

Auditimi ka përfshirë ekzaminimin në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin kryerjen e procedurave tatimore, referuar dosjeve përkatëse, si dhe të dhënave dhe çdo dokumenti të ndodhur në sistemin C@TS, mbështetur në analizë risku, duke përzgjedhur kampionin mbi të cilin u kryen testet analitike.

##### **Opinion i modifikuar/kualifikuar<sup>1</sup>**

Sipas opinionit tonë, përveç efekteve të çështjeve të cilësuara në paragrafin e “Baza për opinionin e modifikuar/kualifikuar” subjekti i audituar, DTM ka vepruar në përputhje me kriteret e vlerësimit (Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”; Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar; Ligj nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar (TVSH) në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligj nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të Ardhurat” i ndryshuar, etj.), gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj.

##### **Baza për opinionin e modifikuar/kualifikuar:**

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për përputhshmërinë.

<sup>1</sup> Opinioni i modifikuar, i cilësuar/kualifikuar: Audituesi duhet të shprehë një opinion të cilësuar, kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomalië apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura.



Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për dhënien e këtij opinion.

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se, subjekti i audituar DTM, në disa raste nuk ka vepruar në përputhje me kriteret e vlerësimit. Shkeljet e evidentuara në disa çështje të audituara, janë materiale por jo të përhapura, referuar popullatave, nën popullatave të kampionuara dhe kampioneve të testuara, sipas përshkrimit të mëposhtëm:

#### **Përshkrimi i çështjeve kryesore:**

Si rezultat i veprimeve të kryera në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar; ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar; ligjin nr. 92/2014, datë 24.7.2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; UMF nr. 24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; UMF nr. 6, datë 30.01.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar etj., janë konstatuar efekte negative në grumbullimin e të ardhurave buxhetore gjatë auditimit të raporteve të kontroleve tatimore, duke shkaktuar mungesën e evidentimit dhe të kërkimit për arkëtim të shumës prej **2,024,711 mijë lekë**, konkretisht si pasojë e faturimeve të situacioneve të punimeve ndërtimore poshtë nivelit të përcaktuar në EKB, mangësive në inventar, shitjeve pa faturë tatimore, kreditim i gabuar i TVSH-së së karburantit, zbatimit të gabuar të koeficientit të rregullimit të TVSH-së, shitjeve të objekteve ndërtimore poshtë çmimit të referencës të përcaktuar me VKM nr. 168, datë 27.3.2019; si dhe uljen e humbjes në vlerën 230,296 mijë lekë në një rast të konstatuar. Gjithashtu në raportet e kontrollit në vend kanë rezultuar pasaktësi në transaksionet me ortakun të kryera në kundërshtim me parimet dhe kushtet e tregut duke mos aplikuar norma interesi, dhe me mos njohjen si të ardhur të parapagimeve për shitjet e njësisive të banimit të cilat janë të pajisura me certifikatë shfrytëzimi, po pa kalim titulli të pronësisë.

Nga auditimi u konstatua se shitja e mallit naftë bruto e kryer nga kompania “B.P” me destinacion jashtë territorit të Shqipërisë rezultuan diferenca të pagesës së rentës minerare ku sipas çmimit të bursës brend të rivlerësuar në procedurë eksporti në shumën totale 1,315,285 mijë lekë si dhe rillogaritje të pagesës së rentës minerare me një detyrim tatimor të taksës kombëtare të rentës minerare në shumën 131,528 mijë lekë, bazuar në nenin 5 të ligjit nr. 153/2020 për “Regjimin fiskal në sektorin hidrokarbur renta minerare”.

Problematika të tjera të konstatuara lidhen me masat e ndërmarra për vjeljen e detyrimeve të papaguara, mangësitë në procesin e monitorimit të të ardhurave tatimore, dobësi në procedurat e ndjekura për përzgjedhjen e subjekteve objekt kontrolli në vend, mos realizim i propozimeve për kontroll nga DTM në masën 50%, mangësitë në sistemet e aplikuara duke rezultuar me diferenca në deklarimin e TVSH-së në dogana krahasimisht me deklarimin në sistemin C@TS tatime, etj.

#### **Përgjegjësitë e Drejtuesve të DTM:**

Strukturat drejtuese të DTM, janë përgjegjëse për realizimin e të ardhurave tatimore, në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e aplikuara (kriteret e vlerësimit). Ato janë përgjegjëse për zbatimin e gjithë kuadrit rregullator në fushën e kontrollit dhe vlerësimit të subjekteve tatimpaguese, menaxhimin e borxhit tatimor, shërbimin ndaj tatimpaguesve, nxjerrjen e vendimeve etj. Gjithashtu, strukturat drejtuese të DTM janë përgjegjëse për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, hartimin e procedurave, aktiviteteve të kontrollit, gjurmës së auditimit për të aktivitet kryesore të saj.

#### **Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH mbi Auditimin e Përputhshmërisë:**

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse veprimtaria e subjektit të audituar është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin e tij profesional në punën audituese.

Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me zbatueshmërinë e kriterëve të vlerësimit, kuadrin ligjor dhe rregullator nga ana e subjektit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

## **II. HYRJA**

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të Projekt Raportit të Auditimit dhe Programit të Auditimit nr.14/1 prot., datë 09.01.2023, i ndryshuar, të miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 11.01.2023 deri më datë 30.06.2023, në subjektin Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj (DTM) është kryer auditimi për periudhën nga 01.01.2021-31.12.2022, me objekt: “Mbi përputhshmërinë e veprimtarisë” nga grupi i auditimit:

1. J. T., Përgjegjës Grupi
2. R. G., Auditues
3. A. D., Auditues
4. B. P., Auditues
5. R. Xh., Auditues
6. E. C., Auditues

### **1.Objekti i auditimit**

Objekti i auditimit është rritja e një konkluzioni nëse aktiviteti i zhvilluar në Drejtorinë e Tatimpaguesve të Mëdhenj është në përputhje ose jo me dispozitat ligjore, nënligjore dhe rregullatore përkatëse.

Në funksion të përmbushjes së misionit/angazhimit, objektivat kryesore të veprimtarisë audituese janë:

- Evidentimi i shmangieve të veprimtarisë së DTM me kriteret e vlerësimit në bazë të kërkesave të kuadrit rregullator në fuqi për periudhën objekt i auditimit;
- Evidentimi i të metave dhe mangësive në lidhje me rregullshmërinë e proceseve sipas legjislacionit dhe rregullave të funksionimit të miratuara nga DPT;
- Vlerësimi i veprimeve, zbulimi i mospërputhjeve me pasojë të ardhura të pa llogaritura, mungesë të ardhurash dhe ato të evazionit tatimor;
- Vlerësimi i përmbushjes së misionit të DTM për realizimin e të ardhurave tatimore dhe jo tatimore;
- Vlerësimi i transparencës me publikun dhe biznesin, krahasimi i rezultateve të veprimtarisë së institucionit midis viteve objekt i auditimit;
- Ballafaqimi dhe diskutimi i rezultateve të auditimit me personat përgjegjës;

- Përcaktimi i rekomandimeve në bazë të gjetjeve nga auditimi, për përmirësimin e gjendjes në të ardhmen, shlyerjen e dëmeve të mundshme ekonomike dhe parandalimin e mospërputhjeve në të ardhmen;

- Dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, gjatë veprimtarisë së tij;

## **2. Qëllimi i auditimit**

Qëllimi i auditimit është evidentimi i devijimit nga standardet e pranuar të shkeljeve të parimeve të ligjshmërisë, të menaxhimit financiar, me synim ndërmarrjen e masave dhe veprimeve korrigjuese nga ana e subjektit të audituar. Nëpërmjet kryerjes së këtij auditimi KLSH synon të promovojë:

- Transparencën, duke ofruar raport të besueshëm për fondet nëse janë administruar sipas një procesi të rregullt dhe është respektuar kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi;

- Përgjegjshmërinë ndaj devijimeve të raportimit dhe ndaj shkeljeve të kuadrit ligjor rregullator, në mënyrë që të mund të merren veprime korrigjuese dhe personat përgjegjës të përgjigjen për veprimet e tyre;

- Qeverisjen e mirë, duke identifikuar dobësitë dhe duke vlerësuar rregullshmërinë aty ku kuadri ligjor rregullator rezulton i pamjaftueshëm dhe/ose i papërshtatshëm, si dhe duke marrë parasysh riskun e mashtrimit në lidhje me përputhshmërinë.

## **3. Identifikimi i çështjes**

Fushëveprimi i këtij auditimi është vlerësimi me siguri të arsyeshme i veprimtarisë së Drejtorisë së Tatimpaguesve të Mëdhenj për periudhën objekt auditimi nga 01.01.2021 deri më 31.12.2022, në përputhje me aktet ligjore të cilat rregullojnë veprimtarinë e këtij institucioni sipas ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij. Përputhshmëria dhe rregullshmëria në procedurat e ndjekura nga ana e drejtorive përbërëse në DTM të cilat monitorojnë ecurinë e realizimit të të ardhurave tatimore, masat e marra për mbledhjen e detyrimeve tatimore, ecurinë e vetëdeklarimit të tatimpagueseve, saktësinë e këtyre deklaratave, monitorimin e mos deklaruesve në të gjitha llojet e tatimeve, prokurimet, përputhshmëria ligjore në veprimtarinë e Drejtorisë së Kontrollit, Drejtorisë së Mbledhjes së Detyrimeve dhe Drejtorisë së Shërbimit ndaj Tatimpaguesve, zbatimit të buxhetit, si dhe çështje të tjera të cilat kanë rezultuar gjatë auditimit etj.

## **4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese**

Është detyrimi i strukturave drejtuese në DTM, që në kryerjen e veprimtarive, të respektojnë parimet e menaxhimit të shëndoshë financiar, të ligjshmërisë e të transparencës në administrim, si dhe të përgjigjen për veprimet e tyre dhe rezultatet që burojnë prej tyre përpara organit që i ka emëruar ata ose të cilëve u ka deleguar përgjegjësinë sipas përcaktimeve në ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar dhe Rregullores së Brendshme, miratuar sipas Urdhrit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 19, datë 22.02.2017.

Drejtori përfaqëson DTM dhe vepron si pikë e parë e kontaktit midis DPT dhe institucionin. Është përgjegjës për menaxhimin e burimeve njerëzore për të maksimizuar mbledhjen e të ardhurave tatimore, si dhe zbatimin e detyrave të autorizuar sipas legjislacionit në fuqi.

Drejtori i Kontrollit mban përgjegjësi në menaxhimin e sektorëve të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor, në zbatimin e planeve mujore dhe vjetore të kësaj drejtorie, dhe merr raporte lidhur me zbatimin e tyre nga përgjegjësit e sektorëve. Përgatit raport për realizimin e detyrave dhe harton plane kontrolli apo vizita fiskale për inspektorët në varësi.

Drejtori i Shërbimit mban përgjegjësi në informimin e Drejtorit Rajonal dhe raporton çdo problematikë të stafit punonjës. Siguron përdorimin, publikimin, dhe raportimin e të dhënave brenda afateve të përcaktuara.

### **5. Përgjegjësitë e audituesve**

Përgjegjësia e grupit të auditimit është të shprehë konkluzionin dhe një opinion mbi çështjet që janë nën auditim. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI. Këto standarde kërkojnë që audituesit të respektojnë kërkesat etike, si dhe të planifikojë e kryejë auditimin me qëllim që të arrijë nivelin e sigurisë së kërkuar nëpërmjet auditimit të realizuar;

- Të vlerësojë nëse, informacionet mbi çështjet në të gjitha aspektet materiale janë në përputhje me kriteret e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi. Masa e ndjekjes nga subjekti i audituar i rregullave, legjislacionit dhe akteve normative, politikave, kodeve të miratuara apo kushtet e përcaktuara (ISSAI 4000), nuk paraqesin devijime materiale nga kriteret e vlerësimit, si pasaktësi apo gabime dhe janë në përputhje me kuadrin rregullator mbi bazën e të cilit e ushtrohet veprimtaria e subjektit të audituar. Ne si Auditues Shtetëror do të shprehemi me një opinionin mbi përputhshmërinë dhe rregullshmërinë e aktivitetit të institucionit, si dhe përdorimin e duhur dhe eficient të burimeve financiare prej tij.

Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10 “Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t”, si dhe ISSAI 30 “Kodi Etik”, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Objektivat e punës sonë lidhen me garantimin e sigurisë së arsyeshme për çështjet subjekt auditimi, që mund të kenë ekzistuar, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin dhënien e opinionit. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë në veprimtarinë e subjektit të audituar. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

### **6. Kriteret e vlerësimit**

Përcaktimet ligjore dhe rregullat e funksionimit të DTM, normat dhe metodat e përcaktuara sipas kërkesave të ligjeve, akteve administrative, rregullores së institucionit dhe përcaktimet në marrëveshjet ndërkombëtare që kanë lidhje me sistemin tatimor në Republikën e Shqipërisë.

Legjislacioni bazë e dytësor, dhe dispozita të tjera, si dhe kriteret përkatëse që janë përdorur dhe iu jemi referuar për kryerjen e vlerësimeve gjatë auditimit:

- *Kushtetuta dhe Ligji nr. 154.2014 “Mbi organizimin dhe funksionimit e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;*
- *Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar;*
- *Ligji Nr. 8438, Datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar ;*
- *Ligji Nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar ;*
- *Ligji me Nr. 92.2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar ne RSH” i ndryshuar ;*
- *Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar;*
- *Rregullore e brendshme me nr. 19, datë 22.02.2017 “Për miratimin e rregullores së brendshme për funksionimin e administratës tatimore”;*
- *Rregullore nr. 2 “Mbi procedurat e përzgjedhjes për kontroll të tatimpaguesve”;*
- *Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 26, datë 27.12.2007 “Për disa ndryshime në udhëzimin e Ministrisë të Financave nr. 14, datë 28.12.2006”;*

- Etj.

## **7. Standardet e auditimit**

Standardet e auditimit të aplikuara në kryerjen e punës paraqiten si më poshtë:

- ISSAI 100 *“Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”* që përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi;
- ISSAI 400 *“Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë”* që përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë;
- ISSAI 4000 *“Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë”*; si dhe ISSAI 4200;
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilisteve IFAC;
- Praktika të mira të fushës si: Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të audituesve; Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t;
- INTOSAI *“Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë”* etj;
- Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të audituesve;
- Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI *“Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë”* etj.

## **8. Metodat e auditimit**

Metodat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit, në procedurat bazë dhe në procedurat analitike pas testeve të kryera, me qëllim arritjen e objektivave të auditimit. Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodat dhe teknikat e mëposhtme:

- a. Intervistimi - duke marrë informacion nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit dhe atij të përfshirë për një çështje të caktuar, e kombinuar kjo me shqyrtimin e evidencave përkatëse;
- b. Raporte dhe informacione - shfrytëzimi i raporteve, informacioneve relevante dhe që kanë lidhje me objektivat e auditimit dhe specifikisht me drejtimit e auditimit;
- c. Verifikimi në sistemin elektronik - me përzgjedhje të çështjeve të veçanta të auditimit, sipas drejtimeve të auditimit;
- d. Të kombinuara, sipas rastit dhe vlerësimit të audituesve.

Audituesit e KLSH janë përpjekur në çdo rast në përzgjedhjen e arsyeshme dhe të mjaftueshme të metodave dhe teknikave veçmas dhe/ose të kombinuara, si dhe shtrirjen e tyre për të dhënë siguri të arsyeshme në arritjen e konkluzioneve të auditimit në tërësi, dhe sipas drejtimeve në veçanti.

## **9. Dokumentimi i auditimit**

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatorë, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre. Në përfundim të auditimit në terren, Akteve të Konstatimeve të mbajtura mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, u përgatit ky Projekt Raport i Auditimit.

Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga gabimi material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë procesit të vlerësimit të rrezikut, audituesit vlerësojnë nivelin e kontrollit të brendshëm relevant në entitetin DTM, në mënyrë që të programoheshin procedurat e auditimit, që janë të përshtatshme për kushtet e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit. Mbështetur në ISSAI 1315, objektivi i audituesit është identifikimi dhe vlerësimi i risqeve e anomalive, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale. Grupi i auditimit ka kryer vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në institucion sa i takon: (a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të 5-të komponentëve të kontrollit të brendshëm. Vlerësimi i kontrollit të brendshëm kryhet nëpërmjet testeve të kontroleve. Gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm paraqesin risk të moderuar. Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit ka konsistuar në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm u administrua dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke ia nënshtruar vlerësimit përmes skepticizmit profesional nga ana e audituesve.

### **III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT**

#### **1. Informacioni i Përgjithshëm mbi subjektin nën auditim**

Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj (DTM), është krijuar dhe funksionon në zbatim të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008, i ndryshuar dhe është strukturë e Administratës Tatimore Qendrore që merret direkt me mbledhjen e detyrimeve tatimore, me ofrimin e shërbimeve dhe asistencës për tatimpaguesit, kontrollin e deklaratave dhe pagesave, kontrollin e tatimpaguesve, si dhe mbledhjen e borxhit tatimor. Objektivat kryesorë të veprimtarisë së DTM konsistojnë në verifikimin e përmbushjes vullnetare të detyrimeve tatimore sipas legjislacionit në fuqi nga ana e tatimpaguesve dhe kontrollin ndaj evazionit fiskal apo shmangieve tatimore që mund të jenë kryer nga tatimpaguesi. Objektivat e përgjithshme të DTM-së përfshijnë:

- Të sigurojë ndërmarrjen e të gjithë veprimeve në aktivitetin e tyre të cilat çojnë në zbatimin rigoroz të planit strategjik të administratës tatimore qendrore;
- Të mbledhi të ardhurat tatimore në përputhje me procedurat e përcaktuara në legjislacionin tatimor në fuqi me koston më të ulët të mundshme, nëpërmjet nxitjes dhe vetëvlerësimit e plotësimit vullnetar të detyrimeve nga tatimpaguesit dhe nëpërmjet kontroleve të paanshme për të gjithë tatimpaguesit, për të zbuluar dhe korrigjuar rastet e moszbatimit të ligjeve tatimore;
- Të bashkëpunojnë me drejtoritë përkatëse në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për zbatimin e planit operacional në përputhje me objektivat e vendosura në planin strategjik të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve;
- Të përcaktojnë plane operationale vjetore me shkrim për çdo funksion;
- Të bashkëpunojnë me strukturat përkatëse në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për trajnimin e punonjësve;
- Të hartojnë dhe zbatojnë programe në mënyrë që përgjegjësit të përgatisin raporte me shkrim për vlerësimin e punës së kryer gjatë vitit nga punonjësit nën varësinë e tyre;

- Të ndjekin të gjitha procedurat standarde të punës, të përcaktuara nga drejtoritë funksionale në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.

DTM-ja përbëhet nga drejtori funksionale si: Drejtoria e Kontrollit Tatimor, Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse, Drejtoria e Detyrimeve Tatimore të Papaguara, Drejtoria e Shërbimit ndaj Tatimpaguesit etj., të cilat më pas ndahen në sektorë, ku çdo strukturë organizative brenda DTM-së mbulon një funksion të caktuar në përputhje me aktet nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e saj.

## 2. Përshkrimi i auditimit sipas drejtimeve të auditimit

### 2.1. Mbi auditimin e programimit të të ardhurave tatimore dhe kontributeve, realizimi i tyre, ndarë sipas strukturës përkatëse për periudhën objekt auditimi. Mbi vlerësimin e përputhshmërisë ligjore të veprimtarisë së Drejtorisë së Analizës, Riskut dhe Kontabilitetit të të Ardhurave

Në zbatim të programit buxhetor “Të ardhurat tatimore” në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë hartohen treguesit e të ardhurave në bazë të politikave të qeverisë, ndërsa administratës tatimore i dërgohet plani i të ardhurave i miratuar nga MFE. Ky plan detajohet dhe miratohet nga Komiteti i Përmblidhjes, për t’u përcjellë me shkresë secilës DRT, mbështetur në të ardhurat faktike të viteve të mëparshme për secilën DRT dhe peshën specifike të secilës drejtori në totalin e të ardhurave tatimore, pa përfshirë në këtë analizë faktorë të tillë si: struktura e tatimpaguesve sipas llojit, ndryshimet në statusin e tyre, problematikat në lidhje me mbledhjen e të ardhurave dhe borxhit tatimor që këto drejtori mbartin, në raport kjo dhe me kapacitetet në dispozicion të secilës DRT. Si rezultat, sektori i analizës dhe kontabilitetit në DTM nuk kryen analiza lidhur me parashikimin e arkëtimeve, projekt plane, apo raporteve të tilla të ngjashme me qëllim dërgimin e tyre pranë DPT në kuadër të kryerjes së një planifikimi të të ardhurave, pasi ky plan i përcillet i përgatitur për zbatim nga DPT.

Në zbatim të Nenit 4 “Drejtori i Drejtorisë Rajonale Tatimore” të Rregullores së Funksionimit të Administratës Rajonale Tatimore, pika 3 “... Qëllimi i punës është arritja e objektivave operacionale dhe objektivave të përcaktuara në Planin Strategjik të Administratës Tatimore, si dhe të objektivave dhe programeve të përcaktuara nga Zyra Qendrore për mbledhjen e të ardhurave për Drejtorinë Rajonale Tatimore”; pika 6: “Përgatit raporte për Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve ku përmbledh progresin e bërë kundrejt planit dhe shmangiet nga programi i miratuar. Raportet përfshijnë jo vetëm analizën e realizimit të të ardhurave dhe devijimet nga programi por edhe analizën e treguesve të performancës së Drejtorisë Rajonale Tatimore dhe pjesëve përbërëse të saj”, konstatohet se nga ana e DTM për periudhën objekt auditimi (viti 2021 dhe 2022) nuk rezultojnë të jenë hartuar dhe dërguar pranë DPT plane operacionale të veprimtarisë institucionale, plane vjetore, apo raporte për realizimin e të ardhurave dhe treguesve të performancës, në kundërshtim me kuadrin rregullator cituar më sipër.

Në dispozicion të grupit të auditimit u vendosën vetëm analizat e sektorit të të ardhurave për vitin 2021 dhe 2022, në të cilat janë paraqitur të dhënat statistikore mbi nivelin e realizimit krahasuar me planin dhe 2 vitet paraardhëse, në nivel progresiv dhe sipas muajit Dhjetor. Gjithashtu janë paraqitur top subjektet performues sipas zërit të të ardhurave. Në këtë dokument mungojnë analizat e kryera lidhur me nivelin e realizimit krahasuar me planin, për të evidentuar shkaqet e mos realizimit/mbi realizimit në nivel industrie/fenomenesh/apo edhe subjekteve, apo shkaqet që kanë çuar në mos realizim/mbi realizim krahasuar me vitin paraardhës. Pra, si rezultat

puna e DTM në planifikimin e të ardhurave tatimore konsiston në paraqitjen e të dhënave statistikore në nivel tepër sintetik, pa u analizuar mbi faktorët që kanë ndikuar në mbi realizimin/mosrealizimin e tyre; argumentet dhe faktorët që kanë ndikuar, bazuar në fenomenet e konstatuara gjatë kontrollit në industrinë përkatëse.

Grupi i auditimit kërkoi informacion për arsyet e tejkalimit; mos realizimit të të ardhurave sipas zërave përkatës, për periudhën objekt auditimit, për të cilat nuk u vendosën në dispozicion argumentet përkatëse nga ana e DTM.

Në raportin e vendosur në dispozicion nga Sektori i Analizës dhe Kontabilitetit, u konstatuan se ekzistonin diferenca mes të dhënave të raportuara në tabelën përmbledhëse të të ardhurave, si dhe me të dhënat e analizuar për secilin zë më vete të të ardhurave, në brendësi të raportit. Shkak për këtë arsye sipas informacionit të sektorit ishte fakti se: “Në tabelën nr.2 janë të ardhurat në kohë reale, kjo do të thotë që: Në secilin nga muajt e periudhës 2022,2021 sa subjekte që janë, kanë bërë derdhjet e muajit. Në tabelat e tjera janë arkëtimet periodike, që do të thotë se ndryshimet e subjekteve (largimet ose ardhjet në DTM) që bëhen në muaj të ndryshëm, paraqiten si arkëtime që nga Janari e deri në Dhjetor.”. Në konkluzionin e grupit të auditimit, kryerja e raportimit në këtë formë (me dy momente të ndryshme kohore të mara për bazë për analizimin: në kohë reale vs arkëtime periodike) krijon konfuzion dhe nuk mundëson gjenerimin e një informacioni të saktë dhe të krahasueshëm për efekt analize, duke qenë se ky është edhe qëllimi kryesor i këtij raporti. Struktura e subjekteve nën administrimin e DTM për periudhën objekt auditimi paraqitet si më poshtë:

Tabela 2.1.1-Struktura e subjekteve DTM

SUBJEKTET ME STATUS AKTIV NË DTM		
Sektori	Viti	
	2021	2022
	Nr	Nr
Në Sektorin e Ndërtimit	123	135
Në Sektorin e Prodhimit	152	159
Në Sektorin e Shërbimit	187	199
Në Sektorin e Transportit	36	33
Në Sektorin e Tregtisë	373	394
<b>Total</b>	<b>871</b>	<b>920</b>


*Burimi: DTM*

Nga sa më sipër rezulton se në vitin 2022 numri i subjekteve nën juridiksionin e DTM ka pësuar një rritje prej rreth 5%, ku pjesën më të madhe të rritjes e zënë subjektet e tregtisë, ndjekur nga sektori i ndërtimit dhe shërbimit; ndërkohë që në sektorin e transportit numri i subjekteve rezulton në ulje.

Të ardhurat e realizuara nga DTM sipas zërave më kryesorë të tyre për periudhën 2020-2022, paraqiten sipas grafikut të mëposhtëm:



Grafiku 2.1.1-Realizimi i të ardhurave DTM



Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DTM

Sikundër vërehet më sipër, zërat kryesorë rezultojnë me rritje për vitin 2022 krahasimisht me vitin 2021, ku përjashtim bën zëri i të ardhurave nga TVSH dhe TVSH neto, i cili për vitin 2022 rezulton me rënie krahasuar me periudha paraardhëse. Gjithashtu, edhe rimbursimet e kryera, për vitin 2022 rezultojnë më pak se viti 2021. Për sa i përket të ardhurave jo tatimore, për vitin 2022 ato rezultojnë me rënie, por kontributi i këtij zëri në totalin e të ardhurave paraqitet relativisht i ulët.

### Viti 2021

Plani i të ardhurave për vitin 2021 është përcjellë me shkresën e DPT nr. 847/2, prot datë 15.02.2021. Përgjatë vitit 2021, ky plan është rishikuar në zbatim të Aktit Normativ nr.4, datë 05.02.2021 me shkresën nr. 5597/1, prot datë 01.04.2021; si dhe në zbatim të Aktit Normativ nr. 18, datë 14.04.2021 plani është rishikuar me shkresën nr. 8627/1, prot datë 21.05.2021 të DPT.

Tabela 2.1.2-Plani i të ardhurave DTM

Në milion lekë

Nr.	E M E R T I M I	Realizimi 2020	Plan sipas Ligjit të Buxhetit	Plan sipas Aktit Normativ nr.4, datë 05.02.2021	Plan sipas Aktit Normativ nr. 18, datë 14.04.2021	Diferenca <sup>2</sup>
10	<b>D.R.Tatimore Tatimpaguesit e Mëdhenj TOTAL (bruto)</b>	<b>88,710</b>	<b>101,536</b>	<b>102,417</b>	<b>103,180</b>	<b>+1,644</b>
	( Tatimet + Rimbursime + Kontributet )	-				-
A	<b>Te Ardhurat Tatimore gjithsej (bruto)</b>	<b>66,529</b>	<b>79,936</b>	<b>79,914</b>	<b>80,389</b>	<b>+1,353</b>
	<i>Nga te cilat:</i>	-				
1	Tatimi Vlerës se Shtuar	23,782	30,000	30,878	30,878	+878
	- Tatimi Vlerës se Shtuar (neto)	13,367	19,500	20,378	20,378	+878
	- Rimbursimi i kryer (gjithej)	10,415	10,500	10,500	10,500	-
3	Tatim mbi Fitimin	17,399	20,581	20,581	20,961	+380
4	Ardhura Personale	17,936	19,200	19,200	19,296	+96
8	Taksat Nacionale	6,705	7,770	7,770	7,770	-
9	Taksa Qarkullimit Rrugor	-	600	600	600	-
11	Lojërat e Fatit	694	885	885	885	-
12	Te tjera pa identifikuar	0	0	0	-	

<sup>2</sup> Diferenca e përlogaritur kundrejt planit te përcaktuar në zbatim të Ligjit për Zbatimin e Buxhetit të Vitit 2021

13	Dënimet Administrative	11	0	0	-	
<b>B</b>	<b>Te Ardhurat Tatimore gjithsej (neto)</b>	<b>56,112</b>	<b>68,536</b>	<b>69,414</b>	<b>69,889</b>	<b>+ 1,353</b>
C	Kontributet e Sigurimeve gjithsej	22,182	22,500	22,500	22,791	+ 291
<b>D</b>	<b>D.R.Tatimore Tatimpaguesit e Mëdhenj TOTAL (neto)</b>	<b>78,294</b>	<b>91,036</b>	<b>91,914</b>	<b>92,680</b>	<b>+ 1,644</b>
	Tarifa jo tatimore	2,322			-	

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DTM

Për vitin 2021, plani fillestar dhe e ai i rishikuar në zbatim të akteve normative paraqitet me rritje krahasuar me realizimin e të ardhurave për vitin 2020. Sikundër vërehet nga tabela e mësipërme, me Aktin Normativ nr. 18, datë 14.04.2021, plani në total për të ardhurat tatimore bruto të DTM është rritur me 1,353 milion lekë, krahasuar me planin e përcaktuar në zbatim të Ligjit të Buxhetit për vitin 2021. Planin paraqitet gjithashtu në rritje me 1,353 milion lekë për të ardhurat tatimore neto. Ecuria e realizimit të planit vjetor paraqitet si më poshtë:

Tabela 2.1.3-Realizimi i planit të të ardhurave 2021

Në milion lekë

EMERTIMI	Fakt 2020	Plani fillestar 2021	Plan përfundimtar 2021	Fakt 2021	Realizimi % <sup>3</sup>	Diferencë (Realizim-Plan)	Diferencë 2021-2020
<b>D.R.Tatimore Tatimpaguesit e Mëdhenj TOTAL (bruto)</b>	<b>88,710</b>	<b>101,536</b>	<b>103,180</b>	<b>104,260</b>	<b>101%</b>	<b>1,080</b>	<b>15,550</b>
( Tatimet + Rimbursime + Kontributet )	-		-	-			
<b>Te Ardhurat Tatimore gjithsej (arkëtim)</b>	<b>66,528</b>	<b>79,036</b>	<b>80,389</b>	<b>79,271</b>	<b>99%</b>	<b>-1,118</b>	<b>12,743</b>
<i>Nga te cilat:</i>	-		-	-			
Tatimi Vlerës se Shtuar	23,782	30,000	30,878	28,768	93%	-2,110	4,986
- Tatimi Vlerës se Shtuar (neto)	13,367	19,500	20,378	12,117	59%	-8,261	-1,250
- Rimbursimi i kryer (gjithsej)	10,415	10,500	10,500	16,651	159%	6,151	6,236
Tatim mbi Fitimin	17,399	20,581	20,961	20,984	100%	23	3,585
Ardhura Personale <sup>4</sup>	17,936	19,200	19,296	20,718	107%	1,422	2,782
Taksat Nacionale	6,705	7,770	7,770	7,350	95%	-420	645
Taksa Qarkullimit Rrugor	-	600	600	-			
Lojërat e Fatit	694	885	885	1,437	162%	552	743
Te tjera pa identifikuar	0	0	-	-			
Dënimet Administrative	11	0	-	14			3
<b>Te Ardhurat Tatimore gjithsej (neto)</b>	<b>56,112</b>	<b>68,536</b>	<b>69,889</b>	<b>62,620</b>	<b>90%</b>	<b>-7,269</b>	<b>6,508</b>
Kontributet e Sigurimeve gjithsej	22,182	22,500	22,791	24,989	110%	2,198	2,807
<b>D.R.Tatimore Tatimpaguesit e Mëdhenj TOTAL (neto)</b>	<b>78,294</b>	<b>91,036</b>	<b>92,680</b>	<b>87,609</b>	<b>95%</b>	<b>-5,071</b>	<b>9,315</b>
Tarifa jo tatimore	2,322		-	3,010			688


Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DTM

Nga të dhënat e tabelës së mësipërme rezulton se të ardhurat bruto nga tatimet (Të ardhurat tatimore dhe Kontributet nga Sigurimet Shoqërore e Shëndetësore) janë realizuar në masën 101% kundrejt planit të të ardhurave, ose me tejkalim në shumën 1,080 milion lekë, ndërsa të ardhurat tatimore neto paraqiten me mosrealizim për 1,118 milion lekë, pra janë arkëtuar më pak në masën 1%. Krahasuar me vitin 2020, të ardhurat bruto janë mbledhur 15,550 milion lekë më shumë, nga të cilat vetëm të ardhurat tatimore bruto rezultojnë të jenë realizuar 12,743 milion lekë më shumë. Për sa i përket realizimit të të ardhurave sipas planit për çdo muaj, situata paraqitet si më poshtë, për zërat më kryesorë të të ardhurave:

Grafiku 2.1.2-Ecuria e planit ne muaj


<sup>3</sup> Realizimi i përlogarit kundrejt planit të rishikuar të vitit

<sup>4</sup> Duke përfshirë në këtë zë edhe të ardhurat nga tatimi në burim



Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DTM

Struktura e të ardhurave tatimore për vitin 2021 paraqitet sipas grafikut të mëposhtëm.  
Grafiku 2.1.3-Te ardhurat sipas strukturës



Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DTM

Struktura e të ardhurave tatimore tregon se TVSH-ja vazhdon të jetë kontribuesi kryesor në të hyrat publike me 36% të të ardhurave tatimore; Tatimi mbi fitimin zë 27% të të ardhurave tatimore; Tatimi mbi të ardhurat personale përbën 26% të të ardhurave tatimore; taksa nacionale me 9% të të ardhurave tatimore dhe lojërat e fatit me 2%.

Realizimi i të ardhurave detajuar sipas zërave për vitin 2021 paraqitet si më poshtë:

#### A. Të Ardhurat Tatimore (në arkëtim)

Për vitin 2021, të ardhurat tatimore janë programuar në shumën 80,389 milion lekë dhe janë realizuar 79,271 milion lekë, me një mosrealizim prej 1,118 milion lekë, ose 1% më pak.

Krahasuar me vitin 2020, në të cilën të ardhurat u realizuan 66,528 milion lekë, të ardhurat e vitit 2021 paraqiten me rritje në vlerën 79,271 milion lekë, ose 19 % më shumë.

### Të Ardhurat Tatimore ndarë sipas llojit.

Realizimi i të ardhurave sipas llojit të tatimeve krahasuar me planin e vitit 2021 dhe faktin e vitit 2020, paraqitet si më poshtë:

#### A.1 Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (bruto).

Për vitin 2021 të ardhurat nga TVSH në terma bruto u realizuan në shumën 28,768 milion lekë, ose në masën 93 % të planit, me një mosrealizim në shumën 2,110 milion lekë; ndërsa krahasuar me vitin 2020 janë arkëtuar 4,986 milion lekë më shumë, ose rreth 21% më shumë, ku rezultojnë 367 shoqëri me rritje të pagesës së TVSH-së në shumën 9,142 milion leke dhe 310 subjekte me ulje të pagesës në shumën 4,554 milion lekë.

Me poshtë paraqiten pagesat e tatimit mbi vlerën e shtuar për vitin 2021, krahasuar me të njëjtën periudhë me vitin e kaluar dhe të vitit 2019, sipas nëngrupeve të industrive mujore dhe progresive:

Tabela 2.1.4-Te ardhurat nga TVSH sipas industrisë

Në milion lekë

Sektori	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021
Sektori i Ndërtimit	3,412	3,187	3,308
Sektori i Prodhimit	6,802	5,558	7,457
Sektori i Shërbimit	7,592	6,873	7,236
Sektori i Transportit	451	405	451
Sektori i Tregtisë	7,517	8,154	10,312
<b>Total</b>	<b>25,773</b>	<b>24,176</b>	<b>28,765</b>

Burimi: DTM

Nga tabela e mësipërme rezulton se industria që ka performuar më tepër në pagesat e TVSH-së për vitin 2021 është ajo që i përket nëngrupit të tregtisë me 10,312 milion lekë; për tu ndjekur më pas nga ajo e prodhimit me 7,457 milion lekë dhe në vend të tretë paraqitet sektori i shërbimit me 7,236 milion lekë. Shoqëritë që kanë dhënë efektin më të madh në të ardhurat e TVSH-së progresive për vitin 2021 dhe atë paraardhës paraqiten si më poshtë:

Tabela 2.1.5- Te ardhurat nga TVSH sipas top subjekteve

Në lekë

Subjekti	Aktiviteti	Viti 2021	Viti 2020
O.S.T	në Sektorin e Prodhimit	49,257,493	438,927,197
O.S.SH	në Sektorin e Prodhimit	693,068,970	966,276,643
O.SH.E.E	në Sektorin e Prodhimit		207,237,881
"A."	në Sektorin e Shërbimit		205,782,546
K.	në Sektorin e Tregtisë	196,447,038	361,229,822
S.A.A	në Sektorin e Shërbimit	20,970,080	167,888,204
V.A	në Sektorin e Shërbimit	846,106,054	962,667,123
P.A	në Sektorin e Shërbimit	23,327,736	127,578,264
A-B.	në Sektorin e Ndërtimit	126,367,683	225,279,669
M.	në Sektorin e Tregtisë	139,843,810	237,458,418
T.	në Sektorin e Shërbimit	96,536,644	186,441,572
A.	në Sektorin e Ndërtimit	28,071,939	107,922,552
B.S	në Sektorin e Tregtisë	19,711,107	94,854,234
I.T.S	në Sektorin e Prodhimit	13,079,295	84,614,278
IE	në Sektorin e Prodhimit	66,504,139	134,291,078
D-A.	në Sektorin e Shërbimit	286,796,412	354,413,540
A.K	në Sektorin e Ndërtimit	34,845,179	100,086,367
A.C	në Sektorin e Prodhimit	145,082,832	201,523,055
T.E	në Sektorin e Ndërtimit	65,520,478	119,833,865
L. - SHPK	në Sektorin e Ndërtimit	8,973,367	59,678,829
E. SHPK	në Sektorin e Prodhimit	74,199,424	124,619,172
"G.C"	në Sektorin e Tregtisë	31,576,697	75,867,166
L.	në Sektorin e Tregtisë	24,945,344	68,837,959

Burimi: DTM

### A.1.1. Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (neto).

Për vitin 2021, të ardhurat nga Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (Neto) ishin programuar në vlerën prej 20,378 milion lekë dhe janë realizuar në vlerën prej 12,117 milion lekë, me një mosrealizim në vlerë prej 8,261 milionë lekë, ose 41 % më pak. Nga auditimi konstatohet se nuk është kryer asnjë analizë nga ana e DTM për arsytet që kanë ndikuar në mosrealizimin e këtij zëri kryesor në të ardhurat tatimore. Krahasuar me vitin 2020 ku u arkëtuan 13,367 milion lekë, të ardhurat nga TVSH-ja neto janë arkëtuar 1,250 milion lekë më pak, ose 9 % më pak.

### A.1.2 Rimbursimi i TVSH-së.

Për vitin 2021 rimbursimi për TVSH-në ishte programuar në vlerën 10,500 milion lekë dhe është realizuar në vlerën 16,651 milion lekë, me një tejkalim prej 6,151 milion lekë ose 59 % më shumë. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2020 në të cilën janë rimbursuar 10,415 milion lekë, rimbursimet janë realizuar 6,236 milion lekë më shumë, ose 60% më shumë.

### A.2 Tatimi mbi Fitimin

Të ardhurat tatimore nga tatimi mbi fitimin, janë programuar në shumën 20,961 milion lekë dhe aktualisht janë arkëtuar 20,984 milion lekë, me një tejkalim prej 23 milion lekë. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2020, në të cilën u arkëtuan 17,399 milion lekë, të ardhurat nga ky lloj tatimi janë realizuar 3,585 milion lekë më tepër, ose 21% më shumë, ku rezultojnë 464 shoqëri me rritje të pagesës së Tatim mbi fitimit në shumën 7,770 milion leke, dhe 327 subjekte me ulje të pagesës në shumën 4,341 milion lekë.

Shoqëritë që kanë dhënë efektin më të madh në të ardhurat e Tatim Fitimit për periudhën 2021-2020, paraqiten si më poshtë:

Tabela 2.1.6- Te ardhurat nga tatim fitimi sipas top subjekteve

Në lekë

Subjekt	Aktiviteti	Viti 2021	Viti 2020
O.S.H.E.E	në Sektorin e Prodhimit	150,000,000	700,000,000
K.G	në Sektorin e Tregtisë	47,884,313	357,739,345
R.I.C.T	në Sektorin e Shërbimit	71,499,625	248,631,909
V.A	në Sektorin e Shërbimit	266,222,008	427,288,075
K.E.SH SHA	në Sektorin e Prodhimit	1,638,346,843	1,766,673,194
A-B.	në Sektorin e Ndërtimit	100,889,919	229,097,295
T.I.A SHPK	në Sektorin e Transportit	104,743,794	231,859,645
G.R.T	në Sektorin e Tregtisë	3,205,309	94,064,996
A.	në Sektorin e Shërbimit	23,691,717	111,795,385
U.K.T	në Sektorin e Prodhimit	38,991,087	122,155,481
"A."	në Sektorin e Shërbimit	20,000	80,122,095
M.	në Sektorin e Ndërtimit	11,159,792	87,706,759
A. BP A.	në Sektorin e Tregtisë	17,777,877	92,787,569
D-A.	në Sektorin e Shërbimit	19,205,983	93,598,351
M.C.A	në Sektorin e Shërbimit	11,865,673	83,003,335
S.A.A.	në Sektorin e Shërbimit	3,442,737	62,112,547
S.E.R.E	në Sektorin e Prodhimit	18,084,036	72,372,938
E. G.	në Sektorin e Ndërtimit	3,045,398	55,030,234
D.	në Sektorin e Shërbimit	11,218,598	60,657,935
B. O. A.	në Sektorin e Shërbimit	264,053,986	311,920,363
B.S	në Sektorin e Tregtisë	3,223,577	46,387,239
A.G.O	në Sektorin e Tregtisë	1,871,849	43,590,102

Burimi: DTM

### A.3 Tatimi mbi të Ardhurat Personale.

Tatimi mbi të ardhurat personale është programuar në vlerën 19,296 milion lekë dhe është realizuar 20,718 milion lekë, me një tejkalim prej 1,422 milion lekë ose 7 % më shumë. Në këto të ardhura janë inkuadruar edhe të ardhurat nga tatimi në burim. Të ardhurat nga tatimi në burim për vitin 2021 janë në shumën 16.358; te ardhurat nga rivlerësimi i pasurisë janë në shumën 4.360 miliard lekë, ku të ardhurat nga tatimi në burim janë në shumën 6.630 miliard lekë, të ardhurat nga tatimi mbi pagën janë në shumën 9.728 miliard lekë. Krahasuar me të njëjtën

periudhë të vitit të kaluar, në të cilin u arkëtuan 17,936 milion lekë, të ardhurat nga ky lloj tatimi janë realizuar 2,782 milion lekë më tepër, ose 16% më shumë, ku rezultojnë 632 shoqëri me rritje të pagesës së tatimit mbi pagën në shumën 1,424 milion lekë dhe 237 subjekte me ulje të pagesës në shumën 593 milion lekë.

#### A.4 Taksat Nacionale

Të ardhurat tatimore nga taksat nacionale janë programuar në vlerën 7,770 milion lekë dhe faktikisht janë arkëtuar 7,350 milion lekë, me një mosrealizim 420 milion lekë, ose 5% më pak. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2020, në të cilën u arkëtuan 6,705 milion lekë, mbledhja e taksave është në rritje prej 645 milion lekë ose 10 % më shumë. Krahasuar me vitin paraardhës, rezultojnë 10 shoqëri me rritje të pagesës së taksave dhe tarifave kombëtare në shumën 418 milion lekë dhe 9 subjekte me ulje të pagesës në shumën 69 milion lekë.

Shoqëritë që kanë dhënë efektin më të madh në të ardhurat e taksave dhe tarifave kombëtare për periudhën 2021/2020 paraqiten si më poshtë:

Tabela 2.1.7- Te ardhurat nga taksat nacionale sipas top subjekteve

*Në lekë*

Subjekt	Aktiviteti	Viti 2021	Viti 2020
D.P.SH.T.RR	në Sektorin e Transportit	4,838,133,217	4,888,462,765
A. – Sh.S	në Sektorin e Shërbimit	102,189,153	111,536,811
R.B.H. B.	në Sektorin e Prodhimit	8,762,175	14,063,808
A. E.	në Sektorin e Shërbimit	4,666,667	7,007,428

*Burimi: DTM*

#### A.5 Taksa e Qarkullimit Rrugor

Te ardhurat tatimore nga Taksat e Qarkullimit dhe Karburantit të cilat janë programuar 600 milion lekë, janë arkëtuar 0 lekë, njësoj si vitin paraardhës.

#### A.6 Lojërat e fatit

Të ardhurat tatimore nga lojërat e fatit janë programuar në vlerën 885 milion lekë dhe faktikisht janë arkëtuar 1,437 milion lekë, me një mbi realizim 552 milion lekë ose 63% më tepër. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2020, në të cilën u arkëtuan 694 milion lekë, mbledhja e taksave është në rritje prej 743 milion lekë ose 107 % më shumë, ku rezultojnë 3 shoqëri me rritje të pagesës së tatimit mbi lojërat e fatit në shumën 714 milion lekë dhe 1 subjekt me ulje të pagesës në shumën 1 milion lekë.

Shoqëritë që kanë dhënë efektin më të madh në të ardhurat e tatimit mbi lojërat e fatit për periudhën 2019-2021 paraqiten si më poshtë:

Tabela 2.1.8- Te ardhurat nga lojërat e fatit sipas top subjekteve

*Ne milion lekë*

Subjekt	Aktiviteti	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021
R.I.C.T	në Sektorin e Shërbimit	707	533	608,
L.K	në Sektorin e Shërbimit	34	21	20

*Burimi: DTM*

### B. Të Ardhurat nga Kontributet e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore

Për vitin 2021, të ardhurat nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore janë programuar në shumën 22,791 milion lekë dhe janë realizuar 24,989 milion lekë, me një tejkalim prej 2,198 milion lekë, ose 10 % më shumë se plani përcaktuar sipas Aktit Normativ nr. 18, datë 14.04.2021. Konstatohet se në vitin 2021, të ardhurat nga kontributet, krahasuar me vitin 2020, janë rritur në vlerën për 2,807 milion lekë, ose 13% më shumë ku rezultojnë 651 shoqëri me rritje të pagesës së kontributeve për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore në shumën 3,200 milion lekë dhe 231 subjekte me ulje të pagesës në shumën 879 milion lekë.

Nga krahasimi i të dhënave statistikore për të ardhurat tatimore të realizuara gjatë vitit 2021 krahasuar me realizimin e vitit 2020, vërehet se ato janë realizuar me shumë, megjithatë nga ana e DTM nuk rezulton të jetë kryer asnjë analizë për arsyet që kanë ndikuar në këto rezultate.

Shoqëritë që kanë dhënë efektin më të madh në të ardhurat e kontributeve të sigurimeve shoqërore për periudhën 2021/2020 paraqiten si më poshtë:

Tabela 2.1.9- Te ardhurat nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore sipas top subjekteve

Në lekë

Subjekt	Aktiviteti	Viti 2021	Viti 2020
O.S.H.E.E.	në Sektorin e Prodhimit	75,066,580	181,514,721
"A."	në Sektorin e Shërbimit	9,836,153	111,818,817
S.T	në Sektorin e Ndërtimit	3,641,464	74,393,786
S.	në Sektorin e Shërbimit	5,692,718	57,466,717
L.	në Sektorin e Ndërtimit	3,822,471	45,605,226
A.	në Sektorin e Shërbimit	283,029,614	322,890,826
S.A.A	në Sektorin e Shërbimit	14,412,728	46,190,251
T.W.A	në Sektorin e Shërbimit	75,621,350	101,386,400
M.C.F	në Sektorin e Prodhimit	11,439,830	33,771,817
T.E	në Sektorin e Ndërtimit	40,982,030	55,772,128
D.	në Sektorin e Prodhimit		14,720,765
G.	në Sektorin e Shërbimit	6,865,320	21,566,787
D.H	në Sektorin e Prodhimit	25,173,799	39,580,975
F.T.A	në Sektorin e Shërbimit	2,234,235	12,668,416
J.V.R.T.A.B	në Sektorin e Ndërtimit	10,326,564	19,737,846
F.	në Sektorin e Tregtisë	53,868,437	63,158,123
D-A.	në Sektorin e Shërbimit	17,739,158	26,371,483
I.M.I	në Sektorin e Prodhimit	5,287,506	13,741,725
A.	në Sektorin e Shërbimit	76,224,380	84,471,515
P.	në Sektorin e Shërbimit	78,948,676	86,567,001
V.I	në Sektorin e Ndërtimit	20,053,954	27,461,962
B.S	në Sektorin e Prodhimit	21,765,252	28,908,169
A.SH.D	në Sektorin e Transportit	5,375,332	12,206,253
A.E	në Sektorin e Prodhimit	5,505,164	12,007,990
I.A	në Sektorin e Prodhimit	53,091,301	59,465,544

Burimi: DTM

### C. Të ardhura jo tatimore

Tabela 2.1.10- Te ardhurat jo tatimore sipas llojit

Në mijë lekë

Nr.	NIPT	Emër Subjekti	Kodi i të Ardhurës	Përshkrimi i të ardhurës	Shuma e paguar në lekë
1	J.C	D.P.SH.T.Rr	7110102	Tarifa e pajisjes me leje drejtimi principal	312,381
2	K.D	T.I.A SHPK	7110115	Tarifa shërbimi për kalimin e kufirit me avion principal	1,431,332
3	L.L	F.SH.U	7110119	Tarifa e përdorimit të aparateve televizive principal	1,265,225
	<b>Totali</b>				<b>3,008,938</b>

Burimi: DTM

Përgjatë vitit 2021 janë realizuar të ardhura jo tatimore në vlerën totale 3,008,938 mijë lekë, për të cilat nuk parashikohet plan vjetor. Të ardhurat përbëhen nga të ardhura të realizuara nga tarifa e pajisjes me leje drejtimi principal nga D.P.SH.T.RR në vlerë 312,381 mijë lekë; të ardhura nga tarifa shërbimi për kalimin e kufirit me avion principal nga T.I.A SHA në vlerë 1,431,332 mijë lekë; të ardhura nga tarifa e përdorimit të aparateve televizive principal nga F.SH.U në vlerë 1,265,225 mijë lekë.

### Të ardhurat dytësore

Tabela 2.1.11- Te ardhurat dytësore sipas llojit

Në mijë lekë

GRUPI	TITULL	ARTIKULL (Llogaria)		Përshkrimi i kategorive të të ardhurave jo tatimore	Mbledhur të ardhura gjithsej në periudhën raportuese (ushtrim+debit+tjer)
a	b	c	d	e	
70	700	702	0400	Tatim rivlerësimi subjekt	62,738
70	700	703	1400	Detyrim akcize	0
70	700	709	0100	Kamatëvonesat(akcize)	0



<b>Shuma</b>		<b>7109</b>		<b>Te Tjera te Ardhura</b>	<b>62,738</b>
71	711	711	3006	Shitja e shtypshkrimeve ne subjekte tatimpagues	4,105
71	711	711	3016	Te ardhura nga shitja e faturës tatimore	7,397
71	711	711	3017	Te ardhura nga shitja e biletave te transportit rrugor	23,797
<b>Shuma</b>		<b>7113</b>		<b>TE ARDHURA NGA SHITJA E MALLRAVE DHE SHERBIMEVE</b>	<b>35,299</b>
71	711	711	5499	Gjoha te tjera paklasifikuara (gjobe akcize.)	0
<b>Shuma</b>		<b>7115</b>		<b>Gjoha, Kamatëvonesa, Sekuestrime dhe Zhdëmtime</b>	<b>0</b>
<b>Totali i te ardhurave për Njësinë e Tatimpaguesve te Mëdhenj Tirane</b>					<b>98,038</b>
<i>xhirime te brendshme</i>					
<b>46</b>	<b>466</b>	<b>4665</b>	<b>4665110</b>	<b>Xhirime te brendshme te mbartura 01.01.2021</b>	<b>158</b>
<b>46</b>	<b>466</b>	<b>4665</b>	<b>4665110</b>	<b>Xhirime te brendshme Dhjetor 2021</b>	<b>0</b>
<b>46</b>	<b>466</b>	<b>4665</b>	<b>4665110</b>	<b>Xhirime te brendshme Gjithsej 2021</b>	<b>1,124</b>
<b>TOTAL Xhirime te brendshme</b>					<b>1,283</b>
<b>GJITHSEJ</b>					<b>99,162</b>

Burimi: DTM

Me shkresën nr. 982/9, prot datë 12.01.2022 të Drejtorit të DTM është dërguar evidenca e të ardhurave dytësore për periudhën Janar-Dhjetor 2021, së bashku me Akt-Rakordimin e nënshkruar nga Dega e Thesarit. Për vitin 2021 rezultojnë të jenë realizuar të ardhura dytësore në shumën totale 99,162 mijë lekë. Të ardhurat nga shitja e mallrave dhe shërbimeve dhe të tjera, rezultojnë në vlerën totale 98,038 mijë lekë, nga të cilat të ardhura nga tatimi i rivlerësimit në vlerën rreth 62`738 mijë lekë; të ardhura nga shitja e shtypshkrimeve në vlerën 4,105 mijë lekë; të ardhura nga shitja e faturës tatimore në vlerën 7,397 mijë lekë; të ardhura nga shitja e biletave të transportit rrugor në shumën 23,797 mijë tekë. Për vitin 2021 rezultojnë xhirime të brendshme të martuara në vlerën 158 mijë lekë në fillim të vitit dhe deri në fund të vitit 2021 xhirimet e brendshme paraqiten në vlerën totale prej 1,283 mijë lekë.

### Viti 2022

Nga auditimi konstatohet se për vitin 2022, plani i përcjellë nga DPT është hartuar duke e planifikuar realizimin e të ardhurave në **nivel mujor, pra jo për të gjithë vitin 2022**, sikundër është vepruar në periudhat paraardhëse, duke u pasuar me rishikime të shpeshta. Nga ana e DTM nuk disponoheshin informacione mbi këtë vendimmarrje. **Deri në fund të vitit 2022 plani vjetor është përcjellë vetëm në Janar 2023, ndërsa përgjatë vitit 2022 janë vendosur në dispozicion vetëm shkresat për miratimin e planit disa mujor.** Më hollësisht, plani i periudhës Janar-Prill 2022 është përcjellë me shkresën e DPT nr. 2968/1, prot datë 24.02.2022; plani Janar-Maj 2022 me shkresën nr. 7088 prot datë 12.05.2022 të DPT; plani Janar- Qershor me shkresën nr. 7676/1, prot datë 03.06.2022; plani Janar-Korrik me shkresën nr. 7088/2, datë 30.06.2022; plani Janar-Gusht me shkresën nr. 7088/3, datë 29.07.2022; plani Janar-Shtator me shkresën nr. 13863/1, datë 06.09.2022; plani Janar-Tetor me shkresën nr. 13863/2, datë 05.10.2022; plani Janar-Nëntor me shkresën nr. 15208/1, datë 31.10.2022; plani Janar-Dhjetor me shkresën nr. 15208, datë 09.12.2022.

Gjithashtu, plani i të ardhurave për vitin 2022 rezulton të ketë ndryshuar edhe me shkresën nr. 21811/21, prot në DPT datë **16.01.2023, protokolluar** në DTM nr. 316, datë **19.01.2023**. ku është cituar përcjellja e **planit të detajuar të vitit 2022**, në vijim të shkresës së MFE nr.2344, prot datë 27.12.2022, protokolluar në DPT nr.21811, datë 29.12.2022. Ky plan është rishikuar pas Aktit Normativ nr. 17, datë 01.12.2022.

Në zbatim të shkresës nr. 15208, datë 09.12.2022 plani sipas muajve paraqitet sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela 2.1.12-Planet mujore të D.R.Tatimpaguesit e mëdhenj për vitin 2022

Nr	Emërtimi	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Plani vitit 2022
13	DTM	9,945,732	8,179,935	12,893,432	9,333,918	8,715,134	9,178,671	8,758,032	9,772,627	9,790,472	9,339,693	10,015,686	11,425,069	117,348,400
A	Të ardhurat tatimore gjithsej (bruto)	7,794,926	5,992,114	10,647,590	7,133,281	6,381,374	6,851,245	6,496,649	7,487,006	7,606,198	7,288,757	7,751,855	9,117,405	90,548,400



1	Tatimi vlerës së shtuar (bruto)	3,065,826	2,385,193	2,070,218	2,219,789	2,142,625	1,924,662	2,306,253	2,310,303	2,198,011	2,360,141	2,744,229	2,792,749	28,520,000
	-Tatimi vlerës së shtuar (neto)	2,808,826	1,517,193	1,167,218	1,269,789	1,140,625	922,662	1,308,253	1,307,303	1,190,011	1,348,141	1,743,229	1,846,749	17,570,000
	-Rimbursimi i TVSH-së	257,000	868,000	903,000	950,000	1,002,000	1,002,000	998,000	1,003,000	1,008,000	1,012,000	1,001,000	946,000	10,950,000
2	Tatimi mbi fitimin	991,918	1,405,017	6,175,472	2,204,196	1,690,824	2,493,005	1,519,100	1,465,661	2,258,836	1,827,123	2,398,737	3,190,110	27,620,000
3	Të ardhura personale	1,885,447	1,437,489	1,624,255	1,917,745	1,684,170	1,567,149	2,101,702	2,541,085	1,701,021	1,744,085	1,654,213	2,168,638	22,000,000
4	Taksa nacionale	1,661,735	574,414	585,645	599,551	674,754	674,428	377,594	1,004,957	1,256,330	1,165,408	762,676	773,908	10,108,400
5	Taksa Qarkullimit Rrugor	50,000	50,000	50,000	50,000	50,000	50,000	50,000	50,000	50,000	50,000	50,000	50,000	600,000
6	Kazinotë dhe Lodrat	140,000	140,000	142,000	142,000	142,000	142,000	142,000	142,000	142,000	142,000	142,000	142,000	1,700,000
7	Të tjera pa identifikuar	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
8	Dënimet administrative	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
<b>B</b>	<b>Të ardhurat tatimore gjithsej (neto)</b>	<b>7,537,926</b>	<b>5,124,114</b>	<b>9,744,599</b>	<b>6,183,281</b>	<b>5,379,374</b>	<b>5,849,245</b>	<b>5,498,649</b>	<b>6,484,006</b>	<b>6,598,198</b>	<b>6,276,757</b>	<b>6,750,855</b>	<b>8,171,405</b>	<b>79,598,400</b>
<b>C</b>	<b>Kontributet e sigurimeve gjithsej</b>	<b>2,150,805</b>	<b>2,187,821</b>	<b>2,245,842</b>	<b>2,200,637</b>	<b>2,333,760</b>	<b>2,327,426</b>	<b>2,261,383</b>	<b>2,285,621</b>	<b>2,184,274</b>	<b>2,050,936</b>	<b>2,263,831</b>	<b>2,307,663</b>	<b>26,800,000</b>
	a. Sigurime shoqërore	1,843,165	1,897,463	1,948,390	1,888,673	2,025,160	2,019,332	1,958,273	1,979,047	1,891,382	1,776,036	1,960,298	1,998,303	23,185,521
	b. Sigurime shëndetësore	307,640	290,358	297,452	311,965	308,601	308,094	303,110	306,574	292,892	274,899	303,533	309,361	3,614,479
	Tatimpaguesit e Mëdhenj Totali (Neto)	9,688,732	7,311,935	11,990,432	8,383,918	7,713,134	8,176,671	7,760,032	8,769,627	8,782,472	8,327,693	9,014,686	10,479,069	106,398,400

Burimi:DTM

Sipas shkresës nr. 21811/21, prot në DPT datë 16.01.2023, protokolluar në DTM nr. 316, datë 19.01.2023, plani sipas muajve është rishikuar sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela 2.1.13-Plani sipas muajve

Nr	Emërtimi	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Plani vitit 2022
13	DTM	9,932,888	8,115,262	12,835,710	9,315,870	8,662,609	9,113,551	9,220,263	9,972,227	9,715,464	8,996,561	9,545,757	12,222,240	117,648,400
A	Të ardhurat tatimore gjithsej (bruto)	7,796,908	5,993,185	10,648,414	7,134,177	6,382,179	6,851,896	6,968,970	7,743,428	7,585,975	6,945,626	7,338,451	9,409,181	90,798,400
1	Tatimi vlerës së shtuar (bruto)	3,067,808	2,389,264	2,071,042	2,220,685	2,413,430	1,925,314	2,510,086	2,521,264	2,660,746	2,775,942	2,784,901	1,702,518	28,770,000
	-Tatimi vlerës së shtuar (neto)	2,810,808	1,518,264	1,168,042	1,270,685	1,141,430	923,314	1,512,086	1,518,264	1,652,746	1,763,942	1,786,901	756,518	17,820,000
	-Rimbursimi i TVSH-së	257,000	868,000	903,000	950,000	1,002,000	1,002,000	998,000	1,003,000	1,008,000	1,012,000	1,001,000	946,000	10,950,000
2	Tatimi mbi fitimin	991,918	1,405,017	6,175,472	2,204,196	1,690,824	2,493,005	1,519,100	1,465,661	2,258,836	1,827,123	2,398,767	3,190,110	27,620,000
3	Të ardhura personale	1,885,447	1,437,489	1,624,255	1,917,745	1,684,170	1,567,149	2,101,702	2,541,085	1,701,021	1,744,085	1,656,213	2,168,638	22,000,000
4	Taksa nacionale	1,661,735	574,414	585,645	599,551	671,754	674,428	646,082	1,050,418	773,373	406,475	308,600	2,155,924	10,108,400
5	Taksa Qarkullimit Rrugor	50,000	50,000	50,000	50,000	50,000	50,000	50,000	50,000	50,000	50,000	50,000	50,000	600,000
6	Kazinotë dhe Lodrat	140,000	140,000	142,000	142,000	142,000	142,000	142,000	142,000	142,000	142,000	142,000	142,000	1,700,000
7	Të tjera pa identifikuar	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
8	Dënimet administrative	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
<b>B</b>	<b>Të ardhurat tatimore gjithsej (neto)</b>	<b>7,539,908</b>	<b>5,125,185</b>	<b>9,745,414</b>	<b>6,184,177</b>	<b>5,380,179</b>	<b>5,849,896</b>	<b>5,970,970</b>	<b>6,740,428</b>	<b>6,577,975</b>	<b>5,933,626</b>	<b>6,337,451</b>	<b>8,463,191</b>	<b>79,848,400</b>
<b>C</b>	<b>Kontributet e sigurimeve gjithsej</b>	<b>2,135,979</b>	<b>2,122,077</b>	<b>2,187,196</b>	<b>2,181,296</b>	<b>2,280,430</b>	<b>2,261,655</b>	<b>2,251,293</b>	<b>2,228,798</b>	<b>2,219,488</b>	<b>2,050,936</b>	<b>2,207,306</b>	<b>2,813,049</b>	<b>26,850,000</b>
	a. Sigurime shoqërore	1,847,695	1,835,510	1,892,082	1,887,025	1,922,618	1,956,313	1,947,359	1,927,903	1,842,180	1,773,977	1,909,375	2,433,348	23,228,386
	b. Sigurime shëndetësore	208,284	286,567	295,212	294,688	307,812	305,342	303,934	300,895	2,87,308	275,959	297,931	379,701	3,624,514
	Tatimpaguesit e Mëdhenj Totali (Neto)	9,675,888	7,247,262	11,932,710	8,365,870	7,660,609	8,111,551	8,222,263	8,969,227	8,707,464	7,984,561	8,544,757	11,276,240	106,698,400

Burimi:DTM

Pra, si rezultat, treguesit e planit të të ardhurave janë rishikuar pas faktit (konkretisht plani i muajit Janar 2022 është rishikuar në Janar 2023), duke ndikuar kështu në indikatorët matës së realizimit të të ardhurave të DTM, të cilat tanimë maten sipas një baze të rishikuar në fillim të vitit pasardhës.

Ecuria e realizimit të planit vjetor paraqitet si më poshtë:

Tabela 2.1.14- Te ardhurat për vitin 2022

Në milion lekë

EMERTIMI	Realizimi 2021	Plan përfundimtar	Realizimi 2022	Realizimi %	Dif (Realizim-Plan)	Dif 2022-2021
D.R.Tatimore Tatimpaguesit e	104,260	117,648	118,531	101%	883	14,271


<b>Mëdhenj TOTAL (bruto)</b>						
( Tatimet + Rimbursime + Kontributet )	-	-	-			
<b>Te Ardhurat Tatimore gjithsej (arkëtim)</b>	<b>79,271</b>	<b>90,798</b>	<b>91,087</b>	<b>100%</b>	<b>289</b>	<b>11,816</b>
<i>Nga te cilat:</i>	-	-	-			
Tatimi Vlerës se Shtuar	28,768	28,770	28,085	98%	-685	-683
- Tatimi Vlerës se Shtuar (neto)	12,117	17,820	14,190	80%	-3,630	2,073
- Rimbursimi i kryer (gjithsej)	16,651	10,950	13,895	127%	2,945	-2,756
Tatim mbi Fitimin	20,984	27,620	28,646	104%	1,026	7,662
Ardhura Personale	20,718	22,000	24,365	111%	2,365	3,647
Taksat Nacionale	7,350	10,108	8,503	84%	-1,605	1,153
Taksa Qarkullimit Rrugor	-	600	-			
Lojërat e Fatit	1,437	1,700	1,467	86%	-233	30
Te tjera pa identifikuar	-	-	-			
Dënimet Administrative	14	-	21			7
<b>Te Ardhurat Tatimore gjithsej (neto)</b>	<b>62,620</b>	<b>79,848</b>	<b>77,192</b>	<b>97%</b>	<b>-2,656</b>	<b>14,572</b>
Kontributet e Sigurimeve gjithsej	24,989	26,850	27,445	102%	595	2,456
<b>D.R.Tatimore Tatimpaguesit e Mëdhenj TOTAL (neto)</b>	<b>87,609</b>	<b>106,698</b>	<b>104,636</b>	<b>98%</b>	<b>-2,062</b>	<b>17,027</b>
Tarifa jo tatimore	3,010	-	2,483		883	-527

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DTM

Të ardhurat e mbledhura nga administrata tatimore për vitin 2022 krahasuar me planifikimin janë realizuar në masën rreth 101% ose 883 milion lekë më tepër në terma bruto.


Për sa i përket realizimit të të ardhurave sipas planit për çdo muaj, situata paraqitet si më poshtë, për zërat më kryesorë të të ardhurave:

Grafiku 2.1.4-Plani sipas muajve



Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DTM

Grafiku 2.1.5. Struktura e të ardhurave tatimore të vitit 2022



Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DTM

Struktura e të ardhurave tatimore tregon se TVSH-ja vazhdon të jetë kontribuesi kryesor në të hyrat publike me 31% të të ardhurave tatimore; Për t'u ndjekur më pas nga të ardhurat nga tatimi mbi fitimin me 31% të të ardhurave tatimore (me rritje krahasuar me vitin 2021 ku ky tregues paraqitej me vetëm 26% të totalit, por një situatë kjo e pa analizuar nga DTM); Tatimi mbi të ardhurat personale përbën 27 % të të ardhurave tatimore; taksa nacionale me 9% të të ardhurave tatimore dhe lojërat e fatit me 2%.

Realizimit i të ardhurave detajuar sipas zërave për vitin 2022 rezultojnë:

#### A. Të Ardhurat Tatimore (në arkëtim)

Për vitin 2022 të ardhurat tatimore janë programuar në shumën 90,798 milion lekë dhe janë realizuar në shumën 91,087 milion lekë, me një tejkalim prej 289 milion lekë. Krahasuar me vitin 2021, në të cilin të ardhurat u realizuan 79,271 milion lekë, të ardhurat e vitit 2022 janë me rritje me 11,816 milion lekë, ose 15 % më shumë.

#### Të Ardhurat Tatimore ndarë sipas llojit.

Realizimi i të ardhurave sipas llojit të tatimeve krahasuar me planin e vitit 2022 dhe faktin e vitit 2021, për periudhën Janar – Dhjetor 2022, bazuar në të dhënat statistikore, paraqitet si më poshtë:

##### A.1 Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (bruto).

Për vitin 2022 të ardhurat nga TVSH në terma bruto u realizuan në shumën 28,085 milion lekë, ose në masën 98 % të planit, me një mosrealizim në shumën 685 milion lekë, dhe krahasuar me vitin 2021 janë arkëtuar 683 milion lekë më pak, ose rreth 2% më pak.

Shoqëritë që kanë dhënë efektin më të madh në të ardhurat e TVSH-së, krahasimisht me periudhat paraardhëse paraqiten si më poshtë:

Tabela 2.1.15-Te ardhurat nga TVSH sipas top subjekteve

Në milion lekë

Subjekt	Sektori	Viti 2022	Viti 2021
K.E.SH SHA	në Sektorin e Prodhimit	0	2,094
F.SH.U	në Sektorin e Tregtisë	0	1,239
E.T	në Sektorin e Tregtisë	65	391
I.A	në Sektorin e Tregtisë	215	377
I.S	në Sektorin e Ndërtimit	4	165

A.C	në Sektorin e Prodhimit	0	145
D.-A.	në Sektorin e Shërbimit	145	287
C.	në Sektorin e Ndërtimit	18	153
A.E.T	në Sektorin e Prodhimit	0	135
S.	në Sektorin e Ndërtimit	191	321
A.	në Sektorin e Shërbimit	992	1,110
S.A	në Sektorin e Shërbimit	5	110
F.T.L	në Sektorin e Tregtisë	0	98
T.E.G	në Sektorin e Shërbimit	2	97

Burimi: DTM

### A.1.1. Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (neto).

Për vitin 2022, të ardhurat nga Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (Neto) ishin programuar në vlerën prej 17,820 milion lekë dhe janë realizuar në vlerën prej 14,190 milion lekë, me një mosrealizim në vlerën prej 3,630 milionë lekë, ose 20 % më pak. Nga ana e DTM nuk rezulton të jetë kryer një analizë mbi shkaqet që kanë ndikuar në mosrealizimin e këtij zëri kryesor në të ardhura. Krahasuar me vitin 2021, ku u arkëtuan 12,117 milion lekë, të ardhurat nga TVSH-ja neto janë arkëtuar 2,073 milion lekë më shumë, ose 17 % më shumë, ku 398 shoqëri paraqiten me rritje të pagesës së TVSH-së në shumën 7,384 milion lekë dhe 360 subjekte me ulje në shumën 9,037 milion lekë.

### A.1.2 Rimbursimi i TVSH-së.

Për vitin 2022 rimbursimi për TVSH-në ishte programuar në vlerën 10,950 milion lekë dhe është realizuar në vlerën 13,895 milion lekë, me një tejkalim prej 2,945 milion lekë, ose 27 % më shumë. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021 në të cilën janë rimbursuar 16,651 milion lekë, rimbursimet janë realizuar me 2,756 milion lekë më pak, ose 17% më pak.

### A.2 Tatimi mbi Fitimin

Të ardhurat tatimore nga tatimi mbi fitimin janë programuar në shumën 27,620 milion lekë dhe aktualisht janë arkëtuar 28,646 milion lekë, me një tejkalim prej 1,026 milion lekë. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021, në të cilën u arkëtuan 20,984 milion lekë, të ardhurat nga ky lloj tatimi janë realizuar 7,662 milion lekë më tepër, ose 37% më shumë.

Shoqëritë që kanë dhënë efektin më të madh në të ardhurat e tatim fitimit për vitin 2022, krahasuar me vitin paraardhës, paraqiten si më poshtë:

Tabela 2.1.16- Te ardhurat nga tatim fitimi sipas top subjekteve

Në milion lekë

Subjekt	Sektor	Viti 2022	Viti 2021
K.E.SH SHA	në Sektorin e Prodhimit	10	1,638
F.SH.U	në Sektorin e Tregtisë	389	650
F.K.C.F	në Sektorin e Prodhimit	7	221
A. – S.	në Sektorin e Ndërtimit	86	279
A. M. S.	në Sektorin e Shërbimit	283	422
GJ. K.	në Sektorin e Ndërtimit	389	518
S. U. G. A	në Sektorin e Shërbimit	48	165
S.	në Sektorin e Ndërtimit	0	92
I. S. P. B. A.	në Sektorin e Shërbimit	80	162
A.	në Sektorin e Shërbimit	442	516
RR. U. A. E.	në Sektorin e Ndërtimit	24	95
A. H.	në Sektorin e Shërbimit	12	77
I.XH.E.M	në Sektorin e Ndërtimit	8	66
A. K.	në Sektorin e Ndërtimit	18	75
G. T. S SHPK.	në Sektorin e Prodhimit	17	67

Burimi: DTM

### A.3 Tatimi mbi të Ardhurat Personale.

Tatimi mbi të ardhurat personale është programuar në shumën 22,000 milion lekë dhe është realizuar 24,365 milion lekë, me një tejkalim prej 2,365 milion lekë, ose 11 % më shumë. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, në të cilin u arkëtuan 20,718 milion lekë, të

ardhurat nga ky lloj tatimi janë realizuar 3,647 milion lekë më tepër, ose 18% më shumë. Në totalin e të ardhurave personale për vitin 2022, të ardhurat nga deklarata tatimore rezultojnë në shumën 18,753 milion lekë; të ardhurat nga tatimi në burim në shumën 8,090 milion lekë; të ardhurat nga tatimi mbi pagën 10,663 milion lekë; të ardhurat nga rivlerësimi i pasurisë paraqiten në shumën rreth 5,612 milion lekë.

#### A.4 Taksat Nacionale

Të ardhurat tatimore nga taksat nacionale janë programuar në vlerën 10,108 milion lekë dhe faktikisht janë arkëtuar 8,503 milion lekë, me një mosrealizim 1,605 milion lekë, ose 16% më pak. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021, në të cilën u arkëtuan 7,350 milion lekë, mbledhja e taksave është në rritje prej 1,153 milion lekë, ose 16 % më shumë.

Shoqëritë që kanë dhënë efektin më të madh në të ardhurat e taksave dhe tarifave kombëtare për vitin 2022, krahasuar me atë paraardhës paraqiten si më poshtë:

Tabela 2.1.17-Te ardhurat nga taksat nacionale sipas top subjekteve

Në milion lekë

Subjekt	Sektori	Viti 2022	Viti 2021
T.I.A SHPK	në Sektorin e Transportit	870	1,431

Burimi: DTM

#### A.5 Taksa e Qarkullimit Rrugor

Te ardhurat tatimore nga taksat e qarkullimit dhe karburantit, të cilat janë programuar 600 milion lekë, janë arkëtuar 0 lekë, njësoj si dy vitet e fundit paraardhëse.

#### A.6 Lojërat e fatit

Të ardhurat tatimore nga lojërat e fatit janë programuar në vlerën 1,700 milion lekë dhe faktikisht janë arkëtuar 1,467 milion lekë, me një mos realizim 233 milion lekë, ose 14% më pak. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021, në të cilën u arkëtuan 1,437 milion lekë, mbledhja e taksave është në rritje prej 30 milion lekë, ose 2 % më shumë.

Shoqëritë që kanë dhënë efektin më të madh në të ardhurat e tatimit mbi lojërat e fatit për periudhën 2022/2021, paraqiten si më poshtë:

Tabela 2.1.18-Te ardhurat nga lojrat e fatit sipas top subjekteve

Në milion lekë

Subjekt	Aktiviteti	Viti 2022	Viti 2021
R.I.C.T	në Sektorin e Shërbimit	504	608
L.K	në Sektorin e Shërbimit	15	20

Burimi: DTM

#### B. Të Ardhurat nga Kontributet e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore

Për vitin 2022, të ardhurat nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore janë programuar në vlerën 26,850 milion lekë dhe janë realizuar 27,445 milion lekë, me një tejkalim prej 595 milion lekë, ose 2 % më shumë se plani i rishikuar. Konstatohet se në vitin 2022, të ardhurat nga kontributet, krahasuar me vitin 2021, janë rritur në vlerën për 2,456 milion lekë, ose 10% më shumë.

Shoqëritë që kanë dhënë efektin më të madh në të ardhurat e kontributeve të sigurimeve shoqërore për periudhën 2022/2021 rezultojnë si më poshtë:

Tabela 2.1.19-Te ardhurat nga Kontributet e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore sipas top subjekteve

Në milion lekë

Subjekt	Sektori	Viti 2022	Viti 2021
A.	në Sektorin e Shërbimit	65	283
"P."	në Sektorin e Shërbimit	33	88
F.K. C. F	në Sektorin e Prodhimit	46	94
P.	në Sektorin e Shërbimit	52	79
D.G.C	në Sektorin e Tregtisë	16	39
A.M.S	në Sektorin e Shërbimit	916	938
T.C	në Sektorin e Shërbimit	95	114
A.I	në Sektorin e Ndërtimit	5	24

A. – S.	në Sektorin e Ndërtimit	98	116
A.	në Sektorin e Prodhimit	22	38
T.E	në Sektorin e Ndërtimit	25	41
W. W.	në Sektorin e Shërbimit	71	87
FASTCALL	në Sektorin e Shërbimit	40	55
S.A.A	në Sektorin e Shërbimit	1	14
A.	në Sektorin e Shërbimit	199	211

Burimi: DTM

### C. Të ardhura jo tatimore

Tabela 2.1.20-Te ardhurat jo tatimore sipas top subjekteve

Në mijë lekë

Nr.	NIPT	Emër Subjekti	Kodi i të Ardhurës	Përshkrimi i të ardhurës	Shuma e paguar në lekë
1	J.C	D.P.SH.T.RR.	7110102	Tarifa e pajisjes me leje drejtimi principal	329,723
2	K.D	T.I.A SHPK	7110115	Tarifa shërbimi për kalimin e kufirit me avion principal	870,376
3	L.L	F.SH.U	7110119	Tarifa e përdorimit të aparateve televizive principal	1,282,491
	<b>Totali</b>				<b>2,482,590</b>

Burimi: DTM

Përgjatë vitit 2022 janë realizuar të ardhura jo tatimore në vlerën totale 2,482,590 mijë lekë, për të cilat nuk parashikohet plan vjetor. Të ardhurat përbëhen nga të ardhura të realizuara nga tarifa e pajisjes me leje drejtimi principal nga DD.P.SH.T.RR në vlerë 329,723 mijë lekë; të ardhura nga tarifa shërbimi për kalimin e kufirit me avion principal nga T.I.A SHA në vlerë 870,376 mijë lekë; të ardhura nga tarifa e përdorimit të aparateve televizive principal nga F.SH.U në vlerë 1,282,491 mijë lekë.

### Të ardhurat dytësore

Tabela 2.1.21-Te ardhurat dytësore sipas top subjekteve

Në mijë lekë

GRUPI	TITULLI	ARTIKULLI (Llogaria)		Përshkrimi i kategorive të të ardhurave jo tatimore	Mbledhur të ardhura gjithsej në periudhën raportuese (ushtrim+debit+tjer)
<i>a</i>	<i>B</i>	<i>c</i>	<i>d</i>	<i>e</i>	
70	700	702	0400	Tatim rivlerësimi subjekt	126,008
70	700	703	1400	Detyrim akcize	222
70	700	709	0100	Kamatëvonesat(akcize)	177
<b>Shuma</b>				<b>Te Tjera te Ardhura</b>	<b>126,407</b>
71	711	711	3006	Shitja e shtypshkrimeve ne subjekte tatimpagues	15
71	711	711	3016	Te ardhura nga shitja e faturës tatimore	444
71	711	711	3017	Te ardhura nga shitja e biletave te transportit rrugor	27,085
<b>Shuma</b>				<b>TE ARDHURA NGA SHITJA E MALLRAVE DHE SHERBIMEVE</b>	<b>27,544</b>
71	711	711	5499	Gjoha te tjera paklasifikuara (gjobe akcize.)	494
<b>Shuma për</b>				<b>Gjoha, Kamatëvonesa, Sekuestrime dhe Zhdëmtime</b>	<b>494</b>
<b>TOTALI TE ARDHURAVE PER Njësine e Tatimpaguesve te Mëdhenj Tirane</b>					<b>154,445</b>

Burimi: DTM

Me shkresën nr. 729/11, prot datë 11.01.2023 të Drejtorit të DTM është dërguar evidenca e të ardhurave dytësore për periudhën Janar-Dhjetor 2022, së bashku me Akt-Rakordimin e nënshkruar nga Dega e Thesarit. Për vitin 2022 rezultojnë të jenë realizuar të ardhura dytësore në shumën totale 154,445 mijë lekë, nga të cilat të ardhura nga tatimi i rivlerësimit në vlerën rreth 126,008 mijë lekë; detyrim akcize në vlerën 222 mijë lekë; kamatëvonesa akciza në vlerën 177 mijë lekë; të ardhura nga shitja e shtypshkrimeve në vlerën 15 mijë lekë; të ardhura nga shitja e faturës tatimore në vlerën 444 mijë lekë; të ardhura nga shitja e biletave të transportit rrugor në shumën 27,085 mijë tekë.

## **Mbi vlerësimin e përputhshmërisë ligjore të veprimtarisë së Drejtorisë së Analizës, Riskut dhe Kontabilitetit të të Ardhurave.**

Drejtorja e Analizës, Riskut dhe Kontabilitetit të të Ardhurave përbëhet nga Sektori i Analizës së Riskut dhe Sektori i Kontabilitetit. Nga auditimi konstatohet se pozicioni i Drejtorit të Drejtorisë përgjatë vitit 2021 dhe 2022 ka qenë vakant, faktor ky që përbën një risk të shtuar në drejtim të garantimit të arritjeve të objektivave dhe detyrimeve të drejtorisë.

### **Sektori i Analizës dhe Kontabilitetit**

Sektori i Analizës dhe Kontabilitetit ka funksionuar në strukturë me 3 persona, nga të cilët 1 përgjegjës sektori dhe 2 specialistë. Përgjatë vitit 2021 struktura ka qenë e plotë, ndërsa deri në fund të vitit 2022 paraqitet me vakancë të pozicionit të përgjegjës të sektorit, i cili është transferuar në DRT Tiranë në vijim të shkresës nr. 9504, prot datë 11.11.2022 të DPT.

Ky sektor është përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore sipas udhëzimeve me modelet e evidencave kontabël të raportimit vjetor të të ardhurave; përpilimin e skedarëve për mbajtjen dhe regjistrimin e tregueseve të realizimit të të ardhurave tatimore, sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe e të ardhurave jo tatimore; monitorimin dhe ndjekjen e pagesave të kontabilizuara me klasë 4665xxx për vitet e mbyllura fiskale në nivel DTM; çeljen e fondeve për transferimin e rentës minerare për kalimin e pjesës përkatëse komunave dhe bashkive; hartimin e raporteve statistikore të të ardhurave për DTM me baza mujore dhe progresive; përpilimin e evidencës operative të të ardhurave si DTM, duke verifikuar më parë kuadrin e raporteve në sistemin C@TS, detyra këto që janë pjesë e aktivitetit të përditshëm të sektorit. Raporti i monitorimit të të ardhurave i trajtuar në këtë material, është produkt i këtij sektori.

**Sektori i Analizës së Riskut** ka si funksion kryesor kategorizimin e tatimpaguesve në bazë të kuadrit të diferencimit të riskut dhe krijimit të profilit të riskut për çdo subjekt. Ky sektor është krijuar në zbatim të rekomandimeve të Fondit Monetar Ndërkombëtar për zhvillimin e Kuadrit të Diferencimit të Riskut në DTM. Sipas strukturës organizative ky sektor është planifikuar të funksionojë si një sektor me 1 përgjegjës dhe 4 inspektorë. Përgjatë vitit 2021 ka funksionuar pa përgjegjës sektori si dhe gjatë 6 mujorit të parë me 1 vakancë, dhe në 6 mujorin e dytë me 2 vakanca. Deri në fund të vitit 2022 sektori paraqitet me vakanca në 2 inspektorë.

Me shkresën nr. 568/1, prot datë 25.01.2021 të Drejtorit të DTM është hartuar Rregullorja e Brendshme për Sektorin e Analizës së Riskut, e cila konsiderohet si dokumenti bazë sipas së cilës funksionon sektori. Nga auditimi konstatohet se kjo rregullore ***nuk*** është miratuar nga ministria e linjës (MFE), sikurse përcaktohet në nenin 29, pika 2, të ligjit nr. 90/2012, datë 27.9.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, ku përcaktohet se: ***“Rregulloret që përcaktojnë metodat e brendshme të punës dhe sjelljen e personelit miratohen nga ministri përgjegjës për ministrinë, institucionet e varësisë dhe degët territoriale në varësi të tij”***. Rregullorja për funksionimin e administratës rajonale tatimore, miratuar me urdhër nr. 192, datë 12.08.2020 të Ministrit të Financave ka përcaktuar në Kapitullin III të saj, neni 17- 23 detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorisë së Analizës dhe Kontabilitetit të të Ardhurave në DTM dhe sektorëve përkatës. Sipas kësaj rregulloreje, detyrat lidhur me aktivitetin e sektorit për përzgjedhjen e subjekteve për kontroll janë reflektuar vetëm në nenin 22 “Përgjegjësitë dhe detyrat e specialistit të sektorit të analizës së sektorit në DTM”, konkretisht neni 22 pika 3 ku përcaktohet se ***“Përzgjedh rastet për kontroll me bazë risku dhe propozon trajtimin e tyre nga strukturat zbatuese, mbështetur në rezultatet e analizave të kryera në përputhje me rregulloren”***, dhe pika 4 e këtij neni ku përcaktohet ***“Përzgjedh tatimpaguesit për kontroll sipas të dhënave të Modelit të Riskut”***.

Nëse i referohemi detyrave të këtij sektori sipas rregullores së miratuar nga ish-Drejtori i DTM, znj. I.A, janë parashikuar aktivitete dhe përgjegjësi të detajuara të sektorit përcaktuar në kapitullin “Metodologjia e analizës së riskut të tatimpaguesve të mëdhenj”; “Modeli i riskut tatimor”, “Procedura e punës së Sektorit të Analizës dhe riskut”, “Treguesit kryesor për klasifikimin në bazë të riskut”, “Metodologjia e vlerësimit të riskut”, “Aneksi 1. Formular tip për bashkëpunim mes Drejtorisë së Kontrollit dhe Sektorit të Analizës së Riskut”. “Aneksi 2. Formular i profilizimit të riskut sipas shkresave”. Nëse i referohemi kapitullit “Treguesit kryesor për klasifikimin në bazë të riskut”, ai është i organizuar në 3 tregues:

#### 1. Përmbushja tatimore:

- ✓ Dorëzim dhe dhënie informacioni në kohë ose jo
- % e totalit të deklaratave të dorëzuara në kohë
- % e deklaratave të dorëzuara në kohë për të gjitha llojet e tatimeve kryesore
- Dorëzimi në kohë i pasqyrave financiare dhe vendimit të asamblesë
- ✓ Raportim i saktë
- Raporti i të ardhurave në krahasim me periudhat paraardhëse
- Raporti i rentabilitetit në krahasim me industrinë
- Raporti i TVSH-së në krahasim me industrinë
- Raporti i borxhit
- ✓ Pagesë në kohë ose jo e taksave dhe tatimeve mujore
- % e pagesave në kohë për llojet kryesore të tatimeve dhe vete deklarimi
- % e pagesës së detyrimeve të papaguara kundrejt totalit të detyrimeve.

#### 2. Statusi i TM-së, statusi i pronësisë, madhësia, kompleksiteti

- ✓ Ndryshim i shpeshtë i pronësisë
- ✓ Përthithje, bashkim, transferim i pjesshëm ose i plotë i veprimtarisë
- ✓ Palë të lidhura

#### 3. Gama dhe kompleksiteti i transaksioneve në të cilat janë përfshirë

- Shumëllojshmëri veprimtarish brenda një subjekti të vetëm

-Nga auditimi konstatohet se punonjësit e Sektorit të Analizës, Riskut dhe Kontabilitetit të të Ardhurave nuk disponojnë akses në modulën “Menaxhimi i Riskut” (duke përfshirë të gjithë raportet e modulit) në sistemin C@TS. Edhe pas e-mail-it të përcjellë prej tyre pranë IT në DPT në datën 10.12.2022, aksesit nuk është mundur.

-Në zbatim të Vendimit nr. 28, datë 03.03.2022 të Komitetit të Përmbushjes pranë DPT është miratuar ndryshimi në Manualin e Menaxhimit të Riskut, konkretisht Kapitulli V, “Strukturat për zbatimin e këtij manuali dhe funksionet e DMR” duke shtuar pikën 5.4 “Strukturat për zbatimin e këtij manuali dhe funksionet e DMR”, ku përcaktohet se “ *Përfshirë nga rregulli më sipër bën DTM, ku propozimet për kontroll të tatimpaguesve të vlerësuar me risk të lartë bëhet ne raportin 50% me 50% të rasteve*”, me argumentimin se në DTM ekziston struktura e analizës së riskut e cila është funksionale tashmë edhe me trajtimin e duhur. Përgjatë vitit 2021 dhe 6 mujorit të parë të vitit 2021, Sektori i riskut ka përcjellë pranë Drejtorisë së Kontrollit propozime rast pas rasti për subjekte të propozuara për të kaluar kontroll të plotë, në total për vitin 2021 367 shkresa të tilla dhe për 6-mujorin e parë të vitit 2022 76 shkresa.

Për sa i përket shkresave të përcjella nga DTM për kontroll vlerësuar në bazë të analizës së riskut të hartuar nga ky sektor, ato i përkasin 6 mujorit të dytë të vitit 2022, konkretisht:



- Shkresa nr. 6332, prot datë 18.07.2022 e Drejtorit të DTM, znj. E.C, drejtuar Drejtorisë së Kontrollit Tatimor pranë DPT, ku janë përzgjedhur 21 tatimpagues për kontroll të thelluar për muajin Korrik 2022, të evidentuar si me risk bazuar në kriteret, rregullat dhe analizat e riskut.
- Shkresa nr. 6677, prot datë 02.08.2022 e Drejtorit të DTM, znj. E.C, drejtuar Drejtorisë së Kontrollit Tatimor pranë DPT, ku janë përzgjedhur 21 tatimpagues për kontroll të thelluar për muajin Gusht 2022, të evidentuar si me risk bazuar në kriteret, rregullat dhe analizat e riskut.
- Shkresa nr. 7031, prot datë 01.09.2022 e Drejtorit të DTM, znj. E.C, drejtuar Drejtorisë së Kontrollit Tatimor pranë DPT, ku janë përzgjedhur 23 tatimpagues për kontroll të thelluar për muajin Shtator 2022, të evidentuar si me risk bazuar në kriteret, rregullat dhe analizat e riskut.
- Shkresa nr. 7602, prot datë 28.09.2022 e Drejtorit të DTM, znj. E.C, drejtuar Drejtorisë së Kontrollit Tatimor pranë DPT, ku janë përzgjedhur 22 tatimpagues për kontroll të thelluar për muajin Tetor 2022, të evidentuar si me risk bazuar në kriteret, rregullat dhe analizat e riskut.
- Shkresa nr. 8767, prot datë 24.10.2022 e Drejtorit të DTM, znj. E.C, drejtuar Drejtorisë së Kontrollit Tatimor pranë DPT, ku janë përzgjedhur 19 tatimpagues për kontroll të thelluar për muajin Nëntor 2022, të evidentuar si me risk bazuar në kriteret, rregullat dhe analizat e riskut. .
- Shkresa nr. 9884, prot datë 30.11.2022 e Drejtorit të DTM, znj. E.C, drejtuar Drejtorisë së Kontrollit Tatimor pranë DPT, ku janë përzgjedhur 19 tatimpagues për kontroll të thelluar tematik për muajin Dhjetor 2022, të evidentuar si me risk bazuar në kriteret, rregullat dhe analizat e riskut. Gjithashtu në muajin Dhjetor janë përzgjedhur 4 tatimpagues për kontroll të thelluar *tematik* për muajin Dhjetor 2022, përcjellë me shkresën nr. 9885, prot datë 30.11.2022, të evidentuar si me risk bazuar në kriteret, rregullat dhe analizat e riskut, të përcjella me shkresën nr. 9895, prot datë 30.11.2022 e Drejtorit të DTM, znj. E.C, drejtuar Drejtorisë së Kontrollit Tatimor pranë DPT.

Objektivi kryesor i sektorit është analiza e riskut për të gjitha subjektet që janë në menaxhimin e DTM-së dhe përfundimi i profileve të riskut për bilancet e hartuara. Ky objektiv planifikohet të arrihet nëpërmjet: analizës së plotë në bazë të treguesve të riskut i subjekteve, propozimit për kontroll i subjekteve me risk të lartë, komunikimit dhe nxitjes së përmbushjes vullnetare (dërgimi i letrave dhe komunikimi me tatimpaguesit për subjektet me risk të ulët dhe të mesëm), krijimin dhe përditësimin i regjistrit të riskut për subjektet sipas industrive. Deri në fund të vitit 2021 nga sektori është bërë ndarja e subjekteve sipas industrive, klasifikimi dhe kategorizim fillestar në bazë të dy treguesve kryesorë (norma e rentabilitetit dhe norma e pagesës së TVSH-së), analizë e detajuar sipas formatit të miratuar për subjektet sipas industrive, plotësimi i regjistrit të riskut, klasifikimi i subjekteve në bazë të KDR-së dhe trajtimi, monitorimi lidhur me problematikat e evidentuara, evidentim i tatimpaguesve me qarkullim të lartë dhe një deri në dy punonjës (administrator dhe një punonjës).

-Manuali i kontrollit nga Zyra, parashikon si detyrë mujore të Sektorit të Kontrollit nga Zyra *“Analizojnë dhe propozojnë kontrolle të thelluara për tatimpagues të ndryshëm brenda 30 % të kontrolleve mujore që propozohen nga DRT-të, mbas planifikimit të kontrolleve, për mbyllje, përthithje e ndarje apo të propozimeve për kontroll të sektorëve të hetimit për muajin pasardhës”*.

Gjithashtu, kapitulli “Procedurat e shqyrtimit të treguesve të pasqyrave e financiare dhe analiza” i Manualit të Kontrollit nga Zyra, parashikon se : *“Për çdo konstatim shmangie dhe parregullsi që ndikojnë në pasqyrimin e pasaktë të detyrimeve tatimore, bëjnë vlerësimet e duhura dhe në raste të rëndësishme propozon në Drejtorinë e Menaxhimit të Riskut në DPT-ë për kontroll të*

plotë tatimor.” dhe “Nëse, pas verifikimit të deklaratës vjetore të tatimit mbi fitimin dhe të pasqyrave financiare si më sipër rezultoi se shuma e tatimit mbi fitimin të deklaruar është e saktë, sektori i Kontrollit nga Zyra i pranon pasqyrat financiare, duke njoftuar dhe tatimpaguesin, se edhe mund të ri-ekzaminohen me një kontroll të ardhshëm. Në rast të kundërt kur ka dyshime për fshehje të detyrimeve tatimore i propozon Drejtorisë së Menaxhimit të Riskut për ushtrim të kontrollit të plotë.”

Nga auditimi lidhur me funksionimin e ndërveprimit mes Strukturës së Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Sektorit të Analizës së Riskut për të garantuar një mbulim të plotë të subjekteve të klasifikuara si me risk në programet e kontrollit, u konstatuan problematika që kanë çuar në dublikimin e punës, dhe mungesë efektiviteti në funksionet e këtyre strukturave. Më hollësisht, pavarësisht se është detyra e Sektorit të Kontrollit nga Zyra përcjellja e rasteve për kontroll të thelluar pranë Sektorit të Analizës dhe Riskut, këto propozime përcillen rast pas rasti përgjatë vitit referuar situatës që ka rezultuar për të dhënat nga zyra të tatimpaguesve. Megjithatë, nuk disponohet një regjistër i përmbledhur mbi rastet e përcjella, problematikën e konstatuar, datën e përcjelljes për kontroll të thelluar; analizën e inspektorit përgjegjës të sektorit nga zyra; etj. Sektori i Analizës së Riskut nga ana tjetër, disponon një regjistër risku të vetin dhe profile risku për çdo tatimpagues, informacione këto që i shërbejnë këtij sektori për të kryer më pas propozimet për kontroll të thelluar pranë DPT. Në analizën e kryer për efekt të hartimit të profileve të riskut, vihet re përfshirja e indikatorëve matës që faktikisht janë analiza që kryhen edhe nga sektori i kontrollit nga zyra . Në bazë të shkresave të hartuara nga Sektori i Analizës së Riskut pranë DTM, për subjektet e propozuara për kontroll, janë evidentuar edhe problematika të tilla si: Mospërputhje mes të ardhurave të deklaruara në PASH me ato të deklaruara në FDP e TVSH-së; mospërputhjen në zërin importe mes TVSH-së dhe FDP-së; mospërputhje në zërin eksporte mes TVSH-së dhe FDP-së; “Diferenca nëpërmjet amortizimit sipas pasqyrës së AAM me shpenzimet e amortizimit në pasqyrën e fluksit të parasë”; “Diferenca mes kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe fondit të pagave”, “Diferenca mes shpenzimeve në PASH me ato në TF”; “Diferenca mes listë pagesave dhe detyrimeve për paga në PASH”; Gjithashtu, nga sektori i riskut nuk rezultojnë të përcillen kërkesa për të kryer verifikimet e nevojshme në sistem të tatimpaguesve, pranë sektorit të kontrollit nga zyra, për çështje që mund të sistemohen apo verifikohen nga kjo strukturë.

Grupi i auditimit kërkoi informacion pranë Sektorit të Riskut lidhur me propozimet e kryera për kontroll nga Sektori i Kontrollit nga zyra për vitin 2021 dhe 2022 ku u informuam se:

- Për periudhën janar 2021 - dhjetor 2021 Propozimet për kontroll nga DTM-ja në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve janë bërë direkt nga Drejtoria e Kontrollit të DTM-së, dhe jo nga Sektori i Analizës së Riskut.
- Për periudhën janar 2022 - Maj 2022 Propozimet për kontroll nga DTM-ja në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve janë bërë direkt nga Drejtoria e Kontrollit të DTM-së, dhe jo nga Sektori i Analizës së Riskut.
- Për periudhën Qershor 2022 deri Dhjetor 2022 Propozimet për kontroll nga DTM-ja në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve janë bërë nga Sektori i Analizës së Riskut dhe për këtë periudhë nuk ka ndonjë propozim direkt nga kontrolli për " Kontroll në vend" por ka shkresa me problematika të ndryshme të cilat janë marrë për bazë në përcaktimin e subjekteve me " Risk të lartë" dhe është ndjekur procedura përkatëse rast pas rasti.

-Referuar regjistrin të vendosur në dispozicion nga Sektori i Analizës së Riskut, duke kryqëzuar informacionin me subjektet e propozuara për kontroll të plotë pranë DPT konstatohet se:

- Nga 106 subjekte ne total te propozuara per kontroll per periudhen Korrik-Nentor 2022:
  - 15 me risk
  - 75 pa risk
  - 15 me risk NA

Pra, per periudhen Korrik-Nentor, nga totali prej 106 subjektesh te propozuara, rezultojne se **vetem 14% e tyre paraqesin risk** sipas regjistrit te riskut te Sektorit te Analizes se Riskut, nderkohet qe **70% e subjekteve te tjera te propozuara per kontroll pranë DPT rezultojne pa risk**; dhe 15 te tjerat nuk ishin subjekte te analizës së riskut (risk NA).

- Nga 20 subjektet e përfshira ne kontroll per muajin Dhjetor 2022, te pa propozuara nga sektori i riskut:
  - 10 me risk NA
  - 1 me risk
  - 9 pa risk

Për muajin Dhjetor rezultojnë të jenë propozuar fillimisht 20 subjekte për kontroll tematik, nga të cilat vetëm 1 prej tyre rezulton me risk (5% e totalit). Për 19 subjekte të tjera të propozuara për kontroll, për të cilat nuk ishin hartuar shkresat me modulet përkatëse të riskut, por sektori ishte bazuar në të dhënat që gjeneroheshin nga regjistri i tyre i riskut. Sipas këtij regjistri të vendosur në dispozicion në fillim të periudhës së auditimit, nga këto subjekte rezulton se 8 prej tyre **janë transferuar pranë DTM vetëm në muajin Tetor 2022**, dhe menjëherë janë vlerësuar nga ana e drejtorisë si subjekte që përbëjnë risk për të kaluar në kontroll të plotë, pra vetëm 1 muaj pas transferimit të tyre në këtë drejtori. Ndërkohë 2 subjekte të tjera rezultojnë me status risku “NA”, 1 me risk dhe 8 pa risk. Përgjatë auditimit për subjektet e muajit dhjetor u ri dërgua formati i regjistrit për këto subjekte ku të dhënat ishin plotësuar manualisht duke i referuar si subjekte me risk (pavarësisht se sipas formulës së aplikuar në versionin e mëparshëm të regjistrit, nuk rezultonin si të tilla).

-Nga auditimi konstatohet se për periudhën objekt auditimi nuk është realizuar detyrimi për kryerjen e propozimeve për kontroll të tatimpaguesve të vlerësuar me risk të lartë bëhet ne raportin 50% me 50% të rasteve, pra 50% të kontrolleve nga DTM dhe 50% nga DPD.

Më hollësisht:

## Viti 2021

Tabela 2.1.22-Tabela mbi propozimet për kontroll

Muaji	Statusi	Kontrolle te propozuara nga DTM (risku)	Kontrolle te propozuara nga DPT	Total	% e kontrolleve të kryera në vijim të propozimit të DTM	Koment
Janar	Plan	10		10		
	Fakt	10	22	32	31%	
Shkurt	Plan	9		9		
	Fakt	9	24	33	27%	
Mars	Plan	12		12		
	Fakt	12	51	63	19%	16 vizita tematike raste 1 janë te pezulluara
Prill	Plan	9		9		
	Fakt	6	23	29	21%	
Maj	Plan	12		12		
	Fakt	12	23	35	34%	
Qershor	Plan	14		14		
	Fakt	14	26	40	35%	
Korrik	Plan	8		8		
	Fakt	8	41	49	16%	
Gusht	Plan	9		9		
	Fakt	4	35	39	10%	
Shtator	Plan	0		0		
	Fakt	0	6	6	0%	

Tetor	Plan	0		0	
	Fakt	0	11	11	0%
Nëntor	Plan	6		6	
	Fakt	6	16	22	27%
Dhjetor	Plan	14		14	
	Fakt	4	37	41	10%
<b>Total</b>	<b>Plan</b>	<b>103</b>		<b>103</b>	
	<b>Fakt</b>	<b>85</b>	<b>315</b>	<b>400</b>	<b>21%</b>

*Burimi: DTM*

Për vitin 2021 janë realizuar 400 programe kontrolli në vend, nga të cilat 85 janë propozuar nga DTM (21% e totalit) dhe 315 nga DPT.

### Viti 2022

*Tabela 2.1.23-Tabela mbi propozimet për kontroll*

Muaji	Statusi	Kontrolle te propozuara nga DTM (risku)	Kontrolle te propozuara nga DPT	Total	% e kontrolleve të kryera në vijim të propozimit të DTM	Koment
Janar	Plan	10		10		
	Fakt	10	29	39	26%	
Shkurt	Plan	17		17		
	Fakt	17	29	46	37%	
Mars	Plan	11		11		
	Fakt	11	35	46	24%	
Prill	Plan	20		20		
	Fakt	20	28	48	42%	
Maj	Plan	23		23		
	Fakt	23	30	53	43%	
Qershor	Plan	21		21		
	Fakt	21	17	38	55%	
Korrik	Plan	21		21		
	Fakt	21	23	44	48%	për muajin Korrik janë planifikuar 12 raste 3 (ri kontrolle sipas rekomandimeve te KLSH)
Gusht	Plan	21		21		
	Fakt	21	24	45	47%	
Shtator	Plan	23		23		
	Fakt	23	27	50	46%	për muajin shtator janë planifikuar 3 raste 3(ri kontrolle sipas rekomandimeve te KLSH për DRT Durrës, transferuar subjektet ne DTM)
Tetor	Plan	22		22		
	Fakt	22	38	60	37%	Për muajin Tetor janë transferuar 9 subjekte nga DRT Tirane (8 raste 1+1 rast 2)
Nëntor	Plan	19		19		
	Fakt	19	31	50	38%	Për muajin Nëntor janë transferuar 4 subjekte nga DRT Tirane (4 raste 1)
Dhjetor	Plan	19		19		
	Fakt	19	30	49	39%	
<b>Total</b>	<b>Plan</b>	<b>227</b>		<b>227</b>		
	<b>Fakt</b>	<b>227</b>	<b>341</b>	<b>568</b>	<b>40%</b>	

*Burimi: DTM*

Për vitin 2022 janë realizuar 568 programe kontrolli në vend, nga të cilat 227 janë propozuar nga DTM (40% e totalit) dhe 341 nga DPT.

Për sa trajtuar më sipër, pas përcjelljes së Projektraportit të auditimit, nga ana e znj. L.K, Përgjegjëse e Sektorit të Analizës së Riskut, me shkresën nr. 52/28, prot në DTM datë 11.09.2023 dhe nr. 14/11, prot në KLSH datë 12.09.2023 janë shprehur objeksionet si më poshtë: **Pretendimi i subjektit:** Sa i takon evidentimit tuaj për 75 subjekte që ju pretendoni dhe i keni konsideruar si të dala pa risk në planet e kontrollit miratuar nga DPD për periudhën Korrik-Nëntor 2022, sqarojmë se ju keni marrë për bazë vetëm regjistrin por nuk keni marrë në konsideratë shkresat e Drejtorisë së Kontrollit Tatimor me objekt propozime të planeve të kontrollit, apo indikatorë të tjerë të përdorur për hartimin e profileve si indiciet që rezultojnë nga Drejtoria e Kontrollit nga Zyra, detyrimet e papaguara në kohë, moduli i riskut në sistem. Për të gjitha këto, nga ana jonë kryhet një analizë e thelluar, dhe nuk bazohet vetëm në të dhënat e regjistrit, por edhe në të dhënat shkresore. Gjithashtu, lidhur me konstatimin për propozimet Dhjetor 2022, në këtë muaj janë kaluar për kontroll tematik 4 subjekte për të cilat janë hartuar profilet përkatëse. Në asnjë rrethanë nuk provohet dhe dokumentohet pretendimi se nuk është realizuar detyrimi për kryerjen e propozimeve për kontroll të tatimpaguesve me risk të lartë.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Lidhur me pretendimin se nga ana e riskut janë përdorur edhe indikatorë të tjerë për përzgjedhjen e subjekteve objekt kontrolli, sqarojmë se vazhdimisht nga ana e grupit të auditimit është kërkuar në mënyrë të vazhdueshme metodika e përdorur nga ana e sektorit për përzgjedhjen e subjekteve. Në dispozicion të grupit të auditimit u vendos regjistri i riskut dhe shkresat e përcjella për propozimet çdo muaj së bashku me profilet e riskut. Lidhur me pretendimin se vendimmarrja ka ardhur si pasojë e propozimeve të përcjella nga drejtori të tjera pranë DTM, sqarojmë se nga ana juaj nuk u përcoll një përmbledhëse e të gjithë kërkesave të përcjella në mënyrë që të dokumentohet procesi i ndjekur që vërteton edhe propozimet e përzgjedhura për çdo muaj. Shtuar këtu faktin se këto propozime janë të një numri të konsiderueshëm dhe kanë një fluks të konsiderueshëm (trajtuar edhe në drejtimin e auditimit për kontrollin nga zyra) dhe nuk dokumentohet të jetë kryer nga ana e riskut një analizë për përzgjedhjen dhe prioritarizimin e tyre. Për sa i përket observacionit se nuk provohet mos kryerja e propozimeve për kontroll të tatimpaguesve me risk të lartë, sqarojmë se referuar regjistrin të riskut, propozimet për kontroll nuk reflektojnë një prioritarizim të rasteve respektivisht me nivelin e riskut që ka rezultuar.

**Titulli i gjetjes:** **Problematika në performancën e mbledhjes së disa prej zërave të të ardhurave tatimore në DTM**

**Situata 1:**

Nga auditimi konstatohet se për vitin 2021 pavarësisht se të ardhurat bruto nga tatimet në Drejtorinë e Tatimpaguesve të Mëdhenj paraqiten me një nivel realizimi në masën 101% kundrejt planit të të ardhurave (me një tejkalim në shumën 1,080 milion lekë), të ardhurat tatimore neto rezultojnë me një realizim në masën 99% kundrejt planit, pra me një mos realizim në vlerën 1,118 milion lekë. Kjo situatë është ndikuar kryesisht nga niveli i realizimit të të ardhurave nga TVSH dhe taksave nacionale, ku konkretisht të ardhurat nga Tatimi mbi Vlerën e Shtuar, i cili është dhe kontribuesi kryesor në të ardhurat tatimore në terma bruto janë realizuar në masën 93 % të planit, me një mosrealizim në shumën 2,110 milion lekë; Të ardhurat nga TVSH paraqiten me një mosrealizim 8,261 milionë lekë, ose 41 % më pak se plani; taksat nacionale paraqiten me një mosrealizim 420 milion lekë, ose 5% më pak. Nga auditimi konstatohet se nuk është kryer asnjë analizë nga ana e DTM për arsyet që kanë ndikuar në mosrealizimin e këtij zëri kryesor në të ardhurat tatimore. Për vitin 2022 të ardhurat nga TVSH në terma bruto janë realizuar në shumën 28,085 milion lekë, ose në masën 98 % të planit, me një mosrealizim në shumën 685 milion lekë, dhe krahasuar me vitin 2021 janë arkëtuar

683 milion lekë më pak, ose rreth 2% më pak. Të ardhurat nga Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (Neto) paraqiten me një mosrealizim prej 3,630 milionë lekë, ose 20 % më pak; të ardhurat tatimore nga taksat nacionale janë programuar në vlerën 10,108 milion lekë paraqiten me një mosrealizim 1,605 milion lekë, ose 16% më pak; të ardhurat tatimore nga lojërat e fatit paraqiten me një mos realizim 233 milion lekë, ose 14% më pak.

<b>Kriteri :</b>	Ligji nr.137/2020, datë 16.11.2020 “Për buxhetin e vitit 2021”, i ndryshuar; shkresën e DPT nr. 847/2, prot datë 15.02.2021, Akti Normativ nr.4, datë 05.02.2021, Aktit Normativ nr. 18, datë 14.04.2021; Shkresa nr. 5597/1, prot datë 01.04.2021 e DPT; Shkresa nr. 8627/1, prot datë 21.05.2021 e DPT; Shkresa e DPT nr. 2968/1, prot datë 24.02.2022, Shkresa nr. 7088 prot datë 12.05.2022 e DPT, Shkresa nr. 7676/1, prot datë 03.06.2022 Shkresa nr. 7088/2, datë 30.06.2022; Shkresa nr. 7088/3, datë 29.07.2022; Shkresa nr. 13863/1, datë 06.09.2022; Shkresa nr. 13863/2, datë 05.10.2022; Shkresa nr. 15208/1, datë 31.10.2022; Shkresa nr. 15208, datë 09.12.2022. Shkresa nr. 21811/21, prot në DPT datë 16.01.2023, protokolluar në DTM nr. 316, datë 19.01.2023.
<b>Shkaku</b>	Mangësi në drejtim të përcaktimit të planit apo monitorimit të nivelit të realizimit për të ardhurat tatimore sipas llojit referuar subjekteve që operojnë nën juridiksionin e DTM.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Mosrealizimi i planit impakton arritjen e objektivave jo vetëm të institucionit por edhe administratës tatimore, për shkak të kontributit të konsiderueshëm në shkallë vendi, që kanë subjektet që operojnë pranë DTM.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë
<b>Rekomandimi:</b>	Drejtori i DTM të analizojë faktorët të cilat kanë ndikuar në realizimin e planit të të ardhurave tatimore sipas zërave, veçanërisht për llojet e të ardhurave që rezultojnë me mos realizim, dhe referuar subjekteve që operojnë nën juridiksionin e DTM, duke nxjerrë edhe përgjegjësitë përkatëse në funksion të arritjes së objektivave institucional.
<b>Titulli i gjetjes:</b>	<b>Mangësi në drejtim të përcaktimit të planifikimit, dhe procedurave të implementuara për efekt të monitorimit të realizimit të të ardhurave tatimore</b> Nga auditimi konstatohet se për vitin 2022, plani i përcjellë nga DPT është hartuar duke e planifikuar realizimin e të ardhurave në nivel mujor, pra jo për të gjithë vitin 2022, sikundër është vepruar në periudhat paraardhëse, duke u pasuar me rishikime të shpeshta. Nga ana e DTM nuk disponoheshin informacione mbi këtë vendimarrje. Deri në fund të vitit 2022 plani vjetor është përcjellë vetëm në Janar 2023, ndërsa përgjatë vitit 2022 janë vendosur në dispozicion vetëm shkresat për miratimin e planit disa mujor. Më hollësisht, plani i periudhës Janar-Prill 2022 është përcjellë me shkresën e DPT nr. 2968/1, prot datë 24.02.2022; plani Janar-Maj 2022 me shkresën nr. 7088 prot datë 12.05.2022 të DPT; plani Janar- Qershor me shkresën nr. 7676/1, prot datë 03.06.2022; plani Janar-Korrik me shkresën nr. 7088/2, datë 30.06.2022; plani Janar-Gusht me shkresën nr. 7088/3, datë 29.07.2022; plani Janar-Shtator me shkresën nr. 13863/1, datë 06.09.2022; plani Janar-Tetor me shkresën nr. 13863/2, datë 05.10.2022; plani Janar-Nëntor me shkresën nr. 15208/1, datë 31.10.2022; plani Janar-Dhjetor me shkresën nr. 15208, datë 09.12.2022.
<b>Situata :</b>	Gjithashtu, plani i të ardhurave për vitin 2022 rezulton të ketë ndryshuar edhe me shkresën nr. 21811/21, prot në DPT datë 16.01.2023, protokolluar në DTM nr. 316, datë 19.01.2023. ku është cituar përcjellja e planit të detajuar të vitit 2022, në vijim të shkresës së MFE nr.2344, prot datë 27.12.2022, protokolluar në DPT nr.21811, datë 29.12.2022. Ky plan është rishikuar pas Aktit Normativ nr. 17, datë

01.12.2022. Pra, si rezultat, treguesit e planit të të ardhurave janë rishikuar pas faktit (konkretisht plani i muajit Janar 2022 është rishikuar në Janar 2023), duke ndikuar kështu në indikatorët matës së realizimit të të ardhurave të DTM, të cilat tanimë maten sipas një baze të rishikuar në fillim të vitit pasardhës.

Nga auditimi konsiderohet se Sektori i Analizës dhe Kontabilitetit në DTM nuk kryen analiza lidhur me parashikimin e arkëtimeve, projekt plane, apo raporteve të tilla të ngjashme me qëllim dërgimin e tyre pranë DPT në kuadër të kryerjes së një planifikimi të të ardhurave, pasi ky plan i përcillet i përgatitur për zbatim nga DPT. Në zbatim të Nenit 4 “Drejtori i Drejtorisë Rajonale Tatimore” të Rregullores së Funksionimit të Administratës Rajonale Tatimore, pika 3 “.. *Qëllimi i punës është arritja e objektivave operacionale dhe objektivave të përcaktuara në Planin Strategjik të Administratës Tatimore, si dhe të objektivave dhe programeve të përcaktuara nga Zyra Qendrore për mbledhjen e të ardhurave për Drejtorinë Rajonale Tatimore*”; pika 6: “Përgatit raporte për Drejtorin e Përgjithshëm të Tatimeve ku përmbledh progresin e bërë kundrejt planit dhe shmangiet nga programi i miratuar. Raportet përfshijnë jo vetëm analizën e realizimit të të ardhurave dhe devijimet nga programi por edhe analizën e treguesve të performancës së Drejtorisë Rajonale Tatimore dhe pjesëve përbërëse të saj”, konstatohet se nga ana e DTM për periudhën objekt auditimi (viti 2021 dhe 2022) nuk rezultojnë të jenë hartuar dhe dërguar pranë DPT plane operacionale të veprimtarisë institucionale, plane vjetore, apo raporte për realizimin e të ardhurave dhe treguesve të performancës, në kundërshtim me kuadrin rregullator cituar më sipër.

Në dispozicion të grupit të auditimit u vendosën vetëm analizat e sektorit të të ardhurave për vitin 2021 dhe 2022, në të cilat janë paraqitur të dhënat statistikore mbi nivelin e realizimit krahasuar me planin dhe 2 vitet paraardhëse, në nivel progresiv dhe sipas muajit Dhjetor. Gjithashtu janë paraqitur top subjektet performues sipas zërit të të ardhurave. Në këtë dokument mungojnë analizat e kryera lidhur me nivelin e realizimit krahasuar me planin, për të evidentuar shkaqet e mos realizimit/mbi realizimit në nivel industrie/fenomenesh/apo edhe subjekteve, apo shkaqet që kanë çuar në mos realizim/mbi realizim krahasuar me vitin paraardhës. Pra, si rezultat puna e DTM në planifikimin e të ardhurave tatimore konsiston në paraqitjen e të dhënave statistikore në nivel tepër sintetik, pa u analizuar mbi faktorët që kanë ndikuar në mbi realizimin/ mosrealizimin e tyre; argumentet dhe faktorët që kanë ndikuar, bazuar në fenomenet e konstatuara gjatë kontrollit në industrinë përkatëse.

Grupi i auditimit kërkoi informacion për arsyet e tejkalimit; mos realizimit të të ardhurave sipas zërave përkatës, për periudhën objekt auditimit, për të cilat nuk u vendosën në dispozicion argumentet përkatëse nga ana e DTM.

Në raportin e vendosur në dispozicion nga Sektori i Analizës dhe Kontabilitetit, u konstatuan se ekzistonin diferenca mes të dhënave të raportuara në tabelën përmbledhëse të të ardhurave, si dhe me të dhënat e analizuara për secilin zë më vete të të ardhurave, në brendësi të raportit. Shkak për këtë arsye sipas informacionit të sektorit ishte fakti se : “Në tabelën nr.2 janë të ardhurat në kohë reale, kjo do të thotë që: Në secilin nga muajt e periudhës 2022,2021 sa subjekte që janë, kanë bërë derdhjet e muajit. Në tabelat e tjera janë arkëtimet periodike, që do të thotë se ndryshimet e subjekteve ( largimet ose ardhjet në DTM) që bëhen në muaj të ndryshëm, paraqiten si arkëtime që nga Janari e deri në Dhjetor.”. Në konkluzionin e grupit të auditimit, kryerja e raportimit në këtë formë (me dy momente të ndryshme kohore të mara për bazë për analizimin: në kohë reale vs arkëtime periodike) krijon konfuzion dhe nuk mundëson gjenerimin e një

	informacioni të saktë dhe të krahasueshëm për efekt analize, duke qenë se ky është edhe qëllimi kryesor i këtij raporti.
<b>Kriteri :</b>	Neni 4 “Drejtori i Drejtorisë Rajonale Tatimore” të Rregullores së Funkcionimit të Administratës Rajonale Tatimore, pika 3 , pika 6.
<b>Shkaku</b>	Mungesa e analizave lidhur me parashikimin e arkëtimeve, projekt plane, apo raporteve të tilla të ngjashme për efekt planifikimi; mungesa e analizave të kryera lidhur me nivelin e realizimit krahasuar me planin, për të evidentuar shkaqet e mos realizimit/mbi realizimit në nivel industrie/fenomenesh/apo edhe subjekteve, apo shkaqet që kanë çuar në mos realizim/mbi realizim krahasuar me vitin paraardhës. Mangësi në identifikimin e shkaqeve që çenojnë realizimin, për të ndërmarrë më pas iniciativa për përmirësimin e situatës dhe realizimit të objektivave. Mangësi në raportin aktual që përgatitet nga DTM për efekt të realizimit të të ardhurave ku kryerja e raportimit në këtë formë (me dy momente të ndryshme kohore të mara për bazë për analizimin: në kohë reale vs arkëtime periodike) krijon konfuzion dhe nuk mundëson gjenerimin e një informacioni të saktë dhe të krahasueshëm për efekt analize, duke qenë se ky është edhe qëllimi kryesor i këtij raporti.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	E lartë
<b>Rëndësia:</b>	
<b>Rekomandimi:</b>	<p>- Drejtori i DTM të marrë masat për përcaktimin e procedurave, detyrave dhe përgjegjësiive konkrete, në drejtim të programimit dhe raportimit pranë DPT lidhur me progresin e bërë kundrejt planit të të ardhurave tatimore dhe shmangiet nga programi i miratuar, duke konsideruar edhe formate tip raportimi , me qëllim që ndjekja dhe realizimi i të ardhurave për çdo zë të bëhet më efektiv dhe eficient, duke garantuar planifikimin në funksion të një shpërndarje sa më të drejtë dhe reale të planit të të ardhurave sipas llojit dhe strukturës, me qëllim shmangien e rishikimeve të shpeshta të këtij plani përgjatë vitit.</p> <p>- Strukturat drejtuese pranë DTM të marrin masat për hartimin e planit operacional të veprimtarisë institucionale, planeve vjetore, dhe raporteve periodike, në funksion të mirë menaxhimit dhe monitorimit të institucionit për arritjen e objektivave.</p>
<b>Titulli i gjetjes:</b>	<b>Mangësi të konstatuara në veprimtarinë e Sektorit të Analizës së Riskut pranë DTM</b>
<b>Situata :</b>	Nga auditimi lidhur me funksionimin e ndërveprimit mes Strukturës së Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Sektorit të Analizës së Riskut për të garantuar një mbulim të plotë të subjekteve të klasifikuara si me risk në programet e kontrollit, <u>nga konstatuan problematika që kanë çuar në dublikimin e punës, dhe mungesë efektiviteti në funksionet e këtyre strukturave në drejtim të analizave të kryera për propozimet për kontroll në vend për tatimpaguesit pranë DTM.</u> Më hollësisht, Sektori i Kontrollit nga Zyra (një sektor i planifikuar për të funksionuar me 10 inspektorë dhe 1 Përgjegjës Sektori) ka përcjellë përgjatë vitit rast pas rasti subjektet për të cilat janë evidentuar problematika referuar situatës që ka rezultuar për të dhënat nga zyra të tatimpaguesve. Këto propozime, së bashku me analizat e kryera nga sektori që dokumentojnë arsyet e propozimit, nuk përmbledhen nga ana e Sektorit të Analizës dhe Riskut, për të shqyrtuar rastet e përcjella, problematikën e konstatuar, datën e përcjelljes për kontroll të thelluar; analizën e inspektorit përgjegjës të sektorit nga zyra; etj, në mënyrë që kjo vendimmarrje ti shërbejë strukturës për të priorizuar rastet dhe të përmbledhë propozimet. Faktikisht, Sektori i Analizës së Riskut (një strukturë e programuar për të funksionuar me 3 persona, nga të cilët një përgjegjës sektori dhe 2 specialistë), disponon një regjistër risku të vetin dhe profile risku për çdo tatimpagues, informacione këto që i shërbejnë këtij sektori për të kryer më pas propozimet për kontroll të thelluar pranë DPT dhe për të cilat nga sektori i riskut kryhet një punë tepër voluminoze me



analiza statistikore që faktikisht janë pjesë e punës së sektorit të kontrollit nga zyra. Konkretisht, në analizën e kryer për efekt të hartimit të profileve të riskut, vihet re përfshirja e indikatorëve matës që faktikisht janë analiza që kryhen edhe nga sektori i kontrollit nga zyra të tilla si: Mospërputhje mes të ardhurave të deklaruara në PASH me ato të deklaruara në FDP e TVSH-së; mospërputhjen në zërin importe mes TVSH-së dhe FDP-së; mospërputhje në zërin eksporte mes TVSH-së dhe FDP-së; “Diferenca nëpërmjet amortizimit sipas pasqyrës së AAM me shpenzimet e amortizimit në pasqyrën e fluksit të parasë”; “Diferenca mes kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe fondit të pagave”, “Diferenca mes shpenzimeve në PASH me ato në TF”; “Diferenca mes listë pagesave dhe detyrimeve për paga në PASH”; çështje këto që janë pjesë e monitorimit të përditshëm të inspektorëve të Sektorit të Kontrollit nga Zyra, sipas ndarjes .

Nga auditimi konstatohet se Rregullorja e Brendshme për Sektorin e Analizës së Riskut, si dokumenti bazë sipas së cilës funksionon sektori ***nuk*** është miratuar nga ministria e linjës që është MFE, sikurse përcaktohet në nenin 29, pika 2, të ligjit nr. 90/2012, datë 27.9.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, ku përcaktohet se rregulloret që përcaktojnë metodat e brendshme të punës dhe sjelljen e personelit miratohen nga ministri përgjegjës për ministrinë, institucionet e varësisë dhe degët territoriale në varësi të tij.

Nga auditimi konstatohet se punonjësit e Sektorit të Analizës, Riskut dhe Kontabilitetit të të Ardhurave nuk disponojnë akses në modulën “Menaxhimi i Riskut” (duke përfshirë të gjithë raportet e modulit) në sistemin C@TS, me qëllim analizimin e këtyre informacioneve për efekt të procedurave të planifikimit.

Rregullorja për funksionimin e administratës rajonale tatimore, miratuar me urdhër nr. 192, datë 12.08.2020 të Ministrisë të Financave , Kapitullin III , neni 17- 23 ; neni 22 “Përgjegjësitë dhe detyrat e specialistit të sektorit të analizës së sektorit në DTM”, pika 3 ku përcaktohet se “*Përzgjedh rastet për kontroll me bazë risku dhe propozon trajtimin e tyre nga strukturat zbatuese, mbështetur në rezultatet e analizave të kryera në përputhje me rregulloren*”, dhe pika 4 e këtij neni ku përcaktohet “*Përzgjedh tatimpaguesit për kontroll sipas të dhënave të Modelit të Riskut*”.

**Kriteri :** Vendimi nr. 28, datë 03.03.2022 i Komitetit të Përmbyshjes pranë DPT ku është miratuar ndryshimi në Manualin e Menaxhimit të Riskut, konkretisht Kapitulli V, “Strukturat për zbatimin e këtij manuali dhe funksionet e DMR” duke shtuar pikën 5.4 “Strukturat për zbatimin e këtij manuali dhe funksionet e DMR”, ku përcaktohet se “ *Përrjashtim nga rregulli më sipër bën DTM, ku propozimet për kontroll të tatimpaguesve të vlerësuar me risk të lartë bëhet ne raportin 50% me 50% të rasteve*”.

-Neni 29, pika 2, të ligjit nr. 90/2012, datë 27.9.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, ku përcaktohet se: “***Rregulloret që përcaktojnë metodat e brendshme të punës dhe sjelljen e personelit miratohen nga ministri përgjegjës për ministrinë, institucionet e varësisë..***”

**Shkaku**

Kryerja e të njëjtave procedura monitoruese nga dy struktura të ndryshme; mungesa e regjistrave që analizojnë kërkesat për kontroll të njësive pranë DTM.

**Ndikimi/Efekti:**

Duplikim i detyrave dhe mangësi që mund të çënojnë realizimin e detyrave të Sektorit të Analizës së Riskut

**Rëndësia:**

E lartë

**Rekomandimi:**

- Drejtori i DTM nëpërmjet Sektorit të Analizës së Riskut pranë DTM dhe Drejtorinë e Kontrollit pranë DTM, të vlerësojë procedurat aktuale të implementuara për efekt të vendimmarrjes në propozimin e subjekteve që do i nënshtrohen kontrollit në vend, duke shqyrtuar mundësinë e hartimit të një

databazë të Sektorit të Analizës së Riskut për konsolidimin e propozimeve për kontroll në vend të përcjella nga Sektori i Zyrës apo atij në Vend sipas problematikave përkatëse, në mënyrë që të garantohet se konkluzionet për përzgjedhjen e subjekteve të DTM objekt kontrolli në vend, do të jenë produkt i prioritizimit të problematikave dhe analizave të përcjella nga njësitë e sipërcituara, duke shmangur duplikimin e detyrave nëpërmjet sektorëve.

- Drejtori i DTM të marrë masat për përcjelljen e Rregullores së Brendshme për Sektorin e Analizës së Riskut pranë institucioneve eprore me qëllim miratimin e këtij dokumenti nga autoriteti përgjegjës për miratimin e rregulloreve që përcaktojnë metodat e brendshme të punës dhe sjelljen e personelit.

**Titulli i gjetjes:** **Problematika të konstatuara në drejtim të përzgjedhjes së subjekteve në kuadër të kontrollit në vend ku përmendet mos realizimi i detyrimit për kryerjen e kontrolleve në vend në masën 50%; mangësi në prioritizimin e subjekteve me risk të lartë për t'u propozuar për kontroll**

**Situata :** -Nga auditimi konstatohet se për periudhën objekt auditimi nuk është realizuar detyrimi për kryerjen e propozimeve për kontroll të tatimpaguesve të vlerësuar me risk të lartë në raportin 50% me 50% të rasteve ( pra 50% të kontrolleve propozuar nga DTM dhe 50% nga DPT). Konkretisht:

-Për vitin 2021 janë realizuar 400 programe kontrolli në vend, nga të cilat 85 janë propozuar nga DTM (21% e totalit) dhe 315 nga DPT.

-Për vitin 2022 janë realizuar 568 programe kontrolli në vend, nga të cilat 227 janë propozuar nga DTM (40% e totalit) dhe 341 nga DPT.

Grupi i auditimit kërkoi informacion pranë Sektorit të Riskut lidhur me propozimet e kryera për kontroll nga Sektori i Kontrollit nga zyra për vitin 2021 dhe 2022 ku u informuam se:

- Për periudhën Janar 2021 - Dhjetor 2021, propozimet për kontroll nga DTM-ja në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve janë bërë direkt nga Drejtoria e Kontrollit të DTM-së, dhe jo nga Sektori i Analizës së Riskut.
- Për periudhën Janar 2022 - Maj 2022, propozimet për kontroll nga DTM-ja në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve janë bërë direkt nga Drejtoria e Kontrollit të DTM-së, dhe jo nga Sektori i Analizës së Riskut.
- Për periudhën Qershor 2022- Dhjetor 2022, propozimet për kontroll nga DTM-ja në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve janë bërë nga Sektori i Analizës së Riskut dhe për këtë periudhë nuk ka ndonjë propozim direkt nga kontrolli për " Kontroll në vend" por janë hartuar shkresa me problematika të ndryshme të cilat janë marrë për bazë në përcaktimin e subjekteve me " Risk të lartë" dhe është ndjekur procedura përkatëse rast pas rasti.

-Referuar regjistrin të vendosur në dispozicion nga Sektori i Analizës së Riskut, duke kryqëzuar informacionin me subjektet e propozuara për kontroll të plotë pranë DPT konstatohet se për periudhën Korrik-Nëntor 2022, nga totali prej 106 subjektsh të propozuara, rezultojnë se vetëm 15 subjekte (ose 14% e totalit ) paraqiten si subjekte me risk sipas regjistrin të riskut të Sektorit të Analizës së Riskut, ndërkohë që 70% e subjekteve të tjera të propozuara për kontroll pranë DPT rezultojnë pa risk (75 subjekte); dhe 15 të tjera (16%) nuk ishin subjekte të analizës së riskut (risk "NA").

Nga auditimi u konstatua se 20 subjektet e përfshira për kontroll tematik (si rezultat i indicieve të tilla si përthithje, shitje aksione, etj), në muajin Dhjetor 2022, vetëm 1 prej tyre rezulton me risk (5%); 10 subjekte me risk NA (50%) dhe 9 subjekte pa risk (45%). Për sa i përket propozimeve për kontroll të plotë në vend, në muajin Dhjetor 2022 janë përcjellë propozime për kontroll në vend për 19 subjekte, ku nga

këto, sipas regjistrimit të riskut 8 prej tyre janë transferuar pranë DTM vetëm në muajin Tetor 2022, dhe menjëherë janë vlerësuar nga ana e drejtorisë si subjekte që përbëjnë risk për të kaluar në kontroll të plotë, pra vetëm 1 muaj pas transferimit të tyre në këtë drejtori. Ndërkohë 2 subjekte të tjera rezultojnë me statusin “NA”, 8 subjekte pa risk, dhe vetëm 1 me risk. Përgjatë auditimit për subjektet e muajit Dhjetor u ri dërgua formati i regjistrimit për këto subjekte, ku të dhënat ishin plotësuar manualisht, duke i referuar si subjekte me risk (pavarësisht se sipas formulës së aplikuar në versionin e mëparshëm të regjistrimit, nuk rezultonin si të tilla).

Vendimi nr. 28, datë 03.03.2022 i Komitetit të Përbushjes pranë DPT ku është miratuar ndryshimi në Manualin e Menaxhimit të Riskut, konkretisht Kapitulli V, “Strukturat për zbatimin e këtij manuali dhe funksionet e DMR” duke shtuar pikën 5.4 “Strukturat për zbatimin e këtij manuali dhe funksionet e DMR”, ku përcaktohet se “ *Përfshirja nga rregulli më sipër bën DTM, ku propozimet për kontroll të tatimpaguesve të vlerësuar me risk të lartë bëhet në raportin 50% me 50% të rasteve*”;

**Kriteri :**

Rregullorja për funksionimin e administratës rajonale tatimore, miratuar me urdhër nr. 192, datë 12.08.2020 të Ministrit të Financave neni 22 “Përgjegjësitë dhe detyrat e specialistit të sektorit të analizës së sektorit në DTM”, pika 3 përcaktohet se “ *Përzgjedh rastet për kontroll me bazë risku dhe propozon trajtimin e tyre nga strukturat zbatuese, mbështetur në rezultatet e analizave të kryera në përputhje me rregulloren*”, dhe pika 4 e këtij neni ku përcaktohet “ *Përzgjedh tatimpaguesit për kontroll sipas të dhënave të Modelit të Riskut*”.

**Shkaku**

Vendimmarrje jo e drejtë në procedurat e ndjekura për efekt të përzgjedhjes së subjekteve që do i nënshtrohen kontrollit në vend, si në përqindjen e subjekteve; ashtu edhe në riskun real që mbart çdo subjekt; Mangësi në linjat e raportimit dhe komunikimit me sektorët për të dokumentuar drejt proceset e punës të çdo njësie.

**Ndikimi/Efekti:**

Mos realizim i detyrimit për përzgjedhjen e subjekteve me risk të lartë në masën 50% me 50%; përfshirja në kontroll e subjekteve që nuk përfaqësojnë realisht subjektet me risk më të lartë për kontroll.

**Rëndësia:**

E lartë

**Rekomandimi:**

Strukturat përgjegjëse pranë DTM dhe DPT të marrin masat për garantimin e mbulimit me kontroll në vend të propozimeve nga DTM në masën 50% të totalit të kontrolleve të kryera, duke prioritarizuar në përzgjedhje të subjekteve që mbartin realisht risk, dokumentuar kjo në rezultatet e indikatorëve të implementuar në regjistrin e riskut të strukturës përgjegjëse.

**2.2. Mbi vlerësimin e përputhshmërisë ligjore të veprimitarisë së Drejtorisë së Kontrollit Tatimor**

**-Sektori i Kontrollit në Vend**

Në bazë të dokumentacionit të vendosur në dispozicion nga DTM grupi i auditimit ka përzgjedhur dosjet e kontrollit mbi bazë risku të vlerësuar. Përzgjedhja konsistoi në respektim të parimet të proporcionalitetit dhe objektivitetit në shqyrtimin e dosjeve për çdo inspektor kontrolli duke pasur si referencë kriteret bazë në lidhje me:

- Numri i kontrolleve normale;
- Numri i kontrolleve për rimbursim;
- Xhiron (Të ardhurat pa TVSH për secilin nga vitet e periudhës objekt auditimi);

- Norma e fitimit vjetor bruto/të ardhura për secilin nga vitet objekt auditimi;
- Të dhënat e zbulimeve gjatë kontrollit;
- Sektori dhe lloji i aktivitetit ku bën pjesë subjekti.

Për arritjen e konkluzioneve të auditimit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Dosjet e kontrollit të ushtruar në tatimpagues të cilat përfshin ndër të tjera njoftimin për kontroll, programin e kontrollit, projekt raportin dhe raportin përfundimtar të kontrollit, formularin 3, procesverbale dhe akt konstatime të mbajtura nga ana e inspektorëve, njoftim vlerësimet tatimore, etj;

-Deklarimet në sistemin C@TS sipas tatimpaguesve që përfshijnë ndër të tjera librat e blerjes dhe të shitjes, deklaratat tatimore, pasqyrat financiare, inventarët analitikë, etj;

-Udhëzime, rregullore në zbatim të legjislacionit tatimor në fuqi;

-Dokumentacione dhe informacione shtesë të vendosura në dispozicion sipas rastit nga ana e inspektorëve tatimorë, etj;

**Sa më sipër, u përzgjedhën për auditim dosjet fizike të raporteve të kontrolleve të viteve 01.01.2021-31.12.2022.**

Në bazë të dokumentacionit të vendosur në dispozicion nga DTM sipas kampionit të tatimpaguesve, për raportet e kontrollit të kryer nga administrata tatimore, nga auditimi i kryer, analizuar rast pas rasti u konstatua se:

**-Subjekti: “B.” SHPK**

**Nipti: J.I**

**Adresa kryesore: Lagja Nr. 3, Rruga Mahmut Daci, ZK- 2315, pasuria nr. 35/43, Kukës**

**Aktiviteti: “Tregtim Mallrash e produktesh bujqësore e blektorale me shumice e pakice, import-eksport i tyre (Vazhdon edhe më tepër sipas përshkrimit të QKB-së).”**

**Inspektori: H.M.**

**Përgjegjës Sektori: E.M.**

**Drejtor Kontroll: M.R.**

**Drejtori Rajonal: I.A.**

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

- Për **TVSH**-periudha tatimore nga 07/2019-12/2020

- Për **Tatim Fitimin** periudha tatimore: 2019-2020

- Për **Sigurimet Shoqërore e shëndetësore**-periudha tatimore nga 07/2019-12/2020

- **Të tjera** periudha tatimore: 07/2019-12/2020

- **Orë pune:** 220 orë

**Në dosjen fizike administrohet dokumentacioni si më poshtë vijon:**

- Njoftim për kontroll tatimor nr. 1494 prot., datë 19.02.2021

- Njoftimi i kontrollit tatimor me nr. 1494/2 prot., datë 26.03.2021, bashkëngjitur program kontrolli

- Kërkesë nga subjekti “B.” SHPK, nr. 47/21 prot., datë 04.03.2021, administruar në DTM me nr. 1494/1 prot, datë 08.03.2021, për përfshirje në program kontrolli të periudhës së kontrollit edhe për Tatim-Fitimin e vitit 2020.

- Kërkesë për shtim të periudhës së kontrollit datë 14.05.2021, nga Inspektori H.M.

- Kërkesë për zgjerim të periudhës së kontrollit me nr. 1494/3 prot., datë 19.05.2021, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

- Shkresa nr. 9054/2 prot., datë 31.05.2021, miratim kërkesë për shtrirje të periudhës së kontrollit, nga Drejtori i Përgjithshëm.
- Autorizim shtesë, për kryerjen e kontrollit tatimor për Tatim-Fitimin e vitit 2020.
- Procesverbal për inventarin fizik datë 26.04.2021, hedhur në sistemin C@TS datë 30.6.2021.
- Procesverbal për kontrollin e TVSH, datë 11.06.2021, hedhur në sistemin C@TS datë 30.6.2021.
- Shkresa nr. 1494/6 prot, datë 01.07.2021, kërkesë për informacion Drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme.
- Shkresa nr.12073/1 prot., datë 15.07.2021, kthim përgjigje nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.
- Formulari 1-Raport i vizitës së kontrollit
- Shkresa nr. 1494/5 prot., datë 01.07.2021, dërgim Raporti Paraprak të Kontrollit Tatimor, hedhur në sistemin C@TS në datë 30.06.2021.
- Njoftimi vlerësimi tatimor nr. 1494/9 prot., datë 16.08.2021,
- Shkresa nr. 1494/10 prot, datë 16.08.2021, për dërgimin e raportit përfundimtar të kontrollit
- Raport kontrolli me nr. 1494/8 prot., datë 16.08.2021, hedhur në sistemin C@TS në datë 11.08.2021.

**Nga auditimi ka rezultuar se:**

- Në sistemin C@TS mungon dokumenti mbi Njoftimin e Kontrollit, ndërkohë që Projekt Raporti, Raporti dhe procesverbalet mbi kontrollin e kryer nuk janë hedhur brenda ditës së nesërme të punës nga momenti që janë mbajtur, jo në përputhje me përcaktimet e Manualin i Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2.2.
- Raporti nuk ka të bashkangjitur si pjesë përbërëse të tij “Formulari-pyetësor i vetë deklaramit para kontrollit”, jo në përputhje me Manualin i Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2.1 paragrafi 6.
- Projekt Raporti është hartuar në datë 18.06.2021, hedhur në sistemin C@TS në datë 30.06.2021, dërguar në subjekt me shkresën nr. 1494/5 prot., datë 01.07.2021, ndërkohë që Raporti Përfundimtar i Kontrollit mbajtur në 06.08.2021, hedhur në sistemin C@TS në datë 11.08.2021, përcjellë në subjekt me shkresën nr. 1494/8 prot., datë 16.08.2021, duke mos respektuar afatet për hartimin e Raportit Përfundimtar të Kontrollit, jo në përputhje me përcaktimet e Manualit të Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2.5.
- Kontrolli është kryer në tejkalim të afatit të parashikuar në programin e kontrollit, me afat 220 orë pune, pasi kontrolli ka filluar me datë 26.04.2021 dhe ka përfunduar në datë 18.06.2021, pra 304 orë/40 ditë pune, më shumë 84 orë pune, jo në përputhje me përcaktimet e Manualit të Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2.3 ku citohet: *“Kohëzgjatja e nevojshme e kontrollit përcaktohet nga të dhënat e analizës së riskut. Kohëzgjatja e kontrollit përcaktohet në baze të orëve të punës të parashikuara në Programin e Kontrollit. Kjo periudhë kohe merr parasysh kohën e kontrollit, pa përfshirë kohën për përgatitjen e raportit të kontrollit, i cili duhet të përgatitet brenda shtatë ditëve kalendarike nga data e përfundimit të tij tek tatimpaguesi”*.
- Është kryer kontrolli i librave të shitjeve, librave të blerjeve, deklarimi në sistem për periudhën objekt kontrolli dhe nuk rezultuan diferenca midis librave dhe FDP-ve.
- Nga verifikimi i kontratave të qerasë, në lidhje me pagesat e tatim burimit, rezulton se janë zbatuar çmimet referencë të qerave sipas përcaktimeve të VKM nr. 469, datë 03.06.2015 “Për përcaktimin e vlerës minimale të çmimit të referencave të qirave të ndërtesave për qëllime tatimore”.

- Është kryer kontrolli për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore për periudhën objekt kontrolli, sipas përcaktimit të programit të kontrollit, nga ku rezulton se janë zbatuar përcaktimet ligjore mbi sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.
- Nga auditimi i shitjeve pa TVSH rezulton se janë deklaruar shitje pa TVSH kundrejt klientit Universiteti Bujqësor, makineritë *Shpërndarës i plehut R22401, Traktor Basak TIPI 2100 SL 4ËD R22404, Traktor Bujqësor marka Basak Modeli 2080 R22675*, sipas deklaratave doganore përkatëse në përputhje me përcaktimet të VKM Nr. 953, datë 29.12.2014 “Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Nga rivlerësimet e bëra nga dogana, rezulton se për 4 artikuj, për vitin 2020, konkretisht bersi soje, grure, miell t500 dhe miser kanë rezultuar diferenca për shkak se në shumë raste rivlerësimi doganor bëhet me muaj me vonesë nga data e çlirimit të mallrave nga dogana, në një kohë që mallrat janë shitur në momentin që mbërrijnë në subjekt. Gjithashtu referuar dhe deklarimeve të subjektit në koston e produkteve të blera për rishitje janë kontabilizuar vetëm shpenzimet e faturuara, shpenzimet e transportit të dokumentuara me fatura, taksat doganore në rastet kur ka pasí aplikimi i çmimeve të referencës në Doganë është vetëm për llogaritjen e TVSH-së.
- Janë analizuar shitjet për artikujt kryesorë në raport me koston e magazinimit, çmimi i shitjes me shumicë, çmimi i shitjes me pakice, marzhi i përdorur etj dhe nuk kanë rezultuar mangësi, shitje nën ose baraz me kosto, gjithashtu marzhi i fitimit i llogaritur është brenda normave të lejuara.
- Në lidhje me bilancin material sqarojmë se nga ana e inspektorit të kontrollit është kryer bilanci material për periudhën 31.12.2019-31.12.2020, për 10 artikuj, *nga 110 artikuj*, që figurojnë në total, tek inventari kontabël i subjektit, por pa cilësuar në raport se cila ka qenë baza e përzgjedhjes pikërisht të këtyre produkteve për kontroll. Sa më sipër nga Inspektori i Kontrollit nuk janë respektuar dispozitat dhe përcaktimet ligjore lidhur me punën e inspektorëve të Sektorit të Kontrollit në Vend në kundërshtim me përcaktimet e programit të kontrollit, dhe Manualin e Kontrollit Tatimor, Kapitulli VIII, pika 8.
- Nga kontrolli i bilancit material për 29 artikuj kryesor për nga sasia dhe vlera, për periudhën 31.12.2019-31.12.2020, për disa artikuj kanë rezultuar diferenca ndërmjet gjendjes fizike dhe gjendjes kontabël, trajtuar në akt-konstatimi. Sqarojmë se një pjesë e mosrakovimeve vjen nga kontabilizimi i Akt Kontrollit Nr.7885/2 prot., datë 02.11.2020 e raportuar si e ardhur në librin e shitjeve dhe në analizën e shitjeve totale sipas artikujve por nuk është pasqyruar tek bilanci material në Raport Kontrolli, pasi sistemimi i librit të shitjes është bërë nga Inspektori i kontrollit dhe në subjekt është bërë kontabilizimi me artikull kontabel, si dhe një pjesë për shkak të pasaktësive të pasqyrimin të të dhënave (*si emërtime, sasi*) për secilin artikull të paraqitur nga Inspektori në Raport Kontrolli, ndërkohë që diferencat për karburantet rezultojnë nga firot ligjore gjatë ruajtjes, transportit dhe tregtimit të tyre, trajtuar hollësisht me observacionet, për pasojë këto mos rakovime nuk kanë efekte në pasqyrimin e situatës financiare të subjektit.

**-Subjekti:** “B. & C.” SHPK

**Nipti:** K.T

**Adresa kryesore:** Katund i Ri, Autostrada Tiranë-Durrës, pranë ish-Radiostacionit Kashar

**Aktiviteti:** “Import-eksport dhe shitje me shumicë dhe pakice të mallrave e lendeve të para për industrinë e ndërtimit. Ndërtime të ndryshme civile, industriale, social-kulturore të gjithë llojeve. Import-eksport dhe shitje-blerje me shumicë dhe pakice të karburanteve e lubrifikanteve. Import-

*eksport dhe shitje-blerje me shumice dhe pakice te makinave dhe auto veturave të të gjitha llojeve e tonazheve.... (Vazhdon edhe më tepër sipas përshkrimit të QKB-së)."*

**Inspektori:** A.DH.

**Inxhinieri:** E.A.

**Përgjegjës Sektori:** S.M.

**Drejtor Kontrolli:** O.C

**Drejtor Rajonal:** E.C

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

- Për **Rimbursimin e TVSH-Periudha tatimore Tetor 2021-Korrik 2022**

- **Ore pune:** 70 orë

**Në dosjen fizike administrohet dokumentacioni si më poshtë vijon:**

- Shkresa elektronike DPT-së e printuar nga sistemi C@TS, sipas numrit të çështjes E0000986438, datë 08.09.2022, për kontrollin në vend të kërkesës për rimbursim të tatimpaguesit, për TVSH për periudhën Tetor 2021- Korrik 2022 në vlerën 120,361,568 lekë.

- Njoftim për kontroll tatimor nr. 7160 prot., datë 12.09.2022, bashkëngjitur program kontrolli.

- Në dosje nuk administrohet akt-verifikimi datë 20.10.2022, mbi verifikimin në vend të ndërtimit të objektit "Tregtim Magazinim dhe Ekspozim pllakash", mbajtur nga Inxhinieri E. A., hedhur në sistemin C@TS datë 02.12.2022.

- Projekt Raport i mbajtur në datë 21.10.2022, hedhur në sistemin C@TS në datë 25.11.2022.

- Shkresa nr. 7160/2 prot., datë 22.11.2022, për dërgimin e Projekt Raportit të kontrollit.

- Shkresa datë 23.11.2022 e kompanisë B. & C. SHPK, administruar pranë DTM me nr. 7160/3 prot, datë 23.11.2022, kthim përgjigje mbi projekt raportin e kontrollit.

- Raport kontrolli i mbajtur datë 25.11.2022, protokolluar në DTM me nr. 7160/4 prot., datë 26.11.2022, hedhur në sistemin C@TS në datë 02.12.2022.

- Shkresa nr. 7160/5 prot., datë 25.11.2022, dërgim Raporti Përfundimtar Kontrollit.

- Formulari 1- Raport i vizitës së kontrollit, hedhur në sistemin C@TS në datë 25.11.2022.

**Nga auditimi ka rezultuar se:**

- Në sistemin C@TS mungon dokumenti mbi Njoftimin e Kontrollit.

- Projekt Raporti, Raporti dhe procesverbalet mbi kontrollin e kryer janë hedhur me vonesë në C@TS, jo në përputhje me Manualin, Kapitulli II, pika 2.2.

- Raporti nuk ka bashkëngjitur si pjesë përbërëse të tij "Formulari-pyetësor i vetë deklarimit para kontrollit", jo në përputhje me Manualin i Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2.1 paragrafi 6.

- Kontrolli është kryer në tejkallim të afatit të parashikuar në programin e kontrollit, me afat 70 orë/9 ditë, pasi kontrolli ka filluar me datë 14.09.2019 dhe ka përfunduar në datë 27.09.2020, më shumë se 9 ditë pune, jo në përputhje me përcaktimet e Manualit të Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2.3.

- Është bërë evidentimi i numrave të llogarive bankare me të cilat operon shoqëria.

- Nga kontrolli i dokumentacionit si dhe nga verifikimi ne sistem rezultuan diferenca midis librave dhe FDP-ve për periudhën Nëntor 2021, ne kolonën e Import Investimi me 20% ne deklaratën e TVSH-se është 6,299,910 leke dhe TVSH 1,259,982 ndërsa ne librin e deklaruar nga subjekti është deklaruar ne kolonën e Import investimi me 6% vlera 1,406,255 leke dhe TVSH 281,251 leke si dhe në kolonën e Import Investimi me 20% vlera 4,893,655 leke dhe TVSH 978,731 leke. Nga subjekti nuk është bërë ende korigjimi i librit të periudhës Nëntor 2021, në sistemin C@TS dhe nga DTM duhet të merreshin masa për vendosjen e gjobës 50,000 lekë, pasi mos ndryshimi i librave nga tatim paguesi bie në kundërshtim me përcaktimet Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Neni-118- Mos mbajtja e saktë e librave,

regjistrave dhe dokumentacionit. *“Tatimpaguesi që nuk arrin të mbajë regjistrat dhe dokumentacionin tatimor, të kërkuar sipas këtij ligji, detyrohet të paguajë një gjobë me 10 000 lekë për çdo shkelje, në rastet kur është person fizik që ushtron veprimtari ekonomike tregtare apo si i vetëpunësuar dhe 50 000 lekë kur është person juridik”.*

- Nga shqyrtimi i kontratave të qerasë rezulton se ato janë mbi nivelin e referencës së qerasë minimale për qëllime fiskale sipas përcaktimeve ligjore përkatëse.

- Është bërë kontrolli i TVSH për periudhën objekt kontrolli dhe krahasimi ndërmjet treguesve sipas FDP-ve dhe të dhënave të Sistemit Informatik, Librave të Blerje, Shitjeve dhe faturave përkatëse.

- Është bërë evidentimi i blerjeve sipas origjinës, importe, blerje brenda vendit dhe i blerjeve që i shërbejnë shitjeve të përjashtuara.

- Është bërë kontrolli importeve dhe të dhënave të DPD nga ku kanë rezultuar diferenca të cilat kanë ardhur si shkak i rivlerësimit nga DPD, të cilat janë sqaruar në mënyrë analitike për çdo deklaratë.

- Është bërë analiza e kostos së çmimit të shitjes për periudhën Tetor 2021- Korrik 2022, e detajuar për të gjithë artikujt, por nuk është bërë inventari fizik krahasuar me inventarin kontabël në kundërshtim me përcaktimet e programit të kontrollit dhe Manualit të Kontrollit Tatimor, Kapitulli VIII, pika 8, kapitulli IX, pika 9.

- Është bërë kontrolli i eksporteve dhe janë sqaruar në mënyrë analitike diferencat ndërmjet eksporteve të deklaruara nga shoqëria dhe atyre të deklaruara nga dogana.

**-Subjekti:** *“R.B.H.B.” SHA*

**Nipti:** *L.A*

**Adresa kryesore:** *Lagja Balldren, Zone Kadastrale 1045, Nr Pasurie (A), Elbasan*

**Aktiviteti:** *Përpunimi dhe tregtimi i naftës dhe nënprodukteve të saj. Import, eksport dhe tregtimi me shumice e pakice i naftës dhe nënprodukteve të saj. Importi, eksporti, dhe tregtimi me shumice e pakice i gazit të lëngshëm, etj.*

**Inspektori:** *O.K.*

**Përgjegjës Sektori:** *A.D.*

**Drejtor Kontrolli:** *O.C.*

**Drejtor Rajonal:** *D.I.*

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

- Për **Rimbursimin e TVSH-Periudha tatimore Prill 2021-Tetor 2021**

- **Ore pune:** *80 orë*

**Në dosjen fizike administrohet dokumentacioni si më poshtë vijon:**

- Njoftim për kontroll tatimor nr. 785/1 prot., datë 16.02.2022, bashkëngjitur program kontrolli.

- Shkresa DPT-së me nr. 1472/2 prot., datë 08.02.2022, drejtuar DTM, për kontrollin në vend të kërkesës për rimbursim të tatimpaguesit, për TVSH për periudhën Prill 2021-Tetor 2021.

- Shkresa nr. 785/3 prot., datë 07.03.2022, për dërgimin e Projekt Raportit të kontrollit, por nuk administrohet Projekt Raporti në dosje. Në sistemin C@TS është hedhur në datë 02.03.2022, mbajtur në datë 27.10.2022.

- Shkresa nr. 4813/1 prot., datë 17.03.2022, kthim përgjigje e DPD-së, mbi të dhënat për deklaratat doganore të eksportit të shoqërisë për periudhën Prill 2021-Tetor 2021, administruar në DPD me nr. 785/4 prot., datë 18.03.2022, bashkëngjitur deklaratat.

- Raport kontrolli i mbajtur datë 23.03.2022, protokolluar në DTM me nr. 785/5 prot., datë 30.03.2022, hedhur në sistemin C@TS në datë 06.04.2022.



- Shkresa nr. 785/6 prot., datë 30.03.2022, dërgim Raporti Përfundimtar Kontrollit.
- Formulari 1- Raport i vizitës së kontrollit datë 27.02.2022.

**Nga auditimi ka rezultuar se:**

Subjekti "R.B.H. B." SHA me NIPT L.A ka paraqitur pranë Drejtorisë së rimbursimit të TVSH-së në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, dhe për dijëni Drejtorisë Tatimore të Tatimpaguesve të Mëdhenj kërkesën për rimbursim TVSH-je që i përket periudhës Prill-Tetor 2021, sipas shkresës së DPT-se nr 1472/2 prot, datë 08.02.2022 protokolluar në DTM me nr 785 prot, datë 10.02.2022, për miratim kontrolli të rimbursimit të TVSH-se që përfshin periudhën 01.04.2021 deri 31.10.2021, sipas kërkesës së subjektit. “Për rimbursim TVSH-je ne shumen 140,207,837 lekë. Kjo tepriçë TVSH-je vjen nga Eksportet e realizuara nga ana e shoqërisë.

- Në sistemin C@TS mungon dokumenti mbi Njoftimin e Kontrollit dhe Formulari 1- Raport i vizitës së kontrollit.

- Projekt Raporti, Raporti mbi kontrollin e kryer janë hedhur me vonesë në C@TS, jo në përputhje me Manualin e Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2.2.

- Raporti nuk ka bashkangjitur si pjesë përbërëse të tij “Formulari-pyetësor i vetë deklarimit para kontrollit”, jo në përputhje me Manualin e Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2.1 paragrafi 6.

- Është bërë kontrolli i eksporteve dhe janë sqaruar në mënyre analitike diferencat ndërmjet eksporteve të deklaruara nga shoqëria dhe atyre të deklaruara nga dogana, për muajin Qershor, Korrik dhe Shtator 2021, ndërkohë që për muajin Maj diferenca është 142 lekë.

- Është bërë verifikimi i blerjeve të tatueshme brenda vendit, eksportet dhe shitjet e tatueshme, sipas raport kontrollit.

- Është bërë analiza e kostos së çmimit të shitjes për periudhën Qershor-Tetor 2021, nga ku rezultojnë se çmimet e shitjes si brenda vendit si dhe në eksport janë më të larta se kosto e prodhimit të tyre.

- Është bërë bilanci material nga data 01.06.2021 (*lenë nga kontrolli i fundit*), deri në datën 31.12.2021, ku sipas të dhënave të paraqitura në Raport Kontrolli nuk kanë rezultuar diferenca.

- Bilanci material i lëvizjes në prodhim është bërë për periudhën 01.06.2021-31.12.2021, bilanci material për lëndën e parë është bërë për periudhën 01.06.2021-31.12.2021, bilanci material për produktin e gatshëm është bërë për periudhën 01.06.2021-01.06.2021, ndërkohë që kërkesa për rimbursimin e TVSH sipas njoftimit për kontroll dhe programit të kontrollit është për periudhën Prill-Tetor 2021.

- Sa sipër rezulton se janë 2 muaj Nëntor-Dhjetor 2021 për të cilat është bërë kontrolli i bilancit material por që nuk është përcaktuar në program kontrolli, në kundërshtim me përcaktimet e Manualit të Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2.1, germa a, ku citohet “*Njoftimi i kontrollit tatimor përmban periudhën ose periudhat tatimore, për të cilat kryhet kontrolli tatimor*”.

Gjithashtu nga analiza e bilancit material të paraqitur në Raport Kontrolli dhe kartës teknologjike të miratuar për shoqërinë, nuk administrohen të dhëna të mjaftueshme, për të rakorduar për sasinë e prodhuar për zërin 3- “*Gjysmë e produkte Elbasan Magazina 1*” në sasinë 8,166,523 kg, zërin 5- “*Gjysmë Produkte (Hollues)*” në sasinë 1,077,840 kg, pasi nuk ka të dhëna specifike për sasinë e lëndës së parë të përdorur për këto dy zëra, si dhe humbjet nga prodhimi, çka e bën të paqartë metodologjinë e kontrollit të aplikuar në këtë rast nga Inspektori i Kontrollit në kundërshtim me Manualin e Kontrollit Tatimor, Kapitulli VIII, pika 8.

**-Subjekti:** “D.A.” SHPK

**Nipti:** J.T

**Adresa kryesore:** Lagja 4, Rruga Egnatia, Zona kadastrale 8514, Nr. pasurie 2/30- N2, N3,

Durrës.

**Adrese sekondare:** Lagja 4, Rruga Iljaz Reka, pranë stacionit të trenit, Zona kadastrale 8514 , Nr. pasurie 4/33+1-84 , Durres.

**Aktiviteti:** Agjensi detare, spedicionere dhe turistike.

**Inspektori:** B.M.

**Përgjegjës Sektori:** A.S.

**Drejtor Kontrolli:** M.R.

**Drejtor Rajonal:** I.A.

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

Periudha për kontroll (Rikontroll).

Sipas njoftimit dhe programit për kontroll, periudha që do të kontrollohet është:

**TVSH 2014/01-2017/07**

**Tatim Fitimi 2014-2016**

**Sigurimet Shoqërore 2014/01-2017/07**

**Të tjera Deri 2017/07**

**Ore pune:** 228 orë

Sipas njoftimit të kontrollit nr. 4393/1 prot, datë 03.08.2020, ka filluar ri kontrolli tatimor. Me shkresën 4393/2 prot, datë 03.08.2020, shoqëria është përzgjedhur dhe për kontroll tatimor.

Sipas Autorizimit nr. 4393/4 prot, datë 04.09.2020, shtesë për kryerje kontrolli tatimor, është kryer kontrolli si më poshtë:

**TVSH 2017/08-2020/01**

**Tatim Fitimi 2017-2018**

**Sigurimet Shoqërore 2017/08-2020/01**

**Ore pune shtesë:** 304 orë

**Nga auditimi ka rezultuar se:**

- Në sistemin C@TS mungon dokumenti mbi Njoftimin e Kontrollit dhe Formulari 1- Raport i vizitës së kontrollit.

- Projekt Raporti është mbajtur në datë 26.11.2020 dhe është hedhur në sistem në datë 23.12.2020, ndërkohë që raporti i kontrollit është mbajtur në datë 11.05.2020, hedhur në sistem po në datë 11.05.2020. Raporti i Kontrollit është mbajtur dhe është hedhur në sistem gati 5 muaj më vonë nga data kur është mbajtur projekt raporti, në kundërshtim me përcaktimet e Manualin i Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2.2, 2.5 paragrafi 10.

- Është kryer intervista me tatimpaguesin dhe njohja me aktivitetin në tërësi.

- Është kryer kontrolli për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore për periudhën Janar 2014-Janar 2020, sipas përcaktimit të programit të kontrollit.

- Është kryer kontrolli mbi tatim burimin dhe shqyrtimi i kontratave të qerasë, rezulton se ajo është mbi nivelin e referencës së qerasë minimale për qëllime fiskale sipas përcaktimeve ligjore përkatëse.

- Është kryer kontrolli i TVSH-së, analiza e shitjeve, librat e shitjeve, analiza e blerjeve, librat e blerjeve, deklarimi në sistem për periudhën 2014/01-2020/01, saktësia e deklarimit të TVSH-së duke i krahasuar me FDP-te mujore.

- Nga kontrolli i blerjeve të përjashtuara për vitin 2019, rezulton një diferencë më e madhe në librat e blerjeve në krahasim me FDP-te në shumën 30,000 lekë, diferencë e cila ka të bëjë me blerjet e përjashtuara të muajit Shtator 2019 të deklaruara më pak nga ana e shoqërisë në plotësimin e FDP përkatëse ku blerjet e përjashtuara sipas librave të blerjeve janë 63,774,141 lekë ndërsa në FDP janë deklaruar blerje të përjashtuara në shumën 63,744,141 lekë. Për

diferencën në shumën 30,000 lekë nga ana e Inspektorit janë bërë rivlerësimet përkatëse duke rritur në muajin Shtator 2019 blerjet e përjashtuara në shumën 30,000 lekë.

- Është kryer kontrolli i zërit shpenzime “*Amortizime*”, ku përgjithësisht kanë të bëjnë me amortizimet e llogaritura për ndërtesa (zyra), impiante dhe makineri, mjete transporti dhe pajisje zyrash e kompjuterike, për të cilat nga ana e shoqërisë janë zbatuar normat e amortizimit sipas grupeve përkatëse.

- Për vitin 2018 është bërë kontrolli i eksporteve dhe importeve të deklaruara nga shoqëria, ku janë sqaruar në mënyre analitike diferencat ndërmjet atyre të deklaruara nga shoqëria dhe atyre të deklaruara nga dogana.

- Është kryer analiza e zërave të bilancit kontabël si aktivet, detyrimet dhe kapitali i vet për periudhën 2014-2018, sipas përcaktimit të programit të kontrollit. Është kryer analiza e rezultatit financiar dhe analiza e zërave të të ardhurave dhe shpenzimeve për periudhën 2014-2018, sipas përcaktimit të programit të kontrollit.

- Nga kontrolli i shpenzimeve për vitin 2017, rezulton se janë deklaruar si shpenzime për “*Zhvlërimi i aktiveve afatgjata materiale*” në shumën 2,570,853 lekë, ndërsa në fakt këto shpenzime janë 1,836,425 lekë. Diferenca e deklaruar me shumë në shpenzime të ushtrimit për shumën 734,428 lekë janë shpenzime të pa zbritshme sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për Tatimin mbi të Ardhurat” i ndryshuar, neni 21, Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni nr 115 dhe Udhëzimit të Ministrisë të Financave në zbatim të tij, pika 3.6, germa 1. Nga ana e Inspektorit janë bërë rivlerësimet përkatëse duke rritur shpenzimet e pazbritshme për 2017 në shumën 734,428 lekë dhe detyrim 24,126 lekë.

- Në zërin shpenzime për pritje e përcjellje në shumën 40.000 lekë ka të bëjë me shpenzimet e kryera për organizimin e festave të vitit të ri me punonjësit e shoqërisë, shpenzime të cilat janë të karakterit të konsumit personal dhe si të tilla janë shpenzime të pazbritshme sipas përcaktimeve ligjore sipërcituar. Nga ana e Inspektorit janë bërë rivlerësimet përkatëse në deklaratën e tatimit fitimit të vitit 2017 duke rritur shpenzimet e pazbritshme në shumën 40.000 leke dhe është llogaritur penalteti.

-Rezultoni se blerjet e kryera për kafe për personelin në shumën 189,568 leke janë blerje të karakterit të konsumit personal dhe si të tilla janë shpenzime të panjohura. Nga ana e Inspektorit janë bërë rivlerësimet përkatëse në deklaratën e tatimit fitimit të vitit 2017 duke rritur shpenzimet e pazbritshme për 189,568 lekë, si dhe detyrim shtesë penaltetit në vlerën 6,227 lekë.

- Në zërin shpenzime për subvencione, për vitin 2018, në shumën 50.000 leke ka të bëjë me shpenzimet e kryera për sponsorizime për të cilën shoqëria nuk disponon dokumentacionin e duhur dhe si të tilla këto shpenzime janë të pazbritshme. Nga ana e Inspektorit janë bërë rivlerësimet përkatëse në deklaratën e tatimit fitimit të vitit 2018, duke rritur shpenzimet e pazbritshme në deklaratën e tatimit fitimit të vitit 2018 për 50.000 leke dhe duke llogaritur penaltetin.

- Në zërin shpenzime zyre, për vitin 2018, në shumën 372,217 lekë ka të bëjë me shpenzimet e kryera për shërbimet e ofruara për riparime të ndryshme, blerje materiale të tjera si dhe blerje për personelin kafe në shumën 237,082 leke për nevojat e aktivitetit.

- Në zërin shpenzime për pritje e përcjellje në shumën 189,550 lekë ka të bëjë me shpenzimet e kryera për organizimin e festave të vitit të ri me punonjësit e shoqërisë për të cilat shoqëria disponon fature të rregullt tatimore.

Këto shpenzime janë blerje të karakterit të konsumit personal dhe si të tilla janë shpenzime të panjohura. Nga ana e Inspektorit janë bërë rivlerësimet përkatëse në deklaratën e tatim fitimit të vitit 2018, duke rritur shpenzimet e pazbritshme dhe duke llogaritur penalitetin.

- Sipas përcaktimit në program kontrolli, pika VIII, është trajtuar hollësisht shkresa e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës me nr.841 prot., datë 06.02.2020 protokolluar në DPT me nr.2970 prot, datë 10.02.2020 me lëndë “Kërkesë për kontroll tatimor”.

- Në përfundim shoqërisë i është llogaritur një detyrim total në vlerën 265,382 lekë për të cilën është bërë njoftimi vlerësimi përkatës.

**-Subjekti:** “C.A.” SHPK

**Nipti:** L.L

**Adresa kryesore:** Njësia Bashkiake nr.5, Rruga “Janos Hunyadi”, nr. 20, prapa Fakultetit Juridik, Tiranë.

**Aktiviteti:** “Ofrimi i të gjitha shërbimeve që lidhen me shërbime komunikimi (call center), shërbime kontakti (contact center) si dhe aktivitet administrativ ndihmës (back office), në fushën e kujdesit ndaj klientit, telemarketingut apo tele-shitjeve (teleselling)...(Vazhdon edhe më tepër sipas përshkrimit të QKB-së).”

**Inspektori:** G.J.K.

**Përgjegjës Sektori:** A.S.

**Drejtor Kontrolli:** M.R.

**Drejtor Rajonal:** I.A.

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

- Për **Rimbursimin e TVSH-Periudha tatimore Gusht 2018- Janar 2020**

- **Ore pune:** 120 orë

**Në dosjen fizike administrohet dokumentacioni si më poshtë vijon:**

- Kërkesa e shoqërisë “C.A.” SHPK, drejtuar DPT-së, për rimbursimin e TVSH për periudhën Gusht 2018-Janar 2020 në vlerën 19,347,942 lekë.

- Shkresa e DPT-së me nr. 8867/2 prot., datë 26.05.2021, drejtuar DTM-së, për kontrollin në vend të kërkesës për rimbursim të tatimpaguesit, për TVSH për periudhën Gusht 2018- Janar 2020 në vlerën 19,347,942 lekë.

- Njoftim për kontroll tatimor nr. 4670/1 prot., datë 02.06.2021, bashkëngjitur program kontrolli.

- Shkresa nr. 4670/2 prot., datë 12.07.2021, për dërgimin e Projekt Raportit të kontrollit.

- Shkresa datë 15.07.2021 e kompanisë “C.A.” SHPK, administruar pranë DTM me nr. 4670/3 prot, datë 19.07.2021, kthim përgjigje mbi projekt raportin e kontrollit.

- Raport kontrolli i mbajtur datë 21.07.2021, protokolluar në DTM me nr. 4670/4 prot., datë 23.07.2021, hedhur në sistemin C@TS në datë 08.07.2021.

- Procesverbali nr. 1, datë 16.06.2021, mbi detyrimet e konstatuara.

- Formulari 3- Raport i vizitës së kontrollit.

- Njoftimi vlerësimi për detyrimet tatimore me nr. 4670/5 prot, datë 23.07.2021.

**Nga auditimi ka rezultuar se:**

- Formulari 3- Raport i vizitës së kontrollit dhe Raporti Përfundimtar i Kontrollit nuk janë hedhur në sistemin C@TS, jo në përputhje me Manualin, Kapitulli II, pika 2.2.

- Formulari 3- nënshkrimi nga Inspektori, Përgjegjësi i Sektorit, Drejtori Drejtorisë dhe Drejtori i Drejtorisë Rajonale nuk ka datë.

- Procesverbali mbi kontrollin e kryer është hedhur me vonesë në C@TS, jo në përputhje me Manualin, Kapitulli II, pika 2.2.

- Raporti nuk ka të bashkangjitur si pjesë përbërëse të tij “Formulari-pyetësor i vetë deklarimit para kontrollit”, jo në përputhje me Manualin i Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2.1 paragrafi 6.
- Subjekti “C.A.” SHPK me NIPT L.L ka paraqitur “Kërkesë për rimbursim të TVSH-së” nr. ska, datë 17.05.2021, protokolluar në D.P.Tatimeve me Nr. 8867, datë 18.05.2021 për periudhën tatimore, Gusht 2018-Janar 2020 për shumën 19,347,942 lekë.  
Me shkresën e DPT-së nr. 8867/2 prot., datë 26.05.2021, me lënde “Dërgohet shkresë për veprim”, protokolluar në DTM me nr.4670 prot., datë 27.05.2021, është kërkuar kontrolli dhe saktësimi i shumës së rimbursueshme të TVSH-së sipas kërkesës së subjektit “C.A.” SHPK me NIPT L.L.
- Është kryer kontrolli i TVSH-së, analiza e shitjeve, librat e shitjeve, analiza e blerjeve, librat e blerjeve, deklarimi në sistem për periudhën 08.2018-01.2020.
- Janë analizuar treguesit e pagesës apo tepricës kreditore të TVSH-së.
- Janë analizuar klientët dhe furnitorët kryesorë.
- Janë kontrolluar dhe verifikuar faturat e blerjes dhe të shitjes dhe rakordimi i tyre me FDP.
- Është kryer zbërthimi e analiza e komponentëve të TVSH-së.
- Verifikimi dhe kontrolli i deklaratave të TVSH-së dhe përputhja e tyre me të dhënat e librave të blerjes dhe shitjes.
- Është bërë kontrolli i importeve dhe janë sqaruar në mënyre analitike diferencat ndërmjet importeve të deklaruara nga shoqëria dhe atyre të deklaruara nga dogana.
- Është përcaktuar prejardhja e tepricës së TVSH-së kreditore në fund të periudhës.

**-Subjekti:** “C.S.” SHPK

**Nipti:** L.U

**Adresa kryesore:** Rruga Muhamet Gjollësia, Qendra Tregtare Tirana Ring Center, Ndërtesa Nr.8, Zyra katet VI-VIII, Nr.Pasurie 3/22-N10/1, ZK 8210, Vol 33, Fq 191, Kodi postar 1001.

**Aktiviteti:** “Furnizimi i shërbimeve dhe administrimi i arkivave, shërbime telematike, lajmesh, banke të dhënash, nëpërmjet krijimit të portaleve internet; administroje shërbime "call center" dhe të kontaktit telefonike në përgjithësi, edhe nëpërmjet marrjes dhe kalimit të telefonatave, e gjitha si për llogari të saj edhe për llogari të të tretëve...”

**Inspektori:** D.B.

**Përgjegjës Sektori:** A.D.

**Drejtor Kontrolli:** E.M.

**Drejtor Rajonal:** E.C.

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

- Për **Rimbursimin e TVSH-Periudha tatimore Janar 2018- Dhjetor 2019**

- **Ore pune:** 181 orë

**Në dosjen fizike administrohet dokumentacioni si më poshtë vijon:**

- Shkresa e DPT-së sipas numrit të çështjes E0001009166, datë 28.10.2022, drejtuar DTM-së, për kontrollin në vend të kërkesës për rimbursim të tatimpaguesit, për TVSH për periudhën Janar 2018-Dhjetor 2019 në vlerën 26,851,641 lekë.
- Njoftim për kontroll tatimor nr. 9420 prot., datë 07.11.2022, bashkëngjitur program kontrolli.
- Shkresa nr. 9420/1 prot., datë 09.12.2022, për dërgimin e Projekt Raportit të Kontrollit.
- Shkresa e Shoqërisë “C. S” SHPK, konfirmim marrje raport kontrolli, administruar në DTM me nr. 9420/2 prot., datë 23.12.2022.

- Raport kontrolli i mbajtur datë 27.12.2022, protokolluar në DTM me nr. 9420/3 prot, datë 29.12.2022, hedhur në sistemin C@TS në datë 29.12.2022.
- Shkresa nr. 9420/4 prot., datë 29.12.2022, njoftimi vlerësimi për detyrimet tatimore.
- Shkresa nr. 9420/5 prot., datë 29.12.2022, për evadimin e praktikës.
- Procesverbali nr. 1, datë 25.11.2022, mbi detyrimet e konstatuara.
- Procesverbali nr. 2, datë 01.12.2022, mbi detyrimet e konstatuara.
- Formulari 3- Raport i vizitës së kontrollit.

**Nga auditimi ka rezultuar se:**

- Formulari 3- nënshkrimi nga Drejtori Drejtorisë dhe Drejtori i Drejtorisë Rajonale nuk ka datë.
- Procesverbali dhe Projekt Raporti mbi kontrollin e kryer është hedhur me vonesë në C@TS, jo në përputhje me Manualin, Kapitulli II, pika 2.2.
- Raporti nuk ka të bashkangjitur si pjesë përbërëse të tij “Formulari-pyetësor i vetë deklarimit para kontrollit”, jo në përputhje me Manualin e Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2.1 paragrafi 6.
- Subjekti “C.S” SHPK me NIPT L.U ka paraqitur “Kërkesë për rimbursim të TVSH-së” numër RAE0000230630, datë 20.10.2022, për periudhën Janar 2018-Dhjetor 2019 për shumën 26,851,641 lekë.
- Shkresa e DPT-së, pa numër dhe datë, sipas numrit të çështjes E0001009166, datë 28.10.2022, drejtuar DTM-së, është kërkuar kontrolli dhe saktësimi i shumës së rimbursueshme të TVSH-së sipas kërkesës së subjektit “C.S.” SHPK me NIPT L.U.
- Është kryer kontrolli i TVSH-së, analiza e shitjeve, librat e shitjeve, analiza e blerjeve, librat e blerjeve, deklarimi në sistem për periudhën 01.2018-12.2019.
- Janë analizuar treguesit e pagesës apo tepricës kreditore të TVSH-së.
- Janë analizuar klientët dhe furnitorët kryesorë.
- Janë kontrolluar dhe verifikuar faturat e blerjes dhe të shitjes dhe rakordimi i tyre me FDP.
- Është kryer zberthimi e analiza e komponentëve të TVSH-së.
- Verifikimi dhe kontrolli i deklaratave të TVSH-së dhe përputhja e tyre me të dhënat e librave të blerjes dhe shitjes.
- Është bërë kontrolli i importeve dhe janë sqaruar në mënyre analitike diferencat ndërmjet importeve të deklaruara nga shoqëria dhe atyre të deklaruara nga dogana.
- Është përcaktuar prejardhja e tepricës së TVSH-së kreditore në fund të periudhës.

**-Subjekti:** “A.” SHA

**Nipti:** L.M

**Adresa kryesore:** Rr. Donika Kastrioti, Vila 9/1, Tiranë

**Aktiviteti:** Shoqëria ka për objekt të saj sigurimet e përgjithshme, si dhe çdo objekt tjetër veprimtarie të lejuar nga legjislacioni në fuqi dhe që nuk vjen në kundërshtim me Ligjin Nr.9267 date 29.07.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe ri sigurimit dhe ndërmjetësimin ne sigurime dhe ri sigurime” dhe me rregullat e përcaktuara me akte të veçanta nënligjore.

**Inspektori:** M.H dhe S.M.

**Përgjegjës Sektori:** A.D.

**Drejtor Kontrolli:** O.C.

**Drejtor Rajonal:** E.C.

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

- Për TVSH 11/2019 – 10/2021
- Tatim Fitimi 2019-2020

- **Sigurimet Shoqërore, Shëndetësore dhe TAP 11/2019 – 10/2021.**
- **Tatime te Tjera 11/2019 - 10/2021.**
- **Afati i kontrollit:** 316 ore pune.

**Në dosjen fizike administrohet dokumentacioni si më poshtë vijon:**

- Njoftim për kontroll tatimor nr. 10949 prot., datë 22.12.2021, bashkëngjitur program kontrolli.
- Shkresa nr. 11 prot., datë 07.01.2022, drejtuar DTM-së, për dërgimin e formularit pyetësor i vetë deklarimit.
- Procesverbali nr. 1, datë 07.02.2022.
- Procesverbali nr. 2, datë 07.02.2022.
- Formulari 1- Raport i vizitës së kontrollit datë 04.07.2022.
- Shkresa nr. 10949/3 prot., datë 06.07.2022, për dërgimin e Projekt Raportit të kontrollit, por nuk administrohet Projekt Raporti në dosje. Në sistemin C@TS është hedhur në datë 04.07.2022, mbajtur në datë 31.05.2021.
- Raport kontrolli i mbajtur datë 10.08.2021, protokolluar në DTM me nr. 10949/4 prot., datë 15.08.2022, hedhur në sistemin C@TS në datë 11.08.2021.
- Shkresa nr. 10949/5 prot., datë 15.08.2022, njoftimi vlerësimi për detyrimet tatimore.
- Shkresa nr. 10949/6 prot., datë 15.08.2022, për evadimin e praktikës.

**Nga auditimi ka rezultuar se:**

- Njoftimi i kontrollit është bërë në datë 22.12.2021, ndërkohë që kontrolli në subjekt ka filluar në datë 07.02.2022, duke mos respektuar afatin 30 ditor nga njoftimi i kontrollit, në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit 9920 “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 81, pika 1.1.
- Projekt Raporti dhe procesverbalet mbi kontrollin e kryer janë hedhur me vonesë në C@TS, jo në përputhje me Manualin e Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2.2.
- Formulari nr. 3, nënshkrimi nga Përgjegjësi i Sektorit të Kontrollit, Drejtori i Kontrollit dhe Drejtori i Drejtorisë Rajonale nuk kanë datë.
- Kontrolli është kryer në tejkalim të afatit të parashikuar në programin e kontrollit, me afat 316 orë pune, pasi kontrolli ka filluar me datë 07.02.2022 dhe ka përfunduar në datë 31.05.2022, pra 600 orë/79 ditë pune, jo në përputhje me përcaktimet e Manualit të Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2.3.
- Projekt Raporti është mbajtur në datë 31.05.2022, hedhur në sistemin C@TS në datë 04.07.2022, dhe nisur subjektit me shkresën nr. 10949/3 prot., datë 06.07.2022, gati 35 ditë nga përfundimi nga Inspektori, jo sipas përcaktimeve të Ligjit 9920 “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 81, pika 1.
- Projekti është përfunduar në subjekt në datë 31.05.2021, ndërkohë Raporti Përfundimtar i Kontrollit është përfunduar në datë 10.08.2022, duke tejkaluar afatet nga përgatitja dhe dërgimi i Projekt Raporti deri në përgatitjen dhe dërgimin e Raportit Përfundimtar të Kontrollit në subjekt, në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit Nr. 9920 “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 83, pika 1 dhe 4, Neni 84, pika 1.
- Nga auditimi konstatohet se nuk është bërë analiza për çmimet e aplikuara nga kompania në krahasim me çmimet e investiguara dhe bilanci material për policat e sigurimit në kundërshtim me përcaktimet e pikave të kontrollit, “Kontrolli për tatim fitimin”, sipas Programit të Kontrollit të miratuar, si dhe përcaktimet e Ligjit 9920 “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, Kreu X, neni 80, pika 5 dhe 6, Neni 81, Manualit të Kontrollit Tatimor, Kapitulli VIII, pika 8, kapitulli IX, pika 9. Sipas shpjegimeve të inspektorëve të kontrollit analiza e çmimeve dhe bilanci material nuk është kryer pasi shitjet e policave të sigurimit monitorohen

online nga AMF dhe nuk është nevojshme, por nuk është bërë asnjë sqarim në Raport Kontrolli, për këtë pikë referuar përcaktimeve ligjore. Nga DTM duhet të merren masa që në të ardhmen të azhornohen programet e kontrollit, referuar përcaktimeve ligjore, duke mos përfshirë pika për të cilat nuk është e nevojshme realizimi i kontrollit.

- Nga kontrolli i ushtruar mbi pagesën e taksës kombëtare mbi primin e shkruar, rezultoi se nga të dhënat e paraqitura për periudhën Nëntor-Dhjetor 2019 dhe Janar-Tetor 2021, në Raport Kontrolli nuk janë bërë sqarime analitike për vlerën e primit të shkruar bruto sipas produkteve. Gjithashtu për vitin 2020, në Raport Kontrolli nuk është bërë analizë dhe sqarime analitike për mos rakordimet e rezultuara ndërmjet shitjeve të deklaruara për produktet “*mjete motorike*” dhe “*pasuri*” dhe vlerave të primit shkruar bruto të llogaritur për këto produkte, se çfarë përfaqësojnë këto diferenca, klasifikimin e tyre, nëse janë për bashkë sigurimet, primit e vetë shoqërisë, risigurimet, etj., Mosrakordimet për secilin zë, për vitin 2020 paraqitet si më poshtë:

Produkti	2020		
	Shitje	Primi shkruar Bruto	Diferenca
Mjete motorrike	1,091,207,681	997,768,742	93,438,939
Prona	82,118,774	72,692,633	9,426,141
TOTALI	1,173,326,455	1,070,461,375	102,865,080

Sipas shpjegimeve të dhëna nga Inspektori i Kontrollit në observacione, mosrakordimet ndërmjet shitjeve të deklaruara dhe vlerave të primit të shkruar për vitin 2020, kanë ardhur për shkak të primeve të vetë shoqërisë të sqaruara në mënyrë analitike për secilin zë, për cdo vit, por këto diferenca nuk përputhen me ato të nxjerra nga Grupi i Auditimit.

- Nga analiza mbi blerjet e kryera nga kompania dhe zërit shpenzimet në Bilanc, për zërin “*Servis Deme*” në vlerën 205,006,791 lekë për periudhën Nëntor 2019-Tetor 2021, nga ana e Inspektorit nuk është bërë analizë e thelluar nëse këto shpenzime janë në funksion të aktivitetit ekonomik të kompanisë, në raport kontroll nuk ka të dhëna në lidhje me kontrollin për dosjet e dëmeve, procedurën e ndjekur, vlerën e miratuar, dokumentacion e administruar në dosje, kampionin e përzgjedhjes së dosjeve për kontroll. Veprimet më sipër bien në kundërshtim me pikat e miratuara të Programit të Kontrollit si dhe përcaktimet e Manualit të Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2.1, Kapitulli VIII, pika 8.

**-Subjekti:** “A.” SHA

**Nipti:** J.S

**Adresa kryesore:** Jordan Misja, Tiranë

**Aktiviteti:** “*Import, blerje dhe tregti me shumice të produkteve të naftës, etj. Tregtimin me shumice të naftës bruto. Furnizim i të gjitha mjeteve detare me hidrokarbure në Porte dhe në Rada.*”

**Inspektori:** E.D.

**Përgjegjës Sektori:** A.D.

**Drejtor Kontrolli:** O.C.

**Drejtor Rajonal:** E.C.

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

- Për TVSH, për periudhën nga Korrik 2020 - Qershor 2022.

- Për Tatim Fitimin për vitet 2020 dhe 2021.

- Për Sigurimet Shoqërore, Shëndetësore dhe TAP për periudhën Korrik 2020-Qershor 2022.

- Për tatime të tjera Korrik 2020-Qershor 2022.

- Ore pune: 128 orë pune

Kontrolli filloi në datën 23/09/2022 dhe përfundoi në datën 12/10/2022.

Në dosjen fizike administrohet dokumentacioni si më poshtë vijon:



- Njoftim për kontroll tatimor nr. 6954/2 prot, datë 21.09.2022, bashkëngjitur program kontrolli.
- Shkresa nr.6954/3 prot, datë 17.10.2022, për dërgimin e Projekt Raportit të Kontrollit.
- Shkresa e Shoqërisë A. SHA, konfirmim marrje Projekt Raport Kontrolli, administruar në DTM me nr. 6954/1 prot datë 16.09.2022.
- Raport kontrolli i mbajtur datë 27.10.2022, protokolluar në DTM me nr. 6954/5 prot, datë 28.10.2022, hedhur në sistemin C@TS në datë 27.10.2022.
- Shkresa e Shoqërisë A. SHA me nr. 962 prot, datë 24.10.2022, konfirmim marrje Raport Kontrolli, administruar në DTM me nr. 6954/4 prot datë 25.10.2022.
- Shkresa nr. 6954/6 prot, datë 28.10.2022, njoftimi vlerësimi për detyrimet tatimore.
- Shkresa nr. 6954/7 prot, datë 28.10.2022, për evadimin e praktikës.
- Procesverbali nr. 1, datë 28.09.2022, mbi detyrimet e konstatuara.
- Procesverbali nr. 2, datë 28.09.2022, mbi detyrimet e konstatuara.
- Procesverbali nr. 3, datë 05.10.2022, mbi detyrimet e konstatuara.
- Procesverbali nr. 4, datë 07.10.2022, mbi detyrimet e konstatuara.
- Formulari 3- Raport i vizitës së kontrollit.

**Nga auditimi ka rezultuar se:**

- Formulari 3- nënshkrimi nga Inspektori, Përgjegjësi i Sektorit, Drejtori Drejtorisë dhe Drejtori i Drejtorisë Rajonale nuk ka datë.
- Procesverbalet dhe Projekt Raporti mbi kontrollin e kryer janë hedhur me vonesë në C@TS, jo në përputhje me Manualin, Kapitulli II, pika 2.2.
- Është kryer kontrolli i TVSH-së, analiza e shitjeve, librat e shitjeve, analiza e blerjeve, librat e blerjeve, deklarimi në sistem për periudhën 01.2018-12.2019.
- Janë analizuar treguesit e pagesës apo tepricës kreditore të TVSH-së.
- Janë analizuar klientët dhe furnitorët kryesorë.
- Janë kontrolluar dhe verifikuar faturat e blerjes dhe të shitjes dhe rakordimi i tyre me FDP.
- Është kryer zbërthimi e analiza e komponentëve të TVSH-së.
- Është kryer verifikimi dhe kontrolli i deklaratave të TVSH-së dhe përputhja e tyre me të dhënat e librave të blerjes dhe shitjes.
- Është bërë kontrolli i importeve dhe janë sqaruar në mënyre analitike diferencat ndërmjet importeve të deklaruara nga shoqëria dhe atyre të deklaruara nga dogana.
- Është përcaktuar prejardhja e tepricës së TVSH-së kreditore në fund të periudhës.
- Nga analiza e TVSH për periudhën 01.07.2020-31.12.2020, nga krahasimi i shitjeve në FDP rezulton vlera e tatueshme 139,981,013 lekë dhe shitjeve të paraqitura sipas librit të shitjeve rezulton vlera 151,518,859 leke, pra kemi një diferencë prej 11,537,846 leke, e cila nga Inspektori është konsideruar si paradhënie ndaj klientëve, shoqëruar me fatura tatimore dhe të deklaruara si nga shitësi dhe nga blerësi. Ndërkohë nga të dhënat e marra nga shitjet me kasë për gazoil dhe benzine për adresat si dhe FDP e deklaruara, të pasqyruara në Raport Kontrolli, rezulton se vlera 11,537,846 lekë është deklaruar si shitje me kasë në Porto Romano. Kjo diferencë konstatohet dhe nga analiza e bilancit material, ku subjekti për vlerën e parapagimit ka bërë zbritje gjendjen e inventarit, çka tregon se kjo sasi karburanti është shitur dhe malli nuk pasqyrohet gjendje në inventar, janë të dhëna kontradiktore. Gjithashtu nga të dhënat e pasqyruara në bilanc kjo vlerë nuk është llogaritur si paradhënie. Nga shpjegimet dhe të dhënat e vëna në dispozicion Grupit të Auditimit nga Inspektori i Kontrollit, nga argumentet e trajtuara më sipër si dhe mënyrës se si funksionon sektori hidrokarbureve, mbetet e paqartë klasifikimi i kësaj vlere si parapagim dhe mbart risk për mos pasqyrim të saktë të situatës financiare dhe llogaritjen e detyrimeve tatimore. Nëse do ti referohemi përcaktimeve të Ligjit nr.9920, datë

19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Nenit 124, për vlerën 11,537,846 lekë, do të llogaritej një detyrim total 8,076,491 lekë ( *TVSH+ TF+ gjoba*).

- Nga analiza e koston dhe bilancit material për periudhën 01.07.2020-31.12.2021 kanë rezultuar diferenca dhe mos pasqyrim i saktë i gjendjes në inventar, pasi produkti naftë është paraqitur me kosto ndërsa produkti benzine me çmim shitje, si më poshtë:

a)- *Analiza e koston për periudhën 01.07.2020-31.12.2020*

Nr.	EMERTIMI	Sasi	Kosto	Vlefte	Kosto sipas analizës	Vlera me kosto	Diferenca në vlerë të tatueshme
1	Diesel	21,619	104	2,238,682	104	-	-
2	Benzine	25,750	122	3,142,130	105	2,703,794	438,336

Sa më sipër rezulton se për pasqyrimin e gjendjes së inventarit, subjekti naftën e ka paraqitur me kosto ndërsa produktin benzinë me çmim shitje. Diferenca e vlerës 438,336 lekë, midis koston dhe çmimit të shitjes, reflektohet në gjendjen e inventarit të deklaruar nga shoqëria.

b)- *Bilanci material për periudhën 01.07.2020-31.12.2020*

Artikulli	Gjendje fillim	Hyrje sipas Raport Kontrollit	Hyrje sipas deklarimeve te subjektit	Dalje	Gjendje Kontabël	Gjendje fizik	Diferenca ne Litra
Diesel	255,311	971,573	1,149,574	1,205,265	21,619	199,620	178,001
Benzine	30,984	227,476	232,782	232,710	25,750	31,056	5,306

c)- *Bilanci material për periudhën 01.01.2021-31.12.2021*

Artikulli	Gjendje fillim	Hyrje sipas Raport Kontrollit	Hyrje sipas C@TS	Dalje sipas Raport Kontrollit	Dalje Sipas C@TS	Gjendje Kontabël fund	Gjendje Fizike Litra	Diferenca ne Litra
Diesel	21,618.98	406,290	425,158	427,908.98	426,373	-	20,403.98	20,403
Benzine	25,750.42	49,175	61,000	74,925.42	61,000	-	25,750.42	25,750

- Sa sipër nga shpjegimet dhe të dhënat e vëna në dispozicion Grupit të Auditimit nga Inspektori i Kontrollit, nga analiza e të dhënave të pasqyruara në Raportin e Kontrollit, si dhe mënyrës se si funksionon sektori hidrokarbureve, mbeten të paqarta mos pasqyrimi i saktë i gjendjes në inventar dhe mos rakordimet në bilancin material për periudhën 01.07.2020-31.12.2021, duke mbartur risk për mospasqyrim të saktë të situatës financiare dhe llogaritjen e detyrimeve tatimore. Nëse do të ti referohemi përcaktimeve të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Nenit 124, për analizën e pasaktë të koston dhe mosrakordimet në bilancin material, do të llogaritej detyrimi, si më poshtë:

a)- *Për periudhën 01.07.2020-31.12.2020*

Nr.	EMERTIMI	Diferenca në vlerë të tatueshme	TVSH/Gjobe	Tatim Fitimi/ Gjobe
1	Diesel	-		
2	Benzine	438,336	175,334	131,500
	SHUMA		306,834 lek	

Artikulli	Diferenca ne vlere te tatueshme	TVSH/Gjobe	Tatim Fitimi/ Gjobe
Diesel	22,784,128	9,113,652	6,835,238
Benzine	673,862	269,544	202,158
		9,383,196	7,037,397
SHUMA			16,420,593

b)- *Për periudhën 01.01.2021-31.12.2021*

Artikulli	Diferenca ne vlere te tatueshme	TVSH/Gjobe	Tatim Fitimi/ Gjobe
Diesel	2,774,941	1,109,976	832,482
Benzine	3,605,000	1,442,000	1,081,500
		2,551,976	1,913,982
SHUMA			4,465,959

Në përfundim në kushtet kur nga Grupi i auditimit nuk administrohet të dhënat të mjaftueshme, dhe pasqyrimi i tyre në Raport Kontrolli është i paqartë, nga DPT duhet të merren të gjitha masat

konform legjislacionit tatimor për të kryer vlerësimet dhe rivlerësimet përkatëse, pasi ka risk për mospasqyrim të saktë të situatës financiare dhe llogaritjen e detyrimeve tatimore me efekt mungesën e të ardhurave për buxhetin e shtetit, sa më sipër.

- Nga verifikimi i pasqyrave financiare të viteve 2020, rezulton se subjekti në pasiv të bilancit (Detyrime Afatshkurtra), zëri “Debitore dhe kreditore të tjerë” është pasqyruar në shumën 527,683,598 lekë. Sipas raportit të kryer nga ana e inspektorit citohet se...“në bilancin e vitit 2020 zëri “debitor e kreditor të tjerë” paraqitet në shumën 527,683,598 lekë dhe kjo shumë përfaqëson detyrimet që ka shoqëria gjendje me 31.12.2020 ndaj ortakut dhe shoqërive me të njëjtin ortak G., A.. Kjo llogari ka ardhur në renie, saktësisht në vlerën (8,207,057) lekë. Nuk ka asnjë informacion nëse ka kontratat të lidhura midis palëve, afatet e huadhënies, mënyra e kryerjes se transaksioneve (me Banke apo Cash), etj, nga ana e inspektorit nuk është kryer një analizë dhe nuk është dhënë asnjë shpjegim në lidhje me krijimin e këtyre të ardhurave, të cilat i janë dhënë hua shoqërisë. Nga ana e inspektorit nuk është bërë informacioni RAD (Raportim i Aktivitetit të Dyshimtë) në lidhje me shumat e parave të cilat kanë kaluar si hua ortakut ndaj shoqërisë, veprime këto jo në përputhje me dispozitat e ligjit Nr.9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit” i ndryshuar, neni 18.1 si dhe UMF Nr.16, datë 16.2.2009 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe për të luftuar financimin e terrorizmit në sistemin e tatim-taksave”, neni 5, pika 1 dhe 2.

- Në lidhje me transaksionet kur ortakut i jep shoqërisë hua ose e anasjellta, pa aplikuar interesa, grupi i audituesve gjykon se kemi të bëjmë me veprime të cilat janë pa thelb ekonomike dhe jo në përputhje me parimin e vlerës së tregut. Veprime këto në kundërshtim me përcaktimet e pikave b, c, dh të nenit 71, geramat a, b, c, ç të nenit 71/2 dhe germa ç të neni 72 të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave Nr. 24, datë 02.09.2008, i ndryshuar. Referuar kuadrit legjislativ tatimor, rezulton se ortakut dhe shoqëria me përgjegjësi të kufizuara janë entitete të ndryshme dhe me personalitet juridik të ndarë, sipas përcaktimeve në Ligjin Nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”. Sipas legjislacionit tatimor si shoqëria dhe ortakut konsiderohen si “Palë të lidhura”, meqenëse ortakut ka ndikim në vendimmarrjen e shoqërisë për shkak të zotërimit të kuotave/aksioneve të saj sipas përcaktimeve në Ligjin Nr.42/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar dhe Udhëzimin Nr.16, datë 18.6.2014 “Për transferimin e çmimit”, gjë që sjell se çdo marrëdhënie apo transaksion midis tyre duhet t’u përmbahet kushteve dhe parimeve të tregut (Arm’s Length). Megjithëse nuk ka të përcaktuar saktë dhe qartë mënyrën e procedimit në legjislacionin tatimor të fushës së llogaritjes së interesave dhe detyrimeve tatimore të rillogaritura në rastet e huadhënies nga llogaria e ortakut drejt llogarisë së shoqërisë ose e anasjelltas, referuar Kodit Civil i miratuar me Ligjin Nr.7850 datë 29.07.1994, i ndryshuar, nenet 1050-1055, Kreu XIX “Huaja”, cilësohet se huamarrësi duhet t’i paguajë huadhënësit një interes në rastet kur ekziston një marrëveshjeve ndërmjet palëve.

**-Subjekti:** “A. G. O.” SHA

**Nipti:** L.P

**Adresa kryesore:** Njësia Administrative Nr. 5, Rruga “Sulejman Delvina”, Ndërtesa nr. 11, Hyrja 10, Ap. 7/1019.

**Aktiviteti:** “Import dhe eksporti i hidrokarbureve të gjitha llojeve, të karburanteve, naftës, gaz dhe nënprodukteve të tyre me shumicë si dhe përpunimi i naftës bruto dhe nënprodukteve të saj.”

**Inspektori: A.D.**

**Përgjegjës Sektori: A.C.**

**Drejtor Kontrolli: M.R.**

**Drejtor Rajonal: I.A.**

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

- Për **Rimbursimin e TVSH-Periudha tatimore Dhjetor 2020-Maj 2021**

- **Ore pune: 80 orë**

**Në dosjen fizike administrohet dokumentacioni si më poshtë vijon:**

- Njoftim për kontroll tatimor nr. 6331/1 prot., datë 02.07.2022, bashkëngjitur program kontrolli.
- Shkresa DPT-së me nr. 11249/2 prot., datë 28.06.2021, drejtuar DTM, administruar me nr. 6331 prot., datë 29.06.2021, për kontrollin në vend të kërkesës për rimbursim të tatimpaguesit, për TVSH për periudhën Dhjetor 2020-Maj 2021.
- Shkresa nr. 6331/3 prot., datë 03.08.2021, për dërgimin e Projekt Raportit të kontrollit, por nuk administrohet Projekt Raporti në dosje. Në sistemin C@TS është hedhur në datë 03.08.2021, mbajtur në datë 29.07.2021.
- Formulari 1- Raport i vizitës së kontrollit datë 02.07.2021.
- Shkresa nr. 6331/2 prot., datë 03.08.2021, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, për konfirmimin e Importeve.
- Raport kontrolli i mbajtur datë 23.08.2021, protokolluar në DTM me nr. 6331/5 prot., datë 25.08.2022, hedhur në sistemin C@TS në datë 26.08.2021.
- Shkresa nr. 6331/6 prot., datë 25.08.2022, njoftimi vlerësimi për detyrimet tatimore.
- Shkresa nr. 6331/7 prot., datë 25.08.2022, dërgim Raporti Përfundimtar Kontrolli.
- Shkresa nr. 6331/7 prot., datë 25.08.2022, për evadimin e praktikës.
- Procesverbali nr. 1, datë 08.07.2021, për inventarin fizik.

**Nga auditimi ka rezultuar se:**

Subjekti “A. G. O” SHA me Nipt L.P, me kërkesën nr. 01/26 prot., datë 21.06.2021 “Kërkesë për rimbursim të TVSH-së” për periudhën tatimore Dhjetor 2020-Maj 2021, përcjell pranë DTM me shkresën e DPT-së, nr. 11249/2 prot., datë 28.06.2021, administruar në DTM nr.6331 prot., datë 29.06.2021, me lëndë “Dërgohet shkresë për veprim”, ka kërkuar rimbursimin e TVSH për vlerën 86,050,586 lekë.

Shoqëria për periudhën Dhjetor 2020-Maj 2021 ka rezultuar me TVSH kreditore -86,050,586 lekë.

Në gjendjen e TVSH-së kreditore kanë ndikuar vlera e TVSH-së e munguar nga eksportet, vlera e TVSH-së e munguar nga shtesa në parapagim në blerje, vlera e TVSH-së e munguar si rezultat i ndryshimit në rritje të gjendjes së inventarit.

- Projekt Raporti, Raporti dhe procesverbalet mbi kontrollin e kryer janë hedhur me vonesë në C@TS, jo në përputhje me Manualin e Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2.2.

- Raporti nuk ka bashkëngjitur si pjesë përbërëse të tij “Formulari-pyetësor i vetë deklaramit para kontrollit”, jo në përputhje me Manualin e Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2.1 paragrafi 6.

- Formulari nr. 3, nuk është hedhur në sistemin C@TS, nënshkrimi nga Inspektori i Kontrollit, Përgjegjësi i Sektorit të Kontrollit, Drejtori i Kontrollit dhe Drejtori i Drejtorisë Rajonale nuk kanë datë.

- Është bërë kontrolli i importeve dhe janë sqaruar në mënyre analitike diferencat ndërmjet importeve të deklaruara nga shoqëria dhe atyre të deklaruara nga dogana.

- Është bërë verifikimi i blerjeve të tatueshme brenda vendit, eksportet dhe shitjet e tatueshme, sipas raport kontrollit dhe në sistemin C@TS dhe nuk kanë rezultuar mangësi.

- Është bërë analiza e kostos dhe e marzhit të koeficientit të çmimit të shitjes për periudhën Dhjetor 2020-Maj 2021, nga ku rezultojnë se çmimet e shitjes si brenda vendit si dhe në eksport janë më të larta se kosto e prodhimit të tyre, ku marzhi i rritjes së çmimit për njësi është 11.3, ndërkohë marzhi i rritjes së çmimit në % është 32.2 %.
- Është bërë bilanci material nga data 31.11.2020 (*lenë nga kontrolli i fundit*), deri në datën 31.05.2021, ku sipas të dhënave të paraqitura nuk kanë rezultuar diferenca.
- Janë analizuar treguesit e pagesës apo tepricës kreditore të TVSH-së.
- Është kryer zberthimi e analiza e komponentëve të TVSH-së.
- Është përcaktuar prejardhja e tepricës së TVSH-së kreditore në fund të periudhës.

**-Subjekti:** “A.” SHA

**Nipti:** K.V

**Adresa kryesore:** Rr. Themistokli, Vila 3/1, Tiranë

**Aktiviteti:** Shoqëria ka për objekt të saj sigurimet e përgjithshme, si dhe çdo objekt tjetër veprimtarie të lejuar nga legjislacioni në fuqi dhe që nuk vjen në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit Nr.9267, datë 29.07.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe ri sigurimit dhe ndërmjetësimin në sigurime dhe ri sigurime” dhe me rregullat e përcaktuara me akte të veçanta nënligjore.

**Inspektori:** G.J, O.B.

**Përgjegjës Sektori:** A.S.

**Drejtor Kontrolli:** M.R.

**Drejtor Rajonal:** I.A.

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

- Per TVSH 01/2016 -12/2020
- Tatim Fitimi 2015-2019
- Sigurimet Shoqërore, Shëndetësore 01/2016 -12/2020
- Tatime te Tjera 01/2016 -12/2020
- Afati i kontrollit: 280 ore pune

**Në dosjen fizike administrohet dokumentacioni si më poshtë vijon:**

- Njoftim për kontroll tatimor nr. 1594/1 prot., datë 29.03.2021, bashkëngjitur program kontrolli.
- Procesverbali nr. 1, datë 20.05.2021.
- Procesverbali nr. 2, datë 20.05.2021.
- Formulari 1- Raport i vizitës së kontrollit datë 24.05.2021.
- Shkresa nr. 1594/2 prot., datë 14.06.2021, për dërgimin e Projekt Raportit të kontrollit, por nuk administrohet Projekt Raporti në dosje. Në sistemin C@TS është hedhur në datë 04.06.2021, mbajtur në datë 24.05.2021.
- Shkresa nr. 203/2 prot., datë 28.06.2021, observacione nga kompania A., administruar në DTM me nr. 1594/3 prot., datë 30.06.2021.
- Raport kontrolli i mbajtur datë 05.07.2021, protokolluar në DTM me nr. 1594/4 prot, datë 05.07.2021, hedhur në sistemin C@TS në datë 05.07.2021.
- Shkresa nr. 1594/5 prot., datë 05.07.2021, njoftimi vlerësimi për detyrimet tatimore.
- Shkresa nr. 1594/6 prot., datë 05.07.2021, për dërgimin e Raportit Përfundimtar të Kontrollit në subjekt.
- Shkresa nr. 1594/6 prot., datë 05.07.2021, për evadimin e praktikës.

**Nga auditimi ka rezultuar se:**

- Njoftimi i kontrollit është bërë në datë 24.02.2021, ndërkohë që kontrolli në subjekt ka filluar në datë 06.04.2021, duke mos respektuar afatin 30 ditor nga njoftimi i kontrollit, në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 81, pika 1.1.
- Projekt Raporti mbi kontrollin e kryer është hedhur me vonesë në C@TS, jo në përputhje me Manualin e Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2.2.
- Formulari nr. 3, nënshkrimi nga Inspektori, Përgjegjësi i Sektorit të Kontrollit, Drejtori i Kontrollit dhe Drejtori i Drejtorisë Rajonale nuk kanë datë.
- Projekti është përfunduar në subjekt në datë 24.05.2021, ndërkohë Raporti Përfundimtar i Kontrollit është përfunduar në datë 05.07.2021, duke tejkaluar afatet nga përgatitja dhe dërgimi i Projekt Raporti deri në përgatitjen dhe dërgimin e Raportit Përfundimtar të Kontrollit në subjekt, në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit Nr. 9920 “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 83, pika 1 dhe 4, Neni 84, pika 1.
- Nuk është bërë analiza për çmimet e aplikuara nga kompania në krahasim më çmimet e investiguara, jo sipas përcaktimit e pikave të kontrollit “Kontrolli për tatim fitimin”, sipas Programit të Kontrollit të miratuar. Sipas shpjegimeve të inspektorëve të kontrollit analiza e çmimeve nuk është kryer pasi shitjet e policave të sigurimit monitorohen online nga AMF dhe nuk është nevojshme, por nuk është bërë asnjë sqarim në Raport Kontrolli për këtë pikë referuar përcaktimeve ligjore. Nga DTM duhet të merren masa që në të ardhmen të azhurnohen programet e kontrollit, referuar përcaktimeve ligjore, duke mos përfshirë pika për të cilat nuk është e nevojshme realizimi i kontrollit.
- Nga analiza e bilancit material për vitet 2016, 2017 dhe 2018 ka mospërputhje ndërmjet të dhënave të paraqitura në Raport Kontrolli me të dhënat sipas inventarit të lëvizjes së policave, të deklaruara nga subjekti në sistemin C@TS sipas viteve respektive. Për vitet 2019 dhe 2020 nuk administrohen të dhëna të deklaruara në sistemin C@TS për inventarin e lëvizjes së policave të sigurimit. Sqarojmë se mosrakordimet në bilancin material për vitin 2016, bazuar në dokumentacionin shtesë të vënë në dispozicion, kanë ardhur si pasojë e përfshirjes së elementit promocional që nuk ka destinacion shitjen, ndërkohë që në Raport Kontrolli është bërë bilanci material vetëm për lëvizjen e policave pa përfshirë elementët promocional, diferenca e konstatuar përputhet me elementet promociionale të nxjerrë nga magazina e shoqërisë A. gjatë shitjes së policave për vitin 2016, trajtuar hollësisht në observacione, dhe nuk kanë efekte në pasqyrimin e situatës financiare të shoqërisë. E njëjta gjë vlen dhe për vitet pasuese 2017 dhe 2018.
- Nga kontrolli i ushtruar mbi pagesën e taksës kombëtar mbi primin e shkruar, analiza e shitjeve sipas librave të shitjeve dhe FDP të deklaruara për vitet 2017 dhe 2019, si dhe analizës së pasqyrave financiare rezulton se vlera e tatueshme për efekt të llogaritjes së taksës mbi primin e shkruar është e ndryshme nga ajo e paraqitur në Raport Kontrolli, ka mospërputhje të vlerave të primit të shkruar për zërat “Mjete motorike” dhe “Shëndeti në udhëtim”. Këto mospërputhje të analizuar në akt konstatimi, bazuar në sqarimet analitike për çdo zë dhe dokumentacionin shtesë të vënë në dispozicion me observacione, kanë ardhur si pasojë e bashkë sigurimeve dhe faturave që hartojnë kompanitë me njëra-tjetrën për cedimin në bashkë sigurim të primit dhe taksës përkatëse, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 52/2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe ri sigurimit", dhe nuk kanë efekte në pasqyrimin e situatës financiare të shoqërisë.

**-Subjekti:** "F." SHA

**Nipti:** J.N

**Adresa kryesore:** Rr "Nikolla Zoraqi "Ndërtesa 19, Hyrja 1, Njësia Bashkiake nr. 3 , Tiranë

**Aktiviteti:** "Tregtim, import, eksport me shumice dhe pakice, grumbullim, shpërndarje, përpunim medikamente, material, bime, lende te para, artikuj gjysmë te përpunuar, aparatura, pajisje laboratorike farmaceutike, mjekësore. Prodhim, ambalazhim, paketim, medikament....."

**Inspektori:** I.D.

**Përgjegjës Sektori:** E.M.

**Drejtor Kontrolli:** O.C.

**Drejtor Rajonal:** E.C

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

- Për TVSH, për periudhën nga **12/2020-02/2022**
- Për **Tatim Fitimin** për vitet **2020-2021**
- Për **Sigurimet Shoqërore, Shëndetësore dhe TAP** për periudhën **12/2020- 02/2022.**
- **Të tjera 12/2020- 02/2022.**
- **Ore pune: 160 orë pune**

**Kontrolli filloi ne datën 29/06/2022 dhe përfundoi ne datën 25/07/2022.**

**Në dosjen fizike administrohet dokumentacioni si më poshtë vijon:**

- Njoftim për kontroll tatimor nr. 3134/2 prot., datë 27.06.2022, bashkëngjitur program kontrolli.
- Shkresa nr.3134/3 prot., datë 29.07.2022, për dërgimin e Projekt Raportit të Kontrollit.
- Shkresa e Shoqërisë F. SHA me nr. 290/08 prot., datë 12.08.2022, konfirmim marrje Raport Kontrolli, administruar në DTM me nr. 3134/4 prot., datë 12.08.2022.
- Raport kontrolli i mbajtur datë 18.08.2022, protokolluar në DTM me nr. 3134/5 prot., datë 19.08.2022, hedhur në sistemin C@TS në datë 22.08.2022.
- Shkresa nr. 3134/6 prot., datë 19.08.2022, njoftimi vlerësimi për detyrimet tatimore.
- Shkresa nr. 3134/7 prot., datë 19.08.2022, për evadimin e praktikës.
- Procesverbali datë 29.06.2022, inventari fizik.
- Procesverbalet nr. 1, 2, 3, 4, 5, 6 dhe 7 mbi detyrimet e konstatuara.
- Formulari 3- Raport i vizitës së kontrollit.

**Nga auditimi i Raportit Përfundimtar të Kontrollit rezulton se:**

- Formulari 3- nënshkrimi nga Drejtori Drejtorisë dhe Drejtori i Drejtorisë Rajonale nuk ka datë.
- Raporti nuk ka bashkëngjitur si pjesë përbërëse të tij "Formulari-pyetësor i vetë deklaramit para kontrollit", jo në përputhje me Manualin e Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2.1 paragrafi 6.
- Është bërë kontrolli i TVSH për periudhën objekt kontrolli dhe krahasimi ndërmjet treguesve sipas FDP-ve dhe të dhënave të Sistemit Informatik, Librave të Blerje, Shitjeve dhe faturave përkatëse.
- Është bërë evidentimi i blerjeve sipas origjinës, importe, blerje brenda vendit dhe i blerjeve që i shërbejnë shitjeve të përjashtuara.
- Është bërë kontrolli i importeve të shoqërisë dhe janë shpjeguar në mënyrë analitike të gjitha diferencat me doganën.
- Sipas programit të kontrollit është realizuar bilanci material me përzgjedhje, nga ku nuk kanë rezultuar diferenca.
- Është kryer kontrolli për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore për periudhën objekt kontrolli.
- Është kryer kontrolli për tatimin në burim ku bazuar në kontratat noteriale të qerave janë zbatuar kërkesat e çmimeve të referencës dhe për rrjedhojë zbatimi i VKM nr.469, date

03.06.2015 “Për përcaktimin e vlerës minimale të çmimit të referencave të qirave të ndërtesave për qëllime tatimore”.

- Nga kontrolli i zërit *“Kontrolli i blerjeve të investimeve vendase pa TVSH”* për periudhën Dhjetor 2020-Shkurt 2022, në lidhje me punimet e kryera për mirëmbajtje dhe riparime të kryera, me emërtimin rikonstruksion godine, në raport kontrolli cilësohet se shoqëria është pajisur me lejen përkatëse Nr.12176/1, date 28.04.2016, si dhe K-20878/1, datë 17.07.2017 nga Bashkia Tiranë, por nuk është përcaktuar afati i lejes për kryerjen e këtyre punimeve duke qenë se likuidimet e situacioneve vazhdojnë deri në shkurt të vitit 2022, ndërkohë që leja është e vitit 2017. Nga Inspektori i Kontrollit nuk është analizuar në Raport Kontrolli ky fakt dhe mbart risk për mos pasqyrim të saktë të situatës financiare dhe llogaritjen e detyrimeve tatimore.

-Në dosje nuk administrohet dokumentacioni ligjor justifikues për huat e deklaruara nga subjekti për institucionet bankë dhe jo bankë, sipas përcaktimeve të programit të kontrollit. Sipas shpjegimeve të Inspektorëve, këto dokumente nuk janë administruar në dosje për shkak të volumit të madh, por janë vënë në dispozicion të Grupit të Auditimit me observacionet për fazën e Projekt Raportit.

- Nga analiza mbi blerjet e kryera nga kompania dhe zërit shpenzimet në Bilanc për vitin 2021, në zërin *“Shpenzime te tjera”*, janë pasqyruar *“Shpenzimet për shërbime profesionale/Shpenzime konsulence mbi tregun farmaceutik”* në vlerën 13,650,000 lekë, ku në raport citohet se këto shpenzime kanë të bëjnë me prezantimin e produkteve farmaceutike te reja Italiane në treg nga persona fizik të regjistruar me nipt si biznes i vogël, ndërkohë që po në zërin *“Shpenzime te tjera”*, janë pasqyruar si shpenzime marketingu vlera 4,630,735 leke, nga të cilat materiale promocionale në shumën 1,191,448 leke, reklama e marketing për futjen në treg të produkteve të reja farmaceutike në shumën 2,831,909 leke. Nga ana e Inspektorit nuk është bërë analizë e thelluar nëse *“Shpenzime konsulencë mbi tregun farmaceutik”* në vlerën 13,650,000 lekë janë në funksion të aktivitetit ekonomik të kompanisë, duke marrë në konsideratë dhe vlerën e tyre. Sqarojmë se të dhënat e vëna në dispozicion të Grupit të Auditimit janë të pamjaftueshme për të bërë vlerësimet përkatëse dhe mos analizimi i tyre në Raport Kontrolli mbart risk për mos pasqyrim të saktë të situatës financiare dhe llogaritjen e detyrimeve tatimore.

**Gjetja:** **Mosveprim nga Inspektori i Kontrollit në Vend për aplikimin e penaliteteve për mos mbajtjen e saktë të librave, sipas parashikimeve ligjore.**

**Situata:** Në një rast nga auditimi i raport kontrollit tatimor të subjektit “B. & C.” SHPK, nga kontrolli i dokumentacionit si dhe nga verifikimi në sistem rezultuan diferenca midis librave dhe FDP-ve për periudhën Nëntor 2021, në kolonën e Import Investimi me 20% në deklaratën e TVSH-së është 6,299,910 lekë dhe TVSH 1,259,982 ndërsa në librin e deklaruar nga subjekti është deklaruar në kolonën e Import investimi me 6% vlera 1,406,255 lekë dhe TVSH 281,251 lekë si dhe në kolonën e Import Investimi me 20% vlera 4,893,655 lekë dhe TVSH 978,731 lekë. Nga subjekti nuk është bërë ende korrigjimi i librit të periudhës Nëntor 2021, në sistemin C@TS dhe nga DTM duhet të merreshin masa për vendosjen e gjobës 50,000 lekë, pasi mos ndryshimi i librave nga tatim paguesi bie në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Neni-118- Mos mbajtja e saktë e librave, regjistrave dhe dokumentacionit. *“Tatimpaguesi që nuk arrin të mbajë regjistrat dhe dokumentacionin tatimor, të kërkuar sipas këtij ligji, detyrohet të paguajë një gjobë me 10 000 lekë për çdo shkelje, në rastet kur është person fizik që ushtron veprimtari ekonomike tregtare apo si i vetëpunësuar dhe 50*



	<i>000 lekë kur është person juridik”.</i>
<b>Kriteri:</b>	-Ligji Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 118, 128/3; -UMF Nr.24 datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pika 118, 128/3; -Rregulloren e Funksionimit të Administratës Tatimore dalë me Urdhrin nr.19, datë 22.02.2017; -Rregulloren e funksionimit të administratës Tatimore dalë me Urdhrin nr. 192, datë 12.08.2020; -Manuali i Kontrollit Tatimor.
<b>Impakti:</b>	Nga ana e Inspektorit të Kontrollit në Vend, nuk është kryer penalizimi i subjektit për mos mbajtja të saktë të librave, regjistrave dhe dokumentacionit, sipas nenit 118 të Ligji Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
<b>Shkaku:</b>	Mosrespektimi i dispozitave dhe përcaktimeve ligjore lidhur me punën e Sektorit të Kontrollit në Vend.
<b>Rëndësia:</b>	E mesme
<b>Rekomandimi:</b>	Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj, të kryejë të gjitha veprimet e duhura ligjore dhe administrative, me qëllim arkëtimin e detyrimeve tatimore të ri llogarituara për subjektin “B. & C.” SHPK me Nipt- K.T, në shumën 50,000 lekë.
<b>Gjetja:</b>	<b>Mosrespektim i pikave të programit të kontrollit të miratuar si dhe mungesa e të dhënave të mjaftueshme për të rakorduar për sasinë e prodhuar, në kundërshtim me përcaktimet e Manualit të Kontrollit Tatimor.</b>
<b>Situata:</b>	Në një rast nga auditimi i raport kontrollit tatimor të subjektit “R.B.H B.” SHA, janë konstatuar mangësi pasi bilanci material i lëvizjes në prodhim është bërë për periudhën 01.06.2021-31.12.2021, bilanci material për lëndën e parë është bërë për periudhën 01.06.2021-31.12.2021, bilanci material për produktin e gatshëm është bërë për periudhën 01.06.2021-01.06.2021, ndërkohë që kërkesa për rimbursimin e TVSH sipas njoftimit për kontroll dhe programit të kontrollit është për periudhën Prill-Tetor 2021. Sa sipër rezulton se janë 2 muaj Nëntor-Dhjetor 2021 për të cilat është bërë kontrolli i bilancit material por që nuk është përcaktuar në program kontrolli, në kundërshtim me përcaktimet e Manualit të Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2.1, germa a, ku citohet “Njoftimi i kontrollit tatimor përmban periudhën ose periudhat tatimore, për të cilat kryhet kontrolli tatimor”.
	Gjithashtu nga analiza e bilancit material të paraqitur në Raport Kontrolli dhe kartës teknologjike të miratuar për shoqërinë, nuk administrohen të dhëna të mjaftueshme, për të rakorduar për sasinë e prodhuar për zërin 3- “Gjysëm e produkte Elbasan Magazina 1” në sasinë 8,166,523 kg, zërin 5- “Gjysëm Produkte (Hollues)” në sasinë 1,077,840 kg, pasi nuk ka të dhëna specifike për sasinë e lëndës së parë të përdorur për këto dy zëra, si dhe humbjet nga prodhimi.
<b>Kriteri:</b>	- Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 81 dhe 83. - Manualit të Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2.1, germa a.
<b>Impakti:</b>	Realizimi i kontrollit në kundërshtim me përcaktimet e programit të kontrollit
<b>Shkaku:</b>	Mosrespektim i përcaktimeve të Manualit të Kontrollit Tatimor për realizimin e programit të kontrollit në subjekt.

<b>Rëndësia:</b>	E lartë
<b>Rekomandimi:</b>	Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, nëpërmjet Sektorit të Cilësisë dhe Standardizimit të Procedurave dhe Drejtorisë Ligjore dhe Teknike, të marrin të gjitha veprimet e nevojshme administrative, me qëllim hartimin e një qarkoreje dhe metodologjie të mirë përcaktuar, për standardizimin e procedurave të kontroleve tatimore të rimbursimit të TVSH-së për kontrollin e tatimpaguesve me aktivitetet përpunimin dhe tregtimi i naftës dhe nënprodukteve të saj, duke përcaktuar qartësisht periudhat për kontrollin e bilancit material.
<b>Gjetja:</b>	<b>Parregullsi të konstatuara nga auditimi i raportit të kontrollit të subjektit “F.” SHA, në lidhje me kontrollin e investimeve vendase pa TVSH, mungesa e analizës së thelluar për njohjen e shpenzimeve që i shërbejnë aktivitetit.</b>
<b>Situata:</b>	Në një rast nga auditimi i raportit të kontrollit tatimor të subjektit “F.” SHA, me NIPT-J.N, janë konstatuar mangësi si më poshtë: - Nga kontrolli i zërit “Kontrolli i blerjeve të investimeve vendase pa TVSH” për periudhën Dhjetor 2020-Shkurt 2022, në lidhje me punimet e kryera për mirëmbajtje dhe riparime të kryera, me emërtimin rikonstruksion godine, në raportin e kontrollit cilësohet se shoqëria është pajisur me lejen përkatëse Nr.12176/1, date 28.04.2016, si dhe K-20878/1, datë 17.07.2017 nga Bashkia Tiranë, por nuk është përcaktuar afati i lejes për kryerjen e këtyre punimeve duke qenë se likuidimet e situacioneve vazhdojnë deri në shkurt të vitit 2022, ndërkohë që leja është e vitit 2017. - Nga analiza mbi blerjet e kryera nga kompania dhe zërit shpenzimet në Bilanc për vitin 2021, në zërin “Shpenzime të tjera”, janë pasqyruar “Shpenzimet për shërbime profesionale/Shpenzime konsulence mbi tregun farmaceutik” në vlerën 13,650,000 lekë, ku në raport citohet se këto shpenzime kanë të bëjnë me prezantimin e produkteve farmaceutike të reja Italiane në treg nga persona fizik të regjistruar me nipt si biznes i vogël, ndërkohë që po në zërin “Shpenzime të tjera”, janë pasqyruar si shpenzime marketingu vlera 4,630,735 leke, nga të cilat materialet promovionale në shumën 1,191,448 leke, reklama e marketing për futjen në treg të produkteve të reja farmaceutike në shumën 2,831,909 leke. Nga ana e Inspektorit nuk është bërë analizë e thelluar nëse “Shpenzime konsulence mbi tregun farmaceutik” në vlerën 13,650,000 lekë janë në funksion të aktivitetit ekonomik të kompanisë, duke marrë në konsideratë dhe vlerën e tyre.
<b>Kriteri:</b>	- Ligji nr.9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Neni 80, 81 dhe 115. - Manualit të Kontrollit Tatimor, Kapitulli VIII, pika 8.
<b>Impakti:</b>	Nga ana e inspektorëve të Sektorit të Kontrollit në Vend, nuk është kryer analizë e thelluar për mangësitë e konstatuara çka mund të përbëjë risk për vlerësim të gabuar të të dhënave dhe situatës financiare të subjektit.
<b>Shkaku:</b>	Mosrespektimi i dispozitave dhe përcaktimeve ligjore lidhur me punën e inspektorëve të Sektorit të Kontrollit në Vend.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë
<b>Rekomandimi:</b>	Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj për tatimpaguesin “F.” SHA, për të cilët janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në analizimin e të dhënave të paraqitura në Raportin e Kontrollit, të kryerje një analizë të thelluar nga zyra ose të propozojë kryerjen vizitave fiskale, për vlerësimin e situatës financiare.

<b>Gjetja:</b>	Parregullsi të konstatuara nga auditimi i raporteve të kontrollit, të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor në Vend, DTM, në lidhje me mos llogaritjen e interesave për transaksionet e huamarrjes dhe huadhënies së shoqërive me ortakët.
<b>Situata:</b>	Në një rast nga auditimi i raport kontrollit tatimor të subjektit “A.” SHA, janë konstatuar mangësi pasi nga verifikimi i pasqyrave financiare të viteve 2020, rezulton se subjekti në pasiv të bilancit (Detyrime Afatshkurtra), zëri “Debitore dhe kreditore të tjerë” është pasqyruar në shumën 527,683,598 lekë. Sipas raportit të kryer nga ana e inspektorit citohet se...“në bilancin e vitit 2020 zëri “debitor e kreditor të tjerë” paraqitet në shumën 527,683,598 lekë dhe kjo shumë përfaqëson detyrimet që ka shoqëria gjendje me 31.12.2020 ndaj ortakut dhe shoqërive me të njëjtin ortak G., A.. Kjo llogari ka ardhur në rënie, saktësisht në vlerën (8,207,057) lekë. Nuk ka asnjë informacion nëse ka kontratat të lidhura midis palëve, afatet e huadhënies, mënyra e kryerjes se transaksioneve (me Banke apo Cash), etj, nga ana e inspektorit nuk është kryer një analizë dhe nuk është dhënë asnjë shpjegim në lidhje me krijimin e këtyre të ardhurave, të cilat i janë dhënë hua shoqërisë. Në lidhje me transaksionet kur ortakut i jep shoqërisë hua ose e anasjellta, pa aplikuar interesa, grupi i audituesve gjykon se kemi të bëjmë me veprime të cilat janë pa thelb ekonomike dhe jo në përputhje me parimin e vlerës së tregut. Veprime këto në kundërshtim me përcaktimet e pikave b, c, dh të nenit 71, gjerat a, b, c, ç të nenit 71/2 dhe germa ç të neni 72 të Ligjit Nr.9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave Nr. 24, datë 02.09.2008, i ndryshuar. Referuar kuadrit legjislativ tatimor, rezulton se ortakut dhe shoqëria me përgjegjësi të kufizuara janë entitete të ndryshme dhe me personalitet juridik të ndarë, sipas përcaktimeve në Ligjin Nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”. Sipas legjislacionit tatimor si shoqëria dhe ortakut konsiderohen si “Palë të lidhura”, meqenëse ortakut ka ndikim në vendimmarrjen e shoqërisë për shkak të zotërimit të kuotave/aksioneve të saj sipas përcaktimeve në Ligjin Nr.42/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar dhe Udhëzimin Nr.16, datë 18.6.2014 “Për transferimin e çmimit”, gjë që sjell se çdo marrëdhënie apo transaksion midis tyre duhet t’u përmbahet kushteve dhe parimeve të tregut (Arm’s Length). Megjithatë nuk ka të përcaktuar saktë dhe qartë mënyrën e procedimit në legjislacionin tatimor të fushës së llogaritjes së interesave dhe detyrimeve tatimore të ri llogaritura në rastet e huadhënies nga llogaria e ortakut drejt llogarisë së shoqërisë ose e anasjelltas, referuar Kodit Civil i miratuar me Ligjin Nr.7850 datë 29.07.1994, i ndryshuar, nenet 1050-1055, Kreu XIX “Huaja”, cilësohet se huamarrësi duhet t’i paguajë huadhënësit një interes në rastet kur ekziston një marrëveshjeve ndërmjet palëve.
<b>Kriteri:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ligji Nr.7850 datë 29.07.1994 “Kodi civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 1050-1055, Kreu XIX “Huaja”;</li> <li>- Ligji Nr.42/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar;</li> <li>- Udhëzimi Nr.16 datë 18.6.2014 “Për transferimin e çmimit”.</li> </ul>
<b>Impakti:</b>	Nga ana e inspektorit të kontrollit në vend, nuk janë kryer verifikimet e subjektit sipas legjislacionit për verifikimin e transaksioneve të huadhënies dhe huamarrjes së shoqërive me ortakët.
<b>Shkaku:</b>	Mosrespektimi i dispozitave dhe përcaktimeve ligjore lidhur me punën e inspektorëve të Sektorit të Kontrollit në vend.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë

- Rekomandimi:** -DTM në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, të hartojnë një metodologji të qartë dhe të saktë nënligjore, ose një manual udhëzues për analizimin e llogarisë së ortakut, kur konstatohen se jepen hua ose shuma nga llogaria e ortakut në favor të llogarisë së shoqërisë, ku ata janë ortakë ose anasjelltas, për raste kur këto hua jepen pa interes, nisur edhe nga përcaktimet ligjore që parashikon Kodi Civil.
- Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj në bashkëpunim me DPT, të analizojë situatën e kontrollit të kryer, referuar gjetjeve nga auditimi i KLSH-së, si dhe të vlerësojë përcjelljen e tyre pranë strukturës kompetente pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, për vlerësimin dhe identifikimin e mëtejshëm të burimeve të financimit.
- Gjetja:** Parregullsi të konstatuara nga auditimi i raportit të kontrollit të subjektit “A.” SHA, në lidhje me mungesën e analizës dhe sqarimeve analitike për mosrakordimet e rezultuara për bashkësigurimet dhe mungesën e analizës së thelluar të zërit shpenzimet në bilanc, për zërin “Servis Deme”.
- Situata:** Nga auditimi i raportit të kontrollit tatimor të subjektit “A.” SHA, janë konstatuar mangësi si më poshtë:
- Nga kontrolli i ushtruar nuk është bërë analizë e thelluar dhe sqarime analitike për mosrakordimet e rezultuara ndërmjet shitjeve të deklaruara për produktet “mjete motorike” dhe “pasuri” dhe vlerave të primit shkruar bruto të llogaritur për këto produkte, se çfarë përfaqësojnë këto diferenca, klasifikimin e tyre, nëse janë për bashkësigurimet, primet e vetë shoqërisë, risigurimet, etj, duke e bërë të paqartë llogaritjen e taksës mbi primin e shkruar. Sipas shpjegimeve të dhëna nga Inspektori i Kontrollit në observacione, mosrakordimet ndërmjet shitjeve të deklaruara dhe vlerave të primit të shkruar për vitin 2020, kanë ardhur për shkak të primeve të vetë shoqërisë të sqaruara në mënyrë analitike për secilin zë, për cdo vit, por këto diferenca nuk përputhen me ato të nxjerra nga Grupi i Auditimit.
  - Nga analiza mbi blerjet e kryera nga kompania dhe zërit shpenzimet në Bilanc, për zërin “Servis Deme” në vlerën 205,006,791 lekë për periudhën Nëntor 2019-Tetor 2021, nga ana e Inspektorit nuk është bërë analizë e thelluar nëse këto shpenzime janë në funksion të aktivitetit ekonomik të kompanisë, në raport kontroll nuk ka të dhëna në lidhje me kontrollin për dosjet e dëmeve, procedurën e ndjekur, vlerën e miratuar, dokumentacion e administruar në dosje, kampionin e përzgjedhjes së dosjeve për kontroll. Veprimet më sipër bien në kundërshtim me pikat e miratuara të Programit të Kontrollit si dhe përcaktimet e Manualit të Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2.1, Kapitulli VIII, pika 8.
- Kriteri:** - Ligji nr.9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Neni 80, 81 dhe 115.
- Manualit të Kontrollit Tatimor, Kapitulli VIII, pika 8.
- Impakti:** Nga ana e inspektorëve të Sektorit të Kontrollit në Vend, nuk është kryer analizë e thelluar për mangësitë e konstatuara çka mund të përbëjë risk për vlerësim të gabuar të të dhënave dhe situatës financiare të subjektit.
- Shkaku:** Mosrespektimi i dispozitave dhe përcaktimeve ligjore lidhur me punën e inspektorëve të Sektorit të Kontrollit në Terren.
- Rëndësia:** E lartë
- Rekomandimi:** Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj për tatimpaguesin “A.” SHA, për të cilët janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në analizimin e të dhënave të paraqitura në Raport Kontrolli, të kryerje një analizë të thelluar nga zyra ose të

propozojë kryerjen vizitave fiskale, për vlerësimin e situatës financiare.

**Gjetja:** Parregullsi të konstatuara nga auditimi i raportit të kontrollit të subjektit “A.” SHA, pasqyrimi i pasaktë i gjendjes në inventar, mosrakordime në bilancin material, të gjendjes fizike me gjendjen kontabël dhe paqartësi në klasifikimin e parapagimeve.

**Situata:** Në një rast nga auditimi i raportit të kontrollit tatimor të subjektit “A.” SHA, janë konstatuar mangësi pasi:

- Nga analiza e TVSH për periudhën 01.07.2020-31.12.2020, nga krahasimi i shitjeve në FDP rezulton vlera e tatueshme 139,981,013 lekë dhe shitjeve të paraqitura sipas librit të shitjeve rezulton vlera 151,518,859 leke, pra kemi një diferencë prej 11,537,846 leke, e cila nga Inspektori është konsideruar si paradhënie ndaj klientëve, shoqëruar me fatura tatimore dhe të deklaruara si nga shitësi dhe nga blerësi. Ndërkohë nga të dhënat e marra nga shitjet me kasë për gazoil dhe benzine për adresat si dhe FDP e deklaruara, të pasqyruara në Raportin e Kontrollit, rezulton se vlera 11,537,846 lekë është deklaruar si shitje me kasë në Porto Romano. Kjo diferencë konstatohet dhe nga analiza e bilancit material, ku subjekti për vlerën e parapagimit ka bërë zbritje gjendjen e inventarit, çka tregon se kjo sasi karburanti është shitur dhe malli nuk është më gjendje në inventar, e për pasojë kjo vlerë nuk mundet të klasifikohet si parapagim. Gjithashtu nga të dhënat e pasqyruara në bilanc kjo vlerë nuk është llogaritur si paradhënie. Nga shpjegimet e dhëna Grupit të Auditimit nga Inspektori i Kontrollit, nga argumentet e trajtuara më sipër si dhe mënyrës se si funksionon sektori hidrokarburave, mbetet e paqartë klasifikimi i kësaj vlere si parapagim dhe mbart risk për mospasqyrim të saktë të situatës financiare dhe llogaritjen e detyrimeve tatimore.

- Nga analiza e kostos së mallrave konstatohet mos pasqyrim i saktë i gjendjes në inventar, pasi produkti naftë është paraqitur me kosto ndërsa produkti benzinë me çmim shitje. Diferenca e vlerës 438,336 lekë, midis kostos dhe çmimit të shitjes, reflektohet në gjendjen e inventarit të deklaruar nga shoqëria.

- Nga analiza e bilancit material për periudhën 01.07.2020-31.12.2021 janë konstatuar mosrakordime ndërmjet gjendjes fizike dhe gjendjes kontabël, përkatësisht për periudhën 01.07.2020-31.12.2020, për produktin Diesel 178,001 litra dhe produktin Benzine 5306 litra, për periudhën 01.01.2021-31.12.2021, për produktin Diesel 20,403 litra dhe produktin Benzine 25,750 litra. Nga shpjegimet e dhëna Grupit të Auditimit nga Inspektori i Kontrollit, nga analiza e të dhënave të pasqyruara në Raportin e Kontrollit, si dhe mënyrës se si funksionon sektori hidrokarburave, mbeten të paqarta mosrakordimet në bilancin material për periudhën 01.07.2020-31.12.2021, duke mbartur risk për mos pasqyrim të saktë të situatës financiare dhe llogaritjen e detyrimeve tatimore me efekt mungesën e të ardhurave për buxhetin e shtetit.

**Kriteri:** - Ligji Nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 60, neni 71, neni 71/1, neni 115;

- UMF Nr.24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; pika 60, pika 71, pika 71.1, pika 115;

- Rregullore e Funksionimit të Drejtorive Rajonale Tatimore dalë me Urdhrin Nr.192, datë 12.08.2020. të Ministrit të Financave;

- Rregullore e Funksionimit të Administratës Tatimore dalë me Urdhrin Nr.19 (Nr.1482/2., prot) datë 22.02.2017, të Ministrit të Financave;

- Manual i Kontrollit nga Zyra.

**Impakti:** Parregullsi të konstatuara nga auditimi i raportit të kontrollit duke mbartur risk

për mospasqyrim të saktë të situatës financiare dhe llogaritjen e detyrimeve tatimore.

**Shkaku:** Mosrespektimi i dispozitave dhe përcaktimeve ligjore lidhur me punën e inspektorëve të Sektorit të Kontrollit në Terren.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandimi:** Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj, për tatimpaguesit “A.” SHA, për të cilin janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në analizimin e të dhënave të paraqitura në Raport Kontrollit, të marrë masat e duhura administrative konform legjislacionit tatimor, të kryerje një analizë të thelluar nga zyra të situatës financiare të tatimpaguesit duke bërë vlerësimet dhe rivlerësimet përkatëse ose të propozojë kryerjen e kontroleve të thelluara në vend/vizitave fiskale, në rastin e vlerësimit me risk të lartë të mos pasqyrimin të saktë të situatës financiare dhe mos llogaritjen e detyrimeve tatimore me efekt mungesën e të ardhurave për buxhetin e shtetit.

Në lidhje me pikën 2.2 të Projekt Raportit, janë paraqitur observacione me shkresën nr. 52/28 prot., datë 11.09.2023, administruar në KLSH me nr. 14/11 prot., datë 12.09.2023, nga z.A.DH. me detyrë Inspektor, i cili ka bërë **komente dhe shpjegime**, konkretisht:

*Në lidhje me konstatimin për subjektin B. SHPK, sqaron se gjoha sipas parashikimeve të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Neni-118, aplikohet kur gabimet janë jo materiale dhe jo të sakta, si dhe kur nuk janë përsëritur, ndërkohë në rastin konkret kemi të bëjmë vetëm me një rast të mosdeklarimit të saktë.*

**Qëndrimi i Grupit të Auditimit:** *Në lidhje me pretendimet e ngritura, sqarojmë se ato janë të përsëritura me ato të paraqitura për akt-konstatimet dhe nuk janë paraqitur argumente apo dokumente shtesë, për pasojë observacioni juaj nuk merret në konsideratë.*

Në lidhje me pikën 2.2 të Projekt Raportit, janë paraqitur observacione me shkresën nr. 52/28 prot., datë 11.09.2023, administruar në KLSH me nr. 14/11 prot., datë 12.09.2023, nga z. M.H. dhe z. S.M, me detyrë Inspektor Sektori i Kontrollit në Vend, të cilët kanë bërë **komente dhe shpjegime** dhe konkretisht:

*Për konstatimet për subjektin A. SHA , sqarojnë se:*

*1) Në akt konstatim shpreheni se kontrolli është kryer duke tejkuluar afatet e parashikuar në programin e kontrollit.*

*-Në lidhje me sa pretendohet nga ana Juaj ju bëjmë me dije se për periudhën që është kryer kontrolli në shoqërinë “A.” SHA me NIPT L.M, kontrolli në shoqëri u ndërpre pasi gjatë kësaj periudhe nga inspektori M.H është kryer kontrole të thelluara në shoqërinë B.K.T me NIPT J.Q, me Njoftimit Kontrollit Tatimor dhe programit kontrollit me Nr. Prot 6084/1, datë 03/09/2021 me 680 orë/pune, i cili është filluar 08.0.2021 dhe mbyllur me datë 30.06.2022.*

*Kontrolli në shoqëri u ndërpre pasi gjatë kësaj periudhe nga inspektori S.M janë kryer vizita fiskale dhe kontrole të thelluara, në shoqëritë I. SHPK me NIPT J.F për verifikimin e kryer në vend në zbatim të urdhrin të punës nr. 2161 prot, datë 18.03.2022, T. SHPK, me NIPT K.E, për verifikimin e kryer në vend të zbatimit të urdhrin të punës nr. 2484 prot, datë 29.03.2022, “E.” SHPK, sipas Njoftimit të Kontrollit Tatimor dhe programit kontrollit me Nr. 10937/2 prot, datë 31.01.2022, me 316 orë pune, i cili është filluar me 08.02.2022 dhe mbyllur me datë 11.04.2022.*

*Njoftimi kontrolli është bërë me datë 27.01.2022 paraqitur në subjekt dhe filluar kontrollin në 07.02.2022 dhe përfunduar me datë 30.05.2022, pra janë konsumuar 600 orë pune, që pasi heqim lejen e zhvilluar nga data 01.03.2022 deri në datë 14.03.2022, që i takojnë 80 orë pune, heqim orët e konsumuara tek “E.” SHPK, që janë 316 orë pune sipas programit të kontrollit rezulton që kontrolli është kryer për 284 orë pune, brenda afateve ligjore. Bashkëlidhur Urdhrat e punës dhe lejet vjetore të kryera.*

*Pika 2 : Në akt konstatim shpreheni se janë tejkuluar afatet nga përgatitja dhe dërgimi i Projekt Raportit deri në përgatitjen e Raportit përfundimtar të kontrollit në subjekt.*

Bazuar ne ligjin Nr.9920 date 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë “neni 83, pika 4 keni të drejtë të kundërshtoni rezultatet e këtij kontrolli tatimor brenda 15 ditëve kalendarike mbas datës që vlerësohet të jetë marrë nga ana e shoqërisë, 10 dite i ka posta në dispozicion për ta dërguar në shoqëri dhe 10 ditë për të sjellë kundërshtime në qoftë se ka, që në total bëjnë 35 ditë. Projekt-Raporti është dërguar me postë rekomande më datë 06.07.2022 me nr prot 10949/3 dhe Raportit përfundimtar të kontrollit është mbajtur më datë 10.08.2022 që përbën 35 ditë nga momenti dërgimit të Projekt Raportit të kontrollit. Nga sa sqaruam më sipër nuk kemi tejkalim të afateve.

Pika 3. Në akt konstatim shpreheni se duhet të bëjë analizë të behej bërë analiza e çmimeve dhe bilanci material.

-Në lidhje me sa pretendohet nga ana juaj ju sqarojmë se bilancin material nuk bërë për arsyeje se primet e sigurimit janë online dhe menaxhohen nga AMF dhe nuk ka diçka fizike dhe rakordimi bëhet cdo vit nga AMF-ja se sa prime janë lëshuar. Prandaj nuk bërë inventari fizik dhe bilanci material. Analiza e çmimeve nuk është bërë pasi primet e sigurimit janë me çmime të përcaktuara nga AMF-ja për të cilin shoqëria paguan dhe taksën.

Pika 4. Në akt konstatim shpreheni se nuk janë bërë sqarime analitike për vlerën e primit të shkruar bruto sipas produkteve, dhe për diferencat ndërmjet shitjeve të deklaruar për produkt dhe vlerave të primit shkruar bruto te llogaritura për këto produkte.

Në lidhje me sa pretendohet nga ana juaj ju sqarojmë si më poshtë:

Shoqëritë e Sigurimit në baze të Ligjit nr. 9975 date 28/07/2008, Për Taksat Kombëtare , të ndryshuar , me Ligjin 127/2016 datë 15/12/2016 neni 5 pika g), në fund të fjalisë shtohen fjalët: “Për qëllime të mbledhjes së taksës, këto shoqëri e evidentojnë atë veçmas nga primi.”.

Gjithashtu jemi njoftuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve me Shkresën nr . Prot 7260 datë 29/06/2017 , Lënda; Njoftim mbi ndryshimin e deklaratës së taksës kombëtare dhe deklarin e taksës së primit të shkruar. Duke iu referuar ndryshimeve në Udhëzimin nr. 12 datë 04.04.2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin Nr. 26 datë 04/09/2008 “Për Taksat Kombëtare” të ndryshuara, si dhe ndryshimeve në formën e deklaratës se taksave kombëtare, Taksa mbi primet e shkruara me përjashtim të primeve të sigurimit për produktet e jetës, shëndetit në udhëtim dhe kartonit jeshil, nuk duhet të deklarohet në formularin e tarifave kombëtare , por duhet të deklarohet në rubrikat respektive nr. 77 dhe 78 me emërtimin “Taksë e primit të shkruar” të “Formularit të deklarimit dhe pagesës së Taksave Kombëtare”

Si rrjedhojë Të ardhurat nga primet e shkruara në Pasqyrën e Performancës janë Neto (pa taksën 10%). Taksa 10% mbi primin në kontabilitet paraqitet si detyrim dhe jo si shpenzim, pra nuk ndikon në Pasqyrën e Performancës. Të ardhurat nga shitja në Librin e Shitjes janë deklaruar në Total , duke qenë se nuk ka një kolonë në Librat e Shitjes për Taksën Kombëtare 10 % të Primit, për ta evidentuar atë me vete.

Gjithashtu shoqëritë e sigurimit kanë pjesë të aktivitetit të tyre dhe shitjet me bashkësigurim, ku marrin pjesë më shumë se një kompani. Në rastin kur kompania A. SHA , është në pozicionin e Liderit, faturën e shitjes për vlerën e plotë të bashkësigurimit e lëshon Ansig për Subjektin përkatës. Ndërkohë kompanitë bashkësiguruese lëshojnë faturë blerje për A. për pjesën e primit për të cilin ato hyjnë në bashkësigurim. E ardhura neto e shoqërisë , që paraqitet në kontabilitet dhe PASH, është diferenca e këtyre faturave. Pra faturat që lëshojnë shoqëritë e tjera që hyjnë në bashkësigurim, janë fatura blerje për shoqërinë dhe deklarohen në Librat e Blerjes. Ndërkohë në kontabilitet siç e përmenda dhe më lart netojnë primin që shoqërisë i takon.

Më poshtë është pasqyruar në mënyrë të përmbledhur Taksa Kombëtare dhe Primet për periudhën e inspektuar, si më poshtë:

<b>Taksa Kombetare Nentor-Dhjetor 2019</b>	
<b>Viti 2019</b>	<b>Taksa Kombetare</b>
Nentor	8,548,255
Dhjetor	11,778,414
<b>Total</b>	<b>20,326,669</b>

**Prime Nentor-Dhjetor 2019**

<b>Lloji i Produktit</b>	<b>Prime Bruto te shkruara 2019</b>	<b>Taksa 10%</b>
Prime Aksidente personale	863,634.19	86,363.45
Prime Garanci Kontrate	4,755,254.77	475,525.48
Prime Garanci Oferte	49,052.77	4,905.25
Prime Mallra ne Transport	137,697.15	13,769.72
Prime Pergjegjesi Produkti	2,240,602.56	224,060.20
Shendeti ne Udhetim	609,436.56	
Prime sigurim prone efekt kredie	1,939,217.18	193,921.72
Prime Sigurimi Kasko	18,457,516.75	1,845,751.68
Prime Sigurimi i pergjegjesise se pasagjereve	68,978.75	6,897.88
Prime sigurimi CIS & CIT	134,903.93	13,490.39
Prime Karton Jeshil	18,887,321.70	
Prime sigurimi Kufitare	4,363,741.95	436,374.17
Prime sugrimi TPL	153,211,079.95	15,321,108.00
Prime Vjedhje	492,760.00	49,276.00
Zjarri dhe Rreziqe Shtese	16,693,688.80	1,669,368.88
<b>Totali</b>	<b>222,904,886.25</b>	<b>20,340,812.80</b>

*Diferenca që rezulton janë prime të vete shoqërisë*

<b>Viti 2020</b>	<b>Taksa Kombetare</b>
Janar	7,766,507
Shkurt	7,822,649
Mars	4,265,779
Prill	5,332,910
Maj	8,884,422
Qershor	10,002,210
Korrik	10,507,720
Gusht	8,672,200
Shtator	7,752,362
Tetor	10,457,765
Nentor	8,430,656
Dhjetor	10,496,774
<b>Total</b>	<b>100,391,954</b>

<b>Produkti</b>	<b>Prime Viti 2020</b>	<b>Taksa 10%</b>
Prime Aksidente personale	1,573,961.33	157,396.13
Prime CAR	41,4520.80	41,452.08
Prime Garanci Kontrate	15,307,555.91	1,530,755.59
Prime Garanci Oferte	695,611.93	69,561.19
Prime Mallra ne Transport	663,144.62	66,314.46
Prime nga sigurimi skafeve	168,186.00	16,818.60
Prime pergjegjesi Civile	435,454.56	43,545.46
Prime Pergjegjesi Produkti	15,700,611.43	1,570,061.14
Prime policia nxenes student	6,273.00	627.30
Shendeti ne Udhetim	1,266,219.50	-
Prime sigurim prone efekt kredie	6,959,972.52	695,997.25
Prime Sigurimi Kasko	104,324,534.02	10,432,453.40
Prime Sigurimi i pergjegjesise se pasagjereve	454,620.35	45,462.03
Prime sigurimi CIS & CIT	1,829,867.83	182,986.78
Prime Karton Jeshil	68,169,356.44	-
Prime sigurimi Kufitare	24,060,542.88	2,406,054.29
Prime sugrimi TPL	801,214,308.61	80,121,430.86
Prime Vjedhje	2,012,636.90	201,263.69
Zjarri dhe Rreziqe Shtese	28,505,069.21	2,850,506.92
<b>Totali</b>	<b>1,073,762,447.85</b>	<b>100,432,687.19</b>

*Diferenca që rezulton janë prime të vete shoqërisë*

*Taksa Kombëtare Janar-Tetor 2021*



Janar – Tetor 2021	Tarifa 10%
Janar	8,318,050
Shkurt	7,452,993
Mars	6,703,706
Prill	6,104,603
Maj	8,347,723
Qershor	9,545,253
Korrik	11,080,348
Gusht	9,444,358
Shtator	8,538,918
1 Tetor	8,515,551
<b>Total</b>	<b>84,051,503</b>

Produkti	Prim e Janar-Tetor 2021	Taksa 10%
Prim e Aksidente personale	1,201,247.27	120,124.73
Prim e CAR	171,280.00	17,128.00
Prim e Garanci Kontrate	14,172,448.78	1,417,244.88
Prim e Garanci Oferte	1,061,018.09	106,101.81
Prim e Mallra ne Transport	328,673.81	32,867.38
Prim e nga sigurimi skafeve	215,915.50	21,591.55
Prim e Pergjegjesi Produkti	9,816,854.38	981,685.44
Prim e policia nxenes student	908.90	90.89
Shendetit ne Udhetim	1,223,571.20	-
Prim e sigurim prone efekt kredie	5,161,828.91	516,182.89
Prim e Sigurimi Kasko	82,780,834.58	8,278,083.46
Prim e Sigurimi i pergjegjesise se pasagjereve	272,086.82	27,208.68
Prim e sigurimi CIS & CIT	1,849,207.01	184,920.70
Prim e Karton Jeshil	75,786,566.60	-
Prim e sigurimi Kufitare	30,085,888.80	3,008,588.88
Prim e sigurimi TPL	667,099,472.08	66,709,947.21
Prim e Vjedhje	151,213.30	15,121.33
Zjarri dhe Rreziqe Shtese	36,707,481.45	3,670,748.14
<b>Totali</b>	<b>928,086,497.48</b>	<b>85,107,635.97</b>

*Diferenca qe rezulton janë prime te vete shoqërisë*

*Pika 5. Në akt konstatim shpreheni se nuk është bërë analiza e thelluar për shpenzimet konsulencë financiare dhe servise dëmi.*

*-Në lidhje me sa pretendohet nga ana juaj ju sqarojmë se analiza e blerjeve nga ana e kontrollit është bërë e thelluar por në raport janë paraqitur të përmbledhura, më poshtë po jua paraqesim dhe analitikiisht sipas periudhave të kontrollit*

*-Shpenzimet për servise dëmi*

*Nga ana e kontrollit është kontrolli i shpenzimeve për servise dëmi të cilat I kanë shërbyer aktivitetit të shoqërisë, metoda e përdorur për kontrollin e këtyre dosjeve ka qenë me përzgjedhje sipas dosjeve me vlerën më të lartë por duke qenë se janë voluminoze nuk janë paraqitura në raport të kontrollit.*

**Qëndrimi i Grupit të Auditimit:** Në lidhje me pretendimet e paraqitura, për respektimin e procedurave dhe afateve gjatë ushtrimit të kontrollit në subjekt, si respektimin e afateve për hartimin dhe dërgimin e

Projekt Raportit dhe Raportit final, nuk janë paraqitur argumente apo dokumenta të reja nga ato të trajtuara gjatë auditimit, për pasojë observacioni juaj nuk merret në konsideratë.

-Në lidhje me pretendimin tuaj se analiza e çmimeve dhe realizimi i bilancit material nuk është i nevojshëm pasi primet e sigurimit janë online dhe menaxhohen nga AMF, Grupi Auditimit sqaron se në Raport Kontrollit, nuk është bërë sqarim për këtë pikë referuar bazës ligjore përkatëse, gjithashtu nga DTM duhej të azhurnohej programi i kontrollit duke mos përfshirë pika për të cilat nuk është e nevojshme realizimi i kontrollit.

- Në lidhje me mosrakovimet e konstatuara në pagesën e taksës mbi primin e shkruar, Grupi i auditimit, sqaron se pavarësisht shpjegimeve të dhëna nga Inspektori i Kontrollit në observacione, sipas të cilit mosrakovimet ndërmjet shitjeve të deklaruara dhe vlerave të primit të shkruar për vitin 2020, kanë ardhur për shkak të primeve të vetë shoqërisë të sqaruara në mënyrë analitike për secilin zë, për çdo vit, këto diferenca përsëri nuk përputhen me ato të nxjerra nga Grupi i Auditimit për zërat “mjete motorike” dhe “pasuri”, pra nuk janë sqaruar analitikisht të gjitha diferencat.

- Në lidhje me pretendimin tuaj për zërin “Shpenzimet e konsulencës financiare”, Grupi i auditimit, bazuar në argumentet dhe sqarimet e detajuara e analitike për çdo faturë të paraqitur për këtë zë të bilancit, ka marrë në konsideratë observacionin tuaj gjatë fazës së hartimit Projekt Raportit.

- Në lidhje me pretendimin tuaj për zërin “servise dëmi”, nuk janë paraqitur argumente apo dokumenta shtesë nga ato të trajtuara për akt konstatimet, për pasojë observacioni juaj nuk merret në konsideratë.

Në lidhje me pikën 2.2 të Projekt Raportit, janë paraqitur observacione me shkresën nr. 52/28 prot., datë 11.09.2023, administruar në KLSH me nr. 14/11 prot., datë 12.09.2023, nga z. I.D dhe z. E.M me detyrë Inspektor Sektori i Kontrollit në Vend, të cilët kanë bërë komente dhe shpjegime dhe konkretisht:

*Për konstatimet për subjektin “F.” SHPK , sqarojnë së punimet e mirëmbajtjes dhe riparimeve janë kryer bazuar në lejen Nr.12176/1,date 28.04.2016, si dhe leje Nr. K-20878/1,datë 17.07.2017, Nr. K-2077/8, datë 30.05.2018 dhe me shtesë leje ndërtimi Nr. K-7840, DATË 19.12.2020, shtesë e cila është pa afat të përcaktuar, lëshuar nga Bashkia Tiranë.*

-Në lidhje me dokumentacionin ligjor justifikues për huat e deklaruara nga subjekti për institucionet bankë dhe jo bankë, sqarojnë se shoqëria F. ka nënshkruar me Alpha Banke kontratë për kufi Kredie shumëqëllimore me nr. ABA\_20190529-2681, datë 29.05.2019, nënshkruar pranë noter J.ZH. me Nr. 6172 Rep, Nr. 2055 Kol, datë 26.06. 2019 si dhe marrëveshje shtesë për këtë kontratë. Gjithashtu shoqëria ka nënshkruar Kontratë Leasing për automjete në punë me Nr. 2149 Rep, Nr. 711 Kol, datë 05.03.2019 dhe me Raiffeisen Leasing Nr. 1960 Rep, Nr. 758 Kol, datë 05,08,20219. Kontratat e mësipërme janë bashkëngjitur observacionit.

- Në lidhje me konstatimet për zërin “Shpenzimet për shërbime profesionale/Shpenzime konsulence mbi tregun farmaceutik” dhe “Shpenzime konsulence mbi tregun farmaceutik”, sqarojnë se këto shpenzime janë të mbështetura në fatura tatimore bazuar në kontrata midis palëve, të gjitha këto shpenzime janë tërësisht në funksion të aktivitetit dhe plotësojnë të gjitha kushtet e nenit 20 të Ligjit Nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”. Bashkëlidhur sqarimit të dhënë në lidhje me kryerjen e këtyre shpenzimeve kemi paraqitur disa nga kontratat e lidhura midis palëve si dhe faturat tatimore specifike të faturimit të tyre shërbimeve për një muaj si Kontratë shërbimi datë 06.10.2021; Faturë tatimore nr. 1/2021, datë 25.10.2021; Kontratë shërbimi datë 11.10.2021, faturë tatimore nr. 5/2021, datë 14.12.2021.

- Në zërin ‘Shpenzime të tjera’, janë pasqyruar si shpenzime marketingu në vlerën 4,630,735 lekë, nga të cilat materiale promocionale janë në shumën 1,191,448, reklama dhe marketing në shumën 2,831,909 lekë. Theksojmë se aktiviteti i shoqërisë është tregtim, import-eksport me shumicë dhe pakicë, medikamente dhe materiale mjekësore. Në portofolin e produkteve që tregtohen numërohen mbi 20 kompani të njohura europiane për të cilat shoqëria kryen marketimin dhe tregtimin e tyre. Këto dy zëra shpenzime kanë qene në funksion të shitjes së grupeve të tjera të produkteve të shoqërisë dhe vlen të theksohet se këto shpenzime janë tërësisht në funksion të aktivitetit të saj dhe janë shpenzime të cilat plotësojnë të gjitha kushtet e nenit 20 të ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998.

**Qëndrimi i Grupit të Auditimit:** Në lidhje me pretendimin e ngritur për afatin e lejes së ndërtimit, nuk janë paraqitur argumente apo dokumenta shtesë nga ato të trajtuara për akt konstatimet, për pasojë observacioni juaj nuk merret në konsideratë.

- Në lidhje me pretendimet për dokumentacionin ligjor justifikues për huat e deklaruara nga subjekti për institucionet bankë dhe jo bankë, bazuar në dokumentacionin e dorëzuar, kontratat përkatëse bashkëngjitur, observacioni juaj do të merret në konsideratë.

- Në lidhje me pretendimet për zërin “Shpenzimet për shërbime profesionale/Shpenzime konsulence mbi tregun farmaceutik” dhe “Shpenzime konsulence mbi tregun farmaceutik”, sqarojmë se të dhënat dhe argumentet e vëna në dispozicion të Grupit të Auditimit janë të pamjaftueshme për të bërë vlerësimet përkatëse dhe mos analizimi i tyre në Raport Kontrolli mbart risk për mos pasqyrim të saktë të situatës financiare dhe llogaritjen e detyrimeve tatimore, për pasojë observacioni juaj nuk merret në konsideratë.

- **Tatimpagues:** A. SHPK me NIPT L.I e cila ushtron aktivitetin e tregtimit me shumicë të produkteve ushqimore pije në rolin e distributorit me shumicë sipas raport kontrollit tatimor të hartuar nga inspektori.

**Adresë Kryesore:** Tirane Kashar Yzberisht Lagjja Yzberisht, Rruga 3, Dëshmorët, magazina nr.17.

**Lloji i Kontrollit:** Kontroll për TVSH për periudhën Mars 2020 - Shkurt 2022, kontroll i tatimit për vitin 2020-2021, kontroll për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore Mars 2020-Shkurt 2022, të tjera Mars 2020- Shkurt 2022.

**Inspektori:** D.P.

Subjekti është njoftuar për kontroll tatimor me nr. 3141 datë 28.04.2022 dhe më pas me nr.3141/2 datë 31.05.2022. Programi i kontrollit është miratuar nga përgjegjësi i sektorit E.M. dhe Drejtori i Drejtorisë së Kontrollit O.C për 144 orë punë dhe raporti i kontrollit është hartuar në datë 15.08.2022. Formulari nr. 3 është miratuar nga përgjegjës E.M., drejtor kontrolli O. C. dhe Drejtor Rajonal E.C..

-Në raport kontrolli është kryer inventarizimi fizik që është krahasuar me inventarin kontabël nga i cili nuk kanë rezultuar diferenca.

-Është kryer analiza e deklarimeve të shoqërisë me sistemin informatik e ndarë në disa periudha. Blerjet e mallrave bëhen kryesisht te një furnitor kryesor që është A. D. & D. SHPK dhe shoqëria vepron si shpërndarës i produkteve të këtij furnitori në subjekte të tjera të tatueshme. Sipas raport kontrollit të gjitha shitjet janë kryer drejt personave të regjistruara në organet tatimore, pra në formën e tregtisë me shumicë.

-Janë kryer analizat mbi normativat e kreditimit të blerjeve të karburantit të cilat kanë rezultuar brenda marzhit të lejuar prej 3% për sektorin e tregtisë.

-Në lidhje me lëvizjet dhe gjendjet e mallrave për periudhën deri në 31.12.2020 në raport kontrolli nga inspektori është shprehur se “nga kontrolli dhe nga krahasimi me gjendjen kontabël nuk rezultuan diferenca”. Për këtë pohim janë kryer testet e krahasimit të inventarit në raport kontrolli në 31.12.2020 me inventarin e deklaruar nga tatimpaguesi së bashku me pasqyrat financiare. Nga krahasimi analitik i tyre rezultojnë diferenca ku sipas raport kontrollit janë 201,135 njësi mallra për rishitje, ndërkohë që sipas inventarit të deklaruar janë 204,096 njësi mallra për rishitje. Sipas shpjegimeve të dhëna nga ana e inspektorit tatimor këto diferenca rezultojnë si pasojë e mospërfshirjes së të gjithë artikujve në analizën e bilancit material, por vetëm për atë pjesë që i përket listës së përzgjedhur për inventarizim fizik. Nga krahasimi i bilancit material për produktet e përzgjedhur me inventarin sipas pasqyrave financiare nuk rezultuan diferenca.

-Janë analizuar marzhet nga ana e inspektorit për çdo produkt të shitur që variojnë nga 1% deri në 43.5%. Nga auditimi konstatohet se nga ana e inspektorit tatimor nuk është kryer një analizë e detajuar për të siguruar që nuk janë realizuar shitje nën kosto për produktet e tregtuara. Sipas shpjegimeve të dhëna nga inspektori, çdo shitje është realizuar mbi kosto duke qenë se çmimet e shitjes përcaktohen nga furnizuesi kryesor i tatimpaguesit, por duke mos paraqitur evidenca në lidhje me analizën e kryer.

- Në pasqyrat financiare të vitit 2020 konstatohet e drejtë e arkëtueshme në vlerën 7,809,284 lekë ndaj ortakut. Në raport kontrolli nuk janë referuar të dhëna të detajuara në lidhje me këtë të drejtë të arkëtueshme si dhe për vitin 2020 nuk janë njohur të ardhura nga shoqëria për interes të arkëtueshëm për këtë hua. Në të njëjtën mënyrë, edhe në pasiv të pasqyrave financiare paraqitet llogari të tjera të pagueshme për shumën 10,976,514 lekë. Për vitin 2021 vlera e llogarisë së të drejtave ndaj ortakut paraqitet në shumën 14,390,722 leke, duke u dyfishuar në vlerë në krahasim me një vit më parë. Sipas programit të kontrollit të miratuar është parashikuar detyra e evidentimit dhe dokumentimit të saktë të huave në mjete monetare si dhe lëvizjet e llogarisë së ortakëve; duke vendosur dokumentacionin ligjor bashkëngjitur raportit të kontrollit për huatë e deklaruar nga subjekti duke i ndarë sipas institucioneve banka dhe jo banka. Nga auditimi konstatohet se nuk është kryer karakterizimi i operacioneve me ortakun në kushte tregu duke llogaritur të ardhura të tatueshme nga interesi.

-Per pagesat e qerasë në lidhje me tatimin në burim nuk është kryer analizë në raport në lidhje me respektimin e kërkesave të kuadrit rregullator të çmimit minimal të qiradhënies në raportin e kontrollit. Për këtë çështje u kërkua dokumentacion shtesë në lidhje me kontratën e qerasë ku të reflektohen sipërfaqja dhe çmimi referencë për metër katror dhe u vendos në dispozicion analiza e kryer për çmimin minimal të qerasë për efekte tatimore.

Në lidhje me konstatimet e mësipërme për tatimpagues A., nga ana e subjektit të audituar janë paraqitur observacione duke pretenduar si më poshtë:

*...sqaroj se analiza e marzhit të artikujve që tregtohen nga tatimpaguesi është realizuar sipas pikave të programit të kontrollit dhe është pasqyruar në programin e kontrollit në faqet 10,11,12,13,19,20,21,22,24,25,26. Nga analiza ka rezultuar se subjekti ka kryer shitje në marzhet 1-43.5%*

*- ...sqaroj se tatimpaguesi për periudhën 2020-2021 nuk ka kryer shpenzime për interesa huaje. Në vitin 2022 ortakut ka kthyer pjesërisht huanë e marrë.*

Në përgjigje të këtyre observacioneve sqarojmë se analiza e kryer nga ana e inspektorit për shitjet nuk është e dokumentuar ku vlerat e paraqitura janë mesatarizuar.

Në lidhje me huadhëniet ndaj ortakut sqarojmë se konstatimi qëndron për mos llogaritjen e të ardhurave nga interesi dhe jo për faktin se nuk janë deklaruar shpenzime interesi. Këto lëvizje, për huadhëniet e shoqërisë drejt ortakut nuk rezultojnë të jenë analizuar sipas përcaktimeve në programin e kontrollit për të konkluduar edhe në faktin se kjo formë e përdorur nga ana e tatimpaguesve paraqet shpërndarje të mjeteve monetare të shoqërisë duke anashkaluar pagesën e tatimit mbi dividentin. Nuk rezulton të jetë kryer një analizë e thelbit ekonomik të vendosjes në përdorim të mjeteve monetare të tatimpaguesit në shërbim të ortakut të shoqërisë dhe për këtë arsye observacioni nuk merret në konsideratë.

Nga Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj me shkresë nr. 52/28 datë 11.09.2023 protokolluar në KLSH me nr. 14/11 datë 12.09.2023 janë paraqitur observacione mbi Projekt Raportin e Auditimit. Në përmbajtje të këtyre observacioneve, për këtë tatimpagues konstatohet se janë paraqitur të njëjtat observacione si në fazën e akt konstatimeve të pasqyruara dhe trajtuara si më sipër, për këtë arsye këto observacione nuk merren në konsideratë.

- **Tatimpagues:** KP T. & D. SHPK me NIPT L.K i cili ushtron aktivitetin e tregtimit me shumicë të produkteve ushqimore pije alkoolike dhe jo alkoolike në rolin e distributorit me shumicë sipas raport kontrollit tatimor të hartuar nga inspektori.

**Adresë Kryesore:** Rruga Sabaudin Gabrani, Magazina pranë ish S.M.T Tiranë.

**Lloji i Kontrollit:** Kontroll për TVSH për periudhën Janar 2014- Dhjetor 2019, kontroll i tatim fitimit për vitin 2014-2019, kontroll për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore 2014-2019 të tjera 2014-2019 (një pjesë e periudhës së kontrolluar përfshin rikontroll tatimor).

**Inspektori:** F.GJ.

Subjekti është njoftuar për kontroll tatimor me nr. 9212 datë 19.11.2020 dhe më pas me nr.9212/1 datë 06.01.2021. Programi i kontrollit është miratuar nga përgjegjësi i sektorit A.S. dhe Drejtori i Drejtorisë së Kontrollit M.R. për 600 orë punë dhe raporti i kontrollit është hartuar në datë 10.05.2021. Formulari nr. 3 është miratuar nga përgjegjës A.S., drejtor kontrolli M.R. dhe Drejtor Rajonal I.A..

Aktiviteti i shoqërisë sipas raportit të kontrollit përfshin një magazinë qendore si vend kryesor të ushtrimit të aktivitetit dhe adresë sekondare në automjete për tregtimin me shumicë të C. C. , U. T., M.&D. dhe C.. Kontrolli në këtë subjekt është iniciuar sipas shkresës nr. 12806 datë 19.10.2020 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë me objekt “Kërkesë për vlerësim tatimor urgjent”. Sipas kësaj shkrese i është kërkuar DTM që të mos njihen shitjet e kryera nga tatimpaguesi KP T. & D. pasi është faktuar nga gjykata që subjekti ka kryer shitje të mallrave (pije) drejt personave fiktivë të cilët nga ana e tyre i kanë faturuar fiktivisht tatimpaguesve në sektorin e ndërtimit me qëllim krijimin e skemave të TVSH. Kjo pasi është vërtetuar nga gjykata që këto subjekte (klientët e KP T. & D.) janë fiktiv dhe nuk kanë pasur asnjë aktivitet tregtar dhe janë përdorur për të shkarkuar mallin që e kanë shitur pa dokumentacion tatimor. Për këtë qëllim në raport kontrolli shitjet e kryera nga tatimpaguesi drejt subjekteve të cituara në shkresën e prokurorisë janë rivlerësuar si të ishin kryer në formën e shitjeve me pakicë (pasi është marrë autorizim për evidentimin e çmimeve me pakicë në tatimpagues të tjerë për produktet e shitur) dhe janë nxjerrë detyrime shtesë për këto shitje të realizuara.

-Nga inspektori është kryer inventarizimi fizik për 50 artikuj me qarkullim më të lartë (pa specifikuar përzgjedhjen) dhe nuk kanë rezultuar diferenca. Gjatë viteve objekt kontrolli janë kryer bilancet materiale vetëm në sasi por duke ulur numrin e mallrave për rishitje për të kontrolluar, konkretisht 45 nga 274 në vitin 2019; 39 nga 244 në vitin 2018; 37 nga 216 për vitin 2017; 31 nga 25 në vitin 2016; 10 nga 25 në vitin 2015 dhe 10 për vitin 2014 që është viti i ushtrimit të aktivitetit. Kjo analizë është kryer duke përfshirë artikujt për të cilët është bërë inventarizim fizik. Në raportin e kontrollit është kryer analiza e bilancit material për një numër të kufizuar artikujsh ku janë krahasuar vit pas viti lëvizja e mallrave në sasi duke u shprehur që janë kryer rigrupime të artikujve po pa ndryshuar vlerë. Kjo e bën të pamundur ndjekjen e inventarit megjithëse janë iniciuar kontrole paraprake për deklaratimet e inventarëve sipas gjendjes së pasqyrave financiare. Në lidhje me këtë pikë janë kërkuar shpjegime në lidhje me natyrën e rigrupimeve dhe në të njëjtën kohë për inventarin përfaqësues si zgjedhje për kryerjen e bilancit material, nga ku konstatohet se rigrupimet kryesore janë kryer në mbyllje të vitit 2016 dhe pjesa e kontrolluar e artikujve të bilancit material në krahasim me artikujt sipas pasqyrave financiare nuk ka diferenca.

-Në analizën e kryer për efekt të TVSH në shitjet e përjashtuara janë përfshirë vlera e ambalazheve të kthyeshme, konkretisht shishe në vlerën 25,123,447 leke. Për analogji, në vitin

2018 blerjet e ambalazhit nga C. C i ka raportuar si blerje të përjashtuara. Për këtë arsye shitjet e tatueshme sipas deklarimeve rezultojnë të jenë nënvlerësuar për shumën 25,123,447 lekë.

***Detyrimi për Tatim Fitimin* 25,123,447 \* 15% = 3,768,517 lekë**

***Gjobë* 3,768,517 \* 0.06% x 365 ditë = 825,305 lekë.**

***Totali = 4,593,822***

-Nga ana e inspektorit tatimor nuk rezulton të jetë ushtruar kontroll tatimor për shitje në tatimpagues në statusin pasiv duke qenë se tatimpaguesi objekt kontrolli ka precedencë në shitje të realizuar në subjekte sipas shkresës për fillimin e kontrollit.

- Te blerjet e përjashtuara të vitit 2018 është raportuar blerje për kafe sipas përshkrimit të furnitorit për vlerën 2.3 milion lekë ndërkohë që për të njëjtin furnitor nga jashtë kjo lloj blerje është raportuar si importe mallrash me TVSH, duke pasur diferencë në trajtim. Për këtë çështje u kërkua shpjegim nga ana e inspektorit tatimor dhe rezultoi se është plotësim i gabuar i deklaratës pasi rezulton import mallrash të tatueshëm, për të cilat nuk është bërë ndryshimi i deklaratës së pasaktë.

-Nga ana e inspektorit të kontrollit nuk është kryer një analizë sipas produkteve në lidhje me çmimin e blerjes dhe çmimin e aplikuar të shitjes në mënyrë që të provohet shitja mbi marzh për produktet e përzgjedhura, por vetëm janë mesatarizuar çmimet e shitjes dhe blerjes për produktet e marrë në analizë. Në këtë mënyrë nuk arrihet siguri që nga ana e subjektit të gjitha shitjet të jenë kryer mbi koston e tyre pasi vlerat janë mesatarizuar.

-Ne pasqyrat financiare të vitit 2019 është paraqitur llogaria në shumën 12,981,874 leke që ka të bëjë me detyrime të ortakut ndaj shoqërisë. Nga ana e shoqërisë nuk janë llogaritur shitje të përjashtuara për të ardhura nga interesi i kësaj huaje të dhënë në kushtet e tregut sipas përcaktimeve të bëra në ligjin për procedurat tatimore.

-Në analizën e kryer në raportin e kontrollit tatimor në krahasimin e shpenzimeve të raportuara në pasqyrën e performancës financiare me deklaratimet në FDP të TVSH konstatohet se ekzistojnë diferenca nga rakordimi përse i përket rregullimeve për efekt të shtesës së aseteve gjatë vitit dhe ndryshimit të gjendjes së materialeve. Konkretisht në lidhje me shtesën e aseteve rregullimi në raport përfshin shumën 4,232,311 lekë ndërkohë që shtesa e aseteve sipas pasqyrës së amortizimit përfshin shumën 5,103,102 lekë, nga të cilat 4,933,430 lekë për mjete transporti dhe 169,672 lekë për kompjutera (kjo është vlera e saktë pasi edhe në librin e blerjes të muajit qershor evidentohet transaksioni me nr. Fature 77264772 datë 18.06.2019 nga furnitori H.L G. me NIPT K.W për blerje automjeti në shumën 4,995,030 lekë. Për rrjedhojë janë mbivlerësuar një pjesë e shpenzimeve të periudhës për diferencën e cila duhet të trajtohet si një shtesë e aseteve dhe jo shpenzim i zbritshëm për vitin. **Për këtë arsye shpenzimet e zbritshme duhet të rivlerësohen për 722,719 lekë (4,955,030-4,232,311).**

***Detyrimi për Tatim Fitimin* 722,719 \* 15% = 108,408 lekë**

***Gjobë* 108,408 \* 0.06% x 365 ditë = 23,741 lekë.**

***Totali = 132,149***

Në lidhje me ndryshimin e gjendjes së inventarit për efekt rakordimi të FDP me pasqyrën e performancës konstatohet se nuk është përfshirë ndryshimi i gjendjes së materialeve të para (ambalazhe) në vlerën 354,198 lekë.

- Gjatë periudhës objekt kontrolli nga tatimpaguesi janë raportuar blerje për leasing për automjete dhe konstatohet se nga ana e inspektorit nuk janë kryer kontrole nëse këto blerje janë për autovetura apo automjete të tjera, në mënyrë që të gjykohet në rast se këto blerje duhen trajtuar si të zbritshme për efekt të TVSH-së apo si blerje të përjashtuara, por shtesa e aseteve në pasqyrat financiare pasqyron automjete.

-Në vitin 2017 për efekt të rakordimit të shpenzimeve sipas FDP me shpenzimet sipas PASH ndryshimi i gjendjes së mallrave nuk ka përfshirë ndryshimin e gjendjeve të materialeve të para (ambalazhe) në shumën 1,892,715 lekë gjatë analizës së kryer. Blerjet e asetëve nuk janë përfshirë në blerje asetësh në detajimin e blerjeve të përjashtuara apo ato të tatueshme në analizën e kryer nga inspektori në raport.

***Efekt i financiar i shmangur me efekt të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit është në shumën 4,725,971 lekë.***

Në lidhje me konstatimet e mësipërme për tatimpagues KP T. D., nga ana e subjektit të audituar janë paraqitur observacione duke pretenduar si më poshtë:

*...rigrupimi i artikujve është bërë nga shoqëria në përputhje me programin e saj ekonomik dhe financiar. Artikujt në inventarin kontabël janë paraqitur të grupuar kurse në inventarin fizik janë pasqyruar në mënyrë analitike se ashtu kanë qenë kartelat e produkteve por me të njëjtin çmim dhe ska asnjë deviacion apo dublim.*

*- për shitjet e përjashtuara në vitin 2017 ...sipas nenit 39 të ligjit nr.92/2014 dhe nenit 30 të udhëzimit të MF nr.6 datë 30.01.2015 vlera e ambalazheve të kthyeshme nuk përfshihet në vlerën e tatueshme të furnizimit që do të thotë se nuk pasqyrohet në kosto dhe as në të ardhura. Këto shitje të deklaruara në fdp e TVSH-së kanë të bëjnë vetëm me evidentimin e ambalazhit qarkullues në faturat e shitjes dhe në fakt është kthim i ambalazhit në treg nga klientët te kompania. Ambalazhi kthehet në fabrikë dhe thjesht qarkullohet por dokumentohet për të identifikuar klientët në marrëdhëniet tregtare. Vlera e ambalazhit qarkullues nuk është e ardhur për shoqërinë dhe ky veprim është sqaruar edhe në sistemin tatimor të çështjet e mia të subjektit. Theksojmë se i njëjti trajtim është bërë në raportin e kontrollit për shitjet e përjashtuara të vitit 2018 dhe nuk qëndron ajo çfarë thuhet nga audituesit e KLSH për analogji në vitin 2018 blerjet e ambalazhit nga C. C. i ka raportuar si blerje të përjashtuara.*

*-për analizën e shitjeve në tatimpagues pasivë, ..pas datës 21.03.2019 deri në fund 2019 nga ana e kontrollit tatimor nuk janë konstatuar shitje në tatimpagues me statusin pasiv.*

*-për importin e kafes .. deklarimet janë paraqitur drejt por në librat e blerjes nuk janë bërë ndryshimet përkatëse dhe nuk qëndron ajo çfarë thuhet nga audituesit.*

*-për analizën e marzhit të shitjes ...nga ana jonë për periudhën objekt kontrolli janë verifikuar llogaritë furnitorë-mallra dhe klientë mallra duke bërë krahasimin e kostos së blerjes së mallit me çmimin e shitjes dhe nuk rezultuan shitje të mallrave nën kosto, dhe kjo analizë është pasqyruar në raport në mënyrë të përmbledhur e cila disponohet edhe për çdo produkt të shitur.*

*-për rivlerësimin për diferencën e vlerës së asetëve ..nuk qëndron pasi nuk janë shtuar shpenzimet për këtë zë as amortizimi. Në PASH amortizimi është në shumën 1,308,702 lekë pra nuk është rënduar në blerje amortizimi për mjetet e transportit pavarësisht shtesës së asetëve.*

*-për krahasimin e fdp me shpenzimet në pash për efektin e ndryshimit të gjendjes ambalazheve .... sipas deklaratimit të shoqërisë vlera e mallit në vitin përkatës është e ndarë nga vlera e ambalazhit dhe diferenca e mësipërme nuk është përfshirë në tabelë pas sipas ligjit vlera e ambalazhit nuk është element as i kostos as i të ardhurave. ..nuk rezultojnë efekte fiskale sa i takon shpenzimeve të pasqyruara në bilanc pavarësisht se në tabelën e mësipërm nuk është pasqyruar ndryshimi i gjendjes së ambalazhit.*

Në përgjigje të këtyre observacioneve sqarojmë se:

- në rigrupim janë përfshirë konsolidim produktesh të cilat kanë kosto blerje të ndryshme dhe për këtë arsye observacioni nuk merret në konsideratë.

- për ambalazhin qarkullues të kthyeshëm që është deklaruar në shitje të përjashtuara nga tatimpaguesi por nuk është llogaritur për efekt të të ardhurave të tatueshme për tatim fitimin, neni 30 i UMF nr.6 datë 30.01.2015 përcaktohet se "...Vlera e ambalazheve të kthyeshme nuk përfshihet në vlerën e tatueshme të furnizimit, përveç kur ambalazhet e kthyeshme nuk janë kthyer nga blerësi". Për atë kohë sa nuk është kryer verifikim nëse janë kthyer ose jo si dhe nëpërmjet faturave të shitjes, klientëve të shoqërisë i është dhënë mundësia që ta quajnë të zbritshëm këtë transaksion nëpërmjet faturës përkatëse, observacioni nuk merret në konsideratë.

-për shitjet në tatimpagues pasivë në raport kontrolli nuk ka asnjë dokumentim në lidhje me kontrollin e kryer ose jo për këtë pikë për periudhën 21.03.2019-31.12.2019, duke qenë se ky tatimpagues paraqet precedencë në këtë shkelje tatimore, për këto arsye observacioni nuk merret në konsideratë.

-Analiza për cdo produkt të shitur për marzhin e shitjes nuk është vendosur në dispozicion dhe nuk merret në konsideratë observacioni.

-Për rakordimet fdp-pasqyrë pozicioni financiar, sqarojmë se elementët e shtesës së aseteve (që ndryshon në vlerë nga pasqyrimi në librat e blerjeve) dhe ndryshimit të gjendjes të ambalazheve nuk janë marrë në konsideratë kur janë shpjeguar shpenzimet në tërësi për shoqërinë dhe krahasimi i tyre me librat duke sjellë shpenzime të cilat janë zbritur po nuk përputhen me librat, me efekt në detyrimin për tatim fitimi. Për këto arsye observacioni nuk merret në konsideratë.

Nga Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj me shkresë nr. 52/28 datë 11.09.2023 protokolluar në KLSH me nr. 14/11 datë 12.09.2023 janë paraqitur observacione mbi Projekt Raportin e Auditimit. Në përmbajtje të këtyre observacioneve, për këtë tatimpagues konstatohet se janë paraqitur të njëjtat observacione si në fazën e akt konstatimeve të pasqyruara dhe trajtuara si më sipër, për këtë arsye këto observacione nuk merren në konsideratë. Gjithashtu në takimin ballafaques në KLSH të zhvilluar në datën 19.09.2023, nga ana e inspektorit tatimor u prezantuan argumente në lidhje me stornimin e blerjeve nga distributori kryesor të cilat kanë sjellë efektin e deklarimit të të ardhurave të përjashtuara, për të cilat nga ana e grupit të auditimit u sqarua se janë pjesë e mungesës së analizës së dokumentacionit në lidhje me kthyeshmërinë e ambalazhit qarkullues ose jo, pjesë e cila bën edhe ndarjen në rast se këto të ardhura duhet të përfshihen si pjesë e të ardhurave të tatueshme apo jo.

- **Tatimpagues: A. SHPK me NIPT L.K** i cili ushtron aktivitetin e import eksport dhe tregtimit të metaleve e materialeve të ndërtimit.

**Adresë Kryesore:** Kavaje Luz i vogël , Objekt privat ne Zonën kadastrale 2539

**Lloji i Kontrollit:** Kontroll për TVSH për periudhën Janar 2019 – Maj 2022, kontroll i tatim fitimit për vitin 2018-2021, kontroll për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore Dhjetor 2020-Janar 2022 të tjera Dhjetor 2020-Janar 2022.

**Inspektori:** E.S.

Tatimpaguesi është njoftuar për kontroll me shkresën nr. 6558 datë 28.07.2022 dhe shkresë nr. 6558/1 datë 14.09.2022 dhe programi i kontrollit për 224 orë punë është miratuar nga përgjegjësi A.D. dhe drejtori O.C. përfshin ndër të tjera kryerjen e inventarizimit fizik, kryqëzimin e të dhënave, analizën e blerjeve dhe të shitjeve etj. Formulari nr. 3 është miratuar nga përgjegjës A.D., drejtor kontrolli O.C. dhe Drejtor Rajonal E.C..

Objekti i veprimtarisë së tatimpaguesit për periudhën objekt kontrolli është kryesisht tregtimi i hekurit. çimentos sipas tre llojeve të produktit, skrapit të cilat i blen nga furnitor vendas dhe importi (një pjesë të hekurit) dhe i shet në klientë vendas duke ofruar edhe transportin në disa raste me mjetet e veta apo duke e nënkontraktuar këtë shërbim. Sipas raport kontrollit, nga inventarizimi fizik nuk kanë rezultuar diferenca për 4 artikuj (3 lloje çimentosh dhe gazoil) të përzgjedhur duke qenë se nuk ka pasur gjendje të mallit hekur për kryerjen e inventarit fizik.

- Gjatë analizës së aktivitetit në raport kontrolli janë evidentuar furnizime në tatimpagues të autorizuar në kuadër të procesit të rindërtimit i cili është i përjashtuar për efekte të TVSH-së. Për shitjen e përjashtuar në kuadër të procesit të rindërtimit drejt GPG për çimento konstatohet se çimentoja është deklaruar si blerje e tatueshme dhe në Shtator 2020 është kryer rregullimi i TVSH duke ulur TVSH të zbritshme në mënyrë që të balancohen furnizimet e përjashtuara në kuadër të blerjeve të përjashtuara. Për këtë, VKM e përjashtimit përcakton që subjekti duhet të pajiset me autorizim nga DPT ndërkohë që konkretisht subjekti është bazuar në një shkresë të DPT (për trajtimin e përgjithshëm të procesit të rindërtimit) sipas së cilës nuk ka aplikuar për autorizim por është bazuar në autorizimin e subjektit ndërtues të rindërtimit.



-Në analizën e të ardhurave të tatueshme për vitin 2019 janë përfshirë parapagime për hekur në vlerën 10,450,833 lekë, ndërkohë që në analizën e kryer për të ardhurat e tatueshme për tatim fitimi të gjitha shitjet e periudhës janë përfshirë në të të ardhura të tatueshme, duke mos trajtuar si parapagim por si të ardhur të periudhës. Në të njëjtën kohë në lidhje me këtë transaksion nuk rezultojnë që të jenë njohur të ardhura të papërfituara (arkëtime në avancë për porosi) në pasiv të pasqyrave financiare për vitin 2019. I njëjti konstatim përfshin edhe vitin 2020 ku shuma e raportuar si parapagim për hekur prej 3,750,000 lekë nuk përputhet me arkëtime për porosi në avancë në pasqyra financiare e cila paraqitet në shumën 1,231,417 lekë.

-Nga ana e inspektorit tatimor gjatë analizës së marzheve të aplikuara janë përdorur çmime mesatare blerje dhe çmime mesatare shitje duke mesatarizuar marzhet dhe duke mos krijuar siguri nëpërmjet evidencave të dokumentuara që subjekti të mos ketë shitur mallra nën kosto.

-Tatimpaguesi gjatë vitit 2019 ka marrë hua nga shoqëria Xh.F K. ku konstatohet se megjithëse janë marrë hua jo me normat e tregut (0.1% për 5 vite), tatimpaguesi nuk ka llogaritur shpenzime interesi në pasqyrat financiare. Teprica e huasë sipas pasqyrave financiare në fund të vitit 2019 paraqitet në shumën 23,654,500 lekë ndërkohë që në fund të vitit 2020 paraqitet në shumën 11,260,000 lekë.

Në lidhje me konstatimet e mësipërme për tatimpagues A., nga ana e subjektit të audituar janë paraqitur observacione duke pretenduar si më poshtë:

*...në analizën e shitjeve për vitet 2019 dhe 2020 përshkrimi në raportin e kontrollit "parapagime hekur ndërtimi" është bërë vetëm për efekt analize të shitjeve sipas natyrës dhe përbërjes së tyre si dhe detajimi i shitjeve sipas faturave të cilat janë të regjistruara në librin e shitjes dhe në fdp. Parapagimi i marrë për shitje hekuri në vitin 2019 nuk paraqitur nga shoqëria në pasiv të bilancit në zërin shuma të arkëtuara për porosi për arsye se e gjithë shuma është zbritur totalisht brenda vitit 2019. Ndërsa parapagimi i marrë në vitin 2020 për shitje hekuri është zbritur pjesërisht në vitin 2020 -2,654,720 lekë dhe diferenca ka rezultuar në pasiv të bilancit në zërin shuma të arkëtuara për porosi.*

Në përgjigje të këtyre observacioneve sqarojmë se merret në konsideratë observacioni për paraqitjen e parapagimit në analizën e shitjeve dhe efektit të pasqyrimin të tij në pasi të bilancit në vlerën 0 në vitin 2020 sipas anulimit të parapagimit me librat e shitjes bashkëngjitur. Për vitin 2020, vlera e të ardhurave të papërfituara  $3,750,000 - 2,654,720 = 1,095,280$  lekë nuk përputhet përsëri me shumën e paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar për vitin 2020 të të ardhurave të papërfituara në shumën 1,231,417 lekë, me një diferencë prej 136,137 lekë.

**-Tatimpagues: G. SHPK me NIPT J.J** i cili ushtron aktivitetin e tregimit të energjisë elektrike dhe prodhimit të ferrokromit në Uzinën e Elbasanit, shitjen e tij si dhe shitje për projektin e matësave me OST.

**Adresë Kryesore:** Njësia Bashkiake nr. 5, Rruga Ibrahim Rugova, Pallati nr. 64, Tiranë.

**Lloji i Kontrollit:** Saktësim i shumës së rimbursueshme të TVSH-së të kërkuar për periudhën Shtator - Dhjetor 2020.

**Inspektori:** D.GJ.

Tatimpaguesi është njoftuar për kontroll tatimor me nr. 2484/1 datë 08.04.2021.2022. Programi i kontrollit është miratuar nga përgjegjësi i sektorit E.M. dhe Drejtori i Drejtorisë së Kontrollit M.R. për 56 orë punë dhe raporti i kontrollit është hartuar në datë 28.05.2021.

Formulari nr. 3 është miratuar nga përgjegjës E.M., drejtor kontrolli M.R. dhe Drejtor Rajonal I.A.

Aktiviteti kryesor i shoqërisë përfshin prodhimin e ferrokromit në uzinë dhe në të njëjtën kohë të tregimit të energjisë elektrike. Ferrokromi i prodhuar nga tatimpaguesi është i destinuar për eksport dhe është trajtuar si furnizim me 0%, për blerjet që i shërbejnë kësaj pjese të aktivitetit i

lind TVSH e kreditueshme. Për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike tatimpaguesi vepron në rolin e tregtarit duke importuar/blerë brenda vendit energji elektrike dhe duke shitur pjesën më të madhe të energjisë në tregun e brendshëm.

-Nga ana e inspektorit tatimor nuk është kryer inventarizimi fizik i kromit dhe ferrokromit duke paraqitur si argument vështirësinë e shpërndarjes dhe në peshim, megjithëse këto mallra përbëjnë aktivitetin kryesor nga e cila është krijuar teprica e kreditueshme e TVSH-së. Gjithashtu nuk është kryer inventarizimi fizik për mallra të tjerë me vlerë të lartë sipas listës së inventarit në mbyllje të periudhës ushtrimore. Inventari fizik është kryer për mallrat në një adresë sekondare nga ku nuk kanë rezultuar diferenca. Nga 1110 artikuj me vlerë 1,866,513,838 lekë sipas listës së inventarit analitik dorëzuar me pasqyrat financiare nga ana e inspektorit tatimor janë përzgjedhur për inventarizim fizik vetëm 25 artikuj me vlerë 6.16 milion lekë.

-Në raportin e kontrollit tatimor është kryer analiza e shitjeve dhe blerjeve për periudhën Shtator Dhjetor 2020 duke i analizuar sipas llojit dhe natyrës së tyre. Për aktivitetet kryesore të shoqërisë që përfshijnë prodhimin e shitjen e mineralit të ferrokromit dhe për tregtimin e energjisë elektrike është kryer analizë e veçantë.

Në këtë mënyrë, për aktivitetin e prodhimit është pasqyruar bilanci material dhe në lidhje me sasisë e hyra të materialeve të para dhe daljet për prodhimin e ferrokromit nga ku nuk kanë rezultuar diferenca. Gjithashtu është kryer edhe bilanci material i produktit të gatshëm në sasi si dhe janë krahasuar kosto e prodhimit me çmimet e shitjes së tij për eksport.

-Për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike është kryer analizë e lëvizjeve të sasisë së energjisë sipas konfirmimeve të OST SHA për importet, blerjet, shitjet brenda vendit dhe eksportet e shoqërisë. Megjithatë konstatohet se kontrolli mbi çmimet e aplikuara dhe krahasimin e tyre me koston e blerjes së energjisë është kryer duke mesatarizuar vlerat dhe në këtë mënyrë nuk është arritur siguri nëse përgjatë kësaj periudhe shitjet rast pas rasti të jenë kryer mbi koston e mallit, kjo për vetë natyrën e energjisë e cila nuk magazinohet dhe sipas politikës kontabël të tatimpaguesit për regjistrimin e daljeve të inventarit.

Në lidhje me konstatimet e mësipërme për tatimpagues GSA, nga ana e subjektit të audituar janë paraqitur observacione duke pretenduar si më poshtë:

*...nuk është kryer inventarizimi i produktit të gatshëm ferrokrom produkt i gatshëm dhe materialeve si mineral kromi, koks, kuarc pasi do të kërkonte përpunimin (ngarkim, peshim shkarkim) të një sasive prej 33,881.47 Mt në pamundësi me mjetet dhe kohën në dispozicion.*

*- për tregtinë e energjisë elektrike, nuk mund të krahasohen faturat e shitjes me çmimin mesatar mujor të blerjes për arsyet e mëposhtme:*

*1.Fatura e blerjes nuk i përkasin të gjitha periudhës nga data 01 deri në datën 30/31 të muajit. Faturat e blerjes janë të detajuara me periudha të ndryshme kohore dhe gjithashtu me intervale të ndryshme kohore gjatë së njëjtës ditë. Pra një faturë shitje mund të jetë kryer në një interval kohor që mund ti përkasë vetëm një apo disa faturave të blerjes por jo të gjitha blerjeve të realizuara gjatë muajit.*

*2.Gjatë periudhës së kontrollit shoqëria konsumon energji elektrike për aktivitetin e ferrokromit e cila është një blerje që nuk mund të konsiderohet si energji e tregtueshme dhe të ndikojë në mesatarizimin e çmimit të energjisë elektrike për krahasimin e çmimeve të shitjes.*

Në përgjigje të observacioneve të mësipërme sqarojmë:

-kryerja e inventarizimit fizik është pjesë e programit të miratuar të kontrollit, por duke pasur në konsideratë burimet kohore në dispozicion nga ana e inspektorit për afatin e kryerjes së tij nga grupi i auditimit është marrë parasysh që në fazën e konstatimit argumentimi i bërë për të. Konstatimi kryesor i grupit të auditimi lidhet me artikujt e tjerë sipas listës analitike të inventarit dhe peshës specifike të përzgjedhjes së inspektorit në raport me popullatën e inventarit e cila nuk është përfaqësuese dhe për këtë arsye nuk merret në konsideratë observacioni.

- për aktivitetin e tregtimit dhe konsumimit të energjisë elektrike, sqarojmë se pretendimi se faturat e blerjes nuk i përkasin të gjitha të njëjtës periudhë, nuk qëndron pasi energjia është një mall që nuk magazinohet dhe për këtë arsye është e mundshme analiza me metodën e identifikimit specifik duke pasur parasysh edhe konfirmimet nga institucionet përkatëse me objekt veprimtarie sistemin e transmetimit të energjisë. Përdorimi i energjisë për vetëkonsum është i përcaktuar qartë në legjislacionin e TVSH si një shembull i furnizimit për nevoja të veprimtarisë ekonomike dhe në konstatim nuk jemi shprehur për mesatarizimin për këtë komponent, por për mënyrën e kryerjes së kontrollit ku nuk është dokumentuar dhe arritur konkluzion i saktë se nuk janë realizuar shitje nën kosto për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike. Për këto arsye observacioni nuk merret në konsideratë.

- **Tatimpagues: B. E. SHPK me NIPT L.I** e cila ushtron aktivitetin e rafinerisë së përpunimit të naftës bruto dhe prodhimit të nënprodukteve të saj.

**Adresë Kryesore:** Njësia Bashkiake Nr.5, Rruga Emin Duraku, Pallati Binjakët, Nr.5, Tiranë.

**Lloji i Kontrollit:** Kontroll për TVSH për periudhën Maj 2017-Janar 2020, kontroll i tatim fitimit për vitin 2017 dhe 2018, kontroll për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore Maj 2017 –Janar 2020, të tjera Maj 2017-Janar 2020.

**Inspektori:** B.K. dhe A.SH.

Dosja fizike për këtë kontroll tatimor nuk është vendosur në dispozicion nga Arkiva pasi është transferuar për ndjekje si tatimpagues në një tjetër drejtori rajonale tatimore. Sipas raport kontrollit tatimpaguesi ushtron aktivitet si rafineri e përpunimit të naftës bruto dhe prodhimit të nënprodukteve të saj në Uzinën e Përpunimit të Thellë të Naftës në Ballsh sipas Kontratës së Qerasë date 05/03/2018, me tatimpaguesin A. E. SHA me Nipt L.C, ku vlera mujore e qerave është 22.5 milion leke. Shërbimin e rafinimit dhe përpunimit të lëndës së parë, naftë bruto, shoqëria B. E., ia kryen shoqërisë T. E. SHA, me NIPT L.A, me të cilën ka lidhur kontratë me objekt *“Ofrimi i shërbimeve, duke përfshirë depozitimin, përpunimin me cilësi dhe/ose përzierjen/shkrirjen e lëndës së parë në produkte naftë”*, ku për produktin lëndë e parë naftë bruto, që është pronë e shoqërisë T. E. SHA, shoqëria B. E. SHA, për rafinimin dhe përpunimin e kryer, do të përfitojë një tarifë prej 53 \$/ton. Kosto e rafinimit përfshin të gjitha shpenzimet që shoqëria B. kryen për përpunimin e lëndës së parë dhe nxjerrjen e nënproduktit. Kështu, shoqëria B. E. SHA paraqet në blerjet mujore qeranë e paguar shoqërisë A. E. SHA për përdorimin e rafinerisë së naftës në Ballsh, ndërsa në shitje deklaron tarifën e rafinimit dhe përpunimit prej 53\$/ton, që i faturon shoqërisë T. E. SHA (si zotëruese e produktit të përpunuar).

-Nga auditimi konstatohet se nga ana e inspektorëve tatimorë nuk është kryer kontroll në lidhje me çmimin e qerasë së dakortësuar ndërmjet palëve për objektin e marrë me qera, nëse kjo vlerë është mbi tarifën minimale të përcaktuar me VKM. Gjithashtu nga ana e inspektorëve tatimore rezulton të mos jetë kontrolluar transaksioni i qeradhënies së makinerive apo aseteve të tjera të cilat bëjnë pjesë në asetin gjenerues të parasë, duke qenë se shoqëria ka marrë me qera të gjithë rafinerinë me të gjitha asetet që ajo disponon nga pronari i saj “A. E.”. Në këtë mënyrë, referuar përcaktimeve të bëra në ligjin “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar, qiradhënia e aseteve të tjera nga ndërtesa, është furnizim i tatueshëm me TVSH dhe në këtë mënyrë ky transaksion duhet të ishte objekt kontrolli dhe përcaktimi të shumës së TVSH e cila duhet të ishte e pagueshme për një tatimpagues dhe e kreditueshme për tjetrin, por që në total do të paraqiste të ardhura shtesë për buxhetin e shtetit nga TVSH.

-Nga auditimi konstatohet se në raport kontrolli nuk është kryer një analizë për shitjet e analizuara nga shoqëria në lidhje me sasinë e produktit të përpunuar duke qenë se të ardhurat nga shitja janë të lidhura në mënyrë të drejtpërdrejtë me sasinë e produktit të përpunuar sipas tarifës së përpunimit të përcaktuar në kontratë ndërmjet palëve.

Sipas analizës së kryer në raportin e kontrollit tatimor, shoqëria ka pasur aktivitet kryesisht gjatë periudhës Maj 2018 – Shtator 2019 në të cilën ka pasur volum në blerje/importe dhe shitje të tatueshme. Në blerjet e përjashtuara, pjesën më të madhe të shpenzimeve e zënë qeraja dhe taksat vendore. Në importet e mallrave, pjesën më të madhe e zënë blerjet për aditiv, soluc. Në blerjet e tatueshme brenda vendit pjesën më të madhe të tyre e zënë energjia elektrike, kimikate dhe materiale të tjera të ndryshme.

-Nga ana e inspektorëve tatimorë nuk është kryer bilanci material i mallrave përgjatë periudhës objekt kontrolli, duke vendosur në dyshim kreditueshmërinë e TVSH për këto produkte dhe nëse ato i kanë shërbyer aktivitetit ose jo. Kjo sepse shitjet e tatimpaguesit përbëhen nga ofrim shërbimi dhe nuk përfshijnë tarifimin për shitjen e materialeve të tjera, duke qenë jashtë objektit të veprimtarisë së tij. Duke mos u kryer bilanci material nuk verifikohet saktësia e blerjeve të tatueshme dhe importeve për qëllime të aktivitetit të tatueshëm. Kjo pasi në çdo moment tatimpaguesi nuk është në kontroll të mallit që përpunon pasi sipas raport kontrollit (nafta bruto), lënda e parë është në pronësi të shoqërisë (T. E.) që tarifohet nga ana e B. E..

Përcaktimi i tarifës së shërbimit fiks për shitjet e realizuara për periudhën objekt kontrolli dhe mos funksionimi në kushtet e kapacitetit normal si pasojë e mos furnizimit me lëndë të parë (naftë bruto) të përfituesit të shërbimit ka sjellë për pasojë akumulimin e humbjeve nga realizimi i shërbimit për shkak të kostove të larta fikse të angazhuara (pagat, qeraja, energji elektrike, etj). Në blerjet e tatueshme, konstatohet se janë përfshirë blerje për materiale të para në procesin e prodhimit që përfshijnë sipas pasqyrave financiare artikujt aditiv dhe katalizator. Sipas marrëdhënies së përshkruar në raport kontrolli tatimor dhe shpjegimeve të dhëna nga ana e inspektorit tatimor, nga ana e tatimpaguesit është marrë me qera rafineria së bashku me mjetet si një e tërë dhe duke punësuar punonjësit e specializuar është ofruar shërbimi për përpunimin e naftës bruto për llogari të tatimpaguesit T. E., i cili është zotërues i materialit të parë dhe produkteve që përfitohen nga procesi i përpunimit. Ky argumentim është përdorur për marrëdhënien e krijuar sipas së cilës nafta bruto nuk bëhet hyrje të tatimpaguesi B. por është gjatë gjithë kohës në pronësi të T. E.. Në të njëjtën logjikë, edhe materialet e tjera të cilat janë në funksion të procesit të përpunimit (aditiv, katalizator) i nënshtrohen të njëjtit parim dhe për këtë arsye, blerjet e realizuara nga tatimpaguesi B. konstatohet se nuk i shërbejnë aktivitetit të tatueshëm të tij, por tatimpaguesit T. E. duke qenë se referuar modelit të biznesit të paraqitur në raportin e kontrollit tatimor dhe faktit të qënies së tatimpaguesit T. E. si subjekt i prodhimit të mallrave të akcizës (naftës dhe nënprodukteve të saj). Për këtë arsye, është vendosur në dispozicion kontrata e lidhur ndërmjet palëve ku përcaktohen të drejtat dhe detyrimet, tarifa, mallrat, depozitimi etj. Nga analiza e kësaj kontrate dhe marrëdhënies së krijuar ndërmjet tatimpaguesve konstatohet se në çdo rast shoqëria B. energji është përgjegjëse vetëm për procesin e përpunimit, duke qenë se për materialet e para dhe produktet e gatshme është përgjegjëse shoqëria T. E. dhe tarifa e përcaktuar në marrëveshje ndërmjet palëve përfshin çmimin e dakortësuar vetëm për ofrimin e përpunimit me asetet përpunuese dhe angazhimin e punonjësve për procesin e transformimit të lëndëve të para në produkt të gatshëm. Në këtë mënyrë konstatohet se shoqëria B. E. ka përfshirë në blerje të kreditueshme solucione dhe hollues (të cilat ndryshojnë natyrën dhe cilësinë e produktit të gatshëm), që janë materiale të para në procesin e përpunimit të naftës bruto, për të cilat ka kredituar TVSH, në një kohë që subjekt i autorizuar në regjimin e magazinës fiskale për përpunimin e mallrave të akcizës është shoqëria T. E.. Për këtë arsye, blerjet e kryera për solucion dhe hollues nuk i shërbejnë aktivitetit të shoqërisë B. E. por, shoqërisë T. E. dhe rrjedhimisht nuk duhet të ishte kredituar TVSH sipas

tabelave të mëposhtme për periudhën objekt kontrolli duke qenë se edhe përdorimi i tyre nuk është faturuar po ka kaluar në shpenzime:

Shoqëria	Vendi importit	Vlera tatueshme	TVSH	Natyra
C.S. C. Ltd	Zvicër	56,794,550	11,358,910	aditiv, soluc
CS C. LTD	KINE	18,000,370	3,600,074	aditiv, soluc
P. E. SA	Zvicër	10,407,470	2,081,494	aditiv'
H. T. A/S	Danimarke	3,578,245	715,649	katalizator
L. G. CH. Co. Ltd	KINE	3,407,980	681,596	aditiv'
I. LIMITED	Britani e Madhe	2,214,455	442,891	aditiv'
CS C. LTD	ZVICER	71,450,685	14,290,137	aditiv, soluc
H. T. A/S	Danimarke	55,164,690	11,032,938	katalizator
I. LIMITED	Britani e Madhe	7,427,955	1,485,591	aditiv
L. G. CH. Co Ltd	KINE	1,849,805	369,961	soluc
<b>Totali</b>		<b>230,296,205</b>	<b>46,059,241</b>	

Në total vlera prej 46,059 mijë lekë përfaqëson kreditim të padrejtë të TVSH në blerje. Në njëjtën kohë edhe vlera pa TVSH e materialeve nuk duhet të njihet edhe si shpenzim për efekt të tatimit duke qenë se nuk i shërben aktivitetit të shoqërisë dhe duhet të ulë humbjen tatimore të realizuar përgjatë periudhës së cilës i përket.

-Nga auditimi konstatohet se në pasiv të pasqyrës së pozicionit financiar tatimpaguesi ka hua afatshkurtër në shumën 200,557,631 lekë nga tatimpaguesi T. E. dhe nga ana tjetër në pasqyrën e performancës financiare shpenzimet e interesit paraqiten në shumën 410 lekë, duke mos deklaruar shpenzime interesi dhe trajtuar këtë hua me kushte tregu. Për shpenzimet e interesit të llogaritura në lidhje me këtë hua do të pakësohet humbja e realizuar përgjatë periudhës duke qenë se të ardhurat e periudhës nuk kanë mundur të mbulojnë shpenzimet operative të funksionimit të rafinerisë, kryesisht prej shpenzimeve të larta për paga dhe energji elektrike.

**Detyrimi për TVSH-në  $230,296,205 * 20\% = 46,059,241$  lekë**

**Gjobë  $46,059,241 * 0.06\% * 365$  ditë = 10,086,974 lekë.**

**Ulje humbje = 230,296,205 lekë**

**Efkti financiar i shmangur me efekt të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit është në shumën 56,146,215 lekë.**

Në lidhje me konstatimet e mësipërme për tatimpagues B. E., nga ana e subjektit të audituar janë paraqitur observacione duke pretenduar si më poshtë:

-Për qiramarrjen është referuar VKM nr.469 datë 03.06.2015 “Për përcaktimin e vlerës minimale të çmimit të referencave të qirave të ndërtesave për qëllime tatimore”, pikat 1 dhe 2 të saj. ....Si shihet në VKM flitet për dhënien me qira të ndërtesës dhe jo për marrjen me qira të ndërtesës. Pra sipas VKM krahasimi i vlerës së dhënë me qira sipas kontratës së qerasë mes palëve dhe referencave të kësaj VKM kryhet te qeradhënësi i cili ka detyrimin të zbatojë referencat e kësaj VKM. ...Pra në rastin tonë zbatimi i kësaj i kësaj VKM kryhet nga tatimet te shoqëria A. E. dhe jo te shoqëria B. e cila ka një faturë tatimore të cilën e ka të regjistruar te blerjet e përjashtuara, pa ndikim në TVSH e pagueshme të shitjeve të saj.

- mbi kryerjen e analizave për shitjet dhe sasinë e produktit të përpunuar ....Meqenëse të ardhurat e deklaruar nga shoqëria kanë qenë të rregullta nuk është trajtuar në raport kontroll mënyra e llogaritjes së tyre pasi çdo faturë kishte të bashkëlidhur sasinë e naftës së përpunuar të shumëzuar më tarifën përkatëse. Meqenëse grupi i kontrollit tatimor nuk pati probleme lidhur me deklarimin e shitjeve në raport kontrolli shitjet janë konsideruar të rregullta. ...Paraprakisht sqarojmë se grupi i kontrollit tatimor kanë qenë më herët kontroll tatimor në shoqërinë T. E., kontroll i mbyllur më datë 19.12.2019 dhe për rrjedhojë problematikat dhe të kuptuarit e mënyrës së operimit të shoqërive kanë qenë edhe më të qarta. Në kontrollin tatimor të ushtruar në shoqërinë T. E. është kryer bilanci i lëvizjes së lëndës së parë naftë bruto sa ka hyrë në procesin e rafinimit dhe sa nënprodukte kanë dalë nga ky proces. Raport Kontrolli tatimor i shoqërisë T. E. gjendet në sistemin cats dhe inspektorëve të KLSH iu sqarua mënyra e përllogaritjes së të ardhurave të shoqërisë B., faqe 18 e RK. Në vijim janë dhënë llogaritjet bazuar në raportin e T. E. për  $252,213.8 * 4747$  lekë/ton = 1,197,258,908 lekë për vitin 2018 pa diferenca dhe e

*njëta llogaritje është kryer nga grupi i kontrollit dhe për periudhën janar-shtator 2019 dhe nuk ka pasur diferenca në deklaram.*

*-për kreditimin e padrejtë të TVSH-së ...Shoqëria B. për të kryer përpunimin e naftës bruto të cilën e sjell porositi, shoqëria T. E., e cila fut në rafineri vetëm natë bruto dhe vetëm naftë bruto kanë lidhur një kontratë duke vendosur një tarifë përpunimi 53\$/ton të përpunuar. Në këtë tarifë janë përfshirë të gjitha llojet e proceseve të shërbimit të rafinimit por edhe të materialeve që duhen për të realizuar këtë shërbim. Që të kryhet përpunimi i naftës bruto dhe të nxirren nënproduktet e naftës siç janë solar koks naftë virgine, gazoil, sqfur, shoqëria ka kryer blerjet e holluesit aditiv katalizator të cilat i fut në procesin e prodhimit për hollimin e naftës bruto. Përveç këtyre, pjesë përbërëse e shpenzimeve të rafinimit janë energjia elektrike, pagat, etj. Në asnjë pikë të kontratës e cila iu vu në dispozicion inspektorëve të KLSH në formatin elektronik në versionin anglisht pasi dosja fizike nuk ndodhet në arshivën e institucionit tonë nuk thuhet që tarifa e shërbimit nuk përfshin materialet shumë të domosdoshme në procesin e përpunimit të naftës bruto siç janë aditiv dhe katalizator por përfshin vetëm energjinë elektrike dhe punëtorinë. Ky është një qëndrim jo objektiv, një opinion i gabuar duke nxjerrë kështu konkluzione të gabuara dhe duke prodhuar efekte financiare jo reale të munguara në buxhetin e shtetit. Për ta thjeshtuar situatën, duke qenë edhe të njëjtët inspektorë në kontrollin e ushtruar në shoqërinë T. E., nëse këto materiale do të ishin blerë njëkohësisht edhe nga shoqëria T. E. por edhe nga shoqëria B., atëherë do na lindte e drejta të vinim në pikëpyetje faktin që materialet e blera për përpunimin e naftës bruto në rafineri nuk i kanë shërbyer aktivitetit të shoqërisë B. pasi këto materiale i ka futur në rafineri edhe shoqëria T. E.. Për këtë qëllim në vëmendjen tuaj blerjet e realizuara nga shoqëria T. E. për periudhën Maj Dhjetor 2018... ..Pra siç shihet nga pasqyra e blerjeve nga importi dhe brenda vendit, shoqëria T. E. nuk blen hollues, aditiv dhe katalizator që tja japë shoqërisë B. për përpunimin e naftës. Këto janë materiale të domosdoshme në procesin e rafinimit, që shoqëria B. nëpërmjet tarifës së rafinimit ia shet shoqërisë T. E.. Shoqëria B. për blerjet nga importi për aditiv dhe katalizator zotëron deklaratat origjinale të importit dhe faturat e blerjes së mallrave nga importi. Këto blerje nga importi jo vetëm që janë në funksion të veprimtarisë ekonomike të shoqërisë B. por janë nga blerjet më të rëndësishme të kësaj shoqërie, pa të cilat nuk do të mund të kryhej rafinimi i naftës bruto.*

Në përgjigje të këtyre observacioneve sqarojmë se:

-objekt i konstatimit për qeradhënien është trajtimi për makineritë dhe linjën e përpunimit sipas përcaktimeve të bëra në ligjin “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar, ku qiradhënia e aseteve të tjera nga ndërtesa, është furnizim i tatueshëm me TVSH dhe në këtë mënyrë ky transaksion duhet të ishte objekt kontrolli dhe përcaktimi të shumës së TVSH e cila duhet të ishte e pagueshme për një tatimpagues dhe e kreditueshme për tjetrin, por që në total do të paraqiste të ardhura shtesë për buxhetin e shtetit nga TVSH. Për këto arsye observacioni nuk merret në konsideratë.

- për kryerjen e analizave për shitjet dhe sasinë e produktit të prodhuar së bashku me lëvizjen e bilancit material sqarojmë se është pjesë e detyrave të përcaktuara në programin e kontrollit tatimor dhe manualin e kontrollit tatimor të cilat nuk rezultojnë të jenë zbatuar për këtë konstatim. Referimi në raporte të tjera paralele nuk është objekt i konstatimeve mbi këtë tatimpagues sipas kampionit të përcaktuar të auditimit. Për këtë arsye observacioni nuk merret në konsideratë.

- për kreditimin e padrejtë të TVSH-së dhe pretendimit se në kontratën e lidhur ndërmjet palëve “nuk thuhet që tarifa e shërbimit nuk përfshin materialet shumë të domosdoshme në procesin e përpunimit të naftës bruto siç janë aditiv dhe katalizator por përfshin vetëm energjinë elektrike dhe punëtorinë”, sqarojmë se konstatimi nuk është mbështetur në këtë fakt, por në faktin se në kontratë është parashikuar një çmim përpunimi prej 53\$/ton me kushtet që të gjitha materialet e para të nevojshme për procesin e prodhimit sigurohen dhe janë pronë e shoqërisë T. E.. Pra në kontratë nuk thuhet që tarifa e shërbimit nuk përfshin materialet e domosdoshme në procesin e përpunimit, por thuhet që tarifa përfshin operacionet e përpunimit të naftës, ndërsa materialet e para, produktet dhe gjysmë produktet janë në pronësi të T. E. dhe është T. E. që ka detyrimin për furnizimin e tyre drejt procesit të përpunimit, i cili kryhet nga B. E.. Me ndryshimin e kushteve të këtij parashikimi nuk rezultojnë të jenë ndryshuar tarifa përkatëse e përpunimit në kushte të lira tregu për ofrimin e shërbimeve. Në pretendimet me observacione nuk janë paraqitur as reflektim marrëveshje shtesë në çmim të ndryshuar dhe as destinacion i blerjeve për holluesin i cili, ka

trajtim të diferencuar në varësi të kushteve të subjekteve që e përdorin atë për procesin e përpunimit të naftës dhe për më tepër që për ta përdorur si lëndë të parë duhet autorizimi përkatës nga autoritetet doganore në kushtet e regjimit fiskal me mallrat e akcizës. Për këto arsye observacioni nuk merret në konsideratë.

Në takimin ballafaques në KLSH të zhvilluar në datën 19.09.2023, nga ana e inspektorit tatimor u prezantuan argumente në lidhje me të drejtën për kreditimin e TVSH si pasojë e dokumentacionit të rregullt ligjor të konstatuar në subjekt dhe faktin e disponimit nga ana e tatimpaguesit të licensave/autorizimeve përkatëse për ushtrimin e aktivitetit dhe përpunimin e mallrave objekt konstatimi të detyrimeve së bashku me kartën teknologjike përkatëse dhe ato të tatimpaguesit të lidhur me të. Nga ana e përfaqësuesve të subjektit të audituar dhe përfaqësuesve të KLSH u konkludua në lidhje me aspektin procedural të konstatimit për lejet/licensat për ushtrimin e veprimtarisë me qëllim lindjen e të drejtës për të kredituar TVSH për shpenzimet e deklaruara që lidhen me objektin e veprimtarisë të lidhur edhe me autoritetet doganore kompetente. Nga ana tjetër, kjo marrëdhënie e krijuar me palën e lidhur si pasojë e kontratës ndërmjet palëve, reflekton kryerjen e operacioneve për përpunimin që shprehimisht nuk është përcaktuar përdorimi i materialeve, por një gjë e tillë nuk është ndaluar nga ana tjetër në kontratë dhe paralelisht nuk është shoqëruar me ndryshim në tarifën e ofrimit të shërbimit. Në vijim, nga përfaqësuesit e subjektit të audituar janë përcjellë dokumentacion shtesë në lidhje me pretendimet në ballafaqim që përfshijnë ekstraktin nga QKB për tatimpagues B. dhe vendimin për shtimin e objektit të veprimtarisë me përmbajtje “Shoqëria do të operojë si rafineri duke ushtruar aktivitetin e përpunimit të naftës bruto dhe prodhimit të nënprodukteve të saj” si dhe raport administrimi për vitin financiar 2017. Përsa i përket këtij dokumentacioni shtesë sqarojmë se nuk është ai i dakortësuar në takimin ballafaques, për arsye se përfshin objektin e veprimtarisë për blerjet e kredituara por nuk paraqet dokumentacion justifikues për licensimin/autorizimin si dhe kartën teknologjike për ushtrimin e veprimtarisë së përpunimit të produkteve dhe nënprodukteve të naftës nga autoritetet përkatëse.

- **Tatimpagues:** **M. T. SHPK me NIPT J.A** i cili ushtron aktivitetin e përpunimit, prodhimit, shpërndarjes, tregtimit të miellit dhe nënprodukteve të tij, drithërave dhe nënprodukteve të tyre, import eksport i të gjitha llojeve të mallrave industriale, ushqimore, bujqësore, blegtorare dhe minerale.

**Adresë Kryesore:** Bulevardi Teodor Keko, rruga Agim Qarri Tiranë.

**Lloji i Kontrollit:** Rikontroll për TVSH periudha 11/2014-03/2018, për tatim fitimin 2014-2017, sigurimet shoqërore 11/2014-03/2018 dhe të tjera 11/2014-03/2018.

**Inspektori:** E.A.

Ky rikontroll tatimor është filluar në bazë të rekomandimeve të auditimit të mëparshëm të KLSH në lidhje me parregullsitë e konstatuara dhe për këtë arsye me njoftim nr. 6675/1 datë 02.09.2022 bashkëlidhur me programin e kontrollit është ushtruar kontrolli tatimor. Formulari nr. 3 është miratuar nga përgjegjës S.M., drejtor kontrolli O.C. dhe Drejtor Rajonal E.C..

Nga auditimi konstatohet se nga ana e inspektorit tatimor është kryer një analizë e hollësishme në lidhje me inventarët sipas periudhave dhe krahasimit të kostos së ponderuar me çmimin mesatar të shitjes së aplikuar nga ana e tatimpaguesit periudhë pas periudhës objekt kontrolli.

Për këtë praktikë kontrolli, nuk është kryer inventarizim fizik në datën e kontrollit, por inspektori tatimor është bazuar në procesverbalin e mbajtur në 01.08.2018 nga kontrolli tatimor i mëparshëm i ushtruar.

Konstatohet se është kryer analiza e blerjeve dhe shitjeve sipas periudhave të kontrolluara duke i ndarë në të kreditueshme dhe të pa kreditueshme.

Është kryer analiza e kreditimit të karburantit në raport kontrolli brenda normativave të lejueshmërisë së kreditimit të tij në raport me qarkullimin e realizuar.

Është kryer analiza për efekt të tatim fitimit sipas deklaratave të dorëzuara dhe pasqyrave financiare të dorëzuara.

- **Tatimpagues: B. SHPK me NIPT K.A** i cili ushtron aktivitetin në fushën minerare sipas ligjit nr. 8761 datë 02.04.2001 “Për miratimin e marrëveshjes koncensionare” dhe ligjit nr. 73/2017 datë 27.04.2017 “Për miratimin e shtesës së marrëveshjes koncensionare deri në vitin 2043, për nxjerrjen kryesisht të mineralit të bakrit sipas lejeve të shfrytëzimit në objekte të ndryshme.”

**Adresë Kryesore:** Rruga Papa Gjon Pali II, ABA Business Centre, Kati 13, Tiranë.

**Lloji i Kontrollit:** Kontroll për tatim fitimin për vitet 2019-2020, kontroll për kontributet për periudhën Shtator 2019-Dhjetor 2020 sipas njoftimit fillestar të kontrollit tatimor dhe shtesë kontrolli për rimbursimin e kërkuar të TVSH për periudhën Shtator 2021-Tetor 2021.

**Inspektori:** V. M.

Tatimpaguesi është njoftuar për kontroll tatimor me nr. 10938/2 datë 27.01.2022. Programi i kontrollit është miratuar nga përgjegjësi i sektorit E.M. dhe Drejtori i Drejtorisë së Kontrollit M.R. për 160 orë punë dhe raporti i kontrollit është hartuar në datë 16.06.2022.

Formulari nr. 3 është miratuar nga përgjegjës E.M., drejtor kontrolli O.C. dhe Drejtor Rajonal E.C..

Sipas raportit të kontrollit tatimor, tatimpaguesi operon me një marrëveshje koncesioni 42 vjeçare të dhënë nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (aktualisht Ministria e Energjisë dhe Industrisë) e Republikës së Shqipërisë, e cila fillimisht ka qenë një marrëveshje koncesioni për 30 vite. Marrëveshja përfshin minierën e bakrit Munellë, minierën e bakrit Lakrosh dhe uzina e pasurimit në Fushë Arrëz. Veprimtaria kryesore e Shoqërisë është të zhvillojë, ndërtojë dhe modernizojë industrinë e minierave në Shqipëri, të kryejë studime dhe eksplorime gjeologjike dhe minerale, për të kryer importimin dhe eksportimin e mineraleve. Kontrolli është planifikuar për tatim fitimin duke qenë se tatimpaguesi është subjekt eksportues dhe si i tillë është objekt i kontrollit në mënyrë të vazhdueshme për efekt të rimbursimit të TVSH-së.

-Nga ana e inspektorit tatimor është kryer kontrolli për tatim fitimin sipas pasqyrave financiare të dorëzuara dhe në vijim janë kryer rakordimet edhe me librat e deklaratat për qarkullimin dhe blerjet e kryera nga shoqëria.

-Janë analizuar llogaritë e pasqyrës së pozicionit financiar dhe llogaritë e pasqyrës së performancës financiare. Ndër zërat kryesorë të audituar janë përfshirë llogaritë e zhvlerësimeve dhe amortizimeve të llogaritura duke qenë se blerjet kryesore shoqëria i ka nga proceset e nënkontraktuara të nxjerrjes së mineralit nga furnitorë palë të treta. Për pjesën e zhvlerësimeve të aseteve dhe të inventarëve apo rimarrjeve të tyre konstatohet se janë përfshirë në shpenzime të panjohura dhe në të ardhura të pa tatueshme respektivisht sipas periudhës objekt kontrolli.

-Nga auditimi konstatohet se në raport kontrolli nuk është marrë siguri nga ana e inspektorit në lidhje me sasinë e inventarit të nxjerrë dhe të përpunuar sipas procesit të përpunimit. Nuk është kryer një analizë sipas kartës teknologjike, pasi sipas shpjegimeve të dhëna nga ana e inspektorit tatimor, kjo kartë teknologjike rezulton e pa miratuar për subjektin dhe nuk është paraqitur duke qenë jo në përputhje me përcaktimet e bëra në pikën 7 të VKM nr. 434 datë 20.05.2015 “Për përcaktimin e normativave për frot, humbjet, dëmtimet dhe skarcot gjatë prodhimit, magazinimit, transportimit, etj të njohura për qëllime fiskale”.

-Nga auditimi konstatohet se nuk është kryer inventari fizik dhe bilanci material për harxhimin e lëndëve të para dhe ato ndihmëse sipas detyrave të përcaktuara në programin e kontrollit të miratuar si dhe Manualin e Kontrollit Tatimor.



-Përsa i përket pjesës së raportit të kontrollit që përfshin analizën e rimbursimit të TVSH të kërkuar nga tatimpaguesi konstatohet se tatimpaguesi plotëson kushtet për përfitimin e rimbursimit duke qenë se operon për eksport dhe teprica e kreditueshme lind nga blerjet brenda vendit me TVSH apo importet me TVSH në funksion të realizimit të shitjeve jashtë vendit në formën e eksporteve.

Në lidhje me konstatimet e mësipërme për tatimpagues B., nga ana e subjektit të audituar janë paraqitur observacione duke pretenduar si më poshtë:

*-Është shpjeguar procesi i prodhimit dhe marrëdhënia me nënkontraktoret dhe fakti se shoqëria eksporton mineralin, është kryer inspektimi nga një grup i përbashkët pune midis MIE dhe AKBN për investimet e tatimpaguesit dhe zgjatjen e afatit të koncesionarit; janë paraqitur proceset e përpunimit të mineralit etj.*

*-Lëvizja e materialeve dhe prodhimit është bërë në analizën e TVSH-së kur shoqëria kontrollohet për TVSH-në bëhet lëvizja e inventarit të materjaleve dhe prodhimi. Dhe në rastin konkret për pjesën e analizës së TVSH-së për periudhën 01.09.2021-31.10.2021 në faqen 55-56 të raportit. Ndërsa në analizën e tatim fitimit është analizuar në faqet 8,14-15,27,34-35 të raportit kontrollit.*

Në përgjigje të këtyre observacioneve sqarohet se nuk janë paraqitur argumenta shtesë mbi mos kryerjen e bilancit material, pjesë e detyrave të programit të kontrollit dhe kërkesave të manualit të kontrollit tatimor si dhe në raport kontrolli nuk rezultojnë të jenë trajtuar konfirmimet nga AKBN sipas kartës teknologjike në prodhim dhe përpunim. Për këto arsye observacioni nuk merret në konsideratë.

Nga Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj me shkresë nr. 52/28 datë 11.09.2023 protokolluar në KLSH me nr. 14/11 datë 12.09.2023 janë paraqitur observacione mbi Projekt Raportin e Auditimit. Në përmbajtje të këtyre observacioneve, për këtë tatimpagues konstatohet se janë paraqitur të njëjtat observacione si në fazën e akt konstatimeve të pasqyruara dhe trajtuara si më sipër, për këtë arsye këto observacione nuk merren në konsideratë.

**-Tatimpagues: “AD.P. C.” SHPK me NIPT K.T** e cila ushtron ne fushën e tregimit te kafes, sheqer, import-eksport i tyre, bar kafe, tregti me shumicë dhe pakicë të artikujve të ndryshëm ushqimorë, industrialë, bujqësor, blegtoral, tregti të makinerive të ndryshme industriale, dhënia me qera e ambienteve të ndryshëm, restorant, dhënie dhe marrje me qera të aktiveve, prodhim dhe tregtim të artikujve të ndryshëm ushqimorë, ushtrim i transportit për llogari të vet apo të të tretëve.

**Adresë Kryesore:** Durrës, Rruga “Asti Gogoli”, Lagjja nr.14

**Lloji i Kontrollit:** Kontroll për TVSH për periudhën Janar 2016-Shkurt 2021, kontroll i tatim fitimit për vitin 2015-2019, kontroll për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore Janar 2016-Shkurt 2021, të tjera Janar 2016-Shkurt 2021.

**Inspektori:** E.K.

Subjekti është njoftuar për kontroll tatimor me nr. 2593/2 datë 29.04.2021. Programi i kontrollit është miratuar nga përgjegjësi i sektorit E.M. dhe Drejtori i Drejtorisë së Kontrollit M.R. për 256 orë punë dhe raporti i kontrollit është hartuar në datë 15.11.2021.

Formulari nr.3 është miratuar nga përgjegjësi E.M., drejtor kontrolli M.R. dhe Drejtor Rajonal I.A..

-Nga auditimi konstatohet se është kryer analiza e shitjeve dhe blerjeve për periudhën objekt kontrolli në mënyrë të detajuar për efekt të TVSH si dhe janë kryer kontrollet në lidhje me deklaratimet e pasqyrave financiare dhe deklaratave të tatim fitimit.

-Janë kryer analizat në lidhje me krahasimin e çmimit të shitjes dhe koston së mallrave për artikujt e marrë për kontroll si dhe është kryer bilanci material në lidhje me gjendjet sipas periudhave dhe lëvizjet e materialeve. Konstatohet se analiza është kryer duke u bazuar në të dhëna të mesatarizuara duke mos arritur siguri në lidhje me rastet e shitjes së mallrave nën kosto,

megjithëse sipas të dhënave të paraqitura vlera e marzhit bruto të realizuar nga shoqëria rezulton në vlera të larta për sektorin e distributorit kryesor, në nivelet 22-53%. Në raport kontrolli nuk është pasqyruar analiza e çmimeve të aplikuara të diferencuara për shumicë dhe pakicë, por kjo analizë është vendosur në dispozicion pas kërkesës për informacion.

-Janë analizuar shpenzimet e deklaruara dhe në raport me deklarimet për shpenzimet e panjohura për efekt të kërkesave të legjislacionit për tatimin mbi fitimin.

-Është kryer analiza e rakordimit të importeve me doganën duke qenë se shumicën e blerjeve të periudhës shoqëria e ka nga importet e mallrave ku importon kafen nga distributorë të huaj.

-Nga auditimi konstatohet se në lidhje me blerjet nga importi të investimeve është përfshirë vlera e aktiveve që shoqëria i blen për t'ua vendosur në dispozicion tatimpaguesve, drejt të cilëve kryen shitjet me shumicë dhe që marrin në përdorim ekspreset së bashku me blerjet e mallit kryesor kafes. Në lidhje me këto aktive të dhëna në përdorim, në raport kontrolli nuk rezulton të jetë kryer një analizë në lidhje me plotësimin ose jo të kushteve sipas Neni 18, pika 1, germa i te udhëzimit nr.6, date 30.01.2015 "Për Tatimin mbi vlerën e Shtuar" ku shprehet se "*Në rast se klienti, të cili i është dhënë në përdorim aktivi nga furnizuesi i tij, paguan të njëjtin çmim si edhe një klient, i cili thjesht blen mallra pa marrë në përdorim aktive të kësaj natyre, atëherë nuk llogaritet TVSH mbi dhënie në përdorim të aktiveve*". Pas kërkesës për informacion nga ana e inspektorit tatimor është sqaruar se tatimpaguesi për të gjithë klientët disponon kontrata për lënien në përdorim të këtyre ekspresëve si dhe çdo të dhënë tjetër të klientit, pika të kontratës siç janë çmimi, sasia etj.

- **Tatimpagues:** "A.G.T. SHA" *me Nipt* L.C i cili ushtron veprimtarinë në fushën e tregtimit me shumicë të lëndëve djegëse, të ngurta, të lëngta ose të gazta dhe produkteve lidhur me to.

**Adresë Kryesore:** Fshati Pjeze, Xhafzotaj, Durrës..

**Lloji i Kontrollit:** Kontroll për TVSH për periudhën Shkurt 2020-Maj 2022, kontroll i tatimit fitimit për vitin 2019-2021, kontroll për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore Shkurt 2020-Maj 2022, të tjera Shkurt 2020-Maj 2022.

**Inspektori:** G.J dhe O.B.

Subjekti është njoftuar për kontroll tatimor me nr. 2556/1 datë 30.05.2022. Programi i kontrollit është miratuar nga përgjegjësi i sektorit A.T. dhe nga Drejtori i Drejtorisë së Kontrollit O.C. për 256 orë punë dhe raporti i kontrollit është hartuar në datë 07.11.2022.

Formulari nr.3 është miratuar nga përgjegjës A.D., drejtori i kontrollit O.C. dhe miratuar nga Drejtor Rajonal E.C..

-Nga auditimi konstatohet se nga ana e inspektorëve tatimorë është kryer analiza e blerjeve dhe shitjeve e detajuar sipas deklaratave të dorëzuara duke i kategorizuar sipas natyrës së blerjes.

-Për periudhën objekt kontrolli nuk rezulton të jetë kryer inventarizimi fizik i mallrave të tatimpaguesit dhe dokumentimi me procesverbalin përkatës.

- Nga auditimi konstatohet se është kryer analiza e bilancit material në lidhje me sasi të mallit kryesor që tregton tatimpaguesi.

-Në raportin e kontrollit rezulton të jetë kryer analiza e marzhit të realizuar nga tatimpaguesi por duke mesatarizuar vlerat e çmimeve të shitjes dhe blerjes për çdo muaj, duke mos kryer testim në lidhje me mundësinë e shitjes nën koston e mallrave.

-Nga ana e inspektorëve tatimorë nuk rezulton të jetë kryer një analizë në lidhje me çmimin e aplikuar në shitje nga ana e tatimpaguesit përse i përket diferencimit ndërmjet shitjeve për gazin për automjete dhe gazin për konsum familjar të cilat paraqesin çmime të ndryshme në shitje për shkak të akcizës që aplikohet në gazin e përdorur për automjete. Ky konstatim bazohet në faktin

se një pjesë e klientëve të analizuar në raport kontrolli drejt të cilëve është shitur malli përfaqësojnë subjekte të tregtimit të naftës, benzinës, gazit në pikat e shitjes me shumice/pakicë.

- Nga ana e inspektorëve tatimorë konstatohet se nuk është kryer një analizë në lidhje me aktivitet e dhëna në përdorim të tretëve për stimulimin e shitjeve dhe çmimin e aplikuar në rastin e stimulimit të këtyre shitjeve sipas kërkesave të legjislacionit të TVSH-së.

- Në analizën e kryer nga ana e inspektorëve tatimorë në lidhje me tatim fitimin dhe pasqyrat financiare konstatohet është bërë detajimit i të ardhurave dhe shpenzimeve dhe janë rakorduar edhe me deklaratimet e fdp-ve.

-Nga auditimi konstatohet se nuk është kryer një analizë në lidhje me marrëdhëniet e huasë të dhëna apo të marra me tatimpagues të tjerë duke qenë se objekti i veprimtarisë së shoqërisë nuk është huadhënia si dhe në rastin e huadhënies ajo nuk është orientuar drejt institucioneve të licensuara për të ushtruar këtë aktivitet në Republikën e Shqipërisë. Nuk rezulton të jetë kryer një analizë në lidhje me kushtet e huadhënies dhe thelbin ekonomik të tyre si dhe llogaritjen e interesave sipas rastit për tepricat e tyre të raportuara në pasqyrën e pozicionit financiar.

Në lidhje me konstatimet e mësipërme për tatimpagues A.G.T, nga ana e subjektit të audituar janë paraqitur observacione duke pretenduar si më poshtë:

*-përsa i përket analizës së çmimit të diferencuar .....paraqitja në raport e detajuar shkakton një zgjatje informacioni pa dhënë konkretisht thelbin e paraqitur në tabelën përkatëse të marzhit. Nga ana e kontrollit me zgjedhje i janë kërkuar subjektit përkatës me email kartelat e llogarive të klientëve. Secila nga këto kartela klientësh është analizuar në detaje sa i përket çmimit të shitjes së mallit në krahasim me kostot e blerjes. Në raport është përfshirë për totalin dhe llogaritja e marzhit duke marrë parasysht edhe shpenzimet e tjera përveç kostos së mallit. ...Në raport, analiza specifike sipas klientëve nuk është paraqitur pasi shkakton tej zgjatje në informacion i cili dhe nga viti në vit është pothuajse i njëjtte. Por analiza sipas kartelave për shitje nën kosto është kryer. Gjithashtu për tu bindur dhe për saktësinë e hedhjes së të dhënave në sistemin kontabël të përdorur nga ana e shoqërisë fillimisht është kryer kontrolli me zgjedhje për faturat e shitjeve dhe të blerjeve. Zgjedhja ka qenë rastësore dhe është kontrolluar çmimi sasia furnitori për blerjet dhe njëkohësisht çmimi sasia dhe klient te shitjet.*

*-për aktivitet e dhëna në përdorim .... subjekti në vijim të kryerjes së aktivitetit ka shpërndarë ngrohëset me qëllim përfitimin e të ardhurave nëpërmjet blerjes së gazit. Nuk ka qenë e mundur ndjekja e përfitimeve që vijnë drejtpërdrejtë vetëm nga ana e këtyre aktiveve pasi është e pamundur ta masësh duke qenë se gazi i blerë nuk mund të lidhet gjithmonë me përdorimin e tyre dhe mund të përdoret dhe për qëllime të tjera nga ana e subjekteve blerëse. Duke qenë se nuk ka marrëveshje që ti sigurojë përfitimet e ardhshme të sigurta, të atribuara totalisht këtyre aktiveve jemi në kushtet kur një analizë e tillë nuk mund të kryhet drejtpërdrejtë por është përfshirë në analizën e kosto çmimit për gazin.*

*-sa i përket marrëveshjeve të huave, pavarësisht se subjekti nuk e ka në objektin e aktivitetit, nuk do të thotë se qëllimi i huadhënies ka qenë përfitimi ekonomik. Gjatë veprimtarisë në bazë të të dhënave të administruara nga ana e subjektit për të ruajtur marrëdhëniet tregtare apo për të mbështetur klientë potencialë të ardhshëm apo partnerë të ardhshëm në biznes është përdorur dhe huadhënia. Në bazë të raportit hua të marra/hua të dhëna është kryer dhe penalizimi për këto shpenzime interesi të deklaruara por pa i krahasuar me të ardhurat përkatëse që duhet të realizonte. Kryesisht këto marrëdhënie kanë lindur gjatë periudhës së pandemisë. Për arsye të mungesës së fondeve të nevojshme si për likuidimin e furnitorëve dhe pagesa të tjera. Megjithatë në respekt të ligjit janë konsideruar shpenzime të pa njohura ato për interesa duke përllogaritur raportin....*

*-Në lidhje me çmimin e shitjes së gazit ...Shoqëria gazin e blen totalisht nga furnitorët vendas dhe në faturat e blerjes nuk detajoheshin çmimet e blerjes në blerje, e për pasojë nuk mundet që të përcaktohet dhe në shitje çmimet janë kontraktuale sipas destinacion të tyre, ata evidentohen të shitësi fundor sipas rastit për ngrohej apo auto. Në raportin e kontrollit analiza është bërë sipas çmimit mesatar të realizuar faktike duke marrë në analizë klientë me përzgjedhje.*

*-Për inventarizimin fizik ky i fundit nuk është kryer pasi periudha e programuar për kontroll nuk përkon me datën kur inspektorët janë paraqitur në objekt. Në rastin konkret kontrolli ka filluar më datë 16.06.2022 ndërsa periudha e programuar është 22/05.*

Në përgjigje të observacione të mësipërme sqarojmë se:

- Për analizën e marzheve nuk janë paraqitur evidenca gjatë auditimit në lidhje me testimet e kryera dhe për këtë arsye observacioni nuk merret në konsideratë.

-Për dhënien në përdorim të aktiveve, nuk është pasqyruar në raport kontrolli analiza me çmimin e aplikuar në rastin e marrëveshjeve kontraktuale me krahasimin me çmimin normal të aplikuar, sipas përcaktimeve në udhëzimin për TVSH, për këtë arsye observacioni nuk merret në konsideratë.

-për konstatimin për huadhënien, në observacione është pohuar konstatimi i natyrës tregtare apo përfitimi i klientëve/partneriteteve, duke mos sjellë argumenta shtesë dhe për këto arsye observacioni nuk merret në konsideratë.

-në lidhje me çmimin e diferencuar të gazit, në observacion është pranuar konstatimi duke transferuar mbartjen e problemit që në blerje, për këto arsye nuk merret në konsideratë për aq kohë sa analiza mbi çmimet e diferencuara nuk është kryer dhe për shitjet është përdorur i njëjti çmim.

-Për mos kryerjen e inventarizimit, pretendimi se nuk përkon periudha kontrolluar me kohën e kryerjes së kontrollit nuk qëndron pasi praktika aktuale e kontrollit tatimor mundëson inventarizimin fizik dhe krahasimin në retrospektivë me gjendjen e raportuar kontabël, për këto arsye nuk merret në konsideratë.

Nga Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj me shkresë nr. 52/28 datë 11.09.2023 protokolluar në KLSH me nr. 14/11 datë 12.09.2023 janë paraqitur observacione mbi Projekt Raportin e Auditimit. Në përmbajtje të këtyre observacioneve, për këtë tatimpagues konstatohet se janë paraqitur të njëjtat observacione si në fazën e akt konstatimeve të pasqyruara dhe trajtuara si më sipër, për këtë arsye këto observacione nuk merren në konsideratë.

- **Tatimpagues: A. SHPK me NIPT J.Q** e cila ushtron në fushën e ndërtimeve të të gjitha llojeve, rruge, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, ujësjellës e kanalizime, tregtim artikuj industriale, prodhim e tregtim te materialeve te ndërtimit dhe lendeve drusore, shfrytëzim, prodhim e tregtim te mineraleve, shpime nëntokësore dhe prodhim betoni.

**Adresë Kryesore:** Rruga Sulejman Delvina, Pallati Fati, shk.1, Ap.19, Tirane.

**Lloji i Kontrollit:** Kontroll për TVSH për periudhën Tetor 2019 – Dhjetor 2021, kontroll i tatim fitimit për vitin 2019-2020, kontroll për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore Tetor 2019 – Dhjetor 2021, të tjera Tetor 2019 – Dhjetor 2021.

**Inspektori:** F.S. dhe inxhinier ndërtimi I.K.

Subjekti është njoftuar për kontroll tatimor me nr. 326/2 datë 31.01.2022. Programi i kontrollit është miratuar nga përgjegjësi i sektorit A.D. dhe Drejtori i Drejtorisë së Kontrollit M.R. për 200 orë punë dhe raporti i kontrollit është hartuar në datë 23.03.2022.

Formulari është miratuar nga përgjegjës A.D., drejtor kontrolli M.R. dhe Drejtor Rajonal D.I.

-Në lidhje me këtë praktikë kontrolli konstatohet se akt konstatimi i mbajtur nga inxhinieri i ndërtimit, pjesë e dosjes fizike të paraqitur në grupin e auditimit nuk është pjesë e dokumenteve të hedhura në sistemin cats për kontrollin e realizuar në kundërshtim me parashikimet e bëra në manualin e kontrollit tatimor.

-Nga ana e inspektorit tatimor janë analizuar blerjet dhe shitjet e tatueshme të realizuara nga ana e tatimpaguesit duke i ndarë ato sipas natyrës. Gjithashtu është kryer bilanci material për mallrat kryesore sipas lëvizjes së tyre dhe duke u mbështetur në akt konstatimin e mbajtur nga inxhinieri.

-Nga analiza e kryer për inventarin e paraqitur sipas pasqyrave financiare të raportuara dhe të analizuara në raport kontrolli konstatohet se është paraqitur llogaria analitike e inventarit të imët e cila paraqitet me një tepriçë negative në shumën (-6,392,655) për vitin 2020, duke mos u analizuar nga inspektori në lidhje me vërtetësinë e gjendjes negative të llogarive të inventarit si

dhe efektet që ajo paraqet në rakordimin e kryer me fdp dhe koston e mallrave të shitura si pasojë e ndryshimit të gjendjeve.

-Është kryer analiza e kreditimit të naftës si një nga elementët kryesore të blerjeve të tatueshme të realizuara nga ana tatimpaguesi për aktivitetin e shtrimit të rrugëve.

-Në raport kontrolli, sipas analizës së blerjes së tatueshme brenda vendit është paraqitur shuma 905 milion lekë, e njëjtë me raportimin edhe në totalin e fdp përkatëse, por nga shuma aritmetike e blerjeve të analizuara konstatohet se ajo është 910 milion lekë.

-Nga auditimi konstatohet se janë paraqitur situacione si shitje të tatueshme drejt vetë tatimpaguesit në pjesën e parë të analizës së kryer nga kontrolli. Sipas shpjegimeve dhëna nga ana e inspektorit tatimor kjo mënyrë faturimi dhe deklarimi është kryer nga tatimpaguesi për ato raste kur ka kryer punime të evidentuara me situacione përkatëse të cilat ende nuk janë marrë në dorëzim nga ana e përfituesit të punimeve të ndërtimit. Më pas, pas marrjes në dorëzim dhe kolaudit të punimeve është kryer anulimi i faturës paraardhëse të shitjes dhe faturimi drejt përfituesit të punimeve të ndërtimit në të njëjtën vlerë. Kjo praktikë nuk është në përputhje me parashikimet e bëra në udhëzimin për TVSH, neni 20, ku përcaktohet që faturimi duhet të kryhet çdo muaj drejt përfituesve të shërbimit. Sipas shpjegimeve të dhëna nga ana e inspektorit konstatohet se për efekt të tatim fitimit këto faturime janë raportuar në të ardhurat e periudhës dhe jo si parapagime.

- Nga auditimi konstatohet se për vitin 2020, në analizën e kryer për efekt të tatim fitimit janë kryer rakordimet për të ardhurat për efekt të tatim fitimit me qarkullimin e raportuar për efekt të TVSH-së. Në këtë rakordim është ulur vlera e të ardhurave për efekt të tatim fitimit si pasojë e zbritjes së të ardhurave të shtyra të arkëtuara gjatë periudhës duke zvogëluar të ardhurën e tatueshme. Nga analiza e shënimeve shpjeguese në të ardhurat e shtyra konstatohet se në këtë llogari, shuma prej 282,211,471 lekë i përket arkëtimeve të marra po nga A., pra nga vetë tatimpaguesi për punimet e kryera të cilat nuk janë marrë në dorëzim. Ky veprim duhet të pasqyrohet në zërin e bilancit klientë pasi janë punime të kryera drejt të tretëve dhe nuk duhet të trajtohet si autofaturim. Referuar gjendjes së raportuar të kësaj llogarie dhe faktit që është e pamundur që tatimpaguesi të faturojë dhe arkëtojë po nga vetja për punime konstatohet se është zvogëluar padrejtësisht e ardhura e tatueshme për efekt të tatimit mbi fitimin për vitin 2020 duke sjell një efekt si më poshtë:

***Detyrimi për Tatim Fitimin  $282,211,471 * 15\% = 42,316,721$  lekë***

***Gjobë  $42,316,721 * 0.06\% \times 365$  ditë = 9,267,362 lekë.***

***Efkti financiar i shmangur me efekt të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit është në shumën 51,584,082 lekë.***

-Nga auditimi konstatohet se gjatë vitit 2020 aktivet e tatimpaguesit janë shtuar si pasojë e bashkimit me përthithje me një shoqëri tjetër. Nga ana e inspektorit tatimor nuk rezulton të jetë analizuar procesi i bashkimit me përthithje në kuadër të transferimit drejt tatimpaguesit të të drejtave dhe detyrimeve që mbart subjekti i përthithur në bazë të parashikimeve të bëra në legjislacionin e TVSH në rastin e përthithjeve.

-Nga ana e inspektorit tatimor nuk rezulton të jetë analizuar procesi i prodhimit të betonit dhe respektimi i kartës teknologjike në lidhje me sasi të përdorura të materialeve për prodhimin e tij dhe lëvizjet e këtyre materialeve, sipas vlerave të paraqitura në akt konstatimin e mbajtur nga ana e inxhinierit.

Në lidhje me konstatimet e mësipërme për tatimpagues A., nga ana e subjektit të audituar janë paraqitur observacione duke pretenduar si më poshtë:

-Në lidhje me inventarin "...Vlera e inventarit ne total është e pandryshueshme 24,542,551 leke. Përshkrimi Brenda grupit është bere gabim ku (11,962,372-6,392,655) rezulton 5,569,717 e ndare ne

stoku i materialeve ndihmese ne shumen 2,371,516 leke inventar i imët ne shumen 3,198,201 leke. Kjo është e sistemuar ne bilancin e vitit 2021“.

-Vlera prej 910 milion e trajtuar më lart është thjesht një lapsus në përpunimin dhe trajtimin e të dhënave në tabelën e dërguar.

- në lidhje me detyrimin për tatim fitimin të llogaritur të ardhura të munguara “...kjo vlerë është evidentuar në detyrimet e shoqërisë (pasiv të bilancit). Vlera prej 282,211,471 lekë është parapagim për punime për tu kryer për objektin Ndërtim rruga Qukës-Qafë Pllocë. Pra vlera prej 282,211,471 lekë nuk përfaqëson të ardhura për efekt të llogaritjes së tatim fitimit pasi nuk janë punime të kryera. Kjo vlerë është deklaruar për efekt të pagesës së TVSH-së. Nga ana e shoqërisë vlera 282,211,471 lekë është e evidentuar në pasiv të bilancit (rimerret në periudhat e ardhshme tatimore, në momentin e kryerjes së punimeve. .. Aktualisht, në fund të vitit 2022 kjo llogari paraqitet në vlerën 187,155,411 lekë, për rrjedhojë shoqëria ka rimarrë në të ardhura të tatueshme një pjesë të vlerës së mësipërme duke paguar në këtë mënyrë dhe detyrimet përkatëse përsa i përket tatim fitimit. Në raport kontrolli është ruajtur edhe krahasimi i të ardhurave të pasqyruara në bilanc dhe atyre të paraqitura në fdp e TVSH.

**Totali i te ardhurave te paraqitura ne bilanc 1,264,519,239 leke**

**Totali i te ardhurave te paraqitura ne FDP e TVSH-se 1,466,823,370 leke**

**Diferenca -202,304,131 leke**

Diferenca prej 202,304,131 leke është e sqaruar si me poshtë:

<b>Përshkrimi</b>	<b>shuma</b>
Qarkullimi i tatueshem	1,466,823,370
Shtohen te ardhurat e rimarra nga vitet e mëparshme	151,185,017
Shtohet efekti i kurseve te këmbimit te përfshira ne zërin “Te ardhura te tjera te shfrytëzimit”	-15,625,022
Zbriten te ardhurat e shtyra për vitin 2020	-314,122,296
Zbriten vlera kontabël e AAM-ve te shitura përfshire ne zërin “Te ardhura te tjera te shfrytëzimit”	-23,741,830
<b>Shuma e qarkullimit e korrektuar</b>	<b>1,264,519,239</b>
<b>Sipas kontabilitetit</b>	<b>1,264,519,239</b>
<b>Diferenca</b>	<b>0</b>

Referuar të dhënave të mësipërme nuk rezultojnë diferenca ndërmjet të ardhurave të paraqitura në bilanc dhe të ardhurave të paraqitura në fdp e TVSH-së.

-Në lidhje me shtesën në vitin 2020 të aktiveve të tatimpaguesit si pasojë e bashkimit me përthithje sqarojmë se përthithja e shoqërisë Emuliv është bërë bazuar në vendimin e ortakëve. ..Theksojmë se kjo shoqëri nuk ka pasur aktivitet për disa vite.

-Në lidhje me sasi të e përdorura të materialeve sqarojmë se zberthimi i bazës materiale është bërë në përputhje me specifikimet teknike të projektit dhe formulat përkatëse për çdo produkt që përdoret. Brenda specifikimeve teknike ndërtohen formulat për prodhimin e markave të caktuara ku kjo formulë përcaktohet nga laboratorit dhe miratohet nga supervizori, e njëjta gjë përdoret dhe për asfaltet. Në raport kontrolli është trajtuar lëvizja e bazës materiale me zberthimet e bëra në akt konstatimin e inxhinierit janë bërë rivlerësimet tatimore përkatëse duke llogaritur detyrimet tatimore përkatëse.

Në përgjigje të observacioneve të mësipërme sqarojmë:

-në lidhje me inventarin negativ, sistemimi i konstatimit në vitin 2021 pohon konstatimin e grupit të audimit dhe për këtë arsye observacioni nuk merret në konsideratë.

-në lidhje me diferencën e paraqitur si lapsus pranohet observacioni.

-në lidhje me detyrimin për tatim fitimi, në observacione pretendohet se të ardhurat e papërfituara janë për projektin e rrugës Qukës Qafë Pllocë, që sipas përshkrimit në raport kontrolli shoqëria është pjesëmarrës në formën e partneritetit në një entitet të pavarur A. dhe S. (joint venture).

Në vitin 2020, sipas shënimeve shpjeguese, rezulton se për vlerën 282,211,471 lekë tatimpaguesi ka njohur të ardhura të shtyra për parapagime të kryera po nga vetë ky tatimpagues “A. SHPK”, dhe jo nga “A. dhe S. shoqëri e thjeshtë”, që është shoqëria që implementon projektin Qukës Qafë Pllocë. Për këto arsye, observacioni nuk merret në konsideratë.

-në lidhje me bashkimin me përthithje, nuk janë paraqitur argumente shtesë për kontrollin e efekteve të tij në deklaratat e TVSH dhe nuk merret në konsideratë observacioni.

-në lidhje me mungesën e analizës së kartës teknologjike të prodhimit të betonit e produkteve të tjera nuk janë paraqitur argumenta shtesë për mos kryerjen e tij në raport kontrolli si pjesë e detyrave të programit të kontrollit dhe manualit të kontrollit tatimor dhe për këtë arsye nuk merret në konsideratë.

Nga Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj me shkresë nr. 52/28 datë 11.09.2023 protokolluar në KLSH me nr. 14/11 datë 12.09.2023 janë paraqitur observacione mbi Projekt Raportin e Auditimit. Në përmbajtje të këtyre observacioneve, për këtë tatimpagues konstatohet se janë paraqitur të njëjtat observacione si në fazën e akt konstatimeve të pasqyruara dhe trajtuara si më sipër, për këtë arsye këto observacione nuk merren në konsideratë.

Në takimin ballafaques në KLSH të zhvilluar në datën 19.09.2023, nga ana e inspektorit tatimor u prezantuan argumenta në lidhje me trajtimin e arkëtimeve në avancë dhe nga ana e grupit të auditimit u pasqyrua efekti i arkëtimeve në avancë nga vetë tatimpaguesi nëpërmjet paraqitjes të të pranishmëve në takim të shënimeve shpjeguese sipas pasqyrave financiare të publikuara për periudhën objekt auditimi.

**-Tatimpagues:** “A.” SHPK me NIPT J.K e cila ushtron veprimtarinë në fushën e ndërtimeve civile si rruge, autostrada, diga e tunele, ujësjellësi e gazsjellëse, nënstacione e kabina, linja te tensionit te larte e te mesëm, punime te inxhinierisë se mjedisit, punime prishje ndërtimesh, prodhim dhe tregtim i materialeve te ndryshme inerte, punime gërmimi, sistemimi e tarracimi, rikonstrukcione të të gjitha llojeve, etj.

**Adresë Kryesore:** Rruga Urani Pano, Ap. C-07, kati gjashte, hyrja 10.

**Lloji i Kontrollit:** Kontroll për TVSH për periudhën Mars 2016-Gusht 2020, kontroll i tatim fitimit për vitin 2016-2019, kontroll për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore Mars 2016-Gusht 2020, të tjera Mars 2016-Gusht 2020.

**Inspektori:** A.H. dhe inxhinier ndërtimi I.K.

Subjekti është njoftuar për kontroll tatimor me nr. 8007/2 datë 29.10.2020. Programi i kontrollit është miratuar nga përgjegjësi i sektorit A.C dhe i pa firmosur nga Drejtori i Drejtorisë së Kontrollit M.R. për 512 orë punë dhe raporti i kontrollit është hartuar në datë 01.03.2021.

Formulari nr.3 është miratuar nga përgjegjës A.C., drejtor kontrolli M.R. dhe Drejtor Rajonal I.A..

-Nga auditimi në lidhje me këtë praktikë konstatohet se nuk është kryer një analizë e blerjeve të tatueshme brenda vendit sipas natyrës së tyre prej furnitorëve kryesorë, me përjashtim të punimeve të kryera nga ana e nënkontraktorëve, duke mos dokumentuar të drejtën për kreditueshmërinë e tatimit mbi vlerën e shtuar për të gjithë periudhën e kontrolluar.

-Analiza e kryer në lidhje me lëvizjen e materialeve rezulton të jetë e pa plotë duke mos e detajuar dhe paraqitur evidenca sipas objekteve të ndërtimit dhe krahasimit me preventivat përkatës të miratuar.

-Shitjet e analizuara në raport kontrolli drejt tatimpaguesve dhe sipas situacioneve përkatëse nuk rakordojnë me shitjet e deklaruara në deklaratën e TVSH sipas periudhave të analizuara. Këto diferenca përfshijnë shitje të padeklaruara si pasojë e diferencave me situacionet të cilat paraqesin detyrime në lidhje me TVSH për tatimpaguesin si në tabelën e mëposhtme:

Periudha	Vlera e situacionit për Mars- Dhjetor 2016 pa TVSH	Vlera e situacionit për Janar-Dhjetor 2017 pa TVSH	Vlera e situacionit për Janar-Shkurt 2018 pa TVSH	Vlera e situacionit për Janar-Shkurt 2019 pa TVSH	Vlera e situacionit për Janar-Gusht 2020 pa TVSH
Vlera e situacioneve	542,683,659	854,473,855	818,596,136	373,856,709	105,939,007
Vlera sipas situatës financiare	540,434,394	863,567,571	936,911,891	447,914,736	71,733,591
Diferenca	-2,249,265	9,093,716	118,315,755	74,058,027	-34,205,416

Për rastet kur diferenca është pozitive, nuk janë analizuar shitjet e tjera të mundshme përveç situacioneve.

Për diferencën në vitin 2016 në shumën 2,249,265 lekë dhe në vitin 2020 në shumën 34,205,416 lekë konstatohet se nuk janë deklaruar si shitje të periudhës.

**Detyrimi për TVSH-në viti 2016;  $2,249,265 * 20\% = 449,853$  lekë**

**Gjobë  $449,853 * 100\% = 449,853$  lekë.**

**Detyrimi për Tatim Fitimin viti 2016;  $2,249,265 * 15\% = 337,389$  lekë**

**Gjobë  $337,389 * 100\% = 337,389$  lekë.**

**Detyrimi për TVSH-në viti 2020;  $34,205,416 * 20\% = 6,841,083$  lekë**

**Gjobë  $6,841,083 * 100\% = 6,841,083$  lekë.**

**Detyrimi për Tatim Fitimin viti 2020;  $34,205,416 * 15\% = 5,130,812$  lekë**

**Gjobë  $5,130,812 * 100\% = 5,130,812$  lekë.**

-Në analizën e pasqyrave financiare, si pjesë e raportit të kontrollit mbi tatimin mbi fitimin konstatohet vlerë e lartë e aktiveve afatshkurtra në shumën 771 milion lekë, në rritje vit pas viti dhe argumentimi i kryer në lidhje me këtë llogari është i gabuar duke i paraqitur si detyrime ndaj të tretëve, ndërkohë që duhet të pasqyrohen të drejta për të arkëtuar ndaj të tretëve. Nga ana e inspektorit tatimor nuk rezultojnë të jenë analizuar këto të drejta mbi marrëdhëniet dhe thelbin ekonomik të transaksioneve që kanë sjellë lindjen e këtyre të drejtave duke qenë se përbëjnë një zë material të pasqyrave financiare.

- Në analizën e furnitorëve, si pjesë e detyrimeve drejt ndaj të tretëve janë përfshirë furnitorë me vlerë negative në shumën totale 44 milion lekë duke mos u analizuar nga inspektori për efekt të pakësimit negativ të detyrimeve dhe lidhjen me blerjet e realizuara përgjatë periudhës së kontrolluar.

-Në analizën e blerjeve të tatuashme raportohet që të ketë blerje për leasing pa e specifikuar vlerën përkatëse, ndërkohë që në blerjet e përjashtuara nuk raportohen blerje për leasing për vlerën e interesit e cila duhet të raportohet si blerje e përjashtuar, duke paraqitur mundësinë e kreditimit të TVSH për interesat e leasing të kryera nga tatimpaguesi, në kundërshtim me parashikimet e bëra udhëzimin për TVSH.

-Në raport kontrolli nuk është kryer një analizë nga ana e inspektorit tatimor në lidhje me rentën minerare, për sasi të dhe vlerën e përcaktuar për tu paguar, duke mos dokumentuar ligjshmërinë e llogaritjes dhe pagesës së rentës minerare sipas artikujve, sasive dhe tarifës së aplikuar.

-Në raportin e kontrollit tatimor është kryer analiza për betonin e prodhuar nga tatimpaguesi për vitin 2017 dhe jo për vitet e tjera pavarësisht se në analizën e materialeve është shprehur për beton të blera dhe prodhuar nga shoqëria. Në betonin e prodhuar në vitin 2017 konstatohen diferenca ndërmjet sasisë së prodhuar sipas analizës së prodhimit të betonit me sasinë e deklaruar të situacionuar, duke paraqitur për disa lloje vlerë më të lartë të prodhuar por të pasituacionuar. Në analizën e kryer mbi lëvizjen e bilancit material dhe sasive të prodhuara të betonit të përdorur në situacione, konstatohet se një analizë e tillë është kryer vetëm për vitin 2017, pavarësisht se hyrjet e betonit për vitet e tjera cilësohen si hyrje nga blerja dhe prodhimi.

Për vitin 2017, konstatohen diferenca sipas analizës së bilancit material për sasinë e situacionuar dhe betonit të prodhuar nga vetë shoqëria. Konkretisht paraqiten sipas tabelës së mëposhtme:

Lloji I betonit	Sasia e prodhuar	Shitje e situacionuar	Diferenca në sasi	çmimi	Diferenca në vlerë
<i>Beton M-150</i>	660	646	(14)	5,720	(80,080)
<i>Beton M-250</i>	1,360	1,166	(194)	6,250	(1,212,500)
<i>Beton M-300</i>	1,923	224	(1,699)	6,800	(11,553,200)
<b>TOTALI</b>					<b>(12,845,780)</b>

Diferenca në vlerë përbën shitje të pa deklaruar për të cilën llogariten detyrime si më poshtë:

**Detyrimi për TVSH-në  $12,845,780 * 20\% = 2,569,156$  lekë**

**Gjobë  $2,569,156 * 100\% = 2,569,156$  lekë.**



**Detyrimi për Tatim Fitimin 12,845,780\* 15% = 1,926,867 lekë**

**Gjobë 1,926,867 \* 100%= 1,926,867 lekë.**

**Efekt i financiar i shmangur me efekt të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit është në shumën 34,510,323 lekë.**

Në lidhje me konstatimet e mësipërme për tatimpagues A., nga ana e subjektit të audituar janë paraqitur observacione duke pretenduar si më poshtë:

*-janë paraqitur tabela për blerjet mars dhjetor 2016 sipas furnitorëve dhe natyrës së mallrave apo shërbimeve të blera.*

*-për diferencën e shitjeve me situacionet “..për kontratat e punimeve janë marrë paradhënie punimesh të cilat janë rikthyer nga subjekti sipas situacioneve të dorëzuara pranë autoritetit kontraktor. Në rastet kur diferenca është negative do të thotë që kthimi i paradhënies është më i madh se vlera e paradhënies së marrë gjatë periudhës përkatëse.*

*- për aktivet afatshkurtra, është sjellë i njëjti argumentim i bërë në raportin e kontrollit tatimor.*

*-për furnitorët në vlerë negative “.. vijnë nga pasqyrimi i detyrimit të furnitorëve në lekë dhe në euro të cilat nuk janë grupuar në një monedhë të vetme. Pasqyrimi është bërë sipas kërkesës së furnitorëve”.*

*- “..në blerjet e tatueshme janë futur të gjitha blerjet me leasing duke qenë se kanë lidhje me mjete të rënda të transportit, makinerive dhe të ngjashme. Në bazë të udhëzimeve dhe ligjeve në fuqi lejohet kreditimi i TVSH për këto mjete. Blerjet e autoveturave me leasing janë raportuar në blerje të përjashtuara.*

*-në analizën e rentës minerale “..për vitin 2018 është paguar rentë për 100,100 m3 inerte lumore në vlerë rente 4,204,200 lekë. Për vitin 2019 është llogaritur dhe paguar rentë për 79,617 m3 inere lumore me vlerë rente 3,343,914 lekë”.*

*-në analizën e konsumit të betonit në vitin 2017 në tabelën tuaj janë pasqyruar prodhimi i betonit dhe shitjet e situacionuara duke nxjerrë diferenca. Në aktin e kontrollit janë pasqyruar blerjet e betonit nga të tretët dhe shitjet sipas situacioneve për të cilat nuk rezultojnë diferenca. Shoqëria ka blerë beton por ka bërë dhe prodhim betoni për të plotësuar nevojat që duheshin sipas kontratave të punimeve. Në tabelën e hartuar dhe pasqyruar në aktkontroll në vitin 2017 dhe periudhat e tjera është bërë verifikimi i materialeve të blera dhe konsumuara.*

Në përgjigje të këtyre observacioneve sqarojmë:

-paraqitja e tabelave jashtë afatit të auditimit në terren dhe vetëm për vitin 2016, nuk paraqet siguri për përmbajtjen e tyre dhe mundësinë e verifikimit në sistem dhe për këto arsye nuk trajtohen e nuk merren në konsideratë për aq kohë sa nuk janë pjesë e raportit të kontrollit, e evidentuar si mangësi gjatë auditimit.

-në lidhje me diferencën e shitjeve me situacionet pretendimi se janë parapagimet që shkaktojnë këto efekte, nuk janë të shoqëruara me dokumentacion justifikues dhe fakte për tu trajtuar dhe nuk pasqyrojnë secilën vlerë të trajtuar si diferencë në konstatim dhe për këtë arsye observacioni nuk merret në konsideratë.

-në lidhje me vlerën negative të furnitorëve, pretendimi se është bërë sipas kërkesës së furnitorëve nuk përbën argument për ekzistencën e tyre në llogari të pasivit dhe nuk merret në konsideratë.

- në lidhje me leasing sqarojmë se konstatimi ka të bëjë me trajtimin e shpenzimeve të interesit të cilat duhet trajtuar si blerje e përjashtuar dhe nuk janë paraqitur fakte dhe prova që blerjet për leasing janë në funksion të aktivitetit të tatueshëm për makineri e pajisje, për këto arsye observacioni nuk merret në konsideratë.

-për rentën minerare, për vlerat e pretenduara të trajtuara nuk janë paraqitur fakte dhe prova por vetëm deklarim nga inspektori si dhe konstatimi qëndron për faktin e mungesës së analizës në raport kontrolli dhe për këtë arsye nuk merret në konsideratë observacioni.

-në lidhje me diferencat e betonit të situacionuar me betonin e prodhuar nuk janë paraqitur argumenta shtesë dhe nuk merret në konsideratë observacioni.

- **Tatimpagues:** “A.” SHPK me Nipt L.T i cili ushtron veprimtarinë në fushën e zbatimit, projektimit të ndërtimeve civile, punime dheu, prodhim elementesh të parafabrikuar, betone dhe beton arme, ndërtime rrugësh dhe vepra arti, prodhim dhe tregim me shumice dhe pakice të materjaleve të ndërtimit, inerte, gurë, zhavore, blloqe betone etj.

**Adresë Kryesore:** Njësia Administrative nr. 3, Rruga Kongresi I manastirit, Zona Kadastrale nr.8140, Nr pasurie 3/967, Tiranë me nr serjal: SN-5600020-10-18.

**Lloji i Kontrollit:** Kontroll për TVSH për periudhën Janar 2018-Dhjetor 2021, kontroll i tatim fitimit për vitin 2018-2020, kontroll për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore Janar 2018-Dhjetor 2021, të tjera Janar 2018-Dhjetor 2021.

**Inspektori:** A.XH. dhe I.K. inxhinier ndërtimi.

Subjekti është njoftuar për kontroll tatimor me nr. 318/1 datë 31.01.2022. Programi i kontrollit është miratuar nga përgjegjësi i sektorit A.D. dhe nga Drejtori i Drejtorisë së Kontrollit M.R. për 240 orë punë dhe raporti i kontrollit është hartuar në datë 06.05.2022.

Formulari nr.3 është miratuar nga përgjegjës A.D., pa firmosur nga drejtori i kontrollit O.C. dhe miratuar nga Drejtor Rajonal E.C..

- Nga auditimi është konstatuar se për lejen për objektin nr.4 në proces ndërtimi nga shoqëria, sipas lejes bashkëngjitur raport kontrollit, paraqesin shoqërinë jo si të vetme në rolin e investitorit (dy investitorë sipas lejes së ndërtimit) dhe si të vetëm në rolin e ndërtuesit, çka ndryshon edhe trajtimin fiskal për efekt të njohjes së situacioneve të ndërtimit si investitor dhe në shitjet e përfunduar.

- Nga auditimi konstatohet se në raport kontrolli është kryer analiza e koston mesatare të ndërtimit për efekt fiskal për objektet ndërtimore me shkallë përfundimi 100%, konkretisht sipas lejes së ndërtimit nr.1 dhe lejes së ndërtimit nr.2, duke u shprehur se janë respektuar kërkesat e legjislacionit në fuqi. Llogaritja e koston mesatare nga ana e inspektorit tatimor është kryer si raport i situacioneve progresive me sipërfaqen e ndërtimit të investitorit duke zbritur pjesën e sipërfaqes ndërtimore të pronarëve të truallit. Nga auditimi konstatohet se kjo përllogaritje është e gabuar pasi kosto e ndërtimit sipas situacioneve i atribuohet të gjithë sipërfaqes ndërtimore sipas lejes së përcaktuar të ndërtimit dhe nga llogaritjet e kryera nga audituesit rezultojnë koston mesatare si më poshtë:

Leja e ndërtimit nr.1

Përshkrimi	Vlera
Vlera e situacioneve (01.01.2018-31.12.2022)	613,948,676
Sip për Kosto MF	20,232.94
Kosto mesatare	30,344.02
Kosto minimale fiskale Tirana	32,113.00
Diferenca në vlerë	35,791,726.22

Leja e ndërtimit nr.2

Përshkrimi	Vlera
Vlera e situacioneve (01.01.2018-31.12.2022)	461,749,383
Sip për Kosto MF	16,671
Kosto mesatare	27,697
Kosto minimale fiskale Tirana	32,113
Diferenca në vlerë	73,616,074

Nga raporti i kontrollit dhe analiza e kryer nga grupi i audituesve të KLSH rezulton se subjekti i cili është në rolin e ndërtuesit dhe sipërmarrësit të punimeve, në këtë rast ka kryer faturime të situacioneve të punimeve të kryera poshtë nivelit të kostove mesatare që janë përcaktuar në *Udhëzimin e Këshillit të Ministrave Nr.3 “Miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banësive, për vitin 2016”*. Kjo është situata e “shitjes nën kosto”, konkretisht kjo situatë ku subjekti faturon nën koston mesatare të miratuara ka sjellë ulje të

pagesës së TVSH-së, si dhe ulje të tatimit mbi fitimin për veprime të cilat bien në kundërshtim me nenin 124 “Kundërvajtjet në lëshimin e faturave tatimore, dëftesave tatimore dhe dokumentimin e transaksioneve” të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Ndërsa në lidhje me subjektin investitor nga ana e inspektorëve të kontrollit duhet të ishin kryer veprime rregulluese duke rivlerësuar transaksionet (vlera e situacioneve të punimeve të ndërtimit në blerje) drejt vlerës minimale të për efekte fiskale sipas përcaktimeve ligjore në fuqi.

Në zbatim të shkronjës c të nenit 71 “E drejta për të përdorur mënyra alternative vlerësimi”, shkronjës ç dhe d të pikës 1 dhe të pikës 2 të nenit 71/2 “Përdorimi i metodave alternative të vlerësimit në rastet e veprimeve për shmangien e tatimit dhe abuzimit me parimet e ligjit tatimor” dhe shkronjës ç të pikës 1 të nenit 72 “Baza e mënyrave alternative të vlerësimit” të Ligjit Nr.9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ku përcaktohet se:

Neni 71 “E drejta për të përdorur mënyra alternative vlerësimi”.

Administrata tatimore ka të drejtë të përdorë mënyra alternative vlerësimi të detyrimit tatimor të tatimpaguesit dhe të nxjerrë një vlerësim, në rastet kur:

c) tatimpaguesi nuk mban ose ruan llogari apo regjistrime të sakta të transaksioneve.

Neni 71/2 “Përdorimi i metodave alternative të vlerësimit në rastet e veprimeve për shmangien e tatimit dhe abuzimit me parimet e ligjit tatimor”.

1. Në rastet kur një apo disa tatimpagues kryejnë një veprim/transaksion apo seri veprimesh/transaksionesh direkte apo indirekte me persona të tretë, ku:

ç) forma e veprimit/transaksionit nuk reflekton thelbin e tij ekonomik;

d) evidentohen elemente të veprimeve/transaksioneve që synojnë shmangien ose uljen e detyrimeve tatimore.

2. Kur një veprim/transaksion apo seri veprimesh/transaksionesh janë në kushtet e pikës 1 më sipër, veprimi/transaksioni rikarakterizohet dhe detyrimi tatimor llogaritet në përputhje me dispozitat për vlerësimin tatimor alternativ të këtij ligji dhe ligjeve të tjera tatimore.

Neni 72 “Baza e mënyrave alternative të vlerësimit”

1. Mënyrat alternative të vlerësimit nuk kufizohen, por bazohen në:

ç) Të dhënat e tërthorta, bazuar në çmimet e tregut të mallrave dhe shërbimeve të ngjashme, të çmimeve të referencave të qirave, të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave;

Në këtë rast do të bëhet rikarakterizimi i shpenzimeve shtesë të cilat rezultojnë nga përllogaritjet e grupit të auditimit por nuk do t'i njihen subjektit si shpenzime të zbritshme të cilat do të ishin n.q.s. do të ishin deklaruar korrekt nga subjekti, por mqs këto parregullsi po evidentohen nga grupi i audituesve do të kalojnë si shpenzime të panjohura duke kaluar e gjithë e ardhura si fitim. Pra nga grupi i auditimit është kryer rikarakterizimi i shpenzimeve dhe investimeve, **diferenca midis vlerës së faturuar të situacioneve deri tek niveli i kostove minimale fiskale të ndërtimit**, të pa njohur dhe regjistruara nga subjekti si të ardhura dhe ndryshimi në deklaratën e tatim fitimit do të bëhet në rritje të të ardhurave dhe të shpenzimeve, por shpenzimet nuk njihen si të zbritshme për efekt të tatim fitimit, **kjo do të ishte e mundur kur vete subjekti do të deklaronte këto shpenzime, jo kur kjo bëhen nga inspektori ose nga rekomandimi i grupit të audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit**, pra kjo do të thotë se rritja në të ardhura do të kalojë e gjitha si fitim.

Në lidhje me TVSH-në, nuk do të kemi njohjen e TVSH-së zbritshme për këto shpenzime sepse kanë kaluar periudha 12 mujore që i jep të drejtën që ta kreditojë sipas përcaktimeve të pikës 4 të

nenit 76 “Mënyra e ushtrimit të së drejtës së zbritjes” të Ligjit Nr.92/2014 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ku përcaktohet se:

4. Nëse personi i tatueshëm nuk kryen zbritjen e TVSH-së në periudhën tatimore në të cilën i lind e drejta e zbritjes, ai mund ta zbresë këtë shumë të TVSH-së së zbritshme pas kësaj periudhe tatimore, por jo më vonë se 12 periudha tatimore përfshirë periudhën në fjalë.

Kurse penalizimi i subjektit nga ana e inspektorëve duhet të ishte kryer sipas nenit 115 “Plotësim i pasaktë i deklaratës tatimore” të Ligjit Nr.9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: 1. Dorëzimi i një deklarate tatimore të pasaktë dënohet me një gjobë të barabartë me 0,06 për qind të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë, gjatë së cilës pagesa nuk është kryer. Në asnjë rast, gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike.

Përshkrimi	Vlera
Diferenca në vlerë leja 1	35,791,726
Diferenca në vlerë leja 2	73,616,074
<b>Totali</b>	<b>109,407,800</b>
TVSH	21,881,560
Gjobe TVSH	4,726,417
Tatim fitimi	16,411,170
Gjobe 0.06%	3,544,813
<b>Total detyrime</b>	<b>46,563,960</b>

**Detyrimi për TVSH-në  $109,407,800 * 20\% = 21,881,560$  lekë**

**Gjorbë  $21,881,560 * 0.06\% * 365 = 4,726,417$  lekë.**

**Detyrimi për Tatim Fitimin  $109,407,800 * 15\% = 16,411,170$  lekë**

**Gjorbë  $16,411,170 * 0.06\% * 365 = 3,544,813$  lekë.**

-Nga auditimi konstatohet se janë përfshirë në blerje të tatueshme brenda vendit për të cilën është kredituar TVSH blerje në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 20 të udhëzimit nr.6 datë 30.01.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar sipas tabelës së mëposhtme:

#### **Për vitin 2019**

Nr	Emri shitësit	Rrethi	NIPTI	Përshkrimi	Vlera	TVSH
7	A.M	Tirane	L.D	Arkitekture	3,598,296	719,659
26	G.C	Tirane	L.O	Arkitekture	2,458,334	491,667
37	I.E Bv Spv	Tirane	L.B	Depozitim Dheu	17,288,142	3,457,629
55	O. SHA	Tirane	K.H	Lidhje kontrate Energjie	5,724,605	1,144,921
76	U.K.T SHA	Tirane	L.P	Lidhje kontrata Uji	81,669	16,333
<b>Totali</b>					<b>29,151,046</b>	<b>5,830,209</b>

Blerjet e mësipërme janë kryer nga tatimpaguesi për aktivitetin e shijes së ndërtesave i cili është një furnizim i përjashtuar dhe jo në rolin e ndërtuesit që përfshin pjesën e aktivitetit të tatueshëm të tatimpaguesit. **Rrjedhimisht, TVSH në shumën 5,830,209 lekë është kredituar padrejtësisht nga tatimpaguesi ku rrjedhin detyrime për vlerën e tatimit të munguar si dhe gjobë për kreditim të gabuar në nivelin 21.6% të detyrimit në shumën 1,259,325 lekë.**

**Detyrimi për TVSH-në  $29,151,046 * 20\% = 5,830,209$  lekë**

**Gjorbë  $5,830,209 * 0.06\% * 365 = 1,259,325$  lekë.**

- Nga auditimi konstatohet se sipas pasqyrave financiare, financimi i aktivitetit të ndërtimit është kryer nëpërmjet llogarisë së arkëtimeve në avancë sipas tabelës së mëposhtme ndër vite:

Llogaria	2018	2019	2020
Arkëtimet në avancë për porosi	173,097,240	789,436,549	1,502,463,320

Kjo llogari nuk rezulton të jetë analizuar nga ana e inspektorit tatimor në kushtet kur sipas pasqyrave financiare kompania rezulton të jetë themeluar me kapital minimal prej 100 lekë dhe nga ana tjetër ka akumuluar deri në fund të vitit 2020 aktive nga ndërtimi për shitje në vlerën 1,797,606,135 lekë. Gjithashtu, në raportin e kontrollit të hartuar nga ana e inspektorit tatimor

konstatohet se këto parapagime nuk janë raportuar në deklaratat e TVSH të dorëzuar nga ana e tatimpaguesit për periudhën 2018-2020, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 20 të udhëzimit nr.6 datë 30.01.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Shitjet e përjashtuara reuzltojnë të jenë analizuar vetëm për vitin 2021 në faqen 32-33 të raport kontrollit dhe rezultojnë të jenë analizuar 31 milion lekë paradhënie dhe 130 milion lekë të raportuara si shitje në bazë të kontratave noteriale përkatëse.

-Nga auditimi konstatohet se në shitjet e analizuar për vitin 2021, në analizën e kryer nga inspektori tatimor nuk është respektuar kufiri minimal i çmimit të shitjes sipas zonës në të cilën ndodhet objekti në bazë të kriterëve të përcaktuara në *Udhëzimin e Këshillit të Ministrave Nr.3 “Miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2016” për rastet e mëposhtme:*

Sipërfaqe	Çmimi euro/lek	kursi	Çmimi lek	Çmimi minimal I shitjes	Diferenca	Diferenca ne vlere
52	962	121.51	116,836.54	154,000.00	-37,163.46	-1,932,499.92
105.9	66,966	1	66,966.01	77,000.00	-10,033.99	-1,062,599.54
99.3	504	122.76	61,812.69	77,000.00	-15,187.31	-1,508,099.88
139.38	574	121.29	69,616.87	77,000.00	-7,383.13	-1,029,060.66
105.91	600	121.15	72,694.58	77,000.00	-4,305.42	-455,987.03
42.2	948	120.74	114,445.50	154,000.00	-39,554.50	-1,669,199.90
64.74	600	120.74	72,444.00	77,000.00	-4,556.00	-294,955.44
65.66	600	120.74	72,444.00	77,000.00	-4,556.00	-299,146.96
90.28	603	120.48	72,648.32	77,000.00	-4,351.68	-392,869.67
137.77	436	120.48	52,470.06	77,000.00	-24,529.94	-3,379,489.83
<b>Totali</b>						<b>-12,023,908.84</b>

**Si rezultat i shitjes nën çmimin minimal të lejuar për efekte fiskale lindin detyrimet e për nënvlerësim të të ardhurave të përjashtuara në vlerën 15% të tatim fitimit të munguar (15%\*12,023,908.84) në shumën 1,803,586 lekë dhe gjobë në masën 100% 1,803,586 lekë për të ardhura të padeklaruara.**

***Detyrimi për Tatim Fitimin 12,023,908 \* 15% = 1,803,586 lekë***

***Gjobë 1,803,586 \* 100%= 1,803,586 lekë.***

- Nga auditimi konstatohet se pagesat për lejet e ndërtimit sipas analizës së shtesës së llogarisë aktive afatgjata të mbajtura për shitje janë akumuluar për herë të parë në vitin 2019, ndërkohë që procesi i ndërtimit ka filluar me situacionime në vitin 2018. Këto fakte në lëvizjen e llogarive tregojnë mundësinë e kreditimit të TVSH për situacionet përpara miratimit të lejes së ndërtimit sipas lejeve nr.1 dhe nr.2 të ndërtimit të cituara në raportin e kontrollit ose zbardhjes së dokumentit të lejes së ndërtimit përpara pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë nga tatimpaguesi. Nga ana e inspektorit tatimor nuk rezultojnë të jenë analizuar këto fakte për të arritur në konkluzione mbi të drejtën e kreditimit të TVSH për punimet përpara lindjes së të drejtës për të ndërtuar sipas aktit përkatës dhe përmbushjes së detyrimeve në lidhje me pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë.

***Efekt i financiar i shmangur me efekt të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit është në shumën 57,260,666 lekë.***

Në lidhje me konstatimet e mësipërme për tatimpagues A., nga ana e subjektit të audituar janë paraqitur observacione duke pretenduar si më poshtë:

-Lidhur me lejen e objektit 4. – *Këtë fakt e kemi pasqyruar edhe në raportin e kontrollit duke i bashkëngjitur raportit dhe lejen e ndërtimit të këtij objekti. Shoqëritë investitore kanë lidhur marrëveshje aneks kontratë midis tyre në lidhje me raportet përkatëse paraprake sipas premtimeve në pjesëmarrjen në investim dhe mënyrën përfundimtare të ndarjes së pronësisë në lidhje me respektimin e marrëveshjes apo ndikimin e faktorëve të tjerë të jashtëm. Parimisht midis shoqërive është caktuar kuota e pjesëmarrjes në këtë investim 99% A. dhe 1% D. projektim dhe zbatim. Duke qenë se asnjëra nga shoqëritë investitore nuk*

do të bëjnë shitje me TVSH të objekteve ndërtimore, pra shitjet e pasurive të paluajtshme do të jenë të gjitha të përjashtuara, nga ana jonë pasi u analizua si më sipër u vlerësua që të zgjatëshim më shumë në raportin e kontrollit. Për më tepër, për periudhën e kontrollit ky objekt është në fazën fillestare dhe shoqëria investitore dhe ndërtuese A. do ti faturojë shitje të situacionuara prej 1% (apo në nivelin e investimeve reale të kryera) të totali të kostos të situacionuar për këtë objekt në momentin që e vlerësojnë saktësisht këtë pjesëmarrje në investim. Pra është një ngjarje që ka për të ndodhur në të ardhmen që të bëhej e mundur pozicionimi i saktë i kostos proporcionale sipas aneks kontratës së lidhur midis palëve ku do të bëhej dhe trajtimi fiskal për kostot e situacionuara dhe shitjeve të përjashtuara.

-Lidhur me konstatimet për lejen 1 dhe 2 ....Për lejen nr.2 grupi i auditimit citon se sipërfaqe ndërtimi është 26,667,46 m<sup>2</sup> ku në fakt ky objekt sipas akt konstatimit të inxhinierit i cili është përfshirë edhe në aktin e kontrollit, ka një sipërfaqe ndërtimi totale 16,568.22 m<sup>2</sup>, pra grupi i auditimit e ka vlerësuar në përlllogaritjet e tij, me një diferencë më të madhe tepër të konsiderueshme prej 10,099.24 m<sup>2</sup> duke sjellë në të njëjtën kohë edhe diferencën vlerore të kostos mesatare të ndërtimit të këtij objekti në një masë rreth 61% më të vogël se kostoja mesatare reale. Përveç sa më sipër, në vlerësimin e kostos mesatare të ndërtimit të objekteve nr.1 dhe nr.2 me qëllim për ta krahasuar me koston minimale fiskale të zonës në të cilën janë ndërtimet duhet të merren në konsideratë edhe të gjitha shpenzimet e tjera operative shpenzimet e studim projekteve, shpenzimet noteriale, ndërmjetësuese etj dhe për më tepër edhe shpenzimet për taksat e lejeve të ndërtimit të këtyre objekteve. ..Grupi i auditimit, edhe pse e ka përmendur të drejtën dhe mënyrën e vlerësimeve alternative të detyrimeve tatimore për rastin tonë, jemi të sigurtë që edhe ata mendojnë njësoj si ne se në proceset e ndërtimit të këtyre objekteve ndërtimore, rivlerësimi i kostos së ndërtimit të objektit, i cili jep efekt në ndryshimin e vlerës së situacionit përfundimtar të tij, mund të kryhet vetëm në rastet: 1. Kur janë konstatuar gabime matematikore në përlllogaritjen e vlerave financiare, 2.kur janë konstatuar zëra punimesh të kryera në fakt por të pa situacionuara fare ap të situacionuara me diferenca sasiore krahasuar me volumet faktike. Në mungesë të këtyre konstatimeve në punimet ndërtimore nuk mund të bëjmë asnjë vlerësim alternativ për të caktuar konston mesatare të ndërtimit të objektit dhe jo për më tepër të vijojmë dhe me përlllogaritjen e detyrimeve tatimore.

..Rivlerësimet e detyrimeve tatimore në lidhje me tatim fitimin në punimet e ndërtimit nuk mund të bëhen përveçse në procesin e shitjes së tyre proces i cili do të gjenerojë fitim si diferencë e çmimeve të shitjes së ndërtesave me koston e tyre sado vlerë të ulët apo të lartë të ketë ajo. Ky fitim i cili do të realizohet në momentin e shitjes së ndërtesave do të gjenerojë në të njëjtën kohë edhe detyrimin e tatim fitimit për shitjen e tyre për periudhën tatimore në të cilën ndodh shitja e ndërtesës. Gjithashtu për një rast të ngjashëm nga ana e Drejtorisë së Tatimpaguesve të Mëdhenj me shkresën nr. 307/37 datë 12.06.2019 i është drejtuar DPT me lëndën “Kërkesë për interpretim dhe sqarim teknik” ku kjo e fundit me shkresën nr. 11840/1 datë 19.09.2019 ku ndër të tjera citon “Nivelet më të ulëta të çmimeve të shitjeve dhe kostove të ndërtimit të krahasuara me çmimet të shitjeve dhe kostove të ndërtimit të miratuara nga EKB nuk janë shkelje tatimore referuar legjislacionit tatimor pasi këto udhëzime nga Enti Kombëtar i Banesave nuk kanë dalë për qëllim të përlllogaritjes së detyrimeve tatimore të tatimpaguesve. Këto udhëzime kanë dalë në zbatim të ligjit nr.92932 datë 13.05.2004 “Për programet sociale të strehimit”, në përfundim aktet ligjore dhe nën ligjore duhej të zbatohen sipas fushës për të cilën ato kanë dalë dhe sipas përmbajtjes lëndore të tyre. Gjithashtu me shkresën e Drejtorit të Përgjithshëm 12111 datë 07.10.2011 për kompetencë sqaron administratën tatimore për shfuqizimin e marrëveshjes me ndërtuesit dhe për rrjedhojë dhe të VKM 173. Përsa me sipër, vlerësimet e paraqitura nga grupi i auditimit nuk qëndrojnë dhe pasi të verifikohen duhet që të rishikohen duke u trajtuar në përputhje me legjislacionin tatimor dhe atë të ndërtimit për fushën specifike të objektit të veprimtarisë të këtij subjekti për të cilat besojmë se do të përputhen me vlerësimet e bëra nga ana jonë gjatë procesit të kontrollit tatimor.

-Lidhur me kreditimin e TVSH në blerje .... për këto lloj blerjesh të cituara nga ana juaj, subjekti me të drejtë si për çdo blerje mallrash dhe shërbimesh në funksion të ndërtimit i ka kredituar në blerje si pjesë përbërëse e shpenzimeve gjatë procesit të ndërtimit dhe në vijim në periudhat tatimore përkatëse këto shpenzime janë faturuar si shitje nëpërmjet situacioneve mujore duke u përfshirë në koston e objektit dhe duke përlllogaritur mbi to shitje TVSH në shitje, pra duke e rikthyer TVSH e kredituar në TVSH të

*pagueshme. Efekti i kësaj TVSH të kredituar është zeruar në situacionet mujore të shitjeve të cilat janë përfshirë këto blerje.*

*-lidhur me financimin nëpërmjet arkëtimeve në avancë .....Financimi për realizimin e punimeve ka ardhur kryesisht nga kontratat e porosisë së lidhura me klientë potencialë individë në vazhdimësi, ku shoqëria ka lëshuar fatura tatimore paraprake për të gjithë subjektet të cilët kanë bërë porosi për të blerë pasuri të paluajtshme dhe pjesa tjetër e derdhjeve nga individë është pasqyruar rregullisht në pasqyrat financiare si parapagime dhe porosi për shitje. Vlera e arkëtimeve për porosi të paguara pas datës 01.01.2020 me hyrjen në fuqi të ndryshimeve ligjore për detyrimin edhe të subjekteve ndërtimore për prerjen e faturave për parapagimet edhe nga individë të ndryshëm porositës, subjekti pas kësaj periudhe i ka marrë masat dhe ka prerë fatura tatimore edhe për parapagime të marra nga persona individë.*

*- për respektimin e kufirit minimal në shitje .....Meqenëse dy objekte janë në nivelin 100% të punimeve, ... u kryer llogaritja paraprake e fitimit mbi shitjet e këtyre duke marrë çmimin mesatar të kontratave të porosisë me qëllim deklarimin e fitimit paraprak. Pra fitimi nga shitja është llogaritur në bazë të rregullave kontabël në fuqi si diferencë e të ardhurave faktike të realizuara me shpenzimet e njohura fiskalisht, në periudhën përkatëse tatimore viti kalendarik. Dhe shitja është bazuar në sipërfaqet totale dhe llojin e tyre të dhëna këto të paraqitura në aktin e konstatimit të inxhinierit dhe sipërfaqeve të hipotekuara në emër të shoqërisë të trajtuara në raport kontrolli. Çmimi mesatar i kontratave paraprake të lidhura nga shoqëria është 82,180 lekë/m<sup>2</sup> i cili është marrë si çmim mesatar nga kontratat e porosisë dhe është më i lartë se çmimi minimal i shitjes sipas zonës kadastrale të përcaktuar në udhëzimin ne.3 datë 28.01.2016, tabela 3, zona 3/1 vlera e shitjes 77,000 lekë. Përsa i takon tabelës së shitjeve për vitin 2021 që i jeni referuar është tabela për të treguar sipërfaqet dhe llojin e ambienteve të shitura ndërsa vlera e shitjeve respektive janë pasqyruar në tabelat më lart në raport kontrollin që përputhej me librin e shitjeve të deklaruar nga shoqëria ku nuk kishte diferencë krahasuar me zonën kadastrale të përcaktuar në udhëzimin e sipërpërmendur.*

*-për kreditimin e TVSH përpara miratimit të lejes ...Leja nr.1 është zbardhur në datën 11.08.2018 me një afat 60 mujor dhe para zbardhjes së lejes janë kryer të gjitha pagesat e taksës së ndikimit në infrastrukturë në shumën e përcaktuar nga autoriteti përkatës, punimet në objekt sipas verifikimeve nga ana jonë qoftë të grafikut të punimeve si dhe situacionet e faturimeve të kryera nga subjekti kanë filluar në muajin dhjetor 2018, nga analizimi i pasqyrave financiare të vitit 2018 është paraqitur shuma e akumuluar në zërin aktive të mbajtura për shitje në shumën 145,081,280 lekë ku analitikisht rezultonin të përfshira pagesë e taksës së ndikimit në infrastrukturë si dhe një situacionim për muajin dhjetor 2018, pra punimet kanë filluar në përputhje me afatet ligjore të cilat e bëjnë të drejtë kreditimin e TVSH për blerje mallrash e shërbimesh nga të tretë.*

Në përgjigje të observacioneve të mësipërme sqarojmë:

- në lidhje me objektin sipas lejes 4, sqarojmë se ekzistenca e një investitori tjetër nga shoqëria ndërtuese në leje nuk është paraqitur në raport kontrolli dhe kjo është evidentuar vetëm nga leja e ndërtimit. Ky fakt duhet të ishte shoqëria me analizën e shitjeve për objektin 4, ku shoqëria A. duhet të kishte faturuar 1% të vlerës së situacioneve në periudhën e duhur te investitori tjetër dhe jo në të ardhmen referuar kërkesave të udhëzimit për TVSH, për këto arsye observacioni nuk merret në konsideratë.

- në lidhje me objektet sipas lejeve 1 dhe 2, sqarojmë se në faqen 2 të raportit të kontrollit tatimor të hartuar nga inspektori i kontrollit tatimor, sipërfaqe e raportuar sipas tabelës së pasqyruar është 26,667.46 m<sup>2</sup>, ndërkohë që për të njëjtën leje në akt verifikimin e inxhinierit sipërfaqe është ajo e pretenduar në observacione prej 16,568.22. Duke mos pasur siguri në lidhje me sipërfaqen e paraqitur në dy dokumenta zyrtarë që ka prodhuar procedura e kryerjes së kontrollit tatimor ku raportohen vlera të ndryshme për të njëjtën leje, observacioni nuk merret në konsideratë.

Për pretendimin se nuk duhet kryer vlerësim alternativ, nga grupi i auditimit është bërë argumentimi shterues mbi përcaktimet e kuadrit specifik rregullator për ndërtimet dhe kostot minimale fiskale, që sjellim në vëmendjen tuaj janë një kërkesë e udhëzimit për TVSH për aktivitetin e ndërtimit dhe për këtë arsye nuk merren në konsideratë. Përsa i përket tatim fitimit sqarojmë se fitimi shtesë nga vlerësimi alternativ për koston minimale fiskale është një fitim që vjen nga operacionet ndërtimore dhe jo nga shitja e pasurive individuale të paluajtshme, për këto arsye observacioni nuk merret në konsideratë.



Pretendimi mbi shkresën e DPT sqarohet se nuk është materializuar në formën e pasqyrit në udhëzim i interpretimit teknik, ndërkohë që respektimi i kostos minimale fiskale është i pasqyruar si kërkesë në udhëzimin për TVSH, për këto arsye mbështetja në një shkresë dhe jo në përputhje me udhëzimin na kushtëzon mos marrjen në konsideratë të observacioneve.

*-në lidhje me blerjet e kreditueshme, sqarohet se sipas konstatimit ato i përkasin tatimpaguesit në rolin e investitorit dhe jo të ndërtuesit, sipas përcaktimeve të bëra në udhëzimin për TVSH, meqenëse tatimpaguesi sillet në të dyja rolet në pozitë që ka sipas përcaktimeve të lejeve të ndërtimit, për këto arsye observacioni nuk merret në konsideratë.*

*-për financimin e aktivitetit të ndërtimit, sqarohet se mungesa e faturave për parapagimet e individëve nuk është e argumentuar me ndryshime në bazë ligjore të referuar përpara 2020, ndërkohë që kërkesat e ligjit për TVSH përcaktojnë që çdo furnizim kundrejt pagesës dokumentohet me faturë në momentin e ndodhjes së tij, ligj në fuqi që nga viti 2014, për këto arsye observacioni nuk merret në konsideratë.*

*- për respektimin e çmimit minimal në shitje, merret në konsideratë çmimi i referuar sipas çmimit minimal në shitje për zonën e Tiranës dhe efektet e tij pasqyrohen në tabelën përkatëse në formën e detyrimeve në rastet kur çmimi i shitjes është më i vogël se ky çmim minimal.*

*-për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë sqarohet se pagesa e taksës është e dokumentuar në pasqyra financiare të vitit 2019 dhe jo 2018 sikurse pretendohet në observacione dhe për këtë arsye nuk merren në konsideratë.*

Nga Drejtorja e Tatimpaguesve të Mëdhenj me shkresë nr. 52/28 datë 11.09.2023 protokolluar në KLSH me nr. 14/11 datë 12.09.2023 janë paraqitur observacione mbi Projekt Raportin e Auditimit. Në përmbajtje të këtyre observacioneve, për këtë tatimpagues konstatohet se janë paraqitur të njëjtat observacione si në fazën e akt konstatimeve të pasqyruara dhe trajtuara si më sipër, për këtë arsye këto observacione nuk merren në konsideratë.

Në takimin ballafaques në KLSH të zhvilluar në datën 19.09.2023, nga ana e inspektorit tatimor u prezantuan argumenta në lidhje me sipërfaqen e objektit sipas lejes nr.2 të cilat u shoqëruan me dërgimin e akt kolaudimit si pjesë e dokumentacionit shtesë, të cilat merren në konsideratë nga grupi i auditimit për pjesën e sipërfaqes, pavarësisht gabimit të pasqyruar në raportin përfundimtar të kontrollit dhe reflektimi i respektimit të kostos minimale të ndërtimit për këtë objekt rishikohet për efektet në bazë të fakteve shtesë të paraqitura.

**-Tatimpagues:** “B.”SHA me NIPT J.C e cila ushtron ne fushën e prodhim dhe tregtim grure,mielli ,hime dhe artikuj te tjerë me shumice dhe pakice

**Adresë Kryesore:** Njësia Bashkiake Nr.6 Rruga “Konferenca e Pezës” Tirane.

**Lloji i Kontrollit:** Kontroll për TVSH për periudhën Dhjetor 2019 – Nëntor 2021, kontroll i tatimit fitimit për vitin 2019-2020, kontroll për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore Dhjetor 2019 – Nëntor 2021, të tjera Dhjetor 2019 – Nëntor 2021.

**Inspektori:** D.GJ.

Subjekti është njoftuar për kontroll tatimor me nr. 386/1 datë 03.03.2022. Programi i kontrollit është miratuar nga përgjegjësi i sektorit E.M. dhe Drejtori i Drejtorisë së Kontrollit M.R. për 300 orë punë dhe raporti i kontrollit është hartuar në datë 23.03.2022.

Formulari është miratuar nga përgjegjësi E.M., drejtor kontrolli O.C. dhe Drejtor Rajonal E.C..

-Nga auditimi konstatohet se në analizën e marzhit të realizuar nga shitja e produkteve të gatshëm, nuk është kryer një analizë e detajuar në lidhje me shitjet e realizuara me kasë dhe atyre drejt tatimpaguesve të regjistruar, për efekt të çmimit të diferencuar midis shitjeve me shumicë dhe shitjeve me pakicë duke qenë se shitjet me pakicë përbëjnë mbi 50% të qarkullimit të tatuashëm të tatimpaguesit.

-Nga auditimi konstatohet se në raportin kontrolli është kryer analiza e bilancit material për lëvizjet e mallrave por nuk është kryer një analizë në lidhje me aktivitetin e prodhimit sipas kartës teknologjike të miratuar. Kjo analizë e munguar nuk dokumenton sasinë e përdorur të lëndës së



parë për prodhim si dhe të produktit të gatshëm të pasqyruar në lëvizjet e bilancit material në të njëjtën kohë me shqyrtimin e humbjeve/firove të mundshme nga procesi i prodhimit.

-Nga auditimi konstatohet se në analizën e klientëve të shoqërisë sipas pasqyrave financiare paraqiten si klientët për mallra e shërbime te pa arkëtuar ne fund te vitit, subjekti C. B. në shumën 49,530,300 lekë, ndërkohë që referuar objektit të veprimtarisë të kësaj banke të nivelit të dytë, nuk është argumentuar nga ana e inspektorit tatimor thelbi ekonomik i marrëdhënies së krijuar midis tyre referuar objekte të veprimtarisë së secilit tatimpagues.

- Nga analiza e pasqyrave financiare, konstatohet se për vitin 2019, nga ana e tatimpaguesit nuk është llogaritur amortizim për pjesën më të madhe të aseteve, e cila nuk rezulton të jetë analizuar nga ana e inspektorit tatimor në kushtet kur tatimpaguesi ka ushtruar aktivitet përgjatë të gjithë periudhës objekt kontrolli dhe ka rezultuar me humbje të pa analizuar në mënyrë të detajuar.

-Nga auditimi konstatohet se nga analiza e bilancit material për vitet 2019 dhe 2020 të paraqitur në raportin e kontrollit tatimor, për disa artikuj rezultojnë diferenca për produktet e pasqyruara në tabelën e mëposhtme në krahasim me inventarin analitik të dorëzuar nga tatimpaguesi në sistemin c@ts:

MAGAZINA LENDES PARE	njësi	Gjendje 31.12.2019	sipas inv. te subjektit	Diferenca	kosto	vler tat
MIELL ZAKONSHEM	TON	4	12	8.26	32,100	265,146
AMBALLAZH NE KG	Kilogram	5,689	4,963	726	260	188,760
QESE LETRE	Kilogram	13,562	14,287	725	113	81,925
<b>vl e tatushme</b>						<b>535,831</b>

MAGAZINA PRODUKTIT GATESHEM TIRANE	E	njësi	Gjendje 01.01.2020	Hyrje Janar 2020 - Dhjetor 2020	Dalje Janar 2020 - Dhjetor 2020	Gjendje 31.12.2020	sipas inv te subjektit	Diferenca	kosto	vler tat
MIELL PROPER PIZZA	PROPER	TON	13	188	135	65	7	58.33	35,000	2,041,550

Për sa më sipër, diferenca në vlerë përbën shitje të pa deklaruar si pasojë e diferencave në inventar për të cilën llogariten detyrime si më poshtë:

**Detyrimi për TVSH-në  $2,577,381 * 20\% = 515,476$  lekë**

**Gjobë  $515,476 * 100\% = 515,476$  lekë.**

**Detyrimi për Tatim Fitimin  $2,577,381 * 15\% = 386,607$  lekë**

**Gjobë  $386,607 * 100\% = 386,607$  lekë.**

**Efekti financiar i shmangur me efekt të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit është në shumën 1,804,167 lekë.**

Në lidhje me konstatimet e mësipërme për tatimpagues B., nga ana e subjektit të audituar janë paraqitur observacione duke pretenduar si më poshtë:

-për konstatimin klientë B. C. "Kompania B. në datë 20.06.2014 është kredituar nga C. L. në shumën 533,000 euro për blerje makineri e pajisje të ardhura nga kompanitë italiane për të cilat janë bërë hyrje nga kompania dhe për efekt kreditimi kanë kaluar në pronësi të C.L. deri në momentin e likuidimit të detyrimit nga kompania. Pra marrëdhënia e C.L. me B. SHA ka qenë vetëm për kreditimin e makinerive të tyre të fabrikës. Kreditimi i mjeteve të prodhimit nuk ka qenë pjesë e kontrollit deri në momentin e likuidimit të detyrimit pranë leasing nuk është llogaritur amortizimi".

-nga analiza e bilancit material 2019-2020 e paraqitur në sistemin cats për inventarin e deklaruar në 09.01.2020 gjendja e inventarit në sasi është depozituar 149,131.94 kg me vlerë 342,233,402 lekë kurse në bilanc në datë 31.03.2020 është deklaruar sasia 149,123.74 kg me vlerë 342,287,324 lekë pra më shumë për një diferencë sasi 10 kg dhe 53,922 lekë. Kjo diferencë është thjesht nga përpunimi i të dhënave vjetore e për këto arsye kryhet dhe kontrolli në vend. Për diferencat e konstuara nga auditimi "po të shikohen nga ana juaj është nxjerr një diferencë me plus në zërin ambalazhe në kg me sasinë 726 kg dhe në zërin tjetër qese ambalazhi në kg 725, ndërkohë që po të vërehej mirë nga ana juaj zëri qese në

*ambalazhe diferenca është në minus dhe këto dy vlera rakordojnë me njëra tjetrën dhe diferenca është zero”.*

-Përsa i përket bilancit material për 2020, diferenca për artikullin proper piza e cila sipas subjektit në bilanc është 6.68 ton dhe në inventarin e kontabilitetit 65 ton ka ndodhur pas inventarizimit përfundimtar në magazinë dhe është bërë kompensimi produkteve brenda llojit duke mos korrigjuar në asnjë rast vlerën gjithsej. Theksojmë se ndryshimi i vlerës në magazinë jep ndikim direkt në rezultatin final të kompanisë. Ky fenomen nuk është rasti pa diferenca nuk jep ndryshim rezultati pasi artikujt të gjithë të një lloji janë vlerësuar me të njëjtën kosto magazine.

Në përgjigje të observacioneve të mësipërme sqarojmë:

-për klientin tregtar C., sqarojmë se ky klientë është paraqitur në listën e klientëve nga marrëdhëniet tregtare ndërkohë që pretendimi në observacione citon një marrëdhënie huaje nëpërmjet leasing e cila pasqyron qartazi një detyrim nga huadhënësve, për këto arsye observacioni nuk merret në konsideratë.

-për diferencat në inventar, pretendimi se janë lëvizje ndërmjet zërave në kg për ambalazhet dhe pretendimi që diferencat vijnë si pasojë e kompensimit të miellit nuk qëndrojnë pasi këto produkte paraqiten me çmime të diferencuara dhe duhet të ishin konstatuar nga kryerja e kontrollit tatimor, për më tepër që është kryer edhe inventarizim fizik dhe është ndërtuar edhe bilanci material. Për këto arsye observacioni nuk merret në konsideratë.

Nga Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj me shkresë nr. 52/28 datë 11.09.2023 protokolluar në KLSH me nr. 14/11 datë 12.09.2023 janë paraqitur observacione mbi Projekt Raportin e Auditimit. Në përmbajtje të këtyre observacioneve, për këtë tatimpagues konstatohet se janë paraqitur të njëjtat observacione si në fazën e akt konstatimeve të pasqyruara dhe trajtuara si më sipër, për këtë arsye këto observacione nuk merren në konsideratë.

Në takimin ballafaques në KLSH të zhvilluar në datën 19.09.2023, nga ana e inspektorit tatimor u prezantuan argumenta në lidhje me pretendimet për diferencat në inventar për ambalazhet të cilat nuk kanë efekt në total pasi janë rigrupime ndërmjet artikujve si dhe pretendime në lidhje me leasing që e vendosin subjektin financiar bankar në rolin e klientit.

- **Tatimpagues:** “E.” SHPK me Nipt J.V i cili ushtron veprimtarinë në fushën e ndërtimit të linjave industriale për përpunimin e mishit e prodhimin e sallamit si dhe tregtimin e këtyre produkteve, prodhimin industrial në përgjithësi, tregtimin e mallrave të import-eksportit.

**Adresë Kryesore:** Superstrada Tirane-Durrës Km 4.8.

**Lloji i Kontrollit:** Kontroll për TVSH për periudhën Janar 2017-Qershor 2022, kontroll i tatimit për vitin 2017-2021, kontroll për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore Janar 2017-Qershor 2022, të tjera Janar 2017-Qershor 2022.

**Inspektori:** E.K.

Subjekti është njoftuar për kontroll tatimor me nr. 6904/1 datë 23.09.2022. Programi i kontrollit është miratuar nga përgjegjësi i sektorit S.M. dhe nga Drejtori i Drejtorisë së Kontrollit O.C. për 248 orë punë dhe raporti i kontrollit është hartuar në datë 16.12.2022.

Formulari nr.3 është miratuar nga përgjegjësi S.M., drejtori i kontrollit O.C. dhe miratuar nga Drejtor Rajonal E.C..

Nga auditimi i raportit të kontrollit tatimor konstatohet se janë kryer analizat e deklaratave të tatimpaguesit dhe janë analizuar blerjet dhe shitjet sipas llojit të realizuar për periudhën objekt kontrolli. Është bërë analiza e bilancit material për disa artikuj të përzgjedhur dhe është kryer inventarizimi fizik. Përsa i përket analizës së kostos së prodhimit të produkteve ushqimore, është kryer analizë e përgjithshme dhe jo sipas kartës teknologjike në lidhje me llojet e produkteve të prodhuara, duke mos analizuar produktet e përzgjedhura për kontroll në lidhje me sasinë e produktit të gatshëm të prodhuar nga sasia e materialeve të para dhe ndihmëse të përdorura.

-Për blerjet nga importi është kryer rakordimi me të dhënat e doganës.

-Janë analizuar sipas natyrës dhe furnitorëve blerjet e realizuara për të cilat është kredituar TVSH-ja si dhe është kryer analiza e kreditimit të TVSH për blerjet e karburantit.

-Janë analizuar pasqyrat financiare dhe janë rakorduar me librat për periudhën objekt kontrolli.

Në lidhje me konstatimet e mësipërme për tatimpagues E., nga ana e subjektit të audituar janë paraqitur observacione duke pretenduar si më poshtë:

*..është e pamundur nga ana e shoqërisë të bëjë faturë për çdo artikull si për shembull për të bërë dalje një sasi mish derri 5000 kg nga magazina i destinuar për 50 artikuj për të evidentuar konsumin e mishit për çdo artikull përveç 50 faturave që duhej të shoqëronin mishin me faturë shoqërimi në çdo proces. ..Kjo do të sillte një kosto shtesë për shoqërinë pasi do duheshin magazina me sipërfaqe të mëdha për të vendosur në pozicione të dedikuara lëndën e parë të destinuar për çdo artikull personel shtesë për të koordinuar lëvizjet dhe në këtë mënyrë do rriteshin ndjeshëm vështirësi operative. Prandaj është kryer një analizë e përgjithshme për konsumin e lëndës së parë.*

Në përgjigje të këtyre observacioneve sqarojmë se konstatimi përfshin vetëm ato produkte përfundimtare për të cilat është bërë përzgjedhja për inventarizim dhe për të cilat është ndërtuar bilanci material, në mënyrë që të krahasohej vlera e miratuar sipas kartës teknologjike me vlerën e shpërndarë për kosto sipas deklarimeve të tatimpaguesit, për këto arsye observacioni për vështirësitë e tërësisë së procesit nuk merret në konsideratë.

- **Tatimpagues: “F. K. C. F.” SHPK me Nipt K.E** i cili ushtron veprimtarinë në fushën e prodhimit të çimentos, gëlqeres, shfrytëzimi i tyre, import, eksport, transport mallrash, etj.

**Adresë Kryesore:** Fabrika e Çimentos, Fushë Krujë, Durrës

**Lloji i Kontrollit:** Kontroll i tatim fitimit për vitin 2017-2020, kontroll për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore Janar 2018-Prill 2021, të tjera deri në Prill 2021.

**Inspektori:** A.SH.

Subjekti është njoftuar për kontroll tatimor me nr. 6095/1 datë 28.07.2021. Programi i kontrollit është miratuar nga përgjegjësi i sektorit A.T. dhe nga Drejtori i Drejtorisë së Kontrollit M.R. për 264 orë punë dhe raporti i kontrollit është hartuar në datë 23.12.2021.

Formulari nr.3 është miratuar nga përgjegjësi A.T., drejtor kontrolli M.R. dhe Drejtor Rajonal I.A..

-Nga auditimi i raportit të kontrollit konstatohet se nga ana e inspektorit tatimor është kryer një analizë në lidhje me marzhin e realizuar nga shitja e artikullit kryesor të aktivitetit të shoqërisë që është çimentoja duke u ndërtuar edhe bilanci material, lëvizjet e tij si dhe është kryer përlllogaritja për prodhimin e çimentos. Gjatë periudhës objekt kontrolli shoqëria ka realizuar edhe operacionet e blerjes dhe shitjes së apartamenteve, për të cilat nga ana e inspektorit tatimor nuk është kryer një analizë në lidhje me bilancin material të tyre. Nga ndërtimi i bilancit material në bazë të të dhënave të paraqitura në raport kontrolli dhe pasqyrat financiare të deklaruara në c@ts për apartamentet konstatohen diferencat e paraqitura si më poshtë:

Viti	Gjendje fillim	Blerje gjate vitit	Shitje	Gjendja sipas pasqyrave	Gjendje fund llogaritur	Diferenca ne vlere
2017	501,983,903	281,897,000	112,659,240	587,629,334	671,221,663	(83,592,329)
2018	587,629,334	538,415,492	443,457,584	663,214,589	682,587,242	(19,372,653)
2019	663,214,589	59,245,503	391,144,326	350,146,025	331,315,766	18,830,259
2020	350,146,025	12,250,867	18,920,986	335,690,407	343,475,906	(7,785,499)

Për vitet në të cilat konstatohen diferenca në vlera negative konsiderohen si shitje e padekluarar si pasojë e diferencave në inventar për të cilat llogariten detyrimet si më poshtë:

Viti/përshkrimi	Vlera	
	2017	(83,592,329)
	2018	(19,372,653)
	2020	(7,785,499)
<b>Totali</b>		<b>(110,750,481)</b>

**Detyrimi për Tatim Fitimin 110,750,481\* 15% = 16,612,572 lekë**

**Gjobë 16,612,572 \* 100%= 16,612,572 lekë.**

**Efekt i financiar i shmangur me efekt të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit është në shumën 33,225,144 lekë.**

Gjithashtu konstatohet se nga ana e tatimpaguesit në vitin 2018 është kryer riklasifikimi sipas pasqyrave financiare ku apartamente në vlerë 663,214,589 lekë, nga llogaria e aktive të mbajtura për investim kanë kaluar në inventarë të tatimpaguesit. Sipas llogarisë së lëndëve të para të analizuar në raport kontrolli konstatohet se e gjithë kjo vlerë ka kaluar në shpenzime të periudhës për vitin 2018 duke mos u analizuar nga ana e inspektorit tatimor dhe ky trajtim nuk ka rezultuar i njëjtë në vitet financiarë 2019 dhe 2020.

Në të njëjtën kohë, ri klasifikim ka pësuar edhe llogaria e paradhënies për apartamente e cila ka kaluar në llogarinë e inventarëve dhe jo në llogarinë e parapagimeve pasi shoqëria nuk i ka në formë fizike të zotërueshme sipas klasifikimit dhe një gjë e tillë nuk rezulton të jetë analizuar në raport kontrolli nga ana e inspektorit tatimor.

-Nga auditimi konstatohet se nga ana e inspektorit tatimor është kryer analiza e shpenzimeve të pazbritshme të deklaruara vetëm për vitin 2017, duke mos u analizuar vitet 2018-2020 me efekt në mos marrjen siguri në lidhje me fitimin e tatueshëm fiskal për vitet 2018-2020.

Në lidhje me konstatimet e mësipërme për tatimpagues F. K. C. F , nga ana e subjektit të audituar janë paraqitur observacione duke pretenduar si më poshtë:

*-Në datën 01.01.2016 gjendja e kartelës së apartamenteve është 151,832,018 lekë e përbërë nga apartamentet sipas bilancit të vitit 2015..*

*Gjatë vitit 2016 janë bërë blerje 350,151,885 lekë, nga këto: 1. Blerje njësisht ndërtimi në vlerën 228,382,750 lekë; 2. Kemi 11 njësi ndërtimi vetëm me kontrata për secilën njësi, për këto njësi nuk janë bërë faturat e shitjes nga ndërtuesit. Duke qenë se mungonin faturat shoqëria ka bërë kontabilizimin nëpërmjet kontratave me kursin e BSH në datën e kontratës, pra nuk janë deklaruar në librat e blerjes mqs nuk kishte se çfarë të deklarohej por janë bërë regjistrimet e transaksioneve në bilancin e vitit 2016. 3.kemi mobilim njësisht ndërtimi në vlerën 2,473,007 lekë, kjo vlerë në vitin 2016 është kapitalizuar tek vlera e apartamenteve.*

*Diferencat e blerjeve për vitin 2017 vijnë për arsyet e mëposhtme: 1. Blerje njësisht me faturë në vlerën 186,635,169 lekë. 2. Stornim i regjistrimit të blerjeve të njësisve të vitit 2016 pa faturë, duke qenë se ndërtuesit i lëshuan faturat në vitin 2017 në vlerën 119,296,128 lekë. Ky stornim është reflektuar në bilanc por nuk ka patur efekt në deklarimin e librave të blerjes. 3. Regjistrimi i faturave të blerjeve të njësisve të vitit 2016 me faturat e lëshuara në vitin 2017. Në këtë moment shoqëria ka deklaruar në librat e blerjes faturat e blerjeve të njësisve në vlerën 116,167,651 lekë. 4. Diferenca e kursit të këmbimit mes vlerës së kontabilizuar në bilancin e vitit 2016 dhe kursit të faturës në vitin 2017 është në vlerën 3,128,477 lekë. 5. Kemi blerje për 2 njësi ndërtimi pa faturë por me kontratë, vlera 15,497,856 lekë. 6. Kemi mobilim njësisht ndërtimi në vlerën 16,267 lekë, kapitalizuar te vlera e apartamenteve.*

*Diferencat e blerjeve për vitin 2018 vijnë për arsyet e mëposhtme: 1. Diferenca në vlerën 2,489,274 lekë vjen nga kapitalizimi i mobilimit të apartamenteve. Në vitet 2016-2017 ky zë është kapitalizuar ndërsa në vitin 2018 është stornuar veprimi i kapitalizimi dhe është kaluar në shpenzim të panjohur. Diferencat e shitjeve në vlerën 16,883,379 lekë vijnë për shkak se llogaritjet për pakësimin e apartamenteve janë bërë mbi vlerën e shitjes, ndërsa gjendja sipas pasqyrave është bërë në bazë të kostos së apartamenteve. Shitjet nën kosto janë klasifikuar si shpenzime të panjohura.*

*Diferencat e blerjeve për vitin 2019 vijnë për arsyet e mëposhtme: 1. Kemi blerje me faturë në vlerën 59,245,503 lekë për dy njësi. 2. Diferencë kursi mes faturës dhe deklarimit në bilanc në vlerën 49,902 lekë për apartamentin e blerë nga F. B.. 3. Kemi blerje pa faturë për dy njësi në shumën 39,358,638 lekë. 4. Kemi mobilim për një apartament të shitur në vlerën 960,000 lekë. Diferencat e shitjeve në vlerën 21,438,476 lekë vijnë për shkak se llogaritjet për pakësimin e apartamenteve janë blerë mbi vlerën e shitjes, ndërsa gjendja sipas pasqyrave është bërë në bazë të kostos së apartamenteve. Shitjet nën kosto janë klasifikuar si shpenzime të panjohura.*

*Diferencat në shitje për vitin 2020 vetëm në shitje në vlerën 7,785,499 lekë vijnë për shkak se llogaritjet për pakësimin e apartamenteve janë bërë mbi vlerën e shitjes ndërsa gjendja sipas pasqyrave është bërë në bazë të kostos së apartamenteve.*

*-Gjithashtu përse theksohet për ri klasifikim llogarisht sqarojmë se riklasifikimi ka ndodhur nga një llogari bilanci në një tjetër dhe asnjë nga këto ri klasifikime nuk ka kaluar në shpenzime.*

Në përgjigje të këtyre observacioneve sqarojmë se konstatimi i grupit të auditimit përfshin faktin thelbësor të mos kryerjes dhe mos paraqitjes së bilancit material në raportin e kontrollit tatimor për apartamentet si një nga komponentët kryesorë të shitjeve të shoqërisë, përveç produktit kryesor të saj çimentos. Në këto kushte, vlerat e pasqyruara në konstatim përfshijnë gjendje fillestare dhe gjendje përfundimtare sipas deklaramit në pasqyrat financiare, ndërkohë që aktiviteti gjatë vitit për hyrjet dhe daljet e apartamenteve është marrë nga faktet e paraqitura në raportin e kontrollit tatimor. Për rrjedhojë, paraqitja me observacione e tabelave përtej periudhës së kontrolluar si dhe të pa mbështetur me evidencë dokumentare për deklarimet e njëanshme me observacione, të cilat nuk përbëjnë evidenca auditimi, kushtëzon mos marrjen në konsideratë të observacioneve.

**Titulli:** **Analiza jo të plota të dhe të pa dokumentuara të krahasimit të shitjeve me koston e blerjes së mallrave**

**Situata:** Nga auditimi i raporteve të kontrollit të përzgjedhura, konstatohet se nga ana e inspektorëve tatimor nuk është kryer një analizë e detajuar për tu siguruar që nuk janë realizuar shitje nën kosto për produktet e tregtuara. Nuk është kryer një analizë sipas produkteve në lidhje me çmimin e blerjes dhe çmimin e aplikuar të shitjes në mënyrë që të provohet shitja mbi marzh për produktet e përzgjedhura, por vetëm janë mesatarizuar çmimet e shitjes dhe blerjes për produktet e marrë në analizë. Ky konstatim përfshin konstatimet e arritura nga auditimi i raporteve të kontrollit tatimor të ushtruar në tatimpaguesit A., Kp T. D., A., G., A. G. T. dhe B. Në disa raste, analiza nuk përfshin diferencimin e shitjeve drejt tatimpaguesve me shumicë dhe atyre me pakicë, mbi të cilët aplikohen çmime të ndryshme, fakt që nuk rezulton të jetë analizuar gjatë kontrolleve dhe të jetë pasqyruar në raportin e kontrollit tatimor. Në sektorë specifikë, si ai i energjisë elektrike për G. nuk rezulton të jetë analizuar shitjet me metodën e identifikimit specifik për vetë natyrën e energjisë elektrike që nuk magazinohet dhe në sektorin e gazit nuk janë trajtuar shitjet e diferencuara për çmime të ndryshme të gazit për automjete dhe atij për konsum familjar, të cilët paraqesin çmime të ndryshme të aplikuara.

Në dy raste në kontrollet e ushtruara në tatimpagues A. G. T. dhe A. P. C. nuk rezultojnë të jenë analizuar çmime preferenciale të shitjes për aktivet të dhëna në përdorim, pasi në raportin e kontrollit nuk rezulton të jetë kryer një analizë në lidhje me plotësimin ose jo të kushteve sipas Neni 18, pika 1, germa i te udhëzimit nr.6, date 30.01.2015 "Për Tatimin mbi vlerën e Shtuar" ku shprehet se "Në rast se klienti, të cilit i është dhënë në përdorim aktivi nga furnizuesi i tij, paguan të njëjtin çmim si edhe një klient, i cili thjesht blen mallra pa marrë në përdorim aktive të kësaj natyre, atëherë nuk llogaritet TVSH mbi dhënie në përdorim të aktiveve".

**Kriteri:** Manuali i kontrollit tatimor, Ligji nr. 92/2014 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë", I ndryshuar

**Ndikimi/Efekti:** Programet përkatëse të miratuara të kontrollit  
Mungesë e sigurisë për deklarimin e saktë të shitjeve mbi koston e mallit të shitur

**Shkaku:** Mos kryerja e analizave të sakta dhe mungesë evidencash shoqëruese të raporteve të kontrollit

<b>Rëndësia:</b>	E lartë
<b>Rekomandimi:</b>	<p>Nga ana e DTM në hartimin e programeve të kontrollit në tatimpagues që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në sektorin e tregtisë të përcaktohet një metodologji e qartë e kontrollit duke shmangur mesatarizimet në analizën e marzheve në mënyrë që të arrihet siguria për deklarimin e saktë të detyrimeve tatimore.</p> <p>Nga DTM për sektorë të veçantë si ai i tregtimit të energjisë elektrike dhe tregtimit të gazit natyror të përcaktohen metodologji të specifikuar për kryerjen e kontrollit të krahasimit çmimesh të aplikuara dhe krahasimit me koston e mallit të shitur.</p> <p>Në rastin e subjekteve që së bashku me tregtimin e produkteve ofrojnë për përdorim aktive në mënyrë që të realizojnë shitjet, të implementohet në program kontrolli analiza mbi çmimet e diferencuara të shitjes me qëllim saktësimin e aplikimit ose jo të TVSH-së.</p>
<b>Titulli:</b>	<b>Mungesë analizash në raport kontrolli të sjelljes së tatimpaguesit në drejtim të huadhënies/huamarrjes nga palë të treta jo institucione financiare.</b>
<b>Situata:</b>	<p>Nga auditimi u konstatua se, gjatë zhvillimit të aktivitetit të tyre tatimpaguesit A., Kp T. D., A., dhe A. G. T., B. në periudha të ndryshme kohore kanë kryer transaksione huamarrje apo huadhënie me ortakun apo me tatimpagues të tjerë. Këto transaksione nuk konfirmohen me saktësi në raportet e kontrollit tatimor, si pagesa të kryera nëpërmjet sistemit bankar dhe të pasqyruara me prova shkresore në aktet e mbajtura nga inspektorët e kontrollit, si dhe nuk janë aplikuar interesa. Nuk është kryer karakterizimi i operacioneve me ortakun në kushte tregu duke llogaritur të ardhura të tatueshme nga interesi dhe nuk detajohen huadhëniet e ortakut apo të tatimpaguesve të tjerë, për të kontrolluar thelbin tregtar të operacioneve të angazhimit të tatimpaguesve, si dhe për të kontrolluar mundësinë e shmangies së detyrimit të dividendit nëpërmjet tërheqjeve me llogarinë e ortakut duke shmangur detyrimet tatimore.</p> <p>Nga auditimi konstatohet se nuk është kryer një analizë në lidhje me marrëdhëniet e huasë të dhëna apo të marra me tatimpagues të tjerë duke qenë se objekti i veprimtarisë së shoqërisë nuk është huadhënia si dhe në rastin e huadhënies ajo nuk është orientuar drejt institucioneve të licensuara për të ushtruar këtë aktivitet në Republikën e Shqipërisë. Nuk rezulton të jetë kryer një analizë në lidhje me kushtet e huadhënies dhe thelbin ekonomik të tyre si dhe llogaritjen e interesave sipas rastit për tepricat e tyre të raportuara në pasqyrën e pozicionit financiar.</p> <p>Këto veprime financiare vlerësohen pa thelb ekonomik dhe në kundërshtim me parimin e vlerës së tregut, me përcaktimet e germave “b”, “c” dhe “dh” të nenit 71, gjerat “a”, “b”, “c” dhe “ç” të nenit 71/2 dhe germa “ç” të neni 72 të ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 24, datë 02.09.2008 i ndryshuar. Për këto raste nuk është kryer vlerësim alternativ i situatës financiare së shpenzimeve të interesit të pallogaritura në PASH, si rrikarakterizim të ardhurash duke sjellë si pasojë detyrime tatimore.</p>
<b>Kriteri:</b>	ligji nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	programet individuale të kontrollit tatimor
	Mundësi shmangie të tatimit mbi dividendin, shmangie të detyrimeve tatimore të tjera nga anashkalimi i thelbit ekonomik të transaksioneve mbi formën e

<b>Shkaku:</b>	paraqitur Mos kryerja e analizave në raport kontroll dhe mos respektimi i programeve të kontrollit
<b>Rëndësia:</b>	E lartë
<b>Rekomandimi:</b>	Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj t'i kërkojë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve të hartojë një akt administrativ për analizimin e llogarisë së ortakut, në rastet kur konstatohen se jepen hua ose shuma nga llogaria e ortakut në favor të llogarisë së shoqërisë, ku ata janë ortakë ose anasjelltas, për raste kur këto hua jepen pa interes. - Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj në bashkëpunim me DPT, të analizojë situatën e kontrollit të kryer në subjektet "A." SHPK, "KP." SHPK, "A." SHPK, "A. G. T." SHA dhe "B. E." SHPK, referuar gjetjeve nga auditimi i KLSH-së, si dhe të vlerësojë përcjelljen e tyre pranë strukturës kompetente pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, për vlerësimin dhe identifikimin e mëtejshëm të burimeve të financimit.
<b>Titulli:</b>	<b>Mangësi në mungesën e kryerjes së inventarizimit fizik dhe analizën e prodhimit.</b>
<b>Situata:</b>	Nga auditimi i dosjeve të kontrollit konstatohet në disa raste në tatimpaguesit B. dhe A. G. T. nuk është kryer inventarizimi fizik megjithëse ai ka qenë pjesë e programit të kontrollit dhe është kërkesë e manualit të kontrollit tatimor. Në raste të tjera në praktikat e audituara, megjithëse është kryer konstatohet se përzgjedhja e kampionit të inventarit nuk është e argumentuar si përfaqësuese e popullatës pasi mbi këto produkte të përzgjedhura kryhet edhe analiza e bilancit material, duke mos marrë siguri në lidhje me kontrollin e ushtruar. Në rastin e subjektit B., mos kryerja e inventarizimit fizik është shoqëruar edhe me mos kryerje të analizës së proceseve të prodhimit sipas kartës të teknologjike e cila rezulton e pa miratuar nga organet kompetente, në kundërshtim me aktet nënligjore për tatimin mbi fitimin. Në raste të tjera, në kontrollin e ushtruar në tatimpagues E., analiza e kryer për respektimin e kartës teknologjike rezulton t jetë përgjithësuese dhe jo specifike për produktet e marra në analizë për inventarizim fizik dhe për të cilat është ndërtuar bilanci material. Këto kontrolle janë jo në përputhje me kërkesat e manualit të kontrolli tatimor
<b>Kriteri:</b>	Manuali i kontrollit tatimor
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Analiza jo përfaqësuese për inventarin dhe sasi të prodhimit e shitjes
<b>Shkaku:</b>	Mos kryerja e inventarit fizik dhe analizës së prodhimit
<b>Rëndësia:</b>	E lartë
<b>Rekomandimi:</b>	Nga ana e DTM, në subjektet që përfshijnë procese prodhimi dhe përpunimi të cilat janë objekt miratimit të kartës teknologjike, të kryhet verifikimi i miratimit të gjitha kartave teknologjike në rast se janë dorëzuar pranë organit tatimor. Nga ana e DTM, të përcaktohet kampioni i përzgjedhur për auditim pas miratimit nga strukturat drejtuese si aneks i programit të kontrollit tatimor përpara fillimit të tij, në mënyrë që të jetë përfaqësues.
<b>Titulli:</b>	<b>Mangësi të identifikuar në auditimin e praktikës së kontrollit të zhvilluar në tatimpagues KP T. &amp; D. SHPK për mos deklarim të ardhurash nga shitja e ambalazheve</b>
<b>Situata:</b>	Nga auditimi mbi kontrollin e ushtruar në tatimpaguesin KP T. & D. SHPK me NIPT L.K janë konstatuar mangësi të cilat përfshijnë:

- Në raportin e kontrollit është kryer analiza e bilancit material për një numër të kufizuar artikujsh ku janë krahasuar vit pas viti lëvizja e mallrave në sasi duke u shprehur që janë kryer rigrupime të artikujve po pa ndryshuar vlerë, megjithëse kostot e artikujve të grupuar janë të ndryshëm.

- Në analizën e kryer për efekt të TVSH në shitjet e përjashtuara janë përfshirë vlera e ambalazheve të kthyeshme, konkretisht shishe në vlerën 25,123,447 leke. Për analogji, në vitin 2018 blerjet e ambalazhit nga C.C i ka raportuar si blerje të përjashtuara. Për këtë arsye shitjet e tatueshme sipas deklarimeve rezultojnë të jenë nënvlerësuar për shumën 25,123,447 lekë dhe **detyrimi tatimor për tatim fitimin vlerësohet në shumën 4,593,822 lekë.**

-Nga ana e inspektorit tatimor nuk rezulton të jetë ushtruar kontroll tatimor për shitje në tatimpagues në statusin pasiv duke qenë se tatimpaguesi objekt kontrolli ka precedencë në shitje të realizuar në subjekte sipas shkresës për fillimin e kontrollit.

-Në analizën e kryer në raportin e kontrollit tatimor në krahasimin e shpenzimeve të raportuara në pasqyrën e performancës financiare me deklaratimet në FDP të TVSH konstatohet se ekzistojnë diferenca nga rakordimi përse i përket rregullimeve për efekt të shtesës së aseteve gjatë vitit dhe ndryshimit të gjendjes së materialeve. Për rrjedhojë janë mbivlerësuar një pjesë e shpenzimeve të periudhës për diferencën e cila duhet të trajtohej si një shtesë e aseteve dhe jo shpenzim i zbritshëm për vitin. **Për këtë arsye shpenzimet e zbritshme duhet të rivlerësohen për 722,719 lekë (dhe detyrimi tatimor për tatim fitimin vlerësohet në shumën 132,149 lekë.**

-Në lidhje me ndryshimin e gjendjes së inventarit për efekt rakordimi të FDP me pasqyrën e performancës konstatohet se nuk është përfshirë ndryshimi i gjendjes së materialeve të para (ambalazhe) në vlerën 354,198 lekë. Në vitin 2017 për efekt të rakordimit të shpenzimeve sipas FDP me shpenzimet sipas PASH ndryshimi i gjendjes së mallrave nuk ka përfshirë ndryshimin e gjendjeve të materialeve të para (ambalazhe) në shumën 1,892,715 lekë gjatë analizës së kryer.

**Në total, efekti financiar i shmangur me efekt të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit është në shumën 4,725,971 lekë.**

<b>Kriteri:</b>	Ligji për tatimin mbi të ardhurat
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Të ardhura të munguara për tatim fitimin
<b>Shkaku:</b>	Mos raportimi i të ardhurave të përjashtuara për ambalazhe në deklaratën e tatim fitimit, analiza jo e saktë e rakordimet pasqyra fdp
<b>Rëndësia:</b>	E lartë
<b>Rekomandimi:</b>	Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj, referuar mangësive dhe parregullsive në procedurën e kontrollit, vlerësuar me efekte negative në të ardhurat tatimore, në përputhje me kërkesat ligjore dhe proceduriale, të kryejë rikontroll tatimor me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit të evidentuara paraprakisht në vlerën prej <b>4,725,971</b> lekë.
<b>Titulli:</b>	<b>Mangësi të identifikuar në auditimin e praktikës së kontrollit të zhvilluar në tatimpagues Byllis energji për kreditim të padrejtë të TVSH</b>
<b>Situata:</b>	Nga auditimi mbi kontrollin e ushtruar në tatimpaguesin B. E. SHPK me NIPT L.I janë konstatuar mangësi të cilat përfshijnë: - Nga auditimi konstatohet se nga ana e inspektorëve tatimorë rezulton të mos jetë kontrolluar transaksioni i qeradhënies së makinerive apo aseteve të tjera të cilat bëjnë pjesë në asetin gjenerues të parasë, duke qenë se shoqëria ka marrë me qera të gjithë rafinerinë me të gjitha asetet që ajo disponon nga pronari i saj



“A. E.”. Në këtë mënyrë, referuar përcaktimeve të bëra në ligjin “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar, qiradhënia e aseteve të tjera nga ndërtesa, është furnizim i tatueshëm me TVSH dhe në këtë mënyrë ky transaksion duhet të ishte objekt kontrolli dhe përcaktimi të shumës së TVSH e cila duhet të ishte e pagueshme për një tatimpagues dhe e kreditueshme për tjetrin, por që në total do të paraqiste të ardhura shtesë për buxhetin e shtetit nga TVSH.

- Nga auditimi konstatohet se në raport kontrolli nuk është kryer një analizë për shitjet e analizuara nga shoqëria në lidhje me sasinë e produktit të përpunuar duke qenë se të ardhurat nga shitja janë të lidhura në mënyrë të drejtpërdrejtë me sasinë e produktit të përpunuar sipas tarifës së përpunimit të përcaktuar në kontratë ndërmjet palëve. Nga ana e inspektorëve tatimorë nuk është kryer bilanci material i mallrave përgjatë periudhës objekt kontrolli, duke vendosur në dyshim kreditueshmërinë e TVSH për këto produkte dhe nëse ato i kanë shërbyer aktivitetit ose jo. Kjo sepse shitjet e tatimpaguesit përbëhen nga ofrim shërbimi dhe nuk përfshijnë tarifimin për shitjen e materialeve të tjera, duke qenë jashtë objektit të veprimtarisë së tij. Duke mos u kryer bilanci material nuk verifikohet saktësia e blerjeve të tatueshme dhe importeve për qëllime të aktivitetit të tatueshëm.

-Në blerjet e tatueshme, konstatohet se janë përfshirë blerje për materiale të para në procesin e prodhimit që përfshijnë sipas pasqyrave financiare artikujt aditiv dhe katalizator. Sipas marrëdhënies së përshkruar në raport kontrolli tatimor dhe shpjegimeve të dhëna nga ana e inspektorit tatimor, nga ana e tatimpaguesit është marrë me qera rafineria së bashku me mjetet si një e tërë dhe duke punësuar punonjësit e specializuar është ofruar shërbimi për përpunimin e naftës bruto për llogari të tatimpaguesit T. E., i cili është zotërues i materialit të parë dhe produkteve që përfitohen nga procesi i përpunimit. Ky argumentim është përdorur për marrëdhënien e krijuar sipas së cilës nafta bruto nuk bëhet hyrje të tatimpaguesi B. por është gjatë gjithë kohës në pronësi të T. E.. Në të njëjtën logjikë, edhe materialet e tjera të cilat janë në funksion të procesit të përpunimit (aditiv, katalizator) i nënshtrohen të njëjtit parim dhe për këtë arsye, blerjet e realizuara nga tatimpaguesi B. konstatohet se nuk i shërbejnë aktivitetit të tatueshëm të tij, por tatimpaguesit T. E. duke qenë se referuar modelit të biznesit të paraqitur në raportin e kontrollit tatimor dhe faktit të qënies së tatimpaguesit T. E. si subjekt i prodhimit të mallrave të akcizës (naftës dhe nënprodukteve të saj). Për këtë arsye, është vendosur në dispozicion kontrata e lidhur ndërmjet palëve ku përcaktohen të drejtat dhe detyrimet, tarifa, mallrat, depozitimi etj. Nga analiza e kësaj kontrate dhe marrëdhënies së krijuar ndërmjet tatimpaguesve konstatohet se në çdo rast shoqëria B. E. është përgjegjëse vetëm për procesin e përpunimit, duke qenë se për materialet e para dhe produktet e gatshme është përgjegjëse shoqëria T. E. dhe tarifa e përcaktuar në marrëveshje ndërmjet palëve përfshin çmimin e dakortësuar vetëm për ofrimin e përpunimit me asetet përpunuese dhe angazhimin e punonjësve për procesin e transformimit të lëndëve të para në produkt të gatshëm. Në këtë mënyrë konstatohet se shoqëria B. E. ka përfshirë në blerje të kreditueshme solucione dhe hollues (të cilat ndryshojnë natyrën dhe cilësinë e produktit të gatshëm), që janë materiale të para në procesin e përpunimit të naftës bruto, për të cilat ka kredituar TVSH, në një kohë që subjekt i autorizuar në regjimin e magazinës fiskale për përpunimin e mallrave të akcizës është shoqëria T. E.. Për këtë arsye, blerjet e kryera për solucion dhe hollues nuk i shërbejnë aktivitetit të shoqërisë B. E. por, shoqërisë T. E. dhe rrjedhimisht nuk duhet të ishte kredituar TVSH. Efekti financiar i shmangur

me efekt të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit është në shumën 56,146,215 lekë detyrime për tatimin mbi vlerën e shtuar, si dhe uljen e humbjes në vlerën 230,296,205 lekë.

**Kriteri:**

Ligji për tatimin mbi vlerën e shtuar i ndryshuar

**Ndikimi/Efekti:**

Të ardhura të munguara në shumën 56,146,215 lekë

**Shkaku:**

Kreditimi i padrejtë i TVSH

**Rëndësia:**

E lartë

**Rekomandimi:**

Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj, referuar mangësive dhe parregullsive në procedurën e kontrollit, vlerësuar me efekte negative në të ardhurat tatimore, në përputhje me kërkesat ligjore dhe proceduriale, të kryejë rikontroll tatimor me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit të evidentuara paraprakisht në vlerën prej 56,146,215 lekë si dhe ulja e humbjes në vlerën 230,296,205 lekë.

**Titulli:**

**Mangësi të identifikuar në auditimin e praktikës së kontrollit të zhvilluar në tatimpagues A. si pasojë e deklarimit jo të drejtë të të ardhurave të shtyra**

**Situata:**

Nga auditimi mbi kontrollin e ushtruar në tatimpaguesin A. SHPK me NIPT J.Q janë konstatuar mangësi të cilat përfshijnë:

-Nga analiza e kryer për inventarin e paraqitur sipas pasqyrave financiare të raportuara dhe të analizuara në raport kontrolli konstatohet se është paraqitur llogaria analitike e inventarit të imët e cila paraqitet me një tepricë negative në shumën (-6,392,655) për vitin 2020, duke mos u analizuar nga inspektori në lidhje me vërtetësinë e gjendjes negative të llogarive të inventarit si dhe efektet që ajo paraqet në rakordimin e kryer me fdp dhe koston e mallrave të shitura si pasojë e ndryshimit të gjendjeve.

-Nga auditimi konstatohet se janë paraqitur situacione si shitje të tatueshme drejt vetë tatimpaguesit në pjesën e parë të analizës së kryer nga kontrolli. Sipas shpjegimeve dhëna nga ana e inspektorit tatimor kjo mënyrë faturimi dhe deklarimi është kryer nga tatimpaguesi për ato raste kur ka kryer punime të evidentuara me situacione përkatëse të cilat ende nuk janë marrë në dorëzim nga ana e përfituesit të punimeve të ndërtimit. Më pas, pas marrjes në dorëzim dhe kolaudimit të punimeve është kryer anulimi i faturës paraardhëse të shitjes dhe faturimi drejt përfituesit të punimeve të ndërtimit në të njëjtën vlerë. Kjo praktikë nuk është në përputhje me parashikimet e bëra në udhëzimin për TVSH, neni 20, ku përcaktohet që faturimi duhet të kryhet çdo muaj drejt përfituesve të shërbimit.

- Nga auditimi konstatohet se për vitin 2020, në analizën e kryer për efekt të tatim fitimit janë kryer rakordimet për të ardhurat për efekt të tatim fitimit me qarkullimin e raportuar për efekt të TVSH-së. Në këtë rakordim është ulur vlera e të ardhurave për efekt të tatim fitimit si pasojë e zbritjes së të ardhurave të shtyra të arkëtuara gjatë periudhës duke zvogëluar të ardhurën e tatueshme. Nga analiza e shënimeve shpjeguese në të ardhurat e shtyra konstatohet se në këtë llogari, shuma prej 282,211,471 lekë i përket arkëtimeve të marra po nga A., pra nga vetë tatimpaguesi për punimet e kryera të cilat nuk janë marrë në dorëzim. Ky veprim duhet të pasqyrohet në zërin e bilancit klientë pasi janë punime të kryera drejt të tretëve dhe nuk duhet të trajtohet si autofaturim. Referuar gjendjes së raportuar të kësaj llogarie dhe faktit që është e pamundur që tatimpaguesi të faturojë dhe arkëtojë po nga vetja për punime konstatohet se është zvogëluar padrejtësisht e ardhura e tatueshme për efekt të tatimit mbi fitimin për vitin 2020 duke sjell një efekt si më poshtë:

*Detyrimi për Tatim Fitimin 282,211,471 \* 15% = 42,316,721 lekë*

*Gjobë 42,316,721 \* 0.06% x 365 ditë = 9,267,362 lekë.*

*Efekti financiar i shmangur me efekt të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit është në shumën 51,584,082 lekë.*

-Nga auditimi konstatohet se gjatë vitit 2020 aktivet e tatimpaguesit janë shtuar si pasojë e bashkimit me përthithje me një shoqëri tjetër. Nga ana e inspektorit tatimor nuk rezulton të jetë analizuar procesi i bashkimit me përthithje në kuadër të transferimit drejt tatimpaguesit të të drejtave dhe detyrimeve që mbart subjekti i përthithur në bazë të parashikimeve të bëra në legjislacionin e TVSH në rastin e përthithjeve.

-Nga ana e inspektorit tatimor nuk rezulton të jetë analizuar procesi i prodhimit të betonit dhe respektimi i kartës teknologjike në lidhje me sasitë e përdorura të materialeve për prodhimin e tij dhe lëvizjet e këtyre materialeve, sipas vlerave të paraqitura në akt konstatimin e mbajtur nga ana e inxhinierit.

**Kriteri:**

Ligji për tatimin mbi vlerën e shtuar

Ligji për tatimin mbi fitimit

Manuali i kontrollit tatimor

**Ndikimi/Efekti:**

Të ardhura të munguara për tatimin mbi fitimin *në shumën 51,584,082 lekë.*

**Shkaku:**

Raportimi i të ardhurave si të ardhura të shtyra

**Rëndësia:**

E lartë

**Rekomandimi:**

Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj, referuar mangësive dhe parregullsive në procedurën e kontrollit, vlerësuar me efekte negative në të ardhurat tatimore, në përputhje me kërkesat ligjore dhe proceduriale, të kryejë rikontroll tatimor me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit të evidentuara paraprakisht në vlerën prej *51,584,082 lekë.*

**Titulli:**

**Mangësi të identifikuar në auditimin e praktikës së kontrollit të zhvilluar në tatimpagues A. si pasojë e situacioneve të padeklaruara si shitje dhe shitjeve të betonit të padeklaruara**

**Situata:**

Nga auditimi mbi kontrollin e ushtruar në tatimpaguesin "A." SHPK me NIPT J.K janë konstatuar mangësi të cilat përfshijnë:

-Nga auditimi në lidhje me këtë praktikë konstatohet se nuk është kryer një analizë e blerjeve të tatueshme brenda vendit sipas natyrës së tyre prej furnitorëve kryesorë, me përjashtim të punimeve të kryera nga ana e nënkontraktorëve, duke mos dokumentuar të drejtën për kreditueshmërinë e tatimit mbi vlerën e shtuar për të gjithë periudhën e kontrolluar.

-Analiza e kryer në lidhje me lëvizjen e materialeve rezulton të jetë e pa plotë duke mos e detajuar dhe paraqitur evidenca sipas objekteve të ndërtimit dhe krahasimit me preventivat përkatës të miratuar.

-Shitjet e analizuar në raport kontrolli drejt tatimpaguesve dhe sipas situacioneve përkatëse nuk rakordojnë me shitjet e deklaruara në deklaratën e TVSH sipas periudhave të analizuar. Këto diferenca përfshijnë shitje të padeklaruara si pasojë e diferencave me situacionet të cilat paraqesin detyrime në lidhje me TVSH dhe tatim fitimin për tatimpaguesin në shumën totale 25,518,274 lekë.

-Në analizën e pasqyrave financiare, si pjesë e raportit të kontrollit mbi tatimin mbi fitimin konstatohet vlerë e lartë e aktiveve afatshkurtra në shumën 771 milion lekë, në rritje vit pas viti dhe argumentimi i kryer në lidhje me këtë llogari është i gabuar duke i paraqitur si detyrime ndaj të tretëve, ndërkohë që duhet të pasqyrohen të drejta për të arkëtuar ndaj të tretëve. Nga ana e inspektorit tatimor nuk rezultojnë të jenë analizuar këto të drejta mbi

marrëdhëniet dhe thelbin ekonomik të transaksioneve që kanë sjellë lindjen e këtyre të drejtave duke qenë se përbëjnë një zë material të pasqyrave financiare.

- Në analizën e furnitorëve, si pjesë e detyrimeve drejt ndaj të tretëve janë përfshirë furnitorë me vlerë negative në shumën totale 44 milion lekë duke mos u analizuar nga inspektori për efekt të pakësimit negativ të detyrimeve dhe lidhjen me blerjet e realizuara përgjatë periudhës së kontrolluar.

-Në analizën e blerjeve të tatueshme raportohet që të ketë blerje për leasing pa e specifikuar vlerën përkatëse, ndërkohë që në blerjet e përjashtuara nuk raportohen blerje për leasing për vlerën e interesit e cila duhet të raportohet si blerje e përjashtuar, duke paraqitur mundësinë e kreditimit të TVSH për interesat e leasing të kryera nga tatimpaguesi, në kundërshtim me parashikimet e bëra udhëzimin për TVSH.

-Në raportin e kontrollit tatimor është kryer analiza për betonin e prodhuar nga tatimpaguesi për vitin 2017 dhe jo për vitet e tjera pavarësisht se në analizën e materialeve është shprehur për beton të blera dhe prodhuar nga shoqëria. Në betonin e prodhuar në vitin 2017 konstatohen diferenca ndërmjet sasisë së prodhuar sipas analizës së prodhimit të betonit me sasinë e deklaruar të situacionuar, duke paraqitur për disa lloje vlerë më të lartë të prodhuar por të pasituacionuar. Në analizën e kryer mbi lëvizjen e bilancit material dhe sasive të prodhuara të betonit të përdorur në situacione, konstatohet se një analizë e tillë është kryer vetëm për vitin 2017, pavarësisht se hyrjet e betonit për vitet e tjera cilësohen si hyrje nga blerja dhe prodhimi. Për vitin 2017, konstatohen diferenca sipas analizës së bilancit material për sasinë e situacionuar dhe betonit të prodhuar nga vetë shoqëria të cilat përbëjnë shitje të pa deklaruara dhe implikojnë detyrime tatimore për TVSH dhe tatim fitimin në shumën 8,992,046 lekë.

***Efekt i financiar i shmangur nga ky kontroll tatimor me efekt të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit është në shumën 34,510,323 lekë.***

<b>Kriteri:</b>	Ligji për tatimin mbi vlerën e shtuar Ligji për tatimin mbi fitimin Ligji për procedurat tatimore Manuali i kontrollit tatimor
<b>Ndikimi/Efekt:</b>	Të ardhura të munguara në shumën 34,510,323 lekë
<b>Shkaku:</b>	Diferenca ndërmjet shitjeve të deklaruara dhe situacioneve si dhe shitjet e padeklaruara të betonit
<b>Rëndësia:</b>	E lartë
<b>Rekomandimi:</b>	Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj, referua mangësive dhe parregullsive në procedurën e kontrollit, vlerësuar me efekte negative në të ardhurat tatimore, në përputhje me kërkesat ligjore dhe proceduriale, të kryejë rikontroll tatimor me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit të evidentuara paraprakisht në vlerën prej <b>34,510,323</b> lekë.
<b>Titulli:</b>	<b>Mangësi të identifikuar në auditimin e praktikës së kontrollit të zhvilluar në tatimpagues A. nga mosrespektimi i kostos minimale fiskale në ndërtim dhe çmimit fiskal minimal të shitjes në ndërtim si dhe kreditim të padrejtë të TVSH.</b>
<b>Situata:</b>	Nga auditimi mbi kontrollin e ushtruar në tatimpaguesin <b>“A.” SHPK me Nipt</b> L.T janë konstatuar mangësi të cilat përfshijnë: - Nga auditimi është konstatuar se për lejen për objektin nr.4 në proces ndërtimi nga shoqëria, sipas lejes bashkëngjitur raport kontrollit, paraqesin

shoqërinë jo si të vetme në rolin e investitorit (dy investitorë sipas lejes së ndërtimit) dhe si të vetëm në rolin e ndërtuesit, çka ndryshon edhe trajtimin fiskal për efekt të njohjes së situacioneve të ndërtimit si investitor dhe në shitjet e përfunduar.

- Nga auditimi konstatohet se në raport kontrolli është kryer analiza e kostos mesatare të ndërtimit për efekt fiskal për objektet ndërtimore me shkallë përfundimi 100%, konkretisht sipas lejes së ndërtimit nr.1 dhe lejes së ndërtimit nr.2, duke u shprehur se janë respektuar kërkesat e legjislacionit në fuqi. Llogaritja e kostos mesatare nga ana e inspektorit tatimor është kryer si raport i situacioneve progresive me sipërfaqen e ndërtimit të investitorit duke zbritur pjesën e sipërfaqes ndërtimore të pronarëve të truallit. Nga auditimi konstatohet se kjo përllogaritje është e gabuar pasi kosto e ndërtimit sipas situacioneve i atribuohet të gjithë sipërfaqes ndërtimore sipas lejes së përcaktuar të ndërtimit dhe nga llogaritjet e kryera nga audituesit rezultojnë kostot mesatare më të ulëta, nën koston minimale fiskale të lejuara nga kuadri rregullator. Nga raporti i kontrollit dhe analiza e kryer nga grupi i audituesve të KLSH rezulton se subjekti i cili është në rolin e ndërtuesit dhe sipërmarrësit të punimeve, në këtë rast ka kryer faturime të situacioneve të punimeve të kryera poshtë nivelit të kostove mesatare që janë përcaktuar në *Udhëzimin e Këshillit të Ministrave Nr.3 "Miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2016"*. Kjo është situata e "*shitjes nën kosto*", konkretisht kjo situatë ku subjekti faturon nën kostot mesatare të miratuara ka sjellë ulje të pagesës së TVSH-së, si dhe ulje të tatimit mbi fitimin për veprime të cilat bien në kundërshtim me *nenin 124 "Kundërvajtjet në lëshimin e faturave tatimore, dëftesave tatimore dhe dokumentimin e transaksioneve" të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë"*, i ndryshuar.

Ndërsa në lidhje me subjektin investitor nga ana e inspektorëve të kontrollit duhet të ishin kryer veprime rregulluese duke rivlerësuar transaksionet (*vlera e situacioneve të punimeve të ndërtimit në blerje*) drejt vlerës minimale të për efekte fiskale sipas përcaktimeve ligjore në fuqi.

*Në zbatim të shkronjës c të nenit 71 "E drejta për të përdorur mënyra alternative vlerësimi", shkronjës ç dhe d të pikës 1 dhe të pikës 2 të nenit 71/2 "Përdorimi i metodave alternative të vlerësimit në rastet e veprimeve për shmangien e tatimit dhe abuzimit me parimet e ligjit tatimor" dhe shkronjës ç të pikës 1 të nenit 72 "Baza e mënyrave alternative të vlerësimit" të Ligjit Nr.9920, datë 19.5.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë"*, i ndryshuar

Në këtë rast do të bëhet rikarakterizimi i shpenzimeve shtesë të cilat rezultojnë nga përllogaritjet e grupit të auditimit por nuk do t'i njihen subjektit si shpenzime të zbritshme të cilat do të ishin n.q.s. do të ishin deklaruar korrekt nga subjekti. Pra nga grupi i auditimit është kryer rikarakterizimi i shpenzimeve dhe investimeve, ***diferenca midis vlerës së faturuar të situacioneve deri tek niveli i kostove minimale fiskale të ndërtimit***, të pa njohur dhe regjistruara nga subjekti si të ardhura dhe ndryshimi në deklaratën e tatimit do të bëhet në rritje të të ardhurave dhe të shpenzimeve, por shpenzimet nuk njihen si të zbritshme për efekt të tatimit fitimit.

Kurse penalizimi i subjektit nga ana e inspektorëve duhet të ishte kryer sipas *nenit 115 "Plotësim i pasaktë i deklaratës tatimore" të Ligjit Nr.9920, datë 19.5.2008 "Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë"*, i ndryshuar, *ku përcaktohet se: 1. Dorëzimi i një deklarate tatimore të pasaktë dënohet me*

*një gjobë të barabartë me 0,06 për qind të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë, gjatë së cilës pagesa nuk është kryer. Në asnjë rast, gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike. Efekti financiar i mosrespektimit të kostos minimale fiskale në ndërtim vlerësohet 46,563,960 lekë.*

-Nga auditimi konstatohet se janë përfshirë në blerje të tatueshme brenda vendit për të cilën është kredituar TVSH blerje në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 20 të udhëzimit nr.6 datë 30.01.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pasi janë kryer nga tatimpaguesi për aktivitetin e shijes së ndërtesave i cili është një furnizim i përjashtuar dhe jo në rolin e ndërtuesit që përfshin pjesën e aktivitetit të tatueshëm të tatimpaguesit. **Rrjedhimisht, TVSH në shumën 5,830,209 lekë është kredituar padrejtësisht nga tatimpaguesi ku rrjedhin detyrime për vlerën e tatimit të munguar si dhe gjobë për kreditim të gabuar në nivelin 21.6% të detyrimit në shumën 1,259,325 lekë, në total 7,089,534 lekë.**

- Nga auditimi konstatohet se sipas pasqyrave financiare, financimi i aktivitetit të ndërtimit është kryer nëpërmjet llogarisë së arkëtimeve në avancë. Kjo llogari nuk rezulton të jetë analizuar nga ana e inspektorit tatimor në kushtet kur sipas pasqyrave financiare kompania rezulton të jetë themeluar me kapital minimal prej 100 lekë dhe nga ana tjetër ka akumuluar deri në fund të vitit 2020 aktive nga ndërtimi për shitje në vlerën 1,797,606,135 lekë. Gjithashtu, në raportin e kontrollit të hartuar nga ana e inspektorit tatimor konstatohet se këto parapagime nuk janë raportuar në deklaratat e TVSH të dorëzuar nga ana e tatimpaguesit për periudhën 2018-2020, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 20 të udhëzimit nr.6 datë 30.01.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Shitjet e përjashtuara reuzltojnë të jenë analizuar vetëm për vitin 2021 në faqen 32-33 të raport kontrollit dhe rezulton të jenë analizuar 31 milion lekë paradhënie dhe 130 milion lekë të raportuara si shitje në bazë të kontratave noteriale përkatëse.

Nga auditimi konstatohet se në shitjet e analizuara për vitin 2021, në analizën e kryer nga inspektori tatimor nuk është respektuar kufiri minimal i çmimit të shitjes sipas zonës në të cilën ndodhet objekti në bazë të kriterëve të përcaktuara në *Udhëzimin e Këshillit të Ministrave Nr.3 “Miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2016”*. **Si rezultat i shitjes nën çmimin minimal të lejuar për efekte fiskale lindin detyrimet e për nënvlerësim të të ardhurave të përjashtuara në vlerën 15% të tatim fitimit të munguar ( $15\% * 12,023,908.84$ ) në shumën 1,803,586 lekë dhe gjobë në masën 100% 1,803,586 lekë për të ardhura të padeklaruara.**

- Nga auditimi konstatohet se pagesat për lejet e ndërtimit sipas analizës së shtesës së llogarisë aktive afatgjata të mbajtura për shitje janë akumuluar për herë të parë në vitin 2019, ndërkohë që procesi i ndërtimit ka filluar me situacionime në vitin 2018. Këto fakte në lëvizjen e llogarive tregojnë mundësinë e kreditimit të TVSH për situacionet përpara miratimit të lejes së ndërtimit sipas lejeve nr.1 dhe nr.2 të ndërtimit të cituara në raportin e kontrollit ose zbardhjes së dokumentit të lejes së ndërtimit përpara pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë nga tatimpaguesi. Nga ana e inspektorit tatimor nuk rezulton të jenë analizuar këto fakte për të arritur në konkluzione mbi të drejtën e kreditimit të TVSH për punimet përpara lindjes së të drejtës për të ndërtuar sipas aktit përkatës dhe përmbushjes së detyrimeve në lidhje me pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë.

<b>Kriteri:</b>	<p><b><i>Efekti financiar i shmangur me efekt të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit është në shumën 57,260,666 lekë.</i></b></p> <p><i>Ligjit Nr.92/2014 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar</i></p> <p><i>Ligjit Nr.9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar</i></p> <p><i>Ligji për tatimin mbi fitimin i ndryshuar</i></p> <p><i>Udhëzimin e Këshillit të Ministrave Nr.3 “Miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2016”;</i></p> <p><i>udhëzimi nr.6 datë 30.01.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar</i></p>
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në shumën 193,881,111 lekë
<b>Shkaku:</b>	Kreditimi i padrejtë, ndërtim dhe shtije nën vlerat e përcaktuar fiskale
<b>Rëndësia:</b>	E lartë
<b>Rekomandimi:</b>	<p>Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj, referuar mangësive dhe parregullsive në procedurën e kontrollit, vlerësuar me efekte negative në të ardhurat tatimore, në përputhje me kërkesat ligjore dhe proceduriale, të kryejë rikontroll tatimor me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit të evidentuara paraprakisht në vlerën prej <b>57,260,666</b> lekë.</p>
<b>Titulli:</b>	<p><b>Mangësi të identifikuar në auditimin e praktikës së kontrollit të zhvilluar në tatimpagues B. në diferenca të inventarit të deklaruar.</b></p>
<b>Situata:</b>	<p>Nga auditimi mbi kontrollin e ushtruar në tatimpaguesin “B.” SHA <u>me NIPT J.C</u> janë konstatuar mangësi të cilat përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-Nga auditimi konstatohet se në raport kontrolli është kryer analiza e bilancit material për lëvizjet e mallrave por nuk është kryer një analizë në lidhje me aktivitetin e prodhimit sipas kartës teknologjike të miratuar. Kjo analizë e munguar nuk dokumenton sasinë e përdorur të lëndës së parë për prodhim si dhe të produktit të gatshëm të pasqyruar në lëvizjet e bilancit material në të njëjtën kohë me shqyrtimin e humbjeve/firove të mundshme nga procesi i prodhimit.</li> <li>-Nga auditimi konstatohet se në analizën e klientëve të shoqërisë sipas pasqyrave financiare paraqiten si klientët për mallra e shërbime te pa arkëtuar ne fund te vitit, subjekti C. B. në shumën 49,530,300 lekë, ndërkohë që referuar objektit të veprimtarisë të kësaj banke të nivelit të dytë, nuk është argumentuar nga ana e inspektorit tatimor thelbi ekonomik i marrëdhënies së krijuar midis tyre referuar objekte të veprimtarisë së secilit tatimpagues.</li> <li>- Nga analiza e pasqyrave financiare, konstatohet se për vitin 2019, nga ana e tatimpaguesit nuk është llogaritur amortizim për pjesën më të madhe të asetëve, e cila nuk rezulton të jetë analizuar nga ana e inspektorit tatimor në kushtet kur tatimpaguesi ka ushtruar aktivitet përgjatë të gjithë periudhës objekt kontrolli dhe ka rezultuar me humbje të pa analizuar në mënyrë të detajuar.</li> <li>-Nga auditimi konstatohet se nga analiza e bilancit material për vitet 2019 dhe 2020 të paraqitur në raportin e kontrollit tatimor, për disa artikuj rezultojnë diferenca për produktet ambalazhe dhe miell në krahasim me inventarin analitik të dorëzuar nga tatimpaguesi në sistemin c@ts. Për sa më sipër, diferenca në vlerë përbën shitje të pa deklaruar si pasojë e diferencave në inventar për të cilën llogariten <b>detyrime për TVSH dhe tatimin mbi fitimin në shumën 1,804,167 lekë si efekt financiar i shmangur me efekt të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit</b></li> </ul>

**Kriteri:** Ligji për procedurat tatimore i ndryshuar  
Ligji për tatimin mbi vlerën e shtuar i ndryshuar  
Ligji për tatimin mbi fitimin i ndryshuar  
Manuali i kontrollit tatimor

**Ndikimi/Efekti:** Të ardhura të munguara në shumën 1,804,167 lekë

**Shkaku:** Diferencat në inventar dhe mos kryerja e analizës së prodhimit

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandimi:** Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj, referuar mangësive dhe parregullsive në procedurën e kontrollit, vlerësuar me efekte negative në të ardhurat tatimore, në përputhje me kërkesat ligjore dhe proceduriale, të kryejë rikontroll tatimor me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit të evidentuara paraprakisht në vlerën prej **1,804,167** lekë.

**Titulli:** **Mangësi të identifikuar në auditimin e praktikës së kontrollit të zhvilluar në tatimpagues**

**Situata:** Nga auditimi mbi kontrollin e ushtruar në tatimpaguesin “*F. K. C. F.* ” *SHPK me Nipt K.E* janë konstatuar mangësi të cilat përfshijnë:

-Nga auditimi i raportit të kontrollit konstatohet se nga ana e inspektorit tatimor është kryer një analizë në lidhje me marzhin e realizuar nga shitja e artikullit kryesor të aktivitetit të shoqërisë që është çimentoja duke u ndërtuar edhe bilanci material, lëvizjet e tij si dhe është kryer përlogaritja për prodhimin e çimentos. Gjatë periudhës objekt kontrolli shoqëria ka realizuar edhe operacionet e blerjes dhe shitjes së apartamenteve, për të cilat nga ana e inspektorit tatimor nuk është kryer një analizë në lidhje me bilancin material të tyre. Nga ndërtimi i bilancit material në bazë të të dhënave të paraqitura në raport kontrolli dhe pasqyrat financiare të deklaruara në c@ts për apartamentet konstatohen diferencat për periudhën objekt kontrolli. Për vitet në të cilat konstatohen diferenca në vlera negative konsiderohen si **shitje e padeklaruar si pasojë e diferencave në inventar për të cilat llogariten detyrimet për tatimin mbi fitimin në shumën 33,225,144 lekë.**

- Gjithashtu konstatohet se nga ana e tatimpaguesit në vitin 2018 është kryer riklasifikimi sipas pasqyrave financiare ku apartamente në vlerë 663,214,589 lekë, nga llogaria e aktive të mbajtura për investim kanë kaluar në inventarë të tatimpaguesit. Sipas llogarisë së lëndëve të para të analizuar në raport kontrolli konstatohet se e gjithë kjo vlerë ka kaluar në shpenzime të periudhës për vitin 2018 duke mos u analizuar nga ana e inspektorit tatimor dhe ky trajtim nuk ka rezultuar i njëjtë në vitet financiarë 2019 dhe 2020.

Në të njëjtën kohë, ri klasifikim ka pësuar edhe llogaria e paradhënieve për apartamente e cila ka kaluar në llogarinë e inventarëve dhe jo në llogarinë e parapagimeve pasi shoqëria nuk i ka në formë fizike të zotërueshme sipas klasifikimit dhe një gjë e tillë nuk rezulton të jetë analizuar në raport kontrolli nga ana e inspektorit tatimor.

-Nga auditimi konstatohet se nga ana e inspektorit tatimor është kryer analiza e shpenzimeve të pazbritshme të deklaruara vetëm për vitin 2017, duke mos u analizuar vitet 2018-2020 me efekt në mos marrjen siguri në lidhje me fitimin e tatueshëm fiskal për vitet 2018-2020.

**Kriteri:** Ligji për tatimin mbi fitimin  
Manuali i kontrollit tatimor

**Ndikimi/Efekti:** Të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit

**Shkaku:** Mos kryerja e bilancit material për apartamentet

**Rëndësia:** E lartë



**Rekomandimi:** Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj, referuar mangësive dhe parregullsive në procedurën e kontrollit, vlerësuar me efekte negative në të ardhurat tatimore, në përputhje me kërkesat ligjore dhe proceduriale, të kryejë rikontroll tatimor me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit të evidentuara paraprakisht në vlerën prej **33,225,144** lekë.

**-Në lidhje me auditimin e praktikës së Raportit Përfundimtar të Kontrollit** evaduar me shkresën nr. 10936/5 prot date 26.07.2022 për shoqërinë **“B.M.T.”** SHPK me NIPT L.G, nga Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj, i realizuar në bazë të Njoftimit Kontrolli nr. 10936/1 Prot. date 27.01.2022 dhe Program Kontrollit për periudhën nëntor 2019 deri tetor 2021 nga inspektori : z. I.P. dhe afati 316 orë pune.

*Për TVSH-ne* 11/2019 - 10/2021

*Për Tatim Fitimin* 2019 - 2020

*Për Sigurimet Shoqërore & Shëndetësore* 11/2019 - 10/2021

*Te tjera* 11/2019 - 10/2021

**Problematikat që janë audituar :**

- Rakordimi i faturave të shitjes dhe blerjeve si dhe rakordimi i shifrave të inventarit.
- Rakordimi i pagesës së TVSH- se apo i tepricës kreditore.
- Rakordimi i të ardhurave dhe i blerjeve të deklaruara në F.D.P - të mujore me ato të hedhura në sistemin informatik të dhënave.
- Rakordimi i saktësisë për shërbimet e shitura.
- Rakordimi i saktësisë të lëvizjeve të bankës dhe të arkës sipas pasqyrit në Raportin Përfundimtar të Kontrollit.
- Rakordimi i blerjeve sipas origjinës, importe, dhe blerje brenda vendit apo blerje që i shërbejnë shitjeve të tatueshme apo shitjeve të përjashtuara.
- Rakordimi i importeve me të dhënat e doganës dhe krahasimi me sistemin informatik.
- Rakordimi i inventarit të lëvizjes së pullave fiskale sipas eksporteve të shoqërisë dhe rakordimi me të dhënat e doganës në funksion të sasisë së fijeve dhe paketave të cigareve.
- Rakordimi i shitjeve sasiore tek personat individë (shitje me pakice) në ndryshim nga shitjet me shumicë me qëllim evidentimin e çmimit tregtues (marzh tregtar të rritur) për shitje tatimore të realizuara si shitje me pakicë në ndryshim nga çmimi me shumicë.
- Rakordimi për shitjet brenda vendit nëse aplikohen skema të veçanta ligjore shitjet me TVSH zero.
- Rakordimi për amortizimin e aseteve.
- Zbatimi i shkresës së DPT-se Nr.10189 prot, date 03.05.2013 *“Aneksi i indikatorëve të aktiviteteve të dyshimta për raportim nga inspektorët tatimor”*.
- Rakordimi i të ardhurave të deklaruara në bilancin kontabël me ato të deklaruara në F.D.P - të mujore.
- Rakordimi i cilësuar i përllogaritjeve të bëra për kostot e mallrave dhe prodhimet e shitura.
- Rakordimi i saktësisë të shpenzimeve të regjistruar në librat kontabël, për blerjet e kryera nga tatimpaguesi të regjistruar në TVSH –se.
- Rakordimi dhe analiza e normativave në harxhimin e materialeve sipas natyrës dhe shërbimit të tyre në funksion të aktivitetit apo jo.
- Rakordimi nëse shpenzimet e regjistruara i shërbejnë totalisht veprimtarisë së tatimpaguesit, si rakordimi i përllogaritjeve të bëra për shpenzimet e blerjes së mallrave dhe kostos së prodhimit ose shërbimit duke llogaritur edhe marzhin tregtar.
- Rakordimi i shërbimeve dhe faturave nga jashtë, vlerat dhe përshkrimi i shërbimeve të kryera.

- Rakordimi i saktësisë së deklarimit të te ardhurave personale, te tatimit ne burim dhe disidentit, etj.

- Rakordimi i të dhënave mbi klientët dhe furnitorët (lidhja e tyre me te ardhurat dhe shpenzimet).

**Nga auditimi për këtë dosje konstatohet se nuk është kryer:**

- Rakordimi i inventarit të lëvizjes së pullave fiskale sipas eksporteve te shoqërisë dhe rakordimi me të dhënat e doganës në funksion të sasisë së fijeve dhe paketave të cigareve.

- Rakordimi i shitjeve sasiore tek personat individë (shitje me pakice ) ne ndryshim nga shitjet me shumicë me qëllim evidentimin e çmimit tregtues (marzh tregtar të rritur) për shitje tatimore të realizuara si shitje me pakicë në ndryshim nga çmimi me shumicë.

Nga auditimi u konstatua se rezultojnë pasaktësi materiale në llogaritjen dhe qëndrimin e DTM në lidhje me llogaritjen e koston e mallrave te shitura KMSH me një diference te pajustificuar në **shumën 13,214,552 lekë** të cilat duhet të ishin llogaritur si detyrime tatimore në lidhje me TVSH dhe Tatim Fitimin pasi janë raportuar shifra me te larta ne librat e blerjes, janë kryer si shpenzime por nuk janë raportuar ne bilancin material te dorëzuar te vitit 2019 dh 2020.

Ne lidhje me te dhënat financiare te vitit 2019 konstatohet sa me poshtë vijon se konstatohet një diference e pajustificuar e KMSH-se ne shumen 13,039,387 leke.

<i>Situata financiare viti 2019</i>	<i>Leke</i>
KMSH e llogaritur nga te dhënat e raportuara	<b>1,566,920,008</b>
<b><i>Pasqyrat Financiare 2019</i></b>	
KMSH	1,546,570,879
Shpenzime te tjera	7,309,742
KMSH sipas Bilancit	<b>1,553,880,621</b>
<b><i>Diference e pajustificuar</i></b>	<b>13,039,387</b>
Fitimi rritet me vlerën	13,039,387
Tatim fitimi 15%	1,955,908
Gjobe 100%	1,955,908
TVSH	2,607,877
Gjobe 100%	2,607,877
<b><i>Totali i te ardhurave tatimore pa llogaritura</i></b>	<b>9,127,571</b>

Ne lidhje me te dhënat financiare te vitit 2020 konstatohet sa me poshtë vijon se konstatohet një diference e pajustificuar e KMSH-se ne shumen 5,838,544 leke

<i>Situata financiare viti 2020</i>	
KMSH e llogaritur nga te dhënat	<b>1,652,317,503</b>
<b><i>Pasqyrat Financiare 2020</i></b>	
KMSH	1,635,340,949
Shpenzime te tjera	11,138,010
KMSH sipas Bilancit	<b>1,646,478,959</b>
<b><i>Diference e pajustificuar</i></b>	<b>5,838,544</b>
Fitimi rritet me vlerën	5,838,544
Tatim fitimi 15%	875,782
Gjobe 100%	875,782
TVSH	1,167,709
Gjobe 100%	1,167,709
<b><i>Totali i te ardhurave tatimore pa llogaritura</i></b>	<b>4,086,981</b>

Nga grupi auditues janë rekomanduar dhe llogaritur edhe detyrimet tatimore respektive për detyrimet tatimore bazuar ne legjislacionin ne fuqi ne lidhje me diferencat e pajustificuara te KMSH-se për vitin 2019 dhe 2020 ne **shumen totale 13,214,552 leke** (detyrim Tatim Fitimi, detyrim TVSH- je dhe gjobe TVSH dhe Tatim Fitim )

*Referuar Njoftimit te Kontrollit Tatimor me nr me nr 10936/1 Prot date 27.01.2022 dhe programit të kontrollit bashkëngjitur tij programit përkatës te miratuar ne zbatim te tij është kryer kontrolli nga inspektori e kontrollit i Drejtorisë së Tatimpaguesve të Mëdhenj z. I.P., trajtuar nga përgjegjës sektori z. A.C., Drejtore M.R. dhe përcjellë pranë operatorit ekonomik sipas shkresës administrative nga znj I.A. Drejtore e DTM.*

**-Në lidhje me kontrollin e kryer, ne shoqërinë “A. C.” SHPK me NUIS K.W” SHPK** lidhur me kontrollin e ushtruar ne këtë shoqëri ne zbatim te Njoftimit te Kontrollit Tatimor me nr. Nr. 6569/1 Prot, datë 01.09.2022 me programin e kontrollit kryer kontrolli nga inspektori e kontrollit i Drejtorisë së Tatimpaguesve të Mëdhenj z. M. M. *Referuar programit të kontrollit në lidhje me TVSH-në u kontrolluan periudhat tatimore*

*Nëntor 2019 deri Maj 2022, ne lidhje me Tatim Fitimin*

*Viti 2019-2021 dhe në lidhje me “Kontributet e Sigurimeve Shoqërore dhe Tatimin mbi të Ardhurat” u kontrollua periudha tatimore Nëntor 2019 deri Maj 2022 dhe të tjera për periudhën deri Maj 2022.*

*Nga grupi i auditimit u audituan :*

- Rakordimi i faturave te shitjes dhe blerjeve si dhe rakordimi i shifrave të inventarit
- Rakordimi i pagesës se TVSH- se apo i tepricës kreditore
- Rakordimi i te ardhurave dhe i blerjeve te deklaruar ne F.D.P - te mujore me ato të hedhura në sistemin informatik të të dhënave.
- Rakordimi i saktësisë për shërbimet e shitura,
- Rakordimi i saktësisë të lëvizjeve të bankës dhe te arkës sipas pasqyrimit në Raportin Përfundimtar të Kontrollit.
- Rakordimi i blerjeve sipas origjinës, importe, dhe blerje brenda vendit apo blerje qe i shërbejnë shitjeve te tatueshme apo shitjeve te përjashtuara.
- Rakordimi i importeve me te dhënat e doganës dhe krahasimi me sistemin informatik
- Rakordimi për shitjet brenda vendit nëse aplikohen skema te veçanta ligjore shitjet me TVSH zero
- Rakordimi për amortizimin e asetëve
- Rakordimi i te ardhurave te deklaruar ne bilancin kontabël me ato te deklaruar ne F.D.P - te mujore
- Rakordimi i cilësuar i përlogaritjeve te bëra për kostot e mallrave dhe prodhimet e shitura,
- Rakordimi i saktësisë të shpenzimeve te regjistruar ne librat kontabël, për blerjet e kryera nga tatimpaguesi te regjistruar ne TVSH -se
- Rakordimi dhe analiza e normativave ne harxhimin e materialeve sipas natyrës dhe shërbimit te tyre në funksion të aktivitetit apo jo.
- Rakordimi nëse shpenzimet e regjistruara i shërbejnë totalisht veprimtarisë se tatimpaguesit , si rakordimi i përlogaritjeve te bëra për shpenzimet e blerjes se mallrave dhe kostos se prodhimit ose shërbimit duke llogaritur edhe marzhin tregtar.
- Rakordimi i shërbimeve dhe faturave nga jashtë, vlerat dhe përshkrimi i shërbimeve te kryera
- Rakordimi i saktësisë së deklarimit të te ardhurave personale, te tatimit ne burim dhe dividendit, etj.
- Rakordimi i të dhënave mbi klientët dhe furnitorët (*lidhja e tyre me te ardhurat dhe shpenzimet*).dhe te tjera.
- Rezulton e pasqyruar sakte dhe me marzhe mbi normat e industrisë respektive fitimi bruto si dhe marzhi i shitjeve për shitjet me pakice dhe shumice me një diference te theksuar pozitive, për marzhin e shitjeve me pakice.

**Ne lidhje me periudhën e kredituar te karburantit nëntor-dhjetor 2019**

Konstatohet se shoqëria karburantit e magazinon në adresën Sheqi i Madh dhe më pas e shpërnda në me botë në pikat e saj për furnizimin e mjeteve të transportit dhe makinerive. Një pjesë të punimeve shoqëria i kryen me nënkontraktore, gërmime në rrugë, punime

rikonstruksioni në ndërtim e të tjera.

**Bilanci i lëvizjes së karburantit për periudhën nëntor-dhjetor 2019**

Njësia matëse	Gjendja në çelje			Blerjet			Daljet			Gjendja me 31.12.2019		
	Sasi	Çmimi	Vlera	Sasi	Çmimi	Vlera	Sasi	Çmimi	Vlera	Sasi	Çmimi	Vlera
litra	9,400	130.8	1,229,802	172,401	128	22,142,692	180,909	129	23,247,614	892	140	124,880

Trajtuar sa më poshtë edhe tabela e kreditimit të vlerës së tatueshme të karburantit të blere për periudhën **nëntor-dhjetor 2019**.

Shitjet sipas natyrës	Shitjet	Punime/nenkontraktoret	Punime nga shoqëria	Norma %	Vlera e lejuar	Konsumi në fakt	Diferenca me pak sesa kufiri i lejuar
Asfaltobeton	654,400		654,400	14	91,616		
Beton	2,795,050		2,795,050	14	391,307		
Inerte	617,433		617,433	33	203,753		
Shtirim Rruge	113,075,247	25,075,291	87,999,955	32	28,159,986		
<b>Totali</b>	<b>117,142,130</b>	<b>25,075,291</b>	<b>92,066,838</b>		<b>28,846,662</b>	<b>23,247,614</b>	<b>5,599,048</b>

Konstatohet se nuk rezultojnë të dhëna të hollësishme e detajuar sipas nr të kontratës afatit kohor të lidhjes së kontratës së punimeve për vitin 2019 , si dhe të dhëna zyrtare administrative për numrin e lejes së ndërtimit , datën e lidhjes së kontratës, afatin e fillimit dhe mbarimit të punimeve, që ka kryer kjo kompani për aktivitete të kryera nga Investitorë Publik dhe Kompani Private për punime sipas zërit shtirim rruge në vlerën 117,142,130 leke. Konstatohet subjekti ka kredituar vlerë të tatueshme për harxhim karburant me pak sesa kufiri ligjor i lejuar me një diferencë mpak në vlerën 5,599,048 leke.

**Ne lidhje me periudhën e kredituar të karburantit Janar-Dhjetor 2020**

Konstatohet se shoqëria karburantit e magazinon në adresën Sheqi i Madh dhe më pas e shpërnda në me botë në pikat e saj për furnizimin e mjeteve të transportit dhe makinerive. Një pjesë të punimeve shoqëria i kryen me nënkontraktore, gërmime në rrugë, punime rikonstruksioni në ndërtim e të tjera.

**Bilanci i lëvizjes së karburantit për periudhën Janar-dhjetor 2020**

Njësia matëse	Gjendja në çelje			Blerjet			Daljet			Gjendja me 31.12.2020		
	Sasi	Çmimi	Vlera	Sasi	Çmimi	Vlera	Sasi	Çmimi	Vlera	Sasi	Çmimi	Vlera
litra	892	140	124,880	1,504,717	109	163,375,434	1,497,559	109	162,634,939	8,050	108	865,375

Trajtuar sa më poshtë edhe tabela e kreditimit të vlerës së tatueshme të karburantit të blere për periudhën **Janar-dhjetor 2020**.

Shitjet sipas natyrës	Shitjet	Punime/nenkontraktoret	Punime nga shoqëria	Norma %	Vlera e lejuar	Konsumi në fakt	Diferenca
Asfaltobeton	17,802,300		17,802,300	14	2,492,322		
Beton	4,111,913	322,087	3,789,826	14	530,576		
Inerte	23,245,586		23,245,586	33	7,671,043		
Shtirim rruge	1,182,730,359	70,614,049	1,112,116,310	32	355,877,219	162,634,939	

Konstatohet subjekti ka kredituar vlerë të tatueshme për harxhim karburant me pak sesa kufiri ligjor i lejuar. Konstatohet se nuk rezultojnë të dhëna të hollësishme e detajuar sipas nr të kontratës afatit kohor të lidhjes së kontratës së punimeve për vitin 2020 , si dhe të dhëna zyrtare administrative për numrin e lejes së ndërtimit , datën e lidhjes së kontratës, afatin e fillimit dhe mbarimit të punimeve, që ka kryer kjo kompani për aktivitete të kryera nga Investitorë Publik dhe Kompani Private për punime sipas zërit shtirim rruge në vlerën 1,182,730,359 leke.

**Ne lidhje me periudhën e kredituar të karburantit Janar-Dhjetor 2021**

Konstatohet se shoqëria karburantit e magazinon në adresën Sheqi i Madh dhe më pas e shpërnda në me botë në pikat e saj për furnizimin e mjeteve të transportit dhe makinerive. Një pjesë të punimeve shoqëria i kryen me nënkontraktore, gërmime në rrugë, punime rikonstruksioni në ndërtim e të tjera.

**Bilanci i lëvizjes së karburantit për periudhën Janar-dhjetor 2021**

Njësia matëse	Gjendja në çelje			Blerjet			Daljet			Gjendja me 31.12.2021		
	Sasi	Çmimi	Vlera	Sasi	Çmimi	Vlera	Sasi	Çmimi	Vlera	Sasi	Çmimi	Vlera

litra	8,050	108	865,375	1,469,716	122	178,705,457	1,474,366	121	179,125,998	3,400	131	444,833
-------	-------	-----	---------	-----------	-----	-------------	-----------	-----	-------------	-------	-----	---------

Trajtuar sa më poshtë edhe tabela e kreditimit te vlerës se tatueshme te karburantit te blere për periudhën **Janar-dhjetor 2021**.

Shitjet sipas natyrës	Shitjet	Punime/		Norma %	Vlera e lejuar	Konsumi ne fakt	Diferenca
		nenkontraktoret	Punime nga shoqëria				
Asfaltobeton	4,212,400		4,212,400	14	589,736		
Beton	5,195,777		5,195,777	14	727,409		
Inerte	5,031,129		5,031,129	33	1,660,273		
Shtirim rruge	1,429,299,624	190,600,129	1,238,699,495	32	396,383,838		
Hekur	4,678,350		4,678,350				
Rrjet teli, llamarine, tel xingato	13,598,258		13,598,258				
Mjete me qera	2,550,000		2,550,000				
Ndertim banesash	219,575,816	56,915,378	162,660,438	8	13,012,835		
Mjete transporti	22,929,560		22,929,560				
<b>Totali</b>	<b>1,707,070,914</b>	<b>247,515,507</b>	<b>1,459,555,407</b>		<b>412,374,091</b>	<b>179,125,998</b>	<b>233,248,093</b>

Konstatohet subjekti ka kredituar vlere te tatueshme per harxhim karburant me pak sesa kufiri ligjor i lejuar. Konstatohet se nuk rezultojnë te dhëna te hollësishme e detajuar sipas nr te kontratës afatit kohor te lidhjes se kontratës se punimeve për vitin 2021, si dhe te të dhëna zyrtare administrative për numrin e lejes se ndërtimit , datën e lidhjes se kontratës, afatin e fillimit dhe mbarimit te punimeve, që ka kryer kjo kompani për aktivitete të kryera nga Investitorë Publik dhe Kompani Private për punime sipas zërit shtirim rruge ne vlerën 1,429,299,624 lekë.

Trajtuar sa më poshtë edhe tabela e kreditimit te vlerës se tatueshme te karburantit te blere për periudhën **Janar-Maj 2022**

Shitjet sipas natyres	Shitjet	Pun/nenkont	Punime nga shoqëria	Norma %	Vlera e lejuar	Konsumi ne fakt	Diferenca
Asfaltobeton	354,750		354,750	14	49,665		
Beton	7,359,611		7,359,611	14	1,030,346		
Inerte	10,833		10,833	33	3,575		
Shtirim rruge	325,328,488	21,982,000	303,346,488	32	97,070,876		
Hekur	4,507,201		4,507,201				
Rrjet teli, llamarine, tel xingato	3,866,000		3,866,000				
Mjete me qera	240,000		240,000				
Ndertim banesash	259,602,350	44,412,513	215,189,837	8	17,215,187		
Parapagim blerje apartamenti	22,076,930		22,076,930				
Mjete transporti	57,505,033		57,505,033				
<b>Totali</b>	<b>680,851,196</b>	<b>66,394,513</b>	<b>614,456,683</b>		<b>115,369,649</b>	<b>114,944,186</b>	<b>425,463</b>

Konstatohet se nuk rezultojnë te dhëna te hollësishme e detajuar sipas nr te kontratës afatit kohor te lidhjes se kontratës se punimeve për vitin 2022, si dhe te të dhëna zyrtare administrative për numrin e lejes se ndërtimit , datën e lidhjes se kontratës, afatin e fillimit dhe mbarimit te punimeve, që ka kryer kjo kompani për aktivitete të kryera nga Investitorë Publik dhe Kompani Private për punime sipas zërit shtirim rruge ne vlerën 325,328,499 leke.

Në përfundim të auditimi nuk rezultojnë pasaktësi materiale në llogaritjen dhe qëndrimin e DTM me kontrollin e kësaj procedure. Për sa me sipër trajtuar ne përfundim kjo dosje kontrolli është trajtuar dhe evaduar gjate procedurave te kontrollit tatimor nga nëpunësit përgjegjës sa me poshtë vijon :

*Referuar Njoftimit te Kontrollit Tatimor me nr. Nr. 6569/1 Prot, datë 01.09.2022 me programin e kontrollit është kryer kontrolli nga inspektori e kontrollit i Drejtorisë së Tatimpaguesve të Mëdhenj z. M. M., trajtuar nga përgjegjës sektori z. E. M., drejtor drejtorie z. O. C. dhe përcjellë pranë operatorit ekonomik sipas shkresës administrative nr. 6569/3 prot date 28.10.2022 nga znj E. C. Drejtoresh DTM.*

**- Në lidhje me kontrollin e kryer, ne shoqërinë “A. K.” SHPK** lidhur me kontrollin e ushtruar ne këtë shoqëri ne zbatim te Njoftimit te Kontrollit Tatimor me nr. 5969 /2 Prot. date 02/07/2021 ,si dhe programit përkatës te miratuar ne zbatim te tij.

**Periudha tatimore qe është kontrolluar.**

*Për TVSH-ne : Nga data 01.10.2019 deri ne 31.05.2021.*

Për Sigurimet shoqërore, shëndetësore dhe TAP, dhe te tjera : Nga data 01.10.2019 deri ne 31.05.2021. Për Tatimin mbi te Ardhurat : Vitet 2019 dhe 2020.

**Nga auditimi u konstatua se**

Objektet ne te cilat shoqëria ka deklaruar punime për periudhën e kontrolluar (Tetor 2019 – Maj 2021), bazuar edhe ne akt-konstatimin inxhinierik, mbajtur nga inxhinieri i DTM z.I. K.(bashkëlidhur këtij raport kontrolli), janë si me poshtë:

Emërtimi I objektit	Leja e ndërtimit/ Kontrata	Investitori	Vlera preventivit	Deklarime te mëparshme	Deklaruar tetor - dhjetor 2019 me TVSH	Deklaruar Janar-Dhjetor 2020 me TVSH	Deklaruar Janar-Maj 2021 me TVSH
Agjensia Ujesjelles Kanalizime ,Ndertimi I rrjetit te ujesjesit dhe KUZ ne fSHAtin Luz	Kontrata 3547 dt.01.11.2016	Agjensia Kombetare e Ujesjelles Kanalizime	353,778,907	297,571,879	12,049,560	44,156,636	
Strukture Banimi dhe sherbimi 8.911. kate Rruga Liman Kaba	Kontrata nr 26443/7 dt.22.09.2017	A Konstruksion	1,184,200,000	685,897,368	30,985,104	234,869,025	259,485,122
Ndertim dhe transferim H/ c Backa1, Backa 2, skrapar	Kontrata nr 86 dt.04.06.2018	K. M. Energji	1.156.806.769	689,738,297	244,785,527		
Ndertimi I skemës ujitëse-Sektori I Ri Ne Xeng,Divjake	25.09.2018	Bashkia Divjake	69.657.079	18,036,000	51,620,892		
Rikualifikimi i rrugës 20 Janari"Qyteti Divjake	Kontrata nr 547 dt.21.06.2019	Bashkia Divjake	70.473.960	6,000,000	6,003,000	58,470,230	
Ndertim I Stacionit te Pompimit ,tubacioni kryesor dhe rrjeti shpërndarës te ujesjellësit Grabian	Kontrata Nr3236/6 dt.25.09.2019	FSHZH	121.153.167	17,999,964	6,626,483	96,526,321	
Godine Banimi dhe sherbimi9-10 kat rruga Fejzi Hizmo	Kontrata nr 2469, dt.21.06.2019	A. SHPK	736.416.055	12,156,696	128,108,642	210,254,337	86,939,998
Rehabilitimi I skemave ujitese, Bashkite Has, Kucove, Maliq e Lushnje	kontrata no :ref .No ERIP/1/E/001	MBZHR,Projekti menxhimit te ujrave	1.726.682.770		333,594,718	1,375,420,299	
Rindertimi I Banesave te demtuara nga termeti ne Bashkin ,Shijak	Kontrata nr 7169/3 dt 22.11.2019	Agjensia eKombetare e Mbrojtjes Civile	157,510,807		19,127,563	120,055,862	
Rikonstruksion I shkolles se mesme Sami Frasherit, Permet	Kontrata 547 dt 01.03.2019	Bashkia Permet	81,490,378	49,146,647		31,643,564	
Rikualifikimi dhe Sistemi I Lumit Gjanica, Loti II,Fier	Kontrata nr dt 14.10.2020	FSHZH	630,577,556			84,078,222	
Rrjeti I kanalizimeve te ujrave te zeza Luz, Kavaje, faza II dhe rrjeti tercial I kuz	04.05.2020	Ujesjelles Kanalizime Kavaje	147,030,370			147,030,336	
Rehabilitim objektsh dhe mbrojtje lumore,Loti I Rehabilitimi hidrovovresh, Hamallaj dhe Divjake	Kontrata nr 3373/22 dt 31.08.2020	Ministria Bujqesise dhe Zhvillimit Rural	94,188,457			63,801,711	26,382,354
FV, sistem I kanalizimeve KUZ dhe KUB ,te Prestige Resort,Golem	Kontrata dt 20.01.2021	E. SHPK					2,881,421
Rindertimi I shkolles se mesme te bashkuar Selman Daci	Kontrata nr 2 ne zbatim te marjeshjes 837/2020	Fondi Shqiptar I Zhvillimit	122,510,000				61,255,000
Mbrojtja nga lumi, Drin,Berdica	Kontrata nr 1555/1 dt 15.02.2021	Projekti I menaxhimit te ujrave	23,977,296				23,977,296
Furnizimi me uje per zonat bregdetare te Bashkise Divjakedhe Njesise Administrative Remas, Loti 1	Kontrata nr 360/12 dt 02.04.2021	Bashkia Divjake	496,126,333				49,330,400
Rikonstruksion I kanali vadites te fSHAtit Zhulat	Kontrata nr 213 dt 08.01.2021	Bashkia Gjyrokaster	64,788,709				9,618,060
Projektim,Financim,Ndertim,Mirembajtje dhe transferim"Per Permiresim e Infrastruktures Arsimore ne Bashkine Tirane, ne zoneb Tirans 4	Kontrata nr 4907 rep, 1874 ko dt 08.09.2020	Bashkia Tirane,Ministria Arsimit, Sportit dhe Rinis	770,363,053				23,676,600
<b>SHUMA</b>				<b>991,369,530</b>	<b>832,901,489</b>	<b>2,466,306,543</b>	<b>543,546,251</b>

Nga auditimi konstatohet se për periudhën tetor–dhjetor 2019 shoqëria ka kryer punime si me poshtë sipas zërit dhe llojit te punimeve.

Përshkrimi	Totali	Shërbime te trete	Shoqëria
Rruge 32%	5,002,500		5,002,500
Te tjera 8%	216,532,897	99,227,235	117,305,662
Gërmime /Cpime 25%	481,983,537	4,166,666	477,816,871
<b>Totali</b>	<b>703,518,934</b>	<b>103,393,901</b>	<b>600,125,033</b>

Nga auditimi konstatohet se për periudhën tetor–dhjetor 2019 shoqëria ka blere karburant kryer punime si me poshtë;

Furnitorët	Nipt	Vlera	TVSH
A. S. A	K.R	5,400,613	1,080,122.00
K. SHA	J.P	3,960,910	792,182.00
S. G. SHPK	K.V	3,983,333	796,667.00
E.D.A	K.V	93,505,917	18,701,184.00
E.D.A	K.V	1,216,000	Perjashtuar
V.A	K.V	410,000	Perjashtuar

G.C	K.T	256,500	Perjashtuar
SHUMA		108,733,273	21,370,155

Nga auditimi konstatohet se për periudhën tetor–dhjetor 2019 shoqëria ka kredituar karburant si me poshtë :

	Analiza e karburantit të harxhuar në krahasim me normativat	% e lejuar	Vlerat lejuar(Leke)	Nafta e përdorur (leke)
Proceset e kryera	Vlera(leke)			
Ndërtim Rruges	5,002,500	32%	1,600,800	
Ndërtime të tjera	216,532,897	8%	17,322,631	129,522,887
Gërmime/Cpime	477,816,871	25%	119,454,218	
<b>Totali</b>	<b>600,125,033</b>		<b>139,419,316</b>	

1-Konstatohet se shoqëria disponon inventarin e nevojshëm të mjeteve për kreditimin e këtij karburanti dhe gjithashtu shpenzimet faktike për gazoilin për çdo veprimtari ekonomike justifikohen me volumin e punës së kryer, rrugët e realizuara nga mjetet, normativat e konsumit të gazoilit për rrugë ose proces të kryer, por në Raportin Përfundimtar të Kontrollit nuk janë pasqyruar mjetet motorikë gjendje të cilat ka përdore shoqëria për këtë proces pune .

2-Konstatohet se nuk është bërë një analizë e sakte për zërin Gërmim/Cpim të kredituar në masën 25% nuk është analizuar saktë lloji i punimit konform përcaktimeve të nenit 55/ “Kufizime të zbritjes së TVSH”.

3-Në lidhje me shitjet e përjashtuara nuk janë të dhëna në lidhje me sipërfaqen, llojin e kontratës, kostos së ndërtimit, kostos së shitjes

1. BANESA KOPSHTI ZOOLOGJIK	34,370,612
2. BANESA YZBERISHT NR3/2	12,680,169
3 BANESA YZBERISHT NR 6	4,554,670
4. BANESA YZBERISHT NR 5	3,716,737
	<b>55,322,188</b>

Nga auditimi konstatohet se për periudhën janar –dhjetor 2020 shoqëria ka kryer punime si me poshtë

Përshkrimi	Totali	Shërbime nga të treta	Shoqëria
Rruge 32%	48,725,191	-	48,725,191
Te tjera 8%	796,791,669	189,355,281	607,436,388
Gërmime/Cpime 25 %	1,230,963,953	448,940,673	782,023,280
<b>Totali</b>	<b>2,076,480,813</b>	<b>638,295,954</b>	<b>1,438,184,859</b>

Nga auditimi konstatohet se për periudhën janar–dhjetor 2020 shoqëria ka blerë karburant si me poshtë:

Furnitorët	Nipt	Vlera e tatueshme	TVSH
K. SHA	K.V	13,163,885	2,632,777
K. SHA	K.V	652,770	Përjashtuar
S. SHPK	K.V	10,349,296	2,069,859
S. SHPK	K.V	751,840	Perjashtuar
A.S.A	K.R	3,741,676	748,335
AFT	K.L	60,833	12,167
E.D.A	K.N	160,280,285	32,056,057
E.D.A	K.N	1,348,740	Perjashtuar
<b>Grand Total</b>		<b>190,349,325</b>	<b>26,053,845</b>

Nga auditimi konstatohet se për periudhën janar–dhjetor 2020 shoqëria ka kredituar karburant si me poshtë:

Analiza e karburantit të harxhuar në krahasim me normativat			
Shërbimet e Kryera	% e lejuar	Vlera e lejuar(Leke)	Nafta e përdorur (leke)
Vlera(leke)			
48,725,191	32%	15,592,061	187,230,837
607,436,388	8%	48,594,911	
782,023,280	25%	195,505,820	
<b>1,438,184,859</b>	<b>0</b>	<b>259,692,792</b>	

1-Konstatohet se shoqëria disponon inventarin e nevojshëm të mjeteve për kreditimin e këtij karburanti dhe gjithashtu shpenzimet faktike për gazoilin për çdo veprimtari ekonomike justifikohen me volumin e punës së kryer, rrugët e realizuara nga mjetet, normativat e konsumit të gazoilit për rrugë ose proces të kryer, por në Raportin Përfundimtar të Kontrollit nuk janë pasqyruar mjetet motorikë gjendje të cilat ka përdore shoqëria për këtë proces pune .



2-Konstatohet se nuk është bere një analize e sakte për zërin Gërmim/Cpim te kredituar ne masën 25% nuk është analizuar sakte lloji i punimit konform përcaktimeve te nenit 55/ “Kufizime të zbritjes së TVSH”.

3-Ne lidhje me shitjet e përjashtuara nuk janë te dhëna ne lidhje me sipërfaqen, llojin e kontratës, koston se ndërtimit, koston se shitjes për shitje te përjashtuara banesa.

Shitje te Përjashtuara banesa	Vlera
BANESA KOPSHTI ZO	35,755,673
<b>TOTALI</b>	<b>75,767,529</b>

Nga auditimi konstatohet se për periudhën Janar–Maj 2021 shoqëria ka kredituar karburant si me poshtë sipas zërit dhe llojit te punimeve

Përshkrimi	Shërbimet e Kryera	% e lejuar	Vlera e lejuar(Leke)	Nafta e përdorur (leke)	Nafta e blere(leke vlere e tatushme)
Proceset e kryera	Vlera(leke)				
GERMIME/ CPIME	41,108,668	25%	10,277,167	37,891,498	
Ndërtime te tjera	347,809,981	8%	27,824,798		
<b>Totali</b>	<b>388,918,649</b>		<b>38,101,965</b>		

1-Konstatohet se shoqëria disponon inventarin e nevojshëm te mjeteve për kreditimin e këtij karburanti dhe gjithashtu shpenzimet faktike për gazoilin për çdo veprimtari ekonomike justifikohen me volumin e punës së kryer, rrugët e realizuara nga mjetet, normativat e konsumit të gazoilit për rrugë ose proces të kryer.

2-Konstatohet se nuk është bere një analize e sakte për zërin Gërmim/Cpim te kredituar ne masën 25% nuk është analizuar sakte lloji i punimit konform përcaktimeve te nenit 55/ “Kufizime të zbritjes së TVSH”. 5969 /2 Prot. date 02/07/2021 te cilat nuk vërtetohet nga dokumentacioni i raportit te kontrollit te auditimit te sjellin materialisht pasoja direkte në të ardhurat tatimore.

Në përfundim të auditimi rezultojnë nuk pasaktësi materiale në llogaritjen dhe qëndrimin e DTM me kontrollin e kësaj procedure. Për sa me sipër trajtuar ne përfundim kjo dosje kontrolli është trajtuar dhe evaduar gjate procedurave te kontrollit tatimor nga nëpunësit përgjegjës sa me poshtë vijon :

*Referuar Njoftimit te Kontrollit Tatimor me nr. 5969 /2 Prot. date 02/07/2021 ,si dhe programit përkatës te miratuar ne zbatim te tij është kryer kontrolli nga inspektori e kontrollit i Drejtorisë së Tatimpaguesve të Mëdhenj z. E. D., trajtuar nga përgjegjës sektori z. E .M., drejtor drejtorie z. O.C. dhe përcjellë pranë operatorit ekonomik sipas shkresës administrative nga znj E. C.*

**- Në lidhje me kontrollin e kryer, në shoqërinë “A.”**, me nipt J.K, në zbatim të Njoftim Kontrollit Tatimor te Drejtorisë të Tatimpaguesve të Mëdhenj , me nr. Nr.2598/2, datë 07.05.2021. konstatohet se :

*Periudha tatimore objekt kontrolli përcaktuar sipas programit të kontrollit të TVSH. periudha*

*Tatimi Fitimi*

*2017-2019*

*Për Sigurimet Shoqërore e Shëndetësore*

*201703-202102*

*Tatime të tjera*

*201703-202102*

*Inspektori G. P.*

Çështjet që janë kontrolluar nga inspektori i kontrollit z. G. P. janë :

-Zbatimi i detyrave dhe shlyerja e detyrimeve të lëna nga kontrollet e ushtruara më parë tek tatimpaguesi,si dhe ato që detyrohet nga zbatimi i legjislacioni fiskal në tërësi.

-Verifikimi i akteve juridike mbi bazën e të cilave ushtron veprimtarinë e tij tatimpaguesi dhe përputhjae tyre reale me këtë veprimtari.

-Njohja me aktivitetin tregtar dhe gjendjen e biznesit në tërësi duke kryer intervistimin e drejtuesve tëshoqërisë. Evidentimi i borxheve dhe huave të shoqërisë dhe statusi i tyre.

-Kontrolli mbi TVSH-në e llogaritur për t’u paguar, TVSH-në e zbritshme, TVSH-në e shitjes.Verifikimi mbi saktësinë e deklaramit të TVSH-së në blerje dhe shitje për periudhat



përkatëse.

-Kontrolli mbi pasqyrat financiare të aktiv-pasivit, verifikimi i aseteve dhe inventarit, kontrolli i pasqyrës së të ardhura-shpenzime, llogaritja dhe pagesa e tatimit mbi fitimin.

Programi i Kontrollit ne subjekt ka filluar me datë 25.05.2021.

*Nga grupi i auditimit u audituan :*

- Rakordimi i faturave të shitjes dhe blerjeve si dhe rakordimi i shifrave të inventarit

- Rakordimi i pagesës së TVSH- se apo i tepicës kreditore

- Rakordimi i të ardhurave dhe i blerjeve të deklaruara në F.D.P - të mujore me ato të hedhura në sistemin informatik të të dhënave.

- Rakordimi i saktësisë për shërbimet e shitura,

- Rakordimi i saktësisë të lëvizjeve të bankës dhe të arkës sipas pasqyrit në Raportin Përfundimtar të Kontrollit.

- Rakordimi i blerjeve sipas origjinës, importe, dhe blerje brenda vendit apo blerje që i shërbejnë shitjeve të tatueshme apo shitjeve të përjashtuara.

- Rakordimi i importeve me të dhënat e doganës dhe krahasimi me sistemin informatik

-Rakordimi për shitjet brenda vendit nëse aplikohen skema të veçanta ligjore shitjet me TVSH zero

- Rakordimi për amortizimin e aseteve

- Rakordimi i të ardhurave të deklaruara në bilancin kontabël me ato të deklaruara në F.D.P - të mujore

- Rakordimi i cilësuar i përlllogaritjeve të bëra për kostot e mallrave dhe prodhimet e shitura,

- Rakordimi i saktësisë të shpenzimeve të regjistruar në librat kontabël, për blerjet e kryera nga tatimpaguesi të regjistruar në TVSH -se

- Rakordimi dhe analiza e normativave në harxhimin e materialeve sipas natyrës dhe shërbimit të tyre në funksion të aktivitetit apo jo.

- Rakordimi nëse shpenzimet e regjistruara i shërbejnë totalisht veprimtarisë së tatimpaguesit , si rakordimi i përlllogaritjeve të bëra për shpenzimet e blerjes së mallrave dhe kostos së prodhimit ose shërbimit duke llogaritur edhe marzhin tregtar.

-Rakordimi i shërbimeve dhe faturave nga jashtë, vlerat dhe përshkrimi i shërbimeve të kryera

- Rakordimi i saktësisë së deklaratimit të të ardhurave personale, të tatimit në burim dhe dividetit, etj.

- Rakordimi i të dhënave mbi klientët dhe furnitorët (*lidhja e tyre me të ardhurat dhe shpenzimet*).dhe të tjera.

-Rezultoni e pasqyruar sakte dhe me marzhe mbi normat e industrisë respektive fitimi bruto si dhe marzhi i shitjeve për shitjet me pakice dhe shumice me një diferencë të theksuar pozitive, për marzhin e shitjeve me pakice.

**Ne lidhje me afatet administrative të Evadimit të Dosjes Tatimore rezultoi se :**

- Është kryer kontrolli per zbatimin e kërkesave te Ligjit Nr.8438 date 28.12.1998 “Per Tatimin mbi te ardhurat ne RSh” i ndryshuar, kreu IV “Tatimi i mbajtur ne burimin e te ardhurave” si dhe Udhëzimit Nr. 5, date 30.01.2006 “Per Tatimin mbi te ardhurat ne RSh” i ndryshuar, duke analizuar furnitorët per te cilët shoqëria ka paguar tatim ne burim apo ka aplikuar ne DPT per shmangje.

- Është kryer kontrolli per TAP dhe Sigurime Shoqërore.

- Është kryer kontrolli mbi saktësimin e gjendjes kreditore dhe rimbursimi i TVSH-së, për të cilin subjekti ka paraqitur prane Drejtorise se rimbursimit te TVSH-se ne Drejtorise e Përgjithshme te Tatimeve kërkesën per rimbursim TVSH-je ne shumen 129,034,888 leke, e cila është miratuar po në këtë vlerë. Per sa me sipër trajtuar ne përfundim kjo dosje kontrolli është trajtuar dhe evaduar gjate procedurave te kontrollit tatimor nga nëpunësit përgjegjës sa me poshtë vijon :

*Referuar Njoftimit te Kontrollit Tatimor me Lajmërim Kontrolli dhe programit të kontrollit bashkëngjitur ushtruar mbi subjektin S. A. me nipt Nipti: L.Q. dhe programit përkatës te miratuar ne zbatim te tij është kryer kontrolli nga inspektori e kontrollit i Drejtorisë së Tatimpaguesve të Mëdhenj T.F., trajtuar nga përgjegjës sektori z. A.D., drejtor drejtorie z. O.C. dhe përcjellë pranë operatorit ekonomik sipas shkresës administrative nga znj. E. C. Drejtore Rajonale e DTM.*

- **Në lidhje me auditimin e praktikës së Raportit Përfundimtar të Kontrollit evaduar me shkresën nr. 10936/5 prot date 26.07.2022 per shoqërinë “A.”** SHPK me Nipt J.L, nga Drejtoria Tatimore e Tatimpaguesve te Medhenj, i realizuar ne bazë te Njoftim Kontrolli nr. 4192/2 Prot date 07.06.2021 dhe Program Kontrollit.

Inspektoret qe ka kryer kontrollin z. A. D.

Periudha tatimore qe është kontrolluar:

-Per TVSH-ne nga Shtator 2018 deri me Mars 2021.

-Per Tatim Fitimin viti 2018,2019,2020.

-Per sigurimet shoqërore dhe shëndetësore nga Shtator 2018 deri me Mars 2021.

-Te tjera nga Shtator 2018 deri me Mars 2021.

**Problematikat qe janë audituar :**

-Rakordimi i faturave te shitjes dhe blerjeve si dhe rakordimi i shifrave të inventarit;

-Rakordimi i pagesës se TVSH- se apo i tepicës kreditore;

-Rakordimi i te ardhurave dhe i blerjeve te deklaruar ne F.D.P - te mujore me ato të hedhura në sistemin informatik të të dhënave;

-Rakordimi i saktësisë per shërbimet e shitura;

-Rakordimi i saktësisë të lëvizjeve të bankës dhe te arkës sipas pasqyrimit në Raportin Përfundimtar të Kontrollit;

-Rakordimi i blerjeve sipas origjinës, importe, dhe blerje brenda vendit apo blerje qe i shërbejnë shitjeve te tatueshme apo shitjeve te perjashtuara;

- Rakordimi i importeve me të dhënat e doganës dhe krahasimi me sistemin informatik ;
- Rakordimi i inventarit të lëvizjes së pullave fiskale sipas eksporteve të shoqërisë dhe rakordimi me të dhënat e doganës në funksion të sasisë së fijeve dhe paketave të cigareve;
- Rakordimi për shitjet brenda vendit nëse aplikohen skema të veçanta ligjore shitjet me TVSH zero;
- Rakordimi për amortizimin e aseteve;
- Zbatimi i shkresës së DPT-se Nr.10189 prot,date 03.05.2013 “Aneksi i indikatorëve të aktiviteteve të dyshimta për raportim nga inspektorët tatimor” ;
- Rakordimi i të ardhurave të deklaruara në bilancin kontabël me ato të deklaruara në F.D.P - të muajore ;
- Rakordimi i cilësuar i përllogaritjeve të bëra për kostot e mallrave dhe prodhimet e shitura;
- Rakordimi i saktësisë të shpenzimeve të regjistruar në librat kontabël, për blerjet e kryera nga tatimpaguesi të regjistruar në TVSH -se;
- Rakordimi dhe analiza e normativave në harxhimin e materjaleve sipas natyrës dhe shërbimit të tyre në funksion të aktivitetit apo jo.
- Rakordimi nëse shpenzimet e regjistruara i shërbejnë totalisht veprimtarisë së tatimpaguesit , si rakordimi i përllogaritjeve të bëra për shpenzimet e blerjes së mallrave dhe kostos së prodhimit ose shërbimit duke llogaritur edhe marzhin tregtar.
- Rakordimi i shërbimeve dhe faturave nga jashtë, vlerat dhe përshkrimi i shërbimeve të kryera
- Rakordimi i saktësisë së deklarimit të të ardhurave personale, të tatimit në burim dhe dividendit, etj.
- Rakordimi i të dhënave mbi klientët dhe furnitorët (*lidhja e tyre me të ardhurat dhe shpenzimet*).

Në përfundim të auditimit rezultojnë nuk pasaktësi materiale në llogaritjen dhe qëndrimin e DTM me kontrollin e kësaj procedure .

Për sa me sipër trajtuar në përfundim kjo dosje kontrolli është trajtuar dhe evaduar gjatë procedurave të kontrollit tatimor nga nëpunësit përgjegjës sa me poshtë vijon :

*Referuar Njoftimit të Kontrollit Tatimor me nr. 4192/2 Prot date 07.06.2021 dhe Program Kontrollit. dhe programit të kontrollit bashkëngjitur ushtruar mbi subjektin “A.” SHPK me Nipt J.L dhe programit përkatës të miratuar në zbatim të tij është kryer kontrolli nga inspektori e kontrollit i Drejtorisë së Tatimpaguesve të Mëdhenj A. D., trajtuar nga përgjegjës sektori z. E.M., drejtorie z. M.R. dhe përcjellë pranë operatorit ekonomik sipas shkresës administrative nga znj. I.A. Drejtore Rajonale e DTM.*

**- Në lidhje me auditimin e praktikës së Raportit Përfundimtar të Kontrollit evaduar me shkresën nr. 4388/2 prot. dt. 01.06.2021 për shoqërinë “A.” SHPK me Nipt L.R, nga Drejtoria Tatimore e Tatimpaguesve të Medhenj, i realizuar në bazë të Njoftimit Kontrolli dhe Program Kontrollit.**

Kohëzgjatja e kontrollit nga 01.06.2021 deri me 15.07.2021.

Kontrolli u krye nga inspektori i kontrollit tatimor **H. M.**

*Periudha e kontrolluar nga 01.02.2018 deri me 31.03.2021 për TVSH-ne, sigurimet shoqërore, shëndetësore, Tatimin mbi të ardhurat personale e tatimet e tjera, si dhe Bilancet e viteve 2018, 2019 dhe 2020 për Tatimin mbi Fitimin.*

**Problematikat që janë audituar :**

- Rakordimi i faturave të shitjes dhe blerjeve si dhe rakordimi i shifrave të inventarit;
- Rakordimi i pagesës së TVSH- se apo i tepicës kreditore;
- Rakordimi i të ardhurave dhe i blerjeve të deklaruara në F.D.P - të muajore me ato të hedhura në sistemin informatik të të dhënave;

- Rakordimi i saktësisë për shërbimet e shitura;
  - Rakordimi i saktësisë të lëvizjeve të bankës dhe të arkës sipas pasqyimit në Raportin Përfundimtar të Kontrollit;
  - Rakordimi i blerjeve sipas origjinës, importe, dhe blerje brenda vendit apo blerje që i shërbejnë shitjeve të tatueshme apo shitjeve të perjashtuara;
  - Rakordimi i importeve me të dhënat e doganës dhe krahasimi me sistemin informatik ;
  - Rakordimi për shitjet brenda vendit nëse aplikohen skema të veçanta ligjore shitjet me TVSH zero;
  - Rakordimi për amortizimin e aseteve;
  - Zbatimi i shkresës së DPT-së Nr.10189 prot,date 03.05.2013 “*Aneksi i indikatorëve të aktivitetëve të dyshimta për raportim nga inspektoret tatimor*” ;
  - Rakordimi i të ardhurave të deklaruara në bilancin kontabël me ato të deklaruara në F.D.P - të mujore ;
  - Rakordimi i cilësuar i përlllogaritjeve të bëra për kostot e mallrave dhe prodhimet e shitura;
  - Rakordimi i saktësisë të shpenzimeve të regjistruar në librat kontabël, për blerjet e kryera nga tatimpaguesi të regjistruar në TVSH -se;
  - Rakordimi dhe analiza e normativave në harxhimin e materjaleve sipas natyrës dhe shërbimit të tyre në funksion të aktivitetit apo jo;
  - Rakordimi në shpenzimet e regjistruara të shërbejnë totalisht veprimtarisë së tatimpaguesit , si rakordimi i përlllogaritjeve të bëra për shpenzimet e blerjes së mallrave dhe kostos së prodhimit ose shërbimit duke llogaritur edhe marzhin tregtar;
  - Rakordimi i shërbimeve dhe faturave nga jashtë, vlerat dhe përshkrimi i shërbimeve të kryera;
  - Rakordimi i saktësisë së deklarimit të të ardhurave personale, të tatimit në burim dhe dividetit, etj;
  - Rakordimi i të dhënave mbi klientët dhe furnitorët (*lidhja e tyre me të ardhurat dhe shpenzimet*);
  - auditimi i kontrollit të kryer për sigurimet shoqërore;
  - auditimi për tatime të tjera ;
- Në përfundim të auditimit nuk rezultojnë pasaktësi materiale në llogaritjen dhe qëndrimin e DTM me kontrollin e kësaj procedure. Për sa me sipër trajtuar në përfundim kjo dosje kontrolli është trajtuar dhe evaduar gjatë procedurave të kontrollit tatimor nga nëpunësit përgjegjës sa më poshtë vijon :

*Referuar Njoftimit të Kontrollit Tatimor dhe Program Kontrollit. dhe programit të kontrollit bashkëngjitur ushtruar mbi subjektin “A.” SHPK me Nipt L.R dhe programit përkatës të miratuar në zbatim të tij është kryer kontrolli nga inspektori e kontrollit i Drejtorisë së Tatimpaguesve të Mëdhenj H.M., trajtuar nga përgjegjës sektori z. A.T., drejtorie z. M.R. dhe përcjellë pranë operatorit ekonomik sipas shkresës administrative nr. 4388/2 prot. dt. 01.06.2021 nga znj I.A. Drejtore Rajonale e DTM.*

***-Në lidhje me auditimin e praktikës së Raportit Përfundimtar të Kontrollit evaduar me shkresën nr. 4388/2 prot. dt. 01.06.2021 për shoqërinë “A. C.” SHPK me nipt K.T, nga Drejtoria Tatimore e Tatimpaguesve të Medhenj, i realizuar në bazë të Njoftimit Kontrolli dhe Program Kontrollit. Në këtë kontroll sipas Autorizimit Nr. 3132/3 Prot, datë 15.06.2022, ka marrë pjesë dhe Inxhinjeri i DTM z. E. A. i cili ka kryer zberthimet materiale të situacioneve sipas Raportit Teknik të datës 22.07.2022 i cili është pjesë integrale e këtij raport kontrolli. Kontrolli u krye nga inspektori i kontrollit tatimor M. M..***

*Referuar programit të kontrollit, në lidhje me “Tatimin mbi Fitimin” u kontrolluan periudhat tatimore 2017-2021, në lidhje me “Tatimin mbi Vlerën e Shtuar”, janë kontrolluar periudhat tatimore nga muaji Mars 2017 deri në Shkurt 2022.*

*Në lidhje me “Kontributet e Sigurimeve Shoqërore dhe Tatimin mbi të Ardhurat”, u kontrolluan periudhat tatimore nga muaji Mars 2017 deri në Shkurt 2022 dhe “Tatime të tjera” periudha deri Shkurt 2022.*

**Problematikat që janë audituar :**

- Rakordimi i faturave të shitjes dhe blerjeve si dhe rakordimi i shifrave të inventarit ;
- Rakordimi i pagesës së TVSH- se apo i tepcës kreditore ;
- Rakordimi i të ardhurave dhe i blerjeve të deklaruara në F.D.P - të mujore me ato të hedhura në sistemin informatik të të dhënave;
- Rakordimi i saktësisë për shërbimet e shitura;
- Rakordimi i blerjeve sipas origjinës, importe, dhe blerje brenda vendit apo blerje që i shërbejnë shitjeve të tatueshme apo shitjeve të përjashtuara;
  - Rakordimi i importeve me të dhënat e doganës dhe krahasimi me sistemin informatik ;
- Rakordimi për shitjet brenda vendit nëse aplikohen skema të veçanta ligjore shitjet me TVSH zero;
- Rakordimi për amortizimin e aseteve;
- Rakordimi i të ardhurave të deklaruara në bilancin kontabël me ato të deklaruara në F.D.P - të mujore ;
- Rakordimi i cilësuar i përlllogaritjeve të bëra për kostot e mallrave dhe prodhimet e shitura;
- Rakordimi i saktësisë të shpenzimeve të regjistruar në librat kontabël, për blerjet e kryera nga tatimpaguesi të regjistruar në TVSH -se;
- Rakordimi dhe analiza e normativave në harxhimin e materjaleve sipas natyrës dhe shërbimit të tyre në funksion të aktivitetit apo jo;
- Rakordimi nëse shpenzimet e regjistruara i shërbejnë totalisht veprimtarisë së tatimpaguesit , si rakordimi i përlllogaritjeve të bëra për shpenzimet e blerjes së mallrave dhe kostos së prodhimit; ose shërbimit duke llogaritur edhe marzhin tregtar;
- Rakordimi i shërbimeve dhe faturave nga jashtë, vlerat dhe përshkrimi i shërbimeve të kryera;
- auditimi i kontrollit të kryer për sigurimet shoqërore;
- auditimi për tatime të tjera.

**Gjithashtu u konstatua se :**

*1-Në lidhje me kreditimin e karburantit për periudhën e kontrolluar të vitit 2017 (Mars-Dhjetor) shoqëria ka zbritur TVSH-në për blerje karburanti në shumën 290,679 lekë për vlerë të tatueshme 1,453,389 lekë, për vitin 2018 ka zbritur TVSH-në për blerje karburanti në shumën 823,720 lekë për vlerë të tatueshme 4,118,598 lekë, për vitin 2019 shoqëria ka zbritur TVSH-në për blerje karburanti në shumën 654,028 lekë për vlerë të tatueshme 3,270,138 lekë, për vitin 2020 shoqëria ka zbritur TVSH-në për blerje karburanti në shumën 694,858 lekë për vlerë të tatueshme 3,474,290 lekë, dhe për vitin 2021 shoqëria ka zbritur TVSH-në për blerje karburanti në shumën 784,769 lekë për vlerë të tatueshme 3,923,846 lekë dhe nuk ka tejkaluar normativën e përcaktuar në ligjin Nr. 92/2014 datë 24.07.2014 “Për TVSH-në” nenit 74 si dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave Nr 6 datë 30.01.2015 “Për TVSH-në” neni 55. Konstatohet gjatë auditimit se nuk është kryer një analizë e plote e mjeteve motorike që janë përdorur nga shoqëria në vitet respektive për kreditimin e karburantit të trajtuar sa me sipër*

*2-Konstatohet se shoqëria ka deklaruar shitje përfundimtare për vitin 2018 sipas kontratave për apartamente, njësi tregtare, parkim dhe pronare tëke informale në shumën 209,206,262 lekë, për vitin 2020 shoqëria ka deklaruar shitje të përjashtuara nga TVSH-ja në vlerë 94,876,717 lekë të*

detajuara shitje apartamenti, njësi tregtarë ose parkim shitje përfundimtare 2022 sipas kontratave për apartamente, njësi tregtare dhe parkim kemi në shumën 3,531,189 lekë pa detajuar llojin e sipërfaqes, zonën e ndërtimit, kostot e shitjes dhe afatin kohor të shitjes

3-Per vitin 2017 konstatohet se llogaria “Arkëtime në avancë për porosi” pasqyruar në shumën 349,981,471 lekë ka përfshirë arkëtimet e marra nga klientët të cilët kanë lidhur kontratë me porosi në lidhje me shitjen e apartamenteve, njësi tregtare dhe garazheve, për vitin 2018 konstatohet se llogaria “Arkëtime në avancë për porosi” është pasqyruar në shumën 318,942,515 lekë, për vitin 2019 konstatohet se llogaria “Arkëtime në avancë për porosi” është pasqyruar në shumën 254,388,415 lekë për vitin 2021 konstatohet se llogaria “Arkëtime në avancë për porosi” është pasqyruar në shumën 185,653,270 lekë dhe për vitin llogaria “Arkëtime në avancë për porosi” është pasqyruar në shumën 124,803,874 lekë. Konstatohet se nuk është kryer një analizë e detajuar për statusin e arkëtimeve në llogarinë “Arkëtime në avancë për porosi” për vitet 2017 deri 2021 në lidhje me afatin përfundimtar të lejes së ndërtimit dhe aktit të kolaudimit të objekteve të ndërtimit me qëllim tezaurimin dhe llogaritjen e arkëtimeve në avancë për porosi si shitje përfundimtare pjesore të detyrueshme bazuar në legjislacionin në fuqi.

Konstatohet se në lidhje me huatë të marra të trajtuara në llogarinë “Të tjera të pagueshme” pasqyruar në shumën 45,671,550 lekë për vitin 2017, në shumën 42,302,328 lekë për vitin 2018, në shumën 56,924,459 lekë për vitin 2018, në shumën 54,994,709 lekë për vitin 2019, në shumën 54,994,709 lekë për vitin 2020 dhe në shumën 41,455,914 lekë për vitin 2021 përfaqësohet nga detyrimi i shoqërisë ndaj huadhënësit por pa trajtuar kontratën, kushtet, afatin dhe formën e huase.

Në përfundim të auditimit rezultojnë nuk pasaktësi materiale në llogaritjen dhe qëndrimin e DTM me kontrollin e kësaj procedure. Për sa me sipër trajtuar në përfundim kjo dosje kontrolli është trajtuar dhe evaduar gjatë procedurave të kontrollit tatimor nga nëpunësit përgjegjës sa me poshtë vijon :

*Referuar Njoftimit të Kontrollit Tatimor dhe Programit të Kontrollit dhe programit të kontrollit bashkëngjitur ushtruar mbi subjektin “A. C.” SHPK me nipt K.T., dhe programit përkatës të miratuar në zbatim të tij është kryer kontrolli nga inspektori i kontrollit të Drejtorisë së Tatimpaguesve të Mëdhenj M. M., trajtuar nga përgjegjës sektori z. E.M., drejtorie z. O.C. dhe përcjelle pranë operatorit ekonomik sipas shkresës administrative nga znj. E.C. Drejtore Rajonale e DTM.*

Në lidhje me gjetjet dhe konstatimet e trajtuara në **Projekt Raportin e Auditimit të dërguar me nr. 14/9 date 04.08.2023 prot date 04.03.2023 KLSH dhe 52/26 Prot DTM date 08.08.2023** mbi auditimin e ushtruar në Drejtorinë e Tatimpaguesve të Mëdhenj, në bazë të programit të auditimit financiar nr. 14/1 prot, datë 09.01.2023, mbajtur në datë 30.06.2023. në zbatim të pikës 2 të Programit të Auditimit “Mbi vlerësimin e përputhshmërisë ligjore të veprimtarisë së Drejtorisë së Kontrollit Tatimor/Sektori i Kontrollit në Vend/Sektori i Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit”, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë dërguar sipas shkresës nr. ... datë ..... nga nëpunësi i audituar dhe konkretisht **z. I. P.** ka bërë komente dhe shpjegime me shkresën e mësipërme të Drejtorisë së Tatimpaguesve të Mëdhenj dhe konkretisht.

**Pretendimi i subjektit auditues** konsiston në faktin që gjetjet dhe konstatimet që lidhen me trajtimet e bëra në Projekt Raportin e Auditimit **me nr. 14/9 date 04.08.2023 prot date 04.03.2023 KLSH dhe 52/26 Prot DTM date 08.08.2023** dërguar pranë DTM në lidhje me konstatimet në adresë të subjektit Ballkan M. T. SHPK me Nipt L.G nuk qëndrojnë pasi llogaritja e kostos së mallrave të shitura KMSH për vitin ushtrimor 2019 dhe 2020 është deklaruar drejte dhe është llogaritur drejte nga shoqëria duke trajtuar faktin se referenca doganore, transporti, nuk janë elemente të kostos së blerjes së mallit dhe nuk regjistrohen kontabilitetin e shoqërisë por në librat e blerjes së mallit dhe FDP e TVSH/se si dhe blerje malli pa fatura tatimore si dhe shpenzime bankare, shpenzime për gjopa dhe dëmshpërblime rreshtuar në



shpenzimet e panjohura , taksa per kolaudim, lokale, vlera e mbetur e aktiveve te shitura.

#### **Qëndrimi auditues**

Grupi auditues gjykon që te mos merret ne konsiderate observacioni pasi nga te dhënat makro te marra nga sistemi Cats rezulton nje diference per e kostove te mallit per vitin 2019 dhe 2020 e llogaritur kjo midis deklarimit te KMSH ne bilancin per vitin 2019 dhe 2020 dhe Kostos se Mallrave te Shitur te llogaritur nga te dhënat e sistemit Cats sipas formulës KMSH= (Inventar i meparshem+blerje+shpenzime+investime+importe)-Inventar fund viti ne shumat respektive te pasqyruara ne materialin e shtjelluar sa me siper per kete subjekt.

Kjo analize nuk është kryer nga ana e inspektorit tatimor z. I. P. ne Raportin Paraprak te Kontrollit dhe ne Raportin Përfundimtar te Kontrollit per vitet e kontrolluara te aktivitetit financiar 2019 dhe 2020 duke kryer veprime ne kundërshtim me legjislacioni tatimor te fushës dhe manualin e kontrollit financiar.

Në lidhje me gjetjet dhe konstatimet e trajtuara në **Projekt Raportin e Auditimit te dërguar me nr. 14/9 date 04.08.2023 prot date 04.03.2023 KLSH dhe 52/26 Prot DTM date 08.08.2023** mbi auditimin e ushtruar në Drejtorinë e Tatimpaguesve të Mëdhenj, në bazë të programit të auditimit financiar nr. 14/1 prot, datë 09.01.2023, mbajtur në datë 30.06.2023. në zbatim të pikës 2 të Programit të Auditimit “Mbi vlerësimin e përputhshmërisë ligjore të veprimtarisë së Drejtorisë së Kontrollit Tatimor/Sektori i Kontrollit në Vend/Sektori i Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit”, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë dërguar sipas shkresës nr. ... datë ..... nga nëpunësi i audituar dhe konkretisht **z.F.S.** ka bërë komente dhe shpjegime me shkresën e mësipërme te Drejtorise se Tatimpaguesve te Mëdhenj dhe konkretisht.

**Pretendimi i subjektit auditues** konsiston ne faktin qe gjetjet dhe konstatimet qe lidhen me trajtimet e bëra në Projekt Raportin e Auditimit **me nr. 14/9 date 04.08.2023 prot date 04.03.2023 KLSH dhe 52/26 Prot DTM date 08.08.2023** dërguar prane DTM ne lidhje me konstatimet ne adrese te subjektit E. G. me Nipt K.P

**Pretendimi i subjektit auditues** konsiston ne faktin qe gjetjet dhe konstatimet qe lidhen me trajtimet e bëra në akt konstatim në ngarkim të subjektit E. G. me nipt K.P që lidhen me pasaktësinë materiale në shumën 8,873,563 lekë nuk është zbërthyer dhe analizuar pasi nuk ka qenë objekt tatim fitimi i vitit 2021 pasi nuk ka gjendje inventari malli në fund të periudhës në mungesë të hartimit të bilancit si dhe me problematikën e aktivitetit të kompanisë si shitje me pakicë ose shumicë konkludohet që aktiviteti është i gjithi me pakicë dhe nuk mund të kemi krahasim të shitjeve me pakicë ose shumicë, pjesa e huave është kaluar me kalime bankare nga ortaku i vetëm, si dhe per subjektin \*B.\* me nipt K.H argumentohet se subjekti ka shitur me marzh fitimi apartamente dhe bazuar ne shkresën nr 307/42 date 20.09.2019 te lëshuar nga Drejtoria Teknike Ligjore DPD, ne lidhje me huate këto fonde jane kaluar brenda kompanive te grupi si dhe parapagimet e vitit 2021 nuk jane pjese shqyrtimi e grupit te kontrollit pasi jane jashtë afatit te kontrollit

#### **Qëndrimi auditues**

Grupi auditues gjykon që ne lidhje me gjetjet dhe konstatimet e observuar per subjektin E. G. te merret ne konsiderate observacioni dhe te reflektohet ne Raportin e Auditimit .Grupi auditues gjykon që ne lidhje me gjetjet dhe konstatimet e observuar per subjektin B. SHPK te merret ne konsiderate observacioni dhe te reflektohet observacioni i bere.

Në lidhje me gjetjet dhe konstatimet e trajtuara në **Projekt Raportin e Auditimit te dërguar me nr. 14/9 date 04.08.2023 prot date 04.03.2023 KLSH dhe 52/26 Prot DTM date 08.08.2023** mbi auditimin e ushtruar në Drejtorinë e Tatimpaguesve të Mëdhenj, në bazë të programit të auditimit financiar nr. 14/1 prot, datë 09.01.2023, mbajtur në datë 30.06.2023. në zbatim të pikës 2 të Programit të Auditimit “Mbi vlerësimin e përputhshmërisë ligjore të veprimtarisë së Drejtorisë së Kontrollit Tatimor/Sektori i Kontrollit në Vend/Sektori i Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit”, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë dërguar sipas shkresës nr. ... datë ..... nga nëpunësi i audituar dhe konkretisht **z.A.D.** ka bërë komente dhe shpjegime me shkresën e mësipërme te DTM dhe konkretisht.

**Pretendimi i subjektit auditues** konsiston ne faktin qe gjetjet dhe konstatimet qe lidhen me trajtimet e bëra në Projekt Raportin e Auditimit **me nr. 14/9 date 04.08.2023 prot date 04.03.2023 KLSH dhe 52/26 Prot DTM date 08.08.2023** dërguar prane DTM ne lidhje me konstatimet ne adrese te subjektit B. me

Nipt K.H dhe H. F. N. me Nipt J.E

**Pretendimi i subjektit auditues** konsiston ne faktin qe gjetjet dhe konstatimet qe lidhen me trajtimet e bëra në akt konstatim në ngarkim të subjektit B.O. me nipt K.H për trajtime dhe konstatime që lidhen me kryerjen e inventarit fizik, mos pasqyrimin në raportin përfundimtar te kontrollit te te dhënave zyrtare që lidhen me llojin e investimit, lejen e shfrytëzimit, tepricën pozitive te TVSH-se , mënyrën e kërkesës ekonomike per te cilën janë realizuar blerjet nga investime vendase , lejen zhvillimore , lejen e ndërtimit duke paraqitur por pa kryer nje analize te sakte te afateve dhe statusit te shpenzimeve te punimeve te kryera sipas lejeve respektive dhe afateve ligjore te aprovuara dhe miratuara nga Bashkia Shijak dhe Bashkia Tirane

1-Leje Zhvillimi nr.45 date 21.03.2019 Bashkia Shijak objekti “Përfaqësia Iveco”

2-Leje Ndërtimi nr. 1475/1prot date 03.05.2019 Bashkia Shijak “Përfaqësia Iveco 1 dhe 2 kate” me afat 24 Muaj nga data e lëshimit dhe afat fillimi punimi 1 vit nga data e lëshimit te lejes

3-Leje Ndërtimi nr prot E-16411/7 date 16.09.2019”godine hotelerie 1,9,dhe 10 kate me 2 kate parkim nëntoke” me afat 60 muaj dhe afat fillimi punimi 1 vit nga data e lëshimit te lejes

Gjithashtu trajtohet ne observacion fakti qe blerjet e investimeve vendase per periudhën 01.08.2018 deri me date 31.06.2022 jane kryer ne funksion te aktivitetit dhe kane dokumentacionin e duhur ligjor sipas nenit 101 te ligjit nr.92/2014 date24.07.2014 por pa dhënë informacion te plote me prova dhe fakte ligjore ne observacionin e bere ne lidhje me trajtimet dhe konstatimet e grupit auditues. Në lidhje me gjetjet dhe konstatimet e kryera në ngarkim te subjektit “H. F. N.” me nipt J.Ë nëpunësi i autorizuar z.A.D. pretendon se per artikullin rrushkull çmimi i artikullit është vendosur sipas çmimit mesatar qe shoqëria operon duke dhënë edhe shpjegimet respektive, ne lidhje me artikullin betulla pretendohet se sasia e daljes është 35,720 kg e provuar kjo edhe me deklarata doganore bashkëlidhur, ndërsa per artikullin Hisell gabimi prej 80 kg ( gabim ne formule) nuk cenon vlerat dhe gjendjen ne fund

#### **Oëndrimi auditues**

Grupi auditues gjykon që te mos merret ne konsiderate observacioni pasi nuk ka argumente te plota me prova dhe akte shkresore ne mbështetje te materialit dhe observacionit te kryer.

Në lidhje me gjetjet dhe konstatimet e trajtuara në **Projekt Raportin e Auditimit te dërguar me nr. 14/9 date 04.08.2023 prot date 04.03.2023 KLSH dhe 52/26 Prot DTM date 08.08.2023** mbi auditimin e ushtruar në Drejtorinë e Tatimpaguesve të Mëdhenj, në bazë të programit të auditimit financiar nr. 14/1 prot, datë 09.01.2023, mbajtur në datë 30.06.2023. në zbatim të pikës 2 të Programit të Auditimit “Mbi vlerësimin e përputhshmërisë ligjore të veprimtarisë së Drejtorisë së Kontrollit Tatimor/Sektorit i Kontrollit në Vend/Sektorit i Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit”, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë dërguar sipas shkresës datë 30.09. 2023 nga nëpunësi i audituar dhe konkretisht **z V. M.** ka bërë komente dhe shpjegime me shkresën e mësipërme te Drejtorise se Tatimpaguesve te Mëdhenj dhe konkretisht.

**Pretendimi i subjektit auditues** konsiston ne faktin qe gjetjet dhe konstatimet qe lidhen me trajtimet e bëra në Projekt Raportin e Auditimit **me nr. 14/9 date 04.08.2023 prot date 04.03.2023 KLSH dhe 52/26 Prot DTM date 08.08.2023** dërguar prane DTM ne lidhje me konstatimet ne adrese te subjektit A. me Nipt K.M nuk qëndrojnë pasi llogaritja e koston se mallrave te shitura KMSH per vitin ushtrimor 2021 është deklaruar drejte dhe është llogaritur drejte nga shoqeria duke trajtuar faktin se,elementet e koston se mallit janë te sakte referuar te dhënave ne bilancin material te deklaruar nga shoqeria per vitin 2021 dhe sipas verifikimeve te kryera gjate kontrollit tatimor nuk janë vërejtur pasaktësi materiale.

#### **Oëndrimi auditues**

Grupi auditues gjykon që te mos merret ne konsiderate observacioni pasi nga te dhënat makro te marra nga sistemi Cats dhe te dhënave te marra nga deklarimet ne Bilancit te dorëzuar per vitin ushtrimor 2021 rezulton nje diference e pajustificuar **në shumën 444,526,273 mijë lekë e cila eshte karakterizuar si shpenzim i panjohur** per deklarimet e trajtuara per vitin 2021 e llogaritur kjo midis deklarimit te KMSH ne bilancin per vitin 2021 dhe Koston se Mallrave te Shitur te llogaritur nga te dhënat e sistemit Cats sipas formulës KMSH= (Inventar i meparshem+blerje+shpenzime+investime+importe)-Inventar fund viti ne shumate respektive te pasqyruara ne materialin e shtjelluar sa me siper per kete subjekt. Kjo analize nuk është kryer nga ana e inspektorit tatimor z. V. M. ne Raportin Paraprak te Kontrollit dhe ne Raportin

*Përfundimtar te Kontrollit per vitet e kontrolluara te aktivitetit financiar 2021 duke kryer veprime ne kundërshtim me legjislacioni tatimor te fushës dhe manualin e kontrollit financiar.*

*Te dhena sipas BILANCIT TE VITIT 2021.*

*1- Blerja e Materialeve te pergjithshme ( 2021) shuma 8,613,929 mije leke*

*2- Shpenzime te pergjithshme administrative 982,578 mije leke*

*KMSH =Totali Blerje dhe Shpenzime =9,596,507 mije leke*

*Te dhena te nxjerra sipas sistemit CATS nga sistemi elektronik Tatimor.*

*1-- Inventari ne fillim Viti 2021 shuma 1,944,170 mije leke*

*2-Blerje te raportuara (perjashtuara nga TVSH) ne deklarata FDP per vitin 2021 shuma 537,413 mije leke*

*3- Vlerat e Importeve te raportuara ne FDP per vitin 2021 shuma 1,939,104 mije leke*

*4- Blerje nga Furnitore vendas te raportuara ne FDP per vitin 2021 shuma 7.876,105 mije leke*

*5- Inventari ne fund te vitit 2021 sipas raportimit ne sistem shuma 3,171,813 mije leke*

*6-Shpenzime te tjera deklaruar zero*

*KMSH sipas deklarimit ne raportimin ne deklaratat e percaktuara tatimore*

*KMSH e llogaritur nga grupi auditues = (1+2+3+4)-(5-6)= 9,124,980 mije leke.*

*DIFERENCA = KMSH deklaruar-KMSH llogaritur= 444,526,273 leke*

*Shuma prej 444,526,273 eshte shpenzim i pajustificuar dhe nga pikepamja e legjislacionit tatimor te fushes konsiderohet ne menyre automatike shpenzim i panjohur dhe per kete qellim jane rekomansuar edhe detyrimet tatimore respektive ne zbatim te legjislacionit tatimor duke rrillogaritur edhe detyrimet tatimore respektive shoqeruar edhe me sanksionet respektive*

**- Subjekti:** A. A. E. SHA.

**Nipti:** L.A.

**Adresë Kryesore:** Njësia Bashkiake Nr.2, Rruga Papa Gjon Pali i II-të, ABA Business Center, Kati 6, Nr.601, Tiranë.

**Aktiviteti:** Financim, projektim, ndërtim, vënien në punë, administrimin, mirëmbajtjen e hidrocentraleve "Peshqesh", "Ura e Fanit" dhe te "Fangut" dhe transferimin e tyre ne përfundim të kontratës nga Koncesionari tek A.K në zbatim të kontratës së koncesionit. Ndërtimi, operimi dhe transferimi i hidrocentraleve "Peshqesh", "Ura e Fanit" dhe të "Fangut", tek A.K, ku përfshihet financimi, ndërtimi, vënia në punë, prodhimi, furnizimi, transmetimi, shpërndarja, eksportimi dhe shitja e energjisë në zbatim të kontratës së koncesionit.

**Inspektori:** G. J.

**Inspektori:** O. B.

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

- Për **TVSH** - periudha tatimore nga: **01/2017-02/2021**.

- Për **Tatim Fitimin** periudha tatimore nga: **2015-2019**.

- Për **Sigurimet Shoqërore e Shëndetësore** - periudha tatimore nga: **01/2017-02/2021**.

- Të **Tjera** periudha tatimore nga: **01/2017-02/2021**.

Nga auditimi i raportit të kontrollit tatimor të tatimpaguesit "A. A. E." SHA, i cili ka volume në vlera të larta të punimeve ndërtimore si dhe kompleksitet të lartë të transaksioneve financiare, janë konstatuar mungesa të analizave dhe vlerësimeve të detajuara të kontratave koncesionare, lejeve të ndërtimit, punimeve referuar projekteve, grafikut të punimeve, aktet e kolaudimit të veprave dhe raportet e AKBN-së, si institucioni përgjegjës për monitorimin e hidrocentraleve, element këto që rrisin riskun operacional për trajtimin korrekt të situatës. Nga rrjedh se nga administrata tatimore e DTM-së, janë certifikuar investime dhe TVSH-ja, për vlera punimesh ende të pa certifikuara prej organeve kompetente sipas detyrimeve kontraktuale dhe legjislacionit të fushës përkatëse, pavarësisht riskut teknik ose risqeve të tjera që mund të çenojnë

funksionimin normal të tyre, garantimin dhe gjenerimin e të ardhurave të tatueshme të vijueshme, të cilat i japin tatimpaguesit të drejtën e zbritjes së tatimit sipas përcaktimeve të *Kreut IX "Lindja dhe aplikimi i së drejtës së zbritjes" të Ligjit Nr.92/2014 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe Udhëzimit Nr.6, datë 30.01.2015 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë"*.

Sipas marrëveshjes së koncesionit, shoqëria koncesionare është e lejuar që të furnizojë prodhimin neto të energjisë elektrike brenda ose jashtë Shqipërisë. Marrëveshja e koncesionit përbën një model projekti i tipit BOT (*Ndërtim-Operim-Transferim*) dhe do të zgjasë për një periudhë prej 41 vjetësh (*35 vjet me një zgjatje prej 6 vitesh e aprovuar nga vendimi Nr.442 me date 22 Maj 2013*), me të drejtë zgjatjeje automatike pas përmbushjes së disa kushteve të përcaktuara në marrëveshjen e koncesionit. Pas kësaj periudhe hidrocentrali do t'i transferohet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës (METE), pa asnjë tarifë bashkë me pajisjet e lidhura operuese, të drejtat dhe kontratat. Koncesionari do të ndërtojë tre hidrocentrale "*Peshqesh*", "*Ura e Fanit*" dhe "*Fangu*" (*Siç specifikohet në shtesën e kontratës së koncesionit aprovuar nga vendimi Nr.51 me date 25.01.2017 me një kapacitet total të instaluar prej 109.71 MW, investimi total është 210,184,740 Euro*). Ndërtimi i tre hidrocentraleve të Peshqeshit përfundoi me 4 Maj 2015. Kapaciteti i instaluar dhe kapaciteti vjetor për prodhimin është 34 MW dhe 118.400.000 kWh respektivisht. Ndërtimi i hidrocentralit Ura Fanit dhe Fangu përfundojë më 30 nëntor 2017.

*Baza e përgatitjes së pasqyrave financiare, përshkruar në shënimet shpjeguese deklarohet se është në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), por nuk është shpjeguar mbi cilin standard dhe parim është bërë klasifikimi i kontratës koncesionare si aktiv afatgjatë material dhe metoda e amortizimit përkatëse për këtë aktiv.*

Veprime këto të cilat në gjykimin e grupit të auditimit janë në kundërshtim me *Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF)*, sepse në përfundim të ndërtimit dhe vendosjes në punë të hidrocentraleve, duke filluar prodhimin e energjisë elektrike, duhet që të gjitha investimet në punime, makineri dhe shërbime të kryera, për sjelljen në gjendje pune të hidrocentralit, të ishin kapitalizuar në dy llogari kontabël të bilancit sipas klauzolave, përkatësisht në zërat aktive afatgjata jo-materiale dhe aktive financiare. Ndarje kjo sipas përcaktimeve të SNK 38 "Aktivet Jo-materiale", SNK 39 "Instrumentet Financiar", KIRFN 12 "Marrëveshjet Koncesionare të Shërbimit", KIS 29 "Marrëveshjet e Koncesionit për Shërbimet - Dhënia e informacioneve shpjeguese" dhe SKK 13 "Aktivet biologjike dhe marrëveshjet koncesionare", e cila është në harmoni me SNRF, në varësi të periudhës që autoriteti kontraktor i ka siguruar shitjen e garantuar të energjisë (*xx vjet*) si aktiv financiar, kurse për pjesën tjetër të kohëzgjatjes së afatit të kontratës koncesionare (*xx vjet*), ku shoqëria ka të drejtë ta shes energjinë elektrike në treg të lirë si aktiv afatgjatë jo-material.

Në aspektin kontabël jemi në situatën e një **marrëveshje koncesionare të kushtëzuar** dhe ku përfitimit ekonomike të ardhshme, do të vijnë nga e drejta e tarifimi për energjinë që do të shitet sipas përcaktimeve të marrëveshjes koncesionare. Gjithashtu për t'u theksuar është edhe fakti se shoqëria nuk e kontrollon aktivin sepse nuk është pronare e aktivit material të krijuar që në rastin konkret është hidrocentrali, pra nuk plotësohet kushti "*pronësisë/kontrollit mbi aktivin*", që të njihet si aktiv afatgjatë material në bilancin e shoqërisë si dhe nuk është aktiv material afatgjatë, që do t'i gjenerojnë të ardhura por e drejta e tarifimit nga e cila do të gjenerohen edhe të ardhurat e shoqërisë, pra nuk plotësohet që nga përdorimi i aktivit do të gjenerohen të ardhura në të

ardhmen. Por për ta përfituar të drejtën e tarifimit duhet të bëjë ndërtimin dhe vënien në punë të hidrocentraleve sipas përcaktimeve të kontratës koncesionare përkatëse.

Sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit, konkretisht KIRFN Interpretimi Marrëveshjet Koncesionare të Shërbimit, Standardi Ndërkombëtar i Kontabilitetit 38 Aktivitet Jo-Materiale, KIS Interpretimi Marrëveshjet e Koncesionit për Shërbimet: Dhënia e informacioneve shpjeguese:

- Nëse operatori siguron shërbime ndërtimi ose të përmirësimit, shuma e arkëtuar ose për t'u arkëtuar nga operatori do të njihet në përputhje me SNRF 15 me vlerën e saj të drejtë. Shuma mund të jetë një e drejtë për: (a) një aktiv financiar, ose (b) një aktiv jo material.

- Operatori do të njohë një aktiv financiar në masën që ai ka një të drejtë kontraktuale të pakushtëzuar për të arkëtuar mjete monetare ose një aktiv financiar tjetër nga ose me urdhër të konçesiondhënësit për shërbimet e ndërtimit; koncesion dhënësi ka pak, nëse ka, mundësi të mos paguajë, sepse zakonisht marrëveshja është e detyrueshme me ligj. Operatori ka një të drejtë të pakushtëzuar të arkëtojë mjete monetare nëse koncesion dhënësi garanton kontraktualisht t'i paguajë operatorit (a) shuma të specifikuar ose të përcaktueshme apo (b) diferencën, nëse ka, midis shumave të arkëtuara nga përdoruesit e shërbimit publik dhe shumave të specifikuar ose të përcaktueshme, madje edhe kur pagesa është në varësi të plotësisht të kërkesave nga operatori për cilësinë ose efikasitetin e specifikuar të infrastrukturës.

- Operatori do të njohë një aktiv jo-material në masën që i jep atij të drejtën (licencën) për t'i tarifuar përdoruesve të shërbimit publik. Një e drejtë për t'ia faturuar shpenzimet përdoruesve të shërbimit publik nuk është një e drejtë e pakushtëzuar për të arkëtuar mjete monetare, sepse shumat janë në varësi të shkallës së përdorimit të shërbimit nga publiku.

Sipas Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit, përcaktohet se:

### **SKK 13 “Aktivitet biologjike dhe marrëveshjet koncesionare”**

- “Një marrëveshje koncesionare e shërbimeve është një marrëveshje ku një qeveri ose një organ tjetër i sektorit publik (koncesion dhënësi) kontraktin një operator privat për të ndërtuar (ose përmirësuar), përdorur dhe mirëmbajtur aktivitetet e infrastrukturës së konçesiondhënësit si rrugë, ura, tunele, aeroporte, rrjete të shpërndarjes së energjisë, burgje apo spitale. Në këto marrëveshje, koncesion dhënësi kontrollon ose rregullon çfarë shërbimesh duhet të ofrojë operatori duke përdorur aktivitetet, kujt duhet t'ia sigurojë dhe me çfarë çmimi, dhe gjithashtu kontrollon çdo interes të mbetur domethënës në aktive në fund të afatit të marrëveshjes”.

- Ka dy kategori kryesore të marrëveshjeve koncesionare të shërbimeve:

(a) Në njërën, operatori merr një aktiv financiar, një të drejtë kontraktuale të pakushtëzuar për të marrë një shumë specifike ose të përcaktueshme fluksesh monetare ose një aktiv tjetër financiar nga qeveria në këmbim të ndërtimit ose përmirësimit të një aktivi të shërbimit publik dhe më pas duke përdorur dhe mirëmbajtur aktivitetin për një periudhë kohe të specifikuar. Kjo kategori përfshin garanci nga qeveria për të paguar për çdo mungesë ndërmjet shumave të marra nga përdoruesit e shërbimit publik dhe shumave të specifikuar apo të përcaktueshme.

(b) Në tjetrën, operatori merr një aktiv jo-material—një të drejtë tarifimi për përdorimin e një aktivi të sektorit publik që ai ndërton ose përmirëson dhe më pas e përdor dhe e mirëmban për një periudhë kohe të specifikuar. Një e drejtë për t'ia tarifuar përdoruesve nuk është një e drejtë e pakushtëzuar për të marrë mjete monetare sepse shumat janë të kushtëzuara në masën në të cilën publiku përdor shërbimin.

- Modeli i aktivitetit financiar: Operatori duhet të njohë një aktiv financiar në masën që ai ka një të drejtë kontraktuale të pakushtëzuar për të marrë mjete monetare ose një aktiv tjetër financiar nga ose në drejtimin e konçesiondhënësit për ndërtimin e shërbimeve. Operatori duhet të masë aktivitetin financiar me vlerën e drejtë. Më tej, ai duhet të ndjekë SKK 3 Instrumentet Financiare.

- Modeli i aktivitetit jo material: Operatori duhet të njohë një aktiv jo-material në masën që i jep atij të

drejtën (licencën) për t'i tarifuar përdoruesve të shërbimit publik. Operatori duhet fillimisht të masë aktivin jo-material me vlerën e drejtë. Më tej për kontabilizimin e aktivitet jo material, operatori duhet të zbatojë kërkesat e SKK5 Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jo materialë.

**SKK 5 “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivitet Afatgjata Jo materialë” - i përmirësuar.**

- Një AAJM do të paraqitet me koston e tij minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi.
- Një njësi ekonomike duhet të shpërndajë shumën e amortizueshme të një aktivi jo material në bazë sistematike gjatë jetës së tij të dobishme. Amortizimi për çdo periudhë do të njihet si një shpenzim, përveç nëse një SKK tjetër kërkon që kostoja të njihet si pjesë e koston së një aktivi tjetër.
- Amortizimi fillon kur aktivi jo material është i disponueshëm për përdorim, p.sh. kur ai është në vendin dhe në kushtet e domosdoshme për të qenë i përdorshëm sipas mënyrës së menduar nga drejtuesit. Amortizimi pushon kur aktivi çregjistrohet.
- Njësia ekonomike do të zgjedhë një metodë amortizimi që pasqyron modelin me të cilin ajo pret të konsumojë përfitimet ekonomike të ardhshme të aktivitet. Nëse njësia ekonomike nuk mund ta përcaktojë këtë model të besueshëm, ajo do të përdorë metodën lineare.
- Të gjitha aktivitet jomateriale do të konsiderohen që kanë një jetë të fundme të dobishme. Jeta e dobishme e një aktivi jomaterial që rrjedh nga të drejtat kontraktuale ose të drejta të tjera ligjore nuk duhet të kalojë periudhën e të drejtave kontraktuale ose të drejtave të tjera ligjore, por mund të jetë më e shkurtër në varësi të periudhës gjatë të cilës njësia pret të përdorë aktivin. Nëse të drejtat kontraktuale ose të drejta të tjera ligjore janë mbartur për një afat të kufizuar që mund të rinovohet, jeta e dobishme e aktivitet jomaterial do të përfshijë periudhën e rinovimit vetëm në qoftë se ka evidencë për të mbështetur rinovimin nga njësia ekonomike pa kosto të konsiderueshme.
- Nëse një njësi ekonomike nuk është në gjendje të bëjë një vlerësim të besueshëm të jetës së dobishme të aktivitet jomaterial, jeta e dobishme do të supozohet që të jetë dhjetë vite.

Pra nga sa më sipër arrijmë në konkluzionin se çdo investim dhe shpenzim që subjekti ka kryer për të vendosur në gjendje pune hidrocentralin (**përmirësim i tokës + ndërtesa + makineri**), me qëllim prodhimin e energjisë elektrike sipas kushteve dhe përcaktimeve të kontratës koncesionare me autoritetin kontraktor duhet të kapitalizoheshin dhe njiheshin në fund tek vlera e aktivitet jo-material dhe trajtimi i mëposhtëm i tij të vazhdonte sipas përcaktimeve të standarteve të kontabilitetit, paraqitur konkretisht si më poshtë:

Lekë

Zëri/Viti	2015	2016	2017	2018	2019
Përmirësim Tokë	153,461,504	227,606,694	-	-	-
Ndërtesa	26,742,473	33,689,073	-	-	-
Makineri	83,398,627	117,951,872	-	-	-
AAJM HEC	-	-	461,484,418	1,597,447,271	1,535,196,808

Burimi: DTM, përpunoni KLSH.

Lekë

Viti	AAJM (HEC)	Amortizimi	Vlera e mbetur	Shtesa
2017	32,860,991,574	888,134,907	31,972,856,667	
<b>Shtesa në vlerë për 2018 (+Investime)</b>				<b>536,749,943</b>
2018	32,509,606,610	903,044,628	31,606,561,982	
2019	31,606,561,982	903,044,628	30,703,517,354	

Burimi: DTM, përpunoni KLSH.

Nga analiza e mësipërme dalim në përfundimin se nëpërmjet kontabilizimit të gabuar të marrëveshjes koncesionare si aktiv afatgjatë material në pasqyrat financiare dhe aplikimit të

metodës jo të duhur të amortizimit, shoqëria ka rënduar PASH padrejtësisht me më shumë shpenzime amortizimi se sa përcaktohet nga SNRF dhe SNK, duke kryer në këtë mënyrë uljen e fitimit ta tatuashëm në mënyrë të padrejtë gjë që ka sjell uljen e detyrimit tatimor për tatim fitimin.

Lekë

Viti	2015	2016	*** 2017	2018	2019
Amortizimi i llogaritur AYEN AS SHA	263,602,604	379,247,639	461,484,418	1,597,447,271	1,535,196,808
Amortizimi i llogaritur sipas SNK/SNRF/SKK	0	0	888,134,907	903,044,628	903,044,628
<b>Diferenca</b>	<b>263,602,604</b>	<b>379,247,639</b>	<b>-426,650,489</b>	<b>694,402,643</b>	<b>632,152,180</b>

Burimi: DTM, përpunoni KLSH.

Shpenzimet e amortizimit të njohura më shumë se përcaktimet e SNRF dhe SNK do të klasifikohen si shpenzime të panjohura sipas përcaktimeve të shkronjës j) shpenzimet të cilat tejkalojnë kufijtë e përcaktuar me ligj apo me akte nënligjore të nenit 21 “Shpenzime të panjohura” të Ligjit Nr.8438, Datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar. Për këto parregullsi do të kryhet penalizimi i subjektit sipas përcaktimeve të nenit 115 “Plotësim i pasaktë i deklarates tatimore” të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008, ku përcaktohet qartë: “Dorëzimi i një deklarate tatimore të pasaktë dënohet me një gjobë të barabartë me 0,06 përqind të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë, gjatë së cilës pagesa nuk është kryer. Në asnjë rast, gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike”.

Lekë

Viti	2015	2016	*** 2017	2018	2019
<b>Dif-Shp panjohura</b>	<b>263,602,604</b>	<b>379,247,639</b>	<b>426,650,489</b>	<b>694,402,643</b>	<b>632,152,180</b>
Tatim Fitimi (15%)	39,540,391	56,887,146	63,997,573	104,160,396	94,822,827
Gjobë (21.9%) Tatim Fitimi	8,659,346	12,458,285	14,015,469	15,624,059	14,223,424
Tatimi Neto pas TF	224,062,213	322,360,493	362,652,916	590,242,247	537,329,353
Tatim mbi Dividentin (8%)	17,924,977	25,788,839	29,012,233	47,219,380	42,986,348
Gjobë Tatim Dividenti (21.9%)	3,925,570	5,647,756	6,353,679	10,341,044	9,414,010
<b>Total</b>	<b>70,050,284</b>	<b>100,782,026</b>	<b>113,378,954</b>	<b>177,344,879</b>	<b>161,446,610</b>

Burimi: DTM, përpunoni KLSH.

Nga sa më sipër janë sjellë si pasojë efekte tatimore të pallogaritura në shumën 359,408,333 lekë detyrime të tatimit mbi fitimin dhe 64,980,583 lekë gjobë 21.9%, 162,931,777 lekë detyrime të tatimit mbi dividentin dhe 35,682,059 lekë gjobë 21.9%, pra të ardhura gjithsej të munguar për buxhetin e shtetit në vlerën prej 623,002,752 lekë.

**- Subjekti:** “F.” SHPK.

**Nipti:** L.D.

**Adresë Kryesore:** Lagjja “Vllaznia”, Xhafzotaj, Durrës.

**Aktiviteti:** Prodhimin mobilje me materiale të veta dhe fason veshje tapicerie dhe të tjera lidhur me to, tregtim dhe import-eksporti i mobileve. Objekti i aktivitetit të shoqërisë dhënies me qera, shitjes. blerjes si dhe ne rolin e agentit për pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe çdo aktivitet tjetër i lejuar.

**Lloji i Kontrollit:** Kontroll i plotë.

**Inspektori:** I. T.

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

- Për **Tatim Fitimin** periudha tatimore nga: **2019-2020**.

- Për **Sigurimet Shoqërore e Shëndetësorë** - periudha tatimore nga: **01/2020-12/2021**.

- Të Tjera periudha tatimore nga: **01/2020-12/2021**.

Nga verifikimi i pasqyrave financiare të periudhave tatimore 2019-2020, ka rezultuar se në zërat e “Huamarrje AASH” dhe “Huamarrje AAGJ”, janë përfshirë hua nga individë dhe shoqëri në monedha të ndryshme paraqitur si më poshtë:

Huamarrjet AASH		2020		2019	
Emërtimi i Llogarisë	Monedha llog.	Vlera ne monedhe llog.	Vlera sipas monedhës baze	Vlera ne monedhe llog.	Vlera sipas monedhës baze
Hua T.C	Euro	392,536.81	48,556,803.40	381,102	46,406,772
Hua Sh. T.	Lekë	9,315,000.00	9,315,000.00	9,315,000	9,315,000
Hua V.T	Lekë	-	-	4,120,000	4,120,000
<b>TOTALI</b>		<b>9,707,537</b>	<b>57,871,803.397</b>	<b>13,816,102</b>	<b>59,841,772</b>

Burimi: DTM, përpunoni KLSH.

Huamarrjet AAGJ		2020		2019	
Emërtimi i Llogarisë	Monedha llog.	Vlera ne monedhe llog.	Vlera sipas monedhës baze	Vlera ne monedhe llog.	Vlera sipas monedhës baze
Hua E.D	Lekë	-	-	4,000,000	4,000,000
Hua A.C	Lekë	15,000,000	15,000,000.00	15,000,000	15,000,000
Hua F. T.	Euro	50,000	6,185,000.00	100,000	12,177,000
Hua E.	Euro	-	-	144,415	17,585,415
Hua E.	USD	-	-	100,000	10,864,000
Hua D.	Euro	200,000	24,740,000.00	200,000	24,354,000
Hua Agj	Lekë	62,000,000	62,000,000		
<b>TOTALI</b>		<b>77,250,000</b>	<b>107,925,000</b>	<b>19,544,415</b>	<b>83,980,415</b>

Burimi: DTM, përpunoni KLSH.

Në raportin e kontrollit tatimor nga ana e inspektorit nuk është kryer një analizë se si janë kaluar këto shuma monetare në favor të shoqërisë, nuk është analizuar asnjë kontratë huamarrje midis shoqërive dhe individëve, kushtet e vendosura, normat e interesit të aplikuara, plani i shlyerjes së huasë, përcaktimi i kështit, principalit dhe llogaritja e interesit, gjithashtu nuk kemi sqarim për këto financime huaje se për çfarë do t'i shërbejnë aktivitetit të shoqërisë.

Nga analiza e shoqërive huadhënëse kanë rezultuar se janë palë të lidhura sipas përcaktimeve në dispozitat e ligjit Nr.42/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, ligjin nr.43/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar dhe udhëzimin Nr.16 , datë 18.6.2014 “Për transferimin e çmimit”, gjë që rritë riskun për transaksione që nuk bazohen në parimin e vlerës së tregut, transaksionet që janë pa efekte ekonomike thelbësore, transaksionit që nuk reflekton thelbin e tij ekonomik dhe me tendencë për të rritur shpenzimet me qëllim uljen ose shmangien e detyrimeve tatimore të tatimit mbi fitimin.

*Neni 1*

**a) Dy persona konsiderohen të jenë palë të lidhura, kur: i) një person merr pjesë direkt apo indirekt**



*në menaxhimin, kontrollin apo kapitalin e personit tjetër; ose*

**b) Një person merr pjesë direkt ose indirekt në menaxhimin, kontrollin apo kapitalin e një personi tjetër, kur:**

*i) ai person zotëron, direkt ose indirekt, 50 për qind ose më shumë të kapitalit aksionar të personit tjetër; ose ii) efektivisht kontrollon vendimet e biznesit të këtij personi tjetër.*

<b>Subjekti</b>	<b>Ortakët</b>	<b>Pjesëmarrja në përqindje (%)</b>
E. SHPK	V. F.	12.5%
	A. F.	12,5%
	<b>I. L.</b>	<b>50%</b>
	A. F.	25%
D. SHPK	A. F.	25%
	V. F.	25%
	<b>I. L</b>	<b>50%</b>

Burimi: DTM, përpunoni KLSH.

<b>Subjekti</b>	<b>Ortakët</b>	<b>Pjesëmarrja në përqindje (%)</b>
F. SHPK	V. F.	25%
	<b>I. L.</b>	<b>25%</b>
	F. T.	50%

Burimi: DTM, përpunoni KLSH.

Nga ana e inspektori të kontrollit tatimor nuk është bërë informacioni RAD (Raportim i Aktivitetit të Dyshimtë) në lidhje me shumatat e parave të cilat kanë kaluar si huadhënie nga individë drejt shoqërisë, veprime këto jo në përputhje me dispozitat e *Ligjit Nr.9917 datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit”* i ndryshuar, neni 18.1 si dhe *UMF Nr.16, datë 16.2.2009 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe për të luftuar financimin e terrorizmit në sistemin e tatim-taksave”, neni 5, pika 1 dhe 2.*

#### **Neni 18 Raportimi i organeve tatimore**

*Organet tatimore identifikojnë subjektet e tyre, sipas procedurave të parashikuara në nenin 4 të këtij ligji dhe i raportojnë autoritetit përgjegjës menjëherë dhe në çdo rast, jo më vonë se 72 orë pas regjistrimit të veprimit, për çdo dyshim, sinjalizim, njoftim ose të dhënë, që ka të bëjë me pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit.*

#### **Neni 2 Përkufizime**

*Transaksione të dyshimta - çdo transaksion (pavarësisht sasisë), që nga natyra ose karakteri është i pazakonshëm për aktivitetin e personit, ose që për ndonjë arsye tjetër ngre dyshime për pastrim parash ose financim të terrorizmit.*

#### **Neni 5 Raportimi i aktivitetit të dyshimtë**

*Organet tatimore i raportojnë autoritetit përgjegjës menjëherë dhe në çdo rast, jo më vonë se 72 orë pas regjistrimit të veprimit, për çdo dyshim, sinjalizim, njoftim ose të dhënë, që ka të bëjë me pastrimin e parave dhe/ose financimin e terrorizmit. 2. Nëse zbulohet një transaksion i dyshimtë, atëherë duhet dërguar një raport tek autoriteti përgjegjës për aktivitetin e dyshimtë (sipas shtojcave në anekset II dhe III për 4 formularin dhe instruksionet bashkëlidhur, të cilat janë pjesë e këtij udhëzimi). 3. Bashkëngjitur këtij udhëzimi në shtojcën numër 1, janë pasqyruar modele të dyshimta të përdorura si standarde ndërkombëtare dhe kombëtare, orientuese për zbulimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. 4. Punonjësve të organeve tatimore u ndalohet të informojnë klientin ose çdo person tjetër, në lidhje me procedurat e verifikimit të rasteve të dyshimta, si dhe për çdo raportim tek autoriteti përgjegjës”.*

Palë të lidhura rezultojnë edhe furnitorët dhe klientët kryesore të shoqërisë, por nga ana e inspektorit nuk ka një analizë të thelluar të kartelave sintetike të llogarive përkatëse, por është mjaftuar vetëm me përshkrim të shumave në mënyrë tabelare dhe si rezultat grupi i auditimit gjykon se jemi në kushtet e pamundësisë objektive për të vijuar analizën e mëtejshme të situatës.

Nr	Klienti 2019	NIPTI	Vlera ne leke	Furnitori 2019	NIPTi	Vlera në lekë
1	B.	L.G	27,861,916	F. T.	K.N	59,773,927
2	F.T.	K.A	13,979,954	Fl. T.	K.A	4,374,161
3	F.SHPK	K.N	1,123,331	B.	L.G	1,629,607
4	Er.	J.B	637,549	D.	L.L	1,247,469
<b>Totali</b>			<b>43,602,750</b>	<b>Totali</b>		<b>67,025,164</b>

Burimi: DTM, përpunoni KLSH.

Nr	Klienti 2020	NIPTi	Vlera ne leke	Furnitori 2020	NIPTi	Vlera në lekë
1	F. T.	K.A	14,369,106	F. T.i	K.N	25,496,684
2	F.SHPK	K.N	553,483	F. T.	K.A	4,374,161
<b>Totali</b>			<b>14,922,589</b>	<b>Totali</b>		<b>29,870,845</b>

Burimi: DTM, përpunoni KLSH.

**- Subjekti:** “P. C.” SHPK.

**Nipti:** L.D.

**Adresë Kryesore:** Lagjja 18 Tetori, Lushnje.

**Aktiviteti:** Tregti fruta dhe perime, Import-Eksport.

**Lloji i Kontrollit:** Rimbursim TVSH.

**Inspektori:** A. X..

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

- Për **TVSH** - periudha tatimore nga: **05/2018 – 11/2019**.

Nga auditimi i Raportit Përfundimtar të Kontrollit rezulton se:

- Kontrolli është kryer në tejkallim të afatit të parashikuar në programin e kontrollit, jo në përputhje me përcaktimet e Manualit të Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2.3, për shkak se edhe sikundër është cituar në raport ka patur disa ndërprerje të kontrollit si rezultat i autorizimeve të tjera, programeve të tjera të kontrolleve, dhe kryerjes së periudhës së lejes së zakonshme.

- Është kryer kontrolli i FDP-ve dhe deklarimeve të shoqërisë për TVSH-në sipas dokumentacionit bashkangjitur dosjes së kontrollit si dhe të dhënave në sistemin informatik dhe nuk kanë rezultuar diferenca.

- Të gjitha deklaratat doganore kanë rezultuar të regjistruara rregullisht në librin e shitjes dhe shumat e paraqitura në to kanë rakorduar me rubrikat përkatëse të librit të shitjeve dhe rubrikat përkatëse të FDP-ve.

- Blerjet brenda vendit kanë rezultuar të kryera për qëllime të aktivitetit ekonomik, ku ka rezultuar një diferencë në vlerë të tatueshme për shumën 910,2609 lekë dhe TVSH të zbritshme për shumën 182,035 lekë, si rezultat i një kontrolli të ushtruar sipas Njoftim Kontrollit Tatimor, Nr.4153/2 datë 26.03.2019, ku janë vendosur detyrime në vlerë 182,052 lekë dhe 13,108 lekë gjobë.

- Për sa i përket blerjeve nga fermerët vendas nuk kane rezultuar diferenca dhe nga ana e DTM është kryer verifikimi i akt marrëveshjeve për çdo fermer, të cilat kanë rezultuar të lidhura para datës së furnizimit nga fermerët, janë të pajisura me adresën e fermerëve, nr telefoni, nipte të fermerit, artikuj dhe janë protokolluar në organin tatimor, sipas *UMF Nr.19, datë 03.11.2014 “Për aplikimin e regjimit të veçantë të skemës së kompensimit të prodhuesve bujqësore”*.

- Është bërë bilanci material për periudhën Maj-Dhjetor 2018 dhe për periudhën Janar-Nëntor 2019 për blerjet e mallrave për eksport për fruta dhe perime, ku nuk kanë rezultuar diferenca.
- Është kryer analiza krahasimore e çmimit të eksportit/çmim blerje dhe nuk kanë rezultuar shitje nën kosto.
- Nga rakordimi i eksporteve të vitit 2019 kanë rezultuar disa diferenca për shkak të mosdeklarimit të disa deklaratave doganore nga ana e doganës, por të cilat zotërohen nga subjekti dhe janë vendosur në dispozicion bashkangjitur dosjes së kontrollit.

**- Subjekti:** “O.” SHPK.

**Nipti:** J.Q.

**Adresë Kryesore:** Rruga e Kosovareve, Pallati Orion 2, Pranë Kompleksit Dinamo, Tiranë.

**Aktiviteti:** Projektim, zbatim, në fushën e ndërtimeve civile, turistike, bujqësore, ekonomike, veshje fasadash, banesa, hotele, objekte kulturi, rrugë, infrastrukturë, rikonstruksione civile, mirëmbajtje, zhvillim dekori në mjedise urbane. Prodhim, përpunim i materialeve të ndërtimit, transportimi dhe tregtim i tyre. Magazinimi dhe shpërndarja e materialeve të ndërtimit. Organizimi dhe pajisja e panairëve dhe ekspozitave të shërbimeve, reklamave dhe marketingu. Import dhe eksport i materialeve të ndërtimit. Tregtim i tyre me shumicë dhe pakicë. Të zhvillojë çdo veprimtari dhe aktivitet tjetër në përputhje me legjislacionin shqiptar. Dhënie ambiente me qera.

**Lloji i Kontrollit:** Kontroll i plotë.

**Inspektori:** R. A.

**Inxhinier:** I. K.

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

- Për **TVSH** - periudha tatimore nga: **03/2017-03/2022**.
- Për **Tatim Fitimin** periudha tatimore nga: **2017-2021**.
- Për **Sigurimet Shoqërore e Shëndetësore** - periudha tatimore nga: **03/2017-03/2022**.
- Të tjera periudha tatimore nga: **03/2017-03/2022**.

Nga auditimi i raportit të kontrollit tatimor dhe aktit të verifikimit të mbajtur për subjektin “O.” SHPK, nga ana e inspektorit dhe inxhinierit pranë DTM, janë konstatuar mungesa e analizave dhe vlerësimeve të projektit dhe preventivit të punimeve, nuk është kryer një zbërthim i materialeve dhe lëndës së parë në përbërje të punimeve të situacionuar, bazuar në manualin nr.1 “Analiza Teknike-Për prodhimin e materialeve të ndërtimit, udhëzime dhe kritere” dhe manualin nr.2 “Analiza Teknike-Për punimet e ndërtimit të ndërtesave”, si dhe krahasimi me punimet e kryera realisht në terren. Gjithashtu janë konstatuar mungesa e analizave të librezës së masave, situacioneve pjesore mujore, progresive dhe përfundimtare të volumit të punimeve të ndërtimit, të cilat janë dokumente justifikuese për verifikimin e volumit të punimeve të kryera sipas përcaktimeve të nënpikave 3.2 dhe 3.3 të pikës 3, Kreu 1 të Udhëzimit Nr.3, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, ndryshuar me Udhëzimin Nr.1 datë, 16.06.2011, konkretisht:

*3.2 Libreza e masave për punimet e ndërtimit është dokumentacioni bazë për verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve të ndërtimit, të vendosura në situacion. Kjo librezë hartohet nga drejtuesi teknik i objektit dhe firmoset nga ai, nga mbikëqyrësi i punimeve dhe nga përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit, për të cilin është miratuar leja e ndërtimit.*

*3.3 Situacionet mujore pjesore, progresive dhe përfundimtare hartohen mbi bazën e volumeve të llogaritura në librezën e masave dhe çmimeve faktike, mbështetur në analizat teknike të çmimeve, që përfshihen në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit, të miratuara çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave. Ato firmosen nga drejtuesi teknik i objektit, mbikëqyrësi i punimeve dhe përfaqësuesi ligjor*

*i sipërmarrësit për të cilin është miratuar leja e ndërtimit. Në rastet kur në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit mungojnë analizat teknike të çmimeve të zërave të punimeve të kryera në objekt, veprohet në përputhje me procedurën e përcaktuar në pikën 8 të vendimit nr.514, datë 15.8.2007 të Këshillit të Ministrave "Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit".*

Nga dokumentacioni shtesë i vendosur në dispozicion nga ana e inxhinierit të ndërtimit gjatë fazës së punës në terren, ka rezultuar se shoqëria është pajisur me **Certifikatë Përdorimi nr.3/7 prot., datë 18.02.2020, për objektin "TB3 - Ndërtim Godine banimi dhe shërbimesh 3 dhe 7-8 kate mbi tokë dhe 2 kate parkim nëntokë", në Rrugën e Dibrës, miratuar me vendim Nr.17, datë 12.04.2017 të Këshillit Kombëtar të Territorit nr.825/2 prot, datë 12.10.2017.** Por nga kontrolli i lëvizjes së llogarisë së parapagimeve për këtë objekt ndërtimor të pajisur me certifikatë përdorimi, rezulton se vazhdohet me parapagime nga klientët duke mos njohur të ardhura nga shitja e apartamenteve ose njërive të tjera, por njihet detyrimi përkatës si "Parapagime të arkëtuara", në seksionin e pasivit të bilancit kontabël. Konkretisht parapagimet për këtë objekt përgjatë periudhës 2020-2022:

Emri blerësit	Rrethi blerësit	Viti	NIPT-i	Përshkrimi	Përshkrimi	Shitje të përjashtuara
A. SHPK	TIRANE	2020	L.0	paradhënie	tb3	18,544,500
U.A	TIRANE	2020	H.Ë	paradhënie	tb3	10,388,774
A.K	Vlore	2020	J.O	paradhënie	parapagim tb3	5,032,340
K.B	TIRANE	2020	I.V	paradhënie	parapagim tb3	3,157,140
F.C	TIRANE	2020	I.D	paradhënie	parapagim tb3	2,682,460
A.S	Vlore	2020	J.O	paradhënie	parapagim tb3	2,306,600
E.L	TIRANE	2020	I.C	paradhënie	parapagim tb3	2,107,150
N.SH	TIRANE	2020	H.L	paradhënie	tb4,tb3	2,049,390
S.S	TIRANE	2020	I.Ë	paradhënie	parapagim tb3	1,980,820
F.B	BURREL	2020	I.L	paradhënie	parapagim tb3	1,743,456
E.S	TIRANE	2020	H.T	paradhënie	parapagim tb3	1,735,020
J.Q	TIRANE	2020	I.P	paradhënie	parapagim tb3	1,608,905
E.B	TIRANE	2020	I.G	paradhënie	parapagim tb3	1,484,481
P.D	DURRES	2020	G.K	paradhënie	parapagim tb3	1,222,820
A.K	TIRANE	2020	I.H	paradhënie	parapagim tb3	1,221,400
M.D	TIRANE	2020	I.H	paradhënie	parapagim tb3	830,331
A.P	DURRES	2020	H.G	paradhënie	parapagim tb3	742,980
A.LL.	Shkodër	2020	I.H	paradhënie	parapagim tb3	681,450
Z.K	TIRANE	2020	H.B	paradhënie	parapagim tb3	620,500
D.B	Bulqize	2020	H.K	paradhënie	parapagim tb3	618,500
A.A	TIRANE	2020	J.S	paradhënie	parapagim tb3	616,490
I.B	TIRANE	2020	J.A	paradhënie	parapagim tb3	493,380
D.T	TIRANE	2020	I.R	paradhënie	parapagim tb3	365,820
M.M	TIRANE	2020	I.B	paradhënie	parapagim tb3	309,825
E.B	TIRANE	2020	I.K	paradhënie	parapagim tb3	247,240
G.S	TIRANE	2020	I.A	paradhënie	parapagim tb3	162,400
M.D	TIRANE	2020	I.B	paradhënie	parapagim tb3	124,050
R.D	Dibër	2020	H.K	paradhënie	parapagim tb3	123,760
R.K	TIRANE	2020	I.I	paradhënie	kthim parapagimi tb3	(1,968,480)
V.B	TIRANE	2020	H.H	paradhënie	kthim parapagimi o3	(3,108,000)
A.E	TIRANE	2020	7753162	paradhënie	kthim parapagimi tb3	(3,723,000)
R.E	TIRANE	2020	I.I	paradhënie	kthim parapagimi tb3	(5,324,260)
A.N	TIRANE	2020	H.T	paradhënie	kthim parapagimi tb3	(5,671,370)
D.H	TIRANE	2021	I.B	paradhënie	tb3	5,408,479
F.T	TIRANE	2021	F.C	paradhënie	tb3	3,035,316
A. K.	TIRANE	2021	I.H	paradhënie	tb3	2,337,450
D. B.	Bulqize	2021	H.K	paradhënie	tb3	2,163,525
K. B.	TIRANE	2021	I.V	paradhënie	tb3	1,780,630
A. G.	TIRANE	2021	G.K	paradhënie	tb3	1,669,005
R. DH.	TIRANE	2021	H.H	paradhënie	tb3	1,228,600
E. S.	TIRANE	2021	H.T	paradhënie	tb3	1,109,610
A. K.	Vlore	2021	G.J	paradhënie	tb3	974,160
DH. C.	TIRANE	2021	H.G	paradhënie	tb3	949,564

Y. B.	TIRANE	2021	I.K	paradhënie	tb3	739,320
R.H.	TIRANE	2021	I.Ë	paradhënie	tb3	616,100
G. P.	TIRANE	2021	G.C	paradhënie	tb3	605,950
E.Xh.	Korçë	2021	I.O	paradhënie	tb3	558,165
A. D.	TIRANE	2021	H.V	paradhënie	tb3	544,200
P. D.	DURRES	2021	G.K	paradhënie	tb3	487,245
B. K.	TIRANE	2021	H.P	paradhënie	tb3	333,639
SH. B.	TIRANE	2021	I.B	paradhënie	tb3	303,000
E. C.	TIRANE	2021	I.J	paradhënie	tb3	247,140
I. B.	TIRANE	2021	J.A	paradhënie	tb3	244,530
R. D.	Dibër	2021	H.K	paradhënie	tb3	243,141
O.K.	ITALI	2021	I.M	paradhënie	tb3	200,822
G. S.	TIRANE	2021	I.A	paradhënie	tb3	161,924
G. R.	DURRES	2021	H.T	kthim parapagimi tb3	kthim parapagimi tb3	(1,000,000)
L. A.	TIRANE	2021	I.S	kthim parapagimi tb3	kthim parapagimi tb3	(9,768,912)
D. B.	BURREL	2022	H.K	paradhënie	tb3	1,212,800
D. H.	TIRANE	2022	I.B	paradhënie	tb3	606,400
<b>Totali</b>						<b>60,398,675</b>

Burimi: DTM, përpunoni KLSH.

Nga analiza e rrethanave të transaksionit, grupi i auditimit gjykon se për objektin që është pajisur me certifikatë shfrytëzimi, shoqëria ka transferuar rreziqet dhe përfitimet kryesore lidhur me pronësinë tek blerësi, pra shoqëria nuk mbartë më risqe të rëndësishme për apartamentet dhe njësitë e tjera të shërbimit të shitura, të cilat sot shfrytëzohen efektivisht nga blerësit me të drejta të plota mbi këto prona siç parashikohet në SKK 8, pavarësisht nëse është bërë apo jo kalimi i titullit të pronësisë. Konkretisht duhet të debitohet llogaria e parapagimeve të arkëtuara dhe të kreditohet llogaria e të ardhurave, duke njohur të ardhura nga shitja e apartamenteve dhe njësie të tjera të shërbimit, konform përcaktimeve ligjore në fuqi të cilat janë sqaruar si më poshtë:

Bazuar në nenin 19 “Fitimi i tatueshëm” të Ligjit Nr.8438 “Për tatimin mbi te ardhurat”, ndryshuar:

*Fitimi i tatueshëm për periudhën tatimore përcaktohet në bazë të bilancit dhe të anekseve të tij, që duhet të jenë në përputhje me ligjin “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, me dispozitat e këtij ligji, si dhe me aktet nënligjore të nxjerra nga Ministria e Financave për këtë qëllim.*

Bazuar në Ligjin Nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”:

*Standardet Kombëtare të Kontabilitetit” (SKK) janë standardet e hartuara dhe të publikuara nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit, të cilat shpallen të detyrueshme për zbatim me urdhër të ministrit përgjegjës për financat.*

Bazuar në SKK 8 “Te ardhurat”:

- Të ardhurat janë përfitimet ekonomike bruto, të marra gjatë periudhës kontabël, si rezultat i rrjedhës normale të veprimtarisë së njësisë ekonomike, atëherë kur këto përfitime ekonomike çojnë në rritjen e kapitalit (këtu nuk përfshihen rritjet, që lidhen me kontributet nga pjesëmarrësit në kapital).
- Produkte janë të mira të prodhuara nga njësia ekonomike me qëllim shitje.
- Të ardhurat nga shitja e mallrave dhe e produkteve do të njihen kur janë plotësuar të gjitha kushtet e mëposhtme:
  - (a) njësia ekonomike ia ka kaluar blerësit të gjitha rreziqet dhe përfitimet, që lidhen me pronësinë e mallrave dhe produkteve;
  - (b) njësia ekonomike nuk vazhdon të jetë e përfshirë në mënyrë të vazhdueshme në menaxhimin e mallrave dhe te produkteve në atë masë që tregon se ende zotëron titullin e pronësisë dhe/ose ka kontroll efektiv mbi mallrat/produktet e shitura;
  - (c) shumat e të ardhurave mund të matet me besueshmëri;
  - (d) është e mundur që përfitimet ekonomike, që lidhen me transaksionin, do të merren nga njësia ekonomike;
  - (e) kostot që kanë ndodhur, ose që do të ndodhin në lidhje me transaksionin, mund të maten me besueshmëri

- Vlerësimi nëse një njësi ekonomike ka transferuar rreziqet dhe përfitimet kryesore lidhur me pronësinë tek blerësi, kërkon një analizë të rrethanave të transaksionit. Në shumicën e rasteve, kalimi i rreziqeve dhe i përfitimeve, në lidhje me pronësinë, tek blerësi, përputhet me kalimin e titullit ligjor (për shembull, në shitjet me pakicë ajo ndodh në kohën e dorëzimit të mallrave/produkteve tek blerësi; në rastin e shitjes me dorëzim pjesor, kalimi i titullit ligjor bëhet siç përshkruhet në marrëveshjen e dorëzimit pjesor). Në rrethana të caktuara kalimi i rreziqeve dhe i përfitimeve, që burojnë nga pronësia, nuk ndodh në të njëjtën kohë me kalimin e titullit ligjor.

Nëse rreziqet që lidhen me pronësinë nuk i kalojnë blerësit, atëherë të ardhurat nuk njihen, pavarësisht nga fakti nëse titulli ligjor i ka kaluar blerësit apo jo. Shembuj të situatave, ku rreziqet nuk i kanë kaluar blerësit dhe, si rrjedhim, të ardhurat nuk njihen nga njësi ekonomike, janë:

(a) kur njësi ekonomike mbarë një detyrim për rezultate jo të kënaqshme, që nuk mbulohet nga garancitë normale.

(b) kur arkëtimi i të ardhurave nga një shitje e caktuar është i kushtëzuar nga gjenerimi i të ardhurave nga shitja e mëtejshme e këtyre mallrave apo produkteve nga ana e blerësit;

(c) kur mallrat apo produktet transportohen e duhet të montohen, dhe montimi është një pjesë e rëndësishme e kontratës, i cili nuk është kryer akoma nga shitësi;

(d) kur blerësi ka të drejtë ta anulojë blerjen, për arsye të përcaktuara në kontratën e shitjes, dhe shitësi është i pasigurt mbi mundësinë e kthimit apo moskthimit të mallit apo produktit

- Nëse njësi ekonomike mbarë vetëm një rrezik të parëndësishëm, që lidhet me pronësinë, atëherë të ardhurat nga shitja njihen, edhe pse titulli ligjor nuk është kaluar. Shembuj të situatave të tilla janë:

(a) blerësi ka të drejtë t'i kthejë mallrat apo produktet gjatë kohës së specifikuar në kontratë, dhe njësi ekonomike është në gjendje ta parashikojë mundësinë e kthimit, në bazë të përvojës së mëparshme. Në kohën e shitjes, njësi ekonomike i njeh të ardhurat nga shitja dhe krijon një provizion për mallrat apo produktet me mundësi kthimi;

(b) titulli ligjor i mallrave apo produkteve të shitura mbahet nga njësi ekonomike si siguri për arkëtimin e shumës.

**- Subjekti:** “M. I.” SHPK.

**Nipti:** J.H.

**Adresë Kryesore:** Njësia Bashkiake Nr.7 Rruga Nexho Konomi, Tiranë.

**Aktiviteti:** Punimet e ndërtimit (këtu futen veprat e artit), tregti me shumicë dhe pakicë materiale ndërtimi, inerteve, materialeve elektrike, hidraulike e hidrosanitare, linja për prodhim material etj.

**Lloji i Kontrollit:** Kontroll i plotë.

**Inspektori:** D. L.

**Inxhinier:** B. F.

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

- Për **TVSH** - periudha tatimore nga: **12/2018-05/2020**.

- Për **Tatim Fitimin** periudha tatimore nga: **2018-2019**.

- Për **Sigurimet Shoqërore e Shëndetësorë** - periudha tatimore nga: **12/2018-05/2020**.

- Të tjera periudha tatimore nga: **12/2018-05/2020**.

Nga auditimi i raport kontrollit tatimor dhe akt verifikimit të mbajtur për subjektin “M. I.” SHPK, nga ana e inspektorit dhe inxhinierit pranë DTM, janë konstatuar mungesa e analizave dhe vlerësimeve të projektit dhe preventivit të punimeve, nuk është kryer një zberthim i materialeve dhe lëndës së parë në përbërje të punimeve të situacionuar, bazuar në manualin nr.1 “Analiza Teknike-Për prodhimin e materialeve të ndërtimit, udhëzime dhe kritere” dhe manualin nr.2 “Analiza Teknike-Për punimet e ndërtimit të ndërtesave”, si dhe krahasimi me punimet e kryera realisht në terren dhe si rezultat grupi i auditimit gjykon se jemi në kushtet e pamundësisë objektive për të vijuar analizën e mëtejshme të situatës . Gjithashtu janë konstatuar mungesa e

analizave të librezës së masave, situacioneve pjesore mujore, progresive dhe përfundimtare të volumit të punimeve të ndërtimit, të cilat janë dokumente justifikuese për verifikimin e volumit të punimeve të kryera sipas përcaktimeve të nënplikave 3.2 dhe 3.3 të pikës 3, Kreu 1 të Udhëzimit Nr.3, datë 15.2.2001 “Për mbikëqytjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, ndryshuar me Udhëzimin Nr.1 datë, 16.06.2011, konkretisht:

*3.2 Libreza e masave për punimet e ndërtimit është dokumentacioni bazë për verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve të ndërtimit, të vendosura në situacion. Kjo librezë hartohet nga drejtuesi teknik i objektit dhe firmoset nga ai, nga mbikëqyrësi i punimeve dhe nga përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit, për të cilin është miratuar leja e ndërtimit.*

*3.3 Situacionet mujore pjesore, progresive dhe përfundimtare hartohen mbi bazën e volumeve të llogaritura në librezën e masave dhe çmimeve faktike, mbështetur në analizat teknike të çmimeve, që përfshihen në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit, të miratuara çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave. Ato firmosen nga drejtuesi teknik i objektit, mbikëqyrësi i punimeve dhe përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit për të cilin është miratuar leja e ndërtimit. Në rastet kur në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit mungojnë analizat teknike të çmimeve të zërave të punimeve të kryera në objekt, veprohet në përputhje me procedurën e përcaktuar në pikën 8 të vendimit nr.514, datë 15.8.2007 të Këshillit të Ministrave "Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit".*

Nga auditimi i raportit të kontrollit tatimor të subjektit “M. I.” SHPK, kanë rezultuar se për punimet e ndërtimit në objektet “Objekti Kompleks banimi dhe shërbimesh 1.4.6 dhe 8 kate me 1 dhe 2 kat parkim nëntokë ne Rr. Nexho Konomi, Tiranë”, nga përlllogaritjet e grupit të auditimit kanë rezultuar faturim të punimeve të ndërtimit poshtë nivelit të kostove mesatare që janë përcaktuar në Udhëzimin e Këshillit të Ministrave Nr.3 “Miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2016”, paraqitur si më poshtë:

<b>Objekt Kompleks banimi dhe shërbimesh 1.4.6 dhe 8 kate me 1 dhe 2 kat parkim nëntokë ne Rr. Nexho Konomi, Tiranë.</b>	
<b>Leje ndërtimi 11141/7, dt. 20.08.2015.</b>	
<b>Investitor: “M. C. I.” SHPK me NIPT J.H.</b>	
<b>Ndërtues: “M. C. I.” SHPK me NIPT J.H.</b>	
<b>Situacioni (vlera) : 2,236,197,551.02 leke me TVSH.</b>	
<b>Sipërfaqe për kosto : 80,888.15 m<sup>2</sup>.</b>	
<b>Sipërfaqe totale : 83,205.28 m<sup>2</sup>.</b>	
<b>Përqindja e punimeve sipas Ing: 92 %.</b>	

Burimi: DTM, përpunoni KLSH.

Nr	Emërtimi	Njësi	Sip. Neto	Sip e përbashkët	Sip. Ndërtimi	Sip.J/k	Sip. Totale
1	Parkim nënoke	m <sup>2</sup>	10,501.40	10,975.60	21,477.00	0	21,477
2	Ambiente tregtare	m <sup>2</sup>	6,271	1,063	7,334	0	7,334
3	Ambiente banimi	m <sup>2</sup>	46,568.70	5,508.45	52,077.15	0	52,077.15
4	Ballkone Konsol	m <sup>2</sup>	0	0	-	1,555.81	1,555.81
5	Veranda	m <sup>2</sup>	0	0	-	761.32	761.32
	<b>Shuma</b>	<b>m<sup>2</sup></b>	<b>63,341.10</b>	<b>17,547.05</b>	<b>80,888.15</b>	<b>2,317.13</b>	<b>83,205.28</b>

Burimi: DTM, përpunoni KLSH.

Zëri	Vlera e tatueshme
Vlera e situacionuar (Maj 2022 me TVSH)	2,236,197,551
Niveli faktik i punimeve	92%
Sipërfaqe Ndërtimi	80,888.15



Kosto/m <sup>2</sup>	30,050
Kosto Minimale Fiskale	32,113
<b>Diferenca</b>	<b>2,063</b>
<b>Diferenca në Vlerë</b>	<b>153,558,717</b>

Burimi: DTM, përpunoni KLSH.

Në raportin e kontrollit tatimor dhe akt verifikimin e inxhinierit nuk kemi evidentim të këtyre transaksioneve poshtë nivelit të kostove mesatare të miratuara për ndërtimin dhe nuk gjejmë justifikim të kësaj situatë të tatimpaguesit në aspektin ekonomik si integrim horizontal, vertikal, ekonomi shkalle apo specializim, që të justifikojë uljen e kostove. Nga sa më sipër grupi i auditimit del në konkluzionin se jemi në situatën e faturimeve të situacionit të punimeve të ndërtimit dhe shitjes nën kostot mesatare të miratuara në Udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr.3 “Miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2016”, nga ana e subjektit “M.C I.” SHPK, i cili është njëkohësisht në rolin e ndërtuesit dhe investitorit të punimeve të ndërtimit, parregullsi kjo që ka sjellë ulje të pagesës së TVSH-së si dhe ulje të tatimit mbi fitimin dhe nga ana e inspektorit të kontrollit tatimor duhet të ishte kryer penalizimi sipas nenit 124 “Kundërvajtjet në lëshimin e faturave tatimore, dëftesave tatimore dhe dokumentimin e transaksioneve” e Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ku përcaktohet qartë se: “Mos lëshimi i faturës tatimore, dëftesës tatimore apo i faturës tatimore me TVSH dënohet me gjobë të barabartë me 100 përqind të tatimit të padeklaruar, si rezultat i mos lëshimit të faturës, përveç tatimit dhe kamatëvonesave që llogariten dhe paguhen në përputhje me dispozitat e këtij ligji apo të ligjeve specifike tatimore”.

<b>Emërtimi</b>	<b>Vlera</b>
Diferenca në vlerë në Objekt Kompleks banimi dhe shërbimesh 1.4.6 dhe 8 kate me 1 dhe 2 kat parkim nëntokë, në Rr. Nexho Konomi, Tiranë	153,558,717
TVSH (20%)	30,711,743
Gjobë (100%) TVSH (100%)	30,711,743
Tatim Fitimi (15%)	23,033,808
Gjobë (100%) Tatim Fitimi (100%)	23,033,808
<b>Detyrime Total</b>	<b>107,491,102</b>

Burimi: DTM, përpunoni KLSH.

Nga sa më sipër janë sjellë si pasojë efekte tatimore të pallogaritura në shumën 23,033,808 lekë detyrime të tatimit mbi fitimin dhe 23,033,808 lekë gjobë 100%, 30,711,743 lekë detyrime të TVSH-së dhe 30,711,743 lekë gjobë 100%, pra të ardhura gjithsej të munguar për buxhetin e shtetit në vlerën prej 107,491,102 lekë.

Nga analiza e librit të blerjeve dhe pasqyrës të ardhurave dhe shpenzimeve janë konstatuar se janë njohur si shpenzime, dy fatura blerje nga shoqëria “T. E. 2” SHPK, të cilat kanë përshkrimin “kamatëvonesa”, paraqitur si më poshtë me vlerat përkatëse:

<b>Emri Tregtar</b>	<b>Rrethi</b>	<b>NIPT</b>	<b>Lloji i blerjes</b>	<b>Të përjashtuara me TVSH jo të zbritshme</b>
T. E.2 SHPK	Tiranë	K.R	Kamatëvonesë	3,200,077
T. E. 2 SHPK	Tiranë	K.R	Kamatëvonesë	7,319,027
<b>Totali</b>				<b>10,519,104</b>

Burimi: DTM, përpunoni KLSH.



Veprime të cilat janë në kundërshtim me përcaktimet e pikës f të nenit 21 “Shpenzime të panjohura”, të Ligjit Nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar:

“Për efekt të përcaktimit të fitimit të tatueshëm, nuk njihen shpenzimet si vijon: f) gjobat, kamatë-vonesat dhe kushtet e tjera penale”;

Nga ana e inspektorit të kontrollit tatimor duhet të ishte kryer rregullimi i PASH, duke i kaluar kamatëvonesat si shpenzime të panjohura për efekt të llogaritjes së tatim fitimit si dhe duke kryer penalizmin e subjektit sipas përcaktimeve të nenit 115 “Plotësim i pasaktë i deklaratës tatimore” të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar: “Dorëzimi i një deklaratë tatimore të pasaktë dënohet me një gjobë të barabartë me 0,06 për qind të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë, gjatë së cilës pagesa nuk është kryer. Në asnjë rast, gjoja nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike”.

Emërtimi	Vlera
Ri klasifikim si shpenzim i panjohur	10,519,104
Tatim Fitimi (15%)	1,577,866
Gjobë (21.9%%) Tatim Fitimi sipas nenit 115	345,553
<b>Detyrime Total</b>	<b>1,923,418</b>

Burimi: DTM, përpunoni KLSH.

Nga sa më sipër janë sjellë si pasojë efekte tatimore të pallogaritura në shumën 1,577,866 lekë detyrime të tatimit mbi fitimin dhe 345,553 lekë gjobë 21.9%, për periudhën, pra të ardhura gjithsej të munguar për buxhetin e shtetit në vlerën prej 1,923,418 lekë.

Nga grupi i auditimit, u kontrolluan çmimet e shitjes së të njëjësive ndërtimore apartamente, dyqane, parkim etj, tek objekti “**Objekti - Godine banimi e shërbimesh 5,6 dhe 7 kate me 3 kate parkimi nëntokë ne Rrugën "Kajo Karafili", Tiranë**”, dhe rezultuan shitje nën çmimin fiskal minimal të zonë 10/1, të përcaktuar në Aneksin Nr.1 dhe Nr.2 të VKM Nr.168, datë 27.3.2019. Konkretisht sipas Aneksit Nr.2 “Çmimet mesatare referuese për metër katror sipërfaqe ndërtimi për vlerësimin e vlerës së taksueshme për ndërtime dhe ambiente jo-banimi”, rezulton se: a) Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi për veprimtari ekonomike tregtimi shërbimi është 1.5 (një pikë pesë) herë më i lartë se çmimi i sipërfaqeve të banimit sipas qyteteve. Në këtë kategori përfshihen edhe njësitë tregtare, ku njëkohësisht realizohen edhe procese të përziera prodhimi, tregtimi apo shërbimi me pakicë. Në zonat që përfshihen në Bashkinë Tiranë ky koeficient është 2 (dy) herë më i lartë. Fillimisht sqarojmë se në akt konstatimin e mbajtur nga Inxhinieria B. F. në përllogaritjet e sipërfaqeve të shitura me çmimin e referencës së zonës, janë kryer llogaritje të gabuara sepse nuk janë marrë në analizë pjesët e përbashkëta të cilat janë të shitshme dhe i faturohen klientëve. Në këtë mënyrë është ulur padrejtësisht vlera e të ardhurave, prandaj nga grupi i auditimit po paraqiten përllogaritjet si më poshtë:

Kati	Njësi	Sip/Kati	Sip përb 10%	Pronaret 30%	Sip për shitje	Zona 10/1	Vlera (ALL) '
0	Shërbime	1,234	123.4	333.2	777.4	290,000	261,232,000
1	Banim	1,285	128.5	347	809.5	145,000	136,010,000
2	Banim	1,324	132.4	357.5	834.1	145,000	140,142,500
3	Banim	1,226	122.6	331	772.4	145,000	129,775,000
4	Banim	1,188	118.8	320.8	748.4	145,000	125,744,000
5	Banim	1,152	115.2	311	725.8	145,000	121,945,000
6	Banim	1,117	111.7	301.6	703.7	145,000	118,233,000
7	Banim	1,031	103.1	278.4	649.5	145,000	109,127,000
8	Banim	991	99.1	267.6	624.3	145,000	104,893,000
<b>Totali</b>		<b>10,548</b>	<b>1,055</b>	<b>2,848</b>	<b>6,645</b>		<b>1,247,101,500</b>

Burimi: DTM, përpunoni KLSH.

Kati	Njësi	Sipër Kati	Sip përb/rruge	Pronaret 30%	Sip shitje	Zona 10/1	Vlera (ALL)
-3	Parkim	2,192	1,397	238.5	556.5	43,500	84,977,250
-2	Parkim	2,192	1,427	229.5	535.5	43,500	85,368,750
-1	Parkim	2,192	1,427	229.5	535.5	43,500	85,368,750
<b>Totali</b>		<b>6,576</b>	<b>4,251</b>	<b>697.5</b>	<b>1,627.50</b>	.	<b>255,714,750</b>

Burimi: DTM, përpunoni KLSH.

Nga kontrolli dhe analiza e të dhënave në lidhje me kontratat e shitjes, të paraqitura në raportin e kontrollit tatimor të cilat përbëjnë të ardhurat faktike të arkëtuara nga shoqëria, kanë rezultuar diferenca dhe parregullsi të cilat po paraqiten si më poshtë:

Emër Mbiemër	Njësi	Rep/Kol	Date	Vlera ALL	Sip	Çmimi	Dif me çmimin Ref	TR shtese mbi vlerën kontratës
P. C.	Shërbime	152 rep/110 kol	07.12.2016	17,461,230	123.8	141,044	148,956	18,440,770
N. C.2012	Shërbime	148 rep/106 kol	07.12.2016	17,297,400	136.2	127,000	163,000	22,200,600
N. C.2012	Shërbime	137 rep/100 kol	13.03.2018	7,874,000	50.8	155,000	135,000	6,858,000
M. Sh.	Shërbime	600 rep/498 kol	06.10.2018	35,636,200	197.2	180,711	109,289	21,551,800
F. L. & S. L.	Shërbime	825 rep/645 kol	18.06.2020	20,988,020	76.4	274,712	15,288	1,167,980
Xh. O.	Shërbime	05 rep/04 kol	03.01.2014	25,400,000	132.1	192,279	97,721	12,909,000
				<b>124,656,850</b>				<b>83,128,150</b>

Burimi: DTM, përpunoni KLSH.

Emër Mbiemër	Njësi	Rep/Kol	Date	Vlera ALL	Sip	Çmimi	Dif me çmimin Ref	TR shtese mbi vlerën kontratës
A. M.	Banim	322 rep/261 kol	22.08.2017	8,125,000	91.6	88,701	56,299	5,157,000
G. T.	Banim	324 rep/264 kol	8.04.2019	16,190,375	110.4	146,652	-1,652	
M. L.	Banim	72 rep/62 kol	27.10.2016	5,625,000	113.1	49,735	95,265	10,774,500
M. L.	Banim	71 rep/61 kol	27.10.2016	5,625,000	136.9	41,088	103,912	14,225,500
Xh. G.	Banim	293 rep/236 kol	27.07.2017	14,263,200	97.4	146,439	-1,439	
G. Gj.	Banim	321 rep/258 kol	25.02.2020	12,112,800	83.3	145,412	-412	
K. N.	Banim	487 rep/393 kol	09.11.2017	10,125,000	98.1	103,211	41,789	4,099,500
O. K.	Banim	118 rep/103 kol	11.04.2017	13,600,000	136	100,000	45,000	6,120,000
N. K.	Banim	468 rep/376 kol	27.10.2017	8,750,000	78.2	111,893	33,107	2,589,000
N. D.	Banim	368 rep/289 kol	19.09.2017	14,130,000	128.5	109,961	35,039	4,502,500
M. P.	Banim	277 rep/222 kol	22.07.2017	13,124,625	90	145,829	-829	
Sh. P.	Banim	114 rep/101 kol	06.04.2017	5,028,375	50.1	100,367	44,633	2,236,125
H. V.	Banim	213 rep/ 164 kol	12.04.2018	11,750,000	117.5	100,000	45,000	5,287,500
E. B.	Banim	132 rep/91 kol	30.11.2016	13,380,250	102.5	130,539	14,461	1,482,250
G. A.	Banim	76 rep/66 kol	31.10.2016	12,500,000	112	111,607	33,393	3,740,000
N. Ll.	Banim	54 rep/46 kol	08.02.2017	10,117,750	103.5	97,756	47,244	4,889,750
E. P.	Banim	487 rep/401 kol	08.08.2018	23,165,000	156	148,494	-3,494	
Z. R.	Banim	94 rep/81 kol	28.03.2017	12,250,000	123	99,593	45,407	5,585,000
E. D.	Banim	147 rep/105 kol	07.12.2016	15,452,750	106	145,781	-781	
B. K.	Banim	314 rep /254 kol	09.08.2017	15,625,000	108.3	144,275	725	78,500
A. G. SHPK	Banim	176 rep /125 kol	17.12.2016	12,500,000	99	126,263	18,737	1,855,000
B. M.	Banim	180 rep/129 kol	20.12.2016	16,250,000	141.2	115,085	29,915	4,224,000
Z. K.	Banim	1392 rep/841 kol	29.04.2015	13,950,000	102.4	136,230	8,770	898,000
V. B.	Banim	108 rep/95 kol	06.04.2017	15,000,000	132.6	113,122	31,878	4,227,000
D. K.	Banim	629 rep/527 kol	17.10.2018	17,500,000	168.5	103,858	41,142	6,932,500
G. B.	Banim	84 rep/73 kol	06.11.2016	7,500,000	57	131,579	13,421	765,000
G. B.	Banim	84 rep/73 kol	06.11.2016	6,250,000	51.3	121,832	23,168	1,188,500
G. B.	Banim	83 rep/72 kol	06.11.2016	8,775,000	57.5	152,609	-7,609	
G. B.	Banim	83 rep/72 kol	06.11.2016	9,509,000	64.2	148,115	-3,115	
E.O	Banim	1259 rep/1013	28.08.2020	13,750,000	201.7	68,171	76,829	15,496,500

		kol						
L.I	Banim	2513 rep/1821 kol	10.09.2014	15,925,000	123.2	129,261	15,739	1,939,000
R.B	Banim	4920 rep/1595 kol	02.10.2018	5,500,000	108.1	50,879	94,121	10,174,500
N.C	Banim	148 rep/106 kol	07.12.2016	10,812,500	86.5	125,000	20,000	1,730,000
N.C	Banim	148 rep/106 kol	07.12.2016	10,850,000	124	87,500	57,500	7,130,000
A.F	Banim	60 rep/52 kol	17.12.2017	11,256,000	77	146,182	-1,182	
B.S	Banim	86 rep/75 kol	11.11.2016	10,625,000	93.3	113,880	31,120	2,903,500
E.D	Banim	170 rep/145 kol	24.05.2017	10,625,000	83.3	127,551	17,449	1,453,500
B.H	Banim	130 rep/94 kol	08.03.2018	12,808,625	107	119,707	25,293	2,706,375
F.K	Banim	390 rep/311 kol	29.09.2017	175,175,000	787.9	222,332	-77,332	
F.K	Banim	184 rep/155 kol	29.05.2017	21,450,000	110	195,000	-50,000	
F.K	Banim	184 rep/155 kol	29.05.2017	123,500,000	654	188,838	-43,838	
				<b>770,451,250</b>				<b>134,390,500</b>

Burimi: DTM, përpunoni KLSH.

Emër Mbiemër	Njësi	Rep/Kol	Date	Vlera ALL	Sip.	Çmimi	Dif me çmimin Ref	TR shtese mbi vlerën kontratës
M. Sh.	Parkim	600 rep/498 kol	06.10.2018	625,000	15	41,667	1,833	27,500
G. T.	Parkim	324 rep/264 kol	8.04.2019	625,000	15	41,667	1,833	27,500
M. L.	Parkim	72 rep/62 kol	27.10.2016	625,000	15	41,667	1,833	27,500
M. L.	Parkim	71 rep/61 kol	27.10.2016	625,000	15	41,667	1,833	27,500
Xh. G.	Parkim	293 rep/236 kol	27.07.2017	625,000	15.4	40,584	2,916	44,900
N. D.	Parkim	368 rep/289 kol	19.09.2017	625,000	15	41,667	1,833	27,500
M. P.	Parkim	277 rep/222 kol	22.07.2017	625,000	15	41,667	1,833	27,500
E.B.	Parkim	132 rep/91 kol	30.11.2016	1,250,000	30.4	41,118	2,382	72,400
G. A.	Parkim	76 rep/66 kol	31.10.2016	625,000	15	41,667	1,833	27,500
N. Ll.	Parkim	54 rep/46 kol	08.02.2017	1,250,000	30	41,667	1,833	55,000
E. D.	Parkim	147 rep/105 kol	07.12.2016	625,000	15	41,667	1,833	27,500
G. b.	Parkim	84 rep/73 kol	06.11.2016	2,500,000	62	40,323	3,177	197,000
B.&Sh.N.	Parkim	86 rep/75 kol	11.11.2016	625,000	15	41,667	1,833	27,500
B. H.	Parkim	130 rep/94 kol	08.03.2018	625,000	15	41,667	1,833	27,500
F. K. C.F.	Parkim	390 rep/311 kol	29.09.2017	28,125,000	150	187,500	-144,000	
L. I.	Parkim	2513 rep/1821 kol	10.09.2014	625,000	15	41,667	1,833	27,500
E. O.	Parkim	1259 rep/1013 kol	28.08.2020	1,250,000	30.4	41,118	2,382	72,400
E. P.	Parkim	144 rep/123 kol	08.05.2017	625,000	15	41,667	1,833	27,500
				<b>42,500,000</b>				<b>771,700</b>

Burimi: DTM, përpunoni KLSH.

Njësi Banimi	Vlera
TR deklaruar nga kontratat e shoqërisë (Sip neto për shitje = 5,572 m <sup>2</sup> )	770,451,250
TR deklaruar sipas [Çmim Ref x Sip Tot (Sip për shitje + Sip përbashkët)]	943,022,000
<b>Diferenca për rivlerësim</b>	<b>(172,570,750)</b>

Burimi: DTM, përpunoni KLSH.

Njësi Shërbimi	Vlera
TR deklaruar nga kontratat e shoqërisë (Sip neto për shitje = 716.5 m <sup>2</sup> )	124,656,850
TR deklaruar sipas [Çmim Ref x Sip Tot (Sip për shitje + Sip përbashkët)]	243,571,000
<b>Diferenca për rivlerësim</b>	<b>(118,914,150)</b>

Burimi: DTM, përpunoni KLSH.

Nga analiza e mësipërme në total nga mosdeklarimi në shitje i sipërfaqeve të përbashkëta dhe i shitjes nën çmimin minimal fiskal të përcaktuar në VKM Nr.168, datë 27.3.2019, rezultuan

**291,484,900 lekë**, ku nga grupi i auditimit është rivlerësuar situata financiare e shoqërisë duke rritur të ardhurat dhe penalizimin sipas përcaktimeve të nenit 128 “Lëshimi i faturës së pasaktë”, të Ligjit Nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar, ku përcaktohet qartë se: “Tatimpaguesi, që lëshon faturë tatimore të pasaktë e që rezulton me ulje të detyrimit apo rritje të shumës për t’u rimbursuar, dënohet me gjobë të barabartë me 50 për qind të shumës së efektit në ulje të detyrimit tatimor, përveç detyrimeve tatimore dhe interesave të llogaritura në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të ligjeve specifike tatimore.

<b>Emërtimi</b>	<b>Vlera</b>
Rivlerësim i të ardhurave	291,484,900
TVSH (20%)	58,296,980
Gjobë TVSH (50%)	29,148,490
Tatim Fitimi (15%)	43,722,735
Gjobë Tatim Fitimi (50%)	21,861,368
Tatimi Neto pas TF	247,762,165
Tatim mbi Dividentin (8%)	19,820,973
Gjobë Tatim Dividenti (50%)	9,910,487
<b>Detyrime Total</b>	<b>182,761,032</b>

Burimi: DTM, përpunoni KLSH.

Nga sa më sipër janë sjellë si pasojë efekte tatimore të pallogaritura në shumën 43,722,735 lekë detyrime të tatimit mbi fitimin dhe 21,861,368 lekë gjobë 50%, 58,296,980 lekë detyrime të TVSH-së dhe 29,148,490 lekë gjobë 50%, detyrime të tatimit mbi dividendin 19,820,973 lekë dhe 9,910,487 lekë gjobë 50%, pra të ardhura gjithsej të munguar për buxhetin e shtetit në vlerën prej 182,761,032 lekë.

Nga analiza e gjendjes së magazinës më 31.12.2018 dhe 31.12.2019 dhe lëvizjeve për produktin “**lëndë e parë/prodhim inerte**”, ka rezultuar se ja ka faturuar si shitje shoqërisë “X. T.” SHPK, me kosto duke mos aplikuar marzhe fitimi në shitje. E njëjta situatë paraqitet edhe për produktin “**çimento**”, për të cilën janë kryer transaksionet e shitjes dhe blerjes pa aplikuar marzhe fitimi në shitje si më poshtë:

Nr	Artikulli	Njësia	Gjendja në 31/12/2018		
			Sasi	Çmimi	Vlera
1	Lëndë e parë prodhim inerte	m <sup>3</sup>	32,254	400	12,901,600

Burimi: DTM, përpunoni KLSH.

Nr	Artikulli	Njësia	GJENDJA NE 31/12/2019		
			Sasi	Çmimi	Vlera
1	Lëndë e parë prodhim inerte	m <sup>3</sup>	-	-	-

Burimi: DTM, përpunoni KLSH.

Emrit tregt blerësit	Rrethi	NIPT	Lloji i shitjes	VI Tat 20 %	TVSH
X.s T.SHPK	Tiranë	J.B	Shitje lëndë e parë inerte	12,901,600	2,580,320

Burimi: DTM, përpunoni KLSH.

Libër Blerje					
Emri tregtar	Rrethi	NIPT	Lloji i blerjes	VI Tat	TVSH
MC. L SHPK (Për Tremën Cimento)	Tiranë	L.A	Blerje e shitje Cimento për Tremën	9,248,782	1,849,757

Burimi: DTM, përpunoni KLSH.

Libër Shitje					
Emrit treg blerësit	Rrethi	NIPT	Lloji i shitjes	VI Tat 20 %	TVSH
T. E.2 SHPK	Tiranë	K.R	Shitje Cimento rifuxho	9,248,783	1,849,757

Burimi: DTM, përpunoni KLSH.

Nga ana e inspektorese së kontrollit tatimor duhet të ishte kryer vlerësimi alternativ i situatës financiare të tatimpaguesit, duke rivlerësuar transaksionin dhe aplikuar marzhe fitimi sepse plotësohen kushtet sipas përcaktimeve si më poshtë:

Neni 71/2 “Përdorimi i metodave alternative të vlerësimit në rastet e veprimeve për shmangien e tatimit dhe abuzimit me parimet e ligjit tatimor” i Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, konkretisht pika b) dhe d)

**b) veprimet/transaksionet nuk bazohen në parimin e vlerës së tregut;**

**d) evidentohen elemente të veprimeve/transaksioneve që synojnë shmangien ose uljen e detyrimeve tatimore.**

Neni 72 “Baza e mënyrave alternative të vlerësimit” i Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, konkretisht pika a:

Mënyrat alternative të vlerësimit nuk kufizohen, por bazohen në:

**a) të dhëna të drejtpërdrejta, që gjenden në deklaratat tatimore ose në dokumentet apo në një informacion tjetër, dhënë nga tatimpaguesi;**

Në këtë rast do të përdorim të dhënat të cilat gjenden në pasqyrat financiare të deklaruara nga tatimpaguesi, konkretisht marzhet bruto të deklaruara në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin 2019.

Zëri	Vlera
Fitimi Bruto 2019	154,253,381
Totali i të Ardhurave 2019	2,349,126,389
<b>Marzhi bruto %</b>	<b>7%</b>

Burimi: DTM, përpunoni KLSH.

Nga ana e inspektorese së kontrollit tatimor, për këtë parregullsi duhet të ishte kryer penalizmi i subjektit sipas përcaktimeve të nenit 115 “Plotësim i pasaktë i deklaratës tatimore”, të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008, ku përcaktohet qartë se: “Dorëzimi i një deklarate tatimore të pasaktë dënohet me një gjobë të barabartë me 0,06 përqind të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë, gjatë së cilës pagesa nuk është kryer. Në asnjë rast, gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike”.

Zëri	Vlera
Të ardhura (12,901,600 + 9,428,783)	22,150,383
% Marzhi Bruto Mes	7.00%
Të ardhurat e rivlerësuar	1,550,527
TVSH (20%)	310,105
Gjobë TVSH (21.9%)	67,913
Tatim Fitim (15%)	232,579
Gjobë Tatim Fitim (21.9%)	50,935
Tatimi Neto pas TF	1,317,948
Tatim mbi Dividentin (8%)	105,436
Gjobë Tatim Dividenti (21.9%)	23,090
<b>Totali</b>	<b>790,059</b>

Burimi: DTM, përpunoni KLSH.

Nga sa më sipër janë sjellë si pasojë efekte tatimore të pallogaritura në shumën 232,579 lekë detyrime të tatimit mbi fitimin dhe 50,935 lekë gjobë 21.9%, 310,105 lekë detyrime të TVSH-së dhe 67,913 lekë gjobë 21.9%, detyrime të tatimit mbi dividendin 105,436 lekë dhe 23,090 lekë

gjobë 21.9%, pra të ardhura gjithsej të munguar për buxhetin e shtetit në vlerën prej 790,059 lekë.

Nga auditimi i raportit të kontrollit kanë rezultuar mangësi procedurale në trajtimin e pikave të programit të kontrollit tatimor, veprime këto në kundërshtim me përcaktimet e Kapitullit VII “Kryerja e kontrollit tatimor” të Manualit të Kontrollit Tatimor, konkretisht:

- Nuk është kryer një analizë e plotë e postit të “Arkëtimeve në avancë”;
- Nuk është kryer një analizë e plotë e transaksioneve dhe marrëdhënieve të kleringut;
- Nuk është kryer një analizë e plotë transaksioneve me palët e lidhura.

**- Subjekti:** “C.” SHPK.

**Nipti:** J.S.

**Adresë Kryesore:** Njësia Administrative Nr.10, Rruga Kajo Karafili, Nd.2, H.4, Ap.3, Tiranë.

**Aktiviteti:** Në fushën e ndërtimit, projektimit, zbatimit dhe Importe-Export të materialeve e makinerive të ndryshme të ndërtimit.

**Lloji i Kontrollit:** Kontroll i plotë.

**Inspektori:** M. A.

**Inxhinier:** I. K.

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

- Për **TVSH** - periudha tatimore nga: **10/2019-06/2021**.
- Për **Tatim Fitimin** periudha tatimore nga: **2019-2020**.
- Për **Sigurimet Shoqërore e Shëndetësorë** - periudha tatimore nga: **10/2019-06/2021**.
- Të Tjera periudha tatimore nga: **10/2019-06/2021**.

Nga auditimi i Raportit Përfundimtar të Kontrollit rezulton se:

- Është kryer inventari fizik në magazinën e mbajtjes së materialeve të ndërtimit të shoqërisë në Vorë, si dhe janë renditur adresat sekondare sipas objekteve në proces në momentin e kontrollit.
- Është kryer kontrolli i blerjeve dhe shitjeve me TVSH duke krahasuar të dhënat e deklaruara nëpërmjet FDP-ve dhe të dhënave që rezultojnë në sistemin informatik tatimor C@TS, dhe nuk kanë rezultuar diferenca.
- Është analizuar procedura e kreditimit të TVSH-së për blerjet e karburantit, të cilat rezultojnë se janë sipas normave të lejuara nga ligji.
- Janë analizuar blerjet e përjashtuara nga TVSH sipas autorizimit për rindërtimin dhe nuk rezultojnë problematika.
- Për blerjet nga importi është bërë krahasimi me të dhënat e dërguara nga DPD në sistemin informatik tatimor C@ts, ku nuk kanë rezultuar diferenca.
- Nga analiza e shitjeve të tatueshme ka rezultuar se ato konsistojnë kryesisht në shitje situacionesh enteve publike nga lidhja e kontratave të shërbim shtrim rrugësh apo ndërtim rikonstruksion ndërtesash.
- Është kryer kontrolli për tatimin mbi fitimin dhe elementët e pasqyrave financiare si aktive, pasive, kapitalin dhe PASH dhe nuk kanë rezultuar problematika.
- Është kryer kontrolli për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe TAP dhe nuk kanë rezultuar problematika.

**- Subjekti:** Gj. 87 SHPK.

**Nipti:** L.T.

**Adresë Kryesore:** Rruga Dora D’Istria, Tiranë.

**Aktiviteti:** Zbatimin e kontratës koncesionare/PPP “Përmirësimi, ndërtimi, operimi, dhe mirëmbajtje e Rrugës së Arbrit”, sipas kontratës së lidhur me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë Nr.553 Rep, Nr.247 Kol, datë 16.03.2018, në Tiranë, Shqipëri dhe të miratuar me VKM Nr.180, datë 28.03.2018 dhe e botuar në fletoren zyrtare Nr.50, datë 11.04.2018, e cila do t’i kalohet shoqërisë Gj. SHPK në datën e themelimit të saj. Në këtë kuadër, shoqëria Gj. SHPK ka të drejtë të kryejë të gjitha dhe çdo aktivitet të nevojshëm për realizimin e objektit të saj.

**Lloji i Kontrollit:** Kontroll i plotë.

**Inspektori:** A. H.

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

- Për **TVSH** - periudha tatimore nga: **04/2018-10/2020**.

- Për **Tatim Fitimin** periudha tatimore nga: **2018-2019**.

- Për **Sigurimet Shoqërore e Shëndetësore** - periudha tatimore nga: **04/2018-10/2020**.

- **Të Tjera** periudha tatimore nga **04/2018-10/2020**.

Nga auditimi i raportit të kontrollit tatimor rezulton se:

- Është kryer kontrolli i TVSH-së, analiza e shitjeve, librat e shitjeve, analiza e blerjeve, librat e blerjeve.

- Është kryer analiza e të ardhurave (*shitjet sipas FDP-se dhe situatës financiare, shifra e afarizmit*) dhe shpenzimeve (*kostot e punimeve, shpenzimet për qera, shpenzime për paga, furnitorë, komisione bankare, tarifa, etj*) dhe nuk kanë rezultuar parregullsi.

- Shoqëria nuk ka rezultuar me inventar gjendje materialesh apo mallrash dhe ky deklaram është përputhur me të dhënat e pasqyrave financiare.

- Është kryer kontrolli për tatimin mbi fitimin dhe elementët e pasqyrave financiare si aktive, pasive, kapitalin dhe PASH dhe nuk kanë rezultuar problematika.

- Është kryer kontrolli për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe TAP dhe nuk kanë rezultuar problematika.

- **Subjekti:** N. C. SHPK.

**Nipti:** K.A.

**Adresë Kryesore:** Qendra Administrative Nr.5, Rruga Robert Shwarc, Selitë e Vogël, Lagjja Nr.8, Zona Kadastrale 8260, Pasuria Nr.6/192, Dyqani Nr.7.

**Aktiviteti:** Aktivitet ndërtimi banesash dhe objekte social-kulturore, ndërtime me konstruksione metalike, nyje prodhim inertesh, prodhim parafabrikatesh, tregti eksport-import, me shumicë dhe pakicë i mallrave industriale, bojëra të ndryshme, llace, dyluente etj. Pike servisi automjetesh lavazho etj.

**Lloji i Kontrollit:** Kontroll i plotë.

**Inspektori:** I. L.

**Inxhinier:** E. A.

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

- Për **TVSH** - periudha tatimore nga: **02/2020-03/2022**.

- Për **Tatim Fitimin** periudha tatimore nga: **2019-2021**.

- Për **Sigurimet Shoqërore e Shëndetësorë** - periudha tatimore nga: **02/2020-03/2022**.

- **Të Tjera** periudha tatimore nga: **02/2020-03/2022**.

Nga auditimi i raport kontrollit tatimor dhe akt verifikimit të mbajtur për subjektin N. C. SHPK, nga ana e inspektorit dhe inxhinierit pranë DTM, janë konstatuar mungesa e analizave dhe vlerësimeve të projektit dhe preventivit të punimeve, nuk është kryer një zbërthim i matrialeve dhe lëndës së parë në përbërje të punimeve të situacionuar, bazuar në manualin nr.1 “Analiza



Teknike-Për prodhimin e matrialeve të ndërtimit, udhëzime dhe kritere” dhe manualin nr.2 “Analiza Teknike-Për punimet e ndërtimit të ndërtesave”, si dhe krahasimi me punimet e kryera realisht në terren dhe si rezultat grupi i auditimit gjykon se jemi në kushtet e pamundësisë objektive për të vijuar analizën e mëtejshme të situatës. Gjithashtu janë konstatuar mungesa e analizave të librezës së masave, situacioneve pjesore mujore, progresive dhe përfundimtare të volumit të punimeve të ndërtimit, të cilat janë dokumenta justifikuese për verifikimin e volumit të punimeve të kryera sipas përcaktimeve të nënpikave 3.2 dhe 3.3 të pikës 3, Kreu 1 të Udhëzimit Nr.3, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, ndryshuar me Udhëzimin Nr.1 datë, 16.06.2011, konkretisht:

3.2 Libreza e masave për punimet e ndërtimit është dokumentacioni bazë për verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve të ndërtimit, të vendosura në situacion. Kjo librezë hartohet nga drejtuesi teknik i objektit dhe firmoset nga ai, nga mbikëqyrësi i punimeve dhe nga përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit, për të cilin është miratuar leja e ndërtimit.

3.3 Situacionet mujore pjesore, progresive dhe përfundimtare hartohen mbi bazën e volumeve të llogaritura në librezën e masave dhe çmimeve faktike, mbështetur në analizat teknike të çmimeve, që përfshihen në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit, të miratuara çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave. Ato firmosen nga drejtuesi teknik i objektit, mbikëqyrësi i punimeve dhe përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit për të cilin është miratuar leja e ndërtimit. Në rastet kur në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit mungojnë analizat teknike të çmimeve të zërave të punimeve të kryera në objekt, veprohet në përputhje me procedurën e përcaktuar në pikën 8 të vendimit nr.514, datë 15.8.2007 të Këshillit të Ministrave "Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit".

Nga auditimi i raportit të kontrollit tatimor të subjektit N. C. SHPK, kanë rezultuar se për punimet e ndërtimit në objektet “Objekti Godinë banimi dhe shërbimi 7-9 kate me 2 kate parkim nëntokë-Kulla 1, Rruga "Robert Shvarc", Tiranë”, nga përllogaritjet e grupit të auditimit kanë rezultuar faturim të punimeve të ndërtimit poshtë nivelit të kostove mesatare që janë përcaktuar në Udhëzimin e Këshillit të Ministrave Nr.3 “Miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2016”, paraqitur si më poshtë:

<b>Objekti Godinë banimi dhe shërbimi 7-9 kate me 2 kate parkim nëntokë-Kulla 1, Rruga "Robert Shvarc", Tiranë.</b>
<b>Leje Zhvillimore Ndërtimi Nr. prot 9025/10, datë 06.10.2014 miratuar me Vendim të Kryetarit të Bashkisë Tiranë Nr. prot 902577 datë 30.07.2014</b>
<b>Investitor: "N. C." SHPK NIPT K.A</b>
<b>Ndërtues: "N. C." SHPK NIPT K.A</b>
<b>Situacioni (vlera): 803,644,139 Leke me TVSH.</b>
<b>Sipërfaqe për kosto: 25,220 m<sup>2</sup>.</b>
<b>*** Sipërfaqe përfundimtare: 28,419.22 m<sup>2</sup>.</b>
<b>Përqindja e punimeve sipas Ing: 100 %.</b>

Burimi: DTM, përpunoni KLSH.

<b>Emërtimi</b>	<b>Njësia</b>	<b>Sip Totale</b>	<b>Sip Hip</b>	<b>Pronar trualli</b>	<b>Sip të përbashk</b>	<b>Sip për shitje</b>
Apartamente	m <sup>2</sup>	16,745.85	14,829.21	6,298.07	1,916.64	8,531.14
Dyqane	m <sup>2</sup>	2,413.37	2,152.37	807.27	261.10	1,345.1
Parkime+Depo	m <sup>2</sup>	9,260	4,215	1,440	5,045	2,775
<b>Total</b>	<b>m<sup>2</sup></b>	<b>28,419.22</b>	<b>21,196.58</b>	<b>8,620.34</b>	<b>7,222.74</b>	<b>12,651.24</b>

Burimi: DTM, përpunoni KLSH.

<b>Zëri</b>	<b>Vlera e tatueshme</b>
Vlera e situacionuar (me TVSH)	803,644,139
Niveli faktik i punimeve	100%



Sipërfaqe Ndërtimi	25,220.00
<b>Sipërfaqe Ndërtimi pas kolaudit</b>	<b>28,419.22</b>
Kosto/m <sup>2</sup>	28,278
Kosto Minimale Fiskale	32,113
<b>Diferenca</b>	<b>3,835</b>
<b>Diferenca në Vlerë</b>	<b>108,982,273</b>

Burimi: DTM, përpunoni KLSH.

Në raportin e kontrollit tatimor dhe akt verifikimin e inxhinierit nuk kemi evidentim të këtyre transaksioneve poshtë nivelit të kostove mesatare të miratuara për ndërtimin dhe nuk gjejmë justifikim të kësaj situatë të tatimpaguesit në aspektin ekonomik si integrim horizontal, vertikal, ekonomi shkalle apo specializim, që të justifikojë uljen e kostove. Nga sa më sipër grupi i auditimit del në konkluzionin se jemi në situatën e faturimeve të situacionit të punimeve të ndërtimit dhe shitjes nën kostot mesatare të miratuara në Udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr.3 “Miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banësive, për vitin 2016”, nga ana e subjektit N. C. SHPK, i cili është njëkohësisht në rolin e ndërtuesit dhe investitorit të punimeve të ndërtimit, parregullsi kjo që ka sjellë ulje të pagesës së TVSH-së si dhe ulje të tatimit mbi fitimin dhe nga ana e inspektorit të kontrollit tatimor duhet të ishte kryer penalizimi sipas nenit 124 “Kundërvajtjet në lëshimin e faturave tatimore, dëftesave tatimore dhe dokumentimin e transaksioneve” e Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ku përcaktohet qartë se: “Moslëshimi i faturës tatimore, dëftesës tatimore apo i faturës tatimore me TVSH dënohet me gjobë të barabartë me 100 përqind të tatimit të padeklaruar, si rezultat i moslëshimit të faturës, përveç tatimit dhe kamatëvonesave që llogariten dhe paguhen në përputhje me dispozitat e këtij ligji apo të ligjeve specifike tatimore”.

<b>Emërtimi</b>	<b>Vlera</b>
Objekti Godinë banimi dhe shërbimi 7-9 kate me 2 kate parkim nëntokë-Kulla 1, Rruga "Robert Shvarc", Tiranë.	108,982,273
TVSH (20%)	21,796,455
Gjobë TVSH (100%)	21,796,455
Tatim Fitimi (15%)	16,347,341
Gjobë Tatim Fitimi (100%)	16,347,341
<b>Detyrime Total</b>	<b>76,287,591</b>

Burimi: DTM, përpunoni KLSH.

Nga sa më sipër janë sjellë si pasojë efekte tatimore të pallogaritura në shumën 16,347,341 lekë detyrime të tatimit mbi fitimin dhe 16,347,341 lekë gjobë 100%, 21,796,455 lekë detyrime të TVSH-së dhe 21,796,455 lekë gjobë 100%, pra të ardhura gjithsej të munguar për buxhetin e shtetit në vlerën prej 76,287,591 lekë.

- Nga ana e inspektorit të kontrollit nuk është kryer një analizë e detajuar e të dhënave mbi kontratat e shitjes së apartamenteve, njërive të shërbimit dhe parkimeve.
- Tek llogaria parapagimeve nuk është kryer një analizë e detajuar e kësaj llogari sipas kontratë porosive për blerje në objektet e papërfunduara të cilat janë akoma në proces.
- Nuk ka kryer një analizë të detajuar e llogarive “Të drejta të arkëtueshme nga njësitë ekonomike brenda grupit” dhe “DASH-Të pagueshme ndaj njërive ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse”.

Nga analiza e bilancit të lëvizjes materiale të kryera nga inspektori dhe inventari i deklaruar në sistemin C@ts për vitin 2020, kanë rezultuar diferencat të pa justifikuar, të cilat po paraqiten si më poshtë:

Artikulli	Njësi	T1	Blere	Gj+ bler	Dalje	Gj Kont & Fizike Inspektor	Gj Bilanci	Dif
		Sasi	Sasi	Sasi	Sasi	Sasi	Sasi	Sasi
Rërë	m <sup>3</sup>	-	114	114	103	11	4	7
Cimento	ton	-	25	25	23	2	1	1
Tulla 10X25X25	copë	-	9,120	9,120	8,320	800	-	800
Tulla 20X25X25	copë	-	37,120	37,120	30,320	6,800	1,120	5,680
Granil	m <sup>3</sup>	-	29	29	23	6	-	6

Burimi: DTM, përpunoni KLSH.

Nga analiza dhe krahasimi midis inventarit të deklaruar në sistemin C@ts bashkangjitur pasqyrave financiare nga ana e subjektit për vitin 2021, dhe lëvizjes material të kryer nga inspektori i kontrollit kanë rezultuar diferenca të pa justifikuar, paraqitur në vlera si më poshtë:

Artikulli	Njësia	T1	Blere	Gj+ bler	Dalje	Gj kont & Fizike Inspektori	Gj Bilanci	Dif
		Sasi	Sasi	Sasi	Sasi	Sasi	Sasi	Sasi
Pllaka	m <sup>2</sup>	-	7	7	-	7	253	246
Profile	kg	-	1,780	1,780	1,780	-	407	407
Kol	kg	-	-	-	-	-	1,400	1,400
Bojak	kg	-	-	-	-	-	20	20
Boje	kg	-	-	-	-	-	668	668

Burimi: DTM, përpunoni KLSH.

Artikulli	Dif	Kosto	Dif
	Sasi	Lek	Lek
Pllaka	245.8	852.16	209,461
Profile	407	122.85	50,000
Kol	1400	21.45	30,030
Boje	668	407.47	272,190
Rërë	7	1329.995	9,310
Cimento	1	9180	9,180
Tulla 10X25X25	800	34.335	27,468
Tulla 20X25X25	5680	34.335	195,023
Granil	6		
Bojak	20		-
<b>Totale</b>			<b>802,662</b>

Burimi: DTM, përpunoni KLSH.

Nga grupi i auditimi këto diferenca të konstatuara dhe të pajustificuara do të konsiderohen si shitje pafaturë dhe shitjet e tatueshme të shoqërisë për periudhën do të rivlerësohen duke u rritur në shumën prej **802,662** lekë. Për këto parregullësi të konstatuara do të kryhet penalizimi i subjektit sipas përcaktimeve të nenit 124 “Kundërvajtjet në lëshimin e faturave tatimore, dëftesave tatimore dhe dokumentimin e transaksioneve” të Ligjit Nr.9920 datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar dhe udhëzimit në zbatim të tij, shoqërisë i linden detyrimet si më poshtë:

Emërtimi	Vlera
Diferenca Shitje pa faturë	802,662
Detyrim TVSH (20%)	160,532
Gjobë TVSH (100%)	160,532
Detyrim TF (15%)	120,399
Gjobë TF (100%)	120,399
Tatimi Neto pas TF	682,263
Tatim mbi Dividentin (8%)	54,581

Gjobë Tatim Dividenti (100%)	54,581
<b>Total</b>	<b>671,024</b>

Burimi: DTM, përpunoni KLSH.

Nga sa më sipër janë sjellë si pasojë efekte tatimore të pallogaritura në shumën 120,399 lekë detyrime të tatimit mbi fitimin dhe 120,399 lekë gjobë 100%, 160,532 lekë detyrime të TVSH-së dhe 160,532 lekë gjobë 100%, 54,581 lekë detyrime të tatimit mbi dividendin dhe 54,581 lekë gjobë 100%, pra të ardhura gjithsej të munguar për buxhetin e shtetit në vlerën prej 671,024 lekë.

**- Subjekti:** A. K. SHPK.

**Nipti:** J.C.

**Adresë Kryesore:** Njësia Bashkiake Nr.4, Rruga "Aleksandër Moisiu", Ndërtesa Nr.117, Zona Kadastrale Nr.8120, Tiranë.

**Aktiviteti:** Ndërtim, montim, zhvillim, zbatim për ndërtimin e linjave të tensionit të lartë dhe të ulët, rikonstruksione objektesh, prodhimin dhe tregtimin e materialeve të ndërtimit, import eksport me pakicë dhe shumicë të mallrave ushqimore, industriale, bujqësore, tregtim karburantesh dhe të vajrave lubrifikante të të gjitha llojeve. Bar kafe. Administrim dhe mirëmbajtje e ndërtesave të banimit. Palestër gjimnastikore e aktivitete të ndryshme sportive.

**Lloji i Kontrollit:** Kontroll i plotë.

**Inspektori:** M. X.

**Inxhinier:** E. A.

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

- Për **TVSH** - periudha tatimore nga: **02/2020-03/2022**.
- Për **Tatim Fitimin** periudha tatimore nga: **2019-2021**.
- Për **Sigurimet Shoqërore e Shëndetësorë** - periudha tatimore nga: **02/2020-03/2022**.
- Të Tjera periudha tatimore nga: **02/2020-03/2022**.

Nga auditimi i raport kontrollit tatimor dhe akt verifikimit të mbajtur për subjektin A. K. SHPK, nga ana e inspektorit dhe inxhinierit pranë DTM, janë konstatuar mungesa e analizave dhe vlerësimeve të projektit dhe preventivit të punimeve, nuk është kryer një zbërthim i matrialeve dhe lëndës së parë në përbërje të punimeve të situacionuar, bazuar në manualin nr.1 "Analiza Teknike-Për prodhimin e matrialeve të ndërtimit, udhëzime dhe kritere" dhe manualin nr.2 "Analiza Teknike-Për punimet e ndërtimit të ndërtesave", si dhe krahasimi me punimet e kryera realisht në terren dhe si rezultat grupi i auditimit gjykon se jemi në kushtet e pamundësisë objektive për të vijuar analizën e mëtejshme të situatës . Gjithashtu janë konstatuar mungesa e analizave të librezës së masave, situacioneve pjesore mujore, progresive dhe përfundimtare të volumit të punimeve të ndërtimit, të cilat janë dokumenta justifikuese për verifikimin e volumit të punimeve të kryera sipas përcaktimeve të nënpikave 3.2 dhe 3.3 të pikës 3, Kreu 1 të Udhëzimit Nr.3, datë 15.2.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit", ndryshuar me Udhëzimin Nr.1 datë, 16.06.2011, konkretisht:

*3.2 Libreza e masave për punimet e ndërtimit është dokumentacioni bazë për verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve të ndërtimit, të vendosura në situacion. Kjo librezë hartohet nga drejtuesi teknik i objektit dhe firmoset nga ai, nga mbikëqyrësi i punimeve dhe nga përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit, për të cilin është miratuar leja e ndërtimit.*

*3.3 Situacionet mujore pjesore, progresive dhe përfundimtare hartohen mbi bazën e volumeve të llogaritura në librezën e masave dhe çmimeve faktike, mbështetur në analizat teknike të çmimeve, që përfshihen në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit, të miratuara çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave. Ato firmosen nga drejtuesi teknik i objektit, mbikëqyrësi i punimeve dhe përfaqësuesi ligjor*

*i sipërmarrësit për të cilin është miratuar leja e ndërtimit. Në rastet kur në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit mungojnë analizat teknike të çmimeve të zërave të punimeve të kryera në objekt, veprohet në përputhje me procedurën e përcaktuar në pikën 8 të vendimit nr.514, datë 15.8.2007 të Këshillit të Ministrave "Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit".*

Nga auditimi i raportit të kontrollit tatimor të subjektit A. K. SHPK, kanë rezultuar se për punimet e ndërtimit në objektet "Godinë banimi 9 kat me 1 kat Nëntokësor rruga Aleksander Moisiu", nga përlllogaritjet e grupit të auditimit kanë rezultuar faturim të punimeve të ndërtimit poshtë nivelit të kostove mesatare që janë përcaktuar në Udhëzimin e Këshillit të Ministrave Nr.3 "Miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2016", paraqitur si më poshtë:

<b>Godinë banimi 9 kate me 1 kat nëntokësore Rruga "Aleksandër Moisiu"</b>
<b>Leje Ndërtimi L-25338/8 datë 31.03.2020</b>
<b>Investitor: "A. A. K." SHA - NIPT J.Y</b>
<b>Ndërtues: "A. K." SHPK - NIPT J.C.</b>
<b>Situacioni (Vlera): 472,622,381 lekë me TVSH.</b>
<b>Sipërfaqe për kosto: 16,775.98 m<sup>2</sup>.</b>
<b>Sipërfaqe totale: 16,775.98 m<sup>2</sup>.</b>
<b>Përqindja e punimeve sipas Ing: 92 %.</b>

Burimi: DTM, përpunoni KLSH.

<i>Emërtimi</i>	<i>Njësia</i>	<i>Sip Totale</i>	<i>Pronarët</i>	<i>Sip neto</i>	<i>Sip shkalle, Ashensor</i>	<i>Sip ambiente teknike, kabine elekt</i>	<i>Sip rruge kalimi makina, këmbësorë</i>
Parkim	m <sup>2</sup>	4,022.30	1,287.14	1,529.34	99.28	51.27	1,055.27
Amb Tregtare	m <sup>2</sup>	1,073.23	343.43	576.46	128.86	24.48	-
Amb Banese	m <sup>2</sup>	-	-	-	-	-	-
Sip Banimi	m <sup>2</sup>	11,680.45	3,737.74	7,942.71	-	-	-
<b>Shuma Totale</b>	<b>m<sup>2</sup></b>	<b>16,775.98</b>	<b>5,368.31</b>	<b>10,048.51</b>	<b>228.14</b>	<b>75.75</b>	<b>1,055.27</b>

Burimi: DTM, përpunoni KLSH.

<i>Zëri</i>	<i>Vlera e tatueshme</i>
Vlera e situacionuar (me TVSH)	472,622,381
Niveli faktik i punimeve	92%
Sipërfaqe Ndërtimi	16,775.98
Kosto/m <sup>2</sup>	30,622
Kosto Minimale Fiskale	32,113
<b>Diferenca</b>	<b>1,491</b>
<b>Diferenca në Vlerë</b>	<b>23,006,501</b>

Burimi: DTM, përpunoni KLSH.

Në raportin e kontrollit tatimor dhe akt verifikimin e inxhinierit nuk kemi evidentim të këtyre transaksioneve poshtë nivelit të kostove mesatare të miratuara për ndërtimin dhe nuk gjejmë justifikim të kësaj situatë të tatimpaguesit në aspektin ekonomik si integrim horizontal, vertikal, ekonomi shkalle apo specializim, që të justifikojë uljen e kostove. Nga sa më sipër grupi i auditimit del në konkluzionin se jemi në situatën e faturimeve të situacionit të punimeve të ndërtimit dhe shitjes nën kostot mesatare të miratuara në Udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr.3 "Miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2016", nga ana e subjektit "A. K." SHPK, i cili është njëkohësisht në rolin e ndërtuesit dhe investitorit të punimeve të ndërtimit, parregullësi kjo që ka sjellë ulje të pagesës së TVSH-së si

dhe ulje të tatimit mbi fitimin dhe nga ana e inspektorit të kontrollit tatimor duhet të ishte kryer penalizimi sipas nenit 124 “Kundërvajtjet në lëshimin e faturave tatimore, dëftesave tatimore dhe dokumentimin e transaksioneve” e Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ku përcaktohet qartë se: “Moslëshimi i faturës tatimore, dëftesës tatimore apo i faturës tatimore me TVSH dënohet me gjobë të barabartë me 100 përqind të tatimit të padeklaruar, si rezultat i moslëshimit të faturës, përveç tatimit dhe kamatëvonesave që llogariten dhe paguhen në përputhje me dispozitat e këtij ligji apo të ligjeve specifike tatimore”.

<b>Emërtimi</b>	<b>Vlera</b>
Diferenca në vlerë në "Godinë banimi 9 kate me 1 kate nëntokësor Rruga Aleksandër Moisiu"	23,006,501
TVSH (20%)	4,601,300
Gjobë TVSH (100%)	4,601,300
Tatim Fitimi (15%)	3,450,975
Gjobë Tatim Fitimi (100%)	3,450,975
<b>Detyrime Total</b>	<b>16,104,551</b>

Burimi: DTM, përpunoni KLSH.

Nga sa më sipër janë sjellë si pasojë efekte tatimore të pallogaritura në shumën 3,450,975 lekë detyrime të tatimit mbi fitimin dhe 3,450,975 lekë gjobë 100%, 4,601,300 lekë detyrime të TVSH-së dhe 4,601,300 lekë gjobë 100%, pra të ardhura gjithsej të munguar për buxhetin e shtetit në vlerën prej 16,104,551 lekë.

Nga kontrolli i blerjeve për periudhën objekt kontrolli, ka rezultuar se shoqëria ka bërë blerje karburanti për të cilën ka kredituar edhe TVSH në blerje, konkretisht si më poshtë:

<b>Viti</b>	<b>Shitësit</b>	<b>Rrethi</b>	<b>NIPT</b>	<b>Vlera e tatueshme për blerje nga furnitorët vendas</b>	<b>TVSH për blerje nga fermerët vendas</b>	<b>Përshkrimi</b>
2020	A. O.	Tirane	K.F	47,625	9,525	Nafte/Gaz/Primer
2020	E. & O.	Tirane	L.A	1,686,849	337,371	Nafte+Gaz
2021	E. & O.	Tirane	L.A	104,688	20,938	Nafte+Gaz
<b>Totali</b>				<b>1,839,162</b>	<b>367,834</b>	

Burimi: DTM, përpunoni KLSH.

Kurse nga kontrolli i inventarit të makinave, të paraqitura në bilanc, ka rezultuar se shoqëria ka në pronësi, 3 automjete të cilat po paraqiten si më poshtë:

<b>Nr</b>	<b>Lloji i mjetit</b>	<b>Tipi/Markë</b>	<b>Targë</b>	<b>Kapaciteti</b>
1	Autoveturë	Range Rover	A.X	4 Persona
2	Autoveturë	Mercedes Benz	A.X	2 Persona
3	Kamiocinë	Mercedes Benz	A.D	2 Persona

Burimi: DTM, përpunoni KLSH.

Pra figurojnë 2 automjete të shoqërisë, për të cilat inspektori i kontrollit duhet të kishte kryer verifikimet n.q.s. janë furnizuar me karburant nga shoqëria për të cilin është bërë kreditimi i TVSH në blerje, veprime këto të cilat janë në kundërshtim me përcaktimet ligjore të nenit 74 “Kufizimet e së drejtës së zbritjes” të Ligjit Nr.92/2014 “Për TVSH-në, në Republikën e Shqipërisë”:

*Përfshihen nga e drejta e zbritjes së TVSH-së shpenzimet për blerjen, importin e mallrave, shpenzimet për shërbimet si më poshtë:*

**b) shpenzimet e karburantit të çdo lloji, i përdorur për auto veturat;**

Gjithashtu duhet të ishte kryer penalizimi i subjektit sipas përcaktimeve të nenit 115 “Plotësim i pasaktë i deklaratës tatimore” të Ligjit Nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: *Tatimpaguesi, i cili nuk arrin që, brenda afatit të parashikuar në këtë ligj për pagesë, të paguajë shumën e detyrimit tatimor e të kontributit, detyrohet të paguajë një gjobë, të barabartë me 0,06 për qind të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë, gjatë së cilës pagesa nuk është kryer. Në asnjë rast, gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike.*

Emërtimi	Vlera e tatueshme për blerje nga furnitorët vendas	TVSH për blerje nga fermerët vendas
Blerje karburanti	1,839,162	367,834
Autoveturë-RANGE ROVER	735,665	-
Autoveturë-MERCEDES BENZ	735,665	-
Kamiocinë-MERCEDES BENZ	613,054	122,611
<b>Kredituar TVSH shtesë</b>		<b>245,223</b>

Burimi: DTM, përpunoni KLSH.

Emërtimi	Vlerë
Ulje e tepicës kreditore të TVSH-së	245,223
Gjobjë TVSH (21.9%)	53,703.84
<b>Total</b>	<b>298,927</b>

Burimi: DTM, përpunoni KLSH.

Nga sa më sipër janë sjellë si pasojë efekte tatimore të pallogaritura në shumën 245,223 lekë ulje e tepicës kreditore të TVSH-së dhe 53,703 lekë gjobjë, pra të ardhura gjithsej të munguar për buxhetin e shtetit në vlerën prej 298,927 lekë.

**- Subjekti:** “A.-S.” SHPK.

**Nipti:** J.W.

**Adresë Kryesore:** Sheshi Italia, Arena Center, Seksioni D, Kati 5 Tiranë.

**Aktiviteti:** Ndërtime civile, përpunim e tregtim të materialeve të ndërtimit, përdorim e trajtim të materialeve për instalime elektrike e hidraulike, shitë-blerje me shumicë e pakicë, import-eksport, ndërtime civile, industriale, tregti, import-export. Transport i mallrave për të tretë me qera dhe për llogari të vet brenda vendit. Tregti me shumicë e ujit të pijshëm dhe e ujit industrial. Transport me mjete jashtë norme për llogari të vet dhe të tretëve brenda dhe jashtë vendit. Ndërtimi i autostradave, rrugëve, aerodromeve, fushave sportive etj.

**Lloji i Kontrollit:** Kontroll i plotë.

**Inspektori:** I. D.

**Inxhinier:** E. A.

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

- Për **TVSH** - periudha tatimore nga: **11/2020-03/2022**.
- Për **Tatim Fitimin** periudha tatimore nga: **2020-2021**.
- Për **Sigurimet Shoqërore e Shëndetësore** - periudha tatimore nga: **11/2020-03/2022**.
- Të Tjera periudha tatimore nga: **11/2020-03/2022**.

Nga auditimi i raportit të kontrollit tatimor, konkretisht në drejtim të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore sipas pikës së programit të kontrollit, kanë rezultuar problematikat si më poshtë:

- Nga kontrolli i listë pagesave të subjektit të deklaruara në sistemin C@ts për periudhën 11/2020-03/2022, ka rezultuar se shoqëria ka deklaruar për punonjësit 26 ditë pune që është në tejkalim të kohëzgjatjes normale të punës prej 174 orë në muaj ose 22 ditë pune dhe pagesa për ditët shtesë duhet të kryhet me një shtesë jo më pak se 25% të pagesës të ditës normale sipas përcaktimeve të Kreut IX të



**Kodit të Punës në R.SH.**

- Gjithashtu janë konstatuar raste ku shoqëria ka deklaruar pagesa të pagave orare për punonjësit poshtë pagës minimale orare që është përcaktuar në Vendim Nr.809, datë 26.12.2018 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi” dhe Vendimin Nr.1025, datë 16.12.2020 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”.

- Nga ana e inspektorit të kontrollit tatimor nuk janë analizuar kontratat individuale të punës midis shoqërisë dhe punonjësve, në lidhje me përputhshmërinë e tyre me përcaktimet e dispozitave të Kodit të Punës në R.SH.

- Nuk janë analizuar regjistrat që duhet të mbajë tatimpaguesi sipas përcaktimeve të nenit 15 “Mbajtja e regjistrimeve” të Ligjit Nr.9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

- Nuk ka një analizë të llogaritjes së pagës dhe elementëve përbërës të saj sipas përcaktimeve të dispozitave të nenit 119 të Kreut XI të Kodit të Punës në R.SH.

- Nuk janë analizuar regjistrat që duhet të mbajë tatimpaguesi sipas përcaktimeve të nenit 15 “Mbajtja e regjistrimeve” të Ligjit Nr.9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

- Nuk ka një analizë të llogaritjes së pagës dhe elementëve përbërës të saj sipas përcaktimeve të dispozitave të nenit 119 të Kreut XI të Kodit të Punës në R.SH.

- Nuk ka një analizë të numrit të lartë të ndryshimit të punonjësve të shoqërisë, kryesisht në lidhje me largimet e shpeshta n.q.s. ndërprerjet e marrëdhënieve të punës janë konform kontratave dhe përcaktimeve të Kodit të Punës.

- Janë konstatuar parregullësi në llogaritjen e ditëve të punës dhe pagës për efekt të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për punonjësit e punësuar rishtazi ose të larguar përgjatë muajit.

- Nga kontrolli për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si dhe TAP-in, për periudhën 11/2020-03/2022 dhe nga analiza e listë pagesave të dorëzuar nga subjekti në sistemin C@ts, janë konstatuar parregullësi në llogaritjen e pagës për efekt të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për punonjësit me numër kategorie për kontributet 2/004(6), sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Në lidhje me situatën e trajtuar më sipër grupi i audituesve gjykon se janë arsye themelore për të kryer rivlerësimin e pagave, kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi, për punonjësit me paga të deklaruara jo konform përcaktimeve të legjislacionit, në lidhje me këtë tatimpagues i cili ka plotësuar deklarata tatimore që përmbajnë të dhëna të pasakta ose të falsifikuara dhe nuk mban dhe ruan llogari apo regjistrime të sakta të transaksioneve, veprime të cilat janë në kundërshtim me germën b, c të nenit 71, gërma a e nenit 72 të Ligjit Nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave Nr.24 date 02.09.2008, i ndryshuar në zbatim të tij, ku përcaktohet se:

Neni 71 “E drejta për të përdorur mënyra alternative vlerësimi” i Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, konkretisht pika:

**b) deklarata tatimore përmban të dhëna të pasakta ose të falsifikuara;**

**c) tatimpaguesi nuk mban ose ruan llogari apo regjistrime të sakta të transaksioneve;**

Neni 72 “Baza e mënyrave alternative të vlerësimit”:

1. Mënyrat alternative të vlerësimit nuk kufizohen, por bazohen në:

**a) të dhëna të drejtpërdrejta, që gjenden në deklaratat tatimore ose në dokumentet apo në një informacion tjetër, dhënë nga tatimpaguesi;**

Muaj	Nr pun	Paga Bruto	Paga Bruto Rivlerësuar	Diferenca	Sig Sh PDH (15%)	Sig Sh PM (9.5%)	Sig Sh PDH	Sig Sh PM	TAP (13%)	Paga Neto
------	--------	------------	------------------------	-----------	------------------	------------------	------------	-----------	-----------	-----------

							(1.7%)	(1.7%)		
Nëntor 2020	331	7,540,500	9,182,700	1,642,200	246,330	156,009	27,917	27,917	101,255	1,357,019
Dhjetor 2020	76	2,507,616	2,792,626	285,010	42,751	27,076	4,845	4,845	5,570	247,518
Janar 2021	466	13,593,109	16,318,777	2,802,032	420,305	266,193	47,635	47,635	343,898	2,144,307
Shkurt 2021	438	13,005,288	15,630,061	2,624,773	393,716	249,353	44,621	44,621	327,195	2,003,603
Mars 2021	447	13,484,310	16,193,076	2,708,766	406,315	257,333	46,049	46,049	327,869	1,911,731
Prill 2021	451	13,638,651	16,392,164	2,753,513	413,027	261,584	46,810	46,810	346,104	2,099,016
Maj 2021	449	13,353,584	16,061,486	2,707,902	406,185	257,251	46,034	46,034	340,048	2,064,569
Qershor 2021	501	13,967,004	16,748,736	2,781,732	417,260	264,265	47,289	47,289	333,205	2,136,973
Korrik 2021	400	12,583,992	15,204,456	2,620,464	393,070	248,944	44,548	44,548	337,147	1,989,825
Gusht 2021	460	13,750,356	16,540,795	2,790,439	418,566	265,092	47,437	47,437	343,061	2,134,849
Shtator 2021	442	12,565,233	15,125,346	2,560,113	384,017	243,211	43,522	43,522	311,360	1,962,021
Tetor 2021	394	11,916,677	14,372,635	2,455,958	368,394	233,316	41,751	41,751	319,275	1,861,616
Nëntor 2021	365	10,733,625	12,908,098	2,174,473	326,171	206,575	36,966	36,966	273,856	1,657,075
Dhjetor 2021	340	10,318,533	12,389,918	2,071,385	310,708	196,782	35,214	35,214	260,112	1,579,277
Janar 2022	336	10,151,764	12,221,634	2,069,870	310,480	196,638	35,188	35,188	12,445	1,583,258
Shkurt 2022	336	10,208,894	12,128,228	2,074,317	311,148	197,060	35,263	35,263	261,741	1,580,252
Mars 2022	320	9,803,991	11,818,820	2,014,829	302,224	191,409	34,252	34,252	247,813	1,444,943
<b>Total</b>		<b>193,123,127</b>	<b>232,029,555</b>	<b>39,137,775</b>	<b>5,870,666</b>	<b>3,718,089</b>	<b>665,342</b>	<b>665,342</b>	<b>4,491,955</b>	<b>29,757,853</b>

Burimi: DTM, përpunoni KLSH.

Nr	Emërtimi	Vlera
1	Paga Bruto	193,123,127
2	Paga Bruto Rivlerësuar	232,029,555
3	Diferenca Paga Bruto	39,137,775
<b>4</b>	<b>Diferenca Paga Neto</b>	<b>29,757,853</b>
5	Diferenca Sig Shoq Punëmarrësi (9.5%)	3,718,089
6	Diferenca Sig Shënd Punëmarrësi (1.7%)	665,342
<b>7</b>	<b>Diferenca Sig Shoq Punëdhënësi (15%)</b>	<b>5,870,666</b>
<b>8</b>	<b>Diferenca Sig Shënd Punëdhënësi (1.7%)</b>	<b>665,342</b>
9	Diferenca TAP (13%)	4,491,955
<b>10</b>	<b>Rivlerësim i shpenzimeve të padeklaruar nga subjekti [(4)+(7)+(8)]</b>	<b>36,293,861</b>

Burimi: DTM, përpunoni KLSH.

Penalizmi i subjektit duhet të ishte bërë sipas llogaritjeve të mëposhtme në bazë të pikës 3 të nenit 119 “Mosdeklarimi i punonjësve dhe fshehja e pagës” të Ligjit Nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar, ku përcaktohet qartë se: “Nëse nga verifikimi dhe kontrolli rezulton se tatimpaguesi ka fshehur dhe nuk ka deklaruar pagën e saktë të përfituar nga punëmarrësi, si rezultat i marrëdhënies së punësimit, tatimpaguesi-punëdhënësi, përveç detyrimit për pagimin e shumës së detyrimit tatimor dhe kontributit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, të llogaritur për gjithë periudhën që provohet se është kryer shkelja, dënohet me gjobë në masën 100 për qind të detyrimit dhe kontributit të llogaritur”.

Emërtimi	Vlera
Sig Shoq Punëdhënësi (15%)	5,870,666
Gjobë Sig Shoq Punëdhënësi (100%)	5,870,666
Sig Shoq Punëmarrësi (9.5%)	3,718,089
Gjobë Sig Shoq Punëmarrësi (100%)	3,718,089
Sig Shënd Punëdhënësi (1.7%)	665,342
Gjobë Sig Shënd Punëdhënësi (100%)	665,342
Sig Shënd Punëmarrësi (1.7%)	665,342
Gjobë Sig Shënd Punëmarrësi (100%)	665,342
TAP (13%)	4,491,955
Gjobë TAP (100%)	4,491,955
<b>Detyrime Total</b>	<b>30,822,788</b>

Burimi: DTM, përpunoni KLSH.



Nga sa më sipër janë sjellë si pasojë efekte tatimore të pallogaritura në shumën 5,870,666 lekë detyrime të Sig Shoq Punëdhënësi dhe 5,870,666 lekë gjobë 100%, 3,718,089 lekë detyrime të Sig Shoq Punëmarrësi dhe 3,718,089 lekë gjobë 100%, 665,342 lekë detyrime Sig Shënd Punëdhënësi dhe 665,342 lekë gjobë 100%, 665,342 lekë detyrime Sig Shënd Punëmarrësi dhe 665,342 lekë gjobë 100%, 4,491,955 lekë detyrime TAP dhe 4,491,955 lekë gjobë 100%, pra të ardhura gjithsej të munguar për buxhetin e shtetit në vlerën prej 30,822,788 lekë.

Në lidhje me pagat e padeklaruar saktë nga ana e subjektit do të kryhet rivlerësimi i situatës financiare të subjektit, ku shpenzimi i fondit të pagave të rivlerësuar do të rikarakterizohet si e ardhura dhe do të kryhet penalizimi i subjektit sipas përcaktimeve të nenit 115 “Plotësim i pasaktë i deklaratës tatimore”, të Ligjit Nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar, ku përcaktohet qartë se: “Dorëzimi i një deklaratë tatimore të pasaktë dënohet me një gjobë të barabartë me 0,06 përqind të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë, gjatë së cilës pagesa nuk është kryer. Në asnjë rast, gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike”.

<b>Emërtimi</b>	<b>Vlera</b>
Rivlerësim i shpenzimeve ( <b>Paga Neto + Sig Shoq &amp; Sig Shënd Punëdhënësi</b> )	36,293,861
TVSH (20%)	7,258,772
Gjobë TVSH (21.9%)	1,589,671
Tatim Fitimi (15%)	5,444,079
Gjobë Tatim Fitimi (21.9%)	1,192,253
Tatimi Neto pas TF	30,849,782
Tatim mbi Dividentin (8%)	2,467,983
Gjobë Tatim Dividenti (21.9%)	540,488
<b>Detyrime Total</b>	<b>18,493,247</b>

Burimi: DTM, përpunoni KLSH.

Nga sa më sipër janë sjellë si pasojë efekte tatimore të pallogaritura në shumën 5,444,079 lekë detyrime të tatimit mbi fitimin dhe 1,192,253 lekë gjobë 21.9%, 7,258,772 lekë detyrime të TVSH-së dhe 1,589,671 lekë gjobë 21.9%, detyrime të tatimit mbi dividentin 2,467,983 lekë dhe 540,488 lekë gjobë 21.9%, pra të ardhura gjithsej të munguar për buxhetin e shtetit në vlerën prej 18,493,247 lekë.

Gjithashtu nga kontrolli në sistemin C@ts i listëpagesave janë konstatuar në muajin Mars 2021 dhe Janar 2022, disa paga bruto në vlera të larta të cilat nuk janë analizuar nga ana e inspektorit të kontrollit, paraqitur si më poshtë:

<b>Nr</b>	<b>ID</b>	<b>Emër Mbiemër</b>	<b>Funksioni</b>	<b>Paga Bruto</b>	<b>Periudha</b>
1	I.V	E. P.	Drejtor	6,731,906	03/2021
4	G.N	E. S.	Sipërmarrës	6,520,057	03/2021
2	H.M	B.LI.	Drejtor i Përgjithshëm në ndërtim	4,899,229	03/2021
3	H.D	A. A.	Drejtor i Zbatimit të Projektit	5,103,269	03/2021
5	G.N	E. S.	Sipërmarrës	8,883,362	01/2022
<b>Total</b>				<b>32,137,823</b>	

Burimi: DTM, përpunoni KLSH.

Nga analiza e raport kontrollit për periudhën Janar-Dhjetor 2021, rezulton se shoqëria ka kryer blerje shërbime nga individë të cilët nuk janë të punësuar në shoqëri, për të cilat është llogaritur, mbajtur dhe paguar tatimi në burim sipas kontratave respektive. Në raport kontrolli sqarohet se janë *shërbime inxhinierike, menaxhimi dhe përzgjedhje e matrialeve të ndërtimit në treg me*

**argumentin se janë projekte specifike (Projektet: Rikualifikim i Lumit të Vlorës dhe Ndërtimi i Ujësjellësit Librazhd).**

- I. I. në shumën 21,808,162 lekë ose 150,000 euro për projektin “Rikualifikim i Lumit të Vlorës” sipas kontratës së shërbimit nr.22 datë 12.02.2021 dhe nisur nga fakti se për këtë shërbim nga një individ që nuk është i punësuar në kompani, është një shërbim i paguar vetëm në një rast dhe jo në mënyrë të njëtrajtshme muaj për muaj dhe për këtë shërbim është llogaritur dhe paguar tatimi në burim në masën 15% mbi vlerën e shërbimit të kryer.

- A. I. në vlerën 21,808,162 lekë ose 150,000 euro për projektin “Ndërtimi i Ujësjellësit Librazhd” sipas kontratës së shërbimit nr.25 datë 12.02.2021 dhe nisur nga fakti se për këtë shërbim nga një individ që nuk është i punësuar në kompani, është një shërbim i paguar vetëm në një rast dhe jo në mënyrë të njëtrajtshme muaj për muaj dhe për këtë shërbim është llogaritur dhe paguar tatimi në burim në masën 15% mbi vlerën e shërbimit të kryer.

Shitësi	Rrethi	NIPT	Vlera	Tatim Burim	Natyra e shp
A. I.	Tiranë	I.Q	21,808,162	3,271,224	Konsulence
I. I.	Tiranë	G.O	21,808,162	3,271,224	Konsulence
<b>Total</b>			<b>43,616,324</b>	<b>6,542,448</b>	

Burimi: DTM, përpunoni KLSH.

Fillimisht sqarojmë se nga kontrolli më i thelluar në sistemin C@ts dhe të dhënave të QKB, rezulton se z. I. I., z. A. I. dhe shoqëria “A. – S.” SHPK, janë palë të lidhura sipas përcaktimeve të nenit 1 të Ligjit Nr.42/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, konkretisht:

- Z. I. I. është ortak i zotërues i 100% të kuotave të shoqërisë “M.” SHPK me NIPT M.C, e cila nga ana e saj është zotëruese e 57% të kuotave të shoqërisë “F.” SHPK me NIPT L.K, e cila është zotëruese e 100% të kuotave të shoqërisë “A.-S.” SHPK me NIPT J.2Ë. Si përfundim arrijmë në konkluzionin se I.t I. dhe shoqëria “A. – S.” SHPK, janë palë të lidhura sepse është zotërues në mënyrë indirekte i 57% të kuotave.

- Z. A. I. është administrator i shoqërisë V. SHPK me NIPT L.S, kapitali i saj është zotëruar nga shoqëria “F.” SHPK me NIPT L.K, e cila zotëron edhe kapitalin e shoqërisë “A. – S.” SHPK, sipas numrit të çështjes: CN.-12-16, “**Depozitimi i vendimit date 24.11.2016, ku është vendosur: Kalimi i kuotave të ortakeve z. I. I. dhe z. S. I. që zotërojnë në shoqërinë "V." në formën e kontribut në natyrë në kapitalin e shoqërisë së themeluar "F." SHPK**”. Kjo përqindje e zotërimit të kuotave të shoqërisë V. SHPK, ka vazhduar deri në datën 23.12.2021 kur është kryer edhe ndryshimi tjetër sipas numrit të çështjes: CN.-12-21, kur është larguar si ortak shoqëria "F." SHPK”. Kontrata e shërbimit midis shoqërisë dhe A. I. është lidhur në datë 12.02.2021, gjë që vërteton faktin se kemi të bëjmë me veprime midis palëve të lidhura.

- Në raportin e kontrollit tatimor nuk është kryer një analizë e kontratave që janë lidhur midis shoqërisë dhe individëve si dhe të nevojës specifike që ka shoqëria për këtë shërbim në realizimin e projekteve të “Rikualifikim i Lumit të Vlorës” dhe “Ndërtimi i Ujësjellësit Librazhd”.

- Gjithashtu theksojmë se kontratat e punëve publike për projektet e “Rikualifikim i Lumit të Vlorës” dhe “Ndërtimi i Ujësjellësit Librazhd”, janë lidhur përpara se sa kontratat e shërbimit me këta dy individë, nga rrjedh se shoqëria është shpallur fituese e tenderit duke plotësuar kriteret e përgjithshme dhe specifike si dhe çdo kërkesë tjetër të përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Në këtë logjikë rrjedh se nuk janë të domosdoshme këto “shërbime inxhinierike, menaxhimi dhe përzgjedhje e matrialeve të ndërtimit në treg”, për realizimin e kontratave të projekteve të “Rikualifikim i Lumit të Vlorës” dhe “Ndërtimi i Ujësjellësit Librazhd”.

- Nga kontrolli i listëpagesave të dorëzuara në sistemin C@ts, rezulton se shoqëria ka të punësuar në mënyrë të përhershme mesatarisht mbi 100 inxhinier të profileve të ndryshme, çdo muaj përgjatë periudhës së kontrollit 11/2020-03/2022, por nga ana e inspektorit të kontrollit tatimor nuk ka një analizë n.q.s. ky shërbim mund të kryhet nga personeli i brendshëm pa qenë nevoja e kontraktimit të jashtëm si dhe nuk ka një kontroll dhe analizë të formimit profesional dhe ekzistencën e certifikimeve dhe licencave të miratuara për këtë shërbim që po ofrojnë këta individë ndaj shoqërisë.

Nga sa më sipër grupi i auditimit gjykon se jemi në kushtet e shpenzimeve të cilat nuk janë kryer për qëllime fitimi, sigurimi dhe ruajtje të fitimit, gjë që është në shkelje të përcaktimeve të nenit 20 të Ligjit Nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar:

*- Për përcaktimin e fitimit të tatueshëm në Republikën e Shqipërisë njihen si shpenzime ato që kryhen për qëllime fitimi, sigurimi dhe ruajtje të fitimit, në masën që këto shpenzime provohen dhe dokumentohen nga tatimpaguesi, si dhe kur janë objekt i kufizimeve të specifikuara nga ky ligj.*

Nga sa argumentuar sa më sipër, ku rezulton se shpenzimet për “shërbime inxhinierike, menaxhimi dhe përzgjedhje e materialeve të ndërimit në treg”, nuk janë kryer për qëllime fitimi, sigurimi dhe ruajtje të fitimit duhet të rrikarakterizohen si shpenzime të panjohur duke rivlerësuar situatën financiare dhe penalizuar subjektin për këto parregullësi në deklaram sipas përcaktimeve të nenit 115 “Plotësim i pasaktë i deklaratës tatimore”, të Ligjit Nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar, ku përcaktohet qartë se: “Dorëzimi i një deklarate tatimore të pasaktë dënohet me një gjobë të barabartë me 0,06 përqind të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë, gjatë së cilës pagesa nuk është kryer. Në asnjë rast, gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike”.

<i>Emërtimi</i>	<i>Vlera</i>
Shpenzime të panjohura (Rivlerësim i shpenzimeve të konsulencës)	43,616,324
Tatim Fitimi (15%)	6,542,449
Gjobë Tatim Fitimi (21.9%)	1,432,796
Tatimi Neto pas TF	37,073,875
Tatim mbi Dividentin (8%)	2,965,910
Gjobë Tatim Dividenti (21.9%)	649,534
<b><i>Detyrime Total</i></b>	<b><i>11,590,689</i></b>

Burimi: DTM, përpunoni KLSH.

Nga sa më sipër janë sjellë si pasojë efekte tatimore të pallogaritura në shumën 6,542,449 lekë detyrime të tatimit mbi fitimin dhe 1,432,796 lekë gjobë 21.9%, 2,965,910 lekë detyrime të tatimit mbi dividentin dhe 649,534 lekë gjobë 21.9%, pra të ardhura gjithsej të munguar për buxhetin e shtetit në vlerën prej 11,590,689 lekë.

Gjithashtu nga auditimi i raportit të kontrollit janë konstatuar dy fatura “**Shërbim konsulence financiare dhe menaxhimi**” nga shoqëria “F.” SHPK, e cila zotëron 100% të kapitalit të shoqërisë “A.-S.”, theksojmë se këto vlera janë dukshëm më të larta se shërbimet e konsulencës nga shoqëri të tjera, të cilat nuk janë palë të lidhura dhe nga ana e inspektorit nuk është kryer një analizë e detajuar se çfarë janë këto shpenzime dhe si i kanë shërbyer aktivitetit të “A.-S.” SHPK.

<b>Viti</b>	<b>Shitësi</b>	<b>Rrethi</b>	<b>NIPT</b>	<b>VI Tat</b>	<b>TVSH</b>	<b>Përshkrimi</b>
2020	F.	Tirane	L.K	3,464,440	692,888	Shërbim Konsulenc Financiare
2021	F.	Tirane	L.K	19,772,634	3,954,528	Shërbim Konsulenc Menaxhimi
<b>Totali</b>				<b>23,237,074</b>	<b>4,647,416</b>	

Burimi: DTM, përpunoni KLSH.

Nga analiza e raportit të kontrollit tatimor rezulton se shoqëria ka kryer shitje të aktiveve afatgjata si mjete pune, mjete transporti dhe vilë në G. C., pa realizuar fitim, ku vlera e shitjes është sa vlera e mbetur, paraqitur si më poshtë:

Emërtimi	Data	VI Shitjes	VI Mbetur	+/-
Am Rentals (Eskavator Esc 022 Nrs Cat 0330 dthbd0140)	31.03.20	3,379,420	3,379,420	-
Am rentals(Eksavator,Eskavator ,Eskavator Buldozier	31.03.20	14,971,322	14,971,322	-
Am rentals(Buldozer,Greider,Minieskavator,Minieskavator, Minieskavator Minieskavator,Minieskavator,Rul Rul001, Rul005,Rul008,Minieskavator,Minieskavator, Greider grd003-cat 143h ,Robot-Rob 012,Minieskavator Buldozer bul009,MinieskavatorMNS022,Minieskavator)	17.04.20	6,614,950	6,614,950	-
Am rentals (Robot 010,Robot Rob 011)	17.04.20	202,889	202,889	-
Am rentals(Motogroidu GRD 004-Cat 120 B9C00612)	17.04.20	5,558,819	5,558,819	-
A. SHPK(Tranxhe prerese deri ne 16 mm,Prerese hidraulike, Tranxhe hidraulike,makine metal prerese plazem,Kalander hidraulike ,kompresor,l metalike,Makineri	07.05.20	16,399,110	16,399,110	-
Am rentals(Vinc Liberr ltm 105513)	6/18/2020	17,189,013	17,189,013	-
Am rentals(Ford Cmax AA446UZ)	6/18/2020	2,585,266	2,585,266	-
Am rentals(Audi AG,AA 498YH)	6/18/2020	5,121,545	5,121,545	-
Am rentals(Buldozer D6NXL )	6/18/2020	4,212,374	4,212,374	-
Am rentals(Rul dheu CA5500)	6/18/2020	3,946,455	3,946,455	-
Am rentals(Rul dheu CA5500)	6/18/2020	3,946,455	3,946,455	-
Am rentals(Motorr grader Cat )	6/18/2020	15,633,690	15,633,690	-
Am rentals(Buldoze D6TXL)	6/18/2020	9,067,905	9,067,905	-
Am rentals(Vinc Liberr ltm 103012)	6/18/2020	8,659,165	8,659,165	-
Am rentals(Rul Hamm )	6/18/2020	5,053,799	5,053,799	-
Am rentals(Eskavator cat325 BLN-nr5)	27/07/2020	176,539	176,539	-
Am rentals(Eskavator AA547 CM)	27/07/2020	120,235	120,235	-
Am rentals(Eksavator JBC AA 241 GV JS 200E-Nrs)	27/07/2020	1,346,101	1,346,101	-
Am rentals(Eskavator JSB -Js 200E AA 480CF)	27/07/2020	1,186,394	1,186,394	-
Am rentals(Kamion Man AA327 MU)	27/07/2020	1,552,799	1,552,799	-
Am rentals(Kamion Man AA 168 HO)	27/07/2020	1,552,799	1,552,799	-
Am rentals(Kamion Man AA 719XE)	27/07/2020	1,088,850	1,088,850	-
Am rentals(Rimorkio FR6802C)	27/07/2020	11,667	11,667	-
Am rentals(Pirun toyota MNG014)	27/07/2020	1,418,593	1,418,593	-
Am rentals(Buldozer Dsg -Nr.5.1 DD 00307)	27/07/2020	254,720	254,720	-
Am rentals(Mjet Ngrites Fh strom 18-45)	27/07/2020	893,993	893,993	-
Am rentals(MNG 009 Oirun Linde H 700-02-Hrs)	30/07/2020	525,878	525,878	-
Am rentals(Mng 012 AA 438JN Liberr ltm )	30/07/2020	15,240,336	15,240,336	-
Am rentals(MNG 13 Pirun Moniton+Pirun teleskopik)	30/07/2020	5,720,921	5,720,921	-
Am rentals(Fadrom Cat 428 CT)	14/12/2020	153,659	153,659	-
Am rentals(Scania R12 autobot)	14/12/2020	99,671	99,671	-
Am rentals(Ifa ADK 885141)	14/12/2020	208,855	208,855	-
Am rentals( Kamion Man 26-331)	14/12/2020	99,671	99,671	-
Am rentals(Kamion Benz 25-35)	14/12/2020	80,600	80,600	-
Am rentals(Kamiocine M-benz 208D )	14/12/2020	38,576	38,576	-
Am rentals(Kamion Man 19-331)	14/12/2020	103,824	103,824	-
Am rentals(Kamion Actros EDB9541611K568007)	14/12/2020	68,088	68,088	-
Am rentals(Kamion Man 33-360)	14/12/2020	286,155	286,155	-
Am rentals(Kamion Man 14-170)	14/12/2020	121,901	121,901	-
Am rentals(Hyndai KMJEAH7HP9U157728)	14/12/2020	172,174	172,174	-
Am rentals(Fadrom JCB -4CX)	14/12/2020	166,492	166,492	-
Am rentals(Kamion Man 33-360)	14/12/2020	99,671	99,671	-
Am rentals(Locateli Gril 935)	14/12/2020	45,682	45,682	-
Am rentals(Takraf 1253447384)	14/12/2020	95,619	95,619	-
Am rentals(JCB 170 seria 11)	14/12/2020	199,958	199,958	-
Am rentals(Cekic hidraulik,rul vibrus hekur gom,rul vetelevizes,cekic hn1560, cekic sb 300,cekic sb 302,gurethyses me zinxhir, rul bomg,vibratorik hidraulik per eskavator)	18/12/2020	9,982,891	9,982,891	-
N.M SHPK (Kontrata 3963/1394 G. C.)	6/19/2020	37,029,463	37,029,463	-
<b>Shuma</b>		<b>202,684,952</b>	<b>202,684,952</b>	<b>-</b>

Burimi: DTM, përpunoni KLSH.

Nga kontrolli i detajuar në sistemin C@ts dhe QKB, rezulton se kuotat e kapitalit të shoqërisë blerëse “A.R” SHPK dhe shoqërisë shitëse “A.S” SHPK, zotërohen nga shoqëria “F.” SHPK, e cili zotëron 100% të kapitalit të tyre. Në këtë mënyrë kemi që subjektet A.R SHPK dhe A.S SHPK, janë palë të lidhura dhe transaksionet midis tyre janë transaksione të kontrolluara të cilat duhet t’ju përmbahen kushteve dhe parimeve të tregut të lirë, sipas përcaktimeve të nenit 1 të Ligjit Nr.42/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar. Në lidhje me situatën e trajtuar më sipër grupi i audituesve gjykon se janë arsye themelore për të kryer rivlerësimin e transaksioneve midis palëve të lidhura jo në bazë të parimit të vlerës së tregut në shitjen pa realizuar fitimit të mjeteve të punës dhe mjeteve të transportit si dhe duke shmangur tatim mbi fitimin për fitimet kapitale, dhe njëkohësisht merr në vlera të larta me qera mjete pune dhe makineri po nga kjo shoqëri. Si dhe gjithashtu transaksionit pa efekte ekonomike thelbësore me shoqërinë N. M. SHPK, në shitjen e vilës në G.C pa realizuar dhe duke shmangur pagesën e tatimit mbi fitimin.

Veprime të cilat janë në kundërshtim me *germën dh të nenit 71, gerrat a, b, c, ç dhe d të neni 71/2 si dhe gërma a e nenit 72 të Ligjit Nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave Nr.24 date 02.09.2008, i ndryshuar në zbatim të tij, ku përcaktohet se:*

*Neni 71 “E drejta për të përdorur mënyra alternative vlerësimi” i Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, konkretisht pika:*

***dh) tatimpaguesi hyn në transaksione me persona të lidhur jo në bazë të parimit të vlerës së tregut, ose hyn në transaksione pa efekte ekonomike thelbësore;***

*Neni 71/2 “Përdorimi i metodave alternative të vlerësimit në rastet e veprimeve për shmangien e tatimit dhe abuzimit me parimet e ligjit tatimor” i Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar, konkretisht pika:*

*Në rastet kur një apo disa tatimpagues kryejnë një veprim/transaksion apo seri veprimesh/transaksionesh direkte apo indirekte me persona të tretë, ku:*

***a) veprimet e ndërmarra nga tatimpaguesi deformojnë parimet e ligjit tatimor;***

***b) veprimet/transaksionet nuk bazohen në parimin e vlerës së tregut;***

***c) veprimet/transaksionet janë pa efekte ekonomike thelbësore;***

***ç) forma e veprimet/transaksionit nuk reflekton thelbin e tij ekonomik;***

***d) evidentohen elemente të veprimeve/ transaksioneve që synojnë shmangien ose uljen e detyrimeve tatimore.***

*Neni 72 “Baza e mënyrave alternative të vlerësimit”:*

*1. Mënyrat alternative të vlerësimit nuk kufizohen, por bazohen në:*

***a) të dhëna të drejtpërdrejta, që gjenden në deklaratat tatimore ose në dokumentet apo në një informacion tjetër, dhënë nga tatimpaguesi;***

Nga sa analizuar më sipër në lidhje me transaksionet e shitjes së mjeteve të punës dhe mjeteve të transportit, midis palëve të lidhura që nuk u përmbahen kushteve të tregut dhe transaksioneve pa efekte ekonomike thelbësore me shoqërinë N. M. SHPK, në shitjen e vilës në G. C., pa realizuar, do të kryhet rivlerësimi i situatës financiare të subjektit duke përdorur të dhëna të deklaruara nga vet subjekti, konkretisht marzhin neto të fitimit të deklaruar në pasqyrat financiare:

<b>Përshkrimi</b>	<b>Vlera lekë</b>
Të ardhurat	6,065,242,570



Shpenzimet	4,457,196,292
Shpenzimet e panjohura	10,022,829
<b>Fitimi i tatueshem</b>	<b>1,618,069,107</b>
<b>Ne %</b>	<b>26.68%</b>

Burimi: DTM, përpunoni KLSH.

Duke kryer penalizimin e subjektit për këto parregullësi sipas përcaktimeve të nenit 115 “Plotësim i pasaktë i deklaratës tatimore”, të Ligjit Nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar, ku përcaktohet qartë se: “Dorëzimi i një deklaratë tatimore të pasaktë dënohet me një gjobë të barabartë me 0,06 përqind të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë, gjatë së cilës pagesa nuk është kryer. Në asnjë rast, gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike”.

<b>Emërtimi</b>	<b>Vlera</b>
Të ardhurat	202,684,952
Marzhi i fitimit	26.68%
Fitimi i tatueshëm i padeklaruar	54,076,345
Tatim Fitimi (15%)	8,111,452
Gjobë Tatim Fitimi (21.9%)	1,776,408
Tatimi Neto pas TF	45,964,893
Tatim mbi Dividentin (8%)	3,677,191
Gjobë Tatim Dividenti (21.9%)	805,305
<b>Detyrime Total</b>	<b>14,370,356</b>

Burimi: DTM, përpunoni KLSH.

Nga sa më sipër janë sjellë si pasojë efekte tatimore të pallogaritura në shumën 8,111,452 lekë detyrime të tatimit mbi fitimin dhe 1,776,408 lekë gjobë 21.9%, 3,677,191 lekë detyrime të tatimit mbi dividendin dhe 805,305 lekë gjobë 21.9%, pra të ardhura gjithsej të munguar për buxhetin e shtetit në vlerën prej 14,370,356 lekë.

Nga grupi i auditimit, u kontrolluan çmimet e shitjes së njësive komerciale zyra dhe depo, tek objekti “S. A. A.”, drejt shoqërisë I. SHPK (të cilat janë palë të lidhura), dhe rezultuan shitje nën çmimin fiskal minimal të zonë 2/1, të përcaktuar në Aneksin Nr.1 dhe Nr.2 të VKM Nr.168, datë 27.3.2019. Konkretisht sipas Aneksit Nr.2 “Çmimet mesatare referuese për metër katror sipërfaqe ndërtimi për vlerësimin e vlerës së taksueshme për ndërtime dhe ambiente jo-banimit”, rezulton se: a) Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi për veprimtari ekonomike tregtimi shërbimi është 1.5 (një pikë pesë) herë më i lartë se çmimi i sipërfaqeve të banimit sipas qyteteve. Në këtë kategori përfshihen edhe njësitë tregtare, ku njëkohësisht realizohen edhe procese të përziera prodhimi, tregtimi apo shërbimi me pakicë. Në zonat që përfshihen në **Bashkinë Tiranë ky koeficient është 2 (dy) herë më i lartë.**

Përshkrimi	Neto	Çmimi i shitjes pa TVSH	Vlera e shitjes	Çmim shitjes me TVSH	Vl e shitjes me TVSH	Çmimi i Referencës Zona 2/1	Dif Çmim	Dif Vlerë
Njësi Komerciale/Zyra	2,277	275,927	628,340,910	331,112	754,009,092	374,000	42,888	97,655,976
Zyra	5,947	275,927	1,640,937,726	331,112	1,969,125,272	374,000	42,888	255,054,936
Zyra	2,723	151,441	412,373,438	181,729	494,848,126	374,000	192,271	523,553,933
<b>Shuma</b>	<b>12,816</b>		<b>2,937,529,690</b>		<b>3,525,035,628</b>			<b>876,264,845</b>

Burimi: DTM, përpunoni KLSH.

Në total shitje nën çmimin minimal fiskal të përcaktuar në VKM Nr.168, datë 27.3.2019, rezultuan **876,264,845 lekë**, ku nga grupi i auditimit është rivlerësuar situata financiare e shoqërisë duke rritur të ardhurat dhe penalizimin sipas përcaktimeve të nenit 128 “Lëshimi i faturës së pasaktë”, të Ligjit Nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar, ku përcaktohet qartë se: “Tatimpaguesi, që lëshon faturë tatimore të pasaktë e që rezulton me ulje të detyrimit apo rritje të shumës për t’u rimbursuar, dënohet me gjobë të barabartë me 50 për qind të shumës së efektit në ulje të detyrimit tatimor, përveç detyrimeve tatimore dhe interesave të llogaritura në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të ligjeve specifike tatimore.

<b>Emërtimi</b>	<b>Vlera</b>
Rivlerësim i të ardhurave	876,264,845
TVSH (20%)	146,044,141
Gjobë TVSH (50%)	73,022,070
Tatim Fitimi (15%)	109,533,106
Gjobë Tatim Fitimi (50%)	54,766,553
Tatimi Neto pas TF	766,731,739
Tatim mbi Dividentin (8%)	61,338,539
Gjobë Tatim Dividenti (50%)	30,669,270
<b>Detyrime Total</b>	<b>475,373,678</b>

Burimi: DTM, përpunoni KLSH.

Nga sa më sipër janë sjellë si pasojë efekte tatimore të pallogaritura në shumën 109,533,106 lekë detyrime të tatimit mbi fitimin dhe 54,766,553 lekë gjobë 50%, 146,044,141 lekë detyrime të TVSH-së dhe 73,022,070 lekë gjobë 50%, 61,338,539 lekë detyrime të tatimit mbi dividentin dhe 30,669,270 lekë gjobë 50%, pra të ardhura gjithsej të munguar për buxhetin e shtetit në vlerën prej 475,373,678 lekë.

**- Subjekti:** A.

**Nipti:** K.L

**Adresë Kryesore:** Fshati Bishqethem, Lagjja Rruga e Kishës, Autostrada Fier-Lushnje, Zona Kadastrale Nr.1197, Pasuria Nr.5632, Kolonjë, Lushnje.

**Aktiviteti:** Grumbullim, përpunim e tregtim të bulmetit (Qumësht, kos, djathë e nënproduktet). Import-Eksport. Transport të bulmetit e të nënprodukteve të tij. Grumbullim, prodhim, përpunim, stampim në forma të ndryshme, të lëndëve plastike e tregtim të tyre. Tregtim të kafshëve shtëpiake. Mbarështim gjedhi e prodhim qumështi.

**Lloji i Kontrollit:** Kontroll i plotë.

**Inspektori:** R. A.

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

- Për **TVSH** për periudhën nga: **07/2020–12/2021**.

- Për **Tatim Fitimin** për periudhën: **2020**.

- Për **Sigurimet Shoqërore e Shëndetësore** për periudhën: **07/2020-12/2021**.

- Të tjera periudha tatimore nga: **07/2020-12/2021**.

Nga auditimi i raportit të kontrollit tatimor rezulton se:

- Është kryer kontrolli i TVSH-së duke përfshirë analizën e TVSH së pagueshme në raport me qarkullimin total duke analizuar shitjet dhe blerjet, si më poshtë:

- Në analizë janë pasqyruar blerjet e përjashtuara me TVSH jo të zbritshme/pa TVSH, të cilët kryesisht përbëhen nga shërbimin e transportit ndërkombëtar, siguracione mjjetesh TPL, shërbime

doganore dhe nuk kanë rezultuar diferenca mes blerjeve të raportuara në librin e blerjes me ato të deklaruara në FDP.

- Blerjet e investimit brenda vendit pa TVSH kanë përfshirë blerjen e sistemit financiar Navision për mbajtjen e kontabilitetit, blerjen e tokave, dhe nuk kanë rezultuar diferenca mes blerjeve të raportuara në librin e blerjes me ato të deklaruara në FDP.

- Importet e përjashtuara të investimit pa TVSH kanë konsistuar në blerjen e dy makinerive për prodhim.

- Importet me shkallë tatimore 20%, kanë të bëjnë me importin e mallrave për shitje, blerje lëndë e parë si dhe pjesë këmbimi për mirëmbajtjen e makinerive për të cilat shoqëria ka paguar TVSH në doganë dhe e krediton atë, për të cilat është kryer rakordimi i të dhënave me doganën dhe nuk ka diferenca.

- Importet e investimeve me shkallë tatimore 20% kanë konsistuar në importin e makinerive të prodhimit, për të cilat është kryer rakordimi i të dhënave me doganën dhe nuk ka diferenca.

- Kontrolli i blerjeve nga furnitorët vendas me TVSH 20%, ku nga rakordimi i blerjeve të raportuara në librin e blerjes me ato të deklaruara në FDP për çdo periudhe nuk kanë rezultuar diferenca. Konsumi i karburantit ka qenë brenda kufijve të parashikuara në Udhëzimin Nr.6.

- Kontrolli i blerjeve nga furnitorët vendas me 6% TVSH ka përfshirë spote publicitare për të cilat shoqëria ka kredituar TVSH-në dhe nga rakordimi i blerjeve të raportuara në librin e blerjes me ato të deklaruara në FDP nuk kanë rezultuar diferenca.

- Blerjet e investimeve vendase me TVSH 20%, ka përfshirë investimin e ndërtimit të një objekti, për të cilin shoqëria është pajisur me Leje Ndërtimi nga Bashkia Lushnje me Nr.166 datë 25.07.2019 dhe punimet shoqëria i ka kryer 100% me nënkontraktor.

- Blerje fermerët vendas me TVSH 6%, për të cilat fermerët janë të pajisur me kodin e fermerit dhe shoqëria disponon kontratat përkatëse me ta.

- Shitje të përjashtuara përfshijnë qera ambienti, dhe nuk kanë rezultuar diferenca mes librin e shitjes me ato të deklaruara në FDP.

- Shitje pa TVSH konsistojnë në shërbime marketingu të rimbursuara nga furnitori.

- Nga rakordimi i shitjeve të raportuara në librin e shitjes me ato të deklaruara në FDP për çdo periudhe nuk kanë rezultuar diferenca.

- Shitjet e Tatueshme me TVSH 20% kanë të bëjnë me shitjen e mallrave dhe vetëm në një rast me shitjen e një aseti. Nga rakordimi i shitjeve të raportuara në librin e shitjes me ato të deklaruara në FDP për çdo periudhe nuk kanë rezultuar diferenca.

- Kontrolli i eksporteve, të cilat konsistojnë në shitjet e mallrave për eksport jashtë territorit të R. SH si dhe dërgimin e pjesëve të këmbimit të makinerive për riparim.

- Nga rakordimi për të dhënat e deklaruara nga shoqëria me ato të dërguar nga dogana rezultuan diferenca, të cilat janë analizuar për çdo rast duke identifikuar deklaratat respektive doganore dhe kanë ardhur si rezultat i diferencës në kohë në deklarim mes tatimeve dhe doganave dhe në disa raste mos reflektimin e disa deklaratave në sistemin e tatimeve pavarësisht se shoqëria i ka disponuar ato.

- Në magazinën kryesore që disponon shoqëria është kryer inventari fizik për artikujt që zënë peshën kryesore, dhe nuk kanë rezultuar diferenca.

- Është analizuar bilanci material për të gjithë artikujt e prodhuar nga shoqëria dhe për lëndën e parë (qumësht), duke vlerësuar koeficientet e kartës teknologjike për qumështin e përdorur për secilin produkt të prodhuar, për të cilat nuk kanë rezultuar diferenca.

- Është kryer kontrolli për tatimin mbi fitimin dhe elementët e pasqyrave financiare si aktive, pasive, kapitalin dhe PASH dhe nuk kanë rezultuar problematika.



- Është kryer kontrolli për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe TAP dhe nuk kanë rezultuar problematika.

**- Subjekti:** “I.” SHPK.

**Nipti:** L.H.

**Adresë Kryesore:** Rruga Dafaive, Njësia Bashkiake Nr.7, Kompleksi i ndërtimeve I. SHPK, Tiranë.

**Aktiviteti:** Kryerjen e punimeve tokësore lidhur me ndonjë vepër muratore, ndërtimin e rrugëve, kanalizime, ndërtime që lidhen me interesa publike dhe private në familje, tregtare dhe industriale. Prodhim dhe shitje të asfaltit dhe betonit mik. Shfrytëzim dhe përpunim të materialeve të grupit të ndërtimit etj.

**Lloji i Kontrollit:** Kontroll i plotë.

**Inspektori:** Z. D.

**Inxhinier:** I. K.

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

- Për **TVSH** - periudha tatimore nga: **07/2018-09/2020**.

- Për **Tatim Fitimin** periudha tatimore nga: **2018-2019**.

- Për **Sigurimet Shoqërore e Shëndetësore** - periudha tatimore nga: **07/2018-09/2020**.

- Të Tjera periudha tatimore nga: **07/2018-09/2020**.

Nga auditimi i raportit të kontrollit tatimor dhe aktit verifikimit të mbajtur për subjektin “I.” SHPK, nga ana e inspektorit dhe inxhinierit pranë DTM, janë konstatuar mungesa e analizave dhe vlerësimeve të projektit dhe preventivit të punimeve, nuk është kryer një zbërthim i matrialeve dhe lëndës së parë në përbërje të punimeve të situacionuar, bazuar në manualin nr.1 “Analiza Teknike-Për prodhimin e matrialeve të ndërtimit, udhëzime dhe kriteret” dhe manualin nr.2 “Analiza Teknike-Për punimet e ndërtimit të ndërtesave”, si dhe krahasimi me punimet e kryera realisht në terren dhe si rezultat grupi i auditimit gjykon se jemi në kushtet e pamundësisë objektive për të vijuar analizën e mëtejshme të situatës. Gjithashtu janë konstatuar mungesa e analizave të librezës së masave, situacioneve pjesore mujore, progresive dhe përfundimtare të volumit të punimeve të ndërtimit, të cilat janë dokumenta justifikuese për verifikimin e volumit të punimeve të kryera sipas përcaktimeve të nënparagrafave 3.2 dhe 3.3 të pikës 3, Kreu 1 të Udhëzimit Nr.3, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, ndryshuar me Udhëzimin Nr.1 datë, 16.06.2011, konkretisht:

*3.2 Libreza e masave për punimet e ndërtimit është dokumentacioni bazë për verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve të ndërtimit, të vendosura në situacion. Kjo librezë hartohet nga drejtuesi teknik i objektit dhe firmoset nga ai, nga mbikëqyrësi i punimeve dhe nga përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit, për të cilin është miratuar leja e ndërtimit.*

*3.3 Situacionet mujore pjesore, progresive dhe përfundimtare hartohen mbi bazën e volumeve të llogaritura në librezën e masave dhe çmimeve faktike, mbështetur në analizat teknike të çmimeve, që përfshihen në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit, të miratuara çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave. Ato firmosen nga drejtuesi teknik i objektit, mbikëqyrësi i punimeve dhe përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit për të cilin është miratuar leja e ndërtimit. Në rastet kur në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit mungojnë analizat teknike të çmimeve të zërave të punimeve të kryera në objekt, veprohet në përputhje me procedurën e përcaktuar në pikën 8 të vendimit nr.514, datë 15.8.2007 të Këshillit të Ministrave "Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit".*

Nga auditimi i raportit të kontrollit tatimor të subjektit “I.” SHPK, kanë rezultuar se për punimet e ndërtimit në objektet “Kompleks banimi dhe shërbimi 1,8,10 dhe 12 kate, me 1 kate parkimi

nëntokë dhe dy godina banimi dhe shërbimi 12 kate me 1 kate parkimi nëntokë, Rruga “Artan Lenja”, Tiranë, nga përlogaritjet e grupit të auditimit kanë rezultuar faturim të punimeve të ndërtimit poshtë nivelit të kostove mesatare që janë përcaktuar në Udhëzimin e Këshillit të Ministrave Nr.3 “Miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2016”, paraqitur si më poshtë:

<b>Kompleks banimi dhe shërbimi 1,8,10 dhe 12 kate, me 1 katë parkimi nëntokë dhe dy godina banimi dhe shërbimi 12 kate me 1 kate parkimi nëntokë, Rruga “Artan Lenja”, Tiranë</b>
<b>Leje Zhvillimore ndërtimi me Vendimin Nr.prot E-6546/4, datë 12.04.2017 të Bashkisë Tiranë për miratim sheshi ndërtimi dhe Vendimin Nr.E-6546/5, date 12.04.2017 te Bashkisë Tirane për dhënie leje ndërtimi ne favor te shoqërisë ” I. SHPK” .</b>
<b>Investitor: "I." SHPK NIPT L.H</b>
<b>Ndërtues: "I." SHPK NIPT L.H</b>
<b>Situacioni (vlera): 828,754,499 Leke me TVSH.</b>
<b>Sipërfaqe për kosto: 26,841 m<sup>2</sup>.</b>
<b>Përqindja e punimeve sipas Ing: 100 %.</b>
Burimi: DTM, përpunoni KLSH.

Nr.	Emërtimi	Njësia	Sip Neto	Sip Përbashkët	Sip. Totale	Sip Veranda
1	Apartamente	m <sup>2</sup>	17,053	1,942	18,995	142
2	Njësi Shërbimi	m <sup>2</sup>	1,694	148	1,842	814
3	Parkime	m <sup>2</sup>	2,990	1,905	4,895	-
4	Depo	m <sup>2</sup>	88	65	153	-
<b>Total</b>		<b>m<sup>2</sup></b>	<b>21,824</b>	<b>4,061</b>	<b>25,885</b>	<b>956</b>

Burimi: DTM, përpunoni KLSH.

Zëri	Vlera e tatueshme
Vlera e situacionuar (me TVSH )	828,754,499
Niveli faktik i punimeve	100%
Sipërfaqe Ndërtimi	26,841
Kosto/m <sup>2</sup>	30,876
Kosto Minimale Fiskale	32,113
<b>Diferenca</b>	<b>1,237</b>
<b>Diferenca në Vlerë</b>	<b>33,190,534</b>

Burimi: DTM, përpunoni KLSH.

Në raportin e kontrollit tatimor dhe akt verifikimin e inxhinierit nuk kemi evidentim të këtyre transaksioneve poshtë nivelit të kostove mesatare të miratuara për ndërtimin dhe nuk gjejmë justifikim të kësaj situatë të tatimpaguesit në aspektin ekonomik si integrim horizontal, vertikal, ekonomi shkalle apo specializim, që të justifikojë uljen e kostove. Nga sa më sipër grupi i auditimit del në konkluzionin se jemi në situatën e faturimeve të situacionit të punimeve të ndërtimit dhe shitjes nën kostot mesatare të miratuara në Udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr.3 “Miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2016”, nga ana e subjektit “I.” SHPK, i cili është njëkohësisht në rolin e ndërtuesit dhe investitorit të punimeve të ndërtimit, parregullësi kjo që ka sjellë ulje të pagesës së TVSH-së si dhe ulje të tatimit mbi fitimin dhe nga ana e inspektorit të kontrollit tatimor duhet të ishte kryer penalizimi sipas nenit 124 “Kundërvajtjet në lëshimin e faturave tatimore, dëftesave tatimore dhe dokumentimin e transaksioneve” e Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat

Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ku përcaktohet qartë se: “Moslëshimi i faturës tatimore, dëftesës tatimore apo i faturës tatimore me TVSH dënohet me gjobë të barabartë me 100 përqind të tatimit të padeklaruar, si rezultat i moslëshimit të faturës, përveç tatimit dhe kamatëvonesave që llogariten dhe paguhen në përputhje me dispozitat e këtij ligji apo të ligjeve specifike tatimore”.

<b>Emërtimi</b>	<b>Vlera</b>
Kompleks banimi dhe shërbimi 1,8,10 dhe 12 kate, me 1 katë parkimi nëntokë dhe dy godina banimi dhe shërbimi 12 kate me 1 kate parkimi nëntokë, Rruga “Artan Lenja”, Tiranë.	33,190,534
TVSH (20%)	6,638,107
Gjobë (100%) TVSH sipas nenit 124	6,638,107
Tatim Fitimi (15%)	4,978,580
Gjobë (100%) Tatim Fitimi sipas nenit 124	4,978,580
<b>Detyrime Total</b>	<b>23,233,374</b>

Burimi: DTM, përpunoni KLSH.

Nga sa më sipër janë sjellë si pasojë efekte tatimore të pallogaritura në shumën 4,978,580 lekë detyrime të tatimit mbi fitimin dhe 4,978,580 lekë gjobë 100%, 6,638,107 lekë detyrime të TVSH-së dhe 6,638,107 lekë gjobë 100%, pra të ardhura gjithsej të munguar për buxhetin e shtetit në vlerën prej 23,233,374 lekë.

Nga auditimi i raportit të kontrollit është konstatuar se **“Kompleksi banimit dhe shërbimit 1,8,10 dhe 12 kate, me 1 kat parkimi nëntokë dhe dy godina banimi dhe shërbimi 12 kate me 1 kat parkimi nëntokë. Rruga “Artan Lenja”, Tiranë**, ka rezultuar se shoqëria është pajisur me Akt Kolaudimi dhe **Certifikatë Përdorimi Nr.E.të objektit.**

<b>Emërtimi</b>	<b>2018</b>	<b>2019</b>	<b>2020</b>
Arkëtime në avancë për porosi	993,173,672	1,349,424,296	1,705,824,334

Burimi: DTM, përpunoni KLSH.

<b>Emërtimi</b>	<b>Vlera</b>
Vlera Totale e Arkëtimeve në Avancë për Porosi:	1,285,591,656
Vlera Totale nga të Ardhurat e Konstatuara:	492,928,740
Vlera e Parapagimeve në Total për I. SHPK dhe E. SHPK:	792,662,916
Vlera e Parapagimeve në total të arkëtuara në emër të E. SHPK, 40 % vlerës Tot	317,065,166
<b>Vlera e Parapagimeve të IBN SHPK, 60 % e vlerës totale sipas Kontratës së Shkëmbimit:</b>	<b>475,597,749</b>

Burimi: DTM, përpunoni KLSH.

Por nga kontrolli i lëvizjes së llogarisë së parapagimeve për këtë objekt ndërtimor të pajisur me certifikatë përdorimi, rezulton se vazhdohet me parapagime nga klientët duke mos njohur të ardhura nga shitja e apartamenteve ose njësisive të tjera, por njihet detyrimi përkatës si “Arkëtime në avancë për porosi”, në seksionin e pasivit të bilancit kontabël. Nga analiza e rrethanave të transaksionit, grupi i auditimit gjykon se për objektin që është pajisur me certifikatë shfrytëzimi, shoqëria ka transferuar rreziqet dhe përfitimet kryesore lidhur me pronësinë tek blerësi, pra shoqëria nuk mbartë më risqe të rëndësishme për apartamentet dhe njësitë e tjera të shërbimit të shitura, të cilat sot shfrytëzohen nga blerësit me të drejta të plota mbi këto prona siç parashikohet

ne SKK 8, pavarësisht nëse është bërë apo jo kalimi i titullit të pronësisë. Konkretisht duhet të debitohet llogaria e parapagimeve të arkëtuara dhe të kreditohet llogaria e të ardhurave, duke njohur të ardhura nga shitja e apartamenteve dhe njësisve të tjera të shërbimit, konform përcaktimeve ligjore në fuqi të cilat janë sqaruar si më poshtë:

Bazuar në nenin 19 “Fitimi i tatueshëm” të Ligjit Nr.8438 “Për tatimin mbi te ardhurat”, ndryshuar:

*Fitimi i tatueshëm për periudhën tatimore përcaktohet në bazë të bilancit dhe të anekseve të tij, që duhet të jenë në përputhje me ligjin “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, me dispozitat e këtij ligji, si dhe me aktet nënligjore të nxjerra nga Ministria e Financave për këtë qëllim.*

Bazuar në Ligjin Nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”:

*Standardet Kombëtare të Kontabilitetit” (SKK) janë standardet e hartuara dhe të publikuara nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit, të cilat shpallen të detyrueshme për zbatim me urdhër të ministrit përgjegjës për financat.*

Bazuar në SKK 8 “Te ardhurat”:

*- Të ardhurat janë përfitimet ekonomike bruto, të marra gjatë periudhës kontabël, si rezultat i rrjedhës normale të veprimtarisë së njësisë ekonomike, atëherë kur këto përfitime ekonomike çojnë në rritjen e kapitalit (këtu nuk përfshihen rritjet, që lidhen me kontributet nga pjesëmarrësit në kapital).*

*- Produkte janë të mira të prodhuara nga njësia ekonomike me qëllim shitje.*

*- Të ardhurat nga shitja e mallrave dhe e produkteve do të njihen kur janë plotësuar të gjitha kushtet e mëposhtme:*

*(a) njësia ekonomike ia ka kaluar blerësit të gjitha rreziqet dhe përfitimet, që lidhen me pronësinë e mallrave dhe produkteve;*

*(b) njësia ekonomike nuk vazhdon të jetë e përfshirë në mënyrë të vazhdueshme në menaxhimin e mallrave dhe te produkteve në atë masë që tregon se ende zotëron titullin e pronësisë dhe/ose ka kontroll efektiv mbi mallrat/produktet e shitura;*

*(c) shuma e të ardhurave mund të matet me besueshmëri;*

*(d) është e mundur që përfitimet ekonomike, që lidhen me transaksionin, do të merren nga njësia ekonomike;*

*(e) kostot që kanë ndodhur, ose që do të ndodhin në lidhje me transaksionin, mund të maten me besueshmëri*

*- Vlerësimi nëse një njësi ekonomike ka transferuar rreziqet dhe përfitimet kryesore lidhur me pronësinë tek blerësi, kërkon një analizë të rrethanave të transaksionit. Në shumicën e rasteve, kalimi i rreziqeve dhe i përfitimeve, në lidhje me pronësinë, tek blerësi, përputhet me kalimin e titullit ligjor (për shembull, në shitjet me pakicë ajo ndodh në kohën e dorëzimit të mallrave/produkteve tek blerësi; në rastin e shitjes me dorëzim pjesor, kalimi i titullit ligjor bëhet siç përshkruhet në marrëveshjen e dorëzimit pjesor). Në rrethana të caktuara kalimi i rreziqeve dhe i përfitimeve, që burojnë nga pronësia, nuk ndodh në të njëjtën kohë me kalimin e titullit ligjor.*

*Nëse rreziqet që lidhen me pronësinë nuk i kalojnë blerësit, atëherë të ardhurat nuk njihen, pavarësisht nga fakti nëse titulli ligjor i ka kaluar blerësit apo jo. Shembuj të situatave, ku rreziqet nuk i kanë kaluar blerësit dhe, si rrjedhim, të ardhurat nuk njihen nga njësia ekonomike, janë:*

*(a) kur njësia ekonomike mbart një detyrim për rezultate jo të kënaqshme, që nuk mbulohet nga garancitë normale.*

*(b) kur arkëtimi i të ardhurave nga një shitje e caktuar është i kushtëzuar nga gjenerimi i të ardhurave nga shitja e mëtejshme e këtyre mallrave apo produkteve nga ana e blerësit;*

*(c) kur mallrat apo produktet transportohen e duhet të montohen, dhe montimi është një pjesë e rëndësishme e kontratës, i cili nuk është kryer akoma nga shitësi;*

*(d) kur blerësi ka të drejtë ta anulojë blerjen, për arsye të përcaktuara në kontratën e shitjes, dhe shitësi është i pasigurt mbi mundësinë e kthimit apo moskthimit të mallit apo produktit*

*- Nëse njësia ekonomike mbart vetëm një rrezik të parëndësishëm, që lidhet me pronësinë, atëherë të ardhurat nga shitja njihen, edhe pse titulli ligjor nuk është kaluar. Shembuj të situatave të tilla janë:*

(a) blerësi ka të drejtë t'i kthejë mallrat apo produktet gjatë kohës së specifikuar në kontratë, dhe njësia ekonomike është në gjendje ta parashikojë mundësinë e kthimit, në bazë të përvojës së mëparshme. Në kohën e shitjes, njësia ekonomike i njeh të ardhurat nga shitja dhe krijon një provizion për mallrat apo produktet me mundësi kthimi;

(b) titulli ligjor i mallrave apo produkteve të shitura mbahet nga njësia ekonomike si siguri për arkëtimin e shumës.

Nga verifikimi i pasqyrave financiare të viteve 2018-2019, rezulton se subjekti në aktiv të bilancit **“Të drejta të arkëtueshme”** në zërin **“Tituj të huadhënies në njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse”**, ka paraqitur huadhënien e shoqërisë ndaj ortakut pa interes dhe pa një sqarim n.q.s. i kanë shërbyer për mbulimin e shpenzimeve dhe blerjeve të mallrave me qëllim vazhdimin normal të aktivitetit të shoqërisë.

Emërtimi	2018	2019
Nga njësitë ekonomike brenda grupit *	98,037,649	98,037,649

Burimi: DTM, përpunoni KLSH.

Nga analiza e dosjes së kontrollit nuk gjejmë informacion sesi shoqëria me saktësi i ka kaluar këto shuma mjetesh monetare në favor të ortakut, pasi në raportin kontrollin tatimor nuk është përmendur dhe sqaruar asnjë dokument justifikues për të vërtetuar transaksionin, si konferma bankare të transaksionit, kontratë huadhënie midis palëve apo vendim asambleje të shoqërisë për këtë borxh që po i jepet ortakut, sepse referuar përcaktimeve të Ligjit Nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, rezulton se ortaku dhe shoqëria me përgjegjësi të kufizuara, janë entitete të ndryshme dhe me personalitet juridik të ndarë. Sipas legjislacionit tatimor, shoqëria dhe ortaku konsiderohen si “palë të lidhura”, meqenëse ortaku ka ndikim në vendimmarrjen e shoqërisë për shkak të zotërimit të kuotave/aksioneve të saj, sipas përcaktimeve në Ligjin Nr.42/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, gjë që sjell se çdo marrëdhënie apo transaksion midis tyre duhet t’u përmbahet kushteve dhe parimeve të tregut.

Nga analiza e raportit të kontrollit tatimor pasqyrohet se subjekti ka shitur 2,827 m<sup>3</sup> beton të markave të ndryshme për vitin 2019, të paraqitura si më poshtë:

Emërtimi	Njësia	Sasia e shitur (m <sup>3</sup> )
Beton 150	m <sup>3</sup>	109.5
Beton 200	m <sup>3</sup>	57.5
Beton 250	m <sup>3</sup>	936
Beton 300	m <sup>3</sup>	1,464
Beton 350	m <sup>3</sup>	260
<b>Totali</b>		<b>2,827</b>

Burimi: DTM, përpunoni KLSH.

Nga ana e inxhinierit të ndërtimit janë përcaktuar normativat e prodhimit të 1 m<sup>3</sup> beton të markave të ndryshme që po paraqiten si më poshtë:

Emërtimi	Koefficientet e përdorur		
	Rëre (m <sup>3</sup> )	Çakëll/Granil (m <sup>3</sup> )	Cimento (ton)
Beton M 150	0.51	0.81	0.29
Beton M 200	0.49	0.79	0.34
Beton M 250	0.47	0.77	0.38
<b>Beton C25/30 (M300)</b>	<b>0.43</b>	<b>0.73</b>	<b>0.388</b>

Beton M 370 A	0.45	0.55	0.44
---------------	------	------	------

Burimi: DTM, përpunoni KLSH.

Duke qenë se inspektori i kontrollit dhe inxhinieri nuk janë shprehur për normativën e prodhimit të betoni M300, do të bazohemi tek normativa e deklaruar sipas Manualit Nr.1 “Analiza Teknike” Për prodhimin e materialeve të ndërtimit, udhëzime e kritere, ku përcaktohet se për prodhimin e 1m<sup>3</sup> beton M300 do të nevojiten 0.43m<sup>3</sup> rërë, 0.73 m<sup>3</sup> çakëll dhe 0.388 ton çimento. Duke u nisur nga normativat e deklaruar si dhe sipas manualit të ndërtimit është kryer zbërthimi i sasive të matrialeve të nevojshme për prodhimin e sasive të betonit të deklaruar të shitura nga shoqëria:

Emërtimi	Njësia	Sasia e shitur (m <sup>3</sup> )	Rërë (m <sup>3</sup> )	Çakëll/Granil (m <sup>3</sup> )	Cimento (ton)
Beton 150	m <sup>3</sup>	109.5	55.8	88.7	31.8
Beton 200	m <sup>3</sup>	57.5	28.2	45.4	19.6
Beton 250	m <sup>3</sup>	936	439.9	720.7	355.7
Beton 300	m <sup>3</sup>	1,464	629.5	1,068.70	568
Beton 350	m <sup>3</sup>	260	117	143	114.4
<b>Totali</b>		<b>2,827</b>	<b>1,270.50</b>	<b>2,066.60</b>	<b>1,089.40</b>
<b>Lëndë të para të përdorura</b>			<b>2,391</b>	<b>2,448</b>	<b>1,289</b>
<b>Diferenca</b>			<b>1,120.54</b>	<b>381.44</b>	<b>199.58</b>
<b>Kosto sipas Inventarit të BK 2019</b>			<b>163 lek/m<sup>3</sup></b>	<b>600 lek/m<sup>3</sup></b>	<b>7016 lek/ton</b>
<b>Diferenca në vlerë</b>			<b>182,648</b>	<b>228,864</b>	<b>1,400,253</b>

Burimi: DTM, përpunoni KLSH.

Nga grupi i auditimi këto diferenca të konstatuara dhe të pajustificuara do të konsiderohen si shitje pafaturë dhe shitjet e tatueshme të shoqërisë për periudhën do të rivlerësohen duke u rritur në shumën prej **1,811,765** lekë. Për këto parregullësi të konstatuara do të kryhet penalizimi i subjektit sipas përcaktimeve të nenit 124 “Kundërvajtjet në lëshimin e faturave tatimore, dëftesave tatimore dhe dokumentimin e transaksioneve” të Ligjit Nr.9920 datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar dhe udhëzimit në zbatim të tij, shoqërisë i linden detyrimet si më poshtë:

Emërtimi	Vlera
Diferenca Totale	1,811,765
Detyrim TVSH (20%)	362,353
Gjobë TVSH (100%)	362,353
Detyrim TF (15%)	271,765
Gjobë TF (100%)	271,765
Tatimi Neto pas TF	1,540,000
Tatim mbi Dividentin (8%)	123,200
Gjobë Tatim Dividenti (100%)	123,200
<b>Total</b>	<b>1,514,636</b>

Burimi: DTM, përpunoni KLSH.

Nga sa më sipër janë sjellë si pasojë efekte tatimore të pallogaritura në shumën 271,765 lekë detyrime të tatimit mbi fitimin dhe 271,765 lekë gjobë 100%, 362,353 lekë detyrime të TVSH-së dhe 362,353 lekë gjobë 100%, 123,200 lekë detyrime të tatimit mbi dividendin dhe 123,200 lekë gjobë 100%, pra të ardhura gjithsej të munguar për buxhetin e shtetit në vlerën prej 1,514,636 lekë.

Nga grupi i auditimit, u kontrolluan çmimet e shitjes së të njëjësive ndërtimore apartamente, dyqane, parkim etj, tek objekti **“Kompleksi banimi X kate, me 1-3 kat pranë Kopshtit Botanik” në Selitë, Komuna Farkë, Tiranë**, dhe rezultuan shitje nën çmimin fiskal minimal të zonë 6, të përcaktuar në Aneksin Nr.1 dhe Nr.2 të VKM Nr.168, datë 27.3.2019. Konkretisht sipas Aneksit Nr.2 **“Çmimet mesatare referuese për metër katror sipërfaqe ndërtimi për vlerësimin e vlerës së taksueshme për ndërtime dhe ambiente jo-banimi”**, rezulton se: a) *Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi për veprimtari ekonomike tregtimi shërbimi është 1.5 (një pikë pesë) herë më i lartë se çmimi i sipërfaqeve të banimit sipas qyteteve. Në këtë kategori përfshihen edhe njësitë tregtare, ku njëkohësisht realizohen edhe procese të përziera prodhimi, tregtimi apo shërbimi me pakicë. Në zonat që përfshihen në Bashkinë Tiranë ky koeficient është 2 (dy) herë më i lartë.*

Struktura	Nr Njësi	Sip shitur m <sup>2</sup> total	Vlera	Çmimi mesatar	Çmim Z/6	Dif	Dif vlerë
Apartament	34	4,376	267,868,234	61,213	65,000	-3,787	16,571,912
Dyqane	1	389	36,776,870	94,615	130,000	-35,385	13,764,765
Parkim	3	263	7,798,362	29,618	45,500	-15,882	4,176,966
Të Tjera	-	-	-	-	-	-	-
<b>Total</b>	<b>38</b>	<b>5.028</b>	<b>312,443,466</b>				<b>34,513,643</b>

Burimi: DTM, përpunoni KLSH.

Në total shitje nën çmimin minimal fiskal të përcaktuar në VKM Nr.168, datë 27.3.2019, rezultuan **34,513,643 lekë**, ku nga grupi i auditimit është rivlerësuar situata financiare e shoqërisë duke rritur të ardhurat dhe penalizimin sipas përcaktimeve të nenit 128 **“Lëshimi i faturës së pasaktë”**, të Ligjit Nr.9920 datë 19.05.2008 **“Për procedurat tatimore në R.SH”**, i ndryshuar, ku përcaktohet qartë se: **“Tatimpaguesi, që lëshon faturë tatimore të pasaktë e që rezulton me ulje të detyrimit apo rritje të shumës për t’u rimbursuar, dënohet me gjobë të barabartë me 50 përqind të shumës së efektit në ulje të detyrimit tatimor, përveç detyrimeve tatimore dhe interesave të llogaritura në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të ligjeve specifike tatimore.**

Emërtimi	Vlera
Diferenca Totale	34,513,643
Detyrim TVSH (20%)	6,902,729
Gjobë TVSH (50%)	3,451,365
Detyrim TF (15%)	5,177,046
Gjobë TF (50%)	2,588,523
Tatimi Neto pas TF	29,336,597
Tatim mbi Dividentin (8%)	2,346,928
Gjobë Tatim Dividenti (50%)	1,173,464
<b>Totali</b>	<b>21,640,054</b>

Burimi: DTM, përpunoni KLSH.

Nga sa më sipër janë sjellë si pasojë efekte tatimore të pallogaritura në shumën 5,177,046 lekë detyrime të tatimit mbi fitimin dhe 2,588,523 lekë gjobë 50%, 6,902,729 lekë detyrime të TVSH-së dhe 3,451,365 lekë gjobë 50%, 2,346,928 lekë detyrime të tatimit mbi dividentin dhe 1,173,464 lekë gjobë 50%, pra të ardhura gjithsej të munguar për buxhetin e shtetit në vlerën prej 21,640,054 lekë.

Nga analiza e PASH, ka rezultuar se shoqëria ka njohur shpenzime financiare prej 7,026,420 lekë për vitin 2018 dhe 12,030,207 lekë për vitin 2019, me pretendimin se janë shpenzime të cilat kanë ardhur nga humbjet e shkaktuara nga kurset e këmbimit dhe nga ana e inspektorit të kontrollit nuk është bërë një analizë e detajuar e llogarive në valutë të huaj dhe diferencave të kursit të këmbimit që e kanë shkaktuar, por është mjaftuar se faktin se janë nxjerr nga sistemi informatik financiar **“Financa 5”** e subjektit.



**- Subjekti:** “R.M.” SHPK.

**Nipti:** L.K.

**Adresë Kryesore:** Ish Kaldaja Provizore Nr.4, Zona Kadastrale Nr.3965, Nr.Pasurie 481/3, pranë ndërmarrjes së seleksionimit të metaleve, ish Kombinati Metalurgjik, përgjatë rrugës Nacionale Elbasan-Peqin, Bradashesh, Elbasan.

**Aktiviteti:** Aktivitet në fushën minerare. Kërkim, zbulim, shfrytëzim sipërfaqësor dhe/ose nëntokësor të mineraleve të dobishme metalore dhe jo metalore (industriale), si dhe tregtim, import-eksport të mineraleve, ruajtjen, transportimin, përdorimin në sipërfaqe dhe në nëntokë të lëndëve e materialeve plasëse.

**Lloji i Kontrollit:** Kontroll i plotë.

**Inspektori:** G. P.

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

- Për **TVSH** - periudha tatimore nga: **01/2021-02/2022**.

- Për **Tatim Fitimin** periudha tatimore nga: **2020-2021**.

- Për **Sigurimet Shoqërore e Shëndetësorë** - periudha tatimore nga: **01/2021-02/2022**.

- Të Tjera periudha tatimore nga: **01/2021-02/2022**.

Nga auditimi i raportit të kontrollit tatimor u konstatua se:

Kontrolli pranë shoqërisë ka filluar në 20.06.2022 dhe në momentin e kontrollit, shoqëria “R. M.” SHPK, nuk ka ushtruar aktivitet tregtar për shkak të ndërprerjes përfundimtare të kontratave të sipërmarrjes me kontraktorin “B.” SHA dhe në datë 25.06.2022, shoqëria ka larguar nga listëpagesa të gjithë punonjësit e nëntokës (166 punëmarrës) dhe në liste pagesë rezultojnë vetëm administrata me gjithsej 9 punëmarrës.

Shoqëria zotëron:

- Leje Minerare Nr.6., datë 27.08.2001, për objektin minerar Munellë;

- Leje Minerare Nr.1., datë 07.02.2014, për objektin minerar Qafë-Bari;

- Leje për karrierë efuzive Nr.1., datë 13.03.2014;

- Autorizim për përdorim të lëndëve plasëse Nr.2278/5, datë 23.06.2014;

- Me kontratën noteriale “Marrëveshje nënkontraktimi, Miniera e Munellës”, me nr.4649.rep, nr.1536.kol, datë 01.11.2017, lidhur midis palëve “B.” SHA (kontraktori) dhe “R. M.” SHPK (nënkontraktori), është rënë dakord që “B.” SHA, ta nënkontraktojë proceset përkatëse të punës të përfshira në kontratë (nxjerrje minerali, transport minerali, përpunim minerali, hapje dhe shfrytëzim të minierës, karrierës së efuziveve Munellë, trajtim të efuzivit mbushës në impiantin e thyerjeve-fraksionizmit munellë, transportin nën-tokë të materialeve për mbushjen e hapësirave të shfrytëzimit), tek “R. M.” SHPK. Sipas kontratës nënshkruar midis palëve, shoqëria kontraktore angazhohet ti japë në përdorim shoqërisë nënkontraktore, të gjitha pajisjet si kamionë-vagonë me naftë, vinç, ashensor, kapanone etj, që shërbejnë për nxjerrjen e mineralit nga miniera. Nënkontraktori angazhohet për mirëmbajtjen me koston e tij të pajisjeve të dhëna në përdorim dhe dorëzimin e tyre në gjendje pune. Nënkontraktori detyrohet të zgjerojë dhe zhvillojë objektin minerar dhe ti faturojë situacionet e punimeve përkatëse të zgjerimit, kontraktorit.

- Me kontratën noteriale me nr.1523.rep, nr.458.kol, datë 27.03.2018, lidhur midis palëve “B.” SHA (kontraktori) dhe “R. M.” SHPK (nënkontraktori), është rënë dakort që “B.” SHA ta nënkontraktojë proceset përkatëse të punës të përfshira në kontratë (veprimtarinë minerare të përpunimit të xeherorit të bakrit Munellë, pranë fabrikës së pasurimit të bakrit Fushë-Arrëz), tek “R. M.” SHPK.



-Me kontratën noteriale “Marrëveshje nënkontraktimi, Miniera e Qafë-Barit”, me nr.916.rep, nr.274.kol, datë 25.02.2019, lidhur midis palëve “B.” SHA (kontraktori) dhe “R. M.” SHPK (nënkontraktori), është rënë dakort që “B.” SHA, ta nënkontraktojë proceset përkatëse të punës të përfshira në kontratë (nxjerrje minerali, transport minerali, përpunim minerali, hapje dhe shfrytëzim të minierës, karrierës së efuziveve Munellë, trajtim të efuzivit mbushës në impiantin e thyerjeve- fraksionizmit munellë, transportin nën-tokë të materialeve për mbushjen e hapësirave të shfrytëzimit), tek “R. M.”. Sipas kontratës nënshkruar midis palëve, shoqëria kontraktore angazhohet ti japë në përdorim shoqërisë nënkontraktore, të gjitha pajisjet si kamionë-vagonë me naftë, vinç, ashensor, kapanone etj, që shërbejnë për nxjerrjen e mineralit nga miniera. Nënkontraktori angazhohet për mirëmbajtjen me koston e tij të pajisjeve të dhëna në përdorim dhe dorëzimin e tyre në gjendje pune.

- Me shkresën Nr.1535/1.prot, datë 01.12.2017, “Përgjigje kërkesës suaj për miratim nënkontraktori”, të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, është miratuar nënkontraktimi i të drejtës minerare për Lejen Nr.643, datë 27.08.2001, nënkontraktimi i Lejes për karrierë efuzive Nr.1689, datë 13.03.2014, për shfrytëzimin e objektit mineralar Munellë, tek “R.M.” SHPK.

-Me shkresën nr.2865/1.prot, datë 23.07.2019, “Përgjigje kërkesës suaj për miratim nënkontraktori”, të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, është miratuar nënkontraktimi i të drejtës minerare për Lejen nr.1., datë 07.02.2014, për objektin mineralar Qafë-Bari, tek nënkontraktori “R. M.” SHPK. Pas miratimit të nënkontraktimit të lejeve minerare sa më sipër, shoqëria “R. M.” SHPK në muajin Janar 2018 ka filluar procesin e nxjerrjes së mineralit, zgjerimit dhe mirëmbajtjes së objekteve minerare. Shoqëria i faturon kontraktorit, shitjen e shërbimit të nxjerrjes së mineralit (pra minerali i nxjerrë është pronë e kontraktorit), shitjes së punimeve të zhvillimit dhe mirëmbajtjes së objektit mineralar si dhe transportit të mineralit për në fabrikën e përpunimit Fushë-Arrëz. Në bazë të volumit të mineralit të nxjerrë dhe punimeve të kryera në minierë, shoqëria harton situacion punimesh mujor dhe lëshon faturën tatimore përkatëse të shitjes. Plani i punës në objektin mineralar për llogari dhe nën juridiksionin e kontraktorit “B.” SHA, monitorohen dhe miratohen nga AKBN.

- Shoqëria nuk kryen transaksione në shitje me para në dorë e për këtë arsye nuk disponon pajisje fiskale.

- Nga kontrolli me përzgjedhje i veprimeve të arkës, nuk kanë rezultuar pagesa me para në dore mbi 150.000 lekë, me subjekte tregtare.

- Nga krahasimi i të dhënave sipas faturave tatimore të shitjes të regjistruara në librat e shitjes me të dhënat sipas FDP-ve të deklaruara nga ana e subjektit në SIT C@TS rezulton të mos ketë parregullësi.

- U bë krahasimi i të dhënave të raportuara për eksportet në SIT C@ts dhe kanë rezultuar diferenca më të dhënat e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe kanë rezultuar diferenca të cilat janë argumentuar nga ana e inspektorit të kontrollit.

- Nga krahasimi i të dhënave sipas faturave tatimore të blerjes të regjistruara në librat e blerjes me të dhënat sipas FDP-ve të deklaruara nga ana e subjektit në SIT C@TS rezulton të mos ketë diferenca.

- U bë krahasimi i të dhënave të raportuara për importet në SIT C@ts dhe kanë rezultuar diferenca më të dhënat e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe kanë rezultuar diferenca të cilat janë argumentuar nga ana e inspektorit të kontrollit.

- Është kryer analiza e blerjes së karburantit dhe TVSH së kredituar dhe ka rezultuar brenda normave të lejuara të përcaktuara në neni 55 të Udhëzimit Nr.6 datë 30.01.2015 "Për TVSH në R.SH", i ndryshuar.

- Është analizuar bilanci material ku ka rezultuar se materialet që disponohen gjendje janë kryesisht materiale të imta si kapsolle dinamiti, fitil, detonator, lëndë plasëse si dhe hekur për armaturë, antifrizë, çimento, karburant diezel, kavallota, vajra hidraulikë, etj të cilat përdoren për procesin e zgjerimit dhe zhvillimit të minierës si dhe për mirëmbajtjen e mjeteve të punës, pra jo për rishitje në kushtet në të cilat blihen, por të situacionuara në punimet mujore të minierës. Për këtë arsye dhe duke u nisur nga fakti se inventari i shoqërisë dhe volumet e punimeve janë të natyrës tërësisht teknike, nga kontrolli është vendosur të merret i mirëqenë inventari kontabël dhe bilanci material i materialeve të paraqitura nga vetë shoqëria.
- Është kryer kontrolli për tatimin mbi fitimin dhe elementët e pasqyrave financiare si aktive, pasive, kapitalin dhe PASH dhe nuk kanë rezultuar problematika.
- Është kryer kontrolli për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe TAP dhe nuk kanë rezultuar problematika.

**- Subjekti:** “G.” SHPK.

**Nipti:** K.O.

**Adresë Kryesore:** Tirana Internacional Hotel, Sheshi Skënderbej, Nr.8, Tiranë.

**Aktiviteti:** Import eksport dhe tregtim me shumicë e pakicë të mallrave të ndryshëm ushqimorë, industriale, elektroshtepiake, karburante, etj. Zhvillim i aktivitetit të hoteleri turizmit, agjenci turistike, agjenci transporti mallrash dhe pasagjerësh. Shoqëria kryen aktivitetin e saj në ambiente në pronësi të saj.

**Lloji i Kontrollit:** Kontroll i plotë.

**Inspektori:** T. F.

**Inxhinier:** I. K.

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

- Për **TVSH** - periudha tatimore nga: **10/2019-05/2021**.
- Për **Tatim Fitimin** periudha tatimore nga: **2019-2020**.
- Për **Sigurimet Shoqërore e Shëndetësorë** - periudha tatimore nga: **10/2019-05/2021**.
- Të tjera periudha tatimore nga: **10/2019-05/2021**.

Nga auditimi i raportit të kontrollit tatimor u konstatua se:

- Nga krahasimi i të dhënave sipas faturave tatimore të shitjes të regjistruara në librat e shitjes me të dhënat sipas FDP-ve të deklaruara nga ana e subjektit në SIT C@TS rezulton të mos ketë diferenca.
- U bë krahasimi i të dhënave të raportuara për eksportet në SIT C@ts dhe kanë rezultuar diferenca më të dhënat e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe kanë rezultuar diferenca të cilat janë argumentuar nga ana e inspektorit të kontrollit.
- Nga krahasimi i të dhënave sipas faturave tatimore të blerjes të regjistruara në librat e blerjes me të dhënat sipas FDP-ve të deklaruara nga ana e subjektit në SIT C@TS rezulton të mos ketë diferenca.
- U bë krahasimi i të dhënave të raportuara për importet në SIT C@ts dhe kanë rezultuar diferenca më të dhënat e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe kanë rezultuar diferenca të cilat janë argumentuar nga ana e inspektorit të kontrollit.
- Është kryer analiza e blerjes së karburantit dhe TVSH së kredituar dhe ka rezultuar brenda normave të lejuara të përcaktuara në neni 55 të Udhëzimit Nr.6 datë 30.01.2015 "Për TVSH në R.SH", i ndryshuar.
- Është kryer analiza e TVSH-së së paguar.
- Është kryer analiza e kostos së materialeve dhe punimeve të shoqërisë dhe nuk kanë rezultuar parregullësi.

- Nga ana e kontrollit tatimor në momentin e kontrollit me datë 03.09.2021 është kryer inventari fizik me zgjedhje për saktësimin e gjendjes së materialeve dhe mallrave, pasi për punimet e kryera, shoqëria në fund të çdo muaji përpilon situacionin e punimeve të ndërtimit dhe mbi bazën e tij lëshon faturën tatimore të shitjes, e cila regjistrohet në librin e shitjes dhe deklarohet në FDP-në përkatëse. Nga ana e kontrollit për ndërtimin e bilanceve materiale për disa artikuj të cilët u inventarizuan është përdorur inventari fizik i shoqërisë datë 18/11/2019 si datë fillimi për kontroll të TVSH-së si dhe inventarët e datave 31.12.2019 dhe 31.12.2020 si dhe inventari fizik i kryer nga ana inspektorit në fillim të kontrollit, pra më datë 03/09/2021. Për pjesën e aktivitetit të ndërtimit që kryen kompania për ndërtimin e bilancit material, nga ana e inxhinierit të kontrollit I. K. është mbajtur Akt Konstatimi datë 08/10/2021, për kryerje të verifikimit tatimore për ndërtimet e realizuar, harxhimin e materialeve të ndërtimit për periudhat e kontrolluara 18/11/2019-03/09/2021, dhe për diferencat që janë konstatuar është kryer penalizimi sipas legjislacionit në fuqi nga ana e inspektorese së kontrollit.
- Është kryer analiza dhe kontrolli i rregullimit të TVSH-së, në blerje për shkak të aktivitetit dhe shitjeve të përjashtuara që subjekti realizon.
- Është kryer kontrolli për tatimin mbi fitimin dhe elementët e pasqyrave financiare si aktive, pasive, kapitalin dhe PASH dhe nuk kanë rezultuar problematika.
- Është kryer kontrolli për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe TAP dhe nuk kanë rezultuar problematika.

**- Subjekti:** “4 .” SHPK.

**Nipti:** K.L.

**Adresë Kryesore:** Kodra e Diellit 2, Farkë, Kompleks Hotelerie me struktura 2, 3 dhe 5 kate, me dy kate nëntokë, Nr Pasurie 51/256.

**Aktiviteti:** Në fushën e ndërtimit, projektimin dhe zbatimin duke përfshirë por pa u kufizuar i veprave urbane, civile, industriale, arkitekturore, rrugore dhe hekurudhore, urave dhe veprave të artit. Punime elektrike, tregtim me shumicë e pakicë të materialeve elektrike, import eksportin e tyre, prodhim dhe tregtim betoni dhe inerte, tregtim me shumicë dhe me pakicë, import-eksport të artikujve të ndryshëm industrial, ushqimorë, elektroshtepiake, konfeksione, kozmetike.

**Lloji i Kontrollit:** Kontroll i plotë.

**Inspektori:** D. B.

**Inxhinier:** I. K.

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

- Për **TVSH** - periudha tatimore nga: **01/2020-04/2021**.
- Për **Tatim Fitimin** periudha tatimore nga: **2019-2020**.
- Për **Sigurimet Shoqërore e Shëndetësorë** - periudha tatimore nga: **01/2020-04/2021**.
- Të tjera periudha tatimore nga: **01/2020-04/2021**.

Nga auditimi i raportit të kontrollit tatimor u konstatua se:

- Nga krahasimi i të dhënave sipas faturave tatimore të shitjes të regjistruara në librat e shitjes me të dhënat sipas FDP-ve të deklaruara nga ana e subjektit në SIT C@TS rezulton të mos ketë diferenca.
- U bë krahasimi i të dhënave të raportuara për eksportet në SIT C@ts dhe kanë rezultuar diferenca më të dhënat e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe kanë rezultuar diferenca të cilat janë argumentuar nga ana e inspektorit të kontrollit.
- Nga krahasimi i të dhënave sipas faturave tatimore të blerjes të regjistruara në librat e blerjes me të dhënat sipas FDP-ve të deklaruara nga ana e subjektit në SIT C@TS rezulton të mos ketë diferenca.

- U bë krahasimi i të dhënave të raportuara për importet në SIT C@ts dhe kanë rezultuar diferenca më të dhënat e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe kanë rezultuar diferenca të cilat janë argumentuar nga ana e inspektorit të kontrollit.
- Është kryer analiza e blerjes së karburantit dhe TVSH së kredituar dhe ka rezultuar brenda normave të lejuara të përcaktuara në neni 55 të Udhëzimit Nr.6 datë 30.01.2015 "Për TVSH në R.SH", i ndryshuar.
- Mbi bazën inventarit fizik datë 31.12.2019 dhe 31.12.2020, të mbajtur dhe deklaruar sipas PF viti 2019 dhe 2020 nga shoqëria, faturave të blerjes, faturave të shitjes, kartelave të magazinës, zbërthimit të bazës materiale të harxhuar sipas akt-konstatimit datë 26.08.2021 të mbajtur nga inxhinieri, u hartua bilanci material, nga ku nuk rezultuan parregullësi.
- Është kryer analiza dhe rregullimi i TVSH-së, në blerje për shkak të punimeve të përjashtuara të rindërtimit që ka kryer.
- Është kryer kontrolli për tatimin mbi fitimin dhe elementët e pasqyrave financiare si aktive, pasive, kapitalin dhe PASH dhe nuk kanë rezultuar problematika.
- Është kryer kontrolli për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe TAP dhe nuk kanë rezultuar problematika.

**- Subjekti:** "A." SHPK.

**Nipti:** L.M.

**Adresë Kryesore:** Njësia Bashkiake Nr.11, Rruga Lord Bajron, banese private Nr.14, Tiranë.

**Aktiviteti:** Studimin, projektimin, sipërmarrjen zbatuese dhe/ose investimin, për realizimin me fonde publike dhe/ose jopublike të veprave publike dhe/ose private si: ndërtimin e ndërtesave publike dhe private, rrugëve, urave, tuneleve, mbikalimeve e nënkalimeve, autostradave, traseve hekurudhore, dhe të gjitha veprave të tjera madhore, ujësjellësve, linjave mbitokësore dhe nëntokësore për energjinë dhe telekomunikacionet, ndërtimin dhe rehabilitimin e veprave ujitëse, centralet, objektet turistike, objektet ushtarake, objektet e kultit, rrjetet inxhinierike, portet, aeroportet objektet industriale, të gjitha restaurimet në përgjithësi, rikonstruksione të veprave të artit, montimet e konstruksioneve metalike, në fushën e tregtisë shoqëria do të kryejë tregtimin dhe import-eksportin me shumicë e pakicë, të të gjitha mallrave me ose pa akcize, duke përfshirë por pa u kufizuar ne industriale, ushqimore, mjekësore, bujqësore, blegtorale, elektroshtepiake, të ndërtimit (hidrosanitare, elektrike, mobileri), të mjeteve kryesore dhe ndihmëse të prodhimit, të makinerive, të të gjitha mineraleve, të lëndës drusore, të lëndëve të para dhe të përpunuara për procesin e prodhimit etj.

**Lloji i Kontrollit:** Vizitë fiskale.

**Inspektori:** O. K.

**Inspektori:** D. B.

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

- Për **Sigurimet Shoqërore e Shëndetësore** - periudha tatimore nga: **01/2021-12/2021**.

- Të **TAP** nga: **01/2021-12/2021**.

**Objekt i kontrollit:** Kontroll të vet deklarimeve mbi nivelin e pagave, llogaritjen, mbajtjen dhe derdhjen e detyrimeve tatimore nga tatimpaguesit si dhe kontrollit në funksion të faktorëve të riskut nxjerre nga Njësia Speciale Anti Informalitet, ngritur me Urdhrin Nr.1, datë 05/01/2022 "Për ngritjen e Njesisë Speciale Anti Informalitet për të ardhurat nga punësimi dhe shërbimet".

Nga auditimi i raportit të kontrollit për vizitën fiskale është konstatuar se është kryer rivlerësim i listëpagesave për periudhën Janar 2021-Dhjetor 2021, duke rivlerësuar në rritje fondin e pagave me vlerën 6,772,412 lekë në lidhje me punonjësit me pagë minimale 30,000 lekë të cilët kanë punuar 26 ditë pune në muaj. Ky vlerësim tatimor është miratuar me Vendimin Nr.1537/2 prot.,

datë 27.04.2022 të Drejtorit Rajonal, në përputhje dhe zbatim të e Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 54, pika 5, gërma e) dhe neni 72, pika 1, gërma a), si dhe Udhëzimit të MFE Nr.24 datë 02.09.2008, i ndryshuar, pika 54.6, pika 71.2 dhe pika 72.1, mbështetur në propozimin e inspektorëve të kontrollit 13.04.2022. Në gjykimin e grupit të auditimit nuk janë konstatuar parregullësi në këtë raport kontrolli tatimor.

**- Subjekti:** “E.” SHPK.

**Nipti:** K.I.

**Adresë Kryesore:** Lagjia 14, Rruga Vëllazërimi, Kompleksi Euro-Business 2006, Durrës.

**Aktiviteti:** Import-eksport, tregtim me shumice e pakice artikuj të ndryshëm ushqimorë, elektronike. Shërbime bar-bufe, aktivitete argëtuese, zbavitje, bilardo etj.

**Lloji i Kontrollit:** Kontroll i plotë.

**Inspektori:** S. M.

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

- Për **TVSH** - periudha tatimore nga: **11/2019-10/2021**.

- Për **Tatim Fitimin** periudha tatimore nga: **2019-2020**.

- Për **Sigurimet Shoqërore e Shëndetësore** - periudha tatimore nga: **11/2019-10/2021**.

- Të Tjera periudha tatimore nga: **11/2019-10/2021**.

Nga auditimi i raportit të kontrollit tatimor, konkretisht në drejtim të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore sipas pikës së programit të kontrollit, kanë rezultuar problematikat si më poshtë:

*Nisur nga natyra e aktivitet të tregtisë kryesisht me pakicë që zhvillon shoqëria si dhe duke kontrolluar në faqen online të shoqërisë rezulton se aktiviteti zhvillohet çdo ditë **e hënë - e diel në oraret e përcaktuara 07:30-22:30**, të cilat në total përbëjnë 15 orë punë në ditë, pra dy turne. Kurse nga kontrolli i listëpagesave të deklaruara nga subjekti në sistemin C@ts për periudhën 11/2019-10/2021, ka deklaruar për punonjësit 22 ditë punë në muaj. Nga llogaritjet e grupit të auditimit rezulton se punonjësit punojnë më shumë se 22 ditë pune në muaj, nga rezulton se punohet edhe të ditë të shtune dhe të diele, ku sipas përcaktimeve të neni 87 të Kodit të Punës duhet që pagesa orare të jetë minimalisht 25% më e lartë se pagesa minimale orare, gjithashtu punohet edhe në turn të dytë në fashën orare 19:30-22:30, për të cilën paga orare duhet të jetë 20% më e lartë se pagesa minimale orare sipas përcaktimeve të neni 81 të Kodit të punës.*

*- Nga ana e inspektorit të kontrollit tatimor nuk janë analizuar kontratat individuale të punës midis shoqërisë dhe punonjësve, në lidhje me përputhshmërinë e tyre me përcaktimet e dispozitave të Kodit të Punës në R.SH.*

*- Nuk janë analizuar regjistrat që duhet të mbajë tatimpaguesi sipas përcaktimeve të nenit 15 “Mbajtja e regjistrimeve” të Ligjit Nr.9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.*

*- Nuk ka një analizë të llogaritjes së pagës dhe elementëve përbërës të saj sipas përcaktimeve të dispozitave të nenit 119 të Kreut XI të Kodit të Punës në R.SH.*

*- Nuk janë analizuar regjistrat që duhet të mbajë tatimpaguesi sipas përcaktimeve të nenit 15 “Mbajtja e regjistrimeve” të Ligjit Nr.9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.*

*- Nuk ka një analizë të llogaritjes së pagës dhe elementëve përbërës të saj sipas përcaktimeve të dispozitave të nenit 119 të Kreut XI të Kodit të Punës në R.SH.*

Në lidhje me situatën e trajtuar më sipër grupi i audituesve gjykon se janë arsye themelore për të kryer rivlerësimin e pagave, kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi, për punonjësit me paga të deklaruara jo konform përcaktimeve të

legjislacionit, në lidhje me këtë tatimpagues i cili ka plotësuar deklarata tatimore që përmbajnë të dhëna të pasakta ose të falsifikuara dhe nuk mban dhe ruan llogari apo regjistrime të sakta të transaksioneve, veprime të cilat janë në kundërshtim me gërmën b, c të nenit 71, gërma a e nenit 72 të Ligjit Nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave Nr.24 date 02.09.2008, i ndryshuar në zbatim të tij, ku përcaktohet se:

Neni 71 “E drejta për të përdorur mënyra alternative vlerësimi” i Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, konkretisht pika:

**b) deklarata tatimore përmban të dhëna të pasakta ose të falsifikuara;**

**c) tatimpaguesi nuk mban ose ruan llogari apo regjistrime të sakta të transaksioneve;**

Neni 72 “Baza e mënyrave alternative të vlerësimit”:

1. Mënyrat alternative të vlerësimit nuk kufizohen, por bazohen në:

**a) të dhëna të drejtpërdrejta, që gjenden në deklaratat tatimore ose në dokumentet apo në një informacion tjetër, dhënë nga tatimpaguesi;**

Muaj	Nr pun	Paga Bruto	Paga Rivlerësuar	Diferenca	Sig Sh PDH (15%)	Sig Sh PM (9.5%)	Sig Sh PDH (1.7%)	Sig Sh PM (1.7%)	TAP (13%)	Paga Neto
Nëntor 2019	91	2,414,000	2,813,538	399,538	59,931	37,956	6,792	6,792	10,860	343,930
Dhjetor 2019	87	2,307,796	2,689,866	382,070	57,311	36,297	6,495	6,495	10,383	328,896
Janar 2020	78	2,072,000	2,411,604	339,604	50,941	32,262	5,773	5,773	9,309	292,260
Shkurt 2020	76	2,014,117	2,349,768	335,651	50,348	31,887	5,706	5,706	9,070	288,988
Mars 2020	72	1,904,198	2,226,096	321,898	48,285	30,580	5,472	5,472	8,592	277,253
Prill 2020	75	1,988,818	2,318,850	330,032	49,505	31,353	5,611	5,611	8,951	284,118
Maj 2020	80	2,189,261	2,473,440	284,179	42,627	26,997	4,831	4,831	9,547	242,804
Qershor 2020	84	2,296,003	2,597,112	301,109	45,166	28,605	5,119	5,119	7,712	190,273
Korrik 2020	90	2,465,133	2,782,620	317,487	47,623	30,161	5,397	5,397	10,741	271,188
Gusht 2020	97	2,653,295	2,999,046	345,751	51,863	32,846	5,878	5,878	11,576	295,451
Shtator 2020	100	2,732,322	3,091,800	359,478	53,922	34,150	6,111	6,111	11,934	307,282
Tetor 2020	64	1,808,192	1,978,752	170,560	25,584	16,203	2,900	2,900	7,638	143,820
Nëntor 2020	65	1,818,404	2,009,670	191,266	28,690	18,170	3,252	3,252	7,757	162,087
Dhjetor 2020	68	1,916,648	2,102,424	185,776	27,866	17,649	3,158	3,158	8,115	156,854
Janar 2021	98	3,067,257	3,538,290	471,033	70,655	44,748	8,008	8,008	60,171	358,107
Shkurt 2021	99	3,088,660	3,574,395	485,735	72,860	46,145	8,257	8,257	61,107	370,226
Mars 2021	97	3,034,898	3,502,185	467,287	70,093	44,392	7,944	7,944	59,125	355,826
Prill 2020	93	2,938,440	3,357,765	419,325	62,899	39,836	7,129	7,129	56,427	315,933
Maj 2020	94	2,970,440	3,393,870	423,430	63,515	40,226	7,198	7,198	55,046	320,960
Qershor 2020	71	2,367,617	2,563,455	195,838	29,376	18,605	3,329	3,329	25,459	148,445
Korrik 2020	18	603,226	649,890	46,664	7,000	4,433	793	793	6,066	35,371
Gusht 2020	26	855,427	938,730	83,303	12,495	7,914	1,416	1,416	9,913	64,060
Shtator 2020	21	709,400	758,205	48,805	7,321	4,636	830	830	6,345	36,994
Tetor 2020	25	851,944	902,625	50,681	7,602	4,815	862	862	6,589	38,416
<b>Total</b>		<b>51,067,496</b>	<b>58,023,996</b>	<b>6,956,500</b>	<b>1,043,475</b>	<b>660,867</b>	<b>118,261</b>	<b>118,261</b>	<b>547,831</b>	<b>5,629,541</b>

Burimi: DTM, përpunoni KLSH.

Nr	Emërtimi	Vlera
1	Paga Bruto	51,067,496
2	Paga Bruto Rivlerësuar	58,023,996
3	Diferenca Paga Bruto	6,956,500
<b>4</b>	<b>Diferenca Paga Neto</b>	<b>5,629,541</b>
5	Diferenca Sig Shoq Punëmarrësi (9.5%)	660,867
6	Diferenca Sig Shënd Punëmarrësi (1.7%)	118,261
<b>7</b>	<b>Diferenca Sig Shoq Punëdhënësi (15%)</b>	<b>1,043,475</b>
<b>8</b>	<b>Diferenca Sig Shënd Punëdhënësi (1.7%)</b>	<b>118,261</b>
9	Diferenca TAP (13%)	547,831
<b>10</b>	<b>Rivlerësim i shpenzimeve të padeklaruar nga subjekti [(4)+(7)+(8)]</b>	<b>6,791,277</b>

Burimi: DTM, përpunoni KLSH.

Penalizmi i subjektit duhet të ishte bërë sipas llogaritjeve të mëposhtme në bazë të pikës 3 të nenit 119 “Mosdeklarimi i punonjësve dhe fshehja e pagës” të Ligjit Nr.9920 datë 19.05.2008

“Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar, ku përcaktohet qartë se: “Nëse nga verifikimi dhe kontrolli rezulton se tatimpaguesi ka fshehur dhe nuk ka deklaruar pagën e saktë të përfutur nga punëmarrësi, si rezultat i marrëdhënies së punësimit, tatimpaguesi-punëdhënës, përveç detyrimit për pagimin e shumës së detyrimit tatimor dhe kontributit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, të llogaritur për gjithë periudhën që provohet se është kryer shkelja, dënohet me gjobë në masën 100 për qind të detyrimit dhe kontributit të llogaritur”.

<b>Emërtimi</b>	<b>Vlera</b>
Sig Shoq Punëdhënësi (15%)	1,043,475
Gjobë Sig Shoq Punëdhënësi (100%)	1,043,475
Sig Shoq Punëmarrësi (9.5%)	660,867
Gjobë Sig Shoq Punëmarrësi (100%)	660,867
Sig Shënd Punëdhënësi (1.7%)	118,261
Gjobë Sig Shënd Punëdhënësi (100%)	118,261
Sig Shënd Punëmarrësi (1.7%)	118,261
Gjobë Sig Shënd Punëmarrësi (100%)	118,261
TAP (13%)	547,831
Gjobë TAP (100%)	547,831
<b>Detyrime Total</b>	<b>4,977,388</b>

Burimi: DTM, përpunoni KLSH.

Nga sa më sipër janë sjellë si pasojë efekte tatimore të pallogaritura në shumën 1,043,475 lekë detyrime të Sig Shoq Punëdhënësi dhe 1,043,475 lekë gjobë 100%, 660,867 lekë detyrime të Sig Shoq Punëmarrësi dhe 660,867 lekë gjobë 100%, 118,261 lekë detyrime Sig Shënd Punëdhënësi dhe 118,261 lekë gjobë 100%, 118,261 lekë detyrime Sig Shënd Punëmarrësi dhe 118,261 lekë gjobë 100%, 547,831 lekë detyrime TAP dhe 547,831 lekë gjobë 100%, pra të ardhura gjithsej të munguar për buxhetin e shtetit në vlerën prej 4,977,388 lekë.

Në lidhje me pagat e padeklaruara saktë nga ana e subjektit do të kryhet rivlerësimi i situatës financiare të subjektit, ku shpenzimi i fondit të pagave të rivlerësuara do të rikarakterizohet si e ardhura dhe do të kryhet penalizimi i subjektit sipas përcaktimeve të nenit 115 “Plotësim i pasaktë i deklaratës tatimore”, të Ligjit Nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar, ku përcaktohet qartë se: “Dorëzimi i një deklarate tatimore të pasaktë dënohet me një gjobë të barabartë me 0,06 për qind të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë, gjatë së cilës pagesa nuk është kryer. Në asnjë rast, gjopa nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike”.

<b>Emërtimi</b>	<b>Vlera</b>
Rivlerësim i shpenzimeve ( <b>Paga Neto + Sig Shoq &amp; Sig Shënd Punëdhënësi</b> )	6,791,277
TVSH (20%)	1,358,255
Gjobë TVSH (21.9%)	297,458
Tatim Fitimi (15%)	1,018,692
Gjobë Tatim Fitimi (21.9%)	223,093
Tatimi Neto pas TF	5,772,585
Tatim mbi Dividentin (8%)	461,807
Gjobë Tatim Dividenti (21.9%)	101,136
<b>Detyrime Total</b>	<b>3,460,441</b>

Burimi: DTM, përpunoni KLSH.

Nga sa më sipër janë sjellë si pasojë efekte tatimore të pallogaritura në shumën 1,018,692 lekë detyrime të tatimit mbi fitimin dhe 223,093 lekë gjobë 21.9%, 1,358,255 lekë detyrime të TVSH-së dhe 297,458 lekë gjobë 21.9%, detyrime të tatimit mbi dividendin 461,807 lekë dhe 101,136 lekë gjobë 21.9%, pra të ardhura gjithsej të munguar për buxhetin e shtetit në vlerën prej 3,460,441 lekë.

Nga kontrolli i blerjeve për periudhën objekt kontrolli, ka rezultuar se shoqëria ka bërë blerje karburanti për të cilën ka kredituar edhe TVSH në blerje, konkretisht si më poshtë:

Viti	Shitësit	Rrethi	NIPT	Vlera e tatueshme për blerje nga furnitorët vendas	TVSH për blerje nga fermerët vendas	Përshkrimi
2019	A. P.	Durrës	L.N	275,000	55,000	Karburant
2020	A. P.	Durrës	L.N	862,502	172,500	Karburant
2020	K.	Durrës	J.P	811,680	162,336	Karburant
2021	A. P.	Durrës	L.N	61,250	12250	Karburant
2021	K.	Durrës	J.P	2,987,491	597,498	Karburant
<b>Totali</b>				<b>4,997,923</b>	<b>999,584</b>	

Burimi: DTM, përpunoni KLSH.

Në raportin e kontrollit tatimor nga ana e inspektore nuk është kryer një analizë e detajuar e shfrytëzimit të mjeteve të transportit, rrugët e realizuara, normativat e konsumit për rrugë, proces pune ose volum punimesh etj, veprime këto në kundërshtim me përcaktimet e nenit 55 “Kufizime të zbritjes së TVSH për disa furnizime” të Udhëzimit Nr.6, datë 30.01.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në R.SH”:

*Shpenzimet faktike për gazoilin për çdo veprimtari ekonomike duhet të justifikohen me volumin e punës së kryer, rrugët e realizuara nga mjete/et, normativat e konsumit të gazoilit për rrugë ose proces të kryer, etj. Në çdo rast, këto shpenzime duhet të jenë të kryera realisht dhe të justifikuara sipas veprimeve të realizuara për nevoja të veprimtarisë ekonomike, të provuara me dokumentacionin përkatës, por jo më shumë se normativat e përcaktuara në këtë udhëzim.*

Nga kontrolli i inventarit të makinave, të paraqitura në anekse të bilanceve të viteve 2019-2021, ka rezultuar se shoqëria ka në pronësi, 8 automjete të cilat po paraqiten si më poshtë. Në kushtet e mungesës së të dhënave dhe regjistrimeve mbi konsumin dhe harxhimin e karburantit nga ana e auto veturave dhe mjeteve të punës, do të supozohet se kanë konsum të barabartë të çdo mjete.

Nr	Lloji i mjetit	Tipi/Markë	Targë	Rivlerësim për konsumin e karburantit	
				VI Tat	TVSH
1	ATP	MERCEDES BENZ	A.U	624,740	124,948
2	<b>AUTOVETURE</b>	<b>MERCEDES BENZ</b>	<b>A.D</b>	<b>624,740</b>	<b>124,948</b>
3	<b>AUTOVETURE</b>	<b>MERCEDES BENZ</b>	<b>A.M</b>	<b>624,740</b>	<b>124,948</b>
4	ATV	RENAULT MIDLUM	A.F	624,740	124,948
5	<b>AUTOVETURE</b>	<b>FORD FUSION</b>	<b>A.T</b>	<b>624,740</b>	<b>124,948</b>
6	ATP	IVECO FIAT	A.T	624,740	124,948
7	<b>AUTOVETURE</b>	<b>OPEL</b>	<b>A.S</b>	<b>624,740</b>	<b>124,948</b>
8	<b>AUTOVETURE</b>	<b>VOLKSVAGEN</b>	<b>A.K</b>	<b>624,740</b>	<b>124,948</b>

Burimi: DTM, përpunoni KLSH.



Pra figurojnë 5 auto vetura të shoqërisë, për të cilat inspektori i kontrollit duhet të kishte kryer verifikimet n.q.s. janë furnizuar me karburant nga shoqëria për të cilin është bërë kreditimi i TVSH në blerje, veprime këto të cilat janë në kundërshtim me përcaktimet ligjore të nenit 74 “Kufizimet e së drejtës së zbritjes” të Ligjit Nr.92/2014 “Për TVSH-në, në Republikën e Shqipërisë”:

*Përfshihen nga e drejta e zbritjes së TVSH-së shpenzimet për blerjen, importin e mallrave, shpenzimet për shërbimet si më poshtë:*

**b) shpenzimet e karburantit të çdo lloji, i përdorur për auto veturat;**

Gjithashtu duhet të ishte kryer penalizimi i subjektit sipas përcaktimeve të nenit 115 “Plotësim i pasaktë i deklaratës tatimore” të Ligjit Nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: *“Tatimpaguesi, i cili nuk arrin që, brenda afatit të parashikuar në këtë ligj për pagesë, të paguajë shumën e detyrimit tatimor e të kontributit, detyrohet të paguajë një gjobë, të barabartë me 0,06 për qind të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë, gjatë së cilës pagesa nuk është kryer. Në asnjë rast, gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike”.*

Emërtimi	Vlerë
Ulje e tepicës kreditore të TVSH-së	624,740
Gjobë TVSH (21.9%)	136,818
<b>Total</b>	<b>761,558</b>

Burimi: DTM, përpunoni KLSH.

Nga sa më sipër janë sjellë si pasojë efekte tatimore të pallogaritura në shumën 624,740 lekë ulje e tepicës kreditore të TVSH-së dhe 136,818 lekë gjobë, pra të ardhura gjithsej të munguar për buxhetin e shtetit në vlerën prej 761,558 lekë. Nga auditimi i raportit të kontrollit tatimor është konstatuar se nga ana e inspektorit nuk është kryer një analizë e ambienteve të marra me qera nga ana e shoqërisë për të verifikuar nga janë konform përcaktimeve të Vendimit Nr. 469, datë 3.6.2015 “Për përcaktimin e vlerës minimale të çmimit të referencave të qirave të ndërtesave për qëllime tatimore”.

**- Subjekti:** “Gj. K.” SHA.

**Nipti:** J.U.

**Adresë Kryesore:** Njësia 5, Rruga "Dora D'Istria", Tiranë.

**Aktiviteti:** Ndërtime të ndryshme civile si rrugë, autostrada, diga e tunele, ujësjellësa e gazsjellëse, nënstacione e kabina, linja të tensionit lartë e të mesëm, punime të inxhinierisë së mjedisit, punime prishje ndërtimesh. Punime hidrosanitare e të sinjalistikës rrugore. Barriera e mbrojtje rrugore. Linja telefonike e radiofoni. Impiante të ujit të pijshëm dhe pastrimit të tij. Punime topogjeodezike etj. Prodhim dhe tregtim i materialeve të ndryshme inerte. Punime gërmimi, sistemimi e tarracimi. Organizim i rojeve private, transporte mallrash të të gjitha llojeve, import e eksport i karburanteve e lëndëve të tjera djegëse, ngritje e ambienteve shplohëse e argëtuese, servise e lavazho të të gjitha llojeve, bare e restorante, salla pishinash e palestere, Rikonstruksione të të gjitha llojeve etj.

**Lloji i Kontrollit:** Kontroll i plotë.

**Inspektori:** A. H..

**Inxhinier:** I. K.

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

- Për TVSH - periudha tatimore nga: **06/2016-05/2021.**

- Për Tatim Fitimin periudha tatimore nga: **2016-2020.**

- Për Sigurimet Shoqërore e Shëndetësorë - periudha tatimore nga: **06/2016-05/2021.**

- Të Tjera periudha tatimore nga: **06/2016-05/2021**.

Nga auditimi i raport kontrollit tatimor dhe akt verifikimit të mbajtur për subjektin “G. K.” SHA, nga ana e inspektorit dhe inxhinierit pranë DTM, rezulton se subjekti përgjatë kësaj periudhe, është i angazhuar në 44 kontrata pune ndërtimore, me autoritete publike, subjekte private si dhe punime për veten. Nga kontrolli i mëtejshëm, janë konstatuar mungesa e analizave dhe vlerësimeve të projektit dhe preventivit të punimeve, nuk është kryer një zbërthim i matrialeve dhe lëndës së parë në përbërje të punimeve të situacionuar, bazuar në manualin nr.1 “Analiza Teknike-Për prodhimin e matrialeve të ndërtimit, udhëzime dhe kritere” dhe manualin nr.2 “Analiza Teknike-Për punimet e ndërtimit të ndërtesave”, si dhe krahasimi me punimet e kryera realisht në terren. Gjithashtu janë konstatuar mungesa e analizave të librezës së masave, situacioneve pjesore mujore, progresive dhe përfundimtare të volumit të punimeve të ndërtimit, të cilat janë dokumenta justifikuese për verifikimin e volumit të punimeve të kryera sipas përcaktimeve të nënpikave 3.2 dhe 3.3 të pikës 3, Kreu 1 të Udhëzimit Nr.3, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, ndryshuar me Udhëzimin Nr.1 datë, 16.06.2011, konkretisht:

*3.2 Libreza e masave për punimet e ndërtimit është dokumentacioni bazë për verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve të ndërtimit, të vendosura në situacion. Kjo librezë hartohet nga drejtuesi teknik i objektit dhe firmoset nga ai, nga mbikëqyrësi i punimeve dhe nga përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit, për të cilin është miratuar leja e ndërtimit.*

*3.3 Situacionet mujore pjesore, progresive dhe përfundimtare hartohen mbi bazën e volumeve të llogaritura në librezën e masave dhe çmimeve faktike, mbështetur në analizat teknike të çmimeve, që përfshihen në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit, të miratuara çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave. Ato firmosen nga drejtuesi teknik i objektit, mbikëqyrësi i punimeve dhe përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit për të cilin është miratuar leja e ndërtimit. Në rastet kur në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit mungojnë analizat teknike të çmimeve të zërave të punimeve të kryera në objekt, veprohet në përputhje me procedurën e përcaktuar në pikën 8 të vendimit nr.514, datë 15.8.2007 të Këshillit të Ministrave "Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit".*

Nga auditimi i raportit të kontrollit tatimor të hartuar nga inspektori i kontrollit janë konstatuar mangësi procedurale në trajtimin dhe analizimin e thelluar të pikave të programit të kontrollit tatimor, kryesisht në lidhje me trajtimin e blerjeve të realizuara nga shoqëria (blerje të përjashtuara, importe me shkallë TVSH 20%, importe të investimit me shkallë 20%, blerje brenda vendit me shkallë TVSH 20%, investime nga furnitorë vendas me shkallë 20%), të cilat janë trajtuar në mënyrë sintetike pa kryer një analizë të detajuar sipas furnitorëve dhe përshkrimit të artikujve (*shërbime dhe produkte/materiale*). Veprime këto të cilat janë në kundërshtim me përcaktimet e Kapitullit VII “Kryerja e kontrollit tatimor” të Manualit të Kontrollit Tatimor, konkretisht:

*- Blerjet nga importi dhe rakordimet në sasi dhe natyrë mallrash në përputhje me nevojën dhe natyrën e aktivitetit, paraqitja e tyre për secilën periudhë (vit) në një pasqyrë, rakordimi me deklaratimet dhe mbajtja e proces-verbaleve në rastet e mosrakordimeve,*

*- Regjistrimi në mënyrë kronologjike i blerjeve dhe kontrolli i deklaratimeve mbi përputhshmërinë, përshkrimi i blerjeve sipas faturave të ndarë sipas zërave (mallra, materialë, lëndë të para, shërbime, blerje shërbime nga të tretë, etj sipas konstatimeve në fakt (importi dhe vendi).*

*- Krahasimi i importeve të bëra me rakordimin e të dhënave të marra nga Dogana.*

Nga kontrolli i shitjeve të vitit 2020 dhe 2021, sipas raport kontrolli inspektori është shprehur se shitjet e përjashtuara kanë qenë në vlerat 74,211,182 lekë dhe 106,011,282 lekë, kundrejt FSHZH-së, sipas situacionit të punimeve për “Ndërtimin e rrjetit rrugor dhe infrastrukturës urbane të Zonës Nr.1, Njësia Administrative Bubq” (për të cilin nuk ka analizë në raport

kontroll), janë të përjashtuara në bazë të Autorizimit Nr.250 datë 20.11.2020, prot 21978/1 ”Përjashtim nga TVSH-ja për subjektet e rindërtimit”. Inspektori citon se punimet e kryera për rindërtimin janë kryer 100% me nënkontraktor, këto janë blerje pa TVSH dhe shitje të përjashtuara, por nga auditimi i raport kontrollit tatimor i blerjeve nga nënkontraktoret, nuk janë të paraqitura blerje të përjashtuara për procesin e rindërtimit.

Viti	Blerësi	NIPT	Përshkrimi	Vlera pa TVSH
2020	FSHZH	J.W	Situac punimesh rindërtimi	74,211,182
2021	FSHZH	J.W	Situac punimesh rindërtimi	106,011,282
<b>Totali</b>				<b>180,222,464</b>

Burimi: DTM, përpunoni KLSH.

Nga auditimi i raportit të kontrollit tatimor, konkretisht i lëvizjes së bilancit material dhe akt konstatimit të mbajtur nga inxhinierit për zberthimin e bazës materiale, kanë rezultuar diferenca të pajustificuara, të cilat po paraqiten në mënyrë të detajuar si më poshtë:

Nr	Emërtimi	Njësia	Gjendje 01.08.16	Hyrjet 08-12 2016	Daljet 08-12 2016	Dalje Inxhinieri	Diferenca
1	Beton 100	m <sup>3</sup>	0	8	8	628	(620)
2	Beton 150	m <sup>3</sup>	0	22	22	8,925	(8,903)
3	Beton 200	m <sup>3</sup>	0	485.5	485.5	2,510	(2,025)
4	Beton 250	m <sup>3</sup>	0	74	74	28,352	(28,278)
5	Cimento	ton	4	19,336	19,340	2,823	16,517
6	Zhavorr	m <sup>3</sup>	0	16,589	16,589	16,565	24
7	Granil	m <sup>3</sup>	0	148	148	1356	(1,208)
8	Çakull	m <sup>3</sup>	0	1,076	1,076	250	826
9	<b>Bitum</b>	<b>ton</b>	<b>0</b>	<b>165</b>	<b>165</b>	-	-
10	<b>Nafte</b>	<b>litra</b>	<b>15,223</b>	<b>1,503,076</b>	<b>1,515,282</b>	-	-
11	<b>Solar</b>	<b>Kg</b>	<b>0</b>	<b>25,710</b>	<b>25,710</b>	-	-
12	<b>Emulsion-praimer</b>	<b>Kg</b>	<b>0</b>	<b>10,460</b>	<b>10,460</b>	-	-

Burimi: DTM, përpunoni KLSH.

Nr	Emërtimi	Njësia	Gjendje 01.01.17	Hyrjet 2017	Daljet 2017	Dalje Inxhinieri	Diferenca
1	Beton 150	m <sup>3</sup>	0	459	459	8,459	(8,001)
2	Beton 200	m <sup>3</sup>	0	1,210	1,210	7,381	(6,172)
3	Beton 250	m <sup>3</sup>	0	527	527	45,929	(45,402)
4	Beton 300	m <sup>3</sup>	0	110	110	12,738	(12,628)
5	Cimento	ton	0	50,342	50,342	14,395	35,947
6	Asfalt Binder	ton	0	5,144	5,144	6,866	(1,722)
7	Stabilizant	m <sup>3</sup>	0	17,019	17,019	17,307	(288)
8	Granil	m <sup>3</sup>	0	696	696	7,552	(6,856)
9	<b>Bitum</b>	<b>ton</b>	<b>0</b>	<b>633,175</b>	<b>633,175</b>	-	-
10	<b>Nafte</b>	<b>litra</b>	<b>3,017</b>	<b>4,763,501</b>	<b>4,754,088</b>	-	-
11	<b>Solar</b>	<b>Kg</b>	<b>0</b>	<b>118,956</b>	<b>118,956</b>	-	-

Burimi: DTM, përpunoni KLSH.

Nr	Emërtimi	Njësia	Gjendje 01.01.18	Hyrjet 2018	Daljet 2018	Dalje Inxhinieri	Diferenca
1	Cimento	ton	0	28,328	28,328	10,291	18,037
2	Rërë	m <sup>3</sup>	0	602	602	9,589	(8,987)
3	Stabilizant	m <sup>3</sup>	0	345	345	1,636	(1,291)
4	Granil	m <sup>3</sup>	0	1,326	1,326	5,245	(3,919)
5	Çakull	m <sup>3</sup>	0	4,000	4,000	5,005	(1,005)
6	<b>Bitum</b>	<b>ton</b>	<b>0</b>	<b>324,560</b>	<b>324,560</b>	-	-
7	<b>Nafte</b>	<b>litra</b>	<b>12,430</b>	<b>6,577,986</b>	<b>6,582,016</b>	-	-
8	<b>Solar</b>	<b>Kg</b>	<b>0</b>	<b>13,220</b>	<b>13,220</b>	-	-

Burimi: DTM, përpunoni KLSH.

Për vitin 2018 nga ana e inspektorit të kontrollit nuk është kryer bilanci i lëvizjes materiale për materiale të rëndësishme si betoni, asfalte etj edhe pse është kryer zbërthimi nga ana e inxhinierit, konkretisht paraqitur si më poshtë:

Nr	Emërtimi	Njësia	Gjendje 01.01.18	Hyrjet 2018	Daljet 2018	Dalje Inxhinier	Gjendje Kontabël 31.12.2018	Gjendje Fizike 31.12.2018
1	Beton 100	m <sup>3</sup>				595		
2	Beton 150	m <sup>3</sup>				904		
3	Beton 200	m <sup>3</sup>				1,671		
4	Beton 250	m <sup>3</sup>				12,399		
5	Beton 300	m <sup>3</sup>				3,775		
6	Beton 350	m <sup>3</sup>				19		
7	Beton 370	m <sup>3</sup>				3,169		
8	Torkrit	m <sup>3</sup>				23,648		
9	Asfalt Baze	ton				243		
10	Asfalt Binder	ton				3,848		
11	Asfalt Tapet	ton				1,986		
12	Zhavorr	m <sup>3</sup>				5,645		
13	Gure	m <sup>3</sup>				1,956		

Burimi: DTM, përpunoni KLSH.

Nr	Emërtimi	Njësia	Gjendje 01.01.19	Hyrjet 2019	Daljet 2019	Dalje Inxhinieri	Diferenca
1	Beton 200	m <sup>3</sup>	0	5	5	216	(211)
2	Cimento	ton	0	42342	42342	7207	35,135
3	Rërë	m <sup>3</sup>	0	12	12	721	(709)
4	Stabilizant	m <sup>3</sup>	0	1	1	237	(236)
5	<b>Nafte</b>	<b>litra</b>	<b>8,400</b>	<b>12,095,081</b>	<b>12,095,981</b>	-	-

Burimi: DTM, përpunoni KLSH.

Për vitin 2019 nga ana e inspektorit të kontrollit nuk është kryer bilanci i lëvizjes materiale për materiale të rëndësishme si betoni, asfalte, granil, gur, çakull, zhavorr etj edhe pse është kryer zbërthimi nga ana e inxhinierit, konkretisht paraqitur si mëposhtë:

Nr	Emërtimi	Njësia	Gjendje 01.01.19	Hyrjet 2019	Daljet 2019	Dalje Inxhinieri	Gjendje Kontabël 31.12.2019	Gjendje Fizike 31.12.2019
1	Beton 100	m <sup>3</sup>				53		
2	Beton 150	m <sup>3</sup>				1,404		
4	Beton 250	m <sup>3</sup>				5,782.5		
5	Beton 300	m <sup>3</sup>				10,201.5		
6	Beton 370	m <sup>3</sup>				35,436		
7	Torkrit	m <sup>3</sup>				20,517		
8	Gur	m <sup>3</sup>				560		
9	Granil	m <sup>3</sup>				178		
10	Çakull	m <sup>3</sup>				11,268		
11	Asfalt Binder	ton				80		
12	Asfalt Tapet	ton				792		
13	Zhavorr	m <sup>3</sup>				4,937		

Burimi: DTM, përpunoni KLSH.

Nr	Emërtimi	Njësia	Gjendje 01.01.20	Hyrjet 2020	Daljet 2020	Dalje Inxhinieri	Diferenca
1	Cimento	ton	0	43,799	43,799	14,410	29,389
2	<b>Nafte</b>	<b>litra</b>	<b>7,500</b>	<b>13,288,460</b>	<b>13,284,470</b>	-	-

Burimi: DTM, përpunoni KLSH.

Për vitin 2020 nga ana e inspektorit të kontrollit nuk është kryer bilanci i lëvizjes materiale për materiale të rëndësishme si betoni, asfalte etj edhe pse është kryer zbërthimi nga ana e inxhinierit, konkretisht paraqitur si mëposhtë:

Nr	Emërtimi	Njësia	Gjendje 01.01.20	Hyrjet 2020	Daljet 2020	Dalje Inxhinieri	Gjendje Kontabël 31.12.2020	Gjendje Fizike 31.12.2020
1	Beton 100	m <sup>3</sup>				816		
2	Beton 150	m <sup>3</sup>				655		
3	Beton 200	m <sup>3</sup>				581		
4	Beton 250	m <sup>3</sup>				4,651		
5	Beton 300	m <sup>3</sup>				25,239		
6	Beton 350	m <sup>3</sup>				290		
7	Beton 370	m <sup>3</sup>				4,274		
8	Asfalt Baze	ton				9,500		
9	Asfalt Binder	ton				8,407		

Burimi: DTM, përpunoni KLSH.

Nr	Emërtimi	Njësia	Gjendje 01.01.21	Hyrjet 01-07.21	Daljet 01-07.21	Dalje Inxhinieri	Diferenca
1	Beton 250	m <sup>3</sup>	0	48	48	4,914	(4,866)
2	Beton 300	m <sup>3</sup>	0	2	2	4,723	(4,721)
3	Beton 450	m <sup>3</sup>	0	549	549	1,392	(843)
4	Cimento	ton	0	22,062	21,897	9,269	12,793
5	Asfalt Binder	ton	0	1,998	1,998	19,914	(17,916)
6	<b>Bitum</b>	<b>ton</b>	<b>0</b>	<b>1,506,345</b>	<b>1,477,265</b>	-	-
7	<b>Nafte</b>	<b>litra</b>	<b>11,490</b>	<b>6,160,387</b>	<b>6,086,431</b>	-	-
8	<b>Solar</b>	<b>Kg</b>	<b>0</b>	<b>437,980</b>	<b>437,980</b>	-	-

Nisur nga diferencat e konstatuara midis lëvizjes së bilancit material të kryer nga inspektori i kontrollit dhe akt konstatimit të hartuar nga inxhinieri, grupi i auditimit është në kushtet e pamundësisë objektive për të kryer analiza dhe vlerësime të mëtejshme të situatës, prandaj do t'i drejtohem DTM me masë organizative për të administruar dokumentacion justifikues nga tatimpaguesi "Gj. K." SHA, me qëllim vlerësimin korrekt të diferencave të konstatuara.

Nga kontrolli i sistemit C@ts për periudhën 2016-2021, rezulton se ka dorëzuar brenda datës 31 Mars, inventarin analitik të aktiveve afatgjata (makina dhe mjete pune) gjendje deri më datë 31 Dhjetor të vitit fiskal sipas kërkesave të pikës 3.12 "Deklarimi tatimor dhe llogaritja përfundimtare e detyrimit" të Udhëzimit Nr.5, datë 30.01.2006 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar. Nga kontrolli i inventarit të makinave, të paraqitura në anekse të bilanceve të viteve 2016-2021, ka rezultuar se shoqëria ka në pronësi, ndër të cilat edhe autovetura të cilat po paraqiten si më poshtë. Në raportin e kontrollit tatimor nga ana e inspektorit nuk është kryer një analizë e detajuar e shfrytëzimit të mjeteve të transportit, rrugët e realizuara, normativat e konsumit për rrugë, proces pune ose volum punimesh etj dhe si rezultat grupi i auditimit gjykon se jemi në kushtet e pamundësisë objektive për të vijuar analizën e mëtejshme të situatës. Gjithashtu përgjatë periudhës së kontrollit 2016-2021, ka pasur në aktivet e veta autovetura, për të cilat inspektori i kontrollit tatimor, duhet të kishte kryer verifikimet n.q.s. janë furnizuar me karburant nga shoqëria, për të cilin është bërë kreditimi i TVSH në blerje, veprime këto në kundërshtim me përcaktimet e të nenit 74 "Kufizimet e së drejtës së zbritjes" të Ligjit Nr.92/2014 "Për TVSH-në, në Republikën e Shqipërisë" dhe nenit 55 "Kufizime të zbritjes së TVSH për disa furnizime" të Udhëzimit Nr.6, datë 30.01.2015 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në R.SH".

Nr	Viti	Emërtimi	Targa	Lloji
1	2016	Toyota Luxury	A.G	Autoveturë
2	2016	KIA RIO	A.J	Autoveturë

3	2016	SSANGYONG	A.L	Autoveturë
4	2016	Toyota Luxury	A.Z	Autoveturë
5	2016	Ford Everest	A.I	Autoveturë
6	2016	Range Rover	A.Y	Autoveturë
7	2016	Mitsubishi	T.P	Autoveturë
8	2016	Benz Fouristrad	T.M	Autoveturë
<b>Totali (8/64) 12.5%</b>				

Nr	Viti	Emërtimi	Targa	Lloji
1	2017	KIA RIO	A.J	Autoveturë
2	2017	SSANGYONG	A.L	Autoveturë
3	2017	Toyota Luxury	A.Z	Autoveturë
4	2017	Ford Everest	A.I	Autoveturë
5	2017	Range Rover	A.Y	Autoveturë
6	2017	Mitsubishi	T.P	Autoveturë
7	2017	Benz Fouristrad	T.M	Autoveturë
8	2017	Dacia	A.A	Autoveturë
9	2017	Porsche Cayene	A.O	Autoveturë
10	2017	Dacia	A.A	Autoveturë
11	2017	Land Rover	A.A	Autoveturë
<b>Totali (11/78) 14.1%</b>				

Nr	Viti	Emërtimi	Targa	Lloji
1	2018	KIA RIO	A.J	Autoveturë
2	2018	SSANGYONG	A.L	Autoveturë
3	2018	Toyota Luxury	A.Z	Autoveturë
4	2018	Ford Everest	A.I	Autoveturë
5	2018	Range Rover	A.Y	Autoveturë
6	2018	Mitsubishi	T.P	Autoveturë
7	2018	Benz Fouristrad	T.M	Autoveturë
8	2018	Dacia	A.A	Autoveturë
9	2018	Porsche Cayene	A.O	Autoveturë
10	2018	Dacia	A.A	Autoveturë
11	2018	Land Rover	A.A	Autoveturë
12	2018	Dacia Duster	A.V	Autoveturë
13	2018	Dacia Duster	A.V	Autoveturë
14	2018	Dacia Duster EDC Confort	A.R	Autoveturë
15	2018	Dacia Duster Essential	A.P	Autoveturë
16	2018	Land Rover	A.R	Autoveturë
<b>Totali (16/94) 17%</b>				

Nr	Viti	Emërtimi	Targa	Lloji
1	2019	DACIA	A.V	Autoveturë
2	2019	DACIA	A.V	Autoveturë
3	2019	VOLKSEAGEN Caddy	A.X	Autoveturë
4	2019	VOLKSEAGEN Caddy	A.X	Autoveturë
5	2019	KIA	A.D	Autoveturë
6	2019	KIA	A.J	Autoveturë
7	2019	SSANGYONG	A.L	Autoveturë
8	2019	DACIA	A.A	Autoveturë
9	2019	TOYOTA	A.Z	Autoveturë
10	2019	FORD	A.I	Autoveturë
11	2019	DACIA	A.R	Autoveturë

12	2019	DACIA	A.A	Autoveturë
13	2019	DACIA	A.P	Autoveturë
14	2019	FORD	T.K	Autoveturë
15	2019	LAND ROVER	A.Y	Autoveturë
16	2019	LAND ROVER	A. A	Autoveturë
17	2019	PORSCHE	A.O	Autoveturë
<b>Totali (17/104) 16.3%</b>				

Nr	Viti	Emërtimi	Targa	Lloji
1	2020	DACIA	A.V	Autoveturë
2	2020	DACIA	A.V	Autoveturë
3	2020	VOLKSËAGEN Caddy	A.X	Autoveturë
4	2020	VOLKSËAGEN Caddy	A.X	Autoveturë
5	2020	KIA	A.D	Autoveturë
6	2020	KIA	A.J	Autoveturë
7	2020	SSANGYONG	A.L	Autoveturë
8	2020	DACIA	A.A	Autoveturë
9	2020	TOYOTA	A.Z	Autoveturë
10	2020	FORD	A.I	Autoveturë
11	2020	DACIA	A.R	Autoveturë
12	2020	DACIA	A.A	Autoveturë
13	2020	DACIA	A.P	Autoveturë
14	2020	FORD	T.K	Autoveturë
15	2020	RANGE ROVER	A.C	Autoveturë
16	2020	LAND ROVER	A.A	Autoveturë
17	2020	PORSCHE	A.O	Autoveturë
18	2020	Dacia Dusta	A.K	Autoveturë
<b>Totali (18/119) 15.1%</b>				

Nr	Viti	Emërtimi	Targa	Lloji
1	2021	DACIA	A.V	Autoveturë
2	2021	DACIA	A.V	Autoveturë
3	2021	VOLKSËAGEN Caddy	A.X	Autoveturë
4	2021	VOLKSËAGEN Caddy	A. X	Autoveturë
5	2021	KIA	A.D	Autoveturë
6	2021	KIA	A.J	Autoveturë
7	2021	SSANGYONG	A.L	Autoveturë
8	2021	DACIA	A.A	Autoveturë
9	2021	TOYOTA	A.Z	Autoveturë
10	2021	FORD	A.I	Autoveturë
11	2021	DACIA	A.R	Autoveturë
12	2021	DACIA	A.A	Autoveturë
13	2021	DACIA	A.P	Autoveturë
14	2021	FORD	T.K	Autoveturë
15	2021	RANGE ROVER	A.C	Autoveturë
16	2021	LAND ROVER	A.A	Autoveturë
17	2021	PORSCHE	A.O	Autoveturë
18	2021	Dacia Dusta	A.K	Autoveturë
19	2021	Dacia Dusta	A.Z	Autoveturë
20	2021	Dacia Dusta	A.N	Autoveturë
21	2021	Dacia Dusta	A.N	Autoveturë
<b>Totali (21/133) 15.8%</b>				

Burimi: DTM, përpunoni KLSH.

Nga auditimi i raportit të kontrollit tatimor si dhe bilanceve kontabël të deklaruara në sistemin C@ts, rezulton se shoqëria ka pasur transaksione në vlera të larta me palë të lidhura, duke qenë se “G. K.” SHA, ka ndikim në vendimmarrjen e këtyre shoqërive, për shkak të zotërimit të kuotave/aksioneve të tyre, sipas përcaktimeve në Ligjin Nr.42/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, gjë që sjell se çdo marrëdhënie apo transaksion midis tyre duhet t’u përmbahet kushteve dhe parimeve të tregut, analizë kjo që nuk është kryer nga ana e inspektorit të kontrollit.

Kompania	Detyrimi T1	Faturime	Arkëtime	Detyrimi T2	% Zot
G. SHPK	5,777,724,417	6,742,738,225	3,413,225,000	9,107,237,642	100%
G. K SHPK	59,531,350	-	-	59,531,350	60%
D. SHPK	1,638,393,238	-	273,500,000	1,364,893,238	50%
<b>Totali</b>	<b>7,475,649,005</b>	<b>6,742,738,225</b>	<b>3,686,725,000</b>	<b>10,531,662,230</b>	

Burimi: DTM, përpunoni KLSH.

**- Subjekti:** E. K. SHPK.

**Nipti:** L.T.

**Adresë Kryesore:** Portëz, Zona Kadastrale Nr.3031, Nr. Pasurie 307/39, Fier.

**Aktiviteti:** Ndërtime civile, turistike, industriale, bujqësore-Rikonstruksione, ndërtime banesash shumëkatëshe, ndërtime rrugësh, punime të mirëmbajtjes dhe sinjalizimit në rrugë, ura dhe vepra arti, rikonstruksione godinash civile, ekonomike veshje fasadash, punime dhe gërmime dheu sistemime, tarracime terrenesh, murature me beton arme dhe kompletim me instalime e nevojshëm për to, ndërtim ujësjellësa dhe kanalizime e impiante vaditje, investitorë në fushën e ndërtimeve civile, turistike, industriale, bujqësore, vepra kulturore, rrugë etj.

**Lloji i Kontrollit:** Kontroll i plotë.

**Inspektori:** B. M.

**Inspektori:** D. B.

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

**- Kontroll për TVSH-në** periudha tatimore nga: **10/2017 – 02/2022.**

**- Kontroll për Tatim Fitimin** periudha tatimore: **2017-2021.**

**- Kontroll për Sigurimet Shoqërore e Shëndetësore,** periudha tatimore nga: **10/2017 – 02/2022.**

**- Tatime te tjera,** periudha tatimore nga: **10/2017 – 02/2022.**

Nga auditimi i raportit të kontrollit tatimor rezulton se:

- Nga analiza e bilancit material dhe krahasimi i gjendjes së materialeve të ndërtimit sipas inventarit kontabël me gjendjen e materialeve sipas inventarit fizik, nuk rezultojnë diferenca.

- Është kryer kontrolli i blerjeve dhe shitjeve me TVSH, duke krahasuar të dhënat e deklaruara nëpërmjet FDP-ve dhe të dhënave që rezultojnë në sistemin informatik tatimor C@TS, dhe nuk kanë rezultuar diferenca ose parregullësi.

- Për blerjet nga importi është kryer krahasimi me të dhënat e dërguara nga DPT në sistemin informatik tatimor C@ts.

- Është analizuar procedura e kreditimit të TVSH-së, për blerjet e karburantit, të cilat kanë rezultuar brenda normave ligjore.

- Është kryer kontrolli për tatimin mbi fitimin dhe elementët e pasqyrave financiare si aktive, pasive, kapitalin dhe PASH dhe nuk kanë rezultuar problematika.

- Është kryer kontrolli për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe TAP dhe nuk kanë rezultuar problematika.



**-Subjekti:** “I. K.” SHPK.

**Nipti:** K.J.

**Adresë Kryesore:** Rruga Zaja, Kodër Bërxullë, Vorë.

**Aktiviteti:** Sinjalistikë rrugore vertikale, horizontale, siguri rrugore, ndriçuese dhe jo ndriçuese, studim, projektim, prodhim, montim, zbatim dhe tregtim të tyre. Import-eksport, tregti me shumice dhe pakicë sinjalistikës rrugore, targa prokate, veshje pune, pajisje dhe veshje për shmangien e aksidenteve, për sigurimin teknik në punë etj

**Lloji i Kontrollit:** Kontroll i plotë.

**Inspektori:** H. M.

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

- Për **TVSH** - periudha tatimore nga: **03/2019-02/2022**.

- Për **Tatim Fitimin** periudha tatimore nga: **2019-2021**.

- Për **Sigurimet Shoqërore e Shëndetësore** - periudha tatimore nga: **01/2020-04/2021**.

- Të Tjera periudha tatimore nga: **03/2019-02/2022**.

Nga auditimi i raportit të kontrollit tatimor u konstatua se:

- Është kryer kontrolli për pasqyrat financiare dhe rezultatit financiar në zbatim të kërkesave të Ligjit Nr.9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij.

- Është kryer kontrolli i TVSH-së duke përfshirë analizën e TVSH-së, së pagueshme në raport me qarkullimin total duke analizuar shitjet dhe blerjet e përjashtuara me TVSH jo të zbritshme/pa TVSH, Importet mallrash dhe investimesh me shkallë tatimore 20%, blerjet nga furnitorët vendas me TVSH 20%, blerjet nga furnitorët vendas me 6%, Autongarkesë e TVSH-së. Nga rakordimi i të ardhurave në FDP-në mujore me të ardhurat e deklaruara në bilancin kontabël kanë rezultuar diferenca për të cilat janë përlllogaritur detyrimet dhe penaltetet pasi janë konsideruar të ardhura të padeklaruara në bilanc.

- Është kryer analiza e bilancit material për periudhat objekt kontrolli. Nga kjo analizë janë konstatuar diferenca materiale që kanë rezultuar shitje të padeklaruara dhe për të cilat janë përlllogaritur detyrimet dhe penaltetet përkatëse nga ana e inspektorit të kontrollit.

- Është kryer analiza e pagesës së TVSH-së.

-Është kryer kontrolli i kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat personale.

- Nga verifikimi i fondit të pagave dhe shpenzimeve për udhëtime e dieta kanë rezultuar tejkalim i marzhit 50% të fondit të pagave për të cilat janë përlllogaritur detyrimet dhe penaltetet përkatëse nga ana e inspektorit të kontrollit.

- Gjithashtu, nga verifikimi i shpenzimeve të bilancit kanë rezultuar shpenzime të pa zbritshme në zërin shpenzime të tjerë, për të cilat janë përlllogaritur detyrimet dhe penaltetet përkatëse nga ana e inspektorit të kontrollit.

**-Subjekti:** “A. C.” SHPK.

**Nipti:** K.F.

**Adresë Kryesore:** Rruga e Dibrës ish truproja e shkollës Skënderbej, Tiranë.

**Aktiviteti:** Import-Export, Tregëti shumicë-pakicë artikuj të ndryshëm, lëndë djegëse, Tregëti buke, duro-alumini, Aktivitet në fushën e ndërtimeve të gjitha llojeve, mirëmbajtje dhe zhvillim i dekoreve në mjediset urbane, Shpime puse Hidrogeologjike dhe geologjinxhinierike, meremetim, pastrim, mirëmbajtje, etj. Grumbullim, transportim mbetje inerte (Dhera).

**Lloji i Kontrollit:** Kontroll i plotë.

**Inspektori: D. B.**

**Inxhinier: I. K.**

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

- Për **TVSH** - periudha tatimore nga: **03/2017-02/2022**.

- Për **Tatim Fitimin** periudha tatimore nga: **2017-2021**.

- Për **Sigurimet Shoqërore e Shëndetësorë** - periudha tatimore nga: **03/2017-02/2022**.

- Të tjera periudha tatimore nga: **03/2017-02/2022**.

Nga auditimi i raport kontrollit tatimor dhe akt verifikimit të mbajtur për subjektin A. C. SHPK, nga ana e inspektorit dhe inxhinierit pranë DTM, janë konstatuar mungesa e analizave dhe vlerësimeve të projektit dhe preventivit të punimeve, nuk është kryer një zbërthim i matrialeve dhe lëndës së parë në përbërje të punimeve të situacionuar, bazuar në manualin nr.1 “Analiza Teknike-Për prodhimin e matrialeve të ndërtimit, udhëzime dhe kriteret” dhe manualin nr.2 “Analiza Teknike-Për punimet e ndërtimit të ndërtesave”, si dhe krahasimi me punimet e kryera realisht në terren dhe si rezultat grupi i auditimit gjykon se jemi në kushtet e pamundësisë objektive për të vijuar analizën e mëtejshme të situatës. Gjithashtu janë konstatuar mungesa e analizave të librezës së masave, situacioneve pjesore mujore, progresive dhe përfundimtare të volumit të punimeve të ndërtimit, të cilat janë dokumenta justifikuese për verifikimin e volumit të punimeve të kryera sipas përcaktimeve të nënpikave 3.2 dhe 3.3 të pikës 3, Kreu 1 të Udhëzimit Nr.3, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, ndryshuar me Udhëzimin Nr.1 datë, 16.06.2011, konkretisht:

*3.2 Libreza e masave për punimet e ndërtimit është dokumentacioni bazë për verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve të ndërtimit, të vendosura në situacion. Kjo librezë hartohet nga drejtuesi teknik i objektit dhe firmoset nga ai, nga mbikëqyrësi i punimeve dhe nga përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit, për të cilin është miratuar leja e ndërtimit.*

*3.3 Situacionet mujore pjesore, progresive dhe përfundimtare hartohen mbi bazën e volumeve të llogaritura në librezën e masave dhe çmimeve faktike, mbështetur në analizat teknike të çmimeve, që përfshihen në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit, të miratuara çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave. Ato firmosen nga drejtuesi teknik i objektit, mbikëqyrësi i punimeve dhe përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit për të cilin është miratuar leja e ndërtimit. Në rastet kur në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit mungojnë analizat teknike të çmimeve të zërave të punimeve të kryera në objekt, veprohet në përputhje me procedurën e përcaktuar në pikën 8 të vendimit nr.514, datë 15.8.2007 të Këshillit të Ministrave "Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit".*

Nga verifikimi i pasqyrave financiare të viteve 2018-2019, rezulton se subjekti në aktiv të bilancit **“Kapital i Nënshkruar i Papaguar”**, ka paraqitur huadhënien e ortakut ndaj shoqërisë, pa interes dhe pa një sqarim n.q.s. i kanë shërbyer për mbulimin e shpenzimeve dhe blerjeve të mallrave me qëllim vazhdimin normal të aktivitetit të shoqërisë. Në raport kontrolli sqarohet se kjo hua është dhënë me vendim asambleje, pa pasur një dokument justifikues siç është kontrata e huadhënies siç përcaktohet edhe nga Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, sepse referuar përcaktimeve të Ligjit Nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, rezulton se ortakut dhe shoqëria me përgjegjësi të kufizuar, janë entitete të ndryshme dhe me personalitet juridik të ndarë. Sipas legjislacionit tatimor, shoqëria dhe ortakut konsiderohen si “palë të lidhura”, meqenëse ortakut ka ndikim në vendimmarrjen e shoqërisë për shkak të zotërimit të kuotave/aksioneve të saj, sipas përcaktimeve në Ligjin Nr.42/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, gjë që

sjell se çdo marrëdhënie apo transaksion midis tyre duhet t'u përmbahet kushteve dhe parimeve të tregut.

<i>Emërtimi</i>	<b>2017</b>	<b>2018</b>	<b>2019</b>	<b>2020</b>	<b>2021</b>
<i>Kapital i nënshkruar i papaguar</i>	4,858,017	23,182,363	64,803,505	101,454,579	111,799,174

Burimi: DTM, përpunoni KLSH.

**-Subjekti:** “M. K.” Shpk.

**Nipti:** J.Q.

**Adresë Kryesore:** Njësia Bashkiake Nr.7 Rruga Nikolla Jorga, Godina Nr.18/2, Tiranë.

**Aktiviteti:** Punimet e ndërtimit (ku futen veprat e artit), tregti me shumicë dhe pakicë materiale ndërtimi, inerteve, materialeve elektrike, hidraulike e hidrosanitare, linja për prodhim material, import-eksport, tregtim të mallrave të ndryshme industriale, ushqimore, të materialeve të ndërtimit, me shumicë e pakicë etj. Veprimtari në fushën e ndërtimit e projektimit, restaurimit të objekteve kulturore ose të kultit, veprimtari imobiliare për shitje e blerje, veprimtari në fushën e turizmit, bar-restorant, hotel. Import-eksport në fushën e karburanteve, vajrave lubrifikante etj. Studim, projektim, zbatim, prodhim dhe tregtim i energjisë elektrike nga burime alternative si parqet e erës, të tjera për strehime (Vila, apartamente, shtëpi pushimi, bujtina etj).

**Lloji i Kontrollit:** Kontroll i plotë.

**Inspektori:** I. D.

**Inxhinier:** I.K.

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

- Për **TVSH** - periudha tatimore nga: **10/2019-12/2019**.
- Për **Tatim Fitimin** periudha tatimore nga: **2019**.
- Për **Sigurimet Shoqërore e Shëndetësorë** - periudha tatimore nga: **10/2019-12/2019**.
- Të Tjera periudha tatimore nga: **10/2019-12/2019**.

Nga auditimi i raport kontrollit tatimor dhe akt verifikimit të mbajtur për subjektin “M. K.” Shpk, nga ana e inspektorit dhe inxhinierit pranë DTM, janë konstatuar mungesa e analizave dhe vlerësimeve të projektit dhe preventivit të punimeve, nuk është kryer një zbërthim i materialeve dhe lëndës së parë në përbërje të punimeve të situacionuar, bazuar në manualin nr.1 “Analiza Teknike-Për prodhimin e materialeve të ndërtimit, udhëzime dhe kritere” dhe manualin nr.2 “Analiza Teknike-Për punimet e ndërtimit të ndërtesave”, si dhe krahasimi me punimet e kryera realisht në terren dhe si rezultat grupi i auditimit gjykon se jemi në kushtet e pamundësisë objektive për të vijuar analizën e mëtejshme të situatës . Gjithashtu janë konstatuar mungesa e analizave të librezës së masave, situacioneve pjesore mujore, progresive dhe përfundimtare të volumit të punimeve të ndërtimit, të cilat janë dokumente justifikuese për verifikimin e volumit të punimeve të kryera sipas përcaktimeve të nënpikave 3.2 dhe 3.3 të pikës 3, Kreu 1 të Udhëzimit Nr.3, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, ndryshuar me Udhëzimin Nr.1 datë, 16.06.2011, konkretisht:

*3.2 Libreza e masave për punimet e ndërtimit është dokumentacioni bazë për verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve të ndërtimit, të vendosura në situacion. Kjo librezë hartohet nga drejtuesi teknik i objektit dhe firmoset nga ai, nga mbikëqyrësi i punimeve dhe nga përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit, për të cilin është miratuar leja e ndërtimit.*

*3.3 Situacionet mujore pjesore, progresive dhe përfundimtare hartohen mbi bazën e volumeve të llogaritura në librezën e masave dhe çmimeve faktike, mbështetur në analizat teknike të çmimeve, që përfshihen në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit, të miratuara çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave. Ato firmosen nga drejtuesi teknik i objektit, mbikëqyrësi i punimeve dhe përfaqësuesi ligjor*

*i sipërmarrësit për të cilin është miratuar leja e ndërtimit. Në rastet kur në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit mungojnë analizat teknike të çmimeve të zërave të punimeve të kryera në objekt, veprohet në përputhje me procedurën e përcaktuar në pikën 8 të vendimit nr.514, datë 15.8.2007 të Këshillit të Ministrave "Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit".*

Nga auditimi i raportit të kontrollit tatimor të subjektit "M. K." Shpk, kanë rezultuar se për punimet e ndërtimit në objektet "Godinë banimi dhe shërbime 10 kate me 1 kat parkim nëntokë Rruga "Don Bosko", Tiranë", nga përlllogaritjet e grupit të auditimit kanë rezultuar faturim të punimeve të ndërtimit poshtë nivelit të kostove mesatare që janë përcaktuar në Udhëzimin e Këshillit të Ministrave Nr.3 "Miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2016", paraqitur si më poshtë:

<b>Objekti: Godinë banimi dhe shërbime 10 kate me 1 kat parkim nëntokë Rruga "Don Bosko", Tiranë.</b>
<b>Leje Ndërtimit Nr.A-1269/6 dt.28.03.2018</b>
<b>Investitor: "M. K." Shpk me NIPT J.Q në 50% &amp; "B. I" Shpk me NIPT L.S në 50%.</b>
<b>Ndërtues: "M. K." Shpk me NIPT J.Q</b>
<b>Situacioni Progresiv deri në shtator 2019: 331,212,977 leke me TVSH.</b>
<b>Përqindja e punimeve sipas Ing deri në shtator 2019: 85 %.</b>
<b>Situacioni tetor-dhjetor 2019: 40,596,448 lekë me TVSH</b>
<b>*** Përqindja e punimeve sipas llogaritjeve të grupit të KLSH deri në dhjetor 2019: 95.42 %.</b>
<b>Sipërfaqe për kosto: 13,251.10 m<sup>2</sup>.</b>
<b>Sipërfaqe totale: 13,251.10 m<sup>2</sup>.</b>

Burimi: DTM, përpunoni KLSH.

Nr	Emërtimi	Njësia	Sip. Neto	Sip. Përbashkët	Sip Ndërtimi	Sip. J/K	Sip. Totale
1	Parkime	m <sup>2</sup>	983.6	1,090.50	2,074.10	0	2,074.10
2	Ambjente Shërbimi	m <sup>2</sup>	984.5	101.9	1,086.40	0	1,086.40
3	Ambjente Banimi	m <sup>2</sup>	9,503.50	587	10,090.50	0	10,090.50
4	Ballkone	m <sup>2</sup>	0	0	0	0	0
5	Veranda	m <sup>2</sup>	0	0	0	0	0
	<b>Shuma</b>	<b>m<sup>2</sup></b>	<b>11,471.60</b>	<b>1,779.50</b>	<b>13,251.10</b>	<b>0</b>	<b>13,251.10</b>

Burimi: DTM, përpunoni KLSH.

Zëri	Vlera e tatueshme
Vlera e situacionuar me TVSH	371,809,425
Niveli faktik i punimeve	95.42%
Sipërfaqe Ndërtimi	13,251.10
Kosto/m <sup>2</sup>	29,406
Kosto Minimale Fiskale	32,113
<b>Diferenca</b>	<b>2,707</b>
<b>Diferenca në Vlerë</b>	<b>34,233,757</b>

Burimi: DTM, përpunoni KLSH.

Në raportin e kontrollit tatimor dhe akt verifikimin e inxhinierit nuk kemi evidentim të këtyre transaksioneve poshtë nivelit të kostove mesatare të miratuara për ndërtimin dhe nuk gjejmë justifikim të kësaj situatë të tatimpaguesit në aspektin ekonomik si integrim horizontal, vertikal,

ekonomi shkalle apo specializim, që të justifikojë uljen e kostove. Nga sa më sipër grupi i auditimit del në konkluzionin se jemi në situatën e faturimeve të situacionit të punimeve të ndërtimit dhe shitjes nën kostot mesatare të miratuara në Udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr.3 “Miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2016”, nga ana e subjektit “M. K.” Shpk, i cili është njëkohësisht në rolin e ndërtuesit dhe investitorit të punimeve të ndërtimit, parregullsi kjo që ka sjellë ulje të pagesës së TVSH-së si dhe ulje të tatimit mbi fitimin dhe nga ana e inspektorit të kontrollit tatimor duhet të ishte kryer penalizimi sipas nenit 124 “Kundërvajtjet në lëshimin e faturave tatimore, dëftesave tatimore dhe dokumentimin e transaksioneve” e Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ku përcaktohet qartë se: “Mos lëshimi i faturës tatimore, dëftesës tatimore apo i faturës tatimore me TVSH dënohet me gjobë të barabartë me 100 përqind të tatimit të padeklaruar, si rezultat i mos lëshimit të faturës, përveç tatimit dhe kamatëvonesave që llogariten dhe paguhen në përputhje me dispozitat e këtij ligji apo të ligjeve specifike tatimore”.

<b>Emërtimi</b>	<b>Vlera</b>
Diferenca në vlerë në objektin "Godinë banimi dhe shërbime 10 kate me 1 kat parkim nëntokë Rruga "Don Bosko", Tiranë"	34,233,757
TVSH (20%)	5,705,626
Gjobë (100%) TVSH sipas nenit 124	5,705,626
Tatim Fitimi (15%)	4,279,220
Gjobë (100%) Tatim Fitimi sipas nenit 124	4,279,220
<b>Detyrime Total</b>	<b>19,969,692</b>

Burimi: DTM, përpunoni KLSH.

Nga sa më sipër janë sjellë si pasojë efekte tatimore të pallogaritura në shumën 4,279,220 lekë detyrime të tatimit mbi fitimin dhe 4,279,220 lekë gjobë 100%, 5,705,626 lekë detyrime të TVSH-së dhe 5,705,626 lekë gjobë 100%, pra të ardhura gjithsej të munguar për buxhetin e shtetit në vlerën prej 19,969,692 lekë.

Nga analiza e raportit të kontrollit tatimor ka rezultuar se shoqëri “M. K.” Shpk ka arkëtuar interesa nga shoqëritë “A.” Shpk dhe “B. I.” Shpk bazuar në kontratat e huadhënies lidhur me këto shoqëri. Konkretisht sipas kontratës së huasë datë 26.02.2018, amenduar me kontratën për shtyrje afati datë 26.02.2019, për shumën e huasë prej 80,000 Euro me një normë vjetore interesi prej 2%, ku shoqëria M. K. Shpk si huadhënëse është ortake në shoqërinë huamarrëse A. Shpk në masën 16.85% të kapitalit themeltar. Gjithashtu huamarrës shoqëria B. I. Shpk me nipt L.S sipas kontratës noteriale të huasë Nr.405 Rep dhe 81 Kol datë 15.04.2017, në të cilën palët (*Huadhënësi dhe Huamarrësi me të drejta pronësie të barabarta*), kanë blerë një tokë për ndërtim në Lalëz, Durrës me një sipërfaqe prej 30,000 m<sup>2</sup> me vlerë prej 900,000 euro për secilin ose 1,800,000 euro në total për ndërtim vilash.

<b>Emërtimi</b>	<b>Gjendje 31.12.2018</b>	<b>Gjendje 31.12.2019</b>
Hua në lekë	100,743,312	57,104,333
<b>Shuma</b>	<b>100,743,312</b>	<b>57,104,333</b>

<b>Nr.</b>	<b>Emri Tregtar</b>	<b>Rrethi</b>	<b>NIPT</b>	<b>Përshkrimi</b>	<b>Vlera</b>
1	A. Shpk	Tiranë	L.H	Interes Huaje	50,502
2	B. I.Shpk	Tiranë	L.S	Interes Huaje	1,186,637

<b>Total</b>	<b>1,237,139</b>
--------------	------------------

Burimi: DTM, përpunoni KLSH.

Nga analiza e pasivit të bilancit të shoqërisë rezulton se shoqëria ka hua afatgjata në bankat e nivelit të dytë për të cilat paguan interesat përkatëse sipas përcaktimeve të kontratave të huamarrjes.

<b>Detyrime afatgjata:</b>	<b>2018</b>	<b>2019</b>
Titujt e huamarrjes	319,700,944	274,114,307
<b>Totali i Detyrimeve afatgjata</b>	<b>319,700,944</b>	<b>274,114,307</b>

<b>Emërtimi</b>	<b>Gjendje 31.12.2019</b>
Shpenzime të tjera financiare (Interesa Bankare)	10,196,680
<b>Shuma</b>	<b>10,196,680</b>

Burimi: DTM, përpunoni KLSH.

Grupi i audituesve gjykon në lidhje me shpenzimet e interesit se kemi të bëjmë me shpenzime të panjohura që nuk i kanë shërbyer aktivitetit të shoqërisë, me arsyetimin se shoqëria në aktivitetin e saj të deklaruar nuk e ka huadhënien si dhe nuk është e licencuar për t'a kryer atë, gjithashtu theksojmë se shoqëria ka paguar interesa në nivelin e 4% për kreditë afatgjata që ka marrë nga bankat e nivelit të dytë dhe nga ana tjetër ka dhënë hua shoqërive (*A. Shpk – Palë e lidhur dhe B. I. Shpk-Ortak në investim*) me norma afërsisht 2%, veprime këto të cilat nuk janë konform vlerës dhe parimeve të një tregu të lirë si dhe janë në kundërshtim me përcaktimet e nenit 20 të Ligjit Nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.

*Për përcaktimin e fitimit të tatueshëm në Republikën e Shqipërisë njihen si shpenzime ato që kryhen për qëllime fitimi, sigurimi dhe ruajtje të fitimit, në masën që këto shpenzime provohen dhe dokumentohen nga tatimpaguesi, si dhe kur janë objekt i kufizimeve të specifikuar nga ky ligj.*

<b>Emërtimi</b>	<b>Gjendje 31.12.2018</b>	<b>Gjendje 31.12.2019</b>
Hua në lekë	100,743,312	57,104,333
Titujt e huamarrjes	319,700,944	274,114,307
<b>Raporti</b>	<b>32%</b>	<b>21%</b>
Shpenzime interesa bankare njohur nga subjekti	10,196,680	
Shpenzime interesa bankare të panjohura	2,124,204	

Burimi: DTM, përpunoni KLSH.

Nga sa argumentuar sa më sipër, ku rezulton se “*Shpenzimet e interesit për hua të afatgjata*”, nuk janë kryer për qëllime fitimi, sigurimi dhe ruajtje të fitimit duhet të rikarakterizohen si shpenzime të panjohur duke rivlerësuar situatën financiare dhe penalizuar subjektin për këto parregullsi në deklarim sipas përcaktimeve të nenit 115 “*Plotësim i pasaktë i deklaratës tatimore*”, të Ligjit Nr.9920 datë 19.05.2008 “*Për procedurat tatimore në R.SH*”, i ndryshuar, ku përcaktohet qartë se: “*Dorëzimi i një deklaratë tatimore të pasaktë dënohet me një gjobë të barabartë me 0,06 përqind të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë, gjatë së cilës pagesa nuk është kryer. Në asnjë rast, gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike*”.

<b>Emërtimi</b>	<b>Vlera</b>
Shpenzime të panjohura (Rivlerësim i shpenzimeve të interesit)	2,124,204
Tatim Fitimi (15%)	318,631
Gjobë Tatim Fitimi (21.9%)	69,780

Tatimi Neto pas TF	1,805,573
Tatim mbi Dividentin (8%)	144,446
Gjobë Tatim Dividenti (21.9%)	31,634
<b>Detyrime Total</b>	<b>564,490</b>

Burimi: DTM, përpunoni KLSH.

Nga sa më sipër janë sjellë si pasojë efekte tatimore të pallogaritura në shumën 318,631 lekë detyrime të tatimit mbi fitimin dhe 69,780 lekë gjobë 21.9%, 144,446 lekë detyrime të tatim dividenti dhe 31,634 lekë gjobë 21.9%, pra të ardhura gjithsej të munguar për buxhetin e shtetit në vlerën prej 564,490 lekë.

Shoqëria bazuar në nenin 73 “Rregullat për aplikimin e koeficientit të zbritjes së TVSH-së” të Ligjit 92/2014 “Për TVSH në R.SH” si dhe në nenin 56 “Rregulla praktike mbi zbritjen e TVSH-së”, pika 3 “Koeficienti i Zbritjes së TVSH-së” të Udhëzimit Nr.6 datë 30.01.2015, për shpenzimet me karakter të përgjithshëm për periudhën Janar-Shtator 2019 (**Periudhë e kontrolluar më parë për TVSH**) sipas Raport-Kontrollit të datës 13.01.2021, nuk është zbatuar kreditimi i pjesshëm i TVSH, por është lënë detyrë kontrollit pasardhës që të bëhet rregullimi i TVSH për komplet vitin 2019.

Nga ana e inspektorit nuk është vepruar konform përcaktimeve të Ligjit Nr.92/2014 "TVSH në RSH", i ndryshuar, pika 1 e nenit 69, neni 72, neni 78 si dhe nenin 80, konkretisht:

1. Llogaritja e pasaktë e koeficientit të zbritjes së TVSH-së në baza mujore dhe jo vjetore;
2. Nuk ka kryer rregullimin e TVSH në blerjet e furniturave, të cilat janë vështirë të ndashme masa e të cilave ka kontribuar dhe është përdorur për si për kryerjen e transaksioneve të tatueshme që sjellin të drejtën e zbritjes së TVSH-së mbi bazën e neneve 69 dhe 70, të këtij ligji, edhe për transaksionet që nuk e sjellin këtë të drejtë.

Nga të dhënat e raportit të kontrollit dhe sistemit C@ts në lidhje me shitjet për periudhën 01.01.2019-31.12.2019, rillogarisim koeficientin e zbritjes së TVSH-së (baza vjetore), sipas përcaktimeve të nenit 72 të Ligjit Nr.92/2014 "Për TVSH në R.SH", i ndryshuar:

Emërtimi	Vlera
Shitje të përjashtuara	660,377,128
Shitje të tatueshme me shkallë 20%	312,180,201
<b>Koef zbritjes TVSH-së</b>	<b>32.10%</b>

Burimi: DTM, përpunoni KLSH.

Nga kontrolli analitikë i “Blerjeve të tatueshme me 20% TVSH nga furnitorë vendas” për vitin 2019, janë evidentuar blerjet e furniturave të cilat u kanë shërbyer të dy aktiviteteve dhe mbi të cilën duhet të aplikohet koeficienti i zbritjes së TVSH-së.

Emri Tregtar	Rrethi	NIPT	Përshkrimi	Vlera	TVSH
A&A Sh.p.k.	Tiranë	K.E	Program informatike	228,580	45,716
A.S.G.	Tiranë	K.Ë	Makina me qera	72,864	14,573
A. S.C.	Tiranë	K.I	Shërbim telekomunikacioni	46,750	9,350
A.	Tiranë	J.N	Shërbim telekomunikacioni	2,500	500
A.	Tiranë	K.I	Artikuj kancelarie	52,284	10,457
A. S	Tiranë	K.M	Shërbim sigurie	2,676,668	535,333
Ç. D. & P.	Tiranë	K.O	Aktivitet publicistik	79,912	15,982
D. P.	Tiranë	L.F	Printime	179,000	35,800



D. G.	Tiranë	J.I	Gaz	23,700	4,740
F.	Tiranë	K.G	Sistem kundër zjarrit	5,000	1,000
G. L.	Tiranë	K.I	Lule natyrale	716,959	143,392
G. S.	Tiranë	I.T	Shërbim noterie	9,400	1,800
K. N.	Tiranë	K.H	Audit	150,000	30,000
L. P.	Tiranë	K.B	Shërbim noterie	9,400	1,800
N.	Tiranë	K.B	Pajisje elektronike	577,483	115,497
N. C.	Tiranë	L.C		94,284	18,857
O.	Tiranë	K.H	Energji elektrike	4,348,785	869,697
P. P.	Tiranë	K.L	Artikuj kancelarie	20,000	4,000
S.R.	Tiranë	L.P	Shërbim marketingu	8,000	1,600
T.	Tiranë	J.N	Shërbim telekomunikacioni	17,500	3,500
T. I.	Rogozh	K.V		975,715	195,143
T. V.	Tiranë	L.A	Shërbim konsulence	176,000	35,200
U. K.	Tiranë	J.O	Ujësjiellës	250,662	50,132
V. P. F.	Tiranë	L.V	Agjenci imobiliare	250,420	50,084
V.	Tiranë	K.L	Shërbim telekomunikacioni	327,912	65,514
V.x E.	Tiranë	L.O	Pajisje zyre	157,709	31,543
A.	Tiranë	L.C	Veshje pune	5,200	1,040
A. S.	Tiranë	K.I	Artikuj kancelarie	21,875	4,375
A. S.	Tiranë	K.M	Sherbim sigurie	890,001	178,000
B.	Tiranë	K.R	Lule natyrale	13,333	2,667
D. B.	Tiranë	L.M	Sherbim noterie	26,700	5,340
E.	Tiranë	L.C	Sherbim restorant	78,433	15,687
G. L.	Tiranë	K.I	Lule natyrale	694,085	138,817
H-L Group	Tiranë		Mirembajtje automjeti	66,667	13,333
I-Fire	Tiranë	L.H	Veshje pune	15,667	3,133
L. 2000	Tiranë	K.F	Artikuj kancelarie	31,250	6,250
M. R.	Tiranë	K.S	Sherbim reklamimi	3,843	769
M. M.	Tiranë		Mirembajtje automjeti	2,042	408
O.	Tiranë		Energji elektrike	85,276	17,055
S. T.	Tiranë	L.A	Shërbime grafike/printime	151,200	30,240
T.	Tiranë	J.N	Sherbim telekomunikacioni	7,500	1,500
U-K.	Tiranë	J.O	Ujesjelles	930,357	186,071
V.	Tiranë	K.L	Shërbim telekomunikacioni	339,185	67,837
X.T.	Tiranë	J.B	Shërbim telekomunikacioni	268,333	53,667
<b>Totali</b>				<b>15,088,434</b>	<b>3,017,399</b>

Burimi: DTM, përpunoni KLSH.

Emërtimi	Vlera
Zbritja e TVSH sipas Koeficientit përfundimtar të TVSH	968,585
(-) zbritja e TVSH sipas Koeficientit fillestar të TVSH	3,017,399
<b>(=) Rregullimi i Zbritjes së TVSH</b>	<b>-2,048,814</b>

Burimi: DTM, përpunoni KLSH.

Gjithashtu duhet të ishte kryer penalizmi i subjektit sipas përcaktimeve të nenit 115 “Plotësim i pasaktë i deklaratës tatimore”, të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008, ku përcaktohet qartë se:



“Dorëzimi i një deklarate tatimore të pasaktë dënohet me një gjobë të barabartë me 0,06 përqind të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë, gjatë së cilës pagesa nuk është kryer. Në asnjë rast, gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike”.

Në lekë

<b>Zëri i bilancit</b>	<b>2019</b>
Ulje e gjendjes kreditore të TVSH	2,048,814
Gjobë TVSH (21.9%)	448,690
<b>Detyrime Shtesë</b>	<b>2,497,504</b>

Burimi: DTM, përpunoni KLSH.

Nga sa më sipër janë sjellë si pasojë efekte tatimore të pallogaritura në shumën 2,048,814 lekë ulje e tepricës kreditore të TVSH-së dhe 448,690 lekë gjobë 21.9%, pra të ardhura gjithsej të munguar për buxhetin e shtetit në vlerën prej 2,497,504 lekë.

Nga auditimi i raportit të kontrollit tatimor, konkretisht në drejtim të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore sipas pikës së programit të kontrollit, kanë rezultuar problematikat si më poshtë:

- Nga kontrolli i listëpagesave të subjektit të deklaruar në sistemin C@ts për periudhën 10/2019-12/2019, ka rezultuar se shoqëria ka deklaruar për punonjësit 26 ditë pune që është në tejkalim të kohëzgjatjes normale të punës prej 174 orë në muaj ose 22 ditë pune dhe pagesa për ditët shtesë duhet të kryhet me një shtesë jo më pak se 25% të pagesës të ditës normale sipas përcaktimeve të Kreut IX të Kodit të Punës në R.SH.

- Gjithashtu janë konstatuar raste ku shoqëria ka deklaruar pagesa të pagave orare për punonjësit poshtë pagës minimale orare që është përcaktuar në Vendim Nr.809, datë 26.12.2018 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”.

- Nga ana e inspektorit të kontrollit tatimor nuk janë analizuar kontratat individuale të punës midis shoqërisë dhe punonjësve, në lidhje me përputhshmërinë e tyre me përcaktimet e dispozitave të Kodit të Punës në R.SH.

- Nuk janë analizuar regjistrat që duhet të mbajë tatimpaguesi sipas përcaktimeve të nenit 15 “Mbajtja e regjistrimeve” të Ligjit Nr.9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

- Nuk ka një analizë të llogaritjes së pagës dhe elementëve përbërës të saj sipas përcaktimeve të dispozitave të nenit 119 të Kreut XI të Kodit të Punës në R.SH.

- Nuk janë analizuar regjistrat që duhet të mbajë tatimpaguesi sipas përcaktimeve të nenit 15 “Mbajtja e regjistrimeve” të Ligjit Nr.9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

- Nuk ka një analizë të llogaritjes së pagës dhe elementëve përbërës të saj sipas përcaktimeve të dispozitave të nenit 119 të Kreut XI të Kodit të Punës në R.SH.

- Nuk ka një analizë të numrit të lartë të ndryshimit të punonjësve të shoqërisë, kryesisht në lidhje me largimet e shpeshta n.q.s. ndërprerjet e marrëdhënieve të punës janë konform kontratave dhe përcaktimeve të Kodit të Punës.

- Janë konstatuar parregullsi në llogaritjen e ditëve të punës dhe pagës për efekt të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për punonjësit e punësuar rishtazi ose të larguar përgjatë muajit.

- Nga kontrolli për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si dhe TAP-in, për periudhën 11/2020-03/2022 dhe nga analiza e listëpagesave të dorëzuar nga subjekti në sistemin C@ts, janë konstatuar parregullsi në llogaritjen e pagës për efekt të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për punonjësit me numër kategorie për kontributet 2/004(6), sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Në lidhje me situatën e trajtuar më sipër grupi i audituesve gjykon se janë arsye themelore për të kryer rivlerësimin e pagave, kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi, për punonjësit me paga të deklaruar jo konform përcaktimeve të legjislacionit, në lidhje me këtë tatimpaguesi i cili ka plotësuar deklarata tatimore që përmbajnë të dhëna të pasakta ose të falsifikuara dhe nuk mban dhe ruan llogari apo regjistrime të sakta të transaksioneve, veprime të cilat janë në kundërshtim me *germën b, c të nenit 71, germa a e nenit 72 të Ligjit Nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave Nr.24 date 02.09.2008, i ndryshuar në zbatim të tij, ku përcaktohet se:*

*Neni 71 “E drejta për të përdorur mënyra alternative vlerësimi” i Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, konkretisht pika:*

***b) deklarata tatimore përmban të dhëna të pasakta ose të falsifikuara;***

***c) tatimpaguesi nuk mban ose ruan llogari apo regjistrime të sakta të transaksioneve;***

*Neni 72 “Baza e mënyrave alternative të vlerësimit”:*

*1. Mënyrat alternative të vlerësimit nuk kufizohen, por bazohen në:*

***a) të dhëna të drejtpërdrejta, që gjenden në deklaratat tatimore ose në dokumentet apo në një informacion tjetër, dhënë nga tatimpaguesi;***

Muaj	Nr. pune	Paga Bruto	Paga Bruto Rivlerësuar	Diferenca	Sig Sh PDH (15%)	Sig Sh PM (9.5%)	Sig Sh PDH (1.7%)	Sig Sh PM (1.7%)	TAP (13%)	Paga Neto
Tetor 2019	13	312,000	385,016	73,016	10,952	6,937	1,241	1,241	3,123	61,715
Nëntor 2019	14	351,000	433,888	82,888	12,433	7,874	1,409	1,409	3,691	69,914
Dhjetor 2019	14	364,000	450,576	86,576	12,986	8,225	1,472	1,472	3,975	72,905
<b>Total</b>		<b>1,027,000</b>	<b>1,269,480</b>	<b>242,480</b>	<b>36,372</b>	<b>23,036</b>	<b>4,122</b>	<b>4,122</b>	<b>10,789</b>	<b>204,533</b>

Burimi: DTM, përpunoni KLSH.

Nr	Emërtimi	Vlera
1	Paga Bruto	1,027,000
2	Paga Bruto Rivlerësuar	1,269,480
3	Diferenca Paga Bruto	242,480
<b>4</b>	<b>Diferenca Paga Neto</b>	<b>204,533</b>
5	Diferenca Sig Shoq Punëmarrësi (9.5%)	23,036
6	Diferenca Sig Shënd Punëmarrësi (1.7%)	4,122
7	<b>Diferenca Sig Shoq Punëdhënësi (15%)</b>	<b>36,372</b>
8	<b>Diferenca Sig Shënd Punëdhënësi (1.7%)</b>	<b>4,122</b>
9	Diferenca TAP (13%)	10,789
<b>10</b>	<b>Rivlerësim i shpenzimeve të padeklaruar nga subjekti [(4)+(7)+(8)]</b>	<b>245,027</b>

Burimi: DTM, përpunoni KLSH.

Penalizmi i subjektit duhet të ishte bërë sipas llogaritjeve të mëposhtme në bazë të pikës 3 të nenit 119 “Mosdeklarimi i punonjësve dhe fshehja e pagës” të Ligjit Nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar, ku përcaktohet qartë se: *“Nëse nga verifikimi dhe kontrolli rezulton se tatimpaguesi ka fshehur dhe nuk ka deklaruar pagën e saktë të përfituar nga punëmarrësi, si rezultat i marrëdhënies së punësimit, tatimpaguesi-punëdhënësi, përveç detyrimit për pagimin e shumës së detyrimit tatimor dhe kontributit të sigurimeve shoqërore dhe*

shëndetësore, të llogaritur për gjithë periudhën që provohet se është kryer shkelja, dënohet me gjobë në masën 100 për qind të detyrimit dhe kontributit të llogaritur”.

<b>Emërtimi</b>	<b>Vlera</b>
Sig Shoq Punëdhënësi (15%)	36,372
Gjobë Sig Shoq Punëdhënësi (100%)	36,372
Sig Shoq Punëmarrësi (9.5%)	23,036
Gjobë Sig Shoq Punëmarrësi (100%)	23,036
Sig Shënd Punëdhënësi (1.7%)	4,122
Gjobë Sig Shënd Punëdhënësi (100%)	4,122
Sig Shënd Punëmarrësi (1.7%)	4,122
Gjobë Sig Shënd Punëmarrësi (100%)	4,122
TAP (13%)	10,789
Gjobë TAP (100%)	10,789
<b>Detyrime Total</b>	<b>156,882</b>

Burimi: DTM, përpunoni KLSH.

Nga sa më sipër janë sjellë si pasojë efekte tatimore të pallogaritura në shumën 36,372 lekë detyrime të Sig Shoq Punëdhënësi dhe 36,372 lekë gjobë 100%, 23,036 lekë detyrime të Sig Shoq Punëmarrësi dhe 23,036 lekë gjobë 100%, 4,122 lekë detyrime Sig Shënd Punëdhënësi dhe 4,122 lekë gjobë 100%, 4,122 lekë detyrime Sig Shënd Punëmarrësi dhe 4,122 lekë gjobë 100%, 10,789 lekë detyrime TAP dhe 10,789 lekë gjobë 100%, pra të ardhura gjithsej të munguar për buxhetin e shtetit në vlerën prej 156,882 lekë.

Në lidhje me pagat e padeklaruar saktë nga ana e subjektit do të kryhet rivlerësimi i situatës financiare të subjektit, ku shpenzimi i fondit të pagave të rivlerësuara do të rikarakterizohet si e ardhura dhe do të kryhet penalizimi i subjektit sipas përcaktimeve të nenit 115 “Plotësim i pasaktë i deklaratës tatimore”, të Ligjit Nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar, ku përcaktohet qartë se: “Dorëzimi i një deklarate tatimore të pasaktë dënohet me një gjobë të barabartë me 0,06 përqind të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë, gjatë së cilës pagesa nuk është kryer. Në asnjë rast, gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike”.

<b>Emërtimi</b>	<b>Vlera</b>
Rivlerësim i shpenzimeve ( <b>Paga Neto + Sig Shoq &amp; Sig Shënd Punëdhënësi</b> )	245,027
TVSH (20%)	49,005
Gjobë TVSH (21.9%)	10,732
Tatim Fitimi (15%)	36,754
Gjobë Tatim Fitimi (21.9%)	8,049
Tatimi Neto pas TF	208,273
Tatim mbi Dividentin (8%)	16,662
Gjobë Tatim Dividenti (21.9%)	3,649
<b>Detyrime Total</b>	<b>124,851</b>

Burimi: DTM, përpunoni KLSH.

Nga sa më sipër janë sjellë si pasojë efekte tatimore të pallogaritura në shumën 36,754 lekë detyrime të tatimit mbi fitimin dhe 8,049 lekë gjobë 21.9%, 49,005 lekë detyrime të TVSH-së dhe 10,732 lekë gjobë 21.9%, 16,662 lekë detyrime të tatimit mbi dividendin dhe 3,649 lekë gjobë 21.9%, pra të ardhura gjithsej të munguar për buxhetin e shtetit në vlerën prej 124,851 lekë.

**-Subjekti:** “F.” SHPK.

**Nipti:** J.S.

**Adresë Kryesore:** Njësia Bashkiake Nr.2, Rruga “Murat Toptani”, përballe Kinema Milenium, godina Nr.3, Pedonalja, Tiranë.

**Aktiviteti:** Veprimtari në fushën e ndërtimeve të të gjitha llojeve restaurimit, ndërtime civile, industriale turistike, bujqësore. Ndërtime civile mbi 5 kate, rikonstruksione, ndërtim banese me skelet mbi 8 kate. Ndërtime rrugore. Punime të mirëmbajtjes dhe sinjalizimit në rrugë. Ndërtime autostrada-pista aeroportesh etj. Ndërtime hekurudhore dhe ura. Punime në sistemin elektrik dhe të sinjalizimit. Ndërtime ujësjellësa etj”. Shoqëria kryen shërbime në përputhje me aktet nënligjore të legalizuara për veprimtarinë e saj ekonomike.

**Lloji i Kontrollit:** Kontroll i plotë.

**Inspektori:** I. D.

**Inxhinier:** I. K.

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

- Për **TVSH** - periudha tatimore nga: **01/2020-04/2021**.

- Për **Tatim Fitimin** periudha tatimore nga: **2020**.

- Për **Sigurimet Shoqërore e Shëndetësorë** - periudha tatimore nga: **01/2020-04/2021**.

- Të tjera periudha tatimore nga: **01/2020-04/2021**.

Nga auditimi i raport kontrollit tatimor dhe akt verifikimit të mbajtur për subjektin “F.” SHPK, nga ana e inspektorit dhe inxhinierit pranë DTM, janë konstatuar mungesa e analizave dhe vlerësimeve të projektit dhe preventivit të punimeve, nuk është kryer një zbërthim i matrialeve dhe lëndës së parë në përbërje të punimeve të situacionuar, bazuar në manualin nr.1 “Analiza Teknike-Për prodhimin e matrialeve të ndërtimit, udhëzime dhe kriterë” dhe manualin nr.2 “Analiza Teknike-Për punimet e ndërtimit të ndërtesave”, si dhe krahasimi me punimet e kryera realisht në terren dhe si rezultat grupi i auditimit gjykon se jemi në kushtet e pamundësisë objektive për të vijuar analizën e mëtejshme të situatës . Gjithashtu janë konstatuar mungesa e analizave të librezës së masave, situacioneve pjesore mujore, progresive dhe përfundimtare të volumit të punimeve të ndërtimit, të cilat janë dokumenta justifikuese për verifikimin e volumit të punimeve të kryera sipas përcaktimeve të nënplikave 3.2 dhe 3.3 të pikës 3, Kreu 1 të Udhëzimit Nr.3, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, ndryshuar me Udhëzimin Nr.1 datë, 16.06.2011, konkretisht:

*3.2 Libreza e masave për punimet e ndërtimit është dokumentacioni bazë për verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve të ndërtimit, të vendosura në situacion. Kjo librezë hartohet nga drejtuesi teknik i objektit dhe firmoset nga ai, nga mbikëqyrësi i punimeve dhe nga përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit, për të cilin është miratuar leja e ndërtimit.*

*3.3 Situacionet mujore pjesore, progresive dhe përfundimtare hartohen mbi bazën e volumeve të llogaritura në librezën e masave dhe çmimeve faktike, mbështetur në analizat teknike të çmimeve, që përfshihen në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit, të miratuara çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave. Ato firmosen nga drejtuesi teknik i objektit, mbikëqyrësi i punimeve dhe përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit për të cilin është miratuar leja e ndërtimit. Në rastet kur në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit mungojnë analizat teknike të çmimeve të zërave të punimeve të kryera në objekt, veprohet në përputhje me procedurën e përcaktuar në pikën 8 të vendimit nr.514, datë 15.8.2007 të Këshillit të Ministrave "Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit".*

Nga verifikimi sipas të dhënave të C@ts, i pasqyrave financiare të vitit 2020, rezulton se subjekti në pasiv të bilancit (Detyrime Afatshkurtra) në zërin “Dëftesa të pagueshme (Marrëdhënie Ortaku)”, ka paraqitur huadhënien e ortakut ndaj shoqërisë pa interes dhe me pretendimin se

kanë shërbyer për mbulimin e shpenzimeve dhe blerjeve të mallrave me qëllim vazhdimin normal të aktivitetit të shoqërisë. Nga analiza e dosjes së kontrollit nuk gjejmë informacion sesi ortaku me saktësi i ka kaluar këto shuma mjeteshe monetare në favor të shoqërisë, pasi në raportin kontrollin tatimor nuk është përmendur dhe sqaruar asnjë dokument justifikues për të vërtetuar transaksionin, si konferma bankare të transaksionit, kontratë huadhënie midis palëve apo vendim asambleje të shoqërisë për këtë borxh që po merret nga ortaku, sepse referuar përcaktimeve të Ligjit Nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, rezulton se ortaku dhe shoqëria me përgjegjësi të kufizuara, janë entitete të ndryshme dhe me personalitet juridik të ndarë. Sipas legjislacionit tatimor, shoqëria dhe ortaku konsiderohen si “palë të lidhura”, meqenëse ortaku ka ndikim në vendimmarrjen e shoqërisë për shkak të zotërimit të kuotave/aksioneve të saj, sipas përcaktimeve në Ligjin Nr.42/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, gjë që sjell se çdo marrëdhënie apo transaksion midis tyre duhet t’u përmbahet kushteve dhe parimeve të tregut.

<i>Zëri i Bilancit</i>	<i>2020</i>
<i>Dëftesa të pagueshme (Marrëdhënie Ortaku)</i>	<i>231,804,933</i>

Burimi: DTM, përpunoni KLSH.

Në lidhje me rregullimin e TVSH-së në blerje, sqarojmë se për periudhën 01.01.2020-31.12.2020 shoqëria ka bërë rregullim për shitjet e përjashtuara të kryera për rindërtimin të cilën e ka pasqyruar në FDP e muajit Janar 2021 si më poshtë:

<b>Nr fat</b>	<b>Nr Serisë</b>	<b>Date</b>	<b>Shitësi</b>	<b>Rrethi</b>	<b>Nipti</b>	<b>VI Tat</b>	<b>TVSH</b>
1	77431501	31.01.2021	F. SHPK	Tiranë	J61922018S	-117,093,905	-23,418,781
			<b>Shuma</b>			<b>-117,093,905</b>	<b>-23,418,781</b>

Burimi: DTM, përpunoni KLSH.

Shoqëria gjatë periudhës Gusht-Nëntor 2020 ka realizuar dhe deklaruar si shitje të përjashtuara punime në lidhje me Rindërtimin. Kjo bazuar në nenin 53 të Ligjit Nr.92/2014 “Për TVSH”, i ndryshuar si dhe në udhëzimin në zbatim të tij, Ligjin Nr.97/2019 “Për Miratimin e Aktit Normativ me fuqinë e ligjit nr.9 date 16.12.2019 të Këshillit të Ministrave “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore, VKM-së Nr.143 datë 13.02.2020 "Për procedurat për lëshimin e autorizimit për subjektet e rindërtimit dhe për përjashtimin nga tatimi mbi vlerën e shtuar të furnizimit të mallrave dhe shërbimeve për qëllime të procesit të rindërtimit".

Për sa më sipër bazuar në kërkesën e shoqërisë “Për përjashtimin nga TVSH-ja për furnizimin e mallrave dhe Shërbimeve gjatë procesit të rindërtimit” me nr.159 prot datë 19.08.2020, protokolluar në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve me nr.16339 prot datë 19.08.2020, shoqëria F. SHPK është pajisur me dy autorizime përjashtimi si më poshtë vijon:

<b>Nr</b>	<b>Nr Autorizimi DTM</b>		<b>Nr Autorizimi DPT-së</b>	
1	6384/1	02.09.2020	86	26.08.2020
2	8868/1	27.11.2020	177	29.10.2020

Burimi: DTM, përpunoni KLSH.

Këto autorizime janë lëshuar në bazë të kërkesave të shoqërisë "F." SHPK për pajisje me autorizim në zbatim të, VKM Nr.804, datë 30.09.2020 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr.143, datë 13.02.2020. Sipas këtyre autorizimeve, shoqëria "F." SHPK, autorizohet

“Për përjashtimin nga TVSH-ja për furnizimin e mallrave dhe Shërbimeve gjatë procesit të rindërtimit”, ku te dhënat ne lidhje procesin e rindërtimit dhe deklarimet progresive deri në muajin Nëntor 2020 kohë në të cilën objekti i rindërtimit ka përfunduar plotësisht, paraqiten si më poshtë:

Autorizimi nga Drejtori i Përgjithshëm	Marrëveshja e lidhur për programin e rindërtimit	Leja e ndërtimit te objektit me date, përshkrim dhe afati	Sipërfaqe për rindërtim ose restaurim	Preventivi punimeve TP që është pajisur me autorizim	Periodha fillimit punimeve	Periodha e mbarimit të punimeve	Vlera e situacionit te punimeve progresive Dhjetor 2020 të faturuara te përjashtuar nga TVSH	Niveli punimeve progresive Dhjetor 2020/krahasuar me preventivin në %
Autorizim Nr.86 date 26.08.2020; Nr.Prot.16339/2 date 26.08.2020	Kontrata Nr.3, Nr.prot 1319 date 22.06.2020 ne zbatim te marrëveshjes kuadër Nr.831 date 17.04.2020 me Fondin e Zhvillimit	"Rindërtimi i shkollës 9-vjecare "Neim Babameto",Durrës me leje ndertimi Nr.903 dt.18.08.2020, me afat 6-muaji	2,988	224,500,000	Gusht 2020	Nëntor 2020	224,500,000	100
Autorizim Nr.177 date 29.10.2020; Nr.Prot.20258/1 date 29.10.2020	Kontrata Nr.25117/45 date 30.09.2020 lidhur me bashkine Tirane	Ndertim I shkolles 9-Vjecare 17-shkurti,Qesarake e Vjetër",Tirane me afat 6-muaji		191,431,500			-	-

Burimi: DTM, përpunoni KLSH.

**Autorizimi "Për përjashtim nga TVSH për subjektet e rindërtimit" nga DPT me Nr.86, datë 26.08.2020**, bazuar në kontratën midis shoqërisë “F.” SHPK dhe autoritetit kontraktor Fondit Shqiptar të Zhvillimit Nr.3, prot.1319, datë 22.06.2020, në zbatim të Marrëveshjes Kuadër Nr.831 datë 17.04.2020, "Rindërtimi i shkollës 9-vjecare “Neim Babameto”, Durrës, ku shoqëria është pajisur me leje ndërtimi Nr.903 datë 18.08.2020 nga Bashkia Durrës. Sipërfaqja e përgjithshme e ndërtimit sipas lejes së ndërtimit është 2,987.76 m<sup>2</sup>, numri i kateve mbi tokë 4 kate me afat kohor 6 muaji nga dita e fillimit të punimeve dhe vlerë preventivimi punimesh 224,500,000 lekë.

Nga sa më sipër grupi i auditimi gjykon se duhet të ishte kryer rregullimi i koeficientit të zbritjes së TVSH konform përcaktimeve të pikës 1 të nenit 69, neni 72, neni 78 si dhe neni 80 të Ligjit Nr.92/2014 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Nga të dhënat e raportit të kontrollit dhe sistemit C@ts në lidhje me shitjet për periudhën 01.01.2020-31.12.2020, grupi i auditimit ka rilogaritur koeficientin e zbritjes së TVSH-së, në vlerën 90.2%, mbi baza vjetore, për të gjithë periudhën, për të cilën gjykon se duhet të ishte kryer rregullimi i TVSH, për “Blerje të tatueshme me 20% TVSH nga furnitorë vendas”, “Importeve të investimeve me shkallë 20%” dhe “Investime nga furnitorë vendas me shkallë 20%”, për vitin 2020, të cilat janë blerje të furniturave, investimeve në mjete pune dhe ndërtim godinash për nevoja të biznesit, të cilat janë vështirë të ndashme masa e të cilave ka kontribuar dhe është përdorur për si për kryerjen e transaksioneve të tatueshme që sjellin të drejtën e zbritjes së TVSH-së mbi bazën e neneve 69 dhe 70, të këtij ligji, edhe për transaksionet që nuk e sjellin këtë të drejtë.

Nga kontrolli analitikë i “Blerjeve të tatueshme me 20% TVSH nga furnitorë vendas” për vitin 2020, janë evidentuar blerjet e furniturave të cilat u kanë shërbyer të dy aktiviteteve dhe mbi të cilën duhet të aplikohet koeficienti i zbritjes së TVSH-së.

Shitësi	Nipti	Rrethi	Vl Tat	TVSH	Emërtimi
A.t SHA	J.E	Fier	564,167	112,833	Lubrifikant
D.	J.C	Tirane	2,500	500	Taksa Vjetore
K.	J.P	Lushnje	3,477,887	695,579	Karburant
K.	J.K	Tirane	41,850	8,370	Pjese Kembimi,Servis

Dh.	J.I	Tirane	5,000	100	Sherbime Doganor
A. SHA	J.N	Tirane	49,956	9,996	Internet,Telefon
D.	J.C	Tirane	25,000	5,000	Agjensi Doganore
D.	J.C	Tirane	40,210	8,040	Taksa Vjetore
K.	J.P	Tirane	94,833	18,967	Materiale Zyre
F. SHPK	J.K	Tirane	746,000	149,200	Goma
G.	J.T	Tirane	4,255,020	851,004	Pjese Kembimi,Servis
T.	J.P	Tirane	2,175,557	435,112	Pjese Kembimi,Servis
A.S	J.G	Tirane	48,050	9,610	Pjese Kembimi
G.A	J6.M	Tirane	3,588,004	717,596	Sherbim Laboratorik
T. SHPK	J.Q	Tirane	524,441	104,887	Pjese Kembimi
X. SHA	JF	Kavaje	286,015	57,203	Pjese Kembimi
O. SHPK	J.I	Tirane	54,976,078	10,995,214	Karburant
Fbl P.	J.B	Tirane	34,960	6,992	Servis
K. Shk	J.C	Tirane	9,578,948	1,915,788	Vegla Pune, Mat Nd
A. SHPK	J.M	Tirane	732,200	146,440	M.Elektroshtepiake
N. SHPK	J.S	Sarande	16,250	3,250	Pjese Kembimi
A. SHPK	J.R	Tirane	123,310	24,662	Gjeotekstil
I. 99 SHA	J.T	Fier	19,317,534	3,863,506	Solar
K. O SHA	J.L	Durres	497,584	99,516	Pjese Kembimi
Al. U.	J.D	Tirane	174,024	34,804	Pjese Kembimi
G.SHPK	J.D	Tirane	113,880	22,776	Pjese Kembimi
L. I.	J.P	Tirane	77,625	15,525	Uje
T. SHA	K.P	Tirane	54,250	10,850	Pjese Kembimi
M. SHPK	K.H	Tirane	5,909,802	1,181,961	Vegla Pune
R. SHPK	K.H	Tirane	1,552,383	310,479	Pjese Kembimi
A.	K.B	Tirane	10,000	2,000	Kamera
V.A.	K.L	Tirane	594,077	118,815	Sherbim Telefonik
N.	K.B	Tirane	20,167	4,033	Mat.Elektroshtepiake
T. O. SHA	K.F	Diber	9,501,899	1,900,379	Pjese Kembimi
A.V. Pune	K.L	Tirane	14,201	2,840	Vegla Pune
F. R.	K.J	Tirane	4,347,048	869,411	Pjese Kembimi
N.SHPK	K.T	Vlore	21,833	4,367	Sherbim Interneti
R.M	K.N	Tirane	160,000	32,000	Studim Gjeologjik
D.D	K.T	Tirane	55,000	11,000	Mirembajte Ashkensori
J.L	K.V	Tirane	155,001	30,999	Pjese Kembimi,Servis
S. A. 2000	K.F	Tirane	24,000	4,800	Servis
I. H.	K.E	Tirane	57,659	11,531	Pjese Kembimi
K.	K.A	Tirane	9,829,352	1,965,870	Veshje Pune
B. O. SHA	K.T	Tirane	69,167,666	13,833,534	Karburant
R P.a	K.A	Rrogozhine	440,833	88,167	Pjese Kembimi
D.C	K.R	Fier	1,271,183	254,237	Pjese Kembimi
TH.K	K.B	Sarande	3,833	767	Shpenzime Noterial
T.A	K.S	Tirane	107,000	21,400	Sherbim Interneti
F.S	K.P	Vlore	17,500	3,500	Vegla Pune
A.e SHPK	K.J	Tirane	25,833	5,167	Veshje Pune
T. Th.	K.I	Tirane	150,417	30,083	Pjese Kembimi
B.-Alb SHPK	K.K	Tirane	26,666	5,334	Distributor Uji
U. Albania	K.V	Tirane	266,560	53,312	Pjese Kembimi
U. T.	K.I	Tirane	2,617	523	Deklarate Doganore
A.H.	K.E	Tirane	3,460,633	692,127	Pjese Kembimi
T. SHPK	K.B	Tirane	52,917	10,583	Pjese Kembimi
H. SHPK	K.Ë	Tirane	2,235,330	447,069	Pjese Kembimi
P. A.	K.P	Tirane	306,293	61,259	Pjese Kembimi
V. Gj.	K.H	Sarande	59,084	11,816	Pjese Kembimi,Servis
F. S.	K.M	Tirane	24,916	4,984	Pjese Kembimi
M.T.	K.B	Tirane	65,833	13,167	Mobilje
E. Td SHPK	K.M	Durres	125,000	25,000	Pjese Kembimi
K. 06 SHPK	K.R	Tirane	7,173,712	1,434,743	Goma
K. SHPK	K.U	Tirane	154,535	30,907	Vegla Pune
Z. Trans SHPK	K.T	Berat	6,500	1,300	Transport,Agjensi Dog
A. T.	K.P	Tirane	199,000	39,800	Pjese Kembimi,Riparim
S. E. SHPK	K.Q	Vlore	7,639,599	1,527,920	Pilota
5a SHPK	K.A	Tirane	39,667	7,933	Vegla Pune
G. I. T.	K.H	Tirane	226,659	45,332	Veshje Pune
C.A.A SHPK	K.O	Tirane	35,883,740	7,176,748	Goma



5a SHPK	K.A	Tirane	302,750	60,550	Vegla Pune
B. Group	K.O	Tirane	3,625,000	725,000	Karburnat
I. S.	K.R	Durres	921,524	184,306	Materiale Zyre
D. P. A. SHPK	K.J	Tirane	520,738	104,146	Banera`
A. Security	K.M	Tirane	3,624,000	724,800	Sherbim Sigurie
P. O. SHPK	K.B	Tirane	4,750	950	Kuti Ndhime E Shpejte
O.	K.H	Tirane	947,149	189,428	Energji Elektrike
A.-3d SHPK	K.M	Vlore	5,917	1,183	Vegla Pune,Mat Nde
V.t A.	K.T	Vlore	138,167	27,633	Vegla Pune
M.r A.	K.F	Tirane	5,250	1,050	Gaz
M.	K.Q	Tirane	29,171	5,834	Trans+Shebrim Portual
lt SHPK	K.B	Tirane	260,937	52,187	Kamera
S. SHPK	K.O	Tirane	229,849	45,970	Skela
A. SHPK	K.D	Tirane	458,025	91,605	Pajisje Sigurie
I.SHPK	K.I	Tirane	527,972	105,594	Printime
H. SHPK	K.U	Tirane	166,259	33,252	Makineri Pune
K.T SHPK	K.K	Kavaje	646,533	129,307	Riparim Makinash
K. K.	K.E	Fier	702,879	140,575	Sherbim me Vinc
A. M. SHPK	K.O	Tirane	75,833	15,167	Pjese Kembimi
K. B.	K.S	Vlore	114,835	22,965	Dhe, Transport
V. Al S. SHPK	K.D	Tirane	83,333	16,667	Pjese Kembimi
H.A. SHPK	K.U	Tirane	587,231	117,447	Makineri Pune
A.I	K.P	Tirane	27,140	5,428	Kompjuter
M.R	K.S	Tirane	470,005	94,001	Bandera,Tabela Punimesh
K.D	K.A	Durres	14,833	2,967	Vegla Pune,Pj.Kembimi
T. C SHPK	K.D	F-Kruje	1,923,252	384,650	Pjese Kembim,Servis
I.SHPK	K.I	Tirane	171,282	34,256	Printime
K. K.	K.O	Sarande	116,333	23,267	Pjese Kembimi
H.SHPK	K.D	Shkoder	192,000	38,400	Certifikim Personeli
S. A.Albania	K.V	Tirane	151,572	30,327	Kolaudime
Is I.Service	L.H	Tirane	22,496	4,499	Pjese Kembimi
A. D.	L.L	Durres	110,000	22,000	Pjese Kembimi
P. S. Shkp	L.A	Tirane	1,037,767	207,553	Kompjuter
I. G. SHPK	L.A	Durres	56,000	11,200	Pjese Kembimi
A.T SHPK	L.T	Durres	178,333	35,667	Trans,Sherbim Dog
M.M	L.S	Durres	137,500	27,500	Riparim Kafazesh
L.I	L.O	Tirane	91,666	18,334	Elektromotor
L.	L.A	Tirane	957,702	191,540	Pjese Kembimi
Ecit	L.M	Tirane	22,333	4,467	Pasaporte, Kontroll
E.T SHPK	L.V	Tirane	197,551	39,511	Vegla Pune
R.G SHPK	L.H	Durres	107,398	21,480	Transport
T.O SHA	L.F	Diber	433,416	86,683	Pjese Kembimi
S.D SHPK	L.P	Tirane	115,409	23,082	Kolaudime
ID	L.P	Shijak	416,669	83,331	Sherbime Juridike
S. SHA	L.A	Tirane	686,513	137,303	Pjese Kembimi
E.N	L.A	Tirane	417,388	83,478	Automjet
V. SHPK	L.S	Tirane	132,000	26,400	Tahograf
A.P	L.V	Tirane	63,200	12,640	Sherbim Noterie
F.O	L.B	Tirane	237,500	47,500	Goma
T.A.H	L.M	Tirane	273,293	54,659	Certifikim Iso
A.t SHPK	L.T	Tirane	22,686	4,537	Pjese Kembimi
D.A SHPK	L.Q	Tirane	1,000	200	Pjese Kembimi,Tuba
T.A.T	L.K	Tirane	182,438	36,488	Tahograf
C.S SHPK	L.T	Durres	515,621	103,124	Pjese Kembimi
F.D	L.O	Durres	385,392	77,078	Riparime Makinash
R.S	L.A	Tirane	602,575	120,515	Vegla Pune
A. SHA	L.E	Fier	4,575,470	915,094	Vaj Lubrifikant
M.J	L.U	Tirane	25,000	5,000	Sherbim Noterie
M.J	L.V	Tirane	871,330	174,266	Sherbim Noterie
R.P	L.C	Durres	1,807,856	361,571	Karburant
E. SHPK	L.G	Tirane	152,635	30,525	Bojra,Printer
E.P.A	L.L	Tirane	859,000	171,800	Trajnim me Certifikim
M.T	L.N	Tirane	52,917	10,583	Pjese Kembimi
E.O	L.R	Tirane	241,666	48,334	Lubrifikante
A.D	L.3F	Vlore	11,667	2,333	Uje
T.D	L.O	Tirane	17,500	3,500	Veshje Pune



A.M	L.U	Tirane	978,640	195,728	Sherbim Konsulence
E.Z	L.U	Durres	756,667	151,333	Pjese Kembimi, Riparim
A.S	L.V	Tirane	436,000	87,200	Sherbime Mekanike
A. SHPK	L.A	Tirane	20,416	4,084	Pjese Kembimi
K.G SHA	L.I	Tirane	14,078,166	2,815,634	Gaz
T. SHPK	L.F	Tirane	94,000	18,800	Rikualif Punonjesish
H.U	L.G	Kavaje	9,685	1,937	Pjese Kembimi
E.L	L.V	Fier	333,333	66,667	Pjese Kembimi
IS	L.J	Lushnje	64,167	12,833	Riparim Automjetesh
S.A SHPK	L.J	Tirane	705,400	141,080	Veshje Pune
M. T. C.	L.G	Durres	121,000	24,200	Goma
G. SHPK	L.D	Tirane	2,279,066	455,812	Vegla Pune
I. SHPK	L.M	Tirane	25,729	5,146	Vegla Pune
T.H	L.G	Durres	2,628,000	525,600	Transport
M.P	L.A	Durres	404,886	80,977	Tenda Kamioni
C.B SHA	L.G	F-Kruje	24,562	4,912	Pjese Kembimi
S.R	L.F	Vlore	12,500	2,500	Pjese Kembimi
M Group	L.M	Lezhe	290,548	58,110	Pjese Kembimi, Servis
E.X	L.P	Tirane	14,500	2,900	Monitor
D.H SHPK	L.J	Tirane	27,481	5,496	Mobilje
C.C	L.R	Durres	340,416	68,084	Kafe
E. SHPK	L.S	Tirane	2,957	591	Materiale Zyre
D.P SHPK	L.G	Tirane	185,000	37,000	Ngarkim,Transport
A.K	L.P	Tirane	21,000	4,200	Servis
A.P	L.S	Tirane	346,100	69,220	Pjese Kembimi
B.Group	L.O	Kamez	38,537,500	7,707,500	Karburnat
B.B	L.U	Tirane	56,470	11,294	Veshje Pune,Maska
U. SHA	L.P	Tirane	401,588	80,316	Uje
V.B	L.B	Fier	103,040	20,608	Pjese Kembimi
M.A	L.I	Tirane	600,000	120,000	Sherbim Auditimi
E.R	L.I	Tirane	603,000	120,600	Sherbim GPS
A, SHPK	L.T	Tirane	36,891	7,378	Shebrim Konsulence
I.D	L.O	Tirane	1,113,570	222,714	Sherbime Juridike
P. SHPK	L.J	Tirane	10,500	2,100	Riparim Paisjesh
T. SHPK	L.M	Sarande	895,088	179,012	Transport
B	L.K	Tirane	100,363	20,072	Vegla Pune
S.E	L.K	Tirane	45,716,752	9,143,348	Karburant
L.S	M.Q	Tirane	14,500	2,900	Pjese Kembimi
G.D	M.Q	Tirane	1,113,570	222,714	Konsulence Juridike
H.S	M.M	Tirane	36,167	7,233	Pjese Kembimi
<b>Totali</b>			<b>409,609,705</b>	<b>81,921,037</b>	

Burimi: DTM, përpunoni KLSH.

Nga kontrolli analitikë i “Importeve të investimeve me shkallë 20%” dhe “Investime nga furnitorë vendas me shkallë 20%”, për vitin 2020, janë evidentuar blerjet e makinave të punës dhe mjeteve të transportit, të cilat u kanë shërbyer të dy aktiviteteve dhe mbi të cilën duhet të aplikohet koeficienti i zbritjes së TVSH-së.

Shitësi	Vendi	VI Tat	TVSH	Përshkrimi
S.T	France	9,268,770	1,853,754	Eskavator
F.M	Kine	2,338,685	467,737	Makineri per prerje guri
T.I	Itali	1,208,990	241,798	Impjant betoni
T.I	Itali	2,681,870	536,374	Impjant betoni
T.I	Itali	2,724,830	544,966	Panele metalike
Z.E	Itali	488,505	97,701	Makineri per prerje metali
P/G	Gjermani	1,053,904	210,781	Kapese metalike per fabrikate
A.I	Itali	2,766,176	553,235	Autobetoniere
C.O	Itali	9,928,596	1,985,719	Fadrome volvo
C.O	Itali	6,964,836	1,392,967	Fadrome volvo
T.I	Itali	174,076	34,815	Makineri per pastrim rere
C.G	Itali	1,036,718	207,344	Koke terheqese
C.A	Itali	1,896,435	379,287	Fadrome volvo
C.G	Itali	2,536,637	507,327	Gjysem rimorkio
C.A	Itali	5,714,095	1,142,819	Makineri asfalto shtruese
T.G	Itali	766,011	153,202	Makineri pastruese rere

C.G	Itali	2,536,637	507,327	Koke terheqese
C.G	Itali	1,070,222	214,044	Gjysem rimorkio
C.P	Itali	82,271	16,454	Varke vetelevizese
F.X	Kine	3,029,743	605,949	Sonde shpimi
T.I	Itali	322,634	64,527	Reduktor per mak vinc
C.G	Itali	2,539,502	507,900	Koke terheqese
C.G	Itali	1,073,430	214,686	Gjysem rimorkio
C.G	Itali	1,071,085	214,217	Gjysem rimorkio
C.G	Itali	2,538,683	507,737	Koke terheqese
D. B.SRL	Itali	5,014,827	1,002,965	Kamion man
I.G	Itali	3,106,879	621,376	Greider, pirun
C.G	Itali	1,361,580	272,316	Betoniere
Z.	Itali	2,523,899	504,780	Rrashinuse asfalto betoni
R.M	Itali	1,249,342	249,868	Autobetoniere
B.M	Itali	1,429,795	285,959	Bobkat
C. SPA	Itali	662,896	132,579	Kamion i perdorur
C.SPA	Itali	849,820	169,964	Gjysem rimorkio
<b>Shuma</b>		<b>82,012,379</b>	<b>16,402,474</b>	

Burimi: DTM, përpunoni KLSH.

Shitësi	Rrethi	Nipti	VI Tat	TVSH	Pershkrimi
T.Shqiperi	Tiranë	J.P	5,206,597	1,041,319	Eskavator
T.Shqiperi	Tiranë	J.P	5,206,597	1,041,319	Eskavator
T.Shqiperi	Tiranë	J.P	9,667,057	1,933,411	Eskavator
T.Shqiperi	Tiranë	J.P	9,667,057	1,933,411	Eskavator
T.C SHPK	F- Krujë	K.D	12,404,000	2,480,800	Makineri e rëndë pune
A.S.A SHA	Tiranë	J.G	5,676,917	1,135,383	Makinë pune Pick-Up
F. SHPK	Tiranë	J.S	40,550,500	8,110,100	Ndërtim për vete Godinë Polifunkionale TEG
V.Mi. Albania	Tiranë	L.L	1,000,000	200,000	Makineri për thyerje guresh
F. SHPK	Tiranë	J.S	51,863,280	10,372,656	Ndërtim për vete Godinë Polifunkionale TEG
<b>Shuma</b>			<b>141,242,005</b>	<b>28,248,399</b>	

Burimi: DTM, përpunoni KLSH.

Nga kontrolli i sistemit C@ts ka rezultuar se nuk ka dorëzuar brenda datës 31 mars, inventarin analitik të mallrave, si dhe inventarin e aktiveve afatgjata gjendje deri më datë 31 dhjetor të vitit fiskal sipas kërkesave të pikës 3.12 “Deklarimi tatimor dhe llogaritja përfundimtare e detyrimit” të Udhëzimit Nr.5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar. Gjithashtu në raportin e kontrollit tatimor nga ana e inspektorese nuk është kryer një analizë e detajuar e shfrytëzimit të mjeteve të transportit, rrugët e realizuara, normativat e konsumit për rrugë, proces pune ose volum punimesh etj, veprime këto në kundërshtim me përcaktimet e nenit 55 “Kufizime të zbritjes së TVSH për disa furnizime” të Udhëzimit Nr.6 , datë 30.01.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në R.SH” dhe si rezultat grupi i auditimit gjykon se jemi në kushtet e pamundësisë objektive për të vijuar analizën e mëtejshme të situatës:

*Shpenzimet faktike për gazoilin për çdo veprimtari ekonomike duhet të justifikohen me volumin e punës së kryer, rrugët e realizuara nga mjete/et, normativat e konsumit të gazoilit për rrugë ose proces të kryer, etj. Në çdo rast, këto shpenzime duhet të jenë të kryera realisht dhe të justifikuara sipas veprimeve të realizuara për nevoja të veprimtarisë ekonomike, të provuara me dokumentacionin përkatës, por jo më shumë se normativat e përcaktuara në këtë udhëzim.*

Nga sa më sipër janë evidentuar disa fatura furnizimi karburant nga shoqëria të cilat nuk justifikohen me volumin e punës së kryer, rrugët e realizuara nga mjete/et, normativat e konsumit të gazoilit për rrugë ose proces të kryer etj. Gjithashtu nuk justifikohen nga aspekti fizik sasia e madhe e karburantit të furnizuar për shkak se subjekti nuk ka depozita të deklaruara si dhe nuk

ka marrëveshje për depozitim me shoqëri të tjera dhe si rezultat grupi i auditimit gjykon se jemi në kushtet e pamundësisë objektive për të vijuar analizën e mëtejshme të situatës .

Nr Faturës	Numri Serial	Data Faturës	Emri i Shitësit	Rrethi	NIPT	Vlera	VI Tat Furnitor vendas	TVSH	Çmim mes	Sasia/Lt
696	66849800	03.01.2020	B. Group	Tiranë	L.O	4,950,000	4,125,000	825,000	140	35,357.14
261646199	261646199	31.01.2020	O SHPK	Tiranë	J.I	5,600,000	4,666,667	933,333	140	40,000.00
711	66849815	01.02.2020	B.i Group	Tiranë	L.O	4,950,000	4,125,000	825,000	140	35,357.14
727	668449831	01.03.2020	B.i Group	Kamëz	L.O	3,100,000	2,583,333	516,667	140	22,142.86
261646484	261646484	01.03.2020	O. SHPK	Tiranë	J.I	5,600,000	4,666,667	933,333	140	40,000.00
<b>261547307</b>	<b>261547307</b>	<b>31.05.2020</b>	<b>O. SHPK</b>	<b>Fier</b>	<b>J.3I</b>	<b>1,410,000</b>	<b>1,175,000</b>	<b>235,000</b>	<b>140</b>	<b>10,071.43</b>
<b>261647307</b>	<b>261647307</b>	<b>31.05.2021</b>	<b>O. SHPK</b>	<b>Fier</b>	<b>J.I</b>	<b>843,100</b>	<b>702,583</b>	<b>140,517</b>	<b>140</b>	<b>6,022.14</b>
769	66849863	01.06.2020	B. Group	Tiranë	L.O	4,410,000	3,675,000	735,000	140	31,500.00
779	68849873	01.07.2020	B.Group	Tiranë	L.O	4,410,000	3,675,000	735,000	140	31,500.00
261598046	261598046	21.07.2020	O. SHPK	Fier	J.I	4,410,000	3,675,000	735,000	140	31,500.00
792	668449887	01.08.2020	B. Group	Tiranë	L.O	4,350,000	3,625,000	725,000	140	31,071.43
261648127	261648127	25.08.2020	O. SHPK	Tiranë	J.I	5,258,000	4,381,667	876,333	140	37,557.14
261648338	261648338	31.08.2020	O. SHPK	Tiranë	J.I	2,063,845	1,719,871	343,974	140	14,741.75
807	66849902	01.09.2020	B. Group	Tiranë	L.O	4,350,000	3,625,000	725,000	140	31,071.43
816	66849911	01.10.2020	B. Group	Tiranë	L.O	4,350,000	3,625,000	725,000	140	31,071.43
261649046	261649046	31.10.2020	O.SHPK	Tiranë	J.I	2,221,249	1,851,041	370,208	140	15,866.06
828	66849923	01.11.2020	B. Group	Tiranë	L.O	4,900,000	4,083,333	816,667	140	35,000.00
839	668449934	01.12.2020	B. Group	Tiranë	L.O	5,600,000	4,666,667	933,333	140	40,000.00
845	66849940	01.01.2021	B. Group	Tiranë	L.O	4,900,000	4,083,333	816,667	140	35,000.00
26165006	26165006	15.01.2021	O. SHPK	Tiranë	J.I	4,330,650	3,608,875	721,775	140	30,933.21
261598723	261598723	16.02.2021	O. SHPK	Fier	J.I	4,778,500	3,982,083	796,417	140	34,132.14
<b>858</b>	<b>66849953</b>	<b>01.03.2021</b>	<b>B.Group</b>	<b>Tiranë</b>	<b>L.O</b>	<b>4,550,000</b>	<b>3,791,667</b>	<b>758,333</b>	<b>140</b>	<b>32,500.00</b>
<b>867</b>	<b>66849962</b>	<b>01.03.2021</b>	<b>B.Group</b>	<b>Tiranë</b>	<b>L.O</b>	<b>4,440,000</b>	<b>3,700,000</b>	<b>740,000</b>	<b>140</b>	<b>31,714.29</b>
261650700	261650700	16.03.2021	O. SHPK	Fier	J.I	4,622,040	3,851,700	770,340	140	33,014.57
878	66849973	01.04.2021	B. Group	Kamëz	L.O	4,440,000	3,700,000	740,000	140	31,714.29
<b>261598944</b>	<b>261598944</b>	<b>16.04.2021</b>	<b>O.I SHPK</b>	<b>Fier</b>	<b>J.3I</b>	<b>310,000</b>	<b>258,333</b>	<b>51,667</b>	<b>140</b>	<b>2,214.29</b>
<b>261651070</b>	<b>261651070</b>	<b>16.04.2021</b>	<b>O.SHPK</b>	<b>Fier</b>	<b>J.I</b>	<b>5,225,000</b>	<b>4,354,167</b>	<b>870,833</b>	<b>140</b>	<b>37,321.43</b>

Burimi: DTM, përpunoni KLSH.

Gjithashtu nga kontrolli i artikujve të librave të blerjes për periudhë tatimore të vitit 2020, ka rezultuar blerje lëndë djegëse solar, por nuk ka të sqaruar në raport kontrolli se sipas cilit proces përdoret kjo lëndë djegëse dhe n.q.s. ka kartë teknologjike për këtë proces prodhimi dhe si rezultat grupi i auditimit gjykon se jemi në kushtet e pamundësisë objektive për të vijuar analizën e mëtejshme të situatës .

Shitësi	Nipti	Rrethi	VI Tat	TVSH	Emërtimi
I. 99 SHA	J.T	FIER	19,317,534	3,863,506	SOLAR

Burimi: DTM, përpunoni KLSH.

**-Subjekti:** “A.K” SHPK.

**Nipti:** K.M.

**Adresë kryesore:** Kodra e Diellit II, Godine e kombinuar 4 kat + 1 kat nëntokë, Nr.Pasurie 51/159, Selitë, Tiranë.

**Aktiviteti:** Aktiviteti i ndërtimit dhe investimeve në ndërtimin e godinave me karakter civil e industrial.

**Lloji i Kontrollit:** Kontroll i Plotë.

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

- Për **TVSH** - periudha tatimore nga: **02/2020-06/2021**.

- Për **Tatim Fitimin** periudha tatimore nga: **2019-2020**.

- Për **Sigurimet Shoqërore e Shëndetësorë** - periudha tatimore nga: **02/2020-06/2021**.

- Të Tjera periudha tatimore nga: **02/2020-06/2021**.

Nga auditimi i raportit të kontrollit tatimor u konstatua se:

- Është kryer kontrolli i TVSH-së duke krahasuar të dhënat midis FDP së TVSH-së dhe librave të blerjes të deklaruar në sistemin informatik tatimor C@TS, ku nuk rezultojnë diferenca.

- U bë krahasimi i të dhënave të raportuara për eksportet në SIT C@ts dhe kanë rezultuar diferenca më të dhënat e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave të cilat janë argumentuar nga ana e inspektorit të kontrollit.
- Nga krahasimi i të dhënave sipas faturave tatimore të shitjes të regjistruara në librat e shitjes me të dhënat sipas FDP-ve të deklaruara nga ana e subjektit në SIT C@TS, ku nuk kanë rezultuar diferenca.
- U bë krahasimi i të dhënave të raportuara për importet në SIT C@ts dhe kanë rezultuar diferenca më të dhënat e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave të cilat janë argumentuar nga ana e inspektorit të kontrollit.
- U bë analiza e TVSH-se dhe faktorët influencues ne pagesën e saj dhe nuk kanë rezultuar problematika.
- U bë analiza e blerjes së karburantit dhe TVSH- së kredituar e cila ka rezultuar brenda normave të lejuara të përcaktuara në neni 55 të Udhëzimit Nr.6 datë 30.01.2015 "Për TVSH në R.SH", i ndryshuar.
- U bë analizave e blerjeve dhe shitjeve në funksion të punimeve të situacionuara për rindërtimin sipas Autorizimeve për përjashtim nga TVSH- , ku janë evidentuar disa diferenca për të cilat janë përlllogaritur detyrimet dhe penalitetet përkatëse.
- U bë inventarizimi fizik dhe lëvizja e bazës materiale sipas bilancit të lëvizjes materiale për artikujt qe zënë e peshën kryesore ne aktivitetin e shoqërisë dhe nuk kanë rezultuar problematika.
- U bë analiza e objekteve për të cilat shoqëria ka deklaruar punime për periudhën e kontrolluar, për të cilat në disa raste janë bërë rivlerësime në të ardhura nga ana e inspektorit të kontrollit.
- U bë kontrolli për tatimin mbi fitimin dhe elementët e pasqyrave financiare si aktive, pasive, kapitalin dhe PASH dhe nuk kanë rezultuar problematika.
- U bë kontrolli për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe TAP dhe nuk kanë rezultuar problematika.
- U bë kontrolli për tatimin në burim në zbatim te Ligjit me nr 8438 date 28/12/1998 Për Tatimin mbi te Ardhurat , ligjit me nr 9920 date 19/05/2008 Për Procedurat Tatimore ne RSH neni 117, pika b si dhe UMF-ve ne zbatim te tyre, ku janë evidentuar disa detyrime për të cilat janë përlllogaritur edhe penalitetet përkatëse nga inspektori.

**-Subjekti:** “D.” SHPK.

**Nipti:** L.D.

**Adresë Kryesore:** Autostrada TR-DR, Km 5, Stacioni Zoteknik, Xhafzotaj, Durrës.

**Aktiviteti:** Prodhim dhe tregtim, Llac i thatë, koll, stuko, prodhime të tjera me bazë çimento, grafiato të lëngshme, bojra. Shoqëria mund të ndërtojë objekte/ndërtime civile në funksion të aktivitetit të saj. Tregti me shumicë dhe pakicë. Shitje-blerje pasuri të paluajtshme. Prodhim dhe tregtim polisteroli (EPS). Punime të ndryshme të të gjitha këtyre materialeve që prodhon shoqëria, import-eksport të të gjitha këtyre materialeve. Punime ndërtimi si muratura, suvatime, nivelime, shtrim pllakash, instalime elektrike, hidroizolime dhe hidraulike, parket, karpentieri, punime të ndryshme ndërtimi me nënkontraktore etj. Rikonstruksione për objektet e veta, për godina banimi, pallate të ndryshme, ndërtime civile dhe ekonomike për çfarëdo lloj objekti, veshje fasadash të godinave të ndryshme, prodhim dhe tregtim materiale inertesh e materiale të ndryshme ndërtimi si dhe lëndë drusore. Prerje dhe përpunim pllake gres, porcelani, mermer, granit, gur, xham, kuarc, qeramike etj në forma dhe përmasa të ndryshme. Dhënie me qera të ambienteve të shoqërisë për palë të treta, me qëllim ushtrim aktiviteti.

**Lloji i Kontrollit:** Kontroll i plotë.

**Inspektori: I. T.**

Sipas aktit të kontrollit subjekti është kontrolluar për:

- TVSH-në për periudhën nga 2019/10-2021/02
- **Tatim Fitimin** për vitet 2019-2020
- **Sigurimet Shoqërore, Shëndetësore dhe TAP-in** për periudhën nga 2019/10-2021/02
- **Tatime të tjera** 2019/10-2021/02

Nga auditimi i raportit të kontrollit tatimor u konstatua se:

- Është kryer kontrolli i TVSH-së duke krahasuar të dhënat midis FDP së TVSH-së dhe librave të blerjes të deklaruar në sistemin informatik tatimor C@TS, ku rezultojnë diferenca të cilat janë argumentuar nga ana e inspektorit të kontrollit, dhe në rastet e evidentimit të blerjeve që nuk kanë qenë në funksion të aktivitetit të shoqërisë, janë përlogaritur detyrimet dhe penaltitetet përkatëse.
- Është kryer kontrolli i TVSH-së duke krahasuar të dhënat midis FDP së TVSH-së dhe librave të shitjes së deklaruar në sistemin informatik tatimor C@TS, ku rezulton të mos ketë diferenca.
- U bë analiza e blerjes së karburantit dhe TVSH- së kredituar e cila ka rezultuar brenda normave të lejuara të përcaktuara në neni 55 të Udhëzimit Nr.6 datë 30.01.2015 "Për TVSH në R.SH", i ndryshuar.
- U bë analiza e autofaturimeve të kryera në zbatim të skemës së autofaturim (reverse charge) sipas Ligjit nr.92/2014 date 24/07/2014 "Për TVSH-ne" dhe Udhëzimit nr 6 date 30.01.2015 në zbatim të tij, dhe konkretisht neni 24 i ligjit dhe neni 24 pika 3 i udhëzimit, ku faturat janë paraqitur si në librin e blerjeve dhe në atë të shitjeve.
- Është kryer analiza dhe rregullimi i TVSH-së, në blerje dhe shitje për punime të përjashtuara të rindërtimit që ka kryer subjekti sipas autorizimeve përkatëse.
- Është kryer inventarizimi fizik në selinë e shoqërisë për disa prej artikujve që zënë peshën më të madhe të aktivitetit.
- Është kryer bilanci material për artikujt që zënë peshën kryesore në aktivitetin e shoqërisë, duke marrë për bazë të dhënat e kontrollit të fundit datë 04.02.2020, shitjet dhe blerjet e shoqërisë për periudhën 04.02.2020-31.05.2021 dhe gjendjet kontabël.
- Është kryer analiza e KMSH dhe çmimit të shitjes ku ka rezultuar se shoqëria operon me një marzh çmimi të lartë krahasuar me mesataren e industrisë.
- Është kryer zberthimi i kartës teknologjike dhe nuk kanë rezultuar problematika.
- Është kryer kontrolli për transaksionet me subjektet pasive dhe nuk kanë rezultuar problematika.
- U bë kontrolli për tatimin mbi fitimin dhe elementët e pasqyrave financiare si aktive, pasive, kapitalin dhe PASH dhe nuk kanë rezultuar problematika.
- U bë kontrolli për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe TAP dhe nuk kanë rezultuar problematika.
- U bë kontrolli për tatimin në burim për deklarimet dhe pagesat e shoqërisë dhe nuk kanë rezultuar problematika.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni pa nr protokollit dhe datë 15.08.2023 "Kundërshtim për Projekt Raportin e Auditimit", protokolluar në KLSH me Nr.14/10 Prot., datë 29.08.2023, nga Znj. M. Xh, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

***Pretendimet e subjektit:*** Në observacionin e dërguar nga Inspektoria e Kontrollit Operacional Znj. M. Xh., ka parashtruar si në vijim: - Pretendon se në raport janë pasqyruar lëvizjet materiale të deklaruar nga akti i inxhinierit si dhe volumet e punimeve janë deklaruar në çdo situacion mujorë për secilin objekt më vete. - Pretendon se objekti nuk është përfunduar por niveli i realizimit të punimeve

është 92% si dhe shprehet se niveli referues i kostove sipas EKB nuk është i zbatueshëm, si element i bazës së vlerësimit. Gjithashtu citon se DTM i ka kërkuar Drejtorisë Ligjore dhe Teknike me shkresën Nr.307 datë kërkesë për interpretim dhe në përgjigje të kësaj kërkesë ku thuhet se kostot mesatare të ndërtimit nuk janë akte nënligjore të nxjerra në zbatim të ligjeve tatimore. Si të tilla nuk mund të shërbejnë për përcaktimin e shkeljeve të legjislacioni tatimor apo shmangieve të detyrimeve tatimore, ky udhëzim nuk përcakton si shkelje midis kostos dhe çmimit të shitjes pasi nuk përcakton dhe nuk është për llogaritjen e detyrimeve tatimore të tatimpaguesit. Kostoja faktike e realizuar është rezultat i volumit të punimeve dhe materialeve të përdorura, të situacionuara dhe deklaruara në libra dhe FDP. Këto janë dokumenta të cilat janë verifikuar nga kontrolli tatimor. Gjatë kontrollit nuk është konstatuar asnjë kusht që parashikon neni 71 i Ligjit Nr.9920, pra nuk mund të përdoret e drejta për vlerësim alternativë. Sqarim i mëtejshëm është bërë se objekti është kolauduar në tetor 2022 dhe nga vlera progresive e pasqyruar në raportin e kontrollit prej 472,622,381 lekë janë shtuar volumet e punimeve prej 48,031,895 lekë, duke çuar situacionin përfundimtar të realizuar për objektin në vlerën totale 520,654,276 lekë, e cila pjesëtuar më sipërfaqen e ndërtimit prej 16,284.84 m<sup>2</sup> sipas akt kolaudimit përfundimtar, kemi një shtesë në kosto prej 2,949 lek/m<sup>2</sup> (48,031,895 lek/16,284.84 m<sup>2</sup>). Siç shihet shtesa e kostos për 2,949 lek/m<sup>2</sup> nga subjekti është më e madhe se vlerësimi i bërë nga ana e Kontrollit të Lartë të Shtetit me 1,491 lek/m<sup>2</sup>, bashkangjitur observacionit janë vendosur si dokumentacion justifikues Akt Kolaudimi dhe Situacioni Përfundimtar i objektit të përfunduar. - Në lidhje me diferencat e konstatuara në artikullin “Hekur”, sqarohet se në librat e blerjes janë të pasqyruara të gjitha faturimet për blerje ku në brendësi të faturës përshkruhen parapagimet dhe stornimi i parapagimeve në momentin e deklarimit për këtë artikull, pra vlera e paraqitur në librat e shoqërisë saktëson TVSH për pagesë ose kreditim dhe jo sasinë e mallit hyrje në magazinë. Nga grupi i auditimit për vitet 2020, 2021 dhe 2022 është marrë vlera e furnitorit të deklaruar në librin e blerjes më çmimin mesatar duke dal në sasi jo të saktë. Kjo pasi sasia nuk del nga vlerat e faturave të furnitorit të deklaruar, pasi në deklarim kemi raste të parapagimeve që sipas ligjit duhet të prerë faturë dhe në rast pagese pavarësisht se nuk është kryer furnizimi. Gjithashtu në lidhje me diferencat e konstatuara në artikullin “Hekur” ka paraqitur çdo faturim në blerje si dhe çdo hyrje në magazinë sipas viteve përkatëse dhe në fund pretendon se diferencat e konstatuara nga grupi i audituesve të KLSH nuk qëndrojnë sepse janë në tejkalim të të drejtës për vlerësim alternativ sipas nenit 71 të Ligjit Nr.9920. - Në lidhje me kreditimin e karburantit shprehet se nuk zë peshë në xhiron e deklaruar dhe se ka deklaruar blerje karburanti për kamionçine të cilën e përdorë për transportin e materialeve të ndërtimit, gjithashtu sqaron se autoveturat gjendje inventariale janë për rishitje pasi janë marrë me kontrata porosie për blerje apartamenti. Gjithashtu pretendon se në inventarët e AAM të mjeteve të transportit të shoqërisë, krahas automjeteve ka dhe kamionçinë me targa A.D, si dhe në blerjet e karburantit dhe lëndë djegëse kemi blerje karburanti për makineri dhe gaz që është lëndë e parë për izolim, bashkangjitur edhe kartela e llogarive për blerje karburanti. Gjithashtu sqaron faktin se shpenzimet e karburantit janë shumë të ulëta në lidhje me të drejtën e kreditimit të TVSH sipas nenit 74 “Kufizimet e së drejtës së zbritjes” të Ligjit Nr.92/2014 “Për TVSH-në, në Republikën e Shqipërisë”, sepse pjesa më e madhe e punimeve janë kryer me nënkontraktor dhe shpenzimet e karburantit janë përdorur për kamionçinë për punimet e kryera nga vet subjekti.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Në lidhje me pjesën e parë të observimit grupi i auditimit i qëndron konstatimit se në raportin e kontrollit tatimor, nuk ka analiza dhe vlerësimeve të projektit dhe preventivit të punimeve, si dhe nuk është kryer një zbërthim i materialeve dhe lëndës së parë në përbërje të punimeve të situacionuar. Gjithashtu janë konstatuar mungesa e analizave të librezës së masave, situacioneve pjesore mujore, progresive dhe përfundimtare të volumit të punimeve të ndërtimit, të cilat janë dokumenta justifikuese për verifikimin e volumit të punimeve të kryera. Gjithashtu theksojmë se bashkëlidhur praktikës së raportit të kontrollit tatimor, nuk ndodhet asnjë kopje e lejeve të ndërtimit, sheshit, akt-kolaudime, kontratat e shkëmbit të truallit etj. Gjithashtu edhe pse trajtohen shitjet e realizuara nga shoqëria nuk jepen të dhëna dhe detaje në lidhje me kontrata e shitjes. Në lidhje me pjesën e observacionit për kostot sipas EKB-së, sqarojmë se në pikën 2 të udhëzimit citohet qartësisht se: “Kostoja mesatare e ndërtimit dhe vlera mesatare e apartamenteve në

tregun e lirë të banesave sipas qyteteve, për vitin 2016, të jetë sipas tabelave nr.1, nr.2 dhe nr.3, bashkëlidhur këtij udhëzimi”. Pra kemi pasur një grup pune dhe një studim të mirëfilltë të tregut, i cili ka dalë në përfundimin në lidhje me kostot mesatare të ndërtimit sipas qyteteve, të cilat janë miratuar nga Këshilli i Ministrave. Këto kosto përbëjnë një referencë të tregut të lirë dhe grupi i auditimit gjykon se nga ana e inspektorëve të kontrollit dhe inxhinierit të ndërtimit duhet të ishte kryer një analizë më e kujdesshme në lidhje me këto punime ndërtimi, për të verifikuar n.q.s. subjekti ndërtues ka integrim vertikal, horizontal ose avantazh konkurrues në treg që ka arritur të ndërtojë poshtë këtyre kostove të përcaktuara në udhëzimet përkatëse. Në përfundim grupi i auditimit gjykon se jemi në kushtet kur tatimpaguesi nuk ka mbajtur regjistrime të sakta në lidhje me transaksionet e kryera jashtë logjikes së tregut normal dhe të lirë, me element që synojnë të shmangien ose uljen e detyrimeve tatimore, nga ku plotësohen kushtet për të përdorur metodat e vlerësimit alternativ sipas përcaktimeve të legjislacionit tatimor në fuqi. Kjo pjesë e observacionit nuk merret në konsideratë. Në lidhje me diferencat e konstatuar të materialit “Hekur” sqarojmë se nga administrimi i observacionit së bashku me regjistrimet e magazinës ku janë përcaktuar sasi të cilat korrespondojnë me sasi të sipas faturave për blerjen e hekurit, që janë vendosur në dispozicion, grupi i auditimit gjykon dhe merr në konsideratë këtë pjesë të observacionit duke kryer reflektimet përkatëse në raportin përfundimtar të auditimit. Gjithashtu në lidhje me problematikën e kreditimit të TVSH-së, së karburantit nga autoveturat nuk janë sjellë argumentim ligjor, dokumenta justifikuese ose analiza për të kundërshtuar konstatimet e grupit të audituesve të KLSH. Kjo pjesë e observacionit nuk merret në konsideratë.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me Nr.52/28 Prot dhe datë 11.09.2023 “Përcjellje observacionesh”, protokolluar në KLSH me Nr.14/11 Prot., datë 12.09.2023, nga përfaqësuesit e DTM, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

**Pretendimet e subjektit:** 1. Në observacionin e dërguar nga Inspektori i Kontrollit Operacional në DTM, z. S. M., ka parashtruar si në vijim: a. Pretendon se janë analizuar kontrata e punës së lidhur nga shoqëria me punonjësit dhe gjithashtu sqaron se për orët shtesë të punës është kryer pagesa konform përcaktimeve të Kodit të Punës në R.SH. b. Pretendon se analiza e kryerjes së karburantit është konform përcaktimeve ligjore të Ligjit Nr.92/2014 “Për TVSH-në, në R.SH”. c. Gjithashtu pretendon se është kryer kontrolli i qera të ambienteve krahasuar me çmimet e referencës të përcaktuara në VKM Nr.469, datë 03.06.2015.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Sqarojmë se aktivitetin shoqëria e zhvillohen çdo ditë e hënë - e diel në oraret e përcaktuara 07:30-22:30, të cilat në total përbëjnë 15 orë punë në ditë, pra dy turne. Kurse nga kontrolli i listëpagesave të deklaruara nga subjekti në sistemin C@ts për periudhën 11/2019-10/2021, ka deklaruar për punonjësit 22 ditë punë në muaj. Nga llogaritjet e grupit të auditimit rezulton se punonjësit punojnë më shumë se 22 ditë pune në muaj, nga rezulton se punohet edhe të ditë të shtunë dhe të diele, ku sipas përcaktimeve të neni 87 të Kodit të Punës duhet që pagesa orare të jetë minimalisht 25% më e lartë se pagesa minimale orare, gjithashtu punohet edhe në turn të dytë në fashën orare 19:30-22:30, për të cilën paga orare duhet të jetë 20% më e lartë se pagesa minimale orare sipas përcaktimeve të neni 81 të Kodit të Punës. Dhe në observacionin e inspektorit të kontrollit nuk paraqitet asnjë argumentim ligjor ose dokumenta justifikuese për të kundërshtuar konstatimet e grupit të audituesve të KLSH. Gjithashtu edhe në lidhje me kreditimin e TVSH-së, së karburantit nga autoveturat nuk janë dhënë asnjë argumentim ligjor ose dokumenta justifikuese për të kundërshtuar konstatimet e grupit të audituesve të KLSH. Observacioni nuk merret në konsideratë.

2. Në observacionin e dërguar nga Inspektori i Kontrollit Operacional në DTM, z. Z. D. dhe ish Përgjegjësi i Sektorit z. A. Ç., ka parashtruar si në vijim: a. Pretendon se niveli referues i kostove sipas EKB nuk është i zbatueshëm, si element i bazës së vlerësimit. Gjithashtu citon se DTM i ka kërkuar Drejtorisë Ligjore dhe Teknike me shkresën Nr.307 datë kërkesë për interpretim dhe në përgjigje të kësaj kërkesë ku thuhet se kostot mesatare të ndërtimit nuk janë akte nënligjore të nxjerra në zbatim të

ligjeve tatimore. Si të tilla nuk mund të shërbejnë për përcaktimin e shkeljeve të legjislacioni tatimor apo shmangieve të detyrimeve tatimore, ky udhëzim nuk përcakton si shkelje midis kosos dhe çmimit të shitjes pasi nuk përcakton dhe nuk është për llogaritjen e detyrimeve tatimore të tatimpaguesit. Kostoja faktike e realizuar është rezultat i volumit të punimeve dhe materialeve të përdorura, të situacionuara dhe deklaruara në libra dhe FDP. Këto janë dokumenta të cilat janë verifikuar nga kontrolli tatimor. Gjatë kontrollit nuk është konstatuar asnjë kusht që parashikon neni 71 i Ligjit Nr.9920, pra nuk mund të përdoret e drejta për vlerësim alternativë. b. Në lidhje me shitjet në “Kopshtin Botanik” nën çmimin referencë pretendon se janë llogaritur detyrime TVSH pa drejtësisht në rastin kur furnizimi i banesave është i përjashtuar, tatimi i dividendit nuk është kusht që të ndodh, është marr si bazë VKM Nr.168, e cila merret me ndryshim të VKM Nr.13, për të cilën pretendon se nuk është nivel referues për shitjen e njërive ndërtimore tek blerësi por për llogaritjen e bazës së taksës vendore. c. Pretendon se nuk ekzistojnë diferencat në materialet e përdorura.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** - Në lidhje me pjesën e parë të observimit grupi i auditimit i qëndron konstatimit se në raportin e kontrollit tatimor, nuk ka analiza dhe vlerësimeve të projektit dhe preventivit të punimeve, si dhe nuk është kryer një zberthim i materialeve dhe lëndës së parë në përbërje të punimeve të situacionuar. Gjithashtu janë konstatuar mungesa e analizave të librezës së masave, situacioneve pjesore mujore, progresive dhe përfundimtare të volumit të punimeve të ndërtimit, të cilat janë dokumenta justifikuese për verifikimin e volumit të punimeve të kryera. Gjithashtu theksojmë se bashkëlidhur praktikës së raportit të kontrollit tatimor, nuk ndodhet asnjë kopje e lejeve të ndërtimit, sheshit, akt-kolaudime, kontratat e shkëmbit të truallit etj. Gjithashtu edhe pse trajtohen shitjet e realizuara nga shoqëria nuk jepen të dhëna dhe detaje në lidhje me kontrata e shitjes. Në lidhje me pjesën e observacionit për kostot sipas EKB-së, sqarojmë se në pikën 2 të udhëzimit citohet qartësisht se: “Kostoja mesatare e ndërtimit dhe vlera mesatare e apartamenteve në tregun e lirë të banesave sipas qyteteve, për vitin 2016, të jetë sipas tabelave nr.1, nr.2 dhe nr.3, bashkëlidhur këtij udhëzimi”. Pra kemi pasur një grup pune dhe një studim të mirëfilltë të tregut, i cili ka dalë në përfundimin në lidhje me kostot mesatare të ndërtimit sipas qyteteve, të cilat janë miratuar nga Këshilli i Ministrave. Këto kosto përbëjnë një referencë të tregut të lirë dhe grupi i auditimit gjykon se nga ana e inspektorëve të kontrollit dhe inxhinierit të ndërtimit duhet të ishte kryer një analizë më e kujdesshme në lidhje me këto punime ndërtimi, për të verifikuar n.q.s. subjekti ndërtues ka integrim vertikal, horizontal ose avantazh konkurrues në treg që ka arritur të ndërtojë poshtë këtyre kostove të përcaktuara në udhëzimet përkatëse. Në përfundim grupi i auditimit gjykon se jemi në kushtet kur tatimpaguesi nuk ka mbajtur regjistrime të sakta në lidhje me transaksionet e kryera jashtë logjikës së tregut normal dhe të lirë, me element që synojnë të shmangien ose uljen e detyrimeve tatimore, nga ku plotësohen kushtet për të përdorur metodat e vlerësimit alternativ sipas përcaktimeve të legjislacionit tatimor në fuqi. - Kurse në lidhje me observacionet për shitjet në “Kopshtin Botanik” nën çmimin referencë të përcaktuar në VKM Nr.168 dhe diferencat e rezultuara në materialet e përdorura, nuk do të merren në konsideratë sepse nuk sjellin argumentin ligjor ose fiskal ose dokumenta justifikuese për të kundërshtuar konstatimin e grupit të auditimit.

3. Në observacionin e dërguar nga Inspektori i Kontrollit Operacional në DTM, z. I. D. dhe Ing. I. K., për subjektin “M. K.” SHPK, ka parashtruar si në vijim: a. Pretendon se nuk mund të bëhet rivlerësim sepse qëndrimi zyrtar i DPT nëpërmjet Drejtorisë Juridike ku sipas interpretimit mbi përlllogaritjet e kostove dhe çmimit të shitjes së sipërfaqeve të ndërtimit përjashton nivelin referues të EKB apo çdo VKM tjetër që nuk është për përlllogaritjen e detyrimeve tatimore. (Bashkangjitur observacionit janë vendosur dokumentacion). Gjithashtu pretendon se nuk mund të bëhet ky rivlerësim sepse jemi në 95.40% të nivelit të punimeve dhe nuk ka përfunduar akoma objekti. b. Në lidhje me vlerësimin e interesave të llogaritura nga raporti i huadhënie/huamarrje në %, shprehet se nuk janë korrekte vlerësimi i grupit të audituesve sepse nuk parashikohen nga nenet 20 dhe 21 të Ligjit Nr.8348 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar. c. Në lidhje me llogaritjen e koef zbritjes së TVSH, pretendohet se është kryer një gabim në llogaritjen e tij nga ana e grupit të auditimit. d. Në lidhje me rivlerësimin e pagave të punonjësve shprehet se nuk mund të kryhet rivlerësim sepse nuk plotësohet asnjë nga kushtet



e nenit 71 të Ligjit Nr.9920 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** - Në lidhje me pjesën e parë të observimit grupi i auditimit i qëndron konstatimit se në raportin e kontrollit tatimor, nuk ka analiza dhe vlerësimeve të projektit dhe preventivit të punimeve, si dhe nuk është kryer një zbërthim i materialeve dhe lëndës së parë në përbërje të punimeve të situacionuar. Gjithashtu janë konstatuar mungesa e analizave të librezës së masave, situacioneve pjesore mujore, progresive dhe përfundimtare të volumit të punimeve të ndërtimit, të cilat janë dokumenta justifikuese për verifikimin e volumit të punimeve të kryera. Gjithashtu theksojmë se bashkëlidhur praktikës së raportit të kontrollit tatimor, nuk ndodhet asnjë kopje e lejeve të ndërtimit, sheshit, akt-kolaudime, kontratat e shkëmbit të truallit etj. Gjithashtu edhe pse trajtohen shitjet e realizuara nga shoqëria nuk jepen të dhëna dhe detaje në lidhje me kontrata e shitjes. Në lidhje me pjesën e observacionit për kostot sipas EKB-së, sqarojmë se në pikën 2 të udhëzimit citohet qartësisht se: “Kostoja mesatare e ndërtimit dhe vlera mesatare e apartamenteve në tregun e lirë të banesave sipas qyteteve, për vitin 2016, të jetë sipas tabelave nr.1, nr.2 dhe nr.3, bashkëlidhur këtij udhëzimi”. Pra kemi pasur një grup pune dhe një studim të mirëfilltë të tregut, i cili ka dalë në përfundimin në lidhje me kostot mesatare të ndërtimit sipas qyteteve, të cilat janë miratuar nga Këshilli i Ministrave. Këto kosto përbëjnë një referencë të tregut të lirë dhe grupi i auditimit gjykon se nga ana e inspektorëve të kontrollit dhe inxhinierit të ndërtimit duhet të ishte kryer një analizë më e kujdesshme në lidhje me këto punime ndërtimi, për të verifikuar n.q.s. subjekti ndërtues ka integrim vertikal, horizontal ose avantazh konkurrues në treg që ka arritur të ndërtojë poshtë këtyre kostove të përcaktuara në udhëzimet përkatëse. Në përfundim grupi i auditimit gjykon se jemi në kushtet kur tatimpaguesi nuk ka mbajtur regjistrime të sakta në lidhje me transaksionet e kryera jashtë logjikës së tregut normal dhe të lirë, me element që synojnë të shmangien ose uljen e detyrimeve tatimore, nga ku plotësohen kushtet për të përdorur metodat e vlerësimit alternativ sipas përcaktimeve të legjislacionit tatimor në fuqi. – Në lidhje me interesat e huasë sqarojmë se nga grupi i audituesve janë konsideruar si shpenzime të panjohura pjesa e shpenzimeve të interesi që janë paguar për huatë e marrë nga bankat, të cilat janë dhënë pa interes hua palëve të lidhura, ndërkohe që nuk e ka pjesë të aktivitetit të saj kredidhënien si dhe nuk i kanë shërbyer sigurimit të fitimit si dhe sqarojmë se është tjetër fenomen problematike nga paralelizmi me raste të tjera të përmendura nga inspektori. Si përfundim gjykojmë se observacioni i inspektorëve nuk ja sjellë argumente dhe dokumenta justifikues për të kundërshtuar konkluzionin e grupit të audituesve. – Sqarojmë se problematika që ngre grupi i auditimit nuk është vlera e koef zbritjes së TVSH-së, por vlera e shpenzimeve me karakter të përgjithshëm që u kanë shërbyer të dy aktiviteteve dhe mbi të cilën duhet të aplikohet koeficienti i zbritjes së TVSH-së. – Në lidhje me problematikat e konstatuara nga grupi i auditimit në lidhje me pagat, sqarojmë se nga kontrolli i listëpagesave të subjektit të deklaruar në sistemin C@ts për periudhën 10/2019-12/2019, ka rezultuar se shoqëria ka deklaruar për punonjësit 26 ditë pune që është në tejkalim të kohëzgjatjes normale të punës prej 174 orë në muaj ose 22 ditë pune dhe pagesa për ditët shtesë, nuk janë kryer me një shtesë jo më pak se 25% të pagesës të ditës normale sipas përcaktimeve të Kreut IX të Kodit të Punës në R.SH, dhe nga ana e inspektorëve të kontrollit nuk janë sjellë argumentim ligjore ose dokumenta justifikuese shtesë, për të kundërshtuar konstatimet e grupit të audituesve të KLSH. Observacioni nuk merret në konsideratë.

4. Në observacionin e dërguar nga Inspektori i Kontrollit Operacional në DTM, z. I. D. dhe Ing E. A. dhe Përgjegjës z. E. M., ka parashtruar si në vijim: a. Në lidhje me rivlerësimin e pagave të punonjësve me 26 ditë pune, shprehet se nuk mund të kryhet rivlerësim sepse nuk plotësohet asnjë nga kushtet e nenit 71 të Ligjit Nr.9920 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar. Gjithashtu sqaron se për vet natyrën e punës punonjësit kanë punuar 7 orë ditët e javës dhe 5 orë ditën e shtunë duke mos e kaluar më shumë se 174 orë punë në muaj dhe se nuk ka paga poshtë pagës minimale të përcaktuar më ligj. b. Lidhur me pagesat e larta të disa punonjësve, sqarojnë se janë bonuse të vendosura nga menaxhmenti i shoqërisë për të cilat është llogaritur dhe paguar tatim sipas përcaktimeve ligjore në fuqi. c. Në lidhje me konsulencat teknike, sqaron se këto shërbime nuk asnjë shpenzime të panjohura dhe se i kanë shërbyer shoqërisë sepse: ekzistojnë kontratat e shërbimit, shërbimi është kryer në fakt

sepse kanë përfunduar projektet, pagesat janë kryer nëpërmjet sistemit bankar si dhe është deklaruar dhe paguar tatim në burim për këto shërbime. d. Në lidhje me shitjen e ATQ me vlerë të mbetur sqaron se: nuk ka një përcaktim të saktë ligjore që ta ndalojë shitjen e ATQ-ve me vlerë të mbetur, nuk plotësohet asnjë nga kushtet e nenit 71 të Ligjit Nr.9920 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar dhe norma e fitimit të shoqërisë prej 26.68% nuk mund të përdoret apriori për të kryer rivlerësim. e. Në lidhje me shitjen e njësisë komerciale tek stadiumi Air-Albania, sqaron se: shitjet janë bërë mbi kostot e realizuara në ndërtim, pretendon se nuk mund të bëhet rivlerësim sepse qëndrimi zyrtar i DPT nëpërmjet Drejtorisë Juridike ku sipas interpretimit mbi përlllogaritjet e kostove dhe çmimit të shitjes së sipërfaqeve të ndërtimit përjashton nivelin referues të EKB apo çdo VKM tjetër që nuk është për përlllogaritjen e detyrimeve tatimore. (Bashkangjitur observacionit janë vendosur dokumentacion).

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** - Në lidhje me problematikat e pagave të konstatuara nga grupi i auditimit sqarojmë se nga kontrolli i listëpagesave të subjektit të deklaruar në sistemin C@ts për periudhën 11/2020-03/2022, ka rezultuar se shoqëria ka deklaruar për punonjësit 26 ditë pune që është në tejkallim të kohëzgjatjes normale të punës prej 174 orë në muaj ose 22 ditë pune dhe pagesa për ditët shtesë nuk është kryer me një shtesë jo më pak se 25% të pagesës të ditës normale sipas përcaktimeve të Kreut IX të Kodit të Punës në R.SH. – Në lidhje me pagesat e larta të disa punonjësve të shoqërisë, të cilat zënë një peshë të konsiderueshme në totalin e listpagesës së shoqërisë, grupi i audituesve i qëndron konstatimit se nuk ka pasur një analizë në raportin e kontrollit tatimor të hartuar në lidhje me këto bonuse për të cilat pretendohet në observacion, se mbi cilat kritere dhe përmbushje objektivash janë paguar. – Në lidhje me shpenzimet e konsulencës teknike të paguara nga z. A. I. dhe I. I., grupi i audituesve mban të njëjtin qëndrim, edhe mbas observacionit të inspektorit të kontrollit i cili asnjë argumentim ligjore ose dokumenta justifikuese për të kundërshtuar konstatimet e grupit të audituesve të KLSH, sepse kontratat e shërbimit janë lidhur mbas datës së fitimit të tenderit, fakt ky që tregon se shoqëria ka qenë në gjendje të përmbush kryerjen e punimeve sepse ka përmbushur kriteret e përgjithshme, specifike si dhe çdo kërkesë tjetër të përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. – Në lidhje me shitjen e ATQ me vlerë të mbetur pa realizuar fitimi, grupi i auditimit sqaron se është një transaksion midis palëve të lidhura në shkelje të parimit të vlerës së tregut duke shmangur tatim fitimit. Dhe në vijim merren me qera mjetet e punës nga i njëjti subjekt që janë palë të lidhura në vlera me të larta se transaksioni i shitjes, transaksione këto në gjykimin e grupit të audituesve që janë jashtë logjikës së një tregu normal dhe të lirë, dhe në observacionin e inspektorit nuk sillen argumente ligjore dhe dokumentacion justifikues për të kundërshtuar konstatimin. - Në lidhje me shitjen e AQT të njësisë komerciale të stadiumi Air Albania poshtë çmimit minimal fiskalë të përcaktuar në VKM Nr.168, datë 27.3.2019, sqarojmë se nuk ka sjellë argumentet ligjorë për të kundërshtuar konstatimin e grupit të audituesve të KLSH. Observacioni nuk merret në konsideratë.

5. Në observacionin e dërguar nga Inspektori i Kontrollit Operacional në DTM, z. I. L. dhe Ing E.A, ka parashtruar si në vijim: - Sqaron se niveli referues i kostove sipas EKB nuk është i zbatueshëm, si element i bazës së vlerësimit sipas shkresës Nr.11840 Prot., datë 19.09.2019. Pretendon se sipas raportit të kontrollit teknik sipërfaqja ndërtimore e objektit ka rezultuar 25,220 m<sup>2</sup>, që ka dal si diferenca midis sipërfaqes së përgjithshme të hipotekuar prej 28,419 m<sup>2</sup> minus sipërfaqet jashtë konturit të objektit (konsula + veranda). - Për diferencat e konstatuara sqaron se ka qenë lapsus në mbartjen e tabelave të excelit, por pa efekte fiskale.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Sqarojmë se të dhënat janë mbi të cilat ka kryer analiza dhe kanë nxjerr konkluzione grupi i auditimit janë marrë nga raporti i kontrollit tatimor dhe raporti teknik i inxhinierit. Për sipërfaqen totale prej 28,419m<sup>2</sup> mbi të cilin grupi i auditimit ka llogaritur koston ndërtimore, ku është përfshirë edhe kosto e ndërtimit të konsula dhe veranda. Grupi i auditimit i qëndron konstatimit se në raportin e kontrollit tatimor, nuk ka analiza dhe vlerësimeve të projektit dhe preventivit të punimeve, si dhe nuk është kryer një zberthim i materialeve dhe lëndës së parë në përbërje të punimeve të situacionuar. Gjithashtu janë konstatuar mungesa e analizave të librezës së masave, situacioneve pjesore mujore, progresive dhe përfundimtare të volumit të punimeve të ndërtimit, të cilat

janë dokumenta justifikuese për verifikimin e volumit të punimeve të kryera. Gjithashtu theksojmë se bashkëlidhur praktikës së raportit të kontrollit tatimor, nuk ndodhet asnjë kopje e lejeve të ndërtimit, sheshit, akt-kolaudime, kontratat e shkëmbit të truallit etj. Gjithashtu edhe pse trajtohen shitjet e realizuara nga shoqëria nuk jepen të dhëna dhe detaje në lidhje me kontrata e shitjes. Në lidhje me pjesën e observacionit për kostot sipas EKB-së, sqarojmë se në pikën 2 të udhëzimit citohet qartësisht se: “Kostoja mesatare e ndërtimit dhe vlera mesatare e apartamenteve në tregun e lirë të banesave sipas qyteteve, për vitin 2016, të jetë sipas tabelave nr.1, nr.2 dhe nr.3, bashkëlidhur këtij udhëzimi”. Pra kemi pasur një grup pune dhe një studim të mirëfilltë të tregut, i cili ka dalë në përfundimin në lidhje me kostot mesatare të ndërtimit sipas qyteteve, të cilat janë miratuar nga Këshilli i Ministrave. Këto kosto përbëjnë një referencë të tregut të lirë dhe grupi i auditimit gjykon se nga ana e inspektorëve të kontrollit dhe inxhinierit të ndërtimit duhet të ishte kryer një analizë më e kujdesshme në lidhje me këto punime ndërtimi, për të verifikuar n.q.s. subjekti ndërtues ka integrim vertikal, horizontal ose avantazh konkurrues në treg që ka arritur të ndërtojë poshtë këtyre kostove të përcaktuara në udhëzimet përkatëse. Në përfundim grupi i auditimit gjykon se jemi në kushtet kur tatimpaguesi nuk ka mbajtur regjistrime të sakta në lidhje me transaksionet e kryera jashtë logjikes së tregut normal dhe të lirë, me element që synojnë të shmangien ose uljen e detyrimeve tatimore, nga ku plotësohen kushtet për të përdorur metodat e vlerësimit alternativ sipas përcaktimeve të legjislacionit tatimor në fuqi.

6. Në observacionin e dërguar nga Inspektorët e Kontrollit Operacional në DTM, z. G. J. dhe znj.O. B., ka parashtruar si në vijim: Sqarojnë se sipas përcaktimeve të neneve të marrëveshjes koncesionare të j Nr.8348 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar. Bashkangjitur është vendosur në dispozicion Vendimi i Drejtorisë së Apelit Tatimor Nr.2346/2 Prot., datë 30.05.2014 si analogji për rastin konkret.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, Grupi i Auditimit pasi shqyrtoi observacionin Tuaj sqaron se: Qëndrimi dhe argumenti i inspektorëve të Kontrollit Operacional në DTM, Znj. B. dhe Z. J., bazohet tek kontrata koncesionare e lidhur midis subjektit dhe autoritetit kontraktor dhe jo në përcaktimet e standarteve kombëtare dhe ndërkombëtare të kontabilitetit për regjistrimin dhe metodën e amortizimit të aktivitetit “HEC”. Gjithashtu sqarojmë se nuk mund të bëhet analogji me raste të ndryshme dhe konkretisht me Vendimin e DAP pasi ai nuk është i detyrueshëm për të gjitha aktet administrative tatimore, sepse nuk përbën një vendim njësuës ose vendim unifikues. Observacioni nuk merret në konsideratë.

7. Në observacionin e dërguar nga Inspektoria e Kontrollit Operacional në DTM, Znj. D..L, ka parashtruar si në vijim: a. Pretendon se objekti nuk është përfunduar por niveli i realizimit të punimeve është 92% si dhe shprehet se niveli referues i kostove sipas EKB nuk është i zbatueshëm, si element i bazës së vlerësimit. Gjithashtu citon se DTM i ka kërkuar Drejtorisë Ligjore dhe Teknike me shkresën Nr.307 datë kërkesë për interpretim dhe në përgjigje të kësaj kërkesë ku thuhet se kostot mesatare të ndërtimit nuk janë akte nënligjore të nxjerra në zbatim të ligjeve tatimore. Si të tilla nuk mund të shërbejnë për përcaktimin e shkeljeve të legjislacionit tatimor apo shmangieve të detyrimeve tatimore, ky udhëzim nuk përcakton si shkelje midis kostos dhe çmimit të shitjes pasi nuk përcakton dhe nuk është për llogaritjen e detyrimeve tatimore të tatimpaguesit. Kostoja faktike e realizuar është rezultat i volumit të punimeve dhe materialeve të përdorura, të situacionuara dhe deklaruara në libra dhe FDP. Këto janë dokumenta të cilat janë verifikuar nga kontrolli tatimor. Gjatë kontrollit nuk është konstatuar asnjë kusht që parashikon neni 71 i Ligjit Nr.9920, pra nuk mund të përdoret e drejta për vlerësim alternativë. b. Pretendon se nuk janë njohur për efekt të llogaritjes së tatimit mbi fitimin dy faturat e blerjes nga shoqëria “T. Eg.” SHPK. c. Në lidhje me shitjen e produkteve “Lëndë e pare/inerte” pa aplikuar vlerë të shtuar dhe marzh fitimi sepse shoqëria ka kryer një marrëveshje me çmim preferencial me subjektin të cilit i ka kryer shitjen dhe pretendon se përderisa janë palë të lidhura si dhe kushtet financiare të marrëveshjes përputhen me vlerën e tregut. Gjithashtu pretendon se nuk mund të përdoret marzhi i nxjerrë nga PASH prej 7% sepse ai lidhet me aktivitetin kryesor të

shoqërisë i cili është ndërtimi kurse të ardhurat nga dy faturat e përmendura përbëjnë vetëm 0.9% të totalit të ardhurave. d. Në lidhje me shitjet nën çmimin e referencës pretendon se në raport kontroll janë kryer saktë të gjitha sqarimet nga ana e inspektore dhe gjithashtu pretendon se në lidhje me pjesët e përbashkëta se janë sipas marrëveshjes më ndërtuesin ato nuk janë pjesë ndërtimore të shitshme dhe për të cilat nuk gjenerohen të ardhura. Gjithashtu sqaron se sipërfaqet e shitshme janë nxjerr nga ana e inxhinieres së DTM, që ka përpiluar aktin e konstatimit. e. Pretendon se janë kryer analizat dhe vlerësime të projektit dhe preventivit të punimeve si dh është kryer zbërthimi i materialeve dhe lëndës së parë në përbërje të punimeve të situacionuara. e. Pretendon se në raport janë pasqyruar lëvizjet materiale të përdorimeve në aktin e inxhinierit si dhe është bërë rivlerësimi i diferencave të konstatuara. Gjithashtu pretendon se referuar Akti-Konstatimit ka një analizë dhe vlerësim të projekteve dhe preventivit të punimeve për çdo objekt. f. Pretendon se nuk ka zë në bilanc për arkëtimet në avancë që lidhen me arkëtimet nga klientët si dhe nuk ka marrëdhënie dhe transaksione kleringu.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** - Në lidhje me pjesën e parë të observimit grupi i auditimit i qëndron konstatimit se në raportin e kontrollit tatimor, nuk ka analiza dhe vlerësimeve të projektit dhe preventivit të punimeve, si dhe nuk është kryer një zbërthim i matierialeve dhe lëndës së parë në përbërje të punimeve të situacionuar. Gjithashtu janë konstatuar mungesa e analizave të librezës së masave, situacioneve pjesore mujore, progresive dhe përfundimtare të volumit të punimeve të ndërtimit, të cilat janë dokumenta justifikuese për verifikimin e volumit të punimeve të kryera. Gjithashtu theksojmë se bashkëlidhur praktikës së raportit të kontrollit tatimor, nuk ndodhet asnjë kopje e lejeve të ndërtimit, sheshit, akt-kolaudime, kontratat e shkëmbit të truallit etj. Gjithashtu edhe pse trajtohen shitjet e realizuara nga shoqëria nuk jepen të dhëna dhe detaje në lidhje me kontrata e shitjes. - Në lidhje me pjesën e observacionit për kostot sipas EKB-së, sqarojmë se në pikën 2 të udhëzimit citohet qartësisht se: “Kostoja mesatare e ndërtimit dhe vlera mesatare e apartamenteve në tregun e lirë të banesave sipas qyteteve, për vitin 2016, të jetë sipas tabelave nr.1, nr.2 dhe nr.3, bashkëlidhur këtij udhëzimi”. Pra kemi pasur një grup pune dhe një studim të mirëfilltë të tregut, i cili ka dalë në përfundimin në lidhje me kostot mesatare të ndërtimit sipas qyteteve, të cilat janë miratuar nga Këshilli i Ministrave. Këto kosto përbëjnë një referencë të tregut të lirë dhe grupi i auditimit gjykon se nga ana e inspektorëve të kontrollit dhe inxhinierit të ndërtimit duhet të ishte kryer një analizë më e kujdesshme në lidhje me këto punime ndërtimi, për të verifikuar n.q.s. subjekti ndërtues ka integrim vertikal, horizontal ose avantazh konkurrues në treg që ka arritur të ndërtojë poshtë këtyre kostove të përcaktuara në udhëzimet përkatëse. Në përfundim grupi i auditimit gjykon se jemi në kushtet kur tatimpaguesi nuk ka mbajtur regjistrime të sakta në lidhje me transaksionet e kryera jashtë logjikës së tregut normal dhe të lirë, me element që synojnë të shmangien ose uljen e detyrimeve tatimore, nga ku plotësohen kushtet për të përdorur metodat e vlerësimit alternativ sipas përcaktimeve të legjislativitetit në fuqi. – Në lidhje me shitjen e “lëndë e pare/inerte” dhe “çimento” pa aplikuar marzhe fitimi, grupi i audituesve gjykon se argumentet e sjellë nga inspektorët e kontrollit nuk e rrëzojnë konstatimin. Konkretisht sqarojmë se çmimi preferencial i përcaktuar në një marrëveshje midis palëve të lidhura nuk është domosdoshmërisht çmimi i tregut dhe në rastin konkret vërtetohet lehtësisht sepse është shitur pa marzhe fitimi, gjithashtu mqs shitja e këtyre materialeve nuk përbën aktivitetin kryesorë të shoqërisë nuk të lind e drejta të shesësh pa aplikuar marzhe fitimi edhe pse betonin pretendon se nuk e prodhon më vet por e blen nga subjekti “F. B.” SHPK. Aplikimi i normës së fitimit 7% është kryer në zbatim të plotë të përcaktimeve ligjore të a) të nenit 72 “Baza e mënyrave alternative të vlerësimit” i Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”. – Në lidhje me rivlerësimin e shitjes së sipërfaqeve të përbashkëta të padeklaruara, sqarojmë se nën frymën e përcaktimeve ligjore të nenit 209 “Objektet e përbashkëta të ndërtesave” të Kodit Civil i R.SH”, i ndryshuar dhe nenit 52 “Regjistrimi i mjediseve të përbashkëta në ndërtesa” të Ligjit Nr.111/2018 “Për Kadastrën”. Shprehet qartë se pas përfundimit të ndërtimit, ndërtuesi është i detyruar që të bëjë regjistrimin e gjithë sipërfaqes ndërtimore në ZVRPP. Në këtë sipërfaqe ndërtimore përfshihen si sipërfaqet e banimit, ato të shërbimit edhe sipërfaqet e përbashkëta. Si rrjedhojë në momentin e shitjes së një njësie subjekti ndërtuesi duhet t’i kalojë pronësinë palës blerëse si për sipërfaqen e brendshme edhe për pjesën takuese të sipërfaqes së përbashkët. Gjithashtu sqarojmë se nga ana e inspektore së

kontrollit dhe inxhinieres nuk është bërë një analizë e kontratave të shitjes së njësisive, kartelave të pasurive dhe certifikatave të pronësisë. Nga sa sqaruar më sipër observacioni nuk merret në konsideratë. - Së fundi sqarohet se tek posti i DAGJ të bilancit kontabël të shoqërisë, konkretisht zëri “Huamarrjet (Shuma të arkëtuara për porosi)”, për vitin 2018, rezulton me një teprice kreditore në vlerën 1,743,602,075 lekë, që përfaqëson parapagime për apartamente të cilat ende nuk kanë kaluar në pronësi. Tek përshkrimi i faturave të blerjes në raport kontrolli kanë përshkrimin klering por nuk ka një analizë të detajuar të këtyre transaksioneve. Observacioni nuk merret në konsideratë.

8. Në observacionin e dërguar nga Drejtor i DTM, Znj. E. Ç., ka parashtruar si në vijim: Gjate periudhës që ushtrojë detyrën e Drejtorit Rajonal, kam menaxhuar burimet njerëzore në DTM përputhje me planin strategjik, objektivat operacionale dhe përcaktimeve ligjore fiskale në fuqi. Fakt ky që vërtetohet nga arritja e përmbushjes së planit të të ardhurave duke maksimizuar mbledhjen e të ardhurave tatimore si dhe kam menaxhuar dhe mbajtur borxhin tatimor në nivele të qëndrueshme me tendencë në ulje. Sqarohet se gjatë kësaj periudhe janë rritur vlerat e zbulimeve për kontrole tatimore si dhe cilësia e raporteve dhe kontroleve tatimore, gjë që tregon se janë mirë organizuar burimet njerëzore duke garantuar performancë dhe administrim efektiv të tatimeve si dhe realizim eficient të detyrave funksionale për të përmbushur arritjen e objektivave të parashikuara. Gjithashtu sqarohet se janë ndërmarrë verifikime dhe kontrole të cilësisë së punës së inspektorëve fakt ky që është reflektuar më konkretisht dhe e argumentuar tek vlerësimi periodikë 6-mujorë i inspektorëve në punë. Sqarohet se pjesë e këtij menaxhimi të një drejtorie tatimore të madhe siç është DTM, ka qenë dhe Drejtoria e Kontrollit Tatimor, e cila ka detyrat e veta të sanksionuara në këtë rregullore. Nga natyra e problematikave të konstatuara nga ana e grupit të auditimit, rezulton se lidhen drejtpërdrejt me detyrat funksionale të inspektorit të kontrollit tatimor në DTM sepse janë inspektorët të cilët verifikojnë faturat, ekzistencën e aktiveve, gjendjen e mallit në magazinë, kryejnë inventarizimin, kontrollojnë lejet e ndërtimit dhe dokumentacione të tjera justifikuese etj, sipas përcaktimeve të pikave të programit të kontrollit, manualit të kontrollit tatimor dhe Rregullores së Funksionimit të Administratës Tatimore, dalë me Urdhrin Nr.192 (Nr.14858/1., prot) datë 12.08.2020, të Ministrit të Financave. Hallkat e tjera në sigurimin e cilësisë dhe zbatimin e pikave të programit të kontrollit, përcaktimeve të manualit të kontrollit tatimor në përputhje me përcaktimet ligjore fiskale në fuqi, në hartimin e raporteve të kontrollit tatimor, janë Përgjegjësi i Sektorit të Kontrollit Tatimor dhe Drejtori i Kontrollit, të cilët kanë përgjegjësi sipas përcaktimeve të pikave 1, 2, 3, 4, 5, 7, 8 të nenit 58 “Detyrat e Përgjegjësit të Sektorit të Operacioneve të Kontrollit” dhe Pikat 2, 7, 11 të nenit 57 “Detyrat e Drejtorit të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor në DRT”, të Rregullores së Funksionimit të Administratës Tatimore, dalë me Urdhrin Nr.192 (Nr.14858/1., prot) datë 12.08.2020, të Ministrit të Financave.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Nga shqyrtimi i observacionit të Znj. Ç., nuk ka një kundërshtim të konkluzioneve të grupit të auditimit dhe gjithashtu sqarohet se Drejtori Rajonal sipas Formularit të dokumentimit të lëvizjes së dokumentacionit të kontrollit, firmos dhe ka të drejtën e komenteve në aneksin e raportit paraprak dhe përfundimtar e bën përgjegjës, sepse manuali ju rezervon të drejtën e shprehjes dhe të komenteve për rezultatet e procedurës së kontrollit. Në rastin e Drejtorit Rajonal ky fakt që përbën përgjegjësi funksionale të nëpunësit/titullar si person që ka detyrën dhe nënshkruan aktin administrative të organit përkatës të administratës publike sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë. Observacioni nuk merret në konsideratë.

9. Në observacionin e dërguar nga Përgjegjësi i Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit, Znj. E. M., ka parashtruar si në vijim: Pretendon se rekomandimet 15.2, 15.3, 16.1 dhe 16.2 nuk mund të ngarkohen për zbatim nga SKZM.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Nga shqyrtimi i observacionit të Znj. M., sqarohet se përmbajtja e rekomandimeve nuk kanë kundërshtim me nenin 85 të Ligjit Nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, sepse kanë të bëjnë me kërkim në rrugë zyrtare të informacionit dhe dokumentacion justifikues nga tatimpaguesi me qëllim verifikimin e tyre, e cila është në sinkron dhe konform përcaktimeve të objektit të punës së Sektorit, përcaktuar në Manualin e

**1. Titulli gjetjes:** Parregullsi të konstatuara nga auditimi i raportit të kontrollit të subjektit “M.I.” SHPK, në lidhje me faturimin e situacioneve të punimeve të ndërtimit poshtë kostove minimale fiskale të ndërtimit, njohja e faturimeve të kamatëvonesave si shpenzime të njohura për efekt llogaritje të tatimit mbi fitimin në PASH, shitje e njësive ndërtimore poshtë çmimit minimal fiskal dhe mos njohje e të ardhurave nga shitjet e pjesëve të përbashkëta ndërtimore, si dhe shitje të materialeve të ndërtimit pa aplikuar mazhe fitimi.

**Situata:** Nga auditimi i raportit të kontrollit tatimor të subjektit “M. I.” SHPK, u konstatua se nga ana e inspektoreve të kontrollit nuk është vepruar në përputhje me përcaktimet e dispozitave ligjore, konkretisht problematikat si në vijim:

1. Nga auditimi i raportit tatimor dhe aktit verifikimit të mbajtur për subjektin “M. I.” SHPK, nga ana e inspektorit dhe inxhinierit pranë DTM, janë konstatuar mungesa e analizave dhe vlerësimeve të projektit dhe preventivit të punimeve, nuk është kryer një zbërthim i materialeve dhe lëndës së parë në përbërje të punimeve të situacionuar, bazuar në manualin nr.1 “Analiza Teknike-Për prodhimin e materialeve të ndërtimit, udhëzime dhe kritere” dhe manualin nr.2 “Analiza Teknike-Për punimet e ndërtimit të ndërtesave”, si dhe krahasimi me punimet e kryera realisht në terren. Gjithashtu janë konstatuar mungesa e analizave të librezës së masave, situacioneve pjesore mujore, progresive dhe përfundimtare të volumit të punimeve të ndërtimit, të cilat janë dokumenta justifikuese për verifikimin e volumit të punimeve të kryera sipas përcaktimeve të nënpikave 3.2 dhe 3.3 të pikës 3, Kreu 1 të Udhëzimit Nr.3, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, ndryshuar me Udhëzimin Nr.1 datë, 16.06.2011.

2. Nga grupi i auditimit është kryer analiza e kostove të ndërtimit të objekteve dhe ka rezultuar se subjekti “M. I.” SHPK, është në rolin e sipërmarrësit dhe investitorit, pra në këtë rast ka kryer faturime të situacioneve të punimeve të kryera poshtë nivelit të kostove mesatare që janë përcaktuar në Udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr.3 “Miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2016”. Duhet të ishin rivlerësuar transaksionet, duke çuar vlerën e situacioneve të punimeve të ndërtimit në blerje drejt vlerës minimale të ndërtimit për efekte fiskale, për diferencat si më poshtë:

**- Objekti Kompleks banimi dhe shërbimesh 1, 4, 6 dhe 8 kate me 1 dhe 2 kate parkim nëntokë në Rr. Nexho Konomi, Tiranë: 153,558,717 lekë; diferenca vlerë faturimi – kosto minimale fiskale ndërtimi (2,063 lekë/m<sup>2</sup>) x sipërfaqe ndërtimit (80,888.15 m<sup>2</sup>).**

Në sensin ekonomik të situatës jemi në kushtet e situatës së “shitjes nën kosto”, sepse në raportin e kontrollit nuk kemi justifikimin e këtyre transaksioneve nën kostot mesatare të ndërtimit, me element të tillë si specializimin, integrimin horizontal ose vertikal apo ekonomitë e shkallës të subjektit. Në këtë rast do të bëhet rikarakterizimi i shpenzimeve shtesë të cilat rezultojnë nga përlllogaritjet e grupit të auditimit por nuk do t'i njihen subjektit si shpenzime të zbritshme për efekt të llogaritjes së tatimit mbi fitimin si dhe nuk do të lejohet kreditimi i TVSH-së në blerje, të cilat do të ishin n.q.s. do të ishin deklaruar korrekt nga subjekti, por mqs këto parregullsi po evidentohen

nga grupi i audituesve do të kalojnë si shpenzime të panjohura duke kaluar e gjithë e ardhura si fitim. Pra nga grupi i auditimit është kryer rikarakterizimi i shpenzimeve dhe investimeve, diferenca midis vlerës së faturuar të situacioneve deri tek niveli i kostove minimale fiskale të ndërtimit, të panjohur dhe paregjistruara nga subjekti si të ardhura dhe ndryshimi në deklaratën e tatim fitimit do të bëhet në rritje të të ardhurave dhe të shpenzimeve, por shpenzimet nuk njihen si të zbritshme për efekt të tatim fitimit, kjo do të ishte e mundur kur vete subjekti do të deklaronte këto shpenzime, jo kur kjo bëhen nga inspektori ose nga rekomandimi i grupit të audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit, pra kjo do të thotë se rritja në të ardhura do të kalojë e gjitha si fitim, si dhe duke kryer penalizimin e subjektit sipas përcaktimeve të nenit 124 “Kundërvajtjet në lëshimin e faturave tatimore, dëftesave tatimore dhe dokumentimin e transaksioneve” e Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, duke sjellë si pasojë efekte tatimore të pallogaritura në shumën 23,033,808 lekë detyrime të tatimit mbi fitimin dhe 23,033,808 lekë gjobë 100%, 30,711,743 lekë detyrime të TVSH-së dhe 30,711,743 lekë gjobë 100%, pra të ardhura gjithsej të munguar për buxhetin e shtetit në vlerën prej 107,491,102 lekë.

3. Nga analiza e librit të blerjeve dhe pasqyrës të të ardhurave dhe shpenzimeve janë konstatuar se janë njohur si shpenzime, dy fatura, në vlerë totale 10,519,104 lekë nga shoqëria “T. E. 2” SHPK, të cilat kanë përshkrimin “kamatëvonesa”, veprime të cilat janë në kundërshtim me përcaktimet e pikës f) të nenit 21 “Shpenzime të panjohura”, të Ligjit Nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar. Nga ana e grupit të audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit, është kryer rregullimi i shpenzimeve në PASH, duke i kaluar kamatëvonesat si shpenzime të panjohura për efekt të llogaritjes së tatim fitimit si dhe duke kryer penalizimin e subjektit sipas përcaktimeve të nenit 115 “Plotësim i pasaktë i deklaratës tatimore” të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar, duke sjellë si pasojë efekte tatimore të pallogaritura në shumën 1,577,866 lekë detyrime të tatimit mbi fitimin dhe 345,553 lekë gjobë 21.9%, për periudhën, pra të ardhura gjithsej të munguar për buxhetin e shtetit në vlerën prej 1,923,418 lekë.

4. Nga grupi i auditimit, u kontrolluan çmimet e shitjes së të njëjësive ndërtimore apartamente, dyqane, parkim etj, tek objekti “Godine banimi e shërbimesh 5, 6 dhe 7 kate me 3 kate parkimi nëntokë ne Rrugën "Kajo Karafili", Tiranë dhe rezultuan shitje nën çmimin fiskal minimal të zonë 10/1, të përcaktuar në Aneksin Nr.1 dhe Nr.2 të VKM Nr.168, datë 27.3.2019. Gjithashtu nga auditimi i akt konstatimin e mbajtur nga inxhinieria, në përlllogaritjet e sipërfaqeve të shitura me çmimin e referencës së zonës, janë kryer llogaritje të gabuara sepse nuk janë marrë në analizë pjesët e përbashkëta të cilat janë të shitshme dhe i faturohen klientëve. Në këtë mënyrë është ulur padrejtësisht vlera e të ardhurave, nga grupi i auditimit po paraqiten përlllogaritjet si më poshtë:

#### **Njësi Banimi**

TR kontratat shoqërisë (Sip neto për shitje = 5,572 m<sup>2</sup>) = 770,451,250 lekë  
 TR deklaruar [Çmim Ref x Sip Tot (Sip shitje + Sip për)] = 943,022,000 lekë

**Diferenca për rivlerësim = 172,570,750 lekë**

#### **Njësi Shërbimi**

TR kontratat shoqërisë (Sip neto për shitje = 716.5 m<sup>2</sup>) = 124,656,850 lekë

TR deklaruar [Çmim Ref x Sip Tot (Sip shitje + Sip për)] = 243,571,000 lekë

**Diferenca për rivlerësim = 118,914,150 lekë**

Nga analiza e mësipërme në total nga mosdeklarimi në shitje i sipërfaqeve të përbashkëta dhe i shitjes nën çmimin minimal fiskal të përcaktuar në VKM Nr.168, datë 27.3.2019, rezultuan 291,484,900 lekë, ku nga grupi i auditimit është rivlerësuar situata financiare e shoqërisë duke rritur të ardhurat dhe penalizimin sipas përcaktimeve të nenit 128 “Lëshimi i faturës së pasaktë”, të Ligjit Nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar, duke sjellë si pasojë efekte tatimore të pallogaritura në shumën 43,722,735 lekë detyrime të tatimit mbi fitimin dhe 21,861,368 lekë gjobë 50%, 58,296,980 lekë detyrime të TVSH-së dhe 29,148,490 lekë gjobë 50%, detyrime të tatimit mbi dividendin 19,820,973 lekë dhe 9,910,487 lekë gjobë 50%, pra të ardhura gjithsej të munguar për buxhetin e shtetit në vlerën prej 182,761,032 lekë.

5. Nga analiza e gjendjes së magazinës më 31.12.2018 dhe 31.12.2019 dhe lëvizjeve për produktin “Lëndë e parë/prodhim inerte”, ka rezultuar se ka faturuar si shitje shoqërisë “X. T.” SHPK, me kosto duke mos aplikuar marzhe fitimi në shitje. E njëjta situatë paraqitet edhe për produktin “çimento”, për të cilën janë kryer transaksionet e shitjes dhe blerjes, me vlerë të tatueshme 22,150,383 lekë, pa aplikuar marzhe fitimi në shitje. Nga grupi i auditimit është kryer vlerësimi alternativ i situatës financiare të tatimpaguesit, duke rivlerësuar transaksionin dhe aplikuar marzhe fitimi (7% sa fitimi i vitit 2019, deklaruar në bilanc), duke qenë se plotësohen kushtet sipas përcaktimeve të pikave b) dhe d) të nenit 71/2 “Përdorimi i metodave alternative të vlerësimit në rastet e veprimeve për shmangien e tatimit dhe abuzimit me parimet e ligjit tatimor”, pikën a) të nenit 72 “Baza e mënyrave alternative të vlerësimit”, i Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar dhe penalizimin sipas përcaktimeve të nenit 115 “Plotësim i pasaktë i deklaratës tatimore” të Ligjit Nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar, duke sjellë si pasojë efekte tatimore të pallogaritura në shumën 232,579 lekë detyrime të tatimit mbi fitimin dhe 50,935 lekë gjobë 21.9%, 310,105 lekë detyrime të TVSH-së dhe 67,913 lekë gjobë 21.9%, detyrime të tatimit mbi dividendin 105,436 lekë dhe 23,090 lekë gjobë 21.9%, pra të ardhura gjithsej të munguar për buxhetin e shtetit në vlerën prej 790,059 lekë.

6. Nga auditimi i raportit të kontrollit kanë rezultuar mangësi procedurale në trajtimin e pikave të programit të kontrollit tatimor, veprime këto në kundërshtim me përcaktimet e Kapitullit VII “Kryerja e kontrollit tatimor” të Manualit të Kontrollit Tatimor, konkretisht:

- Nuk është kryer një analizë e plotë e postit të “Arkëtimeve në avancë”;
- Nuk është kryer një analizë e plotë e transaksioneve dhe marrëdhënieve të kleringut;

- Nuk është kryer një analizë e plotë transaksioneve me palët e lidhura.

**Kriteri:**

Ligji Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; neni 71/2; 72; 115; 124; 128;

Ligjit Nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar; neni 21;

VKM Nr.168, datë 27.3.2019;

Udhëzimi i Këshillit të Ministrave Nr.3 “Miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2016”;

Manual i Kontrollit Tatimor.



- Ndikimi/Efekti:** Nga ana e inspektoreve të kontrollit nuk është vepruar në përputhje me përcaktimet e dispozitave ligjore, në lidhje me faturimin e situacioneve të punimeve të ndërtimit poshtë kostove minimale fiskale të ndërtimit, njohja e faturimeve të kamatëvonesave si shpenzime të njohura për efekt llogaritje të tatimit mbi fitimin në PASH, shitje e njësive ndërtimore poshtë çmimit minimal fiskal dhe mos njohje e të ardhurave nga shitjet e pjesëve të përbashkëta ndërtimore, si dhe shitje të materialeve të ndërtimit pa aplikuar mazhe fitimi, duke sjellë si pasojë efekte tatimore të pallogaritura në shumën 292,965,611 lekë për periudhën 12/2018-05/2020.
- Shkaku:** Mosrespektimi i dispozitave dhe përcaktimeve ligjore lidhur me punën e inspektorëve të Sektorit të Kontrollit Operacional.
- Rëndësia:** E Lartë.
- Rekomandimi:** DTM, për tatimpaguesin “M. I.” SHPK, për të cilët janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit, në përputhje me kërkesat ligjore dhe proceduriale, të kryejë ri kontroll tatimor sipas përcaktimeve të nenit 85 “Ri kontrolli tatimor” të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit të evidentuar paraprakisht në vlerën prej 292,965,611 lekë.
- Titulli gjetjes:** **Parregullsi të konstatuara nga auditimi i raportit të kontrollit të subjektit “E.” SHPK, në lidhje me parregullsitë në pagat e deklaruara dhe kreditimi i TVSH së karburantit nga autoveturat.**
- Situata:** Nga auditimi i raporteve të kontrollit tatimor të subjektit “E.” SHPK, u konstatua se nga ana e inspektoreve të kontrollit nuk është vepruar në përputhje me përcaktimet e dispozitave ligjore, konkretisht në drejtim të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore sipas pikës së programit të kontrollit, kanë rezultuar problematikat si më poshtë:
1. Nisur nga natyra e aktivitet të tregtisë kryesisht me pakicë që zhvillon shoqëria si dhe duke kontrolluar në faqen online të shoqërisë rezulton se aktiviteti zhvillohet çdo ditë e hënë - e diel në orare të përcaktuara 07:30-22:30, të cilat në total përbëjnë 15 orë punë në ditë, pra dy turne. Kurse nga kontrolli i listëpagesave të deklaruara nga subjekti në sistemin C@ts për periudhën 11/2019-10/2021, ka deklaruar për punonjësit 22 ditë punë në muaj. Nga llogaritjet e grupit të auditimit rezulton se punonjësit punojnë më shumë se 22 ditë pune në muaj, nga rezulton se punohet edhe të ditë të shtune dhe të diele, ku sipas përcaktimeve të neni 87 të Kodit të Punës duhet që pagesa orare të jetë minimalisht 25% më e lartë se pagesa minimale orare, gjithashtu punohet edhe në turn të dytë në fashën orare 19:30-22:30, për të cilën paga orare duhet të jetë 20% më e lartë se pagesa minimale orare sipas përcaktimeve të neni 81 të Kodit të punës.
  - Nga ana e inspektorit të kontrollit tatimor nuk janë analizuar kontratat individuale të punës midis shoqërisë dhe punonjësve, në lidhje me përputhshmërinë e tyre me përcaktimet e dispozitave të Kodit të Punës në R.SH.
  - Nuk janë analizuar regjistrat që duhet të mbajë tatimpaguesi sipas përcaktimeve të nenit 15 “Mbajtja e regjistrimeve” të Ligjit Nr.9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
  - Nuk ka një analizë të llogaritjes së pagës dhe elementëve përbërës të saj sipas përcaktimeve të dispozitave të nenit 119 të Kreut XI të Kodit të Punës në R.SH.
  - Nuk janë analizuar regjistrat që duhet të mbajë tatimpaguesi sipas

përcaktimeve të nenit 15 “Mbajtja e regjistrimeve” të Ligjit Nr.9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

- Nuk ka një analizë të llogaritjes së pagës dhe elementëve përbërës të saj sipas përcaktimeve të dispozitave të nenit 119 të Kreut XI të Kodit të Punës në R.SH. Në lidhje me situatën e trajtuar më sipër grupi i audituesve gjykon se janë arsye themelore për të kryer rivlerësimin e pagave, kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi, për punonjësit me paga të deklaruara jo konform përcaktimeve të legjislacionit, në lidhje me këtë tatimpagues i cili ka plotësuar deklaratat tatimore që përmbajnë të dhëna të pasakta ose të falsifikuara dhe nuk mban dhe ruan llogari apo regjistrime të sakta të transaksioneve, veprime të cilat janë në kundërshtim me gërmën b, c të nenit 71, gërma a e nenit 72 të Ligjit Nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar dhe penalizimin sipas përcaktimeve të nenit 119 “Mosdeklarimi i punonjësve dhe fshehja e pagës”, të Ligjit Nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar, duke sjellë si pasojë efekte tatimore të pallogaritura në shumën 1,043,475 lekë detyrime të Sig Shoq Punëdhënësi dhe 1,043,475 lekë gjobë 100%, 660,867 lekë detyrime të Sig Shoq Punëmarrësi dhe 660,867 lekë gjobë 100%, 118,261 lekë detyrime Sig Shënd Punëdhënësi dhe 118,261 lekë gjobë 100%, 118,261 lekë detyrime Sig Shënd Punëmarrësi dhe 118,261 lekë gjobë 100%, 547,831 lekë detyrime TAP dhe 547,831 lekë gjobë 100%, pra të ardhura gjithsej të munguar për buxhetin e shtetit në vlerën prej 4,977,388 lekë.

2. Në lidhje me pagat e padeklaruara saktë nga ana e subjektit, është kryer rivlerësimi i situatës financiare, ku shpenzimi i fondit të pagave të rivlerësuara është rikarakterizuar si e ardhura dhe është kryer penalizimi i subjektit sipas përcaktimeve të nenit 115 “Plotësim i pasaktë i deklaratës tatimore”, të Ligjit Nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar, duke sjellë si pasojë efekte tatimore të pallogaritura në shumën 1,018,692 lekë detyrime të tatimit mbi fitimin dhe 223,093 lekë gjobë 21.9%, 1,358,255 lekë detyrime të TVSH-së dhe 297,458 lekë gjobë 21.9%, detyrime të tatimit mbi dividentin 461,807 lekë dhe 101,136 lekë gjobë 21.9%, pra të ardhura gjithsej të munguar për buxhetin e shtetit në vlerën prej 3,460,441 lekë.

3. Nga kontrolli i blerjeve për periudhën objekt kontrolli, ka rezultuar se shoqëria ka bërë blerje karburanti me vlerë të tatueshme = 4,997,923 lekë për të cilën ka kredituar edhe TVSH në blerje në vlerën 999,584 lekë. Në raportin e kontrollit tatimor nga ana e inspektore nuk është kryer një analizë e detajuar e shfrytëzimit të mjeteve të transportit, rrugët e realizuara, normativat e konsumit për rrugë, proces pune ose volum punimesh etj, veprime këto në kundërshtim me përcaktimet e nenit 55 “Kufizime të zbritjes së TVSH për disa furnizime” të Udhëzimit Nr.6, datë 30.01.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në R.SH”. Nga kontrolli i inventarit të makinave, të paraqitura në anekse të bilanceve të viteve 2019-2021, ka rezultuar se shoqëria ka në pronësi, 8 automjete, nga të cilat 5 janë autovetura. Në kushtet e mungesës së të dhënave dhe regjistrimeve mbi konsumin dhe harxhimin e karburantit nga ana e autoveturave dhe mjeteve të punës, do të supozohet se kanë konsum të barabartë të çdo mjeti. Pra për 5 autoveturat e shoqërisë, për të cilat inspektori i kontrollit duhet të kishte kryer verifikimet n.q.s. janë furnizuar me karburant nga shoqëria për të cilin është bërë kreditimi i TVSH në blerje, veprime këto të cilat janë në kundërshtim me përcaktimet ligjore të nenit 74 “Kufizimet e së drejtës së zbritjes” të Ligjit Nr.92/2014 “Për TVSH-në, në Republikën e Shqipërisë”, nga grupi i auditimit

është kryer rregullimi i TVSH-së, së kredituar të karburantit të përdorur nga autoveturat dhe kryer penalizimi i subjektit sipas përcaktimeve të nenit 115 “Plotësim i pasaktë i deklaratës tatimore” të Ligjit Nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, duke sjellë si pasojë efekte tatimore të pallogaritura në shumën 624,740 lekë ulje e tepriçës kreditore të TVSH-së dhe 136,818 lekë gjobë, pra të ardhura gjithsej të munguar për buxhetin e shtetit në vlerën prej 761,558 lekë.

**Kriteri:** Ligji Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 71; 72; 115; 119;  
Ligjit Nr.92/2014 “Për TVSH, në R.SH”, neni 74;  
Udhëzimit Nr.6, datë 30.01.2015 “Për TVSH, në R.SH”: neni 55  
Kodit të Punës në R.SH; neni 81; 87; 119  
Ligjit Nr.9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; neni 15;  
Manuali i Kontrollit Tatimor.

**Ndikimi/Efekti:** Nga ana e inspektoreve të kontrollit nuk është vepruar në përputhje me përcaktimet e dispozitave ligjore, në lidhje me parregullsitë në pagat e deklaruara dhe kreditimi i TVSH së karburantit nga autoveturat duke sjellë si pasojë efekte tatimore të pallogaritura në shumën 9,199,387 lekë për periudhën 11/2019-10/2021.

**Shkaku:** Mosrespektimi i dispozitave dhe përcaktimeve ligjore lidhur me punën e inspektorëve të Sektorit të Kontrollit Operacional.

**Rëndësia:** E Lartë.

**Rekomandimi:** DTM, për tatimpaguesin “E.” SHPK, për të cilët janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit, në përputhje me kërkesat ligjore dhe proceduriale, të kryejë ri kontroll tatimor sipas përcaktimeve të nenit 85 “Ri kontrolli tatimor” të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit të evidentuar paraprakisht në vlerën prej 9,199,387 lekë.

**Titulli gjetjes:** **Parregullsi të konstatuara nga auditimi i raportit të kontrollit të subjektit “A. K.” SHPK, në lidhje me faturimin e situacioneve të punimeve të ndërtimit poshtë kostove minimale fiskale të ndërtimit dhe kreditimi i TVSH së karburantit nga autoveturat.**

**Situata:** Nga auditimi i raporteve të kontrollit tatimor të subjektit “A. K.” SHPK, u konstatua se nga ana e inspektoreve të kontrollit nuk është vepruar në përputhje me përcaktimet e dispozitave ligjore, konkretisht problematikat si në vijim:

1. Nga auditimi i raportit kontrollit tatimor dhe akti verifikimit të mbajtur për subjektin “A. K.” SHPK, nga ana e inspektorit dhe inxhinierit pranë DTM, janë konstatuar mungesa e analizave dhe vlerësimeve të projektit dhe preventivit të punimeve, nuk është kryer një zbërthim i matrialeve dhe lëndës së parë në përbërje të punimeve të situacionuar, bazuar në manualin nr.1 “Analiza Teknike-Për prodhimin e matrialeve të ndërtimit, udhëzime dhe kritere” dhe manualin nr.2 “Analiza Teknike-Për punimet e ndërtimit të ndërtesave”, si dhe krahasimi me punimet e kryera realisht në terren. Gjithashtu janë konstatuar mungesa e analizave të librezës së masave, situacioneve pjesore mujore, progresive dhe përfundimtare të volumit të punimeve të ndërtimit, të cilat janë dokumenta justifikuese për verifikimin e volumit të punimeve të kryera sipas përcaktimeve të nënpikave 3.2 dhe 3.3 të pikës 3, Kreu 1 të Udhëzimit Nr.3, datë 15.2.2001

“Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, ndryshuar me Udhëzimin Nr.1 datë, 16.06.2011.

2. Nga grupi i auditimit është kryer analiza e kostove të ndërtimit të objekteve dhe ka rezultuar se subjekti “A. K.” SHPK, është në rolin e sipërmarrësit/ndërtuesit, pra në këtë rast ka kryer faturime të situacioneve të punimeve të kryera poshtë nivelit të kostove mesatare që janë përcaktuar në Udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr.3 “Miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2016”. Duhet të ishin rivlerësuar transaksionet, duke çuar vlerën e situacioneve të punimeve të ndërtimit në blerje drejt vlerës minimale të ndërtimit për efekte fiskale, për diferencat si më poshtë:

**- Godinë banimi 9 kate me 1 kat nëntokësorë Rruga "Aleksandër Moisiu", Tiranë: 23,006,501 lekë; diferenca vlerë faturimi – kosto minimale fiskale ndërtimi (1,491 lekë/m<sup>2</sup>) x sipërfaqe ndërtimit (15,433.93 m<sup>2</sup>).**

Në sensin ekonomik të situatës jemi në kushtet e situatës së “shitjes nën kosto”, sepse në raportin e kontrollit nuk kemi justifikimin e këtyre transaksioneve nën kostot mesatare të ndërtimit, me element të tillë si specializimin, integrimin horizontal ose vertikal apo ekonominë e shkallës të subjektit. Në këtë rast do të bëhet rikarakterizimi i shpenzimeve shtesë të cilat rezultojnë nga përllogaritjet e grupit të auditimit por nuk do t’i njihen subjektit si shpenzime të zbritshme për efekt të llogaritjes së tatimit mbi fitimin si dhe nuk do të lejohet kreditimi i TVSH-së në blerje, të cilat do të ishin n.q.s. do të ishin deklaruar korrekt nga subjekti, por mqs këto parregullsi po evidentohen nga grupi i audituesve do të kalojnë si shpenzime të panjohura duke kaluar e gjithë e ardhura si fitim. Pra nga grupi i auditimit është kryer rikarakterizimi i shpenzimeve dhe investimeve, diferenca midis vlerës së faturuar të situacioneve deri tek niveli i kostove minimale fiskale të ndërtimit, të panjohur dhe peregjistruara nga subjekti si të ardhura dhe ndryshimi në deklaraten e tatim fitimit do të bëhet në rritje të të ardhurave dhe të shpenzimeve, por shpenzimet nuk njihen si të zbritshme për efekt të tatim fitimit, kjo do të ishte e mundur kur vete subjekti do të deklaronte këto shpenzime, jo kur kjo bëhen nga inspektori ose nga rekomandimi i grupit të audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit, pra kjo do të thotë se rritja në të ardhura do të kalojë e gjitha si fitim, si dhe duke kryer penalizimin e subjektit sipas përcaktimeve të nenit 124 “Kundërvajtjet në lëshimin e faturave tatimore, dëftesave tatimore dhe dokumentimin e transaksioneve” e Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, duke sjellë si pasojë efekte tatimore të pallogaritura në shumën 3,450,975 lekë detyrime të tatimit mbi fitimin dhe 3,450,975 lekë gjobë 100%, 4,601,300 lekë detyrime të TVSH-së dhe 4,601,300 lekë gjobë 100%, pra të ardhura gjithsej të munguar për buxhetin e shtetit në vlerën prej 16,104,551 lekë.

3. Nga kontrolli i blerjeve për periudhën objekt kontrolli, ka rezultuar se shoqëria ka bërë blerje karburanti me vlerë të tatueshme = 1,839,162 lekë për të cilën ka kredituar edhe TVSH në blerje në vlerën 367,834 lekë. Në raportin e kontrollit tatimor nga ana e inspektores nuk është kryer një analizë e detajuar e shfrytëzimit të mjeteve të transportit, rrugët e realizuara, normativat e konsumit për rrugë, proces pune ose volum punimesh etj, veprime këto në kundërshtim me përcaktimet e nenit 55 “Kufizime të zbritjes së TVSH për disa furnizime” të Udhëzimit Nr.6, datë 30.01.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në R.SH”. Nga kontrolli i inventarit të makinave, të paraqitura në anekse të bilanceve të viteve 2019-2021, ka rezultuar se shoqëria ka në pronësi, 3 automjete, nga të cilat 2 janë autovetura. Në kushtet e mungesës së të dhënave dhe regjistrimeve

mbi konsumin dhe harxhimin e karburantit nga ana e autoveturave dhe mjeteve të punës, do të supozohet se kanë konsum të barabartë të çdo mjeti. Pra për 2 autoveturat e shoqërisë, për të cilat inspektori i kontrollit duhet të kishte kryer verifikimet n.q.s. janë furnizuar me karburant nga shoqëria për të cilin është bërë kreditimi i TVSH në blerje, veprime këto të cilat janë në kundërshtim me përcaktimet ligjore të nenit 74 “Kufizimet e së drejtës së zbritjes” të Ligjit Nr.92/2014 “Për TVSH-në, në Republikën e Shqipërisë”, nga grupi i auditimit është kryer rregullimi i TVSH-së, së kredituar të karburantit të përdorur nga autoveturat dhe kryer penalizimi i subjektit sipas përcaktimeve të nenit 115 “Plotësim i pasaktë i deklaratës tatimore” të Ligjit Nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, duke sjellë si pasojë efekte tatimore të pallogaritura në shumën 245,223 lekë ulje e tepicës kreditore të TVSH-së dhe 53,703 lekë gjobë, pra të ardhura gjithsej të munguar për buxhetin e shtetit në vlerën prej 298,927 lekë.

- Kriteri:** Ligji Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 115;  
Ligjit Nr.92/2014 “Për TVSH, në R.SH”, neni 74;  
Udhëzimi i Këshillit të Ministrave Nr.3 “Miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2016”;  
Manuali i Kontrollit Tatimor.
- Ndikimi/Efekti:** Nga ana e inspektoreve të kontrollit nuk është vepruar në përputhje me përcaktimet e dispozitave ligjore, në lidhje me faturimin e situacioneve të punimeve të ndërtimit poshtë kostove minimale fiskale të ndërtimit, diferenca të pajustificuara në inventar të artikullit “hekur” dhe kreditimi i TVSH së karburantit nga autoveturat. , duke sjellë si pasojë efekte tatimore të pallogaritura në shumën 16,403,478 lekë për periudhën 02/2020-03/2022.
- Shkaku:** Mosrespektimi i dispozitave dhe përcaktimeve ligjore lidhur me punën e inspektorëve të Sektorit të Kontrollit Operacional.
- Rëndësia:** E Lartë.
- Rekomandimi:** DTM, për tatimpaguesin “A. K.” SHPK, për të cilët janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit, në përputhje me kërkesat ligjore dhe proceduriale, të kryejë ri kontroll tatimor sipas përcaktimeve të nenit 85 “Ri kontrolli tatimor” të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit të evidentuar paraprakisht në vlerën prej 16,403,478 lekë.

**Titulli gjetjes:** **Parregullsi të konstatuara nga auditimi i raportit të kontrollit të subjektit “N. C.” SHPK, në lidhje me faturimin e situacioneve të punimeve të ndërtimit poshtë kostove minimale fiskale të ndërtimit dhe diferenca në inventar të disa artikujve.**

**Situata:** Nga auditimi i raporteve të kontrollit tatimor të subjektit “N. C.” SHPK, u konstatua se nga ana e inspektoreve të kontrollit nuk është vepruar në përputhje me përcaktimet e dispozitave ligjore, konkretisht problematikat si në vijim:  
1. Nga auditimi i raport kontrollit tatimor dhe akt verifikimit të mbajtur për subjektin “N. C.” SHPK, nga ana e inspektorit dhe inxhinierit pranë DTM, janë konstatuar mungesa e analizave dhe vlerësimeve të projektit dhe preventivit të punimeve, nuk është kryer një zbërthim i matrialeve dhe lëndës së parë në përbërje të punimeve të situacionuar, bazuar në manualin nr.1 “Analiza Teknike-Për prodhimin e matrialeve të ndërtimit, udhëzime dhe kritere” dhe manualin nr.2 “Analiza Teknike-Për punimet e ndërtimit të ndërtesave”, si dhe krahasimi

me punimet e kryera realisht në terren. Gjithashtu janë konstatuar mungesa e analizave të librezës së masave, situacioneve pjesore mujore, progresive dhe përfundimtare të volumit të punimeve të ndërtimit, të cilat janë dokumenta justifikuese për verifikimin e volumit të punimeve të kryera sipas përcaktimeve të nënpikave 3.2 dhe 3.3 të pikës 3, Kreu 1 të Udhëzimit Nr.3, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, ndryshuar me Udhëzimin Nr.1 datë, 16.06.2011.

2. Nga grupi i auditimit është kryer analiza e kostove të ndërtimit të objekteve dhe ka rezultuar se subjekti “N. C.” SHPK, është në rolin e sipërmarrësit dhe investitorit, pra në këtë rast ka kryer faturime të situacioneve të punimeve të kryera poshtë nivelit të kostove mesatare që janë përcaktuar në Udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr.3 “Miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2016”. Duhet të ishin rivlerësuar transaksionet, duke çuar vlerën e situacioneve të punimeve të ndërtimit në blerje drejt vlerës minimale të ndërtimit për efekte fiskale, për diferencat si më poshtë:

**- Objekti Godinë banimi dhe shërbimi 7-9 kate me 2 kate parkim nëntokë-Kulla 1, Rruga "Robert Shvarc", Tiranë: 108,982,273 lekë; diferenca vlerë faturimi – kosto minimale fiskale ndërtimi (3,835 lekë/m<sup>2</sup>) x sipërfaqe ndërtimit mbas kolaudimit (28,419.22 m<sup>2</sup>).**

Në sensin ekonomik të situatës jemi në kushtet e situatës së “shitjes nën kosto”, sepse në raportin e kontrollit nuk kemi justifikimin e këtyre transaksioneve nën koston mesatare të ndërtimit, me element të tillë si specializimin, integrimin horizontal ose vertikal apo ekonomitë e shkallës të subjektit. Në këtë rast do të bëhet rikarakterizimi i shpenzimeve shtesë të cilat rezultojnë nga përllogaritjet e grupit të auditimit por nuk do t'i njihen subjektit si shpenzime të zbritshme për efekt të llogaritjes së tatimit mbi fitimin si dhe nuk do të lejohet kreditimi i TVSH-së në blerje, të cilat do të ishin n.q.s. do të ishin deklaruar korrekt nga subjekti, por mqs këto parregullsi po evidentohen nga grupi i audituesve do të kalojnë si shpenzime të panjohura duke kaluar e gjithë e ardhura si fitim. Pra nga grupi i auditimit është kryer rikarakterizimi i shpenzimeve dhe investimeve, diferenca midis vlerës së faturuar të situacioneve deri tek niveli i kostove minimale fiskale të ndërtimit, të panjohur dhe paregjistruara nga subjekti si të ardhura dhe ndryshimi në deklaratën e tatimit fitimit do të bëhet në rritje të të ardhurave dhe të shpenzimeve, por shpenzimet nuk njihen si të zbritshme për efekt të tatimit fitimit, kjo do të ishte e mundur kur vete subjekti do të deklaronte këto shpenzime, jo kur kjo bëhen nga inspektori ose nga rekomandimi i grupit të audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit, pra kjo do të thotë se rritja në të ardhura do të kalojë e gjitha si fitim, si dhe duke kryer penalizimin e subjektit sipas përcaktimeve të nenit 124 “Kundërvajtjet në lëshimin e faturave tatimore, dëftesave tatimore dhe dokumentimin e transaksioneve” e Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, duke sjellë si pasojë efekte tatimore të pallogaritura në shumën 16,347,341 lekë detyrime të tatimit mbi fitimin dhe 16,347,341 lekë gjobë 100%, 21,796,455 lekë detyrime të TVSH-së dhe 21,796,455 lekë gjobë 100%, pra të ardhura gjithsej të munguar për buxhetin e shtetit në vlerën prej 76,287,591 lekë.

3. Nga analiza e bilancit të lëvizjes materiale të kryera nga inspektori dhe inventari i deklaruar në sistemin C@ts për vitin 2020, kanë rezultuar diferencat të pa justifikuara, konkretisht në sasi dhe artikull: 7m<sup>3</sup> rërë, 1 ton çimento, 800 copë tulla (10x25x25), 5,600 copë tulla (20x25x25), 6m<sup>3</sup> granil. Kurse për vitin 2021 kanë rezultuar diferencat e pajustificuara, konkretisht në sasi dhe artikull:

246 m<sup>2</sup> pllaka, 407 kg profile, 1,400 kg kol, 20 kg bojak, 668 kg bojë. Nga grupi i auditimi këto diferenca të konstatuara dhe të pajustificuara do të konsiderohen si shitje pafaturë dhe shitjet e tatueshme të shoqërisë për periudhën do të rivlerësohen me kosto duke u rritur në shumën prej 802,662 lekë. Për këto parregullësi të konstatuara është kryer penalizimi i subjektit sipas përcaktimeve të nenit 124 “Kundërvajtjet në lëshimin e faturave tatimore, dëftesave tatimore dhe dokumentimin e transaksioneve” të Ligjit Nr.9920 datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar, duke sjellë si pasojë efekte tatimore të pallogaritura në shumën 120,399 lekë detyrime të tatimit mbi fitimin dhe 120,399 lekë gjobë 100%, 160,532 lekë detyrime të TVSH-së dhe 160,532 lekë gjobë 100%, 54,581 lekë detyrime të tatimit mbi dividendin dhe 54,581 lekë gjobë 100%, pra të ardhura gjithsej të munguar për buxhetin e shtetit në vlerën prej 671,024 lekë.

- Nga ana e inspektorit të kontrollit nuk është kryer një analizë e detajuar e të dhënave mbi kontratat e shitjes së apartamenteve, njërive të shërbimit dhe parkimeve.

- Tek llogaria parapagimeve nuk është kryer një analizë e detajuar e kësaj llogari sipas kontratë porosive për blerje në objektet e papërfunduara të cilat janë akoma në proces.

- Nuk ka kryer një analizë të detajuar e llogarive “Të drejta të arkëtueshme nga njësitë ekonomike brenda grupit” dhe “DASH-Të pagueshme ndaj njërive ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse”.

**Kriteri:** Ligji Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; neni 124;

Udhëzimi i Këshillit të Ministrave Nr.3 “Miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2016”;

Manual i Kontrollit Tatimor.

**Ndikimi/Efekti:** Nga ana e inspektoreve të kontrollit nuk është vepruar në përputhje me përcaktimet e dispozitave ligjore, në lidhje me faturimin e situacioneve të punimeve të ndërtimit poshtë kostove minimale fiskale të ndërtimit dhe diferenca të pajustificuara në inventar për disa artikuj, duke sjellë si pasojë efekte tatimore të pallogaritura në shumën 76,958,615 lekë për periudhën 02/2020-03/2022.

**Shkaku:** Mosrespektimi i dispozitave dhe përcaktimeve ligjore lidhur me punën e inspektorëve të Sektorit të Kontrollit Operacional.

**Rëndësia:** E Lartë.

**Rekomandimi:** DTM, për tatimpaguesin “N. C.” SHPK, për të cilët janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit, në përputhje me kërkesat ligjore dhe proceduriale, të kryejë ri kontroll tatimor sipas përcaktimeve të nenit 85 “Ri kontrolli tatimor” të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit të evidentuar paraprakisht në vlerën prej 76,958,615 lekë.

**Titulli gjetjes:** Parregullsi të konstatuara nga auditimi i raportit të kontrollit të subjektit “M. K.” Shpk, në lidhje me faturimin e situacioneve të punimeve të ndërtimit poshtë kostove minimale fiskale të ndërtimit, njohja e shpenzimeve të interesit jo në funksion të aktivitetit dhe jo me qëllim sigurimin e fitimit, kreditim i gabuar i TVSH për blerjet e furniturave me 20% TVSH, që u shërbejnë njëkohësisht aktiviteteve të përjashtuar dhe të tatueshme, parregullësi në pagat e deklaruara.

**Situata:** Nga auditimi i raporteve të kontrollit tatimor të subjektit “M. K.” Shpk, u

konstatua se nga ana e inspektoreve të kontrollit nuk është vepruar në përputhje me përcaktimet e dispozitave ligjore, konkretisht problematikat si në vijim:

1. Nga auditimi i raport kontrollit tatimor dhe akt verifikimit të mbajtur për subjektin “M. K.” Shpk, nga ana e inspektorit dhe inxhinierit pranë DTM, janë konstatuar mungesa e analizave dhe vlerësimeve të projektit dhe preventivit të punimeve, nuk është kryer një zbërthim i matrialeve dhe lëndës së parë në përbërje të punimeve të situacionuar, bazuar në manualin nr.1 “Analiza Teknike-Për prodhimin e matrialeve të ndërtimit, udhëzime dhe kritere” dhe manualin nr.2 “Analiza Teknike-Për punimet e ndërtimit të ndërtesave”, si dhe krahasimi me punimet e kryera realisht në terren. Gjithashtu janë konstatuar mungesa e analizave të librezës së masave, situacioneve pjesore mujore, progresive dhe përfundimtare të volumit të punimeve të ndërtimit, të cilat janë dokumenta justifikuese për verifikimin e volumit të punimeve të kryera sipas përcaktimeve të nënplikave 3.2 dhe 3.3 të pikës 3, Kreu 1 të Udhëzimit Nr.3, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, ndryshuar me Udhëzimin Nr.1 datë, 16.06.2011.

2. Nga grupi i auditimit është kryer analiza e kostove të ndërtimit të objekteve dhe ka rezultuar se subjekti “M. K.” Shpk, është në rolin e sipërmarrësit dhe investitorit, pra në këtë rast ka kryer faturime të situacioneve të punimeve të kryera poshtë nivelit të kostove mesatare që janë përcaktuar në Udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr.3 “Miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2016”. Duhet të ishin rivlerësuar transaksionet, duke çuar vlerën e situacioneve të punimeve të ndërtimit në blerje drejt vlerës minimale të ndërtimit për efekte fiskale, për diferencat si më poshtë:

**- Objekti Godinë banimi dhe shërbime 10 kate me 1 kate parkim nëntokë Rruga "Don Bosko", Tiranë: 34,233,757 lekë; diferenca vlerë faturimi – kosto minimale fiskale ndërtimi (2,707 lekë/m<sup>2</sup>) x sipërfaqe ndërtimit (12,644.2 m<sup>2</sup>).**

Në sensin ekonomik të situatës jemi në kushtet e situatës së “shitjes nën kosto”, sepse në raportin e kontrollit nuk kemi justifikimin e këtyre transaksioneve nën koston mesatare të ndërtimit, me element të tillë si specializimin, integrimin horizontal ose vertikal apo ekonomitë e shkallës të subjektit. Në këtë rast do të bëhet rikarakterizimi i shpenzimeve shtesë të cilat rezultojnë nga përlogaritjet e grupit të auditimit por nuk do t'i njihen subjektit si shpenzime të zbritshme për efekt të llogaritjes së tatimit mbi fitimin si dhe nuk do të lejohet kreditimi i TVSH-së në blerje, të cilat do të ishin n.q.s. do të ishin deklaruar korrekt nga subjekti, por mqs këto parregullësi po evidentohen nga grupi i audituesve do të kalojnë si shpenzime të panjohura duke kaluar e gjithë e ardhura si fitim. Pra nga grupi i auditimit është kryer rikarakterizimi i shpenzimeve dhe investimeve, diferenca midis vlerës së faturuar të situacioneve deri tek niveli i kostove minimale fiskale të ndërtimit, të panjohur dhe paregjistruara nga subjekti si të ardhura dhe ndryshimi në deklaratën e tatimit fitimit do të bëhet në rritje të të ardhurave dhe të shpenzimeve, por shpenzimet nuk njihen si të zbritshme për efekt të tatimit fitimit, kjo do të ishte e mundur kur vete subjekti do të deklaronte këto shpenzime, jo kur kjo bëhen nga inspektori ose nga rekomandimi i grupit të audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit, pra kjo do të thotë se rritja në të ardhura do të kalojë e gjitha si fitim, si dhe duke kryer penalizimin e subjektit sipas përcaktimeve të nenit 124 “Kundërvajtjet në lëshimin e faturave tatimore, dëftesave tatimore dhe dokumentimin e transaksioneve” e Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,



duke sjellë si pasojë efekte tatimore të pallogaritura në shumën 4,279,220 lekë detyrime të tatimit mbi fitimin dhe 4,279,220 lekë gjobë 100%, 5,705,626 lekë detyrime të TVSH-së dhe 5,705,626 lekë gjobë 100%, pra të ardhura gjithsej të munguar për buxhetin e shtetit në vlerën prej 19,969,692 lekë.

3. Nga analiza e raportit të kontrollit tatimor ka rezultuar se shoqëri "M. K." Shpk ka arkëtuar interesa nga shoqëritë "A." Shpk dhe "B. I." Shpk bazuar në kontratat e huadhëniesve lidhur me këto shoqëri. Konkretisht sipas kontratës së huasë datë 26.02.2018, amenduar me kontratën për shtyrje afati datë 26.02.2019, për shumën e huasë prej 80,000 Euro me një normë vjetore interesi prej 2%, ku shoqëria M. K. Shpk si huadhënëse është ortake në shoqërinë huamarrëse A. Shpk në masën 16.85% të kapitalit themeltar. Gjithashtu huamarrës shoqëria B.I. Shpk me NIPT L.S sipas kontratës noteriale të huasë Nr.405 Rep dhe 81 Kol datë 15.04.2017, në të cilën palët (Huadhënësi dhe Huamarrësi me të drejta pronësie të barabarta), kanë blerë një tokë për ndërtim në Lalëz, Durrës me një sipërfaqe prej 30,000 m<sup>2</sup> me vlerë prej 900,000 euro për secilin ose 1,800,000 euro në total për ndërtim vilash. Nga analiza e pasivit të bilancit të shoqërisë rezulton se shoqëria ka hua afatgjata në bankat e nivelit të dytë, gjendja e të cilave në 31.12.2018 rezulton 319,700,944 lekë dhe në 31.12.2019 rezulton 274,114,307 lekë, për të cilat ka paguar 10,196,680 lekë interesa në vitin 2019, sipas përcaktimeve të kontratave të huamarrjes. Grupi i audituesve gjykon në lidhje me shpenzimet e interesit se kemi të bëjmë me shpenzime të panjohura që nuk i kanë shërbyer aktivitetit të shoqërisë, me arsyetimin se shoqëria në aktivitetin e saj të deklaruar nuk e ka huadhënënie si dhe nuk është e licencuara për t'a kryer atë, gjithashtu theksojmë se shoqëria ka paguar interesa në nivelin e 4% për kreditë afatgjata që ka marrë nga bankat e nivelit të dytë dhe nga ana tjetër ka dhënë hua shoqërive (A. Shpk – Palë e lidhur dhe B. I. Shpk-Ortak në investim) me norma afërsisht 2%, veprime këto të cilat nuk janë konform vlerës dhe parimeve të një tregu të lirë si dhe janë në kundërshtim me përcaktimet e nenit 20 të Ligjit Nr.8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar. Nga sa argumentuar sa më sipër, ku rezulton se "Shpenzimet e interesit për huatë afatgjata", nuk janë kryer për qëllime fitimi, sigurimi dhe ruajtje të fitimit, grupi i audituesve i ka rikarakterizuar si shpenzime të panjohur duke rivlerësuar situatën financiare dhe penalizuar subjektin për këto parregullësi në deklaram sipas përcaktimeve të nenit 115 "Plotësim i pasaktë i deklaratës tatimore", të Ligjit Nr.9920 datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në R.SH", i ndryshuar, duke sjellë si pasojë efekte tatimore të pallogaritura në shumën 318,631 lekë detyrime të tatimit mbi fitimin dhe 69,780 lekë gjobë 21.9%, 144,446 lekë detyrime të tatim dividendi dhe 31,634 lekë gjobë 21.9%, pra të ardhura gjithsej të munguar për buxhetin e shtetit në vlerën prej 564,490 lekë.

4. Shoqëria bazuar në nenin 73 "Rregullat për aplikimin e koeficientit të zbritjes së TVSH-së" të Ligjit 92/2014 "Për TVSH në R.SH" si dhe në nenin 56 "Rregulla praktike mbi zbritjen e TVSH-së", pika 3 "Koeficienti i Zbritjes së TVSH-së" të Udhëzimit Nr.6 datë 30.01.2015, për shpenzimet me karakter të përgjithshëm për periudhën Janar-Shtator 2019 (Periudhë e kontrolluar më parë për TVSH) sipas Raport-Kontrollit të datës 13.01.2021, nuk është zbatuar kreditimi i pjesshëm i TVSH, por është lënë detyrë kontrollit pasardhës që të bëhet rregullimi i TVSH për komplet vitin 2019. Nga ana e inspektorit nuk është vepruar konform përcaktimeve të Ligjit Nr.92/2014 "Për TVSH-në, në RSH", i ndryshuar, pika 1 e nenit 69, neni 72, neni 78 si dhe nenin 80. Nga të dhënat e raportit të kontrollit dhe sistemit C@ts në lidhje me shitjet për periudhën 01.01.2019-31.12.2019, rillogarit koeficienti i zbritjes së TVSH-së (baza

vjetore) prej 32.10%, sipas përcaktimeve të nenit 72 të Ligjit Nr.92/2014 "Për TVSH në R.SH", i ndryshuar. Nga kontrolli analitikë i "Blerjeve të tatueshme me 20% TVSH nga furnitorë vendas" për vitin 2019, janë evidentuar blerjet e furniturave me vlerë të tatueshme = 15,088,434 lekë dhe TVSH = 3,017,399 lekë, të cilat u kanë shërbyer të dy aktiviteteve dhe mbi të cilën duhet të aplikohet koeficienti 32.10% i zbritjes së TVSH-së. Nga grupi i audituesve është kryer rregullimi i TVSH së zbritshme, duke njohur si të zbritshme vlerën e TVSH-së prej 968,585 lekë si dhe duke kryer penalizimi i subjektit sipas përcaktimeve të nenit 115 "Plotësim i pasaktë i deklaratës tatimore" të Ligjit Nr.9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, duke sjellë si pasojë efekte tatimore të pallogaritura në shumën 2,048,814 lekë ulje e tepicës kreditore të TVSH-së dhe 448,690 lekë gjobë 21.9%, pra të ardhura gjithsej të munguar për buxhetin e shtetit në vlerën prej 2,497,504 lekë.

5. Nga auditimi i raportit të kontrollit tatimor, konkretisht në drejtim të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore sipas pikës së programit të kontrollit, kanë rezultuar problematikat si më poshtë:

- Nga kontrolli i listëpagesave të subjektit të deklaruar në sistemin C@ts për periudhën 10/2019-12/2019, ka rezultuar se shoqëria ka deklaruar për punonjësit 26 ditë pune që është në tejkalim të kohëzgjatjes normale të punës prej 174 orë në muaj ose 22 ditë pune dhe pagesa për ditët shtesë duhet të kryhet me një shtesë jo më pak se 25% të pagesës të ditës normale sipas përcaktimeve të Kreut IX të Kodit të Punës në R.SH.

- Gjithashtu janë konstatuar raste ku shoqëria ka deklaruar pagesa të pagave orare për punonjësit poshtë pagës minimale orare që është përcaktuar në Vendim Nr.809, datë 26.12.2018 "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi".

- Nga ana e inspektorit të kontrollit tatimor nuk janë analizuar kontratat individuale të punës midis shoqërisë dhe punonjësve, në lidhje me përputhshmërinë e tyre me përcaktimet e dispozitave të Kodit të Punës në R.SH.

- Nuk janë analizuar regjistrat që duhet të mbajë tatimpaguesi sipas përcaktimeve të nenit 15 "Mbajtja e regjistrimeve" të Ligjit Nr.9136, datë 11.9.2003 "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

- Nuk ka një analizë të llogaritjes së pagës dhe elementëve përbërës të saj sipas përcaktimeve të dispozitave të nenit 119 të Kreut XI të Kodit të Punës në R.SH.

- Nuk janë analizuar regjistrat që duhet të mbajë tatimpaguesi sipas përcaktimeve të nenit 15 "Mbajtja e regjistrimeve" të Ligjit Nr.9136, datë 11.9.2003 "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

- Nuk ka një analizë të llogaritjes së pagës dhe elementëve përbërës të saj sipas përcaktimeve të dispozitave të nenit 119 të Kreut XI të Kodit të Punës në R.SH.

- Nuk ka një analizë të numrit të lartë të ndryshimit të punonjësve të shoqërisë, kryesisht në lidhje me largimet e shpeshta n.q.s. ndërprerjet e marrëdhënieve të punës janë konform kontratave dhe përcaktimeve të Kodit të Punës.

- Janë konstatuar parregullësi në llogaritjen e ditëve të punës dhe pagës për efekt të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për punonjësit e punësuar rishtazi ose të larguar përgjatë muajit.

- Nga kontrolli për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si dhe TAP-in, për periudhën 11/2020-03/2022 dhe nga analiza e listëpagesave të dorëzuar nga subjekti në sistemin C@ts, janë konstatuar parregullësi në llogaritjen e pagës për efekt të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe

shëndetësore për punonjësit me numër kategorie për kontributet 2/004(6), sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Në lidhje me situatën e trajtuar më sipër grupi i audituesve gjykon se janë arsye themelore për të kryer rivlerësimin e pagave, kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi, për punonjësit me paga të deklaruara jo konform përcaktimeve të legjislationit, në lidhje me këtë tatimpagues i cili ka plotësuar deklarata tatimore që përmbajnë të dhëna të pasakta ose të falsifikuara dhe nuk mban dhe ruan llogari apo regjistrime të sakta të transaksioneve, veprime të cilat janë në kundërshtim me gërmën b, c të nenit 71, gërma a e nenit 72 të Ligjit Nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar dhe penalizimin sipas përcaktimeve të nenit 119 “Mosdeklarimi i punonjësve dhe fshehja e pagës”, të Ligjit Nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar, duke sjellë si pasojë efekte tatimore të pallogaritura në shumën 36,372 lekë detyrime të Sig Shoq Punëdhënësi dhe 36,372 lekë gjobë 100%, 23,036 lekë detyrime të Sig Shoq Punëmarrësi dhe 23,036 lekë gjobë 100%, 4,122 lekë detyrime Sig Shënd Punëdhënësi dhe 4,122 lekë gjobë 100%, 4,122 lekë detyrime Sig Shënd Punëmarrësi dhe 4,122 lekë gjobë 100%, 10,789 lekë detyrime TAP dhe 10,789 lekë gjobë 100%, pra të ardhura gjithsej të munguar për buxhetin e shtetit në vlerën prej 156,882 lekë.

6. Në lidhje me pagat e padeklaruara saktë nga ana e subjektit, është kryer rivlerësimi i situatës financiare, ku shpenzimi i fondit të pagave të rivlerësuar është rikarakterizuar si e ardhura dhe është kryer penalizimi i subjektit sipas përcaktimeve të nenit 115 “Plotësimi i pasaktë i deklaratës tatimore”, të Ligjit Nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar, duke sjellë si pasojë efekte tatimore të pallogaritura në shumën 36,754 lekë detyrime të tatimit mbi fitimin dhe 8,049 lekë gjobë 21.9%, 49,005 lekë detyrime të TVSH-së dhe 10,732 lekë gjobë 21.9%, 16,662 lekë detyrime të tatimit mbi dividendin dhe 3,649 lekë gjobë 21.9%, pra të ardhura gjithsej të munguar për buxhetin e shtetit në vlerën prej 124,851 lekë.

**Kriteri:** Ligji Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; neni 71; 72; 115; 119; 124;  
Ligji Nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, neni 20;  
Ligjit 92/2014 “Për TVSH në R.SH, neni 69; 72; 73; 78; 80;  
Kodit të Punës në R.SH; neni 81; 87; 119  
Ligjit Nr.9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; neni 15;  
Udhëzimi i Këshillit të Ministrave Nr.3 “Miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2016”;  
Manual i Kontrollit Tatimor.

**Ndikimi/Efekti:** Nga ana e inspektoreve të kontrollit nuk është vepruar në përputhje me përcaktimet e dispozitave ligjore, në lidhje me faturimin e situacioneve të punimeve të ndërtimit poshtë kostove minimale fiskale të ndërtimit, njohja e shpenzimeve të interesit jo në funksion të aktivitetit dhe jo me qëllim sigurimin e fitimit, kreditim i gabuar i TVSH për blerjet e furniturave me 20% TVSH, që u shërbejnë njëkohësisht aktiviteteve të përjashtuar dhe të tatueshme, parregullësi në pagat e deklaruara, duke sjellë si pasojë efekte tatimore të pallogaritura në shumën 23,313,420 lekë për periudhën 10/2019-12/2019.

**Shkaku:** Mosrespektimi i dispozitave dhe përcaktimeve ligjore lidhur me punën e

- inspektorëve të Sektorit të Kontrollit Operacional.  
E Lartë.
- Rëndësia:**
- Rekomandimi:** DTM, për tatimpaguesin “M. K.” Shpk, për të cilët janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit, në përputhje me kërkesat ligjore dhe proceduriale, të kryejë ri kontroll tatimor sipas përcaktimeve të nenit 85 “Rikontroli tatimor” të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit të evidentuar paraprakisht në vlerën prej 23,313,420 lekë.
- Titulli gjetjes:** **Parregullsi të konstatuara nga auditimi i raportit të kontrollit të subjektit “A.-S.” SHPK, në lidhje me parregullësi në pagat e deklaruara, shpenzime konsulenca inxhinierike nga individë palë të lidhura jo për qëllime sigurimi të fitimit, shitje e makinerive dhe mjeteve të transportit drejt palëve të lidhura pa marzh fitimi dhe shitje e njësive komerciale poshtë çmimit minimal fiskal.**
- Situata:** Nga auditimi i raporteve të kontrollit tatimor të subjektit “A.-S.” SHPK, u konstatua se nga ana e inspektoreve të kontrollit nuk është vepruar në përputhje me përcaktimet e dispozitave ligjore, konkretisht problematikat si në vijim:
- Nga auditimi i raportit të kontrollit tatimor, konkretisht në drejtim të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore sipas pikës së programit të kontrollit, kanë rezultuar problematikat si më poshtë:
    - Nga kontrolli i listëpagesave të subjektit të deklaruara në sistemin C@ts për periudhën 11/2020-03/2022, ka rezultuar se shoqëria ka deklaruar për punonjësit 26 ditë pune që është në tejkallim të kohëzgjatjes normale të punës prej 174 orë në muaj ose 22 ditë pune dhe pagesa për ditët shtesë duhet të kryhet me një shtesë jo më pak se 25% të pagesës të ditës normale sipas përcaktimeve të Kreut IX të Kodit të Punës në R.SH.
    - Gjithashtu janë konstatuar raste ku shoqëria ka deklaruar pagesa të pagave orare për punonjësit poshtë pagës minimale orare që është përcaktuar në Vendim Nr.809, datë 26.12.2018 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi” dhe Vendimin Nr.1025, datë 16.12.2020 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”.
    - Nga ana e inspektorit të kontrollit tatimor nuk janë analizuar kontratat individuale të punës midis shoqërisë dhe punonjësve, në lidhje me përputhshmërinë e tyre me përcaktimet e dispozitave të Kodit të Punës në R.SH.
    - Nuk janë analizuar regjistrat që duhet të mbajë tatimpaguesi sipas përcaktimeve të nenit 15 “Mbajtja e regjistrimeve” të Ligjit Nr.9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
    - Nuk ka një analizë të llogaritjes së pagës dhe elementëve përbërës të saj sipas përcaktimeve të dispozitave të nenit 119 të Kreut XI të Kodit të Punës në R.SH.
    - Nuk ka një analizë të numrit të lartë të ndryshimit të punonjësve të shoqërisë, kryesisht në lidhje me largimet e shpeshta n.q.s. ndërprerjet e marrëdhënieve të punës janë konform kontratave dhe përcaktimeve të Kodit të Punës.
    - Janë konstatuar parregullësi në llogaritjen e ditëve të punës dhe pagës për efekt të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për punonjësit e punësuar rishtazi ose të larguar përgjatë muajit.
    - Nga kontrolli për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si dhe TAP-in, për periudhën 11/2020-03/2022 dhe nga analiza e listëpagesave të dorëzuar nga subjekti në sistemin C@ts, janë konstatuar parregullësi në

llogaritjen e pagës për efekt të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për punonjësit me numër kategorie për kontributet 2/004(6), sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Në lidhje me situatën e trajtuar më sipër grupi i audituesve gjykon se janë arsye themelore për të kryer rivlerësimin e pagave, kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi, për punonjësit me paga të deklaruara jo konform përcaktimeve të legjislationit, në lidhje me këtë tatimpagues i cili ka plotësuar deklarata tatimore që përmbajnë të dhëna të pasakta ose të falsifikuara dhe nuk mban dhe ruan llogari apo regjistrime të sakta të transaksioneve, veprime të cilat janë në kundërshtim me gërmën b, c të nenit 71, gërma a e nenit 72 të Ligjit Nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar dhe penalizimin sipas përcaktimeve të nenit 119 “Mosdeklarimi i punonjësve dhe fshehja e pagës”, të Ligjit Nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar, duke sjellë si pasojë efekte tatimore të pallogaritura në shumën 5,870,666 lekë detyrime të Sig Shoq Punëdhënësi dhe 5,870,666 lekë gjobë 100%, 3,718,089 lekë detyrime të Sig Shoq Punëmarrësi dhe 3,718,089 lekë gjobë 100%, 665,342 lekë detyrime Sig Shënd Punëdhënësi dhe 665,342 lekë gjobë 100%, 665,342 lekë detyrime Sig Shënd Punëmarrësi dhe 665,342 lekë gjobë 100%, 4,491,955 lekë detyrime TAP dhe 4,491,955 lekë gjobë 100%, pra të ardhura gjithsej të munguar për buxhetin e shtetit në vlerën prej 30,822,788 lekë.

2. Në lidhje me pagat e padeklaruara saktë nga ana e subjektit, është kryer rivlerësimi i situatës financiare, ku shpenzimi i fondit të pagave të rivlerësuar është rikarakterizuar si e ardhura dhe është kryer penalizimi i subjektit sipas përcaktimeve të nenit 115 “Plotësim i pasaktë i deklaratës tatimore”, të Ligjit Nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar, duke sjellë si pasojë efekte tatimore të pallogaritura në shumën 5,444,079 lekë detyrime të tatimit mbi fitimin dhe 1,192,253 lekë gjobë 21.9%, 7,258,772 lekë detyrime të TVSH-së dhe 1,589,671 lekë gjobë 21.9%, detyrime të tatimit mbi dividendin 2,467,983 lekë dhe 540,488 lekë gjobë 21.9%, pra të ardhura gjithsej të munguar për buxhetin e shtetit në vlerën prej 18,493,247 lekë.

3. Nga analiza e raport kontrollit për periudhën Janar-Dhjetor 2021, rezulton se shoqëria ka kryer blerje shërbime nga individë të cilët nuk janë të punësuar në shoqëri, për të cilat është llogaritur, mbajtur dhe paguar tatimi në burim sipas kontratave respektive. Në raport kontrolli sqarohet se janë shërbime inxhinierike, menaxhimi dhe përzgjedhje e matrialeve të ndërtimit në treg me argumentin se janë projekte specifike (Projektet: Rikualifikim i Lumit të Vlorës dhe Ndërtimi i Ujësjetës Librazhd).

- I. I. në shumën 21,808,162 lekë ose 150,000 euro për projektin “Rikualifikim i Lumit të Vlorës” sipas kontratës së shërbimit nr.22 datë 12.02.2021 dhe nisur nga fakti se për këtë shërbim nga një individ që nuk është i punësuar në kompani, është një shërbim i paguar vetëm në një rast dhe jo në mënyrë të njëtrajtshme muaj për muaj dhe për këtë shërbim është llogaritur dhe paguar tatimi në burim në masën 15% mbi vlerën e shërbimit të kryer.

- A.t I. në vlerën 21,808,162 lekë ose 150,000 euro për projektin “Ndërtimi i Ujësjetës Librazhd” sipas kontratës së shërbimit nr.25 datë 12.02.2021 dhe nisur nga fakti se për këtë shërbim nga një individ që nuk është i punësuar në kompani, është një shërbim i paguar vetëm në një rast dhe jo në mënyrë të njëtrajtshme muaj për muaj dhe për këtë shërbim është llogaritur dhe paguar tatimi në burim në masën 15% mbi vlerën e shërbimit të kryer.

Fillimisht sqarojmë se nga kontrolli më i thelluar në sistemin C@ts dhe të dhënave të QKB, rezulton se z. I.I., z. A. I. dhe shoqëria “A. – S.” SHPK, janë palë të lidhura sipas përcaktimeve të nenit 1 të Ligjit Nr.42/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, konkretisht:

- Z. I. I. është ortak i zotërues i 100% të kuotave të shoqërisë “M.” SHPK me NIPT M.C, e cila nga ana e saj është zotëruese e 57% të kuotave të shoqërisë “F.” SHPK me NIPT L.K, e cila është zotëruese e 100% të kuotave të shoqërisë “A.–S.” SHPK me NIPT J.W. Si përfundim arrijmë në konkluzionin se I. I. dhe shoqëria “A. – S.” SHPK, janë palë të lidhura sepse është zotërues në mënyrë indirekte i 57% të kuotave.

- Z. A. I. është administrator i shoqërisë “V.” SHPK me NIPT L.S, kapitali i saj është zotëruar nga shoqëria “F.” SHPK me NIPT L.K, e cila zotëron edhe kapitalin e shoqërisë “A. – S.” SHPK, sipas numri të çështjes: CN-060800-12-16, “Depozitimi i vendimit date 24.11.2016, ku është vendosur: Kalimi i kuotave të ortakëve z. I. I. dhe z. S. I. që zotërojnë në shoqërinë "V." në formën e kontribut në natyrë në kapitalin e shoqërisë së themeluar "F." SHPK”. Kjo përqindje e zotërimit të kuotave të shoqërisë “V.” SHPK, ka vazhduar deri në datën 23.12.2021 kur është kryer edhe ndryshimi tjetër sipas numrit të çështjes: CN-836966-12-21, kur është larguar si ortak shoqëria "F." SHPK”. Kontrata e shërbimit midis shoqërisë dhe A. I. është lidhur në datë 12.02.2021, gjë që vërteton faktin se kemi të bëjmë me veprime midis palëve të lidhura.

- Në raportin e kontrollit tatimor nuk është kryer një analizë e kontratave që janë lidhur midis shoqërisë dhe individëve si dhe të nevojës specifike që ka shoqëria për këtë shërbim në realizimin e projekteve të “Rikualifikim i Lumit të Vlorës” dhe “Ndërtimi i Ujësjellësit Librazhd”.

- Gjithashtu theksojmë se kontratat e punëve publike për projektet e “Rikualifikim i Lumit të Vlorës” dhe “Ndërtimi i Ujësjellësit Librazhd”, janë lidhur përpara se sa kontratat e shërbimit me këta dy individë, nga rrjedh se shoqëria është shpallur fituese e tenderit duke plotësuar kriteret e përgjithshme dhe specifike si dhe çdo kërkesë tjetër të përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Në këtë logjikë rrjedh se nuk janë të domosdoshme këto “shërbime inxhinierike, menaxhimi dhe përzgjedhje e matrialeve të ndërtimit në treg”, për realizimin e kontratave të projekteve të “Rikualifikim i Lumit të Vlorës” dhe “Ndërtimi i Ujësjellësit Librazhd”.

- Nga kontrolli i listëpagesave të dorëzuara në sistemin C@ts, rezulton se shoqëria ka të punësuar në mënyrë të përhershme mesatarisht mbi 100 inxhinier të profileve të ndryshme, çdo muaj përgjatë periudhës së kontrollit 11/2020-03/2022, por nga ana e inspektorit të kontrollit tatimor nuk ka një analizë n.q.s. ky shërbim mund të kryhet nga personeli i brendshëm pa qenë nevoja e kontraktimit të jashtëm si dhe nuk ka një kontroll dhe analizë të formimit profesional dhe ekzistencën e certifikimeve dhe licencave të miratuara për këtë shërbim që po ofrojnë këta individë ndaj shoqërisë.

Nga sa më sipër grupi i auditimit gjykon se jemi në kushtet e shpenzimeve të cilat nuk janë kryer për qëllime fitimi, sigurimi dhe ruajtje të fitimit, gjë që është në shkëlqje të përcaktimeve të nenit 20 të Ligjit Nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, të cilat janë rikarakterizuar si shpenzime të panjohur duke rivlerësuar situatën financiare dhe penalizuar subjektin për këto parregullësi në deklaram sipas përcaktimeve të nenit 115 “Plotësim i pasaktë i deklaratës tatimore”, të Ligjit Nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar, duke sjellë si pasojë efekte tatimore të pallogaritura në

shumën 6,542,449 lekë detyrime të tatimit mbi fitimin dhe 1,432,796 lekë gjobë 21.9%, 2,965,910 lekë detyrime të tatimit mbi dividendin dhe 649,534 lekë gjobë 21.9%, pra të ardhura gjithsej të munguar për buxhetin e shtetit në vlerën prej 11,590,689 lekë.

4. Nga kontrolli i detajuar në sistemin C@ts dhe QKB, rezulton se kuotat e kapitalit të shoqërisë blerëse "A. R." SHPK dhe shoqërisë shitëse "A.-S." SHPK, zotërohen nga shoqëria "F." SHPK, e cili zotëron 100% të kapitalit të tyre. Në këtë mënyrë kemi që subjektet A. R. SHPK dhe A.-S. SHPK, janë palë të lidhura dhe transaksionet midis tyre janë transaksione të kontrolluara të cilat duhet t'ju përmbahen kushteve dhe parimeve të tregut të lirë, sipas përcaktimeve të nenit 1 të Ligjit Nr.42/2014 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar. Nga analiza e raportit të kontrollit tatimor rezulton se shoqëria ka kryer shitje të aktiveve afatgjata si mjete pune, mjete transporti dhe vilë në G. C.t, pa realizuar fitim, ku vlera e shitjes është sa vlera e mbetur prej 202,684,952 lekë. Nga ku dalim në konkluzionin se kemi të bëjmë me transaksione midis palëve të lidhura jo në bazë të parimit të vlerës së tregut në shitjen pa realizuar fitim, të mjeteve të punës dhe mjeteve të transportit si dhe duke shmangur tatim mbi fitimin për fitimet kapitale, dhe njëkohësisht merr në vlera të larta me qera mjete pune dhe makineri po nga kjo shoqëri. Si dhe gjithashtu transaksionit pa efekte ekonomike thelbësore me shoqërinë N. M. SHPK, në shitjen e vilës në G. C., pa realizuar dhe duke shmangur pagesën e tatimit mbi fitimin. Nga sa analizuar më sipër në lidhje me transaksionet e shitjes së mjeteve të punës dhe mjeteve të transportit, midis palëve të lidhura që nuk u përmbahen kushteve të tregut dhe transaksioneve pa efekte ekonomike thelbësore me shoqërinë N. M. SHPK, në shitjen e vilës në G. C, pa realizuar fitim, grupi i audituesve ka kryer rivlerësimin e transaksioneve duke përdorë marzhin neto të fitimit të deklaruar në pasqyrat financiare prej 26.68%, sipas përcaktimeve të germës dh) të nenit 71, germave a), b), c), ç), d) të nenit 71/2 dhe germës a) të nenit 72 të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në R.SH", i ndryshuar, si dhe duke penalizuar subjektin sipas përcaktimeve të nenit 115 të Ligjit Nr.9920 datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në R.SH", i ndryshuar, duke sjellë si pasojë efekte tatimore të pallogaritura në shumën 8,111,452 lekë detyrime të tatimit mbi fitimin dhe 1,776,408 lekë gjobë 21.9%, 3,677,191 lekë detyrime të tatimit mbi dividendin dhe 805,305 lekë gjobë 21.9%, pra të ardhura gjithsej të munguar për buxhetin e shtetit në vlerën prej 14,370,356 lekë.

5. Nga grupi i auditimit, u kontrolluan çmimet e shitjes së njësive komerciale zyra dhe depo, tek objekti "S.A. A.", drejt shoqërisë I. SHPK (të cilat janë palë të lidhura), dhe rezultuan shitje nën çmimin fiskal minimal të zonë 2/1, të përcaktuar në Aneksin Nr.1 dhe Nr.2 të VKM Nr.168, datë 27.3.2019. Konkretisht sipas Aneksit Nr.2 "Çmimet mesatare referuese për metër katror sipërfaqe ndërtimi për vlerësimin e vlerës së taksueshme për ndërtime dhe ambiente jo-banimi. Në total shitje nën çmimin minimal fiskal të përcaktuar në VKM Nr.168, datë 27.3.2019, rezultuan 876,264,845 lekë, ku nga grupi i auditimit është rivlerësuar situata financiare e shoqërisë duke rritur të ardhurat dhe penalizimin sipas përcaktimeve të nenit 128 "Lëshimi i faturës së pasaktë", të Ligjit Nr.9920 datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në R.SH", i ndryshuar, duke sjellë si pasojë efekte tatimore të pallogaritura në shumën 109,533,106 lekë detyrime të tatimit mbi fitimin dhe 54,766,553 lekë gjobë 50%, 146,044,141 lekë detyrime të TVSH-së dhe 73,022,070 lekë gjobë 50%, 61,338,539 lekë detyrime të tatimit mbi dividendin dhe 30,669,270 lekë gjobë

50%, pra të ardhura gjithsej të munguar për buxhetin e shtetit në vlerën prej 475,373,678 lekë.

6. Nga kontrolli në sistemin C@ts i listëpagesave janë konstatuar në muajin Mars 2021 dhe Janar 2022, pagat bruto në vlera të larta për disa individë, të cilat nuk janë analizuar nga ana e inspektorit të kontrollit, konkretisht: z. E.P., Drejtor (6,731,906 lekë - 03/2021), z. E. S., Sipërmarrës (6,520,057 lekë – 03/2021 dhe 8,883,362 lekë – 01/2022), z. B. L., Drejtor i Përgjithshëm në ndërtim (4,899,229 lekë – 03/2020), z. A. A., Drejtor i Zbatimit të Projektit (5,103,269 lekë – 03/2020).

7. Nga auditimi i raportit të kontrollit janë konstatuar dy fatura “Shërbim konsulence financiare dhe menaxhimi”, në vlerat respektive, fatura 2020 në vlerën 3,464,440 lekë, me 692,888 lekë TVSH dhe Fatura vitit 2021 në vlerën 19,772,634 lekë, me 3,954,528 lekë TVSH, nga shoqëria “F.” SHPK, e cila zotëron 100% të kapitalit të shoqërisë “A.-S.”, theksojmë se këto vlera janë dukshëm më të larta se shërbimet e konsulencës nga shoqëri të tjera, të cilat nuk janë palë të lidhura dhe nga ana e inspektorit nuk është kryer një analizë e detajuar se çfarë janë këto shpenzime dhe si i kanë shërbyer aktivitetit të “A.-S.” SHPK.

**Kriteri:** Ligji Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; neni 71; 71/2; 72; 115; 119; 128;

Ligji Nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, neni 20;

Kodit të Punës në R.SH; neni 81; 87; 119

Ligjit Nr.9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; neni 15;

VKM Nr.168, datë 27.3.2019;

Manual i Kontrollit Tatimor.

**Ndikimi/Efekti:** Nga ana e inspektoreve të kontrollit nuk është vepruar në përputhje me përcaktimet e dispozitave ligjore, në lidhje me parregullësi në pagat e deklaruara, shpenzime konsulencia inxhinierike nga individë palë të lidhura jo për qëllime sigurimi të fitimit, shitje e makinerive dhe mjeteve të transportit drejt palëve të lidhura pa marzh fitimi dhe shitje e njësisve komerciale poshtë çmimit minimal fiskal, duke sjellë si pasojë efekte tatimore të pallogaritura në shumën 550,650,758 lekë për periudhën 11/2020-03/2022.

**Shkaku:** Mosrespektimi i dispozitave dhe përcaktimeve ligjore lidhur me punën e inspektorëve të Sektorit të Kontrollit Operacional.

**Rëndësia:** E Lartë.

**Rekomandimi:** DTM, për tatimpaguesin “A.-S.” SHPK, për të cilët janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit, në përputhje me kërkesat ligjore dhe proceduriale, të kryejë rikontroll tatimor sipas përcaktimeve të nenit 85 “Rikontrolli tatimor” të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit të evidentuar paraprakisht në vlerën prej 550,650,758 lekë.

**Titulli gjetjes:** Parregullsi të konstatuara nga auditimi i raportit të kontrollit të subjektit “I.” SHPK, në lidhje me faturimin e situacioneve të punimeve të ndërtimit poshtë kostove minimale fiskale të ndërtimit, shitje e njësisve ndërtimore poshtë çmimit minimal fiskal si dhe diferenca të pajustificuara në inventarin e lëndës së parë.



## Situata:

Nga auditimi i raporteve të kontrollit tatimor të subjektit “I.” SHPK, u konstatua se nga ana e inspektoreve të kontrollit nuk është vepruar në përputhje me përcaktimet e dispozitave ligjore, konkretisht problematikat si në vijim:

1. Nga auditimi i raport kontrollit tatimor dhe akt verifikimit të mbajtur për subjektin “I.” SHPK, nga ana e inspektorit dhe inxhinierit pranë DTM, janë konstatuar mungesa e analizave dhe vlerësimeve të projektit dhe preventivit të punimeve, nuk është kryer një zbërthim i matrialeve dhe lëndës së parë në përbërje të punimeve të situacionuar, bazuar në manualin nr.1 “Analiza Teknike-Për prodhimin e matrialeve të ndërtimit, udhëzime dhe kriteret” dhe manualin nr.2 “Analiza Teknike-Për punimet e ndërtimit të ndërtesave”, si dhe krahasimi me punimet e kryera realisht në terren. Gjithashtu janë konstatuar mungesa e analizave të librezës së masave, situacioneve pjesore mujore, progresive dhe përfundimtare të volumit të punimeve të ndërtimit, të cilat janë dokumenta justifikuese për verifikimin e volumit të punimeve të kryera sipas përcaktimeve të nënpikeve 3.2 dhe 3.3 të pikës 3, Kreu 1 të Udhëzimit Nr.3, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, ndryshuar me Udhëzimin Nr.1 datë, 16.06.2011.

2. Nga grupi i auditimit është kryer analiza e kostove të ndërtimit të objekteve dhe ka rezultuar se subjekti “I.” SHPK, është në rolin e sipërmarrësit dhe investitorit, pra në këtë rast ka kryer faturime të situacioneve të punimeve të kryera poshtë nivelit të kostove mesatare që janë përcaktuar në Udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr.3 “Miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2016”. Duhet të ishin rivlerësuar transaksionet, duke çuar vlerën e situacioneve të punimeve të ndërtimit në blerje drejt vlerës minimale të ndërtimit për efekte fiskale, për diferencat si më poshtë:

***- Objekti Kompleks banimi dhe shërbimi 1, 8, 10 dhe 12 kate, me 1 katë parkimi nëntokë dhe dy godina banimi dhe shërbimi 12 kate me 1 kate parkimi nëntokë, Rruga “Artan Lenja”, Tiranë: 33,190,534 lekë; diferenca vlerë faturimi – kosto minimale fiskale ndërtimi (1,237 lekë/m<sup>2</sup>) x sipërfaqe ndërtimit (26,841 m<sup>2</sup>).***

Në sensin ekonomik të situatës jemi në kushtet e situatës së “shitjes nën kosto”, sepse në raportin e kontrollit nuk kemi justifikimin e këtyre transaksioneve nën kostot mesatare të ndërtimit, me element të tillë si specializimin, integrimin horizontal ose vertikal apo ekonominë e shkallës të subjektit. Në këtë rast do të bëhet rikarakterizimi i shpenzimeve shtesë të cilat rezultojnë nga përlogaritjet e grupit të auditimit por nuk do t'i njihen subjektit si shpenzime të zbritshme për efekt të llogaritjes së tatimit mbi fitimin si dhe nuk do të lejohet kreditimi i TVSH-së në blerje, të cilat do të ishin n.q.s. do të ishin deklaruar korrekt nga subjekti, por mqs këto parregullësi po evidentohen nga grupi i audituesve do të kalojnë si shpenzime të panjohura duke kaluar e gjithë e ardhura si fitim. Pra nga grupi i auditimit është kryer rikarakterizimi i shpenzimeve dhe investimeve, diferenca midis vlerës së faturuar të situacioneve deri tek niveli i kostove minimale fiskale të ndërtimit, të panjohur dhe peregjistruara nga subjekti si të ardhura dhe ndryshimi në deklaratën e tatimit fitimit do të bëhet në rritje të të ardhurave dhe të shpenzimeve, por shpenzimet nuk njihen si të zbritshme për efekt të tatimit fitimit, kjo do të ishte e mundur kur vete subjekti do të deklaronte këto shpenzime, jo kur kjo bëhen nga inspektori ose nga rekomandimi i grupit të audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit, pra kjo do të thotë se rritja në të ardhura do të kalojë e gjitha si fitim, si dhe duke kryer penalizimin e subjektit sipas përcaktimeve të nenit 124 “Kundërvajtjet në lëshimin e faturave tatimore,

dëftesave tatimore dhe dokumentimin e transaksioneve” e Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, duke sjellë si pasojë efekte tatimore të pallogaritura në shumën 4,978,580 lekë detyrime të tatimit mbi fitimin dhe 4,978,580 lekë gjobë 100%, 6,638,107 lekë detyrime të TVSH-së dhe 6,638,107 lekë gjobë 100%, pra të ardhura gjithsej të munguar për buxhetin e shtetit në vlerën prej 23,233,374 lekë.

3. Nga analiza e raportit të kontrollit tatimor pasqyrohet se subjekti ka shitur 109.5 m<sup>3</sup> beton M150, 57.5 m<sup>3</sup> beton M200, 936 m<sup>3</sup> beton M250, 1,464 m<sup>3</sup> beton M300 dhe 260 m<sup>3</sup> beton M350, për vitin 2019. Duke qenë se inspektori i kontrollit dhe inxhinieri nuk janë shprehur për normativën e prodhimit të betoni M300, do të bazohemi tek normativa e deklaruar sipas Manualit Nr.1 “Analiza Teknike” Për prodhimin e materialeve të ndërtimit, udhëzime e kritere, ku përcaktohet se për prodhimin e 1m<sup>3</sup> beton M300 do të nevojiten 0.43 m<sup>3</sup> rërë, 0.73 m<sup>3</sup> çakëll dhe 0.388 ton çimento. Duke u nisur nga normativat e deklaruar si dhe sipas manualit të ndërtimit është kryer zbërthimi i sasive të materialeve të nevojshme për prodhimin e sasive të betonit të deklaruar të shitura nga shoqëria, nga ku kanë rezultuar diferenca mbi normativë në lëndën e parë të përdorur, konkretisht 1,120.54 m<sup>3</sup> rërë, 381.44 m<sup>3</sup> çakëll dhe 199.58 ton çimento. Nga grupi i auditimi këto diferenca të konstatuara dhe të pajustificuara janë konsideruar si shitje pafaturë dhe shitjet e tatueshme të shoqërisë për periudhën janë rivlerësuar me koston e inventarit sipas bilancit kontabël të vitit 2019, duke u rritur në shumën prej 1,811,765 lekë si dhe është kryer penalizimi i subjektit sipas përcaktimeve të nenit 124 “Kundërvajtjet në lëshimin e faturave tatimore, dëftesave tatimore dhe dokumentimin e transaksioneve” të Ligjit Nr.9920 datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar, duke sjellë si pasojë efekte tatimore të pallogaritura në shumën 271,765 lekë detyrime të tatimit mbi fitimin dhe 271,765 lekë gjobë 100%, 362,353 lekë detyrime të TVSH-së dhe 362,353 lekë gjobë 100%, 123,200 lekë detyrime të tatimit mbi dividentin dhe 123,200 lekë gjobë 100%, pra të ardhura gjithsej të munguar për buxhetin e shtetit në vlerën prej 1,514,636 lekë.

4. Nga grupi i auditimit, u kontrolluan çmimet e shitjes së të njëjësive ndërtimore apartamente, dyqane, parkim etj, tek objekti “Kompleksi banimi 3 kate, me 1-3 kat pranë Kopshtit Botanik” në Selite, Komuna Farkë, Tiranë, dhe rezultuan shitje nën çmimin fiskal minimal të zonë 6, të përcaktuar në Aneksin Nr.1 dhe Nr.2 të VKM Nr.168, datë 27.3.2019. Konkretisht sipas Aneksit Nr.2 “Çmimet mesatare referuese për metër katror sipërfaqe ndërtimi për vlerësimin e vlerës së taksueshme për ndërtime dhe ambiente jo-banimi”. Në total shitje nën çmimin minimal fiskal të përcaktuar në VKM Nr.168, datë 27.3.2019, rezultuan 34,513,643 lekë, ku nga grupi i auditimit është rivlerësuar situata financiare e shoqërisë duke rritur të ardhurat dhe penalizimin sipas përcaktimeve të nenit 128 “Lëshimi i faturës së pasaktë”, të Ligjit Nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar, duke sjellë si pasojë efekte tatimore të pallogaritura në shumën 5,177,046 lekë detyrime të tatimit mbi fitimin dhe 2,588,523 lekë gjobë 50%, 6,902,729 lekë detyrime të TVSH-së dhe 3,451,365 lekë gjobë 50%, 2,346,928 lekë detyrime të tatimit mbi dividentin dhe 1,173,464 lekë gjobë 50%, pra të ardhura gjithsej të munguar për buxhetin e shtetit në vlerën prej 21,640,054 lekë.

5. Nga analiza e PASH, ka rezultuar se shoqëria ka njohur shpenzime financiare prej 7,026,420 lekë për vitin 2018 dhe 12,030,207 lekë për vitin 2019, me pretendimin se janë shpenzime të cilat kanë ardhur nga humbjet e shkaktuara nga kurset e këmbimit dhe nga ana e inspektorit të kontrollit nuk është bërë një

	<p>analizë e detajuar e llogarive në valutë të huaj dhe diferencave të kursit të këmbimit që e kanë shkaktuar, por është mjaftuar se faktin se janë nxjerr nga sistemi informatik financiar “Financa 5” e subjektit.</p>
<b>Kriteri:</b>	<p>Ligji Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; neni 124; 128; VKM Nr.168, datë 27.3.2019; Udhëzimi i Këshillit të Ministrave Nr.3 “Miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2016”; Manual i Kontrollit Tatimor.</p>
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	<p>Nga ana e inspektoreve të kontrollit nuk është vepruar në përputhje me përcaktimet e dispozitave ligjore, në lidhje me faturimin e situacioneve të punimeve të ndërtimit poshtë kostove minimale fiskale të ndërtimit, shitje e njësisive ndërtimore poshtë çmimit minimal fiskal si dhe diferenca të pajustificuara në inventarin e lëndës së parë , duke sjellë si pasojë efekte tatimore të pallogaritura në shumën 46,388,064 lekë për periudhën 07/2018-09/2020.</p>
<b>Shkaku:</b>	<p>Mosrespektimi i dispozitave dhe përcaktimeve ligjore lidhur me punën e inspektorëve të Sektorit të Kontrollit Operacional.</p>
<b>Rëndësia:</b>	<p>E Lartë.</p>
<b>Rekomandimi:</b>	<p>DTM, për tatimpaguesin “I.” SHPK, për të cilët janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit, në përputhje me kërkesat ligjore dhe procedurale, të kryejë rikontroll tatimor sipas përcaktimeve të nenit 85 “Rikontrolli tatimor” të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit të evidentuar paraprakisht në vlerën prej 46,388,064 lekë.</p>
<b>Titulli gjetjes:</b>	<p><b>Parregullsi të konstatuara nga auditimi i raportit të kontrollit, të subjektit “A. A. E.” SHA, në lidhje me klasifikimin në llogarinë e gabuar kontabël dhe aplikimi i metodës jo të duhur të amortizimit të aktivit “H.”.</b></p>
<b>Situata:</b>	<p>Nga auditimi i raportit të kontrollit tatimor të tatimpaguesit “A. A. E.” SHA, i cili ka volume në vlera të larta të punimeve ndërtimore si dhe kompleksitet të lartë të transaksioneve financiare, janë konstatuar mungesa të analizave dhe vlerësimeve të detajuara të kontratave koncesionare, lejeve të ndërtimit, punimeve referuar projekteve, grafikut të punimeve, aktet e kolaudimit të veprave dhe raportet e AKBN-së, si institucioni përgjegjës për monitorimin e hidrocentraleve, element këto që rrisin riskun operacional për trajtimin korrekt të situatës. Nga rrjedh se nga administrata tatimore e DTM-së, janë certifikuar investime dhe TVSH-ja, për vlera punimesh ende të pa certifikuara prej organeve kompetente sipas detyrimeve kontraktuale dhe legjislacionit të fushës përkatëse, pavarësisht riskut teknik ose risqeve të tjera që mund të çenojnë funksionimin normal të tyre, garantimin dhe gjenerimin e të ardhurave të tatueshme të vijueshme, të cilat i japin tatimpaguesit të drejtën e zbritjes së tatimit sipas përcaktimeve të Kreut IX “Lindja dhe aplikimi i së drejtës së zbritjes” të Ligjit Nr.92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Udhëzimit Nr.6, datë 30.01.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”. Sipas marrëveshjes së koncesionit, shoqëria koncesionare është e lejuar që të furnizojë prodhimin neto të energjisë elektrike brenda ose jashtë Shqipërisë. Marrëveshja e koncesionit përbën një model projekti i tipit BOT (Ndërtim-Operim-Transferim) dhe do të zgjasë për një periudhë prej 41 vjetësh (35 vjet me një zgjatje prej 6 vitesh e aprovuar nga</p>

vendimi Nr.442 me date 22 Maj 2013), me të drejtë zgjatjeje automatike pas përmbushjes së disa kushteve të përcaktuara në marrëveshjen e koncesionit. Pas kësaj periudhe hidrocentrali do t'i transferohet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjistikës (METE), pa asnjë tarifë bashkë me pajisjet e lidhura operuese, të drejtat dhe kontratat. Koncesionari do të ndërtojë tre hidrocentrale "Peshqesh", "Ura e Fanit" dhe "Fangu" (Siç specifikohet në shtesën e kontratës së koncesionit aprovuar nga vendimi Nr.51 me date 25.01.2017, me një kapacitet total të instaluar prej 109.71 MW, investimi total është 210,184,740 Euro). Ndërtimi i tre hidrocentraleve të Peshqeshit përfundoi me 4 Maj 2015. Kapaciteti i instaluar dhe kapaciteti vjetor për prodhimin është 34 MË dhe 118.400.000 kWh respektivisht. Ndërtimi i hidrocentralit Ura Fanit dhe Fangu përfundojë më 30 nëntor 2017. Baza e përgatitjes së pasqyrave financiare, përshkruar në shënimet shpjeguese deklarohet se është në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), por nuk është shpjeguar mbi cilin standard dhe parim është bërë klasifikimi i kontratës koncesionare si aktiv afatgjatë material dhe metoda e amortizimit përkatëse për këtë aktiv. Veprime këto të cilat në gjykimin e grupit të auditimit janë në kundërshtim me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), sepse në përfundim të ndërtimit dhe vendosjes në punë të hidrocentraleve, duke filluar prodhimin e energjisë elektrike, duhet që të gjitha investimet në punime, makineri dhe shërbime të kryera, për sjelljen në gjendje pune të hidrocentralit, të ishin kapitalizuar në dy llogari kontabël të bilancit sipas klauzolave, përkatësisht në zërat aktive afatgjata jo-materiale dhe aktive financiare. Ndarje kjo sipas përcaktimeve të SNK 38 "Aktivet Jo-materiale", SNK 39 "Instrumentet Financiar", KIRFN 12 "Marrëveshjet Koncesionare të Shërbimit", KIS 29 "Marrëveshjet e Koncesionit për Shërbimet - Dhënia e informacioneve shpjeguese" dhe SKK 13 "Aktivet biologjike dhe marrëveshjet koncesionare", e cila është në harmoni me SNRF, në varësi të periudhës që autoriteti kontraktor i ka siguruar shitjen e garantuar të energjisë (*xx vjet*) si aktiv financiar, kurse për pjesën tjetër të kohëzgjatjes së afatit të kontratës koncesionare (*xx vjet*), ku shoqëria ka të drejt ta shes energjinë elektrike në treg të lirë si aktiv afatgjatë jo-material. Në aspektin kontabël jemi në situatën e një marrëveshje koncesionare të kushtëzuar dhe ku përfitimit ekonomike të ardhshme, do të vijnë nga e drejta e tarifimit për energjinë që do të shitet sipas përcaktimeve të marrëveshjes koncesionare. Gjithashtu për t'u theksuar është edhe fakti se shoqëria nuk e kontrollon aktivin sepse nuk është pronare e aktivit material të krijuar që në rastin konkret është hidrocentrali, pra nuk plotësohet kushti "*pronësisë/kontrollit mbi aktivin*", që të njihet si aktiv afatgjatë material në bilancin e shoqërisë si dhe nuk është aktivi material afatgjatë, që do t'i gjenerojnë të ardhura por e drejta e tarifimit nga e cila do të gjenerohen edhe të ardhurat e shoqërisë, pra nuk plotësohet që nga përdorimi i aktivit do të gjenerohen të ardhura në të ardhmen. Por për ta përfituar të drejtën e tarifimit duhet të bëjë ndërtimin dhe vënien në punë të hidrocentraleve sipas përcaktimeve të kontratës koncesionare përkatëse. Pra nga sa më sipër arrijmë në konkluzionin se çdo investim dhe shpenzim që subjekti ka kryer për të vendosur në gjendje pune hidrocentralin si përmirësim i tokës + ndërtesa + makineri, me qëllim prodhimin e energjisë elektrike sipas kushteve dhe përcaktimeve të kontratës koncesionare me autoritetin kontraktor duhet të kapitalizoheshin dhe njiheshin në fund tek vlera e aktivit jo-material dhe trajtimi i mëpasshëm i tij të vazhdonte sipas përcaktimeve të standarteve të kontabilitetit. Nga kjo analizë dalim në përfundimin se nëpërmjet kontabilizimit të gabuar të marrëveshjes koncesionare si aktiv afatgjatë material në pasqyrat

financiare dhe aplikimit të metodës jo të duhur të amortizimit, shoqëria ka rënduar PASH padrejtësisht me më shumë shpenzime amortizimi, konkretisht 263,602,604 lekë për vitin 2015, 379,247,639 lekë për vitin 2016, 426,650,489 lekë për vitin 2017, 694,402,643 lekë për vitin 2018, 632,152,180 lekë për vitin 2019, se sa përcaktohet nga SNRF dhe SNK, duke kryer në këtë mënyrë uljen e fitimit të tatueshëm në mënyrë të padrejtë gjë që ka sjell uljen e detyrimit tatimor për tatim fitimin. Nga grupi i auditimit shpenzimet e amortizimit të njohura jo në përputhje me përcaktimet e SNRF dhe SNK, janë klasifikuar si shpenzime të panjohura sipas përcaktimeve të shkronjës j) shpenzimet të cilat tejkalojnë kufijtë e përcaktuar me ligj apo me akte nënligjore të nenit 21 “Shpenzime të panjohura” të Ligjit Nr.8438, Datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar dhe është kryer penalizimi i subjektit sipas përcaktimeve të nenit 115 “Plotësim i pasaktë i deklaratës tatimore”, të Ligjit Nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar, duke sjellë si pasojë efekte tatimore të pallogaritura në shumën 359,408,333 lekë detyrime të tatimit mbi fitimin dhe 64,980,583 lekë gjobë 21.9%, 162,931,777 lekë detyrime të tatimit mbi dividendin dhe 35,682,059 lekë gjobë 21.9%, pra të ardhura gjithsej të munguar për buxhetin e shtetit në vlerën prej 623,002,752 lekë.

**Kriteri:**

- Ligji Nr.8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, neni 22;
- Ligji Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; neni 115;
- SKK 1 “Kuatridi i përgjithshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare”;
- SKK 5 “Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jo materiale”;
- SKK 13 “Aktivet Biologjike dhe Marrëveshjet Konçesionare”;
- SNK 38 “Aktivet Jo-materiale”;
- SNK 39 “Instrumentet Financiar”;
- KIRFN 12 “Marrëveshjet Konçesionare të Shërbimit”;
- KIS 29 “Marrëveshjet e Konçesionit për Shërbimet - Dhënia e informacioneve shpjeguese”;
- SKK 13 “Aktivet biologjike dhe marrëveshjet konçesionare”;
- Manuali i Kontrollit Tatimor.

**Ndikimi/Efekti:**

Nga ana e inspektorit të kontrollit operacional, nuk janë kryer verifikimet e subjektit sipas legjislacionit dhe standarteve të kontabilitetit në lidhje me klasifikimin kontabël dhe përzgjedhjen e metodës së amortizimit për aktivin “HEC”.

**Shkaku:**

Mosrespektimi i dispozitave dhe përcaktimeve ligjore lidhur me punën e inspektorëve të Sektorit të Kontrollit Operacional.

**Rëndësia:**

E Lartë.

**Rekomandimi:** - DTM, për tatimpaguesin “A. A.E.” SHA, për të cilët janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit, në përputhje me kërkesat ligjore dhe procedurale, të kryejë rikontroll tatimor sipas përcaktimeve të nenit 85 “Rikontrolli tatimor” të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit të evidentuar paraprakisht në vlerën prej 623,002,752 lekë.

- DTM në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve në rastet e praktikave të kontrolleve të plota ose rimbursimit të TVSH-së, të tatimpaguesve me aktivitet prodhim i energjisë elektrike, të përcaktojë grupe kontrolli me përbërje minimumi dy inspektorë kontrolli tatimor dhe një inxhinier ndërtimi nga DRT Tiranë dhe të kryejë marrëveshje bashkëpunimi me AKBN-në, me qëllim përfshirjen të një specialisti të AKBN-së, në grup kontrolli, me qëllim vlerësimin e investimit në përputhje me afatet dhe dokumentacionin ligjore për besueshmërinë e kreditimit dhe ligjshmërinë e TVSH-së rimbursueshme.

**Titulli gjetjes:** **Parregullsi të konstatuara nga auditimi i raporteve të kontrollit, të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor, DTM, në lidhje me mos llogaritjen e interesave për transaksionet e huamarrjes dhe huadhënies së shoqërive me ortakët.**

**Situata:** Nga auditimi u konstatua se, gjatë zhvillimit të aktivitetit të tyre shoqëritë “A.C.” SHPK, “I.” SHPK, “F.” SHPK, FDP në periudha të ndryshme kohore kanë kryer transaksione huamarrje dhe huadhënie me ortakun (kreditime dhe debitime nga llogaria e ortakut), për llogari të këtyre shoqërive, me qëllim kryesor mbarëvajtjen normale të aktivitetit tregtar të shoqërive, sipas përshkrimeve në raportet e kontrolleve të inspektorëve tatimor. Këto pagesa nuk konfirmohen me saktësi në raportet e kontrollit tatimor, si pagesa të kryera nëpërmjet sistemit bankar dhe të pasqyruara me prova në aktet e mbajtura nga inspektorët e kontrollit. Në lidhje me transaksionet kur ortakun i jep shoqërisë hua ose e anasjellta, pa aplikuar interesa, grupi i audituesve gjykon se kemi të bëjmë me veprime të cilat janë pa thelb ekonomike dhe jo në përputhje me parimin e vlerës së tregut. Veprime këto në kundërshtim me përcaktimet e pikave b, c, dh të nenit 71, germa a, b, c, ç të nenit 71/2 dhe germa ç të neni 72 të Ligjit Nr.9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave Nr. 24 date 02.09.2008, i ndryshuar, për të cilat duhet të ishte kryer vlerësim alternativ i situatës financiare së shpenzimeve të interesit të pallogaritura në PASH, si rikarakterizim të ardhurash duke sjellë si pasojë detyrime tatimore. Referuar kuadrit legjislativ tatimor, rezulton se ortakun dhe shoqëria me përgjegjësi të kufizuara janë entitete të ndryshme dhe me personalitet juridik të ndarë, sipas përcaktimeve në Ligjin Nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”. Sipas legjislacionit tatimor si shoqëria dhe ortakun konsiderohen si “Palë të lidhura”, meqenëse ortakun ka ndikim në vendimmarrjen e shoqërisë për shkak të zotërimit të kuotave/aksioneve të saj sipas përcaktimeve në Ligjin Nr.42/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar dhe Udhëzimin Nr.16, datë 18.6.2014 “Për transferimin e çmimit”, gjë që sjell se çdo marrëdhënie apo transaksion midis tyre duhet t’u përmbahet kushteve dhe parimeve të tregut (Arm’s Length). Megjithatë nuk ka të përcaktuar saktë dhe qartë mënyrën e procedimit në legjislacionin tatimor të fushës së llogaritjes së interesave dhe detyrimeve tatimore të rillogaritura në rastet e huadhënies nga llogaria e ortakut drejt

llogarisë së shoqërisë ose e anasjelltas, referuar Kodit Civil i miratuar me Ligjin Nr.7850 datë 29.07.1994, i ndryshuar, nenet 1050-1055, Kreu XIX “Huaja”, cilësohet se huamarrësi duhet t’i paguajë huadhënësit një interes në rastet kur ekziston një marrëveshjeve ndërmjet palëve.

**Kriteri:** - Ligji Nr.7850 datë 29.07.1994 “Kodi civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 1050-1055, Kreu XIX “Huaja”;  
- Ligji Nr.42/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar;  
- Udhëzimi Nr.16 datë 18.6.2014 “Për transferimin e çmimit”.

**Ndikimi/Efekti:** Nga ana e inspektorit të kontrollit në vend, nuk janë kryer verifikimet e subjektit sipas legjislacionit për verifikimin e transaksioneve të huadhënies dhe huamarrjes së shoqërive me ortakët.

**Shkaku:** Mosrespektimi i dispozitave dhe përcaktimeve ligjore lidhur me punën e inspektorëve të Sektorit të Kontrollit Operacional.

**Rëndësia:** E Lartë.

**Rekomandimi:** DTM në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, të hartojnë një metodologji të qartë dhe të saktë nënligjore ose një manual udhëzues për analizimin e llogarisë së ortakut, kur konstatohen se jepen hua ose shuma nga llogaria e ortakut në favor të llogarisë së shoqërisë, ku ata janë ortakë ose anasjelltas, për raste kur këto hua jepen pa interes, nisur edhe nga përcaktimet ligjore që parashikon Kodi Civil.

**Titulli gjetjes:** **Parregullsi të konstatuara nga auditimi i raporteve të kontrollit, të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor, DTM, në mosnjohjen e të ardhurave nga parapagimet e shitjes së objekteve ndërtimore të pajisura me certifikatë shfrytëzimi por pa kalim të titullit të pronësisë.**

**Situata:** Nga auditimi u konstatua se të ardhurat nga parapagimet e shitjeve të apartamenteve apo njërive të tjera për objektet ndërtimore të pajisura me certifikatë shfrytëzimi, shoqëritë “O.” SHPK dhe “I.” SHPK, nuk kanë njohur të ardhura nga shitja në PASH sipas periudhave përkatëse, por është vazhduar me njohjen e detyrimit përkatës në pasiv të bilancit kontabël si “Parapagime të arkëtuara”, deri në kalim të titullit të pronësisë tek klienti. Nga analiza e rrethanave të transaksionit, grupi i auditimit gjykon se për objektin që është pajisur me certifikatë shfrytëzimi, shoqëria ka transferuar rreziqet dhe përfitimet kryesore lidhur me pronësinë tek blerësi, pra shoqëria nuk mbartë më risqe të rëndësishme për apartamentet dhe njësitë e tjera të shërbimit të shitura, të cilat sot shfrytëzohen efektivisht nga blerësit me të drejta të plota mbi këto prona siç parashikohet në SKK 8, pavarësisht nëse është bërë apo jo kalimi i titullit të pronësisë, por në mungesë të një përcaktimi ligjor eksplicit për këtë situatë nga legjislacioni tatimor në fuqi, grupi i auditimit do t’i drejtohet DTM me një masë organizative për të përcaktuar një metodologji të qartë dhe të saktë ose një manual udhëzues për llogaritjen e detyrimeve tatimore, për rastet e të ardhurave nga parapagimet për shitjen e njërive nga objektet ndërtimore të pajisura me certifikatë shfrytëzimi.

**Kriteri:** - Ligjit Nr.8438 “Për tatimin mbi të ardhurat”, ndryshuar, neni 19;  
- Ligjin Nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”;  
- SKK 8 “Te ardhurat”;  
- Manuali i Kontrollit Tatimor.

**Ndikimi/Efekti:** Nga ana e inspektorit të kontrollit në vend, nuk është kryer analiza e rrethanave të transaksionit, për objektet që janë pajisur me certifikatë shfrytëzimi, n.q.s. shoqëria ka transferuar rreziqet dhe përfitimet kryesore lidhur me pronësinë tek

blerësi dhe plotësimin të kriterëve të përcaktuara në SKK 8, për njohjen e të ardhurave.

**Shkaku:** Mosrespektimi i dispozitave dhe përcaktimeve ligjore lidhur me punën e inspektorëve të Sektorit të Kontrollit Operacional.

**Rëndësia:** E Lartë.

**Rekomandimi:** DTM në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për parapagimet nga shitja e njësive ndërtimore me certifikatë shfrytëzimi por pa kalim titulli pronësie, të hartojnë një metodologji të qartë ose një manual udhëzues për njohjen e të ardhurave duke analizuar rrethanat e transaksionit dhe vlerësimi nëse një njësi ekonomike ka transferuar rreziqet dhe përfitimet kryesore lidhur me pronësinë tek blerësi.

**Titulli gjetjes:** **Parregullsi të konstatuara nga auditimi i raporteve të kontrollit, të subjektit "F." SHPK në lidhje me zbatimin e koeficientit të TVSH-së, mungesa e analizës së konsumit dhe furnizimit të karburantit dhe kartës teknologjike për lëndën djegëse solar.**

**Situata:** 1. Nga auditimi i raportit të kontrollit tatimor të subjektit "F." SHPK, shoqëria gjatë periudhës Gusht-Nëntor 2020 ka realizuar dhe deklaruar si shitje të përjashtuara punime në lidhje me Rindërtimin, për të cilën ka qenë e pajisur me autorizimet përkatëse lëshuar nga DPT. Në lidhje me rregullimin e TVSH-së në blerje, për periudhën 01.01.2020-31.12.2020, shoqëria ka bërë rregullim për shitjet e përjashtuara të kryera për rindërtimin të cilën e ka pasqyruar në FDP e muajit Janar 2021, nëpërmjet faturës me Nr.1, Nr. Serial 77431501, datë 31.01.2021, me VI. Tat = -117,093,905 lekë dhe TVSH = -23,418,781 lekë. Nga inspektori i kontrollit është kryer rregullimi i TVSH për vlerën 695,550 lekë, për furniturat dhe investimet e blera përgjatë periudhës 08.2020-12.2020. Nga sa më sipër grupi i auditimi gjykon se duhet të ishte kryer rregullimi i koeficientit të zbritjes së TVSH konform përcaktimeve të pikës 1 të nenit 69, neni 72, neni 78 si dhe neni 80 të Ligjit Nr.92/2014 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Nga të dhënat e raportit të kontrollit dhe sistemit C@ts në lidhje me shitjet për periudhën 01.01.2020-31.12.2020, grupi i auditimit ka rillogaritur koeficientin e zbritjes së TVSH-së në vlerë 90.2%, mbi baza vjetore, për të gjithë periudhën, për të cilën gjykon se duhet të ishte kryer rregullimi i TVSH, për "Blerje të tatueshme me 20% TVSH nga furnitorë vendas", "Importeve të investimeve me shkallë 20%" dhe "Investime nga furnitorë vendas me shkallë 20%", për vitin 2020, në total në vlerën e tatueshme 632,864,089 lekë dhe me 126,571,910 lekë TVSH, të cilat janë blerje të furniturave, investimeve në mjete pune dhe ndërtim godinash për nevoja të biznesit, të cilat janë vështirë të ndashme masa e të cilave ka kontribuar dhe është përdorur për si për kryerjen e transaksioneve të tatueshme që sjellin të drejtën e zbritjes së TVSH-së mbi bazën e neneve 69 dhe 70, të këtij ligji, edhe për transaksionet që nuk e sjellin këtë të drejtë.

2. Nga kontrolli i sistemit C@ts ka rezultuar se nuk ka dorëzuar brenda datës 31 mars, inventarin analitik të mallrave, si dhe inventarin e aktiveve afatgjata gjendje deri më datë 31 dhjetor të vitit fiskal sipas kërkesave të pikës 3.12 "Deklarimi tatimor dhe llogaritja përfundimtare e detyrimit" të Udhëzimit Nr.5, datë 30.01.2006 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar. Gjithashtu në raportin e kontrollit tatimor nga ana e inspektore nuk është kryer një analizë e detajuar e shfrytëzimit të mjeteve të transportit, rrugët e realizuara, normativat e konsumit për rrugë, proces pune ose volum punimesh etj, veprime këto në kundërshtim me përcaktimet e nenit 55 "Kufizime të zbritjes së TVSH për disa



furnizime” të Udhëzimit Nr.6 , datë 30.01.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në R.SH”. Nga sa më sipër janë evidentuar fatura furnizim karburanti nga shoqëria të cilat nuk justifikohen me volumin e punës së kryer, rrugët e realizuara nga mjete/et, normativat e konsumit të gazoilut për rrugë ose proces të kryer etj. Gjithashtu nuk justifikohen nga aspekti fizik sasia e madhe e karburantit të furnizuar për shkak se subjekti nuk ka depozita të deklaruara si dhe nuk ka marrëveshje për depozitimin me shoqëri të tjera.

3. Gjithashtu nga kontrolli i artikujve të librave të blerjes për periudhë tatimore të vitit 2020, ka rezultuar blerje lëndë djegëse solar, por nuk ka të sqaruar në raport kontrolli se sipas cilit proces përdoret kjo lëndë djegëse dhe n.q.s. ka kartë teknologjike për këtë proces prodhimi.

**Kriteri:**

- Ligjit Nr.92/2014 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; neni 69, 70, 72; 80;
- Udhëzimit Nr.6 , datë 30.01.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në R.SH”, i ndryshuar, neni 55;
- Manuali i Kontrollit Tatimor.

**Ndikimi/Efekti:** Nga ana e inspektorit të kontrollit në vend, nuk janë kryer analiza dhe verifikime në lidhje me zbatimin e koeficientit të TVSH-së, konsumit dhe furnizimit të karburantit dhe kartës teknologjike për lëndën djegëse solar.

**Shkaku:** Mosrespektimi i dispozitave dhe përcaktimeve ligjore lidhur me punën e inspektorëve të Sektorit të Kontrollit Operacional.

**Rëndësia:** E Lartë.

**Rekomandimi:**

- DTM të analizojë dhe vlerësojë situatën financiare të tatimpaguesit “F.” SHPK, në lidhje me zbatimin e koeficientit të rregullimit të TVSH jo në baza vjetore, për “Blerjet e tatueshme me 20% TVSH nga furnitorë vendas”, “Importet e investimeve me shkallë 20%” dhe “Investimet nga furnitorë vendas me shkallë 20%”, për vitin 2020, në total në vlerën e tatueshme 632,864,089 lekë dhe me 126,571,910 lekë TVSH, të cilat janë blerje të furniturave, investimeve në mjete pune dhe ndërtim godinash për nevoja të biznesit, të cilat janë vështirë të ndashme masa e të cilave ka kontribuar dhe është përdorur për si për kryerjen e transaksioneve të tatueshme që sjellin të drejtën e zbritjes së TVSH-së mbi bazën e neneve 69 dhe 70, të këtij ligji, edhe për transaksionet që nuk e sjellin këtë të drejtë.

- DTM nëpërmjet Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit, të administrojë në rrugë zyrtare informacion dhe dokumentacion justifikues nga tatimpaguesi “F.” SHPK, për furnizimet në vlera të larta me karburant si dhe për shfrytëzimin e mjeteve të transportit dhe autoveturave, rrugët e realizuara, normativat e konsumit për rrugë, proces pune ose volum punimesh, me qëllim vlerësimin e ligjshmërisë së kreditimit të TVSH-së, së karburantit konform përcaktimeve të legjislacionit fiskal në fuqi.

- DTM nëpërmjet Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit, të kryejë verifikimin e miratimit të kartës teknologjike të tatimpaguesit “F.” SHPK, për prodhimin e binderit dhe asfaltobetonit.

**Titulli gjetjes:** **Parregullsi të konstatuara nga auditimi i raporteve të kontrollit, të subjektit “G. K.” SHA në lidhje me diferencat e pajustificuara midis bilancit të lëvizjes materiale dhe akt konstatimit të inxhinierit, mungesa e analizimit të ligjshmërisë së kreditimit të TVSH-së, së karburantit,**

**Situata:** 1. Nga auditimi i raportit të kontrollit tatimor, konkretisht i lëvizjes së bilancit material dhe akt konstatimit të mbajtur nga inxhinierit për zberthimin e bazës materiale, kanë rezultuar diferenca të pajustificuara për periudhën objekt

kontrolli.

2. Nga kontrolli i sistemit C@ts për periudhën 2016-2021, rezulton se ka dorëzuar brenda datës 31 Mars, inventarin analitik të aktiveve afatgjata (makina dhe mjete pune) gjendje deri më datë 31 Dhjetor të vitit fiskal sipas kërkesave të pikës 3.12 “Deklarimi tatimor dhe llogaritja përfundimtare e detyrimit” të Udhëzimit Nr.5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar. Nga kontrolli i inventarit të makinave, të paraqitura në anekse të bilanceve të viteve 2016-2021, ka rezultuar se shoqëria ka në pronësi, ndër të cilat edhe autovetura. Në raportin e kontrollit tatimor nga ana e inspektorit nuk është kryer një analizë e detajuar e shfrytëzimit të mjeteve të transportit, rrugët e realizuara, normativat e konsumit për rrugë, proces pune ose volum punimesh etj, gjithashtu përgjatë periudhës së kontrollit 2016-2021, ka pasur në aktivet e veta autovetura, për të cilat inspektori i kontrollit tatimor, duhet të kishte kryer verifikimet n.q.s. janë furnizuar me karburant nga shoqëria, për të cilin është bërë kreditimi i TVSH në blerje, veprime këto në kundërshtim me përcaktimet e të nenit 74 “Kufizimet e së drejtës së zbritjes” të Ligjit Nr.92/2014 “Për TVSH-në, në Republikën e Shqipërisë” dhe nenit 55 “Kufizime të zbritjes së TVSH për disa furnizime” të Udhëzimit Nr.6 , datë 30.01.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në R.SH”.

**Kriteri:**

- Ligji Nr.92/2014 “Për TVSH-në, në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 74;  
- Udhëzimit Nr.6 , datë 30.01.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në R.SH”, i ndryshuar, neni 55;  
- Manuali i Kontrollit Tatimor.

**Ndikimi/Efekti:**

Nga ana e inspektorit të kontrollit në vend, nuk është kryer analiza dhe vlerësimi i diferencave midis bilancit të lëvizjes materiale dhe akt konstatimit të inxhinierit, mungesa e analizimit të ligjshmërisë së kreditimit të TVSH-së, së karburantit.

**Shkaku:**

Mosrespektimi i dispozitave dhe përcaktimeve ligjore lidhur me punën e inspektorëve të Sektorit të Kontrollit Operacional.

**Rëndësia:**

E Lartë.

**Rekomandimi:**

- DTM nëpërmjet Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit, të administrojë në rrugë zyrtare informacion dhe dokumentacion justifikues nga tatimpaguesi “G. K.” SHA, për diferencat e pajustificuara të konstatuara midis bilancit të lëvizjes materiale dhe akt konstatimit të inxhinierit, me qëllim vlerësimin e mëtejshëm të tyre.  
- DTM nëpërmjet Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit, të administrojë në rrugë zyrtare informacion dhe dokumentacion justifikues nga tatimpaguesi “Gj. K.” SHA, për shfrytëzimin e mjeteve të transportit dhe autoveturave, rrugët e realizuara, normativat e konsumit për rrugë, proces pune ose volum punimesh, me qëllim vlerësimin e ligjshmërisë së kreditimit të TVSH-së, së karburantit konform përcaktimeve të legjislacionit fiskal në fuqi.

***Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore si më poshtë:***

*Ligjin Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar.*

*Ligjin Nr.8438 date 28.12.1998 “Për tatimin mbi te ardhurat”, i ndryshuar.*

*Ligjin Nr.9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar.*

*Ligjin Nr.92/2014 datë 24.7.2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në R.SH”, i ndryshuar.*

*UMF Nr.24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar.*

*UMF Nr.6, datë 30.01.2015, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në R.SH”, i ndryshuar.*

*UMF Nr.5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.*

*Manuali i Kontrollit Tatimor.*

*Rregulloren e Funkcionimit të Drejtorive Rajonale Tatimore dalë me Urdhrin Nr.192, datë 12.08.2020 të Ministrit të Financave.*

*Pika 1 e nenit 59 “Përgjegjësitë dhe detyrat e Inspektorit të Sektorit të Kontrollit në Vend”.*

*Pikat 1, 2, 3, 4, 5, 7, 8 të nenit 58 “Përgjegjësitë dhe detyrat e Përgjegjësit të Sektorit të Kontrollit në Vend”.*

*Pikat 2, 7 e nenit 57 “Përgjegjësitë dhe detyrat e Drejtorit të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor në Drejtoritë e tjera Rajonale”.*

*Pikat 3, 10, 11, 18 të nenit 4 “Drejtori i Drejtorisë Rajonale Tatimore”.*

***Formulari i dokumentimit të lëvizjes së dokumentacionit të kontrollit nga Inspektori deri tek Drejtori i Drejtorisë Rajonale.*** (Inspektor, Përgjegjës Sektori, Drejtor Kontrolli, Drejtor Rajonal). Fakti që firmos dhe ka të drejtën e komenteve Përgjegjësi i Sektorit të Kontrollit, Drejtori i Kontrollit dhe Drejtori Rajonal i DRT-së, në aneksin e raportit paraprak dhe përfundimtar i bën përgjegjës, sepse manuali ju rezervon të drejtën e shprehjes dhe të komenteve për rezultatet e procedurës së kontrollit. Në rastin e Drejtorit Rajonal ky fakt që përbën përgjegjësi funksionale të nëpunësit/titullar si person që ka dijeni dhe nënshkruan aktin administrative të organit përkatës të administratës publike sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë.

**Personat që mbajnë përgjegjësi për problematikat e mësipërme me efekte financiare në të ardhura të munguara dhe/ose me problematika në praktikën e kryerjes së kontrollit tatimor të evidentuar rast pas rasti në praktikën e audituara si më sipër, paraqiten:**

- Z. D. I., Zj. I.A Z. D. T. dhe Zj E. Ç. në cilësinë e Drejtorit Rajonal pranë DTM.

- Zj. M. R. dhe Z. O. C., z.E. M. në cilësinë e Drejtorit të Kontrollit Tatimor pranë DTM.

- Z. A. S., Z. A. D., Z. .A.C, Z. S. M., Zj. A. T., z. E. M. dhe Z. E. M., B. K. në cilësinë e Përgjegjësit të Kontrollit Tatimor pranë DTM.

- Zj. D. P., Z. F. G., Z. E. S., Z. E.A, Zj. B.K, Z. E.K, Z. G.J Zj. O.B Z. F.S Z. I.T ,Z. A.H, Z. A.X., Z. D. Gj., Zj. E. K., z. H. M., z. A. Dh., z. O. K., z. B. M.i, Z. I. L., z. Gj. K., z. D. B., z. M. H. z. S. M., Z. H. M., Znj. M. X. ,z. E. D., Z. R.A ,z. A.D, Znj. M.A, Z. G.P, Z. Z.D, Znj. D. L., Z. I. D. , Znj. T. F. , z. A. H., z.F. S., z. M. M., z. A. D., z. I. P., znj V. M. dhe Z. A. Sh. në cilësinë e inspektorit të Drejtorisë së Kontrollit pranë Drejtorisë Tatimore të Tatimpaguesve të Mëdhenj.

-Znj. B. F., Z. I. K., Z. E. A. në cilësinë e ish inxhinierit të Drejtorisë së Kontrollit pranë DTM.

### **-Sektori i Kontrollit nga Zyra**

#### ***Struktura e Sektorit të Kontrollit nga Zyra***

Sipas strukturës organizative të miratuar për DTM, Sektori i Kontrollit nga Zyra është planifikuar të funksionojë si një sektor me 10 inspektorë dhe 1 përgjegjës sektori, pjesë e Drejtorisë së Kontrollit. Në fillim të vitit 2021 Struktura e Sektorit të Kontrollit nga zyra paraqitet me 1 vakancë në pozicionin e inspektorit, pozicioni i cili më pas është plotësuar deri në fund të vitit 2021. Deri në fund të vitit 2022, struktura paraqitet me 2 vakanca në pozicionet e

inspektorëve për shkak të transferimit të 2 inspektorëve pranë DRT Tiranë sipas shkresës së DPT nr. 9147, prot datë 28.10.2022 “Për angazhimin në kryerjen e kontrolleve pranë DRT-Tiranë” .

### ***Organizimi i punës së sektorit***

-Nga auditimi konstatohet se angazhimi i inspektoreve të kontrollit nga zyra dhe monitorimit në kryerjen e detyrave të tyre funksionale mbështetet në Manualin e Kontrollit nga Zyra të miratuar në Tetor 2018. Ky angazhim nuk konkretizohet në hartimin dhe miratimin e një plani vjetor apo mujor mbi aktivitetin e sektorit, duke evidentuar kështu mangësi që përbëjnë një risk për menaxhimin sa më efektiv të burimeve njerëzore për arritjen e objektivave nga hallkat mbikëqyrëse. Kalendarit pjesë e Manualit të Kontrollit nga Zyra parashikon që në muajin Janar Sektorët e Kontrollit nga Zyra “*Hartojnë planet operationale vjetore si pjesë përbërëse e planit operational të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor*” dhe “*Përcaktojnë objektivat kryesore vjetore në luftën kundër informalitetit, objektiv bazë për realizimin e të ardhurave tatimore*”. Nga auditimi konstatohet se një plan i tillë nuk është hartuar si në nivel Drejtorie Kontrolli, ashtu edhe në nivel institucional, sikundër trajtuar në pikën e të ardhurave të këtij programi auditimi.

### ***Ndarja në nipte e subjekteve sipas inspektorëve***

Ndarja sipas nipteve të tatimpaguesve në rang inspektorësh për kryerjen e detyrave funksionale për monitorimin nga sektori i kontrollit nga zyra, për periudhën 2021-2022 është kryer në zbatim të urdhrave të mëposhtëm:

-Urdhri mbi shpërndarjen e tatimpaguesve në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor i Drejtorit të DTM znj. I. A., shkresa nr. 6368, prot datë 28.08.2020 sipas së cilës janë shpërndarë 881 subjekte aktive nën administrimin e DTM nga data 26.08.2020 e në vazhdim.

-Urdhri mbi shpërndarjen e tatimpaguesve në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor i Drejtorit të DTM znj. I. A., shkresa nr. 8692, prot datë 30.10.2020 sipas së cilës janë shpërndarë 105 subjekte aktive nën administrimin e inspektorit P. K. nga data 29.10.2020 e në vazhdim.

-Urdhri mbi shpërndarjen e tatimpaguesve në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor i Drejtorit të DTM znj. I. A., shkresa nr. 10368, prot datë 28.12.2020 sipas së cilës janë shpërndarë 121 subjekte aktive nën administrimin e inspektorit A. Dh. nga data 24.12.2020 e në vazhdim.

-Urdhri mbi shpërndarjen e tatimpaguesve në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor i Drejtorit të DTM znj. I. A., shkresa nr. 2390, prot datë 25.03.2021 sipas së cilës janë shpërndarë 877 subjekte aktive nën administrimin e DTM nga data 19.03.2021 e në vazhdim.

-Urdhri mbi shpërndarjen e tatimpaguesve në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor i Drejtorit të DTM znj. I. A., shkresa nr. 2778, prot datë 09.04.2021 sipas së cilës janë shpërndarë 105 subjekte aktive nën administrimin e inspektorit A. Z. nga data 08.04.2021 e në vazhdim.

-Urdhri mbi shpërndarjen e tatimpaguesve në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor i Drejtorit të DTM znj. I. A., shkresa nr. 9929, prot datë 05.11.2021 sipas së cilës janë shpërndarë 871 subjekte aktive nën administrimin e DTM nga data 03.11.2021 e në vazhdim; si dhe 138 subjekte të çregjistruar, kërkesë për çregjistrim dhe pasiv nga data 03.11.2021 e në vazhdim.

-Urdhri mbi shpërndarjen e tatimpaguesve në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor i Drejtorit të DTM znj. E. C., shkresa nr. 9570, prot datë 14.11.2022 sipas së cilës janë shpërndarë 957 subjekte aktive nën administrimin e DTM nga data 11.11.2022 e në vazhdim.

Nga auditimi konstatohet se ndarjet në nipte të inspektorëve përgjegjës për monitorim në sektor janë miratuar nga Drejtori i DTM sipas urdhrave, ku nuk dokumentohet kryerja e ndarjes në nipte konform kërkesave të Manualit të Kontrollit nga Zyra i cili citon se: “*Në muajin Janar të çdo viti, Drejtori i Kontrollit Tatimor /Përgjegjësi i Sektorit të Kontrollit nga Zyra në Drejtorinë Rajonale të Tatimeve, merr listën e plotë të tatimpaguesve ... Bazuar në këtë listë, Drejtori i*

*Kontrollit Tatimor /Përgjegjësi i Sektorit të Kontrollit nga Zyra bën ndarjen e të gjithë tatimpaguesve sipas inspektorëve të kontrollit nga zyra, ku ngarkesa për çdo inspektor do jetë sipas llojit të biznesit. Bizneset e mëdha do verifikohen, mbikëqyren nga inspektorët e kontrollit nga zyra të cilat kanë më shumë eksperience dhe janë të mirë përgatitur. Ndërkohë Biznesi i Vogël dhe Biznesi i Vogël me TVSH do i përkasë inspektorëve më të rinj gjë e cila do i ndihmojë ata të krijojnë eksperiencën e duhur. Pra në mënyrë të përmbledhur ndarja do bëhet:*

*Biznesi i Madh – Inspektorë me eksperiencë*

*Biznesi i Vogël – Inspektorë të rinj*

*Biznesi i Vogël me TVSH – Inspektorë të rinj*

*OJF, Ente Shtetërore – Inspektorë të përcaktuar për këtë kategori*

*Në përgatitjen e listës së tatimpaguesve sipas inspektorëve, Drejtori i Kontrollit mban parasysh ndarjen e barabartë të tyre, për të krijuar ngarkesë të barabartë pune për inspektorët”, e cila në rastin e DTM do të duhej të reflektohej ndarja duke identifikuar Biznesi i Madh- OJF, Ente Shtetërore.*

### ***Mbi kërkesat pranë DTM për rimbursimin e TVSH-së***

*Në zbatim të nenit 75/1 të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar ku përcaktohet konkretisht se “Personat e tatueshëm, të regjistruar për TVSH-në, që rezultojnë me tepricë kreditore, kanë të drejtë të paraqesin kërkesën për rimbursimin e TVSH-së së paguar tepër pranë Drejtorisë së Rimbursimit të TVSH-së në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve. Kjo kërkesë paraqitet sipas formularit të miratuar “Kërkesë për rimbursimin e TVSH-së. Brenda 60 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës së tatimpaguesit dhe brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës së tatimpaguesve eksportues, Drejtoria e Rimbursimit të TVSH-së në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, në bashkëpunim me drejtorinë rajonale tatimore, ku është i regjistruar tatimpaguesi, verifikojnë situatën tatimore të tatimpaguesit dhe miratojnë tepricën kreditore si të rimbursueshme...” dhe “2.5.2 Nëse kërkesa për rimbursim rezulton me risk për rimbursim, Drejtoria e Rimbursimit të TVSH-së, në DPT, e dërgon në drejtorinë rajonale ku është regjistruar tatimpaguesi për kontroll nga zyra ose në vend para se të rimbursohet. Procedura e kontrollit kryhet siç është parashikuar në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.”, u kërkuar informacion nëse janë kryer kontrole për rimbursimin e TVSH-së nga ana e Sektorit të Kontrollit nga Zyra për periudhën objekt auditimi”. Nga auditimi rezulton se Sektori i Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit nuk ka kryer asnjë kontroll për rimbursim të TVSH nga zyra për periudhën objekt auditimi, pasi nga kërkesat për rimbursim të dorëzuara pranë DPT nuk është përcjellë asnjë kërkesë për kryerjen e kontroleve nga zyra pranë DTM.*

### ***- Tepricat kreditore të TVSH-së, Tatimit mbi fitimin***

*Për sa i përket tepricave kreditore të TVSH-së dhe TF-së për Top 100 subjektet për vitin 2021 dhe 2022, grupi i auditimit kërkoi informacion nëse janë kryer analiza nga sektori dhe bashkëpunimin e sektorit të kontrollit nga zyra me atë të riskut, pasi sikundër trajtuar në drejtimin e auditimit lidhur me aktivitetin e sektorit të riskut, ky është një nga testet që kryhet edhe nga ky sektor për identifikimin e subjekteve me risk të shtuar. Nga të dhënat e vendosura në dispozicion, u përcollën për çdo rast argumentet përkatëse, paraqitur në kolonën “Komenti i inspektorit të Sektorit të Kontrollit nga Zyra”, sipas aneksit më poshtë, nga ku rezulton se për rastet në të cilat janë identifikuar subjekte me tepricë kreditore me tendenca përgjithësisht rritëse, nga ana e inspektorëve është kërkuar informacion për verifikimin e situatës së rritjes së vazhdueshme të tepricës së TVSH-së apo TF-së, sipas korrespondencave të mësipërme, në zbatim të pikës 4 “Objekt i punës të kontrollit tatimor nga zyra” të Manualit të Kontrollit nga*

Zyra e cila parashikon se : *Analizon nëpërmjet raporteve të implementuar në sistem, nxjerr konkluzione përkatëse për situata të parregullta të deklaratave të ndryshme tatimore, tatimpaguesit me gjendje të lartë e të vazhdueshme kreditore TVSH, tatim fitimi, mos deklarues për lloje të ndryshme tatimi, deklaruesit pa veprimtari apo tatimpaguesit që kanë ndërprerë deklarimin. Të monitorojnë saktësinë e plotësimin të çdo deklarate tatimore mbi bazën e informacioneve të ndryshme që ata kanë dhe mbi bazën e analizës së raporteve të ndryshme të mara nga sistemi informatik apo të kërkuara nga Drejtoria e IT-së.*”; si dhe pika 9 “Kalendari i punëve për strukturat e sektorit të kontrollit nga zyra”, ku përcaktohet se: “Nxjerrin raportet për mënyrën e plotësimin të rubrikave të ndryshme të TVSH-së, si rubrikat “Rregullime të TVSH-së së zbritshme”, “Autongarkesë e TVSH-së në blerje me të drejtë kreditimi”, “Autongarkesë TVSH-së në shitje (reverse charge)”, “Shitjet me shkallë 0 %”, “Shitjet pa TVSH” e rubrika të tjera që plotësimi gabim i tyre çon në uljen e pagesës së tatimit mbi vlerën e shtuar apo rrisin artificialisht gjendjen kreditore dhe kërkesat për rimbursim të TVSH-së”. “Ndjekin me përparësi dorëzimin e deklaratës së tatimit të thjeshtuar të fitimit, brenda datës 10 të muajit”. “Ndjekin me përparësi dorëzimin e deklaratës së tatimit të fitimit, brenda datës 31 të muajit. Nxjerr raportet për treguesit kryesorë të deklaratave të pagesës së tatim fitimit për vitin e kaluar dhe përcakton e harton planin e kontrollit dhe verifikimit të deklaratës me treguesit e pasqyrave financiare. Kontrollon e verifikon plotësimin sipas ligjit të gjithë rubrikave të deklaratës së pagesës së tatim fitimit, në mënyrë të veçantë të “Tatim Fitimi i Shtyrë”, “Humbje e Mbartur”, “Tatim fitimi me shkallën tatimore standarde”, “Tatim fitimi me përqindje të tjera”, sidomos kur këto të fundit kanë vlera të dyja njëkohësisht dhe për çdo konstatim i plotësimin jo korrekt të tyre bën korrigjimin e deklaratës nga tatimpaguesi ose vetë inspektori.”. Në disa prej rasteve të mësipërme, subjektet më pas janë përfshirë në programet e kontrollit në vend.

**- Tatimpaguesit që kanë rezultuar me humbje tatimore**

Grupi i auditimit kërkoi informacion mbi subjektet që kanë rezultuar me **humbje gjatë 3 viteve të fundit** ku rezultojnë 16 prej tyre me humbje për 3 vite radhazi (2019-2021). Për këto subjekte, grupi i auditimit kërkoi informacion pranë DTM për verifikimet e kryera nga inspektorët përkatës lidhur me këto deklarime ku në mënyrë të përmbledhur paraqiten si më poshtë:

Tabela 2.2.2.1- Subjektet që kanë rezultuar me humbje gjatë 3 viteve të fundit 2019-2021

Nipti	Subjekti	Humbja 2019	Humbja 2020	Humbja 2021	Argumentet nga Sektori i Kontrollit nga Zyra
K.G	U.N.T	18,937,962	48,762,655	108,363,688	Dërguar shkresë Sektorit të Riskut nr. 4451 date 19.05.2022
K.K	B.B.F Group	50,518,146	55,761,832	233,174,158	Dërguar shkresë Sektorit të Riskut nr. 7631 date 30.09.2022
L.G	SH.I Petroleum Ltd	128,716,456	91,975,814	64,176,352	Dërguar shkresë për dorëzimin e pasqyrave financiare nr. 5002 date 30.05.2022
L.I	T.S	237,158,844	259,324,640	192,483,551	Dërguar shkresat Sektorit të Riskut nr. 7290 date 16.09.2022, nr. 4596 date 24.05.2022, nr. 7778 date 06.10.2020, nr. 623 date 26.01.2021
L.I	SH.U. Albania B.V	9,612,576,755	2,908,611,491	13,477,500,875	Shoqëria është në proces kontrolli për vitet 217, 2018. Kjo shoqëri mund të kontrollohet nga organi tatimor vetëm pas dërgimit të raportit për miratimin e kostove hidrokarbure nga AKBN
L.R	L.K	296,090,061	192,769,167	100,433,336	Dërguar shkresat Sektorit të riskut nr. 4444 date 19.05.2022, nr. 4278 date 20.05.2021, nr. 5672 date 03.08.2020. Kontrolluar për Tatim Fitimin viti 2020,2021
L.L	N.B	22,640,607	9,956,579	1,191,762	Dërguar shkresë Sektorit të Riskut nr. 5335 date 31.05.2022
L.T	F.A	315,489,625	129,557,154	99,182,456	Dërguar shkresë Sektorit të Riskut nr. 5336 date 31.05.2022
L.H	S.G.A	52,161,807	36,669,451	8,472,949	Transferuar në nëntor 2022 në DTM
L.T	F.T.L	4,497,600	791,621,651	500,000,000	Dërguar shkresë Sektorit të Riskut nr. 5460 date 31.05.2022

L.I	A. A.	1,133,738,694	1,197,705,032	1,132,307,086	Derguar shkresë Sektorit të Riskut nr. 5225 date 31.05.2022, nr. 7748 date 06.10.2022, nr. 810 date 10.02.2023
L.U	I. S.P.A.	4,496,488	17,616,036	126,426,124	Transferuar ne nëntor 2022 ne DTM
L.V	G.R.T	185,141	1,815,513	3,747,185	Transferuar ne nëntor 2022 ne DTM
L.Q	A.C	141,143	3,745,920	25,878,693	Transferuar ne nëntor 2022 ne DTM
L.C	S.C.A	17,704,425	263,768,265	87,911,687	Transferuar ne nëntor 2022 ne DTM
L.H	CW.I.A	2,169,881	32,825,478	73,761,770	Transferuar ne nëntor 2022 ne DTM

*Burimi:DTM*

Pra, në të gjitha rastet e evidentimit të deklarimit me humbje, për subjektet që kanë operuar pranë DTM është përcjellë pranë Sektorit të Riskut kërkesa për kryerjen e kontroleve të plota nga ana e administratës tatimore, dhe mbetet nën juridiksionin e këtij sektori përzgjedhja e subjekteve për tu propozuar për kryerjen e kontrollit në vend, sipas prioriteteve. Përgjatë vitit 2022 nga ana e personelit tatimor në drejtoritë rajonale, dhe për këto raste verifikimet e sektorit kanë vijuar përgjatë vitit 2023 sipas ndarjes në nipte të inspektorëve.

Për sa i përket humbjeve të raportuara për 3 vitet e fundit duke përfshirë edhe rezultatet financiare të raportuara nga ana e tatimpaguesve për vitin 2022, situata paraqitet si më poshtë ku në komente janë identifikuar edhe hapat e ndërmarra në kuadër të procesit të verifikimit nga ana e Sektorit të Kontrollit nga Zyra nuk është finalizuar.

Tabela 2.2.2.2- Subjektet që kanë rezultuar me humbje gjatë 3 viteve të fundit 2020-2022

NIPT	Emri i Subjektit	Humbja 2020	Humbja 2021	Humbja 2022	Koment
L.I	SH.U.A B.V	2,908,611,491	13,477,500,875	12,848,843,173	Dërguar shkresë riskut me Nr.5094 date 16.06.2023
L.I	A.A	1,197,705,032	1,132,307,086	2,064,223,965	Dërguar shkresë riskut me Nr.4028 date 16.05.2023
J.Q	B.B.SH	149,632,552	12,292,260	329,550,271	Nr.3426, date 03.05.2023
K.G	U.N.T	48,762,655	108,363,688	186,116,886	Dërguar shkresë riskut me Nr.3218 date 28.04.2023
L.H	C.E.L.A	32,825,478	73,761,770	183,645,239	Dërguar sektorit te analizës se riskut shkresa Nr.4155 Prot. date 18.05.2023
J.F	B.T	25,695,850	48,959,819	164,715,771	Dërguar shkresë riskut me Nr.2857 date 19.04.2023
L.M	A.	233,140,472	399,791,828	162,172,794	Dërguar shkresë riskut me Nr.3569 date 08.05.2023
L.G	SH.U.P	91,975,814	64,176,352	96,328,548	Dërguar shkresë riskut me Nr.3966 date 16.05.2023
K.K	B.B.F	55,761,832	233,174,158	96,207,924	Dërguar sektorit te analizës se riskut shkresa Nr.3185 Prot. date 27.04.2023
L.R	L.K	192,769,167	100,433,336	66,291,281	Përcjellë sektorit te riskut për verifikim per rezultatin me humbje shkresa nr.3005 dt 25.04.2023. Kontrolluar per tatim fitimin e vitit 2020 dhe 2021 me nr. 3139/2
L.H	S.G.C.A	36,669,451	8,472,949	53,646,898	Dërguar sektorit te analizës se riskut shkresa Nr.3967 Prot. date 16.05.2023
L.I	T.S	259,324,640	192,483,551	41,100,285	Dërguar shkresë sektorit te riskut me nr.2690 prot. date 14.04.2023
L.O	Q.S.K.Z	53,476,714	80,078,986	30,326,190	Përcjellë sektorit te riskut per verifikim per rezultatin me humbje shkresa nr.2994 dt 25.04.2023. Kontrolluar per tatim fitimin e vitit 2020
K.J	E.SHA	27,947,338	14,940,030	21,553,952	Përcjellë sektorit te riskut per verifikim per rezultatin me humbje shkresa nr.3002

					dt 25.04.2023. Kontrolluar per tatim fitimin e vitit 2020, 2021 me nr. 7361/3
K.A	F.A	13,371,978	5,063,733	11,172,479	Nr. 5311 date 23.06.2023
L.V	G.R.T	1,815,513	3,747,185	6,632,529	Nr.3481, date 04.05.2023

Burimi:DTM

### ***Mbi procedurat e ndjekura lidhur me këstet e tatim fitimit***

#### ***Mbi pagesat e tatim fitimit***

- Nga auditimi konstatohet se sistemi C@ts nuk mundëson aplikimin automatik të penaliteteve për tatimpaguesit që kanë likuiduar me vonesë këstet e parapagimeve të tatim fitimit, dhe si rezultat ky proces monitorohet manualisht nga inspektorët e sektorit të kontrollit nga zyra. Për këtë çështje nuk dokumentohen iniciativa të administratës tatimore për shqyrtimin dhe vlerësimin e mundësive në drejtim të kryerjes së ndryshimeve në sistemin C@ts për këtë opsion.

-Gjithashtu, nga auditimi konstatohet se sistemi C@ts për këtë proces është dizenuar në një mënyrë të tillë që pagesa e tatimpaguesit për këstin do të shkojë për detyrimin më të hershëm të tij, pavarësisht periudhës për të cilën po kryhet likuidimi. Si rezultat, në rastet kur subjektet janë penalizuar njëherë për mos pagesë në vonesë të këstit, në momentin e likuidimit të këstit pasardhës, kjo pagesë do të shkojë për mbulimin e detyrimit të parë, dhe për periudhën që ai po kryhen në kohë pagesën, do të rezultojë sërish me vonesë dhe do të jetë objekt penalizimi. Përfundimisht këtu bëjnë rastet kur pagesa do të mbulojë këstet e të dyja periudhave. I njëjti fenomen rezulton edhe për rastet kur kryhen rivlerësime të kësteve nga tatimpaguesit. Rivlerësimi kësteve të tatim fitimit nuk pasqyrohet në sistemin c@ts, sipas akt-vlerësimeve të mbajtura nga inspektorët përgjegjës për çdo tatimpagues, dhe si rezultat ky dokumentacion administrohet nga vetë sektori nëpërmjet shkresave përkatëse fizike. Si rezultat, ky proces rezulton të jetë subjektiv, dhe me vështirësi për tu monitoruar lidhur me saktësinë e vlerësimit të kërkesës për korrektim të këstit, dhe transparencës apo standardizimit të këtij procesi.

#### ***Rishikimi në ulje i kësteve të tatimit mbi fitimin***

-Në zbatim të ligjit nr.8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Neni 3 “Parapagimet”, pika 5, u verifikuan rishikimet e kryera për uljen e kësteve të tatim fitimit për periudhën objekt auditimi. Neni 3 “Parapagimet”, pika 5 citon se: “Në rastin kur tatimpaguesi, në çdo kohë, vërteton para organeve tatimore se tatimi mbi fitimin për këtë periudhë tatimore do të jetë, në mënyrë domethënëse, më i ulët se tatimi mbi fitimin në periudhën paraardhëse ose periudhën e dytë paraardhëse, atëherë organet tatimore pranojnë zvogëlimin e parapagimeve, sipas rregullave të vendosura me udhëzim të Ministrit të Financave. **Në rast se subjekti ka ulur këstet e parapagimit, të caktuara nga organi tatimor, dhe detyrimi tatimor vjetor për tatimfitimin, që rezulton nga bilanci, tejkalon parapagimin me më shumë se 10%, subjekti duhet të paguajë kamatëvonesa mbi diferencën ndërmjet detyrimit real vjetor dhe shumës së parapaguar gjatë vitit, sipas rregullave të vendosura me udhëzim të Ministrit të Financave**”.

Gjithashtu, udhëzimi Nr.5, datë 30.01.2006 “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, i ndryshuar, pika 3.13. “Parapagimet”, çështja 3.13.3 “Korrigjimi në ulje i kësteve mujore të paradhënies të tatimit mbi fitimin” citon se: “Si fakte të cilat mund të argumentojnë kërkesën për uljen e kësteve mujore të paradhënies të tatimit mbi fitimin mund të merren:

- Shitjet gjithsej të realizuara dhe të deklaruara nga tatimpaguesi, për muajt e kaluar të vitit vijues, në raport me shitjet gjithsej të dy viteve të mëparshme. Nëse këto shitje janë ulur në mënyrë të dukshme, administrata tatimore pranon uljen e kësteve proporcionalisht me uljen e vëllimit të shitjeve.



- Mungesa në vijim e kontratave të shitjes së mallrave apo shërbimeve, kontratave të punimeve etj., të cilat do ta reduktojnë në mënyrë domethënëse veprimtarinë dhe të ardhurat e tatimpaguesit për muajt e mbetur të vitit vijues për të cilin kërkohet reduktimi i kësteve mujore të paradhënies të tatimit mbi fitimin.

- Mbarimi i kontratave mbi bazën e të cilave janë realizuar të ardhurat në vitet e mëparshme, përfundimi i objekteve apo punëve të tjera publike të kryera.

-Fatkeqësi apo dëme të tjera që mund t'i kenë ndodhur tatimpaguesit gjatë vitit vijues dhe që do të çojnë në uljen e volumit të veprimtarisë së tij ekonomike.

- Mbyllja e linjave, veprimtarive të caktuara, shkurtimi i ndjeshëm i fuqisë punëtore si rezultat i tkurrjes së veprimtarisë.

“Me dorëzimin e deklaratës vjetore të tatimit mbi fitimin, në rast se detyrimi tatimor vjetor për tatimin mbi fitimin tejkalon shumën e paguar të kësteve mujore të paradhënies të tatimit mbi fitimin me më shumë se 10 për qind, tatimpaguesi detyrohet të paguajë kamatëvonesë, e cila llogaritet në masën 5 për qind për diferencën ndërmjet detyrimit vjetor sipas deklaratës vjetore të tatimit mbi fitimin dhe shumës totale të kësteve mujore të paradhënies të tatimit mbi fitimin të paguara gjatë vitit”.

Manuali i Kontrollit nga Zyra, pika 11.4 “Regjistrimi i kësteve të rishikuara të parapagesave të tatimit mbi fitimin”, përcakton se: “Në rastet kur tatimpaguesi kërkon rishikimin në ulje të kësteve të tatimit fitimit dhe inspektori i kontrollit nga zyra bindet ndaj argumenteve të paraqitura nga tatimpaguesi, bën korigjimin e kësteve në ulje në bazë të dokumentacionit të paraqitur”.

Në zbatim të nenit 114/1, të ligjit 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar, nga ana e DTM janë aplikuar penalitetet përkatëse për tatimpaguesit që kanë rezultuar me mospagim të kësteve të tatimit mbi fitimin konform afateve ligjore, më hollësisht:

Tabela 2.2.2.3 Tatimpaguesit që kanë rezultuar me mospagim të kësteve të tatimit mbi fitimin konform afateve ligjore

Nipti	Subjekti	Kësti fillestar	Kësti përfundimtar	Parapagime	Shënime
L.I	A.M	1,233,099	371,891	10,358,564	Penalizuar sipas Nj-VI Nr.7504 date 26.09.2022
K.H	B.. B	2,117,893	477,725	10,686,123	Penalizuar sipas Nj-VI Nr.7503 date 26.09.2022
J.T	E.SH	3,265,961	585,000	13,998,778	Penalizuar sipas Nj-VI Nr.7514 date 27.09.2022
J.T	I. SH A	2,325,719	-	23,229,577	Penalizuar sipas Nj-VI Nr.6080 date 04.07.2022
K.D	T.I.A	57,454,229	15,738,000	381,658,918	Penalizuar sipas Nj-VI Nr.7505 date 26.09.2022
L.A	N.E.T	2,398,878	331,135	40,265,323	Penalizuar sipas Nj-VI Nr.8120 date 10.10.2022

Burimi: DTM

Në momentin e vendosjes në dispozicion të regjistrimit u identifikuan 4 subjekte për të cilat nuk ishte kryer rishikimi i kështit konform akteve të cituara. Për këto raste, nga ana e strukturës përgjegjëse pranë DTM u krye penalizimi i subjekteve konform ligjit dhe në disa raste u përcollën argumentet përkatëse për të dhënat e paraqitura në sistem, ku përmendim: raste ku detyrimi i deklaratës është kompensuar automatikisht me kredinë e vitit 2020; raste ku detyrimi është kompensuar me TVSH-në e miratuar për rimbursim; raste ku pagesa nuk përfaqëson ulje kësti pasi shoqëria është me aktivitet teknologji informacioni me 5% tatim fitimi; raste ku llogaritja e kësteve me formulën e sistemit është bere gabim me 15% pasi shoqërisë i takon me 5%;etj. Si rezultat, problematikat e konstatuara u sistemuan përgjatë periudhës së auditimit në terren, brenda afateve dhe përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi. Konkretisht:

Për rastet e mëposhtme, në të cilat vlera e tatimit fitimit rezultonte më e ulët se parapagimet në më shumë se 10%, për të cilat u dërgua informacioni pranë DTM. Pas kësaj, nga ana e strukturës

përgjegjëse u ndërmorën masat për aplikimin e penaliteteve sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi:

Tabela 2.2.2.4-Subjekte te penalizuar

Nipti	Subjekti	Kësti fillestar	Kësti përfundimtar	Tatim fitimi	Parapagime	Shënime
K.L	R.I.C	16,611,459	637,776	74,898,152	86,200,811	Penalizuar sipas njoftim vlerësimit nr.2854 date 19.04.2023
K.I	XH.	806,469	506,000	9,565,736	6,877,451	Transferuar ne nëntor 2022. Penalizuar sipas Nj-VI nr. 1880 date 06.03.2023
L.K	A.	1,719,885	-	16,422,673	2,316,181	Penalizuar sipas Nj-VI Nr.296 date 18.01.2023
K.B	E.	417,501	150,000	18,726,249	10,824,118	Transferuar ne nëntor 2022. Penalizuar sipas Nj-VI nr. 2191 date 23.03.2023

Burimi: DTM

Për rastin e P.E, detyrimi i deklaratës është kompensuar automatikisht me kredinë e vitit 2020. Per rastin e subjektit Lufthansa Industry Solutions, tabela e këstit përfundimtar nuk përfaqëson ulje kësti pasi shoqëria është me aktivitet teknologji informacioni me 5% tatim fitimi, dhe llogaritja e kësteve me formulën e sistemit është bere gabim me 15%. Konkretisht:

Tabela 2.2.2.5-Subjekte qe nuk rezultojnë me ulje këste

Nipti	Subjekti	Kësti fillestar	Kësti përfundimtar	Tatim fitimi	Parapagime
L.L	P.E	2,190,573	-	6,249,123	-
L.P	L.I.S	1,347,596	276,137	6,446,350	5,661,921

Burimi: DTM

-Për rishikimet e kryera gjatë vitit 2021 dhe 2022, grupi i auditimit kërkoi informacion lidhur me këtë proces, për të cilat nga ana e sektorit, u vendosën në dispozicion të gjitha shkresat që ishin përcjellë nga subjektet për uljen e kësteve me argumentet përkatëse, së bashku me vendimet për miratimin e tyre:

Tabela 2.2.2.6-Shkresa per ulje te kësteve

Nr	Nipti	Subjekti	Kësti fillestar	Kësti i rivlerësuar	Shënime
1	J.R	A.K	5,907,072	-	Nr. 8874/1 date 25.10.2021
2	J.T	A.	2,956,533	-	Nr. 6043/1 date 29.06.2021
3	J.G	A.SH.D	1,402,459	200,000	Nr. 7563/1 date 30.08.2021
4	J.Ë	A.S	20,225,864	2,789,592	Nr. 5987/1 date 29.06.2021
5	K.E	E.B	1,542,752	-	Nr. 11092 date 29.12.2021
6	K.H	B.-O.SHA	3,659,200	-	Nr. 7126/1 date 30.08.2021
7	K.E	F.-K.C.T.F.	25,305,212	7,300,000	Nr. 11107/1 date 31.12.2021
8	L.5T	S.SH	15,079,423	-	Nr. 11102 date 30.12.2021
9	L.B	S.T	5,484,043	-	Nr. 3252 date 23.04.2021
10	L.L	S.A.B	7,119,910	-	Nr. 10631/1 date 20.12.2021
11	L.D	R.S	1,137,155	-	Transferuar ne nëntor 2022..
12	L.L	F.SH.U	86,559,194	-	Nr. 9772/1 date 02.11.2021
13	L.E	O.S.SH	38,843,993	-	Nr. 9773/1 date 02.11.2021
14	K.E	F.K.C	8,530,464	-	Nr. 7434/1 date 22.09.2022
15	K.Ë	I.C	8,756,524	703,589	Nr. 9155 date 28.10.2022
16	K.M	C.	7,231,873	1,096,237	Nr. 6589/1 date 29.07.2022
17	J.F	K.	4,955,941	-	Nr. 7618 date 29.09.2022
18	L.L	MSSC.	4,739,825	-	Nr. 6587/1 date 29.07.2022
19	L.L	S.A	4,341,974	-	Nr. 2851/1 date 13.05.2022
20	L.K	R.T.M	4,127,407	-	Nr. 7415/1 date 26.09.2022
21	K.G	S.	4,693,786	697,062	Nr. 8085/1 date 26.10.2022
22	L.T	A.	4,333,788	650,000	Nr. 2855/1 date 20.05.2022
23	J.O	R.E	3,455,322	-	Nr. 8740/1 date 31.10.2022
24	L.Q	S.C	3,428,492	546,875	Nr. 7921
25	J.V	K. SHPK	2,411,552	-	Nr. 7182/1 date 28.09.2022

26	K.Ë	D.	5,220,364	3,001,663	Nr. 9825/1 date 30.11.2022
27	K.D	K.	2,259,638	-	Nr. 6588/1 date 29.07.2022
28	K.A	R. K.	1,859,103	-	Transferuar ne nëntor 2022.
29	L.F	E.-S.	1,784,637	-	Nr. 21853/1 date 28.09.2022
30	L.U	"P."	1,766,097	-	Nr. 6881/1 date 25.08.2022
31	L.D	A.I	1,710,756	-	Transferuar ne nëntor 2022.
32	K.D	S. C.	1,661,613	-	Nr. 8867/2 date 11.11.2022
33	L.M	B.	1,514,323	-	Nr. 4169 date 13.05.2022
34	L.T	A.E.S	1,355,193	-	Nr. 5254/4 date 31.10.2022
35	L.I	G.-Dega ne Shqipëri	1,581,223	144,420	Është vlerësimit automatik dhe jo ulje kësti
36	M.J	S. Albania	944,222	-	Nr. 8789/1 date 29.06.2022
37	K.I	XH. SHPK	797,145	205,661	Transferuar ne nëntor 2022.
38	K.O	LIM - EM	1,609,118	287,599	Nr. 8039/1 date 31.10.2022

Burimi: DTM

Nga verifikimi i korrespondencave për rishikimin e kësteve të tatim fitimit konstatohet se miratimi i kërkesave për rishikimin e kësteve të tatim fitimit është kryer pa dokumentuar kryerjen e një analize dhe monitorimi të plotë, veçanërisht në drejtim të nivelit të qarkullimit të shitjeve, ku mbartet edhe risku i rritjes së xhiros por i uljes së tatim fitimit.

Pas mbylljes së afatit për kryerjen e deklaramëve të vitit 2022, u përcoll informacioni lidhur me rivlerësimet e kryera për efekt të tatim fitimit të vitit 2022 nga ana e DTM ishin aplikuar penalitete në rastet kur diferenca mes detyrimit sipas deklaramëve të tatim fitimit rezulton më e lartë se parapagesat në masën 10%, në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", neni 30 pika 5, i ndryshuar me ligjin nr. 177/2013 dhe udhëzimit nr. 5, datë 30.06.2006 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar i cili në pikën 3.13.2 të tij përcakton se "Me dorëzimin e deklaratës vjetore të tatimit mbi fitimit, në rast se detyrimi tatimor për tatimin mbi fitimin tejkalon shumën e parapagimit të tatim fitimit në më shumë se 10%, tatimpaguesi duhet të paguaje një interes në shumën 5% mbi diferencën nëpërmjet detyrimit real vjetor sipas deklaratës së tatim fitimit vjetor dhe shumës së tatim fitimit të parapaguar gjatë vitit.", si më poshtë:

Tabela 2.2.2.7-Rivleresimet e kësteve 2022

Nipti	Subjekti	Kësti fillestar	Kësti i rivlerësuar	Shënime
K.A	R.K	1,859,103	-	Penalizuar Sipas Njoftim Vlerësimit Nr.2879 date 20.04.2023
L.D	A.I	1,710,756	-	Penalizuar Sipas Njoftim Vlerësimit nr.2853 prot, date 19.04.2023

Burimi: DTM

**- Analiza e diferencave të qarkullimit kasave fiskale dhe deklarimit në sistem.**

Në zbatim të ligjit nr 87/2019 "Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit" i cili ka filluar efektet me 1 janar 2021, për transaksionet ndërmjet subjekteve private me 1 korrik 2021 dhe për transaksionet në konsumatorin final me 1 shtator 2021, diferencat e qarkullimit mes kasave fiskale krahasimisht me ato në sistem u analizuan vetëm për vitin 2021. Konkretisht, grupi i auditimit kryqëzoi të dhënat e marra nga DTM në lidhje me kasat fiskale dhe gabimet e kasave, për të nxjerrë xhiron e korrektuar të subjekteve, të cilat u krahasuan me xhiron/qarkullimin e subjekteve sipas deklaratave të TVSH , paraqitur si më poshtë:

Tabela 2.2.2.8-Diferenca e kasave

Nr i subjekteve	Qarkullimi sipas kasës	Të ardhura sipas deklaratës së TVSH	Diferenca (-) (kasa<deklarata e TVSH-së)
435	143,509,978,517	940,044,574,669	(796,534,596,152)

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DTM

Nr i subjekteve	Qarkullimi sipas kasës	Të ardhura sipas deklaratës së TVSH	Diferenca (+) (kasa>deklarata e TVSH-së)
32	10,950,552,982	5,646,191,929	5,304,361,053

Duke u vlerësuar risku për rastet kur qarkullimi sipas kasës rezulton më i madh se qarkullimi sipas deklarates së TVSH-së, në bazë të raportit mbi diferencat e qarkullimit midis kasave fiskale dhe deklarimit në sistem në deklaraten e TVSH, rezultojnë se nga 32 subjekte, vetëm 4 prej tyre janë administruar nga DTM për periudhën objekt auditimi, pasi 28 subjektet e tjera janë transferuar nga DRT-të e tjera në Nëntor 2022. Si rezultat, rezultojnë diferencat si më poshtë në të cilat të dhënat e kasës rezultojnë më të larta se sistemi:

Tabela 2.2.2.9- Diferencat në të cilat të dhënat e kasës rezultojnë më të larta se sistemi

Në lekë

Nipt	Subjekti	Qarkullimi Kasës	Të ardhura Deklarata e TVSH	Diferenca	Koment
K.C	S.M.A	1,696,997,818	971,970,841	725,026,977	Kaluar kontroll te thelluar me nr. 382/2 per periudhën deri 2021/11
K.E	T.	1,582,969,506	1,431,477,160	151,492,346	Kaluar kontroll te thelluar me nr. 2203 per periudhën deri 2022/02
K.Q	M.	2,885,222,631	2,738,290,360	146,932,271	Kaluar kontroll te thelluar me nr. 4330 per periudhën deri 2023/03
L.N	S.H	572,517,309	504,453,568	68,063,741	Kaluar kontroll te thelluar me nr. 5006/2 per periudhën deri 2023/05

Burimi: DTM

Subjekte me veprimtari në sektorin e hidrokarbureve

Konkretisht, grupi i auditimit kryqëzoi të dhënat e marra nga DTM në lidhje me kasat fiskale dhe gabimet e kasave për subjekte me veprimtari në sektorin e hidrokarbureve, për të nxjerrë xhiron e korriguar të subjekteve, të cilat u krahasuan me xhiron/qarkullimin e subjekteve sipas deklarave të TVSH , paraqitur si më poshtë:

Tabela 2.2.2.10- Diferencat e kasës per sektorin e hidrokarbureve

Në lekë

Nr i subjekteve	Qarkullimi sipas kasës	Të ardhura sipas deklarates së TVSH	Diferenca (-) (kasa<deklarata e TVSH-së)
27	28,615,755,567	152,386,390,004	(123,770,634,437)

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DTM

Në lekë

Nr i subjekteve	Qarkullimi sipas kasës	Të ardhura sipas deklarates së TVSH	Diferenca (+) (kasa>deklarata e TVSH-së)
22	89,340,912,443	34,964,504,641	54,376,407,802

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DTM

Nga të dhënat për subjekte me veprimtari në sektorin e hidrokarbureve rezultojnë diferencat si më poshtë në të cilat të dhënat e kasës rezultojnë më të larta se sistemi, nga të cilat vetëm 1 subjekt (D.A Alba) është transferuar nga DRT në DTM në nëntor 2022:

Tabela 2.2.2.11- Diferencat si më poshtë në të cilat të dhënat e kasës rezultojnë më të larta se sistemi

Në lekë

Nipt	Subjekti	Qarkullimi Kasës	Të ardhura Deklarata e TVSH	Diferenca	Koment
J.P	K.	17,055,057,503	15,507,498,767	1,547,558,736	Kaluar kontroll te thelluar me nr. 1798/1 për periudhën deri 2021/12
J.I	B .	601,805,940	545,243,140	56,562,800	Kaluar kontroll të thelluar me nr. 8319/3 per periudhën deri 2022/08
J.C	J.	639,190,666	577,959,758	61,230,908	Kaluar kontroll të thelluar me nr. 2279/1 për periudhën deri 2023/01
K.Q	D.	1,182,721,454	1,059,317,641	123,403,813	Kaluar kontroll të thelluar me nr. 1853 për periudhën deri 2021/12
K.G	A.P.SH	476,363,645	399,786,375	76,577,270	Kaluar kontroll të thelluar me nr. 3293/1 për periudhën deri 2022/02
K.M	K.S	3,235,655,189	2,774,676,409	460,978,780	Kaluar kontroll të thelluar me nr. 4261/1 për periudhën deri 2023/04
K.K	"V.P	1,738,356,711	1,516,872,769	221,483,942	Kaluar kontroll të thelluar me nr. 6557/2 për periudhën deri 2022/05

K.T	"G.C"	7,047,386,205	6,040,419,112	1,006,967,093	Kaluar kontroll të thelluar me nr. 6862/1 për periudhën deri 2023/05
K.C	"L."	756,906,033	742,772,968	14,133,065	Kaluar kontroll të thelluar me nr. 3286/2 për periudhën deri 2022/02
K.C	"A.I" SHPK	387,136,338	349,879,600	37,256,738	Kaluar kontroll të thelluar me nr. 8534 për periudhën deri 2022/08
K.C	D. A.	204,337,560		204,337,560	transferuar
L.A	J.	323,759,631	270,552,929	53,206,702	Kaluar kontroll të thelluar me nr. 3292/1 për periudhën deri 2022/02
L.A	M. -S	442,619,037	370,524,072	72,094,965	Kaluar kontroll të thelluar me nr. 4262/1 për periudhën deri 2023/04
L.E	A.D	817,595,689	726,455,208	91,140,481	Kaluar kontroll të thelluar me nr. 8317/1 për periudhën deri 2022/08
L.M	2A.O	937,523,621	829,869,461	107,654,160	Kaluar kontroll të thelluar me nr. 9539/2 për periudhën deri 2022/09
L.G	G.A	613,906,882	495,641,197	118,265,685	Kaluar kontroll të thelluar me nr. 9541 për periudhën deri 2022/09
L.G	D.O	2,384,311,104	2,303,410,267	80,900,837	Kaluar kontroll të thelluar me nr. 5000 për periudhën deri 2023/04
L.G	E.	494,358,511	453,624,968	40,733,543	Kaluar kontroll të thelluar me nr. 199/2 për periudhën deri 2022/11
ML01	#N/A	12,631,488,581		12,631,488,581	
ML05	#N/A	357,313,933		357,313,933	
ML09	#N/A	34,885,902,739		34,885,902,739	
ML13	#N/A	2,127,215,471		2,127,215,471	

Burimi: DTM

Për këto të dhëna grupi i auditimit kërkoi informacion dhe sipas informacionit verbal të sektorit nga zyra këto vijnë si pasojë e gabimeve në shtypjen e kasës, por ky sektor nuk ka administruar asnjë procesverbal që vërteton këtë situatë. Në vijim të kërkesave të vazhdueshme të grupit të auditimit pranë DTM për vendosjen në dispozicion të procesverbaleve përkatëse, këto dokumentacione nuk u përcollën deri në fund të fazës së auditimit në terren. Pas dorëzimit të akt konstatimeve, nga ana e DTM u dërguan dokumentacionet që vërtetonin kryerjen e verifikimeve të nevojshme nëpërmjet kontrolleve të thelluara për të gjitha rastet e subjekteve me diferenca sipas tabelës së mësipërme për vitin 2021.

Për kodet ML01, ML05, ML09, ML13, që rezultojnë sipas databazës së përpunuar nga DTM me diferencat më sipër, nuk disponohej informacion se kujt i referohen këto kode.

### **- Auditimi i diferencave pozitive/negative midis xhiros të deklaruara në Formularin e Deklarimit të Pagesës të TVSH-së (FDP) dhe Deklaratën e Tatimit mbi Fitimit.**

#### **Viti 2021**

Tabela 2.2.2.12- Xhiroja sipas shitjeve në vlerë më të vogël se në deklaratën e tatim fitimit (Diferencë në vlerë negative).

Në lekë

Nr Subjektesh	Të ardhura FDP-TVSH	Të ardhura Deklarata TF	Diferenca (-)
312	545,818,812,298	601,450,257,125	(45,709,835,735)

Burimi: DTM

Tabela 2.2.2.13- Xhiroja sipas shitjeve në vlerë më të madhe se në deklaratën e tatim fitimit (Diferencë në vlerë pozitive).

Në lekë

Nr Subjektesh	Të ardhura FDP-TVSH	Të ardhura Deklarata TF	Diferenca (+)
471	3,035,083,554,584	2,833,292,319,054	332,421,210,513

Burimi: DTM.

Nga grupi i auditimit u përzgjedhën subjektet që paraqiten me diferencë + apo – me vlerën mbi 100,000,000 lekë, ku rezultuan 226 subjekte, nga të cilat 51 subjekte me deklarim më të lartë TF-së krahasuar me TVSH-në dhe 175 subjekte me deklarim të TF-së më të vogël se TVSH-ja. Për këto raste u kërkua informacion pranë sektorit për iniciativat e ndërmarra, ku sipas përgjigjeve të inspektorëve përgjegjës sipas ndarjes në nipte të inspektorëve, u vendosën në dispozicion

komentet përkatëse shoqëruar me evidenca për çdo rast, në kuadër të detyrimit të sektorit për kryerjen e monitorimeve dhe verifikimeve të nevojshme për të kërkuar informacion nga tatimpaguesit mbi këto diferenca sipas përcaktimeve të pikës 3 të nenit 60 “Detyrimi i tatimpaguesit për të dhënë informacion dhe për të lejuar hyrjen në mjediset e veprimtarisë ekonomike” të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe sipas nenit 71 “E drejta për të përdorur mënyra alternative vlerësimi” dhe neni 71/1 “Letër kujtesa” të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

Më hollësisht, nga kampioni prej 226 subjekte të verifikuara nga grupi i auditimit ka rezultuar se:

- Për 9 subjekte diferenca është e justifikuar pasi ka ardhur si shkak i auto ngarkesës;
- 29 subjekte janë të transferuara pranë DTM në fund të muajit Nëntor, dhe nuk janë arritur të verifikohen inspektorët e DTM gjatë periudhës objekt auditimi;
- Për 178 subjekte diferenca është e justifikuar me evidencën mbështetëse ku më hollësisht rast pas rasti janë trajtuar në aneksin bashkëlidhur, duke identifikuar si shkaqe të ardhurat e rimarra, parapagim, shpenzime interesa dhe komisione, kurse këmbimi, të përjashtuara nga tatim fitimi, kanë kaluar kontroll të plotë, janë propozuar për kontroll, etj.
- Për 10 subjekte nuk janë dorëzuar pasqyrat financiare, dhe nga ana e inspektorëve ka qenë e pamundur verifikimi i pasqyrave financiare. Në këto raste subjektet janë penalizuar dhe nga ana e DTM është përcjellë ri kujtesa për dorëzimin e PF.

### **Viti 2022**

Për sa i përket diferencave për vitin 2022, ku vlera totale e diferencave për të dyja kahet paraqitet si më poshtë, dhe për të cilat procedura e shqyrtimit të pasqyrave financiare bazuar në Ligjin 8438 "Per Tatimin mbi të ardhurat", sipas neni 29, ka filluar në muajin Prill 2023,dhe deri në përfundim të afatit të auditimit në terren ky proces nuk u finalizua.

*Tabela 2.2.2.14-Të ardhura FDP-TVSH më të ulëta se deklarata e TF:*

*Në lekë*

Nr Subjektsh	Të ardhura FDP-TVSH	Të ardhura Deklarata TF	Diferenca (-)
425	882,604,102,084	1,006,492,369,256	(123,888,267,172)

*Burimi: DTM*

*Tabela 2.2.2.15-Të ardhura FDP-TVSH më të larta se deklarata e TF:*

*Në lekë*

Nr Subjektsh	Të ardhura FDP-TVSH	Të ardhura Deklarata TF	Diferenca (+)
351	1,123,805,226,294	933,804,905,731	190,000,320,563

*Burimi: DTM.*

Këto diferenca mbeten objekt verifikimi në auditimin e ardhshëm të KLSH, duke qenë se deri në përfundim të fazës së auditimit në terren ishin në proces verifikimi nga ana e inspektorëve duke hartuar dhe përcjellë letër kujtesat përkatëse pranë subjekteve respektive sipas ndarjes në nipte.

### ***Regjistri i Akt Marrëveshjeve me këste të detyrimeve tatimore të papaguara***

- Marrëveshja me këste aplikohet për tatimpaguesit që nuk kanë mundësi për të paguar në afat detyrimet tatimore, dhe kanë vërtetuar që janë në kushtet e pamundësisë financiare për të paguar të plotë detyrimin tatimor, me aprovim dhe nënshkrim të Drejtorit të Drejtorisë Rajonale dhe tatimpaguesit, bazuar në Ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 i ndryshuar, neni 77 “Marrëveshja e pagesës me këste”, Udhëzimit nr.24, datë 02.09.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, pika 77, si dhe bazuar në shkresën nr.18839 datë 28.09.2020 të DPT. Pas riorganizimit të kryer në strukturat tatimore, në zbatim të Urdhrit nr.33, datë 12.02.2020, të Kryeministrit si dhe pikës 5, të nenit 88, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, ndjekja e akt

marrëveshjeve me kusht kryhet nga Drejtoritë e Kontrollit Tatimor dhe jo nga Drejtoritë e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara pranë Rajoneve. Megjithatë, manuali i rishikuar i Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara nuk paraqet informacion mbi procesin që do të ndiqet për akt marrëveshjet me këste, dhe nga DPT nuk janë miratuar akte të tjera rregullative për këtë çështje sikundër parashikon neni 135 “Nxjerrja e akteve nënligjore” i ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, i ndryshuar, i cili përcakton ndër të tjera se “ *Ngarkohet Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve që të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të nenit 29 pika 2 dhe të miratojë manualin e vlerësimit, të investigimit, të shërbimit të tatimpaguesit dhe të masave shtrënguese, si dhe manuale të tjera.*”, duke cënuar kështu veprimtarinë e strukturave përgjegjëse për monitorimin e tyre, pasi nuk përcaktohen detyrat konkrete që do të kryhen nga ana e tyre.

Grupi i auditimit kërkoi informacion lidhur me marrëveshjet e përsëritura, i cili u vendos në dispozicion vetëm për periudhën pasi monitorimi i tyre ka kaluar në kompetencën e drejtorive të kontrollit pasi këto struktura nuk gjeneronin informacion të mëparshëm për këto akt marrëveshje për periudhën kur monitorimi i tyre kishte qenë nën mbikëqyrjen e drejtorive të mbledhjes së detyrimeve tatimore të papaguara, duke rezultuar kështu me mangësi në drejtim të dorëzimit të punës dhe materialeve përkatëse pas rishpërndarjes së përgjegjëseve. Gjithashtu, mungesa e informacionit të strukturës aktuale përgjegjëse për ndjekjen e akt marrëveshjeve, cënon efektivitetin e vendimmarrjes së saj lidhur me këto akt marrëveshje në momentin që nuk është vepruar duke vlerësuar dhe analizuar edhe historikun e mëparshëm të këtyre subjekteve. Nga auditimi i praktikave për lidhjen e akt-marrëveshjeve konstatohet se, në kërkesat e tatimpaguesve mungon vërtetësia e pamundësisë së situatës aktuale financiare, si dhe argumente nga ana e subjektit, që pavarësisht rrethanës financiare të vështirë, është në gjendje të zbatojë kushtet e marrëveshjes. Gjithashtu mungon dhe analiza e situatës ekonomike financiare të subjektit të realizuar nga vetë DTM, mbështetur në pasqyrat financiare të subjektit, gjendja e detyrimeve, kapitaleve të shoqërisë, aftësia qarkulluese e inventarit, likuiditetet etj.

### Viti 2020

Tabela 2.2.2.16-Akt marrëveshjet e DTM per vitin 2020

Në lekë

Drejtoritë Rajonale	Nr. A-M te lidhura	Nr. Subjekteve qe kane lidhur A-M	Vlera totale e debisë per te cilën është lidhur A-M	Pagesa ne momentin e lidhjes A-M (vlera fillestare e pagesës)	Nr. A-M te anuluar
DTM	8	8	121,874,863	31,157,714	3

**Gjatë vitit 2020** rezultojnë të jenë lidhur 8 akt marrëveshje për 8 subjekte me vlerë totale të detyrimit prej 121,874,863 lekë. Deri në përfundim të këtyre akt marrëveshjeve rezultojnë të kenë përfunduar me sukses 5 prej tyre (71,846,334 lekë detyrime të arkëtuara, ose rreth 59% e total detyrimeve për të cilat janë lidhur A.M). Për 3 akt marrëveshjet e zgjidhura (M. F., I.T.S., G.) nuk janë përmbushur të gjitha pagesat e dakortësuara, ku konkretisht nga totali i detyrimeve për këto 3 akt marrëveshje në vlerën prej 50,028,529 lekë janë paguar 25,087,206 lekë dhe kanë mbetur pa paguar 24,941,336 lekë (rreth 50% e detyrimeve e mbetur pa paguar).

Në momentin e lidhjes së marrëveshjes janë paguar si kusht për lidhjen e marrëveshjes me këste në bazë të ligjit rreth 31,157,714 lekë.

### Viti 2021

Tabela 2.2.2.16-Akt marrëveshjet e DTM per vitin 2021

Në lekë

Drejtoritë Rajonale	Nr. A-M te lidhura	Nr. Subjekteve qe kane lidhur A-M	Vlera totale e debisë per te cilën është lidhur A-M	Pagesa ne momentin e lidhjes A-M (vlera fillestare e pagesës)	Nr. A-M te anuluar
DTM	31	29	820,163,222	238,036,431	10



**Gjatë vitit 2021** rezultojnë të jenë lidhur 31 akt marrëveshje për 29 subjekte me vlerë totale të detyrimit prej 820,163,222 <sup>5</sup> lekë. Deri në përfundim të këtyre akt marrëveshjeve rezultojnë të kenë përfunduar me sukses 19 prej tyre (363,679,932 <sup>6</sup> detyrime të arkëtuara, ose rreth 44% e total detyrimeve për A.M e lidhura gjatë vitit 2022 të cilave u ka përfunduar afati dhe janë administruar nga DTM deri në fund të vitit, pra pa përfshirë AM e transferuara (ku vlera e tyre paraqitet 817,455,207 lekë)<sup>7</sup>. Për 10 akt marrëveshjet e zgjidhura ( G. S.P.A-Dega ne Shqipëri, I. E. BV SPV, H. E., S., A. 2018, I.E, J., I. E. BV SPV, UET, Shoqëri e thjeshte C.A.) nuk janë përmbushur të gjitha pagesat e dakortësuara, ku konkretisht nga totali i detyrimeve të lidhura për këto 10 akt marrëveshje në vlerën prej 444,798,882 lekë janë paguar 123,664,179 lekë dhe kanë mbetur pa paguar 320,955,859 lekë (rreth 72% e detyrimeve të tyre e mbetur pa paguar), 2 akt marrëveshje të 1 subjekti janë transferuar (me vlerë 2,708,015 mijë lekë). Në momentin e lidhjes së marrëveshjes janë paguar si kusht për lidhjen e marrëveshjes me këste në bazë të ligjit rreth 238,036,431 lekë.

### Viti 2022

Tabela 2.2.2.16-Akt marrëveshjet e DTM per vitin 2022

Në lekë

Drejtoria Rajonale	Nr. A-M te lidhura	Nr. Subjekteve qe kane lidhur A-M	Vlera totale e debisë per te cilën është lidhur A-M	Pagesa ne momentin e lidhjes A-M (vlera fillestare e pagesës)	Nr. A-M te anuluar	Nr. A-M në proces
DTM	26	24	1,023,388,081	278,363,812	8	9

**Gjatë vitit 2022** rezultojnë të jenë lidhur 26 akt marrëveshje për 24 subjekte me vlerë totale të detyrimit prej 1,023,388,081<sup>8</sup> lekë. Deri në përfundim të këtyre akt marrëveshjeve rezultojnë të kenë përfunduar me sukses 9 prej tyre (234,763,745<sup>9</sup> detyrime të arkëtuara, ose rreth 28% e total detyrimeve për A.M e lidhura gjatë vitit 2022 të cilave u ka përfunduar afati (ku vlera e tyre paraqitet 838,818,917 lekë)<sup>10</sup>. Për 8 akt marrëveshjet e zgjidhura ( I. E. A. – 2014, I. T. S., I. E. B.SP.V, B.-x, E. I. Grup, A., A.) nuk janë përmbushur të gjitha pagesat e dakortësuara, ku konkretisht nga totali i detyrimeve për këto 8 akt marrëveshje në vlerën prej 604,555,814 lekë janë paguar 157,545,491 lekë dhe kanë mbetur pa paguar 443,375,944 lekë (rreth 74% e detyrimeve të tyre e mbetur pa paguar).9 marrëveshje në vlerën 184,569,164 lekë janë ende në proces. Në momentin e lidhjes së marrëveshjes janë paguar si kusht për lidhjen e marrëveshjes me këste në bazë të ligjit rreth 278,363,812 lekë.

-Situata lidhur me numrin e marrëveshjeve të anuluar për periudhën objekt auditimi, vendosur në dispozicion nga struktura e kontrollit nga zyra paraqitet si më poshtë:

Tabela 2.2.2.23-Akt marrëveshjet e anuluar DTM per vitin 2020

Në lekë

Nr	Tatimpaguesi	NIPTI	Data e Akt-Marrëveshjes	Shuma tatimit për te cilin është lidhur A-M	Afati zbatueshmerisë se A-M	Pagesa te pa kryera ne raport e totalin e vlerës së marrëveshjes
1	M.F	L.A	28.10.2020	3,182,262	26.10.2021	1,591,134
2	I.T.S	L.C	03.11.2020	33,670,008	22.09.2021	20,202,006
3	G.S.A	L.I	28.12.2020	13,176,259	20.12.2021	3,294,066

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DTM

Tabela 2.2.2.24-Akt marrëveshjet e anuluar DTM per vitin 2021

<sup>5</sup> Vlera e detyrimeve të AM sipas sistemit paraqitet në vlerën 821,439,171 lekë.

<sup>6</sup> Vlera totale e detyrimeve sipas AM paraqitet në shumën 372,656,325 lekë.

<sup>7</sup> Sipas sistemit vlera totale e detyrimeve për të cilat është lidhur AM paraqitet në shumën 835,685,180

<sup>8</sup> Vlera e detyrimeve të AM sipas sistemit paraqitet në vlerën 1,019,736,664 lekë.

<sup>9</sup> Vlera totale e detyrimeve sipas AM paraqitet në shumën 234,263,103 lekë.

<sup>10</sup> Sipas sistemit vlera totale e detyrimeve për të cilat është lidhur AM paraqitet në shumën 835,685,180



Në lekë

Nr	Tatimpaguesi	NIPTI	Data e Akt-Marrëveshjes	Shuma tatimit për te cilin është lidhur A-M	Afati zbatueshmeris e se A-M	Pagesa te pa kryera ne raport e totalin e vlerës së marrëveshjes
	G. S.P.A-Dega ne Shqipëri	L.I	21.06.2021	38,692,038	20.06.2022	29,019,024
	I.E BV SPV	L.B	07.01.2021	161,375,634	24.01.2022	53,791,876
	I.E	K.K	22.02.2021	23,283,715	10.08.2022	7,761,283
	S.	J.C	26.02.2021	54,563,602	19.12.2022	0
	A. 2018	L.F	11.06.2021	559,234	27.01.2022	
	I.E	K.U	23.07.2021	37,530,224	25.01.2022	
	J.	L.A	23.07.2021	446,176	23.12.2021	341,568
	I.E BV SPV	L.B	01.09.2021	44,873,882	26.09.2022	18,697,450
	UET	K.OL	10.09.2021	69,664,004	29.12.2022	14,052,978
	COPRI-Aktor	L.O	12.28.2021	13,810,373	28.12.2022	

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DTM

Tabela 2.2.2.25-Akt marrëveshjet e anuluar DTM per vitin 2022

Në lekë

Nr	Tatimpaguesi	NIPTI	Data e Akt-Marrëveshjes	Shuma tatimit për te cilin është lidhur A-M	Afati zbatueshmeris e se A-M	Pagesa te pa kryera ne raport e totalin e vlerës së marrëveshjes
1	A.	J.J	22.09.2022	9,314,666	25.12.2023	3,211,265
2	A.	J.K	16.09.2022	27,841,147	20.12.2022	0
3	B.	K.N	26.08.2022	12,649,206	30.11.2022	
4	E.I.G	K.E	26.08.2022	29,490,604	30.11.2022	0
5	I.E	K.U	27.04.2022	27,162,213	25.10.2022	
6	I.T.S	L.C	29.06.2022	5,065,059	28.10.2022	2,550,146
7	A. 2014	L.M	19.05.2022	15,504,114	20.09.2022	3,710,675
8	I.E.	L.B	05.08.2022	477,528,805	27.12.2023	148,073,405

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DTM

Nga analizimi i akt marrëveshjeve të anuluar në zbatim të udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar i cili përcakton në pikën 78 të tij “Zgjidhja e marrëveshjes së pagesës me këste” se: “Marrëveshja e pagesës me këste mund të zgjidhet nga administrata tatimore në momentin e parë që personi i tatueshëm nuk e respekton atë lidhur me rregullshmërinë e pagesave si dhe kur ai nuk paguan detyrimet e tjera tatimore që lindin gjatë periudhës së mbuluar nga marrëveshja. Në këtë rast, personi i tatueshëm është i detyruar të paguajnë të gjitha detyrimet tatimore të papaguara që mbulojnë nga kjo marrëveshje, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit të zgjidhjes së marrëveshjes. Nëse këto detyrime nuk paguhen, administrata tatimore mbledh detyrimet në përputhje me dispozitat e Kreut XI të Ligjit.”, konstatohet se për këta tatimpagues nuk është kryer ose nuk ka qenë efektive analiza për të vlerësuar riskun lidhur me përmbushjen e kushteve të marrëveshjes, si dhe nuk është analizuar në mënyrë efektive situata nëse plotësohen kushtet e përcaktuara në ligjin e procedurave tatimore, duke mos respektuar pikën 2 dhe 3 të Nenit 18 të Rregullores së funksionimit të DRT-ve. Gjithashtu, për akt marrëveshjet e përsëritura, informacioni u vendos në dispozicion vetëm për periudhën pasi monitorimi i tyre ka kaluar në kompetencën e drejtorive të kontrollit pasi këto struktura nuk gjeneronin informacion të mëparshëm për këto akt marrëveshje për periudhën kur monitorimi i tyre kishte qenë nën mbikëqyrjen e drejtorive të mbledhjes së detyrimeve tatimore të papaguara, duke rezultuar kështu me mangësi në drejtim të dorëzimit të punës dhe materialeve përkatëse pas rishpërndarjes së përgjegjësi. Gjithashtu, mungesa e informacionit të strukturës aktuale përgjegjëse për ndjekjen e akt marrëveshjeve, çënon efektivitetin e vendimmarrjes së saj lidhur me këto akt marrëveshje në momentin që nuk është vepruar duke vlerësuar dhe analizuar edhe historikun e mëparshëm të këtyre subjekteve, sikundër përcakton rregullorja e funksionimit të DRT, neni 18

pika 2 përcakton se “struktura përgjegjëse në DRT pasi merr në dorëzim kërkesat për marrëveshje i analizon ato duke përcaktuar riskun përkatës” dhe pika 3 “ nëse plotëson kushtet pas analizës harton draft marrëveshjen përkatëse për pagesën me këste duke analizuar për të parë situatën nëse plotësohen kushtet e përcaktuara në ligjin e procedurave tatimore”; gjithashtu udhëzuesi i përgjithshëm i procedurave të mbledhjes me forcë datë 15.03.2018 pika 10 përcakton se “Drejtoritë rajonale tatimore mund të lejojnë tatimpaguesit në çdo kohë dhe sa herë që është e nevojshme të lidhë marrëveshje të pagesës me këste, por, në të njëjtën kohë ai duhet të vërtetojë pamundësinë aktuale financiare, si dhe të tregojë që pavarësisht rrethanës financiare të vështirë, është në gjendje të zbatojë kushtet e marrëveshjes”. Për të gjykuar në lidhje me pamundësinë financiare mund të shërbejnë pasqyrat financiare të shoqërisë, gjendja e detyrimeve, kapitaleve të shoqërisë, aftësia qarkulluese e inventarit, likuiditetet etj;”. Nga akt marrëveshjet e anuluar, për periudhën objekt auditimi rezultojnë edhe disa akt marrëveshje të lidhura për të njëjtat subjekte, si një mjet për mos aplikimin e masave të tjera shtrënguese pas përfundimit të afatit për marrëveshjet ekzistuese. Nga auditimi i praktikave për lidhjen e akt-marrëveshjeve konstatohen mangësi në kërkesat e tatimpaguesve në drejtim të vërtetimit të pamundësisë së situatës aktuale financiare, shoqëruar e argumente nga ana e subjektit që pavarësisht rrethanës financiare të vështirë, është në gjendje të zbatojë kushtet e marrëveshjes; mangësi në analizat e situatës ekonomike financiare të subjektit të realizuar nga vetë DTM mbështetur në pasqyrat financiare të subjektit, gjendja e detyrimeve, kapitaleve të shoqërisë, aftësia qarkulluese e inventarit, likuiditetet etj, sikundër përcakton pika 77.1 të Udhëzimit nr.24, datë 02.09.2008 dhe Nenit 18 të Rregullores së funksionimit të DTM për lidhjen e akt-marrëveshjes pika 2 “Struktura përgjegjëse në DRT pasi merr në dorëzim kërkesat për marrëveshje i analizon ato duke përcaktuar riskun përkatës”, dhe pika 3: “Nëse plotëson kushtet pas analizës harton draft marrëveshjen përkatëse për pagesën me këste duke analizuar për të parë situatën nëse plotësohen kushtet e përcaktuara në ligjin e procedurave tatimore.”.

**- Auditimi i diferencave pozitive/negative midis deklaramit në tatime dhe dogana.**

Grupi i auditimit kërkoi vendosjen në dispozicion të të dhënave lidhur me deklaramin e importeve dhe eksporteve që rezultojnë nga autoriteti tatimor (DTM) duke i krahasuar ato me të dhënat që rezultojnë të raportuara nga autoriteti doganor (DPD). Nga kryqëzimi i të dhënave sipas situatës financiare të TVSH-së, librat e blerjes dhe të shitjes me të dhënat e deklaruara sipas doganës janë konstatuar diferenca në të dy kahet:

**Në import**

*Tabela 2.2.2.26- Rastet kur vlera e deklaruar sipas tatimeve është më e madhe se ajo sipas doganave.*

*Në lekë*

Nr Subjektesh <sup>11</sup>	Vlera e deklaruar sipas tatimeve	Vlera e deklaruar sipas doganave	Diferenca
370	73,991,803,925	72,250,256,543	1,741,547,382

Burimi: DTM

*Tabela 2.2.2.27- Rastet kur vlera e deklaruar sipas tatimeve është më e vogël se ajo sipas doganave.*

*Në lekë*

Nr Subjektesh <sup>12</sup>	Vlera e deklaruar sipas tatimeve	Vlera e deklaruar sipas doganave	Diferenca
-----------------------------	----------------------------------	----------------------------------	-----------

<sup>11</sup> Mbi 1000 lekë

<sup>12</sup> Mbi 1000 lekë

177	5,747,958,137	6,339,238,663	(591,280,526)
-----	---------------	---------------	---------------

Burimi: DTM

### **Në eksport**

*Tabela 2.2.2.28- Rastet kur vlera e deklaruar sipas tatimeve është më e madhe se ajo sipas doganave.*

*Në lekë*

Nr Subjektesh <sup>13</sup>	Vlera e deklaruar sipas tatimeve	Vlera e deklaruar sipas doganave	Diferenca
208	46,911,372,209	106,107,865,332	(59,196,493,123)

Burimi: DTM

*Tabela 2.2.2.29- Rastet kur vlera e deklaruar sipas tatimeve është më e vogël se ajo sipas doganave.*

*Në lekë*

Nr Subjektesh <sup>14</sup>	Vlera e deklaruar sipas tatimeve	Vlera e deklaruar sipas doganave	Diferenca
153	142,675,823,060	107,983,349,651	34,692,473,409

Burimi: DTM

Diferencat që kanë lindur mes dy deklarimeve, konstatohet se janë verifikuar dhe analizuar nga inspektorët përkatës për të gjitha rastet duke identifikuar dhe shkaqet përkatëse. Nga shkresat e përcjella rezulton se diferencat më të mëdha ekzistojnë për shkak të deklarimit jo të saktë nga ana e doganës, e cila nuk ka raportuar disa deklarata doganore të cilat faktikisht nga DTM disponohen, dhe janë cituar në informacionet e vendosura në dispozicion. Referuar diferencave të konstatuara në deklarimet mes dy institucioneve, ekziston një risk për ekzistencën e një anomalie të sistemeve sipas së cilave funksionojnë institucionet (Asycuda, C@ts); apo pasaktësi për shkak të modulit të aplikuar në sistemin C@TS në momentin e gjenerimit të të dhënave nga DPD. Kjo problematikë nuk rezulton të jetë dokumentuar në korrespondencat mes DTM dhe DPT përgjatë periudhës objekt auditimi, dhe nuk rezulton të jenë ndërmarrë iniciativat e nevojshme për verifikimin e shkakut të diferencave, me qëllim kryerjen e veprimeve të nevojshme në sistem. Për këto diferenca nga ana e sektorit të kontrollit nga zyra ka vijuar procesi i verifikimeve për justifikimin e tyre nëpërmjet kopjeve fizike të deklaratave doganore të përcjella nga tatimpaguesit. Konkretisht, komentet dhe dokumentacionet e vendosura në dispozicion nga inspektorët për dokumentimin e shkaqeve të diferencave të konstatuara për çdo rast sipas kampionit të përzgjedhur nga grupi i auditimit, duke u konkretizuar edhe me dokumentacionin përkatës, në të dyja kahet, paraqitet sipas aneksit më poshtë.

Për sa trajtuar më sipër, pas përcjelljes së Projektraportit të auditimit, nga ana e znj. E. M., Përgjegjëse e Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit, me shkresën nr. 52/28, prot në DTM datë 11.09.2023 dhe nr. 14/11, prot në KLSH datë 12.09.2023 janë shprehur objeksionet si më poshtë:

**Pretendimi i subjektit:** Sa i takon rekomandimit nr. 18.1 të projektraportit, nga ana e sektorit të kontrollit nga zyra dhe monitorimit është hartuar plani operacional për vitin 2022, i cili nuk u zyrtarizua pasi nuk ishte hartuar plani i ri strategjik dhe operacional i DPT. Sa i takon rekomandimit nr. 19.1 dhe 19.2 procesverbalet e shtypjes gabim të kasave janë administruar nga Sektorët e Kontrollit në Vend. Sa i takon rekomandimit nr. 20.2, Sektori i Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit nuk mund të administrojë konkluzione të raporteve të kontrolleve përfundimtare për tatimpagues me diferenca tatime/dogana. Saktësimi i situatës dhe vërtetësisë së deklarimeve të tatimpaguesve kryer nga inspektori i kontrollit në vend dhe miratuar nga strukturat drejtuese në DTM të cilat janë detyruese për administratën tatimore

<sup>13</sup> Mbi 1000 lekë

<sup>14</sup> Mbi 1000 lekë

sipas përcaktimeve të nenit 85, të ligjit nr. 9920/2008, pika 1, prandaj nuk mund të bëhen objekt i analizimeve të Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Lidhur me observacionin për rekomandimin nr. 18.1 të projektraportit, sqarojmë se rekomandimi për hartimin e planit operacional është përcjellë për tu hartuar në rang DTM, referuar problematikës së trajtuar në material dhe të ri sjellë nga ju në observacion. Lidhur me observacionin për rekomandimin nr. 19.1 dhe 19.2, sqarojmë se rekomandimi nr. 19.1 i drejtohet Sektorit të Kontrollit nga Zyra në mënyrë që të kërkohet paraprakisht nga kjo strukturë informacioni se shkaqet e diferencave vijnë si pasojë e shtypjes gabim të kasës, dhe më vonë në rekomandimin 19.2 është kërkuar të përcillen këto procesverbale pranë jush për të konfirmuar diferencat e konstatuara. Lidhur me observacionin nr. 20.2, sqarojmë se ky observacion ka për qëllim përmirësimin e praktikës së deritanishme të ndjekur nga ana e Sektorit të Kontrollit nga Zyra, për rastet në të cilat përcillen propozimet për kryerjen e kontroleve në vend, në mënyrë që puna e këtij sektori të mos kufizohet vetëm në përcjelljen e këtyre shkresave por edhe administrimin e rezultateve, në mënyrë që të garantohet se diferencat e subjektit janë të justifikuara me sa pretenduar.

**Titulli i gjetjes :** **Mangësi të konstatuara në lidhjen e Aktmarrëveshjeve**

**Situata:**

-Nga auditimi u konstatua se pas riorganizimit të kryer në strukturat tatimore, ndjekja e akt marrëveshjeve ka mbetur nën kompetencën e Drejtorisë së Kontrollit pranë DRT-ve përkatëse. Gjatë vitit 2021 nga ana e DPT është kryer rishikimi i Manualit të Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, ku është hequr kapitulli që më parë parashikonte procedurat që do të ndiqen për zbatimin e marrëveshjeve me këste. Si rezultat, këto procedura nuk janë përfshirë në asnjë prej akteve nënligjore sipas së cilave funksionojnë Drejtoritë e Kontrollit (ndër të tjera edhe DTM) dhe si rezultat, procesi që do të ndiqet për akt marrëveshjet me këste rezultoi i pa rregulluar dhe i pa mbuluar me akte administrative, manuale apo udhëzime të DPT, duke cënuar kështu veprimtarinë e këtyre strukturave përgjegjëse për monitorimin e tyre.

-Nga auditimi i praktikave për lidhjen e akt-marrëveshjeve konstatohet se, në kërkesat e tatimpaguesve mungon vërtetësia e pamundësisë së situatës aktuale financiare, si dhe argumente nga ana e subjektit, që pavarësisht rrethanës financiare të vështirë, është në gjendje të zbatojë kushtet e marrëveshjes. Gjithashtu mungon dhe analiza e situatës ekonomike financiare të subjektit të realizuar nga vetë DTM, mbështetur në pasqyrat financiare të subjektit, gjendja e detyrimeve, kapitaleve të shoqërisë, aftësia qarkulluese e inventarit, likuiditetet etj.

-Nga auditimi konstatohet se **gjatë vitit 2021** rezultojnë të jenë lidhur 31 akt marrëveshje për 29 subjekte me vlerë totale të detyrimit prej 820,163,222<sup>15</sup> lekë. Deri në përfundim të këtyre akt marrëveshjeve rezultojnë të kenë përfunduar me sukses 19 prej tyre (363,679,932<sup>16</sup> detyrime të arkëtuara), ose rreth 44% e total detyrimeve për A.M e lidhura gjatë vitit 2022 të cilave u ka përfunduar afati dhe janë administruar nga DTM deri në fund të vitit, pra pa përfshirë AM e transferuara (ku vlera e tyre paraqitet 817,455,207 lekë)<sup>17</sup>. Për 10 akt marrëveshjet e zgjidhura nuk janë përmbytur të gjitha pagesat e dakortësuara, ku konkretisht nga totali i detyrimeve të lidhura për këto 10 akt marrëveshje në vlerën prej 444,798,882 lekë janë paguar 123,664,179 lekë dhe kanë mbetur pa paguar 320,955,859 lekë (rreth 72% e detyrimeve të tyre e mbetur pa paguar), 2 akt marrëveshje të 1 subjekti janë transferuar (me vlerë 2,708,015 mijë lekë). Në momentin e lidhjes së marrëveshjes janë paguar si

<sup>15</sup> Vlera e detyrimeve të AM sipas sistemit paraqitet në vlerën 821,439,171 lekë.

<sup>16</sup> Vlera totale e detyrimeve sipas AM paraqitet në shumën 372,656,325 lekë.

<sup>17</sup> Sipas sistemit vlera totale e detyrimeve për të cilat është lidhur AM paraqitet në shumën 835,685,180

kusht për lidhjen e marrëveshjes me këste në bazë të ligjit rreth 238,036,431 lekë.

- **Gjatë vitit 2022** rezultojnë të jenë lidhur 26 akt marrëveshje për 24 subjekte me vlerë totale të detyrimit prej 1,023,388,081<sup>18</sup> lekë. Deri në përfundim të këtyre akt marrëveshjeve rezultojnë të kenë përfunduar me sukses 9 prej tyre (234,763,745<sup>19</sup> detyrime të arkëtuara, ose rreth 28% e total detyrimeve për A.M e lidhura gjatë vitit 2022 të cilave u ka përfunduar afati (ku vlera e tyre paraqitet 838,818,917 lekë)<sup>20</sup>. Për 8 akt marrëveshjet e nuk janë përmbushur të gjitha pagesat e dakortësuara, ku konkretisht nga totali i detyrimeve për këto 8 akt marrëveshje në vlerën prej 604,555,814 lekë janë paguar 157,545,491 lekë dhe kanë mbetur pa paguar 443,375,944 lekë (rreth 74% e detyrimeve të tyre e mbetur pa paguar). 9 marrëveshje në vlerën 184,569,164 lekë janë ende në proces. Në momentin e lidhjes së marrëveshjes janë paguar si kusht për lidhjen e marrëveshjes me këste në bazë të ligjit rreth 278,363,812 lekë.

- Nga akt marrëveshjet e anuluar, për periudhën objekt auditimi rezultojnë edhe disa akt marrëveshje të lidhura për të njëjtat subjekte, si një mjet për mos aplikimin e masave të tjera shtrënguese pas përfundimit të afatit për marrëveshjet ekzistuese. Nga auditimi i praktikave për lidhjen e akt-marrëveshjeve konstatohen mangësi në kërkesat e tatimpaguesve në drejtim të vërtetimit të pamundësisë së situatës aktuale financiare, shoqëruar e argumente nga ana e subjektit që pavarësisht rrethanës financiare të vështirë, është në gjendje të zbatojë kushtet e marrëveshjes; mangësi në analizat e situatës ekonomike financiare të subjektit të realizuar nga vetë DTM mbështetur në pasqyrat financiare të subjektit, gjendja e detyrimeve, kapitaleve të shoqërisë, aftësia qarkulluese e inventarit, likuiditetet etj, sikundër përcakton pika 77.1 të Udhëzimit nr.24, datë 02.09.2008 dhe Nenit 18 të Rregullores së funksionimit të DTM për lidhjen e akt- marrëveshjes pika 2 “*Struktura përgjegjëse në DRT pasi merr në dorëzim kërkesat për marrëveshje i analizon ato duke përcaktuar riskun përkatës*”, dhe pika 3: “*Nëse plotëson kushtet pas analizës harton draft marrëveshjen përkatëse për pagesën me këste duke analizuar për të parë situatën nëse plotësohen kushtet e përcaktuara në ligjin e procedurave tatimore*”.

- Gjithashtu, për akt marrëveshjet e përsëritura, informacioni u vendos në dispozicion vetëm për periudhën pasi monitorimi i tyre ka kaluar në kompetencën e drejtorive të kontrollit pasi këto struktura nuk gjeneronin informacion të mëparshëm për këto akt marrëveshje për periudhën kur monitorimi i tyre kishte qenë nën mbikëqyrjen e drejtorive të mbledhjes së detyrimeve tatimore të papaguara, duke rezultuar kështu me mangësi në drejtim të dorëzimit të punës dhe materialeve përkatëse pas rishpërndarjes së përgjegjësiive. Gjithashtu, mungesa e informacionit të strukturës aktuale përgjegjëse për ndjekjen e akt marrëveshjeve, cënon efektivitetin e vendimmarrjes së saj lidhur me këto akt marrëveshje në momentin që nuk është vepruar duke vlerësuar dhe analizuar edhe historikun e mëparshëm të këtyre subjekteve, sikundër përcakton rregullorja e funksionimit të DRT, neni 18 pika 2 përcakton se “*struktura përgjegjëse në DRT pasi merr në dorëzim kërkesat për marrëveshje i analizon ato duke përcaktuar riskun përkatës*” dhe pika 3 “*nëse plotëson kushtet pas analizës harton draft marrëveshjen përkatëse për*

<sup>18</sup> Vlera e detyrimeve të AM sipas sistemit paraqitet në vlerën 1,019,736,664 lekë.

<sup>19</sup> Vlera totale e detyrimeve sipas AM paraqitet në shumën 234,263,103 lekë.

<sup>20</sup> Sipas sistemit vlera totale e detyrimeve për të cilat është lidhur AM paraqitet në shumën 835,685,180

*pagesën me këste duke analizuar për të parë situatën nëse plotësohen kushtet e përcaktuara në ligjin e procedurave tatimore”; gjithashtu udhëzuesi i përgjithshëm i procedurave të mbledhjes me forcë datë 15.03.2018 pika 10 përcakton se “Drejtoritë rajonale tatimore mund të lejojnë tatimpaguesit në çdo kohë dhe sa herë që është e nevojshme të lidhë marrëveshje të pagesës me këste, por, në të njëjtën kohë ai duhet të vërtetojë pamundësinë aktuale financiare, si dhe të tregojë që pavarësisht rrethanës financiare të vështirë, është në gjendje të zbatojë kushtet e marrëveshjes”. Për të gjykuar në lidhje me pamundësinë financiare mund të shërbejnë pasqyrat financiare të shoqërisë, gjendja e detyrimeve, kapitaleve të shoqërisë, aftësia qarkulluese e inventarit, likuiditetet etj;”.*

**Kriteri:** Ligji Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 78,  
Udhëzimi nr. 24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pika 78;  
Rregullore e Funkcionimit të Drejtorive Rajonale Tatimore dalë me Urdhrin Nr.192, datë 12.08.2020. të Ministrit të Financave, pika 2 dhe pika 3 e neni 18;  
Manual i mbledhjes me forcë.  
Udhëzimi nr. 24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar pika 78 e tij;  
Rregullorja e funksionimit të DRT, neni 18 pika 2;  
Udhëzuesi i përgjithshëm i procedurave të mbledhjes me forcë datë 15.03.2018 pika 10 .

**Ndikimi/Efekti:** Mangësi të konstatuara në monitorimin dhe zbatimin e Aktmarrëveshjeve  
**Shkaku:** Problematikat e konstatuara në legjislacionin në fuqi; Mangësi në analizat kryera për përmbushjen e kushteve të nevojshme të marrëveshjes dhe situatës; mangësi në procedurat e ndjekura pas ristrukturimit dhe ndryshimit të përgjegjësive për monitorimin e A.M.

**Rëndësia:** E lartë  
**Rekomandimi 5:** -Drejtori i DTM të marrë masat për përcjelljen pranë DPT të propozimit për parashikimin e procedurës së marrëveshjeve me këste të detyrimeve tatimore në aktet nënligjore miratuar prej saj, ose reflektimin e kësaj çështjeje në një dokument/manual të vetë institucionit, për t’u zbatuar nga strukturat përkatëse të kontrollit.  
-Strukturat përgjegjëse pranë DTM të marrin masat për kryerjen e analizave efektive përpara lidhjes së Akt-Marrëveshjeve duke shqyrtuar historikun dhe aftësinë paguese të tatimpaguesit; si dhe të forcojnë procedurat aktuale të ndjekura përgjatë monitorimit të zbatimit të tyre, me qëllim përmbushjen e kushteve dhe minimizimin e riskut të anulimit, apo përsëritjen e tyre , si një alternativë për të mos kaluar në masa të tjera shtrënguese.

**Titulli i gjetjes :** **Mungesa e planit operacional të Sektorit të Kontrollit nga Zyra**  
**Situata:** -Nga auditimi konstatohet se angazhimi i inspektoreve të kontrollit nga zyra dhe monitorimit në kryerjen e detyrave të tyre funksionale është raportuar nga DTM se mbështetet në Manualin e Kontrollit nga Zyra të miratuar në Tetor 2018. Ky angazhim nuk konkretizohet në hartimin dhe miratimin e një plani vjetor apo mujor mbi aktivitetin e sektorit, duke evidentuar kështu mangësi që përbëjë një risk për menaxhimin sa më efektiv të burimeve njerëzore për arritjen e objektivave nga hallkat mbikëqyrëse. Kalendarit pjesë e Manualit të Kontrollit nga Zyra parashikon që në muajin Janar Sektorët e Kontrollit nga Zyra “Hartojnë planin operacional vjetor si pjesë përbërëse e planit operacional të Drejtorisë së

*Kontrollit Tatimor” dhe “Përcaktojnë objektivat kryesore vjetore në luftën kundër informalitetit, objektiv bazë për realizimin e të ardhurave tatimore”. Nga auditimi konstatohet se një plan i tillë nuk është hartuar si në nivel Drejtorie Kontrolli, ashtu edhe në nivel institucional, sikundër trajtuar në pikën e të ardhurave të këtij programi auditimi.*

**Kriteri:** Ligji Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Rregullore e Funkcionimit të Drejtorive Rajonale Tatimore dalë me Urdhrin Nr.192, datë 12.08.2020 të Ministrit të Financave; Manuali i Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimi.

**Ndikimi/Efekti:** Problematika që ndikojnë në mbarëvajtjen normale të punës, si dhe risk të lartë për shmangie nga detyrimet tatimore.

**Shkaku:** Mungesa e planit institucional, pjesë përbërëse e të cilit është dhe plani i Sektorit të Kontrollit nga Zyra.

**Rëndësia:** E mesme

**Rekomandim** Strukturat përgjegjëse pranë DTM të marë masat për hartimin e planit operacional institucional pjesë e të cilit të jetë edhe plani i Drejtorisë së Kontrollit, me qëllim përcaktimin e objektivave kryesore vjetore në luftën kundër informalitetit, objektiv bazë për realizimin e të ardhurave tatimore në funksion të mbarëvajtjes normale të punës.

**Titulli i gjetjes :** **Mos dokumentim i procesverbaleve të gabimeve të kasës**

**Situata:** Nga auditimi i diferencave në të cilat të dhënat e kasës rezultojnë më të larta se sistemi u konstatuan 22 raste nga të cilat 1 subjekt është transferuar nga DRT në DTM në nëntor 2022. Për rastet e tjera, sipas informacionit verbal të sektorit diferenca vjen si pasojë e gabimeve në shtypjen e kasës, por ky sektor nuk ka administruar asnjë procesverbal që vërteton këtë situatë, pasi këto dokumentacione janë pjesë e punës së Sektorit të Kontrollit në Vend. Në vijim të kërkesave të vazhdueshme të grupit të auditimit pranë DTM për vendosjen në dispozicion të procesverbaleve përkatëse, këto dokumentacione nuk u përcollën deri në fund të fazës së auditimit në terren. Pas dorëzimit të akt konstatimeve, nga ana e DTM u dërguan dokumentacionet që vërtetonin kryerjen e verifikimeve të nevojshme nëpërmjet kontrolleve në vend për të gjitha rastet e subjekteve me diferenca sipas tabelës së mësipërme për vitin 2021. Për kodet ML01, ML05, ML09, ML13, që rezultojnë sipas databazës së përpunuar nga DPD me diferencat e trajtuara në këtë material, nuk disponohej informacion se kujt i referohen këto kode .

**Kriteri:** Ligji Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; 71 “E drejta për të përdorur mënyra alternative vlerësimi”

**Ndikimi/Efekti:** Mangësi në justifikimin e mos kryerjen e vlerësimeve alternative për këta subjekte sipas të ardhurave të vete deklaruara nga subjekti

**Shkaku:** Mos dokumentimi i verifikimeve të kryera për argumentimin/rregullimin e diferencave mes kasës dhe sistemit

**Rëndësia:** E mesme

**Rekomandim** Sektori i Kontrollit nga Zyra pranë DTM të marë masat për të kërkuar informacion lidhur me kodet që rezultojnë me diferenca sipas databazës së DPT, për të identifikuar shkaqet e diferencave.

Sektori i Kontrollit në Vend të dokumentojë procesverbalet e gabimeve të kasës për çdo rast të konstatuar me diferencë, dhe të përcjellë këtë informacion pranë Sektorit të Kontrollit nga Zyra.

**Titulli i gjetjes : Problematika të konstatuar në raportimin e të dhënave mes autoritetit doganor dhe atij tatimor**

**Situata:** Grupi i auditimit kërkoi vendosjen në dispozicion të të dhënave lidhur me deklarimin e importeve dhe eksporteve që rezultojnë nga autoriteti tatimor (DTM) duke i krahasuar ato me të dhënat që rezultojnë të raportuara nga autoriteti doganor (DPD). Nga kryqëzimi i të dhënave sipas situatës financiare të TVSH-së, librat e blerjes dhe të shitjes me të dhënat e deklaruara sipas doganës janë konstatuar diferenca në të dy kahet.

**Në import**

- Rastet kur vlera e deklaruar sipas tatimeve është më e madhe se ajo sipas doganave.

Nr Subjektsh <sup>21</sup>	Vlera e deklaruar sipas tatimeve	Vlera e deklaruar sipas doganave	Diferenca
370	73,991,803,925	72,250,256,543	1,741,547,382

Burimi: DTM

- Rastet kur vlera e deklaruar sipas tatimeve është më e vogël se ajo sipas doganave.

Nr Subjektsh <sup>22</sup>	Vlera e deklaruar sipas tatimeve	Vlera e deklaruar sipas doganave	Diferenca
177	5,747,958,137	6,339,238,663	(591,280,526)

Burimi: DTM

**Në eksport**

- Rastet kur vlera e deklaruar sipas tatimeve është më e madhe se ajo sipas doganave.

Nr Subjektsh <sup>23</sup>	Vlera e deklaruar sipas tatimeve	Vlera e deklaruar sipas doganave	Diferenca
208	46,911,372,209	106,107,865,332	(59,196,493,123)

Burimi: DTM

- Rastet kur vlera e deklaruar sipas tatimeve është më e vogël se ajo sipas doganave.

Nr Subjektsh <sup>24</sup>	Vlera e deklaruar sipas tatimeve	Vlera e deklaruar sipas doganave	Diferenca
153	142,675,823,060	107,983,349,651	34,692,473,409

Burimi: DTM

Diferencat që kanë lindur mes dy deklarimeve, konstatohet se janë verifikuar dhe analizuar nga inspektorët përkatës për të gjitha rastet duke identifikuar dhe shkaqet përkatëse. Nga shkresat e përcjella rezultojnë se diferenca më të mëdha ekzistojnë për shkak të deklarimit jo të saktë nga ana e doganës, e cila nuk ka raportuar disa deklarata doganore të cilat faktikisht nga DTM disponohen dhe janë cituar në informacionet e vendosura në dispozicion. Si rezultat konstatohet se ky fenomen vjen si pasojë e deklarimit jo të njëjtë mes dy institucioneve, duke përbërë kështu një risk për ekzistencën e një anomalie të sistemeve; apo pasaktësi për shkak të modulit të aplikuar në sistemin C@TS në momentin e gjenerimit të të dhënave nga DPD. Kjo problematikë nuk është dokumentuar në korrespondencat mes DTM dhe DPT, dhe nuk rezultojnë të jenë ndërmarrë iniciativat e nevojshme për verifikimin e shkakut të diferencave, me qëllim kryerjen e veprimeve të nevojshme në sistem. Si rezultat i anomalive në sistem, procesi i verifikimeve nga ana e administratës tatimore për justifikimin e diferencave nëpërmjet deklaratave fizike doganore të përcjella nga tatimpaguesit, shoqërohet me një punë të shtuar nga ana e personelit tatimor, për të konkluduar në të njëjtat deklarime.

<sup>21</sup> Mbi 1000 lekë

<sup>22</sup> Mbi 1000 lekë

<sup>23</sup> Mbi 1000 lekë

<sup>24</sup> Mbi 1000 lekë



<b>Kriteri:</b>	Ligji Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; 71 “E drejta për të përdorur mënyra alternative vlerësimi”
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Procesi i verifikimeve nga ana e administratës tatimore për justifikimin e diferencave nëpërmjet deklaratave fizike doganore të përcjella nga tatimpaguesit, shoqërohet me një punë të shtuar nga ana e personelit tatimor, për të konkluduar në të njëjtat deklaratime.
<b>Shkaku:</b>	Deklarimit jo i saktë nga ana e doganës, e cila nuk ka raportuar disa deklarata doganore të cilat faktikisht nga DTM disponohen dhe janë cituar në informacionet e vendosura në dispozicion; risk për ekzistencën e një anomalie të sistemeve; apo pasaktësi për shkak të modulit të aplikuar në sistemin C@TS në momentin e gjenerimit të të dhënave nga DPD.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë
<b>Rekomandim</b>	Strukturat përgjegjëse pranë DPT në bashkëpunim me DPD dhe AKSHI-n, të ngrenë një grup pune me përfaqësues nga këto institucione, me qëllim verifikimin e shkaqeve që kontribuojnë në finalizimin me rezultate të ndryshme mes deklaratimeve të DPT dhe DPD, me qëllim ndërmarrjen më pas të veprimeve rregulluese në sistem, për të minimizuar angazhimin jo efektiv të punonjësve të kontrollit nga zyra për të kryer verifikimet e nevojshme për këto diferenca të cilat konsistojnë kryesisht për shkak të mangësive në raportimin e të dhënave në sistem ku nuk pasqyrohen disa deklarata doganore.
<b>Titulli i gjetjes</b>	<b>Mbi procedurën e ndjekur për rishikimin e kësteve të tatim fitimit</b>
<b>Situata:</b>	<p>- Nga verifikimi i korrespondencave për rishikimin e kësteve të tatim fitimit konstatohet se miratimi i kërkesave për rishikimin e kësteve të tatim fitimit është kryer pa dokumentuar kryerjen e një analize dhe monitorimi të plotë, veçanërisht në drejtim të nivelit të qarkullimit të shitjeve, ku mbartet edhe risku i rritjes së xhiros por i uljes së tatim fitimit.</p> <p>- Nga auditimi konstatohet se sistemi C@ts nuk mundëson <u>aplikimin automatik të penaliteteve</u> për tatimpaguesit që kanë likuiduar me vonesë <u>këstet e parapagimeve të tatim fitimit</u>, dhe si rezultat ky proces monitorohet manualisht nga inspektorët e sektorit të kontrollit nga zyra. Për këtë çështje nuk dokumentohen iniciativa të administratës tatimore për shqyrtimin dhe vlerësimin e mundësive në drejtim të kryerjes së ndryshimeve në sistemin C@ts për këtë opsion.</p> <p>-Gjithashtu, nga auditimi konstatohet se sistemi C@ts për këtë proces është dizenuar në një mënyrë të tillë që pagesa e tatimpaguesit për këstin do të shkojë për detyrimin më të hershëm të tij, <u>pavarësisht periudhës për të cilën po kryhet likuidimi</u>. Si rezultat, në rastet kur subjektet janë paralizuar njëherë për mos pagesë në vonesë të këstit, në momentin e likuidimit të këstit pasardhës, kjo pagesë do të shkojë për mbulimin e detyrimit të parë, dhe për periudhën që ai po kryhen në kohë pagesën, do të rezultojë sërish me vonesë dhe do të jetë objekt penalizmi. Përgjatë këtu bëjnë rastet kur pagesa do të mbulojë këstet e të dyja periudhave. I njëjti fenomen rezulton edhe për rastet kur kryhen <u>rivlerësimet e kësteve</u> nga tatimpaguesit. Rivlerësimi i kësteve të tatim fitimit nuk pasqyrohet në sistemin c@ts, sipas akt-vlerësimeve të mbajtura nga inspektorët përgjegjës për çdo tatimpagues, dhe si rezultat ky dokumentacion administrohet nga vetë sektori nëpërmjet shkresave përkatëse fizike. Si rezultat, ky proces rezulton të jetë subjektiv, dhe me vështirësi për tu monitoruar lidhur me saktësinë e vlerësimit të kërkesës për korrektim të këstit, dhe transparencës apo standardizimit të këtij procesi.</p>
<b>Kriteri:</b>	Ligji nr.8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Neni 3 “Parapagimet”, pika 5, u verifikuan rishikimet e kryera për uljen e kësteve të tatim fitimit për periudhën objekt auditimi. Neni 3 “Parapagimet”, pika 5 citon se: “Në

*rastin kur tatimpaguesi, në çdo kohë, vërteton para organeve tatimore se tatimi mbi fitimin për këtë periudhë tatimore do të jetë, në mënyrë domethënëse, më i ulët se tatimi mbi fitimin në periudhën paraardhëse ose periudhën e dytë paraardhëse, atëherë organet tatimore pranojnë zvogëlimin e parapagimeve, sipas rregullave të vendosura me udhëzim të Ministrit të Financave. Në rast se subjekti ka ulur këstet e parapagimit, të caktuara nga organi tatimor, dhe detyrimi tatimor vjetor për tatimfitimin, që rezulton nga bilanci, tejkalon parapagimin me më shumë se 10%, subjekti duhet të paguajë kamatëvonesa mbi diferencën ndërmjet detyrimit real vjetor dhe shumës së parapaguar gjatë vitit, sipas rregullave të vendosura me udhëzim të Ministrit të Financave”.*

Udhëzimi Nr.5, datë 30.01.2006 “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, i ndryshuar, pika 3.13. “Parapagimet”, çështja 3.13.3 “Korrigjimi në ulje i kësteve mujore të paradhënies të tatimit mbi fitimin” citon se: “Si fakte të cilat mund të argumentojnë kërkesën për uljen e kësteve mujore të paradhënies të tatimit mbi fitimin mund të merren:

- Shitjet gjithsej të realizuara dhe të deklaruara nga tatimpaguesi, për muajt e kaluar të vitit vijues, në raport me shitjet gjithsej të dy viteve të mëparshme. Nëse këto shitje janë ulur në mënyrë të dukshme, administrata tatimore pranon uljen e kësteve proporcionalisht me uljen e vëllimit të shitjeve.

- Mungesa në vijim e kontratave të shitjes së mallrave apo shërbimeve, kontratave të punimeve etj., të cilat do ta reduktojnë në mënyrë domethënëse veprimtarinë dhe të ardhurat e tatimpaguesit për muajt e mbetur të vitit vijues për të cilin kërkohet reduktimi i kësteve mujore të paradhënies të tatimit mbi fitimin.

- Mbarimi i kontratave mbi bazën e të cilave janë realizuar të ardhurat në vitet e mëparshme, përfundimi i objekteve apo punëve të tjera publike të kryera.

-Fatkeqësi apo dëme të tjera që mund t'i kenë ndodhur tatimpaguesit gjatë vitit vijues dhe që do të çojnë në uljen e volumit të veprimtarisë së tij ekonomike.

- Mbyllja e linjave, veprimtarive të caktuara, shkurtimi i ndjeshëm i fuqisë punëtore si rezultat i tkurrjes së veprimtarisë.

“Me dorëzimin e deklaratës vjetore të tatimit mbi fitimin, në rast se detyrimi tatimor vjetor për tatimin mbi fitimin tejkalon shumën e paguar të kësteve mujore të paradhënies të tatimit mbi fitimin me më shumë se 10 për qind, tatimpaguesi detyrohet të paguajë kamatëvonesë, e cila llogaritet në masën 5 për qind për diferencën ndërmjet detyrimit vjetor sipas deklaratës vjetore të tatimit mbi fitimin dhe shumës totale të kësteve mujore të paradhënies të tatimit mbi fitimin të paguara gjatë vitit”.

Manuali i Kontrollit nga Zyra, pika 11.4 “Regjistrimi i kësteve të rishikuara të parapagesave të tatimit mbi fitimin”, përcakton se: “Në rastet kur tatimpaguesi kërkon rishikimin në ulje të kësteve të tatim fitimit dhe inspektori i kontrollit nga zyra bindet ndaj argumenteve të paraqitura nga tatimpaguesi, bën korrigjimin e kësteve në ulje në bazë të dokumentacionit të paraqitur”.

**Ndikimi/Efekti:** Procesi rezulton të jetë subjektiv, dhe me vështirësi për tu monitoruar lidhur me saktësinë e vlerësimit të kërkesës për korrigjim të këstit, dhe transparencës apo standardizimit të këtij procesi.

**Shkaku:** Mangësive në dizenjimin e proceseve të punës në sistemin C@TS

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandim** - Strukturat përgjegjëse pranë DTM në bashkëpunim me DPT të marrin masat për vlerësimin e problematikave të mësipërme, me qëllim vlerësimin e zgjidhjeve optimale në sistemin C@TS për të kryer ndryshimet e nevojshme në drejtim të procedurave të aplikueshme për efekt të aplikimit automatik të penaliteteve për tatimpaguesit që kanë likuiduar me vonesë këstet e parapagimeve të tatim fitimit,

pagesës së tatimpaguesit për këstin do të shkojë për detyrimin më të hershëm të tij, rivlerësimeve të kësteve apo edhe proporcionalitetit të parapagimeve të kësteve të tatim fitimit krahasimisht me tatim fitimin e periudhës.

- Strukturat përgjegjëse pranë DTM të marrin masat për të përmirësuar procesin e punës së ndjekur lidhur me miratimin e kërkesave për rishikimin e kësteve të tatim fitimit për të dokumentuar kryerjen e një analize dhe monitorimi të plotë, veçanërisht në drejtim të nivelit të qarkullimit të shitjeve, ku mbartet edhe risku i rritjes së xhiros por i uljes së tatim fitimit, duke përfshirë në këtë proces edhe aksesin në informacion për çështje specifike edhe të strukturave të tjera pranë DTM, për të mundësuar një vendimmarrje sa më të drejtë të sektorit të kontrollit nga zyra për këtë çështje.

<b>Titulli i gjetjes :</b>	<b>Problematika të konstatuara lidhur me subjektet që nuk kanë dorëzuar pasqyrat financiare, pavarësisht rikujtesave të DTM dhe penalizimit të tyre</b>
<b>Situata:</b>	- Nga auditimi i diferencave të konstatuara lidhur me deklaratimet e TF dhe TVSH u konstatua se në disa raste nga ana e sektorit edhe pse ishin ndërmarrë iniciativat për njoftimin e tatimpaguesve për dorëzimin e pasqyrave financiare në përmbushje të afateve përkatëse, nuk ishte plotësuar ky detyrim nga ana e subjekteve. Konkretisht, rezultojnë 11 subjekte që nuk kanë dorëzuar pasqyrat financiare të vitit 2021 dhe 37 subjekte që nuk kanë dorëzuar pasqyrat financiare të vitit 2022. Kjo situatë konstatohet se ka cënuar përmbushjen e detyrave të sektorit në drejtim të kryerjes së verifikimeve të nevojshme sipas zërave të pasqyrave, për të justifikuar diferencat, duke konkluduar kështu me propozimet e sektorit nga zyra për përfshirjen e këtyre subjekteve për kontroll në vend.
<b>Kriteri:</b>	Ligji 8438 "Per Tatimin mbi te ardhurat", neni 29; Manuali i kontrollit nga Zyra, kapitulli "Procedurat e shqyrtimit të treguesve të pasqyrave e financiare dhe analiza"
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Mos krijimi i kushteve të nevojshme për kryerjen e verifikimeve nga ana e DTM lidhur me situatën financiare të subjektit
<b>Shkak:</b>	Mos respektimi i detyrimit ligjor nga ana e subjekteve për dorëzimin e pasqyrave financiare.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë
<b>Rekomandim</b>	- Strukturat përgjegjëse pranë DTM të marrin masat për hartimin e programeve të kontrollit tematik të Drejtorisë së Kontrollit, me qëllim verifikimin e diferencave të konstatuara për subjektet që nuk kanë dorëzuar pasqyrat financiare, pavarësisht tejkalimit të afateve ligjore dhe rikujtesave të përcjella nga institucioni.

<b>Titulli i gjetjes:</b>	<b>Numri i lartë i vakancave në strukturën e DTM</b>
<b>Situata:</b>	Nga auditimi u konstatuan mangësi në drejtim të plotësisht të strukturës së DTM, situatë kjo që mbart riskun për të cënuar përmbushjen me sukses të detyrave funksionale të drejtorisë, ku konkretisht: - Sipas strukturës organizative të miratuar për DTM, Sektori i Kontrollit nga Zyra është planifikuar të funksionojë si një sektor me 10 inspektorë dhe 1 Përgjegjës Sektor, pjesë e Drejtorisë së Kontrollit. Në fillim të vitit 2021 Struktura e Sektorit të Kontrollit nga zyra paraqitet me 1 vakancë në pozicionin e inspektorit, i cili më pas është plotësuar deri në fund të vitit 2021. Deri në fund të vitit 2022, struktura paraqitet me 2 vakanca në pozicionet e inspektorëve për shkak të transferimit të 2 inspektorëve pranë DRT Tiranë sipas shkresës së DPT nr. 9147, prot datë 28.10.2022 "Për angazhimin në kryerjen e kontroleve pranë DRT-Tiranë". - Drejtorja e Analizës, Riskut dhe Kontabilitetit të të Ardhurave përbëhet nga Sektori

i Analizës së Riskut dhe Sektori i Kontabilitetit. Nga auditimi konstatohet se pozicioni i Drejtorit të Drejtorisë përgjatë vitit 2021 dhe 2022 ka qenë vakant, faktor ky që përbën një risk të shtuar në drejtim të garantimit të arritjeve të objektivave dhe detyrimeve të drejtorisë.

Sektori i Analizës dhe Kontabilitetit ka funksionuar në strukturë me 3 persona, nga të cilët 1 përgjegjës sektori dhe 2 specialistë. Përgjatë vitit 2021 struktura ka qenë e plotë, ndërsa deri në fund të vitit 2022 paraqitet me vakancë të pozicionit të përgjegjës të sektorit, i cili është transferuar në DRT Tiranë në vijim të shkresës nr. 9504, prot datë 11.11.2022 të DPT.

Sektori i Analizës së Riskut sipas strukturës organizative është planifikuar të funksionojë si një sektor me 1 përgjegjës dhe 4 inspektorë. Përgjatë vitit 2021 ka funksionuar pa përgjegjës sektori si dhe gjatë 6 mujorit të parë me 1 vakancë, dhe në 6 mujorin e dytë me 2 vakanca. Deri në fund të vitit 2022 sektori paraqitet me vakanca në 2 inspektorë.

<b>Kriteri:</b>	Urdhri i Kryeministrit nr. 33, datë 12.02.2020 “Për miratimin e strukturës organizative të personelit të Administratës Tatimore Qendrore”.
<b>Ndikimi:</b>	Cënim i performances së strukturave dhe përbushjes së objektivave institucionale.
<b>Shkaku</b>	Numri i lartë i transferimeve në struktura të tjera pranë DPT.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë
<b>Rekomandimi:</b>	Titullari i DTM, në bashkëpunim edhe me DPT, të marrë masa për plotësimin e vendeve vakante, pjesë të shërbimit civil sipas pozicioneve të miratuara në Urdhrin e Kryeministrit nr. 33, datë 12.02.2020 “Për miratimin e strukturës organizative të personelit të Administratës Tatimore Qendrore”.

### **2. 3. Mbi vlerësimin e përputhshmërisë ligjore të veprimtarisë së Drejtorisë së Shërbimeve të Tatimpaguesve**

Në zbatim të pikës 3 të programit të auditimit nr. 14/1 prot, datë 09.01.2023, u auditua dokumentacioni si më poshtë:

- *Struktura e miratuar*
- *Klasifikimi i subjekteve (aktiv/pasiv/ të regjistruar/të ç’regjistruar/të pezulluar etj.) për periudhën objekt auditimi*
- *Vërtetimet që janë lëshuar për subjektet në lidhje me detyrimet*
- *Të dhëna dhe evidenca të tjera statistikore mbi veprimtarinë e kësaj Drejtorie*

Drejtorja e Shërbimit të Tatimpaguesve (këtu e më poshtë DSHT) si pjesë përbërëse e DTM-së, është e organizuar dhe funksionon në zbatim të Rregullores së funksionimit të Administratës Rajonale Tatimore, miratuar me Urdhrin nr. 192, datë 12.08.2020.

DSHT për periudhën e auditimit 01.01.2021-31.12.2022, në zbatim të detyrave funksionale është fokusuar kryesisht në përpunimin e kërkesave për vërtetime, dhënien e asistencës, dhënien e fjalëkalimeve, dërgimin e njoftimeve subjekteve të ndryshme, edukimin dhe informimin e subjekteve me bazën ligjore.

#### **Struktura**

DSHT për periudhën objekt auditimit ka të miratuar në strukturë 7 punonjës: 1 Drejtor Drejtorie, 2 përgjegjës sektori, 4 specialistë, dhe ka funksionuar me 2 Sektorë:

- *Sektori i Asistencës dhe Regjistrimit*, i përbërë nga një Përgjegjës Sektori dhe dy Specialistë, fokusuar kryesisht në administrimin e mirëmbajtjen e regjistrit të tatimpaguesve etj.;

- *Spektori i Edukimit dhe Marrëdhënieve me Publikun*, i përbërë nga një Përgjegjës Spektori dhe dy Specialistë, fokusuar në informimin e shpejtë dhe të saktë të tatimpaguesve në lidhje me ndryshimet ligjore, administrimin dhe zgjidhjen e problemeve të ndryshme teknike brenda një periudhe sa më të shpejtë.

- Një ndër detyrat funksionale DSHT është pranimi dhe përpunimi i kërkesave të tatimpaguesve të regjistruar dhe individëve, në zbatim të Manualit të Shërbimeve për tatimpaguesit dhe individët. Në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit Nr. 158, datë 25.11.2019 “Për marrjen e masave dhe rregullimin e dispozitave ligjore për aplikimin e shërbimeve vetëm online nga data 1.1.2020”, DSHT ka nisur procedurën e shërbimit të tatimpaguesit online.

- Gjithashtu DSHT, në kuadër të përmbushjes së detyrave thelbësore funksionale dhe në përgjigje të kërkesave të individëve apo subjekteve të ndryshme, për periudhën e auditimit ka përpunuar manualisht vërtetime për rastet e poshtëlistuara (të cilat nuk janë mundësuar on-line):

**a- Vërtetime standarde:**

- Vërtetime ESIG03/A për punëmarrës të huaj.

- Vërtetime Form4 për subjekte me detyrime për të cilat subjekti kërkon përfshirjen e komentit për llojin e detyrimit (gjobe, principal) apo statusin e këtij detyrimi.

- Vërtetime Form4 dhe Form ESIG 01/A, Form ESIG 02/A për subjekte me pagesa jo të përputhura në sistem.

- Vërtetime xhiro për vitet e fundit FORM 6, për rastet kur për çështje tenderimi kërkohet xhiro për një afat kohor më të madh se 3 vjet dhe rastet kur kërkohet xhiro e vitit aktual.

Vërtetimet standard të lëshuara për vitet 2021-2022, referuar aneksit 1 dhe 2, Seksioni Aneke, janë 1741 në total që i përkasin kërkesave të paraqitura, të cilat janë plotësuar dhe trajtuar rregullisht. Numrin më të lartë të vërtetimeve të lëshuara sipas llojit e zënë “Formulari E-sig 03/A” (Vërtetim për kontributet individuale të punonjësve) dhe “Formulari 4” (Vërtetim për pagesën e detyrimeve tatimore).

Përkatesisht sipas viteve:

**2021**, numrin më të lartë të aplikimeve për vërtetime e zënë ato të llojit “Formulari E-sig 03/A” (Vërtetim për kontributet individuale të punonjësve) për të cilin janë lëshuar 673 vërtetime, pasuar nga vërtetimet për pagesën e detyrimeve tatimore “Formulari 4” me 189 vërtetime të lëshuara, Vërtetime xhiro për 3 vitet e fundit për tender “Formulari 6” me 90 vërtetime të lëshuara.

**2022**, lëshuar gjithsej 469 vërtetime për “Formulari E-sig 03/A”, pasuar nga 193 vërtetime për “Formulari 4”.

**b- Vërtetime/konfirmime të tjera**, të cilat nuk janë të përfshira në llojet standarde të vërtetimeve që gjenerohen on-line, si p.sh.: konfirmime librash shitje/blerje, konfirmime të pasqyrave financiare, konfirmim për pagesat e tatimit në burim, vërtetime për individë referuar TAP dhe jo kontributeve, etj. Më poshtë paraqitet evidenca sipas muajve respektive dhe viteve dhe progresive:

**Tabela nr. 1** “Konfirmime dhe shkresa, viti 2021”

Konfirmime/shkresa të evaduara	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Total
1 Konfirmime (PF, LIBRA Shitje/blerje, tatime në burim. Etj)	42	181	99	205	83	120	75	62	67	60	72	63	1129
2 Kthim përgjigje për palët e treta	19	51	33	34	12	19	32	22	18	24	16	13	293

Burimi: DSHT/DTM

**Tabela nr. 2** “Konfirmime dhe shkresa, viti 2022”

Konfirmime/shkresa të evaduara	Jana r	Shkur t	Mar s	Pril l	Ma j	Qersh o r	Korri k	Gush t	Shtato r	Teto r	Nënto r	Dhjet o r	Tota l
1 Konfirmime (PF, LIBRA Shitje/blerje, tatime në burim, vërtetim per TAP, etj)	86	158	134	198	124	101	88	77	89	62	60	83	1260
2 Kthim përgjigje për palët e treta	19	17	22	15	22	26	18	23	15	21	14	19	231

Burimi: DSHT/DTM

Sipas të dhënave më sipër rezulton se gjatë vitit 2022 janë dhënë 1260 konfirmime në krahasim me 1129 të dhëna gjatë vitit 2021, pra më shumë, ndërkohë kthim përgjigje për palët e treta ka rënie nga viti 2022 me 231 raste, në krahasim me vitin 2021 me 293 raste.

**Ndërkohë nga portali e-Albania gjenerohen këto vërtetime:**

- Vërtetim xhiro për 3-vjeçarin e fundit për subjektet
- Vërtetim Kontributeve për subjektin
- Vërtetim Kontributeve për individin
- Vërtetim përgjegjësive tatimore etj.

▪ **Çështje të trajtuara nëpërmjet portalit qeveritar**

Volumi i çështjeve të adresuara nëpërmjet portalit qeveritar të cilat janë trajtuar nga Drejtoria e Shërbimit të Tatimpaguesve të Mëdhenj pasqyrohet më poshtë:

**Tabela nr. 3** “Çështje të trajtuara nëpërmjet portalit qeveritar, viti 2021”

Çështje të trajtuara nëpërmjet portalit qeveritar (SQDNE) viti 2021												
Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Total
36	38	42	53	49	75	78	61	69	60	58	59	678

Burimi: DSHT/DTM

**Tabela nr. 4** “Çështje të trajtuara nëpërmjet portalit qeveritar, viti 2022”

Çështje të trajtuara nëpërmjet portalit qeveritar (SQDNE) viti 2022												
Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Total
56	33	63	59	50	110	73	43	27	1	12	23	461

Burimi: DSHT/DTM

Referuar të dhënave më sipër rezulton se numri i çështjeve të trajtuara nga viti në vit ka rënë, nga 678 çështje për vitin 2021 në 461 çështje në vitin 2022, apo 32 % më pak.

Gjithashtu DSHT gjatë periudhës së auditimit ka ushtruar funksionet e saj në drejtim të njoftimit të tatimpaguesve me qëllim parandalimin e mashtrimit dhe nxitjen e korrektimit vullnetar, organizmin e seminareve edukues, si dhe asistimin ballë për ballë për çdo paqartësi mbi legjislacionin dhe procedurat. Më poshtë paraqiten treguesit për periudhën 01.01.2021-31.12.2022:

**Tabela nr. 5** “Treguesit e performancës, viti 2021”

Treguesit e performancës 2021	Jana r	Shkur t	Mar s	Prill	Maj	Qersh o r	Korri k	Gush t	Shtato r	Teto r	Nënto r	Dhjet o r	Total
Numri i njoftimeve i dërguar tatimpaguesve me qëllim parandalimin e	880	1525	1226	1070	11729	874	1225	874	0	874	165	68	20510

mashtirimit dhe nxitjen e korrektimit vullnetar.													
<b>Numri i seminareve edukues të realizuar</b>	5	7	1	2	4	7	0	0	0	0	0	0	26
<b>Numri total i taksapaguesve i asistuar (ballë për ballë)</b>	198	201	200	332	203	77	188	138	134	134	165	155	2125

Burimi: DSHT/DTM

**Tabela nr. 6 “Treguesit e performancës, viti 2022”**

<b>Treguesit e performancës sipas Planit Strategjik të DPT 2017-2021</b>	<b>Jana r</b>	<b>Shku rt</b>	<b>Mar s</b>	<b>Pril l</b>	<b>Ma j</b>	<b>Qersho r</b>	<b>Korri k</b>	<b>Gush t</b>	<b>Shtato r</b>	<b>Teto r</b>	<b>Nënto r</b>	<b>Dhjeta r</b>	<b>Tota l</b>
<b>Numri i njoftimeve të dërguar tatimpaguesve me qëllim parandalimin e mashtirimit dhe nxitjen e korrektimit vullnetar.</b>	0	0	877	877	877	877	877	0	877	1754	255	1852	9123
<b>Numri total i taksapaguesve i asistuar (online)</b>	168	273	189	281	171	157	112	113	143	136	119	135	1997

Burimi: DSHT/DTM

Referuar të dhënave më sipër rezulton se në vitin 2021 janë bërë 20510 njoftime për parandalimin e mashtirimit dhe nxitjen e korrektimit vullnetar, ndërkohë në vitin 2022 janë 9123 raste, apo 55 % më pak, në vitin 2021 janë asistuar ballë për ballë 2125 taksapagues, ndërkohë në vitin 2022 janë asistuar 1997 taksapagues apo 6 % më pak, gjatë vitit 2021 janë organizuar 26 seminare edukues, ndërkohë gjatë vitit 2022 asnjë seminar.

▪ **Regjistrimi dhe ndryshimi i të dhënave të tatimpaguesit në sistemin C@TS**

Spektori Asistencës dhe Regjistrimit në DSHT ka ndjekur në vijimësi pasqyrimin e kërkesave të tatimpaguesve referuar regjistrimit dhe ndryshimeve në regjistrim të të dhënave, në zbatim të manualit të kësaj Drejtorie. Konkretisht, ka ofruar:

- Regjistrimin e kontakteve me tatimpaguesit në C@TS
- Asistencë për hedhjen e të dhënave të adresave sipas njoftimit në faqen zyrtare të datës 3.11.2020 dhe në varësi të kërkesave / e-maileve të subjekteve.
- Ka azhurnuar të dhënat e regjistrimit për subjekte në administrim të saj, sipas kërkesave.

Në lidhje me regjistrimin e kontakteve me tatimpaguesit në C@TS, më poshtë pasqyrohen regjistrimet e çështjeve të mbyllura nga punonjësit e DSHT-së si për kontaktet e krijuara nga tatimpaguesit nëpërmjet e-filing, po ashtu edhe nga punonjësit e shërbimit:

**Tabela nr. 7 “Kontakte të regjistruara, viti 2021”**

Kontakte të regjistruara nëpërmjet çështjeve në C@ts	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Total
Kontakte të regjistruara nëpërmjet rubrikës "Pyetje e Përgjithshme" - krijuar nga tatimpaguesi	111	150	188	115	154	380	166	90	90	427	94	124	2089
Kontakte të regjistruara nëpërmjet rubrikës "Çështje e Përgjithshme" - krijuar nga inspektori Shërbimit	0	214	206	11	345	163	0	26	0	46	0	0	1011

Burimi: DSHT/DTM

**Tabela nr. 8 “Kontakte të regjistruara, viti 2022”**

Kontakte të regjistruara nëpërmjet çështjeve në C@ts	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Total
Çështje të trajtuara nëpërmjet rubrikës "Pyetje e Përgjithshme" - krijuar nga tatimpaguesi	221	72	271	253	303	512	205	155	163	450	218	149	2972

Burimi: DSHT/DTM

✓ Më poshtë pasqyrohen ndryshimet në të dhënat për regjistrim sipas viteve:

**Tabela nr. 9 “Ndryshimi i të dhënave të regjistruara, viti 2021”**

Pasqyrimi i ndryshimeve në regjistrim	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Total
Azhornim të dhënash regjistrimi	1	20	2	2	2	1	4	2	3	4	2	3	46
Shtim përgjegjësish tatimore	0	5	0	0	1	1	0	2	0	1	0	2	12

Burimi: DSHT/DTM

**Tabela nr. 10 “Ndryshimi i të dhënave të regjistruara, viti 2022”**

Pasqyrimi i ndryshimeve në regjistrim	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Total
Azhornim të dhënash regjistrimi	1	1	12	14	0	0	1	0	0	0	0	0	29
Shtim përgjegjësish tatimore	0	1	0	1	1	0	1	0	0	1	0	2	7

Burimi: DSHT/DTM

Referuar të dhënave më sipër rezulton se kontaktet e regjistruara nëpërmjet rubrikës "Pyetje e Përgjithshme", krijuar nga tatimpaguesi, për vitin 2021 janë 2089 raste, ndërsa për vitin 2022 janë 2972, pra ka rritje të kontakteve të regjistruara, ndërkohë që kontakte të krijuara nga tatimpaguesi për vitin 2021 janë 1011 raste, ndërsa për vitin 2022 nuk ka asnjë rast. Azhornimi i të dhënave të regjistrimit për vitin 2021 janë 46 raste, ndërkohë për vitin 2022 janë 29 raste.

▪ **Regjistri i Tatimpaguesve**



Regjistri i Tatimpaguesve, administrohet nga kjo drejtori dhe evidenton subjektet e rinj, siguron kontaktet me tatimpaguesit për të garantuar një data bazë të saktë, mbi regjistrimin/ndryshimin e përgjegjësive tatimore të tatimpaguesve, çregjistrimet në kohë të subjekteve etj.

Të dhënat mbi Regjistrin e subjekteve “Tatimpagues të Mëdhenj” për periudhën 01.01.2021-31.12.2022, paraqiten si më poshtë:

**Tabela nr.11** “Regjistri i subjekteve Tatimpagues të Mëdhenj, me datë 31.12.2021”

Statusi	Nr. i subjekteve sipas statusit											
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
Aktiv	879	878	877	875	874	874	874	873	873	873	871	<b>871</b>
Pasiv	9	10	11	12	13	13	13	14	14	14	14	<b>14</b>
Çregjistruar	105	106	107	107	107	107	107	107	107	107	108	<b>109</b>
Kërkesë për çregjistrim	16	15	14	15	15	15	15	15	15	15	16	<b>15</b>

Burimi: DSHT/DTM

**Tabela nr.12** “Regjistri i subjekteve Tatimpagues të Mëdhenj, me datë 31.12.2022”

Statusi	Nr. i subjekteve sipas statusit											
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
Aktiv	870	870	869	868	867	866	866	865	865	929	924	<b>920</b>
Pasiv	15	15	16	16	17	17	17	18	18	12	12	<b>12</b>
Çregjistruar	109	109	109	109	109	109	109	109	109	110	110	<b>110</b>
Kërkesë për çregjistrim	15	15	15	16	16	17	17	17	17	17	17	<b>18</b>

Burimi: DSHT/DTM

Referuar të dhënave më sipër konstatohet se gjatë vitit 2022 numri i subjekteve aktiv është më i lartë se në vitin 2021, përkatësisht 920 subjekte në vitin 2022 nga 871 subjekte për vitin 2021, ndërkohë që është ulur numri i subjekteve pasiv, 12 subjekte në vitin 2022 nga 14 subjekte për vitin 2021.

#### ▪ Regjistri i subjekteve pasiv në DTM

##### - Viti 2021

Përgjatë vitit 2021 ka pasur në total 5 kalime të subjekteve nga statusi “Aktiv” në “Pasiv”. Numri total i subjekteve pasive në DTM me datë 31.12.2021 ka qenë 14, sipas tabelës më poshtë:

**Tabela nr. 13** “Lista e subjekteve pasive në DTM me datë 31.12.2021”

Nr.	Nipt-i	Emërtimi I subjektit	Statusi	Data e statusit
1	J.P	A.SH	Pasiv	01/07/2020
2	L.M	S.P.A	Pasiv	26/05/2019
3	K.L	A.	Pasiv	31/12/2020
4	K.K	G.I	Pasiv	30/03/2020
5	L.T	S.C.T.	Pasiv	26/11/2019
6	L.A	S.P.A	Pasiv	26/04/2019
7	L.A	A.	Pasiv	16/11/2020
8	L.V	I. T.	Pasiv	29/10/2019
9	K.P	T.A.	Pasiv	26/08/2019
10	L.F	I.P	Pasiv	26/02/2021
11	L.Q	A.S.	Pasiv	02/03/2021
12	L.J	E.	Pasiv	26/04/2021
13	K.D	C.C	Pasiv	5/5/2021
14	K.K	K.K	Pasiv	19/08/2021

Burimi: DSHT/DTM

- Riaktivizime nga statusi pasiv në statusin aktiv, nuk ka pasur.

##### - Viti 2022

Përgjatë vitit 2022 ka pasur në total 4 kalime të subjekteve nga statusi “Aktiv” në “Pasiv”. Deri me datë 31.12.2022 janë transferuar 6 subjekte me status pasiv nga DTM në DRT të tjera në

zbatim të Rregullores nr. 15416, datë 14.09.2022 “Për administrimin e Tatimpaguesve të Mëdhenj”.

Numri total i subjekteve pasive në DTM me datë 31.12.2022 është 12, sipas tabelës më poshtë:

**Tabela nr. 14** “Lista e subjekteve pasive në DTM me datë 31.12.2022”

Nr	Nipt-i	Emertimi I subjektit	Statusi	Data e statusit
1	J.P	A. SH. A	Pasiv	01/07/2020
2	L.M	S.P.A	Pasiv	26/05/2019
3	K.L	A.	Pasiv	31/12/2020
4	L.T	S.C.T	Pasiv	26/11/2019
5	L.A	S.P.A	Pasiv	26/04/2019
6	L.A	A.	Pasiv	16/11/2020
7	L.V	I.T	Pasiv	29/10/2019
8	K.P	T.A	Pasiv	26/08/2019
9	L.F	I.P	Pasiv	26/02/2021
10	K.H	L.F.C.	Pasiv	24/01/2022
11	L.1B	B.T	Pasiv	08/04/2022
12	K.R	E.T	Pasiv	24/05/2022

*Burimi: DSHT/DTM*

- Riaktivizime nga statusi pasiv në statusin aktiv, nuk ka pasur.

Ndryshimi i statusit të subjektit njoftohet në rrugë shkresore në përputhje me legjislacion e procedurave tatimore. Me përmirësimin e teknologjisë së informacionit, kalimi automatik në sistem, i ndryshimit të statusit, ka nisur në Maj të vitit 2016 e vijim.

▪ **Ndryshimi i përgjegjëseve tatimore**

Nga ana e Sektorit të Asistencës dhe Regjistrimit është ndjekur gjithashtu edhe ndryshimi i përgjegjëseve tatimore bazuar në informacionet e ardhura nga Drejtoritë e tjera të DTM si dhe bazuar në kërkesat e subjekteve. Sipas të dhënave të administruara, subjektet për ndryshim të përgjegjësisë tatimore paraqiten si më poshtë: 2

**Tabela nr.15** “Subjekte me shtim të përgjegjëseve tatimore VITI 2021”

Nr	NIPT	Subjektet
1	L.T	E.G
2	L.C	I
3	K.B	P.C
4	L.V	A.S
5	K.T	K.I
6	L.OQ	R.T.N.
7	L.M	A.
8	K.N	E.D.
9	L.A	K.M
10	L.S	S.K.P
11	L.R	A.
12	L.A	A.E

*Burimi: DSHT/DTM*

**Tabela nr.16** “Subjekte me shtim të përgjegjëseve tatimore VITI 2022”

Nr	NIPT	Subjektet
1	K.P	K.K
2	L.G	A.H.C.
3	L.H	I.
4	K.D	L.G.E.
5	J.V	SH.
6	K.L	A.M
7	L.R	T.

*Burimi: DSHT/DTM*

Referuar të dhënave më sipër, rezulton se është ulur numri i subjekteve të cilat kanë pësuar ndryshim në përgjegjësi tatimore për vitin 2021 janë 12, për vitin 2022 janë 7. Për të gjithë

subjektet që kanë ndryshuar përgjegjësi tatimore është përgatitur dhe dërguar njoftimi përkatës. Sqarimi i subjekteve lidhur me detyrimet tatimore dhe afatet e deklarimit dhe të pagesave që rrjedhin nga ndryshimi i kryer, bëhet në mënyrë të vazhdueshme.

▪ **Transferimet e subjekteve nga DTM në DRT të tjera dhe anasjelltas**

Për vitin 2021 nuk ka transferime të subjekteve nga DTM në DRT të tjera dhe anasjelltas. Për vitin 2022 transferimet në zbatim të Rregullores nr. 15416, datë 14.09.2022 “Për administrimin e Tatimpaguesve të Mëdhenj”, janë kryer sipas listës së dërguar nga DPT me anë të shkresës nr. 15994 prot, datë 21.09.2022. Statusi i transferimeve paraqitet si më poshtë:

**Tabela nr.17** “Subjekte të transferuara nga DTM në DRT të tjera dhe anasjelltas, viti 2022”

Evidenca e transferimeve sipas listës së dërguar me ane të shkresës nr.15994 Prot date 21.09.2022	Subjekte per t'u transferuar ne DTM	Subjekte per t'u transferuar nga DTM ne DRT te tjera
		188
Transferuar deri me date 31.12.2022	153	96
Mbetur per t'u transferuar	33	7
Anuluar transferimi	2	

Burimi: DSHT/DTM

- Nga të dhënat më sipër konstatohet se gjatë vitit 2022 nga 188 subjekte për transferim nga DRT në DTM, deri më datë 31.12.2022 janë transferuar 153 subjekte, 33 subjekte nuk janë transferuar, ndërkohë që 2 subjektet konkretisht “K. 2021” me NIPT M.M dhe “G. V. marketing” me NIPT M.J janë rikthyer në DRT fillestare pasi ishin me datë statusi “pasiv” përpara datës 14.09.2022 (data e rregullores “Për administrimin e Tatimpaguesve të Mëdhenj”). Numri i lartë i subjekteve të cilëve iu është miratuar transferimi nga DRT në DTM, gjithsej 33, por që figurojnë të pa transferuar ka ardhur si pasojë:

- Mos përfundimit të kontrolleve të cilat nuk gjenerohen nga sistemi C@TS, ushtruar nga drejtoritë respektive për ato subjekte që kanë kërkuar transferim.
- Planet e hapura të mbledhjes së borxhit nga Drejtoria e Mbledhjes së Borxhit

Gjithashtu nga 103 subjekte për transferim nga DTM në DRT të tjera, janë transferuar 96 subjekte dhe kanë mbetur pa transferuar 7 subjekte, për të njëjtat arsye si më sipër.

- Sektori i Regjistrimit ka kryer informimin e tatimpaguesve të transferuar sipas pikës 6 të Rregullores Nr. 15416 date 14.09.2022 dhe ka ndjekur në vazhdimësi subjektet që mbeten për t’u transferuar nga DTM në DRT të tjera, për të përcjellë në kohë informacionin në lidhje me çështjet që pengojnë ose jo transferimin e tyre.

▪ **Subjekte në status “Kërkesë për Çregjistrim”**

**Viti 2021**

Gjatë vitit 2021 ka pasur 4 subjekte të cilat kanë ndryshuar statusin nga “Kërkesë për Çregjistrim” në “Çregjistruar”. Evidentimi i subjekteve në status “KÇ” dhe pasqyrimi i arsyeve që pengojnë çregjistrimin është përditësuar periodikisht nga ana e Drejtorisë Shërbimit.

Lista e subjekteve në status “Kërkesë për Çregjistrim” me 31.12.2021, paraqitet si më poshtë:

**Tabela nr.18** “Subjekte me përthithje/ndarje”

Nr	Nipti	Emri subjektit	Data "K Ç" ne C@TS	Data e çregjistrimit në QKB	Përthithur nga / ndarje në
1	K.V	S.H.	2.12.2015	2.12.2015	B.M.T

2	K.B	A. SHPK	19.06.2015	19.06.2015	R. 2000
3	J.Q	F.	28.08.2012	28.08.2012	F.-E dhe M.
4	L.P	O. P. GROUP	9.12.2016	9.12.2016	C. Pharma
5	J6.O	U.K. SHA	21.11.2017	21.11.2017	UK Bashkia Tiranë SHA (UKBT); UK Bashkia Vore SHA(UKBV); UK Bashkia Kamëz SHA (UKBK);
6	L.O	E.M.	25.06.2018	25.06.2018	E.M.F.
7	J.K	V.B.	2.10.2018	1.10.2018	I.S.B
8	K.P	T. Co	27.05.2019	27.05.2019	T. Alb SHPK
9	L.F	S.	11.01.2021	11.01.2021	M. TCI
10	K.B	A.	30.12.2020	30.12.2020	V.A. SHA

Burimi: DSHT/DTM

**Tabela nr.19** “Subjekte me likuidim”

Nr	Nipti	Emri subjektit	Data "K Ç" në C@TS	Statusi në QKB
1	L.D	N.G	11.06.2015	Shoqeri ne likuidim e sipër
2	K.T	P.B.G , Dege ne Shqiperi	11.12.2018	Cregjistruar
3	J.I	T.N	31.10.2019	Shoqeri ne likuidim e sipër
4	K.Ë	B.K	29.10.2020	Shoqeri ne likuidim e sipër
5	L.P	C.P	02.11.2021	Shoqeri ne likuidim e sipër

Burimi: DSHT/DTM

### Viti 2022

Përgjatë vitit është shënuar vetëm një subjekt me ndryshim statusi nga “KÇ” në “Çregjistruar”. Evidentimi i subjekteve në status KÇ dhe pasqyrimi i arsyeve që pengojnë çregjistrimin është përditësuar periodikisht nga ana e Drejtorisë Shërbimit.

- Lista e subjekteve në status “Kërkesë për Çregjistrim” me 31.12.2022, paraqitet si më poshtë:

**Tabela nr.20** “Subjekte me përthithje/ndarje”

Nr	Nipti	Emri subjektit	Data "K Ç" ne C@TS	Data e çregjistrimit në QKB	Përthithur nga / ndarje në
1	K.V	S.H	2.12.2015	2.12.2015	B.M
2	K.B	A. SHPK	19.06.2015	19.06.2015	R. 2000
3	J.Q	F.	28.08.2012	28.08.2012	F-E dhe M.
4	L.P	O.P GROUP	9.12.2016	9.12.2016	C. Pharma
5	J.O	U.K	21.11.2017	21.11.2017	UK Bashkia Tiranë SHA (UKBT); UK Bashkia Vore SHA(UKBV); UK Bashkia Kamëz SHA (UKBK);
6	L.O	E.Market	25.06.2018	25.06.2018	E. M.
7	J.K	V. Banka	2.10.2018	1.10.2018	I. S. B. SHA
8	K.P	T. Co	27.05.2019	27.05.2019	T. A.SHPK
9	L.F	S.	11.01.2021	11.01.2021	M. TCI
10	J.R	A.B	01.12.2022	01.12.2021	O. Bank

Burimi: DSHT/DTM

**Tabela nr.21** “Subjekte me likuidim”

Nr	Nipti	Emri subjektit	Data "K Ç" në C@TS	Statusi në QKB
1	L.D	N.G.	11.06.2015	Shoqeri ne likuidim e sipër
2	K.T	P.PB.	11.12.2018	cregjistruar
3	J.I	T.N.	31.10.2019	Shoqeri ne likuidim e sipër
4	K.Ë	B.N.S.	29.10.2020	Shoqeri ne likuidim e sipër
5	L.Q	C.P.	02.11.2021	cregjistruar
6	K.K	G.I.	11.04.2022	Shoqeri ne likuidim e sipër
7	L.M	B.	29.06.2022	Shoqeri ne likuidim e sipër
8	L.P	K.A.	06.10.2022	Shoqeri ne likuidim e sipër

Burimi: DSHT/DTM

Sa sipër rezulton se subjektet të cilat kanë bërë “kërkesë për çregjistrim” që janë çregjistruar me likuidim, përthithje/ndarje, për periudhën 01.01.2021-31.12.2022 janë si numër më i madh në vitin 2022 ku figurojnë 18 të tilla, për vitin 2021 figurojnë 15. Siç shihet numri i tyre ka ardhur duke u ngritur.

Nga DSHT janë ndjekur procedurat për subjektet të cilat kanë kaluar në statusin “Kërkesë për çregjistrim”. Për realizimin e këtij procesi janë mbajtur kontakte me Drejtorinë e Kontrollit Tatimor dhe Drejtorinë e Mbledhjes me Force për të përshpejtuar procedurat e Çregjistrimit në sistemin C@TS.

▪ **Auditimi me zgjedhje i aplikimit të kërkesave për vërtetime, lëshuar nga DSHT.**

Nga Grupi i Auditimit janë marrë me përzgjedhje rastësore praktika për aplikimin e kërkesave për vërtetime të lëshuar nga DSHT, për muajt Shkurt, Mars 2021 dhe Shtator, Tetor 2022, në lidhje me zbatimin e procedurave dhe afateve, sipas viteve si më poshtë:

**Viti 2021**

NR	Subjekti	Data e Aplikimit	Lloji vërtetimit	Afati i lëshimit
1	A.SHPK	10.03.2021	Për Kont Sig.Shoqërore dhe Shend	11.03.2021
2	K. I.	24.03.2021	Për Kont Sig.Shoqërore dhe Shend	26.03.2021
3	In. SHPK	12.02.2021	Vërtetim Xhiro	15.02.2021
4	A.C.	12.02.2021	Vërtetim Xhiro	15.02.2021
5	S.	11.02.2021	Për Kont Sig.Shoqërore dhe Shend	16.02.2022
6	SH.	16.02.2022	Vërtetim Xhiro	17.02.2021
7	I.S.S.	18.02.2021	Vërtetim për shlyerje detyrimi	19.02.2021
8	P.S SHPK	18.02.2021	Për Kont Sig.Shoqërore dhe Shend	19.02.2021
9	S.U.G	23.02.2021	Vërtetim Xhiro	23.02.2021
10	A.L.	29.01.2021	Për Kont Sig.Shoqërore dhe Shend	01.02.2021

*Burimi: Zyra e Protokollit/DTM*

**Viti 2022**

NR	Subjekti	Data e Aplikimit	Lloji vërtetimit	Afati i lëshimit
1	F.A.	29.09.2022	Për Kont Sig.Shoqërore dhe Shend	29.09.2022
2	G. Shops	14.10.2022	Vërtetim për shlyerje detyrimi	14.10.2022
3	C. SHPK	23.09.2022	Vërtetim për shlyerje detyrimi	23.09.2022
4	E.	26.09.2022	Vërtetim për shlyerje detyrimi	26.09.2022
5	D.E SHPK	21.09.2022	Vërtetim Xhiro	22.09.2022
6	A. C.	28.09.2022	Vërtetim për shlyerje detyrimi	28.09.2022
7	A.S.	05.10.2022	Për Kont Sig.Shoqërore dhe Shend	06.10.2022
8	H.S.	10.10.2022	Vërtetim për shlyerje detyrimi	10.10.2022
9	G.G.T.	12.09.2022	Vërtetim për shlyerje detyrimi	12.09.2022
10	A.S.	03.10.2022	Vërtetim për shlyerje detyrimi	03.10.2022

*Burimi: Zyra e Protokollit/DTM*

Nga auditimi ka rezultuar se për periudhën 2021-2022, në 4 raste ka vonesa me 1-4 ditë në lëshimin e vërtetimit jo sipas përcaktimeve të Manualit, pjesa III, pika 2 dhe 7.

**Konkluzion:** Nga auditimi ka rezultuar se nga viti 2021 në vitin 2022, ka rënie të numrit të shërbimeve të ofruara nga DSHT për një pjesë të mirë të shërbimeve, si p.sh.: -*Kthim përgjigje palëve të treta*; -*Çështje të trajtuara nëpërmjet portalit qeveritar*; -*Numri i njoftimeve i dërguar tatimpaguesve me qëllim parandalimin e mashtrimit dhe nxitjen e korrektimit vullnetar*; -*Numri i seminareve edukues të realizuar*; - *Kontakte të regjistruara nëpërmjet rubrikës "Çështje e Përgjithshme"* -*krijuar nga inspektori Shërbimit*; - *Azhornim te dhënash regjistrimi*. Gjithashtu në kuadër të procesit të dixhitalizimit dhe rritjes së numrit të shërbimeve të ofruara online nëpërmjet portalit qeveritar e-Albania, struktura e Drejtorisë së Shërbimit të Tatimpaguesve të Mëdhenj e përbërë nga 7 punonjës (1 Drejtor Drejtorie, 2 përgjegjës sektori, 4 specialistë), në raport me numrin dhe llojin e shërbimeve të ofruara dhe efektivitetit të kësaj Drejtorie, duhet të rishikohet.

**Gjetja:** Rënie e efektivitetit të Drejtorisë së Shërbimit të Tatimpaguesve të Mëdhenj

<b>Situata:</b>	Nga auditimi mbi veprimtarinë e Drejtorisë së Shërbimit të Tatimpaguesve të Mëdhenj, ka rezultuar se nga viti 2021 në vitin 2022, ka rënie të numrit të shërbimeve të ofruara nga DSHT për një pjesë të mirë të shërbimeve, si p.sh.: - <i>Kthim përgjigje palëve të treta</i> ; - <i>Çështje të trajtuara nëpërmjet portalit qeveritar</i> ; - <i>Numri i njoftimeve të dërguar tatimpaguesve me qëllim parandalimin e mashtrimit dhe nxitjen e korrektimit vullnetar</i> ; - <i>Numri i seminareve edukues të realizuar</i> ; - <i>Kontakte të regjistruara nëpërmjet rubrikës "Çështje e Përgjithshme" -krijuar nga inspektori Shërbimit</i> ; - <i>Azhornim të dhënash regjistrimi</i> . Gjithashtu në kuadër të procesit të dixhitalizimit dhe rritjes së numrit të shërbimeve të ofruara online nëpërmjet portalit qeveritar e-Albania, struktura e Drejtorisë së Shërbimit të Tatimpaguesve të Mëdhenj e përbërë nga 7 punonjës (1 Drejtor Drejtorie, 2 përgjegjës sektori, 4 specialistë), në raport me numrin dhe llojin e shërbimeve të ofruara dhe efektivitetit të kësaj Drejtorie, duhet të rishikohet.
<b>Kriteri:</b>	- Rregullore për funksionimin e Administratës Rajonale Tatimore, miratuar me Urdhrin nr. 192, datë 12.08.2020, Kapitulli II, neni 8,9,10 dhe 11. - Urdhri i Kryeministrit nr. 33, datë 12.02.2020 "Për miratimin e strukturës organizative të personelit të Administratës Tatimore", Lidhja nr.1(1/1)-Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj. - Urdhrit të Kryeministrit Nr. 158, datë 25.11.2019 "Për marrjen e masave dhe rregullimin e dispozitave ligjore për aplikimin e shërbimeve vetëm on line nga data 01.01.2020".
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Mungesa e efektivitetit të Drejtorisë së Shërbimit të Tatimpaguesve të Mëdhenj
<b>Shkaku:</b>	Procesi i dixhitalizimit dhe rritja e numrit të shërbimeve të ofruara online nëpërmjet portalit qeveritar e-Albania.
<b>Rëndësia:</b>	E Lartë
<b>Rekomandimi:</b>	Nga DPT të merren masa për rishikimin e strukturës së Drejtorisë së Shërbimeve të Tatimpaguesve në DTM, referuar treguesve të performancës në rënie nga viti 2021 në vitin 2022, efektivitetit të kësaj drejtorie si dhe procesit të dixhitalizimit dhe rritjes së numrit të shërbimeve të ofruara online.

#### **2. 4. Mbi vlerësimin e përputhshmërisë ligjore të veprimtarisë së Drejtorisë së Mbledhjes së detyrimeve tatimore të papaguara**

Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara në Drejtorinë e Tatimpaguesve të Mëdhenj në vazhdim DMDTP në DTM është e organizuar dhe funksionon në zbatim të Ligjit Nr. 9920 datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe Udhëzimit Nr.24 datë 02.09.2008 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, i ndryshuar, "Rregullores së funksionimit të Drejtorive Tatimore Rajonale" miratuar me Urdhrin e MFE nr.19, datë 22.02.2017 dhe në zbatim të manualit "Manuali i mbledhjes së detyrimeve tatimore të papaguara" i cili mbështete në nenin 135, paragrafi "3" dhe "4" të Ligjit Nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Ky manual është i detyrueshëm për Administratën Tatimore. Strukturat e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara në Rajone kanë për detyrë të zbatojnë procedurat e përkrahura në këtë manual. Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara në DTM gjatë vitit 2021 dhe vitit 2022 ka funksionuar me tre sektorë konkretisht si më poshtë:

1. Sektori i Analizës dhe Monitorimit për masat shtrënguese.
2. Sektori i Zbatimit në Terren të masave shtrënguese.
3. Sektori i Procedurave Ligjore të Mbledhjes me Forcë.

Struktura e drejtorisë	2021			2022		
	Plan	Fakt	Dif.	Plan	Fakt	Dif.
Drejtor Drejtorie	1	1		1	1	
Sektori i Analizës dhe Monitorimit për masat shtrënguese.						
<i>Përgjegjës sektori</i>	1	1		1	1	
<i>Inspektor</i>	2	2		2	2	
Sektori i Zbatimit në Terren të masave shtrënguese.						
Përgjegjës sektori	1	1		1	1	
<i>Inspektor</i>	3	2	1 vakant	3	1	2 vakant
Sektori i Procedurave Ligjore të Mbledhjes me Forcë						
<i>Përgjegjës sektori</i>	1	-	1 vakant	1	-	1 vakant
<i>Inspektor</i>	2	2		2	2	
<b>Totali</b>	<b>11</b>	<b>9</b>	<b>2 vakant</b>	<b>11</b>	<b>8</b>	<b>3 vakant</b>

*Burim: nga DTM*

Nga auditimi konstatohet se kjo drejtori ka funksionuar me strukture jo të plotë me 2 vende vakante në vitin 2021 dhe 3 vende vakante në vitin 2022 ose me 80 % të strukturës në vitin 2021 dhe me 72 %, të strukturës në vitin 2022, pra jo në përputhje me strukturën organike të miratuar me Urdhrin e Kryeministrit Nr. 33 datë 12.02.2020 “Për miratimin e strukturës organizative të personelit të Administratës Tatimore Qendrore”. Kjo situatë çënon përmbushjen me sukses të detyrave funksionale dhe realizimin e objektivave të drejtorisë. Nga dokumentet e vëna në dispozicion për vitin 2021 dhe vitin 2022 u konstatua se drejtori i drejtorisë ka formuluar planin operacional për tri sektorë në zbatim të pikës 3 të rregullores “Rregullores së funksionimit të Drejtorive Tatimore Rajonale”. Planit Operacional i Drejtorisë duke organizuar punën kryesisht në:

1. Identifikimin dhe monitorimin e detyrimeve tatimore të papaguara si dhe analiza rast pas rasti për çdo detyrim. Analiza e detyrimeve çdo muaj evidentimi dhe raportimi mujor i tyre për veprime të mëtejshme nga sektorët përkatës.
2. Menaxhimi dhe mbledhja e detyrimeve tatimore të papaguara të vetë deklaruara dhe ato të vlerësuara nga Administrata Tatimore.
3. Ndjek procedurat në zbatim të ligjit në vijimësi dhe masat shtrënguese për subjektet debitorë.
4. Bashkëpunon dhe informon institucionet sipas strukturave përkatëse kryesisht DPT dhe institucione të tjera.
5. Identifikimi i subjekteve me xhiro cash dhe organizimi për arkëtim të detyrimeve të vetëdeklaruara.
6. Procedurat pas marrjes së masave shtrënguese.

### **Niveli i Borxhit tatimor, ecuria e detyrimeve të papaguara për periudhën objekt auditimi.**

Për periudhën objekt auditimi, periudha 01.01.2021 -31.12.2022, në Drejtorinë Tatimpaguesve të Mëdhenj, situata e gjendjes në fillim, krijimi i detyrimit, arkëtimit dhe gjendjes në fund të detyrimit tatimorë të papaguar pasqyrohet si më poshtë.

#### **Ecuria e detyrimeve tatimore të papaguara**

Në zbatim të manualit “Manuali i mbledhjes së detyrimeve tatimore të papaguara” seksionin 3.3.1 “Kërkesat për evidentim dhe analizë” çdo muaj Sektori i Monitorimit, Analizës për Masat Shtrënguese në Drejtorinë e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara në DTM, përgatit raporte dhe analiza lidhur me situatën e detyrimeve tatimore të papaguara të cilat dërgohen brenda datës 8 të çdo muaji pasardhës në rrugë elektronike dhe brenda datës 14 në rrugë zyrtare



pranë DMDTP në DPT. Me kërkesë të grupit auditues u vunë në dispozicion raportet dhe evidencat mujore.

### Viti 2021


Borxhi sipas burimit të krijimit rezulton të jetë nga shtesat e borxhit sipas evidencave në vlerën 450,006 mijë lekë, borxh i krijuar nga vetëdeklarimi është 96,742 mijë lekë dhe borxh i krijuar nga kontrollet, detyrimet e vlerësuara (njoftim vlerësime, gjoba sistemi etj) me një vlerë rreth 353,265 mijë lekë.

Situata e detyrimeve tatimore të papaguara në afat deri në 31 Dhjetor 2021 paraqitet si më poshtë;

Në milion /lekë

DTM	Detyrimet 01.01.2021		Detyrime të shtuara		Detyrime të pakësuara				Detyrimet 31.12.2021		Në proces gjyqësor		Në apelim	
					Arkëtuar		Kthyer per Sistemim							
	Sub.	Shuma	Sub.	Shuma	Sub.	Shuma	Sub.	Shuma	Sub.	Shuma	Sub.	Shuma	Sub.	Shuma
Totali	271	12,509	741	6,375	647	5,211	57	464	308	13,209	96	3,138	28	158

Burimi: nga të dhënat DTM



Referuar të dhënave të mësipërme, gjendja e detyrimeve të papaguara në fillim të vitit 2021 paraqitet në vlerën 12,509 milion lekë që i përket një numri prej 271 subjektsh debitorë, dhe në fund të vitit 2021 këto detyrime rezultojnë në vlerën 13,209 milion lekë që i përket një numri prej rreth 308 subjektsh debitorë. Pra, rritja e pësuar neto e detyrimeve nga 01.01.2021 në 31.12.2021 është rreth 700 milion lekë të detyrimeve të papaguara dhe me 37 të debitorëve të shtuar në fund të vitit 2021. Detyrimet e shtuara janë 741 subjekte me vlerë 6,375 milion lekë. Arkëtimet janë 647 subjekte me vlerë 5,211 milion lekë. Me rritje rezulton edhe numri i subjekteve debitorë me procedurë ankimimi, i cili deri në fund të vitit 2021 paraqitet me 96 subjekte në vlerën 3,138,061 mijë lekë në proces gjyqësor. Krahasuar me vitin paraardhës ku ishin 80 subjekte me vlerë 3,268,056 mijë lekë. Për sa i përket rasteve për sistemim, konstatohet se gjatë vitit 2021 janë 23 raste, krahasuar me vitin 2020 janë rritur me 12 raste më shumë. Nga auditimi konstatohet gjithashtu se stoku i detyrimeve të papaguara rritet me një ritëm më lartë se sa pakësohet (mblidhet), siç tregohet edhe në grafikun e mësipërm ‘Performanca e vitit 2021’. Konstatohet se në muajin korrik detyrimet e shtuara arrijnë vlerën maksimale në vlerën 1,697 milion lekë dhe arkëtimet arrijnë vlerën maksimale në muajin shtator me vlerën 1 milion lekë. Konstatohet se kontributin më të madh në stokun e detyrimeve të papaguara e zënë subjekti “O.



G.” SHA me detyrim të papaguar 5.5 miliard lekë ose 42 % e total detyrimit të papaguar, më pas vjen subjekti “S.P.A.” SHPK me detyrim të papaguar në vlerë 819 milion lekë ose 6 % e total detyrimit të papaguar dhe subjekti “B.P.A.” SHPK me detyrim të papaguar në vlerën 725 milion lekë ose 5 % e total detyrimit të papaguar.


### Viti 2022

Borxhi sipas burimit të krijimit rezulton të jetë nga shtesat e borxhit sipas evidencave në vlerën 550 milion lekë, borxh i krijuar nga vetëdeklarimi 398 mijë lekë dhe borxh i krijuar nga kontrollet, detyrimet e vlerësuara (njoftim vlerësime, gjoba sistemi etj) me një vlerë rreth 152 mijë lekë. Situata e detyrimeve tatimore të papaguara në afat deri në 31 Dhjetor 2022 paraqitet si më poshtë;

Në milion /lekë

DTM	01.01.2022		Detyrime të shtuara		Detyrime të pakësuara				Detyrimet 31.12.2022		Te transferuara (dalje)		Te transferuara (hyrje)	
	Sub.	Shuma	Sub.	Shuma	Arkëtuar		Kthyer per Sistemim		Sub.	Shuma	Sub.	Shuma	Sub.	Shuma
					Sub.	Shuma	Sub.	Shuma						
Totali	308	13,209	1,885	8,119	1,858	5,958	40	362	257	12,484	38	2,643	30	119

Burimi: nga të dhënat DPT



Referuar të dhënave të mësipërme, gjendja e detyrimeve të papaguara në fillim të vitit 2022 paraqitet në vlerën 13,208 milion lekë që i përket një numri prej 308 subjektsh debitore, dhe në fund të vitit 2022 këto detyrime rezultojnë në vlerën 12,484 milion lekë që i përket një numri prej rreth 257 subjektsh debitore. Pra, ulja e pësuar neto e detyrimeve nga 01.01.2022 në 31.12.2022 është rreth 724 milion lekë të detyrimeve të papaguara dhe me 51 të debitorëve të pakësuar në fund të vitit. Detyrimet e shtuara janë 1,885 subjekte me vlerë 8,119 milion lekë, krahasuar me vitin paraardhës janë shtuar më shumë afërsisht 1,117 subjekte me vlerë 1,747 milion lekë. Hyrje nga transferimet 30 subjekte me vlerë 119 milion lekë. Arkëtimet janë 1,858 subjekte me vlerë 5,958 milion lekë. Janë transferuar nga DTM në DRT 38 subjekte me vlerë

2,643 milion lekë. Konstatohet se stoku i detyrimeve të papaguara rritet me një ritëm më lartë se sa pakësohet (mblidhet), kjo tregohet edhe nga trendi linear i paraqitur në grafik “Performanca e vitit 2022”. Siç jepet edhe në grafik në muajin maj detyrimet e shtuara arrijnë vlerën maksimale afërsisht 2,386 milion lekë dhe arkëtimet arrijnë vlerën maksimale në muajin shtator afërsisht 8 milion lekë. Konstatohet se kontributin më të madh në stokun e detyrimeve të papaguara e zënë subjekti “O. G.” SHA me detyrim të papaguar 5 miliard lekë ose 40 % e total detyrimit të papaguar, më pas vjen subjekti “T.A.” SHPK me 2 miliard lekë detyrime të papaguara ose 17 % e total detyrimit të papaguar dhe subjekti “S.P.A.” SHPK me detyrim të papaguar në vlerë 819 milion lekë ose 7 % e total detyrimit të papaguar dhe subjekti “B.A.” SHPK me detyrim të papaguar në vlerën 693 milion lekë ose 6 % e total detyrimit të papaguar. Subjekte me procedurë ankimimi janë 101 subjekte nga këto, janë 90 subjekte me detyrim të papaguar në vlerën 2,433 milion lekë në proces gjyqësor dhe janë 11 subjekte me detyrim në vlerën 111 milion lekë në apel.

### **Detyrimet tatimore sipas statusit të tatimpaguesit**

#### **Viti 2021**

-Tatimpagues me status Aktiv janë 297 subjekte me detyrim tatimorë në vlerën 11,707 milion lekë ose 88.64 % e totalit të detyrimeve tatimore të papaguara, ku peshën më të madhe ose 87 % të totalit të detyrimeve e zënë 15 subjekte tatimpagues. Vlen të theksohet se 8 nga këto tatimpagues janë në proces gjyqësor.

-Tatimpagues me status Pasiv dhe Kërkesë për çregjistrim janë 11 subjekte me detyrim tatimorë në vlerën 1,500 milion lekë ose 11.4% e totalit të detyrimeve.

#### **Viti 2022**

-Tatimpagues me status Aktiv janë 246 subjekte me detyrim tatimorë në vlerën 8,890 milion lekë ose 71 %, e totalit të detyrimeve tatimore të papaguara, ku peshën më të madhe ose 88 % të totalit të detyrimeve e zënë 14 subjekte tatimpagues.

-Tatimpagues me status Pasiv dhe Kërkesë për çregjistrim janë 11 subjekte me detyrim tatimorë në vlerën 3,594 milion lekë ose 29 % e totalit të detyrimeve tatimore të papaguara, ku vetëm një subjekt ka vlerën 2,165 milion lekë që zë 60 % të total detyrimit tatimor me status Pasiv.

### **Detyrimet tatimore të ndara sipas pronësisë**

#### **Viti 2021**

-Tatimpagues Shtetërore janë 17 subjekte me detyrim tatimor të papaguar në shumën 6,761 milion lekë ose 51% e total detyrimit. Nga këto janë institucione jo buxhetore 10 subjekte me vlerë 6,756 milion lekë dhe 7 subjekte me vlerë 4 milion lekë janë institucione buxhetore.

-Tatimpagues Privatë janë 291 subjekte me detyrim tatimor të papaguar në shumën mijë 6,447 milion lekë ose 49 % e total detyrimit.

#### **Viti 2022**

-Tatimpagues Shtetërore janë 15 subjekte në shumën 5,701 milion lekë ose 46 % e total detyrimit. Nga këto janë institucione jo buxhetore 8 subjekte me detyrim tatimorë të papaguar me vlerë 5,696 milion lekë dhe 7 subjekte me detyrim tatimorë të papaguar me vlerë 4 milion lekë janë institucione buxhetore.

-Tatimpagues Privatë janë 242 subjekte me detyrim tatimorë të papaguar në shumën mijë 6,782 milion lekë ose 54% e total detyrimit.

## Detyrimet e papaguara sipas madhësisë së borxhit viti 2021-2022

Ndarja e borxhit sipas madhësisë për vitin 2021 jepet si më poshtë :

Në lekë

Fasha	Aktiv		Pasiv		Totali	
	Nr	Vlera	Nr	Vlera	Nr	Vlera
< 500 lekë	3	765	0	0	3	765
500-10,000	28	211,455	0	0	28	211,455
10,000-50,000	28	793,326	0	0	28	793,326
50,000-500,000	70	15,278,721	0	0	70	15,278,721
500,000-1,000,000	29	22,790,998	1	935,731	30	23,726,729
1,000,000-5,000,000	58	151,387,484	4	12,029,416	62	163,416,900
5,000,000 -100,000,000	66	1,344,221,767	2	48,384,963	68	1,392,606,730
>100,000,000	15	10,173,056,969	4	1,439,790,396	19	11,612,847,365
<b>Totali</b>	<b>297</b>	<b>11,707,741,985</b>	<b>11</b>	<b>1,501,140,506</b>	<b>308</b>	<b>13,208,882,491</b>

Burimi:nga të dhënat DTMError! Not a valid link.

Nga ndarja e detyrimeve sipas fashës dhe statusit shikojmë se 87 % e total detyrimit të vitit e zënë detyrimet tatimore të papaguara me vlerë mbi 100 milion lekë. Janë 19 subjekte me detyrim 11,612,847 mijë lekë, ku peshën më të madhe e zënë tatimpaguesit shtetëror (57 %). Konkretisht 5 subjekte janë tatimpagues shtetëror me status Aktiv, 10 subjekte janë privat me status Aktiv dhe 4 subjekte janë privat me status Pasiv. Nëse e krahasojmë me vitin paraardhës 31.12.2020 subjektet me shumë mbi 100 milion lekë ishin 21 subjekte me vlerë 11,168,071 mijë lekë. Konstatohet se ka një rritje të stokut të detyrimeve të papaguara me 444,776 mijë lekë. Nga analiza e të dhënave konstatohet se janë 13 subjekte të cilët janë të mbartur nga vitit 2020 dhe janë sërish detyrim i pa mbledhur edhe në vitin 2021.

Të dhënat për subjektet debitore mbi 100 milion lekë janë paraqitur në tabelën si më poshtë.

Në milion lekë

Nr	NIPT	Subjekti	Statusi	Detyrim me 31.12.2021	Procedura Aktuale
1	K.H	O.sh.e SHA	Aktiv shtetëror	5,549	Shtetërorë per Arkëtim
2	L.L	F.U.	Aktiv shtetëror	465	Shtetërorë per Arketim
3	J.U	A. SHA	Aktiv shtetëror	312	Në proces Gjyqësor
4	L.E	O.S.SH	Aktiv shtetëror	277	Shtetërorë per Arketim
5	J.L	A.P.D SHA	Aktiv shtetëror	126	Në proces Gjyqësor
	(1)	<b>Shuma</b>		<b>6,732</b>	<b>57.97%</b>
6	K.L	B.P.A	Aktiv privat	725	Në proces Gjyqësor
7	J.H	S.E.D, Dega ne Shqiperi	Aktiv privat	577	Në proces Gjyqësor
8	L.A	T,E SHPK	Aktiv privat	536	Me masa shtrenguse
9	L.G	N. SHPK	Aktiv privat	396	Me masa shtrenguse
10	K.1N	S.O. S.A	Aktiv privat	347	Në proces Gjyqësor
11	K.B	A.M.	Aktiv privat	309	Me masa shtrenguse
12	L.O	SH.C.	Aktiv privat	143	Ne proces Gjyqësor dhe Marrveshje
13	L.I	SH.U. B.V	Aktiv privat	141	Në proces Gjyqësor
14	J.F	B.T. SHPK	Aktiv privat	133	Me masa shtrenguse
15	K.1Q	F.B.C. Co SHPK	Aktiv privat	130	Ne ankim administrativ
	(2)	<b>Shuma</b>		<b>3,441</b>	<b>29.63%</b>
16	L.M	S.P. SHPK	Pasiv privat	819	Me masa shtrenguse
17	L.T	S.C. Tirana	Pasiv privat	367	Me masa shtrenguse
18	L.A	S.P.A. Trading	Pasiv privat	146	Me masa shtrenguse
19	L.1J	E..SH.	Pasiv privat	106	Në proces Gjyqësor
	(3)	<b>Shuma</b>		<b>1,439</b>	<b>12.40%</b>
		<b>TOTALI 1+2+3</b>		<b>11,612</b>	

Burimi: të dhënat nga DTM

## Viti 2022

Ndarja e borxhit sipas madhësisë për vitin 2022.

Në lekë

Madhësia e Borxhit	Aktiv		Pasiv		Totali	
	Nr	Vlera	Nr	Vlera	Nr	Vlera
< 500 leke	3	842	-	-	3	842
500-10,000	21	157,347	-	-	21	157,347
10,000-50,000	16	340,158	-	-	16	340,158
50,000-500,000	66	15,803,627	-	-	66	15,803,627
500,000-1,000,000	28	20,161,058	-	-	28	20,161,058
1,000,000-5,000,000	49	139,021,684	5	13,699,684	54	152,721,368
5,000,000 -100,000,000	53	1,240,216,423	2	81,602,679	69	1,321,819,102
>100,000,000	10	7,475,212,883	4	3,498,387,416		10,973,600,299
<b>Totali</b>	<b>246</b>	<b>8,890,914,022</b>	<b>11</b>	<b>3,593,689,779</b>	<b>257</b>	<b>12,484,603,801</b>

Burimi: të dhënat nga DTM

Nga ndarja e detyrimeve sipas fashës dhe statusit rezulton se 89 % e total detyrimit e zë stoku i detyrimeve tatimore të papaguara me vlerë mbi 100 milion lekë. Konkretisht janë 14 subjekte me detyrim 10,973 milion lekë, ku peshën më të madhe e zë tatim paguesit shtetërorë (51 %), nga këto 4 subjekte janë tatimpagues shtetërorë me status Aktiv, janë 6 subjekte me status privat Aktiv dhe 4 tatimpagues privat me status Pasiv.

Të dhënat për subjektet debitore mbi 100 milion lekë janë paraqitur në tabelën si më poshtë.

Në milion lekë

Nr.	Emri i Subjektit	Pronësia	Statusi	Total	Procedura
1	O. G. SHA	Shtetëror	Aktiv	5,012	Shtetërore per Arkëtim
2	A. SHA	Shtetëror	Aktiv	312	Në proces Gjyqësor
3	A.P.D. SHA	Shtetëror	Aktiv	181	Në proces Gjyqësor
4	F.U. SHA	Shtetëror	Aktiv	122	Shtetërore per Arkëtim
		<b>Shtetëror</b>	<b>51%</b>	<b>5,628</b>	
5	I.E.	Privat	Aktiv	340	Akt Marreveshje
6	S.O. s.a	Privat	Aktiv	328	Në proces Gjyqësor
7	B.T. SHPK	Privat	Aktiv	243	Masa Shtrënguese
8	SHA. b.v	Privat	Aktiv	141	Në proces Gjyqësor
9	F.B.C.	Privat	Aktiv	102	
10	B.P.A.	Privat	Aktiv	693	Në proces Gjyqësor
		<b>Privat/ Aktiv</b>	<b>17%</b>	<b>1,847</b>	
11	S.C.T.	Privat	Pasiv	367	Masa Shtrenguese
12	S.P.	Privat	Pasiv	147	Masa Shtrënguese
13	T.A. SHPK	Privat	Pasiv	2,165	Në proces Gjyqësor
14	S.P.A. SHPK	Privat	Pasiv	820	Urdhër Sekuestrimi
		<b>Privat/ Pasiv</b>	<b>32%</b>	<b>3,498</b>	
	<b>Totali</b>		<b>100%</b>	<b>10,974</b>	

Burim : të dhënat nga DTM

## Detyrimet sipas llojit të Tatimit 2021,2022

### Viti 2021

Në mijë lekë


Lloji i tatimit	Detyrimi papaguar		Në process gjyqësor		Në Apel	
	Vlera	Përqindje	Vlera	Përqindje	Vlera	Përqindje
Tatim Fitimi	8,033,361	61%	498,540	16 %	5,803	11 %
TVSH	3,478,900	26%	1,980,957	64 %	21,412	42 %
Të tjera	1,049,705	8 %	418,911	13 %	2,899	6 %
T.Burim	333,980	3 %	203,161	6.5 %	7,075	14 %
Sig.Shoqëror shëndetsor	242,301	2 %	12,477	0.4 %	13,280	26 %
TAP	70,635	1 %	1,209	0.04%	275	1%
<b>Totali</b>	<b>13,208,882</b>	<b>100 %</b>	<b>3,115,254</b>	<b>100 %</b>	<b>50,745</b>	<b>100 %</b>

Burim : të dhënat nga DTM

Për sa i përket gjendjes së stokut të detyrimeve të papaguara në afat sipas llojit të tatimit, konstatohet se zëri Tatim Fitimi zë peshën më të madhe në stokun e detyrimeve të papaguara në afat, 61% me një vlerë prej rreth 8,033,361 mijë lekë, ndjekur nga TVSH me 26% ose në vlerën

prej rreth 3,478,900 mijë lekë, e më pas zëri “Të Tjera” me 8% ose në vlerën prej rreth 1,049,705 mijë lekë, zëri Sigurimet Shoqërore & Shëndetësore me 2% ose në vlerën prej rreth 242,301 mijë lekë., dhe zëri TAP me rreth 1%, ose në vlerën prej rreth 70,635 mijë lekë.

### Detyrimet sipas llojit të Tatimit 2020 vs 2021



Më hollësisht për zërin e Tatim Fitimit, gjendja e detyrimeve në vitin 2021 rezultojnë 1,303 milion lekë më shumë se viti paraardhës, zëri i TVSH-së rezultojnë 565 milion lekë më pak; zëri i Sigurimeve Shoqërore 117 milion lekë më pak; zëri Tatim ne Burim 3 milion lekë më shumë dhe zëri Të tjera 3 milion lekë më shumë se viti 2020.

### Viti 2022


Në mijë lekë

Lloji i tatimit	Detyrimi i Vlera	papaguar Përqindje	Në proces Vlera	gjyqësor Përqindje
Tatim Fitimi	8,663,643	69 %	502,556	21%
TVSH	2,901,607	23%	1,368,263	56%
Të tjera	354,125	3%	312,370	13%
T.Burim	296,595	2%	195,677	8%
Sig. Shoqëror shëndetësor	206,683	2%	48,521	2%
TAP	61,951	0%	6,382	0%
<b>Totali</b>	<b>12,484,604</b>	<b>100%</b>	<b>2,433,769</b>	<b>100%</b>

Burim : të dhënat nga DTM

Për sa i përket gjendjes së stokut të detyrimeve të papaguara në afat sipas llojit të tatimit, konstatohet se zëri Tatim Fitimi zë peshën më të madhe në stokun e detyrimeve të papaguara në afat, 69% me një vlerë prej rreth 8,663,643 mijë lekë, ndjekur nga TVSH me 23% ose në vlerën prej rreth 2,901,607 mijë lekë, e më pas zëri “Të Tjera” me 3% ose në vlerën prej rreth 354,125 mijë lekë, zëri Sigurimet Shoqërore & Shëndetësore me 2% ose në vlerën prej rreth 206,683 mijë lekë., dhe zëri TAP me rreth 1%, ose në vlerën prej rreth 61,951 mijë lekë. Detyrime të papaguar në procedurë ankimi peshën më të madhe e zë detyrimi i papaguar TVSH 56 % të detyrimit total.

### Detyrimet sipas llojit të Tatimit 2021 vs 2022



Më hollësisht për zërin e Tatim Fitimit, gjendja e detyrimeve në vitin 2022 rezulton 630 milion lekë më shumë se viti paraardhës 2021, zëri i TVSH-së rezulton 577 milion lekë më pak; zëri i Sigurimeve Shoqërore 36 milion lekë më pak; zëri Tatim ne Burim 37 milion lekë më pak dhe zëri Të tjera 634 milion lekë më pak se viti 2021.

Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion, u konstatua se deri me datë 31.12.2022 janë debitorë vetëm për “Kontribute të detyrueshme të sigurimeve shëndetësore dhe shoqërore” 30 subjekte me vlerë totale të detyrimit të papaguar 43,503,745 lekë. Procedura e ndjekur nga drejtoria për 12 raste është dërguar njoftimi pagese, të cilët kanë paguar detyrimin në janar 2023 dhe për 1 rast është vendosur Urdhër bllokimi.

*në lekë*

Procedura	Nr.i rasteve	Shuma e detyrimit te papaguar
Ankimim	6	2,307,354
Dërguar Njoftim për pagesë	12	34,020,499
Urdhër Bllokimi	1	2,946,263
K/Vonesa dhe gjoba sistemi	8	23,505
Marrëveshje për pagesë me këste	1	3,299,757
Sistemim	2	906,367
<b>Totali</b>	<b>30</b>	<b>43,503,745</b>

*Burimi: të dhënat nga DMT, përpunim nga grupi auditues*

### Mosha e detyrimeve të papaguara 2021-2022

*Në mijë lekë*

MOSHA E DETYRIMEVE TE PAPAGUARA NE AFAT DERI NË 31.12.2021							
Periudha	deri 3 muaj	3 - 6 muaj	6-12 muaj	1-2 vjet	2-5 vjet	mbi 5 vjet	Total
Detyrime të papaguara në afat	672,093	816,523	874,070	1,783,606	8,167,991	894,598	13,208,882
PeSHA specifike në %	5 %	6 %	7 %	14 %	62 %	7 %	100 %

*Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DTM*

Për sa i përket gjendjes së stokut të detyrimeve të papaguara në afat sipas moshës për vitin 2021 konstatohet se peshën më të madhe e zë detyrimi me vjetërsi nga 2-5 vite në masën 62 % me një vlerë rreth 8,167,991 mijë lekë. Kontributin më të madh në këtë fashë vjetërsie 2-5 vite e zë detyrimi i papaguar në afat i Tatim Fitimit në masën 59 % dhe detyrimi i papaguar në afat i TVSH-së në masën 32 %. Konstatohet një rritje e stokut të borxhit në moshën 2-5 vite (62 % e total detyrimit të papaguar) krahasuar me vitin paraardhës 2020 zinte 43 % të total detyrimit të papaguar

*Në mijë lekë*

MOSHA E DETYRIMEVE TE PAPAGUARA NE AFAT DERI NË 31.12.2022							
Periudha	deri 3 muaj	3 - 6 muaj	6-12 muaj	1-2 vjet	2-5 vjet	mbi 5 vjet	Total
Detyrime të papaguara në afat	448,070	606,669	2,616,482	1,006,251	5,881,956	1,925,177	12,484,604
PeSHA specifike në %	4 %	5 %	21 %	8 %	47 %	15 %	100 %

*Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DTM*

Për sa i përket gjendjes së stokut të detyrimeve të papaguara në afat sipas moshës për vitin 2022 konstatohet se peshën më të madhe e zë detyrimi me vjetërsi nga 2-5 vite në masën 47 % me një vlerë rreth 5,881,956 mijë lekë, me pas renditet detyrimi i papaguar nga 6-12 muaj që zë 21 % të total detyrimit të papaguar si dhe detyrimi i papaguar mbi 5 vjet që zë 15 % e total detyrimit të papaguar. Konstatohet një rritje e konsiderueshme stokut të borxhit në moshën 6-12 muaj (21 % e total detyrimit të papaguar) ose me 1,742,412 mijë lekë më shumë krahasuar me vitin paraardhës 2021. Në referencë të manualit “Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar”, kapitulli III “Menaxhimi i çështjeve të mbledhjes së detyrimeve tatimore të papaguara”, pikën 3.3.6 “Vendosja e përparësive në analizë”, Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara në Rajone duhet të analizojë faktorët të cilët ndikojnë në përzgjedhjen dhe vendosjen


e përparësisë së mbledhjes së detyrimeve të papaguara për qëllime operative dhe administrative si edhe i duhet dhënë përparësi detyrimeve tatimore të papaguara me te reja te cilat rezultojnë.

## Mosha e detyrimeve të papaguara sipas llojit të tatimit

Në mijë lekë

	Detyrimet Tatimore 2021					
	Tatim mbi te ardhurën personale	Tatim fitimi	TVSH	Sigurime Shoqërore shëndetësore	Të tjera	Totali
borxhi deri ne 3 muaj	24,039	693,627	163,083	71,412	29,142	672,093
borxhi nga 3 - 6 muaj	8,632	143,673	57,908	24,729	12,822	816,523
borxhi nga 6-12 muaj	12,362	935,529	111,175	48,367	77,528	874,070
borxhi nga 1-2 vjet	17,106	1,148,277	162,895	54,616	391,116	1,783,606
borxhi nga 2-5 vjet	15,657	4,813,518	2,578,618	38,932	715,415	8,167,991
borxhi mbi 5 vjet	2,349	170,084	556,976	13,452	151,962	894,598
<b>TOTALI</b>	<b>80,146</b>	<b>7,904,708</b>	<b>3,630,655</b>	<b>251,509</b>	<b>1,377,985</b>	<b>13,208,882</b>

Burimi : të dhëna nga DTM




Në stokun e borxhit të ndarë sipas llojit të tatimit dhe vjetërsisë, kontributin më të madh e ka tatim fitimi për çdo moshë borxhi, e ndjekur nga TVSH. Kontributin më të madh për vjetërsi deri në 3-muaj, që është edhe borxhi më i ri e zë Tatim Fitimi me 71 % të total detyrimit të papaguar. Për moshën 2-5 vjet (e cila zë peshën më të madhe të total detyrimit) detyrimi i papaguar në afat është detyrimi i papaguar nga Tatim Fitimit në masën 59 % dhe detyrimi i papaguar në afat i TVSH-së në masën 23 %.

Në mijë lekë

Moshja e detyrimit	Detyrimet Tatimore sipas llojit të tatimit 2022					
	Tatim mbi te ardhurën personale	Tatim fitimi	TVSH	Sigurime Shoqërore shëndetësore	Të tjera	Totali
borxhi deri ne 3 muaj	22,512	149,547	208,736	52,461	14,813	448,070
borxhi nga 3 - 6 muaj	7,687	262,627	277,549	39,772	19,033	606,669
borxhi nga 6-12 muaj	6,640	2,442,909	128,907	20,406	17,621	2,616,482
borxhi nga 1-2 vjet	11,389	773,462	156,029	40,573	24,798	1,006,251
borxhi nga 2-5 vjet	7,247	3,964,301	1,493,086	40,115	377,206	5,881,956
borxhi mbi 5 vjet	6,475	1,070,796	637,300	13,357	197,248	1,925,177
<b>TOTALI</b>	<b>61,951</b>	<b>8,663,643</b>	<b>2,901,607</b>	<b>206,683</b>	<b>650,720</b>	<b>12,484,604</b>

Burimi : të dhëna nga DTM



Në stokun e borxhit të ndarë sipas llojit të tatimit dhe vjetërsisë, kontributin më të madh e ka tatim fitimi për çdo moshë borxhi, e ndjekur nga TVSH. Kontributin më të madh me moshë borxhi më të re deri në 3-muaj e zë detyrimi i papaguar i TVSH-ës me 47 % dhe i Tatim Fitimit me peshë 33 % Fasha e vjetërsisë nga 6-12 muaj përbëhet nga 93 % detyrim i papaguar i tatimit “Tatim Fitim” dhe pjesa tjetër shpërndahet nga tatime të tjera. Kontributin më të madh për vjetërsi 2-5 vjet (e cila zë peshën më të madhe të total detyrimit) e ka detyrimi i papaguar në afat i Tatim Fitimit në masën 67 % dhe detyrimi i papaguar në afat i TVSH-së në masën 25 %.

#### **Borxhi i ndare sipas Detyrim/Gjobe/Interes**

Në total borxhi i vitit 2021 sipas llojit i ndarë në detyrim, gjobë dhe interes rezulton si më poshtë:

*Në mijë lekë*

Lloji i tatimi	Detyrim	Gjobe	Interes	Totali
TAP	57,671	10,286	2,678	70,635
Tatim Fitim	3,511,066	3,338,995	1,183,300	8,033,361
TVSH	1,314,734	2,096,923	67,243	3,478,900
Sig	195,098	36,668	10,535	242,301
Te tjera	602,646	755,117	25,922	1,383,686
<b>Totali</b>	<b>5,681,214</b>	<b>6,237,990</b>	<b>1,289,678</b>	<b>13,208,882</b>

*Burim: të dhënat nga DTM*

Nga analiza e të dhënave konstatohet se principlali i detyrimeve tatimore të akumuluarra përbën rreth 43% të vlerës totale të detyrimeve tatimore, penalitetet (gjobat) me 47% dhe 10% kamatëvonesat (interesat). Në total borxhi i vitit 2022 sipas llojit i ndarë në detyrim, gjobë dhe interes rezulton si më poshtë:

*Në mijë lekë*

Lloji i tatimi	Detyrim	Gjobe	Interes	Totali
TAP	50,401	9,037	2,513	61,951
Tatim Fitim	3,688,814	3,706,150	1,268,679	8,663,643
TVSH	1,087,224	1,744,705	69,678	2,901,607
Sig	147,134	49,302	10,248	206,683
Te tjera	79,513	549,142	22,065	650,720
<b>Totali</b>	<b>5,053,086</b>	<b>6,058,336</b>	<b>1,373,182</b>	<b>12,484,604</b>

*Burim: të dhënat nga DTM*

Nga analiza e të dhënave konstatohet se principlali i detyrimeve tatimore të akumuluarra përbën rreth 40% të vlerës totale të detyrimeve tatimore, penalitetet (gjobat) me 49% dhe 11% kamatëvonesat (interesat).

#### **Masat Shtrënguese**

Në zbatim të Ligjit nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH” i ndryshuar, dhe Udhëzimi nr.24 datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore”, i ndryshuar parashikojnë



instrumentet që DTM duhet dhe mund të përdorë për mbledhjen me forcë të detyrimit tatimor. Në kapitullin III-të dhe IV-ët të Manualit përcaktohet se administrata tatimore ka autoritetin dhe kompetencat e dhëna për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara si edhe procedurën e masave shtrënguese. Në kapitullin III “Menaxhimi i çështjeve të mbledhjes së detyrimeve tatimore të papaguara” citohet që sistemi mundëson ekzekutimin e veprimeve automatike të lidhura me menaxhimin e detyrimeve tatimore të papaguara. Menaxhimi i detyrimeve tatimore të papaguara në sistemin C@ts quhet “Mbledhje me Forcë”, veprimet e mbledhjes me force kryhen automatikisht nga sistemi pa ndërhyrje manual nga zyrtarët e tatimeve. Në Manualin e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara përcaktohen hallkat e mëposhtme për sigurimin e pagesave të detyrimeve papaguara.

Masat shtrënguese të marra për mbledhjen e detyrimeve tatimore të papaguara dhe arkëtimet gjatë vitit 2021 paraqiten si më poshtë:

Në mijë lekë

	Masat shtrënguese, 2021	Të Vendosura		Të Arkëtuara		Efektiviteti	Të liruara	
		Nr.raste	Shuma	Nr.raste	Shuma		%	Nr.raste
	Llojet							
1	Njoftim dhe kërkesë për të paguar	1,232	4,839,212	768	2,233,358	46 %	0	0
2	Urdhër bllokim të llogarive bankare	59	1,526,053	38	460,337	30 %	33	443,476
3	Urdhër ekzekutime	54	270,836	52	270,427	100 %	0	0
4	Njoftim i përgjithshëm për vendosjen e barrës hipotekore dhe siguruese	18	862,469	1	3,100	0.3 %	1	3,100
5	Njoftim tatimpaguesit për vendosjen e barrës hipotekore dhe siguruese	20	880,502	1	3,100	0.4 %	1	3,100
6	Njoftim për vendosjen e barrës hipotekore	17	362,765	1	3,100	1 %	1	3,100
7	Njoftim për vendosjen e barrës siguruese	16	794,091	1	3,100	0.4 %	1	3,100
8	Urdhër sekuestrimi	5	225,527	0	0	0 %	0	0
9	Njoftim transferimi detyrimi tatimor palës së tretë	0	0	0	0	0 %	0	0
10	Njoftim dhe kërkesë për të paguar nga palët e treta në zbatim të nenit 98	1	1,176	1	1,175	100 %	0	0
11	Njoftim për transferimin e detyrimit Ortakut, Aksionerit, Administratorit	0	0	0	0	0 %	0	0
12	Kërkesë për pezullim të aktivitetit në Doganë	18	827,776	1	3,100	0.4 %	1	3,100
13	Njoftim për vendosjen e masës së sigurimit tatimor në QKB	20	880,502	1	3,100	0.4%	1	3,100
14	Konfiskim i 50% të xhiros ditore	106	642,436	105	487,147	76 %	0	0
	<b>TOTALI</b>	<b>1,566</b>	<b>12,113,343</b>	<b>970</b>	<b>3,471,043</b>	<b>29 %</b>	<b>39</b>	<b>462,076</b>

Burim : të dhëna nga DTM

Për vitin 2021, sikundër vërehet nga tabela e mësipërme janë vendosur në numër 1,566 masa shtrënguese me një vlerë prej 12,113,343 mijë lekë. Janë arkëtuar 3,471,043 mijë lekë. Masa shtrënguese që është aplikuar më tepër ndaj tatimpaguesve është “Njoftim dhe kërkesë për të paguar” më 1,232 raste për vlerën prej rreth 4,839,212 mijë lekë detyrim, nga të cilat janë arkëtuar 768 raste me vlerë 2,233,358 mijë lekë ose 46% të masave të vendosura për detyrimin. Konstatohet se nga ana e drejtorisë nuk është ezauruar në asnjë rast masa “Njoftim transferimi detyrimi tatimor palës së tretë” dhe “Njoftim për transferimin e detyrimit Ortakut, Aksionerit, Administratorit” veprim ky në kundërshtim me përcaktimet në ligjin Ligjit nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH” i ndryshuar, neni 97 “Transferim i detyrimit tatimore palës së tretë” ku citohet se “ Në rastet kur shuma e të ardhurave nga shitja e pasurisë së sekuestruar nuk mbulon të gjithë shumën e detyrimit tatimor të papaguar të tatimpaguesit, administrata tatimore mund të nxjerrë një njoftim për palët e treta, me të cilin urdhëron shlyerjen e drejtpërdrejtë të pagesës, brenda 14 ditëve kalendarike, nga data e marrjes së njoftimit ose që vlerësohet të jetë marrë, në një shumë të barabartë me vlerën e pasurisë së transferuar nga tatimpaguesi te pala e tretë, kur ky transferim është kryer pas nxjerrjes së

*njoftimit të administratës tatimore për sekuestrimin e pasurisë..” dhe neni 99 “Përgjegjësia e ortakut, e aksionerit dhe e administratorit “ sipas këtij neni “nëse edhe pas shitjes së pasurisë së sekuestruar detyrimet tatimore të personit juridik nuk shlyhen plotësisht, atëherë detyrimi tatimor i mbetur transferohet për llogari të ortakut, aksionarit dhe administratorit përgjegjës për shlyerjen e detyrimit tatimor, në përputhje me nenin 16 të ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare..”*

Masat shtrënguese të marra për mbledhjen e detyrimeve tatimore të papaguara dhe arkëtimet gjatë vitit 2022 paraqiten si më poshtë:

Në mijë lekë

	Masat shtrënguese, 2022	Të Vendosura		Të Arketuara		Efektiviteti	Të liruara	
		Nr.raste	Shuma	Nr.raste	Shuma	%	Nr.raste	Shuma
1	Njoftim dhe kërkesë për të paguar	656	7,830,456	636	2,088,356	27 %	-	-
2	Urdhër bllokim të llogarive bankare	80	8,448,191	49	829,783	10 %	4	18,731
3	Urdhër ekzekutime	52	590,376	52	576,532	98 %	-	-
4	Njoftim i përgjithshëm për vendosjen e barrës hipotekore dhe siguruese	9	2,149,595	-	-	0 %	-	-
5	Njoftim tatimpaguesit për vendosjen e barrës hipotekore dhe siguruese	7	5,252,700	-	-	0 %	-	-
6	Njoftim për vendosjen e barrës hipotekore	7	5,252,700	-	-	0 %	-	-
7	Njoftim për vendosjen e barrës siguruese	7	5,252,700	-	-	0 %	3	12,977
8	Urdhër sekuestrimi	-	-	-	-	0 %	-	-
9	Njoftim transferimi detyrimi tatimor palës së tretë	-	-	-	-	0 %	-	-
10	Njoftim dhe kërkesë për të paguar nga palët e treta në zbatim të nenit 98	-	-	-	-	0 %	-	-
11	Njoftim për transferimin e detyrimit Ortakut, Aksionerit, Administratorit	-	-	-	-	0 %	-	-
12	Kërkesë për pezullim të aktivitetit në Doganë	10	5,308,366	-	-	0 %	-	-
13	Njoftim për vendosjen e masës së sigurimit tatimor në QKB	9	5,248,322	-	-	0 %	-	-
14	Konfiskim te xhiros	222	1,061,700	-	-	91 %	-	-
	<b>TOTALI</b>	<b>837</b>	<b>45,333,416</b>	<b>737</b>	<b>3,494,671</b>	<b>8 %</b>	<b>7</b>	<b>31,708</b>

Burim : të dhëna nga DTM

Për vitin 2022, sikundër vërehet nga tabela e mësipërme janë vendosur në numër 837 masa shtrënguese me një vlerë prej 45,333,416 mijë lekë. Janë arkëtuar 3,494,671 mijë lekë. Masa shtrënguese që është aplikuar më tepër ndaj tatimpaguesve është “Njoftim dhe kërkesë për të paguar” më 1,232 raste për vlerën prej rreth 4,839,212 mijë lekë detyrim, nga të cilat janë arkëtuar 636 raste me vlerë 2,088,356 mijë lekë ose 46% te masave të vendosura për detyrimin. Konstatohet se nga ana e drejtorisë nuk është ezauruar në asnjë rast masa; “Njoftim transferimi detyrimi tatimor palës së tretë në zbatim të nenit 98”, “Njoftim për transferimin e detyrimit Ortakut, Aksionerit, Administratorit” dhe “Urdhër sekuestrimi” në kundërshtim me përcaktimet ligjore në ligjin Nr. 9920, datë 19.05.2008 “Procedura Administrative Tatimore “, kreu XI “Mbledhja me forcë e detyrimit tatimorë të papaguar”, neni 97 dhe neni 99 të cituar si më sipër si edhe në kundërshtim me neni 98 “E drejta për të kërkuar detyrimet nga pala e tretë” ku citohet ” Administrata tatimore njëkohësisht me procedurat e tjera të përcaktuara në këtë kre mund t’i kërkojë palës së tretë të kryejë pagesën e drejtpërdrejtë të çdo shume, që kjo palë i detyrohet tatimpaguesit, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e dërgimit të njoftimit palës së tretë...”, në kundërshtim me neni 94 “Urdhri i sekuestrimit “ dhe neni 93 “Sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurisë” ku përcaktohet “..Urdhri për sekuestrimin e pasurisë bëhet me shkrim nga drejtori i drejtorisë përgjegjëse për mbledhjen e detyrimeve të papaguara ose titullari i zyrës tatimore të qeverisjes

vendore. Urdhri duhet të identifikojë tatimpaguesin, pasuria e të cilit është objekt i sekuestrimit, vendndodhjen e pasurisë dhe vlerësimin e tatimit, për të cilin vihet sekuestroja. Urdhri i dërgohet tatimpaguesit me postë rekomande. Administrata tatimore mund ta sekuestrojë pasurinë sipas detyrimit vetëm pas vendosjes së masës së sigurisë mbi pasurinë, në përputhje me nenin 91 të këtij ligji dhe vetëm 30 ditë kalendrike pas datës, kur urdhri i sekuestrimit është marrë ose vlerësohet të jetë marrë nga tatimpaguesi, në formën e parashikuar në nenin 94 të këtij ligji..”. Masat shtrënguese për tatimpaguesit që zënë peshën më të madhe në totalin e detyrimit tatimor të papaguar në DTM janë paraqitur të detajuar ne Aneks nr.1 “Procedura e ndjekur nga drejtoria për debitorët që zënë peshën më të madhe në DTM “.

Nga auditimi rezultoi se në vitin 2021 dhe në vitin 2022 Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të papaguara në DTM nuk ka deklaruar detyrim të papaguar në afat si Detyrim të pa mbledhshëm.

**Titulli i gjetjes:** **Rritja e detyrimeve tatimor të papaguara në fund të vitit 2021 me afërsisht 700 milion lekë të detyrimeve të papaguara dhe me 37 të debitorëve të shtuar në fund të vitit 2021.**

**Situata:** Nga auditimi i drejtorisë DMDTP në DTM rezultoi se gjendja e detyrimeve të papaguara në fillim të vitit 2021 paraqitet në vlerën 12,509 milion lekë që i përket një numri prej 271 subjektsh debitorë, dhe në fund të vitit 2021 këto detyrime rezultojnë në vlerën 13,209 milion lekë që i përket një numri prej rreth 308 subjektsh debitorë. Pra, rritja e pësuar neto e detyrimeve nga 01.01.2021 në 31.12.2021 është rreth 700 milion lekë të detyrimeve të papaguara dhe me 37 të debitorëve të shtuar në fund të vitit. Detyrimet e shtuara të vitit 2021<sup>25</sup> i përkasin 741 subjekteve me vlerë totale prej 6,375 milion lekë.

Gjithashtu, gjendja e detyrimeve të papaguara në fillim të vitit 2022 paraqitet në vlerën 13,208 milion lekë që i përket një numri prej 308 subjektsh debitorë dhe në fund të vitit 2022 këto detyrime rezultojnë në vlerën 12,484 milion lekë që i përket një numri prej rreth 257 subjektsh debitorë. Pra, ulja e pësuar neto e detyrimeve nga 01.01.2022 në 31.12.2022 është rreth 724 milion lekë të detyrimeve të papaguara dhe me 51 të debitorëve të pakësuar në fund të vitit.

**Kriteri:** Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë“, i ndryshuar, pika 1 neni 88 ku përcaktohet se “Administrata tatimore ka autoritetin dhe kompetencat e dhëna sipas këtij kreu për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara për të cilat nuk është ushtruar e drejta e ankimit apo kanë kaluar të gjitha fazat e shqyrtimit administrativ dhe gjyqësor”, Manuali i Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara në hyrje përcakton se “Ky manual del në ndihmë të inspektorëve tatimorë gjatë punës së tyre për mbledhjen e detyrimeve të papaguara” si dhe gjithë dokumenti i është dedikuar procedurave që do të ndiqen në këtë drejtim.

**Ndikimi:** Rritja e stokut të detyrimeve të papaguara.

**Shkaku** Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të papaguara në DTM nuk i ka përdorur të gjithë kompetencat dhe autoritetin e dhënë sipas kreut Nr.XI të ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara për të cilat nuk është ushtruar e drejta e ankimit apo kanë kaluar të gjitha fazat e shqyrtimit administrativ dhe gjyqësor.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandimi:** Nga Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të papaguara në DTM të merren masa konkrete në ushtrimin e kompetencave të dhëna sipas legjislacionit në fuqi, duke zbatuar mënyrat e vlerësimit të riskut, për të përcaktuar dhe zbatuar,

---

<sup>25</sup> Pa përfshirë detyrimet e pakësuar përgjatë vitit 2021.

në çdo rast, masën më të përshtatshme të mbledhjes me forcë, në mënyrë që të maksimizohet mbledhja e detyrimeve tatimore të papaguara.

**Titulli i gjetjes: Mos mbulim i borxhit tatimor me të gjithë masat shtrënguese gjatë vitit 2021 dhe vitit 2022.**

**Situata:** Nga auditimi i masave shtrënguese rezultoi se nga ana e Drejtorisë së Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara nuk janë përmbushur të gjitha detyrimet institucionale gjatë vitit 2021 dhe vitit 2022 lidhur me zbatimin e masave shtrënguese me efekte negative në buxhetin e shtetit të përcaktuara në Manualin “Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar”, kreu XI si dhe Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 99, neni 97 dhe neni 98. Konstatohet se nga ana e drejtorisë gjatë vitit 2021 nuk është ezauruar në asnjë rast masa “Njoftim transferimi detyrimi tatimor palës së tretë” dhe “Njoftim për transferimin e detyrimit Ortakut, Aksionerit, Administratorit”. Konstatohet se nga ana e Drejtorisë gjatë vitit 2022 nuk është ezauruar në asnjë rast masa shtrënguese; “Njoftim transferimi detyrimi tatimor palës së tretë në zbatim të nenit 98”, “Njoftim për transferimin e detyrimit Ortakut, Aksionerit, Administratorit” dhe “Urdhër sekuestrimi”.

**Kriteri:** Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 98 “E drejta për të kërkuar detyrimet nga pala e tretë”, neni 93 “Sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurisë”, neni 97 “Transferim i detyrimit tatimor palës së tretë”, neni 99 “Përgjegjësia e ortakut, e aksionerit dhe e administratorit “ dhe në kundërshtim më Manualin “Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar”, kreu XI “Masat shtrënguese” .

**Ndikimi:** Mos mbulimi i borxhit tatimor me të gjithë masat shtrënguese , rrit riskun e mos arkëtimit të detyrimeve të papaguara nga subjektet.

**Shkaku** Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të papaguara ne DTM nuk i ka përdorur të gjithë instrumentet ligjorë për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara për te cilat nuk është ushtruar e drejta e ankimit apo kanë kaluar të gjitha fazat e shqyrtimit administrativ dhe gjyqësor .

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandimi:** Nga Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të papaguara në DTM të merren masa e nevojshme për të siguruar mbulimin e debitorëve me të gjithë masat shtrënguese të përcaktuara në legjislacionin në fuqi , me qëllim uljen e riskut të mos arkëtimit të detyrimeve tatimore të papaguara.

**Titulli i gjetjes: Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të papaguara ne DTM nuk është plotësuar me numrin e nevojshëm të punonjësve sipas strukturës.**

**Situata:** Nga auditimi konstatohet se kjo drejtori ka funksionuar me strukture jo të plotë gjatë vitit 2021 nga 11 punonjës në plan ka në fakt 9 punonjës, pra me 2 vende vakante (1 (një) inspektor, Sektori i Zbatimit në Terren të masave shtrënguese dhe 1 (një) Përgjegjës sektori, Sektori i Procedurave Ligjore të Mbledhjes me Forcë). Gjatë vitit 2022 rezulton se nga 11 punonjës në plan ka në fakt 8 punonjës, pra me 3 vende vakante (2 (dy) inspektor, Sektori i Zbatimit në Terren të masave shtrënguese dhe 1 (një) Përgjegjës sektori, Sektori i Procedurave Ligjore të Mbledhjes me Forcë) ose me 80 % të strukturës në vitin 2021 dhe me 72 %, të strukturës në vitin 2022 pra jo në përputhje me strukturën organike të miratuar. Kjo situatë cenon përmbushjen me sukses të detyrave funksionale të drejtorisë.

**Kriteri:** Urdhri i Kryeministrit nr. 33, datë 12.02.2020 “Për miratimin e strukturës organizative të personelit të Administratës Tatimore Qendrore”

- Ndikimi:** Mosplotësimi i vendeve vakante për periudha të gjata kohore sjell performancë të ulët në punë dhe cenon përmbushjen e objektivave institucionale.
- Shkaku** Mungesa e plotësimit të vendeve vakante si edhe transferim punonjësi në drejtori të tjera.
- Rëndësia:** E lartë
- Rekomandimi:** Titullari i DTM, në bashkëpunim edhe me DPT, të marrë masa për plotësimin e vendeve vakante, pjesë të shërbimit civil sipas pozicioneve të miratuara në Urdhrin e Kryeministrit nr. 33, datë 12.02.2020 “Për miratimin e strukturës organizative të personelit të Administratës Tatimore Qendror”.

Për subjektet që janë në proces ankimimi njoftimi i DTM nga strukturat përgjegjëse mbi këtë status nuk jepet sipas përcaktimeve dhe afateve ligjorë të përcaktuara në manual “Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar dhe ligj nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 18 “Struktura e Apelit tatimor”. Me hollësisht trajtuar më poshtë:

Nga auditimi i dokumenteve dhe i informacionit të hedhur në sistemit u konstatuan se për 19 subjekte që janë në procedurë ankimimi rezultojnë me çështje të hapura në sistem ose është vijuar më procedurën e mbledhjes së detyrimit tatimorë në kundërshtim me manualin “Manualin e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara” Kreu III, kapitulli 3.2 “Moduli i çështjeve”, pika 3.2.2 “Mbyllja e çështjeve” dhe pika 3.3.2 “Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor” citohet “Sistemi tatimor C@TS mundëson që detyrimet tatimore të cilat janë në proces ankimimi administrative apo gjyqësor të cekohen nga personat përgjegjës. Në këtë mënyrë përdoruesit e sistemit C@TS mund të shikojnë te debia e llogarisë së tatimpaguesit nëse ka të shënuar në apel një detyrim tatimor. Në përmbushje të dispozitës ligjore të sipërcituar, në modulën e çështjeve nuk hapen çështje për detyrimet tatimore të çekuara në apel. Çështjet hapen vetëm për detyrimet të papaguara në afat dhe të paçekuara në apel, në mënyrë që të ndiqet mbledhja e këtyre detyrimeve nga inspektori i caktuar në DMDTP në Rajone duke zbatuar procedurat ligjore të mbledhjes me forcë në përputhje me hapet e veprimeve të çështjes”. Nga auditimi u konstatua se kjo situatë krijohet për dy arsye: 1) Për këto raste nuk është hedhur në sistem C@TS informacioni për detyrimin tatimor në apel nga personat përgjegjës sipas pikës 3.3.2 “Mbledhje me forcë e detyrimit tatimor”. Në mos përmbushje të kësaj dispozite ligjore, në modulën e çështjeve hapen çështje për detyrimet tatimore që janë në proces ankimimi administrativ apo gjyqësor, pra vijohet me procedurën ligjore të mbledhjes së detyrimit. 2) Si dhe nuk informohet në kohë DMDTP në DTM nga drejtorja përgjegjëse referuar në ligjin 9920, Kreu XII, neni 106 pika 4 “Drejtorja e apelimt i dërgon një kopje të ankimit administratës tatimore, që ka nxjerrë vlerësimin tatimor ose vendimin, objekt të ankimit tatimor”. Kjo mungesë informacioni jo sipas përcaktimeve ligjore për drejtorinë sjell jo vetëm pasoja juridike por edhe organizative siç është angazhimi i stafit për të ndjekur këto raste. Nga komunikimi me subjektin konfirmon se ky problem është i vazhdueshëm.

**Titulli i gjetjes:** Detyrimet tatimore të cilat janë në proces ankimimi administrativ apo gjyqësor nuk cekohen nga personat përgjegjës nëse kanë detyrim tatimor në apel në sistemin tatimor C@ts sipas përcaktimeve ligjore .

**Situata:** Nga auditimi i dokumenteve dhe i informacionit të hedhur në sistemit u konstatuan se për 19 subjekte që janë në procedurë ankimimi rezultojnë me çështje të hapura në sistem ose është vijuar më procedurën e mbledhjes së detyrimit tatimorë në kundërshtim me manualin “Manualin e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara” Kreu III, kapitulli 3.2 “Moduli i çështjeve”, pika 3.2.2 “Mbyllja e

çështjeve “dhe pika 3.3.2 “Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor” ku citohet “Sistemi tatimor C@TS mundëson që detyrimet tatimore të cilat janë në proces ankimimi administrative apo gjyqësor të çekohen nga personat përgjegjës. Në këtë mënyrë përdoruesit e sistemit C@TS mund të shikojnë te debia e llogarisë së tatimpaguesit nëse ka të shënuar në apel një detyrim tatimor. Në përmbushje të dispozitës ligjore të sipërcituar, në modulën e çështjeve nuk hapen çështje për detyrimet tatimore të çekuara në apel...”. Nga auditimi u konstatua se kjo situatë krijohet për dy arsye: 1) Për këto raste nuk është hedhur në sistem C@TS informacioni për detyrimin tatimor në apel nga personat përgjegjës sipas pikës 3.3.2 “Mbledhje me forcë e detyrimit tatimor “. Në mos përmbushje të kësaj dispozite ligjore, në modulën e çështjeve hapen çështje për detyrimet tatimore proces ankimimi administrativ apo gjyqësor, pra vijohet me procedurën ligjore të mbledhjes së detyrimit tatimor. 2) Si dhe nuk informohet në kohë DMDTP në DTM nga drejtoria përgjegjëse referuar në ligjin 9920, Kreu XII, neni 106 pika 4 ” Drejtoria e apelimit i dërgon një kopje të ankimit administratës tatimore, që ka nxjerrë vlerësimin tatimor ose vendimin, objekt të ankimit tatimor”. Kjo mungesë informacioni ka sjellë jo vetëm pasoja juridike, por edhe organizative, siç është angazhimi i stafit dhe kohë e panevojshme për të ndjekur këto raste.

<b>Kriteri:</b>	Ligji Nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” neni 18 “Struktura e Apelit tatimorë” dhe Manuali “Manuali i Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara” Kreu III, kapitulli 3.2 “Moduli i çështjeve”, pika 3.2.2 “Mbyllja e çështjeve “dhe pika 3.3.2 “Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor”.
<b>Ndikimi:</b>	Për subjektet tatimore të cilat janë në proces ankimimi administrativ apo gjyqësor vijohet procedura ligjore e mbledhjes së detyrimit tatimorë.
<b>Shkaku</b>	Strukturat përgjegjëse nuk kanë zbatuar përcaktimet ligjorë për hedhjen e informacionit në sistem c@ts për subjektet që janë në proces ankimimi administrative ose gjyqësor si edhe nuk njoftojnë sipas afatit drejtorinë DMDTTP në DTM.
<b>Rëndësia:</b>	E mesme
<b>Rekomandimi:</b>	Titullari i DTM të marrë masa për përcjelljen e kësaj problematike pranë MFE, ku Struktura e Apelit Tatimor në MFE të shqyrtojë situatën e mësipërme, në mënyrë që të garantohet raportimi i informacionit në sistemin C@TS sipas përcaktimeve ligjore për rastet që janë në proces ankimimi.

Për sa konstatuar mësipërm subjekti i audituar Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara në DTM me shkresën nr.14/11 prot., me datë 12.09.2023 ka sjellë observacionet mbi projekt raportin të cilat shkurtimisht po i paraqesim si më poshtë:

**Pretendimi i subjektit:**

Lidhur me sa është rekomanduar nga ana e DMDTP është vijuar me ndjekjen e procedurave sipas ligjit duke ulur ndjeshëm detyrimet tatimore të papaguara. Kjo vërehet edhe në evidencat e detyrimeve tatimore të papaguara, në vitin 2022 kemi një ulje të ndjeshme jo vetëm në numrin e debitorëve por edhe në vlerë krahasuar me vitin 2021. Konkretisht kemi një ulje të numrit me 51 debitorë më pak se në vitin 2021 dhe 724278 mijë lekë më pak se në vitin 2021. Në vijim në vitin 2023 DMDTP në DTM ka vijuar me procedurat për mbledhjen e detyrimit tatimorë sipas legjislacionit në fuqi si rezultat kemi një rënie për vitin 2023 të detyrimit tatimorë të papaguara. Lidhur me sa është rekomanduar në projekt raport ju informojmë se DMDTP ka vijuar me procedurën e mëtejshme për arkëtimin e detyrimeve të papaguara sipas legjislacionit në fuqi si edhe lidhur me sa është konstatuar nga grupi i auditimit për ezaurimin e masës shtrënguese sipas nenit 97 “Transferimi i detyrimit tatimor palës së tretë” dhe nenit 99 “Përgjegjësia e ortakut, aksionerit dhe administratorit, ju sqaroj si më poshtë: Duke ju referuar analizës së kryer në lidhje me masat shtrënguese të marra nga ana e Drejtorisë së Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore

të Papaguara për tatimpaguesit debitorë e evidentuar kjo rast pas rasti, rezulton se nuk janë evidentuar raste të tatimpaguesve debitorë për të cilët duhet të vijohet me këto masa shtrënguese, kjo pasi nga dokumentacioni i shqyrtuar në dosjen fizike të tatimpaguesit që ndodhet në arkivë, dokumenteve të dorëzuar nga vetë tatimpaguesit në sistemin tatimor C@ts, si dhe kthim përgjigjeve zyrtare nga institucionet përkatëse (konkretisht nga Bankat e nivelit të dytë, ASHK, DPSHTRR, RBS etj.), siç edhe pretendohet në akt konstatimin e mbajtur .

Lidhur me sa është rekomanduar ju informojmë se nga ana jonë janë evidentuar të gjithë rastet e debitorëve në proces ankimimi dhe nuk janë cekuar detyrimet nga DAT në MFE.

**Oëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:**

*Në lidhje me observacionet e bëra nga subjekti i audituar DTM mbi Projekt Raportin, datë 30.06.2023, dërguar me shkresën nr. 52/25, datë 11.07.2023 grupi i auditimit gjykon se:*

*Nga grupi auditues sqarohet se konstatimi i bërë mbi rritje e detyrimit tatimorë të papaguar është për vitin 2021 ku rezulton një rritje e borxhit me afërsisht 700 milion lekë. Në lidhje me masat shtrënguese grupi auditues i qëndron mendimit se për periudhën objekt auditimi detyrimi tatimorë i papaguar nuk është i mbuluar më të gjithë masat shtrënguese, pra nuk është ezauruar procedura e mbledhjes me forcë sipas përcaktimeve në Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 98 “E drejta për të kërkuar detyrimet nga pala e tretë”, neni 93 “Sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurisë”, neni 97 “Transferim i detyrimit tatimore palës së tretë”, neni 99 “Përgjegjësia e ortakut, e aksionerit dhe e administratorit “ dhe në kundërshtim më Manualin “Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar”, kreu XI “Masat shtrënguese”. Lidhur me rekomandimin për rastet që janë në proces ankimimi por kanë të cekuar si informacion në c@ts sqarohet se edhe në raport jemi shprehur se ky proces nuk është kryer nga DAT dhe për këtë duhet të bëni me dijeni MFE, të merrni masa duke e përcjellë si problem në formë shkresore.*

*Gjykojmë se nga DMDTP në DTM nuk janë sjellë argumente të qenësishme të cilat mund të ndikojnë në konstatimet tona të cilat janë bazuar në dokumente e fakte. Për sa më lart argumentet e sjella, nuk qëndrojnë dhe nuk merren parasysh nga grupi i auditimit.*

**2.5. Mbi përputhshmërisë dhe rregullshmërinë në ekzekutimin e buxhetit vjetor, për periudhën në auditim**

**Mbi buxhetin 2021- 2022**

Me shkresë datë 19.01.2021, nr. 341/1 prot. DTM ka dërguar pranë DPT relacionin shpjegues për parashikimin e fondeve buxhetore për vitin 2021. Në këtë shkresë janë argumentuar kërkesat buxhetore për çdo llogari ekonomike Fondet buxhetore për vitin 2021 dhe për vitin 2022 janë çelur në zbatim të ligjit nr. 137/2020 “Për Buxhetin e vitit 2021” dhe ligjit nr. 115/2021 “Për Buxhetin e vitit 2022”. Me shkresë datë 28.01.2021, nr. 24619/4 prot. “ Dërgohet limiti mujorë i fondeve buxhetore për shpenzimet korrente të vitit 2021” në DPT. Me shkresë nr. 2690 prot., datë 11.02.2021 janë dërguar nga DPT limitet mujore të fondeve buxhetore për vitin 2021. Tabela në vijim paraqet zërat e buxhetit për vitin 2021, raportuar nga struktura e Financës në DTM;

Viti 2021

Në mijë lekë

Llogaria	Emërtimi	Plani 2021	Fakti 2021	% e Realizimit
600	Paga	122,252	122,044	98 %
601	Sigurime Shoq. Shënd	20,648	20,353	98.5 %
602	Mallra dhe Shërbime	5,000	4,995	99 %
606	Shpenzime kapitale të trupëzuara	94	94	100 %
	<b>Totali</b>	<b>147,994</b>	<b>147,487</b>	<b>99.7 %</b>

Burim ; Të dhëna nga DTM

**Në total për vitin 2021**, shpenzimet për paga art. 600, janë planifikuar në shumën 122,252 mijë lekë ose 83 % e totalit të buxhetit dhe janë shpenzuar në shumën totale 122,044 mijë lekë, me një realizim prej 98%. Shpenzimet për sigurime shoqërore dhe shëndetësore art.601 janë planifikuar në shumën 20,648 mijë lekë ose 13.9 % e total buxhetit dhe janë shpenzuar në shumën totale



20,353 mijë lekë, me një realizim prej 98.5 %. Shpenzimet për Mallra dhe Shërbime art.602 janë planifikuar në shumën 5,000 mijë lekë ose 3 % e total buxhetit dhe janë shpenzuar në shumën totale 4,995 mijë lekë, me një realizim prej 99 %. Shpenzimet për kapitale të trupëzuar janë planifikuar në shumën 94 mijë lekë ose 0.1 % e total buxhetit dhe janë shpenzuar në shumën totale 94 mijë lekë, me një realizim prej 100 %. Në total buxheti i planifikuar në vlerën 147,994 mijë është realizuar në vlerën 147,487 mijë lekë ose 99.7 % pra me një mos realizim në vlerën 506 mijë lekë. Realizimi i strukturës së DTM paraqitet si vijon;

Nr.	Viti 2021	Nr
1	Nr. i planifikuar i punonjësve në strukturë	128
2	Nr. faktik i punonjësve në strukturë	123
3	Vende të lira pune	5

Burim : të dhëna nga DTM

Nga krahasimi i të dhënave faktike për vitin 2021, të raportit të DTM me të dhënat e thesarit dhe të DTP për të njëjtën periudhë raportuese vlerësojmë faktin se për vitin 2021 nuk ka diferenca të planit të buxhetit për të gjitha shpenzimet, po ashtu edhe të realizimit faktit për shpenzimet korrente.

Me shkresë datë 14.01.2022, nr. 154 prot. DTM ka dërguar pranë DPT relacionin shpjegues për parashikimin e fondeve buxhetore për vitin 2022. Me anë të kësaj memoje argumentohet parashikimi i fondeve buxhetore për çdo llogari ekonomike.

Fondet buxhetore për vitin 2022 janë çelur në zbatim të ligjit nr. 115/2021 “Për Buxhetin e vitit 2022”. Me shkresë nr. 22922/36 prot., datë 18.01.2022 është dërguar detaji mi i buxhetit për vitin 2022 për shpenzimet korrente.

*Në mijë lekë*

Llogaria	Emërtimi	Plani 2022
600	Shpenzime personeli	150,000
602	Mallra dhe Shërbime	5,000
	<b>Totali</b>	<b>155,000</b>

Burim : të dhëna nga DTM

Gjatë vitit 2022 buxheti i DTM është ndryshuar sipas tre kërkesave për rialokim fondi drejtuar DPT, të paraqitura në tabelën e mëposhtme:

*Në mijë lekë*

Llogaria	Emërtimi	Shtesa	Pakësimë	Shkresa
60099	Shpenzime personeli		3,500	Shkresa nr.9350 prot., datë 02.06.2022
602	Mallra dhe shërbime	2,000		Shkresa nr.9350 prot., datë 02.06.2022
602	Mallra dhe shërbime	1,500		Shkresa nr. 14709/1 prot. date 16.08.2022
60099	Shpenzime personeli		1,000	Shkresë nr. 19275/ 4 prot., datë 07.11.2022
602	Mallra dhe shërbime	1,000		Shkresë nr. 19275/ 4 prot., datë 07.11.2022
	<b>Totali</b>	<b>4,500</b>	<b>4,500</b>	

Burim : të dhëna nga DTM

Tabela në vijim paraqet zërat e buxhetit për vitin 2022, raportuar nga struktura e Financës në DTM;

Viti 2022

*Në mijë lekë*

Llogaria	Emërtimi	Plani 2022	Fakti 2022	% e Realizimit
600	Paga	124,600	121,697	98 %
601	Sigurime Shoq. Shënd	21,100	20,580	98 %
602	Mallra dhe Shërbime	9,500	9,494	99 %
606	Shpenzime kapitale të trupëzuara	94,000	94,000	100 %
	<b>Totali</b>	<b>155,294</b>	<b>153,457</b>	<b>99 %</b>



**Në total për vitin 2022**, shpenzimet për paga art. 600, janë planifikuar në shumën 124,600 mijë lekë ose 80 % e totalit të buxhetit dhe janë shpenzuar në shumën totale 121,697 mijë lekë, me një realizim prej 98%. Shpenzimet për sigurime shoqërore dhe shëndetësore art.601 janë planifikuar në shumën 21,100 mijë lekë ose 14 % e total buxhetit dhe janë shpenzuar në shumën totale 20,580 mijë lekë, me një realizim prej 98 %. Shpenzimet për Mallra dhe Shërbime art.602 janë planifikuar në shumën 9,500 mijë lekë ose 6 % e total buxhetit dhe janë shpenzuar në shumën totale 9,494 mijë lekë, me një realizim prej 99 %. Shpenzimet për kapitale të trupëzuar janë planifikuar në shumën 94 mijë lekë ose 0.06 % e total buxhetit dhe janë shpenzuar në shumën totale 94 mijë lekë, me një realizim prej 100 %. Të total buxheti i planifikuar prej 155,294 mijë lekë është realizuar në vlerën 153,457 mijë lekë ose 99 % realizim pra me një mos realizim prej 1,837 mijë lekë.

Realizimi i strukturës se DTM paraqitet si vijon;

	Viti 2022	Nr.
1	Nr. i planifikuar i punonjësve në strukturë	128
2	Nr. faktik i punonjësve në strukturë	119
3	Vende të lira pune	9
	Realizimi në % i strukturës	93 %

Burimi: Të dhëna nga DTM

Me shkresën nr.1108 prot., datë 07.02.2023 është dërguar pranë DPT, evidence “Raportim mbi realizimin e shpenzimeve te Institucionit” për periudhën Dhjetor 2022 (progresive). Bashkëngjitur është edhe formati i rakordimit me degën e thesarit për vitin 2022. Nga krahasimi i të dhënave faktike për vitin 2022, të raportit të DTM me të dhënat e thesarit dhe të dhënat e DTP për të njëjtën periudhë raportuese vlerësojmë faktin se për vitin 2022 nuk ka diferenca të planit të buxhetit për të gjitha shpenzimet, po ashtu edhe të realizimit faktit për shpenzimet korrente.

#### **Auditimi i procedurave të prokurimit të fondeve publike.**

Nga auditimi u shqyrtua dokumentacioni në lidhje me regjistrin e parashikimit dhe realizimit të prokurimeve publike, në drejtim të afateve të hartimit të regjistrit të prokurimeve me vlerë të vogël bazuar në nevojat për mallra/punë dhe shërbime dhe raportimit të realizimit të tyre.

#### **Vitin 2021**

Me shkresë nr.724 prot, datë 26.01.2021 është dërguar regjistri i parashikimeve të prokurimeve për mallra/punë/shërbime, limitet e shpenzimeve korente, jashtë afateve kohore, jo në përputhje me kërkesat e VKM nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar, nenit 4, pika 1 “Regjistri i parashikimeve të procedurave të prokurimeve publike”. DTM ka planifikuar të realizojë prokurim publik për 16 raste, në vlerën 4,526,667 lekë (pa TVSH), me burim financimi buxhetin e shtetit. Në regjistër janë përcaktuar objekti i prokurimit, fondi limit i përgjithshëm, procedura e prokurimit, koha e zhvillimit dhe burimet financiare, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe VKM nr.419, datë 29.12.2014 “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar, si dhe Udhëzimeve të APP-së.

Nga auditimi konstatohet se: Hartimi i regjistrit nuk është bërë në përputhje me kuadrin ligjor të Prokurimit Publik pasi, disa nga zërat e regjistrit janë shpenzime të cilat nuk kryhen nëpërmjet procedurave të prokurimit publik konkretisht, zërat:1) Shpenzime uji 2) Shpenzime telefoni 3) Shpenzime poste 4) Shpenzime diete 5) Shpenzime qeramarrje 6) Shpenzime gjyqësore 7) Shpenzime takse 8) Shpenzime energjie, veprime këto në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 4, pika 1, si dhe me Udhëzimin e APP nr.01, datë 05.01.2018, “Për hartimin e regjistrit të parashikimeve të

procedurave të prokurimit publik dhe regjistrit të realizimeve të procedurave të prokurimit dhe krijimi i tyre në sistemin e prokurimit elektronik”, kreu I, pika 1.

Për sa më sipër regjistri i parashikimeve të prokurimeve për prokurimet me blerje të vogël nën vlerën 100,000 lekë faktikisht rezulton për 6 raste, me vlerë 788,334 lekë (pa TVSH), me burim financimi buxhetin e shtetit.

Titullari i DTM për realizimin e procedurave të prokurimeve me blerje me vlerë të vogël gjatë vitit 2021 ka nxjerrë Urdhrin e Brendshëm nr. 341, datë 10.01.2021 “Për krijimin e komisionit të prokurimeve për blerjet me vlerë të vogël”. Për vitin 2021 janë bërë dy blerje të vogla nën 100,000 lekë (85,000 lekë dhe 99,800 lekë) “Shpenzime për mirëmbajtje” dhe “ Shërbim për siguracion”.

“Planifikimi dhe realizimi i procedurave të prokurimit për vitin 2021”

në lekë

Nr.	Lloji i procedurës	Parashikimi		Realizimi	
		Numri	Vlera pa TVSH	Numri	Vlera me TVSH
1	Blerje me Vlerë të Vogël	6	456,667	1	89,897
<b>SHUMA</b>					

Burimi: Regjistri i Parashikimit dhe Realizimit për IIPP

## Vitin 2022

Me shkresë nr.647 prot, datë 02.02.2022 është dërguar regjistri i parashikimeve të prokurimeve për mallra/punë/shërbime, limitet e shpenzimeve korente në DPT, jashtë afateve kohore, jo në përputhje me kërkesat e VKM nr. 285, datë 19.05.2021, nenit 3, pika 3 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar citon “Në çdo rast, afati maksimal i hartimit të regjistrit është jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë nga miratimi i ligjit për buxhetin për vitin ushtrimor pasardhës.” DTM ka planifikuar të realizojë prokurim publik për 15 raste, në vlerën 4,408,333 lekë (pa TVSH), me burim financimi buxhetin e shtetit. Në regjister janë përcaktuar objekti i prokurimit, fondi limit i përgjithshëm, procedura e prokurimit, koha e zhvillimit dhe burimet financiare, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe VKM nr.419, datë 29.12.2014 “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar, si dhe Udhëzimeve të APP-së. Nga auditimi konstatohet se: Hartimi i regjistrit nuk është bërë në përputhje me kuadrin ligjor të Prokurimit Publik pasi, disa nga zërat e regjistrit janë shpenzime të cilat nuk kryhen nëpërmjet procedurave të prokurimit publik konkretisht, zërat: 1) Shpenzime uji 2) Shpenzime telefoni 3) Shpenzime poste 4) Shpenzime diete 5) Shpenzime qeramarrje 6) Shpenzime gjyqësore 7) Shpenzime takse 8) Shpenzime energjie, veprime këto në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 4, pika 1, si dhe me Udhëzimin e APP nr.01, datë 05.01.2018, “Për hartimin e regjistrit të parashikimeve të procedurave të prokurimit publik dhe regjistrit të realizimeve të procedurave të prokurimit dhe krijimi i tyre në sistemin e prokurimit elektronik”, kreu I, pika 1.

Regjistri përfundimtarë i ndryshuar datë 21.11.2022 me nr. 9732 prot. ka planifikuar 6 blerje me procedure prokurimi blerje e vogël në vlerë totale 1,048,017 lekë.

Titullari i DTM për realizimin e procedurave të prokurimeve me blerje me vlerë të vogël gjatë vitit 2022 ka nxjerrë Urdhrin e Brendshëm nr. 124, datë 10.01.2022 “Për krijimin e komisionit të prokurimeve për blerjet me vlerë të vogël”.

Për vitin 2022 janë realizuar 5 blerje me procedurë prokurimi blerje e vogël me vlerë totale 925,414 lekë ose me një realizim 88 % total buxhetit të planifikuar.

“Planifikimi dhe realizimi i procedurave të prokurimit për vitin 2022”

në lekë

Nr.	Lloji i procedurës	Parashikimi		Realizimi	
		Numri	Vlera pa TVSH	Numri	Vlera me TVSH
1	Blerje me Vlerë të Vogël	6	1,048,017	5	925,414
<b>SHUMA</b>					

Burimi: Regjistri i Parashikimit dhe Realizimit për IIPP

Nga dosjet e prokurimit u zgjodhën për auditim 2 procedura që zënë 85 % të total fondit.

### 1- Procedura e prokurimit “Shpenzime mirëmbajtje pajisje zyre”.

Urdhër prokurimi nr. 9970/1, datë 23.12.2022 miratuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor	<b>Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël</b>	-Fitues: “C” SHPK -Vlera fituese 99,000 lekë pa TVSH -Vlera kontratës ose faturës:
Fondi limit 100,000 lekë (pa TVSH)	sipas Urdhër i Brendshëm nr. 124 prot., datë 12.01.2022	Fatura tatimore me vlerë 99,000 lekë pa TVSH, (11,800 lekë me TVSH)
Procedura e prokurimit – blerje me vlerë të vogël nën 100 mijë lekë		
Burimi i Financimit: buxheti i shtetit	Fitues: “C”	-Diferenca nga fondi limit 1,000 lekë
Datë e hapjes së tenderit -	Marrin pjesë 3 OE	Titullar i AK – E.C

#### Dosja e Tenderit

Dosja e procedurës së prokurimit nuk është arkivuar, inventarizuar dhe numerizuar me numër fletësh, veprim në kundërshtim me nenin 36 “Arkivat e numerizuara”, të Ligjit Nr.9154, datë 6.11.2003 “Për Arkivat” dhe Udhëzimin Nr.03 datë 03.04.2014 “Për një shtesë në udhëzimin nr.4 datë 04.07.2013 të Agjensisë së prokurimit publik” “Për zhvillimin e prokurimeve me vlerë të vogël në sistemin e prokurimit elektronik për autoritetet kontraktore dhe operatorët ekonomikë”.

#### Argumentimi i fondit limit

Nga auditimi u konstatua se për llogaritjen e vlerës limit të kontratës nuk ka asnjë dokumentacion apo argumentim nga ana e Autoritetit Kontraktor për të justifikuar vlerën e fondit limit, veprim në pajtueshmëri me VKM Nr. 285 prot., datë 19.05.2021 “Rregullat e prokurimit publik”, Kreu X, neni 76 “Mënyrat për përllogaritjen e vlerës së prokurimit” dhe neni 56, pika 4, si edhe në kundërshtim me Udhëzimin date 05.06.2021 “ Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël”, pika7

#### Ftesa për ofertë

Nga auditimi u konstatua se për llogaritjen e vlerës limit të kontratës janë administruar ofertat nga 3 operatorë ekonomikë.

#### Vlerësimi i ofertave

Në procedurën e prokurimit u konstatua se kanë marrje pjesë 3 operatorë ekonomik. Kriter në llogaritjen e pikëve për operatorët ka qenë çmimi më i favorshëm.

Në përfundim janë renditur: 1) “C” SHPK me vlerë 99,000 lekë 2) “A” me vlerë 114,000 lekë 3) “R” SHPK me vlerë 117,000 lekë. Në klasifikimin përfundimtar rezulton i pari në klasifikim për ofertën më të favorshme “C” SHPK.

#### Zbatimi i kontratës

Për sa më sipër, fatura tatimore e lëshuar nga subjekti “C” SHPK me nipt K36608208V në vlerën 118,800 lekë me TVSH është likuiduar me urdhër shpenzimit nr. 427 datë 29.12.2022 në vlerën totale të faturës dhe brenda afateve të përcaktuara në ligjin e buxhetit. Bashkëlidhur është mbajtur procesverbali i realizimit të shërbimit.

### 2. Procedura e prokurimit “Për kryerjen e transportit/zhvendosjen e institucionit”.

Urdhër prokurimi nr 6111, datë 05.07.2022 miratuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor	<b>Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël</b>	-Fitues: “M” SHPK -Vlera fituese 688,000 lekë pa TVSH -Vlera kontratës ose faturës:
Fondi limit 1,000,000 lekë (pa TVSH)	sipas Urdhrit te Brendshëm nr. 124 prot., datë 12.01.2022	Fatura tatimore me vlerë 688,000 lekë pa TVSH, (11,800 lekë me TVSH)
Procedura e prokurimit – blerje me vlerë të vogël		
Burimi i Financimit: buxheti i shtetit	Fitues: “M” SHPK	-Diferenca nga fondi limit 312,000 lekë
Datë e hapjes së tenderit -06.07.2022	Marrin pjesë 11 OE S’ kualifikuar 1 OE	Titullar i AK – E. C

## **Dosja e Tenderit**

Dosja e procedurës së prokurimit nuk është arkivuar, inventarizuar dhe numerizuar me numër fletësh, veprim në kundërshtim me nenin 36 “Arkivat e numerizuara”, të Ligjit Nr.9154, datë 6.11.2003 “Për Arkivat” dhe Udhëzimin Nr.03 datë 03.04.2014 “Për një shtesë në udhëzimin nr.4 datë 04.07.2013 të Agjencisë së prokurimit publik” “Për zhvillimin e prokurimeve me vlerë të vogël në sistemin e prokurimit elektronik për autoritetet kontraktore dhe operatorët ekonomikë”.

Bashkëlidhur dosjes janë deklaratat e konfliktit të interesit nga të tre anëtarët e komisionit.

## **Argumentimi i fondit limit**

Nga auditimi u konstatua se për llogaritjen e vlerës limit të kontratës është mbajtur një procesverbal i protokolluar ana e Autoritetit Kontraktor për të justifikuar vlerën e fondit, veprim në pajtueshmëri me VKM Nr. 285 prot., datë 19.05.2021 “Rregullat e prokurimit publik”, Kreu X, neni 76 “Mënyrat për përllogaritjen e vlerës së prokurimit”.

## **Ftesa për ofertë**

Nga auditimi u konstatua se për llogaritjen e vlerës limit të kontratës janë administruar ofertat nga 11 operatorë ekonomikë ku 1 operator është skualifikuar pasi vlera është nën 50 % e fondit limit.

## **Vlerësimi i ofertave**

Në procedurën e prokurimit u konstatua se kanë marrje pjesë 11 operatorë ekonomik. Kriter në llogaritjen e pikëve për operatorët ka qenë çmimi më i favorshëm.

Në klasifikimin përfundimtar rezultoi i pari në klasifikim për ofertën më të favorshme M. SHPK, e vlerë ofertë 688,000 pa TVSH.

## **Zbatimi i kontratës.**

Për sa më sipër, është lidhur kontrata 12.07.2022 për kryerjen e shërbimit nga subjekti “M” SHPK, me nipt J.E në vlerën 826,000 lekë me TVSH ( fatura nr.41/2022 datë 02.08.2022, dhe fatura nr. 48/2022 datë 26.08.2022) është likuiduar me urdhër shpenzimit nr. 4246 datë 04.08.2022 në vlerën 521,400 dhe urdhër shpenzimit nr.288 datë 02.09.2022 në vlerën 304,200 lekë. Janë mbajtur dy procesverbale për kryerjen e shërbimit, procesverbali Nr. 1 datë 16.07.2022 dhe procesverbali Nr.2 datë 12.07.2022. Konstatohet se Procesverbalet e mbajtur nuk janë të protokolluar. Nga auditimi i dokumentacionit të praktikës së prokurimit konstatohet se nuk është zbatuar neni 4 i kontratës, janë mbajtur dy proces-verbale në kundërshtim me nenin 4 të kontratës, Kërkesat e raportimit ku citohet “Do të mbahet një proces-verbal, Proces verbali Nr.1 ndërmjet grupit të autorizuar nga DTM dhe përfaqësuesit të shoqërisë “.

**Titulli i gjetjes** Mos kryerja e inventarizimit dhe arkivimit të dosjeve të prokurimit dhe parregullsi të konstatuara në respektimin e rregullave të prokurimit publik në procedurat e prokurimit për blerjet e vogla nën 100 mijë lekë.

**Situata:** Nga auditimi u konstatua se dosjet e procedurave të prokurimit nuk janë inventarizuar dhe arkivuar me numër fletësh, duke sjellë pasiguri në plotësinë dhe administrimin e dokumentacionit të prokurimeve. Nga verifikimi i procedurave të prokurimit blerje me vlerë të vogël për vitin 2021-2022, rezultuan disa parregullsi, të tilla si:

- Mungesa e deklaratave të konfliktit të interesit nga anëtarët e komisionit të prokurimit në praktika prokurimi me procedure blerje e vogël nën 100 mijë lekë;
- Ofertat e marra nga operatorët ekonomik pa datë.
- Procesverbali i mbajtur nga anëtarët e komisionit për shpalljen e fituesit i pa protokolluar.

-Hartimi i regjistrit jo në përputhje me kuadrin ligjor të Prokurimit Publik pasi, disa nga zërat e regjistrit janë shpenzime të cilat nuk kryhen nëpërmjet procedurave të prokurimit publik konkretisht, zërat:1) *Shpenzime uji* 2) *Shpenzime telefoni* 3) *Shpenzime poste* 4) *Shpenzime diete* 5) *Shpenzime qeramarrje* 6) *Shpenzime gjyqësore* 7) *Shpenzime takse* 8) *Shpenzime energjie, veprime këto në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 4, pika 1, si dhe me Udhëzimin e APP nr.01, datë 05.01.2018, “Për hartimin e regjistrit të parashikimeve të procedurave të prokurimit publik dhe regjistrit të realizimeve të procedurave të prokurimit dhe krijimi i tyre në sistemin e prokurimit elektronik”, kreu I, pika 1.*

-Regjistri i parashikimeve të prokurimeve i dërguar jashtë afateve kohore të përcaktuar në VKM Nr. 285 prot., datë 19.05.2021 dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar, neni 4, pika 1.

**Kriteri:** VKM Nr. 285 prot., datë 19.05.2021 dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar, neni 4, pika 1, Udhëzimin e APP nr.1, datë 05.01.2018, kreu I, pika 1. Ligji nr. 9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat”, neni 36 “Arkivat e numerizuara”, Udhëzimi nr. 1, datë 05.01.2018 *Për hartimin e regjistrit të parashikimeve të procedurave të prokurimit publik dhe regjistrit të realizimeve të procedurave të prokurimit dhe krijimi i tyre në sistemin e prokurimit elektronik”, kreu I, pika 1.*

**Ndikimi:** Pasiguri në transparencën e procedurave të prokurimit blerje e vogël.

**Shkaku** Mos njohje dhe mos zbatim i legjislacionit.

**Rëndësia:** E Mesme

**Rekomandimi:** Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj në cilësinë e Autoritetit Kontraktor të marrë masa për sistemimin e dosjeve të procedurave të prokurimit, inventarizimin dhe arkivimin e tyre, sipas lidhjeve dhe në mënyrë kronologjike, me qëllim garantimin e saktësisë dhe plotësisë në administrimin e dokumentacionit. Komisionet e prokurimit të marrin masa që për çdo procedurë prokurim të veprohet në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, duke garantuar siguri dhe transparencë mbi procedurën e prokurimit blerje e vogël.

## **2.6. Çështje të tjera që dalin gjatë auditimit**

### **Mbi auditimin e ushtruar në Drejtorinë e Tatimpaguesve të Mëdhenj, në bazë të programit të auditimit financiar nr. 14/1 prot, datë 09.01.2023, mbajtur në datë 30.06.2023.**

Në lidhje me auditimin e procedurave administrative të kryera nga administrata tatimore e Drejtorisë Rajonale Tatimore nga grupi auditues u trajtua përputhshmëria e afateve kohore ligjore të përpunimit të dosjeve të program kontrolleve të tërhequra nga grupi i kontrollit për auditim mbi bazën e riskut të përpiluar nga audituesit shtetërorë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

### **Nga auditimi rezultoi si më poshtë:**

**-Subjekti: “S” SHPK**

**Nipti: K.T**

- Në sistemin C@TS mungon dokumenti mbi Njoftimin e Kontrollit.

- Formulari nr. 3, nuk është hedhur në sistemin C@TS, nënshkrimi nga Inspektori i Kontrollit, Përgjegjësi i Sektorit të Kontrollit, Drejtori i Kontrollit dhe Drejtori i Drejtorisë Rajonale nuk kanë datë.

- Në dosje nuk administrohet shkresa për dërgimin e Projekt Raportit dhe Raportit Përfundimtar.

- Projekt Raporti, Raporti Përfundimtar i Kontrollit dhe procesverbalet janë hedhur me vonesë në C@TS, jo në përputhje me Manualin i Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2.2.
- Raporti Përfundimtar i Kontrollit është përfunduar në datë 16.07.2021 dhe nisur në subjekt në datë 22.07.2021, ndërkohë që Projekti është përfunduar në subjekt në datë 28.05.2021, pra janë tejkaluar afatet nga përgatitja dhe dërgimi i Projekt Raporti deri në përgatitjen dhe dërgimin e Raportit Përfundimtar të Kontrollit në subjekt, jo sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9920 “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 83, pika 1 dhe 4, Neni 84, pika 1.

**- Subjekti: “A.M” SHPK**

**Nipti: J.P**

- Në sistemin C@TS mungon dokumenti mbi Njoftimin e Kontrollit dhe Raporti Përfundimtar i Kontrollit.
- Njoftimi i kontrollit është bërë në datë 21.05.2021, ndërkohë që kontrolli në subjekt ka filluar në datë 01.06.2021, pra nuk është respektuar afati 30 ditor në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit 9920 “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 81, pika 1.1.
- Procesverbalet dhe Projekt Raporti janë hedhur me vonesë në sistemin C@TS, jo në përputhje me Manualin i Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2.2.
- Formulari nr. 3, nënshkrimi nga Përgjegjësi i Sektorit të Kontrollit, Drejtori i Kontrollit dhe Drejtori i Drejtorisë Rajonale nuk kanë datë.

**- Subjekti: “L” SHPK**

**Nipti: J.P**

- Në sistemin C@TS mungon dokumenti mbi Njoftimin e Kontrollit.
- Njoftimi i kontrollit është bërë në datë 17.07.2020, ndërkohë që kontrolli në subjekt ka filluar në datë 28.07.2020, pra nuk është respektuar afati 30 ditor në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit 9920 “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 81, pika 1.1.
- Formulari nr. 3, nënshkrimi nga Drejtori i Drejtorisë Rajonale nuk ka datë.
- Për realizimin e kontrollit janë planifikuar 240 orë pune, ndërkohë që ore punë në fakt janë 488.
- Procesverbalet janë hedhur me vonesë në sistemin C@TS në datë 03.06.2021, ndërkohë që mbajnë datat si vijon procesverbali nr. 1, datë 24.02.2021, nr. 2, datë 08.04.2021, nr. 3, datë 19.04.2021, nr.4, datë 22.04.2021, nr.5, datë 04.05.2021.
- Kontrolli në terren ka përfunduar në datë 05.05.2021, ndërkohë Projekt Raporti i Kontrollit është përfunduar nga Inspektori në datë 14.05.2021, pra më shumë se 7 ditë, jo sipas përcaktimeve të Ligjit 9920 “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 83, pika 1.
- Raporti Përfundimtar i Kontrollit është përfunduar në datë 24.06.2021 dhe është dërguar në subjekt me shkresën nr. 5130/7 prot, datë 29.06.2021, pra më shumë se 14 ditë nga data e marrjes së kundërshtimit të tatimpaguesit, jo sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9920 “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 84, pika 1.
- Projekt Raporti dhe Raporti mbi kontrollin e kryer janë hedhur me vonesë në C@TS, jo në përputhje me Manualin e Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2.2.

**- Subjekti: I SHPK**

**Nipti: K.R**

- Në sistemin C@TS mungon dokumenti mbi Njoftimin e Kontrollit.
- Formulari nr. 3, nënshkrimi nga Drejtori i Drejtorisë Rajonale nuk ka datë.

- Procesverbali inventarit si dhe procesverbalet nr.1, 2, 3 dhe 4 nuk janë hedhur në sistemin C@TS.
- Projekt Raporti është mbajtur në datë 19.04.2021, hedhur në sistemin C@TS në datë 22.04.2021, dhe nisur subjektit me shkresën nr. 198/2 prot, datë 06.05.2021, pra 14 ditë nga hedhja në C@TS.
- Formulari nr. 3, nuk ka nënshkrim nga Drejtori i Drejtorisë Rajonale, ndërsa nënshkrimi nga Përgjegjësi i Sektorit dhe Drejtori i Kontrollit janë pa datë.
- Projekt Raporti nuk është hartuar brenda 7 ditëve, jo sipas përcaktimeve të Ligjit 9920 “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 81, pika 1.
- Projekt Raporti është mbajtur në datë 10.02.2021, hedhur në sistemin C@TS në datë 19.02.2021, dhe nisur subjektit me shkresën nr. 8002/2 prot, datë 04.03.2021, pra 14 ditë nga hedhja në C@TS.
- Njoftim Kontrolli, procesverbalet, Projekt Raporti dhe Raporti mbi kontrollin e kryer janë hedhur me vonesë në C@TS, jo në përputhje me Manualin i Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2.2.

**- Subjekti: “E.P” SHPK**

**Nipti: J.M**

- Kontrolli është kryer në tejkalim të afatit të parashikuar në programin e kontrollit, me afat 220 orë pune, pasi kontrolli ka filluar me datë 01.09.2020 dhe ka përfunduar në datë 24.12.2020, pra 600 orë/79 ditë pune, jo në përputhje me përcaktimet e Manualit të Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2.3 ku citohet: *“Kohëzgjatja e nevojshme e kontrollit përcaktohet nga të dhënat e analizës së riskut. Kohëzgjatja e kontrollit përcaktohet në baze të orëve të punës të parashikuara në Programin e Kontrollit. Kjo periudhë kohe merr parasysh kohën e kontrollit, pa përfshirë kohën për përgatitjen e raportit të kontrollit, i cili duhet të përgatitet brenda shtatë ditëve kalendarike nga data e përfundimit të tij tek tatimpaguesi.”*

*“Nëse koha e planifikuar për kontroll nuk është e mjaftueshme, e konsideruar kjo nga inspektori i kontrollit mbi baza të argumentuara, ky i fundit i kërkon Drejtorit të Drejtorisë së Kontrollit apo eprorit të tij, zgjatjen e afatit të kontrollit. Drejtori i Drejtorisë së kontrollit nëse e sheh të argumentuar kërkesën e inspektorit ia prezanton atë Drejtorit Rajonal. Ky i fundit, propozon ose jo tek Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve kërkesën për miratim të shtyrjes së afatit të kontrollit. Nëse Drejtori I Përgjithshëm miraton shtyrjen e afatit, dokumentacioni për zgjatjen e afatit të kontrollit hidhet në sistemin informatik C@TS dhe i bëhet e njohur zyrtarisht edhe tatimpaguesit.”*

- Projekt Raporti është mbajtur në datë 31.12.2020, hedhur në sistemin C@TS në datë 07.02.2021, dhe nisur subjektit me shkresën nr. 5103/2 prot, datë 28.01.2021, pra 25 ditë nga përfundimi nga Inspektori, ndërkohë që në sistemin C@TS është hedhur pasi i është nisur subjektit.

- Raporti Përfundimtar i Kontrollit është përfunduar në datë 01.03.2021 dhe është dërguar në subjekt me shkresën nr. 5130/5 prot, datë 01.03.2021, jo sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9920 “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 84, pika 1.

**- Subjekti: “ 2” SHPK**

**Nipti: K.M**

- Në sistemin C@TS mungon dokumenti mbi Njoftimin e Kontrollit.

- Formulari nr. 3, nënshkrimi nga Drejtori i Drejtorisë Rajonale dhe Inspektori nuk ka datë.

- Procesverbalet janë hedhur me vonesë në C@TS, jo në përputhje me Manualin i Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2.2.

**- Subjekti: “K” SHPK**

**Nipti: J.F**

- Në sistemin C@TS mungon dokumenti mbi Njoftimin e Kontrollit.

- Formulari nr. 3, nënshkrimi nga Inspektori, Përgjegjësi i Kontrollit, Drejtori i Kontrollit dhe Drejtori i Drejtorisë Rajonale nuk ka datë.

- Kontrolli në terren ka përfunduar në datë 06.07.2021, ndërkohë Projekt Raporti i Kontrollit është përfunduar nga Inspektori në datë 03.08.2021, pra më shumë se 7 ditë, jo sipas përcaktimeve të Ligjit 9920 “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 83, pika 1.

- Raporti Përfundimtar i Kontrollit është përfunduar në datë 14.09.2021, dërguar në subjekt me shkresën nr. 1458/3 prot, datë 16.09.2021, ndërkohë që Projekti është dërguar në subjekt në datë 06.08.2021, pra më shumë se 14 ditë nga data e marrjes së kundërshtimit të tatimpaguesit mbi Projekt Raportin, jo sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9920 “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 84, pika 1.

- Projekt Raporti dhe procesverbalet mbi kontrollin e kryer janë hedhur me vonesë në C@TS, jo në përputhje me Manualin i Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2.2.

**- Subjekti: “2” SHA**

**Nipti: K.E**

- Në sistemin C@TS mungon dokumenti mbi Njoftimin e Kontrollit.

- Formulari nr. 3, nuk është hedhur në sistemin C@TS, nuk është nënshkruar nga Përgjegjësi i Sektorit të Kontrollit dhe Drejtori i Drejtorisë Rajonale, gjithashtu nënshkrimi nga Inspektori i Kontrollit dhe Drejtori i Kontrollit nuk kanë datë.

- Projekt Raporti dhe procesverbalet mbi kontrollin e kryer janë hedhur me vonesë në C@TS, jo në përputhje me Manualin i Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2.2.

- Në dosje nuk administrohet shkresa për dërgimin e Projekt Raportit dhe Raportit Përfundimtar.

- Raporti Përfundimtar i Kontrollit është përfunduar në datë 04.10.2021, ndërkohë që Projekti është përfunduar në datë 12.07.2021, hedhur në sistemin C@TS në datë 31.08.2021, pra janë tejkaluara afatet nga përgatitja dhe dërgimi i Projekt Raporti deri në përgatitjen dhe dërgimin e Raportit Përfundimtar të Kontrollit në subjekt, jo sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9920 “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 83, pika 1 dhe 4, Neni 84, pika 1.

**- Subjekti: “E” SHA**

**Nipti: K.Ë**

- Në sistemin C@TS mungon dokumenti mbi Njoftimin e Kontrollit.

- Formulari nr. 3, nënshkrimi nga Përgjegjësi i Sektorit të Kontrollit, Drejtori i Kontrollit dhe Drejtori i Drejtorisë Rajonale nuk ka datë.

- Kontrolli është kryer në tejkalim të afatit të parashikuar në programin e kontrollit, me afat 280 orë pune, pasi kontrolli ka filluar me datë 01.04.2021 dhe ka përfunduar në datë 08.06.2021, pra 404 orë, jo në përputhje me përcaktimet e Manualit të Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2.3.

- Procesverbalet dhe Projekt Raporti janë hedhur me vonesë në C@TS, jo në përputhje me Manualin i Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2.2.



**- Subjekti: “R” SHPK**

**Nipti: L.K**

- Në sistemin C@TS mungon dokumenti mbi Njoftimin e Kontrollit.
- Në dosje nuk administrohet njoftim kontrolli si dhe shkresa për dërgimin e Projekt Raportit dhe Raportit Përfundimtar, formulari nr. 3, nënshkrimi nga Përgjegjësi i Sektorit dhe Drejtori i Drejtorisë Rajonale nuk ka datë.
- Kontrolli është kryer në tejkalim të afatit të parashikuar në programin e kontrollit, me afat 240 orë pune, pasi kontrolli ka filluar me datë 22.02.2021 dhe ka përfunduar në datë 30.04.2021, pra 356 orë pune, jo në përputhje me përcaktimet e Manualit të Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2.3.
- Procesverbalet dhe Projekt Raporti mbi kontrollin e kryer janë hedhur me vonesë në C@TS, jo në përputhje me Manualin i Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2.2.
- Projekti është përfunduar në subjekt në datë 30.04.2021, ndërkohë Raporti Përfundimtar i Kontrollit është përfunduar në datë 28.06.2021, pra janë tejkaluara afatet nga përgatitja dhe dërgimi i Projekt Raporti deri në përgatitjen dhe dërgimin e Raportit Përfundimtar të Kontrollit në subjekt, jo sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9920 “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 83, pika 1 dhe 4, Neni 84, pika 1.

**- Subjekti: “T” SHPK**

**Nipti: K.I**

- Në sistemin C@TS mungon dokumenti mbi Njoftimin e Kontrollit dhe Formulari nr. 3.
- Në dosje nuk administrohet Njoftimi i Kontrollit dhe programi i kontrollit, Raporti i kontrollit nuk është i firmosur nga Inspektori i Kontrollit.
- Formulari nr. 3, nënshkrimi nga Përgjegjësi i Sektorit, Drejtori i Kontrollit dhe Drejtori i Drejtorisë Rajonale nuk ka datë.
- Procesverbalet, Projekt Raporti dhe Raporti i Kontrollit janë hedhur me vonesë në C@TS, jo në përputhje me Manualin i Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2.2.

**- Subjekti: “A” SHPK**

**Nipti: K.W**

- Në sistemin C@TS mungon dokumenti mbi Njoftimin e Kontrollit.
- Formulari nr. 3, nënshkrimi nga Inspektori, Përgjegjësi i Sektorit të Kontrollit, Drejtori i Kontrollit dhe Drejtori i Drejtorisë Rajonale nuk ka datë.
- Njoftimi i kontrollit është bërë në datë 13.01.2021, ndërkohë që kontrolli në subjekt ka filluar në datë 03.02.2021, pra nuk është respektuar afati 30 ditor në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit 9920 “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 81, pika 1.1.
- Procesverbalet dhe Projekt Raporti janë hedhur me vonesë në C@TS, jo në përputhje me Manualin i Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2.2.
- Projekt Raporti është përfunduar në datë 07.04.2021 dhe është dërguar në subjekt me shkresën nr. 196/3 prot, datë 19.04.2021, ndërkohë Raporti Përfundimtar i Kontrollit është përfunduar në datë 19.05.2021, nisur në subjekt në datë 20.05.2021, pra janë tejkaluara afatet nga përgatitja dhe dërgimi i Projekt Raporti deri në përgatitjen dhe dërgimin e Raportit Përfundimtar të Kontrollit në subjekt, jo sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9920 “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 83, pika 1 dhe 4, Neni 84, pika 1.

**- Subjekti: "H.X" SHPK**

**Nipti: K.J**

- Në sistemin C@TS mungon dokumenti mbi Njoftimin e Kontrollit.
- Formulari nr. 3, nënshkrimi nga Përgjegjësi i Sektorit të Kontrollit, Drejtori i Kontrollit dhe Drejtori i Drejtorisë Rajonale nuk ka datë.
- Njoftimi i kontrollit është bërë në datë 31.03.2021, ndërkohë që kontrolli në subjekt ka filluar në datë 26.04.2021, pra nuk është respektuar afati 30 ditor në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit 9920 "Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", neni 81, pika 1.1.
- Procesverbalet dhe Projekt Raporti janë hedhur me vonesë në C@TS, jo në përputhje me Manualin e Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2.2.
- Formulari nr. 3, nënshkrimi nga Përgjegjësi i Sektorit të Kontrollit, Drejtori i Kontrollit dhe Drejtori i Drejtorisë Rajonale nuk ka datë.

**- Subjekti: "N" SHPK**

**Nipti: L.A**

- Në sistemin C@TS mungon dokumenti mbi Njoftimin e Kontrollit.
- Formulari nr. 3, nënshkrimi nga Përgjegjësi i Sektorit të Kontrollit, Drejtori i Kontrollit dhe Drejtori i Drejtorisë Rajonale nuk ka datë.
- Njoftimi i kontrollit është bërë në datë 15.06.2021, ndërkohë që kontrolli në subjekt ka filluar në datë 21.06.2021, pra nuk është respektuar afati 30 ditor në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit 9920 "Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", neni 81, pika 1.1.
- Procesverbalet, Projekt Raporti dhe Raporti i Kontrollit janë hedhur me vonesë në C@TS, jo në përputhje me Manualin i Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2.2.
- Projekt Raporti është përfunduar në datë 05.07.2021, ndërkohë Raporti Përfundimtar i Kontrollit është përfunduar në datë 14.09.2021, nisur në subjekt në datë 20.09.2021, pra janë tejkualuar afatet nga përgatitja dhe dërgimi i Projekt Raportit deri në përgatitjen dhe dërgimin e Raportit Përfundimtar të Kontrollit në subjekt, jo sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9920 "Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", neni 83, pika 1 dhe 4, Neni 84, pika 1.

**- Subjekti: "M" SHPK**

**Nipti: K.H**

- Në sistemin C@TS mungon dokumenti mbi Njoftimin e Kontrollit.
- Formulari nr. 3, nënshkrimi nga Përgjegjësi i Sektorit të Kontrollit, Drejtori i Kontrollit dhe Drejtori i Drejtorisë Rajonale nuk ka datë.
- Procesverbalet, Projekt Raporti dhe Raporti i Kontrollit janë hedhur me vonesë në C@TS, jo në përputhje me Manualin e Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2.2.
- Projekt Raporti është përfunduar në datë 19.08.2022, ndërkohë Raporti Përfundimtar i Kontrollit është përfunduar në datë 30.09.2022, nisur në subjekt në datë 05.10.2021, pra janë tejkualuar afatet nga përgatitja dhe dërgimi i Projekt Raportit deri në përgatitjen dhe dërgimin e Raportit Përfundimtar të Kontrollit në subjekt, jo sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9920 "Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", neni 83, pika 1 dhe 4, Neni 84, pika 1.

**- Subjekti: "E" SHPK**

**Nipti: K.Q**

- Në sistemin C@TS mungon dokumenti mbi Njoftimin e Kontrollit dhe Formulari nr. 3.

- Formulari nr. 3, nënshkrimi nga Inspektori, Përgjegjësi i Sektorit të Kontrollit, Drejtori i Kontrollit dhe Drejtori i Drejtorisë Rajonale nuk ka datë.
- Procesverbalet, Projekt Raporti dhe Raporti i Kontrollit janë hedhur me vonesë në C@TS, jo në përputhje me Manualin e Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2.2.
- Projekt Raporti është përfunduar në datë 15.07.2021, nisur në subjekt në datë 27.07.2022, ndërkohë Raporti Përfundimtar i Kontrollit është përfunduar në datë 05.09.2022, nisur në subjekt në datë 12.09.2022, pra janë tejkaluar afatet nga përgatitja dhe dërgimi i Projekt Raportit deri në përgatitjen dhe dërgimin e Raportit Përfundimtar të Kontrollit në subjekt, jo sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9920 “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 83, pika 1 dhe 4, Neni 84, pika 1.

**- Subjekti: “D.A” SHPK**

**Nipti: K.A**

- Në sistemin C@TS mungon dokumenti mbi Njoftimin e Kontrollit.
- Formulari nr. 3, nënshkrimi nga Përgjegjësi i Sektorit të Kontrollit, Drejtori i Kontrollit dhe Drejtori i Drejtorisë Rajonale nuk ka datë.
- Procesverbalet, Projekt Raporti dhe Raporti i Kontrollit janë hedhur me vonesë në C@TS, jo në përputhje me Manualin e Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2.2.
- Kontrolli është kryer në tejkallim të afatit të parashikuar në programin e kontrollit, me afat 176 orë pune, pasi kontrolli ka filluar me datë 28.04.2022 dhe ka përfunduar në datë 16.06.2022, pra 266 orë pune, jo në përputhje me përcaktimet e Manualit të Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2.3.
- Projekt Raporti është përfunduar në datë 16.06.2021, nisur në subjekt në datë 22.07.2022, ndërkohë Raporti Përfundimtar i Kontrollit është përfunduar në datë 26.08.2022, nisur në subjekt në datë 30.08.2022, pra janë tejkaluar afatet nga përgatitja dhe dërgimi i Projekt Raportit deri në përgatitjen dhe dërgimin e Raportit Përfundimtar të Kontrollit në subjekt, jo sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9920 “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 83, pika 1 dhe 4, Neni 84, pika 1.

**- Subjekti: “L” SHPK**

**Nipti: K.C**

- Në sistemin C@TS mungon dokumenti mbi Njoftimin e Kontrollit.
- Formulari nr. 3, nënshkrimi nga Përgjegjësi i Sektorit të Kontrollit, Drejtori i Kontrollit dhe Drejtori i Drejtorisë Rajonale nuk ka datë.
- Njoftimi i kontrollit është bërë në datë 12.07.2021, ndërkohë që kontrolli në subjekt ka filluar në datë 18.07.2021, pra nuk është respektuar afati 30 ditor në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit 9920 “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 81, pika 1.1.
- Në dosje nuk administrohet shkresa për dërgimin e Projekt Raportit.
- Procesverbalet, Projekt Raporti dhe Raporti i Kontrollit janë hedhur me vonesë në C@TS, jo në përputhje me Manualin i Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2.2.
- Kontrolli është kryer në tejkallim të afatit të parashikuar në programin e kontrollit, me afat 240 orë pune, pasi kontrolli ka filluar me datë 18.07.2022 dhe ka përfunduar në datë 30.09.2022, pra 432 orë pune, jo në përputhje me përcaktimet e Manualit të Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2.3.
- Projekt Raporti është përfunduar në datë 05.09.2021, ndërkohë Raporti Përfundimtar i Kontrollit është përfunduar në datë 04.11.2022, nisur në subjekt në datë 04.11.2022, pra janë

tejkalar afatet nga përgatitja dhe dërgimi i Projekt Raporti deri në përgatitjen dhe dërgimin e Raportit Përfundimtar të Kontrollit në subjekt, jo sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9920 “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 83, pika 1 dhe 4, Neni 84, pika 1.

**- Subjekti: “A.S” SHPK**

**Nipti: K.M**

- Në sistemin C@TS mungon dokumenti mbi Njoftimin e Kontrollit.
- Formulari nr. 3, nënshkrimi nga Përgjegjësi i Sektorit të Kontrollit, Drejtori i Kontrollit dhe Drejtori i Drejtorisë Rajonale nuk ka datë.
- Procesverbalet dhe Projekt Raporti janë hedhur me vonesë në C@TS, jo në përputhje me Manualin e Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2.2.

**- Subjekti: “J” SHPK**

**Nipti: K.H**

- Në sistemin C@TS mungon dokumenti mbi Njoftimin e Kontrollit.
- Formulari nr. 3, nënshkrimi nga Inspektori, Përgjegjësi i Sektorit të Kontrollit, Drejtori i Kontrollit dhe Drejtori i Drejtorisë Rajonale nuk ka datë.
- Njoftimi i kontrollit është bërë në datë 19.05.2021, ndërkohë që kontrolli në subjekt ka filluar në datë 15.06.2022, pra nuk është respektuar afati 30 ditor në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit 9920 “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 81, pika 1.1.
- Procesverbalet, Projekt Raporti dhe Raporti i Kontrollit janë hedhur me vonesë në C@TS, jo në përputhje me Manualin i Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2.2.
- Kontrolli në terren ka përfunduar në datë 21.07.2022 ndërkohë Projekt Raporti është përfunduar nga Inspektori në datë 05.08.2022, pra më shumë se 7 ditë, jo sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9920 “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 83, pika 1.

**- Subjekti: “O” SHPK**

**Nipti: J.I**

- Në sistemin C@TS mungon dokumenti mbi Njoftimin e Kontrollit.
- Formulari nr. 3, nënshkrimi nga Inspektori, Përgjegjësi i Sektorit të Kontrollit, Drejtori i Kontrollit dhe Drejtori i Drejtorisë Rajonale nuk ka datë.
- Procesverbalet dhe Projekt Raporti janë hedhur me vonesë në C@TS, jo në përputhje me Manualin i Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2.2.
- Projekt Raporti është përfunduar në datë 19.10.2021, nisur në subjekt në datë 26.10.2022, ndërkohë Raporti Përfundimtar i Kontrollit është përfunduar në datë 01.12.2022, nisur në subjekt po në datë 01.12.2022, pra janë tejkalar afatet nga përgatitja dhe dërgimi i Projekt Raportit deri në përgatitjen dhe dërgimin e Raportit Përfundimtar të Kontrollit në subjekt.

**- Subjekti: “A.P” SHPK**

**Nipti: J.V**

- Në sistemin C@TS mungon dokumenti mbi Njoftimin e Kontrollit.
- Formulari nr. 3, nënshkrimi nga Inspektori, Përgjegjësi i Sektorit të Kontrollit, Drejtori i Kontrollit dhe Drejtori i Drejtorisë Rajonale nuk ka datë.
- Njoftimi i kontrollit është bërë në datë 20.09.2022, ndërkohë që kontrolli në subjekt ka filluar në datë 05.10.2022, pra nuk është respektuar afati 30 ditor në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit 9920 “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 81, pika 1.1.

- Procesverbalet, Projekt Raporti dhe Raporti i Kontrollit janë hedhur me vonesë në C@TS, jo në përputhje me Manualin i Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2.2.

**- Subjekti: “V.A” SHPK**

**Nipti: L.N**

- Në sistemin C@TS mungon dokumenti mbi Njoftimin e Kontrollit.
- Formulari nr. 3, nënshkrimi nga Inspektori, Drejtori i Kontrollit dhe Drejtori i Drejtorisë Rajonale nuk ka datë, gjithashtu nuk është nënshkruar nga Përgjegjësi i Sektorit të Kontrollit.
- Në dosje nuk administrohet shkresa për dërgimin e Raportit Përfundimtar të Kontrollit.
- Procesverbalet, Projekt Raporti dhe Raporti i Kontrollit janë hedhur me vonesë në C@TS, jo në përputhje me Manualin i Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2.2.
- Kontrolli është kryer në tejkalim të afatit të parashikuar në programin e kontrollit, me afat 272 orë pune, pasi kontrolli ka filluar me datë 31.01.2022 dhe ka përfunduar në datë 01.04.2022, pra 320 orë pune, jo në përputhje me përcaktimet e Manualit të Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2.3.
- Projekt Raporti është përfunduar nga Inspektori në datë 01.04.2022, dërguar në subjekt në datë 22.04.2022, ndërkohë Raporti Përfundimtar i Kontrollit është përfunduar në datë 26.05.2022, nisur në subjekt në datë 31.05.2022, pra janë tejkaluara afatet nga përgatitja dhe dërgimi i Projekt Raportit deri në përgatitjen dhe dërgimin e Raportit Përfundimtar të Kontrollit në subjekt, jo sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9920 “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 83, pika 1 dhe 4, Neni 84, pika 1.

**- Subjekti: “A.Z” SHPK**

**Nipti: K.I**

- Në sistemin C@TS mungon dokumenti mbi Njoftimin e Kontrollit.
- Formulari nr. 3, nënshkrimi nga Inspektori, Përgjegjësi i Sektorit të Kontrollit, Drejtori i Kontrollit dhe Drejtori i Drejtorisë Rajonale nuk ka datë.
- Procesverbalet, Projekt Raporti dhe Raporti i Kontrollit janë hedhur me vonesë në C@TS, jo në përputhje me Manualin i Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2.2.
- Projekt Raporti është përfunduar nga Inspektori në datë 16.11.2022, dërguar në subjekt në datë 21.11.2022, ndërkohë Raporti Përfundimtar i Kontrollit është përfunduar në datë 23.12.2022, nisur në subjekt në datë 28.12.2022, pra janë tejkaluara afatet nga përgatitja dhe dërgimi i Projekt Raportit deri në përgatitjen dhe dërgimin e Raportit Përfundimtar të Kontrollit në subjekt, jo sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9920 “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 83, pika 1 dhe 4, Neni 84, pika 1.

**- Subjekti: “G.L” SHPK**

**Nipti: K.I**

- Në sistemin C@TS mungon dokumenti mbi Njoftimin e Kontrollit dhe Formulari nr. 3.
- Në dosje nuk administrohet shkresa për dërgimin e Raportit Përfundimtar të Kontrollit.
- Procesverbalet dhe Projekt Raporti janë hedhur me vonesë në C@TS, jo në përputhje me Manualin e Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2.2.
- Projekt Raporti është përfunduar nga Inspektori në datë 27.07.2022, dërguar në subjekt në datë 09.09.2022, ndërkohë Raporti Përfundimtar i Kontrollit është përfunduar në datë 10.10.2022, nisur në subjekt në datë 11.10.2022, pra janë tejkaluara afatet nga përgatitja dhe dërgimi i Projekt Raportit deri në përgatitjen dhe dërgimin e Raportit Përfundimtar të Kontrollit në subjekt, jo sipas

përcaktimeve të Ligjit Nr. 9920 “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 83, pika 1 dhe 4, Neni 84, pika 1.

**- Subjekti: “I. SHPK” SHPK**

**Nipti: K.B**

- Në sistemin C@TS mungon dokumenti mbi Njoftimin e Kontrollit.
- Formulari nr. 3, është hedhur në sistemin C@TS por nuk administrohet në dosje fizikisht, gjithashtu nënshkrimi nga Inspektori, Përgjegjësi i Sektorit, Drejtori i Kontrollit dhe Drejtori i Drejtorisë Rajonale nuk ka datë.
- Projekt Raporti dhe Raporti Përfundimtar i Kontrollit nuk kanë të përcaktuar datën kur janë përgatitur nga Inspektori, gjithashtu në dosje nuk administrohet shkresa për dërgimin në subjekt të secilit prej tyre.
- Kontrolli është kryer në tejkalim të afatit të parashikuar në programin e kontrollit, me afat 180 orë/23 dite pune, pasi kontrolli ka filluar me datë 07.06.2022 dhe ka përfunduar në datë 15.07.2022, pra 218 orë/28 ditë pune, jo në përputhje me përcaktimet e Manualit të Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2.3.
- Projekt Raporti është hedhur në sistemin C@TS në datë 18.08.2022, ndërkohë Raporti Përfundimtar i Kontrollit është përfunduar në datë 28.09.2022, hedhur në sistemin C@TS në datë 13.10.2022, pra janë tejkaluar afatet nga përgatitja dhe dërgimi i Projekt Raporti deri në përgatitjen dhe dërgimin e Raportit Përfundimtar të Kontrollit në subjekt, jo sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9920 “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 83, pika 1 dhe 4, Neni 84, pika 1.

**- Subjekti: “M.M” SHPK**

**Nipti: K.P**

- Në sistemin C@TS mungon dokumenti mbi Njoftimin e Kontrollit dhe Formulari nr. 3.
- Formulari nr. 3, nënshkrimi nga Përgjegjësi i Sektorit, Drejtori i Kontrollit dhe Drejtori i Drejtorisë Rajonale nuk ka datë.
- Në dosje nuk administrohet shkresa për dërgimin në subjekt të Projekt Raportit dhe Raportit Përfundimtar të Kontrollit.
- Procesverbalet, Projekt Raporti dhe Raporti Përfundimtar i Kontrollit janë hedhur me vonesë në C@TS, jo në përputhje me Manualin e Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2.2.
- Kontrolli është kryer në tejkalim të afatit të parashikuar në programin e kontrollit, me afat 216 orë pune, pasi kontrolli ka filluar me datë 16.05.2022 dhe ka përfunduar në datë 30.06.2022, pra 260 orë, jo në përputhje me përcaktimet e Manualit të Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2.3.
- Projekt Raporti është përfunduar nga Inspektori në datë 29.06.2022, hedhur në sistemin C@TS në datë 29.07.2022, ndërkohë Raporti Përfundimtar i Kontrollit është përfunduar në datë 31.08.2022, nisur në subjekt në datë 31.08.2022, pra janë tejkaluar afatet nga përgatitja dhe dërgimi i Projekt Raporti deri në përgatitjen dhe dërgimin e Raportit Përfundimtar të Kontrollit në subjekt, jo sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9920 “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 83, pika 1 dhe 4, Neni 84, pika 1.

**- Subjekti: “P.C A” SHPK**

**Nipti: K.B**

- Në sistemin C@TS mungon dokumenti mbi Njoftimin e Kontrollit.

- Projekt Raporti është përfunduar nga Inspektori në datë 06.09.2022, ndërkohë Raporti Përfundimtar i Kontrollit është përfunduar në datë 13.10.2022, nisur në subjekt në datë 18.10.2022, pra janë tejkualuar afatet nga përgatitja dhe dërgimi i Projekt Raporti deri në përgatitjen dhe dërgimin e Raportit Përfundimtar të Kontrollit në subjekt, jo sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9920 “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 83, pika 1 dhe 4, Neni 84, pika 1.

**- Subjekti: “A” SHPK**

**Nipti: L.M**

- Në sistemin C@TS mungon dokumenti mbi Njoftimin e Kontrollit.
- Formulari nr. 3, nënshkrimi nga Përgjegjësi i Sektorit, Drejtori i Kontrollit dhe Drejtori i Drejtorisë Rajonale nuk ka datë.
- Në dosje nuk administrohet shkresa për dërgimin në subjekt të Raportit Përfundimtar të Kontrollit.
- Procesverbalet dhe Projekt Raporti janë hedhur me vonesë në C@TS, jo në përputhje me Manualin e Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2.2.
- Kontrolli është kryer në tejkualim të afatit të parashikuar në programin e kontrollit, me afat 316 orë pune, pasi kontrolli ka filluar me datë 07.02.2022 dhe ka përfunduar në datë 31.05.2022, pra 444 orë/59 dite pune, jo në përputhje me përcaktimet e Manualit të Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2.3.
- Projekt Raporti është përfunduar nga Inspektori në datë 31.05.2022, hedhur në sistemin C@TS në datë 04.07.2022, nisur në subjekt në datë 06.07.2022, ndërkohë Raporti Përfundimtar i Kontrollit është përfunduar në datë 10.08.2022, nisur në subjekt në datë 15.08.2022, pra janë tejkualuar afatet nga përgatitja dhe dërgimi i Projekt Raportit deri në përgatitjen dhe dërgimin e Raportit Përfundimtar të Kontrollit në subjekt, jo sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9920 “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 83, pika 1 dhe 4, Neni 84, pika 1.

**- Subjekti: “A. A” SHPK**

**Nipti: K.D**

- Në sistemin C@TS mungon dokumenti mbi Njoftimin e Kontrollit.
- Formulari nr. 3, nënshkrimi nga Inspektori, Përgjegjësi i Sektorit, Drejtori i Kontrollit dhe Drejtori i Drejtorisë Rajonale nuk ka datë.
- Në dosje nuk administrohet shkresa për dërgimin në subjekt të Raportit Përfundimtar të Kontrollit.
- Procesverbalet, Projekt Raporti dhe Raporti Përfundimtar i Kontrollit janë hedhur me vonesë në C@TS, jo në përputhje me Manualin e Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2.2.
- Kontrolli në terren ka përfunduar në datë 13.03.2022, ndërkohë Projekt Raporti është përfunduar nga Inspektori në datë 31.03.2022, pra më shumë se 7 ditë, jo sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9920 “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 83, pika 1.
- Projekt Raporti është përfunduar nga Inspektori në datë 31.03.2022, hedhur në sistemin C@TS në datë 14.04.2022, nisur në subjekt në datë 15.04.2022, ndërkohë Raporti Përfundimtar i Kontrollit është përfunduar në datë 16.05.2022, nisur në subjekt në datë 19.05.2022, pra janë tejkualuar afatet nga përgatitja dhe dërgimi i Projekt Raportit deri në përgatitjen dhe dërgimin e Raportit Përfundimtar të Kontrollit në subjekt, jo sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9920 “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 83, pika 1 dhe 4, Neni 84, pika 1.

**- Subjekti: “R” SHPK**

**Nipti: L.R**

- Në sistemin C@TS mungon dokumenti mbi Njoftimin e Kontrollit.
- Formulari nr. 3, nënshkrimi nga Përgjegjësi i Sektorit, Drejtori i Kontrollit dhe Drejtori i Drejtorisë Rajonale nuk ka datë.
- Projekt Raporti është përfunduar nga Inspektori në datë 28.02.2022, nisur në subjekt në datë 02.03.2022, ndërkohë Raporti Përfundimtar i Kontrollit është përfunduar në datë 04.04.2022, nisur në subjekt në datë 06.05.2022, pra janë tejkualuar afatet nga përgatitja dhe dërgimi i Projekt Raportit deri në përgatitjen dhe dërgimin e Raportit Përfundimtar të Kontrollit në subjekt, jo sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9920 “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 83, pika 1 dhe 4, Neni 84, pika 1.

**- Subjekti: “E-T” SHPK**

**Nipti: K.H**

- Në sistemin C@TS mungon dokumenti mbi Njoftimin e Kontrollit.
- Formulari nr. 3, nënshkrimi nga Inspektori, Përgjegjësi i Sektorit, Drejtori i Kontrollit dhe Drejtori i Drejtorisë Rajonale nuk ka datë.
- Në dosje nuk administrohet shkresa për dërgimin në subjekt të Projektit dhe Raportit Përfundimtar të Kontrollit.
- Procesverbalet, Projekt Raporti dhe Raporti Përfundimtar i Kontrollit janë hedhur me vonesë në C@TS, jo në përputhje me Manualin e Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2.2.
- Projekt Raporti është përfunduar nga Inspektori në datë 31.05.2022, hedhur në sistemin C@TS në datë 10.06.2022, ndërkohë Raporti Përfundimtar i Kontrollit është përfunduar në datë 11.07.2022, nisur në subjekt në datë 20.05.2022, pra janë tejkualuar afatet nga përgatitja dhe dërgimi i Projekt Raportit deri në përgatitjen dhe dërgimin e Raportit Përfundimtar të Kontrollit në subjekt, jo sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9920 “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 83, pika 1 dhe 4, Neni 84, pika 1.

**- Subjekti: “B.T” SHPK**

**Nipti: K.J**

- Në sistemin C@TS mungon dokumenti mbi Njoftimin e Kontrollit dhe Formulari nr. 3.
- Formulari nr. 3, nënshkrimi nga Inspektori, Përgjegjësi i Sektorit, Drejtori i Kontrollit dhe Drejtori i Drejtorisë Rajonale nuk ka datë.
- Në dosje nuk administrohet shkresa për dërgimin e Projekt Raportit në subjekt.
- Procesverbalet, Projekt Raporti dhe Raporti Përfundimtar i Kontrollit janë hedhur me vonesë në C@TS, jo në përputhje me Manualin e Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2.2.
- Kontrolli në terren ka përfunduar në datë 23.03.2022, ndërkohë Projekt Raporti është përfunduar nga Inspektori në datë 12.04.2022, pra më shumë se 7 ditë, jo sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9920 “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 83, pika 1.
- Projekt Raporti është përfunduar nga Inspektori në datë 12.04.2022, hedhur në sistemin C@TS në datë 04.05.2022, ndërkohë Raporti Përfundimtar i Kontrollit është përfunduar në datë 13.05.2022, nisur në subjekt në datë 31.05.2022, pra janë tejkualuar afatet nga përgatitja dhe dërgimi i Projekt Raportit deri në përgatitjen dhe dërgimin e Raportit Përfundimtar të Kontrollit në subjekt, jo sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9920 “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 83, pika 1 dhe 4, Neni 84, pika 1.



## Konkluzion

**1-** Nga verifikimi i zbatimit të procedurave dhe afateve për kontrollet e ushtruara tek tatimpaguesi **kanë rezultuar mangësi si vijon:**

- Në **32 raste** në sistemin C@TS mungon dokumenti mbi Njoftimin e Kontrollit, në **6 raste** formulari nr. 3, dhe në **1 rast** mungon dokumenti Raporti Përfundimtar i Kontrollit, jo në përputhje me Manualin i Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2.2.

- Në **28 raste**, formulari nr.3, nënshkrimi nga Inspektori i Kontrollit, Përgjegjësi i Sektorit të Kontrollit, Drejtori i Kontrollit dhe Drejtori i Drejtorisë Rajonale nuk kanë datë.

- Në **11 raste** në dosje nuk administrohet shkresa për dërgimin e Projekt Raportit dhe Raportit Përfundimtar.

- Në **1 rast** në dosje nuk administrohet Njoftimi i Kontrollit dhe programi i kontrollit.

- Në **26 raste** Projekt Raporti, Raporti Përfundimtar i Kontrollit dhe procesverbalet janë hedhur me vonesë në C@TS, jo në përputhje me Manualin i Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2.2.

- Në **8 raste** nuk është respektuar afati 30 ditor, nga njoftimi i kontrollit deri në fillimin e kontrollit në subjekt, në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit 9920 “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 81, pika 1.1.

- Në **9 raste** kontrolli është kryer në tejkalim të afatit të parashikuar në programin e kontrollit, jo në përputhje me përcaktimet e Manualit të Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2.3 ku citohet: *“Kohëzgjatja e nevojshme e kontrollit përcaktohet nga të dhënat e analizës së riskut. Kohëzgjatja e kontrollit përcaktohet në baze të orëve të punës të parashikuara në Programin e Kontrollit. Kjo periudhë kohe merr parasysh kohën e kontrollit, pa përfshirë kohën për përgatitjen e raportit të kontrollit, i cili duhet të përgatitet brenda shtatë ditëve kalendarike nga data e përfundimit të tij tek tatimpaguesi”*.

- Në **6 raste** nuk është respektuar afati 7 ditor për përgatitjen e Projekt Raportit nga Inspektori jo sipas përcaktimeve të Ligjit 9920 “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 83, pika 1.

- Në **22 raste** nuk janë respektuar afatet nga përgatitja dhe dërgimi i Projekt Raportit deri në përgatitjen dhe dërgimin e Raportit Përfundimtar të Kontrollit në subjekt, jo sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9920 “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 83, pika 1 dhe 4, Neni 84, pika 1.

**2-** Nga verifikimi i zbatimit të procedurave dhe afateve për kontrollet e ushtruara tek tatimpaguesi, rezulton se afati nga përfundimi i përgatitjes së Projekt Raportit nga Inspektori deri në miratimin e tij nga eprorët (Përgjegjës Sektori/Drejtor) varion nga 10 ditë deri në 2 muaj.

Në përcaktimet e Ligjit Nr. 9920 “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” dhe Manualin e Kontrollit Tatimor, Kapitulli VIII, pika 8, nuk është përcaktuar afati maksimal për miratimin Projekt Raportit nga eprorët (Përgjegjës Sektori/Drejtor), duke e bërë këtë fazë të procedurës së kontrollit evazive.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi rast pas rasti sipas mangësive të konstatuara në dosje Inspektori, Përgjegjësi i Sektorit dhe Drejtori, sipas **Aneksit nr. 6.1**-“Verifikimi i zbatimit të procedurave dhe afateve gjatë ushtrimit të kontrolleve për vitet 2021-2022”.

## II

**-Tatimpagues: A-S J.Ë**, planifikuar për kontroll 288 orë (36 ditë punë).

Inspektori: E.D, përgjegjës sektori A.C, drejtor kontrolli M.R, drejtori rajonal I.A.

-Njoftimi i kontrollit sipas shkresës nr. 6221 datë 24.08.2020 është kryer 30 ditë përpara fillimit të kontrollit, datën 28.09.2020, kur është marrë njoftimi për kontroll. Kontrolli sipas formularit

nr.3 raportohet të ketë filluar në 12.10.2020 ndërkohë që dijani për kontrollin sipas përcaktimeve të programit është marrë në 28.09.2020, pra jo në përputhje me parashikimet e bëra në programin e kontrollit.

-Raporti i kontrollit tatimor (projekti) i dërguar sipas shkresës nr. 6221/3 datë 22.12.2020 është hartuar në tejkallim të afatit 7 ditor nga data e përfundimit të tij te tatimpaguesi (08.12.2020 sipas formularit 3) të përcaktuar në pikën 2.3 të MKT dhe nenit 83 të ligjit për procedurat tatimore.

- Të katërt procesverbalet e hartuar në data të ndryshme janë hedhur në sistemin informatik por jo sipas afatit të përcaktuar në pikën 2.2 të MKT.

-Raporti përfundimtar i kontrollit vlerësohet të jetë miratuar me nr. 6221/5 datë 04.02.2021 në tejkallim të afatit 14-ditor nga marrja e kundërshtimeve të tatimpaguesit me nr. 6221/4 datë 12.01.2021, jo në përputhje me përcaktimet e bëra në pikën 2.5 të MKT dhe neneve 83 dhe 84 të ligjit për procedurat tatimore.

- **Tatimpagues: G J.H**, ushtruar kontroll në bazë të shkresës së DPT, hetimit tatimor nr.22143 datë 17.11.2020 dhe formuluar raport kontrolli verifikim në vend.

Inspektori: E.A.

Pjesë e dosjes fizike të vendosur në dispozicion janë shkresa nr. 9217/1 datë 24.11.2020 (shkresë informuese për verifikim dokumentacioni), raporti i kontrollit (verifikimi në vend) me nr. 9217/3 datë 06.01.2021 dhe njoftim vlerësimi po në këtë datë.

Ky lloj kontrolli është argumentuar të realizohet sipas neneve 68, 80 dhe 81 të LPT, ndërkohë që është hartuar raport kontrolli tatimor pa pasur një program të miratuar. Kjo lloj procedure nuk është parashikuar në ligjin për procedurat tatimore dhe cats është hedhur me vonesë procesverbali i mbajtur. Për këtë arsye duke qenë se nuk është ndjekur formati standard i ushtrimit të kontroleve tatimore nuk mund të auditohet zbatimi i afateve të kontrollit.

- **Tatimpagues A.K J.R**, planifikuar për kontroll 144 orë, (18 ditë punë).

Inspektori: E.D, përgjegjës sektori A.C, drejtor kontrolli M.R, drejtori rajonal I.A.

-Njoftimi i kontrollit sipas shkresës nr. 5969 datë 18.06.2021 nuk është dërguar të paktën 30 ditë para fillimit të kontrollit (sipas shkresës nr 5969/2 datë 02.07.2021 mbi të cilën është marrë njoftim në 06.07.2021), duke qenë jo në përputhje me pikën 2.1.2 të MKT dhe nenin 81 të ligjit për procedurat tatimore.

- Procesverbalet dhe akt konstatimi të hartuar në data të ndryshme janë hedhur në sistemin informatik por jo sipas afatit të përcaktuar në pikën 2.2 të MKT (të nesërmen nga dita e mbajtjes së tij).

-Raporti i kontrollit tatimor (projekti) i dërguar sipas shkresës nr. 5969/3 datë 03.09.2021 është hartuar në tejkallim të afatit 7 ditor nga data e përfundimit të tij te tatimpaguesi (13.08.2021 sipas formularit 3) të përcaktuar në pikën 2.3 të MKT dhe nenit 83 të ligjit për procedurat tatimore.

- Raporti përfundimtar i kontrollit vlerësohet të jetë miratuar me nr. 5969/5 datë 17.09.2021, brenda afatit 14 ditor të përcaktuar të MKT.

- **Tatimpagues A.Or L.C**, është planifikuar për kontroll për 120 orë (15 ditë) në vijim të kërkesës për rimbursim TVSH-je.

Inspektori: D.F, përgjegjës sektori A.C, drejtor kontrolli M.R, drejtori rajonal I.A.

-Tatimpaguesi është njoftuar për kontroll me shkresën nr. 10222/1 datë 29.12.2020.

Procesverbali dhe inventari i fillimit për subjektin janë hedhur në cats në 27.01.2021, jo brenda ditës së nesërme nga mbajtja e tyre duke qenë jo në përputhje me pikën 2.2 të MKT.

-Projekt raporti është hartuar në 25.01.2021 (brenda 7 ditëve nga përfundimi i punës në terren, 22.01.2021) dhe raporti është përfunduar në kohë me nr.10222/3 datë 01.03.2021 (brenda 14 ditëve).

- **Tatimpagues S.E K.P**, është planifikuar për kontroll për 240 orë pune (30 ditë).

Inspektori: I.P, përgjegjës sektori E.M, drejtor kontrolli M. R, drejtori rajonal I.A.

-Tatimpaguesi është njoftuar për kontroll me shkresën nr. 2599 datë 31.03.2021 dhe në vijim me shkresën nr. 2599/2 datë 11.05.2021 (bashkëlidhur dhe programi i kontrollit) duke respektuar afatin 30 ditor të lajmërimit përpara kontrollit. Në njoftimin datë 11.05.2021 ka nënshkruar përfaqësuesi i tatimpaguesit “mora njoftimin” ndërkohë që sipas formularit 3 është paraqitur që kontrolli ka filluar në 04.06.2021, pra rreth 20 ditë më vonë.

-Kontrolli në tatimpagues ka zgjatur deri në 21.07.2021 sipas formularit 3, duke qenë mbi kohën e miratuar në programin e kontrollit prej 30 ditë pune.

-Në sistemin informatik procesverbalet e hartuara nga inspektori janë ngarkuar me vonesë dhe jo brenda ditës së nesërme nga mbajtja e tyre duke qenë jo në përputhje me pikën 2.2 të MKT.

- Projekt raporti sipas SIT është hartuar në 28.07.2021, por është hedhur në sistem në 06.08.2021, ndërkohë që nuk është bashkëngjitur apo dërguar me shkresë në dosjen fizike.

- Raporti është hartuar në 14.10.2021, protokolluar me nr. 2599/4 datë 07.10.2021 në tejkallim të afatit 14 ditor (projekt raporti në 28.07.2021) të përcaktuar në jo në pikën 2.5 të MKT dhe neneve 83 dhe 84 të ligjit për procedurat tatimore.

- **Tatimpagues N.C 2012 L.D**, hartuar në formën e akt konstatimit për verifikimin në vend nga inspektorët D.B dhe O.K në bazë të autorizimit për verifikim në vend lëshuar nga drejtori rajonal Iris Ago.

Ky lloj verifikimi është kryer në bazë të nenit 81/1 të ligjit të procedurave tatimore. Sipas mënyrës së paraqitjes së dosjes dhe realizimit të kontrollit nuk kemi të bëjmë me një kontroll të shoqëruar me program dhe në vijim me raport kontrolli, për këtë arsye nuk është e mundur auditimi i afateve, ndërkohë që vetë procedura e ndjekur është jo sipas përcaktimeve të nenit 81/1 të ligjit për procedurat tatimore.

Në sistemin informatik tatimor nuk rezultojnë të jenë hedhur aktet e këtij autorizimi për verifikim në vend dhe as akt konstatimi apo masat administrative përkatëse nëse ka pasur. Aktet janë dërguar në DPT në formën e informacionit të kërkuar.

- **Tatimpagues Hastoçi J.B** planifikuar për kontroll për 300 orë pune (37 ditë).

Inspektori: B.M, përgjegjës sektori A.C, drejtor kontrolli M.R, drejtori rajonal I.A.

-Tatimpaguesi është njoftuar për kontroll me shkresën nr. 8010 datë 15.10.2020 dhe në vijim me shkresën nr. 8010/2 datë 13.11.2020 (bashkëlidhur dhe programi i kontrollit) duke respektuar afatin 30 ditor të lajmërimit përpara kontrollit (marrë njoftim nga tatimpaguesi në 23.11.2020).

-Projekt raporti është dërguar me nr. 8010/3 datë 22.01.2021, duke përfunduar me vonesë, mbi 7-ditë nga data në të cilën ka përfunduar kontrolli të tatimpaguesi (data 08.01.2021 sipas formularit 3), jo në përputhje me përcaktimet e bëra në pikën 2.3 të MKT dhe nenit 83 të ligjit për procedurat tatimore.

-Raport është përfunduar në 24.02.2021 me nr. prot 8010/4 datë 01.03.2021, me më shumë se 14 ditë vonesë nga data e marrjes dijeni ose vlerësimit se është marrë dijeni të projekt raportit, 22.01.2021, duke qenë jo në përputhje me përcaktimet e bëra në pikën 2.5 të MKT dhe neneve 83 dhe 84 të ligjit për procedurat tatimore.

-Procesverbalet e mbajtura dhe akt konstatimi gjatë realizimit të kontrollit tatimor nuk janë hedhur fare në sistemin informatik duke qenë jo në përputhje me pikën 2.2 të MKT.

- **Tatimpagues H.S K.K** planifikuar për kontroll për 258 orë punë (32 ditë pune).

Inspektori: I.L, përgjegjës sektori A.C, drejtor kontrolli M.R, drejtori rajonal I.A.

-Tatimpaguesi është njoftuar për kontroll me shkresën nr. 10466 datë 29.12.2020 dhe në vijim me shkresën nr. 10466/2 datë 06.01.2021 (marrë njoftim datë 08.01.2021 nga tatimpaguesi) dhe kontrolli ka filluar në 08.01.2021 sipas formularit nr.3, më pak se 30 ditë përpara fillimit të kontrollit në kundërshtim me pikën 2.1.2 të MKT dhe nenin 81 të ligjit për procedurat tatimore.

-Procesverbalet e mbajtura gjatë ushtrimit të kontrollit tatimor janë hedhur me vonesë në sistemin informatik, jo të nesërmen e mbajtjes së tyre, duke qenë jo në përputhje me përcaktimet e bëra në pikën 2.2 të MKT.

- Projekt raporti është hartuar me nr. 10466/3 datë 17.02.2021, jashtë afatit 7 ditor nga mbyllja e kontrollit në teren (08.02.2021 sipas formularit nr.3), duke qenë jo në përputhje me përcaktimet e bëra në pikën 2.3 të MKT dhe nenit 83 të ligjit për procedurat tatimore.

- Raporti përfundimtar i kontrollit është hartuar me nr. 10466/5 datë 08.03.2021, brenda afatit 14 ditor nga marrja e projekt raportit konfirmuar me shkresën nr. 10466/4 datë 23.02.2021.

- **Tatimpagues G.K J.U** planifikuar për kontroll për 240 orë ose 40 ditë pune.

Inspektori: A.H, përgjegjës sektori A.C, drejtor kontrolli M.R, drejtori rajonal I.A.

- Tatimpaguesi është njoftuar për kontroll me shkresën nr. 5971 datë 18.06.2021 dhe në vijim me shkresën nr.5971/2 datë 13.07.2021, marrë njoftim nga tatimpaguesi në 02.08.2021. Sipas formularit 3, kontrolli ka filluar në 02.07.2021, ndërkohë që njoftimi nga tatimpaguesi është marrë në 02.08.2021, datë në të cilën rezulton të ketë filluar kontrolli edhe sipas raportit, pra lajmërimi për kontroll është kryer të paktën 30 ditë para nisjes së tij.

- Në sistemin cats nuk rezultojnë të jenë të hedhura procesverbali dhe akt konstatimi i mbajtur gjatë kontrollit, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 2.2 të MKT.

-Sipas raport kontrollit, kontrolli është kryer nga 02.08.2021-15.09.2021 dhe raporti i kontrollit projekt është përgatitur e dërguar te tatimpaguesi me shkresën nr. 5971/3 datë 07.10.2021 (hedhur në cats në 05.10.2021), jashtë afatit 7 ditor nga mbyllja e kontrollit në terren, duke qenë jo në përputhje me përcaktimet e bëra në pikën 2.3 të MKT dhe nenit 83 të ligjit për procedurat tatimore.

- Raporti përfundimtar i kontrollit është hartuar me nr. 5971/5 datë 28.10.2021, brenda afatit duke marrë parasysh marrjen dijeni të tatimpaguesit sipas shkresës nr.5971/4 datë 25.10.2021.

- **Tatimpagues D G L.S**, është planifikuar për kontroll për 75 orë ose 9 ditë pune në vijim të kërkesës për rimbursimin e TVSH.

Inspektori: A.X dhe V.J, përgjegjës sektori E.M, drejtor kontrolli M.R, drejtori rajonal I.A.

Tatimpaguesi është njoftuar për kontroll me shkresën nr. 1984 datë 04.03.2021 dhe në vijim me nr. 1984/1 datë 11.03.2021.

-Procesverbalet e mbajtura në 15/22/24 Mars 2021 janë hedhur në sistemin cats në 17.05.2021, pra jo të nesërmen e mbajtjes së tyre duke qenë në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 2.2 të MKT.

-Sipas formularit nr.3 kontrolli është ushtruar gjatë periudhës 15.03.2021-05.04.2021, ndërkohë që raporti i kontrollit (projekti) është dërguar me nr. 1984/2 datë 12.05.2021, jashtë afatit 7 ditor

nga mbyllja e kontrollit në terren, duke qenë jo në përputhje me përcaktimet e bëra në pikën 2.3 të MKT dhe nenit 83 të ligjit për procedurat tatimore.

-Raporti përfundimtar i kontrollit është hartuar me nr. 1984/4 datë 01.06.2021 pas marrjes së komenteve nga tatimpaguesi me nr. 1984/3 datë 24.05.2021.

**- Tatimpagues D.F K.B,** planifikuar për kontroll për 600 orë pune ose 75 ditë.

Inspektori: A.D, përgjegjës sektori E.M, drejtor kontrolli M.R, drejtori rajonal I.A.

Tatimpaguesi është njoftuar për kontroll me shkresën nr. 245 datë 14.01.2021 dhe në vijim me nr. 245/1 datë 16.02.2021, pra të paktën 30 ditë para fillimit të kontrollit.

-Procesverbalet e mbajtura gjatë kontrollit (17.02.2021-26.05.2021) janë hedhur në sistemin informatik cats në 18.06.2021, pra jo të nesërmen e mbajtjes së tyre duke qenë në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 2.2 të MKT.

- Raporti i kontrollit rezulton të jetë përgatitur në 05.06.2021 (hedhur në cats në 18.06.2021), ndërkohë që në dosjen fizike nuk ka shkresë të dërgimit të tij te tatimpaguesi. Kontrolli te tatimpaguesi sipas formularit 3 rezulton të ketë përfunduar në 26.05.2021. Në këtë mënyrë, raporti i kontrollit tatimor (projekt) rezulton të jetë hartuar në tejkallim të afatit 7-ditor, duke qenë jo në përputhje me përcaktimet e bëra në pikën 2.3 të MKT dhe nenit 83 të ligjit për procedurat tatimore.

-Raporti i kontrollit përfundimtar rezulton të jetë dërguar me shkresën nr.245/3 datë 03.08.2021, në tejkallim të afatit 14-ditor për hartimin e tij duke qenë jo në përputhje me pikën 2.5 të MKT dhe neneve 83 dhe 84 të ligjit për procedurat tatimore.

**- Tatimpagues I J.D,** planifikuar për kontroll për 254 orë pune ose 32 ditë pune.

Inspektori: A.S, përgjegjës sektori A.C, drejtor kontrolli M.R, drejtori rajonal I.A.

Tatimpaguesi është njoftuar për kontroll me shkresën nr. 2628 datë 01.04.2021 dhe në vijim me shkresë nr. 2628/2 datë 19.04.2021, marrë njoftim në 20.04.2021, duke qenë jo në përputhje më pak se 30 ditë përpara fillimit të kontrollit në kundërshtim me pikën 2.1.2 të MKT dhe nenin 81 të ligjit për procedurat tatimore.

-Procesverbalet e mbajtura gjatë kontrollit në terren (të datave 22.04.2021 dhe 03.06.2021) janë hedhur në sistemin cats në 25.06.2021, pra jo të nesërmen e mbajtjes së tyre duke qenë në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 2.2 të MKT.

- Sipas formularit nr.3 kontrolli në tatimpagues ka përfunduar në datën 04.06.2021, ndërkohë që projekt raporti është dërguar me shkresën nr. 2628/3 datë 25.06.2021.

Në këtë mënyrë, raporti i kontrollit tatimor (projekt) rezulton të jetë hartuar në tejkallim të afatit 7-ditor, duke qenë jo në përputhje me përcaktimet e bëra në pikën 2.3 të MKT dhe nenit 83 të ligjit për procedurat tatimore.

-Raporti përfundimtar i kontrollit rezulton të jetë dërguar me nr. 2628/4 datë 16.07.2021, në tejkallim të afatit 14-ditor për hartimin dhe miratimin e tij duke qenë jo në përputhje me pikën 2.5 të MKT dhe neneve 83 dhe 84 të ligjit për procedurat tatimore.

**- Tatimpagues Z K.M,** planifikuar për kontroll për 220 orë pune ose 27 ditë pune.

Inspektori: M.M dhe G.J, përgjegjës sektori A.C, drejtor kontrolli M.R, drejtori rajonal I.A.

Tatimpaguesi është njoftuar për kontroll me shkresën nr. 2999 datë 06.05.2020, në përgjigje të së cilës ka paraqitur kërkesë për shtyrje me nr. 2999/1 datë 15.05.2020. Në vijim janë paraqitur njoftim për lajmërim kontrolli tatimor me nr. 2999/2 datë 21.07.2020, autorizim për verifikim kontrolli tatimor me nr. 2999/3 datë 05.01.2021 dhe nr. 2999/4 datë 22.02.2021. Sipas formularit

nr. 3 kontrolli ka filluar në 27.11.2020 pra mbi 30 ditë nga data e lajmërimit për kontroll. Kontrolli ka përfunduar në 16.05.2021 duke zgjatur mbi 6 muaj ndërkohë që koha e miratuar për kontroll sipas programit të kontrollit është 27 ditë.

Procesverbali i hartuar në 27.11.2020 nuk rezulton të jetë pasqyruar në sistemin cats duke qenë në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 2.2 të MKT.

- Raporti i kontrollit tatimor (projekt) është hartuar me nr. 2999/5 datë 25.05.2021, ndërkohë që kontrolli te tatimpaguesi ka përfunduar në 16.05.2021 duke u hartuar në tejkallim të afatit 7-ditor të përcaktuar në pikën 2.3 të MKT dhe nenit 83 të ligjit për procedurat tatimore.

- Raporti përfundimtar i kontrollit tatimor është hartuar me nr. 2999/6 datë 18.06.2021, në tejkallim të afatit 14-ditor për hartimin dhe miratimin e tij duke qenë jo në përputhje me pikën 2.5 të MKT dhe neneve 83 dhe 84 të ligjit për procedurat tatimore.

**- Tatimpagues 4, K.L** planifikuar për kontroll për 248 orë pune ose 31 ditë pune.

Inspektori: D.B, përgjegjës sektori A.C, drejtor kontrolli M.R, drejtori rajonal I.A.

Tatimpaguesi është njoftuar për kontroll me shkresën nr. 5966 datë 18.06.2021 dhe në vijim me shkresën nr. 5966/1 datë 16.07.2021 (marrë njoftimi nga tatimpaguesi në 21.07.2021). Sipas formularit nr.3 kontrolli ka filluar në 21.07.2021 dhe ka përfunduar në 02.09.2021.

- Procesverbalet e hartuara dhe akt konstatimi janë pasqyruar në sistemin cats në datë 20.09.2021 pra jo të nesërmen e mbajtjes së tyre duke qenë në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 2.2 të MKT.

- Raporti i kontrollit tatimor (projekti) rezulton të jetë dërguar me nr. 5966/3 datë 21.09.2021, duke u përgatitur në tejkallim të afatit 7-ditor për hartimin e tij nga përfundimi i punës në terren, në kundërshtim me pikën 2.3 të MKT dhe nenit 83 të ligjit për procedurat tatimore.

- Raporti i kontrollit tatimor përfundimtar është hartuar me nr. 5966/5 datë 20.10.2021 në tejkallim të afatit 14-ditor për hartimin dhe miratimin e tij duke qenë jo në përputhje me pikën 2.5 të MKT dhe neneve 83 dhe 84 të ligjit për procedurat tatimore.

**- Tatimpaguesi E.B K.T** planifikuar për kontroll për 600 orë pune ose 75 ditë pune.

Inspektori: D.G, përgjegjës sektori E.M, drejtor kontrolli M.R, drejtori rajonal I.A.

Tatimpaguesi është njoftuar për kontroll me shkresën nr. 4185 datë 20.05.2021 dhe në vijim me shkresën nr. 4185/1 datë 30.06.2021 (marrë njoftim në 06.07.2021), pra të paktën 30 ditë përpara fillimit të kontrollit tatimor. Sipas formularit nr.3 kontrolli ka filluar në 06.07.2021 dhe ka përfunduar në 10.11.2021.

- Procesverbalet e hartuara dhe akt konstatimi në lidhje me kontrollin e ushtruar rezultojnë të jenë pasqyruar në sistemin elektronik cats në 01.12.2021, pra jo brenda ditës së nesërme nga mbajtja e tyre, duke qenë në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 2.2 të MKT.

- Raporti i kontrollit tatimor (projekti) rezulton të jetë dërguar me nr. 4185/3 datë 15.11.2021 brenda afatit të përcaktuar në MKT për hartimin e tij.

- Raporti i kontrollit tatimor përfundimtar është hartuar me nr.4185/5 datë 25.11.2021 brenda afatit të përcaktuar në MKT për hartimin e tij.

**- Tatimpaguesi F.A KT** planifikuar për kontroll për 296 orë pune ose 37 ditë pune.

Inspektori: E.K, përgjegjës sektori E.M, drejtor kontrolli M.R, drejtori rajonal I.A.

Tatimpaguesi është njoftuar për kontroll me shkresën nr. 251 datë 14.01.2021 dhe në vijim me shkresën nr. 251/2 datë 11.02.2021 për të cilën është marrë njoftim nga tatimpaguesi në datën

18.02.2021. Sipas formularit 3, kontrolli tatimor ka filluar në 18.02.2021 dhe ka përfunduar në 16.04.2021, pra tatimpaguesi është njoftuar të paktën 30 ditë përpara fillimit të kontrollit.

- Procesverbalet e hartuara nga inspektori janë hedhur në sistemin cats në 31.05.2021, pra jo brenda ditës së nesërme nga mbajtja e tyre, duke qenë në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 2.2 të MKT

-Raporti i kontrollit tatimor (projekti nuk është pjesë e dosjes fizike dhe në cats paraqitet i hartuar në 21.04.2021, pra brenda afatit 7- ditor nga përfundimi i punës së kontrollit).

-Raporti përfundimtar i kontrollit tatimor është hartuar me nr. 251/4 datë 29.06.2021, në tejkalim të afatit 14-ditor për hartimin dhe miratimin e tij duke qenë jo në përputhje me pikën 2.5 të MKT dhe neneve 83 dhe 84 të ligjit për procedurat tatimore.

**- Tatimpaguesi T. K** planifikuar për kontroll për 280 orë pune ose 35 ditë pune.

Inspektori: A.D, përgjegjës sektori A.C, drejtor kontrolli M.R, drejtori rajonal I.A.

Tatimpaguesi është njoftuar për kontroll me shkresën nr. 6816 datë 15.07.2021 dhe në vijim me nr. 6816/1 datë 10.09.2021, datë në të cilën ka filluar kontrolli sipas formularit nr.3 dhe është respektuar afati i njoftimit të paktën 30 ditë përpara fillimit të kontrollit.

-Akt konstatimi nuk rezulton të jetë pasqyruar në sistemin cats duke qenë në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 2.2 të MKT.

-Raporti i kontrollit tatimor (projekt) është hartuar me nr. 6816/2 datë 26.10.2021, ndërkohë që kontrolli në tatimpagues ka përfunduar në 15.10.2021 sipas formularit nr.3, pra projekt raporti është hartuar në tejkalim të afatit 7—ditor në kundërshtim me pikën 2.3 të MKT dhe nenit 83 të ligjit për procedurat tatimore.

-Raporti përfundimtar i kontrollit tatimor është hartuar me nr. 6816/4 datë 05.11.2021 (dijeni mbi projektin është marrë më 03.11.2021), pra raporti është hartuar brenda afatit 14 ditor nga komentet apo marrja dijeni nga tatimpaguesi.

**- Tatimpaguesi F J.S** planifikuar për kontroll për 148 orë ose 19 ditë pune.

Inspektori: I.D dhe I.K, përgjegjës sektori A.C, drejtor kontrolli M.R, drejtori rajonal I.A.

Tatimpaguesi është njoftuar për kontroll me shkresën nr. 3979 datë 17.05.2021 dhe në vijim me nr. 3979/2 datë 25.05.2021 për të cilën është marrë dijeni në 31.05.2021. Kontrolli ka filluar në 31.05.2021 dhe ka përfunduar në 30.03.2021. Pra njoftimi për ushtrimin e kontrollit tatimor nuk është kryer të paktën 30 ditë përpara fillimit të kontrollit tatimor, në kundërshtim me pikën 2.1.2 të MKT dhe nenin 81 të ligjit për procedurat tatimore.

Akt konstatimi rezulton të jetë pasqyruar në cats në 13.07.2021 dhe procesverbalet, pra jo brenda ditës së nesërme nga mbajtja e tyre, duke qenë në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 2.2 të MKT.

-Raporti i kontrollit tatimor (projekt) është hartuar me nr. 3979/5 datë 12.07.2021 ndërkohë që kontrolli në terren ka përfunduar 30.06.2021, pra projekti është hartuar në tejkalim të afatit 7- ditor, në kundërshtim me pikën 2.3 të MKT dhe nenit 83 të ligjit për procedurat tatimore.

-Raporti i kontrollit tatimor përfundimtar është hartuar me nr. 3979/6 datë 17.08.2021 në tejkalim të afatit 14 ditor për hartimin e tij, duke qenë jo në përputhje me pikën 2.5 të MKT dhe neneve 83 dhe 84 të ligjit për procedurat tatimore.

**- Tatimpaguesi R K.Q** planifikuar për kontroll për 288 orë pune ose 36 ditë pune.

Inspektori: G.C, E.A, përgjegjës sektori A.D/E.M, drejtor kontrolli O.C, drejtori rajonal D. I.

Tatimpaguesi është njoftuar për kontroll me shkresën nr.1801 datë 08.03.2022 dhe në vijim me shkresën nr. 1801/2 datë 14.04.2022, për të cilën është marrë njoftim nga tatimpaguesi në datën 19.04.2022. Kontrolli ka filluar në 19.04.2022 dhe ka përfunduar në 29.06.2022. Më autorizim nr. 1806/6 datë 24.06.2022 është parashikuar shtrirja e kontrollit tatimor për periudha shtesë nga drejtori rajonal. Lajmërimi për ushtrimin e kontrollit është kryer të paktën 30 ditë përpara ushtrimit të kontrollit.

Procesverbal dhe akt konstatim të pasqyruara në sistemin informatik cats nuk janë hedhur të nesërmen e mbajtjes së tyre, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 2.2 të MKT.

-Projekt raporti i kontrollit tatimor është miratuar me nr. 1801/7 datë 15.07.2022, duke u përfunduar jashtë afatit 7-ditor të përcaktuar në pikën 2.3 të MKT dhe nenit 83 të ligjit për procedurat tatimore.

- Raporti i kontrollit tatimor përfundimtar është miratuar me nr. 1801/9 datë 15.08.2022, (njohuria mbi projektin nga tatimpaguesi është bërë e ditur me shkresën nr. 1801/8 datë 25.07.2022) dhe konstatohet se kjo është bërë në tejkallim të afatit 14 ditor për hartimin e tij, duke qenë jo në përputhje me pikën 2.5 të MKT dhe neneve 83 dhe 84 të ligjit për procedurat tatimore.

**- Tatimpaguesi L J.Q** planifikuar për kontroll për 200 orë pune ose 25 ditë pune.

Inspektori: D.B ing I., përgjegjës sektori A.D./E.M, drejtor kontrolli O.C/M.R, drejtori rajonal D.I/E.C.

Tatimpaguesi është njoftuar për kontroll me shkresën nr. 322 datë 20.01.2022 dhe në vijim me shkresën nr. 322/2 datë 09.02.2022 (marrë njoftimi në 15.02.2022). Sipas formularit nr.3 kontrolli ka filluar në 15.02.2022 dhe ka përfunduar në 08.04.2022. Pra njoftimi për ushtrimin e kontrollit tatimor nuk është kryer të paktën 30 ditë përpara fillimit të kontrollit tatimor, në kundërshtim me pikën 2.1.2 të MKT dhe nenin 81 të ligjit për procedurat tatimore. Gjithashtu konstatohet se janë angazhuar më shumë se 25 ditë punë të miratuara në programin e kontrollit.

Procesverbalet e mbajtur për dokumentimin e procesit të kontrollit tatimor nuk janë hedhur në sistemin e tatimeve të nesërmen e mbajtjes së tyre, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 2.2 të MKT.

-Projekt raporti i kontrollit tatimor është miratuar me nr. 322/3 datë 19.04.2022 duke u përfunduar jashtë afatit 7-ditor të përcaktuar në pikën 2.3 të MKT dhe nenit 83 të ligjit për procedurat tatimore.

-Raporti përfundimtar i kontrollit është miratuar me nr. 322/4 datë 02.09.2022 me vonesë të konsiderueshme nga afati 14 ditor pas marrjes dijeni të tatimpaguesit mbi projekt raportin.

**- Tatimpaguesi I K.H,** planifikuar për kontroll sipas formularit të vizitës së kontrollit për 620 orë pune ose 78 ditë pune. (s'ka programin e kontrollit në dosje dhe as ne sistemin cats)

Inspektori: A.D, përgjegjës sektori A.T, drejtor kontrolli M.Rexha, drejtori rajonal I.A.

Tatimpaguesi është njoftuar për kontroll me shkresën nr. 3289/2 datë 12.05.2021 ndërkohë që sipas formularit nr.3 kontrolli në tatimpagues ka filluar në 17.02.2021, duke mos u respektuar afati 30 ditor i lajmërimit për kontroll para fillimit të tij.

Procesverbalet në sistemin informatik janë hedhur në 11.10.2021, jo të nesërmen e ditës në të cilën janë mbajtur, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 2.2 të MKT.

-Raporti i kontrollit tatimor (projekt) është hartuar nga inspektori në 08.07.2021 dhe është dërguar të tatimpaguesi me shkresën nr. 3289/5 datë 02.09.2021, duke u përfunduar jashtë afatit 7-ditor të përcaktuar në pikën 2.3 të MKT dhe nenit 83 të ligjit për procedurat tatimore.



-Raporti përfundimtar i kontrollit është hartuar me nr. 3289/6 datë 08.10.2021 dhe konstatohet se në krahasim me shkresën e dërgimit të projekt raportit të kontrollit dhe mungesës së komenteve nga tatimpaguesi, ky dokument vlerësohet se është hartuar në tejkallim të afatit 14-ditor nga marrja dijani e tatimpaguesit, duke qenë jo në përputhje me pikën 2.5 të MKT dhe neneve 83 dhe 84 të ligjit për procedurat tatimore.

**- Tatimpaguesi A J.D** planifikuar për kontroll për 220 orë pune ose 28 ditë pune.

Inspektori: S.M, përgjegjës sektori E.M, drejtor kontrolli M.R, drejtori rajonal I.A.

Tatimpaguesi është njoftuar për kontroll me shkresën nr. 1495 datë 19.02.2021 dhe në vijim me shkresën nr. 1495/2 datë 12.03.2021, për të cilën është marrë dijani nga tatimpaguesi në 18.03.2021. Në formularin nr.3 nuk janë plotësuar të dhënat në lidhje me datën e fillimit dhe datën e përfundimit të kontrollit, ndërkohë që në raport kontroll është shprehur që ka filluar në 18.03.2021.

Procesverbalet janë hedhur në sistemin informatik në datën 31.05.2021, jo në ditën e nesërme nga dita e mbajtjes së tyre, duke qenë në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 2.2 të MKT.

-Raporti i kontrollit (projekt) i cili sipas kopjes në sistemin informatik është hartuar në 27.04.2021, rezulton se është dërguar me shkresën nr. 495/3 datë 06.05.2021 dhe duke llogaritur kohën e zgjatjes së kontrollit dhe fillimin e tij rezulton të jetë dërguar në kohë.

-Raporti përfundimtar i kontrollit rezulton të jetë dërguar me shkresën nr. 1495/5 datë 26.05.2021, ndërkohë që dijania mbi projekt raportin është njoftuar nga tatimpaguesi me shkresën nr. 1495/4 datë 19.05.2021, duke u hartuar në afat.

**- Tatimpaguesi K J.V**, sipas praktikës së përzgjedhur për auditim rezulton se nuk janë kontrolle tatimore të realizuara në tatimpagues por referuar praktikës së vendosur në dispozicion janë kontrolle të shoqëruara me akt konstatim. Bashkëlidhur praktikës konstatohet vetëm një akt konstatim së bashku me dokumentacion shoqërues dhe shkresa drejtuar arshivës dhe DPT e firmosur nga inspektorët G.C, F.S, përgjegjës A.C, drejtor kontrolli M.R dhe drejtor rajonal I. A. Realizimi i kësaj praktike me thjesht akt konstatim dhe dokumentacion shoqërues bashkengjitur nuk rezulton të jetë i bazuar në kontrollet që ushtron DTM sipas llojeve të kontrolleve bazuar edhe në legjislacionin përkatës përfshirë manualin e kontrollit tatimor dhe ligjin e procedurave tatimore. Kjo sepse në përfundim të kontrollit nuk ka rezultate mbi atë çfarë është konstatuar. Gjithashtu bashkëlidhur praktikës nuk gjendet as autorizimi për kryerjen e kontrollit apo njoftimi për kryerjen e kontrollit tatimor.

**- Tatimpaguesi A J.L**, planifikuar për kontroll për 400 orë pune ose 50 ditë pune.

Inspektori: A.D, përgjegjës sektori E.M, drejtor kontrolli M.R, drejtori rajonal I.A.

Tatimpaguesi është njoftuar për kontroll me shkresën nr.4192 datë 20.05.2021 dhe në vijim me shkresën nr. 4192/2 datë 07.06.2021 për të cilën është marrë njoftim në 08.06.2021, datë në të cilën ka filluar edhe kontrolli pranë tatimpaguesit. Nga auditimi konstatohet se kontrolli ka filluar më herët se periudha 30-ditore e lajmërimit për fillimin e tij, duke qenë jo në përputhje me pikën 2.1.2 të MKT dhe nenin 81 të ligjit për procedurat tatimore.

Konstatohet se procesverbali nuk është hedhur në sistemin informatik në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 2.2 të MKT.

Raporti i kontrollit tatimor (projekti) rezulton të jetë dërguar me shkresën nr.4192/3 datë 30.07.2021, ndërkohë që sipas formularit nr.3 kontrolli te tatimpaguesi ka përfunduar në

14.07.2021 dhe vlerësohet të mos jetë hartuar brenda afatit 7 ditor nga përfundimi i punës në terren duke qenë jo në përputhje me pikën 2.3 të MKT dhe nenit 83 të ligjit për procedurat tatimore.

Raporti përfundimtar i kontrollit tatimor është miratuar me shkresën nr. 4192/4 datë 26.08.2021 dhe rezulton të jetë miratuar përtej afatit 14-ditor nga koha e marrjes dijeni nga ana e tatimpaguesit për aq kohë sa nuk ka konfirmim nga ana e tij duke qenë jo në përputhje me pikën 2.5 të MKT dhe neneve 83 dhe 84 të ligjit për procedurat tatimore.

**- Tatimpaguesi AK K.M** planifikuar për kontroll për 274 orë ose 34 ditë pune.

Inspektori: H.M, përgjegjës sektori A.C/A.D, drejtor kontrolli M.R, drejtori rajonal I.A.

Tatimpaguesi është njoftuar për kontroll me shkresën nr. 7673 datë 23.08.2021 dhe në vijim me shkresën nr. 7673/2 datë 28.09.2021, për të cilën është marrë njoftim në 29.09.2021, nga ku konstatohet se është respektuar koha e lajmërimit para fillimit të kontrollit.

Konstatohet se procesverbalet nuk janë hedhur në sistemin informatik në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 2.2 të MKT.

Projekt raporti i kontrollit (i hartuar me datë 10.11.2021 sipas dokumentit në sistemin informatik) është dërguar me shkresën nr. 7673/3 datë 16.11.2021 ndërkohë që data e përfundimit të punës në tatimpagues sipas formularit nr.3 raportohet të jetë 03.11.2021.

Raporti përfundimtar i kontrollit është hartuar me datë 23.11.2021 ndërkohë që nga subjekti është dërguar shkresë për marrje dijeni me nr.7673/4 datë 18.11.2021 dhe vlerësohet të jetë hartuar e miratuar në kohë.

**- Tatimpaguesi U-K K.V** planifikuar për kontroll për 200 orë ose 25 ditë pune.

Inspektori: A.D, përgjegjës sektori S.M, drejtor kontrolli O.C, drejtori rajonal E.C.

Tatimpaguesi është njoftuar për kontroll me shkresën nr. 1832 datë 09.03.2022 dhe në vijim me nr. 1832/2 datë 17.03.2021 dhe kontrolli sipas formularit nr. 3 ka filluar në 23.03.2022, duke mos u respektuar afati i njoftimit 30 ditor përpara fillimit të kontrollit, në kundërshtim me pikën 2.1.2 të MKT dhe nenin 81 të ligjit për procedurat tatimore.

Konstatohet se procesverbalet nuk është hedhur në sistemin informatik në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 2.2 të MKT.

Raporti i kontrollit tatimor (projekt) është dërguar me shkresën nr. 1832/5 datë 05.05.2022 ndërkohë që kontrolli te tatimpaguesi sipas formularit nr.3 ka përfunduar në 22.04.2022.

Raporti përfundimtar i kontrollit është dërguar me nr. 1832/6 datë 24.06.2022, jo brenda periudhës 14 ditore nga vlerësimi se është marrë dijenia nga tatimpaguesi duke qenë jo në përputhje me pikën 2.5 të MKT dhe neneve 83 dhe 84 të ligjit për procedurat tatimore.

**- Tatimpaguesi K K.Ë** planifikuar për kontroll për 120 orë ose 15 ditë pune.

Inspektori: G.J, përgjegjës sektori S.M/A.T, drejtor kontrolli M.R/O.C, drejtori rajonal D.I/E.C.

Tatimpaguesi është njoftuar për kontroll me shkresën nr. 10941 datë 22.12.2021 dhe në vijim me shkresën nr. 10941/2 datë 27.01.2022 për të cilën është marrë njoftim në 15.02.2022.

Procesverbalet i datës 15.02.2022 është pasqyruar në cats në datën 08.06.2022, duke mos u pasqyruar të nesërmen nga data e mbajtjes së tij, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 2.2 të MKT.

Projekt raporti i kontrollit tatimor është dërguar me shkresën nr. 10941/5 datë 12.05.2022 ndërkohë që sipas formularit nr. 3 kontrolli te tatimpaguesi ka përfunduar në 05.03.2022. Nga

auditimi konstatohet se raporti i kontrollit (projekt) nuk është hartuar brenda afatit 7 ditor duke qenë jo në përputhje me pikën 2.3 të MKT dhe nenit 83 të ligjit për procedurat tatimore.

Raporti përfundimtar i kontrollit është dërguar me shkresën nr. 10941/6 datë 22.06.2022 duke qenë në tejkalim të afatit 14-ditor nga marrja dijani mbi projektin duke qenë jo në përputhje me pikën 2.5 të MKT dhe neneve 83 dhe 84 të ligjit për procedurat tatimore.

**- Tatimpaguesi C.C K.Q** planifikuar për kontroll për 272 orë ose 34 ditë pune.

Inspektori: D.F, përgjegjës sektori A.D/E.M, drejtor kontrolli M.R/O.C, drejtori rajonal Dionis I/E.C.

Tatimpaguesi është njoftuar për kontroll me shkresën nr. 10932 datë 22.12.2021 dhe në vijim me shkresën nr. 10932/1 datë 19.01.2021, ndërkohë që sipas formularit nr.3 kontrolli ka filluar në 31.01.2022.

Procesverbalet e mbajtura në data të ndryshme janë pasqyruar në cats në 13.04.2022, duke mos u pasqyruar të nesërmen nga data e mbajtjes së tij, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 2.2 të MKT.

Projekt raporti i kontrollit tatimor është dërguar me shkresën 10932/2 datë 14.04.2022, ndërkohë që sipas formularit nr.3 kontrolli ka përfunduar në 14.03.2022. Konstatohet se dërgimi i projektit është realizuar përtej afatit 7-ditor, duke qenë jo në përputhje me pikën 2.3 të MKT dhe nenit 83 të ligjit për procedurat tatimore.

Raporti i kontrollit tatimor është miratuar me nr. 10932/3 datë 23.05.2022, duke qenë me periudhë më të gjatë se 14 ditë nga marrja dijani mbi projektin, duke qenë jo në përputhje me pikën 2.5 të MKT dhe neneve 83 dhe 84 të ligjit për procedurat tatimore.

**- Tatimpaguesi KK.U** planifikuar për kontroll për 248 orë ose 31 ditë pune.

Inspektori: O.K, përgjegjës sektori E.M, drejtor kontrolli O.C, drejtori rajonal E.C.

Tatimpaguesi është njoftuar për kontroll me shkresën nr. 27.06.2022 dhe në vijim me shkresën nr. 5973/3 datë 05.08.2022 dhe sipas formularit nr.3 kontrolli ka filluar në 10.08.2022, pra është respektuar periudha 30 ditore e lajmërimit para kontrollit.

Procesverbalet e mbajtura janë pasqyruar në sistemin cats në datën 17.11.2022, duke mos u pasqyruar të nesërmen nga data e mbajtjes së tij, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 2.2 të MKT.

Raporti i kontrollit tatimor (projekt) është dërguar me nr 5973/5 datë 26.10.2022 ndërkohë që kontrolli te tatimpaguesi ka përfunduar sipas formularit nr.3 në datë 18.10.2022, pra projekt raporti është përgatitur në afat.

Raporti përfundimtar i kontrollit është përgatitur me nr. 5973/7 datë 21.11.2022 pas shkrësës së tatimpaguesit me nr. 5973/6 datë 10.11.2022, duke u përgatitur brenda afatit 14-ditor.

**- Tatimpaguesi Ed K.I,** planifikuar për kontroll për 240 orë ose 30 ditë pune.

Inspektori: I.D, përgjegjës sektori E.M, drejtor kontrolli O.C, drejtori rajonal E.C.

Tatimpaguesi është njoftuar për kontroll me shkresën nr. 3133 datë 28.04.2022 dhe në vijim me nr. 3133/2 datë 20.05.2022 (marrë dijani nga tatimpaguesi në 23.05.2022), ndërkohë që kontrolli ka filluar te tatimpaguesi në 23.05.2022 sipas formularit nr.3, rrjedhimisht konstatohet që nuk është respektuar afati 30 ditor i njoftimit përpara kontrollit, në kundërshtim me pikën 2.1.2 të MKT dhe nenin 81 të ligjit për procedurat tatimore.

Procesverbali dhe akt konstatimi janë pasqyruar në sistemin cats në datën 05.07.2022, duke mos u pasqyruar të nesërmen nga data e mbajtjes së tij, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 2.2 të MKT.

Raporti i kontrollit tatimor (projekt) është përgatitur me nr. 3133/3 datë 12.07.2022 dhe kontrolli te tatimpaguesi sipas formularit nr.3 ka përfunduar në 28.06.2022, pra projekt raporti nuk është përgatitur brenda 7 ditësh nga përfundimi i punës, duke qenë jo në përputhje me pikën 2.3 të MKT dhe nenit 83 të ligjit për procedurat tatimore.

Raporti përfundimtar i kontrollit është përgatitur me nr. 3313/4 datë 15.08.2022 duke qenë me periudhë më të gjatë se 14 ditë nga marrja dijani mbi projektin, jo në përputhje me pikën 2.5 të MKT dhe neneve 83 dhe 84 të ligjit për procedurat tatimore.

**- Tatimpaguesi I.D.K Konstruksion K.J** planifikuar për kontroll për 240 orë ose 30 ditë pune.

Inspektori: H.M, përgjegjës sektori E.M, drejtor kontrolli O.C, drejtori rajonal E. C.

Procesverbali dhe akt konstatimi janë pasqyruar në sistemin cats në datën 06.09.2022, në të njëjtën ditë me raportin e kontrollit tatimor, duke mos u pasqyruar të nesërmen nga data e mbajtjes së tij, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 2.2 të MKT.

Tatimpaguesi është njoftuar për kontroll me shkresën nr. 3130 datë 28.04.2022 dhe në vijim me nr. 3130/2 datë 27.06.2022 dhe kontrolli ka filluar në 30.06.2022, duke u respektuar afati 30 ditor i lajmërimit përpara fillimit të kontrollit.

Raporti i kontrollit tatimor (projekt) është përgatitur me nr. 3130/4 datë 22.08.2022 dhe kontrolli te tatimpaguesi sipas formularit nr.3 ka përfunduar në 15.08.2022, brenda afatit 7 ditor.

Raporti përfundimtar i kontrollit është përgatitur me nr. 3130/6 datë 08.09.2022, pas shkresës së paraqitur nga tatimpaguesi me nr. 3130/5 datë 06.09.2022, duke u paraqitur brenda afatit 14 ditor.

**- Tatimpaguesi M** planifikuar për kontroll për 240 orë ose 30 ditë pune.

Inspektori: D.G, përgjegjës sektori E.M, drejtor kontrolli O.C, drejtori rajonal E.C.

Tatimpaguesi është njoftuar për kontroll me nr. 3150 datë 28.04.2022 dhe në vijim me nr. 3150/1 datë 11.05.2022 për të cilën është marrë njoftim në datë 17.05.2022 dhe kontrolli sipas formularit nr. 3 ka filluar në 17.05.2022, rrjedhimisht konstatohet që nuk është respektuar afati 30 ditor i njoftimit përpara kontrollit, në kundërshtim me pikën 2.1.2 të MKT dhe nenin 81 të ligjit për procedurat tatimore.

Procesverbalet janë pasqyruar në sistemin cats në datën 19.08.2022, duke mos u pasqyruar të nesërmen nga data e mbajtjes së tij, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 2.2 të MKT.

Raporti i kontrollit tatimor (projekt) është përgatitur me nr. 3150/2 datë 16.08.2022 ndërkohë që kontrolli te tatimpaguesi ka përfunduar në 09.08.2022, duke u përgatitur brenda afatit 7 ditor.

Raporti përfundimtar i kontrollit është përgatitur me nr. 3150/3 datë 23.09.2022 duke qenë me periudhë më të gjatë se 14 ditë nga marrja dijani mbi projektin, duke qenë jo në përputhje me pikën 2.5 të MKT dhe neneve 83 dhe 84 të ligjit për procedurat tatimore.

**- Tatimpaguesi A K.I** planifikuar për kontroll për 160 orë ose 20 ditë pune.

Inspektori: O.K, përgjegjës sektori E.M, drejtor kontrolli O.C, drejtori rajonal E.C.

Tatimpaguesi është njoftuar për kontroll me nr. 7423 datë 21.09.2022 dhe në vijim me nr. 7423/2 datë 24.10.2022, dhe kontrolli sipas formularit nr.3 ka filluar në 31.10.2022, duke u respektuar afati 30 ditor i lajmërimit.

Procesverbali është pasqyruar në sistemin cats në datën 15.12.2022, duke mos u pasqyruar të nesërmen nga data e mbajtjes së tij, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 2.2 të MKT. Projekt raporti është dërguar me shkresën nr. 7423/4 datë 02.12.2022 dhe kontrolli te tatimpaguesi ka përfunduar më 24.11.2022, pra projekt raporti është përgatitur brenda afatit 7-ditor.

Raporti i kontrollit përfundimtar është përgatitur me nr. 7423/6 datë 19.12.2022 pas konfirmimit nga tatimpaguesi me nr. 7423/6 datë 19.12.2022, pra brenda afatit nga marrja dijani.

#### **- Tatimpaguesi S.I J.T**

Inspektori: H.M, përgjegjës sektori E.M, drejtor kontrolli O.C, drejtori rajonal E.C.

Tatimpaguesi është njoftuar për kontroll me nr. 2187 datë 18.03.2022 dhe në vijim me nr. 2187/2 datë 28.04.2022 dhe kontrolli ka filluar në 28.04.2022, pra është respektuar afati 30 ditor i lajmërimit para kontrollit.

Procesverbali është pasqyruar në sistemin cats në datën 13.06.2022, duke mos u pasuruar të nesërmen nga data e mbajtjes së tij, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 2.2 të MKT.

Projekt raporti është dërguar me shkresën nr. 2187/4 datë 09.06.2022 dhe kontrolli te tatimpaguesi ka përfunduar në 03.06.2022, pra brenda afatit 7 ditor.

Raporti përfundimtar i kontrollit është miratuar me nr. 2187/6 datë 24.06.2022 pas marrjes së konfirmimit nga tatimpaguesi me nr. 2187/5 datë 14.06.2022, pra brenda periudhës së përcaktuar pas marrjes dijani.

#### **- Tatimpaguesi E J.I, planifikuar për kontroll për 200 orë ose 25 ditë pune.**

Inspektori: G.K dhe I.K, përgjegjës sektori E.M, drejtor kontrolli O.C, drejtori rajonal E.C.

Tatimpaguesi është njoftuar për kontroll me nr. 2190 datë 18.03.2022 dhe në vijim me nr. 2190/1 datë 20.04.2022, për të cilën është marrë njoftim në 21.04.2022, datë në të cilën ka filluar kontrolli, pra është respektuar periudha e lajmërimit para kontrollit.

Procesverbalet janë pasqyruar në sistemin cats në datën 27.05.2022, duke mos u pasqyruar të nesërmen nga data e mbajtjes së tij, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 2.2 të MKT.

Projekt raporti është dërguar me shkresën nr. 2190/2 datë 30.05.2022 ndërkohë që kontrolli te tatimpaguesi ka përfunduar në 04.05.2022, pra projekt raporti nuk është përgatitur brenda 7 ditësh nga përfundimi i punës, duke qenë jo në përputhje me pikën 2.3 të MKT dhe nenit 83 të ligjit për procedurat tatimore.

Raporti i kontrollit tatimor përfundimtar është miratuar me nr. 2190/4 datë 02.06.2022, në të njëjtën ditë me marrjen e konfirmimit nga tatimpaguesi me nr. 2190/3 datë 02.06.2022, pra brenda afatit.

#### **- Tatimpaguesi A.C 2014 me nipt L.H planifikuar për kontroll për 80 orë pune sipas formularit nr 3 pasi dosja fizike nuk është përcjellë për këtë tatimpagues dhe lidhet me rimbursim të kërkuar TVSH.**

Inspektori: F.S, përgjegjës sektori E.M, drejtor kontrolli M.R, drejtori rajonal I.A.

Tatimpaguesi është njoftuar për kontroll me nr. 4251/1 datë 28.05.2021 dhe kontrolli ka filluar në 03.06.2021, duke u respektuar afati për kontrollet që përfshijnë rimbursim TVSH.

Procesverbali i inventarizimit fizik i datës 03.06.2021 është pasqyruar në sistemin cats në datën 05.08.2021, duke mos u pasqyruar të nesërmen nga data e mbajtjes së tij, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 2.2 të MKT.

Projekt raporti i pasqyruar në sistemin informatik cats është hartuar në 26.06.2021, ndërkohë që kontrolli te tatimpaguesi ka përfunduar në 26.06.2021, pra projekt raporti është dërguar në afat te tatimpaguesi.

Raporti i kontrollit tatimor përfundimtar është miratuar në datë 27.08.2021 sipas pasqyrimin në sistemin tatimor cats, me datë sistemi 30.08.2021, duke qenë me periudhë më të gjatë se 14 ditë nga marrja dijani mbi projektin, duke qenë jo në përputhje me pikën 2.5 të MKT dhe neneve 83 dhe 84 të ligjit për procedurat tatimore.

### III

1- Nga këqyrja e akteve të Njoftim Kontrolleve u konstatua se në disa raste se akti nuk kishte të përcaktuar inspektorin/nëpunësin përgjegjës të Drejtorisë Rajonale Tatimore si dhe periudhën objekt të kontrollit sipas përcaktimeve ligjore të pikës 2/dh, të nenit 81 të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

2- Gjithashtu u konstatua se bashkëlidhur aktit te Njoftimit të Kontrollit Tatimor, te nënshkruar nga Drejtori Rajonal ishte bashkëlidhur edhe Akti i Programit të Kontrollit i nënshkruar nga përgjegjësi i zyrës së kontrolleve dhe miratuar nga Drejtori i zyrës së Kontrollit Tatimor **por pa datë, numër protokollit dhe vulë të institucionit.**

3- Gjithashtu u konstatua se Formulari i Vetdeklarimit sipas pikës nr.3 të nenit nr. 81 të ligjit nr Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” ne disa raste nuk rezultonte i nënshkruar në asnjë dosje kontrolli nga subjekti tatimpagues objekt kontrolli

Bazuar në ligjin nr. 44/2015 datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” neni 99 përcakton se “**Kërkesat e formës së aktit administrativ të shkruar në letër ose elektronik“ duhet të përmbajnë elementët e mëposhtëm**

- |   |
|---|
| <p>1. Në çdo rast akti administrativ duhet të tregojë qëllimin e tij.</p> <p>2. Akti administrativ i shkruar në letër ose elektronik përmban:</p> <p>a) pjesën hyrëse, që përmban:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>i) emrin e organit publik që nxjerr aktin;</li><li>ii) palët të cilave u drejtohet akti;</li><li>iii) <b>datën e miratimit;</b></li><li>iv) bazën ligjore;</li></ul> <p>b) pjesën arsyetuese;</p> <p>c) dispozitivin që tregon:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>i) pjesën urdhëruese që tregon çfarë është vendosur;</li><li>ii) kohën e hyrjes në fuqi të aktit;</li><li>iii) të drejtën e ankimit, përfshirë organin publik apo gjykatën ku mund të paraqitet ankimi, mjetet e ankimit, afatin dhe mënyrën e përlllogaritjes së tij për paraqitjen e ankimit.</li></ul> <p>3. Nëse nuk parashikohet ndryshe nga ligji, akti administrativ i shkruar në letër përmban nënshkrimin, emrin dhe mbiemrin e shkruar të nëpunësit përgjegjës, apo përkatësisht të kryetarit dhe të sekretarit të organit kolegjal.</p> <p>4. Akti administrativ elektronik nënshkruhet në mënyrë elektronike në përputhje me legjisllacionin në fuqi. Në këto raste, kërkesat e pikës 3, të këtij neni, zëvendësohen me nënshkrimin elektronik të organit publik, në përputhje me legjisllacionin në fuqi.</p> |
|---|

Gjithashtu në nenin 43 të ligjit nr. 44/2015 datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë “Njësia dhe nëpunësi përgjegjës” të kodit të procedurave administrative përcaktohet sa më poshtë vijon se

- |  |
|--|
| <p>1. Në një procedure administrative, të filluar sipas parashikimeve të nenit 41, të këtij Kodi, organi publik vepron nëpërmjet nëpunësit përgjegjës, të përcaktuar sipas rregullave të këtij neni.</p> |
|--|

2. Titullari i organit publik, nëse nuk është përcaktuar ndryshe me ligj ose akt nënligjor, cakton paraprakisht një njësi përgjegjëse për çdo tip procedure administrative në kompetencë të organit, në përputhje me rregullat e brendshme të veprimtarisë së tij. Ky vendim bëhet publik me çdo mjet të përshtatshëm.

3. Drejtuesi i njësisë përgjegjëse merr përsipër vetë ose cakton me akt të shkruar nëpunësin përgjegjës për zhvillimin e procedurës administrative. Nëpunësi përgjegjës zhvillon procedurën administrative dhe në përfundim propozon me shkrim vendimin përfundimtar, ndërsa vendimi merret dhe nënshkruhet nga personi i përcaktuar nga ligji ose aktet nënligjore.

Sa më poshtë janë të saktësuara edhe rastet e audituara për dosjet e program kontrolleve të tërhequra nga grupi i auditimit pranë zyrës së arshiv-protokollit për të cilat janë audituar procedurat e nxjerrjes së Aktit Administrativ të “Njoftimi i Kontrollit Tatimor”.

Në tabelën sa më poshtë trajtohen edhe rastet e praktikave të dosjeve të kontrollit të tërhequra pranë zyrës së arshiv-protokollit shoqëruar me rastet ku nuk është respektuar përcaktimi ligjor i nenit 81 të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” dhe nenit 43 dhe 99 të ligjit nr. 44/2015 datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” në lidhje me procedurat e njoftimit të Program Kontrollit Tatimor, si më poshtë:

Tatimpaguesi	Njoftimi/Kontroll	Data	Autorizim/program/kontroll	Nr/P/Kontroll	Nëpunësit /autorizuar
K.S	2600/3	06.05.2021	Pa procedure	pa date/ firm/vule	A. D/E.M/M.R
K.V	432/1	27.01.2021	Pa procedure	pa date/ firm/vule	A.D/A.C/M.R
J.N	4289/1	22-06-22	Pa procedure	pa date/ firm/vule	A.D/S.M/O.C
K.I	6220/1	12.10.2021	Pa procedure	pa date/ firm/vule	A.X/A.C/M.R
J.C	1834/1	22-04-22	Pa procedure	pa date/ firm/vule	A.D/A.C/O.C
L.E	330/1	21-02-22	Pa procedure	pa date/ firm/vule	B.M/E.M/O.C
L.T	3127/1	06-02-22	Pa procedure	pa date/ firm/vule	D.B, B.M/ E. /O.C
J.N	7330/2	07.09.2021	Pa procedure	pa date/ firm/vule	D.B/E.M/O.C
K.V	4284/2	07-04-22	Pa procedure	pa date/ firm/vule	D.B/E.M/O.C
J.K	6573/1	01.09.2022	Pa procedure	pa date/ firm/vule	D. F/Q.C/A.T
K.J	2661/3	21-04-21	Pa procedure	pa date/ firm/vule	E.D/E M/M.R
K.E	6843/1	17-08-22	Pa procedure	pa date/ firm/vule	E.D/A.C/O.C
J.V	2595/1	05-06-21	Pa procedure	pa date/ firm/vule	F.H/ E.M/M.R
K.A	252/2	11.02.2021	Pa procedure	pa date/ firm/vule	F.S/E. M/M.R
J.G	765/1	21.02.2022	Pa procedure	pa date/ firm/vule	F.S /E.M/O.C
K.O	329/1	21.02.2022	Pa procedure	pa date/ firm/vule	F.S/E.M/O.C
J.A	7650/1	24.09.2021	Pa procedure	pa date/ firm/vule	H.M/A T/M.R
K.N	6478/2	08-02-22	Pa procedure	pa date/ firm/vule	H.M, /E.M/O.C
K.K	6557/2	23-08-22	Pa procedure	pa date/ firm/vule	H.M/A.D/O.C
J.C	10946/1	27-01-22	Pa procedure	pa date/ firm/vule	H.M/ A.T/O.C
K.U	1457/1	26-03-21	Pa procedure	pa date/ firm/vule	I.L/A.C/M.R
K.Ë	3288/2	06-03-21	Pa procedure	pa date/ firm/vule	IT/A.T/M.R
J.C	7669/1	21-09-21	Pa procedure	pa date/ firm/vule	M X, B.F/A.D/M.R
J.C	2191/2	14-04-22	Pa procedure	pa date/ firm/vule	Ma X/E.M/O.C
K.T	3132/2	06-08-22	Pa procedure	pa date/ firm/vule	M. M/E.M/O.C
K.L	5927/1	25.07.2022	Pa procedure	pa date/ firm/vule	M. H/S.H/O.C
L.M	2626/1	20-04-21	Pa procedure	pa date/ firm/vule	O.K, D. B/A.C/M.R
J.T	6813/1	26-08-21	Pa procedure	pa date/ firm/vule	O.K, A.D/M.R
K.S	10119/2	15.12.2021	Pa procedure	pa date/ firm/vule	O.K/A.D/O.C/
J.A	6217/1	10-05-20	Pa procedure	pa date/ firm/vule	P.B/ A.C/M.R/
J.V	4191/2	25-08-21	Pa procedure	pa date/ firm/vule	S.M/E.M/M.R/
K.Q	5926/1	29-07-22	Pa procedure	pa date/ firm/vule	S.M/A.C/O.C/
K.O	6817/2	31-08-21	Pa procedure	pa date/ firm/vule	T.F, A.D./M.R\
L.I	6083/2	23.08.2021	Pa procedure	pa date/ firm/vule	V.M/B.K/M.R/

Si konkluzion nga veprimet dhe mosveprimet e mësipërme arrihet në përfundimin se nga nëpunësit zyrtarë të autorizuar sa më sipër nuk janë përmbushur detyrat funksionale të parashikuara në Rregulloren e Funksionimit të Administratës Tatimore dalë me Urdhrin nr. 192 datë 12.08.2020 si dhe përcaktimit ligjor të nenit 81 të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjit nr. 44/2015 datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”. Nga auditimi u konstatua se nuk rezultojnë të kryera sipas përcaktimeve të nenit 43 dhe 99 të ligjit nr. 44/2015 datë 30.04.2015

“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” procedurat administrative për nxjerrjen e akteve të “**Autorizimit**” për Inspektorin /nëpunës civilë që do të kryejë procedurat e kontrollit tatimor dhe procedura administrative e nxjerrjes së aktit administrative “**Program Kontrolli**” sipas formës së përcaktuar në kodin e procedurave administrative në lidhje me formën dhe përmbajtjen e aktit me nr. datë/firmë/vulë.

**Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:**

1-Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

2-Rregullore e Funkcionimit të Administratës Tatimore dalë me Urdhrin nr. 192 datë 12.08.2020.

3-Rregullore e Funkcionimit të Administratës Tatimore Qendrore miratuar me Urdhër nr. 1482/2 prot, datë 22.02.2017 të Ministrit të Financave

4-Manuli i Procedurave Tatimore.

5- Nenit 43 dhe 99 Ligji nr. 44/2015 datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

**Në lidhje me procedurat tatimore ligjore dhe administrative të ndjekura nga Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj (DTM) për nxjerrjen e Aktit të Raportit Paraprak të Kontrollit Tatimor në përputhje me legjislacionin në fuqi u konstatua se:**

Bazuar në nenin nr. 83 “Raporti i Kontrollit Tatimor” të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar ku përcaktohet se :

**83.1** Pas çdo kontrolli tatimor, jo me shume se 7 shtate dite nga përfundimi i tij, inspektori i kontrollit tatimor, është i detyruar te përgatisë raportin e kontrollit.

**83.2** Raporti i kontrollit tatimor, përshkruan veprimtarinë ekonomike e tregtare te personit te tatueshëm, deklaratat, dokumentet, librat, regjistrat dhe regjistrimet e kontrolluara, te dhënat e shfrytëzuara gjate kontrollit dhe burimet e tyre, mënyrat e ushtrimit te kontrollit, etj. Raporti i kontrollit jep gjetjet e tij, problemet e dala, rezultatet e kontrollit, shkeljet e kryera nga personi i tatueshëm me argumentimin përkatës, shumën e vlerësimit tatimor te propozuar dhe referencat ligjore ku e mbështet atë. Raporti i kontrollit përbën bazën për vlerësimin tatimor pas kontrollit, për kontrolle te mëvonshme si dhe për vlerësimin e punës se vete kontrollorit nga ana e drejtuesve te drejtorisë rajonale te tatimeve.

**83.3** Inspektori i kontrollit i jep urdhëruesit te kontrollit një kopje e raportit të kontrollit, kurse një kopje tjetër ia dërgon personit te tatueshëm, me shërbimin postar rekomande.

**83.4** Personi i tatueshëm i kontrolluar ka të drejtë të kundërshtojë rezultatet e kontrollit tatimor brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve kalendarike pas datës, kur vlerësohet se raporti është marrë nga tatimpaguesi.

**83.5** Kundërshtimi paraqitet me shkrim dhe ai i dërgohet drejtorisë rajonale te tatimeve me shërbimin postar rekomande ose dorëzohet dorazi në drejtorinë rajonale përkundrejt marrjes së një konfirmimi me shkrim.

Në tabelën e mëposhtme janë të saktësuara edhe rastet e audituara për dosjet e Raportit Kontrollit të tërhequra nga grupi i auditimit pranë zyrës së arshiv-protokollit për të cilat janë audituar procedurat e nxjerrjes së Aktit Administrativ të “Raport Kontrolli”. Nga këqyrja e akteve të Përfundimit të Kontrollit në terren nga **inspektori/nëpunësi përgjegjës** dhe datës së evadimit të Raportit Paraprak të Kontrollit u konstatuan raste në të cilat evadimi shkresor i materialit të Raportit Kontrollit nuk ishte kryer brenda afateve të përcaktuara në nenin nr. 83 “Raporti i Kontrollit Tatimor” të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” brenda afatit prej 7 ditësh.

Sa më poshtë rastet ku nga ana e përfaqësuesve të DTM janë zbatuar afatet ligjore të përgatitjes së Raportit të Kontrollit **brenda 7 ditëve** në përputhje me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, si më poshtë:

Tatimpaguesi	Njoftimi/Kontroll	Data	Projekt Raport	Dt/Evadimit	Dt/Inspektorit	Nenpunesit /autorizuar
J.V	2595/1	05-06-21	2595/2	tejkalim afati	tejkalim afati	F. H/ E.M/M.R/LA
J.K	6573/1	01.09.2022	6572/2	afat	afat	D.F/O.C/A T/E.C
J.C	1834/1	22/04/2022	1834/5	afat	afat	A.D/S.M/O.C/E.C
J.G	765/1	21.02.2022	765/2	tejkalim afati	tejkalim afati	F.S/E.M/O.C /E.C
J.C	2191/2	14/04/2022	2191/6	afat	afat	M.X/E.M/O.C/E.C
J.C	10946/1	27/01/2022	10946/2	tejkalim afati	tejkalim afati	H. M/ A.T/O.C/E.C
J.V	4191/2	25/08/2021	4191/3	afat	afat	S.M/E.M/M.R/LA
J.T	6813/1	26/08/2021	6813/3	afati	afati	O. K, A.D/M.R/LA
J.C	7669/1	21/09/2021	7669/2	afat	afat	M. X, B. F/A.D/M.R/D.I



J.A	7650/1	24.09.2021	7650/3	tejkalim afati	tejkalim afati	H.M/A.T/M.R/D.T
J.N	7330/2	07.09.2021	7330/3	afat	afat	D.B/E.M/O.C/E.C
J.N	4289/1	22/06/2022	4289/3	afat	afat	A.D/S.M/O.C/E.C
J.A	6217/1	10-05-20	6217/2	tejkalim afati	tejkalim afati	P. B/ A.C/M.R/L.A
K.J	2661/3	21/04/2021	2661/4	afat	afat	E./E./M/M.R/L.A
K.S	2600/3	06.05.2021	2600/4	afat	afat	A. D/E.M/M.R/L.A
K.Ë	3288/2	06-03-21	3288/3	tejkalim afati	tejkalim afati	I.T/A.Ti/M.R/L.A
K.S	10119/2	15.12.2021	10119/3	afat	afat	O. K/A.D/O.C/E.C
K.U	1457/1	26/03/2021	1457/2	tejkalim afati	tejkalim afati	I.L/A.C/M.R/L.A
K.N	6478/2	08-02-22	6478/3	afat	afat	H.M, EA/E.M/O.C/E.C
K.A	252/2	11.02.2021	252/4	afat	afat	F. S/E.M/L.A
K.V	4284/2	07-04-22	4284/3	afat	afat	D.B/E.M/O.C/E.C
K.T	3132/2	06-08-22	3132/4	afat	afat	MM, EA/E.M/O.C/E.C
K.L	5927/1	25.07.2022	5927/3	tejkalim afati	tejkalim afati	M.H/S.Hi/O.C/E.C
K.K	6557/2	23/08/2022	6557/3	afat	afat	H.M/A.D. O.C/E.C
K.O	6817/2	31/08/2021	6817/3	afat	afat	T.F. I.K/A.D/M.R/L.A
K.I	6220/1	12.10.2021	6220/3	tejkalim afati	tejkalim afati	A.X/A.C/M.R/L.A
K.Q	5926/1	29/07/2022	5926/3	afat	afat	S.M/S.M. O.C/E.C
K.V	432/1	27.01.2021	432/3	afat	afati	A.D/A.C/M.R/ I. A
K.E	6843/1	17/08/2022	6843/1	afat	afat	E.D/S.M/O.C/E.C
K.O	329/1	21.02.2022	329/2	afat	afat	F.S/E. M/O.C/E.C
L.E	330/1	21/02/2022	330/2	afat	afat	B.M/E.M/O.C/E.C
L.T	3127/1	06-02-22	3127/3	afat	afat	D.B. B. M/ E.M/O.C/E.C
L.M	2626/1	20/04/2021	2626/6	afat	afat	O.K. D.B/A.C, M.R/L.A
L.I	6083/2	23.08.2021	6083/3	tejkalim afati	tejkalim afati	V.M/B.K/M.R/L.A

Si konkluzion nga veprimet dhe mosveprimet e mësipërme të kryera në kundërshtim me detyrat funksionale të përcaktuara në fushën e përgjegjësisë ligjore arrihet në përfundimin se nga nëpunësit zyrtare të autorizuar sa me sipër si dhe inspektorët/nëpunës përgjegjës të përmendur në tabelë të nuk kanë përmbushur detyrat funksionale për evadimin e materialeve shkresore zyrtare administrative jashtë afateve të parashikuara shikuara në Rregulloren e Funksionimit të Administratës Tatimore dalë me Urdhrin nr. 192 datë 12.08.2020 si dhe përcaktimit ligjor të nenit 83 të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” dhe nenit 43 dhe 99 të ligjit nr. 44/2015 datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

**Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:**

1-Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

2- Rregulloren e Funksionimit të Administratës Tatimore dalë me Urdhrin nr. 192 datë 12.08.2020

3-Rregullore e Funksionimit të Administratës Tatimore Qendrore miratuar me Urdhër nr. 1482/2 prot, datë 22.02.2017 të Ministrit të Financave

4-Manuali i Kontrollit Tatimor

**🚩 Në lidhje me procedurat tatimore ligjore dhe administrative të ndjekura DTM për nxjerrjen e Aktit të Raportit Përfundimtar të Kontrollit Tatimor në përputhje me legjislacionin në fuqi u konstatua se:**

Bazuar në nenin nr. 84 “Raporti Përfundimtar i Kontrollit Tatimor” dhe nenit 23 “Mënyrat e Komunikimit me Tatimpaguesin” të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar ku përcaktohet se:

1. Raporti përfundimtar i kontrollit tatimor plotësohet dhe nënshkruhet nga të gjithë pjesëtarët e grupit të kontrollit dhe miratohet nga urdhëruesi i kontrollit, brenda 14 ditëve kalendrike nga data e marrjes së kundërshtimit të tatimpaguesit, ose që vlerësohet të jetë marrë nga grupi i kontrollit tatimor.

2. Raporti përfundimtar i kontrollit tatimor përshkruan vendin e kontrollit, periudhën, për të cilën është kryer kontrolli, një përshkrim të dokumenteve të shqyrtuara, personat e intervistuar, arsyetimin e tatimpaguesit, të marrë parasysh dhe rezultatin e argumentuar të kontrollit.

3. Një kopje e raportit përfundimtar të kontrollit tatimor dhe shuma e vlerësimit, nëse ka, i dërgohet tatimpaguesit me postë dhe një kopje dorëzohet në drejtorinë rajonale tatimore apo në njësinë e ngjashme me të.

4. Nëse raporti përfundimtar i kontrollit tatimor propozon një vlerësim të ri, ky vlerësim hyn në fuqi 30 ditë kalendrike nga data që raporti i kontrollit është marrë ose vlerësohet të jetë marrë nga tatimpaguesi

5. Tatimpaguesi, që kundërshton vlerësimin e propozuar, mund ta ankimojë këtë vlerësim, në përputhje me dispozitat e kreut XIII të këtij ligji.

**Neni 23 Mënyrat e komunikimit me tatimpaguesin.**

1. Administrata tatimore mund të kërkojë përdorimin nga tatimpaguesit të formularëve të veçantë, për dorëzimin e dokumentacionit, informacionit apo kërkesave. Kur nuk kërkohet formular, çdo komunikim, i kërkuar sipas legjislacionit tatimor, dërgohet në mënyrë elektronike ose dorëzohet me shkrim, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe.

2. Vlerësimet, njoftimet, vendimet dhe komunikimet zyrtare të administratës tatimore, drejtuar tatimpaguesit, i njoftohen atij duke ia dërguar në adresën e deklaruar nga vetë ai:

a) në rrugë elektronike, në përputhje me legjislacionin e komunikimeve elektronike dhe kur tatimpaguesi ka dhënë pëlqimin për pranimin e njoftimit në rrugë elektronike dhe;

b) nëpërmjet shërbimit postar rekomandë.

3. Aktet e përcaktuara në pikën 2, të këtij neni, dhe çdo korrespondencë tjetër që i dërgohet tatimpaguesit nga administrata tatimore, konsiderohen të marra nga tatimpaguesi jo më vonë se dhjetë ditë kalendarike pas datës së dërgimit të mesazhit elektronik dhe të postës rekomandë. Data e njoftimit është data e nisjes së mesazhit elektronik apo e pranimit të dokumentit nga shërbimi postar. Dhënia e pëlqimit dhe mënyra për marrjen dhe vlefshmërinë e dhënies së pëlqimit për komunikimin elektronik të tatimpaguesit me administratën tatimore rregullohen me udhëzim të Ministrit të Financave.

3/1. Për qëllime të përcaktimit të fillimit të afatit për marrjen e akteve tatimore, sipas këtij ligji, në llogaritjen e afateve në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative nuk përfshihet dita në të cilën del akti. Llogaritja e afatit fillon nga e nesërmja e ditës kur akti është marrë ose konsiderohet të jetë marrë nga tatimpaguesi.

4. Tatimpaguesi është i detyruar të deklarojë adresën e saktë, në mënyrë që të sigurojë marrjen në kohë të njoftimeve.

5. Ministri i Financave, në zbatim të këtij neni, me propozimin e Drejtorit të

Përgjithshëm të Tatimeve, miraton llojet e dokumentacionit, të dhënat, që duhet të

përfshihen në informacion, si dhe procedurat e dërgimit pranë administratës tatimore.

Në tabelën e mëposhtme janë të saktësuara edhe rastet e audituara për dosjet e Raportit të Kontrollit të tërhequra nga grupi i auditimit pranë zyrës së arshiv-protokollit për të cilat janë audituar procedurat e nxjerrjes së Aktit Administrativ të “Raportit Përfundimtar të Kontrollit”. Nga këqyrja e akteve të Evadimit të Raportit Përfundimtar të Kontrollit nga Inspektori/nëpunësi përgjegjës dhe zyrtarët eprorë të ngarkuar nga legjislacioni në fuqi u konstatuan raste në të cilat evadimi shkresor i materialit të Raportit Përfundimtar të Kontrollit nuk ishte kryer brenda afateve të përcaktuara në nenin nr. 84 “Raportit Përfundimtar të Kontrollit Tatimor” të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”. Sa më poshtë rastet ku nga ana e përfaqësuesve të DTM nuk janë zbatuar afatet ligjore të përgatitjes së Raportit Përfundimtar të Kontrollit në përputhje me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, si më poshtë:

	Njoftimi	Data	Rap/perfund	Data Evadimit	Date/Inspektor	Afati kohor	Shkresë Nj/Vlerësim	Nëpunësit
K.K	6557/2	23/08/2022	6557/7	17-10-22	12.10.2022	ne afat	17/10/2022	H. M/A.Dj/O.C/E.C
L.I	6083/2	23.08.2021	6083/4	23.11.2021	17.11.2021	ne afat	23.11.2021	V. Mj/B.K/M.r/I.A
J.V	2595/1	05-06-21	2595/5	29/09/2021	28/09/2021	tejkalim	29/09/2021	F.H/ E.M/M.R/I.A
J.K	6573/1	01.09.2022	6573/3	20.12.2022	20.12.2022	tejkalim	20.12.2022	D.F/O.C/A T/E.C
J.C	1834/1	22/04/2022	1834/8	28/07/2022	26/07/2022	afat	28/07/2022	A.D/S.M/O.C/E.C
J.G	765/1	21.02.2022	765/3	26.07.2022	21.07.2022	tejkalim	26.07.2022	F.S /E.M/O.c/E.C
J.C	2191/2	14/04/2022	2191/9	02.08.2022	20/07/2022	tejkalim	08-02-22	M.X/E.M/O.C/E.C
J.C	10946/1	27/01/2022	10946/6	05.11.2022	05-11-22	tejkalim	17/05/2022	H.M/ A.T/O.C/E.C
J.V	4191/2	25/08/2021	4191/7	18/11/2021	13-11-21	afat	18/11/2021	S.M.M/M.R/I.A
J.T	6813/1	26/08/2021	6813/7	10.11.2021	08.11.2021	tejkalim	11-10-21	O. K, I.K/A.D.M.R/I.A
J.C	7669/1	21/09/2021	7669/6	21/12/2021	20/12/2021	tejkalim	21/12/2021	M.X, B.F/A.D/M.R/D.I
J.A	7650/1	24.09.2021	7650/11	07.12.2021	06.11.2021	tejkalim	07.12.2021	H.M/A T/M.R/D.T
J.N	7330/2	07.09.2021	7330/7	07.12.2021	06.12.2021	tejkalim	07.12.2021	D.B/E.M/O.C.E.C
J.N	4289/1	22/06/2022	4289/6	22/09/2022	14/09/2022	afat	22/09/2022	A.DS.M/O.C/E.C
J.A	6217/1	10-05-20	6217/8	20/04/2021	19/04/2021	tejkalim	20/04/2021	P.B/ A.C/M.R/I.A
K.J	2661/3	21/04/2021	2661/7	18/06/2021	17/06/2021	tejkalim	18/06/2021	E.D/E M/M.R/I.A
K.S	2600/3	06.05.2021	2600/7	15.09.2021	13.09.2021	afat	15.09.2021	A. D/E.MM.R/I.A
K.Ë	3288/2	06-03-21	3288/6	28/10/2021	25/10/2021	tejkalim	28/10/2021	I. T/A.TM.R/I.A
K.S	10119/2	15.12.2021	10119/4	06.05.2022	04.04.2022	tejkalim	06.05.2022	O.K/A.D/O.C/E.C

K.U	1457/1	26/03/2021	1457/5	14/07/2021	13/07/2021	tejkalim	26.03.2021	I. L/A.C/M.R/I.A
K.N	6478/2	08-02-22	6478/7	21/10/2022	17/10/2022	afat	21/10/2022	H.M/E.M/O.C/E.C
K.A	252/2	11.02.2021	252/6	24.06.2021	22.06.2021	tejkalim	24.06.2021	F. SE/mr/I.A
K.V	4284/2	07-04-22	4284/6	28/09/2022	26/09/2022	afat	28/09/2022	D B/E.M/O.C/E.C
K.T	3132/2	06-08-22	3132/7	07.09.2022	02.09.2022	afat	09-07-22	M.M./E.M./O.C./E.C.
K.L	5927/1	25.07.2022	5927/3	26.10.2022	25.10.2022	afat	26.10.2022	M.H/S.M./O.C/E.C.
K.O	6817/2	31/08/2021	6817/6	11-09-21	11-08-21	tejkalim	11-09-21	T.F/A.DM.R/I.A.
K.I	6220/1	12.10.2021	6220/3	07.01.2021	05.01.2021	tejkalim	07.01.2021	A.X/A.C/M.R/I.A.
K.Q	5926/1	29/07/2022	5926/5	28/10/2022	26/10/2022	afat	28/10/2022	S.M/S.M/O.C/E.C.
K.V	432/1	27.01.2021	432/5	24.03.2021	19.03.2021	afat	24.03.2021	A.DA.C/M.R/ I .A.
K.E	6843/1	17/08/2022	6843/5	19/09/2022	16/09/2022	afat	19/09/2022	E.D/S.MO.C/E.C.
K.O	329/1	21.02.2022	329/6	03.06.2022	02.06.2022	afat	03.06.2022	F.S/E.M/O.C./E.C.
L.E	330/1	21/02/2022	330/7	13/05/2022	11-05-22	tejkalim	13/05/2022	B.M/E.M./O.C./E.C.
L.T	3127/1	06-02-22	3127/6	26/10/2022	24/10/2022	afat	26/10/2022	D. B., B.M.E.M./O.C./E.C.
L.M	2626/1	20/04/2021	2626/10	13/09/2021	09-07-21	afat	13/09/2021	O.K., D.B./A.C/M.R/I.A.

Nga veprimet dhe mosveprimet e mësipërme të kryera në kundërshtim me detyrat funksionale të përcaktuara në fushën e përgjegjësisë ligjore arrihet në përfundimin se nga nëpunësit zyrtarë të autorizuar si dhe inspektorët/nëpunës përgjegjës të përmendur në tabelë të cilët nuk kanë përmbushur detyrat funksionale të parashikuara në Rregulloren e Funkcionimit të Administratës Tatimore dalë me Urdhrin nr. 192, datë 12.08.2020 si dhe përcaktimit ligjor të nenit 84 të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” dhe nenit 43 dhe 99 të ligjit nr. 44/2015 datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë.”

***Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:***

1-Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

2-Rregulloren e Funkcionimit të Administratës Tatimore dalë me Urdhrin nr. 192 datë 12.08.2020.

3-Rregullore e Funkcionimit të Administratës Tatimore Qendrore miratuar me Urdhër nr. 1482/2 prot. datë 22.02.2017 të Ministrit të Financave.

4-Manuali i Kontrollit Tatimor.

Sa më sipër për mangësitë e konstatuara rast pas rasti, ngarkohen me përgjegjësi, sipas subjekteve për kontroll, Inspektorët, Përgjegjësit e Kontrollit Tatimor, Drejtorët e Kontrollit Tatimor dhe Drejtorët Rajonal pranë Drejtorisë së Tatimpaguesve të Mëdhenj.

**Gjetja:** Mos respektimi i procedurave dhe afateve në kontrollet e ushtruara tek tatimpaguesi

**Situata:** Nga verifikimi i zbatimit të procedurave dhe afateve për kontrollet e ushtruara tek tatimpaguesi kanë rezultuar mangësi si vijon:

- Në 32 raste në sistemin C@TS mungon dokumenti mbi Njoftimin e Kontrollit, në 6 raste formulari nr. 3, dhe në 1 rast mungon dokumenti Raporti Përfundimtar i Kontrollit, jo në përputhje me Manualin i Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2.2.

- Në 28 raste, formulari nr.3, nënshkrimi nga Inspektori i Kontrollit, Përgjegjësi i Sektorit të Kontrollit, Drejtori i Kontrollit dhe Drejtori i Drejtorisë Rajonale nuk kanë datë.

- Në 11 raste në dosje nuk administrohet shkresa për dërgimin e Projekt Raportit dhe Raportit Përfundimtar.

- Në 1 rast në dosje nuk administrohet Njoftimi i Kontrollit dhe programi i kontrollit.

- Në 26 raste Projekt Raporti, Raporti Përfundimtar i Kontrollit dhe procesverbalet janë hedhur me vonesë në C@TS, jo në përputhje me Manualin

	<p>i Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2.2.</p> <p>- Në 8 raste nuk është respektuar afati 30 ditor, nga njoftimi i kontrollit deri në fillimin e kontrollit në subjekt, në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit 9920 “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 81, pika 1.1.</p> <p>- Në 9 raste kontrolli është kryer në tejkalim të afatit të parashikuar në programin e kontrollit, jo në përputhje me përcaktimet e Manualit të Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2.3 ku citohet: “Kohëzgjatja e nevojshme e kontrollit përcaktohet nga të dhënat e analizës së riskut. Kohëzgjatja e kontrollit përcaktohet në baze të orëve të punës të parashikuara në Programin e Kontrollit. Kjo periudhë kohe merr parasysh kohën e kontrollit, pa përfshirë kohën për përgatitjen e raportit të kontrollit, i cili duhet të përgatitet brenda shtatë ditëve kalendarike nga data e përfundimit të tij tek tatimpaguesi”.</p> <p>- Në 6 raste nuk është respektuar afati 7 ditor për përgatitjen e Projekt Raportit nga Inspektori jo sipas përcaktimeve të Ligjit 9920 “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 83, pika 1.</p> <p>- Në 22 raste nuk janë respektuar afatet nga përgatitja dhe dërgimi i Projekt Raporti deri në përgatitjen dhe dërgimin e Raportit Përfundimtar të Kontrollit në subjekt, jo sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9920 “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 83, pika 1 dhe 4, Neni 84, pika 1.</p>
<b>Kriteri:</b>	- Ligji Nr. 9920 “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, Neni 81, pika 1.1, neni 83, pika 1 dhe 4, Neni 84, pika 1.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	- Manuali i Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2.2, 2.3, Kapitulli VIII, pika 8. Mosrespektimi i procedurave dhe afateve ligjore në kontrollet e ushtruara tek tatimpaguesi.
<b>Shkaku:</b>	Mosrespektimi i përcaktimeve ligjore të Ligjit Nr. 9920 “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, Neni 81, pika 1.1, neni 83, pika 1 dhe 4, Neni 84, pika 1 dhe Manualit të Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2.2, 2.3, Kapitulli VIII, pika 8.
<b>Rëndësia:</b>	E Lartë
<b>Rekomandimi</b>	Nga Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj të merren masa menjëherë dhe në vijimësi të zbatohen me korrektësi procedurat dhe afatet e përcaktuara ligjore për ushtrimin e kontrolleve tek tatimpaguesit.
<b>Gjetja:</b>	<b>Mungesa në parashikimet e Ligjit Nr. 9920 “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” dhe Manualin e Kontrollit Tatimor, Kapitulli VIII, pika 8, për përcaktimin e afatit maksimal nga përfundimi i përgatitjes së Projekt Raportit nga Inspektori deri në miratimin e tij nga eprorët (Përgjegjës Sektori/Drejtor).</b>
<b>Situata:</b>	Nga verifikimi i zbatimit të procedurave dhe afateve për kontrollet e ushtruara tek tatimpaguesi nga Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj, rezulton se afati nga përfundimi i përgatitjes së Projekt Raportit nga Inspektori deri në miratimin e tij nga eprorët (Përgjegjës Sektori/Drejtor) varion nga 10 ditë deri në 2 muaj.
	Në parashikimet e Ligjit Nr. 9920 “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” dhe Manualin e Kontrollit Tatimor, Kapitulli VIII, pika 8, nuk është përcaktuar afati maksimal për miratimin Projekt Raportit nga eprorët (Përgjegjës Sektori/Drejtor), duke e bërë këtë fazë të procedurës së kontrollit evazive.
<b>Kriteri:</b>	- Ligji Nr. 9920 “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.
	- Manuali i Kontrollit Tatimor, Kapitulli VIII, pika 8.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Mosrespektimi i procedurave dhe afateve ligjore në evadimin e materialeve të

	kontrollit.
<b>Shkaku:</b>	Mungesa e përcaktimit ligjor në aktet mbi të cilën ushtron veprimtarinë Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj.
<b>Rëndësia:</b>	E Lartë
<b>Rekomandimi</b>	Nga Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj në bashkëpunim me Drejtorin e Përgjithshme të Tatimeve, të merren masa dhe të bëhen përmirësime në aktet ligjore dhe nënligjore për përcaktimin e afatit maksimal nga përfundimi i përgatitjes së Projekt Raportit nga Inspektori deri në miratimin e tij nga eprorët (Përgjegjës Sektori/Drejtor).
<b>Titulli:</b>	Mangësi të identifikuar në auditimin e afateve të kryerjes së kontrolleve tatimore
<b>Situata:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Njoftimi i fillimit të kontrollit tatimor, në disa raste, rezultoi të jetë dërguar përpara afatit 30 ditor të fillimit të kontrollit, duke mos respektuar afatin 30 ditor të lajmërimit përpara fillimit të kontrollit.</li> <li>- Në të gjitha rastet, procesverbalet dhe akt konstatimi të hartuar në data të ndryshme janë hedhur në sistemin informatik, por jo sipas afatit të përcaktuar në pikën 2.2 të MKT (të nesërmen nga dita e mbajtjes së tij).</li> <li>- Raporti i kontrollit tatimor (projekti) në pjesën më të madhe të kampionit është hartuar në tejkalim të afatit 7 ditor nga data e përfundimit të tij të tatimpaguesit, të përcaktuar në pikën 2.3 të MKT dhe nenit 83 të ligjit për procedurat tatimore.</li> <li>- Raporti përfundimtar i kontrollit vlerësohet të jetë miratuar në pjesën më të madhe të kampionit në tejkalim të afatit 14-ditor nga marrja e kundërshtimeve të tatimpaguesit, jo në përputhje me përcaktimet e bëra në pikën 2.5 të MKT dhe neneve 83 dhe 84 të ligjit për procedurat tatimore.</li> </ul>
<b>Kriteri:</b>	Ligji për procedurat tatimore i ndryshuar Manuali i kontrollit tatimor
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Parregullsi në kryerjen e kontrollit
<b>Shkaku:</b>	Mos respektimi i afateve dhe procedurave administrative
<b>Rëndësia:</b>	E lartë
<b>Rekomandimi:</b>	<p>Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj, referuar mangësive dhe parregullsive në procedurën e kontrollit për afatet të marrë masa për:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- pasqyrimin në kohë të akteve të kontrollit (procesverbale, akt konstatime) në sistemin informatik tatimor;</li> <li>- të mos fillojë kontrolle pa u respektuar afatet e njoftimit të kontrollit;</li> <li>- të përmirësojë procedurën e hartimit të raportit paraprak të kontrollit në kohë</li> <li>- të mbajë komunikim të vazhdueshëm me tatimpaguesit për pasqyrimin e observacioneve dhe respektimin e afatit të përfundimit në kohë të raportit të kontrollit tatimor përfundimtar.</li> </ul>

Në lidhje me pikën 2.6 të Projekt Raportit, janë paraqitur observacione me shkresën nr. 52/28 prot., datë 11.09.2023, administruar në KLSH me nr. 14/11 prot., datë 12.09.2023, nga Inspektorët z.S.M, z. L.K, z. S.M, z. P.B, Znj. A.P, të cilët kanë bërë **komente dhe shpjegime** dhe konkretisht:  
- *Ne lidhje me subjektin "E" SHPK me Nipt 1.Q*

Njoftim kontrollit i firmosur nga perfaqesuesi i shoqërisë ne ditën e fillimit te kontrollit dhe formulari 3 ndodhen ne arshive bashke me gjithë praktiken e kontrollit

-Tek formulari nr. 3, nënshkrimi nga Inspektori (firma) ndodhet tek kutia ne krah te majte te emrit te inspektorit përkatësisht me përshkrimin: Data e dorëzimit te raport kontrollit pranë përgjegjësit te sektorit te kontrollit: Dorëzuar date 15.07.2022

-procesverbalet, projekti dhe raporti përfundimtar janë hedhur ne sistem ne momentin e aksesimit te sistemit tek zyrat e reja.

- Ne lidhje me procedurën e ndjekur nga inspektori sqaroj se:

Afati i kontrollit ne ketë subjekt ka qene 240 ore ose 30 dite pune. Kontrolli ka nisur ne date 01.06.2022 dhe ka përfunduar ne date 12.07.2022 (sipas te dhënave tek Formulari 3), pra 30 dite pune. Inspektori ka përgatitur Projekt Raportin ne date 15.07.2022 (sipas të dhënave tek Formulari 3), bazuar tek neni 83, pika 1 te Ligjit Nr 9920 "Per Procedurat tatimore ne RSH" (brenda 7 ditëve kalendarike) dhe ka bere dorëzimin tek Përgjegjësi i Sektorit te Kontrollit po ne date 15.07.2022 (përshkrimi tek Formulari 3 Dorëzuar date 15.07.2022). Nisja ne subjekt ne date 27.07.2022 është bere pas firmosje nga eproret përkatës. Me pas deri ne përgatitjen e Raportit Përfundimtar te Kontrollit nga ana e inspektorit është ndjekur procedura bazuar ne legjislacionin përkatës, pra persa me sipër duke qene se nga shoqeria nuk ka pasur kundërshtim te rezultateve te kontrollit (sipas Projekt Raportit), nga ana e inspektorit janë llogaritur afatet deri ne përgatitjen e Raportit Përfundimtar te Kontrolli si me poshtë:

data e nisjes ne subjekt te Projekt Raportit është 27.07.2022 (sipas numrit te protokollit) 10 dite kalendarike dërgimi me poste i Projekt Raportit tek tatimpaguesi

15 dite kalendarike dërgimi afati i kundërshtimit te rezultateve te kontrollit

10 dite kalendarike dërgimi me poste i kundërshtimit te rezultateve te kontrollit (nëse ka), data e përgatitjes se Raportit Përfundimtar është 05.09.2022 (ditën e 5-te te përfundimit te afatit te tatimpaguesit). Pra 10 dite + 15 dite + 10 dite + 5 dite 40 dite nga data e nisjes ne subjekt te Projekt Raportit 27.07.2022 deri ne datën e përgatitjes se Raportit Përfundimtar 05.09.2022.

Nisja ne subjekt ne date 12.09.2022 është bere pas firmosje nga eproret përkatës.

-Në lidhje me subjektin "J" me Nipt:KH

Per piken 1 në sistemin C@TS mungon dokumenti mbi Njoftimin e Kontrollit

Ne lidhje me ketë pike ju sqaroj se pavarësisht fakti qe nuk është ngarkuar ne sistem Njoftimi i Kontrollit është ne dosjen e subjektit fizikisht, pasi ne përgjithësi nuk ndiqet si praktike ngarkimi i këtij dokumenti ne sistem, per rastet ne vijim do te bej ngarkimin e këtij dokumenti ne sistemin C@ts. (bashkengjitur fotokopja e marre nga Arshiva).

Vlen te theksoj se programi i kontrollit tatimpaguesit i shkon automatikisht dhe me hapjen e çështjes.

Per piken 2-Formulari 3, nuk është nënshkruar dhe mik ka date nga Përgjegjësi i Kontrollit, Drejtori i Kontrollit dhe nga Drejtori Racional.

Ne lidhje me ketë pike ju sqaroj se: Ky dokument formulari 3 është ngarkuar ne sistem C@ts është hartuar ne Word per lehtësi veprimi, por ne dosje e subjektit është fizikisht i firmosur nga Përgjegjësi i Kontrollit nga Drejtori i Kontrollit nga Drejtori Rajonal, (bashkangjitur fotokopja e marre nga Arshiva).

Per piken 3-Njoftim Kontrolli është bere me dt 19/05/2021, ndërkohë qe kontrollin subjekt ka filluar ne date 15/06/2022, pra nuk është respektuar afati 30 ditor ne kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr. 9920 "Per procedurat ne Republikën e Shqipërisë" neni 81, pika 1.1

Ne lidhje me ketë pike dua t'ju sqaroj se subjekti ka qene me çështje te hapur te pezulluara me shkrese te Dpt sipas nje vendimi te prokurorisë per disa subjekte ne lidhje me disa fatura. Per kete arsye është nuk ka filluar ne kohe si kontroll dhe pasi është bere mbyllja e kësaj çështje është bere dhe procedura per kontroll. Ndërsa sqaroj se subjekti ka sjelle shkrese per fillim e kontrollit me nr. 5590 prot, dt e marre nga Arshiva).

Per piken 4-Procesverbalet dhe Projekt Raport Kontrolli janë hedhur me vonese ne sistemin C@TS, jo ne përputhje me manualin e Kontrollit Tatimor, Kapitulli 14 pika 2.2. Ne lidhje me kete pike ju sqaroj se: Mqs kontrolli ka filluar dhe është përfunduar brenda orëve te vendosura per kontroll por hedhjet me vonese ne sistem per arsye teknike per sa sqarova dhe me lart ne lidhje me mbylljen e çështjes tjetër pasi

n.q.s. nje subjekt ka nje çështje te hapur nuk mund te hapet nje çështje tjetër pa u mbyllur çështja e mëparshme.

-Në lidhje me subjektin "A" SHPK, me Nipt:K.1

Per piken 1-Ne sistemin C@ts mungon dokumenti Mbi Njoftimin e Kontrollit

Ne lidhje me kete pike ju sqaroj se: Pavarësisht faktit qe nuk është ngarkuar ne sistem Njoftimi i Kontrollit është ne dosjen e subjektit fizikisht, pasi ne përgjithësi nuk ndiqet si praktike ngarkimi i këtij dokumenti ne sistem, per rastet ne vijim do te bej ngarkimin e këtij dokumenti ne sistemin (bashkëngjitori fotokopja e marre nga Arshiva). Vlen te theksoj se programi i kontrollit tatimpaguesit i shkon automatikisht dhe me hapjen e çështjes.

Per piken 2-Formulari 3, nuk është nënshkruar dhe nuk ka date nga Përgjegjësi i Kontrollit Drejtori i Kontrollit dhe nga Drejtori Racional.

Ne lidhje me kete pike ju sqaroj se: Ky dokument formulari 3 është ngarkuar ne sistem C@ts është hartuar ne Word per lehtësi veprimi, por ne dosje e subjektit është fizikisht i firmosur nga Përgjegjësi i Kontrollit nga Drejtori i Kontrollit nga Drejtori Rajonal,(bashkëngjitori fotokopja e marre nga Arshiva).

Per piken 3-Ne dosje nuk administrohet shkresa per dërgimin e raport kontrolli përfundimtar

Ne lidhje me kete pike ju sqaroj se kjo shkrese është ne dosjen e subjektit si fq e dyte, pasi faqe e pare është kartela e inventarit te dosjes,(bashkëngjitur fotokopja e marre nga Arshiva).

Per piken 4-Procesverbalet dhe Projekt Raport Kontrolli janë hedhur me vonese ne sistemin C@ts, jo ne përputhje me manualin e Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 22.

Ne lidhje me kete pike ju sqaroj se: Mqs kontrolli ka filluar dhe është përfunduar brenda orëve te vendosura per kontroll por hedhjet me vonese ne sistem per arsye teknike.

-Në lidhje me subjektin "A", me Nipt:K.M

Per piken 1 ne sistemin C@ts mungon dokumenti mbi Njoftimin e Kontrollit

Ne lidhje me kete pike ju sqaroj se: Nga ana ime nuk është ngarkuar ne sistem Njoftimi i Kontrollit, por është ne dosjen e subjektit fizikisht dhe ne përgjithësi nuk ndiqet si praktike ngarkimi i këtij dokumenti ne sistem, per rastet ne vijim do te kem parasysh ngarkimin ne sistemin C@ts, bashkëngjitur fotokopja e marre nga Arshiva). Vlen te theksoj se programi i kontrollit tatimpaguesit i shkon automatikisht dhe me hapjen e çështjes.

Per piken 2 Formulari 3, nuk është nënshkruar dhe nuk ka date nga Përgjegjësi i Kontrollit, Drejtori i Kontrollit dhe nga Drejtori Rajonal.

Ne lidhje me kete pike ju sqaroj se: Nga ana ime është ngarkuar ne sistem C@ts formulari 3 siç është hartuar ne Word per lehtësi veprimi, por ne dosje e subjektit është fizikisht i firmosur nga Përgjegjësi i Kontrollit dhe nga Drejtori Rajonal ndërsa Drejtori i Kontrollit O. C. ka qene me leje nga dt 01/08/2022-08/08/2022,(bashkëngjitur fotokopja e marre nga Arshiva si dhe leja e Drejtorit te Kontrollit marre nga sektori i financës).

Per piken 3 Procesverbalet dhe Projekt Raport Kontrollit janë hedhur me vonese ne sistemin C@ts, jo ne përputhje me manualin e Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2.2.

Ne lidhje me kete pike ju sqaroj se: Mqs kontrolli ka filluar dhe është përfunduar brenda orëve te vendosura per kontroll por hedhjet me vonese ne sistem per arsye teknike pasi ne atë kohe kemi patur shpërnguljen e godinës si dhe kemi pasur probleme me ndërhyrjet ne sistem pas sulmeve kibernetike dhe ne nuk e kishim te mundur punën ne sistemin C@ts, por megjithatë jane hedhur brenda afateve te fazës se pare (projektit) dhe fazës se dyte (përfundimtarit), kërkoj mirëkuptimin nga ana Juaj per te marre shpjegimet e mia, per problemet e konstatuara nga Ju si me lart.

- Në lidhje me subjektin "H" SHPK, me Nipt:K.J

Per piken 1-Ne sistemin C@ts mungon dokumenti mbi Njoftimin e Kontrollit

Ne lidhje me kete pike ju sqaroj se: Pavarësisht faktit qe nuk është ngarkuar ne sistem Njoftimi i Kontrollit është ne dosjen e subjektit fizikisht, pasi ne përgjithësi nuk ndiqet si praktike ngarkimi i këtij dokumenti ne sistem (bashkëngjitori fotokopja e marre nga Arshiva).

Vlen te theksoj se programi i kontrollit tatimpaguesit i shkon automatikisht dhe me hapjen e çështjes. Per piken 2-Formulari 3, nuk është nënshkruar dhe nuk ka date nga Përgjegjësi i Kontrollit, Drejtori i Kontrollit dhe nga Drejtori Rajonal.

Ne lidhje me kete pike ju sqaroj se: Ky dokument formulari 3 është ngarkuar ne sistem C@ts është hartuar ne word për lehtësi veprimi, por ne dosje e subjektit është fizikisht i firmosur nga Përgjegjësi i Kontrollit nga Drejtori i Kontrollit nga Drejtori fotokopja e marre nga Arshiva).

Per piken 3-Njoftim Kontrolli është bere me dt 31/03/2021 ndërkohe qe kontrollin e subjekt ka filluar ne date 26/04/2021, pra nuk është respektuar afati 30 ditor ne kundërshtim me përcaktimet e Ligjit 9920” Per proceduarat ne Republikën e Shqipërisë , neni 81, pika 1.1.

Ne lidhje me kete pike dua t'ju sqaroj se subjekti ka sjelle shkrese per fillim e kontrollit me nr. 2597 prot, dt 19/04/2021 , (bashkengjitur fotokopja e marre nga Arshiva).

Per piken 4-Procesverbalet dhe Projekt Raport Kontrolli jane hedhur me vonese ne sistemin C@ts, jo ne përputhje me manualin e Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2.2.

Ne lidhje me kete pike ju sqaroj se: Mqs kontrolli ka filluar dhe është përfunduar brenda orëve te vendosura per kontroll por hedhjet me vonese ne sistem per arsye teknike.

-Ne lidhje me subjektin "D" SHA me NIPT I.A

Pika 1: Në akt konstatim shpreheni se kontrolli është kryer duke tejkeluar afatet e parashikuar në programin e kontrollit.

-Në lidhje me sa pretendohet nga ana Juaj ju bëjmë me dije se për periudhën që është kryer kontrolli në shoqërinë "D" SHA me NIPT K.A Kontrolli në shoqëri u ndërpre pasi gjatë kësaj periudhe është kryer kontrolli i thelluar, në shoqëritë "A" SHA me NIPT I.M me Njoftimit Kontrollit Tatimor dhe programit kontrollit me nr. 10949/2 datë 27/01/2022 me 316 orë/pune I cili është mbyllur me datë 30.05.2022

Njoftim kontrolli është bërë më datë 22/04/2022 paraqitur në subjekt dhe filluar kontrollin ne 28.04.2022 dhe përfunduar me date 16.06.2022, pra janë konsumuar 280 ore pune, që pasi heqim orët e konsumuar te A 120 orë pune rezulton që kontrolli është kryer për 160 orë pune (nga 176 orë që parashikonte programi ), brenda afateve ligjore. Nga sa sqaruam më sipër nuk kemi tejkallim të afateve.

Pika2 : Në akt konstatim shpreheni se janë tejkeluar afatet nga përgatitja dhe dërgimi i Projekt Raportit deri në përgatitjen e Raportit përfundimtar të kontrollit në subjekt .

-Bazuar ne ligjin Nr.9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” neni 83, pika 4 keni të drejtë të kundërshtoni rezultatet e këtij kontrolli tatimor brenda 15 ditëve kalendarike mbas datës që vlerësohet të jetë marrë nga ana e shoqërisë, 10 dite i ka posta në dispozicion për ta dërguar në shoqëri dhe 10 ditë për të sjellë kundërshtime në qoftë se ka, që në total bëjnë 35 ditë. Projekt-Raporti është dërguar me postë rekomande më datë 22.06.2022 me nr prot 2221/3 dhe Raportit përfundimtar të kontrollit është mbajtur më datë 26.08.2022 që përbën 35 ditë nga momenti dërgimit të Projekt Raportit të Kontrollit. Nga sa sqaruam më sipër nuk kemi tejkallim të afateve.

**Qëndrimi i Grupit të Auditimit:** Në lidhje me pretendimet e ngritura për subjektet "E", "J", "A" SHPK, "A", "H.X" SHPK, "D.A" SHA, sqarojmë se janë të përsëritura me ato për akt-konstatimet dhe nuk janë paraqitur argumente apo dokumente shtesë, për pasojë observacioni juaj nuk merret në konsideratë.



## IV. GJETJE DHE REKOMANDIME

### A. MASA ORGANIZATIVE

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi konstatohet se për vitin 2021, pavarësisht se të ardhurat bruto nga tatimet në Drejtorinë e Tatimpaguesve të Mëdhenj paraqiten me një nivel realizimi në masën 101% kundrejt planit të të ardhurave (me një tejkalim në shumën 1,080 milion lekë), të ardhurat tatimore neto rezultojnë me një realizim në masën 99% kundrejt planit, pra me një mosrealizim në vlerën 1,118 milion lekë. Kjo situatë është ndikuar kryesisht nga niveli i realizimit të të ardhurave nga TVSH-ja dhe taksat nacionale, ku konkretisht të ardhurat nga Tatimi mbi Vlerën e Shtuar, i cili është dhe kontribuesi kryesor në të ardhurat tatimore në terma bruto janë realizuar në masën 93 % të planit, me një mosrealizim në shumën 2,110 milion lekë; Të ardhurat nga TVSH paraqiten me një mosrealizim 8,261 milionë lekë, ose 41 % më pak se plani; taksat nacionale paraqiten me një mosrealizim 420 milion lekë, ose 5% më pak. Nga auditimi konstatohet se nuk është kryer asnjë analizë nga ana e DTM për arsyet që kanë ndikuar në mosrealizimin e këtij zëri kryesor në të ardhurat tatimore. **Për vitin 2022**, të ardhurat nga TVSH-ja në terma bruto janë realizuar në shumën 28,085 milion lekë, ose në masën 98 % të planit, me një mosrealizim në shumën 685 milion lekë, dhe krahasuar me vitin 2021 janë arkëtuar 683 milion lekë më pak, ose rreth 2% më pak. Të ardhurat nga Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (Neto) paraqiten me një mosrealizim prej 3,630 milionë lekë, ose 20 % më pak; të ardhurat tatimore nga taksat nacionale janë programuar në vlerën 10,108 milion lekë paraqiten me një mosrealizim 1,605 milion lekë, ose 16% më pak; të ardhurat tatimore nga lojërat e fatit paraqiten me një mosrealizim 233 milion lekë, ose 14% më pak.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 15-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**1.1 Rekomandimi:** Drejtori i DTM të analizojë faktorët të cilat kanë ndikuar në realizimin e planit të të ardhurave tatimore sipas zërave, veçanërisht për llojet e të ardhurave që rezultojnë me mos realizim referuar subjekteve që operojnë nën juridiksionin e DTM, duke nxjerrë edhe përgjegjësitë përkatëse në funksion të arritjes së objektivave institucionale.

#### Menjëherë dhe në vijimësi

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi konstatohet se për vitin 2022, plani i përcjellë nga DPT është hartuar për çdo muaj, pra jo për të gjithë vitin 2022, sikundër është vepruar në periudhat paraardhëse, dhe si rezultat është shoqëruar me rishikime të shpeshta përgjatë vitit. Planin e të ardhurave për vitin 2022 rezultojnë të ketë ndryshuar edhe me shkresën nr. 21811/21, prot në DPT datë 16.01.2023, protokolluar në DTM nr. 316, datë 19.01.2023. ku është cituar përcjellja e planit të detajuar të vitit 2022, pas Aktit Normativ nr. 17, datë 01.12.2022. Pra, si rezultat, treguesit e planit të të ardhurave janë rishikuar pas faktit (konkretisht plani i muajit Janar 2022, është rishikuar në Janar 2023), duke ndikuar kështu në indikatorët matës së realizimit të të ardhurave të DTM, të cilat tanimë maten sipas një baze të rishikuar në fillim të vitit pasardhës.

- Nga auditimi konstatohet se DTM nuk ka kryer analiza lidhur me parashikimin e arkëtimeve; nuk ka hartuar plane operacionale të veprimtarisë institucionale, plane vjetore, projekt plane të të ardhurave, apo raporteve për realizimin e të ardhurave dhe treguesve të performancës në kuadër të kryerjes së një planifikimi të të ardhurave. Analizat e sektorit të të ardhurave paraqesin të dhënat statistikore mbi nivelin e realizimit krahasuar me planin dhe 2 vitet paraardhëse në nivel progresiv dhe sipas muajit Dhjetor me top subjektet performues sipas zërit të të ardhurave. Në këtë dokument mungojnë analizat e kryera lidhur me nivelin e realizimit krahasuar me planin,

për të evidentuar shkaqet e mos realizimit/mbi realizimit në nivel industrie/fenomenesh/apo edhe subjekteve, apo shkaqet që kanë çuar në mos realizim/mbi realizim krahasuar me vitin paraardhës. Gjithashtu, rezultojnë diferenca mes të dhënave të raportuara në tabelën përmbledhëse të të ardhurave, dhe të dhënat e analizuara për secilin zë më vete të të ardhurave, për shkak të kryerjes së raportimit në dy momente të ndryshme kohore të mara për bazë për analizimin: në kohë reale dhe arkëtime periodike. Kjo situatë krijon konfuzion dhe nuk mundëson gjenerimin e një informacioni të saktë dhe të krahasueshëm për efekt analize, duke qenë se ky është edhe qëllimi kryesor i këtij raporti.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 15-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**2.1 Rekomandimi:** Drejtori i DTM të marrë masat për përcaktimin e procedurave, detyrave dhe përgjegjësive konkrete, në drejtim të programimit dhe raportimit pranë DPT lidhur me progresin e bërë kundrejt planit të të ardhurave tatimore dhe shmangiet nga programi i miratuar, duke konsideruar edhe formate tip raportimi, me qëllim që ndjekja dhe realizimi i të ardhurave për çdo zë të bëhet më efektiv dhe eficient, duke garantuar planifikimin në funksion të një shpërndarje sa më të drejtë dhe reale të planit të të ardhurave sipas llojit dhe strukturës, me qëllim shmangien e rishikimeve të shpeshta të këtij plani përgjatë vitit.

**Brenda vitit 2023**

**2.2 Rekomandimi:** Strukturat drejtuese pranë DTM të marrin masat për hartimin e planit operacional të veprimtarisë institucionale, planeve vjetore, dhe raporteve periodike, në funksion të mirë menaxhimit dhe monitorimit të institucionit për arritjen e objektivave.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi lidhur me funksionimin e ndërveprimit mes Strukturës së Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Sektorit të Analizës së Riskut për të garantuar një mbulim të plotë të subjekteve të klasifikuara si me risk në programet e kontrollit në vend, u konstatuan problematika që kanë çuar në dublikimin e punës si dhe mungesë efektiviteti në funksionet e tyre, në drejtim të analizave të kryera për propozimet për kontroll në vend për tatimpaguesit pranë DTM. Më hollësisht, Sektori i Kontrollit nga Zyra (një sektor i planifikuar për të funksionuar me 10 inspektorë dhe 1 përgjegjës sektori) ka përcjellë përgjatë vitit rast pas rasti subjektet për të cilat janë evidentuar problematika të konstatuara gjatë punës verifikuese të kryer nga inspektorët përgjegjës të sektorit. Këto propozime, shoqëruar me analizat dhe evidencat e sektorit që dokumentojnë arsyet e propozimit për kontroll në vend, konstatohet se nuk përmbledhen në një databazë përmbledhëse nga ana e Sektorit të Analizës dhe Riskut, për të shqyrtuar rastet e përcjella, problematikën e konstatuar, datën e përcjelljes për kontroll të thelluar; analizën e inspektorit përgjegjës të sektorit nga zyra; etj, në mënyrë që kjo vendimmarrje t'i shërbejë strukturës për të prioritetuar rastet dhe të përmbledhë propozimet për kontroll në vend. Faktikisht, Sektori i Analizës së Riskut (një strukturë e programuar për të funksionuar me 3 persona, nga të cilët një përgjegjës sektori dhe 2 specialistë), disponon një regjistër risku të vetin dhe ka hartuar profile risku për çdo tatimpagues, informacione këto që i shërbejnë këtij sektori për të kryer më pas propozimet për kontroll të thelluar pranë DPT. Në analizën e kryer për efekt të hartimit të profileve të riskut, vihet re përfshirja e indikatorëve matës që faktikisht janë analiza që kryhen edhe nga Sektori i Kontrollit nga Zyra, të tilla si: mospërputhje mes të ardhurave të deklaruara në PASH me ato të deklaruara në FDP e TVSH-së, mospërputhjen në zërin importe mes TVSH-së dhe FDP-së, mospërputhje në zërin eksporte mes TVSH-së dhe FDP-së, diferenca nëpërmjet amortizimit sipas pasqyrës së AAM me shpenzimet e

amortizimit në pasqyrën e fluksit të parasë, diferenca mes kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe fondit të pagave, diferenca mes shpenzimeve në PASH me ato në TF, diferenca mes listëpagesave dhe detyrimeve për paga në PASH; çështje këto që janë pjesë e monitorimit të përditshëm të inspektorëve të Sektorit të Kontrollit nga Zyra.

Nga auditimi konstatohet se Rregullorja e Brendshme për Sektorin e Analizës së Riskut, si dokumenti bazë sipas së cilës funksionon sektori **nuk** është miratuar nga MFE, sikurse përcaktohet në nenin 29, pika 2, të ligjit nr. 90/2012, datë 27.9.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, se rregulloret që përcaktojnë metodat e brendshme të punës dhe sjelljen e personelit miratohen nga ministri përgjegjës për ministrinë, institucionet e varësisë dhe degët territoriale në varësi të tij. Gjithashtu, punonjësit e Sektorit të Analizës, Riskut dhe Kontabilitetit të të Ardhurave nuk disponojnë akses në modulën “Menaxhimi i Riskut” (duke përfshirë të gjithë raportet e modulit) në sistemin C@TS, me qëllim analizimin e këtyre informacioneve për efekt të procedurave të planifikimit.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 15-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**3.1 Rekomandimi:** Drejtori i DTM nëpërmjet Sektorit të Analizës së Riskut pranë DTM dhe Drejtorisë së Kontrollit pranë DTM, të vlerësojë procedurat aktuale të implementuara për efekt të vendimmarrjes në propozimin e subjekteve që do i nënshtrohen kontrollit në vend, duke shqyrtuar mundësinë e hartimit të një databazë të Sektorit të Analizës së Riskut për konsolidimin e propozimeve për kontroll në vend të përcjella nga Sektori i Zyrës apo atij në Vend sipas problematikave përkatëse, në mënyrë që të garantohet se konkluzionet për përzgjedhjen e subjekteve të DTM objekt kontrolli në vend, do të jenë produkt i prioritizimit të problematikave dhe analizave të përcjella nga njësive e sipërcituara, duke shmangur duplikimin e detyrave nëpërmjet sektorëve.

### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**3.2 Rekomandimi:** Drejtori i DTM të marrë masat për përcjelljen e Rregullores së Brendshme për Sektorin e Analizës së Riskut pranë institucioneve eprore me qëllim miratimin e këtij dokumenti nga autoriteti përgjegjës për miratimin e rregulloreve që përcaktojnë metodat e brendshme të punës dhe sjelljen e personelit.

### **Brenda vitit 2023**

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi konstatohet se për periudhën objekt auditimi nuk është realizuar detyrimi për kryerjen e propozimeve për kontroll të tatimpaguesve të vlerësuar me risk të lartë në raportin 50% me 50% të rasteve ( pra 50% të kontrolleve propozuar nga DTM dhe 50% nga DPT). Konkretisht, për vitin 2021 janë realizuar 400 programe kontrolli në vend, nga të cilat 85 janë propozuar nga DTM (21% e totalit) dhe 315 nga DPT, dhe për vitin 2022 janë realizuar 568 programe kontrolli në vend, nga të cilat 227 janë propozuar nga DTM (40% e totalit) dhe 341 nga DPT. Për periudhën Janar 2021- Maj 2022 propozimet për kontroll janë bërë direkt nga Drejtoria e Kontrollit të DTM-së, dhe jo nga Sektori i Analizës së Riskut. Ky sektor ka kryer propozimet vetëm për periudhën Qershor 2022- Dhjetor 2022.

-Referuar regjistrimit të vendosur në dispozicion nga Sektori i Analizës së Riskut, duke kryqëzuar informacionin me subjektet e propozuara për kontroll të plotë pranë DPT konstatohet se për periudhën Korrik-Nëntor 2022, nga totali prej 106 subjektsh të propozuara, rezultojnë se vetëm 15 subjekte (ose 14% e totalit) paraqiten si subjekte me risk, ndërkohë që 70% e subjekteve të tjera të propozuara për kontroll rezultojnë pa risk (75 subjekte); dhe 15 të tjera (16%) nuk ishin subjekte të analizës së riskut (risk “NA”). Nga auditimi u konstatua se nga 20 subjektet e

përfshira për kontroll tematik (si rezultat i indicieve të tilla si përthithje, shitje aksione, etj), në muajin Dhjetor 2022, vetëm 1 prej tyre rezulton me risk (5%); 10 subjekte paraqiten me risk NA (50%) dhe 9 subjekte pa risk (45%). Për sa i përket propozimeve për kontroll të plotë në vend, në muajin Dhjetor 2022 janë përcjellë propozime për kontroll në vend për 19 subjekte, ku nga këto, 8 prej tyre janë transferuar pranë DTM vetëm në muajin Tetor 2022, dhe një muaj më vonë janë vlerësuar nga ana e drejtorisë si subjekte që përbëjnë risk për të kaluar në kontroll të plotë. Ndërkohë 2 subjektet e tjera rezultojnë me statusin "NA", 8 subjekte pa risk, dhe vetëm 1 me risk.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 15-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**4.1 Rekomandimi:** Strukturat përgjegjëse pranë DTM dhe DPT të marrin masat për garantimin e mbulimit me kontroll në vend të propozimeve nga DTM në masën 50% të totalit të kontrolleve të kryera, duke prioritarizuar në përzgjedhje të subjekteve që mbartin realisht risk, dokumentuar kjo në rezultatet e indikatorëve të implementuar në regjistrin e riskut të strukturës përgjegjëse.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i raporteve të kontrollit të përzgjedhura, konstatohet se nga ana e inspektorëve tatimor nuk është kryer një analizë e detajuar për t'u siguruar që nuk janë realizuar shitje nën kosto për produktet e tregtuara. Nuk është kryer një analizë sipas produkteve në lidhje me çmimin e blerjes dhe çmimin e aplikuar të shitjes në mënyrë që të provohet shitja mbi marzh për produktet e përzgjedhura, por vetëm janë mesatarizuar çmimet e shitjes dhe blerjes për produktet e marrë në analizë. Ky konstatim përfshin konstatimet e arritura nga auditimi i raporteve të kontrollit tatimor të ushtruar në tatimpaguesit A., K.T.D, A, G, A.G.T dhe B. Në disa raste, analiza nuk përfshin diferencimin e shitjeve drejt tatimpaguesve me shumicë dhe atyre me pakicë, mbi të cilët aplikohen çmime të ndryshme, fakt që nuk rezulton të jetë analizuar gjatë kontrolleve dhe të jetë pasqyruar në raportin e kontrollit tatimor. Në sektorë specifikë, si ai i energjisë elektrike për G. nuk rezulton të jenë analizuar shitjet me metodën e identifikimit specifik për natyrën e energjisë elektrike që nuk magazinohet dhe në sektorin e gazit nuk janë trajtuar shitjet e diferencuara për çmime të ndryshme të gazit për automjete dhe atij për konsum familjar, të cilët paraqesin çmime të ndryshme të aplikuar. Në dy raste në kontrollet e ushtruara në tatimpagues A.G.T dhe A.P.C nuk rezultojnë të jenë analizuar çmime preferenciale të shitjes për aktivet të dhëna në përdorim, pasi në raportin e kontrollit nuk rezulton të jetë kryer një analizë në lidhje me plotësimin ose jo të kushteve sipas Neni 18, pika 1, germa i të udhëzimit nr.6, date 30.01.2015 "Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar".

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 46-325 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**5.1 Rekomandimi:** Nga ana e DTM në hartimin e programeve të kontrollit në tatimpagues që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në sektorin e tregtisë të përcaktohet një metodologji e qartë e kontrollit duke shmangur mesatarizimet në analizën e marzheve në mënyrë që të arrihet siguria për deklarimin e saktë të detyrimeve tatimore ku për sektorë të veçantë si ai i tregtimit të energjisë elektrike dhe tregtimit të gazit natyror të përcaktohen specifika për kryerjen e kontrollit të krahasimit çmimesh të aplikuar dhe krahasimit me koston e mallit të shitur.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**5.2 Rekomandimi:** Në rastin e subjekteve që së bashku me tregtimin e produkteve ofrojnë për përdorim aktive në mënyrë që të realizojnë shitjet, të implementohet në programin e kontrollit analiza mbi çmimet e diferencuara të shitjes me qëllim saktësimin e aplikimit ose jo të TVSH-së.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se, gjatë zhvillimit të aktivitetit të tyre, shoqëritë A.C SHPK, I. SHPK, F. SHPK, A. SHA, A. SHPK, KP.T SHPK, A. SHPK, A.G.T SHA dhe B.E SHPK, F. SHPK në periudha të ndryshme kohore kanë kryer transaksione huamarrje dhe huadhënie me ortakun (kreditime dhe debitime nga llogaria e ortakut), për llogari të këtyre shoqërive, me qëllim kryesor mbarëvajtjen normale të aktivitetit tregtar të shoqërive, sipas përshkrimeve në raportet e kontrolleve të inspektorëve tatimor, ku per rastet e subjekteve “A.” SHA, “I” SHPK, “A.” SHPK, “K” SHPK, “A” SHPK dhe “B.E” SHPK, “F.” SHPK, nga ana e inspektorit nuk është bërë informacioni RAD (Raportim i Aktivitetit të Dyshimtë) në lidhje me shumatat e parave të cilat kanë kaluar si hua ortakut ndaj shoqërisë, veprime këto jo në përputhje me dispozitat e ligjit Nr.9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit” i ndryshuar, neni 18.1 si dhe UMF Nr.16, datë 16.2.2009 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe për të luftuar financimin e terrorizmit në sistemin e tatim-taksave”, neni 5, pika 1 dhe 2 . Këto pagesa nuk konfirmohen me saktësi në raportet e kontrollit tatimor, si pagesa të kryera nëpërmjet sistemit bankar dhe të pasqyruara me prova në aktet e mbajtura nga inspektorët e kontrollit. Në lidhje me transaksionet kur ortaku i jep shoqërisë hua ose e anasjella, pa aplikuar interesa, grupi i audituesve gjykon se kemi të bëjmë me veprime të cilat janë pa thelb ekonomik dhe jo në përputhje me parimin e vlerës së tregut. Veprime këto në kundërshtim me përcaktimet e pikave b, c, dh të nenit 71, gjerat a, b, c, ç të nenit 71/2 dhe gjerat ç të neni 72 të Ligjit Nr.9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave Nr. 24 date 02.09.2008, i ndryshuar, për të cilat duhet të ishte kryer vlerësim alternativ i situatës financiare së shpenzimeve të interesit të pallogaritura në PASH, si rikarakterizim të ardhurash duke sjellë si pasojë detyrime tatimore. Referuar kuadrit legjislativ tatimor, rezultoi se ortaku dhe shoqëria me përgjegjësi të kufizuara janë entitete të ndryshme dhe me personalitet juridik të ndarë, sipas përcaktimeve në Ligjin Nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”. Sipas legjislacionit tatimor si shoqëria dhe ortaku konsiderohen si “Palë të lidhura”, meqenëse ortaku ka ndikim në vendimmarrjen e shoqërisë për shkak të zotërimit të kuotave/aksioneve të saj sipas përcaktimeve në Ligjin Nr.42/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar dhe Udhëzimin Nr.16, datë 18.6.2014 “Për transferimin e çmimit”, gjë që sjell se çdo marrëdhënie apo transaksion midis tyre duhet t’u përmbahet kushteve dhe parimeve të tregut (Arm’s Length). Megjithatë nuk ka të përcaktuar saktë dhe qartë mënyrën e procedimit në legjislacionin tatimor të fushës së llogaritjes së interesave dhe detyrimeve tatimore të rillogaritura në rastet e huadhënies nga llogaria e ortakut drejt llogarisë së shoqërisë ose e anasjelltas, referuar Kodit Civil i miratuar me Ligjin Nr.7850 datë 29.07.1994, i ndryshuar, nenet 1050-1055, Kreu XIX “Huaja”, cilësohet se huamarrësi duhet t’i paguajë huadhënësit një interes në rastet kur ekziston një marrëveshjeve ndërmjet palëve.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 46-325 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**6.1 Rekomandimi:** DTM në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, të hartojnë një metodologji të qartë dhe të saktë nënligjore, ose një manual udhëzues për analizimin e llogarisë së ortakut, kur konstatohen se jepen hua ose shuma nga llogaria e ortakut në favor të llogarisë së shoqërisë, ku ata janë ortakë ose anasjelltas, për raste kur këto hua jepen pa interes, nisur edhe nga përcaktimet ligjore që parashikon Kodi Civil.

**Brenda vitit 2023**

**6.2. Rekomandimi:** Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj në bashkëpunim me DPT, të analizojë situatën e kontrollit të kryer në subjektet “A” SHA, “T” SHPK, “A” SHPK, “K.P.T” SHPK, “A” SHPK, F SHPK dhe “B.E” SHPK, referuar gjetjeve nga auditimi i KLSH-së, si dhe të vlerësojë përcjelljen e tyre pranë strukturës kompetente pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, për vlerësimin dhe identifikimin e mëtejshëm të burimeve të financimit.

**Brenda vitit 2023**

**7. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dosjeve të kontrollit konstatohet në disa raste në taatimpaguesit B. dhe A.G.T nuk është kryer inventarizimi fizik megjithëse ai ka qenë pjesë e programit të kontrollit dhe është kërkesë e manualit të kontrollit tatimor. Në raste të tjera në praktikat e audituara, megjithëse është kryer konstatohet se përzgjedhja e kampionit të inventarit nuk është e argumentuar si përfaqësuese e popullatës pasi mbi këto produkte të përzgjedhura kryhet edhe analiza e bilancit material, duke mos marrë siguri në lidhje me kontrollin e ushtruar. Në rastin e subjektit Beralb, mos kryerja e inventarizimit fizik është shoqëruar edhe me mos kryerje të analizës së proceseve të prodhimit sipas kartës teknologjike, e cila rezulton e pa miratuar nga organet kompetente, në kundërshtim me aktet nënligjore për tatimin mbi fitimin. Në raste të tjera, në kontrollin e ushtruar në tatimpagues E., analiza e kryer për respektimin e kartës teknologjike rezulton të jetë përgjithësuese dhe jo specifike për produktet e marra në analizë për inventarizim fizik dhe për të cilat është ndërtuar bilanci material. Këto kontrole janë jo në përputhje me kërkesat e manualit të kontrollit tatimor.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 46-325 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**7.1 Rekomandimi:** Nga ana e DTM, në subjektet që përfshijnë procese prodhimi dhe përpunimi të cilat janë objekt miratimit të kartës teknologjike, të kryhet verifikimi i miratimit të gjitha kartave teknologjike në rast se janë dorëzuar pranë organit tatimor.

Nga ana e DTM, të përcaktohet kampioni i përzgjedhur për auditim pas miratimit nga strukturat drejtuese si aneks i programit të kontrollit tatimor përpara fillimit të tij, në mënyrë që të jetë përfaqësues.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**8. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i raportit të kontrollit tatimor të subjektit “B&C” SHPK, janë konstatuar diferenca midis të dhënave të deklaruara në librin dhe FDP-në, për periudhën Nëntor 2021, ku konkretisht diferenca ka rezultuar në rubrikën e Import Investimit, pasi sipas deklaratës së TVSH-së janë raportuar investime me shkallë 20% për vlerën e tatueshme 6,299,910 lekë, ndërsa në librin e deklaruar nga subjekti është deklaruar Import investimi me 6% për vlerën e tatueshme 1,406,255 lekë dhe me 20% për vlerën 4,893,655 lekë. Nga subjekti nuk është bërë ende korrigjimi i librit të periudhës Nëntor 2021, në sistemin C@TS dhe nga DTM duhet të merreshin masa për vendosjen e gjobës 50,000 lekë, pasi mos ndryshimi i librave nga tatimpaguesi bie në kundërshtim me përcaktimet Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Neni 118.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 46-325 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**8.1 Rekomandimi:** Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj, të kryejë të gjitha veprimet e duhura ligjore dhe administrative, me qëllim arkëtimin e detyrimeve tatimore të ri llogarituara për subjektin “B&C” SHPK me Nipt- K.T, në shumën 50,000 lekë.

**Brenda vitit 2023**

**9. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i raport kontrollit tatimor të subjektit “R.B” SHA, janë konstatuar mangësi pasi bilanci material i lëvizjes në prodhim është bërë për periudhën 01.06.2021-31.12.2021, bilanci material për lëndën e parë është bërë për periudhën 01.06.2021-31.12.2021, bilanci material për produktin e gatshëm është bërë për periudhën 01.06.2021-01.06.2021, ndërkohë që kërkesa për rimbursimin e TVSH-së sipas njoftimit për kontroll dhe programit të kontrollit është për periudhën Prill-Tetor 2021. Sa sipër rezulton se janë 2 muaj Nëntor-Dhjetor 2021 për të cilat është bërë kontrolli i bilancit material por që nuk është përcaktuar në program kontrolli, në kundërshtim me përcaktimet e Manualit të Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2.1, germa a, ku citohet “Njoftimi i kontrollit tatimor përmban periudhën ose periudhat tatimore, për të cilat kryhet kontrolli tatimor”. Gjithashtu nga analiza e bilancit material të paraqitur në Raport Kontrolli dhe kartës teknologjike të miratuar për shoqërinë, nuk administrohen të dhëna të mjaftueshme, për të rakorduar për sasinë e prodhuar për zërin 3- “Gjysmë produkte Elbasan Magazina 1” në sasinë 8,166,523 kg, zërin 5- “Gjysmë Produkte (Hollues)” në sasinë 1,077,840 kg, pasi nuk ka të dhëna specifike për sasinë e lëndës së parë të përdorur për këto dy zëra, si dhe humbjet nga prodhimi.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 46-325 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**9.1 Rekomandimi:** Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, nëpërmjet Sektorit të Cilësisë dhe Standardizimit të Procedurave dhe Drejtorisë Ligjore dhe Teknike, të marrin të gjitha veprimet e nevojshme administrative, me qëllim hartimin e një qarkoreje dhe metodologjie të mirë përcaktuar, për standardizimin e procedurave të kontroleve tatimore të rimbursimit të TVSH-së për kontrollin e tatimpaguesve me aktivitetet përpunimin dhe tregtimi i naftës dhe nënprodukteve të saj, duke përcaktuar qartësisht periudhat për kontrollin e bilancit material.

**Brenda vitit 2023**

**10. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i raporteve të kontrollit tatimor të subjekteve “F” SHA, dhe “A” SHA, janë konstatuar mangësi si më poshtë:

a) Për subjektin “F” SHA:

- Nga kontrolli i zërit “Kontrolli i blerjeve të investimeve vendase pa TVSH” për periudhën Dhjetor 2020-Shkurt 2022, në lidhje me punimet e kryera për mirëmbajtje dhe riparime të kryera, me emërtimin rikonstruksion godine, në raport kontrolli nuk është përcaktuar afati i lejes për kryerjen e këtyre punimeve duke qenë se likuidimet e situacioneve vazhdojnë deri në Shkurt të vitit 2022, ndërkohë që leja është e vitit 2017.

- Nga analiza mbi blerjet e kryera nga kompania dhe zërit shpenzimet në Bilanc për vitin 2021, në zërin “Shpenzime të tjera”, nga ana e Inspektorit nuk është bërë analizë e thelluar në Raport Kontrolli nëse “Shpenzime konsulence mbi tregun farmaceutik” në vlerën 13,650,000 lekë janë në funksion të aktivitetit ekonomik të kompanisë, duke marrë në konsideratë dhe vlerën e tyre.

b) Për subjektin “A” SHA:

- Nga kontrolli i ushtruar nuk është bërë analizë e thelluar dhe sqarime analitike për mosrakordimet e rezultuara ndërmjet shitjeve të deklaruara për produktet “mjete motorike” dhe “pasuri” dhe vlerave të primit shkruar bruto të llogaritur për këto produkte, për të argumentuar se çfarë përfaqësojnë këto diferenca, klasifikimin e tyre, nëse janë për bashkësigurimet, primet e vetë shoqërisë, risigurimet, etj.

- Nga analiza mbi blerjet e kryera nga kompania dhe shpenzimeve në Bilanc, për zërin “Servis Dëme” në vlerën 205,006,791 lekë për periudhën Nëntor 2019-Tetor 2021, nga ana e inspektorit nuk është bërë analizë e thelluar nëse këto shpenzime janë në funksion të aktivitetit ekonomik të

kompanisë. Në raport kontroll nuk ka të dhëna në lidhje me kontrollin për dosjet e dëmeve, procedurën e ndjekur, vlerën e miratuar, dokumentacion e administruar në dosje, kampionin e përzgjedhjes së dosjeve për kontroll. Veprimet më sipër bien në kundërshtim me pikat e miratuara të Programit të Kontrollit si dhe përcaktimet e Manualit të Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2.1, Kapitulli VIII, pika 8.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 46-325 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**10.1 Rekomandimi:** Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj për tatimpaguesit “F” SHA dhe “A” SHA, për të cilët janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në analizimin e të dhënave të paraqitura në Raport Kontrollit, të kryejë një analizë të thelluar nga zyra ose të propozojë kryerjen e kontrolleve të thelluara/vizitave fiskale, për vlerësimin e situatës financiare.

**Brenda vitit 2023**

**11. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i raport kontrollit tatimor të subjektit “A” SHA, janë konstatuar mangësi pasi:

- Nga analiza e TVSH-së për periudhën 01.07.2020-31.12.2020, nga krahasimi i shitjeve në FDP rezulton vlera e tatueshme 139,981,013 lekë dhe shitjeve të paraqitura sipas librit të shitjeve rezulton vlera 151,518,859 leke, pra kemi një diference prej 11,537,846 lekë, e cila nga Inspektori është konsideruar si paradhënie ndaj klientëve, shoqëruar me fatura tatimore dhe të deklaruara si nga shitësi dhe nga blerësi. Ndërkohë nga të dhënat e marra nga shitjet me kasë për gazoil dhe benzine për adresat si dhe FDP e deklaruara, të pasqyruara në Raport Kontrollit, rezulton se vlera 11,537,846 lekë është deklaruar si shitje me kasë në Porto Romano, pra është shitje malli dhe jo parapagim. Kjo diferencë konstatohet dhe nga analiza e bilancit material, ku subjekti për vlerën e parapagimit ka bërë zbritje gjendjen e inventarit, çka tregon se kjo sasi karburanti është shitur dhe malli nuk pasqyrohet gjendje në inventar, e për pasojë nuk mundet të klasifikohet si parapagim. Gjithashtu nga të dhënat e pasqyruara në bilanc kjo vlerë nuk është llogaritur si paradhënie. Nga shpjegimet dhe të dhënat e vëna në dispozicion grupit të auditimit nga inspektori i kontrollit, nga argumentet e trajtuara më sipër si dhe mënyrës se si funksionon sektori hidrokarbureve, mbetet e paqartë klasifikimi i kësaj vlere si parapagim dhe mbart risk për mos pasqyrim të saktë të situatës financiare dhe llogaritjen e detyrimeve tatimore.

- Nga analiza e kostos së mallrave konstatohet mos pasqyrim i saktë i gjendjes në inventar, pasi produkti naftë është paraqitur me kosto ndërsa produkti benzinë me çmim shitje. Diferenca e vlerës 438,336 lekë, midis kostos dhe çmimit të shitjes, reflektohet në gjendjen e inventarit të deklaruar nga shoqëria.

- Nga analiza e bilancit material për periudhën 01.07.2020-31.12.2021 janë konstatuar mos rakordime ndërmjet gjendjes fizike dhe gjendjes kontabël, përkatësisht për periudhën 01.07.2020-31.12.2020, për produktin Diesel 178,001 litra dhe produktin Benzine 5306 litra, për periudhën 01.01.2021-31.12.2021, për produktin Diesel 20,403 litra dhe produktin Benzine 25,750 litra. Sa sipër nga shpjegimet dhe të dhënat e vëna në dispozicion grupit të auditimit nga inspektori i kontrollit, nga analiza e të dhënave të pasqyruara në Raportin e Kontrollit, si dhe nga vlerësimi i mënyrës se si funksionon sektori hidrokarbureve, mbetet i paqartë mos pasqyrimi i saktë i gjendjes në inventar dhe mos rakordimet në bilancin material për periudhën 01.07.2020-31.12.2021, duke mbartur risk për mos pasqyrim të saktë të situatës financiare dhe llogaritjen e detyrimeve tatimore me efekt mungesën e të ardhurave për buxhetin e shtetit.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 46-325 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**11.1 Rekomandimi:** Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj, për tatimpaguesit “A” SHA, për të cilin janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në analizimin e të dhënave të paraqitura në Raport



Kontrolli, të marrë masat e duhura administrative konform legjislacionit tatimor, të kryerje një analizë të thelluar nga zyra të situatës financiare të tatimpaguesit duke bërë vlerësimet dhe rivlerësimet përkatëse ose të propozojë kryerjen e kontroleve të thelluara në vend/vizitave fiskale, në rastin e vlerësimit me risk të lartë të mos pasqyrimin të saktë të situatës financiare dhe mos llogaritjen e detyrimeve tatimore me efekt mungesën e të ardhurave për buxhetin e shtetit.

**Brenda vitit 2023**

**12. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se shitja e mallit naftë bruto e kryer nga kompania “B.P” me destinacion jashtë territorit të Shqipërisë është kryer nën çmimin e bursës Brent të publikuar sipas buletinit Platts sipas kushtit FOB të lëvrimit dhe si pasojë rezultuan diferenca të pagesës së rentës minerare që lidhen me vlerën e mallit “naftë bruto” në deklaratat e eksportit. Vlera e eksportuar e mallit naftë bruto nga shoqëria B.LTD drejt shoqërisë “C.T S.A.U. T.C ,P DLC” me seli në Spanjë rezulton nën çmimin e publikuar të Naftës Brutto Brent të publikuar nga të dhënat e çmimit PLATTS të nxjerra sipas publikimeve ditore nga komisioni AD-HOC pranë Ministrisë së Financave si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave. Për transaksionet e kryera me procedura eksporti nga territori shqiptar drejt kompanisë C.T S.A.U, T.C, P.DLC me seli në Spanjë rezulton se çmimi për njësi / fuçi neto është në nivelin 23% deri 33% më ulët se çmimi i publikuar i bursës se publikuar nga Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për mallin identik të publikuar “*Naftë Bruto*” të klasifikuar në kodin doganor \*27090090\* të N.M në RSH. Si pasojë janë konstatuar diferenca në pagesën e rentës minerare (*taksë kombëtare*) dhe në llogaritjen e tatimit fitimit për pjesën e vlerës se shitjeve dhe të ardhurave të munguara si pasojë e shitjes së mallit naftë bruto jashtë territorit të RSH nën çmimin e bursës Brent. Bazuar në çmimet e publikuara të bursës Platts u saktësua dhe u trajtua rivlerësimi i pagesës së rentës minerare, për vlerën e mallit të shitur të ri trajtuar sipas çmimit të bursës brend te rivlerësuar në procedure eksporti në shumën 1,315,284,657 lekë për të cilat nga DTM duhet të llogariten edhe detyrimet e tatimit mbi të ardhurat e rivlerësuar nga shitja duke marrë në konsideratë llojin e aktivitetit në përmbushje të përcaktimeve të ligjit Hidrokarbur në Republikën e Shqipërisë ligjit nr. 153/2020 për “*Regjimin fiskal në sektorin hidrokarbur renta minerare*” dhe në frymën e legjislacionit tatimor në RSH, si dhe rivlerësime të pagës së rentës minerare me një detyrim tatimor të taksës kombëtare të rentës minerare në shumën 131,528,466 lekë bazuar në nenin 5 të ligjit nr. 153/2020 për “*Regjimin fiskal në sektorin hidrokarbur renta minerare*” përcakton se sipas ligjit nr. 83/2022 “*Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*”, të ndryshuar duke shkelur parime të tregut të lirë dhe duke anashkaluar parimet e vlerësimit tatimor. Ndërmjet Administratës Tatimore dhe Doganore është nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi dhe informimi të ndërsjellët sipas shkresës nr. 12819 datë 19.06.2018 ku detyrohet Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve të marrë informacion periodik ditor pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave për të dhënat e çmimeve të aplikuara të mallrave të bursës dhe të tjera të dhëna të disponueshme si dhe të bashkëpunojnë për çështje të përbashkëta që lidhen me problematika të vjeljes dhe arkëtimit të ardhurave në Buxhetin e Shtetit.

(*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 46-325 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**12.1 Rekomandimi:** Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave për artikullin “Naftë Bruto” me origjinë nga “*Prodhimi Vendas Shqipëri*” sipas kushtit të lëvrimit FOB, bazuar në faktet dhe provat e trajtuara dhe të paraqitura sa më sipër si dhe në materialin e Raportit të Auditimit të gjykojë dhe të kërkojë ndjekjen e procedurave për kontabilizimin dhe arkëtimin e detyrimeve të pagesës së rentës minerare të

konstatuar si diferenca pagese në shitje malli në procedura eksporti në shumën 131,528,466 lekë, dhe bazuar në çmimet e publikuara të bursës Plats të kërkohet pagesa e detyrimeve të tjera tatimore, për vlerën e mallit të shitur te rivlerësuar të ri trajtuar sipas çmimit të bursës brend të rivlerësuar në procedure eksporti në shumën 1,315,284,657 lekë për të cilat nga DTM duhet të llogariten edhe detyrimet e tatimit mbi të ardhurat e rivlerësuar nga shitja duke marrë konsideratë llojin e aktivitetit, në përmbushje të përcaktimeve të ligjit Hidrokarbur në Republikën e Shqipërisë, neni 5 dhe 6 i ligjit nr. 153/2020 për “Regjimin fiskal në sektorin hidrokarbur renta minerare” dhe në përcaktimet e legjislacionit tatimor në RSH.

**Brenda vitit 2023**

**13. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se për vlerën e TVSH-së së kredituar në blerje në punime civile dhe për blerje të trajtuara me TVSH të përjashtuar për nevoja prodhimi janë kryer veprime në kundërshtim me legjislacionin në fuqi. Nga auditimi konstatohet se kjo problematikë është ndjekur edhe me parë dhe rezultojnë procese gjyqësore administrative dhe çështje gjyqësore në gjykatën e arbitrazhit midis palëve. Më konkretisht gjatë auditimit u konstatua se për vlerat në shumën:

- 499,219 lekë për mallra e shërbime që nuk meritojnë operacione punimi me trajtim shërbimi me vlerë TVSH -je, rezulton se nuk janë trajtuar si shërbim me TVSH të përjashtuar në pikën 2 të Udhëzimit të Përbashkët i MF dhe ME nr. 17, datë 12.6.2015 “Për përcaktimin e listës së mallrave dhe shërbimeve që përdoren në realizimin e fazës së kërkimit të operacioneve hidrokarbure nga shoqëritë e kërkimit të hidrokarbureve, të cilat përjashtohen nga pagesa e TVSH-së, si dhe procedurat e përjashtimit” .

-në shumën 412,068,235 lekë vlerë totale blerje shërbimi nga shoqëri të huaja me TVSH kredituese për mallra dhe shërbime jashtë kritereve ligjore për të cilat duhet te ishin trajtuar edhe detyrimet përkatëse dhe penalitet respektive për vlerën e TVSH-së së kredituar në blerje në shumën 82,413,646 lekë e cila nuk duhet te ishte trajtuar si shërbim me TVSH te kredituar por duhej trajtuar si shërbim me TVSH të përjashtuar.

- ne shumën 69,894,293 lekë për blerje shërbimi nga shoqëri të huaja për shërbime dhe mallra me TVSH të përjashtuar, për të cilat nuk është trajtuar si shërbim me TVSH-je të pagueshme, por është trajtuar si shërbim me TVSH të përjashtuar.

Këto veprime rezultojnë në kundërshtim me pikën 1 të Udhëzimit i Përbashkët i MF dhe ME nr. 17, datë 12.6.2015 përcakton se pika 2 “Lista e mallrave dhe e shërbimeve që përfitojnë përjashtim nga TVSH ja për operacionet e kërkimit të hidrokarbureve, pikën 4.2 e Udhëzimit nr. 17, datë 12.6.2015 te MEI dhe Ministrisë se Financave pikën 4.2, Neni 2 “Personi i tatueshëm” i ligjit nr. 153/2020 “Për regjimin fiskal në sektorin hidrokarbur”, Neni 4 “Përkufizime” i ligjit nr. 153/2020 “Për regjimin fiskal në sektorin hidrokarbur”, neni 25 “Koordinimi me autoritetin rregullator” i ligjit nr. 153/2020 “Për regjimin fiskal në sektorin hidrokarbur”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 46-325 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**13.1 Rekomandimi:** Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj nisur nga situata e mbartur në lidhje me këtë problematikë të diskutuar edhe më parë në çështje gjyqësore siç pretendohet nga observimi i bërë nga nëpunësit e autorizuar për problematikën e investimeve dhe lejes së situacioneve dhe kritereve të investimeve të bëra brenda zonës operuese të kërkim/ prodhimit në zonën Patos-Marinëz bazuar në faktet dhe provat e trajtuara dhe të paraqitura sa më sipër si dhe në materialin e Raportit të Auditimit të gjykojë dhe të kërkojë ndjekjen e procedurave tatimore bazuar në legjislacionin tatimor ne fuqi me qëllim analizimin e vlerës së TVSH-së së kredituar

ne tepriçë dhe të pa trajtuar në procedura blerje situacione për punime brenda zonës së kërkim-prodhimit për punime në:

-shumën 2,499,219 lekë për mallra e shërbime me vlerë TVSH-je të cilat duhet të ishin trajtuar si shërbim me TVSH të përjashtuar bazuar në pikën 2 të Udhëzimit të Përbashkët i MF dhe ME nr. 17, datë 12.6.2015.

- në shumën 412,068,235 leke vlerë totali blerje jashtë kriterëve ligjore për të cilat nga DTM duhet të trajtohen edhe detyrimet përkatëse tatimore për vlerën e TVSH-së së kredituar në blerje në shumën 82,413,646 lekë, e cila nuk duhet të ishte trajtuar si shërbim me TVSH të kredituar por duhej trajtuar si shërbim me TVSH të përjashtuar.

- në shumën 69,894,293 lekë për të cilat nuk është trajtuar si shërbim me TVSH-të pagueshme por është trajtuar si shërbim me TVSH të përjashtuar për blerje shërbimi nga shoqëri të huaja dhe vendase për shërbime dhe mallra me TVSH të përjashtuar për mallra dhe shërbime jashtë kriterëve ligjore për të cilat duhet të trajtohen edhe detyrimet përkatëse tatimore për transaksione dhe vlerë punime në shumën 69,894,293 lekë, për të cilat nuk është trajtuar si shërbim me TVSH-të pagueshme por është trajtuar si shërbim me TVSH të përjashtuar.

### **Brenda vitit 2023**

**14. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se të ardhurat nga parapagimet e shitjeve të apartamenteve apo njësive të tjera për objektet ndërtimore të pajisura me certifikatë shfrytëzimi, shoqëritë “O” SHPK dhe “I” SHPK, nuk kanë njohur të ardhura nga shitja në PASH sipas periudhave përkatëse, por është vazhduar me njohjen e detyrimit përkatës në pasiv të bilancit kontabël si “Parapagime të arkëtuara”, deri në kalim të titullit të pronësisë tek klienti. Nga analiza e rrethanave të transaksionit, grupi i auditimit gjykon se për objektin ndërtimor që është pajisur me certifikatë shfrytëzimi, shoqëria ka transferuar rreziqet dhe përfitimet kryesore lidhur me pronësinë tek blerësi, pra shoqëria nuk mbart më risqe të rëndësishme për apartamentet dhe njësitë e tjera të shërbimit të shitura, të cilat sot shfrytëzohen efektivisht nga blerësit me të drejta të plota mbi këto prona siç parashikohet në SKK 8, pavarësisht nëse është bërë apo jo kalimi i titullit të pronësisë, për të cilat konstatohet mungesa e një përcaktimi ligjor eksplicit, metodologji të qartë dhe të saktë ose një manual udhëzues për llogaritjen e detyrimeve tatimore, për rastet e të ardhurave nga parapagimet për shitjen e njësive nga objektet ndërtimore të pajisura me certifikatë shfrytëzimi, nga legjislacioni tatimor në fuqi.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 46-325 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**14.1 Rekomandimi:** DTM në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për parapagimet nga shitja e njësive ndërtimore me certifikatë shfrytëzimi por pa kalim titulli pronësie, të hartojnë një metodologji të qartë ose një manual udhëzues për njohjen e të ardhurave duke analizuar rrethanat e transaksionit dhe vlerësimi nëse një njësi ekonomike ka transferuar rreziqet dhe përfitimet kryesore lidhur me pronësinë tek blerësi.

### **Brenda vitit 2023**

**15. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i raportit të kontrollit tatimor të subjektit “F” SHPK, shoqëria gjatë periudhës Gusht-Nëntor 2020 ka realizuar dhe deklaruar si shitje të përjashtuara punime në lidhje me Rindërtimin, për të cilën ka qenë e pajisur me autorizimet përkatëse lëshuar nga DPT. Në lidhje me rregullimin e TVSH-së në blerje, për periudhën 01.01.2020-31.12.2020, shoqëria ka bërë rregullim për shitjet e përjashtuara të kryera për rindërtimin të cilën e ka pasqyruar në FDP e muajit Janar 2021, nëpërmjet faturës me Nr.1, Nr. Serial 77431501, datë 31.01.2021, me Vl. Tat = -117,093,905 lekë dhe TVSH = -23,418,781 lekë. Nga inspektori i

kontrollit është kryer rregullimi i TVSH për vlerën 695,550 lekë, për furniturat dhe investimet e blera përgjatë periudhës 08.2020-12.2020. Nga sa më sipër grupi i auditimi gjykon se duhet të ishte kryer rregullimi i koeficientit të zbritjes së TVSH konform përcaktimeve të pikës 1 të nenit 69, neni 72, neni 78 si dhe neni 80 të Ligjit Nr.92/2014 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Nga të dhënat e raportit të kontrollit dhe sistemit C@ts në lidhje me shitjet për periudhën 01.01.2020-31.12.2020, grupi i auditimit ka rilogaritur koeficientin e zbritjes së TVSH-së në vlerë 90.2%, mbi baza vjetore, për të gjithë periudhën, për të cilën gjykon se duhet të ishte kryer rregullimi i TVSH, për "Blerje të tatueshme me 20% TVSH nga furnitorë vendas", "Importeve të investimeve me shkallë 20%" dhe "Investime nga furnitorë vendas me shkallë 20%", për vitin 2020, në total në vlerën e tatueshme 632,864,089 lekë dhe me 126,571,910 lekë TVSH, të cilat janë blerje të furniturave, investimeve në mjete pune dhe ndërtim godinash për nevoja të biznesit, të cilat janë vështirë të ndashme masa e të cilave ka kontribuar dhe është përdorur për si për kryerjen e transaksioneve të tatueshme që sjellin të drejtën e zbritjes së TVSH-së mbi bazën e neneve 69 dhe 70, të këtij ligji, edhe për transaksionet që nuk e sjellin këtë të drejtë.

2. Nga kontrolli i sistemit C@ts ka rezultuar se nuk ka dorëzuar brenda datës 31 mars, inventarin analitik të mallrave, si dhe inventarin e aktiveve afatgjata gjendje deri më datë 31 dhjetor të vitit fiskal sipas kërkesave të pikës 3.12 "Deklarimi tatimor dhe llogaritja përfundimtare e detyrimit" të Udhëzimit Nr.5, datë 30.01.2006 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar. Gjithashtu në raportin e kontrollit tatimor nga ana e inspektorit nuk është kryer një analizë e detajuar e shfrytëzimit të mjeteve të transportit, rrugët e realizuara, normativat e konsumit për rrugë, proces pune ose volum punimesh etj, veprime këto në kundërshtim me përcaktimet e nenit 55 "Kufizime të zbritjes së TVSH për disa furnizime" të Udhëzimit Nr.6 , datë 30.01.2015 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në R.SH". Nga sa më sipër janë evidentuar fatura furnizim karburanti nga shoqëria të cilat nuk justifikohen me volumin e punës së kryer, rrugët e realizuara nga mjete/et, normativat e konsumit të gazoilin për rrugë ose proces të kryer etj. Gjithashtu nuk justifikohen nga aspekti fizik sasia e madhe e karburantit të furnizuar për shkak se subjekti nuk ka depozita të deklaruara si dhe nuk ka marrëveshje për depozitim me shoqëri të tjera.

3. Gjithashtu nga kontrolli i artikujve të librave të blerjes për periudhë tatimore të vitit 2020, ka rezultuar blerje lëndë djegëse solar, por nuk ka të sqaruar në raport kontrolli se sipas cilit proces përdoret kjo lëndë djegëse dhe n.q.s. ka kartë teknologjike për këtë proces prodhimi.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 46-325 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**15.1 Rekomandimi:** DTM të analizojë dhe vlerësojë situatën financiare të tatimpaguesit "F" SHPK, në lidhje me zbatimin e koeficientit të rregullimit të TVSH jo në baza vjetore, për "Blerjet e tatueshme me 20% TVSH nga furnitorë vendas", "Importet e investimeve me shkallë 20%" dhe "Investimet nga furnitorë vendas me shkallë 20%", për vitin 2020, në total në vlerën e tatueshme 632,864,089 lekë dhe me 126,571,910 lekë TVSH, të cilat janë blerje të furniturave, investimeve në mjete pune dhe ndërtim godinash për nevoja të biznesit, të cilat janë vështirë të ndashme masa e të cilave ka kontribuar dhe është përdorur për si për kryerjen e transaksioneve të tatueshme që sjellin të drejtën e zbritjes së TVSH-së mbi bazën e neneve 69 dhe 70, të këtij ligji, edhe për transaksionet që nuk e sjellin këtë të drejtë.

**Brenda vitit 2023**

**15.2 Rekomandimi:** DTM nëpërmjet Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit, të administrojë në rrugë zyrtare informacion dhe dokumentacion justifikues nga tatimpaguesi "F" SHPK, për furnizimet në vlera të larta me karburant si dhe për shfrytëzimin e mjeteve të

transportit dhe autoveturave, rrugët e realizuara, normativat e konsumit për rrugë, proces pune ose volum punimesh, me qëllim vlerësimin e ligjshmërisë së kreditimit të TVSH-së, së karburantit konform përcaktimeve të legjislacionit fiskal në fuqi.

**Brenda vitit 2023**

**15.3 Rekomandimi:** DTM nëpërmjet Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit, të kryejë verifikimin e miratimit të kartës teknologjike të tatimpaguesit “F” SHPK, për prodhimin e binderit dhe asfaltobetonit.

**Brenda vitit 2023**

**16. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i raportit të kontrollit tatimor të subjektit “G.K” SHA, konkretisht i lëvizjes së bilancit material dhe akt konstatimit të mbajtur nga inxhinierit për zbërthimin e bazës materiale, kanë rezultuar diferenca të pajustificuara për periudhën objekt kontrolli.

Nga kontrolli i sistemit C@ts për periudhën 2016-2021, rezulton se ka dorëzuar brenda datës 31 Mars, inventarin analitik të aktiveve afatgjata (makina dhe mjete pune) gjendje deri më datë 31 Dhjetor të vitit fiskal sipas kërkesave të pikës 3.12 “Deklarimi tatimor dhe llogaritja përfundimtare e detyrimit” të Udhëzimit Nr.5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar. Nga kontrolli i inventarit të makinave, të paraqitura në anekse të bilanceve të viteve 2016-2021, ka rezultuar se shoqëria ka në pronësi, ndër të cilat edhe autovetura. Në raportin e kontrollit tatimor nga ana e inspektorit nuk është kryer një analizë e detajuar e shfrytëzimit të mjeteve të transportit, rrugët e realizuara, normativat e konsumit për rrugë, proces pune ose volum punimesh etj, gjithashtu përgjatë periudhës së kontrollit 2016-2021, ka pasur në aktivet e veta autovetura, për të cilat inspektori i kontrollit tatimor, duhet të kishte kryer verifikimet n.q.s janë furnizuar me karburant nga shoqëria, për të cilin është bërë kreditimi i TVSH në blerje, veprime këto në kundërshtim me përcaktimet e të nenit 74 “Kufizimet e së drejtës së zbritjes” të Ligjit Nr.92/2014 “Për TVSH-në, në Republikën e Shqipërisë” dhe nenit 55 “Kufizime të zbritjes së TVSH për disa furnizime” të Udhëzimit Nr.6 , datë 30.01.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në R.SH”.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 46-325 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**16.1 Rekomandimi:** DTM nëpërmjet Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit, të administrojë në rrugë zyrtare informacion dhe dokumentacion justifikues nga tatimpaguesi “G.K” SHA, për diferencat e pajustificuara të konstatuara midis bilancit të lëvizjes materiale dhe akt konstatimit të inxhinierit, me qëllim vlerësimin e mëtejshëm të tyre.

**Brenda vitit 2023**

**16.2 Rekomandimi:** DTM nëpërmjet Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit, të administrojë në rrugë zyrtare informacion dhe dokumentacion justifikues nga tatimpaguesi “G.K” SHA, për shfrytëzimin e mjeteve të transportit dhe autoveturave, rrugët e realizuara, normativat e konsumit për rrugë, proces pune ose volum punimesh, me qëllim vlerësimin e ligjshmërisë së kreditimit të TVSH-së, së karburantit konform përcaktimeve të legjislacionit fiskal në fuqi.

**Brenda vitit 2023**

**17. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se pas riorganizimit të kryer në strukturat tatimore, ndjekja e akt marrëveshjeve të detyrimeve të papaguara ka mbetur nën kompetencën e

Drejtorisë së Kontrollit pranë DRT-ve përkatëse. Gjatë vitit 2021 nga ana e DPT është kryer rishikimi i Manualit të Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, ku është hequr kapitulli që më parë parashikonte procedurat që do të ndiqen për zbatimin e marrëveshjeve me këste. Si rezultat, këto procedura nuk janë përfshirë në asnjë prej akteve nënligjore sipas së cilave funksionojnë Drejtoritë e Kontrollit (ndër të tjera edhe DTM) dhe si rezultat, procesi që do të ndiqet për akt marrëveshjet me këste rezultoi i pa rregulluar dhe i pa mbuluar me akte administrative, manuale apo udhëzime të DPT, duke cënuar kështu veprimtarinë e këtyre strukturave përgjegjëse për monitorimin e tyre.

-Nga auditimi i praktikave për lidhjen e akt-marrëveshjeve konstatohet se në kërkesat e tatimpaguesve mungon vërtetësia e pamundësisë së situatës aktuale financiare, si dhe argumente nga ana e subjektit, që pavarësisht rrethanës financiare të vështirë, është në gjendje të zbatojë kushtet e marrëveshjes. Gjithashtu mungon dhe analiza e situatës ekonomike financiare të subjektit të realizuar nga vetë DTM, mbështetur në pasqyrat financiare të subjektit, gjendja e detyrimeve, kapitaleve të shoqërisë, aftësia qarkulluese e inventarit, likuiditetet, etj.

-Nga auditimi konstatohet se gjatë vitit 2021 rezultojnë të jenë lidhur 31 akt marrëveshje për 29 subjekte me vlerë totale të detyrimit prej 820,163,222 lekë. Deri në përfundim të këtyre akt marrëveshjeve rezultojnë të kenë përfunduar me sukses 19 prej tyre (363,679,932 detyrime të arkëtuara). Për 10 akt marrëveshjet e zgjidhura në vlerën prej 444,798,882 lekë janë paguar 123,664,179 lekë, 2 akt marrëveshje të 1 subjekti janë transferuar (me vlerë 2,708,015 mijë lekë). Gjatë vitit 2022 rezultojnë të jenë lidhur 26 akt marrëveshje për 24 subjekte me vlerë totale të detyrimit prej 1,023,388,081 lekë, ku rezultojnë të kenë përfunduar me sukses 9 prej tyre (234,763,745 detyrime të arkëtuara). Për 8 akt marrëveshjet e nuk janë përmbushur të gjitha pagesat e dakortësuara në vlerën 604,555,814 lekë janë paguar 157,545,491 lekë, 9 marrëveshje në vlerën 184,569,164 lekë janë ende në proces.

- Nga akt marrëveshjet e anuluar, për periudhën objekt auditimi rezultojnë edhe disa akt marrëveshje të lidhura për të njëjtat subjekte, si një mjet për mos aplikimin e masave të tjera shtrënguese pas përfundimit të afatit për marrëveshjet ekzistuese. Nga auditimi i praktikave për lidhjen e akt-marrëveshjeve konstatohen mangësi në kërkesat e tatimpaguesve në drejtim të vërtetimit të pamundësisë së situatës aktuale financiare, shoqëruar me argumente nga ana e subjektit që pavarësisht rrethanës financiare të vështirë, është në gjendje të zbatojë kushtet e marrëveshjes; mangësi në analizat e situatës ekonomike financiare të subjektit të realizuar nga vetë DTM mbështetur në pasqyrat financiare të subjektit, gjendja e detyrimeve, kapitaleve të shoqërisë, aftësia qarkulluese e inventarit, likuiditetet etj, sikundër përcakton pika 77.1 të Udhëzimit nr.24, datë 02.09.2008 dhe Nenit 18 të Rregullores së funksionimit të DTM për lidhjen e akt-marrëveshjes, pika 2. Për akt marrëveshjet e përsëritura, informacioni u vendos në dispozicion vetëm për periudhën pasi monitorimi i tyre ka kaluar në kompetencën e drejtorive të kontrollit pasi këto struktura nuk gjeneronin informacion të mëparshëm për këto akt marrëveshje për periudhën kur monitorimi i tyre kishte qenë nën mbikëqyrjen e drejtorive të mbledhjes së detyrimeve tatimore të papaguara, duke rezultuar kështu me mangësi në drejtim të dorëzimit të punës dhe materialeve përkatëse pas rishpërndarjes së përgjegjësisë.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 46-325 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**17.1 Rekomandimi:** Drejtori i DTM të marë masat për përcjelljen pranë DPT të propozimit për parashikimin e procedurës së marrëveshjeve me këste të detyrimeve tatimore në aktet nënligjore miratuar prej saj, ose reflektimin e kësaj çështjeje në një dokument/manual të vetë institucionit, për t'u zbatuar nga strukturat përkatëse të kontrollit.

**Brenda vitit 2023**

**17.2 Rekomandimi:** Strukturat përgjegjëse pranë DTM të marrin masat për kryerjen e analizave efektive përpara lidhjes së akt-marrëveshjeve duke shqyrtuar historikun dhe aftësinë paguese të tatimpaguesit; si dhe të forcojnë procedurat aktuale të ndjekura përgjatë monitorimit të zbatimit të tyre, me qëllim përmbushjen e kushteve dhe minimizimin e riskut të anulimit, apo përsëritjen e tyre, si një alternativë për të mos kaluar në masa të tjera shtrënguese.

**Brenda vitit 2023**

**18. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi konstatohet se angazhimi i inspektoreve të kontrollit nga zyra dhe monitorimit në kryerjen e detyrave të tyre funksionale është raportuar nga DTM se mbështetet në Manualin e Kontrollit nga Zyra të miratuar në Tetor 2018. Ky angazhim nuk konkretizohet në hartimin dhe miratimin e një plani vjetor apo mujor mbi aktivitetin e sektorit, duke evidentuar kështu mangësi që përbëjë një risk për menaxhimin sa më efektiv të burimeve njerëzore për arritjen e objektivave nga hallkat mbikëqyrëse. Nga auditimi konstatohet se një plan i tillë nuk është hartuar si në nivel Drejtorie Kontrolli, ashtu edhe në nivel institucional.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 46-325 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**18.1 Rekomandimi:** Strukturat përgjegjëse pranë DTM të marrin masat për hartimin e planit operacional institucional pjesë e të cilit të jetë edhe plani i Drejtorisë së Kontrollit, me qëllim përcaktimin e objektivave kryesore vjetore në luftën kundër informalitetit, objektiv bazë për realizimin e të ardhurave tatimore në funksion të mbarëvajtjes normale të punës.

**Brenda vitit 2023**

**19. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i diferencave në të cilat të dhënat e kasës rezultojnë më të larta se sistemi, u konstatuan në total 22 raste, nga të cilat 1 subjekt është transferuar nga DRT në DTM në Nëntor 2022. Për rastet e tjera, sipas informacionit verbal të sektorit diferenca vjen si pasojë e gabimeve në shtypjen e kasës, por ky sektor nuk ka administruar asnjë procesverbal që vërteton këtë situatë, pasi këto dokumentacione janë pjesë e punës së Sektorit të Kontrollit në Vend. Pas dorëzimit të akt konstatimeve, nga ana e DTM u dërguan dokumentacionet që vërtetonin kryerjen e verifikimeve të nevojshme nëpërmjet kontrolleve në vend për të gjitha rastet e subjekteve me diferenca për vitin 2021. Nga raporti i gjeneruar nga DPT kanë rezultuar 4 kategori të dhënash me diferenca të konsiderueshme, për të cilat nuk disponohet informacion nga ana e DTM, duke u kufizuar vetëm me raportimin se këto të dhëna nuk lidhen me tregues real financiar të tatimpaguesve nën administrimin e DTM.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 46-325 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**19.1 Rekomandimi:** Sektori i Kontrollit nga Zyra pranë DTM të marrin masat për të kërkuar informacion lidhur me kategoritë që rezultojnë me diferenca sipas databazës së kasës së gjeneruar nga DPT, për të identifikuar shkaqet e diferencave, duke rekomanduar edhe kryerjen e kontrolleve në vend sipas rasteve.

**Brenda vitit 2023**

**19.2 Rekomandimi:** Sektori i Kontrollit në Vend të dokumentojë procesverbalet e gabimeve të kasës për çdo rast të konstatuar me diferencë, dhe të përcjellë këtë informacion pranë Sektorit të Kontrollit nga Zyra.

**Brenda vitit 2023**

**20. Gjetje nga auditimi:** Grupi i auditimit kërkoi vendosjen në dispozicion të të dhënave lidhur me deklarinimin e importeve dhe eksporteve që rezultojnë nga autoriteti tatimor (DTM) duke i krahasuar ato me të dhënat që rezultojnë të raportuara nga autoriteti doganor (DPD). Nga kryqëzimi i të dhënave sipas situatës financiare të TVSH-së, librat e blerjes dhe të shitjes me të dhënat e deklaruara sipas doganës janë konstatuar diferenca në të dy kahet.

Nga deklarimi në import rezultojnë 370 subjekte në të cilat vlera e deklaruar sipas tatimeve rezulton në total 1,741,547,382 lekë më e madhe se ajo në dogana; dhe për 177 subjekte vlera e deklaruar sipas tatimeve rezulton në total 591,280,526 lekë më e ulët se ajo në dogana. Nga deklarimi në eksport rezultojnë 153 subjekte në të cilat vlera e deklaruar sipas tatimeve rezulton në total 34,692,473,409 lekë më e madhe se ajo në dogana; dhe për 208 subjekte vlera e deklaruar sipas tatimeve rezulton në total 59,196,493,123 lekë më e ulët se ajo në dogana.

Diferencat që kanë lindur mes dy deklarimeve, konstatohet se janë verifikuar dhe analizuar nga inspektorët përkatës për të gjitha rastet duke identifikuar dhe shkaqet përkatëse. Nga auditimi i bazës dokumentare të vënë në dispozicion rezulton se diferenca më të mëdha konsistojnë në mangësitë e raportimit nga ana e autoritetit doganor raportet e të cilit nuk pasqyrojnë të gjitha deklaratat doganore të tatimpaguesve, të cilat faktikisht nga DTM janë administruar dhe janë verifikuar sipas informacionit vendosur në dispozicion. Si rezultat konstatohet se ky fenomen vjen si pasojë e mungesës së koordinimit në sistemet tatimore dhe doganore, duke përbërë kështu një risk për ekzistencën e një anomalie të sistemeve; apo pasaktësi për shkak të modulit të aplikuar në sistemin C@TS në momentin e gjenerimit të të dhënave nga DPD. Kjo problematikë nuk është dokumentuar në korrespondencat mes DTM dhe DPT, dhe nuk rezulton të jenë ndërmarrë iniciativat e nevojshme për verifikimin e shkakut të diferencave, me qëllim kryerjen e veprimeve të nevojshme në sistem.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 46-325 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**20.1 Rekomandimi.** Strukturat përgjegjëse pranë DPT në bashkëpunim me DPD-në dhe AKSHI-n, të ngrenë një grup pune me përfaqësues nga këto institucione, me qëllim verifikimin e shkaqeve që sjellin rezultate të ndryshme mes deklarimeve sipas DPT dhe DPD, me qëllim ndërmarrjen më pas të veprimeve rregulluese në sistemet sipas së cilave funksionojnë këto institucione, për të shmangur ekzistencën e diferencave në deklarinim.

**Brenda vitit 2023**

**20.2 Rekomandimi:** Sektori i Kontrollit nga Zyra të marë masat për rastet ku nga sektori janë identifikuar problematika dhe për të cilat subjektet kanë qenë objekt kontrolli i thelluar në vend, të administrojë konkluzionet e raporteve përfundimtare, me qëllim analizimin dhe verifikimin e diferencave në deklarime, ose problematikave të tjera.

**Brenda vitit 2023**

**21. Gjetje nga auditimi:** Nga verifikimi i korrespondencave për rishikimin e kështjës të tatimit konstatohet se miratimi i kërkesave për rishikimin e kështjës të tatimit është kryer pa dokumentuar kryerjen e një analize dhe monitorimi të plotë, veçanërisht në drejtim të nivelit të qarkullimit të shitjeve, ku mbartet edhe risku i rritjes së xhiros por i uljes së tatimit fitimit.

-Nga auditimi konstatohet se sistemi C@ts nuk mundëson aplikimin automatik të penaliteteve për tatimpaguesit që kanë likuiduar me vonesë këstet e parapagimeve të tatimit fitimit, dhe si rezultat ky proces monitorohet manualisht nga inspektorët e sektorit të kontrollit nga zyra. Për këtë çështje nuk dokumentohen iniciativa të administratës tatimore për shqyrtimin dhe vlerësimin e mundësive në drejtim të kryerjes së ndryshimeve në sistemin C@ts për këtë opsion.



-Gjithashtu, nga auditimi konstatohet se sistemi C@ts për këtë proces është dizenuar në një mënyrë të tillë që pagesa e tatimpaguesit për këstin do të shkojë për detyrimin më të hershëm të tij, pavarësisht periudhës për të cilën po kryhet likuidimi. Si rezultat, në rastet kur subjektet janë paralizuar njëherë për mos pagesë në vonesë të këstit, në momentin e likuidimit të këstit pasardhës, kjo pagesë do të shkojë për mbulimin e detyrimit të parë, dhe për periudhën që ai po kryhen në kohë pagesën, do të rezultojë sërish me vonesë dhe do të jetë objekt penalizmi. Përfundimisht këtu bëjnë rastet kur pagesa do të mbulojë këstet e të dyja periudhave. I njëjti fenomen rezulton edhe për rastet kur kryhen rivlerësime të kësteve nga tatimpaguesit. Rivlerësimi i kësteve të tatim fitimit nuk pasqyrohet në sistemin C@TS, sipas akt-vlerësimeve të mbajtura nga inspektorët përgjegjës për çdo tatimpagues, dhe si rezultat ky dokumentacion administrohet nga vetë sektori nëpërmjet shkresave përkatëse fizike. Si rezultat, ky proces rezulton të jetë subjektiv, dhe me vështirësi për tu monitoruar lidhur me saktësinë e vlerësimit të kërkesës për korrigjime të këstit, dhe transparencës apo standardizimit të këtij procesi.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 46-325 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**21.1 Rekomandimi:** Strukturat përgjegjëse pranë DTM në bashkëpunim me DPT të vlerësojnë zgjidhje optimale në sistemin C@TS në drejtim të procedurave të aplikueshme për efekt të aplikimit automatik të penalteteve për tatimpaguesit që kanë likuiduar me vonesë këstet e parapagimeve të tatim fitimit, pagesës së tatimpaguesit për këstin do të shkojë për detyrimin më të hershëm të tij, rivlerësimeve të kësteve apo edhe proporcionalitetit të parapagimeve të kësteve të tatim fitimit krahasimisht me tatim fitimin e periudhës, me qëllim përmirësimin e analizës së kryer për miratimin e kërkesave për rishikimin e kësteve të tatim fitimit, për të mundësuar një vendimmarrje sa më të drejtë të sektorit të kontrollit nga zyra për këtë çështje.

**Brenda vitit 2023**

**22. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i diferencave të konstatuara lidhur me deklaratimet e TF-së dhe TVSH-së u konstatua se në disa raste nga ana e sektorit edhe pse ishin ndërmarrë iniciativat për njoftimin e tatimpaguesve për dorëzimin e pasqyrave financiare në përmbushje të afateve përkatëse, nuk ishte plotësuar ky detyrim nga ana e subjekteve. Konkretisht, rezultojnë 11 subjekte që nuk kanë dorëzuar pasqyrat financiare të vitit 2021 dhe 37 subjekte që nuk kanë dorëzuar pasqyrat financiare të vitit 2022. Kjo situatë konstatohet se ka cënuar përmbushjen e detyrave të sektorit në drejtim të kryerjes së verifikimeve të nevojshme sipas zërave të pasqyrave, për të justifikuar diferencat, duke konkluduar kështu me propozimet e sektorit nga zyra për përfshirjen e këtyre subjekteve për kontroll në vend.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 46-325 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**22.1 Rekomandimi:** Strukturat përgjegjëse pranë DTM, për subjektet që nuk kanë dorëzuar pasqyrat financiare, pavarësisht tejkalimit të afateve ligjore dhe rikujtesave të përcjella nga institucioni të kryejnë vlerësim nga zyra të situatës financiare, si dhe të përfshijnë në programe të kontrollit tematik në vend, me qëllim verifikimin e diferencave të konstatuara.

**Brenda vitit 2023**

**23. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi veprimtarinë e Drejtorisë së Shërbimit të Tatimpaguesve të Mëdhenj, ka rezultuar se nga viti 2021 në vitin 2022, ka rënie të numrit të shërbimeve të ofruara nga DSHT për një pjesë të mirë të shërbimeve, si p.sh.: Kthim përgjigje palëve të treta; Çështje të trajtuara nëpërmjet portalit qeveritar; Numri i njoftimeve të dërguar tatimpaguesve me qëllim parandalimin e mashtrimit dhe nxitjen e korrigjimit vullnetar; Numri i seminareve edukues të realizuar; Kontakte të regjistruara nëpërmjet rubrikës "Çështje e

Përgjithshme" krijuar nga inspektori Shërbimit; Azhornim te dhënash regjistrimi. Gjithashtu në kuadër të procesit të dixhitalizimit dhe rritjes së numrit të shërbimeve të ofruara online nëpërmjet portalit qeveritar e-Albania, struktura e Drejtorisë së Shërbimit të Tatimpaguesve të Mëdhenj e përbërë nga 7 punonjës (1 Drejtor Drejtorie, 2 përgjegjës sektori, 4 specialistë), në raport me numrin dhe llojin e shërbimeve të ofruara dhe efektivitetit të kësaj Drejtorie, duhet të rishikohet.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 352-362 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**23.1 Rekomandimi:** Nga DPT të merren masa për rishikimin e strukturës së Drejtorisë së Shërbimeve të Tatimpaguesve në DTM, referuar treguesve të performancës në rënie nga viti 2021 në vitin 2022, efektivitetit të kësaj drejtorie si dhe procesit të dixhitalizimit dhe rritjes së numrit të shërbimeve të ofruara online.

**Në vijimësi**

**24. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi rezultoi se gjendja e detyrimeve të papaguara në fillim të vitit 2021 paraqitet në vlerën 12,509 milion lekë që i përket një numri prej 271 subjektsh debitorë, dhe në fund të vitit 2021 këto detyrime rezultojnë në vlerën 13,209 milion lekë që i përket një numri prej rreth 308 subjektsh debitorë. Pra, rritja e pësuar neto e detyrimeve nga 01.01.2021 në 31.12.2021 është rreth 700 milion lekë të detyrimeve të papaguara, dhe me 37 të debitorëve të shtuar në fund të vitit. Gjendja e detyrimeve të papaguara në fillim të vitit 2022 paraqitet në vlerën 13,208 milion lekë që i përket një numri prej 308 subjektsh debitorë dhe në fund të vitit 2022 këto detyrime rezultojnë në vlerën 12,484 milion lekë, që i përket një numri prej rreth 257 subjektsh debitorë. Nga auditimi rezulton se nga ana e drejtorisë DMDTP në DTM stoku i detyrimit tatimorë të papaguar i vitit 2021 dhe vitit 2022 nuk është mbuluar me të gjithë masat shtrënguese të përcaktuar në Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 98 “E drejta për të kërkuar detyrimet nga pala e tretë”, neni 93 “Sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurisë”, neni 97 “Transferim i detyrimit tatimore palës së tretë”, neni 99 “Përgjegjësia e ortakut, e aksionerit dhe e administratorit “ dhe në Manualin “Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar”, kreu XI “Masat shtrënguese”. Nga auditimi rezulton se gjatë vitit 2021 nuk është ezauruar në asnjë rast masa “Njoftim transferimi detyrimi tatimor palës së tretë” dhe “Njoftim për transferimin e detyrimit Ortakut, Aksionerit, Administratorit”; gjatë vitit 2022 nuk është ezauruar në asnjë rast masa shtrënguese; “Njoftim transferimi detyrimi tatimor palës së tretë në zbatim të nenit 98”, “Njoftim për transferimin e detyrimit Ortakut, Aksionerit, Administratorit” dhe “ Urdhër sekuestrimi”. Mos mbulimi i borxhit tatimor me të gjithë masat shtrënguese, rrit riskun e mos arkëtimit të detyrimeve të papaguara nga subjektet.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 362-381 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**24.1 Rekomandimi:** Nga Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të papaguara në DTM të merren masa konkrete në ushtrimin e kompetencave të dhëna sipas legjislacionit në fuqi duke zbatuar mënyrat e vlerësimit të riskut, për të përcaktuar dhe zbatuar, në çdo rast, masën më të përshtatshme të mbledhjes me forcë si edhe duke siguruar mbulimin e borxhit tatimor me të gjithë masat shtrënguese, në mënyrë që të maksimalizohet mbledhja e detyrimeve tatimore të papaguara.

**Në vijimësi**

**25. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumenteve dhe i informacionit të hedhur në sistemin C@TS u konstatuan se për 19 subjekte që janë në procedurë ankimi rezultojnë me çështje të hapura në sistem ose është vijuar më procedurën e mbledhjes së detyrimit tatimorë në

kundërshtim me manualin “Manualin e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara” Kreu III, kapitulli 3.2 “Moduli i çështjeve”, pika 3.2.2 “Mbyllja e çështjeve” dhe pika 3.3.2 “Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor” ku citohet “*Sistemi tatimor C@TS mundëson që detyrimet tatimore të cilat janë në proces ankimimi administrative apo gjyqësor të çekohen nga personat përgjegjës. Në këtë mënyrë përdoruesit e sistemit C@TS mund të shikojnë te debia e llogarisë së tatimpaguesit nëse ka të shënuar në apel një detyrim tatimor. Në përmbushje të dispozitës ligjore të sipërcituar, në modulin e çështjeve nuk hapen çështje për detyrimet tatimore të çekuara në apel...*”. Nga auditimi u konstatua se kjo situatë krijohet për dy arsye: 1) nuk është hedhur në sistem C@TS informacioni për detyrimin tatimor në apel nga personat përgjegjës sipas pikës 3.3.2 “Mbledhje me forcë e detyrimit tatimor”. 2) Si dhe nuk informohet në kohë DMDTP në DTM nga drejtoria përgjegjëse referuar në ligjin 9920, Kreu XII, neni 106 pika 4 ” *Drejtoria e apelimit i dërgon një kopje të ankimit administratës tatimore, që ka nxjerrë vlerësimin tatimor ose vendimin, objekt të ankimit tatimor*”. Në mos përmbushje të kësaj dispozite ligjore, në modulin e çështjeve hapen çështje për detyrimet tatimore proces ankimimi administrativ apo gjyqësor, pra vijohet me procedurën ligjore të mbledhjes së detyrimit tatimor duke sjellë jo vetëm pasoja organizative , por edhe juridike.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 362-381 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**25.1 Rekomandimi:** Titullari i DTM të marrë masa për përcjelljen e kësaj problematike pranë MFE, ku Struktura e Apelit Tatimor në MFE të shqyrtojë situatën e mësipërme, në mënyrë që të garantohet raportimi i informacionit në sistemin C@TS sipas përcaktimeve ligjore për rastet që janë në proces ankimimi.

**Në vijimësi**

**26. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dosjeve të prokurimit me procedurë blerje e vogël për vitin 2021 dhe vitin 2022, rezulton se dosjet e procedurave të prokurimit nuk janë inventarizuar dhe arkivuar me numër fletësh, duke sjellë pasiguri në plotësinë dhe administrimin e dokumentacionit të prokurimeve. Gjithashtu rezultuan disa parregullsi në zbatimin e procedurës së prokurimit blerje e vogël si: procesverbalet e mbajtura nuk janë të protokolluara; ofertat e marra nga operatorët ekonomik janë pa datë; në disa raste mungon deklarata e konfliktit të interesit, etj. Duke sjellë kështu pasiguri në transparencën e procedurave të prokurimit blerje e vogël. Këto veprime janë në kundërshtim me VKM Nr. 285 prot., datë 19.05.2021 dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar, neni 4, pika 1, Udhëzimin e APP nr.1, datë 05.01.2018, kreu I, pika 1. Ligji nr. 9154, datë 6.11.2003 “*Për arkivat*”, neni 36 “*Arkivat e numerizuara*”, Udhëzimi nr. 1, datë 05.01.2018 *Për hartimin e regjistrit të parashikimeve të procedurave të prokurimit publik dhe regjistrit të realizimeve të procedurave të prokurimit dhe krijimi i tyre në sistemin e prokurimit elektronik*”, kreu I, pika 1.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 362-381 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**26.1 Rekomandimi:** Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj në cilësinë e Autoritetit Kontraktor të marrë masa për sistemimin e dosjeve të procedurave të prokurimit, inventarizimin dhe arkivimin e tyre, sipas lidhjeve dhe në mënyrë kronologjike, me qëllim garantimin e saktësisë dhe plotësisë në administrimin e dokumentacionit. Komisionet e prokurimit të marrin masa që për çdo procedurë prokurimi të veprohet në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, duke garantuar siguri dhe transparencë mbi procedurën e prokurimit blerje e vogël.

**Në vijimësi**

**27. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi respektimin e kostos minimale fiskale, çmimit dhe fitimit minimal fiskal për efekt të llogaritjes së detyrimeve tatimore në sektorin e ndërtimit është konstatuar se në praktikën e përzgjedhura për kontroll, megjithëse nuk janë respektuar këto norma nga tatimpaguesit sipas pasqyrit në raportet e kontrollit tatimor, nga inspektorët e kontrollit nuk është kryer vlerësim alternativ sipas kërkesave të Ligjit Nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Nga DTM është pretenduar nëpërmjet observacioneve se moskryerja e vlerësimit alternativ është bazuar në shkresën “Kthim përgjigje” të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve me Nr.11840/1 Prot., datë 19.09.2019 në vijim të kërkesës Nr.307/37 Prot., datë 12.06.2019 me lëndën “Kërkesë për interpretim dhe sqarim teknik”. Në shkresën e DPT, ndër të tjera është cituar “...Nivelet më të ulëta të çmimeve të shitjeve dhe kostove të ndërtimit të krahasuara me çmimet të shitjeve dhe kostove të ndërtimit të miratuara nga EKB nuk janë shkelje tatimore referuar legjislacionit tatimor. Ky fakt nuk i jep të drejtë administratës tatimore të përdorë metodën alternative të vlerësimit pasi nuk është përcaktuar në Udhëzimin e KM nr.4, datë 30.09.2015 dhe se ky udhëzim nuk ka dalë me qëllim të llogaritjes së detyrimeve tatimore të tatimpaguesve. Udhëzimi ka dalë në mbështetje të shkronjës “dh” të nenit 34/1 të Ligjit Nr.9232, datë 13.05.2004 “Për programet sociale të strehimit” të ndryshuar, me propozim të Ministrit të Zhvillimit Urban.....Në përfundim, aktet ligjore dhe nënligjore duhet të zbatohen sipas fushës për të cilën ato kanë dalë dhe sipas përmbajtjes lëndore të tyre”.

KLSH konstaton se legjislacioni aktual në fushën e ndërtimit e ka të përcaktuar qartë detyrimin për respektimin e kostos minimale fiskale, çmimit minimal fiskal dhe fitimit minimal fiskal sipas përcaktimeve të bëra në nenin 20 “Punimet e ndërtimit, kryerja e procesit të ndërtimit, si dhe të mirëmbajtjes” të Udhëzimit Nr.6 datë 30.1.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në R.SH”, i ndryshuar, ku citohet “Gjithashtu, përcaktimi i kostos reale në sektorin e ndërtimit, të investimeve private apo publike, përcaktohet në bazë të metodologjisë së dhënë në Vendimin e Këshillit të Ministrave “Për përdorimin e manualit teknik të çmimeve të punimeve të ndërtimit”. Këto metodologji të llogaritjes së kostos minimale fiskale, çmimit dhe fitimit minimal fiskal për efekt të llogaritjes së detyrimeve tatimore në sektorin e ndërtimit, të investimeve private apo publike, të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore në fuqi, do të shërbejnë si metodologji alternative të vlerësimit”. Pra kjo dispozitë e Udhëzimit të Ministrit të Financave e dalë në zbatim të Ligjit Nr.94/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Ligjit Nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar është detyruese për kryerjen e vlerësimeve alternative, për të cilën konstatohet se nga DPT ka një interpretim jo të drejtë dhe shterues të situatës. Për më tepër, gjatë auditimit të zhvilluar në DTM, faza në terren janë konstatuar raste (*Raport Kontrolli i Shoqërisë “O” SHPK* të përdorjes së vlerësimit alternativ për qëllime të rivlerësimit të ardhurave nga shitja duke u bazuar në çmimin minimal fiskal të përcaktuar në VKM Nr.168, datë 27.03.2019 (i pandryshuar në vijim), ku nga administrata tatimore në këtë rast është gjendur si bazë për kryerjen e vlerësimit alternativ. Gjithashtu referuar përcaktimeve të Udhëzimit Nr.3 datë, 28.12.2016 “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga enti kombëtar i banesave për vitin 2016”, Tabela Nr.1-Kosto mesatare e ndërtimit, përcakton qartë elementët që nuk përfshihen në koston mesatare të ndërtimit (*Kosto e rrjetit inxhinierik, projektit, studimit gjeologjik dhe sizimik, lejes së ndërtimit, truallit*), të cilat janë të detyrueshme t’i shtohen kostos mesatare të ndërtimit për m<sup>2</sup> të publikuar në tabelën nr.1, elementë të cilët konstatohet se nuk janë marrë në konsideratë nga DTM gjatë kontrollit tatimor mbi respektimin e kostove minimale fiskale në sektorin e ndërtimit.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 46-352 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**27.1 Rekomandimi:** Nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve të merren masa të menjëhershme për përcaktimin e efekteve të vlerësimeve alternative, me pasojë të ardhura tatimore të munguara në buxhetin e shtetit, si dhe në vijimësi, të ndjekë zbatimin e përcaktimeve ligjore në lidhje me respektimin e kostos minimale fiskale, çmimit minimal fiskal dhe fitimit minimal fiskal në sektorin e ndërtimit.

### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**28. Gjetje nga auditimi:** Nga verifikimi i zbatimit të procedurave dhe afateve për kontrollet e ushtruara tek tatimpaguesi kanë rezultuar mangësi si vijon:

-Në 32 raste në sistemin C@TS mungon dokumenti mbi Njoftimin e Kontrollit, në 6 raste formulari nr. 3, dhe në 1 rast mungon dokumenti Raporti Përfundimtar i Kontrollit, jo në përputhje me Manualin i Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2.2.

- Në 28 raste, formulari nr.3, nënshkrimi nga Inspektori i Kontrollit, Përgjegjësi i Sektorit të Kontrollit, Drejtori i Kontrollit dhe Drejtori i Drejtorisë Rajonale nuk kanë datë.

- Në 11 raste në dosje nuk administrohet shkresa për dërgimin e Projekt Raportit dhe Raportit Përfundimtar.

- Në 1 rast në dosje nuk administrohet Njoftimi i Kontrollit dhe programi i kontrollit.

- Në 26 raste Projekt Raporti, Raporti Përfundimtar i Kontrollit dhe procesverbalet janë hedhur me vonesë në C@TS, jo në përputhje me Manualin i Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2.2.

- Në 8 raste nuk është respektuar afati 30 ditor, nga njoftimi i kontrollit deri në fillimin e kontrollit në subjekt, në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit 9920 “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 81, pika 1.1.

- Në 9 raste kontrolli është kryer në tejkalim të afatit të parashikuar në programin e kontrollit, jo në përputhje me përcaktimet e Manualit të Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2.3 ku citohet: *“Kohëzgjatja e nevojshme e kontrollit përcaktohet nga të dhënat e analizës së riskut. Kohëzgjatja e kontrollit përcaktohet në baze të orëve të punës të parashikuara në Programin e Kontrollit. Kjo periudhë kohe merr parasysh kohën e kontrollit, pa përfshirë kohën për përgatitjen e raportit të kontrollit, i cili duhet të përgatitet brenda shtatë ditëve kalendarike nga data e përfundimit të tij tek tatimpaguesi”.*

- Në 6 raste nuk është respektuar afati 7 ditor për përgatitjen e Projekt Raportit nga Inspektori jo sipas përcaktimeve të Ligjit 9920 “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 83, pika 1.

- Në 22 raste nuk janë respektuar afatet nga përgatitja dhe dërgimi i Projekt Raportit deri në përgatitjen dhe dërgimin e Raportit Përfundimtar të Kontrollit në subjekt, jo sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9920 “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 83, pika 1 dhe 4, Neni 84, pika 1.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 388-434 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**28.1 Rekomandimi:** Nga Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj të merren masa menjëherë dhe në vijimësi të zbatohen me korrektësi procedurat dhe afatet e përcaktuara ligjore për ushtrimin e kontrollove tek tatimpaguesit.

### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**29. Gjetje nga auditimi:** Nga verifikimi i zbatimit të procedurave dhe afateve për kontrollet e ushtruara tek tatimpaguesi nga DTM, u konstatuan problematika si:

- Afati nga përfundimi i përgatitjes së Projekt Raportit nga Inspektori deri në miratimin e tij nga eprorët (Përgjegjës Sektori/Drejtor) varion nga 10 ditë deri në 2 muaj.
- Njoftimi i fillimit të kontrollit tatimor, në disa raste, rezulton të jetë dërguar përpara afatit 30 ditor të fillimit të kontrollit, duke mos respektuar afatin 30 ditor të lajmërimit përpara fillimit të kontrollit.
- Në të gjitha rastet, procesverbalet dhe akt konstatimi të hartuar në data të ndryshme janë hedhur në sistemin informatik, por jo sipas afatit të përcaktuar në pikën 2.2 të MKT (të nesërmen nga dita e mbajtjes së tij).
- Raporti i kontrollit tatimor (projekti) në pjesën më të madhe të kampionit është hartuar në tejkallim të afatit 7 ditor nga data e përfundimit të tij të tatimpaguesi, të përcaktuar në pikën 2.3 të MKT dhe nenit 83 të ligjit për procedurat tatimore.
- Raporti përfundimtar i kontrollit vlerësohet të jetë miratuar në pjesën më të madhe të kampionit në tejkallim të afatit 14-ditor nga marrja e kundërshtimeve të tatimpaguesit, jo në përputhje me përcaktimet e bëra në pikën 2.5 të MKT dhe neneve 83 dhe 84 të ligjit për procedurat tatimore.
- Në parashikimet e Ligjit Nr. 9920 “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” dhe Manualin e Kontrollit Tatimor, Kapitulli VIII, pika 8, nuk është përcaktuar afati maksimal për miratimin Projekt Raportit nga eprorët (Përgjegjës Sektori/Drejtor), duke e bërë këtë fazë të procedurës së kontrollit evazive.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 388-434 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**29.1 Rekomandimi:** Nga Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj në bashkëpunim me Drejtorin e Përgjithshme të Tatimeve, të merren masa dhe të bëhen përmirësime në aktet ligjore dhe nënligjore për përcaktimin e afatit maksimal nga përfundimi i përgatitjes së Projekt Raportit nga Inspektori deri në miratimin e tij nga eprorët (Përgjegjës Sektori/Drejtor).

**Menjëherë**

**29.2 Rekomandimi:** Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj, referuar mangësive dhe parregullsive në procedurën e kontrollit për afatet të marrë masa për:

- pasqyrimin në kohë të akteve të kontrollit (procesverbale, akt konstatime) në sistemin informatik tatimor;
- të fillojë kontrollet duke respektuar afatet e njoftimit të kontrollit;
- të përmirësojë procedurën e hartimit të raportit paraprak të kontrollit në kohë;
- të mbajë komunikim të vazhdueshëm me tatimpaguesit për pasqyrimin e observacioneve dhe respektimin e afatit të përfundimit në kohë të raportit të kontrollit tatimor përfundimtar.

**Brenda vitit 2023**

**30. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatuan mangësi në drejtim të plotësimit të strukturës së DTM, situatë kjo që mbart riskun për të cenuar përmbushjen me sukses të detyrave funksionale të drejtorisë, ku përmendim: Drejtorinë e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore e cila ka funksionuar me strukturë jo të plotë me 9 nga 11 punonjës gjatë vitit 2021, dhe 8 nga 11 punonjës gjatë vitit 2022; Sektorin e Kontrollit nga Zyra, i cili ka funksionuar me strukturë jo të plotë, me 9 nga 11 punonjës gjatë vitit 2022 për shkak të transferimit të 2 inspektorëve pranë DRT Tiranë; Drejtorinë e Analizës, Riskut dhe Kontabilitetit të të Ardhurave e cila ka funksionuar me vakancë në pozicionin e pozicionin e Drejtorit të Drejtorisë përgjatë vitit 2021 dhe 2022; Sektorin e Analizës dhe Kontabilitetit, i cili ka funksionuar me 2 nga 3 punonjës përgjatë vitit 2022, për shkak të transferimit të 1 inspektori pranë DRT Tiranë dhe Sektori i Analizës së Riskut përgjatë vitit 2021 dhe 2022 ka funksionuar me 2 vakanca, etj.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 15-46 dhe 2.4, faqe 362-381 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**30.1 Rekomandimi:** Titullari i DTM, në bashkëpunim edhe me DPT, të marrë masa për plotësimin e vendeve vakante, pjesë të shërbimit civil sipas pozicioneve të miratuara në Urdhrin e Kryeministrit nr. 33, datë 12.02.2020 “Për miratimin e strukturës organizative të personelit të Administratës Tatimore Qendrore”.

**Brenda vitit 2023**

## **B. TË ARDHURA TË MUNGUARA NË BUXHETIN E SHTETIT**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi kontrollin e ushtruar në tatimpaguesin “K.D” SHPK me NIPT L.K janë konstatuar mangësi të cilat përfshijnë:

- Në raportin e kontrollit është kryer analiza e bilancit material për një numër të kufizuar artikujsh ku janë krahasuar vit pas viti lëvizja e mallrave në sasi duke u shprehur që janë kryer ri grupime të artikujve po pa ndryshuar vlerë, megjithëse kostot e artikujve të grupuar janë të ndryshëm.

- Në analizën e kryer për efekt të TVSH-së në shitjet e përjashtuara janë përfshirë vlera e ambalazheve të kthyeshme, konkretisht shishe në vlerën 25,123,447 leke. Për analogji, në vitin 2018 blerjet e ambalazhit nga coca cola i ka raportuar si blerje të përjashtuara. Për këtë arsye shitjet e tatueshme sipas deklarimeve rezultojnë të jenë nënvlerësuar për shumën 25,123,447 lekë dhe detyrimi tatimor për tatim fitimin vlerësohet në shumën 4,593,822 lekë.

-Nga ana e inspektorit tatimor nuk rezulton të jetë ushtruar kontroll tatimor për shitje në tatimpagues në statusin pasiv duke qenë se tatimpaguesi objekt kontrolli ka precedencë në shitje të realizuar në subjekte sipas shkresës për fillimin e kontrollit.

-Në analizën e kryer në raportin e kontrollit tatimor në krahasimin e shpenzimeve të raportuara në pasqyrën e performancës financiare me deklaratimet në FDP të TVSH-së konstatohet se ekzistojnë diferenca nga rakordimi përse i përket rregullimeve për efekt të shtesës së aseteve gjatë vitit dhe ndryshimit të gjendjes së materialeve. Për rrjedhojë janë mbivlerësuar një pjesë e shpenzimeve të periudhës për diferencën e cila duhet të trajtohej si një shtesë e aseteve dhe jo shpenzim i zbritshëm për vitin. Për këtë arsye shpenzimet e zbritshme duhet të rivlerësohen për 722,719 lekë dhe detyrimi tatimor për tatim fitimin vlerësohet në shumën 132,149 lekë.

-Në lidhje me ndryshimin e gjendjes së inventarit për efekt rakordimi të FDP-së me pasqyrën e performancës konstatohet se nuk është përfshirë ndryshimi i gjendjes së materialeve të para (ambalazhe) në vlerën 354,198 lekë. Në vitin 2017 për efekt të rakordimit të shpenzimeve sipas FDP me shpenzimet sipas PASH ndryshimi i gjendjes së mallrave nuk ka përfshirë ndryshimin e gjendjeve të materialeve të para (ambalazhe) në shumën 1,892,715 lekë gjatë analizës së kryer.

***Në total, efekti financiar i shmangur me efekt të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit vlerësohet në shumën 4,725,971 lekë.***

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 46-352 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**1.1 Rekomandimi:** Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj për tatimpaguesin “K.D” SHPK, referuar mangësive dhe parregullsive në procedurën e kontrollit, vlerësuar me efekte negative në të ardhurat tatimore, në përputhje me kërkesat ligjore dhe proceduriale, të kryejë rikontroll tatimor sipas përcaktimeve të nenit 85 “Ri kontrolli tatimor” të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit të evidentuara paraprakisht në vlerën prej **4,725,971 lekë**.

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi kontrollin e ushtruar në tatimpaguesin **B.E SHPK me NIPT L.I** janë konstatuar mangësi të cilat përfshijnë:

- Nga auditimi konstatohet se nga ana e inspektorëve tatimorë rezulton të mos jetë kontrolluar transaksioni i qeradhënies së makinerive apo asetëve të tjera të cilat bëjnë pjesë në asetin gjenerues të parasë, duke qenë se shoqëria ka marrë me qera të gjithë rafinerinë me të gjitha asetet që ajo disponon nga pronari i saj “A.E”. Në këtë mënyrë, referuar përcaktimeve të bëra në ligjin “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar, qiradhënia e asetëve të tjera nga ndërtesa, është furnizim i tatueshëm me TVSH, dhe në këtë mënyrë ky transaksion duhet të ishte objekt kontrolli dhe përcaktimi të shumës së TVSH-së e cila duhet të ishte e pagueshme për një tatimpagues dhe e kreditueshme për tjetrin, por që në total do të paraqiste të ardhura shtesë për buxhetin e shtetit nga TVSH.

-Nga auditimi konstatohet se në raport kontrolli nuk është kryer një analizë për shitjet e analizuara nga shoqëria në lidhje me sasinë e produktit të përpunuar duke qenë se të ardhurat nga shitja janë të lidhura në mënyrë të drejtpërdrejtë me sasinë e produktit të përpunuar sipas tarifës së përpunimit të përcaktuar në kontratë ndërmjet palëve. Nga ana e inspektorëve tatimorë nuk është kryer bilanci material i mallrave përgjatë periudhës objekt kontrolli, duke vendosur në dyshim kreditueshmërinë e TVSH-së për këto produkte dhe nëse ato i kanë shërbyer aktivitetit ose jo. Kjo sepse shitjet e tatimpaguesit përbëhen nga ofrim shërbimi dhe nuk përfshijnë tarifimin për shitjen e materialeve të tjera, duke qenë jashtë objektit të veprimtarisë së tij. Duke mos u kryer bilanci material nuk verifikohet saktësia e blerjeve të tatueshme dhe importeve për qëllime të aktivitetit të tatueshëm.

-Në blerjet e tatueshme, konstatohet se janë përfshirë blerje për materiale të para në procesin e prodhimit që përfshijnë sipas pasqyrave financiare artikujt aditiv dhe katalizator. Sipas marrëdhënies së përshkruar në raport kontrolli tatimor dhe shpjegimeve të dhëna nga ana e inspektorit tatimor, nga ana e tatimpaguesit është marrë me qera rafineria së bashku me mjetet si një e tërë dhe duke punësuar punonjësit e specializuar është ofruar shërbimi për përpunimin e naftës bruto për llogari të tatimpaguesit T.E, i cili është zotërues i materialit të parë dhe produkteve që përfitohen nga procesi i përpunimit. Ky argumentim është përdorur për marrëdhënien e krijuar sipas së cilës nafta bruto nuk bëhet hyrje të tatimpaguesi B. por është gjatë gjithë kohës në pronësi të T.E. Në të njëjtën logjikë, edhe materialet e tjera të cilat janë në funksion të procesit të përpunimit (aditiv, katalizator) i nënshtrohen të njëjtë parim dhe për këtë arsye, blerjet e realizuara nga tatimpaguesi B. konstatohet se nuk i shërbejnë aktivitetit të tatueshëm të tij, por tatimpaguesit T.E duke qenë se referuar modelit të biznesit të paraqitur në raportin e kontrollit tatimor dhe faktit të qënies së tatimpaguesit T.E si subjekt i prodhimit të mallrave të akcizës (naftës dhe nënprodukteve të saj). Për këtë arsye, është vendosur në dispozicion kontrata e lidhur ndërmjet palëve ku përcaktohen të drejtat dhe detyrimet, tarifa, mallrat, depoztimi etj. Nga analiza e kësaj kontrate dhe marrëdhënies së krijuar ndërmjet tatimpaguesve konstatohet se në çdo rast shoqëria B.E është përgjegjëse vetëm për procesin e përpunimit, duke qenë se për materialet e para dhe produktet e gatshme është përgjegjëse shoqëria T.E dhe tarifa e përcaktuar në marrëveshje ndërmjet palëve përfshin çmimin e dakortësuar vetëm për ofrimin e përpunimit me asetet përpunuese dhe angazhimin e punonjësve për procesin e transformimit të lëndëve të para në produkt të gatshëm. Në këtë mënyrë konstatohet se shoqëria B.E ka përfshirë në blerje të kreditueshme solucione dhe hollues (të cilat ndryshojnë natyrën dhe cilësinë e produktit të gatshëm), që janë materiale të para në procesin e



përpunimit të naftës bruto, për të cilat ka kredituar TVSH, në një kohë që subjekt i autorizuar në regjimin e magazinës fiskale për përpunimin e mallrave të akzicës është shoqëria T.E. Për këtë arsye, blerjet e kryera për solucion dhe hollues nuk i shërbejnë aktivitetit të shoqërisë B.E por, shoqërisë T.E dhe rrjedhimisht nuk duhet të ishte kredituar TVSH. ***Efekti financiar i shmangur me efekt të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit është në shumën 56,146,215 lekë detyrime për tatimin mbi vlerën e shtuar***, si dhe uljen e humbjes në vlerën 230,296,205 lekë. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 46-352 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**2.1 Rekomandimi:** Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj për tatimpaguesin **B.E SHPK**, referuar mangësive dhe parregullsive në procedurën e kontrollit, vlerësuar me efekte negative në të ardhurat tatimore, në përputhje me kërkesat ligjore dhe proceduriale, sipas përcaktimeve të nenit 85 “Ri kontrolli tatimor” të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të kryejë rikontroll tatimor me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit të evidentuara paraprakisht në vlerën prej **56,146,215 lekë** si dhe ulja e humbjes në vlerën 230,296,205 lekë.

**Brenda vitit 2023**

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi kontrollin e ushtruar në tatimpaguesin “**A.**” **SHPK me NIPT J.Q** janë konstatuar mangësi të cilat përfshijnë:

-Nga analiza e kryer për inventarin e paraqitur sipas pasqyrave financiare të raportuara dhe të analizuara në raport kontrolli konstatohet se është paraqitur llogaria analitike e inventarit të imët e cila paraqitet me një tepriçë negative në shumën (-6,392,655) për vitin 2020, duke mos u analizuar nga inspektori në lidhje me vërtetësinë e gjendjes negative të llogarive të inventarit si dhe efektet që ajo paraqet në rakordimin e kryer me fdp dhe koston e mallrave të shitura si pasojë e ndryshimit të gjendjeve.

-Nga auditimi konstatohet se janë paraqitur situacione si shitje të tatueshme drejt vetë tatimpaguesit në pjesën e parë të analizës së kryer nga kontrolli. Sipas shpjegimeve dhëna nga ana e inspektorit tatimor kjo mënyrë faturimi dhe deklarimi është kryer nga tatimpaguesi për ato raste kur ka kryer punime të evidentuara me situacione përkatëse të cilat ende nuk janë marrë në dorëzim nga ana e përfituesit të punimeve të ndërtimit. Më pas, pas marrjes në dorëzim dhe kolauditimit të punimeve është kryer anulimi i faturës paraardhëse të shitjes dhe faturimi drejt përfituesit të punimeve të ndërtimit në të njëjtën vlerë. Kjo praktikë nuk është në përputhje me parashikimet e bëra në udhëzimin për TVSH-në, neni 20, ku përcaktohet që faturimi duhet të kryhet çdo muaj drejt përfituesve të shërbimit.

- Nga auditimi konstatohet se për vitin 2020, në analizën e kryer për efekt të tatim fitimit janë kryer rakordimet për të ardhurat për efekt të tatim fitimit me qarkullimin e raportuar për efekt të TVSH-së. Në këtë rakordim është ulur vlera e të ardhurave për efekt të tatim fitimit si pasojë e zbritjes së të ardhurave të shtyra të arkëtuara gjatë periudhës duke zvogëluar të ardhurën e tatueshme. Nga analiza e shënimeve shpjeguese në të ardhurat e shtyra konstatohet se në këtë llogari, shuma prej 282,211,471 lekë i përket arkëtimeve të marra po nga A., pra nga vetë tatimpaguesi për punimet e kryera të cilat nuk janë marrë në dorëzim. Ky veprim duhet të pasqyrohet në zërin e bilancit klientë pasi janë punime të kryera drejt të tretëve dhe nuk duhet të trajtohet si autofaturim. Referuar gjendjes së raportuar të kësaj llogarie dhe faktit që është e pamundur që tatimpaguesi të faturojë dhe arkëtojë po nga vetja për punime konstatohet se është zvogëluar padrejtësisht e ardhura e tatueshme për efekt të tatimit mbi fitimin për vitin 2020 duke sjell një efekt si më poshtë:

*Detyrimi për Tatim Fitimin  $282,211,471 * 15\% = 42,316,721$  lekë*

*Gjobë 42,316,721 \* 0.06% x 365 ditë = 9,267,362 lekë.*

***Efekti financiar i shmangur me efekt të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit është në shumën 51,584,082 lekë.***

-Nga auditimi konstatohet se gjatë vitit 2020 aktivet e tatimpaguesit janë shtuar si pasojë e bashkimit me përthithje me një shoqëri tjetër. Nga ana e inspektorit tatimor nuk rezulton të jetë analizuar procesi i bashkimit me përthithje në kuadër të transferimit drejt tatimpaguesit të të drejtave dhe detyrimeve që mbart subjekti i përthithur në bazë të parashikimeve të bëra në legjislacionin e TVSH në rastin e përthithjeve.

-Nga ana e inspektorit tatimor nuk rezulton të jetë analizuar procesi i prodhimit të betonit dhe respektimi i kartës teknologjike në lidhje me sasinë e përdorura të materialeve për prodhimin e tij dhe lëvizjet e këtyre materialeve, sipas vlerave të paraqitura në akt konstatimin e mbajtur nga ana e inxhinierit.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 46-352 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**3.1 Rekomandimi:** Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj për tatimpaguesin “A.” SHPK, referuar mangësive dhe parregullsive në procedurën e kontrollit, vlerësuar me efekte negative në të ardhurat tatimore, në përputhje me kërkesat ligjore dhe proceduriale, sipas përcaktimeve të nenit 85 “Ri kontrolli tatimor” të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të kryejë rikontroll tatimor me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit të evidentuara paraprakisht në vlerën prej **51,584,082 lekë.**

**Brenda vitit 2023**

**4. Gjetje nga auditimi:** auditimi mbi kontrollin e ushtruar në tatimpaguesin “A” SHPK me NIPT J.K janë konstatuar mangësi të cilat përfshijnë:

-Nga auditimi në lidhje me këtë praktikë konstatohet se nuk është kryer një analizë e blerjeve të tatueshme brenda vendit sipas natyrës së tyre prej furnitorëve kryesorë, me përjashtim të punimeve të kryera nga ana e nënkontraktorëve, duke mos dokumentuar të drejtën për kreditueshmërinë e tatimit mbi vlerën e shtuar për të gjithë periudhën e kontrolluar.

-Analiza e kryer në lidhje me lëvizjen e materialeve rezulton të jetë e pa plotë duke mos e detajuar dhe paraqitur evidenca sipas objekteve të ndërtimit dhe krahasimit me preventivat përkatës të miratuar.

-Shitjet e analizuar në raport kontrolli drejt tatimpaguesve dhe sipas situacioneve përkatëse nuk rakordojnë me shitjet e deklaruar në deklaratën e TVSH-së sipas periudhave të analizuar. Këto diferenca përfshijnë shitje të padeklaruar si pasojë e diferencave me situacionet të cilat paraqesin detyrime në lidhje me TVSH-në dhe tatim fitimin për tatimpaguesin në shumën totale 25,518,274 lekë.

-Në analizën e pasqyrave financiare, si pjesë e raportit të kontrollit mbi tatimin mbi fitimin konstatohet vlerë e lartë e aktiveve afatshkurtra në shumën 771 milion lekë, në rritje vit pas viti dhe argumentimi i kryer në lidhje me këtë llogari është i gabuar duke i paraqitur si detyrime ndaj të tretëve, ndërkohë që duhet të pasqyrohen të drejta për të arkëtuar ndaj të tretëve. Nga ana e inspektorit tatimor nuk rezultojnë të jenë analizuar këto të drejta mbi marrëdhëniet dhe thelbin ekonomik të transaksioneve që kanë sjellë lindjen e këtyre të drejtave duke qenë se përbëjnë një zë material të pasqyrave financiare.

- Në analizën e furnitorëve, si pjesë e detyrimeve drejt ndaj të tretëve janë përfshirë furnitorë me vlerë negative në shumën totale 44 milion lekë duke mos u analizuar nga inspektori për efekt të

pakësimin negativ të detyrimeve dhe lidhjen me blerjet e realizuara përgjatë periudhës së kontrolluar.

-Në analizën e blerjeve të tatueshme raportohet që të ketë blerje leasing, pa e specifikuar vlerën përkatëse, ndërkohë që në blerjet e përjashtuara nuk raportohen blerje leasing për vlerën e interesit e cila duhet të raportohet si blerje e përjashtuar, duke paraqitur mundësinë e kreditimit të TVSH-së për interesat e leasing të kryera nga tatimpaguesi, në kundërshtim me parashikimet e bëra udhëzimin për TVSH-në.

-Në raportin e kontrollit tatimor është kryer analiza për betonin e prodhuar nga tatimpaguesi për vitin 2017 dhe jo për vitet e tjera pavarësisht se në analizën e materialeve është shprehur për beton të blerë dhe prodhuar nga shoqëria. Në betonin e prodhuar në vitin 2017 konstatohen diferenca ndërmjet sasisë së prodhuar sipas analizës së prodhimit të betonit me sasinë e deklaruar të situacionuar, duke paraqitur për disa lloje vlerë më të lartë të prodhuar por të pasituacionuar. Në analizën e kryer mbi lëvizjen e bilancit material dhe sasive të prodhuara të betonit të përdorur në situacione, konstatohet se një analizë e tillë është kryer vetëm për vitin 2017, pavarësisht se hyrjet e betonit për vitet e tjera cilësohen si hyrje nga blerja dhe prodhimi. Për vitin 2017, konstatohen diferenca sipas analizës së bilancit material për sasinë e situacionuar dhe betonit të prodhuar nga vetë shoqëria të cilat përbëjnë shitje të pa deklaruar dhe implikojnë detyrime taitmore për TVSH dhe tatim fitimin në shumën 8,992,046 lekë.

***Efekt i financiar i shmangur nga ky kontroll tatimor me efekt të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit është në shumën 34,510,323 lekë.***

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 46-352 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**4.1 Rekomandimi:** Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj për tatimpaguesin “A” SHPK, referuar mangësive dhe parregullsive në procedurën e kontrollit, vlerësuar me efekte negative në të ardhurat tatimore, në përputhje me kërkesat ligjore dhe proceduriale, sipas përcaktimeve të nenit 85 “Ri kontrolli tatimor” të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të kryejë rikontroll tatimor me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit të evidentuara paraprakisht në vlerën prej **34,510,323 lekë.**

**Brenda vitit 2023**

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi kontrollin e ushtruar në tatimpaguesin “A” SHPK me Nipt L.T janë konstatuar mangësi të cilat përfshijnë:

- Nga auditimi është konstatuar se për lejen për objektin nr.4 në proces ndërtimi nga shoqëria, sipas lejes bashkëngjitur raport kontrollit, paraqesin shoqërinë jo si të vetme në rolin e investitorit (dy investitorë sipas lejes së ndërtimit) dhe si të vetëm në rolin e ndërtuesit, çka ndryshon edhe trajtimin fiskal për efekt të njohjes së situacioneve të ndërtimit si investitor dhe në shitjet e përjashtuara.

- Nga auditimi konstatohet se në raport kontrolli është kryer analiza e kostos mesatare të ndërtimit për efekt fiskal për objektet ndërtimore me shkallë përfundimi 100%, konkretisht sipas lejes së ndërtimit nr.1 dhe lejes së ndërtimit nr.2, duke u shprehur se janë respektuar kërkesat e legjislacionit në fuqi. Llogaritja e koston mesatare nga ana e inspektorit tatimor është kryer si raport i situacioneve progresive me sipërfaqen e ndërtimit të investitorit duke zbritur pjesën e sipërfaqes ndërtimore të pronarëve të truallit. Nga auditimi konstatohet se kjo përllogaritje është e gabuar pasi kosto e ndërtimit sipas situacioneve i atribuohet të gjithë sipërfaqes ndërtimore sipas lejes së përcaktuar të ndërtimit dhe nga llogaritjet e kryera nga audituesit rezulojnë koston mesatare më të ulëta, nën koston minimale fiskale të lejuara nga kuadri rregullator. Nga raporti i kontrollit dhe analiza e kryer nga grupi i audituesve të KLSH rezulton se subjekti i cili është në

rolin e ndërtuesit dhe sipërmarrësit të punimeve, në këtë rast ka kryer faturime të situacioneve të punimeve të kryera poshtë nivelit të kostove mesatare që janë përcaktuar në Udhëzimin e Këshillit të Ministrave Nr.3 “*Miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2016*”. Kjo është situata e “shitjes nën kosto”, konkretisht kjo situatë ku subjekti faturon nën kostot mesatare të miratuara ka sjellë ulje të pagesës së TVSH-së, si dhe ulje të tatimit mbi fitimin për veprime të cilat bien në kundërshtim me nenin 124 “*Kundërvajtjet në lëshimin e faturave tatimore, dëftesave tatimore dhe dokumentimin e transaksioneve*” të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “*Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar.

Ndërsa në lidhje me subjektin investitor nga ana e inspektorëve të kontrollit duhet të ishin kryer veprime rregulluese duke rivlerësuar transaksionet (*vlera e situacioneve të punimeve të ndërtimit në blerje*) drejt vlerës minimale të për efekte fiskale sipas përcaktimeve ligjore në fuqi në zbatim të shkronjës c të nenit 71 “*E drejta për të përdorur mënyra alternative vlerësimi*”, shkronjës ç dhe d të pikës 1 dhe të pikës 2 të nenit 71/2 “*Përdorimi i metodave alternative të vlerësimit në rastet e veprimeve për shmangien e tatimit dhe abuzimit me parimet e ligjit tatimor*” dhe shkronjës ç të pikës 1 të nenit 72 “*Baza e mënyrave alternative të vlerësimit*” të Ligjit Nr.9920, datë 19.5.2008 “*Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar.

Në këtë rast do të bëhet rikarakterizimi i shpenzimeve shtesë të cilat rezultojnë nga përlllogaritjet e grupit të auditimit por nuk do t’i njihen subjektit si shpenzime të zbritshme të cilat do të ishin nqs do të ishin deklaruar korrekt nga subjekti. Pra nga grupi i auditimit është kryer rikarakterizimi i shpenzimeve dhe investimeve, *diferenca midis vlerës së faturuar të situacioneve deri tek niveli i kostove minimale fiskale të ndërtimit*, të pa njohur dhe regjistruara nga subjekti si të ardhura dhe ndryshimi në deklaratën e tatim fitimit do të bëhet në rritje të të ardhurave dhe të shpenzimeve, por shpenzimet nuk njihen si të zbritshme për efekt të tatim fitimit.

Kurse penalizimi i subjektit nga ana e inspektorëve duhet të ishte kryer sipas nenit 115 “*Plotësim i pasaktë i deklaratës tatimore*” të Ligjit Nr.9920, datë 19.5.2008 “*Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: 1. *Dorëzimi i një deklarate tatimore të pasaktë dënohet me një gjobë të barabartë me 0,06 për qind të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë, gjatë së cilës pagesa nuk është kryer. Në asnjë rast, gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike. Efekti financiar i mosrespektimit të kostos minimale fiskale në ndërtim vlerësohet 46,563,960 lekë.*

-Nga auditimi konstatohet se janë përfshirë në blerje të tatueshme brenda vendit për të cilën është kredituar TVSH blerje në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 20 të udhëzimit nr.6 datë 30.01.2015 “*Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar, pasi janë kryer nga tatimpaguesi për aktivitetin e shijes së ndërtesave i cili është një furnizim i përjashtuar dhe jo në rolin e ndërtuesit që përfshin pjesën e aktivitetit të tatueshëm të tatimpaguesit. Rrjedhimisht, TVSH-ja në shumën 5,830,209 lekë është kredituar padrejtësisht nga tatimpaguesi ku rrjedhin detyrime për vlerën e tatimit të munguar si dhe gjobë për kreditim të gabuar në nivelin 21.6% të detyrimit në shumën 1,259,325 lekë, në total 7,089,534 lekë.

- Nga auditimi konstatohet se sipas pasqyrave financiare, financimi i aktivitetit të ndërtimit është kryer nëpërmjet llogarisë së arkëtimeve në avancë. Kjo llogari nuk rezulton të jetë analizuar nga ana e inspektorit tatimor në kushtet kur sipas pasqyrave financiare kompania rezulton të jetë themeluar me kapital minimal prej 100 lekë dhe nga ana tjetër ka akumuluar deri në fund të vitit 2020 aktive nga ndërtimi për shitje në vlerën 1,797,606,135 lekë. Gjithashtu, në raportin e kontrollit të hartuar nga ana e inspektorit tatimor konstatohet se këto parapagime nuk janë raportuar në deklaratat e TVSH-së të dorëzuar nga ana e tatimpaguesit për periudhën 2018-2020,

në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 20 të udhëzimit nr.6 datë 30.01.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Shitjet e përjashtuara reuzlojnë të jenë analizuar vetëm për vitin 2021 në faqen 32-33 të raport kontrollit dhe rezultoni të jenë analizuar 31 milion lekë paradhënie dhe 130 milion lekë të raportuara si shitje në bazë të kontratave noteriale përkatëse.

Nga auditimi konstatohet se në shitjet e analizuar për vitin 2021, në analizën e kryer nga inspektori tatimor nuk është respektuar kufiri minimal i cmimit të shitjes sipas zonës në të cilën ndodhet objekti në bazë të kriterëve të përcaktuara në *Udhëzimin e Këshillit të Ministrave Nr.3 “Miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2016”*. Si rezultat i shitjes nën çmimin minimal të lejuar për efekte fiskale lindin detyrimet e për nënvlerësim të të ardhurave të përjashtuara në vlerën 15% të tatimit fitimit të munguar ( $15\% * 12,023,908.84$ ) në shumën 1,803,586 lekë dhe gjobë në masën 100% 1,803,586 lekë për të ardhura të padeklaruara.

- Nga auditimi konstatohet se pagesat për lejet e ndërtimit sipas analizës së shtesës së llogarisë aktive afatgjata të mbajtura për shitje janë akumuluar për herë të parë në vitin 2019, ndërkohë që procesi i ndërtimit ka filluar me situacionime në vitin 2018. Këto fakte në lëvizjen e llogarive tregojnë mundësinë e kreditimit të TVSH-së për situacionet përpara miratimit të lejes së ndërtimit sipas lejeve nr.1 dhe nr.2 të ndërtimit të cituara në raportin e kontrollit ose zbardhjes së dokumentit të lejes së ndërtimit përpara pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë nga tatimpaguesi. Nga ana e inspektorit tatimor nuk rezultoi të jenë analizuar këto fakte për të arritur në konkluzione mbi të drejtën e kreditimit të TVSH-së për punimet përpara lindjes së të drejtës për të ndërtuar sipas aktit përkatës dhe përmbushjes së detyrimeve në lidhje me pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë.

***Efekt i financiar i shmangur me efekt të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit është në shumën 57,260,666 lekë.***

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 46-352 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**5.1 Rekomandimi:** Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj për tatimpaguesin “A” SHPK, referuar mangësive dhe parregullsive në procedurën e kontrollit, vlerësuar me efekte negative në të ardhurat tatimore, në përputhje me kërkesat ligjore dhe proceduriale, sipas përcaktimeve të nenit 85 “Ri kontrolli tatimor” të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të kryejë rikontroll tatimor me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit të evidentuara paraprakisht në vlerën prej **57,260,666 lekë.**

**Brenda vitit 2023**

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi kontrollin e ushtruar në tatimpaguesin “B” SHA me NIPT J.C janë konstatuar mangësi të cilat përfshijnë:

-Nga auditimi konstatohet se në raportin kontrolli është kryer analiza e bilancit material për lëvizjet e mallrave por nuk është kryer një analizë në lidhje me aktivitetin e prodhimit sipas kartës teknologjike të miratuar. Kjo analizë e munguar nuk dokumenton sasinë e përdorur të lëndës së parë për prodhim si dhe të produktit të gatshëm të pasqyruar në lëvizjet e bilancit material në të njëjtën kohë me shqyrtimin e humbjeve/firove të mundshme nga procesi i prodhimit.

-Nga auditimi konstatohet se në analizën e klientëve të shoqërisë sipas pasqyrave financiare paraqiten si klientët për mallra e shërbime të pa arkëtuara në fund të vitit, subjekti C.B në shumën 49,530,300 lekë, ndërkohë që referuar objektit të veprimtarisë të kësaj banke të nivelit të dytë, nuk është argumentuar nga ana e inspektorit tatimor thelbi ekonomik i marrëdhënies së krijuar midis tyre referuar objekte të veprimtarisë së secilit tatimpagues.

- Nga analiza e pasqyrave financiare, konstatohet se për vitin 2019, nga ana e tatimpaguesit nuk është llogaritur amortizim për pjesën më të madhe të asetëve, e cila nuk rezulton të jetë analizuar nga ana e inspektorit tatimor në kushtet kur tatimpaguesi ka ushtruar aktivitetet përgjatë të gjithë periudhës objekt kontrolli dhe ka rezultuar me humbje të pa analizuar në mënyrë të detajuar.

-Nga auditimi konstatohet se nga analiza e bilancit material për vitet 2019 dhe 2020 të paraqitur në raportin e kontrollit tatimor, për disa artikuj rezultojnë diferenca për produktet ambalazhe dhe miell në krahasim me inventarin analitik të dorëzuar nga tatimpaguesi në sistemin C@ts. Për sa më sipër, diferenca në vlerë përbën shitje të pa deklaruar si pasojë e diferencave në inventar për të cilën llogariten **detyrime për TVSH-në dhe tatimin mbi fitimin në shumën 1,804,167 lekë si efekt financiar i shmangur me efekt të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit.**

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 46-352 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**6.1 Rekomandimi:** Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj për tatimpaguesin “B” SHA, referuar mangësive dhe parregullsive në procedurën e kontrollit, vlerësuar me efekte negative në të ardhurat tatimore, në përputhje me kërkesat ligjore dhe proceduriale, sipas përcaktimeve të nenit 85 “Ri kontrolli tatimor” të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të kryejë rikontroll tatimor me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit të evidentuara paraprakisht në vlerën prej **1,804,167 lekë.**

**Brenda vitit 2023**

**7. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi kontrollin e ushtruar në tatimpaguesin “F.KC.F ” SHPK me Nipt K.1 janë konstatuar mangësi të cilat përfshijnë:

-Nga auditimi i raportit të kontrollit konstatohet se nga ana e inspektorit tatimor është kryer një analizë në lidhje me marzhin e realizuar nga shitja e artikullit kryesor të aktivitetit të shoqërisë që është cimentoja duke u ndërtuar edhe bilanci material, lëvizjet e tij si dhe është kryer përlllogaritja për prodhimin e cimentos. Gjatë periudhës objekt kontrolli shoqëria ka realizuar edhe operacionet e blerjes dhe shitjes së apartamenteve, për të cilat nga ana e inspektorit tatimor nuk është kryer një analizë në lidhje me bilancin material të tyre. Nga ndërtimi i bilancit material në bazë të të dhënave të paraqitura në raport kontrolli dhe pasqyrat financiare të deklaruara në C@ts për apartamentet konstatohen diferencat për periudhën objekt kontrolli. Për vitet në të cilat konstatohen diferenca në vlera negative konsiderohen si **shitje e padeklaruar si pasojë e diferencave në inventar për të cilat llogariten detyrimet për tatimin mbi fitimin në shumën 33,225,144 lekë.**

- Gjithashtu konstatohet se nga ana e tatimpaguesit në vitin 2018 është kryer riklasifikimi sipas pasqyrave financiare ku apartamente në vlerë 663,214,589 lekë, nga llogaria e aktive të mbajtura për investim kanë kaluar në inventarë të tatimpaguesit. Sipas llogarisë së lëndëve të para të analizuar në raport kontrolli konstatohet se e gjithë kjo vlerë ka kaluar në shpenzime të periudhës për vitin 2018 duke mos u analizuar nga ana e inspektorit tatimor dhe ky trajtim nuk ka rezultuar i njëjtë në vitet financiarë 2019 dhe 2020.

Në të njëjtën kohë, riklasifikim ka pësuar edhe llogaria e paradhënieve për aparatamente e cila ka kaluar në llogarinë e inventarëve dhe jo në llogarinë e parapagimeve pasi shoqëria nuk i ka në formë fizike të zotërueshme sipas klasifikimit dhe një gjë e tillë nuk rezulton të jetë analizuar në raport kontrolli nga ana e inspektorit tatimor.

-Nga auditimi konstatohet se nga ana e inspektorit tatimor është kryer analiza e shpenzimeve të pazbritshme të deklaruara vetëm për vitin 2017, duke mos u analizuar vitet 2018-2020 me efekt në mos marrjen siguri në lidhje me fitimin e tatueshëm fiskal për vitet 2018-2020.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 46-352 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**7.1 Rekomandimi:** Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj për tatimpaguesin “F.K.C.F” SHPK, referuar mangësive dhe parregullsive në procedurën e kontrollit, vlerësuar me efekte negative në të ardhurat tatimore, në përputhje me kërkesat ligjore dhe proceduriale, sipas përcaktimeve të nenit 85 “Ri kontrolli tatimor” të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të kryejë rikontroll tatimor me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit të evidentuara paraprakisht në vlerën prej **33,225,144 lekë**.

**Brenda vitit 2023**

**8. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i raportit të kontrollit tatimor të subjektit “M.I” SHPK me Nipt J.H, u konstatua se nga ana e inspektoreve të kontrollit nuk është vepruar në përputhje me përcaktimet e dispozitave ligjore, konkretisht problematikat si në vijim:

1. Nga auditimi i raport kontrollit tatimor dhe akt verifikimit të mbajtur për subjektin “M.I” SHPK, nga ana e inspektorit dhe inxhinierit pranë DTM, janë konstatuar mungesa e analizave dhe vlerësimeve të projektit dhe preventivit të punimeve, nuk është kryer një zberthim i materialeve dhe lëndës së parë në përbërje të punimeve të situacionuar, bazuar në manualin nr.1 “Analiza Teknike-Për prodhimin e materialeve të ndërtimit, udhëzime dhe kriteret” dhe manualin nr.2 “Analiza Teknike-Për punimet e ndërtimit të ndërtesave”, si dhe krahasimi me punimet e kryera realisht në terren. Gjithashtu janë konstatuar mungesa e analizave të librezës së masave, situacioneve pjesore mujore, progresive dhe përfundimtare të volumit të punimeve të ndërtimit, të cilat janë dokumente justifikuese për verifikimin e volumit të punimeve të kryera sipas përcaktimeve të nënpikave 3.2 dhe 3.3 të pikës 3, Kreu 1 të Udhëzimit Nr.3, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, ndryshuar me Udhëzimin Nr.1 datë, 16.06.2011.

2. Nga grupi i auditimit është kryer analiza e kostove të ndërtimit të objekteve dhe ka rezultuar se subjekti “M.I” SHPK, është në rolin e sipërmarrësit dhe investitorit, pra në këtë rast ka kryer faturime të situacioneve të punimeve të kryera poshtë nivelit të kostove mesatare që janë përcaktuar në Udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr.3 “Miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2016”. Duhet të ishin rivlerësuar transaksionet, duke çuar vlerën e situacioneve të punimeve të ndërtimit në blerje drejt vlerës minimale të ndërtimit për efekte fiskale, për diferencat si më poshtë:

<p>- Objekti Kompleks banimi dhe shërbimesh 1, 4, 6 dhe 8 kate me 1 dhe 2 kate parkim nëntokë në Rr. Nexho Konomi, Tiranë: 153,558,717 lekë; diferenca vlerë faturimi – kosto minimale fiskale ndërtimi (2,063 lekë/m<sup>2</sup>) x sipërfaqe ndërtimit (80,888.15 m<sup>2</sup>).</p>
---

Në sensin ekonomik të situatës jemi në kushtet e situatës së “shitjes nën kosto”, sepse në raportin e kontrollit nuk kemi justifikimin e këtyre transaksioneve nën koston mesatare të ndërtimit, me element të tillë si specializimin, integrimin horizontal ose vertikal apo ekonomitë e shkallës të subjektit. Në këtë rast do të bëhet rikarakterizimi i shpenzimeve shtesë të cilat rezultojnë nga përlllogaritjet e grupit të auditimit por nuk do t’i njihen subjektit si shpenzime të zbritshme për efekt të llogaritjes së tatimit mbi fitimin si dhe nuk do të lejohet kreditimi i TVSH-së në blerje, të cilat do të ishin të tilla nëse do të ishin deklaruar korrekt nga subjekti, por duke marrë në konsideratë faktin se këto parregullsi po evidentohen nga grupi i audituesve do të kalojnë si shpenzime të panjohura duke kaluar e gjithë e ardhura si fitim. Pra nga grupi i auditimit është kryer rikarakterizimi i shpenzimeve dhe investimeve, diferenca midis vlerës së faturuar të situacioneve deri tek niveli i kostove minimale fiskale të ndërtimit, të panjohur dhe paregjistruara nga subjekti si të ardhura dhe ndryshimi në deklaratën e tatim fitimit do të bëhet në rritje të të

ardhurave dhe të shpenzimeve, por shpenzimet nuk njihen si të zbritshme për efekt të tatimit, kjo do të ishte e mundur kur vete subjekti do të deklaronte këto shpenzime, jo kur kjo bëhen nga inspektori ose nga rekomandimi i grupit të audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit, pra kjo do të thotë se rritja në të ardhura do të kalojë e gjitha si fitim, si dhe duke kryer penalizimin e subjektit sipas përcaktimeve të nenit 124 “Kundërvajtjet në lëshimin e faturave tatimore, dëftesave tatimore dhe dokumentimin e transaksioneve” e Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, duke sjellë si pasojë efekte tatimore të pallogaritura në shumën 23,033,808 lekë detyrime të tatimit mbi fitimin dhe 23,033,808 lekë gjobë 100%, 30,711,743 lekë detyrime të TVSH-së dhe 30,711,743 lekë gjobë 100%, pra të ardhura gjithsej të munguar për buxhetin e shtetit në vlerën prej 107,491,102 lekë.

3. Nga analiza e librit të blerjeve dhe pasqyrës të të ardhurave dhe shpenzimeve janë konstatuar se janë njohur si shpenzime, dy fatura, në vlerë totale 10,519,104 lekë nga shoqëria “T.E” SHPK, të cilat kanë përshkrimin “kamatëvonesa”, veprime të cilat janë në kundërshtim me përcaktimet e pikës f) të nenit 21 “Shpenzime të panjohura”, të Ligjit Nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar. Nga ana e grupit të auditimit, është kryer rregullimi i shpenzimeve në PASH, duke i kaluar kamatëvonesat si shpenzime të panjohura për efekt të llogaritjes së tatimit si dhe duke kryer penalizimin e subjektit sipas përcaktimeve të nenit 115 “Plotësim i pasaktë i deklaratës tatimore” të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar, duke sjellë si pasojë efekte tatimore të pallogaritura në shumën 1,577,866 lekë detyrime të tatimit mbi fitimin dhe 345,553 lekë gjobë 21.9%, për periudhën, pra të ardhura gjithsej të munguar për buxhetin e shtetit në vlerën prej 1,923,418 lekë.

4. Nga grupi i auditimit, u kontrolluan çmimet e shitjes së të njëjve ndërtimore apartamente, dyqane, parkim etj, tek objekti “Godine banimi e shërbimesh 5, 6 dhe 7 kate me 3 kate parkimi nëntokë ne Rrugën "Kajo Karafili", Tiranë dhe rezultuan shitje nën çmimin fiskal minimal të zonë 10/1, të përcaktuar në Aneksin Nr.1 dhe Nr.2 të VKM Nr.168, datë 27.3.2019. Gjithashtu nga auditimi i akt konstatimit e mbajtur nga inxhinieria, në përlllogaritjet e sipërfaqeve të shitura me çmimin e referencës së zonës, janë kryer llogaritje të gabuara sepse nuk janë marrë në analizë pjesët e përbashkëta të cilat janë të shitshme dhe i faturohen klientëve. Në këtë mënyrë është ulur padrejtësisht vlera e të ardhurave, nga grupi i auditimit po paraqiten përlllogaritjet si më poshtë:

#### **Njësi Banimi**

TR kontratat shoqërisë (Sip neto për shitje = 5,572 m<sup>2</sup>) = 770,451,250 lekë  
TR deklaruar [Çmim Ref x Sip Tot (Sip shitje + Sip për)] = 943,022,000 lekë  
**Diferenca për rivlerësim = 172,570,750 lekë**

#### **Njësi Shërbimi**

TR kontratat shoqërisë (Sip neto për shitje = 716.5 m<sup>2</sup>) = 124,656,850 lekë  
TR deklaruar [Çmim Ref x Sip Tot (Sip shitje + Sip për)] = 243,571,000 lekë  
**Diferenca për rivlerësim = 118,914,150 lekë**

Nga analiza e mësipërme në total nga mosdeklarimi në shitje i sipërfaqeve të përbashkëta dhe i shitjes nën çmimin minimal fiskal të përcaktuar në VKM Nr.168, datë 27.3.2019, rezultuan 291,484,900 lekë, ku nga grupi i auditimit është rivlerësuar situata financiare e shoqërisë duke rritur të ardhurat dhe penalizimin sipas përcaktimeve të nenit 128 “Lëshimi i faturës së pasaktë”, të Ligjit Nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar, duke sjellë si pasojë efekte tatimore të pallogaritura në shumën 43,722,735 lekë detyrime të tatimit mbi fitimin dhe 21,861,368 lekë gjobë 50%, 58,296,980 lekë detyrime të TVSH-së dhe 29,148,490 lekë



gjobë 50%, detyrime të tatimit mbi dividendin 19,820,973 lekë dhe 9,910,487 lekë gjobë 50%, pra të ardhura gjithsej të munguar për buxhetin e shtetit në vlerën prej 182,761,032 lekë.

5. Nga analiza e gjendjes së magazinës më 31.12.2018 dhe 31.12.2019 dhe lëvizjeve për produktin “Lëndë e parë/prodhim inerte”, ka rezultuar se ka faturuar si shitje shoqërisë “X.T” SHPK, me kosto duke mos aplikuar marzhe fitimi në shitje. E njëjta situatë paraqitet edhe për produktin “çimento”, për të cilën janë kryer transaksionet e shitjes dhe blerjes, me vlerë të tatueshme 22,150,383 lekë, pa aplikuar marzhe fitimi në shitje. Nga grupi i auditimit është kryer vlerësimi alternativ i situatës financiare të tatimpaguesit, duke rivlerësuar transaksionin dhe aplikuar marzhe fitimi (7% sa fitimi i vitit 2019, deklaruar në bilanc), duke qenë se plotësohen kushtet sipas përcaktimeve të pikave b) dhe d) të nenit 71/2 “Përdorimi i metodave alternative të vlerësimit në rastet e veprimeve për shmangien e tatimit dhe abuzimit me parimet e ligjit tatimor”, pikën a) të nenit 72 “Baza e mënyrave alternative të vlerësimit”, i Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar dhe penalizimin sipas përcaktimeve të nenit 115 “Plotësim i pasaktë i deklaratës tatimore” të Ligjit Nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar, duke sjellë si pasojë efekte tatimore të pallogaritura në shumën 232,579 lekë detyrime të tatimit mbi fitimin dhe 50,935 lekë gjobë 21.9%, 310,105 lekë detyrime të TVSH-së dhe 67,913 lekë gjobë 21.9%, detyrime të tatimit mbi dividendin 105,436 lekë dhe 23,090 lekë gjobë 21.9%, pra të ardhura gjithsej të munguar për buxhetin e shtetit në vlerën prej 790,059 lekë.

6. Nga auditimi i raportit të kontrollit kanë rezultuar mangësi proceduriale në trajtimin e pikave të programit të kontrollit tatimor, veprime këto në kundërshtim me përcaktimet e Kapitullit VII “Kryerja e kontrollit tatimor” të Manualit të Kontrollit Tatimor, konkretisht:

- Nuk është kryer një analizë e plotë e postit të “Arkëtimeve në avancë”;
- Nuk është kryer një analizë e plotë e transaksioneve dhe marrëdhënieve të kleringut;
- Nuk është kryer një analizë e plotë transaksioneve me palët e lidhura.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 46-352 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**8.1 Rekomandimi:** Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj për tatimpaguesin “M. I.” SHPK, referuar mangësive dhe parregullsive në procedurën e kontrollit, vlerësuar me efekte negative në të ardhurat tatimore, në përputhje me kërkesat ligjore dhe proceduriale, sipas përcaktimeve të nenit 85 “Ri kontrolli tatimor” të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të kryejë rikontroll tatimor me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit të evidentuara paraprakisht në vlerën prej **292,965,611 lekë.**

**Brenda vitit 2023**

**9. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i raporteve të kontrollit tatimor të subjektit “E” SHPK, me nipt K.I u konstatua se nga ana e inspektoreve të kontrollit nuk është vepruar në përputhje me përcaktimet e dispozitave ligjore, konkretisht në drejtim të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore sipas pikës së programit të kontrollit, kanë rezultuar problematikat si më poshtë:

1. Nisur nga natyra e aktivitetit të tregtisë kryesisht me pakicë që zhvillon shoqëria si dhe duke kontrolluar në faqen online të shoqërisë rezulton se aktiviteti zhvillohet çdo ditë e hënë - e diel në orare të përcaktuara 07:30-22:30, të cilat në total përbëjnë 15 orë punë në ditë, pra dy turne. Kurse nga kontrolli i listëpagesave të deklaruara nga subjekti në sistemin C@ts për periudhën 11/2019-10/2021, ka deklaruar për punonjësit 22 ditë punë në muaj. Nga llogaritjet e grupit të auditimit rezulton se punonjësit punojnë më shumë se 22 ditë punë në muaj, nga rezulton se punohet edhe të ditë të shtune dhe të diele, ku sipas përcaktimeve të neni 87 të Kodit të Punës

duhet që pagesa orare të jetë minimalisht 25% më e lartë se pagesa minimale orare, gjithashtu punohet edhe në turn të dytë në fashën orare 19:30-22:30, për të cilën paga orare duhet të jetë 20% më e lartë se pagesa minimale orare sipas përcaktimeve të neni 81 të Kodit të Punës.

- Nga ana e inspektorit të kontrollit tatimor nuk janë analizuar kontratat individuale të punës midis shoqërisë dhe punonjësve, në lidhje me përputhshmërinë e tyre me përcaktimet e dispozitave të Kodit të Punës në R.SH.

- Nuk janë analizuar regjistrat që duhet të mbajë tatimpaguesi sipas përcaktimeve të nenit 15 “Mbajtja e regjistrimeve” të Ligjit Nr.9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

- Nuk ka një analizë të llogaritjes së pagës dhe elementëve përbërës të saj sipas përcaktimeve të dispozitave të nenit 119 të Kreut XI të Kodit të Punës në R.SH.

Në lidhje me situatën e trajtuar më sipër grupi i audituesve gjykon se janë arsye themelore për të kryer rivlerësimin e pagave, kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi, për punonjësit me paga të deklaruara jo konform përcaktimeve të legjislacionit, në lidhje me këtë tatimpagues i cili ka plotësuar deklarata tatimore që përmbajnë të dhëna të pasakta ose të falsifikuara dhe nuk mban dhe ruan llogari apo regjistrime të sakta të transaksioneve, veprime të cilat janë në kundërshtim me gërmën b, c të nenit 71, gërma a e nenit 72 të Ligjit Nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar dhe penalizimin sipas përcaktimeve të nenit 119 “Mosdeklarimi i punonjësve dhe fshehja e pagës”, të Ligjit Nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar, duke sjellë si pasojë efekte tatimore të pallogaritura në shumën 1,043,475 lekë detyrime të Sig Shoq Punëdhënësi dhe 1,043,475 lekë gjobë 100%, 660,867 lekë detyrime të Sig Shoq Punëmarrësi dhe 660,867 lekë gjobë 100%, 118,261 lekë detyrime Sig Shënd Punëdhënësi dhe 118,261 lekë gjobë 100%, 118,261 lekë detyrime Sig Shënd Punëmarrësi dhe 118,261 lekë gjobë 100%, 547,831 lekë detyrime TAP dhe 547,831 lekë gjobë 100%, pra të ardhura gjithsej të munguar për buxhetin e shtetit në vlerën prej 4,977,388 lekë.

2. Në lidhje me pagat e padeklaruara saktë nga ana e subjektit, është kryer rivlerësimi i situatës financiare, ku shpenzimi i fondit të pagave të rivlerësuara është rikarakterizuar si e ardhura dhe është kryer penalizimi i subjektit sipas përcaktimeve të nenit 115 “Plotësim i pasaktë i deklaratës tatimore”, të Ligjit Nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar, duke sjellë si pasojë efekte tatimore të pallogaritura në shumën 1,018,692 lekë detyrime të tatimit mbi fitimin dhe 223,093 lekë gjobë 21.9%, 1,358,255 lekë detyrime të TVSH-së dhe 297,458 lekë gjobë 21.9%, detyrime të tatimit mbi dividentin 461,807 lekë dhe 101,136 lekë gjobë 21.9%, pra të ardhura gjithsej të munguar për buxhetin e shtetit në vlerën prej 3,460,441 lekë.

3. Nga kontrolli i blerjeve për periudhën objekt kontrolli, ka rezultuar se shoqëria ka bërë blerje karburanti me vlerë të tatueshme prej 4,997,923 lekë për të cilën ka kredituar edhe TVSH në blerje në vlerën 999,584 lekë. Në raportin e kontrollit tatimor nga ana e inspektores nuk është kryer një analizë e detajuar e shfrytëzimit të mjeteve të transportit, rrugët e realizuara, normativat e konsumit për rrugë, proces pune ose volum punimesh etj, veprime këto në kundërshtim me përcaktimet e nenit 55 “Kufizime të zbritjes së TVSH për disa furnizime” të Udhëzimit Nr.6, datë 30.01.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në R.SH”. Nga kontrolli i inventarit të makinave, të paraqitura në anekse të bilanceve të viteve 2019-2021, ka rezultuar se shoqëria ka në pronësi, 8 automjete, nga të cilat 5 janë autovetura. Në kushtet e mungesës së të dhënave dhe regjistrimeve mbi konsumin dhe harxhimin e karburantit nga ana e autoveturave dhe mjeteve të punës, do të supozohet se kanë konsum të barabartë të çdo mjeti. Pra për 5 autoveturat e

shoqërisë, për të cilat inspektori i kontrollit duhet të kishte kryer verifikimet n.q.s. janë furnizuar me karburant nga shoqëria për të cilin është bërë kreditimi i TVSH në blerje, veprime këto të cilat janë në kundërshtim me përcaktimet ligjore të nenit 74 “Kufizimet e së drejtës së zbritjes” të Ligjit Nr.92/2014 “Për TVSH-në, në Republikën e Shqipërisë”, nga grupi i auditimit është kryer rregullimi i TVSH-së, së kredituar të karburantit të përdorur nga autoveturat dhe kryer penalizimi i subjektit sipas përcaktimeve të nenit 115 “Plotësim i pasaktë i deklaratës tatimore” të Ligjit Nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, duke sjellë si pasojë efekte tatimore të pallogaritura në shumën 624,740 lekë ulje e tepicës kreditore të TVSH-së dhe 136,818 lekë gjobë, pra të ardhura gjithsej të munguar për buxhetin e shtetit në vlerën prej 761,558 lekë.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 46-352 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**9.1 Rekomandimi:** Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj për tatimpaguesin “E” SHPK, referuar mangësive dhe parregullsive në procedurën e kontrollit, vlerësuar me efekte negative në të ardhurat tatimore, në përputhje me kërkesat ligjore dhe proceduriale, sipas përcaktimeve të nenit 85 “Ri kontrolli tatimor” të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të kryejë rikontroll tatimor me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit të evidentuara paraprakisht në vlerën prej **9,199,387 lekë**.

**Brenda vitit 2023**

**10. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i raporteve të kontrollit tatimor të subjektit “A.K” SHPK me nipt J.C, u konstatua se nga ana e inspektoreve të kontrollit nuk është vepruar në përputhje me përcaktimet e dispozitave ligjore, konkretisht problematikat si në vijim:

1. Nga auditimi i raport kontrollit tatimor dhe akt verifikimit të mbajtur për subjektin “A.K” SHPK, nga ana e inspektorit dhe inxhinierit pranë DTM, janë konstatuar mungesa e analizave dhe vlerësimeve të projektit dhe preventivit të punimeve, nuk është kryer një zberthim i materialeve dhe lëndës së parë në përbërje të punimeve të situacionuar, bazuar në manualin nr.1 “Analiza Teknike-Për prodhimin e materialeve të ndërtimit, udhëzime dhe kriteret” dhe manualin nr.2 “Analiza Teknike-Për punimet e ndërtimit të ndërtesave”, si dhe krahasimi me punimet e kryera realisht në terren. Gjithashtu janë konstatuar mungesa e analizave të librezës së masave, situacioneve pjesore mujore, progresive dhe përfundimtare të volumit të punimeve të ndërtimit, të cilat janë dokumente justifikuese për verifikimin e volumit të punimeve të kryera sipas përcaktimeve të nënpikave 3.2 dhe 3.3 të pikës 3, Kreu 1 të Udhëzimit Nr.3, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, ndryshuar me Udhëzimin Nr.1 datë, 16.06.2011.

2. Nga grupi i auditimit është kryer analiza e kostove të ndërtimit të objekteve dhe ka rezultuar se subjekti “A.K” SHPK, është në rolin e sipërmarrësit/ndërtuesit, pra në këtë rast ka kryer faturime të situacioneve të punimeve të kryera poshtë nivelit të kostove mesatare që janë përcaktuar në Udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr.3 “Miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2016”. Nga auditimi konstatohet se duhet të ishin rivlerësuar transaksionet, duke çuar vlerën e situacioneve të punimeve të ndërtimit në blerje drejt vlerës minimale të ndërtimit për efekte fiskale, për diferencat si më poshtë:

- Godinë banimi 9 kate me 1 kat nëntokësorë Rruga "Aleksandër Moisiu", Tiranë: 23,006,501 lekë; diferenca vlerë faturimi – kosto minimale fiskale ndërtimi (1,491 lekë/m <sup>2</sup> ) x sipërfaqe ndërtimit (15,433.93 m <sup>2</sup> ).
--

Në sensin ekonomik të situatës jemi në kushtet e situatës së “shitjes nën kosto”, sepse në raportin e kontrollit nuk kemi justifikimin e këtyre transaksioneve nën koston mesatare të ndërtimit, me element të tillë si specializimin, integrimin horizontal ose vertikal apo ekonomitë e shkallës të subjektit. Në këtë rast do të bëhet rikarakterizimi i shpenzimeve shtesë të cilat rezultojnë nga përlogaritjet e grupit të auditimit por nuk do t’i njihen subjektit si shpenzime të zbritshme për efekt të llogaritjes së tatimit mbi fitimin si dhe nuk do të lejohet kreditimi i TVSH-së në blerje, të cilat do të ishin n.q.s. do të ishin deklaruar korrekt nga subjekti, por mqs këto parregullsi po evidentohen nga grupi i audituesve do të kalojnë si shpenzime të panjohura duke kaluar e gjithë e ardhura si fitim. Pra nga grupi i auditimit është kryer rikarakterizimi i shpenzimeve dhe investimeve, diferenca midis vlerës së faturuar të situacioneve deri tek niveli i kostove minimale fiskale të ndërtimit, të panjohur dhe paregjistruara nga subjekti si të ardhura dhe ndryshimi në deklaratën e tatim fitimit do të bëhet në rritje të të ardhurave dhe të shpenzimeve, por shpenzimet nuk njihen si të zbritshme për efekt të tatim fitimit, kjo do të ishte e mundur kur vete subjekti do të deklaronte këto shpenzime, jo kur kjo bëhen nga inspektori ose nga rekomandimi i grupit të audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit, pra kjo do të thotë se rritja në të ardhura do të kalojë e gjitha si fitim, si dhe duke kryer penalizimin e subjektit sipas përcaktimeve të nenit 124 “Kundërvajtjet në lëshimin e faturave tatimore, dëftesave tatimore dhe dokumentimin e transaksioneve” e Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, duke sjellë si pasojë efekte tatimore të pallogaritura në shumën 3,450,975 lekë detyrime të tatimit mbi fitimin dhe 3,450,975 lekë gjobë 100%, 4,601,300 lekë detyrime të TVSH-së dhe 4,601,300 lekë gjobë 100%, pra të ardhura gjithsej të munguar për buxhetin e shtetit në vlerën prej 16,104,551 lekë.

3. Nga kontrolli i blerjeve për periudhën objekt kontrolli, ka rezultuar se shoqëria ka bërë blerje karburanti me vlerë të tatueshme prej 1,839,162 lekë për të cilën ka kredituar edhe TVSH në blerje në vlerën 367,834 lekë. Në raportin e kontrollit tatimor nga ana e inspektores nuk është kryer një analizë e detajuar e shfrytëzimit të mjeteve të transportit, rrugët e realizuara, normativat e konsumit për rrugë, proces pune ose volum punimesh etj, veprime këto në kundërshtim me përcaktimet e nenit 55 “Kufizime të zbritjes së TVSH për disa furnizime” të Udhëzimit Nr.6, datë 30.01.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në R.SH”. Nga kontrolli i inventarit të makinave, të paraqitura në anekse të bilanceve të viteve 2019-2021, ka rezultuar se shoqëria ka në pronësi, 3 automjete, nga të cilat 2 janë autovetura. Në kushtet e mungesës së të dhënave dhe regjistrimeve mbi konsumin dhe harxhimin e karburantit nga ana e autoveturave dhe mjeteve të punës, do të supozohet se kanë konsum të barabartë të çdo mjeti. Pra për 2 autoveturat e shoqërisë, për të cilat inspektori i kontrollit duhet të kishte kryer verifikimet n.q.s. janë furnizuar me karburant nga shoqëria për të cilin është bërë kreditimi i TVSH në blerje, veprime këto të cilat janë në kundërshtim me përcaktimet ligjore të nenit 74 “Kufizimet e së drejtës së zbritjes” të Ligjit Nr.92/2014 “Për TVSH-në, në Republikën e Shqipërisë”. Nga grupi i auditimit është kryer rregullimi i TVSH-së, së kredituar të karburantit të përdorur nga autoveturat dhe kryer penalizimi i subjektit sipas përcaktimeve të nenit 115 “Plotësim i pasaktë i deklaratës tatimore” të Ligjit Nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, duke sjellë si pasojë efekte tatimore të pallogaritura në shumën 245,223 lekë ulje e tepriçës kreditore të TVSH-së dhe 53,703 lekë gjobë, pra të ardhura gjithsej të munguar për buxhetin e shtetit në vlerën prej 298,927 lekë.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 46-352 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**10.1 Rekomandimi:** Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj për tatimpaguesin “A.K” SHPK, referuar mangësive dhe parregullsive në procedurën e kontrollit, vlerësuar me efekte negative në

të ardhurat tatimore, në përputhje me kërkesat ligjore dhe proceduriale, sipas përcaktimeve të nenit 85 “Ri kontrolli tatimor” të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të kryejë rikontroll tatimor me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit të evidentuara paraprakisht në vlerën prej **16,403,478 lekë**.

**Brenda vitit 2023**

**11. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i raporteve të kontrollit tatimor të subjektit “N.C” SHPK, u konstatua se nga ana e inspektoreve të kontrollit nuk është vepruar në përputhje me përcaktimet e dispozitave ligjore, konkretisht problematikat si në vijim:

1. Nga auditimi i raport kontrollit tatimor dhe akt verifikimit të mbajtur për subjektin “N.C” SHPK, nga ana e inspektorit dhe inxhinierit pranë DTM, janë konstatuar mungesa e analizave dhe vlerësimeve të projektit dhe preventivit të punimeve, nuk është kryer një zberthim i matrialeve dhe lëndës së parë në përbërje të punimeve të situacionuar, bazuar në manualin nr.1 “Analiza Teknike-Për prodhimin e matrialeve të ndërtimit, udhëzime dhe kritere” dhe manualin nr.2 “Analiza Teknike-Për punimet e ndërtimit të ndërtesave”, si dhe krahasimi me punimet e kryera realisht në terren. Gjithashtu janë konstatuar mungesa e analizave të librezës së masave, situacioneve pjesore mujore, progresive dhe përfundimtare të volumit të punimeve të ndërtimit, të cilat janë dokumente justifikuese për verifikimin e volumit të punimeve të kryera sipas përcaktimeve të nënpikave 3.2 dhe 3.3 të pikës 3, Kreu 1 të Udhëzimit Nr.3, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, ndryshuar me Udhëzimin Nr.1 datë, 16.06.2011.

2. Nga grupi i auditimit është kryer analiza e kostove të ndërtimit të objekteve dhe ka rezultuar se subjekti “N.C” SHPK, është në rolin e sipërmarrësit dhe investitorit, pra në këtë rast ka kryer faturime të situacioneve të punimeve të kryera poshtë nivelit të kostove mesatare që janë përcaktuar në Udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr.3 “Miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2016”. Nga auditimi konstatohet se duhet të ishin rivlerësuar transaksionet, duke çuar vlerën e situacioneve të punimeve të ndërtimit në blerje drejt vlerës minimale të ndërtimit për efekte fiskale, për diferencat si më poshtë:

*- Objekti Godinë banimi dhe shërbimi 7-9 kate me 2 kate parkim nëntokë-Kulla 1, Rruga "Robert Shvarc", Tiranë: 108,982,273 lekë; diferenca vlerë faturimi – kosto minimale fiskale ndërtimi (3,835 lekë/m<sup>2</sup>) x sipërfaqe ndërtimit mbas kolaudimit (28,419.22 m<sup>2</sup>).*

Në sensin ekonomik të situatës jemi në kushtet e situatës së “shitjes nën kosto”, sepse në raportin e kontrollit nuk kemi justifikimin e këtyre transaksioneve nën kostot mesatare të ndërtimit, me element të tillë si specializimin, integrimin horizontal ose vertikal apo ekonominë e shkallës të subjektit. Në këtë rast do të bëhet rikarakterizimi i shpenzimeve shtesë të cilat rezultojnë nga përlllogaritjet e grupit të auditimit por nuk do t’i njihen subjektit si shpenzime të zbritshme për efekt të llogaritjes së tatimit mbi fitimin si dhe nuk do të lejohet kreditimi i TVSH-së në blerje, të cilat do të ishin n.q.s. do të ishin deklaruar korrekt nga subjekti, por mqs këto parregullsi po evidentohen nga grupi i audituesve do të kalojnë si shpenzime të panjohura duke kaluar e gjithë e ardhura si fitim. Pra nga grupi i auditimit është kryer rikarakterizimi i shpenzimeve dhe investimeve, diferenca midis vlerës së faturuar të situacioneve deri tek niveli i kostove minimale fiskale të ndërtimit, të panjohur dhe paregjistruara nga subjekti si të ardhura dhe ndryshimi në deklaratën e tatim fitimit do të bëhet në rritje të të ardhurave dhe të shpenzimeve, por shpenzimet nuk njihen si të zbritshme për efekt të tatim fitimit, kjo do të ishte e mundur kur vete subjekti do të deklaronte këto shpenzime, jo kur kjo bëhen nga inspektori ose nga rekomandimi i grupit të audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit, pra kjo do të thotë se rritja në të ardhura do të kalojë e

gjitha si fitim, si dhe duke kryer penalizimin e subjektit sipas përcaktimeve të nenit 124 “Kundërvajtjet në lëshimin e faturave tatimore, dëftesave tatimore dhe dokumentimin e transaksioneve” e Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, duke sjellë si pasojë efekte tatimore të pallogaritura në shumën 16,347,341 lekë detyrime të tatimit mbi fitimin dhe 16,347,341 lekë gjobë 100%, 21,796,455 lekë detyrime të TVSH-së dhe 21,796,455 lekë gjobë 100%, pra të ardhura gjithsej të munguar për buxhetin e shtetit në vlerën prej 76,287,591 lekë.

3. Nga analiza e bilancit të lëvizjes materiale të kryera nga inspektori dhe inventari i deklaruar në sistemin C@ts për vitin 2020, kanë rezultuar diferencat të pa justifikuar, konkretisht në sasi dhe artikull: 7m<sup>3</sup> rërë, 1 ton çimento, 800 copë tulla (10x25x25), 5,600 copë tulla (20x25x25), 6m<sup>3</sup> granil. Kurse për vitin 2021 kanë rezultuar diferencat e pajustificuara, konkretisht në sasi dhe artikull: 246 m<sup>2</sup> pllaka, 407 kg profile, 1,400 kg kol, 20 kg bojak, 668 kg bojë. Nga grupi i auditimi këto diferenca të konstatuara dhe të pajustificuara do të konsiderohen si shitje pa faturë dhe shitjet e tatueshme të shoqërisë për periudhën do të rivlerësohen me kosto duke u rritur në shumën prej 802,662 lekë. Për këto parregullsi të konstatuara është kryer penalizimi i subjektit sipas përcaktimeve të nenit 124 “Kundërvajtjet në lëshimin e faturave tatimore, dëftesave tatimore dhe dokumentimin e transaksioneve” të Ligjit Nr.9920 datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar, duke sjellë si pasojë efekte tatimore të pallogaritura në shumën 120,399 lekë detyrime të tatimit mbi fitimin dhe 120,399 lekë gjobë 100%, 160,532 lekë detyrime të TVSH-së dhe 160,532 lekë gjobë 100%, 54,581 lekë detyrime të tatimit mbi dividentin dhe 54,581 lekë gjobë 100%, pra të ardhura gjithsej të munguar për buxhetin e shtetit në vlerën prej 671,024 lekë.

- Nga ana e inspektorit të kontrollit nuk është kryer një analizë e detajuar e të dhënave mbi kontratat e shitjes së apartamenteve, njërive të shërbimit dhe parkimeve.

- Tek llogaria parapagimeve nuk është kryer një analizë e detajuar e kësaj llogari sipas kontratë porosive për blerje në objektet e papërfunduara të cilat janë akoma në proces.

- Nuk ka kryer një analizë të detajuar e llogarive “Të drejta të arkëtueshme nga njësitë ekonomike brenda grupit” dhe “DASH-Të pagueshme ndaj njërive ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse”.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 46-352 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**11.1 Rekomandimi:** Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj për tatimpaguesin “N.C” SHPK, referuar mangësive dhe parregullsive në procedurën e kontrollit, vlerësuar me efekte negative në të ardhurat tatimore, në përputhje me kërkesat ligjore dhe proceduriale, sipas përcaktimeve të nenit 85 “Ri kontrolli tatimor” të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të kryejë rikontroll tatimor me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit të evidentuara paraprakisht në vlerën prej **76,958,615 lekë**.

**Brenda vitit 2023**

**12. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i raporteve të kontrollit tatimor të subjektit “M.K” SHPK, u konstatua se nga ana e inspektoreve të kontrollit nuk është vepruar në përputhje me përcaktimet e dispozitave ligjore, konkretisht problematikat si në vijim:

1. Nga auditimi i raport kontrollit tatimor dhe akt verifikimit të mbajtur për subjektin “M.K” SHPK, nga ana e inspektorit dhe inxhinierit pranë DTM, janë konstatuar mungesa e analizave dhe vlerësimeve të projektit dhe preventivit të punimeve, nuk është kryer një zberthim i matrialeve dhe lëndës së parë në përbërje të punimeve të situacionuar, bazuar në manualin nr.1

“Analiza Teknike-Për prodhimin e materialeve të ndërtimit, udhëzime dhe kritere” dhe manualin nr.2 “Analiza Teknike-Për punimet e ndërtimit të ndërtesave”, si dhe krahasimi me punimet e kryera realisht në terren. Gjithashtu janë konstatuar mungesa e analizave të librezës së masave, situacioneve pjesore mujore, progresive dhe përfundimtare të volumit të punimeve të ndërtimit, të cilat janë dokumenta justifikuese për verifikimin e volumit të punimeve të kryera sipas përcaktimeve të nënpikave 3.2 dhe 3.3 të pikës 3, Kreu 1 të Udhëzimit Nr.3, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, ndryshuar me Udhëzimin Nr.1 datë, 16.06.2011.

2. Nga grupi i auditimit është kryer analiza e kostove të ndërtimit të objekteve dhe ka rezultuar se subjekti “M.K” SHPK, është në rolin e sipërmarrësit dhe investitorit, pra në këtë rast ka kryer faturime të situacioneve të punimeve të kryera poshtë nivelit të kostove mesatare që janë përcaktuar në Udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr.3 “Miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2016”. Nga auditimi konstatohet se duhet të ishin rivlerësuar transaksionet, duke çuar vlerën e situacioneve të punimeve të ndërtimit në blerje drejt vlerës minimale të ndërtimit për efekte fiskale, për diferencat si më poshtë:

- Objekti Godinë banimi dhe shërbime 10 kate me 1 kate parkim nëntokë Rruga "Don Bosko", Tiranë: 34,233,757 lekë; diferenca vlerë faturimi – kosto minimale fiskale ndërtimi (2,707 lekë/m<sup>2</sup>) x sipërfaqe ndërtimit (12,644.2 m<sup>2</sup>).

Në sensin ekonomik të situatës jemi në kushtet e situatës së “shitjes nën kosto”, sepse në raportin e kontrollit nuk kemi justifikimin e këtyre transaksioneve nën kostot mesatare të ndërtimit, me element të tillë si specializimin, integrimin horizontal ose vertikal apo ekonomitë e shkallës të subjektit. Në këtë rast do të bëhet rikarakterizimi i shpenzimeve shtesë të cilat rezultojnë nga përlllogaritjet e grupit të auditimit por nuk do t’i njihen subjektit si shpenzime të zbritshme për efekt të llogaritjes së tatimit mbi fitimin si dhe nuk do të lejohet kreditimi i TVSH-së në blerje, të cilat do të ishin të tilla nëse do të ishin deklaruar korrekt nga subjekti, por duke marrë në konsideratë faktin se këto parregullsi po evidentohen nga grupi i audituesve do të kalojnë si shpenzime të panjohura duke kaluar e gjithë e ardhura si fitim. Pra nga grupi i auditimit është kryer rikarakterizimi i shpenzimeve dhe investimeve, diferenca midis vlerës së faturuar të situacioneve deri tek niveli i kostove minimale fiskale të ndërtimit, të panjohur dhe paregjistruara nga subjekti si të ardhura dhe ndryshimi në deklaratën e tatim fitimit do të bëhet në rritje të ardhurave dhe të shpenzimeve, por shpenzimet nuk njihen si të zbritshme për efekt të tatim fitimit, kjo do të ishte e mundur kur vete subjekti do të deklaronte këto shpenzime, jo kur kjo bëhen nga inspektori ose nga rekomandimi i grupit të audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit, pra kjo do të thotë se rritja në të ardhura do të kalojë e gjitha si fitim, si dhe duke kryer penalizimin e subjektit sipas përcaktimeve të nenit 124 “Kundërvajtjet në lëshimin e faturave tatimore, dëftesave tatimore dhe dokumentimin e transaksioneve” e Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, duke sjellë si pasojë efekte tatimore të pallogaritura në shumën 4,279,220 lekë detyrime të tatimit mbi fitimin dhe 4,279,220 lekë gjobë 100%, 5,705,626 lekë detyrime të TVSH-së dhe 5,705,626 lekë gjobë 100%, pra të ardhura gjithsej të munguar për buxhetin e shtetit në vlerën prej 19,969,692 lekë.

3. Nga analiza e raportit të kontrollit tatimor ka rezultuar se shoqëri “M.K” SHPK ka arkëtuar interesa nga shoqëritë “A” SHPK dhe “B.I” SHPK bazuar në kontratat e huadhëniesve lidhur me këto shoqëri. Konkretisht sipas kontratës së huasë datë 26.02.2018, amenduar me kontratën për shtyrje afati datë 26.02.2019, për shumën e huasë prej 80,000 Euro me një normë vjetore interesi prej 2%, ku shoqëria “M.K” SHPK si huadhënëse është ortake në shoqërinë huamarrëse “A.” SHPK në masën 16.85% të kapitalit themeltar. Gjithashtu huamarrës shoqëria “B.I” SHPK me NIPT L.S sipas kontratës noteriale të huasë Nr.405 Rep dhe 81 Kol datë 15.04.2017, në të cilën palët

(Huadhënësi dhe Huamarrësi me të drejta pronësie të barabarta), kanë blerë një tokë për ndërtim në Lalëz, Durrës me një sipërfaqe prej 30,000 m<sup>2</sup> me vlerë prej 900,000 euro për secilin ose 1,800,000 euro në total për ndërtim vilash. Nga analiza e pasivit të bilancit të shoqërisë rezulton se shoqëria ka hua afatgjata në bankat e nivelit të dytë, gjendja e të cilave në 31.12.2018 rezulton 319,700,944 lekë dhe në 31.12.2019 rezulton 274,114,307 lekë, për të cilat ka paguar 10,196,680 lekë interesa në vitin 2019, sipas përcaktimeve të kontratave të huamarrjes. Grupi i audituesve gjykon në lidhje me shpenzimet e interesit se kemi të bëjmë me shpenzime të panjohura që nuk i kanë shërbyer aktivitetit të shoqërisë, me arsyetimin se shoqëria në aktivitetin e saj të deklaruar nuk e ka huadhënien si dhe nuk është e licencuara për t'a kryer atë, gjithashtu theksojmë se shoqëria ka paguar interesa në nivelin e 4% për kreditë afatgjata që ka marrë nga bankat e nivelit të dytë dhe nga ana tjetër ka dhënë hua shoqërive (A. SHPK – Palë e lidhur dhe B.I SHPK-Ortak në investim) me norma afërsisht 2%, veprime këto të cilat nuk janë konform vlerës dhe parimeve të një tregu të lirë si dhe janë në kundërshtim me përcaktimet e nenit 20 të Ligjit Nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar. Nga sa argumentuar sa më sipër, ku rezulton se “Shpenzimet e interesit për huatë afatgjata”, nuk janë kryer për qëllime fitimi, sigurimi dhe ruajtje të fitimit, grupi i audituesve i ka rikarakterizuar si shpenzime të panjohur duke rivlerësuar situatën financiare dhe penalizuar subjektin për këto parregullësi në deklarim sipas përcaktimeve të nenit 115 “Plotësim i pasaktë i deklaratës tatimore”, të Ligjit Nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar, duke sjellë si pasojë efekte tatimore të pallogaritura në shumën 318,631 lekë detyrime të tatimit mbi fitimin dhe 69,780 lekë gjobë 21.9%, 144,446 lekë detyrime të tatimit dividendi dhe 31,634 lekë gjobë 21.9%, pra të ardhura gjithsej të munguar për buxhetin e shtetit në vlerën prej 564,490 lekë.

4. Shoqëria bazuar në nenin 73 “Rregullat për aplikimin e koeficientit të zbritjes së TVSH-së” të Ligjit 92/2014 “Për TVSH në R.SH” si dhe në nenin 56 “Rregulla praktike mbi zbritjen e TVSH-së”, pika 3 “Koeficienti i Zbritjes së TVSH-së” të Udhëzimit Nr.6 datë 30.01.2015, për shpenzimet me karakter të përgjithshëm për periudhën Janar-Shtator 2019 (Periudhë e kontrolluar më parë për TVSH) sipas Raport-Kontrollit të datës 13.01.2021, nuk është zbatuar kreditimi i pjesshëm i TVSH, por është lënë detyrë kontrollit pasardhës që të bëhet rregullimi i TVSH për komplet vitin 2019. Nga ana e inspektorit nuk është vepruar konform përcaktimeve të Ligjit Nr.92/2014 "Për TVSH-në, në RSH", i ndryshuar, pika 1 e nenit 69, neni 72, neni 78 si dhe nenin 80. Nga të dhënat e raportit të kontrollit dhe sistemit C@ts në lidhje me shitjet për periudhën 01.01.2019-31.12.2019, rillogaritur koeficienti i zbritjes së TVSH-së (baza vjetore) prej 32.10%, sipas përcaktimeve të nenit 72 të Ligjit Nr.92/2014 "Për TVSH në R.SH", i ndryshuar. Nga kontrolli analitikë i “Blerjeve të tatueshme me 20% TVSH nga furnitorë vendas” për vitin 2019, janë evidentuar blerjet e furniturave me vlerë të tatueshme = 15,088,434 lekë dhe TVSH = 3,017,399 lekë, të cilat u kanë shërbyer të dy aktiviteteve dhe mbi të cilën duhet të aplikohet koeficienti 32.10% i zbritjes së TVSH-së. Nga grupi i audituesve është kryer rregullimi i TVSH së zbritshme, duke njohur si të zbritshme vlerën e TVSH-së prej 968,585 lekë si dhe duke kryer penalizimi i subjektit sipas përcaktimeve të nenit 115 “Plotësim i pasaktë i deklaratës tatimore” të Ligjit Nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, duke sjellë si pasojë efekte tatimore të pallogaritura në shumën 2,048,814 lekë ulje e tepricës kreditore të TVSH-së dhe 448,690 lekë gjobë 21.9%, pra të ardhura gjithsej të munguar për buxhetin e shtetit në vlerën prej 2,497,504 lekë.

5. Nga auditimi i raportit të kontrollit tatimor, konkretisht në drejtim të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore sipas pikës së programit të kontrollit, kanë rezultuar problematikat si më poshtë:



- Nga kontrolli i listëpagesave të subjektit të deklaruar në sistemin C@ts për periudhën 10/2019-12/2019, ka rezultuar se shoqëria ka deklaruar për punonjësit 26 ditë pune që është në tejkalim të kohëzgjatjes normale të punës prej 174 orë në muaj ose 22 ditë pune dhe pagesa për ditët shtesë duhet të kryhet me një shtesë jo më pak se 25% të pagesës të ditës normale sipas përcaktimeve të Kreut IX të Kodit të Punës në R.SH.

- Gjithashtu janë konstatuar raste ku shoqëria ka deklaruar pagesa të pagave orare për punonjësit poshtë pagës minimale orare që është përcaktuar në Vendim Nr.809, datë 26.12.2018 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”.

- Nga ana e inspektorit të kontrollit tatimor nuk janë analizuar kontratat individuale të punës midis shoqërisë dhe punonjësve, në lidhje me përputhshmërinë e tyre më përcaktimet e dispozitave të Kodit të Punës në R.SH.

- Nuk janë analizuar regjistrat që duhet të mbajë tatimpaguesi sipas përcaktimeve të nenit 15 “Mbajtja e regjistrimeve” të Ligjit Nr.9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

- Nuk ka një analizë të llogaritjes së pagës dhe elementëve përbërës të saj sipas përcaktimeve të dispozitave të nenit 119 të Kreut XI të Kodit të Punës në R.SH.

- Nuk ka një analizë të numrit të lartë të ndryshimit të punonjësve të shoqërisë, kryesisht në lidhje me largimet e shpeshta n.q.s. ndërprerjet e marrëdhënies të punës janë konform kontratave dhe përcaktimeve të Kodit të Punës.

- Janë konstatuar parregullsi në llogaritjen e ditëve të punës dhe pagës për efekt të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për punonjësit e punësuar rishtazi ose të larguar përgjatë muajit.

- Nga kontrolli për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si dhe TAP-in, për periudhën 11/2020-03/2022 dhe nga analiza e listëpagesave të dorëzuar nga subjekti në sistemin C@ts, janë konstatuar parregullsi në llogaritjen e pagës për efekt të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për punonjësit me numër kategorie për kontributet 2/004(6), sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Në lidhje me situatën e trajtuar më sipër grupi i audituesve gjykon se janë arsye themelore për të kryer rivlerësimin e pagave, kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi, për punonjësit me paga të deklaruar jo konform përcaktimeve të legjislacionit, në lidhje me këtë tatimpaguesi i cili ka plotësuar deklarata tatimore që përmbajnë të dhëna të pasakta ose të falsifikuara dhe nuk mban dhe ruan llogari apo regjistrime të sakta të transaksioneve, veprime të cilat janë në kundërshtim me gërmën b, c të nenit 71, gërma a e nenit 72 të Ligjit Nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar dhe penalizimin sipas përcaktimeve të nenit 119 “Mosdeklarimi i punonjësve dhe fshehja e pagës”, të Ligjit Nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar, duke sjellë si pasojë efekte tatimore të pallogaritura në shumën 36,372 lekë detyrime të Sig Shoq Punëdhënësi dhe 36,372 lekë gjobë 100%, 23,036 lekë detyrime të Sig Shoq Punëmarrësi dhe 23,036 lekë gjobë 100%, 4,122 lekë detyrime Sig Shënd Punëdhënësi dhe 4,122 lekë gjobë 100%, 4,122 lekë detyrime Sig Shënd Punëmarrësi dhe 4,122 lekë gjobë 100%, 10,789 lekë detyrime TAP dhe 10,789 lekë gjobë 100%, pra të ardhura gjithsej të munguar për buxhetin e shtetit në vlerën prej 156,882 lekë.

6. Në lidhje me pagat e padeklaruar saktë nga ana e subjektit, është kryer rivlerësimi i situatës financiare, ku shpenzimi i fondit të pagave të rivlerësuar është rikarakterizuar si e ardhura dhe është kryer penalizimi i subjektit sipas përcaktimeve të nenit 115 “Plotësim i pasaktë i deklarates

tatimore”, të Ligjit Nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar, duke sjellë si pasojë efekte tatimore të pallogaritura në shumën 36,754 lekë detyrime të tatimit mbi fitimin dhe 8,049 lekë gjobë 21.9%, 49,005 lekë detyrime të TVSH-së dhe 10,732 lekë gjobë 21.9%, 16,662 lekë detyrime të tatimit mbi dividendin dhe 3,649 lekë gjobë 21.9%, pra të ardhura gjithsej të munguar për buxhetin e shtetit në vlerën prej 124,851 lekë.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 46-352 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**12.1 Rekomandimi:** Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj për tatimpaguesin “M.K” SHPK, referuar mangësive dhe parregullsive në procedurën e kontrollit, vlerësuar me efekte negative në të ardhurat tatimore, në përputhje me kërkesat ligjore dhe proceduriale, sipas përcaktimeve të nenit 85 “Ri kontrolli tatimor” të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të kryejë rikontroll tatimor me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit të evidentuara paraprakisht në vlerën prej **23,313,420 lekë**.

**Brenda vitit 2023**

**13. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i raporteve të kontrollit tatimor të subjektit “A-S” SHPK, u konstatua se nga ana e inspektoreve të kontrollit nuk është vepruar në përputhje me përcaktimet e dispozitave ligjore, konkretisht problematikat si në vijim:

**1.** Nga auditimi i raportit të kontrollit tatimor, konkretisht në drejtim të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore sipas pikës së programit të kontrollit, kanë rezultuar problematikat si më poshtë:

- Nga kontrolli i listëpagesave të subjektit të deklaruar në sistemin C@ts për periudhën 11/2020-03/2022, ka rezultuar se shoqëria ka deklaruar për punonjësit 26 ditë pune që është në tejkalim të kohëzgjatjes normale të punës prej 174 orë në muaj ose 22 ditë pune dhe pagesa për ditët shtesë duhet të kryhet me një shtesë jo më pak se 25% të pagesës të ditës normale sipas përcaktimeve të Kreut IX të Kodit të Punës në R.SH.

- Gjithashtu janë konstatuar raste ku shoqëria ka deklaruar pagesa të pagave orare për punonjësit poshtë pagës minimale orare që është përcaktuar në Vendim Nr.809, datë 26.12.2018 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi” dhe Vendimin Nr.1025, datë 16.12.2020 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”.

- Nga auditimi konstatohet se nga ana e inspektorit të kontrollit tatimor nuk janë analizuar kontratat individuale të punës midis shoqërisë dhe punonjësve, në lidhje me përputhshmërinë e tyre me përcaktimet e dispozitave të Kodit të Punës në R.SH.

- Nuk janë analizuar regjistrat që duhet të mbajë tatimpaguesi sipas përcaktimeve të nenit 15 “Mbajtja e regjistrimeve” të Ligjit Nr.9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

- Nuk ka një analizë të llogaritjes së pagës dhe elementëve përbërës të saj sipas përcaktimeve të dispozitave të nenit 119 të Kreut XI të Kodit të Punës në R.SH.

- Nuk ka një analizë të numrit të lartë të ndryshimit të punonjësve të shoqërisë, kryesisht në lidhje me largimet e shpeshta n.q.s. ndërprerjet e marrëdhënieve të punës janë konform kontratave dhe përcaktimeve të Kodit të Punës.

- Janë konstatuar parregullësi në llogaritjen e ditëve të punës dhe pagës për efekt të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për punonjësit e punësuar rishtazi ose të larguar përgjatë muajit.

- Nga kontrolli për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si dhe TAP-in, për periudhën 11/2020-03/2022 dhe nga analiza e listëpagesave të dorëzuar nga subjekti në sistemin

C@ts, janë konstatuar parregullësi në llogaritjen e pagës për efekt të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për punonjësit me numër kategorie për kontributet 2/004(6), sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Në lidhje me situatën e trajtuar më sipër grupi i audituesve gjykon se janë arsye themelore për të kryer rivlerësimin e pagave, kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi, për punonjësit me paga të deklaruara jo konform përcaktimeve të legjislacionit, në lidhje me këtë tatimpagues i cili ka plotësuar deklarata tatimore që përmbajnë të dhëna të pasakta ose të falsifikuara dhe nuk mban dhe ruan llogari apo regjistrime të sakta të transaksioneve, veprime të cilat janë në kundërshtim me gërmën b, c të nenit 71, gërma a e nenit 72 të Ligjit Nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar dhe penalizimin sipas përcaktimeve të nenit 119 “Mosdeklarimi i punonjësve dhe fshehja e pagës”, të Ligjit Nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar, duke sjellë si pasojë efekte tatimore të pallogaritura në shumën 5,870,666 lekë detyrime të Sig Shoq Punëdhënësi dhe 5,870,666 lekë gjobë 100%, 3,718,089 lekë detyrime të Sig Shoq Punëmarrësi dhe 3,718,089 lekë gjobë 100%, 665,342 lekë detyrime Sig Shënd Punëdhënësi dhe 665,342 lekë gjobë 100%, 665,342 lekë detyrime Sig Shënd Punëmarrësi dhe 665,342 lekë gjobë 100%, 4,491,955 lekë detyrime TAP dhe 4,491,955 lekë gjobë 100%, pra të ardhura gjithsej të munguar për buxhetin e shtetit në vlerën prej 30,822,788 lekë.

**2.** Në lidhje me pagat e padeklaruara saktë nga ana e subjektit, është kryer rivlerësimi i situatës financiare, ku shpenzimi i fondit të pagave të rivlerësuara është rikarakterizuar si e ardhura dhe është kryer penalizimi i subjektit sipas përcaktimeve të nenit 115 “Plotësim i pasaktë i deklaratës tatimore”, të Ligjit Nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar, duke sjellë si pasojë efekte tatimore të pallogaritura në shumën 5,444,079 lekë detyrime të tatimit mbi fitimin dhe 1,192,253 lekë gjobë 21.9%, 7,258,772 lekë detyrime të TVSH-së dhe 1,589,671 lekë gjobë 21.9%, detyrime të tatimit mbi dividentin 2,467,983 lekë dhe 540,488 lekë gjobë 21.9%, pra të ardhura gjithsej të munguar për buxhetin e shtetit në vlerën prej 18,493,247 lekë.

**3.** Nga analiza e raport kontrollit për periudhën Janar-Dhjetor 2021, rezulton se shoqëria ka kryer blerje shërbime nga individë të cilët nuk janë të punësuar në shoqëri, për të cilat është llogaritur, mbajtur dhe paguar tatimi në burim sipas kontratave respektive. Në raport kontrolli sqarohet se janë shërbime inxhinierike, menaxhimi dhe përzgjedhje e matrialeve të ndërtimit në treg me argumentin se janë projekte specifike (Projektet: Rikualifikim i Lumit të Vlorës dhe Ndërtimi i Ujësjetës Librazhd).

- I.I në shumën 21,808,162 lekë ose 150,000 euro për projektin “Rikualifikim i Lumit të Vlorës” sipas kontratës së shërbimit nr.22 datë 12.02.2021 dhe nisur nga fakti se për këtë shërbim nga një individ që nuk është i punësuar në kompani, është një shërbim i paguar vetëm në një rast dhe jo në mënyrë të njëtrajtshme muaj për muaj dhe për këtë shërbim është llogaritur dhe paguar tatimi në burim në masën 15% mbi vlerën e shërbimit të kryer.

- A.I në vlerën 21,808,162 lekë ose 150,000 euro për projektin “Ndërtimi i Ujësjetës Librazhd” sipas kontratës së shërbimit nr.25 datë 12.02.2021 dhe nisur nga fakti se për këtë shërbim nga një individ që nuk është i punësuar në kompani, është një shërbim i paguar vetëm në një rast dhe jo në mënyrë të njëtrajtshme muaj për muaj dhe për këtë shërbim është llogaritur dhe paguar tatimi në burim në masën 15% mbi vlerën e shërbimit të kryer.

Fillimisht sqarojmë se nga kontrolli më i thelluar në sistemin C@ts dhe të dhënave të QKB, rezulton se z. I.I, z. A.I dhe shoqëria “A-S” SHPK, janë palë të lidhura sipas përcaktimeve të nenit 1 të Ligjit Nr.42/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, konkretisht:

- Z. I.I është ortaku zotërues i 100% të kuotave të shoqërisë “M” SHPK me NIPT M.C, e cila nga ana e saj është zotëruese e 57% të kuotave të shoqërisë “F” SHPK me NIPT L.K, e cila është zotëruese e 100% të kuotave të shoqërisë “A-S” SHPK me NIPT J.Ë. Si përfundim arrijmë në konkluzionin se I. I. dhe shoqëria “A-S” SHPK, janë palë të lidhura sepse është zotërues në mënyrë indirekte i 57% të kuotave.

- Z. A.I është administrator i shoqërisë V. SHPK me NIPT L.S, kapitali i saj është zotëruar nga shoqëria “F” SHPK me NIPT L.K, e cila zotëron edhe kapitalin e shoqërisë “A-S” SHPK, sipas numri të çështjes: CN-060800-12-16, “Depozitimi i vendimit date 24.11.2016, ku është vendosur: Kalimi i kuotave të ortakeve z. I.I dhe z. S.I që zotërojnë në shoqërinë "V" në formën e kontribut në natyrë në kapitalin e shoqërisë së themeluar "F" SHPK”. Kjo përqindje e zotërimit të kuotave të shoqërisë V. SHPK, ka vazhduar deri në datën 23.12.2021 kur është kryer edhe ndryshimi tjetër sipas numrit të çështjes: CN-836966-12-21, kur është larguar si ortake shoqëria "F" SHPK”. Kontrata e shërbimit midis shoqërisë dhe A.I është lidhur në datë 12.02.2021, gjë që vërteton faktin se kemi të bëjmë me veprime midis palëve të lidhura.

- Në raportin e kontrollit tatimor nuk është kryer një analizë e kontratave që janë lidhur midis shoqërisë dhe individëve si dhe të nevojës specifike që ka shoqëria për këtë shërbim në realizimin e projekteve të “Rikualifikim i Lumit të Vlorës” dhe “Ndërtimi i Ujësjellësit Librazhd”.

- Gjithashtu theksojmë se kontratat e punëve publike për projektet e “Rikualifikim i Lumit të Vlorës” dhe “Ndërtimi i Ujësjellësit Librazhd”, janë lidhur përpara se sa kontratat e shërbimit me këta dy individë, nga rrjedh se shoqëria është shpallur fituese e tenderit duke plotësuar kriteret e përgjithshme dhe specifike si dhe çdo kërkesë tjetër të përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Në këtë logjikë rrjedh se nuk janë të domosdoshme këto “shërbime inxhinierike, menaxhimi dhe përzgjedhje e matrialeve të ndërtimit në treg”, për realizimin e kontratave të projekteve të “Rikualifikim i Lumit të Vlorës” dhe “Ndërtimi i Ujësjellësit Librazhd”.

- Nga kontrolli i listëpagesave të dorëzuara në sistemin C@ts, rezulton se shoqëria ka të punësuar në mënyrë të përhershme mesatarisht mbi 100 inxhinier të profileve të ndryshme, çdo muaj përgjatë periudhës së kontrollit 11/2020-03/2022, por nga ana e inspektorit të kontrollit tatimor nuk ka një analizë n.q.s. ky shërbim mund të kryhet nga personeli i brendshëm pa qenë nevoja e kontraktimit të jashtëm si dhe nuk ka një kontroll dhe analizë të formimit profesional dhe ekzistencën e certifikimeve dhe licencave të miratuara për këtë shërbim që po ofrojnë këta individë ndaj shoqërisë.

Nga sa më sipër grupi i auditimit gjykon se jemi në kushtet e shpenzimeve të cilat nuk janë kryer për qëllime fitimi, sigurimi dhe ruajtje të fitimit, gjë që është në shkelje të përcaktimeve të nenit 20 të Ligjit Nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, të cilat janë rikarakterizuar si shpenzime të panjohur duke rivlerësuar situatën financiare dhe penalizuar subjektin për këto parregullësi në deklaram sipas përcaktimeve të nenit 115 “Plotësim i pasaktë i deklaratës tatimore”, të Ligjit Nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar, duke sjellë si pasojë efekte tatimore të pallogaritura në shumën 6,542,449 lekë detyrime të tatimit mbi fitimin dhe 1,432,796 lekë gjobë 21.9%, 2,965,910 lekë detyrime të tatimit mbi dividentin dhe 649,534 lekë gjobë 21.9%, pra të ardhura gjithsej të munguar për buxhetin e shtetit në vlerën prej 11,590,689 lekë.

**4.** Nga kontrolli i detajuar në sistemin C@ts dhe QKB, rezulton se kuotat e kapitalit të shoqërisë blerëse “A.R” SHPK dhe shoqërisë shitëse “A-S” SHPK, zotërohen nga shoqëria “F” SHPK, e cili zotëron 100% të kapitalit të tyre. Në këtë mënyrë kemi që subjektet “A.R” SHPK dhe “A-S” SHPK, janë palë të lidhura dhe transaksionet midis tyre janë transaksione të kontrolluara të cilat

duhet t'ju përmbahen kushteve dhe parimeve të tregut të lirë, sipas përcaktimeve të nenit 1 të Ligjit Nr.42/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar. Nga analiza e raportit të kontrollit tatimor rezulton se shoqëria ka kryer shitje të aktiveve afatgjata si mjete pune, mjete transporti dhe vilë në G.C, pa realizuar fitim, ku vlera e shitjes është sa vlera e mbetur prej 202,684,952 lekë. Nga ku dalim në konkluzionin se kemi të bëjmë me transaksione midis palëve të lidhura jo në bazë të parimit të vlerës së tregut në shitjen pa realizuar fitim, të mjeteve të punës dhe mjeteve të transportit si dhe duke shmangur tatim mbi fitimin për fitimet kapitale, dhe njëkohësisht merr në vlera të larta me qera mjete pune dhe makineri po nga kjo shoqëri. Si dhe gjithashtu transaksionit pa efekte ekonomike thelbësore me shoqërinë N.M SHPK, në shitjen e vilës në G.C, pa realizuar dhe duke shmangur pagesën e tatimit mbi fitimin. Nga sa analizuar më sipër në lidhje me transaksionet e shitjes së mjeteve të punës dhe mjeteve të transportit, midis palëve të lidhura që nuk u përmbahen kushteve të tregut dhe transaksioneve pa efekte ekonomike thelbësore me shoqërinë N.M SHPK, në shitjen e vilës në G.C, pa realizuar fitim, grupi i audituesve ka kryer rivlerësimin e transaksioneve duke përdorë marzhin neto të fitimit të deklaruar në pasqyrat financiare prej 26.68%, sipas përcaktimeve të germës dh) të nenit 71, gërmave a), b), c), ç), d) të nenit 71/2 dhe gërmës a) të nenit 72 të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar, si dhe duke penalizuar subjektin sipas përcaktimeve të nenit 115 të Ligjit Nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar, duke sjellë si pasojë efekte tatimore të pallogaritura në shumën 8,111,452 lekë detyrime të tatimit mbi fitimin dhe 1,776,408 lekë gjobë 21.9%, 3,677,191 lekë detyrime të tatimit mbi dividendin dhe 805,305 lekë gjobë 21.9%, pra të ardhura gjithsej të munguar për buxhetin e shtetit në vlerën prej 14,370,356 lekë.

**5.** Nga grupi i auditimit, u kontrolluan çmimet e shitjes së njësive komerciale zyra dhe depo, tek objekti “Stadiumi Air Albania”, drejt shoqërisë “I” SHPK (të cilat janë palë të lidhura), dhe rezultuan shitje nën çmimin fiskal minimal të zonë 2/1, të përcaktuar në Aneksin Nr.1 dhe Nr.2 të VKM Nr.168, datë 27.3.2019. Konkretisht sipas Aneksit Nr.2 “Çmimet mesatare referuese për metër katror sipërfaqe ndërtimi për vlerësimin e vlerës së taksueshme për ndërtime dhe ambiente jo-banimi. Në total shitje nën çmimin fiskal minimal të përcaktuar në VKM Nr.168, datë 27.3.2019, rezultuan 876,264,845 lekë, ku nga grupi i auditimit është rivlerësuar situata financiare e shoqërisë duke rritur të ardhurat dhe penalizimin sipas përcaktimeve të nenit 128 “Lëshimi i faturës së pasaktë”, të Ligjit Nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar, duke sjellë si pasojë efekte tatimore të pallogaritura në shumën 109,533,106 lekë detyrime të tatimit mbi fitimin dhe 54,766,553 lekë gjobë 50%, 146,044,141 lekë detyrime të TVSH-së dhe 73,022,070 lekë gjobë 50%, 61,338,539 lekë detyrime të tatimit mbi dividendin dhe 30,669,270 lekë gjobë 50%, pra të ardhura gjithsej të munguar për buxhetin e shtetit në vlerën prej 475,373,678 lekë.

**6.** Nga kontrolli në sistemin C@ts i listëpagesave janë konstatuar në muajin Mars 2021 dhe Janar 2022, pagat bruto në vlera të larta për disa individë, të cilat nuk janë analizuar nga ana e inspektorit të kontrollit, konkretisht: z. E.P, Drejtor (6,731,906 lekë - 03/2021), z. E.S, Sipërmarrës (6,520,057 lekë – 03/2021 dhe 8,883,362 lekë – 01/2022), z. B.L, Drejtor i Përgjithshëm në ndërtim (4,899,229 lekë – 03/2020), z. A.A, Drejtor i Zbatimit të Projektit (5,103,269 lekë – 03/2020).

**7.** Nga auditimi i raportit të kontrollit janë konstatuar dy fatura “Shërbim konsulence financiare dhe menaxhimi”, në vlerat respektive, fatura 2020 në vlerën 3,464,440 lekë, me 692,888 lekë TVSH dhe Fatura vitit 2021 në vlerën 19,772,634 lekë, me 3,954,528 lekë TVSH, nga shoqëria “F” SHPK, e cila zotëron 100% të kapitalit të shoqërisë “A-S”, theksojmë se këto vlera janë

dukshëm më të larta se shërbimet e konsulencës nga shoqëri të tjera, të cilat nuk janë palë të lidhura dhe nga ana e inspektorit nuk është kryer një analizë e detajuar se çfarë janë këto shpenzime dhe si i kanë shërbyer aktivitetit të “A-S” SHPK.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 46-352 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**13.1 Rekomandimi:** Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj për tatimpaguesin “A-S” SHPK, referuar mangësive dhe parregullsive në procedurën e kontrollit, vlerësuar me efekte negative në të ardhurat tatimore, në përputhje me kërkesat ligjore dhe proceduriale, sipas përcaktimeve të nenit 85 “Ri kontrolli tatimor” të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të kryejë rikontroll tatimor me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit të evidentuara paraprakisht në vlerën prej **550,650,758 lekë.**

**Brenda vitit 2023**

**14. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i raporteve të kontrollit tatimor të subjektit “I” SHPK, u konstatua se nga ana e inspektoreve të kontrollit nuk është vepruar në përputhje me përcaktimet e dispozitave ligjore, konkretisht problematikat si në vijim:

1. Nga auditimi i raport kontrollit tatimor dhe akt verifikimit të mbajtur për subjektin “I” SHPK, nga ana e inspektorit dhe inxhinierit pranë DTM, janë konstatuar mungesa e analizave dhe vlerësimeve të projektit dhe preventivit të punimeve, nuk është kryer një zbërthim i matrialeve dhe lëndës së parë në përbërje të punimeve të situacionuar, bazuar në manualin nr.1 “Analiza Teknike-Për prodhimin e matrialeve të ndërtimit, udhëzime dhe kritere” dhe manualin nr.2 “Analiza Teknike-Për punimet e ndërtimit të ndërtesave”, si dhe krahasimi me punimet e kryera realisht në terren. Gjithashtu janë konstatuar mungesa e analizave të librezës së masave, situacioneve pjesore mujore, progresive dhe përfundimtare të volumit të punimeve të ndërtimit, të cilat janë dokumenta justifikuese për verifikimin e volumit të punimeve të kryera sipas përcaktimeve të nënpikeve 3.2 dhe 3.3 të pikës 3, Kreu 1 të Udhëzimit Nr.3, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, ndryshuar me Udhëzimin Nr.1 datë, 16.06.2011.

2. Nga grupi i auditimit është kryer analiza e kostove të ndërtimit të objekteve dhe ka rezultuar se subjekti “I” SHPK, është në rolin e sipërmarrësit dhe investitorit, pra në këtë rast ka kryer faturime të situacioneve të punimeve të kryera poshtë nivelit të kostove mesatare që janë përcaktuar në Udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr.3 “Miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2016”. Duhet të ishin rivlerësuar transaksionet, duke çuar vlerën e situacioneve të punimeve të ndërtimit në blerje drejt vlerës minimale të ndërtimit për efekte fiskale, për diferencat si më poshtë:

<p><i>- Objekti Kompleks banimi dhe shërbimi 1, 8, 10 dhe 12 kate, me 1 katë parkimi nëntokë dhe dy godina banimi dhe shërbimi 12 kate me 1 kate parkimi nëntokë, Rruga “Artan Lenja”, Tiranë: 33,190,534 lekë; diferenca vlerë faturimi – kosto minimale fiskale ndërtimi (1,237 lekë/m<sup>2</sup>) x sipërfaqe ndërtimit (26,841 m<sup>2</sup>).</i></p>
---

Në sensin ekonomik të situatës jemi në kushtet e situatës së “shitjes nën kosto”, sepse në raportin e kontrollit nuk kemi justifikimin e këtyre transaksioneve nën kostot mesatare të ndërtimit, me element të tillë si specializimin, integrimin horizontal ose vertikal apo ekonomitë e shkallës të subjektit. Në këtë rast do të bëhet rikarakterizimi i shpenzimeve shtesë të cilat rezultojnë nga përlllogaritjet e grupit të auditimit por nuk do t’i njihen subjektit si shpenzime të zbritshme për efekt të llogaritjes së tatimit mbi fitimin si dhe nuk do të lejohet kreditimi i TVSH-së në blerje, të cilat do të ishin n.q.s. do të ishin deklaruar korrekt nga subjekti, por mqk këto parregullësi po evidentohen nga grupi i audituesve do të kalojnë si shpenzime të panjohura duke kaluar e gjithë e

ardhura si fitim. Pra nga grupi i auditimit është kryer rikarakterizimi i shpenzimeve dhe investimeve, diferenca midis vlerës së faturuar të situacioneve deri tek niveli i kostove minimale fiskale të ndërtimit, të panjohur dhe paregjistruara nga subjekti si të ardhura dhe ndryshimi në deklaratën e tatim fitimit do të bëhet në rritje të të ardhurave dhe të shpenzimeve, por shpenzimet nuk njihen si të zbritshme për efekt të tatim fitimit, kjo do të ishte e mundur kur vete subjekti do të deklaronte këto shpenzime, jo kur kjo bëhen nga inspektori ose nga rekomandimi i grupit të audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit, pra kjo do të thotë se rritja në të ardhura do të kalojë e gjitha si fitim, si dhe duke kryer penalizimin e subjektit sipas përcaktimeve të nenit 124 “Kundërvajtjet në lëshimin e faturave tatimore, dëftesave tatimore dhe dokumentimin e transaksioneve” e Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, duke sjellë si pasojë efekte tatimore të pallogaritura në shumën 4,978,580 lekë detyrime të tatimit mbi fitimin dhe 4,978,580 lekë gjobë 100%, 6,638,107 lekë detyrime të TVSH-së dhe 6,638,107 lekë gjobë 100%, pra të ardhura gjithsej të munguar për buxhetin e shtetit në vlerën prej 23,233,374 lekë.

3. Nga analiza e raportit të kontrollit tatimor pasqyrohet se subjekti ka shitur 109.5 m<sup>3</sup> beton M150, 57.5 m<sup>3</sup> beton M200, 936 m<sup>3</sup> beton M250, 1,464 m<sup>3</sup> beton M300 dhe 260 m<sup>3</sup> beton M350, për vitin 2019. Duke qenë se inspektori i kontrollit dhe inxhinieri nuk janë shprehur për normativën e prodhimit të betoni M300, do të bazohemi tek normativa e deklaruar sipas Manualit Nr.1 “Analiza Teknike” Për prodhimin e materialeve të ndërtimit, udhëzime e kritere, ku përcaktohet se për prodhimin e 1m<sup>3</sup> beton M300 do të nevojiten 0.43 m<sup>3</sup> rërë, 0.73 m<sup>3</sup> çakëll dhe 0.388 ton çimento. Duke u nisur nga normativat e deklaruara si dhe sipas manualit të ndërtimit është kryer zërbërthimi i sasive të materialeve të nevojshme për prodhimin e sasive të betonit të deklaruar të shitura nga shoqëria, nga ku kanë rezultuar diferenca mbi normativë në lëndën e parë të përdorur, konkretisht 1,120.54 m<sup>3</sup> rërë, 381.44 m<sup>3</sup> çakëll dhe 199.58 ton çimento. Nga grupi i auditimi këto diferenca të konstatuara dhe të pajustificuara janë konsideruar si shitje pa faturë dhe shitjet e tatueshme të shoqërisë për periudhën janë rivlerësuar me koston e inventarit sipas bilancit kontabël të vitit 2019, duke u rritur në shumën prej 1,811,765 lekë si dhe është kryer penalizimi i subjektit sipas përcaktimeve të nenit 124 “Kundërvajtjet në lëshimin e faturave tatimore, dëftesave tatimore dhe dokumentimin e transaksioneve” të Ligjit Nr.9920 datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar, duke sjellë si pasojë efekte tatimore të pallogaritura në shumën 271,765 lekë detyrime të tatimit mbi fitimin dhe 271,765 lekë gjobë 100%, 362,353 lekë detyrime të TVSH-së dhe 362,353 lekë gjobë 100%, 123,200 lekë detyrime të tatimit mbi dividentin dhe 123,200 lekë gjobë 100%, pra të ardhura gjithsej të munguar për buxhetin e shtetit në vlerën prej 1,514,636 lekë.

4. Nga grupi i auditimit, u kontrolluan çmimet e shitjes së të njëjësive ndërtimore apartamente, dyqane, parkim etj, tek objekti “Kompleksi banimi 3 kate, me 1-3 kat pranë Kopshtit Botanik” në Selite, Komuna Farkë, Tiranë, dhe rezultuan shitje nën çmimin fiskal minimal të zonë 6, të përcaktuar në Aneksin Nr.1 dhe Nr.2 të VKM Nr.168, datë 27.3.2019. Konkretisht sipas Aneksit Nr.2 “Çmimet mesatare referuese për metër katror sipërfaqe ndërtimi për vlerësimin e vlerës së taksueshme për ndërtime dhe ambiente jo-banimi”. Në total shitje nën çmimin minimal fiskal të përcaktuar në VKM Nr.168, datë 27.3.2019, rezultuan 34,513,643 lekë, ku nga grupi i auditimit është rivlerësuar situata financiare e shoqërisë duke rritur të ardhurat dhe penalizimin sipas përcaktimeve të nenit 128 “Lëshimi i faturës së pasaktë”, të Ligjit Nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar, duke sjellë si pasojë efekte tatimore të pallogaritura në shumën 5,177,046 lekë detyrime të tatimit mbi fitimin dhe 2,588,523 lekë gjobë 50%, 6,902,729 lekë detyrime të TVSH-së dhe 3,451,365 lekë gjobë 50%, 2,346,928 lekë detyrime të

tatimit mbi dividendin dhe 1,173,464 lekë gjobë 50%, pra të ardhura gjithsej të munguar për buxhetin e shtetit në vlerën prej 21,640,054 lekë.

5. Nga analiza e PASH, ka rezultuar se shoqëria ka njohur shpenzime financiare prej 7,026,420 lekë për vitin 2018 dhe 12,030,207 lekë për vitin 2019, me pretendimin se janë shpenzime të cilat kanë ardhur nga humbjet e shkaktuara nga kurset e këmbimit dhe nga ana e inspektorit të kontrollit nuk është bërë një analizë e detajuar e llogarive në valutë të huaj dhe diferencave të kursit të këmbimit që e kanë shkaktuar, por është mjaftuar se faktin se janë nxjerr nga sistemi informatik financiar “Financa 5” e subjektit.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 46-352 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**14.1 Rekomandimi:** Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj për tatimpaguesin “I” SHPK, referuar mangësive dhe parregullsive në procedurën e kontrollit, vlerësuar me efekte negative në të ardhurat tatimore, në përputhje me kërkesat ligjore dhe proceduriale, sipas përcaktimeve të nenit 85 “Ri kontrolli tatimor” të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të kryejë rikontroll tatimor me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit të evidentuara paraprakisht në vlerën prej **46,388,064 lekë**.

### **Brenda vitit 2023**

**15. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i raportit të kontrollit tatimor të tatimpaguesit “A.A.E” SHA, i cili ka volume në vlera të larta të punimeve ndërtimore si dhe kompleksitet të lartë të transaksioneve financiare, janë konstatuar mungesa të analizave dhe vlerësimeve të detajuara të kontratave koncesionare, lejeve të ndërtimit, punimeve referuar projekteve, grafikut të punimeve, aktet e kolaudit të veprave dhe raportet e AKBN-së, si institucioni përgjegjës për monitorimin e hidrocentraleve, element këto që rrisin riskun operacional për trajtimin korrekt të situatës. Nga rrjedh se nga administrata tatimore e DTM-së, janë certifikuar investime dhe TVSH-ja, për vlera punimesh ende të pa certifikuar prej organeve kompetente sipas detyrimeve kontraktuale dhe legjislacionit të fushës përkatëse, pavarësisht riskut teknik ose risqeve të tjera që mund të çenojnë funksionimin normal të tyre, garantimin dhe gjenerimin e të ardhurave të tatueshme të vijueshme, të cilat i japin tatimpaguesit të drejtën e zbritjes së tatimit sipas përcaktimeve të Kreut IX “Lindja dhe aplikimi i së drejtës së zbritjes” të Ligjit Nr.92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Udhëzimit Nr.6, datë 30.01.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”. Sipas marrëveshjes së koncesionit, shoqëria koncesionare është e lejuar që të furnizojë prodhimin neto të energjisë elektrike brenda ose jashtë Shqipërisë. Marrëveshja e koncesionit përbën një model projekti i tipit BOT (Ndërtim-Operim-Transferim) dhe do të zgjasë për një periudhë prej 41 vjetësh (35 vjet me një zgjatje prej 6 vitesh e aprovuar nga vendimi Nr.442 me date 22 Maj 2013), me të drejtë zgjatjeje automatike pas përbushjes së disa kushteve të përcaktuara në marrëveshjen e koncesionit. Pas kësaj periudhe hidrocentrali do t'i transferohet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjistikës (METE), pa asnjë tarifë bashkë me pajisjet e lidhura operuese, të drejtat dhe kontratat. Koncesionari do të ndërtojë tre hidrocentrale "Peshqesh", "Ura e Fanit" dhe "Fangu" (Siç specifikohet në shtesën e kontratës së koncesionit aprovuar nga vendimi Nr.51 me date 25.01.2017, me një kapacitet total të instaluar prej 109.71 MË, investimi total është 210,184,740 Euro). Ndërtimi i tre hidrocentraleve të Peshqeshit përfundoi me 4 Maj 2015. Kapaciteti i instaluar dhe kapaciteti vjetor për prodhimin është 34 MË dhe 118.400.000 kWh respektivisht. Ndërtimi i hidrocentralit Ura Fanit dhe Fangu përfundojë më 30 nëntor 2017. Baza e përgatitjes së pasqyrave financiare, përshkruar në shënimet shpjeguese deklarohet se është në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), por nuk është shpjeguar mbi cilin



standard dhe parim është bërë klasifikimi i kontratës koncesionare si aktiv afatgjatë material dhe metoda e amortizimit përkatëse për këtë aktiv. Veprime këto të cilat në gjykimin e grupit të auditimit janë në kundërshtim me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), sepse në përfundim të ndërtimit dhe vendosjes në punë të hidrocentraleve, duke filluar prodhimin e energjisë elektrike, duhet që të gjitha investimet në punime, makineri dhe shërbime të kryera, për sjelljen në gjendje pune të hidrocentralit, të ishin kapitalizuar në dy llogari kontabël të bilancit sipas klauzolave, përkatësisht në zërat aktive afatgjata jo-materiale dhe aktive financiare. Ndarje kjo sipas përcaktimeve të SNK 38 "Aktivet Jo-materiale", SNK 39 "Instrumentet Financiar", KIRFN 12 "Marrëveshjet Koncesionare të Shërbimit", KIS 29 "Marrëveshjet e Koncesionit për Shërbimet - Dhënia e informacioneve shpjeguese" dhe SKK 13 "Aktivet biologjike dhe marrëveshjet koncesionare", e cila është në harmoni me SNRF, në varësi të periudhës që autoriteti kontraktor i ka siguruar shitjen e garantuar të energjisë (*xx vjet*) si aktiv financiar, kurse për pjesën tjetër të kohëzgjatjes së afatit të kontratës koncesionare (*xx vjet*), ku shoqëria ka të drejt ta shes energjinë elektrike në treg të lirë si aktiv afatgjatë jo-material. Në aspektin kontabël jemi në situatën e një marrëveshje koncesionare të kushtëzuar dhe ku përfitimit ekonomike të ardhshme, do të vijnë nga e drejta e tarifimi për energjinë që do të shitet sipas përcaktimeve të marrëveshjes koncesionare. Gjithashtu për t'u theksuar është edhe fakti se shoqëria nuk e kontrollon aktivin sepse nuk është pronare e aktivit material të krijuar që në rastin konkret është hidrocentrali, pra nuk plotësohet kushti "*pronësisë/kontrollit mbi aktivin*", që të njihet si aktiv afatgjatë material në bilancin e shoqërisë si dhe nuk është aktivi material afatgjatë, që do t'i gjenerojnë të ardhura por e drejta e tarifimit nga e cila do të gjenerohen edhe të ardhurat e shoqërisë, pra nuk plotësohet që nga përdorimi i aktivit do të gjenerohen të ardhura në të ardhmen. Por për ta përfituar të drejtën e tarifimit duhet të bëjë ndërtimin dhe vënien në punë të hidrocentraleve sipas përcaktimeve të kontratës koncesionare përkatëse. Pra nga sa më sipër arrijmë në konkluzionin se çdo investim dhe shpenzim që subjekti ka kryer për të vendosur në gjendje pune hidrocentralin si përmirësim i tokës + ndërtesa + makineri, me qëllim prodhimin e energjisë elektrike sipas kushteve dhe përcaktimeve të kontratës koncesionare me autoritetin kontraktor duhet të kapitalizoheshin dhe njiheshin në fund tek vlera e aktivit jo-material dhe trajtimi i mëpasshëm i tij të vazhdonte sipas përcaktimeve të standardeve të kontabilitetit. Nga kjo analizë dalim në përfundimin se nëpërmjet kontabilizimit të gabuar të marrëveshjes koncesionare si aktiv afatgjatë material në pasqyrat financiare dhe aplikimit të metodës jo të duhur të amortizimit, shoqëria ka rënduar PASH padrejtësisht me më shumë shpenzime amortizimi, konkretisht 263,602,604 lekë për vitin 2015, 379,247,639 lekë për vitin 2016, 426,650,489 lekë për vitin 2017, 694,402,643 lekë për vitin 2018, 632,152,180 lekë për vitin 2019, se sa përcaktohet nga SNRF dhe SNK, duke kryer në këtë mënyrë uljen e fitimit të tatueshem në mënyrë të padrejtë gjë që ka sjell uljen e detyrimit tatimor për tatim fitimin. Nga grupi i auditimit shpenzimet e amortizimit të njohura jo në përputhje me përcaktimet e SNRF dhe SNK, janë klasifikuar si shpenzime të panjohura sipas përcaktimeve të shkronjës j) shpenzimet të cilat tejkalojnë kufijtë e përcaktuar me ligj apo me akte nënligjore të nenit 21 "Shpenzime të panjohura" të Ligjit Nr.8438, Datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar dhe është kryer penalizimi i subjektit sipas përcaktimeve të nenit 115 "Plotësim i pasaktë i deklaratës tatimore", të Ligjit Nr.9920 datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në R.SH", i ndryshuar, duke sjellë si pasojë efekte tatimore të pallogaritura në shumën 359,408,333 lekë detyrime të tatimit mbi fitimin dhe 64,980,583 lekë gjobë 21.9%, 162,931,777 lekë detyrime të tatimit mbi dividentin dhe 35,682,059 lekë gjobë 21.9%, pra të ardhura gjithsej të munguar për buxhetin e shtetit në vlerën prej 623,002,752 lekë.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 46-352 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**15.1 Rekomandimi:** Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj për tatimpaguesin “A.A.E” SHPK, referuar mangësive dhe parregullsive në procedurën e kontrollit, vlerësuar me efekte negative në të ardhurat tatimore, në përputhje me kërkesat ligjore dhe proceduriale, sipas përcaktimeve të nenit 85 “Ri kontrolli tatimor” të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të kryejë rikontroll tatimor me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit të evidentuara paraprakisht në vlerën prej **623,002,752 lekë.**

**Brenda vitit 2023**

**15.2 Rekomandimi:** DTM në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve në rastet e praktikave të kontroleve të plota ose rimbursimit të TVSH-së, të tatimpaguesve me aktivitet prodhim i energjisë elektrike, të përcaktojë grupe kontrolli me përbërje minimumi dy inspektorë kontrolli tatimor dhe një inxhinier ndërtimi nga DTM dhe të kryejë marrëveshje bashkëpunimi me AKBN-në, me qëllim përfshirjen të një specialisti të AKBN-së, në grup kontrolli, me qëllim vlerësimin e investimit në përputhje me afatet dhe dokumentacionin ligjore për bazueshmërinë e kreditimit dhe ligjshmërinë e TVSH-së rimbursueshme.

**Brenda vitit 2023**

**16. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i raportit të kontrollit tatimor të subjektit “B.M.T” SHPK me NIPT L.G, u konstatua se rezultojnë pasaktësi materiale në llogaritjen dhe qëndrimin e Drejtorisë së Tatimpaguesve të Mëdhenj në lidhje me llogaritjen e kostos e mallrave të shitura KMSH me një diferencë të pajustificuar në shumën 13,214,552 lekë të cilat duhet të ishin llogaritur si detyrime tatimore në lidhje me TVSH dhe Tatim Fitimin pasi janë raportuar shifra më të larta në librat e blerjes, janë kryer si shpenzime por nuk janë raportuar në bilancin material të dorëzuar të vitit 2019 dhe 2020.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 46-352 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**16.1 Rekomandimi:** Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj për tatimpaguesin “B.M.T” SHPK, referuar mangësive dhe parregullsive në procedurën e kontrollit, vlerësuar me efekte negative në të ardhurat tatimore, në përputhje me kërkesat ligjore dhe proceduriale, sipas përcaktimeve të nenit 85 “Ri kontrolli tatimor” të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të kryejë rikontroll tatimor me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit të evidentuara paraprakisht në vlerën prej **13,214,552 lekë.**

**Brenda vitit 2023**

**17. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i raportit të kontrollit tatimor të subjektit “A.C” SHPK Tirane me NIPT K.M, u konstatua se nga ana e inspektoreve të kontrollit nuk është vepruar në përputhje me përcaktimet e dispozitave ligjore pasi rezultojnë pasaktësi materiale në llogaritjen dhe qëndrimin e Drejtorisë së Tatimpaguesve të Mëdhenj në lidhje me llogaritjen e kostos e mallrave të shitura KMSH me një diferencë posteve të pajustificuar në shumën 444,526,273 lekë në ndryshim nga KMSH-ja e deklaruar në shumën 9,565,507,000 lekë dhe KMSH-ja e rrillogaritur në shumën 9,124,980,727 lekë, të cilat duhet të ishin llogaritur si detyrime tatimore në lidhje me TVSH dhe Tatim Fitimin pasi janë raportuar shifra më të larta në librat e blerjes, janë kryer si shpenzime por nuk janë raportuar në bilancin material të dorëzuar të vitit 2021. Rezultojnë më tepër shpenzime të pajustificuara në bilanc dhe duhet të riklasifikohen si shpenzime të panjohura në mungesë të argumenteve ligjore të trajtuar në Raportin Përfundimtar

të Kontrollit dhe të dhënave financiare të deklaruara me një detyrim tatimor dhe gjobë ose penalitet tatimor **në shumën totale 133,357,882 lekë.**

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 46-352 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**17.1 Rekomandimi:** Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj për tatimpaguesin “A.C” SHPK, referuar mangësive dhe parregullsive në procedurën e kontrollit, vlerësuar me efekte negative në të ardhurat tatimore, në përputhje me kërkesat ligjore dhe proceduriale, sipas përcaktimeve të nenit 85 “Ri kontrolli tatimor” të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të kryejë rikontroll tatimor me qëllim analizimin dhe verifikimin e të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit të evidentuara paraprakisht në vlerën prej **133,357,882 lekë.**

**Brenda vitit 2023**

## **C. MASA DISIPLINORE**

Mbështetur në nenin 59, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe VKM-në nr.115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve që në vlerësimin e shkeljeve dhe gjykimin përfundimtar që lidhet me kontabilizimin e detyrimeve tatimore të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, për të gjithë punonjësit e konstatuar me përgjegjësi sipas vlerësimit të problematikave, të urdhëroje dhe të konkludojë me nisjen e procedurave të parashikuara në pikën 1 gërma “b”, “c” të nenit 58 të ligjit nr. 152/2013, për shkeljet e konsideruara nga ana jonë si shkelje të rënda, duke urdhëruar fillimin e procedurave për shqyrtimin dhe dhënien e masave përkatëse, për personat përgjegjës në proporcion të plotë me shkeljet e kryera, vlerat e konstatuara, apo veprimet e kryera në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, sipas nenit 58 gërma “b” dhe “c” të nenit 57 dhe 58 të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013, “Për nëpunësin civil”.

## **D. NJOFTIM I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE**

Për punonjësit për të cilët janë rekomanduar masa disiplinore, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, **të ndërmarrë veprimet si më poshtë:**

**a.** Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

**b.** Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

**Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.**

## **KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**

